

**Fet'hi Hasan Melkavi**


**Zhvillimi i  
mendimit pedagogjik  
bashkëkohor islam**

**Konceptet, burimet, veçoritë dhe  
mënyrat e reformimit**



ZHVILLIMI I MENDIMIT PEDAGOGJIK  
BASHKËKOHOR ISLAM  
konceptet, burimet, veçoritë dhe mënyrat e reformimit

Dr. Fet'hi Hasan Melkavi



© LOGOS·A  
S H K U P  
P R I S H T I N Ë  
T I R A N Ë  
2 0 2 3

**BOTON: LOGOS-A**  
BIBLIOTEKA: MENDIMI ISLAM

Për botuesin: Adnan Ismaili  
Kryeredaktor: Husamedin Abazi  
Redaktor biblioteke: Nexhat Ibrahim

Redaktor gjuhësor: Shkëlzen Halimi  
Redaktor artistik & disenji: Edib Agagjyshi  
Redaktor teknik: Naser Fera  
Mbikëqyrës i shtypit: Kemal Ismaili  
Shtypi: Focus Print  
Rr. Pellagonia 3 - Shkup

Copyright © Logos-A, Center for Advanced Studies and the International Institute of Islamic Thought (IIIT), First Edition 1445AH / 2023CE  
ISBN: 978-608-276-045-2 Paperback

Translated into Albanian from the Arabic Title:  
Al-Fikr al-tarbawī al-islāmī al-mu‘aṣir:  
mafāhīmuḥ, maṣādiruḥ, ḥaṣā’iṣuḥ wa subul iṣlāḥiḥ.  
Fathī Ḥasan Malkāwī

Copyright © The International Institute of Islamic Thought (IIIT), First Edition  
1442AH / 2020CE  
ISBN: 978-1-56564-828-9 Hardback


IIIT  
P.O. Box 669  
Herndon, VA 20172, USA  
www.iiit.org

**www.logos-a.com**  
Copyright©Logos-A, 2023

Tirazhi: 500

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Ky libër mund të kopjohet pjesërisht për përdorim personal dhe jofitimprurës.  
Kjo rekomandohet për qëllime promovuese të librit apo edhe për afirmim të kulturës së leximit në përgjithësi.  
Por, nuk lejohet riprodhimi, transmetimi apo kopjimi i këtij libri në tërësi pa lejen paraprake të Logos-A.



MENDIMI ISLAM

# ZHVILLIMI I MENDIMIT PEDAGOGJIK BASHKËKOHOR ISLAM

KONCEPTET, BURIMET, VEÇORITË  
DHE MËNYRAT E REFORMIMIT

Dr. Fet'hi Hasan Melkavi

PËRKTHEU NGA ARABISHTJA:

Naser Ramadani

TITULLI I ORIGINALIT:

Fatḥi Ḥasan Malkāwī

Al-Fikr al-tarbawī al-islāmī al-mu'āṣir:  
mafāhimuh, maṣādiruh, ḥaṣā'iṣuh wa subul iṣlāḥih.

Herndon, USA, 2020



LOGOS·A

Ky libër u botua me mbështjen e  
Institutit Ndërkombëtar të Mendimit Islam (IIIT)



## PËRMBAJTJA:

Parathënie ..... 18

### **KAPITULLI I PARË KONCEPTI, ZHVILLIMI DHE FILOZOFITË E “MENDIMIT PEDAGOGJIK” DHE POZITA E MENDIMIT PEDAGOGJIK ISLAM.....28**

Parathënie .....30

Pjesa e parë: Koncepti i “mendimit pedagogjik” dhe i koncepteve që ndërlidhen me të .....31

1. Mendimi pedagogjik dhe trashëgimia pedagogjike ....31

1.1. Mendimi pedagogjik ..... 31

1.2. Trashëgimia pedagogjike ..... 35

2. Teoria e pedagogjisë dhe filozofia e pedagogjisë.....37

2.1. Teoria e pedagogjisë ..... 37

2.2. Filozofia e pedagogjisë..... 41

3. Mendimi pedagogjik islam në shkrimet moderne dhe bashkëkohore .....46

3.1. Shkrimet pedagogjike në gjuhën arabe ..... 46

3.2. Shkrimet pedagogjike në gjuhët joarabe ..... 56

4. Pozita e mendimit pedagogjik islam në përpjekjet e ngritjes civilizuese të umetit.....62

5. Sulmi ndaj arsimit islam në fillim të shekullit XXI .....64

Pjesa e dytë: Zhvillimi i mendimit pedagogjik në civilizimet njerëzore dhe shoqërinë bashkëkohore.....67

1. Referenca e hulumtimit në zhvillimin e mendimit pedagogjik .....68

2. Pedagogjia në të kaluarën mes periodizimit historik dhe mendimeve filozofike .....75

2.1. Çështja e periodizimit kohor ..... 75

|   |     |
|---|-----|
| 2.2. Ndikimi i teorisë së evolucionit: .....  | 79  |
| 2.3. Ndikimi i bindjes në ligjin e tri shkallëve në të menduarit njerëzor                 | 82  |
| 3. Pedagogjia në kohën e lashtë .....   | 86  |
| 3.1. Pedagogjia në Egjiptin e lashtë .....  | 86  |
| 3.2. Pedagogjia në Kinën e lashtë: .....  | 87  |
| 3.3. Edukata dhe arsimit në Irakun e lashtë.....  | 90  |
| 3.4. Edukata dhe arsimit në Greqinë antike.....   | 94  |
| 4. Zhvillimi i mendimit pedagogjik fetar të hebrenjtë dhe të krishterët.....              | 99  |
| 5. Mendimi pedagogjik në periudhën e renesancës evropiane dhe filozofitë e saj.....       | 113 |
| 5.1. Dukuria e “zhvillimit në jetën njerëzore” .....                                      | 114 |
| 5.2. Zhvillimi i mendimit pedagogjik në periudhën e Renesancës ..                         | 116 |
| Shembuj nga mendimtarët e renesancës evropiane: .....                                     | 119 |
| 5.3. Shembuj nga shkollat dhe drejtimet filozofike.....                                   | 122 |
| Pjesa e tretë: Filozofitë pedagogjike bashkëkohore dhe referencat e tyre perëndimore..... | 131 |
| 1. Disa shembuj rreth filozofive pedagogjike bashkëkohore .....                           | 131 |
| 1.1. Filozofia e arsimit global: .....  | 134 |
| 1.2. Internacionalizimi i arsimit: .....  | 135 |
| 1.3. Arsimit në periudhën e postmodernitetit .....  | 136 |
| 1.4. Arsimit në periudhën e Digimodernizmit .....   | 137 |
| 1.5. Filozofia e arsimit për paqe .....   | 138 |
| 1.6. Arsimit inter-religjioz .....  | 139 |
| 2. Referencat perëndimore të pedagogjisë .....  | 140 |
| 2.1. Dukuria e “paragjykitimit ideologjik perëndimor” .....                               | 140 |
| 2.2. Dukuria e “pasigurisë pedagogjike”: .....  | 143 |
| Përmbyllje .....  | 149 |

## **KAPITULLI I DYTË TRASHËGIMIA PEDAGOGJIKE ISLAME ..... 153**

|  |     |
|--|-----|
| Parathënie .....   | 155 |
| Pjesa e parë: Koncepti “Et-turath – trashëgimi”, zhvillimi, tematikat dhe institucionet e saj..... | 158 |
| 1. Koncepti “trashëgimia pedagogjike” .....  | 158 |

|   |     |
|---|-----|
| 2. Polemikata e vjetra dhe të reja rreth trashëgimisë pedagogjike islame .....                    | 164 |
| Pjesa e dytë: Disa të dhëna rreth zhvillimit të trashëgimisë pedagogjike islame .....             | 173 |
| 1. Zhvillimi në shkencën e tefsirit .....   | 176 |
| 2. Zhvillim në përgjegjësitë arsimore.....  | 178 |
| 3. Zhvillim në pozitën e mësuesit dhe profesionin e mësimdhënies.....                             | 181 |
| 4. Zhvillim në raportin e dijetarëve me pushtetarët .....   | 183 |
| 5. Zhvillimi në marrjen e pagës për mësimdhënie .....   | 187 |
| 6. Zhvillimi në institucionet arsimore.....   | 191 |
| 7. Zhvillimi në orientimet dhe shkollat ideologjike në trashëgiminë e pedagogjisë islame.....     | 197 |
| Pjesa e tretë: Mendimtarët pedagogë të trashëgimisë pedagogjike, veprat dhe shkollat e tyre ..... | 206 |
| 1. Mendimtarët pedagogë dhe veprat e tyre .....   | 206 |
| 2. Shkollat e trashëgimisë pedagogjike.....   | 212 |
| Pjesa e katërt: Literatura e trashëgimisë pedagogjike islame në shkrimet bashkëkohore .....       | 227 |
| 1. Përpyqjet e përbashkëta hulumtuese .....   | 228 |
| 2. Institucionet dhe praktikata pedagogjike: .....  | 230 |
| 3. Disertacionet pedagogjike universitare.....  | 232 |
| 4. Trashëgimia pedagogjike në revistat periodike .....  | 234 |
| 5. Trashëgimia pedagogjike islame në librat e publikuara .....                                    | 234 |
| Përmbyllje:.....  | 237 |

## **KAPITULLI I TRETË BURIMET E MENDIMIT PEDAGOGJIK BASHKËKOHOR ISLAM .....**

|  |     |
|--|-----|
| Parathënie .....   | 244 |
| Pjesa e parë: Kur'ani Famëllartë burim i mendimit pedagogjik.....      | 249 |
| 1. Dituria, mësimnxënia dhe mësimdhënia në Kur'anin Famëllartë: .....  | 253 |
| 1.1. Kujdesi i Kur'anit për diturinë, proceset dhe mjetet e tij: ..... | 253 |
| 1.2. Gjerësia e tematikave të diturisë në Kur'anin Famëllartë .....    | 255 |
| 1.3. Faktorët e procesit pedagogjik në Kur'anin Famëllartë .....       | 255 |



|  |     |
|--|-----|
| 1.4. Llojet e diturive (shkencave) në Kur'anin Famëlartë .....   | 260 |
| 1.5. Burimi i parë për mësimdhënie dhe mësimnxënie .....   | 263 |
| 1.6. Përgjegjësia e mësimnxënies dhe mësimdhënies .....  | 265 |
| 1.7. Kur'ani Famëlartë objekt mësimi .....   | 268 |
| 1.8. Kriteret dhe rregullat e diturisë në Kur'anin Famëlartë .....   | 271 |
| 1.9. Prioritetet e edukatës dhe arsimit në Kur'anin Famëlartë .....  | 274 |
| 2. Tematikat e arsimit në Kur'anin Famëlartë: .....  | 276 |
| 2.1. Mësimi i vizionit të përgjithshëm dhe detajimeve të pjesshme  | 276 |
| 2.2. Mësimi i të menduarit për një jetë më të mirë: .....  | 277 |
| 2.3. Kërkim për shtimin e diturisë .....   | 278 |
| 2.4. Mësimi i metodave mësimore .....  | 278 |
| 2.5. Mësimi i rregullave shoqërore .....   | 279 |
| 2.6. Mësimi i vlerave familjare në pedagogjinë kur'anore: .....  | 280 |
| 2.7. Mësimi i edukatës intelektuale: .....   | 282 |
| 2.8. Mësimi i shkencave shoqërore dhe psikologjike: .....  | 284 |
| 2.9. Mësim për përdorimin e njohurive shkencore: .....   | 287 |
| Pjesa e dytë: Suneti pejgamberik, burim i mendimit pedagogjik .....  | 290 |
| 1. Prezenca e sunetit në çështjet pedagogjike në trashëgimi dhe shkrimet bashkëkohore: .....                 | 291 |
| 2. Argumentimi i sunetit pejgamberik në edukatë dhe arsim .....  | 293 |
| 3. Suneti pejgamberik rreth shkencave që obligativisht duhet mësuar ose duhet mësuar të tjerëve .....        | 300 |
| 4. Mësimnxënia në sunetin pejgamberik .....  | 303 |
| 5. Mësimdhënia në sunetin pejgamberik .....  | 306 |
| Pjesa e tretë: Trashëgimia pedagogjike islame, burim i mendimit pedagogjik islam .....                       | 311 |
| 1. Trashëgimia si burim dhe argumentim .....   | 312 |
| 2. Çështja e anashkalimit të trashëgimisë dhe marrja drejtpërdrejtë nga Kur'ani dhe suneti pejgamberik ..... | 313 |
| 3. Vlera e trashëgimisë pedagogjike islame si burim: ...   | 318 |
| 4. Shembuj për përdorimin e trashëgimisë në çështje pedagogjike bashkëkohore .....                           | 322 |
| 4.1. Obligueshmëria e arsimit .....  | 322 |
| 4.2. Pozita e mësuesit .....   | 324 |

|   |     |
|---|-----|
| Pjesa e katërt: Përvoja pedagogjike bashkëkohore si burim i mendimit pedagogjik bashkëkohor islam ..... | 330 |
| 1. Ç'nënkuptojmë me përvojë bashkëkohore pedagogjike?.....  | 331 |
| 2. Mendimi pedagogjik dhe gjendja civilizuese e shoqërisë .....   | 333 |
| 3. Njeriu si qëllim dhe mjet i pedagogjisë .....  | 334 |
| 4. Bashkëveprimi me përvojën njerëzore bashkëkohore është pikënisja për veprim: .....                   | 338 |
| 5. Referenca e përvojës bashkëkohore dhe obligimi i kohës:.....   | 341 |
| Përmbyllje:.....  | 345 |

## **KAPITULLI I KATËRT INTENCAT E MENDIMIT PEDAGOGJIK ISLAM ..350**

|   |     |
|---|-----|
| Hyrje .....   | 352 |
| Pjesa e parë: Koncepti "intencat edukative" dhe lidhja e tyre me objektivat pedagogjike ..... | 355 |
| Pjesa e dytë: Rereferimi i intencave dhe i objektivave pedagogjike.....                       | 361 |
| Pjesa e tretë: Klasifikimi i intencave pedagogjike.....                                       | 370 |
| 1. Intencat edukative për këtë botë dhe për Botën Tjetër .....                                | 372 |
| 2. Intencat edukative synuese dhe intencat pedagogjike instrumentale.....                     | 376 |
| 3. Klasifikimi i intencave edukative sipas tematikave shkencore .....                         | 384 |
| 4. Klasifikimi i objektivave edukative sipas institucioneve edukative në shoqëri .....        | 386 |
| 5. Intencat edukative sipas llojit të arsimit.....  | 389 |
| Pjesa e katërt: intencat elitare kur'anore dhe manifestimet e tyre edukative .....            | 393 |
| 1. Intenca edukative të tevhidit (njëshmërisë).....   | 395 |
| 2. Intencat edukative të tezkijes (pastrimit shpirtëror) .                                    | 402 |
| 3. Intencat edukative të ndërtimit të jetës (në këtë botë) .....                              | 408 |
| Pjesa e pestë: Aktivizimi dhe përforcimi i intencave edukative .....                          | 418 |
| 1. Aktivizimi dhe funksionalizimi .....   | 418 |
| 2. Aktivizimi i intencave kërkon fekih intencalist .....                                      | 423 |

|  |     |
|--|-----|
| 3. Idetë mes efikasitetit dhe aktivizimit.....                                 | 425 |
| 4. Realiteti i trajtimit intencionalist të veprimtarisë<br>edukative .....     | 428 |
| 5. Vlerësimi i intencave pedagogjike .....                                     | 430 |
| 5.1. Saktësia dhe efikasiteti i ideve .....                                    | 431 |
| 5.2. Përmirësimi edukativ i situatës rrjedhëse .....                           | 434 |
| 5.3. Sistemi i kualitetit në arsim.....  | 436 |
| 5.4. Konceptet islame që karakterizojnë rregullimin apo<br>perfeksionimin..... | 437 |
| Përfundimi.....  | 440 |

## **KAPITULLI I PESTË: TEMATIKAT E MENDIMIT BASHKËKOHOR PEDAGOGJIK..... 443**

|  |     |
|--|-----|
| Hyrje .....  | 445 |
| Pjesa e parë: Dialogu rreth mendimit dhe dijes në tematikat pedagogjike<br>.....   | 448 |
| Pjesa e dytë: Harta e tematikave të përmbajtjes pedagogjike.....                   | 454 |
| 1. Temat e ndërtimit të umetit .....   | 454 |
| 2. Temat e problematikave të ngritura dhe të atyre që<br>duhet ngritur .....       | 456 |
| 3. Tematikat e përgatitjes ideologjike të vështrimit të<br>përgjithshëm.....       | 457 |
| 4. Shkencat metodologjike.....   | 462 |
| 4.1. Shkencat metodologjike të veçanta .....                                       | 462 |
| 4.2. Elementi metodologjik në çdo shkencë.....                                     | 464 |
| Pjesa e tretë: Disiplinat dhe tematikat e pedagogjisë në vështrimin islam<br>..... | 470 |
| 1. Qëllimi me disiplinën shkencore (degëzimin) .....                               | 470 |
| 2. Themelimi i disiplinave të pedagogjisë.....                                     | 472 |
| 3. Teoria pedagogjike dhe filozofia pedagogjike .....                              | 477 |
| 4. Vendi i Islamit në disiplinave pedagogjike .....                                | 480 |
| Pjesa e katërt: Vlerat në disiplinat pedagogjike .....                             | 484 |
| 1. Kujdesi i domosdoshëm për pozitën e vlerave në<br>disiplinat pedagogjike.....   | 484 |
| 2. Premisat e përkushtimit ndaj vlerave në disiplinat<br>pedagogjike .....         | 488 |

|  |     |
|--|-----|
| 3. Mësimi i vlerave në universitete .....      | 492 |
| 4. Edukimi sipas vlerave (të virtytshme) ..... | 498 |
| Përfundim .....                                | 506 |

## **KAPITULLI I GJASHTË: VEÇORITË E MENDIMIT PEDAGOGJIK ISLAM 510**

|  |     |
|--|-----|
| Hyrje .....  | 511 |
| Pjesa e parë: Veçoria e integritit dhe ekuilibrit në mendimin pedagogjik islam .....                 | 514 |
| 1. Natyra e kujdesit për personalitetin e njeriut .....  | 514 |
| 2. Veçoria e veprimit integrues dhe të ekuilibruar në ndërtimin e elementëve të personalitetit ..... | 520 |
| 2.1. Elementi fizik i personalitetit .....   | 522 |
| 2.2. Elementi logjik i personalitetit .....  | 527 |
| 2.3. Elementi shpirtëror-psikik i personalitetit .....   | 532 |
| 3. Integrimi dhe ekuilibri në ndjekje dhe në kreativitet .....                                       | 548 |
| Pjesa e dytë: Veçoria e realizmit në mendimin pedagogjik islam .....                                 | 565 |
| 1. Realizmi dhe idealizmi .....  | 566 |
| 2. Disa reflektime të manifestime në mendimin pedagogjik islam .....                                 | 570 |
| 3. Realizmi në ndërtimin e një mendimi pedagogjik islam-bashkëkohor .....                            | 574 |
| Pjesa e tretë: Kapaciteti dhe shtrirjet e mendimit pedagogjik islam .....                            | 579 |
| 1. Shtrirjet e mendimit pedagogjik islam në tematika: kapacitet dhe integrim .....                   | 579 |
| 2. Shtrirja e mendimit pedagogjik islam në kohë .....  | 583 |
| 3. Shtrirja e mendimit pedagogjik islam në hapësirë ....   | 590 |
| 4. Shtrirja e mendimit pedagogjik islam te çdo njeri ....  | 592 |
| Pjesa e katërt: Manifestimet e integritit dhe të ekuilibrit në mendimin pedagogjik islam .....       | 596 |
| Përfundimi .....   | 606 |

## **KAPITULLI I SHTATË REALITETI I MENDIMIT PEDAGOGJIK ISLAM DHE MËNYRAT E REFORMIMIT ..... 612**

|                  |     |
|------------------|-----|
| Parathënie ..... | 614 |
|------------------|-----|

|   |     |
|---|-----|
| Pjesa e parë: Përshkrim i përgjithshëm i realitetit të mendimit pedagogjik islam dhe konteksti i tij historik dhe bashkëkohor ..... | 619 |
| 1. Plan-programet arsimore universitare .....   | 619 |
| 2. Hulumtimet dhe institucionet hulumtuese .....  | 621 |
| 3. Orientime politike dhe ekonomike .....   | 625 |
| 4. Konteksti historik i realitetit të mendimit pedagogjik islam.....  | 627 |
| 5. Kriza e arsimit është krizë globale .....  | 637 |
| Pjesa e dytë: Referenca (El merxheijeh) e mendimit pedagogjik bashkëkohor .....   | 647 |
| 1. Koncepti “referencë -el-merxheijeh”, llojet dhe nivelet .....  | 649 |
| 2. Karakteristika të përgjithshme të referencës së mendimit pedagogjik perëndimor .....   | 655 |
| 3. Filozofitë në referencën e mendimit perëndimor .....   | 663 |
| 3.1 Laicizmi (shekullarizimi) në referencën e mendimit perëndimor:.....   | 663 |
| 3.2. Globalizmi dhe internacionalizmi.....  | 667 |
| 3.3. Modernizmi dhe postmodernizmi .....  | 672 |
| 3.4. Filozofia humaniste dhe filozofia materialiste .....   | 675 |
| 3.5 Strukturalizmi dhe dekonstrukturalizmi .....  | 678 |
| Pjesa e tretë: Vetëdijësimi për çështjen e reformave pedagogjike dhe përgjegjësitë e qarqeve pedagogjike .....                      | 689 |
| 1. Prania e vizionit islam në reformat pedagogjike .....  | 689 |
| 2. Pasqyra e realitetit dhe ndryshimi i synuar.....   | 695 |
| 3. Formimi i vetëdijes me realitetin e mendimit pedagogjik bashkëkohor dhe pikënisjet e reformave.....                              | 701 |
| 3.1. Vetëdija ndaj realitetit pedagogjik, koncepti dhe rëndësia e saj:.....   | 701 |
| 3.2. Vetëdija rreth domosdoshmërisë së reformimit të realitetit pedagogjik.....   | 704 |
| 3.3. Vetëdija ndaj pikënisjeve të reformimit pedagogjik.....  | 707 |
| 4. Qarqet pedagogjike dhe rëndësia e tyre në përpjekjet e reformimit pedagogjik .....   | 711 |
| 4.1. Rëndësia e familjes në reformimin e arsimit: .....   | 712 |
| 4.2. Rëndësia e arsimit publik në reformimin pedagogjik: .....  | 717 |
| 4.3. Reformat pedagogjike dhe arsimit i lartë .....   | 723 |
| 4.4. Rëndësia e mjeteve të informimit në reformat pedagogjike ....  | 729 |
| Përmbyllje .....  | 733 |

|                                   |     |
|-----------------------------------|-----|
| Përfundimi.....                   | 736 |
| Burimet dhe literatura .....      | 746 |
| Në gjuhën arabe: .....            | 746 |
| Literatura në gjuhë joarabe ..... | 764 |
| Webfaqet elektronike .....        | 771 |

# Reflektime rreth autorit dhe veprës

## I. Intelektual i përmasave botërore

Dr. Fet'hi Hasan Melkavi (1943, Jordani) është një dijetar, pedagog, psikolog, filozof, etik, teolog i rrallë në botën bashkëkohore muslimane dhe në përgjithësi. I kreu të gjitha nivelet e shkollimit zyrtar në vend dhe jashtë. Veproi në vende të ndryshme duke lënë gjurmë të dukshme në kohën e tij dhe për brezat e ardhshëm. Ai punoi në arsimin publik si mësues, mbikëqyrës arsimor dhe pjesëmarrës në hartimin e kurrikulave dhe hartimin e teksteve shkollore, nga viti 1966-1978. Më pas punoi në arsimin universitar nga viti 1984-1996 dhe si profesor vizitor në më shumë se 20 vende në Azi, Afrikë, Evropë dhe Amerikë. Mori pjesë në më shumë se gjashtëdhjetë konferenca me kumtesa dhe kërkime shkencore në shumë vende. Kohët e fundit punoi si drejtor rajonal për Institutin Ndërkombëtar të Mendimit Islam, kryeredaktor i Gazetës Islamike të Dijes (*El-Ma'rifeh*) dhe anëtar i Akademisë Jordaniane të Gjuhës Arabe. Jordanez nga lindja, botëror nga dija dhe intelektualiteti.

Dr. Fet'hi Hasan Melkavi është autor dhe bashkëautor i mbi 40 librave mbi arsimin shkollor dhe universitar me tema shkencore dhe metoda kërkimore, në specialitetin e mësimdhënies së shkencës, metodave të kërkimit shkencor dhe çështjeve të mendimit islam.

## II. Njeriu, qenie e dalluar

Nëse mendimi, përsiatja, soditja, vetëdija, llogaridhënia është një karakteristikë e njeriut që e dallon atë nga të gjitha krijesat e tjera, atëherë është e qartë që mendimi njerëzor të fillojë me njeriun që nga momenti i ardhjes së tij në ekzistencë. Botëkuptimi islam është vendimtar në shprehjen e kësaj. Zoti i Plotfuqishëm ia mësoi Ademit emrat dhe i kërkoi

Ademit që t'ua tregonte engjëjve këta emra (këtë dije)! Ka një proces mësimdhënieje dhe mësimnxënieje, dhe kjo bëhet vetëm me vetëdije, me mësim dhe me të kuptuar, me përsiatje.

Pasoi edhe reprodukimi i njerëzve dhe ekzistimi i fëmijëve, të cilët sipas natyrës së tyre, kanë nevojë për edukim, arsimim, aftësim dhe zhvillim të aftësive intelektuale. Roli i prindërve në procesin e: arsimimit, edukimit, zhvillimit të vetëdijes dhe aftësimit për jetë është i pazëvendësueshëm.

Hiri i Zotit për fëmijët nëpërmjet edukimit nuk humbet kur prindërit mungojnë dhe lindin situata dhe rrethana të reja, ndaj Zoti iu dërgon atyre një model praktik që i mëson se si të veprojnë në këto situata. Situata arsimore bëhet një përvojë e re dhe ndoshta bazë për legjislacionin që rregullon çështjet e jetës.

Mendimi njerëzor ka qenë i lidhur me arsimin dhe shkencën. Njeriu ishte i pajisur me aftësinë për të mësuar gjëra të reja nga ajo që e udhëzoi Zoti për t'u përballur me zhvillimet e jetës. Njeriu është një civil, natyrisht, dhe që në fillimet e tij, ai jeton në një shoqëri në të cilën kërkesat e jetës janë të integruara për të gjithë përmes specializimit në zëjet e: bujqësisë, blegtorisë, gjuetisë, përgatitjes së strehimit, prodhimit të armëve e të tjera, dhe e gjithë kjo kërkon mësim dhe mësimdhënie, edukim dhe trajnim. Zoti i madhëruar nuk e bëri njeriun statik, por i dha lirinë relative dhe mundësinë e fitimit dhe shpenzimit, të vepruarit mirë dhe keq, mirëpo, duke i vënë "shenja" (*ajete*) në të, pranë tij, në tokë, ujë e ajër, në kozmos e kudo, që të përsiasë, reflektojë dhe jetojë në pajtim me rregullat e përgjithshme (*sunnetullah*).

### III. Mendimi pedagogjik bashkëkohor islam

Pjesa më e madhe e asaj që është shkruar për mendimin edukativ islam, edukimin islam, Islamin dhe edukimin, apo ndonjë shtesë në këto tituj, kryesisht kufizohet në dy gjëra:

- Njëra janë udhëzimet edukative në Kur'anin Fisnik dhe Sunnetin e të Dërguarit, dhe



- E dyta është trashëgimia arsimore islame, dhe janë dy burime të mëdha që nuk mund të nënvlerësohen, por pak nga këto shkrime trajtojnë praninë e këtyre direktivave, apo vlerën e vërtetë të asaj trashëgimie në mendimin edukativ dhe praktikat edukative në realitet.

Shumica e mendimit arsimor mbizotërues dhe praktikave arsimore edukative bashkëkohore në shoqëritë arabe dhe muslimane janë jehonë e pastër e përvojës arsimore që lindi dhe u zhvillua, dhe është ende në zhvillim, larg pranisë së vizionit islam. Kjo kërkon realizimin e këtij vizioni në analizën kritike të këtyre përvojave dhe dallimin e asaj që është e përshtatshme për shoqëritë islame dhe që kontribuon në pa-surimin dhe racionalizimin e qytetërimit bashkëkohor.

Ky është realiteti në të cilin ky libër është përpjekur të kontribuojë për të trajtuar, duke adoptuar metodologjinë e integritit kognitiv në ndërtimin e një platforme të mendimit arsimor edukativ bashkëkohor islam, në: konceptet, burimet, karakteristikat, temat, problemet dhe mënyrat e reformimit të tij.

#### IV. E ardhmja ...

Tema e shtruar është e pafund. Një vepër e përkthyer apo e shkruar nuk mbulon nevojat e njerëzve dhe të kohës. As vepra që kemi para nuk ka pretendime të tilla. Por, autori i saj (natyrisht edhe përkthyesi) pretendon që t'i shtyjë para proceset, sado të vogla qofshin. Njëkohësisht, autori pretendon t'i lidhë fijet e shkëputura gjatë historisë për të ndërtuar një të ardhme solide. Në tërë këtë, autori nuk e mohon pjesën tjetër të botës, përvojat dhe arritjet e tyre, duke i analizuar, vlerësuar dhe përdorur ato që mund të jenë të nevojshme për brezat e rinj muslimanë.

Përkthyesi ka bërë një punë të madhe për nxënësit, studentët dhe profesionistët (imamët e profesorët teologë) në përgjithësi. Një materie të rëndë me sukses ka arritur ta afrojë në gjuhën shqipe dhe të vendos disa baza për të ardhmen.

Për çdo lëvdatë është botuesi me përzgjedhjen e autorëve dhe tematikës për ta pasuruar mozaikun ende të varfër të dijes islame në shqip. Mendoj se i gjithë vargu botues i Logos-A ka kontribuar sadopak që para vetes të kemi një vepër të vyeshme për studimet e islamologjisë, e sidomos të pedagogjisë islame.

*N. Ibrahimi*

*02.09.2023*

*Prizren*

# Parathënie

Ideja për përpilimin e këtij libri rreth “mendimit pedagogjik islam” ka lindur qysh herët nga përvoja e autorit në mësimdhënie universitare në programet mësimore të magjistraturës dhe doktoraturës; ngase kërkohet prej tij të ligjërojë lëndë me këtë titull. Ai përshkrimin e kësaj lënde, burimet dhe gjitha leximet e propozuara i ka gjetur të kufizuara në historinë e këtij mendimi, i cili tani më është trashëgimi. Krahas rëndësisë që ka shkrimi rreth “trashëgimisë pedagogjike islame”, i cili vlen të jetë lëndë e veçantë, ne shpresonim të gjejmë diç që vlen të jetë detajim rreth “mendimit pedagogjik bashkëkohor islam”, ose të flet rreth realitetit të këtij mendimi në shoqëritë islame dhe përpjekja e nevojshme për formimin e ardhmërisë së këtyre shoqërive. Kjo është problematika, të cilën përpiqet ta trajtojë ky libër.

Kur filluam të planifikojmë përpilimin e këtij libri, kemi konsultuar një numër të madh të shkrimeve që kishim në disponim në dy gjuhë: arabe dhe angleze. Gjatë shfletimit të tyre kemi vërejtur fjalë të mira rreth pedagogjisë në Kur’an dhe sunetin e Muhammedit alejh’is-selam. Shumica e tyre sillshin rreth vlerës së diturisë dhe dijetarëve, nxitjes për mësimnxënie dhe mësimdhënie, mirëpo pjesa më e madhe e materialit përfshinte bisedë rreth arsimimit, siç kanë shkruar dijetarët muslimanë, ose siç ka shkruar ndonjëri prej tyre, ose e kanë praktikuar shkollat juridike dhe akaidore islame, ose çka kishte prej institucioneve arsimore në ndonjërin nga periudhat e historisë islame, ose në ndonjë vend të botës islame në të kaluarën etj. Për gjithë këtë, vendosëm që libri të përfshijë një kapitull të gjerë rreth trashëgimisë pedagogjike islame që do të sqarojë diç nga kjo përkujdesje marramendëse ndaj kësaj trashëgimie.

Zgjedhëm të fillojmë të shkruajmë rreth kapitullit të veçantë për trashëgiminë, me qëllim që trashëgimia të jetë në konsideratë kur të shkruajmë për kapitujt e tjerë. Kemi bërë

përpjekje të përfshijmë çka është e mundur nga shkrimet rreth temave të trashëgimisë. Puna në këtë drejtim ka zgjatur dy vite. Kështu, materiali i kapitullit u shndërrua në enciklopedi i përfshirë në tri libra, ku totali i faqeve ishte 1648 faqe. Në vitin 2018 ky material u botua me titujt e mëposhtëm:

Trashëgimia pedagogjike islame: gjendja e hulumtimit, vështrime nga zhvillimi dhe përzgjedhje nga tekstet dhe shkollat e tij;

Tekste nga trashëgimia pedagogjike islame

Projekte hulumtuuese në trashëgiminë pedagogjike islame.

Kemi qenë të kujdesshëm që në këto libra të ofrojmë material metodologjik në mendimin pedagogjik islam në kontekstin e tij historik, ku do të përfshihet dimensionin përshkrues i këtij mendimi i cili ka dominuar në periudha të historisë islame dhe i njëjti është bërë trashëgimi. Kjo trashëgimi kishte dhe vazhdon të ketë pozitën, referencat dhe problemet e tij. Krahas dimensionit përshkrues, kemi qenë të kujdesshëm që biseda rreth trashëgimisë të përfshijë edhe dimensionin analitik-kritik përbrenda intencave të cilat i synon Islami, siç i kuptojmë tekstet kur'anore dhe ato pejgamberike sot.

Kemi bërë përpjekje që ky libër të përfshijë çdo gjë që mund të jetë mendim pedagogjik në shoqëritë bashkëkohore islame ashtu siç është në gjendjen e tij reale dhe siç duhet të orientohen përpjekjet e reformimit. Kështu tematika e këtij libri përfshin konceptin e "mendimit pedagogjik islam, zhvillimin dhe rëndësinë e tij në jetën tonë, në aspektin historik, në të tashmen dhe të ardhmen. Krahas kësaj, libri përfshin njoftim të shkurtër rreth burimeve, intencave, përmbajtjeve dhe veçorive të këtij mendimi. Ai nxjerr në pah edhe përpjekjet e nevojshme për formimin e mendimit pedagogjik bashkëkohor islam që do të jetë një kontribut islam i dobishëm në zhvillimin e përvojës njerëzore, duke treguar fuqinë e mendjes së muslimanit për të vazhduar të japë kontributin e tij mendor dhe civilizues.

Edhe pse libri në përfshirjen e tematikave merr kahe akademike, gjendja faktike e muslimanëve bashkëkohorë do të jetë në thelb të interesimeve, me qëllim të përcaktimit të

formave të ngritjes së kësaj gjendje faktike drejt formimit të identitetit civilizues dhe të dalluar për individin, shoqërinë dhe umetin, si dhe për të ofruar një model ku përmes tij Islami do të kontribuojë në vetëdijesimin e civilizimit bashkëkohor njerëzor. Sa i përket kahes akademike, ai dallon nga ajo që është e njohur sa i përket formaliteteve që kërkohen në temat universitare dhe hulumtimet e periodikëve shkencorë, të cilat kërkojnë që me nëntituj të shfaqet problematika e hulumtimit, hipotezat, përkufizimi e termave, rëndësia, metodat, studimet e mëparshme e tjera, ngase këto elemente i gjejmë të shpërndara aty ku e kërkon nevoja në brendinë e librit. Ndonjëherë, nevoja e kërkonte t'i referohemi faqeve elektronike në internet, të cilat i kemi konsultuar në kohë të ndryshme gjatë dy viteve të përpilimit të këtij libri, por duhet nënvizuar se edhe një herë jemi siguruar në linqet e këtyre faqeve gjatë kontrollimit të fundit të librit gjatë periudhës 4-8 Dhjetor 2019, me qëllim që mos të shkruajmë kohën e shfrytëzimit të këtyre faqeve në fusnota veçmas.

Libri përfshin shtatë kapituj. Kapitulli i parë flet rreth “mendimit pedagogjik si koncept dhe si term” dhe lidhshmërinë e tij me konceptet, shprehjet dhe termet që kanë lidhshmëri të drejtpërdrejtë me te, si dhe shprehjet dhe fjalët që i shtohen dhe i bashkëngjiten siç janë: trashëgimia pedagogjike, filozofia pedagogjike, teoria pedagogjike, parimet e pedagogjisë, pedagogjia islame etj. Jemi përpjekur që kapitulli të përfshijë zhvillimin e përvojës njerëzore në sferën e pedagogjisë dhe mendimit pedagogjik nga kohët më të lashta në vende të ndryshme të botës, duke kaluar në mesjetë, i cili përfshin zhvillimin e përvojës islame dhe gjendja e Evropës asokohe dhe në fund, periudha e ashtuquajtur periudha e iluminizmit, modernizmit dhe post modernizmit.

Kapitulli i dytë përfshin në mënyrë të shkurtër “trashëgiminë pedagogjike islame” që gjendet në tri librat e lartcituara. Këtu përfshihet koncepti i “trashëgimisë”, polemikat në të kaluarën dhe tash rreth saj, duke dhënë sinjal rreth disa shenjave të zhvillimit në trashëgiminë pedagogjike. Këtu në

mënyrë të shkurtër përfshihen pedagogët më të njohur, librat, shkollat dhe kahet bashkëkohore.

Kapitulli i tretë ka përfshirë “burimet e mendimit pedagogjik islam” në kontekstin bashkëkohor, duke këmbëngulur si në të gjitha shkrimet tona rreth domosdoshmërisë së përplotësimit në katër burimet islame. Shpallja hyjnore në Kur’an është burimi, referenca dhe gjykues i mendimit tonë islam në të gjitha sferat. Udhëzimet pejgamberike në sunet dhe sure janë zbritje të dispozitave dhe orientimeve kur’anore në kohë, vend dhe gjendje në periudhën e shpalljes. Këto dy burime mbeten referencë e përhershme për gjykim ndaj çdo burimi tjetër. Burimi i tretë është trashëgimia pedagogjike islame, e cila në secilën periudhë ka përfaqësuar të kuptuarit dhe praktikat e muslimanëve ndaj shpalljes hyjnore dhe udhëzimeve pejgamberike. Burimi i katërt është përvoja pedagogjike njerëzore bashkëkohore në të cilin jemi duke jetuar. Andaj nuk kemi rrugëdalje, pos të fillojmë nga gjendja jonë faktike dhe gjendja reale e botës, për ta kuptuar atë dhe për të bërë përpjekje për përmirësim, zhvillim dhe rindërtim.

Kapitulli i katërt, në mënyrë të detajuar përfshin “intencat pedagogjike” dhe lidhshmërinë e tyre me qëllimet, vlerat dhe referencat kur’anore, duke sqaruar intencat e larta kur’anore dhe shfaqjet pedagogjike. Këtu përfshihet kalimi nga biseda rreth intencave në tekste dhe kuptimet e tyre në aktivizimin e tyre në punën bashkëkohore pedagogjike. Kapitulli përmbyllet duke dhënë shenjë rreth vlerësimit të intencave dhe qëllimeve pedagogjike.

Kapitulli i pestë përfshin “përmbajtjet e mendimit pedagogjik”. Në fillim bisedohet rreth dialogut mes mendimit dhe diturisë në përmbajtjet pedagogjike. Më pas prezantimi i temave të përmbajtjeve pedagogjike në formë të një harte, duke u përqendruar në atë që e kemi quajtur shkencat metodologjike. Më pas janë përfshirë disa degë shkencore të pedagogjisë, në veçanti teoria pedagogjike dhe filozofia pedagogjike, si dhe pozicioni i Islamit në shkencat pedagogjike, kapitulli është përmbyllur me kornizën vlerësuese ndaj shkencave pedagogjike dhe domosdoshmëria e pedagogjisë ndaj vlerave.

Kapitulli i gjashtë ka përfshirë “veçoritë e mendimit pedagogjik islam”, duke marrë një kahe ndryshe nga ajo kur flitet për veçoritë. Këtu janë zgjedhur tri veçori të mendimit pedagogjik islam. E para: plotësimi dhe baraspesha në formimin e personalitetit të muslimanit, siç shfaqen në pasim dhe kreativitet. E dyta: realiteti dhe shfaqjet e tij, si dhe domosdoshmëria e rrënjëzimit në mendimin pedagogjik bashkëkohor. E treta: kapaciteti dhe shtrirja në kohë, vend dhe te njeriu.

Libri është përmbyllur me kapitullin e shtatë, i cili përfshin “realitetin e mendimit pedagogjik islam dhe mënyrat e reformimit”. Kapitulli fillon me një përshkrim të përgjithshëm rreth gjendjes së mendimit pedagogjik islam në zhvillimin e tij historik dhe realitetit të tij bashkëkohor, siç shihet në programet e arsimit universitar dhe atë që e zbulojnë studimet dhe hulumtimet e botuara. Këtu tërhiqet vëmendja se problemi esencial i mendimit pedagogjik dominues në shoqëritë islame është sepse ai në përgjithësi është mendim i importuar, edhe pse bota flet për një krizë botërore në arsim si rezultat i referencave filozofike kontradiktore, gjë e cila flet për përgjegjësinë e madhe që është mbi supet e udhëheqësve të mendimit pedagogjik bashkëkohor islam. Kapitulli përmbillet duke folur për domosdoshmërinë e formimit të një vetëdijeje rreth çështjes së reformave pedagogjike dhe përgjegjësitë e të interesuarve për çështjet pedagogjike në këtë formim.

Përkujtojmë se ky libër rreth mendimit pedagogjik bashkëkohor islam dhe librat e ngjashëm me te në mendimin ekonomik, mendimin politik, mendimin administrativ e tjera, vlera e tyre do të mbetet e kufizuar, përderisa me anë të reformimit të përgjithshëm të gjendjes së shoqërive islame nuk kuptojnë rrezikun e mbetjes në gjendjen e pasuesit në realitetin e botës bashkëkohore dhe vështirësitë me të cilat përballen gjatë përpjekjeve për formimin e civilizimit islam. E gjithë kjo duhet filluar nga zhvillimi i mendimit pedagogjik bashkëkohor islam, duke e vënë atë në pozitën e sfidës për të ofruar alternativat e synuara, jo vetëm në nivel të shoqërive islame, por

në nivel botëror, për të treguar efikasitetin e mendimit islam dhe fuqinë e mendjes së muslimanit, i udhëzuar me vlerat e shpalljes hyjnore dhe udhëzimeve peygamberike, për reformimin dhe udhëzimin e civilizimit njerëzor.

Është patjetër të jemi të vetëdijshëm se biseda sot rreth mendimit pedagogjik islam në nivel administrativ, politik dhe ligjor është në kohë kur shoqëritë islame janë të përm-bushura me ligje dhe legjislacione pedagogjike, referencë e të cilave janë filozofitë dhe sistemet ndërkombëtare, të cilat i imponojnë organizata ndërkombëtare ose shtete dominuese, me dëshirë ose pa dëshirë, të cilat përcaktojnë kriteret e pranimit në arenën ndërkombëtare, ose mundësinë e pranimit të shërbimeve dhe ndihmave, ku në dritën e këtyre kriterëve caktojnë objektivat e sistemeve pedagogjike dhe çështjet që ndërlidhen me to, siç janë: plan-programet, metodat, mjetet etj. Disa nga këto legjislacione dhe kriteret mund të lejojnë, në mënyrë të kufizuar praninë e “një Islami lokal”, herë në mënyrë të turpëruar, e herë me krenari. Kjo prani e kufizuar përfshihet në formë të veçorive kulturore dhe historike ose traditave shoqërore. Ndoshta sukseesi i globalizmit në nënshtrimin e shoqërive muslimane në sferën pedagogjike ishte më i madh se sukseesi në shoqëritë jomuslimane, si dhe më i suksesshëm se në sferat tjera, si ajo politike, administrative etj. Në këtë çështje, shfaqet nevoja për përpilimin e këtij libri për të trajtuar këtë çrregullim në mënyrë se si duhet shikuar mendimin pedagogjik islam.

Pedagogjia nuk përkufizohet në atë se është një fushë e njohjeve akademike, që ka një pozitë të rëndësishme në jetën shoqërore, por është e tërë jeta. Shumë lehtë mund të shohim disa çështje të globalizmit në jetën bashkëkohore në shoqëritë islame. Këto çështje shihen në shumë dukuri të jashtme dhe të brendshme prej normave të jetës, si në ushqim, pije, veshje, mjetet e komunikimit; në përmbytjet, gjuhën etj. Këto norma të jetës janë bërë faktori më ndikim më i madh pedagogjik në edukimin e individëve, formimin e personalitetit të tyre, formimin e raporteve shoqërore dhe përcaktimin e vlerave të sjelljes. Në masë të madhe, kjo ishte pikërisht ajo që synonte



mendimi dhe sistemi pedagogjik ta realizojë në shoqëritë muslimane! Ndikimi i globalizmit shihet qartë në të gjitha mjetet edukative dhe arsimore, siç janë: globalizmi i sistemeve të arsimit të përgjithshëm dhe atij universitar; në politikat, plan-programet dhe metodat e këtyre sistemeve; në pozitën dhe rëndësinë e familjes në edukimin dhe zhvillimin e fëmijëve; në pozitën e mjeteve dhe programeve kulturore dhe shoqërore, përfshirë mjetet e informimit, komunikimit dhe transportit, si dhe në mënyrat dhe mjetet të shfaqura dhe të fshehura për kontrollim administrativ dhe ligjor.

Vetëdijesimi rreth asaj që e sjell globalizmi prej pengesave të reformimit islam, na bën të kuptojmë vlerën e sferës, të cilën e gjejmë të hapur në disa raste rreth llojit të “edukimit fetar”, i cili nxitë disa dukuri të fetarizmit praktik, siç janë: namazi, agjërimi, namazi i natës, itikafi, dhikri, lidhja dhe mbështetja tek Allahu, si dhe adhurime tjera, qofshin obligative apo vullnetare. Me siguri se ne gëzohemi me reformat në këtë sferë, por nuk duhet harruar se gjithashtu gëzohen edhe forcat e globalizmit (qofshin shtete, institucione dhe disa hulumtues perëndimorë). Ato thërrasin në meditim, përgatitjen e raporteve, realizimin e studimeve shkencore rreth tyre, për këtë çështje përdorin metodologjinë e hulumtimit shoqëror “antropologjik” dhe “etnografik”, duke shprehur kënaqësinë për këto forma të multikulturalizmit. E gjithë kjo, sipas tyre, është fetarizëm i mirë dhe meriton meditim. Ngjashëm me këtë është edhe ideja që disa programe edukative të përmbajnë tekste fetare rreth bamirësisë, fqinjësisë së mirë, ndihma e nevojtarëve, gjë që ngritë pozitën e njeriut në ahiret.

Jemi të vetëdijshëm për këtë lloj të reformave kur dukuritë e fetarizmit përkufizohen vetëm në këtë pjesë, por megjithatë e shohim si tërheqje nga mundësia e prezantimit efikas në jetën bashkëkohore. Është e mundur që përpjekjet e hulumtuesve në përshkrimin objektiv të këtyre formave të fetarizmit dhe lëvdatat e tyre të jenë shprehje e sinqertë e ndjenjave të tyre, mirëpo, shpirti i paragjykimit perëndimor shfaqet atëherë kur muslimanët përpiqen të bashkojnë mes “fetarizmit në ibadete” dhe “fetarizmit në marrëdhënie-muamelat”, me

qëllim të prezantimit shkencor dhe praktik të Islamit në jetën e përgjithshme, përfshirë reforma politike, zhvillim ekonomik dhe shoqëror, zbulim shkencor, kreativitet civilizues dhe garë në lëvizjen e jetës në botë. Ndoshta kjo është ajo që bën personat vendimmarrës perëndimor të mbrojnë disa lëvizje fetare islame, të cilat heqin dorë nga pjesëmarrja në ndërtim dhe mbeten të mbyllura në dukuritë e fetarizmit formal.

Interesimi jonë në mënyrë të veçantë për mendimin pedagogjik islam, duke bërë përpjekje për të ruajtur identitetin e dalluar të umetit islam, nuk e neglizhon interesimin tonë për mendimin pedagogjik dominues në botën e sodit në shumicën e shoqërive muslimane, ngase përpjekje të mëdha bëhen në botën bashkëkohore për formulimin e botës me një ngjyrë kulturore unike, në mënyrë vullnetare nën titullin: “përshtatshmëria me ndikimet dhe orientimet e globalizmit” ose në mënyrë imponuese nën “presionin e institucioneve të mbështetjes dhe sistemet e financimit dhe investimit”, deri në atë masë që orientimet dhe presionet e globalizmit të arrijnë qëllimin, dhe kështu umeti islam të humbë veçoritë dhe elementet e identitetit.

Çështja sipas neve është çështje e një reformimi të përgjithshëm civilizues. Për të përballuar këtë sfidë, përsërisim atë që kemi thënë në parathënien e librit “Enciklopedia e librave të trashëgimisë”, se elita shkencore dhe kulturore e umetit, duhet të bëjë përpjekjet e nevojshme për grumbullim dhe përplotësim mes tri elementeve: e para - inspirimin e vlerave gjykuese, për të cilat ka orientuar shpallja hyjnore dhe udhëzimi pejgamberik për realizimin e intencave të Islamit, e dyta - marrja e këtyre vlerave si bazë për vlerësimin e trashëgimisë së kaluar të umetit, duke sqaruar vlerën që bartin për kohën e sotme dhe e treta - zotimi i arritjeve të kohës me burimet e saj të ndryshme, duke treguar vlerën që bartin këto arritje. Ky grumbullim përplotësues mes këtyre tre elementeve është bazament për fillimin e forcave kreative në zgjidhjen e problemeve të së tashmes dhe shikimin në horizontet e të së ardhmes. Me këtë bazament, elita kulturore bashkëkohore e umetit do të ketë mundësi të vizatojë rrugën drejt reformimit

të realitetit, kontributit në ndërtimin njerëzor dhe orientimin e civilizimit.

Në fund, mbetet të thuhet edhe ajo se ky libër rreth “mendimit pedagogjik islam” u bë më i madh se sa planifikuam, dhe ka pasur mundësi edhe më shumë të rritet, siç ndodhi me neve në temën: “Trashëgimia pedagogjike islame”, sikur mos të ishim të kujdesshëm që të gjithë shtatë kapituj të jenë në një vëllim, jo vetëm që të jetë më lehtë për lexim, por për t’iu përmbajtur metodologjisë sonë që mundohemi t’i përmbahemi në çdo gjë që shkruajmë, e që është metodologjia e përplotësimit njohës. Jemi të kujdesshëm që lexuesi i këtij libri të jetë i përpiktë dhe të vërejë këtë metodologji në çdo kapitull veçmas, si dhe në librin në përgjithësi.

Diskursi jonë në këtë libër i është drejtuar në rend të parë profesorëve universitarë dhe studentëve të magistraturës dhe doktoraturës. Më pas ai përfshin elitën kulturore, udhëheqësit pedagogjikë, të interesuarit për reforma pedagogjike, ideologjike dhe civilizuese. Grupi i profesorëve dhe studentëve kanë mundësi që çdo kapitull të librit ta llogarisin temë e veçantë e mendimit pedagogjik islam, duke e konsideruar atë si bazë për lëndë të veçantë për studim, ose projekt hulumtues, duke dhënë sqarime detajuese me shembuj dhe praktika. Të njëjtat mund t’i analizojë, kritikojë, përmirësojë, zhvillojë dhe plotësojë.

Kërkojmë nga Allahu këtë vepër ta pranojë në formën më të mirë! Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve!

## KAPITULLI I PARË

### KONCEPTI, ZHVILLIMI DHE FILOZOFITË E “MENDIMIT PEDAGOGJIK” DHE POZITA E MENDIMIT PEDAGOGJIK ISLAM

*Pjesa e parë: Koncepti i “mendimit pedagogjik” dhe konceptet që ndërlidhen me të*

Mendimi pedagogjik dhe trashëgimia pedagogjike

Teoria e pedagogjisë dhe filozofia e pedagogjisë

Mendimi pedagogjik islam në shkrimet bashkëkohore

Pozita e mendimit pedagogjik islam në përpjekjet për ngritjen civilizuese të umetit

Sulmi ndaj arsimit islam në fillim të shekullit XXI

*Pjesa e dytë: Zhvillimi i mendimit pedagogjik në civilizimet njerëzore dhe shoqërinë bashkëkohore*

Referenca e hulumtimit në zhvillimin e mendimit pedagogjik

Pedagogjia në të kaluarën mes periudhave historike dhe vizioneve filozofike

Pedagogjia në kohët e lashta

Zhvillimi i mendimit pedagogjik fetar te hebrenjtë dhe të krishterët

Mendimi dhe filozofitë pedagogjike në civilizimet njerëzore dhe shoqërinë bashkëkohore

*Pjesa e tretë: Filozofi pedagogjike bashkëkohore dhe referencat e tyre perëndimore*

Disa shembuj të filozofisë pedagogjike bashkëkohore

Referencat perëndimore të pedagogjisë

*Përmbyllje:*

# **KAPITULLI I PARË**

**KONCEPTI, ZHVILLIMI DHE  
FILOZOFITË E “MENDIMIT  
PEDAGOGJIK” DHE POZITA E  
MENDIMIT PEDAGOGJIK ISLAM**



## Parathënie

Ky kapitull përbëhet nga tre pjesë. Pjesa e parë: koncepti i “mendimit pedagogjik”: zhvillimi i konceptit, lidhshmëria e tij me shkencat pedagogjike dhe trashëgiminë pedagogjike, rëndësia e tij në përkufizimin e identitetit kulturor dhe formimit civilizues të individit, shoqërisë dhe umetit, elementet e tij, veçoritë e tij dhe llojet e shkrimeve rreth tij. Pjesa e dytë: gjendja e mendimit pedagogjik në civilizimet njerëzore dhe shoqërinë bashkëkohore, dhe filozofitë pedagogjike që e orientojnë atë. Pjesa e tretë: përmbledhje e shkurtër rreth filozofive pedagogjike bashkëkohore dhe referencat e tyre përëndimore.

Prezantimi i këtyre temave është zgjeruar më shumë se sa shpresonte autori, mirëpo nuk ishte lehtë përmbledhja e tyre në mënyrë të shkurtër, sepse ai ka bërë përpjekje që titullit të kapitullit t’ia jep hakun me sqarime dhe kështu ky kapitull mori formën saqë mund të jetë një libër në vete. Ne dëshirojmë që ky kapitull të jetë hyrje për kapitujt e tjerë, në atë mënyrë që gjithë librin e bënë referencë për të gjithë ata që dëshirojnë të kenë njohuri të përgjithshme rreth mendimit pedagogjik islam. Kjo nuk do të thotë se ky libër i mjafton lexuesit dhe nuk do të ketë nevojë të lexojë libra të tjerë, por ky libër ndihmon në formimin e një vizioni, i cili mund të cilësohet si i kompletuar, i ofron vetëdijesim dhe njohuri rreth shumë prej çështjeve të cilat kanë lidhje me mendimin pedagogjik në përgjithësi dhe pozitën e tyre në mendimin pedagogjik islam në veçanti, si dhe hulumtuesit profesionist ia lehtëson rrugët për arritje më të mëdha.

# Pjesa e parë:

## Koncepti i “mendimit pedagogjik” dhe i koncepteve që ndërlidhen me të

### 1. Mendimi pedagogjik dhe trashëgimia pedagogjike

#### 1.1. Mendimi pedagogjik

Koncepti i “mendimit pedagogjik” përbëhet prej dy fjalëve. Secila prej tyre ka rëndësinë e veçantë për përkufizimin e temës, për të cilën mund të flitet nën këtë titull.

Mendimi është rezultat e procesit të të menduarit të cilin e kryen njeriu. Ky rezultat përfshihet në mendime, perceptime, bindje etj. në bazë të së cilave merren qëndrime, vendime dhe sjellje. “Të menduarit” është term kur’anor që e tejkalon marrjen e gjërave në mend vetëm kalimthi. Sipas Kur’anit, “të menduarit” nënkupton shkallë të lartë të vetëdijes dhe përcjelljes. Ibn Ashuri, në Tefsirin e tij është shprehur kështu: “Të menduarit: është angazhim i mendjes, trajtim i të menduarit, si dhe përpjekje në mënyrë të hollësishme ndaj kuptimeve të argumenteve ndaj të vërtetave”.<sup>1</sup> Mendimi njerëzor nuk është çështje teorike e ndarë nga vepra njerëzore dhe realiteti praktik, siç mendon Ibn’ul-Kajimi. Është kështu sepse “fillimi i çdo njohurie teorike dhe veprimi me zgjedhje të lirë janë mendime dhe kujtime, të cilat sjellin perceptimet, perceptimet sjellin vullnetin, ndërsa vullneti sjell veprimin. Përsëritja e shumë e çështjeve sjell traditën, respektivisht zakonshmërinë e çështjeve. Andaj, përmirësimi i këtyre niveleve është i lidhur me përmirësimin e mendimeve dhe kujtimeve, edhe prishja e tyre është e lidhur me prishjen e mendimeve dhe kujtimeve”.<sup>2</sup>

<sup>1</sup> Ibn Ashur, Muhamed Tahir, **Tefsir’ut-Tahrir ve’t-Tenvir**, Tunis: Ed-Dar’ut-Tunisijeti li’n-Neshr, 1984, vëll. 24, fq. 26.

<sup>2</sup> Ibn Kajjim El-Xhevizje, Muhamed ibn Ebu Bekr ibn Ejub (v. 751 h.), **El-Fevaid**, Recension: Muhamed Aziz Shems, Mekë, Daru Alem’ul-Fevaid, 1429 h., fq. 252-253.



Mendimi njerëzor nuk është i ndarë nga emocionet, ngase “njeriu posedon dy fuqi: fuqinë e të menduarit dhe fuqinë e ndjenjave. Nevoja e secilës prej tyre dallon nga nevoja e tjetrës. E para, hulumton rreth të vërtetës për ta njohur atë dhe rreth të mirës për të vepruar me te. Ndërsa e dyta regjistron ndjenjat që gjenden në gjërat, qofshin kënaqësi, dhembje apo diç tjetër. Sqarimi i plotë është ai që t’i plotëson këto dy nevoja, duke t’i sjellë ato me anë të këtyre dy flatrave. Kështu, bashkërisht, ia plotëson atij nevojat mendore dhe kënaqësinë emocionale. Çdo njeri, kur mendon, ai është një filozof i vogël dhe çdo njeri kur ndjenë, ai është një poet i vogël...”<sup>3</sup>

Allahu i Lartëmadhëruar i drejtohet sikur mendjes, ashtu edhe emocioneve. Në Kur’an vëren se si ajeti kur’anor flet për dispozita ligjore ose argumentime dialektike ose rrëfime nga e kaluara, me qëllim që njeriut t’i ofrojë udhëzim për të menduarit e tij dhe urtësi për mendimin e tij. I njëjti ajet, nxit te njeriu ndjenjat e shpresës dhe frikës. Allahu kur thërret për hulumtim, mendim, mësim dhe zbulim, atë e shprehë në forma habitore. ﴿أَفَلَا يَنْظُرُونَ إِلَى الْإِبِلِ كَيْفَ خُلِقَتْ﴾ “A nuk i shikojnë vetë se si janë krijuar? [El-Gashijeh: 17]. Kur zbresin ajetet me rrëfimet më të mira me qëllim që mendja njerëzore të sheh se si përsëriten lajmet, dispozitat dhe legjislacionet, në ato forma që i përngjasin njëra-tjetrës në dispozita, saktësi dhe kontekst, deri në atë masë saqë reagon fuqishëm dhe i njëjti shfaqet në formë të dukshme në lëkurë dhe në formë psikike në zemra. Allahu thotë:

﴿اللَّهُ نَزَّلَ أَحْسَنَ الْحَدِيثِ كِتَابًا مُّتَشَابِهًا مَّثَانِيَ تَقْشَعِرُّ مِنْهُ جُلُودُ الَّذِينَ يَخْشَوْنَ رَبَّهُمْ ثُمَّ تَلِينُ جُلُودُهُمْ وَقُلُوبُهُمْ إِلَىٰ ذِكْرِ اللَّهِ ذَٰلِكَ هُدَىٰ اللَّهِ يَهْدِي بِهِ مَن يَشَاءُ وَمَن يُضِلِلِ اللَّهُ فَمَا لَهُ مِن هَادٍ﴾

“Allahu e shpalli të folmen më të mirë, librin, të ngjashëm në mrekulli, të përsëritur herë pas here (me këshilla e dispozita), që prej (dëgjimit të) tij rrëqethen lëkurët dhe zemrat e tyre. Ky (libër) është udhëzim i Allahut, me të udhëzon atë që do. E atë që Allahu e lë të humbur, për të nuk ka ndonjë udhëzues”. [Ez Zumer: 23]

Është urtësi e Allahut në këtë lloj të diskursit ndaj genies njerëzore dhe në cilësimin e formës që i përgjigjet këtij

<sup>3</sup> Muhammed Abdullah Draz, **En-Nebe’ul-Adhim: Nedharatun xhededetun fi’l-Kur’an’il-Kerim**. Kuvajt: Dar’ul-kalem, botim i nëntë, 2005, fq. 148-151.

diskursi, që ai të na mësojë diç nga realiteti i kësaj qenie njerëzore dhe përplotësimi i mjeteve të vetëdijesimit rreth saj. Ajo nuk është vetëm një copë e një mendimi të ngurtë e as emocione të pakontrolluara, por është një tërësi e kompletuar, në të cilën bashkohet fuqia e të menduarit, polemizuarit, argumentimit, saktësisë dhe zbulimit me fuqinë e reagimit emocional. Ky bashkim është bashkim përplotësimi dhe mbështetjeje, me anë të së cilës qenia njerëzore ngritët në nivelin e përshtatshëm për të pranuar diskursin dhe për t'u udhëzuar me udhëzimin e tij me qëllim të realizimit të së vërtetës nga krijimi.

Fjala “terbije – edukatë - pedagogji”, ka dy kuptime. Kuptimi i parë ai institucional i veçantë, në të cilin përkufizohen veprimet që realizohen në institucionet e rregullta edukativo-arsimore me të gjitha nivelet dhe drejtimet e ndryshme. Kuptimi i dytë është shoqëror i përgjithshëm, në të cilin përkufizohet ndikimi që e kanë institucionet në shoqëri, qoftë familja, shkolla, politikat informative, kulturore, të rinjve dhe tjerë, ndaj personalitetit të individit në dimensionin mendor, psikik, moral, fizik e tjerë, i gjithë ky ndikim shfaqet dhe matet me atë se sa ndryshim shkakton në sjelljen e individit dhe grupeve, si dhe në llojin dhe orientimet e kësaj sjelljeje.

Kuptimi i përgjithshëm i edukatës-pedagogjisë përfshin zhvillimin e njeriut në të gjitha dimensionet e tij, duke përfshirë: arsimimin, edukimin, këshillimin, kulturimin e tjera me qëllim të realizimit të asaj që e ka përmendur Allahu, mundësimin e njeriut për ngritjen e hilafetit dhe përparimit në tokë. Kuptimi gjuhësor i fjalës “terbije” rrjedh nga fjala “Rabbu”, i cili ka kuptimin e zhvillimit hap pas hapi deri në kompletimin e tij.<sup>4</sup> Thuhet: të më edukoj (jurebbeni) një njeri nga fisi Kurejsh është më e dashur për mua se sa të më edukoj një njeri nga fisi Hevazin”.<sup>5</sup> Fjala “terbije” me kalimin e kohës ka

<sup>4</sup> Ragib El-Isfahani, Ebu'l-Kasim Husejn ibn Muhamed ibn'ul-Mufaddal, (v. 502 h.), **Mufredat Elfadh'il-Kur'an**, Recension: Safvan Adnan Davudi, Damask: Dar'ul-ilm, 1412 h., fq. 336.

<sup>5</sup> Pjesë nga fjalët e Safvan ibn Umejjes drejtuar Ebu Sufjanit në betejën e Hunejnit. Këtë e ka thënë kur njerëzit humbën në fillim të luftës. Në lidhje me këtë shih:

Ibn'ul-Ethir, Ebul Seadat Mexhudin Muhamed ibn Muhamed El-Xhezeri (v. 606 h.), **En-Nihajetu fi garib'il-hadithi ve'l-etheri**, Demam-Saudi, 1421 h., fq. 339.

marrë kuptimin e përkujdesjes ndaj fëmijëve në familje. Kjo shihet qartë edhe në disa ajete kur'anore, siç janë: ﴿وَقُلْ رَبِّ ارْحَمْنَاهُمَا﴾ “Zoti im! Mëshiroi ata të dy, sikurse më edukuan mua kur isha i vogël”. [El-Isra: 24]. Gjithashtu na ajetin tjetër: ﴿قَالَ أَلَمْ نُزِدْكَ فِينَا وَلِيدًا﴾ “A nuk të rritëm (edukuan) ty si fëmijë në mesin tonë” [Esh-Shuara: 18]. Në kohë që në fushën e edukimit, fjala “terbije” ndërlidhet me gjitha fazat e jetës së njeriut.

Mendimi pedagogjik nënkupton mendimet, bindjet dhe qëllimet të cilat kontrollojnë praktikatat të cilat synojnë edukimin e fëmijëve dhe përgatitjen e tyre për bartjen e përgjegjësive të jetës, me veprime dhe metoda të caktuar, të cilat realizohen në familje dhe institucionet për arsimim, edukim, këshillim, kulturim dhe vetëdijesim në shoqëri.

Shprehja “el-fikr - mendim” në përdorimin bashkëkohor është term i ri. Mirëpo, materia e tij është bazament mbi të cilin ngritën të gjitha format e aktivitetit njerëzor. Andaj, fekihu-juristi, alimi-i dituri, i kulturuari, filozofi, këshilluesi, thirrësi, reformuesi e tjerë, që të gjithë merren me mendime.<sup>6</sup> Ngjashëm me këtë është edhe politikani, ekonomisti, pedagogu e tjerë, ngase secili prej tyre paraqet mendimet e tij dhe vepron duke u mbështetur në mendimet e grumbulluara në shkencën e politikës, ekonomisë, pedagogjisë, ose mendimet të cilat ishin bazë për përpilimin e ligjeve dhe sistemeve të cilat kontrollojnë veprimet politike, ekonomike, pedagogjike etj. Ashtu siç bisedojmë rreth mendimit pedagogjik, mund të bisedojmë rreth mendimit politik, mendimit ekonomik, mendimit shoqëror, mendimit legjislativ, mendimit administrativ, si dhe sfera të tjera në të gjitha specializimet.

Mund të bisedojmë rreth mendimit pedagogjik në përpjekjet e hulumtuesve bashkëkohorë duke përshkruar atë që është, ose ajo që duhet të jetë në jetën pedagogjike bashkëkohore në përgjithësi, ose në një dimension të caktuar të jetës. P.sh. mund të flitet rreth analizimit të praktikave pedagogjike dominuese në gjendjen reale të umetit ose gjendjen e një

<sup>6</sup> Në raste konkrete, ndonjëri nga termet e lartëcituarat ka përparësi përdorimi. Në lidhje me të shih:

Fet'hi Hasan Melkavi, **El-Bina 'ul-fikriju: mefhumuhu ve mustevejatuhu ve haraituhu**, El-Ma'had El-Alemi lil'fikr'il-islami, 2015, fq. 22-119.

shoqërie të caktuar, zbulimin e referencave ideologjike në të cilat mbështeten këto praktika, ose lidhshmërinë mes këtyre praktikave dhe referencave të tyre ideologjike nga njëra anë dhe gjendjen civilizuese të umetit dhe fuqinë për përballimin e problemeve me të cilat vuan duke dhënë kontributin në praninë efektive në botën bashkëkohore nga ana tjetër.

## 1.2. Trashëgimia pedagogjike

Trashëgiminë pedagogjike islame të cilën e synojmë në këtë kontekst është ajo të cilën e kanë shkruar dijetarët dhe mendimtarët muslimanë në tematikat e edukatës dhe arsimit me qëllim të zhvillimit të individëve, qofshin fëmijë apo të rritur rreth gjërave që u nevojiten atyre për jetën fetare dhe jetën e kësaj bote, si dhe gjërat me të cilat ofrohen tek Allahu për të përfituar shpërbllim në botën tjetër. Këto shkrime përfshijnë fushat e jurisprudencës islame, apologjetikës, hadithit, historisë islame, fushën edukative, sufiste, filozofike e tjera, duke filluar nga periudha e pas shpalljes deri në shekullin XIII hixhri. Me këtë, Kur'ani dhe suneti nuk përfshihen në termin e “trashëgimisë”. Vlerësojmë se shkrimet e dijetarëve dhe mendimtarëve muslimanë pas shekullit XIII hixhri ishin të ndikuara, pak apo shumë, nga ajo që u quajt përplasja civilizuese dhe ideologjike me Perëndimin. Trashëgimia pedagogjike islame në cilën do periudhë është formuar nga tri elemente: e para: mendimi pedagogjik që ishte temë e arsimit, praktikave arsimore dhe edukative, si dhe kontekstit historik në hapësirë, kohë dhe gjendje. Pra, trashëgimia pedagogjike është mendim, edukatë dhe histori.<sup>7</sup>

Ne e dimë se çdo shoqëri ka mendimin pedagogjik, por jo i njëjti mendim në secilën gjeneratë, ngase supozohet që ky mendim të jetë rezultat i të menduarit që bën më shumë se një mendimtar në të njëjtën gjeneratë. Mund të gjenden shumë shkolla ideologjike, të cilat kanë referencat e përgjithshme të përbashkëta, por kanë dallime në detajime, ku si pasojë e

<sup>7</sup> Fet'hi Hasan Melkavi, *Et-Turath'ut-Terbevijj'ul-Islami, halet'ul-bahthi fihi, ve lemehat min tetav-vurihi, ve kutufun min nususihi ve medarisihhi*, Aman: El-Ma'had El-Alemi li'l-fikr'il-islami, 2018, fq. 106, fq. 447.

saj gjejmë praktikime të ndryshme pedagogjike të cilat mbështeten në këto shkolla të shumta ideologjike. Do të vërejmë se mendimi pedagogjik në një kohë përkufizohet me veçoritë e asaj kohe. Më pas, si rezultat i grumbullimit të përvojave dhe ndikimit të kontaktit kulturor, në periudhat e mëvonshme kanë ndodhur disa ndryshime. Me këtë, mendimi pedagogjik në një periudhë të caktuar bëhet trashëgimi pedagogjike për periudhën e mëvonshme. Trashëgimia pedagogjike është mendimi pedagogjik kur bëhet trashëgimi, ngase është prodhim nga e kaluara. Mendimi pedagogjik grek, në realitet ai tash është trashëgimi pedagogjike greke. Mendimi pedagogjik në kohën e abasitëve, në realitet sot është trashëgimi pedagogjike abasite. Mendimi pedagogjik bashkëkohor në një vend apo shtet, do të bëhet trashëgimi pedagogjike për atë vend apo shtet në periudhën e ardhshme.

Megjithatë, disa përbërës të trashëgimisë vazhdojnë nga e kaluara, në të tashmen dhe të ardhmen. Natyrisht, se me shprehjen “periudhë” nuk nënkuptohet një orë, një javë apo muaj, por një periudhë kohore në të cilën në të njëjtën kohë marrin pjesë ndikimet ideologjike, shoqërore dhe politike të caktuara, me ata që jetojnë në atë periudhë kohore, para se të vijë ndikimet tjera për të filluar një periudhë tjetër. Kështu periudha përfshin një gjeneratë ose edhe më shumë.

Supozojmë që rëndësia e mendimit pedagogjik të jetë e pranishme në këtë kontekst. Mendimi pedagogjik në çdo shoqëri është elementi kryesor i filozofisë në të cilën mbështeten politikat, programet dhe praktikat pedagogjike në atë shoqëri. Kjo rëndësi edhe më shumë është e theksuar kur dimë se mendimi pedagogjik është një grumbull i bindjeve dhe parimeve që përcaktojnë veçoritë e personaliteti njerëzor që synohet formimi i tij në shoqëri dhe më pas përcakton veçoritë e shoqërisë së synuar. Këto bindje dhe parime lindin nga “vizioni rreth botës” të cilën e përvetëson shoqëria rreth pikëpamjeve ndaj hapësirës, jetës dhe njeriut. Në te grumbullohen bazamentet mbi të cilat ngritën të gjitha sistemet në shoqëri, qofshin politike, ekonomike, shoqërore, pedagogjike e tjera në atë mënyrë që cilësohet si e baraspeshuar dhe e

kompletuar. Kjo është gjendja e mendimit pedagogjik në shoqëri, në të gjitha periudhat.

Mendimi pedagogjik, lëndën dhe elementet e tij i përfiton nga sistemet njohëse. Siç janë: feja, filozofia, historia, sociologjia, psikologjia dhe shkencat tjera. Kështu koncepti i mendimit pedagogjik ndërlidhet me disa koncepte që kanë lidhje me edukatën dhe arsimin, në veçanti me teorinë pedagogjike, filozofinë pedagogjike, gjë që kërkon një sqarim të shkurtër, aq sa jep mundësi natyra e kësaj teme.

## 2. Teoria e pedagogjisë dhe filozofia e pedagogjisë

### 2.1. Teoria e pedagogjisë

Çka do që të thuhet rreth konceptit të “teorisë” nuk mund të del jashtë asaj se është prodhim mendor që del si rezultat i të menduarit njerëzor. Mirëpo koncepti “teori” në mënyrë të zgjeruar përdoret në dy mënyra:

E para: përdorimi i përgjithshëm që veçohet me cilësimin e idesë apo mendimit të cilin e formon individi apo shoqëria rreth një çështje, pa marrë parasysh bazamentin mbi të cilin ngritët kjo ide apo ky mendim. Kështu p.sh. mund të thuhet: teoria ime rreth dukurisë së ikjes së fëmijëve nga shkolla është kështu..., teoria ime rreth përfshirjes së Kur’anit në plan-programin mësimor është kështu....

E dyta: përdorimi shkencor sipas kriterëve, pa marrë parasysh se bëhet fjalë për shkencat natyrore apo shkencat shoqërore. Kështu mund të thuhet: teoria e shpërthimit të madh rreth fillimit material të hapësirës, teoria atomike rreth formimit të materies, teoria e sjelljes në procesin e të mësuarit, teoria e vlerës në ekonomi, teoria e urfit në fikh etj.

Kur’ani famëlartë, shprehjen “nadhar - shikim-meditim” e përdorë në disa kuptime. Prej tyre veçojmë: kuptimi që është i veçantë për procesin e të menduarit (të menduar me vetëdije, mendim të thellë), konsideratë (el-i’tibar) (të menduarit rreth realitetit të çështjeve, marrja e mësimit nga ngjarjet), mendim me vëmendje (et-tedebbur) (të menduarit në fundin

dhe rezultatet e çështjeve). Në lidhje me këto kuptime kemi ajetet kur'anore:

﴿قَدْ خَلَتْ مِنْ قِبَلِكُمْ سُنَنٌ فَسِيرُوا فِي الْأَرْضِ فَانظُرُوا كَيْفَ كَانَ عَاقِبَةُ الْمُكْذِبِينَ﴾

“Përpara jush kanë kaluar popujt ndaj të cilëve janë zbatuar ligjet, ndaj udhëtoni nëpër tokë dhe shikoni si qe përfundimi i atyre që përgënjeshtroan.” [Alu Imran: 137]

Po ashtu: ﴿فَانظُرْ إِلَى آثَارِ رَحْمَتِ اللَّهِ كَيْفَ يُخَيِّ الْأَرْضَ بَعْدَ مَوْتِنَا إِنَّ ذَلِكَ لَمُخَيِّ الْمَوْتَى﴾  
﴿فَانظُرْ إِلَى آثَارِ رَحْمَتِ اللَّهِ كَيْفَ يُخَيِّ الْأَرْضَ بَعْدَ مَوْتِنَا إِنَّ ذَلِكَ لَمُخَيِّ الْمَوْتَى﴾  
“Shiko pra gjurmët e mëshirës së Allahut, se si e ngjall tokën pas vdekjes së saj, e s'ka dyshim se Ai është që do t'i ngjallë të vdekurit, se Ai për çdo send është i plotfuqishëm”. [Er-Rrum: 50]

Teoria me kuptim formim mendor është pika më e lartë e piramidës të cilin e formon njohja njerëzore. Piramida e njohurive fillon me të vërtetat e pjesshme materiale, të cilat grumbullohen rreth koncepteve më të kuptueshme. Më pas këto koncepte ndërlihen me ligje të cilat përshkruajnë atë që ndodh në jetën reale, dhe në fund vijnë teoritë të cilat komentojnë këto ligje që rregullojnë sjelljen. Detyra e teorisë në formimin e të menduarit është detyrë komentuese, në kohë kur detyrat e niveleve tjera të njohurisë janë përshkruese.

Nëse teoria është nivel i caktuar i njohurisë, ajo nuk është njohuri e pjesshme, por e kompletuar dhe totalitare. “Teoria” në përdorimin e përgjithshëm gjuhësor është përballë “praktikës”. Ka çështje teorike dhe tjera praktike, mirëpo praktika nuk ndahet nga formimi teorik që nxitë për praktikim. Teoria ruan pozicionin e saj në formimin e njohurisë për derisa ajo komenton dukuritë e veçanta me atë njohuri dhe nuk refuzohen në përjashtim nëse nuk është në gjendje të kryen komentimin. Në këtë rast mendohet për një mendim apo ide të re e cila do të jetë në gjendje të komentojë. Kështu refuzohet teoria e parë që në vend të saj të vjen teoria e re.

Teoria është formim mendor që komenton një dukuri të veçantë duke dhënë parashikimet për këtë dukuri. Teoria përbëhet nga një numër i mendimeve, parimeve dhe raporteve të cilat përshkruajnë dukurinë në fushën natyrore, shoqërore, psikologjike e tjera dhe komentojnë këtë dukuri.

Sa i përket teorisë pedagogjike, ajo është një sërë mendimesh, idesh dhe parime të cilat komentojnë dukurinë e “zhvillimit njerëzor”, duke përfshirë përkujdesin, mësim-nxënien dhe mësimdhënien, dhe në dritën e tyre përcaktohen qëllimet, përmbajtjet dhe metodat pedagogjike. Është e njohur se shumë prej sferave të edukimit dhe zhvillimit, si dhe proceset e të mësuarit realizohen përmes imitimit dhe trashëgimisë shoqërore dhe kulturore, mirëpo përfitimi i njohurive të komplikuar ka nevojë për komentim përmes ndonjë teorie të caktuar pedagogjike. Teoria e “edukimit” ose teoria pedagogjike nuk është vetëm një teori, andaj nuk ka vetëm një teori për të komentuar procesin e mësim-nxënies dhe mësimdhënies, i cili shpie drejt një argumenti të caktuar rreth mënyrës së praktikimit të këtij procesi. Andaj, ekziston një numër i teorive, ku secila prej tyre ka mbështetjen e saj filozofike, psikologjike dhe shoqërore.

Teoria pedagogjike angazhohet për njohjen e politikave dhe praktikave pedagogjike, kuptimin dhe përkufizimin e tyre, si dhe përmbajtjet didaktike, përpilimin e plan-programeve mësimore dhe administratës pedagogjike.

Gjatë historisë, njeriu ka njohur teori të shumta pedagogjike. Për këto teori kanë kontribuar dijetarë dhe mendimtarë grekë, kinezë, indianë, muslimanë etj. Secila teori që është zhvilluar në një shoqëri, konceptin e saj e ka bazuar në bindjet fetare dhe filozofike të asaj shoqërie, në gjendjen e saj civilizuese dhe aspiratat politike dhe ekonomike, dhe më pas përgatit formën që në bazë të saj dëshiron shoqëria edukimin e gjeneratave dhe formimin e të ardhmes. Për këtë, teoritë pedagogjike kanë ndryshuar nga një shoqëri në tjetrën. Në të njëjtën shoqëri, teoria pedagogjike ka ndryshuar nga një periudhë në tjetrën dhe nga një mendimtar pedagogjik në tjetrin.

Në shumë raste, teoria pedagogjike mbështetet në teoritë psikologjike, filozofike, ekonomik etj. Ekziston një lidhshmëri e fortë mes pedagogjisë dhe psikologjisë. Pedagogjia është shkencë praktike, e cila në masë të madhe mbështetet në psikologji në komentimet e saj teorike ndaj procesit të të mësuarit njerëzor. Për këtë, kemi teori pedagogjike të sjelljes,



njohjes, formimit etj. Po ashtu, ekziston një lidhje e ngushtë mes teorisë pedagogjike dhe teorisë shoqërore. Si rezultat i saj kemi teorinë pedagogjike kulturore, i cili kujdeset për mënyrën se si ndodhë arsimimi në kulturën e shoqërisë, e që përfshin institucionet pedagogjike të ndryshme si institucionet fetare, familja, shkolla etj. Teoria pedagogjike aplikative e cila mbështetet në sociologjinë pedagogjike. Shumë prej teorive pedagogjike ishin reflektim i filozofive të përgjithshme. Kështu historia njeh teorinë pedagogjike idealiste, realiste, pragmatiste, marksiste etj. Mirëpo, hapësira e punës teorike në fushën pedagogjike i ka dhënë hapësirë filozofëve dhe mendimtarëve me orientime teorike në sfera tjera pedagogjike të marrin pjesë në diskutimin e çështjeve, vlerave dhe politikave pedagogjike. Për këtë, teorinë pedagogjike në zbatimin praktik kanë lëvizur nga sfera e tyre e ngushtë në pedagogji në çështje me specializime të ndërhyra, me qëllim të zhvillimit më të mirë të mendimit, i cili bashkon fushën e pedagogjisë me fushat tjera. Megjithatë, punë më e mirë në studimet e ndërhyra, pra specializime, do të ketë mbështetje të fortë nga specializimi tjetër.

Ndonjëherë, teoria pedagogjike kuptohet në kornizë të përgjithshme e pakufizuar. Kjo ndodhë kur është për qëllim çdo gjë që shkruhet rreth pedagogjisë, qoftë diskutime të çështjeve psikologjike, shoqërore ose filozofike. Ekziston një kuptim tjetër i teorisë pedagogjike, i cili është më i kufizuar, më i ngushtë dhe më i ndërlidhur me shkencën e pedagogjisë. Ky përkufizim është kështu: një grumbull parimesh dhe udhëzimesh të cilat i ofrohen atyre që merren me punë pedagogjike në praktikë. Pra, teoria pedagogjike është teori e edukatës.<sup>8</sup>

Në përgjithësi, teoria pedagogjike islame nuk dallon nga ajo që u tha rreth teorisë pedagogjike. Teoria pedagogjike islame është një grumbull mendimesh dhe idesh, të cilat i kanë përpiluar mendimtarët muslimanë, ose janë praktikuar në shoqëri islame rreth pozitës së pedagogjisë në shoqëri,

<sup>8</sup> Terence W. Moore, **Educational Theory: An Introduction**, Abingdon: Routledge Library Editions/ Education, 2012 Edition (first published 1974), fq. 9.

institucionet, përmbajtjet, plan-programet, metodat e tjera, kështu këto mendime dhe ide ishin reflektim i asaj që ka dominuar në këto shoqëri, në rend të parë çështjet e besimit, të cilat në esencë ngritën mbi vizionin ndaj Botës islame (Islamic Worldview), që përgjigjen ndaj çdo pyetje që lind në mendjen e njeriut rreth Krijuesit, botës së krijuar, njeriut, natyrën e jetës së tij, qëllimi i ekzistimit njerëzor, veçoritë e njeriut, të cilat Islami i synon, shoqërinë që dëshiron ta ngritë përparimin njerëzor, material dhe mendor në tokë e tjera, bazuar në atë se teoria pedagogjike islame është përpjekje mendore njerëzore, vërejmë se këto përpjekje kanë dalluar nga një dijetar musliman në tjetrin dhe nga një shkollë ideologjike në tjetrën. Kështu teoria pedagogjike është ndikuar nga kultura dhe rrethanat politiko-shoqërore që kanë dominuar në periudhat e historisë islame.<sup>9</sup>

Megjithatë, teoria pedagogjike islame ka mbetur e palëkundur në veçoritë e përgjithshme, të cilat e dallojnë nga tjerat. Ajo është pikëpamje dhe perceptim i gjithanshëm i punës edukative dhe arsimore që bën përgatitjen e njeriut si individ dhe si shoqëri për realizimin e qëllimit të ekzistimit të tij në këtë jetë, e që është adhurimi i Allahut. Përmes adhurimit, realizohet pastrimi shpirtëror dhe fizik dhe kryerja e obligimeve të zhvillimit të jetës në tokë. Kjo pikëpamje përcakton themelet, plan-programet, përmbajtjet veçoritë dhe burimet e pedagogjisë, sipas përpjekjeve të pedagogut musliman në të kuptuarit e referencave pedagogjike në Kur'an dhe sunet, duke u bazuar në përvojën e trashëgimisë islame dhe duke kuptuar eksperiencën njerëzore bashkëkohore.

## 2.2. Filozofia e pedagogjisë

Filozofia e pedagogjisë është studimi filozofik i pedagogjisë dhe problemeve të saja. Duhet kuptuar se ajo nuk është pjesë e filozofisë, por është pjesë e pedagogjisë, e cila

<sup>9</sup> Maxhid Arsan El-Kilani, **Tetavurun nadharijetit terbevijetil islamijeti**, Damask & Bejrut: Dari Ibn Kethir, botimi 2, 1985. Libri në mënyrë të detajuar ka përfshirë bazat dhe zhvillimin e teorisë pedagogjike islame gjatë shekujve, duke filluar nga shekulli i parë hixhri, duke përfshirë personalitete të cilat janë marrë me punë pedagogjike, ose kanë folur rreth pedagogjisë, duke i bërë përshkrim empirik ose teorik, dhe shkollat ideologjike të cilave u kanë takuar këto personalitete: juridike, sufiste, filozofike, historike etj.

studiohet në institucionet e saj dhe diskutohet në fushat e saja. Fusha e saj është pedagogjia, por format e studimit të saj ndërlidhen me filozofinë për nga analizimi, sqarimi i koncepteve, çështjeve, teorive dhe gjuhës së përdorur në punën pedagogjike. Filozofët nuk vënë teori pedagogjike ose ekonomike, por ata analizojnë teoritë dhe japin kritika, të cilat ose çojnë në anulimin e teorisë ose riformulimin e saj. Hulumtuesit perëndimorë kanë folur rreth filozofive pedagogjike, duke filluar nga filozofitë e Sokratit (v. 399 para erës së re), Platonit (v. 347 p.e.r.), Aristotelit (v. 322 p.e.r.) rreth pedagogjisë. Më pas kanë bërë një kalim në filozofitë e shekullit XVIII dhe XIX, në veçanti mendimet e Lokut (v. 1704), Rusoit (v. 1788), Kantit (v. 1804), Xhon Stivart Mill (v. 1873), më pas në filozofinë pragmatike të Xhon Djuvit (v. 1952). Më pas janë përfshirë teoritë perëndimore të cilat janë zhvilluar në shekullin e XX dhe filozofitë bashkëkohore siç janë: analitike, ekzistencialiste, kritike, feministe dhe udhëzimet filozofike të post-modernitetit. Shumë pak kanë dhënë shenjë për periudhat islame dhe zhvillimin pedagogjik, përfshirë normat, rregullat teorike dhe zbatimet praktike të pedagogjisë.

Filozofia pedagogjike kujdeset për analizimin dhe sqarimin e koncepteve, çështjeve që kanë pozitë qendrore në mendimin pedagogjik, praktikën pedagogjike etj. ekzistojnë pyetje të vjetra sa vet njeriu, të cilat i ka parashtruar njeriu para se të gjinden specialistët në filozofinë pedagogjike. Është me rëndësi se shumë prej këtyre pyetjeve, akoma janë aktuale dhe se përgjigjet ripërtërihen. Pyetje të tilla janë: cilat janë qëllimet dhe synimet e pedagogjisë? Cilin duhet arsimuar dhe edukuar? Si duhet edukuar individët sipas aftësive dhe interesimeve tyre? Cilat janë përgjegjësitë edukative të shtetit përballë përgjegjësive të prindërve?. Ajo që bie në sy, se përgjigjet ndaj këtyre pyetjeve, gjatë historisë njerëzore, nuk kanë qenë të njëjta, as për llojin njerëzor e as për asnjë shoqëri. Kështu secila shoqëri jep përgjigje, në çdo kohë, sipas rrethanave shoqërore të asaj kohe dhe dobisë që i sjellin përgjigjet për njerëzit e asaj kohe dhe kohës që vjen pas. Në secilën herë, përgjigjet janë të mira dhe jo të mira, duke vazhduar

mendimtarët të japin kritikën ndaj tyre me qëllim të zhvillimit të pedagogjisë në atë që mendojnë se është më e mirë.

Rëndësia e filozofisë pedagogjike fshehët në atë se çështjet pedagogjike madhore, në esencë janë çështje filozofike. Kështu që, natyra e njeriut, kërkesat e zhvillimit dhe përgatitja e tij për të përballuar përgjegjësitë e jetës, natyrë e shoqërisë dhe jeta e synuar, obligimet e individit dhe shoqërisë për sigurimin e njohurive, përvojave pedagogjike, informacioneve, shkathtësive, vlerave e tjera, që të gjitha janë çështje filozofike. Për gjithë këtë, filozofia pedagogjike e kryen obligimin e mendimit filozofik në këto çështje për nga meditim, analizi kritik, përcaktimi normativ për atë që duhet të jetë jeta individuale dhe shoqërore e njeriut. Po ashtu, përfshin natyrën e njohurive të nevojshme dhe vlerat që orientojnë jetën e tij. Po ashtu luan një rol tjetër e që është zbatimi i këtyre analizave për orientimin e politikave dhe praktikave pedagogjike për realizimin e qëllimeve të synuar pedagogjike.

Për të kuptuar më lehtë lidhshmërinë mes pedagogjisë, teorisë pedagogjike dhe filozofisë pedagogjike atë mund ta përshkruajmë me një shtëpi e cila përbëhet nga tre kate. Në katin e parë përfshihen të gjitha praktikët arsimorë si: mësimi, planifikimi, ushtrimi dhe vlerësimi. Në katin e dytë, teorinë pedagogjike e gjejmë në formë të një sërë parimesh të ndërlidhura dhe udhëzime praktike të cilat synojnë ndikimin ndaj praktikave pedagogjike që ndodhin në katin e parë. Ndërsa, në katin e tretë vërejmë filozofinë pedagogjike, e cila kryen rolin e sqarimit të koncepteve të përdorura në dy katet e mëposhtme (si: edukatë, mësimdhënie dhe mësimnxënie) dhe përcaktimin e komponentëve të teorisë pedagogjike, matjen e saktësisë dhe fuqinë e saj për orientimin e praktikave të cilat realizohen në katin e parë.

Dallimet mes tri niveleve duhet kuptuar si dallime logjike, që nënkupton se ajo që ndodhë në secilin kat pikënisjen e ka nga kati që është poshtë tij, për t'i shërbyer dhe për t'i ofruar orientimin e duhur. Kështu p.sh. teoria pedagogjike përcakton aktivitetet pedagogjike dhe i orienton ato. Filozofia pedagogjike përcakton teorinë pedagogjike dhe aktivitetet peda-

gogjike.<sup>10</sup> Ekziston edhe një dallim të një lloji tjetër, e që është se praktikat pedagogjike të cilat realizohen në katin e parë janë aktivitete që shihen, që në të shumtën e rasteve mbështeten në mundësitë materiale dhe rrethanat praktike, në kohë kur teoria pedagogjike në katin e dytë është aktivitet i një niveli më të lartë, i cili cilësohet me atë se përcakton çështjet e nevojshme për shërbimin e praktikave pedagogjike. Ndërsa, filozofia pedagogjike në katin e tretë është aktivitet i një niveli edhe më të lartë, i cili cilësohet me atë përcjell njeriun si individ në shoqëri, duke analizuar konceptet dhe praktikat, duke i dhënë kuptime që ndihmojnë në formimin e teorive të përshtatshme.

Nuk ka dyshim se filozofia pedagogjike formohet nga filozofia e përgjithshme të cilën e pranon shoqëria, referencat e tij ideologjike, bindjet e tij fetare, thesari kulturor dhe ambiciet civilizuese. Bazuar në këtë, nuk ka dyshim se filozofia pedagogjike islame mbështetet në besimin islam dhe sistemin e tij të përgjithshëm. Këtu përfshihen konditat e besimit, përcaktimi i rolit të njeriut në adhurimin e Allahut dhe të qenit të tij mëkëmbës në tokë, duke u bazuar në vlerat e tevhidit, pastrimit shpirtëror dhe zhvillimit civilizues, e gjithë kjo krahas përhapjes së lirisë, bamirësisë dhe drejtësisë. Shoqëria islame, kur të anojë drejt filozofisë pedagogjike islame, ka për obligim të kuptojë dallimin mes gjendjes së saj reale dhe asaj që synon të arrijë. Po ashtu duhet të kuptojë përpjekjet e nevojshme që duhet harxhuar për shndërrim nga gjendja reale në atë të synuar, si dhe praktikat pedagogjike që kërkohen për realizimin e këtij shndërrimi.

Nëse realizohet ky anim drejt teorisë pedagogjike islame, atëherë është lehtë të realizohen detyrat e shpresuara nga ajo për vënien e bazave dhe elementeve të teorisë pedagogjike islame, në veçanti intencat dhe synimet e pedagogjisë në shoqëri, përcaktimin e veçorive, konditave dhe elementeve të sistemit pedagogjik islam, përcaktimin e burimeve të njohurive dhe mjetet e përfitimit, zbulimin e vlerave të cilat kontrolloj-

<sup>10</sup> Moore, *Educational Theory: An Introduction*, fq. 5-8. Shih preview of the book at: - [https://books.google.jo/books?id=sZw96Leb7wIC&printsec=frontcover&dq=inauth or: %22Terence+W.+Moore%22&hl=en&sa=X&ved=0ahUKEwj09sPQ5vHUAhUEt hQKHRVUAkQ6AEIKDAB#v=onepage&q&f=false](https://books.google.jo/books?id=sZw96Leb7wIC&printsec=frontcover&dq=inauth+or:%22Terence+W.+Moore%22&hl=en&sa=X&ved=0ahUKEwj09sPQ5vHUAhUEt hQKHRVUAkQ6AEIKDAB#v=onepage&q&f=false).

në punën pedagogjike, trajtimin e mosmarrëveshjeve mes të interesuarve në fushën e pedagogjisë dhe trajtimin e këtyre problemeve. Kështu do të vërejmë se Islami, i përfshirë në katër burime: Kur'an, sunet, trashëgimi islame dhe përvoja bashkëkohore njerëzore, do të jetë e pranishme në të gjitha këto çështje.

Me kaq mjaftojmë rreth teorisë pedagogjike dhe filozofisë pedagogjike, ngase ne nuk jemi duke përgatitur libër në këtë sferë. Ekzistojnë libra të veçanta për këtë çështje si dhe lëndë studimore universitare në nivel të ciklit të dytë dhe të tretë të studimeve të cilat merren gjerësisht me këtë çështje. Megjithatë, ishte e nevojshme të përkujtojmë rreth disa çështjeve prej të cilave veçojmë:

Fjala rreth teorisë pedagogjike dhe filozofisë pedagogjike është e rëndësishme për arsye se çdo lëndë prej tyre është lloj i të menduarit pedagogjik, i cili bazohet në zbatimet praktike të edukimit dhe arsimimit, duke i orientuar, analizuar, përmirësuar dhe kritikuar këto praktika.

Teorinë në shkencat shoqërore, përfshirë edhe pedagogjinë, nuk e gjejmë të përkufizuar dhe të kriterizuar, siç është rasti në shkencat natyrore, as për nga përbërësit e teorisë, e as për nga qëllimet.

Një pjesë e madhe e materies elementare të teorisë pedagogjike është materie e shkencave tjera si: psikologji, sociologji, ekonomi, biologji, mjekësi e tjera, duke marrë në konsideratë se ndikimet e këtyre shkencave janë të shumta dhe të komplikuar.

Teoria pedagogjike ndikohet shumë nga vlerat të cilat i përvetëson shoqëria, qofshin vlera fetare, politike apo shoqërore.

Sa i përket filozofisë pedagogjike, duhet theksuar se shumë prej shkrimeve që janë në disponim, trajtojnë çështjet filozofike më shumë se sa çështjet pedagogjike. Kështu vërejmë se këto shkrime trajtojnë tri problematikat kryesore të filozofisë: ontologjinë (ekzistimin), epistemologjinë (njohjen) dhe aksiologjinë (vlerat). Ose vërejmë se flasin për tema filozofike në forma tjera, si pikëpamjet ndaj botës në tri elementet krye-

sore: hapësira, jeta dhe njeriu. Ka edhe shkrime që përfshijnë që të dyja këto forma. Ka shumë libra që flasin për tri filozofitë tradicionale: idealizmi, realizmi dhe pragmatizmi, të cilat dominonin në gjysmën e parë të shekullit XX duke theksuar aty-këtu edhe reflektimet e këtyre filozofive në fushën pedagogjike.

### 3. Mendimi pedagogjik islam në shkrimet moderne dhe bashkëkohore

#### 3.1. Shkrimet pedagogjike në gjuhën arabe

Me qëllim të përpilimit të këtij libri, autori ka konsultuar dhjetëra libra të cilat janë në disponim në treg. Çdo libër që në titullin e tij ka pasur “mendimin pedagogjik” përfshirë edhe “arsimin” dhe “edukimin” janë konsultuar. Vërehet se shumica e këtyre librave flasin pak rreth “mendimit pedagogjik” duke përfshirë elementet, veçoritë dhe burimet, ndërsa flasin shumë rreth mendimit pedagogjik që ka dominuar në kohët e mëhershme, e që sot konsiderohet si trashëgimi ose pjesë e historisë. Përzierje mes mendimit pedagogjik dhe trashëgimisë pedagogjike shihet qartë në pjesën dërrmuese të librave. Lexuesi mund ta provojë këtë përgjithësim përmes kontrollimit të dy llojeve të librave:

**Lloji i parë:** librat që flasin rreth mendimit pedagogjik islam ose mendimit pedagogjik arab. Pjesa më e madhe e tyre flasin për zhvillimin e këtij mendimi në periudhat islame, duke filluar nga periudha pejgamberike, periudha emevite, abasite e kështu me radhë. Ose flasin për mendimin pedagogjik të disa dijetarëve të zgjedhur në historinë e pedagogjisë islame si: Ibn Sahnuni, Kabisij, Zernuxhi, Gazali, Ibn Halduni etj. Ose flasin për shkollat e mendimit pedagogjik në historinë islame si: shkalla juridike, filozofike, sufiste, letrare e tjera, ose flasin për mendimin pedagogjik që ka dominuar në një vend prej vendeve islame në një periudhë prej periudhave si: tokat e Shamit në periudhën e ejubijëve, tokat e Egjiptit në periudhën e memlukëve, tokat e Andaluzisë në periudhën e murabitëve etj.

**Lloji i dytë:** librat që flasin rreth mendimit pedagogjik, filozofisë pedagogjike, teorive pedagogjike në përgjithësi, pa iu referuar se është vepër e ndonjë personi arab ose musliman. Do të vërejmë se pjesa dërrmuese e këtyre librave flasin rreth filozofive pedagogjike të cilat i përkasin personaliteteve që në veçanti i njej historia evropiane. Përmbajtjet e këtyre librave janë mendimi pedagogjik ose teoria pedagogjike ose filozofia pedagogjike sipas Sokratit, Platonit, Aristotelit, Rusoit, Djuit e tjerë, mund të gjesh që disa prej librave përfshijnë edhe emrat e disa dijetarëve muslimanë si: Farabiu, Gazaliu etj. Vërejmë se disa prej librave flasin për mendimin pedagogjik, i cili mbështetet në filozofitë pedagogjike të ndërlidhura me këto personalitete, si: idealist, realist, pragmatist, islam etj. Ekzistojnë edhe disa libra që flasin për teoritë dhe filozofitë pedagogjike moderne dhe bashkëkohore, si: ontologjike, epistemologjike dhe aksiologjike etj.<sup>11</sup>

Bazuar në atë se shumë prej asaj që është shkruar rreth mendimit pedagogjik, në realitet ishte shkrim rreth trashëgimisë pedagogjike, dhe me qëllim që biseda jonë rreth mendimit pedagogjik të mos ulë rëndësinë e trashëgimisë pedagogjike, bëjmë me dije se kemi shkruar gjerësisht rreth trashëgimisë pedagogjike, në veçanti atë islame në tri libra, të cilat janë botuar para se të fillojmë përpilimin e këtij libri rreth mendimit pedagogjik bashkëkohorë islam.<sup>12</sup>

Gjatë konsultimit të kësaj literature vërejtëm se termi “mendimi islam” është term i ri, i cili nuk është përdorur në gjysmën e parë të shekullit XX. Më pas, kur filloi të përdoret, nuk u mirëprit, në veçanti nga specialistët në shkencat islame, duke i dhënë përparësi termeve që janë përdorur në librat e mëhershëm si p.sh. termet “el-ilm-shkencë” në çdo fushë, si ilm’ul-fikh (shkenca e jurisprudencës), ilm’ul-akideh

<sup>11</sup> Me këtë nuk dëshirojmë që të bëjmë vlerësim ndaj këtyre librave, ngase secili libër gjykohet sipas rrethave dhe qëllimit të autorit.

<sup>12</sup> Këto tri libra janë:

Et-Turath’ut-terbevijj’ul-islamijju (Trashëgimia pedagogjike islame),

Nusunun muhtaretun min’et-turath’it-terbevijj’il-islamijji (Tekste të përzgjedhura nga trashëgimia pedagogjike islame),

Meshruatun bahthijjetun fi’t-turath’it-terbevijj’il-islamijji (Projekte hulumtuese në trashëgiminë pedagogjike islame)



(apologjetika), ilm'ut-tevhid (shkenca mbi njëshmërinë e Zotit), ilm'ul-mevarith (shkenca e trashëgimisë) etj. Duhet theksuar se materia e termit “el-fikr - mendim” gjendet në Kur'an në mënyrë të qartë.<sup>13</sup> Njeriu i parë prej autorëve të mëvonshëm që ka përdorur termin në titujt e librave të tij është Muhammed Behij në librin e tij “El-Fikr'ul-islamijj'ul-hadith ve sil-letuhu bi'l-isti'mar'il-garbijj” (Mendimi bashkëkohor islam dhe lidhshmëria e tij me okupimin perëndimor), Muhammed Mubarek në librin: “El-Fikr'ul- islamijj'ul-hadith fi muvaxhehet'il-efkar'il-garbijje” (Mendimi bashkëkohor islam në përballimin e mendimeve perëndimore), Muhamed Fet'hi Uthman në librin “El-Fikr'ul-islamijju ve't-tetavvuru” (Mendimi islam dhe zhvillimi), Enver Xhundi në librin “Menabi'ul-fikr'il-islamijj” (Burimet e mendimit islam) etj. Për këtë, nuk është për t'u habitur se pse termi “mendimi pedagogjik islam” nuk është përhapur, përpos në dekadën e fundit të shekullit XX dhe fillim të shekullit XXI. Kishte shumë terme që mbulonin nevojën e veçantë për mendimin. Termi “En-Nudhum'ul-islamijjeh” (Sistemet islame) ishte më i përdorur. Flitet tash për “sistemi pedagogjik islam” ose “sistemi pedagogjik në Islam”, çështja është e ngjashme edhe me termet “shkencat islame”: shkenca e “pedagogjisë në Islam” ose “arsimit në Islam” ose thënë thjesht “pedagogjia islame” ose “arsimi islam”...<sup>14</sup>.

Termet që më së shumti janë përdorur në kontekst të fjalës rreth mendimit pedagogjik islam kanë qenë termet: “pedagogjia islame” dhe termi “arsimi islam”. Kështu kemi libra me këso tituj: historia e pedagogjisë islame, bazat e pedagogjisë islame, qëllimet e pedagogjisë islame, mjetet e pedagogjisë islame, arsimit në periudhën abasite, dituria dhe arsimiti në Andaluzi etj.

<sup>13</sup> Termi “el-fikr” dhe zhvillimi i përdorimit të tij është diskutuar në kapitullin e parë të librit: “El-Bina'ul-fikrij” të autorit Fet'hi Melkavi, fq. 22-69.

<sup>14</sup> Dr. Seid Ismail Ali në vitin 1987 ka botuar librin me titull: “**Buhuthun fi't-terbijjet'il-islamijjeh**” (Hulumtime në pedagogjinë islame). Kur ka bërë ribotimin e tij më 2006 ka bërë ca ndryshime dhe e ka botuar me titull të ri: “El-Fikr'ut-terbevijj'ul-islamijju ve tehadijjat'ul-mustakbeli” (Mendimi pedagogjik islam dhe sfidat e të së ardhmes), ndërsa në brendinë e librit në të shumtën e rasteve mbetet termi i mëparshëm. Shih librin: Seid Ismail Ali, “El-Fikr'ut-terbevijj'ul-islamijju ve tehadijjat'ul-mustakbeli”, Kajro: Dar'us-salam, 2006. Rreth titullit të librit lexo në faqen 5.

Kështu, termi “pedagogjia islame”<sup>15</sup> ka marrë disa kuptime të ndryshme ngase ai kishte kuptimin e:

Lëndë mësimore shkollore që u mësohet nxënësve në shkollat publike. Në te përfshihen çështje fetare të besimit, fikhut, tefsirit, hadithit, etikës dhe disa tekste nga Kur’ani dhe hadithi që përshtaten me moshën e nxënësve. Kjo lëndë ndonjëherë emërtohet si “edukata fetare” ose “edukata fetare islame”. Për këtë ka folur Muhamed Emin Misrij dhe tjerë.<sup>16</sup> Kështu, në bazë të kësaj vijnë edhe titujt e librave shkollorë.

Termin “pedagogjia islame” e gjejmë si titull të ndonjë lënde universitare, si: “Bazat e pedagogjisë islame” ose “plan-programet e pedagogjisë islame” ose “historia e pedagogjisë islame”. Në pjesën më të madhe të përmbajtjeve flitet për personalitete të trashëgimisë pedagogjike islame, institucionet islame, plan-programet islame etj. Këto lëndë aty-këtu përfshijnë edhe disa rekomandime dhe udhëzime rreth mënyrës së mësimdhënies të lëndës së edukatës islame në periudha të ndryshme studimore, si dhe aktivitetet mësimore të veçanta të mësimdhënies.

Këtë term e gjejmë si program mësimor për specializim universitar, si p.sh. “Programet dhe mësimdhënia e pedagogjisë islame”. Në këtë program bëhet përgatitja e mësimdhënësve të “edukatës islame” në shkolla. Mund të vazhdoen studimet në të njëjtin specializim deri në nivelin e doktoraturës, ku më pas vazhdon punën në mësimdhënie universitare në të njëjtin program studimor.

Termin “pedagogji islame” e gjejmë të përdorur në kontekstin e bisedës rreth edukimit të fëmijëve, në të cilin marrin pjesë institucionet edukativo-arsimore si: familja, shkolla, mjetet e informimit, komunikimit, këshillimit kulturor, fetar etj. Këto institucione merren me edukimin e fëmijëve në të gjitha dimensionet, përfshirë edukimin fizik, intelektual,

<sup>15</sup> Në shqip përdoren termet “pedagogji islame” dhe “edukatë islame”. Në gjatë përkthimit kemi përdorur në të shumtën e rasteve termin “pedagogji islame”, me përjashtime të vogla.

<sup>16</sup> El Misrij, Muhamed Emin, **Lemehatun min vesail’it-terbijjet’il-islamijjeti ve gajatiha**, Damask: Dar’ul-Fikr, botimi i katërt, 1978. Në parathënieën e librit, autori thotë: “Qëllimi i parë dhe i fundit është që mësimdhënësi i edukatës fetare të jetë model për njeriun e besimit”. Titulli i kapitullit të parë ishte: “Qëndrimi i edukatës fetare ndaj orientimeve pedagogjike bashkëkohore”, ndërsa titulli i fundit: “Qëllimet e edukatës fetare”, fq. 244.

shpirtëror, moral, sipas normave islame. Sipas normave islame, familja obligohet të furnizojë fëmijët me edukatë islame me qëllim të realizojë zhvillim për të zbatuar vlerat fetare në kryerjen e ibadeteve, bashkëveprimi me të tjerët, sjelljen shoqërore, sjelljen morale etj. Shkollat publike zyrtare duhet të merren me edukim dhe arsimim. Kështu që nuk pritët prej tyre të ofrojnë vetëm arsimim në tematika të ndryshme si ato fetare, gjuhësore, matematikë, gjeografi e tjera, por obligohen të ofrojnë një ambient për edukim pedagogjik në sferat e zhvillimit fizik, shpirtëror, shoqëror, intelektual dhe moral. Kriteret e edukimit në familje dhe shkollë, në shoqëritë islame supozohet të jenë kritere pedagogjike islame.

Pedagogjia islame si disiplinë e shkencave pedagogjike. Shkencat pedagogjike klasifikohen në bazë të veprimeve pedagogjike si: administratë, financim, mësimdhënie, mësimnxënie, vlerësim, ose në bazë të orientimeve ideologjike dhe filozofike si: idealiste, realiste, pragmatiste, islame etj.

Këto janë pesë kuptime të pedagogjisë islame. Ajo që na intereson në këtë kontekst se pedagogjia islame në kuptimin e saj të përgjithshëm përfshin gjitha strukturat e ndryshme edukative, përfshirë familjen, shkollat, universitetet, mjetet e komunikimit dhe informimit dhe fondacionet e ndryshme shoqërore. Gjithashtu përfshin zhvillimin dhe përgatitjen në fushën njohëse dhe morale në çështjet fetare dhe shkencore, duke përfshirë të gjithë individët të moshave të ndryshme. Sa i përket pesë kuptimeve që i cekëm më lartë, shumica e përmbajtjeve të tyre përfshihet në atë që e quajmë “mendimi pedagogjik islam”. Elementet e këtij mendimi përfshihen në çështjet vijuese:

Trashëgimi islame që përfshin shkrimet e dijetarëve islamë rreth diturisë, mësim-nxënies dhe mësimdhënies, qofshin këto shkrime tekste reference, dispozita juridike, përshkrim i praktikave dhe institucioneve në historinë islame rreth realitetit që e kanë përjetuar periudhat e kësaj trashëgimie ose përkufizim i asaj se si duhet të jetë ky realitet. Këto elemente janë më afër bisedës rreth pedagogjisë në historinë islame.

Komentim dhe shpjegim të ajeteve kur'anore dhe haditheve pejgamberike që ndërlidhen me diturinë, mësim-nxënien dhe mësimdhënien, me qëllim të udhëzimit të praktikave arsimore në shoqëritë islame për ruajtjen e identitetit islam të këtyre shoqërive. Komentimi dhe shpjegimi mund të përfshijë atë që ishte e pranishme në trashëgimi, dhe kështu mbetet vazhdim i trashëgimisë, ose është kuptim i ri që e kërkojnë rrethanat, nevojat dhe problemet e të së tashmes, gjë që e bën të jetë mendim bashkëkohor.

Riformulim i mendimit pedagogjik në formimin dhe zhvillimin e tij historik te popujt e ndryshëm, përfshirë edhe teoritë dhe filozofitë e këtij mendimi, duke i bërë analizë kritike, me qëllim që të përcaktohet se ç'mund të pranohet, ç'mund të refuzohet, e ç'mund të përmirësohet, bazuar në dritën e referencave islame.

Diskutimi i rrymave ideologjike dhe filozofive pedagogjike bashkëkohore dominuese sot në shoqëritë islame, duke sqaruar pasojat e këtyre rrymave dhe filozofive në imitim, dobësim, rënie të kreativitetit shkencor dhe mendor, dhe mungesa e kontributit civilizues në botë.

Vërehet se shkrimi rreth mendimit pedagogjik islam<sup>17</sup> ka filluar të kristalizohet në mënyrë të dalluar me fillimin e shekullit XX, nga mesi dhe pjesa e dytë e tij shtohet edhe më shumë. Vërehet se fillimet e hershme ishin tema universitare të shkruara në universitete perëndimore, ku më pas kjo ide kaloi edhe në universitetet arabe. Në të dy rastet, dimension i historik, ishte përmbajtja e këtyre temave, përfshirë tematikat arsimore, institucionet, burimet dhe personalitetet.<sup>18</sup> Prej shkrimeve të mëhershme veçojmë:

<sup>17</sup> Ose "mendimi pedagogjik arab", ngase disa autorë kanë preferuar që titujt e librave të tyre të jenë rreth "mendimit arab", me qëllim të jenë të përshtatshme me rrethanat politike që kanë dominuar në disa periudha historike të disa vendeve. E gjithë kjo me qëllim të ngritjes së çështjes kombëtare, duke iu shmangur çështjeve fetare. Duhet theksuar se përmbajtja e këtyre librave, pothuaj tërësisht përfshinë bisedë rreth dijetarëve të umetit islam gjatë historisë islame, dhe rreth shkollave të mendimeve pedagogjike të njohur në histori, pa marrë parasysh përkatësinë etnike dhe kombëtare të këtyre dijetarëve ose personaliteteve të këtyre shkollave.

<sup>18</sup> Abdullah Abdudajim, **Et-Terbijetu abre't-tarih: mine'l-usur'il-kadimeti hatta evail'il-karn'il-ishrine**, Bejrut: Dar'ul ilmi li'l-melajine, botimi 5, 1984. Autori në fq. 5 tregon se botimi i parë i këtij libri ka qenë në vitin 1960. Në parathënieën e tij, autori ka thënë: "Njohja e zhvillimit të mendimit pedagogjik është një hyrje e nevojshme për gjithë ata që dëshirojnë të kuptojnë teoritë, orientimet dhe sistemet pedagogjike, në të cilat jemi duke jetuar sot. Këto teori, orientime dhe sisteme, sado që të ripërtërihen, ato janë rezultat i

Halil Totah në librin e tij “Pedagogjia tek arabët”, i botuar në shtypshkronjën tregtare në Nabuls të Palestinës më 1935. Libri është përkthim i temës së doktoraturës së autorit të mbrojtur në Universitetin amerikan Kolumbia.

Muhamed Es’ad Tales, në librin e tij “Edukimi dhe arsimimi në islam”, i botuar më 1960. Libri në esencë është pjesë e temës së doktoraturës së tij të mbrojtur në Universitetin e Sorbonës më 1939.<sup>19</sup>

Ahmed Fuad Ehvani, i cili ka mbrojtur temën e doktoraturës në Universitetin e Kajros më 1943 me titull: “Pedagogjia në islam”. Temës ia ka bashkëngjitur librin e detajuar rreth “Gjendjes së mësuesve dhe nxënësve” të Kabisiut, dhe librin “Edukata e mësuesve” të Ibn Sehnunit.<sup>20</sup>

Hitab Atijje Ali në disertacionin e tij me titull: “Arsimi në Egjipt në pjesën e parë të periudhës fatimite”, të cilin e ka botuar më 1947 Dar’ul-Fikr’il-Arabi në Kajro.

Ahmed Shelebi, i cili ka përgatitur temën e tij të doktoraturës në Universitetin e Kembrixhit më 1953 me titull: “Historia e pedagogjisë islame”. Botimi i parë në arabisht ishte më 1967.<sup>21</sup>

Fet’hije Hasan Sulejman, e cila ka shkruar rreth “Orientimi pedagogjik i Gazaliut”, e botuar më 1965 në Kajro: Dar’ul-He-na. Më pas ka shkruar rreth “Orientimi pedagogjik i Ibn Sehnunit”, e botuar më 1957 në Kajro: Mektebetu Nahdati Misr.

Abdullah Abdudajim, i cili ka botuar librin e tij më 1960 rreth Historisë së pedagogjisë. Në të ka përfshirë një kapitull me titullin? “Pedagogjia arabe” ku ka folur për institucionet, planprogramet dhe personalitetet e arsimit islam.

Muhamed Emin Misri në librin e tij “Vështrime rreth mjeteve dhe qëllimeve të pedagogjisë islame”, ku botimi i parë

një historie të gjatë dhe eksperiencë me rrënjë të largëta... Mund që të mos kuptojmë shumë nga frutet e pedagogjisë moderne nëse nuk i njohim bazat dhe rrënjët, dhe nëse nuk e kemi të qartë se si kanë lindur dhe formuar përmes trashëgimisë historike të cilës i përkasin” fq. 6-7. Këtu vërejmë se në një pragraf, autori ka përdorur termet: mendimi pedagogjik, teoria pedagogjike, sistemet pedagogjike dhe trashëgimia historike e pedagogjisë moderne.

<sup>19</sup> Muhamed Es’ad Tales, **Et-Terbijetu ve’t-ta’limu fi’l-islami**, Kajro: Muessesetu Hindavi li’t-ta’limi ve’t-thekafeti, 2014, fq. 27. Botimi i parë i librit ka qenë në vitin 1960.

<sup>20</sup> Ahmed Fuad El-Ehvani, **“Et-Terbijetu fi’l-islam”**. Temës ia ka bashkëngjitur librin i detajuar rreth “Gjendjes së mësuesve dhe nxënësve” të Kabisiut, dhe libri “Edukata e mësuesve” të Ibn Sehnunit, Kajro, Dar’ul-Mearif, 1968.

<sup>21</sup> Ahmed Shelebi, **Tarih’ut-terbijet’il-islamijeti**, Kajro: Dar’ul-Keshshaf, 1954.

ka ndodhur në Damask: Dar'ul-Fikr, pa vit botimi, edhe pse supozohet të jetë viteve të gjashtëdhjeta të shekullit XX. Kopja që është në disponim në shumë faqe të internetit është botimi i katërt i vitit 1978.

Sot, në disponim ka shkrime të shumta rreth mendimit pedagogjik bashkëkohor islam. Për këtë numër të madh të shkrimeve ka kontribuar rritja e vazhdueshme e universiteteve dhe fakulteteve pedagogjike, dalja në shesh e disa revistave periodike shkencore, të specializuara në edukim dhe arsimim. Disa prej tyre të veçanta për arsimin islam. Po ashtu ka kontribuar edhe themelimi i shoqatave profesioniste të specializuara në edukim dhe arsimim, organizimi i konferencave ndërkombëtare, rajonale dhe vendore rreth çështjeve të pedagogjisë islame dhe mendimit pedagogjik islam. E gjithë kjo rreth prezencës së mendimit islam në jetën bashkëkohore.

Prej ngjarjeve të rëndësishme që ka rritur interesimin për mendimin pedagogjik islam është edhe organizimi i konferencës së parë Ndërkombëtare rreth arsimit islam, i mbajtur në Meke në periudhën 12-20 Rabiuthani 1397, respektivisht 31 Mars-8 Prill 1977 nën patronazhin e Universitetit Mbreti Abdulaziz. Në këtë konferencë kanë marrë pjesë 313 mendimtarë, dijetarë dhe hulumtues nga 40 vende. Në te, krahas studimeve që janë bërë rreth gjendjes së arsimit në vendet e ndryshme islame, janë paraqitur edhe 150 tema. Pika e rëndësishme në te ishte interesimi i madh për përcaktimin dhe pranimin e kriterëve për zhvillimin e arsimit islam në shkolla dhe universitete si rrugë për përmirësimin dhe reformimin e realitetit të shoqërive islame. Si rezultat i punimeve të kësaj konference merret vendimi për themelimin e Qendrës Botërore për Arsimin Islam me seli në Universitetin e Mbretit Abdulaziz në Xhidë, themelimi i revistës periodike rreth arsimit islam në gjuhën angleze me seli në Britani, organizimi i konferencave profesionale në të ardhmen. Punimet e kësaj konference janë botuar në gjashtë vëllime në gjuhën arabe, pas përkthimit të punimeve që ishin në gjuhën angleze. Po ashtu gjashtë vëllime në gjuhën angleze, pas përkthimit të

punimeve që ishin në gjuhën arabe.<sup>22</sup> Më pas u organizuan edhe katër konferenca tjera, në Pakistan (1979), Bangladesh (1981), Indonezi (1985) dhe Egjipt-Kajro (1987). Secila konferencë ka përfshirë një fushë të caktuar të pedagogjisë islame. Të gjitha këto konferenca formuan një shtytje rreth interesimit për orientimin islam në sferat e reformimit arsimor, themelimin e universiteteve islame në disa shtete, zhvillimin e plan-programeve dhe projekteve të islamizimit të diturisë, islamizimi i shkencave, orientimi islam i shkencave etj.<sup>23</sup>

Bazuar në atë se sot kemi një numër të madh të shkrimeve dhe shkrimtarëve rreth mendimit pedagogjik islam, ndoshta nuk është e udhës të bëjmë një listë, ku nuk do të përfshinte të gjithë. Megjithatë, do të tregojmë disa nga pionierët që kanë kontribuar në organizimin e konferencave dhe orientimin e interesimit për tematikat e tij gjatë bisedave rreth mendimit pedagogjik islam të cilat janë shkruar në gjuhët joarabe. Sa i përket atyre që kanë kontribuar për të pasuruar këtë fushë me shkrimet e tyre në gjuhën arabe gjatë një periudhe për më shumë se gjysmë shekulli, ku krahas aktivitetit praktik pedagogjik në arsimin publik dhe atë universitar kanë dhënë kontribut të dalluar në sasinë dhe cilësinë e shkrimeve pedagogjike. E shohim për obligim të shkruajmë për dy më të dalluar prej tyre, pa zhvlerësuar edhe të tjerët:<sup>24</sup>

**Seid Ismail Ali:** profesor i bazave të pedagogjisë në Universitetin Ajnu Shems në Egjipt. I lindur në Kajro më 1937. Ka nxjerrë mijëra studentë, të cilët më pas janë bërë profesorë në shumë universitete të vendeve të ndryshme. Deri më tani

<sup>22</sup> Gjashtë vëllimet në gjuhën angleze janë botuar në bashkëpunim mes universitetit të mbretit Abdulaziz në Xhidë dhe shtëpisë britanike për botim Hodder and Stoughton.

<sup>23</sup> Dr. Sejjid Ali Eshref, në konferencën me titull: "Drejt formimit të një teorie pedagogjike bashkëkohore islame" të organizuar në Aman të Jordanisë më 1990 ka paraqitur një kumtesë të detajuar rreth vlerësimit të punëve dhe rekomandimeve të pesë konferencave. Shih: Sayed Ali Ashraf, "Islamic Education: Recommendations and Implementation of the Five Conferences on Islamic Education".

Kumtesa e kompletuar është botuar në punimet e konferencës. Shih: Fet'hi Hasan Melkavi, *Buhuth ul-mu'temer'it-terbevijji, Amman: el-ma'had'ul-alemijju li'l-fikr'il-islamijji ve xhem'ijjet'ud-dirasati ve'l buhuth'il-islamijjeh*, 1990, vëllimi i parë, pjesa në gjuhën angleze, fq. 1-22.

<sup>24</sup> S'ka dyshim se njohja e drejtpërdrejtë e autorit me këta dy personalitete të mendimit pedagogjik bashkëkohor islam, si dhe kontakti dhe bashkëpunimi i tij personal me ta, është i mjaftueshëm për të njohur detajisht kontributin e tyre. Ata me këmbëngulësinë e tyre të qartë për reformat pedagogjike islame janë dalluar nga të tjerët. Zgjedhja e autorit të këtyre dy personaliteteve është bazuar në njohje dhe kontakte të drejtpërdrejta.

ka shkruar më shumë se 120 libra, shumica e të cilave janë në fushën e mendimit pedagogjik islam. Ka dhënë kontribut në artikuj shkencorë, libra dhe praktikë në fushën e arsimit publik dhe atij universitar. Ai, krahas qindra hulumtimeve dhe shkrimeve në disa periodikë shkencorë dhe gazeta javore dhe ditore, ka nxjerrë edhe revistën “Studime pedagogjike” prej 80 vëllimeve dhe “çështje pedagogjike” prej 16 numrave. Prej librave më të njohura të tij janë: Enciklopedia “zhvillimi civilizues i pedagogjisë islame” në shtatë vëllime, enciklopedia “zhvillimi kulturor i arsimit në Egjipt” në pesë vëllime, enciklopedia “Bazat e fikhut pedagogjik islam” në katër vëllime etj.

**Maxhid Arsan Kilani:** i lindur më 1932 në fshatin Shexhe-  
ra, afër qytetit Remtha të Jordanisë. Ka punuar në arsimin publik dhe atë universitar. Ka vdekur më 2015. Është specializuar në studimin e historisë dhe pedagogjisë. Ka studiuar në Universitetin e Kajros, Universitetin e Jordanisë, Universitetin amerikan në Bejrut, Universitetin Petersburg në Panselvani të Amerikës. Ka ligjëruar në universitete të ndryshme të Jordanisë, Arabisë Saudite dhe Emiratet e Bashkuara Arabe. Prej veprave të tij në fushën e mendimit pedagogjik, veçojmë: “Zhvillimi i konceptit të teorisë pedagogjike islame”, “Qëllimet e pedagogjisë islame”, “Filozofia e pedagogjisë islame”, “Pedagogjia dhe e ardhmja në universitetet islame”, Programet pedagogjike islame dhe pedagogët”. Libri më i njohur i tij është “Kështu është shfaqur gjenerata e Salahudinit dhe kështu është kthyer Kudusi”, i cili është botuar në qindra mijëra kopje dhe është përkthyer në shumë gjuhë. Ai ka sqaruar se dukuria “Salahudin” nuk është dukuri e një trimërie individuale e jashtëzakonshme, por është rezultat i përpjekjeve të umetit në reforma politike, ideologjike dhe pedagogjike. Kjo dukuri është një model që mund të përsëritet në çdo kohë. Ai, gjithashtu ka sqaruar rëndësinë e kuptimit të ligjeve historike dhe mundësitë e praktikimit të tre bashkëkohore në jetën e umetit.



### 3.2. Shkrimet pedagogjike në gjuhët joarabe

Më lart biseduam rreth mendimit pedagogjik islam të shkruar në gjuhën arabe. Mirëpo, përgjegjësia shkencore në obligon të theksojmë edhe përpjekjet e ndryshme që janë hartuar në shoqëritë islame joarabe rreth zhvillimit të pedagogjisë islame dhe mendimit pedagogjik islam, në veçanti në Malejzi, Indonezi, Indi, Pakistan, Turqi, Iran dhe në vende të ndryshme të komuniteteve islame në Evropë dhe Amerikën Veriore. Janë shkruar vepra në gjuhët e popujve joarab, si ajo angleze dhe gjuhë tjera evropiane, të cilat saktësisht nuk dihat numri i tyre dhe vetëm një numër i vogël i tyre janë përkthyer në gjuhën arabe. Në mesin e atyre veprave që janë përkthyer janë edhe disa disertacione universitare që janë mbrojtur në universitetet evropiane dhe amerikane, të cilat pas botimit të tyre në gjuhën arabe janë bërë pjesë e botimeve arabe, të cilat i cekëm më lartë. Karakteristikë e tyre është se kanë praktikuar një metodologji të prerë hulumtuese, ku disa prej tyre kanë përfshirë në përmbajtjet e tyre edhe mendime të orientalistëve.

Sa i përket lëndës së mendimit pedagogjik islam që janë shkruar në gjuhët joarabe, mund të dallohen për nga:

- Libra të shkruara në gjuhë të popujve muslimanë nga ana e autorëve muslimanë në shoqëritë islame joarabe nga këndvështrimi islam. Shumë prej këtyre librave trajtojnë çështje pedagogjike lokale që merren me reformimin e gjendjes së arsimit islam në institucionet tradicionale islame të njohura me emrin “medrese” ose “dar’ul-ulum” në vendet e Indisë, “el-havze” në Iran, “medresetë për imam dhe hatib” në Turqi. Kemi edhe libra që trajtojnë gjendjen e arsimit islam në shoqëritë që kanë numër të madh të jomuslimanëve si në Malajzi, ose në shoqëritë ku muslimanët janë pakicë, si në Tajlandë, Filipinë, Kinë etj.<sup>25</sup>

Libra të shkruara me gjuhë evropiane, në veçanti ajo angleze, franceze, spanjolle dhe gjermane, nga ana e jomuslimanëve. Pa dyshim se ka një numër të madh të këtyre shkrime-

<sup>25</sup> Duhet theksuar se edhe ne kemi bërë ca hulumtime rreth arsimit islam në mesin e shqiptarëve të Maqedonisë, të cilat janë botuar në revista të ndryshme shkencore. (Vërejtje e përkthyesit)

ve. Disa prej tyre kanë përmbajtje rreth sqarimit historik të prezantimit islam në fushën e arsimit në periudha kohore dhe vende të caktuar gjeografike. Disa shkrime të tjera janë ndikuar nga metodologjia kritike orientaliste, të cilat në vete mund të ngërthejnë vlera shkencore, por edhe si rezultat të mungesës së informacioneve mund të ngërthejnë edhe të kuptuar të gabuar.

Libra të shkruara në gjuhë evropiane nga muslimanë që jetojnë në Evropë dhe Amerikën Veriore. Këto libra janë shkruar nga këndvështrimi i tyre për të njoftuar me mendimin pedagogjik islam ose thërrasin në reforma ose kritikojnë kontekstet historike dhe e shohin si shkak për prapambetjen e muslimanëve.

Libra të shkruara për shërbim të komuniteteve islame si lëndë mësimore në institucionet arsimore islame publike dhe universitare.

Libra të shkruara rreth arsimit islam në qendrat për hulumtim në Evropë, Amerikë, Kinë, Rusi e tjera me shtytje ideologjike dhe politike, me qëllim të akuzimit të këtyre institucioneve se kinse zhvillojnë ekstremizmin dhe dhunën.

Ky sinjal kalimthi rreth shkrimeve në mendimin pedagogjik islam në gjuhët joarabe është i pamjaftueshëm. Çështja kërkon një kujdes edhe më të madh. Andaj propozojmë që këto shkrime të jenë temë i një hulumtimi shkencor ose një projekti hulumtues që do të ngërthen disa hulumtime, që do të përpiqen për të grumbulluar, verifikuar, studiuar përmbajtjen, sqaruar rëndësinë, karakteristikat dhe rezultatet e këtyre shkrimeve. Pas grumbullimit të tyre, rezultatet të përkthehen në gjuhën arabe dhe gjuhë të tjera për të realizuar një lloj bashkëpunimi dhe këmbim të përvojave mes të interesuarve për çështjen e mendimit pedagogjik islam në nivel të umetit.<sup>26</sup>

<sup>26</sup> Është e përshtatshme të kujtojmë gjashtë vëllimet e kumtesave të Konferencës së Parë rreth arsimit islam në Mekë, të cilat janë botuar në gjuhën arabe nga ana e universitetit të Mbreti Fejsal në Xhidë dhe në gjuhën angleze nga ana e shtëpisë botuese Hodder and Stoughton në Londër. Këto kumtesa janë referencë e rëndësishme për të njoftuar rreth interesimit të vazhdueshëm për reformimin e arsimit nga këndvështrimi islam. Këto kumtesa kanë njoftuar rreth një numri të madh të mendimtarëve musliman të specializuar ose të interesuar për pedagogjinë në shtetet islame dhe komunitetet islame jashtë shteteve islame.

Për të dhënë një pasqyrë të shkurtër rreth rëndësisë dhe burimeve të asaj që është shkruar rreth mendimit pedagogjik islam në gjuhët joarabe, do të tregojmë disa nga revistat periodike të specializuara në pedagogjinë islame, të cilat botohen në disa vende islame. Ja disa prej tyre:

Revista “Edukata në shoqërinë muslimane” që botohet në gjuhën angleze në Universitetin islam shtetëror Sherif Hidajetullah në Xhakarta, në bashkëpunim me pedagogët islamë (Scholars of Islamic Education) në Indonezi. Tarbiya: Journal of Education in Muslim Society

Revista: “Edukata islame” në gjuhën indoneziane e botuar në Universitetin islam shtetëror në vilajetin Joxhikarta. Jurnal Pendidikan Islam (Islamic Educational Journal).

Revista “Edukata islame” (Revistë ndërkombëtare periodike) që boton punimet në gjuhët: malajziane, angleze dhe arabe, dhe botohet nga Fakulteti Pedagogjik në Universitetin Malaja të Malajzisë. Online journal of Islamic Education (O-JIE)

Revista “Arsimi islam dhe arab” e botuar në gjuhën malajziane, angleze dhe arabe nga Universiteti kombëtar në Malajzi. Journal of Islamic and Arabic Education.

Revista “Edukata islame”, revistë periodike në gjuhën perse e botuar në Universitetin e Imam Husejnit në Iran, ndërsa abstraktet në gjuhën angleze. Journal of Islamic Education (Imam Hossein University) Iran.

Revista “Edukata islame” e botuar në gjuhën perse nga Qendra për hulumtime El-Havze, ndërsa abstraktet në gjuhën angleze.

Revista “shkencat fetare” në gjuhën turke (Dini Arastirmalar). Kjo revistë ka botuar një hulumtim të rëndësishëm në vëllimin 9, nr. 25 i viti 2006 me titull: “Zhvillimi i përvojës së arsimit fetar dhe vështrim ndaj arsimit fetar bashkëkohor në Turqi”.

- Periodiku “Edukata islame” e botuar në gjuhën angleze nga Akademia Islame në Kembrixh të Britanisë. (Muslim Education Quarterly).<sup>27</sup>

<sup>27</sup> Duhet theksuar se edhe në gjuhën shqipe kemi Revistën “Edukata islame” e botuar nga Bashkësia Islame e Kosovës dhe Revista “Ikra” e botuar nga Bashkësia Islame e Maqedonisë (Vërejtje e përkthyesit).

Mjaftojmë me këto shembuj rreth revistave të specializuara në arsimin dhe edukimin islam jashtë vendeve arabe. Numri i tyre është shumë i madh. Kështu rrallë mund të ndodhë që ndonjë vend të mos ketë së paku një revistë, në veçanti në çerekshekullin e fundit të shekullit XX, ku në këtë kohë u themeluan universitete të ndryshme islame.

Krahas këtyre temave rreth edukatës islame që publikohen në revista shkencore, shumë tema të edukatës islame publikohen edhe në revista tjera që nuk bartin emërtimin “edukata islame”. Prej këtyre revistave veçojmë:

Revista “Studime islame” që e boton Qendra Oksford për Studime Islame (Journal of Islamic Studies)

Revista “Studime arabe dhe islame” e botuar në Universitetin Bergin në Norvegji (Journal of Islamic Research)

Revista “Studime Islame” e botuar në Institutin e Hulumtimeve Islame në Univesitetin Islam Ndërkombëtar në Islamabad të Pakistanit. (Journal of Islamic Studies)

“Revista Amerikane për Shkencat Islame dhe Shoqërore” e botuar nga Instituti Botëror i Mendimit Islam në Hirind të SHBA-ve. (The American Journal of Islamic Sciences).

Revista akademike periodike në gjuhën turke me emrin. “Vakfi i Erzurumit për kulturë dhe arsim” (EKEV Academi Journal). Kjo revistë ka publikuar një temë të rëndësishme në vëllimin 10, nr. 26 të vitit 2006 me titull: Disa mendime të veçanta rreth politikës së arsimit fetar në Turqi”.

Gjendja e arsimit islam në vendet evropiane dhe Amerikën Veriore meriton një kujdes më të madh. Ekziston një mendim pedagogjik islam i cili është duke u zhvilluar në mënyrë të baraspeshuar mes orientimeve të trashëgimisë pedagogjike dhe përvojave të arsimit bashkëkohor. Në të përplotësohen elementet e prezantimit efektiv të identitetit islam dhe integritetit efikas në shoqëritë evropiane dhe amerikane.<sup>28</sup> Në Amerikën Veriore, numri i shkollave islame është rritur më shumë se 250. E gjithë kjo krahas shumë shkollave

- <sup>28</sup> Ekziston një dallim i vogël të prezencës islame në shoqëritë evropiane dhe amerikane. Shumica e muslimanëve në Evropë janë nën mesataren ekonomike dhe arsimore, në kohë kur shumica e muslimanëve në Amerikë janë mbi mesataren në kriteret ekonomike dhe arsimore.

që nuk mund të numërohen, siç janë shkollat javore, ato të mbrëmjes apo shkollat shtëpiake (homschooling).

Për shërbim të arsimit islam në këto shkolla, në Amerikë dhe Kanada janë themeluar shumë këshilla, lidhje dhe shoqata të specializuara në edukimin dhe arsimin islam. Prej tyre veçojmë: “Këshilli i arsimit islam në Amerikën Veriore”<sup>29</sup> dhe “Lidhja e shkollave islame në Amerikë”.<sup>30</sup> Disa prej tyre janë vazhdimësi e “Darul ulum” të njohura në Indi dhe Pakistan. Disa janë institucione lokale në qytetet e mëdha amerikane. Disa janë institucione të specializuara për reklamim të orientimeve ideologjike, fetare dhe juridike. Disa prej këtyre institucioneve janë si rezultat i përpjekjeve të emigrantëve nga vendet islame, ndërsa disa të tjera nga përpjekjet e muslimanëve amerikanë, me origjinë afrikane.<sup>31</sup> Në shërbim të këtyre shkollave janë themeluar institucione për prodhim të programeve, librave dhe mjeteve të shumta mësimore. Shumë hulumtime dhe studime të veçanta rreth arsimit islam janë publikuar në SHBA.

Për të kuptuar sasinë dhe llojin e hulumtimeve dhe studimeve të publikuara rreth çështjeve të arsimit islam në Amerikën Veriore japim disa shembuj dhe referencat e tyre:

- Berglund, Jenny. *Publicly Funded Islamic Education in Europe and the United States*, Brookings Project on U.S. Relations with the Islamic World, Analysis paper no. 21 April 2015 (52 pages).

- Grewal, Zarena and Coolidge, David. *Islamic Education in the United States: Debates, Practices and Institutions*. In Hammer, Juliane and Safi, Omid. *Cambridge Companion to American Islam*, Chapter 14, pp 246-265. Cambridge University Press 2013.

- Keyworth, Karen. *Islamic Schools of United States: Data-Base Profiles*. Washington: Institute for Social Policy and Understanding (ISPU) Report, May 2011.

<sup>29</sup> Council of Islamic Schools in North America - CISNA

<sup>30</sup> Islamic Schools League of America - ISLA

<sup>31</sup> Afro-American Muslims especially those affiliated Nation of Islam communities headed by Louis Farrakhan.

- Malkawi, Fathi. The Future of Muslim Education in the United States: An Agenda for Research, *American Journal of Islamic Social Sciences*, vol. 20, issue 3&4, 2004, pp. 46-82.

Nëse përpjekjet rreth “arsimit islam” në esencë i drejtohen fëmijëve të muslimanëve, ekzistojnë edhe përpjekje të mëdha rreth “arsimit ndaj islamit”. Në disa shoqëri jomuslimane, rreth feve flitet në arsimin shkollor dhe atë në kontekst të studimeve historike dhe shoqërore. Vërejmë se tekstet shkollore flasin për Islamin dhe muslimanët në mënyrë joobjektive; ose si rezultat i panjohurive nga ana e autorëve, ose shtrembërim të qëllimtë. Edhe gjendja e mësimdhënësve nuk është më e mirë. Nxënësit muslimanë dhe përgjegjësit e tyre janë ballafaquar me raste të tilla dhe kanë ofruar të dhëna për përmirësimin e çështjeve të shtrembëruara. Ky përmirësim ka hasur në mirëkuptim nga ana e mësimdhënësve dhe administrata arsimore, gjë që e ka nxitur Institutin Botëror për Mendim Islam në SHBA të përgatit një projekt rreth rishqyrtimit të teksteve shkollore në studimet shoqërore për të zbuluar mangësitë apo gabimet në informacionet të cilat ndërliidhen me Islamin dhe muslimanët dhe për të përgatitur një udhëzim që do t’ju ofrohet mësimdhënësve rreth përmirësimeve dhe shtojcat e nevojshme. Kështu, janë botuar udhëzime në shtatë vëllime që ngërthejnë këto çështje dhe të njëjtat janë shpërndarë në shkollat amerikane. Instituti për të aftësuar mësimdhënësit se si duhet përfiturat prej tyre ka organizuar trajnime të ndryshme.<sup>32</sup>

Në këtë kontekst thirrjet janë shtuar edhe në atë drejtim ku jomuslimanët do të njihen më shumë me Islamin në shoqëritë ku muslimanët janë pakicë. Disa hulumtues, vendimmarrës pedagogjikë dhe institucione janë angazhuar për të thelluar këtë kuptim në shkrimet e tyre. Shembull për këtë kemi studimin e hulumtuesit malajzias që e ka publikuar “Revista Botërore për Arsim dhe Hulumtim” e cila botohet në Australi, në të cilin flet për udhëzim strategjik të pedagogjisë islame me qëllim të zhvillimit të kësaj pedagogjie ku do të kujdeset

<sup>32</sup> Douglas, Susan. *Muslims in our Community and Around the World: A Supplementary Social Studies*. Herndon VA: International Institute of Islamic Thought and Dubuque, Iowa: Kendall/ Hunt Publication Co. 1995. (Seven Manuals were published in the series each with special title.)

për formimin e njeriut të vyeshëm në një sistem jete ku do të realizojë bindjen e muslimanëve dhe jomuslimanëve se Islami dhe edukimi në frymën islame janë “mëshirë për botët”.<sup>33</sup> Strategjinë të cilën e propozon hulumtuesi kërkon zhvillimin e arsimit islam ku do të riformulohet sipas bazamenteve filozofike dhe njohëse të Islamit, në të së cilave formohet sistemi, administrata, praktikat e mësimdhënies dhe mësim-nxënies. Më pas për të dhënë Islami frutat e tij, procesi duhet të mbështetet me përpjekje kreative ku pedagogjinë islame dhe frutat e tij do t'i vendoste në pozicione udhëheqëse dhe do të lirohej nga imitimi dhe vlerësimi sipas kriterëve të tjerëve.

Sahin, Abdullah. *New Directions in Islamic Education: Pedagogy and Identity Formation*, Kube Publishing Ltd, May, 2015.

#### 4. Pozita e mendimit pedagogjik islam në përpjekjet e ngritjes civilizuese të umetit

Reformimi i arsimit pedagogjik është kërkesë esenciale për realizimin e ngritjes civilizuese të popujve islam, ngase ai konsiderohet çelës i reformimit dhe ndryshimit në të gjitha sferat tjera. Kërkesat reformuese drejtoreshin në dy çështje: e para- reformimi didaktik i programeve dhe metodave të mësimdhënies së shkencave islame në institucionet tradicionale të arsimit islam, si në El-Ez'her, Ez-Zejtune, El-Karavijin dhe institucione tjera në Turqi, Iran Indi; dhe e dyta: përfshirja e lëndëve të reja mësimore, krahas atyre tradicionale. Autorët e kësaj kërkesë mendojnë se lëndët e reja shkencore (qytetare, praktike dhe aplikative), pikërisht janë ato që kanë mundësuar popujt e tjerë të realizojnë fuqinë, lulëzimin, epërsinë prodhuese dhe civilizuese. Është me rëndësi të përkujtojmë se thirrësit më të njohur në këto dy drejtime janë: Xhemaludin Afgani, Muhamed Abduhu, Shekib Arslan. Abdurrahman Kevakibi, Muhamed Reshid Rida, Hasan El-Benna,

<sup>33</sup> Salleh, Muhammad Syukri. "Strategizing Islamic Education", *International Journal of Education and Research*, Vol 1, No. 6, June 2013, fq. 1-14.

Ebu'l-A'la Mevdudi, Ebu'l-Hasan Nedevi, Abdulhamid ibn Badis, Beshir Ibrahim, Muhamed Tahir ibn Ashur etj.<sup>34</sup>

Në gjysmën e dytë të shekullit XX, thirrjet për reforma pedagogjike, i tejkaluan këto çështje dhe ndjehej domosdoshmëria për aktivizimin e pranisë së mendimit islam në mësimin e gjitha sferave, përfshirë shkencat shoqërore, humane dhe natyrore, për të bërë të mundur të kuptohet se vizioni islam para botës<sup>35</sup> është ai që udhëheq filozofitë, teoritë dhe praktikën orientuese të këtyre shkencave. Duhet kuptuar se përgjithësimi i arsimit bashkëkohor, sistemet, filozofitë dhe teoritë e të cilit janë transferuar nga perëndimi, ka shkaktuar një ndarje në personalitetin e muslimanit në aspektin intelektual dhe psikik, si dhe në formimin e shoqërisë muslimane. E gjithë kjo si rezultat i dallimeve mes asaj që ofrojnë lëndët e edukatës dhe shkencave islame nga njëra anë dhe programet e lëndëve mësimore në shkencat shoqërore dhe natyrore nga ana tjetër. Realiteti arsimor ka thelluar këtë dualitet në të menduar, bile edhe në të njëjtin institucion. Kështu në të njëjtin universitet gjejmë fakultet me emërtim islam si: fakulteti i shariatit, fakulteti i shkencave islame, fakulteti i shkencave të shariatit, fakulteti i studimeve islame, krahas fakulteteve me emërtime tjera në të cilat nuk ka fare mendim islam në to si: fakultetet e letërsisë, fakulteti i administratës, fakulteti ekonomik, fakulteti i shkencave, fakulteti i mjekësisë, fakulteti i inxhinierisë etj.

Këtu lindi ideja për trajtimin e këtij realiteti përmes zhvillimit të shkencave islame për të paraqitur vizionin e përshtatshëm për bashkëpunim me shkencat tjera, për unifikimin e sistemit arsimor (islam dhe joislam), anulimin e këtij dualizmi, zhvillimin e pikëpamjes islame në mësimin e gjitha

<sup>34</sup> E ndjej të domosdoshme që me këtë rast të tregoj rëndësinë e asaj për të cilën ka ftuar Muhamed Tahir ibn Ashur që nga fillimi i shekullit XX dhe atë që e ka realizuar në mënyrë praktike. Kjo shihet në njërin nga librat më të rëndësishme të tij. Shih:

Ibn Ashur, Muhamed Tahir. Eljese subhu bikarib? Et-ta'lim'ul-arabijj'ul-islamijju: dirasetun tarihijetun ve arauan ishlahijjetun, Tunizi & Kajro: Daru Sehnun & Darsus selam, botimi 2, 2007. Po ashtu, lexo përpjekjet e reformave të përgjithshme ideologjike të cilat i ka realizuar Ibn Ashuri në librin:

Melkavi, Fet'hi Hasan. El-Shejh Muhamed Tahir ibn Ashur ve kadaja'l-islami ve't-texhdidi fi'l-fikr'il-islamijj'il-muasir, ru'jetun ma'rifiijetun ve menhexhijeh, Hirnedin, Virxhinia, El-Ma'had'ul-Alemijju li'l-fikr'il-islamijj, 2011.

<sup>35</sup> Islamic Worldview



shkencave dhe realizimin e islamizimit të tyre. Arena e mendimit islam ka njohur një numër të mendimtarëve të cilët, bazuar në këtë ide, janë marrë me çështjen e “reformimit të arsimit”. Kështu ata për këtë qëllim pedagogjik, kanë shkruar, kanë edukuar dhe kanë themeluar institucione. Për këtë çështje janë angazhuar personalitete nga specializime akademike të ndryshme. Prej këtyre personaliteteve kemi: Muhammed Mubarek, Ismail Faruki, Muhamed Nekib Attas, Sejid Ali Eshref, Abdulhamid Ebu Sulejman, Taha Xhabir Alvani, Muhamed Haseni, Xhemaludin Atije, Imadudin Halil, Is’hak Ferhan, Muhamed Gazali, Horshid Ahmed, Jusuf Karadavi etj.

## 5. Sulmi ndaj arsimit islam në fillim të shekullit XXI

Ngjarjet e 11 Shtatorit të vitit 2001<sup>36</sup> bënë kthesë historike rreth gjendjes së arsimit islam dhe interesit të madh që e arriti me anë të hulumtimeve, studimeve dhe politikave. Qëndrimi zyrtar amerikan ka supozuar se personat që kanë kryer këtë akt janë rezultat i arsimit islam, i cili zhvillon urrejtjen dhe ekstremizmin dhe thërret për zbatimin e dhunës dhe terrorizmit. Edhe pse kritikantë amerikanë të këtij lloji të arsimit kishin filluar shumë më herët, por madhështia e ngjarjeve të asaj dite ishte arsye për të kaluar në një fazë të re të trajtimit të arsimit islam, me qëllim të ngrirjes së burimeve dhe ndryshimit të programeve të tij në moton e “luftimit të terrorizmit”. E gjithë kjo ishte një përpjekje e shumë shteteve të botës, të cilët, çështjen e “terrorizmit islam” e kishin konsideruar si armik kryesor dhe çështje më e rëndësishme politike brenda shtetit dhe në marrëdhëniet e jashtme.<sup>37</sup> Këto presione të

<sup>36</sup> Këtu është për qëllim ngjarjet e mëngjesit të ditës së martë më 11 shtator 2001, të cilat zyrtarisht janë komentuar si sulme vetëvrasëse ndaj SHBA-ve përmes katër aeroplanëve civilë të kidnapuar me qëllim të përplasjes me objektiva të caktuar. Tre prej këtyre aeroplanëve kanë shkaktuar rënien e dy kullave binjake, respektivisht Qendrën Tregtare në Nju Jork dhe një pjesë të Ministrisë së Mbrojtjes (Pentagoni) në Uashington. Ndërsa aeroplani i katërt është rrëzuar para se të arrijë te objektiva e caktuar. Në lidhje me këto ngjarje janë bërë analizimi dhe komentime shkencore dhe politike.

<sup>37</sup> Politikantë e SHBA-ve dhe raportet e saj me shtetet e Gadishullit Arabik u përcaktuan në atë mënyrë që këto shtete detyrohen të rezistojnë terrorizmin, të realizojnë reforma politike, arsimore dhe financiare për këtë qëllim. Shih: Nivin Abdulmunim Mesad, “Politika e jashtme amerikane përballë shteteve arabe pas ngjarjeve

jashtme u përputhën me atë se disa sisteme të shteteve arabe dhe islame kishin nisur disa procedura për ndryshimin e plan-programeve mësimore edhe më shumë se sa e kanë kërkuar këto presione.

Ajo që na intereson në këtë kontekst është volumi i interesimit me çështjen e “arsimit islam”. Dihet se institucionet perëndimore, pas këtyre ngjarjeve, ishin marrë shumë me studimin e sistemeve arsimore në shtet islame, në veçanti sistemin e medreseve (Madrassa Education) në shtetet e Azisë jugore. Ata kanë financuar dhjetëra studime për këtë qëllim dhe kanë ushtruar presione të mëdha ndaj shteteve arabe dhe islame për zhvillimin e sistemeve të arsimit fetar islam duke argumentuar se ato po mbështesin terrorizmin dhe urrejtjen.

Qindra referenca të cilat figurojnë në dhjetë kapitujt e një libri që flet për këtë temë, nxjerr në pah sasinë e studimeve dhe hulumtimeve që janë realizuar lidhur me sistemet e arsimit islam në shoqëritë islame, përfshirë këtu edhe Indinë, Pakistanin, Bangladeshin, Turqinë, Rusinë, Malajzinë, Indonezinë dhe Kinën.<sup>38</sup>

Për financimin e këtyre studimeve me bollëk kanë kontribuar institucione të shumta perëndimore. Në to kanë marrë pjesë edhe hulumtues muslimanë nga vendet në të cilat janë realizuar studimet. E gjithë kjo për çështje të përfitimit material ose nga bindja e tyre se gjendja e arsimit islam në vendet e tyre kanë nevojë për reformim, edhe nëse nuk është për qëllimin të cilin e synojnë institucionet financuese.

Zyra Kombëtare Amerikane për Hulumtime Aziatike ka ofruar mbështetje financiare për një projekt hulumtues për një afat tre vjetorë për të hulumtuar lidhshmërinë mes institucioneve të arsimit universitar në Pakistan dhe Bangladesh dhe orientimeve drejt ekstremizmit dhe dhunës.<sup>39</sup>

Vërehet se shumë prej studimeve perëndimore kanë pasur në shënjestër vendet e Azisë jugore dhe sistemet tradicionale të 11 Shtator 2001”, në: Prodhimi i urrejtjes në marrëdhëniet arabe-amerikane, Bejrut: Merkez dirasat'il-vahdet-il-arabijeti, 2003, fq. 235.

<sup>38</sup> Sa'eda Buang & Phyllis G. Chew (Ed.). *Muslim Education in the 21st Century, Asian Perspectives*, New York: Routledge, 2014.

<sup>39</sup> Mumtaz Ahmad & Nathew Nelson, *Islamic Education in Bangladesh and Pakistan, Trends in Tertiary Institutions*, Washington: National Bureau of Asian Reserach 2009.

të arsimit islam në to për shkak të lidhjes së këtyre sistemeve me dukurinë “Taliban” të njohur në këto vende, e cila ka luajtur rol në ngjarjet pas humbjes së Bashkimit Sovjetik në Afganistan, si dhe raporteve me organizatën “El-Kaida”, të së cilës i janë veshur sulmet kundër caqeve amerikane në vende të ndryshme.<sup>40</sup>

Ky numër i madh i studimeve akademike është përdorur si lëndë për luftën ideologjike që e kanë filluar institucionet politike me orientim armiqësor ndaj islamit dhe Botës Islame. Këto hulumtime janë shoqëruar me shumë gënjeshtër dhe shpifje të pavërteta, të cilat më pas u përdorën si arsytim për luftëra të cilat janë realizuar dhe vazhdojnë të realizohen ndaj vendeve të botë islame. Megjithatë, nuk kanë munguar disa zëra që mendojnë se rezultatet e studimeve të forta objektive kanë treguar për atë se “medresetë janë viktimë” (Madrasa as a scapegoat), ose argument i pabazë. Ata kanë zbuluar se shumica e atyre që njihen për mendime dhe qëndrime ekstremiste dhe që merren me dhunë, nuk ishin nxënës që kishin kryer arsimin islam.<sup>41</sup>

<sup>40</sup> Warnk, Holger. “Alternative Education or Teaching Radicalism? New literature on Islamic Education in Southeast Asia”, in: *Journal of Current Southeast Asian Affairs*, 28, 4. fq. 111-132.

Revista botohet në Gjermani nga Instituti gjerman për studime ndërkombëtare dhe studimeve të vendeve, në bashkëpunim me Institutin e studimeve aziatike dhe shtypshkronjën e Universitetit Hamburg.

<sup>41</sup> Shih p.sh.:

- Bergen, fq. & Pandey, S. The Madrasa myth, *New York Times*, 14 June 2005.

- Bergen, fq. & Pandey, S. The Madrasa Scapegoat, *Washington Quarterly*, 29, 2006, fq. 117-126.

- Moosa, Ibrahim. *What is a Madrasa?* The University of North Carolina Press, 2015.

## Pjesa e dytë: Zhvillimi i mendimit pedagogjik në civilizimet njerëzore dhe shoqërinë bashkëkohore

As ky libër, e as kjo pjesë nuk është në historinë e pedagogjisë. Për këtë arsye, interesimi ynë nuk është të shkruajmë gjithçka rreth zhvillimit të historisë nga një periudhë në tjetrën, e as nga një civilizim në tjetrin. Do të mjaftojmë me disa çështje të caktuara rreth disa koncepteve të cilat i kemi kuptuar rreth zhvillimit historik në shumë raste. Sipas neve, këto janë disa sinjale të rëndësishme, të cilat hulumtuesi mund t'i ketë në konsideratë gjatë leximit të shumë referencave të cilat janë marrë me zhvillimin e pedagogjisë dhe mendimit pedagogjik gjatë historisë dhe përmes civilizimeve.

Ne mendojmë se çështja e “edukatës dhe arsimit” ndërli-dhet me llojin njerëzor, gjë që imponon hulumtimin në historinë e kësaj çështje, duke filluar nga fillimi i ekzistimit të njeriut. Rezultati i këtij hulumtimi do të ndryshojë, varësisht nga ndryshimi i pikëpamjeve ideologjike dhe teorive të cilat kanë diktuar shkrimet e autorëve dhe hulumtuesve rreth zhvillimit të mendimit pedagogjik dhe praktikave pedagogjike, qofshin këto pikëpamje ideologjike të mbështetura në referenca fetare apo jofetare. Kështu, fazat historike, zhvillimi organik dhe tri fazat e mendimit njerëzor p.sh. vazhdojnë edhe sot e kësaj dite dhe në masë të madhe të kenë ndikim në pikëpamjet e autorëve dhe hulumtuesve, qoftë në përshkrim apo komentim rreth asaj se si ishte gjendja e edukatës dhe arsimit në shoqëritë njerëzore.

Në vazhdim do të sjellim një përshkrim të shkurtër rreth referencës së hulumtimit në zhvillimin e mendimit pedagogjik, si dhe një përshkrim të shkurtër rreth ndikimit të ndryshimit të referencës ideologjike në të kuptuarit e realitetit të

pedagogjisë dhe mënyrës së të shprehurit ndaj këtij të kuptuari. Më pas do të sinjalizojmë rreth disa veçorive të pedagogjisë së vjetër në disa civilizime të vjetra. Pastaj kalimthi do të theksojmë ndryshimet rrënjësore të cilat i përjetoi bota më pas.

Në Evropë, ndodhi transferimi nga situatat greke në fazat e njëpasnjëshme të historisë romake. Më pas u pranua krishterizmi si fe zyrtare në fillimin e shekullit IV të erës së re. Kjo periudhë u shoqërua me një eksperiencë të re në jetë, dituri dhe arsim. Më pas ndodhi ajo që ndodhi. Kisha përvetësoi disa mendime dhe hyri në koalicion me mbretërit. Kjo u pasua nga përpjekjet e liritimit nga prangat të cilat i kishte imponuar kisha, fillimi i zbulimeve gjeografike, zbulimi i Amerikës duke arritur në periudhën e lulëzimit. Më pas u përhapën garat për okupim nga ana e shteteve evropiane, ku secila prej tyre do të ketë vend për të vënë këmbën në të gjitha kontinentet tjera.

Në Azinë perëndimore, në fillimi të shekullit VII të erës së re u shfaq Islami. Në vitin 610 filloi shpallja e Kur'anit të vula e Pejgamberëve, Muhammedi alejh'is-selam. Islami u përhap në mënyrë shumë të shpejtë. E gjithë kjo u shoqërua me një eksperiencë të re në jetë, dituri dhe arsim. Ngjarjet që ndodhnin në Evropë nuk ishin larg asaj që ndodhte në Botën e Re Islame, ngase janë shoqëruar me raste lufte dhe paqeje, ndikim reciprok, bashkëveprim ideologjik dhe kulturor dhe kontaktim të vazhdueshëm deri sot e kësaj dite.

## 1. Referenca e hulumtimit në zhvillimin e mendimit pedagogjik

Nëse “të menduarit” është cilësi e njeriut me të cilën dallohet nga gjitha krijesat tjera, atëherë, supozohet që mendimi njerëzor të kishte filluar me njeriun nga momentet e para të ekzistimit të tij. Pikëpamjet islame ndaj universit janë të pre-ra. Allahu i Lartëmadhëruar ia ka mësuar Ademit emrat dhe ka kërkuar prej tij t'i informojë melaqet për këto emra, gjë të cilën e bëri Ademi. Pra, qysh këtu kemi proces të mësimdhënies dhe mësim-nxënies, gjë e cila nuk mund të realizohet

përpos me kuptim dhe vetëdije, pra me mendim. Më pas në jetën e njerëzve të parë kishte martesë mes meshkujve dhe femrave, ku lindën fëmijë dhe kishin nevojë për edukim, ushtrim, arsimim dhe zhvillim të aftësive mendore. Supozojmë se prindërit kanë kryer procesin e të mësuarit me njohje dhe vetëdije, falë mirësive që Allahu ua ka dhuruar në të kuptuarit e çështjeve dhe asaj që e kanë fituar prej përvojave gjatë jetës së tyre. Në mungesë të edukimit të prindërve dhe në raste të gjendjeve të reja, nuk kanë munguar mirësitë e Allahut, ngase Ai u ka dërguar model praktik që do t'i mësojë ata se si të veprojnë në këso situata. Kështu kjo çështje bëhet një përvojë e re, ose edhe bazament për legjislativë që do t'i rregullojë çështjet e jetës.<sup>42</sup>

Mendimi njerëzor ishte i lidhur ngushtë me procesin e diturisë dhe të mësuarit. Njeriu ishte i pajisur me aftësi për të mësuar gjërat e reja për të cilat e udhëzonte Allahu dhe përballë me risitë e jetës. Njeriu nga natyra e tij është shoqëror dhe qytetëruar. Që nga ditët e para jetonte në një shoqëri që përmbusheshin nevojat e jetës për të gjithë. Kjo plotësohej përmes profesioneve të ndryshme si bujqësia, blegtoria, gjuetia, përgatitja e strehimit, prodhimi i armëve etj. Me siguri se e gjithë kjo ka nevojë për arsimim, edukim dhe ushtrim. Allahu, nuk e la njeriun të mbështetur në veten e tij. Pejgamberët dhe të Dërguarit e Allahut u ofronin popujve të tyre gjithçka që përmirësonte pikëpamjet dhe mendimet e tyre, i pastronte ata shpirtërisht dhe e rregullonte çështjen e jetës së tyre.

Disa prej Pejgamberëve ishin model në zanatet dhe profesionet e tyre. I Dërguari i Allahut, Nuh i alejh'is-selam kishte ndërtuar anijen me ndihmën e Allahut ﴿وَاصْنَعِ الْفُلَكَ بِأَعْيُنِنَا﴾ "E,

<sup>42</sup> Në këtë kontekst përkujtojmë ngjarjen e dy djemve të Ademit, i cili përfundoi me vrasjen e njërit prej tyre. Në këtë rast, vrasësi nuk dinte se ç'të bënte me kufomën e të vrarit. Kështu Allahu dërgoi dy sorra të cilat vriteshin mes vete dhe njëra prej tyre e mbyti tjetrën. Sorra vrasëse hapi një gropë dhe e varrosi tjetrën. E gjithë kjo ndodhi me qëllim të mësohet i biri i Ademit. Në lidhje me këtë çështje, Allahu thotë:

﴿فَبَعَثَ اللَّهُ غُرَابًا يَبْحِثُ فِي الْأَرْضِ لِيُرِيَهُ كَيْفَ يُؤَارِي سَوْءَةَ أَخِيهِ قَالَ يَا وَيْلَتَا أَعَجَزْتُ أَنْ أَكُونَ مِثْلَ هَذَا الْغُرَابِ فَأُوَارِي سَوْءَةَ أَخِي فَأَصْبَحَ مِنَ النَّادِمِينَ﴾

"Allahu dërgoi një sorrë, e cila groponte në dhe, për t'i treguar atij se si ta mbulojë trupin e vëllait. E ai i tha: "I mjeri unë, a nuk qesh i aftë të bëhem si kjo sorrë, e ta mbuloja trupin e vëllait tim?" Ashtu mbeti i penduar". [El-Maide: 31]

mbaroi anijen nën mbikëqyrjen Tonë dhe me mësimin tonë” [Hud: 37]. Davudi alejh’is-selam kishte prodhuar petkat e hekurta me përpikëri dhe shkathtësi të lartë. ﴿وَعَلَّمْنَاهُ صَنْعَةَ لَبُوسٍ لَّكُمْ﴾ “Ne i mësuam atij (Davudit) mbarimin e petkave (të hekurta) për ju, që t’ju mbrojnë në raste lufte. A jeni pra mirënjohës ju për këtë?” [El-Enbija: 80]. Jusufi alejh’is-selam kishte menaxhuar ekonominë e rajonit me urtësi plot 15 vite. ﴿قَالَ اجْعَلْنِي عَلَىٰ خَزَائِنِ الْأَرْضِ إِنِّي حَفِيظٌ عَلَيْم﴾ Ai (Jusufi) tha: “Më cakto mua përgjegjës të depove të vendit, unë jam besnik i dijshtëm” [Jusuf: 55]. Dhurkarnejni kishte ndërtuar një pendë nga hekuri dhe bakri i shkrirë, mëshirë për të dobëtit për t’i mbrojtur nga tiranët e fortë. ﴿أَتُونِي زُبُرَ الْحَدِيدِ حَتَّىٰ إِذَا سَاوَىٰ بَيْنَ الصَّدَفَيْنِ قَالَ انفُجُوا حَتَّىٰ إِذَا جَعَلَهُ نَارًا قَالَ أَتُونِي أُفْرِغْ عَلَيْهِ قِطْرًا﴾ “Më sillni copa të hekurit! E kur e nivelizoi ai me dy anët e kodrave, tha: “Ndizni!”, e kur e bëri atë (hekurin) zjarr (si zjarr nga të ndezurit) tha: “Më sillni bakër të shkrirë t’ia hedhë atij!” [El-Kehf: 96]. Vërehet se këto shembuj që janë udhëzim dhe arsimim nga ana e Allahut, nuk janë mrekulli të veçanta për pejgamberët, siç ishte rasti me shkopin e Musait alejh’is-selam, ose balta e Isait alejh’is-selam. As nuk është ndihmë e ofruar nga ana e xhinëve, shpendëve apo erës, siç i kishte ndodhur Sulejmanit alejh’is-selam, por gjitha këto ishin mendime dhe përvoja njerëzore që ndërlidhen me procesin e të mësuarit për jetë praktike, gjëra të cilat i mësojnë njerëzit sipas parimeve dhe rregullave të përfituara me përvojë të drejtpërdrejtë dhe arsimim.

Gjeneratat disa prej këtyre përvojave i trashëgojnë përmes edukimit familjar, në veçanti elementet e identitetit për secilin popull, siç janë: feja, vlerat, gjuha, historia. Institucionet edukativo-arsimore luajnë rolin e tyre në përcjelljen e këtyre përvojave dhe zhvillimin e tyre. Mendimi njerëzor në përgjithësi ka ndryshuar në vazhdimësi në nivel të individëve, shoqërive dhe popujve, varësisht nga ajo se sa janë plotësuar përvojat e reja për secilin nivel. Kështu ka vazhduar brez pas brezi. Janë zhvilluar shkenca, profesione dhe njohuri në një shoqëri. Ka ndodhur kulturimi mes shoqërive në raste paqeje

dhe lufte dhe kanë vazhduar proceset e zhvillimit dhe ndryshimit në institucionet edukativo-arsimore, si dhe përmbajtjet dhe metodat e tyre.

Historia e pedagogjisë është degë e pedagogjisë. Degë e cila studion zhvillimin e mendimit pedagogjik, filozofitë, teoritë, sistemet, përmbajtjet dhe metodat e këtij mendimi. Edhe pse historia njerëzore ndërlidhet në mënyrë të vazhdueshme dhe popujt trashëgojnë arritjet shkencore dhe civilizuese, megjithatë nuk mund të mohojmë dallimet e pakta apo të shumta në lidhje me mendimin pedagogjik, varësisht nga afrimi apo largimi prej udhëzimeve hyjnore dhe varësisht nga kontaktimi me civilizimet ose shkallën e trashëgimisë mes civilizimeve.

S'ka dyshim se pedagogjia është fusha më e ndërlidhur me natyrën e dalluar të njeriut. Fëmija në krahasim me krijesat tjera, ka nevojë për një kohë të gjatë për përkujdesje, edukim dhe trajnim. Përderisa krijesat tjera kalojnë jetën e tyre me një numër të kufizuar të shkathtësive të cilat i fiton me instinktin e tij, shkathtësi të cilat vazhdojnë gjatë tërë jetës së tij në të njëjtin nivel, në përjashtim nëse njeriu e trajnon për qëllime të ruajtjes, gjahut apo për hulumtim të lëndëve të caktuara,<sup>43</sup> vërejmë se qenia njerëzore pranon rritjen e njohurive, përvojave dhe shprehive, ditë pas ditë, gjatë tërë jetës. Megjithatë, nëse krahasohen proceset e edukimit dhe elementet e saj me proceset dhe elementet e veçanta të cilitdo aktivitet tjetër njerëzor, do të vërejmë se edukimi është më rezistent ndaj ndryshimeve. Ndoshta disa veçori të edukimit që mund t'i imagjinojmë në periudhat e para të jetës njerëzore, vazhdojnë edhe kësaj ditë të dominojnë në edukimin bashkëkohor. Procesi i edukimit vazhdon të sillet rreth përvojave (dituri), të cilat i ofron personi që i posedon ato (mësimdhënës), për

<sup>43</sup> Ajo të tërheq vëmendjen se Kur'ani për trajnimin dhe edukimin e qenve për gjah ka përdorur termin mësim.

﴿يَسْأَلُونَكَ مَاذَا أُحِلَّ لَهُمْ قُلْ أُحِلَّ لَكُمْ الطَّيِّبَاتُ وَمَا عَلَّمْتُم مِّنَ الْجَوَارِحِ مُكَلَّبِينَ يُعَلِّمُونَهُنَّ مِمَّا عَلَّمَكُمُ اللَّهُ فَكُلُوا مِمَّا أَمْسَكْنَ عَلَيْكُمْ وَادْكُرُوا اسْمَ اللَّهِ عَلَيْهِ وَأَقْسُوا لِلَّهِ إِنَّهُ سَرِيعُ الْحِسَابِ﴾

"Të pyesin ty (Muhammed), çka u është lejuar atyre? Thuaju: "U janë lejuar të gjitha ushqimet e mira dhe ai (gjahu) i gjahtarëve (shtazëve) të dresuara që i mësoni ashtu si ju ka mësuar juve Allahu. Hani pra, atë që gjahtuan për juve dhe më parë përmendeni emrin e Allahut. Kini dro nga Allahu pse Allahu shpejt merr masa". [El-Maide: 4]



personat që nuk i posedojnë (nxënësit) me qëllim të përfitimit të tyre (mësim). Këto përvoja mund të jenë informacione, shkathtësi, vlera dhe norma të sjelljes. Vend për arsimim vazhdon të jetë shkolla, edhe pse mund të ndryshon emri, madhësia dhe forma. Leximi dhe shkrimi mbeten dy proceset elementare, sado që të ndryshojnë mjetet dhe format.

Literatura rreth historisë pedagogjike në gjuhën arabe nuk është e pakët, mirëpo shumë prej saj bazohet në atë që është shkruar në gjuhët joarabe, në veçanti ajo që ndërlidhet me civilizimet e vjetra dhe të mesme. Pjesa dërrmuese e tyre është shkruar në gjuhët evropiane, ku shprehen pikëpamjet evropiane të cilat janë të njëanshme dhe injorojnë vlerën e kontributit islam në historinë e pedagogjisë, ose shprehin mosnjohje të burimeve. Shembull për këtë kemi një burim të cilin e kanë shfrytëzuar si referencë shumica e atyre që kanë shkruar rreth historisë së pedagogjisë ose zhvillimit të mendimit pedagogjik.<sup>44</sup> Ky burim është i pedagogut amerikan “Paul Monroe” të cilin e ka publikuar më 1905, i botuar për herë të parë më 1906 nga shtëpia McMilan. Shumë vepra tregojnë se libri është botuar shumë herë, ndërsa herën e fundit në vitin 2016.<sup>45</sup>

Libri është voluminoz, 814 faqe. Cilësohet si gjithëpërfshirës në prezantimin historik të filozofive që kanë dominuar në botë gjatë historisë, duke filluar me historinë e arsimit në Kinë, më pas Greqinë antike dhe Greqinë e re, romakët, mesjetën, krishterizmin, reformat fetare në Evropë, periudha e renesancës, filozofitë pedagogjike idealiste dhe realiste, orientimet psikologjike, shkencore dhe shoqërore dhe orientimet bashkëkohore (në fund të shekullit XIX).

Autori ka caktuar një nënkapitull prej 17 faqeve për arsimin në shoqëritë primitive. Një tjetër nënkapitull prej 34 faqeve rreth arsimit në Kinën e vjetër. Mirëpo, kur ka shkruar për arsimin islam, ai ka theksuar vetëm tri raste kalimthit

<sup>44</sup> Këtë burim e cekëm vetëm si shembull. Ekzistojnë edhe libra tjerë në gjuhën angleze dhe franceze të cilat janë shkruar në fund të shekullit XIX dhe fillim të shekullit XX. Këto ishin si referenca të cilat i kanë cituar autorët arab, të cilët kanë shkruar rreth historisë së pedagogjisë në kohërat e mëhershme, dhe më pas të tjerët kanë cituar prej tyre.

<sup>45</sup> Paul Monroe, *A Text-Book in the History of Education*, New York: The Macmillan Company, 1906, fq. 160, 332.

duke potencuar ndikimin e këtij arsimit në zhvillimin e arsimit në Evropë gjatë mesjetës. Këto raste ishin sipas metodës së njohur orientaliste, ku flasin për muslimanët me emrin “Saracens” ose “Muhamedanët” ose “Arabët”.

Në rastin e parë ka folur vetëm me një fjali dhe atë në kontekst duke sqaruar ndikimin e përkthimeve arabe të veprave të Aristotelit në ruajtjen e tyre në Bagdad dhe në të gjitha anët e perandorisë, dhe më pas edhe në Spanjë, gjë që ka ndikuar në ringjalljen dhe zhvillimin e interesimit evropian për njohjen e Aristotelit “mësuesit”.<sup>46</sup>

Rasti i dytë ku përmenden muslimanët vije në tri shprehje. E para flet për shfaqjen e universiteteve të para në Itali, më saktë përmes shkollës së mjekësisë në Der Salirno “përmes kontaktit me muslimanët”. E dyta flet duke thënë se “përpjekjet dhe mësimet e klerikëve në këtë shkollë janë nxitur përmes kryqëzatave të para dhe kanë përfitur famë jashtë vendit me kalorësit e kthyer”. E treta flet për ndikimin e kryqëzatave në njohjen e evropianëve me shkencën dhe filozofinë greke. Me fillimin e kryqëzatave, Evropa zbuloi “barbarët e lindjes”. Logjikisht mund të kuptohet se “barbarë” ishin vetë perëndimorët. Vetëm atëherë filluan të ndikohen nga veçoritë e lindjes, në veçanti interesimi i tyre për hulumtim dhe lirinë e mendimit. Ky kontakt me lindjen dhe me arsimin islam, i ka ofruar Evropës, jo vetëm njohje me kulturën dhe shkencën arabe (e cila konsiderohej si art i zi apo magji dhe më pas u pranua si shkencë), por i ka ofruar Evropës së shekullit XIII njohje më të plotë rreth Aristotelit dhe filozofisë greke.<sup>47</sup>

Rasti i tretë ku përmendet ndikimi i muslimanëve është përfshirë në katër faqe nën titullin: “Ndikimi i arsimit të muslimanëve”. Aty pranon autori se historia e arsimit në shoqërinë Muhamedane merr shumë kohë që të sqarohet, por ajo që i intereson është ndikimi i arsimit islam në zhvillimin e arsimit në perëndim gjatë shekujve të mesjetës. Ky ndikim shihet në përpjekjet e klerikëve krishterë në Azinë perëndimore, ngase ata ishin që u interesuan për filozofinë greke pas

<sup>46</sup> Monroe, A Text-Book in the History of Education, op, cit., fq. 160.

<sup>47</sup> Ibid., fq. 314-315.

një injorimi total në Evropë. Këta klerikë u bënë punëtorë në administratat e muslimanëve, këtë filozofi e kanë përkthyer nga gjuha siriane dhe greke në atë arabe, në veçanti pjesët që kanë të bëjnë me matematikën, shkencat natyrore dhe mjekësinë. Ky interesim filozofik u rrit dukshëm përmes Ibn Sinasë (Avicena). Autori thotë: “Në kohën kur shkollat krishtere në lindje dhe perëndim të Evropës shkonin drejt zhdukjes, shkollat në Bagdad, Basra, Kufë dhe qytete tjera të muslimanëve lulëzonin me aktivitet mahnitës dhe famë të madhe.<sup>48</sup>

Kjo filozofi është kundërshtuar nga ana e asaj që “Monro” e ka quajtur “Pikëpamje ortodokse muhamedane” të njohura në ortodoksinë krishtere, gjë që kjo filozofi është detyruar të ikë në Afrikën Veriore dhe Abdaluzi. “Nuk mund të thuhet se kjo filozofi dhe arsimit në përgjithësi kanë ndikuar në shoqëri ose ka pasur ndonjë gjenialitet kreativ të madh i rrënjësor në mendjen arabe, por arabët kanë qenë shumë të shpejtë në mësim, përvetësim dhe shfaqjen e shkathtësisë në sqarimin dhe përshtatjen e filozofisë së Aristotelit në kuadër të bindjeve dhe njohurive të tyre shkencore”.<sup>49</sup> Në Spanjë, në veçanti në Kordobë, ky arsim i Aristotelit, pas shekullit të X filloi të gjejë zbatim praktikë. Në të gjitha provincat islame në Perëndim themeluan libraritë dhe shkollat e larta të ngjashme me universitetet sot. Në shumë qytete, afër xhamive u themeluan shkolla për arsimimin e fëmijëve. Derisa Evropa krishtere impononte bindjen fetare rreth idesë se toka është e rrafshët, muslimanët në Andaluzi, fëmijëve ua mësonin gjeografinë dhe se toka është e rrumbullakët. Në fund, kur të krishterët fituan ndaj muhamedanëve, observatorët astronomikë të tyre i shndërruan në kambana të kishave. Prej këtyre arabëve, evropianët gjatë shekujve X dhe XI kanë marrë numrat indian në vend të numrave romak të lodhshme. Nga i njëjti burim kanë ardhur njohuritë rreth algjebres dhe proceset e përparura matematikore. Në medicinë, kirurgji, farmaci, astronomi kanë ofruar shumë, gjë që sot njihen si njohuri të thjeshta elementare. Ata kanë sqaruar tërheqjen e dritës, gravitacionin

<sup>48</sup> Ibid., fq. 331.

<sup>49</sup> Ibid., fq. 332.

etj. Ata kanë arritur të përcaktojnë lartësinë e atmosferës, peshën e ajrit, gravitacionin e gjësendeve, kanë vënë tabela astronomike dhe kanë zbuluar orën. Kultura dhe njohuritë e tyre në tregti, zbulimet gjeografike, detari dhe zbulurim në të gjitha sferat e jetës ishin shumë më të larta se sa tek evropianët. Ata kanë sjellë përdorimin e orizit, sheqerit, pambukut, prodhimin e mëndafshit. I kanë mësuar evropianët se si të përdorin busullën, barutin dhe topin. Kështu pra, në sfera të shumta, kultura arabe i ka shërbyer aktivitetit arsimor për ngritjen e civilizimit në Perëndim në nivel më të lartë.<sup>50</sup>

Autori fjalën e tij rreth ndikimeve islame në arsimin evropian e vazhdon duke potencuar mendimin rushdian<sup>51</sup>, i cili në fillim njihej si mendim racional, dhe se nuk ishte më shumë se komente mbi mendimin aristotelian, mirëpo u bë mendim ortodoks konservator, i cili në këtë cilësi, në shekullin XIV është transferuar në universitetet evropiane, ku në këto universitete është ndaluar të mësohet çdo gjë që bie në kundërshtim me mendimin aristotelian-rushdian. “Në këtë formë, dhe ashtu siç është gjendja në sferën e mjekësisë dhe astronomisë, arsimi arab ka ushtruar ndikim gjatë mesjetës, pasi shoqëria muhamedane për një kohë të gjatë kishte njohur vitalitetin e mendimit”.<sup>52</sup>

## 2. Pedagogjia në të kaluarën mes periodizimit historik dhe mendimeve filozofike

### 2.1. Çështja e periodizimit kohor

Hulumtuesit rreth filogjenezës së njeriut dhe shoqërive njerëzore kanë si traditë të flasin për periudhën më të vjetër historike të ekzistimit të njeriut, duke ofruar një pamje të kësaj jete, pa u mbështetur në burime historike. Periudha e ekzistimit të njeriut, është patjetër të jetë para historisë, e cila ka përfunduar me fillimin e historisë së regjistruar në

<sup>50</sup> Ibid., fq. 332-333.

<sup>51</sup> Averros.

<sup>52</sup> Ibid., fq. 333-334.

shekullin IV para erës së re, periudhë të cilën e konsiderojnë si periudhë e zbulimit të shkrimit për herë të parë. Më pas, në shekujt e mëvonshëm nga kjo datë është njohur shkrimi në civilizimet tjera. Periudhën e parahistorisë, hulumtuesit e ndajnë me veçori të caktuara, varësisht nga mjetet të cilat i ka përdorur njeriu, duke filluar me kohën e gurit, më pas koha e bronzit, më pas koha e hekurit.

Historiani kur shkruan në cilën do fushë të historisë, qoftë histori e politikës, letërsisë, pedagogjisë apo diç tjetër, ka nevojë të mbështetet në një metodë të caktuar për periodizimin kohor. Ai do të vërejë se çështja nuk është thjeshtë çështje objektive ose terminologjike, por e mbulojnë hije të caktuara ideologjike, pa marrë parasysh se historiani ka përdorur ndonjë metodë që e kanë përdorur edhe tjerët para tij apo ka zhvilluar për vete ndonjë metodë të re për periodizim. Ekzistojnë shkrime të rëndësishme në këtë çështje, të cilat flasin për ndikimin e sistemit të periodizimit në studimin e historisë së botës në plan-programet mësimore dhe përcaktimin e specializimeve për programet mësimore. Është e njohur se sistemi më i përhapur i periodizimit historik është ndarja evropiane e historisë në tri periudha: e vjetër, e mesme dhe e re. Edhe pse kjo ndarje është e njëanshme ngase imponon që në programet e studimit të historisë në arsimin publik dhe atë universitar të injorohen kultura, civilizime dhe popuj, ku ndikimi i tyre në histori nuk ka qenë më i vogël se sa ai i evropianëve, megjithatë kjo ndarje vazhdon të përdoret me të madhe në shumicën e vendeve të botës.

Tvinpi në shkrimet e tij historike ka vërejtur problem në ndarjen e periodizimit historik në tri pjesë. Ai sqaron se kjo ndarje është zhvillim i ndarjes në dy pjesë, e vjetër dhe e re ose para erës së re dhe pas erës së re.<sup>53</sup> Gjithashtu ka vërejtur se esenca e periodizimit në dy periudha bazohet në përvojën historike evropiane që ka filluar me historinë krishtere evropiane. Kështu çdo gjë që ishte para ligjit të kishës që shkruan për kohën e re, llogaritet çështje helene e vjetër. Më pas,

<sup>53</sup> Tvinpi, Arnold, Muhtesar dirasetit Tarih, Përkthim: Fuad Muhamed Shibl, Kajro: Qendra kombëtare për përkthim, 2011, vëll. 1, fq. 63-65.

evropianët e shtuan edhe një periudhë mes të vjetrës dhe të rejes dhe e quajtën histori e mesme. Më pas të mesmen e ndanë në ca pjesë, të rejen në ca pjesë dhe kështu me radhë. E gjithë kjo me qëllim që periudhave të caktuara kohore evropiane t'i jepet vlerë.

Sipas Tvinpit, ideja e ndarjes së periudhave kohore në tri pjesë nuk është e saktë. Ai mendon se kjo është e ngjashme me librin e botuar në Evropë rreth gjeografisë së botës, ndërsa në te gjen vetëm gjeografinë e Evropës dhe shtetet përreth Detit Mesdhe.<sup>54</sup> Sipas Tvinpit më e përshtatshme ishte ndarja e botës në civilizime të dalluara. Ai ka numëruar njëzetënjë civilizime, prej të cilave kanë mbetur vetëm pesë. Ato janë: krishterizmi perëndimor, krishterizmi ortodoks, islamik, indian dhe lindjes së largët.

Nga përvoja evropiane gjithashtu kemi edhe një sistem tjetër të periodizimit, i cili ka lindur nga filozofia marksiste. Kjo filozofi ka kuptuar historinë e botës ose ka imponuar që të kalojë përmes pesë periudhave: komunizmi i parë, robërizmi, feudalizmi, kapitalizmi dhe socializmi.

Në historinë islame vërejmë se shumica e historianëve muslimanë si Taberiu (v. 310 h./922) në librin e tij "Historia e pejgamberëve dhe mbretërve", Ibn'ul-Ethir (v. 630 h./1233) në librin e tij "I kompletuari në histori", Sibt ibn'ul-Xhevzi (654 h./1256) në librin e tij "Pasqyra e kohës në historinë e personaliteteve", Ibn Kethir (v. 774 h./1373) në librin e tij "El-Bidajetu ve'n-Nihajetu" dhe të tjerë shënimet e tyre historike i fillojnë me krijimin e hapësirës, diellit dhe hënës, më pas shfaqja e kohës, krijimi i Ademit dhe pasardhësve të tyre deri te Nuh'i Alejh'is-selam, më pas rrëfimet e pejgamberëve sipas radhitjes së tyre kohore, më pas kanë regjistruar popujt e vjetër në vendet e Jemenit, romakëve dhe persianëve, gjendjen e arabëve para Islamit, shpallja e Islamit në kohën e Muhammedit alejh'is-selam, periudhën e Hulefai-rrashidinëve, më pas shfaqjen e grupimeve, fraksioneve dhe shkollave të cilat kanë pasur role politike në historinë islame deri në kohën e

<sup>54</sup> Po aty, fq. 65.

regjistrimit. Disa prej tyre kanë folur edhe për lajmet rreth ndodhive në kohën para kiametit siç ka bërë Ibn Kethiri.

Kur çështja përkufizohet vetëm me historinë islame, atëherë shumica e historianëve fillojnë me periudhën paraislame, të shpalljes, periudha e hulefai-rrashidinëve, më pas periudha e dinastive sunduese (emevitët, abasitët....).

Çështja e “periodizimit historik” është mjaft e rëndësishme që meriton hulumtim kur flitet për zhvillimin e mendimeve njerëzore gjatë historisë dhe atë në sferat politike, ekonomike, arsimore apo çfarëdo teme tjetër. Mjafton të përmendim këtu studimin e Halid Blankinship,<sup>55</sup> i cili ka trajtuar këtë çështje në formë të përshtatshme. Ky studim bartë titullin: “Islami dhe historia botërore: drejt një ndarje të re të periudhave historike”.

Sa i përket historisë së vjetër, ndoshta është e përshtatshme që në të të përfshihen civilizimet të cilat kanë pasur vlerë dhe më pas janë zhdukur, si ajo e luginës së Nilit, Mesopotamia, Kina dhe Greqia.

Nuk është lehtë që saktësisht të përcaktojmë gjendjen pedagogjike dhe mendimet pedagogjike në këtë periudhë historike. Mirëpo, atë që e dimë - me një saktësi më të madhe - se mendimet e hulumtuesve rreth ekzistimit njerëzor në periudhën parahistorike ngritën mbi filozofitë dhe teoritë që përcaktojnë këto mendime. Më parë pamë ndikimin e periodizimit kohor në të kuptuarit dhe zhvillimin e normave të jetës njerëzore. Tani në dy shembuj do të shohim ndikimin e mendimit filozofik në perceptimin tonë ndaj normave të jetës në historinë e vjetër.

Shembulli i parë ka të bëjë me ndikimin e bindjes në filozofinë e evolucionit, ndërsa shembulli i dytë me ndikimin e bindjes në ligjin e Ogyst Kontit rreth tri periudhave të të menduarit njerëzor.

<sup>55</sup> Historian amerikan bashkëkohor i fesë islame. Profesor dhe udhëheqës i Katedrës së feve në Universitetin Tembel në qytetin Filadelfia. Hulumtimi është botuar në “Revistën amerikane për shkencat shoqërore”, të cilin e boton Instituti Botëror i Mendimit Islam në gjuhën angleze. Shih temën në: Blankinship, Khalid. Islam and World History: Towards a New Periodization, *The American Journal of Islamic Social Science*, Vol. 8, No. 3, 1991, fq. 425-452.

## 2.2. Ndikimi i teorisë së evolucionit:

Ata të cilët besojnë në zhvillimin e njeriut përmes evolucionit, flasin për njeriun e parë i cili në formën e tij, nivelin e të menduarit dhe mënyrën e jetës ishte më afër kafshës se sa njeriut. Ata mbështeten në studime antropologjike, gjeologjike, gjenetike, gjuhësore dhe tjera, duke përfshirë edhe studimet e shoqërive të cilat llogariten si “primitive”, të cilat akoma vazhdojnë të jetojnë në disa vende si në Afrikë dhe Amerikën Jugore larg jetës moderne. Një pjesë e madhe e përshkrimeve të jetës së këtyre shoqërive primitive janë vetëm perceptime dhe imagjinata rreth asaj se si ka mund të ishte jeta në atë kohë. Ndoshta mbështeten në të dhëna rreth psikologjisë së zhvillimit njerëzor kur imagjinojnë se periudhat e zhvillimit të jetës njerëzore në tokë janë të ngjashme me periudhat e zhvillimit të njeriut si individ.

Këta hulumtues, rreth pedagogjisë nuk shohin diç më shumë se sa nevojën për ushqim, pije dhe strehim. Kështu, i rrituri mësohet përmes përvojës dhe gabimit, i cili më pas ky i rritur ia mëson atë të vegjëlve. Supozohet se meshkujt kanë mësuar zhvillimin e mjeteve të gjuetisë dhe mbrojtjes, ndërsa femrat kanë mësuar çështjet e strehimit dhe edukimit fizik të të vegjëlve. Ndërsa të gjithë mësojnë rregullat e nënshtrimit ndaj pushtetit të të madhit dhe traditave të grupit. Marrë parasysh atë që ua imponon natyra dhe dukuritë e saj, ata kanë zhvilluar disa lloje të perceptimeve fetare rreth disa simboleve të natyrës që meritojnë nënshtrim dhe adhurim. Supozohet -që në periudhat e mëvonshme- nga mesi i grupit do të del ndonjë person që merr përsipër njerëzve t'ua mëson këtë lloj të adhurimit.

Bazuar në këtë, këta hulumtues, përvojat që i ka përfituar njeriu në këtë periudhë të jetës së njeriut, në rend të parë janë përvoja shkathtësie, më saktësisht shkathtësi për ekzistencë dhe zhvillimin e jetës përballë problemeve të ambientit dhe fuqive të jetës, kafshëve të egra dhe grupeve tjera njerëzore armike. Me qëllim që njeriu të mund të sigurojë nevojat e ekzistencës, këto shkathtësi janë bërë norma kulturore në tri forma: prodhim i mjeteve, tradita shoqërore dhe mësimi i



gjuhës. Këto forma, me siguri se përmes ndonjë forme të arsimimit, të mëdhenjtë do t'ua trashëgojnë të vegjëlve. Jeta në këtë formë të jetës është ambient mësues, ku të vegjëlit vrojtojnë sjelljet e të rriturve, në veçanti sjelljet e prindërve, të cilët i orientojnë fëmijët e tyre drejt përgjegjësive që ata i kanë mësuar më parë. Kështu mendojnë hulumtuesit dhe kështu shkruajnë!

Disa të tjerë besojnë se çdo bisedë rreth njeriut para se të bëhet njeri, është bisedë e pakuptimtë. Andaj, termi “njeriu i parë” sipas formës që e parasheh grupi për të cilin biseduam në paragrafin paraprak është i pakuptimtë. Njeriu -që nga momenti kur ka merituar këtë cilësim- ka poseduar fuqi mendore, jetë familjare dhe shkathtësi praktike, mirëpo, aftësitë, shkathtësitë dhe jeta e tij është zhvilluar me përfitimet e përvojave të vazhdueshme, të cilat ia kanë mundësuar zhvillimin e civilizimeve të vjetra, në të cilat ka pasur shkencë dhe njohuri. Disa prej këtyre civilizimeve llogariten edhe sot e kësaj dite prej çudirave të botës dhe se shkencë bashkëkohore akoma është e pamundur për të zbuluar disa prej detajeve të tyre. Kjo shkencë përfshin sfera të ndryshme të natyrës si arti i ndërtimit, skulpturës, fotografisë, sferat e legjislacionit, sistemeve politike dhe shoqërore, sferat e letërsisë, poezisë, romaneve e tjera prej arteve të gjuhës. Si rezultat i kësaj, zhvillimi i këtyre shkencave dhe arteve në këto shoqëri të mëhershme nuk kanë mundur të arrihen përpos përmes personaliteteve që kanë përfituar këto përvoja, të cilat më pas i kanë sistemuar për t'ua mësuar gjeneratave të reja.

Ka të tjerë që besojnë se Allahu e ka krijuar njeriun në formën më të mirë. I kompletuar fizikisht dhe mendërisht, gjë që ia ka mundësuar të jetë i përgatitur për të pranuar shpalljen dhe udhëzimin e drejtpërdrejtë hyjnor përmes të folurit të drejtpërdrejtë ose përmes prezantimit praktik. Për këtë bazohen në ajete kur'anore që flasin për krijimin e Ademit, mësimin e emrave, dalja nga xheneti, angazhimi i tij për të qenë mëkëmbës në tokë, përkujdesi për të dhe udhëzimi i tij përmes pejgamberëve dhe librave dhe asaj që rrëfëhet në librat e shenjta rreth popujve në periudha të hershme historike. Për

disa prej këtyre popujve të hershme flet edhe Kur'ani. Shumë prej tyre kanë jetuar para mijëra viteve dhe kanë arritur një nivel të lartë të civilizimit dhe prodhimit. Në mesin e tyre kishte peygamberë që ua kanë mësuar njerëzve atë që ua ka mësuar Allahu dhe dituritë e tyre i kanë vënë në shërbim të përmirësimit të gjendjes dhe zgjidhjes së problemeve. Kështu Jusufi aleh'is-selam, bazuar në projektin që ia kishte mësuar Allahu përmes ëndrrës, ka propozuar zgjidhjen e problemit ekonomik në vendin ku do të vuaj nga thatësira për shtatë vite me radhë.<sup>56</sup> Dhulkarnejni, bazuar në atë që ia ka mësuar Allahu, ka ndërtuar një pendë prej bronzit që nuk mund të shpohet, e as të hipet mbi te.<sup>57</sup> Nuhi aleh'is-selam, shumë kohë më parë, nën kujdesin e Allahut ka ndërtuar anijen me drunjë për të përfshirë gjithë ata që i kanë besuar dhe shumë prej kafshëve.<sup>58</sup>

Sido që të jetë filozofia që orienton perceptimin tonë ndaj arsimit në periudhën parahistorike, është patjetër të supozojmë ekzistimin e fuqisë për shfrytëzimin e mendimit tek njeriu në atë periudhë. Prodhimit dhe shfrytëzimit të mjeteve patjetër 'iu paraprijë mendimi në format e tij të ndryshme. Atë mund të shoqërojnë forma simbolike të shprehjes përmes sinjaleve, zërave dhe fjalëve që mund të jenë simbole për kuptime të caktuara. Këto mund të shprehen edhe përmes vizatimeve, shenjave, fotografive dhe shkronjave, të cilat më pas do të shndërrohen në gjuhë të shkruar njerëzore. Me zhvillimin e shkrimit, njerëzia ka bërë një përshpejtim dhe ka kaluar në një periudhë të re të historisë. Ky përshpejtim ka pasur rezultate të mëdha në fushën e arsimit, ngase gjuha dhe mësimi i saj janë bërë trashëgimi kulturore e të gjithëve dhe mjet për mësimin e gjitha formave tjera të përvojave. Në këtë kontekst, është patjetër të përmendim polemikat e vjetra të reja rreth esencës së gjuhës, a është me mësim të drejtpërdrejtë nga Allahu tek Ademi kur ia mësoi emrat dhe më pas

<sup>56</sup> ذَلِكُمْ مِمَّا عَلَّمَنِي رَبِّي "Kjo është nga ajo çka më mësoi Zoti im (nuk është fall e as prognozë)". [Jusuf: 37]

<sup>57</sup> قَالَ مَا مَكَّنِّي فِيهِ رَبِّي خَيْرٌ فَأَعِينُونِي بِقُوَّةٍ أَجْعَلْ بَيْنَكُمْ وَبَيْنَهُمْ رَدْمًا "Ai (Dhulkarnejni) tha: "Atë që mua ma mundësoi Zoti im është shumë më i mirë (nga ajo që ma ofroni ju), po ju më ndihmoni me fuqi punëtorë të bëj një pendë të fortë mes jush dhe mes atyre". [El Kehf: 95]

<sup>58</sup> وَأَصْنَعُ الْفُلَّكَ بِأَعْيُنِنَا "E, ti mbaroje anijen nën mbikëqyrjen Tonë dhe me mësimin tone". [Hud: 37]

të njëjtën ia trashëgoi fëmijëve të tij, ku me kalimin e kohës gjuha u shpërnda në formë të dialekteve dhe në fund në formë të gjuhëve të pavaruara, apo gjuha njerëzore është zhvilluar me zhvillimin e jetës së “njeriut të parë” përmes formave të ndryshme?

Në trashëgiminë islame kemi një sërë tekstesh që flasin për esencën e gjuhës njerëzore dhe lidhshmërinë e saj me format e të menduarit, kuptuarit dhe të perceptuarit. Çështjen se gjuha është shpallje nga Allahu apo e përfituar dhe e caktuar nga vetë njerëzit, e ka diskutuar Ebul-Fet'h ibn Xhini, mirëpo nuk ka qenë i prerë në këtë çështje, ngase ka qenë i luhatur mes shijes dhe gjenialitetit të gjuhës arabe ku mendon se është patjetër të jetë shpallje nga njëra anë, dhe mendimit të mësuesit të tij Ebu Ali Farisi dhe tjerë nga mu'tezilët të cilët thonë se gjuha është zhvilluar nga vetë njerëzit.<sup>59</sup> Shihet se çështja e luhatjes mes këtyre dy teorive rreth zhvillimit të gjuhës ka vazhduar në të gjitha studimet gjuhësore gjatë historisë. Mirëpo, shumica e studimeve gjuhësore bashkëkohore anojnë drejt mendimit për ekzistimin e një fuqie natyrore që lind me njeriun dhe ia mundësojnë përfitimin e gjuhës sipas rrethanave të jetës. Gjuha është një veçori e përbashkët e llojit njerëzor dhe cilësi që e dallon nga të gjitha krijesat. Duke marrë parasysh dallimet e rrethanave në shoqëritë njerëzore, është shumë e natyrshme që të ketë shumë gjuhë dhe të ndryshojnë.<sup>60</sup>

Për këtë, mund të vërtetojmë se mendimet nga filozofitë e ndryshme dhe teoritë nuk kanë munguar në shkrimet rreth historisë së pedagogjisë dhe zhvillimit të mendimit pedagogjik në periudha të ndryshme, bile është e pamundur të mungojnë.

### 2.3. Ndikimi i bindjes në ligjin e tri shkallëve në të menduarit njerëzor

Shumë prej librave perëndimorë që janë referencë në historinë e pedagogjisë, flasin për një numër të shkencëtarëve që janë shfaqur në shekullin XIX. Secili prej tyre ka pasur

<sup>59</sup> Ibn Xhini, Ebul Fet'h Othman (v. 392 h./1002). El-Hasaisu, Kajro: El-Mektebet'ul-ilmijetu, 1952, vëll.1, fq. 40-47.

<sup>60</sup> Bisedën rreth “mendimit dhe gjuhës” shikojë në kapitullin e pestë të këtij libri:

Melkavi, Fet'hi, El-Bina'ul-Fikrijju: mefhumuhu ve mustevejatuhu ve haraituhu, fq. 303-345.

ndikim në zhvillimin e shkencave shoqërore, në veçanti atë të sociologjisë. Prej këtyre shkencëtarëve theksojmë: Ogyst Kont, Herbert Spenser, Emile Durkem, Maks Veber etj. Vërehet qartë se lidhshmëria e zhvillimit të sociologjisë me këta personalitete është një paragjykim që largon zhvillimin historik të sociologjisë në mënyrë të qartë në titull dhe përmbajtje me punën kreative të cilën e kishte themeluar Abdurrahman ibn Haldun në librin e tij “El-Mukaddimeh”. Do të supozojmë se këta katër personalitete të cilët njihen si themelues të sociologjisë, nuk kanë ditur gjë rreth Ibn Haldunit ose të tjerëve që kanë shkruar për tematika të cilat sot llogariten të sociologjisë. Me rëndësi në këtë kontekst është hulumtimi rreth ndikimit të thënieve teorike dhe filozofike të tyre në të kuptuarit e historisë njerëzore dhe perceptimi se në çfarë gjendje ishte jeta e shoqërive në periudha të historisë.

Prej mendimeve që ka sjellë Ogyst Kont (v. 1857) është edhe ligji i tri shkallëve, i cili është bërë edhe kornizë referuese e mendimit të tij dhe mendimit të shumë hulumtuesve deri në ditët e sotme. Sipas këtij ligji, mendimi njerëzor ka kaluar në tri shkallë të ndryshme gjatë zhvillimit, të shoqëruara me tri shkallë të përparimit shoqëror, të cilat shprehin rreth një ligji të përgjithshëm të përparimit njerëzor në fushën e zhvillimit të njohurive dhe realitetit shoqëror.

Kont bën krahasim mes zhvillimit të mendimit në shoqërinë njerëzore dhe zhvillimit të mendimit tek individi. Ai është i mendimit se individi beson fuqishëm në periudhën e fëmijërisë, më pas bëhet dialogues metafizik në periudhën e adoleshencës dhe filozof natyror në periudhën e burrisë. Ky zhvillim në organizimin dhe zhvillimin e shoqërisë njerëzore në të njëjtën kohë flet për tri shkallë:

Shkalla e imagjinatës teologjike, ku Zotin e sheh në të gjitha gjërat dhe në të gjitha ndodhitë. Në të zhvillohet edhe adhurimi nga adhurimi i çdo gjëje që ka shpirt në adhurimin e zotave të shumtë, ku secili prej tyre mbizotëron në njërin nga fuqitë natyrore, dhe krejt në fund zhvillohet në besimin e një Zoti.

Shkalla metafizike teorike, e cila është vazhdim e asaj të mëparshmes. Në këtë periudhë zhvillohet logjika në vend të imagjinatës, ngase njerëzit bëjnë përpjekje të kuptojnë Zotin në formë të idesë dhe të kuptojnë shpirtin si fuqi, të cilët orientojnë ngjarjet e botës, pa besuar se Zoti është realitet. Njeriu hulumtimet e tij i realizon në formë logjike që drejtohen drejt niveleve më të larta në mendimin metafizik.

Shkalla shkencore objektive, në të cilën ka arritur njeriu në shekullin XIX duke u mbështetur në të vërtetat që i ka grumbulluar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe përmes bashkëveprimimit me dukuritë si objekt hulumtimi, ku mendja e njeriut heq dorë nga bindjet që nuk pranojnë diskutim me qëllim për të gjetur lidhjen shkak-pasojë në mënyrë të pastër mendore, po ashtu për të hulumtuar botën me qëllim të zbulimit të ligjeve dhe sistemeve që rregullojnë dukuritë natyrore dhe shoqërore.

Edhe pse ligji i tri shkallëve, të cilin e themeloi Ogyst Kont ka vazhduar të besohet deri në shekullin XX, megjithatë është kritikuar fuqishëm nga vetë qarqet filozofike dhe shkencore perëndimore. Logjika për të cilën flet Konti nuk është e njëjtë në të gjitha shoqëritë. Ideja “e përparimit” nuk bën të studiohet duke u mbështetur në mendim filozofik paraprak. Si dhe nuk është shkencore që ideja e “shkencës” të kuptohet duke u nisur nga paragjykimi kundër mendimeve fetare dhe metafizike.<sup>61</sup>

Muhamed Abdullah Draz ka kritikuar ligjin e Ogyst Kontit duke sqaruar se ndarja e historisë njerëzore në këto tri shkallë është ndarje arbitrare që nuk mbështetet në realitet. Historia njerëzore, në periudha shumë të hershme njerëzore ka njohur shumë shkencë, zanate dhe zbulime në astronomi, inxhinieri, mjekësi e tjera, si dhe historia jonë bashkëkohore njih shumë prej shkencave fetare, orientimeve morale dhe mendimeve metafizike.

Për këtë, Abdullah Draz mendon se tri shkallët -në realitet- nuk janë shkallë të njëpasnjëshme historike, por janë

<sup>61</sup> Ligjin e tri periudhave të mendimit njerëzor dhe kritikën ndaj tij shihni në enciklopedinë britanike:  
- <https://www.britannica.com/topic/Western-philosophy/Modern-philosophy#ref365981>

çështje që veprojnë bashkërisht dhe në të njëjtën kohë te secili njeri, si dhe ato kanë detyra që përplotësojnë njëra-tjetrën në rregullimin e jetës njerëzore në formën më të mirë dhe se secila prej tyre ka fushën e vet që i përshtatet. Abdullah Drazi kur diskuton pozicionin e secilës shkallë, ai përfundon në të kundërtën e asaj që ka përfunduar Konti. Ai mendon se shkalla shkencore objektive duhet të jetë detyrimitisht e para për shkak të nevojës së madhe të njeriut ndaj saj. Sa i përket shkallës teologjike, të cilën Konti e ka radhitur si shkallë e parë -në realitet- ajo është e fundit, “ngase ajo nuk lind te njeriu përpos pas zgjerimit të horizontit, kështu që e tejkalon universin për të dal përtej tij... kështu radhitja merr kahen e kundërt të asaj që e imagjinoi filozofi dhe të tria çështjet kthehen në gjendjen e tyre logjike dhe natyrore: nevoja e trupit, nevoja e mendjes dhe nevoja e shpirtit”.<sup>62</sup>

Shumë prej shkrimeve të cilat flasin për praktikën mësimore në periudhën parahistorike ose rreth edukatës te popujt dhe shoqëritë primitive<sup>63</sup> -fatkeqësisht- mbështeten në këto referenca filozofike, duke cituar njëri nga tjetri. Njëri nga referencat në të cilin janë mbështetur shumica e shkrimeve arabe dhe perëndimore gjatë tërë shekullit XX është libri i përmendur më parë i Paul Monroe. Kapitulli i parë i këtij libri flet rreth pedagogjisë në shoqëritë primitive. Autori tregon se referencat nga të cilat ka marrë materien ishin gjashtë nga evolucioni, antropologjia dhe zhvillimi i shoqërive, më pas tregon katër referenca tjera që flasin për studimin e gjendjes së fëmijëve që janë rritur në ambiente primitive.

Me këtë vërejtje deshëm edhe një herë të vërtetojmë ndikimin e pikëpamjeve teorike dhe filozofike në të kuptuarit e të vërtetave pedagogjike në të kaluarën dhe tash.

<sup>62</sup> Muhamed Abdulla Draz, *Ed-Dinu, buhuthun mumehhedetun li diraseti tarih'il-edjan*, Kuvajt: Darul Kalem, 1970, fq. 85-86.

<sup>63</sup> Këtë vërejtje e kemi vërtetuar gjatë shfletimit të librave të mëposhtëm: Abdudaim, *Et-Terbijetu abre't-tarih: mine'l-usur'il-kadimeti hata evaili karn'il-ishrin*, fq. 19-24  
Esh-Shejbani, *Tetavvurun nadharijati ve'l-efkar'it-terbevijjeti*, fq. 21-23  
Abdulaziz, *Tetavvurin Nadharijjet'it-terbevijjeti*, fq. 75-88  
Sem'an, *Eth-Thekafetu ve't-terbijetu fi'l-usur'il-kadimeti*, fq. 47-61.

### 3. Pedagogjia në kohën e lashtë

#### 3.1. Pedagogjia në Egjiptin e lashtë

Shkrimet në këtë tematikë janë të shumta, mirëpo burimet e shumë prej tyre janë sekondare të cilave u mungon besueshmëria. Zgjedhëm të mbështetemi në tre referenca të autorëve të specializuar shkencërisht në këtë fushë. Referenca e parë është formë e shkurtuar e një ligjërate që e ka mbajtur në Bibliotekën e Aleksandrisë profesori i gjuhës së vjetër egjiptiane në Fakultetin e Arkeologjisë në universitetin e Kajros dhe këshilltarë i Bibliotekës së Aleksandrisë. Kjo formë e shkurtuar është prezantuar në Bibliotekën e Aleksandrisë dhe e përgatitur nga një hulumtues specialist në gjuhën e lashtë egjiptiane. Shihet qartë se hulumtuesi materien e ligjëratës e ka përgatitur nga përvojat personale empirike në gjuhët e lashta egjiptiane dhe arkeologjinë e lashtë egjiptiane, si dhe nga referenca origjinale rreth historisë së lashtë të Egjiptit në pjesën që ka të bëjë me arsimin, përfshirë këtu edhe atë që ka shkruar historiani grek Herodoti rreth vizitës së tij bërë Egjiptit në vitin 440 para erës së re. Hulumtuesi ka përfunduar se arsimi deri në moshën dhjetë vjeçare është zhvilluar në shtëpi. Ai në esencë përfshinte mësimin e profesionit të familjes. Fëmijët e mbretërve arsimoheshin nga edukatorë specialë në shkolla të veçanta për ta. E gjithë kjo krahas themelimit të shkollave të veçanta katërvjeçare për përgatitjen e punëtorëve në administrata shtetërore.

Shkolla në atë kohë quhej shtëpi e diturisë. Kishte shkolla për mësimin e fesë për arritjen në shkallët e ndryshme të priftërisë. Nxënësit mësonin shkrimin, leximin, diktimin, rregullat e gjuhës, transkriptimin, matematikën, gjeometrinë, letërsinë etj. Në mësim përfshiheshin vetëm fëmijët meshkuj, ndërsa femrat në të shumtën e rasteve ishin analfabete. Ndëshkimi fizik ishte i domosdoshëm në arsim. Shihet se shkrimi dhe librat kishin një pozitë të rëndësishme. Është gjetur një tekst përmes të cilit edukatori këshillon të riun duke i thënë: "Vëre zemrën pas librave, duaji ato siç e do nënën tënde, ngase nuk ka gjë më me vlerë se sa librat". Vërehet

se dituria dhe mësim-nxënia ishin mjete për ngritje në nivele shoqërore. Prej fjalëve të urta në Egjiptin e vjetër thënia e njeriut të urtë: “shih, nuk ka shtresë që nuk gjykohet, ndërsa dijetari gjykon veten e tij”. Po ashtu thënia e tij: “Njeriu i mësuar shpërndahet për shkak të veprimit të tij”.<sup>64</sup>

Egjiptianët e lashtë kanë njohur bibliotekat, mënyrat e arkivimit, ruajtjen dhe klasifikimin e dokumenteve. Kanë njohur edhe një lloj tjetër të institucioneve që quheshin “dar’ul-hajati” shtëpi e jetës, të cilat ishin qendra për hulumtime shkencore në sferat fetare dhe shkencore, përfshirë edhe astronominë, farmacinë, inxhinierinë etj. Trashëgimia e egjiptianëve të vjetër të cilën e njohim sot flet për zgjuarsinë e tyre në mjekësi, operacione kirurgjike dhe përgatitjen e barnave. Kjo trashëgimi ruan edhe emrat e mjekëve dhe mjeteve mjekësore. E gjithë kjo krahas matematikës, gjeometrisë, astronomisë, gjeologjisë, bujqësisë, kimisë dhe ndërtimtarisë.<sup>65</sup>

Egjiptianët e vjetër, shkrimi i kanë caktuar një zotëreshë me emrin “Şcat”, ndërsa librit zotin e diturisë me emrin “Tehuti”. Disa faraonë janë shfaqur në fotografi duke bartur me vete mjete për shkrim.<sup>66</sup>

Nga e gjithë kjo përfundojmë se praktikat edukative dhe arsimore në Egjiptin e vjetër janë nisur nga një mendim pedagogjik i cili cilësohet me qartësi dhe gjithëpërfshirje. Ky mendim ngritë vlerën e diturisë dhe mësim-nxënies, në veçanti të shkrimit. I jep përparësi meshkujve, është i ashpër ndaj nxënësve dhe përfshin shkenca të shumta të cilat i njeh civilizimi bashkëkohorë.

### 3.2. Pedagogjia në Kinën e lashtë:

Paul Monroe mendon se pedagogjia e lashtë kineze është shembull i mjaftueshëm për të folur rreth pedagogjisë lindore në kohët e vjetra. Ai e sheh atë si pedagogji konservatore, që

<sup>64</sup> Abdulhalim Nurudin, *Et-Terbijetu ve't-ta'limu fi Misr'el-Kadimeti*, Temën në formë të shkurtuar e ka realizuar hulumtuesi Muhab Dervish. Shih: <https://www.bibalex.org/archeology/attachments/ArcheologicalCulturalSeason/files/2010121912363866625.pdf>.

<sup>65</sup> Semir Edib, *Merhale't-ut-Ta'lim'il Ali fi Misr'el-Kadimeti: Dur'ul-Hajati*, Kajro: El-Arabi li'n-neshri ve't-tevzi', 1990.

<sup>66</sup> Abdulaziz Salih, *Et Terbijetu ve't-ta'limu fi Misr'el-Kadimeti*, Kajro: Dar'ul-kavmijjeti, 1966.



ka për detyrë edukimin e gjeneratave të reja në sistemin e jetës që në të kaluarën kanë dominuar në shoqëri. Kjo e kaluar ka përfshirë tradita, shkathtësi, norma të jetës të cilat realizohen në formë të sistemuar dhe kërkon praktika pedagogjike që përqendrohet në nënshtrim, rregullshmëri, mësim përmendësh dhe përkujtim. Kjo formë pedagogjike ka përfshirë të gjitha trojet dhe banorët e Kinës. Ky sistem ka përfshirë nënshtrimin në provime të rënda në të cilat mund të kalojë vetëm një numër i vogël, të cilët zgjidhen për punë shtetërore dhe kanë një pozitë të dalluar në shoqëri. Këta të punësuar udhëheqin jetën politike dhe kontrollojnë sistemin dhe orientimet e jetës shoqërore. Këta përfaqësojnë shtresën aristokrate politike e ngritur mbi aristokracinë e diturisë.<sup>67</sup>

Që nga shfaqja e Konfuçies dhe përhapja e mësimave të tij në Kinë, pedagogjia kineze përfiton një dimension ideologjik dhe moral i lidhur ngushtë me filozofinë e tij. Të gjitha besimet dhe praktikat në Kinën e vjetër bazoheshin në besimin konfuçist, i cili kishte unifikuar jetën politike dhe atë shoqërore me një sistem të fortë moral dhe filozofik. Kjo fe kishte gjetur mbështetje nga dy fetë tjera që i kishte njohur Kina më parë, budizmi dhe taoizmi. Ky sistem mbështetet në kontrollimin e “pesë raporteve”, të cilat janë bazë e plan-programeve mësimore. Këto pesë raporte janë: pushteti, daba dhe biri, burri dhe gruaja, vëllai me vëllain dhe shoku me shokun. Parim themelor në mësimet e Konfuçias është se virtyti është baraspeshë e plotë mes emocioneve dhe ndjenjave dhe se ajo është doktrinë e mesme.<sup>68</sup>

Pedagogjia konfuçiane kineze ngritët mbi bindjen se njeriu nga natyra e tij është e mirë, dhe se sistemi etik të cilën e mbjell pedagogjia, ruan këtë natyrshmëri të mirë dhe orienton jetën e njeriut në këtë drejtim. Këto mësim flasin kështu: “Njeriu drejtohet drejt virtytit siç drejtohet uji drejt pjesës më të ulët. Kur nxënësi pyet: A ka ndonjë fjalë të mirë që mund të jetë si rregull për ta praktikuar njeriu gjatë tërë jetës? Mësuesi i përgjigjet: Po, ajo është sjellja me të njëjtën masë.

<sup>67</sup> Monroe, A Text-Book of the History of Education, fq. 22.

<sup>68</sup> Ibid., fq. 19.

Atë çka nuk dëshiron që tjerët ta bëjnë ty, mos ua bën të tjerëve”.<sup>69</sup>

Nën ndikimin e sistemit arsimor, Kina ka poseduar një sasi të madhe të metodave të menduarit, ndjenjave, normat e sjelljes, ruajtja e traditave. Megjithatë, kjo pedagogji ka qenë më e ngurtë në krahasim me tjerat në përmbajtje, formë dhe metoda.<sup>70</sup>

Paul Monroe në librin e tij ka kritikuar sistemin arsimor në Kinën e vjetër, sistem i cili shumë prej mësimeve të tij kanë vazhduar të praktikohen deri ka fundi i shekullit XIX. Populli kinez ka ruajtur pozitën e tij dhe ka realizuar qëllimet e veta përmes arsimimit dhe si rezultat i saj sistemi arsimor ka realizuar qëllimet e veta.

Edukimi i individit në këtë sistem ngrihej në kufizimin e tij dhe kujdesjes ndaj stabilizimit të shoqërisë e jo përparimit të tij. Kjo cilësi negative e qëllimeve të pedagogjisë është që sqaron suksesin parcial. Autori në kritikën e tij bën që arsimit i vjetër në Kinë të jetë model i edukimit të popujt lindorë, të cilët nuk janë zhvilluar siç janë zhvilluar popujt perëndimorë!

Monroe më pas ka vënë një nëntitull në titullin rreth Pedagogjisë kineze për ta përfshirë më detajisht, ku në bazë të saj do të gjykon për normën e pedagogjisë lindore në formë të përgjithshme. Ai edhe pse pranon se ekzistojnë divergjenca brenda sistemeve arsimore në lindjen e vjetër, mendon se pedagogjinë kineze është shembull i mrekullueshëm për këtë qëllim. Ai mendon se qëllimi, shpirti dhe parimet e përgjithshme, që kontrollojnë konceptin e “pedagogjisë”, janë të përbashkëta.

Ambienti lindor nuk është i thjeshtë dhe i pasistemuar siç ishte ambienti i njeriut primitiv, i cili jetonte brenda sistemit të trashëguar shoqëror. Tanimë kanë lindur raporte shoqërore të ndërlikuara për familjen, shtetin, fenë, tregtinë, zejtarinë, aktivitetin ushtarak etj. Kështu mësimi i gjuhës u bë çështje e kërkuar dhe për të cilën kihet kujdes i veçantë. Më pas mësi-

<sup>69</sup> Ibid., fq. 26.

<sup>70</sup> Ibid.

mi -deri diku- mori kuptimin e mësimin të gjuhës me përpikëri në formë të letërsisë së kufizuar historike dhe fetare.

Gjendet edhe një cilësi tjetër e arsimit lindor, në të cilën Kina mund të jetë model. Jeta me qëllimin e saj dhe pedagogjia në qëllimet dhe veçoritë e saj, janë të gjykuar përmes formave të pushtetit të jashtëm diktatorial. Individu ka pozitë në shoqëri, por kjo pozitë është e përkufizuar dhe e rregulluar nga jashtë, -thjeshtë- pedagogjia është ajo që ia ka caktuar këtë pozicion. Prej veçorive të pedagogjisë kineze, me të cilat dallohet nga pedagogjitet tjera lindore është edhe ajo se shtresa shoqërore nuk është e përkufizuar paraprakisht, ngase ka mundësi të kalon nga një shtresë në tjetrën shtresë shoqërore. Pushteti i jashtëm këtu janë traditat të cilat mësohen përmes familjes, ndërsa pushteti i familjes gjendet në konfuçionizëm, e cila realizohet përmes proceseve shoqërore që e lidhin individin me pushtetin e të së kaluarës. Në Indi, pushteti i jashtëm fshehët në sistemin e shtresave indiane. Në Persinë e vjetër fshehët te shteti. Në Egjiptin e vjetër fshehët tek udhëheqësit politik dhe fetarë. Në asnjërën prej këtyre shoqërive nuk ka shanse për zhvillimin e personalitetit. Po nëse gjendet mundësia për zhvillimin e aftësive si është rasti te kinezët, ky zhvillim individual përballet me rezistencë kundër tij dhe nuk ka shanse për shprehje të lirë.

### 3.3. Edukata dhe arsimit në Irakun e lashtë

Për të shkruar rreth kësaj teme jemi mbështetur në një numër të kufizuar të referencave, të cilat i kanë përgatitur akademikët specialistë në këtë temë. Gjithë atë që e kanë shkruar e kanë mbështetur në burime origjinale të teksteve historike. Nga mesi i burimeve që kanë shkruar rreth arsimit në Irakun e vjetër ose siç është quajtur Mesopotami (Vendi mes dy lumenjve), jemi mbështetur në një sërë burimesh të cilat llogariten bazë për shumë prej atyre që kanë shkruar në këtë tematikë. Disa prej këtyre burimeve i kanë shkruar personalitete shkencore të specializuara në historinë dhe gjuhën e vjetër të Irakut. Këtu përkujtojmë një hulumtim të botuar në një revistë shkencore, ku hulumtuesi tregon se gjatë përgatitjes

së tij është mbështetur në një sërë tekstesh të përkthyer nga “pllakat sumere”, si dhe në disa libra të cilat janë mbështetur në sqarime nga të dhëna arkeologjike të shkruara në gjuhën akadije, babilije dhe ashurije në formë të pllakave prej baltës. Hulumtuesi përdorimin e burimeve e ka ofruar në atë formë që sjell besueshmëri.<sup>71</sup> Shumë prej të dhënave rreth edukimit dhe arsimimit në Irakun e vjetër janë të shpërndara në librat e historisë së vjetër, librat e zhvillimit të gjuhës, librat e zhvillimit të shkencave, zhvillimi i legjislacioneve e tjera, prej të cilave disa edhe i kemi konsultuar.

Sa i përket zhvillimit të gjuhës, autori i librit “Tarih’ul-kitabeti” (Historia e shkrimit) thekson se dy sistemet e para të shkrimit në historinë njerëzore janë: shkrimi mismari-sumeri dhe shkrimi hieroglifik egjiptas. Që të dyja, siç i quan autori janë në “lindjen e afërt të lashtë”. Sipas tij, shkrimi mismari në Irakun e vjetër është më i vjetër se shkrimi në Egjipt.<sup>72</sup> Ky shkrim konsiderohet i shpikur dhe nuk mund të mbështetet në ndonjë shkrim tjetër ngase është zhvilluar me simbolet e veçanta të tij.<sup>73</sup>

Qëllimi i shkrimit -natyrisht- ishte shprehja dhe regjistrimi i asaj që është në brendinë e njeriut, por me kalimin e kohës është bërë mjet i vet formimit të gjuhës që posedon elementet e stabilizimit, dhe më pas shkolla është bërë fryt i zbulimit dhe zhvillimit të gjuhës. Këto shkolla kanë arritur kulmin e zhvillimit në kohën e babilonasve dhe asirianëve, dhe janë shfaqur qendrat shkencore të specializuara të njohura me emrin “shtëpia e pllakave” ose “shtëpia e urtësisë”. Hulumtuesi Abdurrezak Haxhim transmeton një tekst të njërit nga mbretërit asirian ku shpreh krenarinë për atë që ka mësuar, përfshirë: shkrimin, matematikën dhe urtësinë.<sup>74</sup>

Pionierët e këtyre shkollave në esencë janë djemtë e mbretërve, princave dhe të pasurve. Qëllimi kryesor ka qenë

<sup>71</sup> Abdurrezak Hasan Haxhim, “Ususu kijam’il-medreseti fi bilad’ir-Rrafidejni: dirasetun tarihhijetun”, *Mexhellet’ul-Kadisijjeti li’l-ulum’il-insanijjeti*, vëll 13, nr. 4, 2010, fq. 132-150.

<sup>72</sup> Fridrich, Johans, *Tarih’ul-kitabeti*, përktheu: Sulejman Ahmed, Damask: Menshurat’ul-hej’et’il-amet’is-surijjeti li’l-kitabi, bot. 2, 2013, fq. 55-65. Autori është historian gjerman. Libri është përkthyer në disa gjuhë.

<sup>73</sup> Po aty, fq. 35.

<sup>74</sup> Abdurrezak Hasan Haxhim, “Ususu kijam’il-medreseti fi bilad’ir-Rafidejni: dirasetun tarihhijetun”, *Mexhellet’ul-Kadisijjeti li’l-ulum’il-insanijjeti*, vëll 13, nr. 4, 2010, fq. 134.

përgatitja e shkruesve që do të marrin përsipër menaxhimin e qyteteve, priftërinjve për faltore dhe eprorëve për ushtri. Ishte traditë që shkruesit profesionin t'ua trashëgojnë djemve të tyre. Zbulimet arkeologjike kanë nxjerrë në pah ekzistimin e bibliotekave të mëdha nga pllakat prej balte, të cilat përmbajnë të dhëna rreth shkencave që kanë qenë dominuese në atë kohë, në veçanti gjeometria, mjekësia, astronomia, legjislacioni, gjuha dhe letërsia. Shihet qartë se studimi ishte i gjatë dhe i rëndë dhe se nxënësit iu nënshtroheshin ndëshkimit në rast se nuk mësonin apo silleshin keq.

Taha Xhabir thekson se llojet më të njohura të shkollave në periudhën e babilonasve ishin shkollat e shkrimit, në të cilat nxënësit mësonin shkrimin mismari. Ato ishin shkolla që kanë kontribuar në zhvillimin e aktivitetit letrar, në veçanti fushën e regjistrimit dhe përkthimit. Shkruesit që merreshin me çështje letrare obligoheshin të regjistronin trashëgiminë letrare, transkriptimin e pjesëve letrare të njohura nga rrëfimi i tufanit, rrëfimi i Ejupit babilonas, tekstet mjekësore dhe astronomike, veçoritë e ditëve duke përfshirë gëzimet dhe pikëllimet.<sup>75</sup>

Vërehet se faltarja ka qenë epiqendër e sistemit shoqëror, ekonomik dhe politik. Pikërisht për këtë kishte nevojë për përgatitjen e një shtrese të administratorëve të arsimuar përmes një sistemi arsimor. Edhe praktikisht, pllakat e baltës vërtetojnë "ekzistimin e institucioneve arsimore zyrtare në një kohë më të vjetër historikisht,... vendet kulturore në Irakun jugor mund të dëshmojnë në formë të pranuar se termi (i parë) i shkollave është regjistruar atje... kjo mund të datojë diku kah mijëvjeçari i tretë para erës së re... në kohën e Hamurabit pra në mes të shekullit XVIII para erës së re janë shfaqur institucione që merreshin me transkriptimin e

<sup>75</sup> Taha Bakir, Mukadimetun fi tarih'il-hadarat'il-kadimeti, Pjesa e parë: El-Vexhizu fi tarihi hadareti vadi'r-Rafidejni, Bagdad & Bejrut: Dar'ul-Verrak, 2009, fq. 503-505. Botimi i parë ka qenë më 1951, ndërsa i dytë më 1955.

Taha Bakir është prej profesorëve të vjetër të historisë së vjetër. Është i specializuar në arkeologji dhe gjuhët e vjetra akadije. Gjithashtu është hulumtues empirik në zbulime, hulumtime dhe tekstet e vjetra në Irakun e vjetër. Ka vdekur më 1984.

shkrimeve dhe arsimimin e fëmijëve. Ato institucione lulëzojnë në të gjithë territorin e vendit”.<sup>76</sup>

Fjala sumerite e cila është përballë fjalës “medrese-shkollë” në dialektin akadije do të thotë shtëpi e pllakave. Ekzistojnë tekste që flasin për krenarinë e mbretërve se kanë mësuar në shkolla, tekste që përmbajnë testamentin e shkrimtarit drejtuar mësuesit të djalit të tij, tekste ku shkrimtari flet se ç’ka vepruar kur ka hyrë në shtëpinë e pllakave, përfshirë shkrimin dhe leximin, tekste që flasin për rrugët përreth shkollave dhe sallat e provimeve. Ekzistojnë gjurmë që flasin për ndërtesat e shkollave, si dhe ekzistojnë pllaka që përmbajnë regjistrime arkeologjike të cilat ruajnë të dhëna rreth plan-programeve shkollore në shtëpitë e pllakave. Ajo që tërheq vëmendjen është se shumë prej grave në periudhën e vjetër babilonase ishin mësuese. Ato posedonin pozicione të rëndësishme në jetën shoqërore, dhe se disa prej tyre ishin edhe shkruese.<sup>77</sup> Kjo tregon se gratë kanë marrë pjesë në arsim. Ato janë arsimuar dhe në mesin e tyre kanë dalë shumë shkruese dhe transkriptuese, të cilat kanë qenë të njohura në këtë profesion. Megjithatë, numri i tyre ishte më i vogël se numri i burrave. Në përgjithësi, përqindja e të shkolluarve prej meshkujve dhe femrave ishte e vogël, ngase mësimi nuk ishte obligues dhe se përfshinte fëmijët e të pasurve të cilët nuk kishin nevojë të dërgojnë fëmijët e tyre në punë për të mbuluar shpenzimet e jetës.<sup>78</sup>

Drejtori i shkollës quhej “profesor”. Ai ishte personalitet i rëndësishëm që meritonte respekt. Drejtorin e ndihmonin edhe mësues dhe administratorë të tjerë. Ekzistojnë të dhëna dhe tekste të detajuara rreth plan-programeve të shkollës, sistemeve të provimit dhe raportet e mësuesve me nxënësit. Çështjet e gjuhës, transkriptimit dhe shkrimit kanë përfshirë një hapësirë të madhe. Ato kanë përfshirë emrat e kafshëve dhe bimëve. Janë përfshirë edhe çështjet e numrave, llogaritë e yjeve, përkthimi nga gjuha sumerite në atë akadije. Letërsia

<sup>76</sup> Kristofer Lukas, *Hadaret'ur-Rukum'it-tinijeti ve sijaset'ut-terbijjeti ve't-ta'limi fi'l-Irak'il-kadimi*, Përkthim: Jusuf Abdulmesih, *Silsilet'ul-mevsuat'is-sagireti* (61), Bagdad: Vizaretu Thekafeti ve'l-l'ami, 1980, fq. 17-18.

<sup>77</sup> Sulejman, *El Iraku fit tarihil kadimi*, vep. e cituar, fq. 267.

<sup>78</sup> Haxhim, *Ususu kijam'il-medreseti fi bilad'ir-Rafidejni*, vepër e cituar, fq. 148.

kishte një pozitë më të lartë dhe cilësohej si e shenjtë, në veçanti letërsia e vjershave luftarake.<sup>79</sup>

### 3.4. Edukata dhe arsimit në Greqinë antike

Përsëri kthehemi te disa libra relativisht të vjetër (përafërsisht gjysma e shekullit XX), të cilat janë botuar në gjuhën arabe, me qëllim të sqarojmë dy çështje të rëndësishme: e para se këto libra -në realitet- janë përkthime të librave më të hershme në gjuhë tjera, dhe e dyta se pothuaj çdo gjë që është shkruar më pas në gjuhën arabe prej librave relativisht të reja (tre dekadat e fundit) -në të shumtën e rasteve- janë mbështetur në këto libra të vjetra.

Sidoqoftë, mund të themi në mënyrë të prerë se nuk ka asnjë periudhë historike apo civilizim i vjetër që është hulumtuar e studiuar më shumë se sa civilizimi i vjetër grek. Shkrimet që ndërlidhen me Greqinë antike janë të bollshme, në të gjithë gjuhët dhe në tematika të llojllojshme. Edhe pse këto shkrime janë marrë më shumë me çështjen e “filozofisë” më shumë se sa me çështjet tjera, vërejmë se temat e shkencave, arteve dhe letërsisë janë të pranishme në mënyrë të pavarur ose përmes trajtimeve filozofike, përfshirë këtu edhe çështjen e “edukatës dhe arsimit”.

Pastaj, sasia e materies që e ka gëzuar “edukata dhe arsimit” në Greqinë antike është shumë më i madh se sa sasinë e materies që e ka gëzuar e njëjta çështje në cilindo civilizim tjetër të vjetër. Shembull për këtë është se vërejmë librin: “Kultura dhe edukata në kohërat e vjetra: studim historik krahasues”, i cili pothuaj tërësisht flet për kulturën dhe edukatën te grekët dhe romakët. Autori sqaron shkaqet e këtij studimi të detajuar të kulturës greke duke thënë: “Përgjigjja më e saktë ndaj kësaj pyetjeje është se lloji njerëzor nuk mund të gjejë diçka në kulturën e tij të kësaj jete, e të mos jetë borxh ndaj grekëve... Mund të themi troç, se nuk ka gjë në kulturën greke që nuk ia ndriçon njeriut rrugët e jetës”.<sup>80</sup>

<sup>79</sup> Po aty, fq. 41-49.

<sup>80</sup> Vehib Ibrahim Sem'an, *Eth-Thekafetu ve't-terbijjetu fi'l-usur'il-kadimeti: dirasetun tarihijetun mukareneh*. Nga gjashtë kapituj që ka libri, katër prej tyre flasin për grekët dhe romakët. Nga 383 faqe sa ka libri, 282 flasin për grekët dhe romakët.

Vërejmë se autori Abdullah Abdudajim, në një kapitull të librit të tij rreth pedagogjisë në lindjen e vjetër ka përfshirë pedagogjinë indiane, izraelite, kineze, japoneze, asiriane, persiane, egjiptiane në afër 40 faqe, në kohë kur veçon dy kapituj të plotë për pedagogjinë greke dhe asaj romake në 52 faqe.<sup>81</sup>

Në librin “Zhvillimi i teorisë pedagogjike” vërejmë se autori shpesh jep komplimente dhe njoftime rreth pedagogjisë greke. Ai thotë: “Nëse qëllimet e pedagogjisë moderne -siç janë caktuar sot në shkollat tona- nuk gjejnë gjë më të ngritur se sa të caktojnë për secilin individ në këtë jetë gjërat që jetës i japi vlerë, për këtë mendojmë se përveç në historinë e Greqisë nuk ka dukuri prej dukurive të historisë së pedagogjisë që i intereson nxënësit dhe e shpërblen atë, nëse hulumton në mjetet dhe metodat që realizojnë këto qëllime”.<sup>82</sup> Në realitet, ky kompliment nuk është gjë tjetër, pos përkthim fjalëpërfjalësh i asaj që e ka thënë Monroe.<sup>83</sup>

Admirimi ndaj civilizimit grek vazhdon në pjesën dërrmuese të shkrimeve rreth historisë së edukatës dhe arsimit. Këto shembuj po i përmbyllim me atë që është shkruar në parathënien e përkthimit të librit “Diskursi mbi metodën” (*Discours de la méthode*) të Dekartit, ku redaktori i përkthimi thotë: “në një formë tjetër, kjo nënkupton se filozofët grekë janë ata që kanë përgatitur për mbarë njerëzinë rrugën e të menduarit të drejtë, hulumtimin e hollësishëm në univers, si dhe ngjarjet dhe dukuritë që i përfshin universi dhe lidhshmërinë e tyre me krijuesin dhe me njeriun. Nga ky kënd, njerëzia mbarë i është borxh Greqisë për filozofinë e tyre teorike dhe praktike dhe nuk ka dyshim se ajo ka qenë prodhim i bujshëm logjik dhe vepër e madhe shpirtërore e gjenialitetit grek. Është kështu sepse filozofët grek janë të parët që kanë filozofuar rreth të vërtetës, të parët të cilët kanë medituar në formë filozofike gjatë hulumtimit rreth të vërtetës, të parët që kanë hulumtuar logjikisht në komentimin meto-

<sup>81</sup> Abdudajim, *Et-Terbijjetu abre't-tarihi: mine'l-usur'il-kadimeti hatta evail'il-karn'il-ishrune*, vepër e cituar, fq. 663-664.

<sup>82</sup> Abdulaziz Salih, *Tetavvurun Nadharijet'it-Terbevijjeti*, Kajro: Dar'ul-mearif, 1964, fq. 96. Botimi I pare i tij ka qenë më 1947.

<sup>83</sup> Monroe, *A Text-Book in the History of Education*, *Ibid.*, fq. 59.



dologjik të të vërtetave të çështjeve në atë që shfaqet dhe që fshehët, duke hulumtuar motivet e çështjeve në përgjithësi dhe motivin e parë nga e cila lindin gjitha motivet dhe tek ajo kthehen gjitha çështjet, në veçanti.<sup>84</sup>

Është për t'u habitur, se edhe krahas admirimit të madh dhe komplimenteve të shumta, hulumtuesit vërejnë se një pjesë e asaj që shkruhet rreth civilizimit grek janë vetëm perceptime të pavërtetuara, bile në disa çështje që transmetohen mund të ketë edhe kundërtënie. Kështu Vehib Sem'an në një rast thotë: "Nuk dimë cilat metoda... ose ndoshta... ndoshta... këtë nuk e dimë saktësisht... mund të jetë shkak... ky apo ai shkak ose që të gjitha".<sup>85</sup>

Tekste të ngjashme përsëriten edhe në raste tjera. Ka dallime të mëdha edhe në komentimin e teksteve që u vishen filozofëve grekë, siç është rasti gjatë komentimit të animit të Platonit drejt socializmit të plotë, duke anuluar pronësinë dhe familjen.<sup>86</sup>

Po ashtu, burimet japin të dhëna kontradiktore gjatë përshkrimit të pozitës së femrës në sistemin edukativ, detyrës së femrës në shoqëri dhe pozitës së edukatës ushtarake në sistemin arsimor.<sup>87</sup>

Më e rëndësishme është pamundësia e përgjithësimin e arsimit në Greqinë antike, për shkak të dallimit të edukatës spartane nga ajo athinase, si dhe për shkak të mendimeve të shumta të cilat i kanë ofruar filozofët, sidomos mendimet e Sokratit, Platonit dhe Aristotelit. Shoqëria e Spartës është shoqëri luftarakësh, ku si rrjedhojë e saj edukata në esencë është edukatë fizike dhe shumë pak kujdesen për shkrim dhe lexim. Arsimi është obligativ që është në përkujdesin e shtetit dhe në të shumtën e rasteve përfshin djemtë dhe vajzat. Ndërsa edukata në Athinë ishte më përparimtare, ngase krahas asaj ushtarake, përfshinte edhe dimensionet mendore,

<sup>84</sup> Muhamed Mustafa Hilmi, në parathënieën e librit: Dekart, Rene, *Mekal an'il-menhexh* (Diskurs mbi metodën), përkthyes: Mahmud Muhamed El-Hudejri, Redaktor: Muhamed Mustafa Hilmi, Kajro: El-Muesseset'ul-misrijjetu, botimi 2, 1968, fq. 4-5.

<sup>85</sup> Sem'an, *Eth-Thekafetu ve't-terbijjetu fil'usur'il-kadimeti: dirasetun tarihijjetun mukarenetun*, vepër e cituar, fq. 78.

<sup>86</sup> Po aty, fq. 160-163.

<sup>87</sup> Po aty, fq. 195-199.

letrare, estetike etj. Arsimimi nuk ishte obligativ dhe dominonte tendenca liberale që zhvillonte krenarinë e individit me veten e tij dhe ndjenjën e përgjegjesisë ndaj shoqërisë. Athina nuk njihnte sistem të caktuar pedagogjik për gratë. Gruaja athinase ishte e mbyllur në shtëpi dhe pronë e babait më pas e burrit të saj. Ka dallim mes gruas aristokrate e cila nuk shihej në rrugë, përpos me kokë dhe fytyrë të mbuluar në shoqërim të ndonjë të afërmi të saj dhe gruas së varfër ose grave robëresha që ishin shërbëtore.<sup>88</sup>

Në mesin e përgjithësimeve të cilët vërehen në shumicën e shkrimeve rreth pedagogjisë greke është edhe përgjithësimi që sqaron njërën nga dallimet elementare që dallon këtë pedagogji nga pedagogjitë tjera në civilizimet tjera të vjetra. Ky dallim është dobësimi i dimensionit fetar në krahasim me dominimin e këtij elementi në arsimin e Egjiptit të vjetër ose Irakut të vjetër. Si rezultat i këtij përgjithësimi, vjen përgjithësimi tjetër i cili thotë se shkollat zyrtare në Greqi kanë ndryshuar nga shkollat që kanë qenë më parë në Egjipt, Babiloni ose tek hebrenjtë. Nëse shkollat e Egjiptit dhe Babilonisë kanë shërbyer faraonëve ose imperatorëve dhe shkollat hebraike kanë pasur për qëllim të realizojnë qëllimet fetare, qëllimi i shkollave greke ka qenë edukimi i qytetarëve. Sa i përket orientimit të grekëve ndaj gruas, në aspektin praktik ka qenë i ngjashëm me atë lindor.<sup>89</sup> Arsimi ishte i mundësuar vetëm për elitën dhe se mbi 90 % e popullatës ishin robër dhe shërbëtorë.

Më parë theksuam librin e Paul Monroe i cili flet rreth historisë së pedagogjisë. Në të flet për historinë e vjetër të pedagogjisë në Kinë si shembull për pedagogjinë lindore, më pas pjesa më e madhe e librit flet rreth edukatës në Evropë, duke filluar me Greqinë antike.

Paul Monroe si shkak për zhvillimin e pedagogjisë greke e gjen në pjekurinë që e ka arritur shoqëria greke. Çdo ndryshim në sistemin shoqëror vjen si rezultat i përpjekjeve për të dalë nga ky sistem duke shpikur mendime të reja. Më pas

<sup>88</sup> Muhamed Munir Mursi, *Tarih'ut-terbijjeti fi'sh-sharki ve'l-garbi*, Kajro: Alem'ul-Kutubi, 1977, fq. 83-85.

<sup>89</sup> Sem'an, *Eth-Thekafetu ve't-terbijjetu fi'l-usur'il-kadimeti: dirasetun tarihijjetun mukarenetun*, vepër e cituar, fq. 190-191. Pothuaj të gjitha përgjithësimet e këtij autori janë përkthim i asaj që gjendet në librin e Monroe. Shih: Monroe, *A Text-Book in the History of Education*, Ibd., fq. 59.

shoqëria vëren se këto mendime të reja janë të përshtatshme dhe i pranon ato. Kështu vjen në një gjendje të re ndryshe nga ajo që ishte më parë. Kjo gjendje -vetvetiu- përfaqëson një dimension të dalluar të pedagogjisë greke, ngase rëndësia e pedagogjisë greke -sipas mendimit të Monroe- fshehët në realitetin se shoqëria ka arritur në shkallën e pjekurisë që i ka mundësuar hapjen e derës së zhvillimit. Si rezultat i kësaj, pedagogjia në këtë shoqëri ka dhënë mundësinë të zhvillohet individi dhe të ofron iniciativat e tij. Ofrimi i mundësive të lira për marrjen e iniciativave individuale nxitë për përparim dhe stabilizim shoqëror dhe se kjo çështje është ndër çështjet më të rëndësishme në jetën shoqërore dhe civile, dhe si e tillë llogaritet si çështje e rëndësishme pedagogjike. Monroe është i mendimit se pedagogjia greke është e para që ka realizuar këtë çështje.<sup>90</sup>

Më pas, Monroe ka sqaruar dimensionet në të cilat është zhvilluar personaliteti i qytetarit grek duke përfshirë atë politik, moral, ideologjik dhe artistik. Pastaj Monroe edhe më shumë rritë famën e grekëve në aftësinë e tyre për përgjithësim, jo në formë të përgjithshme siç është rasti me indianët, e as në formë individuale siç është rasti me hebrenjtë, por për shkak se arsimimi është në dituri dhe filozofi në formë abstrakte ndaj ligjeve dhe parimeve ndërkombëtare.

Monroe ka vënë një titull për negativitetet që mund të pranohen në pedagogjinë greke. Është për t'u habitur se si ai, pasi ka numëruar disa prej këtyre negativiteteve, flet për mosekzistimin e sistemit moral duke thënë: "Paqjetër të pranojmë se dobësia më e madhe e personalitetit grek është paaftësia për formulimin e një sistemi të rreptë të parimeve morale. Largpamësia e filozofisë greke ka ofruar një bazament të mjaftueshëm për elitën në numër të vogël që mund të ofrohet me madhështinë morale të Sokratit dhe Platonit. Duke u bazuar në atë se ndjenjat fetare të grupit nuk ishin të mjaftueshme për këtë qëllim, vërejmë se hebraikët ishin burim që mundësonin furnizimin me këtë element të madh të

<sup>90</sup> Monroe, *A Text-Book in the History of Education*, Ibid., fq. 52-53.

personalitetit njerëzor, me qëllim të mbështetjes dhe kompletimit të punës së grekëve”.<sup>91</sup>

#### 4. Zhvillimi i mendimit pedagogjik fetar te hebrenjtë dhe te të krishterët

Më parë theksuam se me “mendim pedagogjik” kemi për qëllim referencën teorike dhe filozofike të cilën e përpilon pedagogu në të kuptuarit e tij ndaj bazave të mësimdhënies dhe mësim-nxënies, si dhe mendimet e tij që kontrollojnë praktikën edukative dhe arsimore në shoqëri. Për këtë, çdo bisedë rreth pedagogjisë në kontekstin teorik dhe praktik, mbështetet në mendim pedagogjik.

Studimi i historisë së njeriut -qoftë nga këndi fetar apo ai laik- vërteton se feja ka qenë prezente me fillimin e jetës së njeriut në tokë, është prezente dhe nuk pritet që do të zhduket. Po ashtu edhe edukata dhe arsimit kanë qenë prezente me fillimin e jetës së njeriut dhe vazhdojnë të jenë. Është kështu për arsye se feja ofron sqarim rreth ekzistimit të botës, detyrën e njeriut dhe qëllimin e ekzistimit dhe jetës së tij në tokë. Pedagogjia gjithnjë ka qenë mjet për përgatitjen e njeriut sipas këtij kuptimi, i cili dallon nga një shoqëri nga tjetra, varësisht nga ndikimi fetar në të. Njeriu i kërkuar në edukatën spartane është ushtari i fortë, i cili u përballon lodhjeve dhe i nënshtrohet sistemit. Në edukatën athinase është qytetari i lirë i kompletuar mentalisht dhe fizikisht. Te hebrenjtë është ai i cili është i lidhur me ligjet e Tevratit duke zbatuar kushtet e përkatësisë në popullin e zgjedhur të Zotit. Te të krishterët është ai i cili beson në Jezusin shpëtues dhe e vë veten në shërbim të tij dhe kështu me radhë.

E pamë të arsyeshme të bashkojmë bisedën rreth pedagogjisë të dy fetë: hebrenjë dhe krishtere, për dy shkaqe. Shkaku i parë ndërlidhet me periudhën e zhvillimit historik. I dërguari i të krishterëve është Isa ibn Merjem, i cili është i dërguari i fundit i Beni Israilëve. Krishterizmi në librin e saj

<sup>91</sup> Ibid, fq. 55.

të shenjtë ka përfshirë Dhiatën e Vjetër, e cila është i veçantë për pejgamberët e mëhershëm të hebrenjtë dhe Dhiatën e Re, e cila është e veçantë për pejgamberinë e Isait alejh'is-selam. Ndërsa shkaku i dytë ndërlihet me gjendjen bashkëkohore, në të cilën kanë përfunduar raportet e ngrohta mes krerëve fetarë të të dyja feve, si dhe mbështetjen e fuqive perëndimore të krishtera ndaj hebrenjve, edhe krahas armiqësisë së madhe që kishte mes ithtarëve të të dyja feve gjatë pjesës dërrmuese të periudhave historike.

Burimet historike fetare janë unik se i Dërguari Ibrahim alejh'is-selam është babai i feve monoteiste: hebraizmit, krishterizmit dhe Islamit. Të gjithë pejgamberët që kanë ardhur pas Ibrahimit janë nga pasardhësit e tij. Djali i tij Is'haku Pejgamber. Jakubi (Israili) i biri i Is'hakut Pejgamber. Djali i Is'hakut, Jusufi, Pejgamber. Nga pasardhësit e Jakubit, të cilët kanë jetuar në Egjipt ka ardhur Musai alejh'is-selam. Pas tij, të gjithë pejgamberët, derisa përfundojnë me Isain alejh'imuslim. Djali i tjetër i Ibrahimit është Ismaili. Nga pasardhësit e tij ka ardhur Muhammedi alejh'is-selam. Për këtë arsye këto tri fe quhet fetë ibrahimite. Ndryshe quhen edhe fetë monoteiste, ngase besojnë në një Zot.

Të tria fetë janë unanim në besimin e tyre ndaj çështjes së "krijimit" që sqaron ekzistimin e njeriut të parë. Në librat e shpallura qartë flitet se ekzistimi njerëzor ka filluar me Ademin dhe Havën dhe se që të dy e njihnin mirë Zotin. ﴿قَالَ﴾

﴿رَبَّنَا ظَلَمْنَا أَنفُسَنَا وَإِن لَّمْ تَغْفِرْ لَنَا وَتَرْحَمْنَا لَنَكُونَنَّ مِنَ الْخَاسِرِينَ﴾ "Ata të dy thanë: "Zoti ynë, ne i bëmë të padrejtë vetvetes sonë, në qoftë se nuk na falë dhe nuk na mëshiron, ne me siguri do të jemi prej të shkatërruarve!" [El-A'raf: 23]. Që të dy njihnin përgjegjësitë e tyre në nënshtrimin ndaj Allahut dhe pasimin e udhëzimeve.

﴿قُلْنَا اهْبِطُوا مِنْهَا جَمِيعًا فَإِمَّا يَأْتِيَنَّكُمْ مِنِّي هُدًى فَمَنْ تَبِعَ هُدَايَ فَلَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ﴾ "Ne u thamë: "Dilni prej aty që të gjithë, e juve gjithqysh do t'u arrijë udhëzim prej Meje, e kush e pranon udhëzimin Tim, për ata nuk ka as frikë as që do të brengosen" (El-Bekare: 38). Këta besimtarë, nuk kanë nevojë të flasin për fetë primitive dhe besimet e kota përfshirë edhe idhujtarinë, duke e cilësuar si periudhë e parë e ekzistimit të njeriut në tokë, duke e

emërtuar atë si “njeriu i parë” i cili është zhvilluar nga kafsha si esencë e tij. Nëse, në disa periudha historike dhe në disa vende të tokës ka pasur besime të këtij lloji, ato ishin pas besimit në fenë monoteiste dhe udhëzimit që i kishte Ademi. Këto besime ishin të deformuara dhe të falsifikuara.<sup>92</sup>

Gjatë daljes së hebrenjve<sup>93</sup> nga Egjipti dhe qëndrimit të tyre në Tih (Sina), Allahu ia zbriti Musait alejh’is-selam pllakat (urdhëresat, këshillat), ku në to kishte rregullat që rregullojnë sistemin e jetës. Më pas, mësimet e këtyre pllakave u shndërruan në ligje të cilat mësoheshin me qëllim të ruajtjes së lidhjeve mes popullatës. Për këtë popull, Allahu konsiderohej mësuesi që e mësonte popullin. I dërgonte atyre peygamber, të cilët ua mësonin atyre çështjet që u duheshin për të rregulluar çështjet fetare dhe të kësaj bote. Në mentalitetin hebraik ka dominuar ideja e sundimit të drejtpërdrejtë hyjnor.<sup>94</sup> Allahu është sunduesi i Cili u drejtohet atyre drejtpërdrejt, ua plotëson kërkesat, u nxjerr ujë nga toka sipas numrit të esbatëve (familjeve), u bën hije me mjegulla në mes të shkretëtirës dhe u zbret atyre ushqim (el-mennu ve’s-selva)... mirëpo, ata i kanë bërë padrejtësi vetvetes, kanë devijuar duke e adhuruar lopën, nuk kanë respektuar ndalesat gjatë ditës së shtunë, kanë vrarë peygamberët, kanë falsifikuar librin e tyre dhe diç kanë shfaqur prej tij dhe pjesën më të madhe e kanë fshehur. Pasi, ata e llogarisin veten, fëmijët dhe të dashurit e tyre si populli i zgjedhur i Zotit, njerëzit e tjerë përveç hebrenjve i emërtojnë me emra që përmbajnë poshtërim dhe nënçmim.<sup>95</sup> Ky Zot sundues i dënonte ata sa herë që

<sup>92</sup> Ibn Xherir Taberiu në komentimin e tij rreth esencës së idhujtarisë transmeton se putat në esencë ishin skulptura të personave të mirë dhe të drejtë të vdekur. Njerëzit më pas kishin dëshirë t’i përkujtojnë ata dhe për këtë kishin bërë skulptura. Me kalimin e kohës, njerëzit kanë harruar esencën e skulpturave dhe kanë filluar t’i adhurojnë. Kështu ato puta u bënë zota që adhuroheshin ose për t’i ofruar te Zoti.

<sup>93</sup> Muhamed Halifeh Hasen është i mendimit se termet (hebraik, izraelit, jahudi) kanë kuptime të ndryshme dhe se secili term ka kuptim të veçantë. Secili term flet për një periudhë të caktuar të historisë së hebrenjve. Më gjerësisht për këtë çështje shih: Muhamed Halifeh Hasan, **Tarih’ud-Dijanet’il-jehudijeti**, Kajro: Dar’uth-Thekafet’il-Arabijeti, 2002, fq. 37-50.

<sup>94</sup> Taha Xhabir Alvani, **El-Hakimijetu ve’l-hejmenetu: Nahve’l-adedi binai mefhum’il-ummeti ve’d-devleti ve’d da’veti**, Hernden-Amman, Instituti Botëror i Mendimit Islam, 2016, fq. 31.

<sup>95</sup> Shprehja goyim ose gentiles nënkupton popujt johebraik, i cili përdoret në kontekst të dallimit të hebrenjve dhe lavdërimit duke nënçmuar të tjerët. Lexo për këtë çështje: goyim. Easton's Bible Dictionary – Gentiles - <http://www.biblestudytools.com/dictionary/gentiles>

devijonin. Ua ashpërsonte çështjet sa herë që ia ashpëronin vetes. Dhiata e Vjetër dhe Kur'ani janë të mbushur me shembuj që flasin për devijimet e tyre dhe format e dënimeve. Prej formave të dënimeve ishte edhe ajo se Zoti dy herë ia mundësoi armikut të dominojnë ndaj tyre, duke ua shkatërruar qytetet dhe duke i robëruar ata.

Pas shkatërrimit të shtëpive, ata u shpërndanë në vende të ndryshme të botës. Kështu ata jetuan në lagje të veçanta për ta (geto)<sup>96</sup>, që për të ruajtur identitetin e tyre impononte arsim të veçantë për ta. Vështirësitë dhe lënia pas dore ka bërë që arsimimi fetar të kufizohet në sinagogë në formë formale, dhe cilësohej me ashpërsi, thatësi dhe zbrazëtirë shpirtërore. Sa i përket edukatës familjare që e kryenin prindërit dhe edukimin shoqëror që përmes manifestimeve të ndryshme e kryente shoqëria, ajo kishte për qëllim trashëgiminë e besimit, identitetin fetar, admirimin e historisë kombëtare të popullit hebraik dhe përfitimin e edukatës së përgjithshme dhe moralit personal dhe shoqëror. Ndjenjat e tyre negative ndaj të tjerëve, kanë rezultuar ndjenja të ngjashme kundër tyre, në veçanti të të krishterët, ngase në librat e tyre shkruhet përgjegjësia e hebrenjve për vrasjen e Mesihut, respektivisht Isait.

Historianët kanë vërejtur se arsimi hebraik ka pasur liri të plotë në vendet islame. Në shkollat e Andaluzisë, arsimi ishte i hapur për nxënësit musliman, fëmijët e të krishterëve dhe hebrenjve<sup>97</sup> dhe të tjerëve nga Evropa që dëshironin të studiojnë. Këto shkolla u kishin lejuar jomuslimanëve të mësojnë në to edhe pse fetvaja e Imam Malikut e ndalonte një gjë të tillë.. hebrenjtë në Andaluzi kishin shkolla të veçanta për ta. Nga mesi i tyre kanë dalë filozofë, mjekë dhe poetë.<sup>98</sup> Nxënësit hebrenj që anonin drejt shkencave dhe letërsisë, mësonin te mësuesit muslimanë, gjë që rezultoi daljen e letrarëve dhe poetëve. Në librin "El Mukri" theksohet se Ebu'l-Hasen Ali ibn Musa ibn Seid El-Ansi, gjatë studimeve, ishte në miqësi

<sup>96</sup> Fjala ghetto në gjuhën angleze do të thotë pjesë e qytetit në të cilin jeton një pakicë e një etniteti ose feje. Për herë të parë kjo shprehje është përdorur për një shoqëri të lënë pasdore, e veçantë për pakicat hebreje në qytetet e Evropës. Shih: <http://dictionary.cambridge.org/dictionary/english/ghetto>.

<sup>97</sup> Esma Hasen Fehmi, Mebadiut terbijetil islamijeti, Kajro: Lexhnetut te'lifi vet terxhemeti, 1947, fq. 162.

<sup>98</sup> Behr Abdulmexhid Muhamed, El-Jehudu fi'l-Endelusi, Kajro: El-Hej'et'ul-misrijetu li'l-kitabi, 1970, fq. 61.

dhe shoqëri me hebraikun Ibrahim ibn Sehl, dhe se mes vete lexonin poezi.<sup>99</sup>

Duke pasur parasysh vuajtjet e hebrenjve në Evropë në shekujt në vijim, disa prej mendimtarëve të tyre, që nga shekulli XVI kanë filluar të hulumtojnë rreth mënyrave se si të dalin nga kjo gjendje. Ata menduan edhe për gjetjen e një vendi të veçantë për ta, ku Palestina në të shumtën e rasteve ishte e synuar. Kah fundi i shekullit XIX u themelua lëvizja sioniste, e cila arriti të merr mbështetjen e Britanisë, e cila kishte okupuar Palestinën pas shpartallimit të Shtetit Osman në Luftën e Parë botërore. Britania në mënyrë të vazhdueshme mbështeste përgatitjen e rrethanave dhe mundësitë e nevojshme për kolonializmin hebraik të Palestinës, derisa u realizua themelimi i shtetit sionist në vitin 1948. Që nga kjo datë, sistemi pedagogjik, përparësi i jep anës kombëtare dhe politike. Arsimi është mjet për të trashëguar eksperiencën e veçantë historike të të kaluarës së popullit hebraik, dhe përgatitjen e tij, jo vetëm për të tashmen shqetësuese, por edhe për atë që mund të ndodhë në të ardhmen prej çështjeve që rrezikojnë sigurinë kombëtare. Kështu, detyrat e arsimit shkollor gjithnjë janë të lidhura me qëllimet e synuara kombëtare dhe ndodhitë e papritura.<sup>100</sup> Edhe krahas asaj se sistemi arsimor përfshin një numër të orientimeve laike, fetare dhe tjera, mund të thuhet se prania fetare që ndërlihdet me formimin e shtetit "hebraik" i ka ngjyrosur qëllimet e arsimit me ideologjinë sioniste.<sup>101</sup>

Isai alejh'is-selam ishte Pejgamberi i fundit i Beni Israilëve. Allahu atij ia kishte mësuar librin, urtësinë, Tevratin dhe Inxhilin. ﴿وَيُعَلِّمُهُ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ وَالنُّوْرَةَ وَالْإِنجِيلَ وَرَسُولًا إِلَىٰ نَبِيِّ إِسْرَائِيلَ﴾ = "Ai (Allahu) ia mëson atij librin (besimin), urtësinë, Tevratin dhe Inxhilin. Dhe, të dërguar te bijtë e Israilit [Alu Imran: 48-49].

<sup>99</sup> El-Mukri Et-Telmesani, Ahmed ibn Muhamed, Nefh'ut-Tibi min gusn'il-Endelus'ir-Retibi, Bejrut: Daru Sadir, 1968, fq. 307. Për detaje rreth gjendjes edukative të hebrenjve në Andaluzinë islame lexo: Halid Junus AbdulazizEl Halidi, El-Jehudu fi'd-Devlet'il-arabijet'il-islamijjeti fi'l-Endelusi, Gaza: Mektebetu Dar'ul-Erkam, 2011, fq. 383-468.

<sup>100</sup> Elad Peled, Isareli Education in: *Comparative educational systems Ignas*, Edward and Corsini, Raymond, (Editors) Chicago Ill.: Reacock Publishers, 1981, f. 185-233.

<sup>101</sup> Emin Deravisheh, In'ikasad'ul-idioloxhijet'is-suhjunijeti ala'n-nidham'it-ta'lim'il-israilijji, *Rua terbevijeh*, nr. 38-39, 2012, fq. 181-187.



Ai nëpërmjet mesazhit të tij trajtonte problemet shoqërore nga të cilat vuante shoqëria e Beni Israilëve, në veçanti dominimin e jetës materiale, zbehjen e jetës shpirtërore dhe sfidimin e legjislacionit hyjnor. Për këtë, mesazhi i Isait alejh'is-selam nuk hoqi nga përdorimi Tevratin, por e mbështeti dhe përforcoi mësimet e tij, si dhe disa gjëra të ndaluara ua lehtësoi. ﴿وَمُصَدِّقًا لِّمَا بَيْنَ يَدَيْهِ مِنَ التَّوْرَةِ وَلِأَجْلِ لَكُمْ بَعْضَ الَّذِي حُرِّمَ عَلَيْكُمْ وَجِئْتُكُمْ بِآيَةٍ مِّن رَّبِّكُمْ فَاتَّقُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا﴾ “Dhe (kam ardhur) që t’ju vërtetoj Tevratin që e keni para duarsh, t’ju lejoj disa që u ishin ndaluar juve, kam ardhur me argument nga Zoti juaj, pra kini frikë Allahun dhe më dëgjoni mua”. [Alu Amran: 50]

Isai alejh'is-selam filloi thirrjen e tij me një mënyrë ndryshe nga ajo që ishin këshillat fetare te hebrenjtë. Ai u fliste njerëzve aty ku gjendeshin dhe në gjuhën që flisnin. Ua mësonte atë që u duhej në jetën e tyre të përditshme dhe i mësonte se Allahu dëshiron t’ua lehtësojë atë që e kishin obligim në legjislacionin e mëhershëm. Kjo gjë i revoltoi hebrenjtë. Ata e akuzuan për herezi dhe e dërguan të gjykatësi romak, ku edhe u dënua për vdekje me kryqëzim.

=Rezultati i gjithë kësaj ishte se disa nga Beni Israilët e besuan atë, ndërsa disa të tjerë e mohuan. لِلْحَوَارِيِّينَ مَنُ أَنْصَارِي إِلَى اللَّهِ قَالَ الْحَوَارِيُّونَ نَحْنُ أَنْصَارُ اللَّهِ فَأَمَنْتَ طَائِفَةٌ مِّن بَنِي إِسْرَائِيلَ وَكَفَرَت طَائِفَةٌ فَأَيَّدْنَا الَّذِينَ آمَنُوا عَلَىٰ عَدُوِّهِمْ فَأَصْبَحُوا ظَاهِرِينَ ﴿

“O ju që besuat, bëhuni ndihmëtarë të Allahut, si Isai, biri i Merjemes, havarijjetëve (besimtarëve të vet të sinqertë) u pat thënë: “Kush është ndihmëtar imi për në rrugën e Allahut?” Havarijjetët i thanë: “Ne jemi ndihmëtarë të rrugës së Allahut!” E një grup prej Beni Israilëve besoi, e një grup refuzoi, e Ne ata që besuan i përkrahëm kundër armikut të tyre dhe ashtu u bënë ngadhënjyes”. [Es-Saf: 14] Nga kjo kohë, feja krishtere u bë fe e re, ndryshe nga feja hebreje.

Besimi bazë te të krishterët është se hebrenjtë kanë bërë komplot ndaj Isait alejh'is-selam dhe e kanë nxjerrë në gjyq, ku është dënuar me vdekje i kryqëzuar. Për këtë, hebrenjtë janë përgjegjës për gjakun e Isait. Prej këtu, urrejtja e hebrenjve dhe orientimi drejt asaj që quhej (antisemitizëm) ishte çështje e njohur te popujt e krishterë.

Mirëpo, shumë prej mendimtarëve hebrenj gjatë dekadave në vazhdim kanë bërë përpjekje me metoda të ndryshme për të ndryshuar këto orientime fetare. Disa prej tyre mbështeten në studime historike dhe krahasuese, në veçanti gjatë analizimit të transmetimeve në Inxhilet e ndryshme që merrem me gjykimin e Isait dhe kryqëzimin e tij, gjë e cila u mundëson këtyre mendimtarëve të hedhin dyshime rreth akuzimit të hebrenjve se kanë shkuar te udhëheqësi romak dhe e kanë nxitur për vrasjen e tij, dhe më pas distancimin e hebrenjve nga gjaku i Isait.<sup>102</sup> Këto përpjekje korrën rezultate, kur Vatikanin më vitin 1965 nxori vendimin për këtë distancim. Nga kjo kohë, në Vatikan, kanë filluar përpjekjet e vazhdueshme rreth asaj që mund të quhet hebraizim i krishterizmit. Në Konferencën e organizuar në Romë në periudhën 30 Tetor deri 2 Nëntor të viti 1997, Papa John Pali II pranon mëkatin ndaj përgjegjesisë së të krishterëve për masakrat e nazistëve, duke kërkuar falje prej hebrenjve. Njëri nga anëtarët e konferencës tregon se një nga propozimet e Konferencës ishte rishikimi dhe ndryshimi i asaj që gjendet në Dhiatën e Re rreth përgjegjesisë së hebrenjve, në veçanti ndryshimin e inxhilëve Meta, Pali dhe rrëfimin e nxënësve në përgjithësi.<sup>103</sup>

Kështu, arsimit fetar hebraik është zhvilluar me zhvillimin e arsimit në botë, qoftë në nivel të arsimit të përgjithshëm, fillor dhe të mesëm apo arsim universitar. Hebrenjtë kanë përfituar nga arsimi i përgjithshëm që i është mundësuar qytetarëve në vendet e Evropës dhe Amerikës, ngase ishte arsim obligativ. Krahas arsimit obligativ, ata shtonin edhe arsimin plotësues hebraik në shtëpi, faltore të hebrenjve dhe shkolla të vikendeve. Kështu, referencat fetare dhe grupet politike dhe profesionale hebraike ishin të kujdesur për të siguruar arsim të plotë fetar hebraik, ose arsim në ambient fetar hebraik, dhe atë në të gjitha nivelet e ndryshme të

<sup>102</sup> Për këto përpjekje, lexo librin:

Paul Winter, *On the Trial of Jesus*, 2nd Ed. Revised and Edited by T. A. Burkill and Geza Vermes, Berlin and New York: Walter De Gruyter, 1974.

<sup>103</sup> <http://khayma.com/alkikh/Yhood/08.htm>

Për të përcjellë disa pika të raporteve mes Vatikanit dhe hebrenjve, mund të referohesh në librin:

Muhamed Abdulhalim Abdulfetah, *El-Ihtirak'ul-jehudi li'l-Vatikan*, Kajro: Dar'ul-kutub'il-misrijeti, 2005.

hebrenjve aty ku gjendeshin. Kështu u themeluan shkolla dhe universitete hebraike. Vetëm në SHBA gjenden 34 universitete dhe fakultete fetare hebraike.<sup>104</sup>

Sa i përket krishterizmit, -siç dihet-, ajo është shfaqur në Lindje, e cila ishte nën sundimin romak. Aty ishte e përhapur idhujtaria fetare, padrejtësia politike dhe shfrenimi moral. Në këso rrethanash, thirrësit e krishterizmit, pothuaj për më shumë se dy shekuj iu kanë nënshtruar dënimeve, vuajtjeve, abuzimeve dhe vrasjeve. Pas vendimit të Perandorit Kostantin, i cili kishte udhëhequr në periudhën (306-337) për heqje dorë nga shtypja e të krishterëve dhe dhënia e të drejtave për ta si të gjithë qytetarëve tjerë, ndikimi i mësimave krishtere në shoqëri kishte marrë përmasa më të mëdha. Kështu u rrit edhe depërtimi i prijësve fetarë krishterë në shoqëri, derisa në vitin 445, Kryetari i kishës së Romës mori pushtet në sferën fetare, pushtet që ishte i barabartë me pushtetin e Perandorit në sferën civile. Më pas në vitin 529 me anulimin e shkollave idhujtare, ndikimi i krishterë u favorizua shumë dhe mundësia ishte e hapur vetëm për shkollat krishtere.

Duhet theksuar se thirrësit e krishterizmit gjatë shtypjes në shoqërinë idhujtare romake, nuk mësonin në shkollat idhujtare ku mësoheshin gjuha, letërsia, filozofia dhe matematika. Kështu, pothuaj që të gjithë të krishterët ishin analfabet, ngase mësimi në këto shkolla binte në kundërshtim me bindjet dhe mësimet e tyre fetare, duke qenë të kënaqur me atë se prijësit fetarë kanë njohuri të mjaftueshme. Mirëpo, me përhapjen e mësimave të Shën Augustinit, i cili kishte mësuar në rininë e tij në shkollat idhujtare, ku kishte mësuar letërsinë latine, filozofinë e Platonit dhe logjikën e Aristotelit, qëndrimi i krishterizmit ndaj filozofisë greke kishte ndryshuar. Kulturën që e kishte përfituar ai kishte ndikim në arsimin krishterë në periudhat vijuese.

Monroe ka përshkruar zhvillimin i cili ka ndodhur gjatë transferimit përmes periudhave të ndërhyra mes veti duke ndikuar dhe duke u ndikuar, nga pedagogjia idhujtare greke

<sup>104</sup> Detajet rreth emrave të universiteteve, fakulteteve, vendeve dhe numrit të studentëve shihni në: <http://www.campuscorner.com/religious-affiliations/jewish-colleges.htm>.

dhe romake në pedagogjinë e krishterë romake. Më pas, përmes themelimit të institucioneve arsimore me orientime të ndryshme si shkollat katedrale (Cathedral schools), manastireve (Monastic schools), vendeve të misticizmit, shkollave për kalërim (chivalry), shkollave civile të formuara nga sindikata profesionale në shoqëri (guilds). Skolasticizmi (scholasticism) kishte një orientim të dalluar nga ajo që ishte dominuese në manastire, duke bërë përpjekje të rikthejë trashëgiminë greke dhe plan-programet mësimore, të cilat në Evropë, që nga shekulli III kishin filluar të zhduken dhe në vend të tyre kishte dominuar arsimit fetar kishtar në manastire. Kështu skolasticizmi, që nga shekulli IX ka filluar të kthejë pozitën, në shekullin XII ka rritur prezencën dhe në shekujt XIV dhe XV ka dominuar në pjesën më të madhe të Evropës. Disa prej këtyre institucioneve janë shndërruar në universitete. Në shekujt XIII dhe XIV fillojnë të shfaqen shenjat e renesancës, ndërsa në shekujt XV dhe XVI, Evropa filloi të hyjë në kohën moderne.

Pedagogjia krishtere e Evropës mesjetare është zhvilluar sipas zhvillimit të gjendjes së përgjithshme fetare. Ky zhvillim ka qenë nën ndikimin e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Prej këtyre faktorëve është edhe çështje e konfrontimit, garës dhe aleancave mes mbretërve dhe prijësve fetarë, lëvizjeve protestuese ndaj kishës dhe njohja me kulturën islame. Gjatë kryqëzatave të cilat kishin ndodhur tetë herë rresht gjatë periudhës (1095-1270), disa prijës fetarë të krishterë kishin kuptuar problemet me të cilat ballafaqohet kisha - nën pushtetin e Papës-, përfshirë korrupsionin dhe dobësitë në mësimet krishtere.<sup>105</sup> Kështu, grupimet e ndryshme krishtere filluan të shkëputen nga Kisha romake, duke formuar shkolla të reja ideologjike, për të cilat kanë themeluar institucione dhe sisteme të veçanta arsimore.

<sup>105</sup> Paul Monroe ka bërë një sqarim të detajuar zhvillimit të institucioneve të arsimit fetar krishterë, përpjekjeve të reformave fetare, ndarjes së fesë në disa kisha dhe fraksione, llojllojshmërisë së sistemeve mësimore, tematikave, personaliteteve, orientimeve ideologjike dhe shkollave filozofike. Pjesa dërrmuese e asaj që është shkruar në këtë tematikë në gjuhën arabe është mbështetur në këtë referencë dhe ngjashëm me te. Në librin e Monroe, në veçanti lexo kapitujt e pestë, gjashtë dhe shtatë.

- Monroe, *A Text-Book in the History of Education*, chapters 5-7, fq. 221-441.

Zhvillimi i sistemeve të arsimit dhe fetarja kishte filluar herët. E gjithë kjo duke iu përgjigjur rrethanave me të cilat ballafaqoheshin prijësit fetarë të krishterë, qoftë në realizimin e fetarisë individuale apo tërheqjes së idhujtarëve në krishterizëm. Për këtë kemi sistemin fetar të cilin e zhvilloi Shën Benedikti (480-550) i cili ka ndikuar në mësimet krishtere për një periudhë që ka zgjatur afër 15 shekuj. Ky sistem është një udhëzues pune për zhvillim shpirtëror individual për prijësit fetarë, i cili bashkon mes tërheqjes së plotë nga njëra anë dhe jetës në grup të pavarur nga shoqëritë nga ana tjetër. Benedikti njihet si themelues i parë i manastireve krishtere në Botën Perëndimore.<sup>106</sup>

Në vazhdim ka ndodhur një sërë mosmarrëveshesh mes kishës në Romë dhe disa përpjekjeve që udhëhiqeshin nga disa priftërinj, të cilat kisha i konsideronte si herezi dhe se udhëheqësit meritojnë të privohen dhe të largohen nga besimi. Mosmarrëveshjet ishin të shumta, por më të rëndësishme ishin ato rreth natyrës së Isait. Krahas kësaj kishte edhe fërkime politike mes patriarkëve gjë e cila rezultoi ndarjen e madhe në vitin 1054 mes Kishës romake (kishës perëndimore) dhe Kishës së Kostandinopojës (Kishës ortodokse lindore).

Në mesin e fraksioneve krishtere ishte edhe fraksioni Dominikan, i cili kishte lindur si rezultat i përpjekjeve të një personaliteti të dalluar të mësimi të krishterë dhe misionar spanjoll Dominik (1170-1221). Ai kishte themeluar një sistem fetar misionar. Ai synonte nxënësit dhe të pasurit. Në mësimet e tij dominonte kujdesi për çështjet ideologjike. Në mesin e këtij fraksioni ka dalë edhe Toma Akuini, i cili po ashtu njihet një nga personalitetet e dalluara në historinë e mësimi të krishterë.

Prej këtyre personaliteteve është edhe Francis Asisi (Francis of Assisi 1181-1226), i cili kishte refuzuar pasurinë materiale dhe kishte formuar një sistem të veçantë për murgjëri, i cili shumë shpejt u shndërrua në sektin Françeskan, që në esencë kujdesej për të varfrit dhe gratë. Nga nxënësit e këtij sekti është edhe filozofi dhe prifti anglez Roxher Bekon

<sup>106</sup> Ibid., fq 248-253.

(1214-1294), i cili pas njohjes me shkencat islame, është njohur me eksperimentet e tij shkencore dhe zhvillimin e metodologjisë shkencore.<sup>107</sup>

Në të njëjtën periudhë është shfaqur Toma Akuini (1225-1274). Ai ishte prift italian që zbatonte sistemin e Benediktit. Më pas ai ka kaluar në sektin Dominikan. Ai u kishte lejuar të krishterëve të lexojnë burimet e krishtera për t'u përgjigjur pyetjeve fetare, të cilat Kisha katolike më parë i kishte ndaluar.

Prej personaliteteve që kanë pasur ndikim të madh në historinë e mësimit të krishterë është edhe përkthimi i Librit të Shenjtë që bëri në gjuhën angleze John Wycliffe (1330-1384), gjë të cilin historianët e njohin si fillim i reformave fetare krishtere dhe fillim i një të ardhme të ndryshme, që i mundëson njeriut të thjeshtë të studiojë burimet fetare vetë dhe me gjuhën e tij vendase, ngase një gjë të tillë, deri në këtë kohë, Kisha e kishte ndaluar dhe posedimin e një kopje të këtij libri të përkthyer në gjuhën angleze e konsideronte krim të madh.

Kah fundi i shekullit XIV u shfaq John Huss (1373-1415), i cili kishte studiuar në Universitetin e Pragës dhe ishte bërë prift në të njëjtin qytet. Ai kishte luftuar korrupsionin në Kishën katolike dhe kishte thirr në reforma. Kjo gjë e kishte irrituar Kishën dhe e kishte gjykuar për vdekje me djegie gjallë, atë së bashku me një numër të pasuesve të tij.

Në fillim të shekullit XVI është shfaqur Desiderius Erasmus (1466-1536), i cili ftonte në reforma fetare, shkollën humaniste, arsimimin e femrës në dy llojet e shkollave që gjendeshin në kohën e tij: shkollat shoqërore dhe shkollat kishtare dhe domosdoshmërinë e mësimit të gjuhëve buri-more për të realizuar koment më të mirë të Librit të Shenjtë. Edhe pse ai shkaktoi një luftë pa kompromis kundër korrupsionit të Kishës, megjithatë thërriste për unitet dhe kundërshtoi ndarjen, për të cilën thërrisnin protestuesit.

<sup>107</sup> Lidhshmërinë e tij me shkencat islame lexoe në librin: Click, Thomas. & Livesey, Steven & Wallis, Faith (Eds). *Medieval Science, Technology and Medicine: An Encyclopedia*, New York and London: Routledge.2005 . fq. 424

Më pas u shfaq Martin Luteri (1483-1546), i cili jetën e tij e kishte filluar si prift. Mirëpo, ai nuk ishte i qetë ndaj mësimëve të Kishës katolike, i cili ndërlidhej me shpëtimin. Ai ka shkruar veprat e tij të njohura rreth çështjeve që mendonte se Kisha katolike i ka çrregulluar. Ai besonte se individit mund vetvetiu të studiojë tekstet e shenjta në gjuhët origjinale dhe në gjuhët e shkollave të përgjithshme.

Prej personaliteteve që kishin rol të dukshëm në reformat arsimore është edhe John Kalvin (1509-1564), i cili jetën e tij e kishte filluar si avokat. Më pas u shndërrua në reformator fetar. Ai kishte pastruar mësimet fetare të Augustinit rreth pushtetit, që sot njihen si mësimet Calviniste. Ka shkruar librin "Institutet e fesë krishtere" përmes të cilit ka sulmuar fuqishëm Kishën katolike. Kalvin ishte detyruar të arratiset për në Gjenevë duke ikur nga dhuna e kishës. Gjatë kësaj periudhe ka shkruar një koment të plotë rreth Librit të Shenjtë.

Këto përpjekje për reforma në arsimin e krishterë nuk ishin larg interesave të mbretërve dhe udhëheqësve politikë dhe ushtarakë. Kështu janë zhvilluar luftëra shkatërruese, të cilat në disa raste kanë zgjatur dhjetëra vite. Prej këtyre luftërave kemi luftën fetare mes katolikëve dhe protestantëve në Francë (1560-1598), luftën e tridhjetë viteve në Gjermani në periudhën (1618-1648). Këto luftëra edhe pse në esencë ishin luftëra fetare mes pushtetit të Kishës katolike romake dhe grupimeve që kundërshtonin pushtetin dhe korrupsionin e saj fetar, ato ishin edhe si rezultat i luftës për pushtet mes mbretërve të Evropës.

Fisher, konfliktin që ka zgjatur në Evropën krishtere përgjatë mesjetës për të hyrë në një gjendje të re evropiane, e ka përshkruar shkurt duke thënë: "Fe të cilën e besojnë njerëzit në hapësira gjeografike të mëdha, rrënjët e tij kanë depërtuar thellë në traditat shoqërore dhe politike të Evropës perëndimore, fuqi shpirtërore të reja e sfidojnë dhunshëm dhe në pjesë të madhe të kontinentit evropian, e detyrojnë të pranojë humbjen, një sistem shoqëror i cili ngritët mbi totalitarizëm po humb realitetin e tij dhe shoqëri perëndimore e krishterë që është shpërndarë në ca pjesë që nuk ka mundësi të ribash-

kohet përsëri. Janë aktivizuar pikëpamje rreth jetës, e cila mbështetet në lirinë e të menduarit dhe ndërgjegjen individuale, të drejtën e shteteve -bile edhe fraksioneve të vogla fetare- për vetëvendosje, kanë arritur në mënyrë graduale të shkatërrojnë organet e vjetra të kishës i cili rregullonte çdo gjë. Po ashtu ka ndihmuar të shfaqen një sërë mendimesh revolucionare, të cilat në fund kanë përfunduar në ndryshimin e sistemeve evropiane dhe formimin e botës së re... në brendinë e kësaj lufte të gjatë, ku Evropën e fundosi në një det prej gjakut janë përzier motivet e mira me ato të këqija, ku është e pamundur dallimi mes tyre. Në brendinë e kësaj polemike të madhe fetare, u shfaq thellësia e emocioneve të gjenialët civilë në të dy palët: katolike dhe protestante. Megjithatë, shumica absolute e evropianëve nuk ishin fetarë si duhet dhe se personalitetet që kishin dominuar në Evropë gjatë luftërave fetare ishin politikanët, udhëheqësit ushtarakë dhe një grup i aventuristëve të cilët kishin shfrytëzuar entuziazmin e të dobëtëve për të realizuar qëllimet e tyre të kësaj jete”.<sup>108</sup> Më pas Fisher pyet: “Reformat protestante me të gjitha rezultatet që nuk mund të numërohen në fushën e artit, muzikës, shkencës dhe letërsisë, a meritojnë këtë çmim që e paguan evropianët në formë të luftërave të egra dhe të gjata”?<sup>109</sup>

Dihet se lufta në Evropë, mes ndikimit të Kishës dhe sistemeve të pushtetit përfundoi duke pranuar sistemin e laicizmit, i cili bënë ndarjen e anëve shpirtërore dhe kohore të jetës së shoqërive. Ai përkufizon pozitën e fesë dhe arsimit fetar në kishë, ndoshta edhe në familje, ndërsa institucionet shoqërore, si ato politike, ekonomike dhe arsimore, aty nuk ka vend për fenë e as për udhëheqësit fetarë. Nëse është patjetër që feja të jetë prezente në disa lëndë mësimore në shkolla ose universitete, atëherë ajo nuk mund të jetë edukatë fetare, por njohuri me fenë si dukuri shoqërore, ku mund të mësohen në kuadër të studimeve historike dhe shoqërore.

Prezenca fetare nuk është zhdukur tërësisht nga shoqëritë evropiane në Evropë dhe Amerikën Veriore. Liritë e përgjith-

<sup>108</sup> Herbert Fisher, *Usus li't-Tarih'il-evrubij'il-hadithi: mine'n-nahdat'il-evrubijjet'ile-th-thvret'il-fransijjeti*, Përkthyes: Zejneb Ismet Rashid & Abdurahim Mustafa, kajro: Darul Mearif, botimi 3, 1970, fq. 25-26.

<sup>109</sup> Po aty.



shme dhe të drejtat e njeriut kanë mundësuar grupet fetare të hapin shkollat e veçanta për ta (pra për grupet krishtere) paralel me shkollat zyrtare “laike”. Në këto shkolla, mësohen disa lëndë fetare dhe disa tema shkencore me pikëpamje fetare si p.sh. “krijimi i njeriut”, krahas “teorisë së evolucionit”. Disa universitete fetare kanë ofruar të gjitha plan-programet përmes pikëpamjeve fetare krishtere.

Walter Ruegg ka diskutuar lindjen e idesë së universitetit dhe mundësinë e transferimit të idesë nga kultura arabe islame, e cila dominonte në Lindje. Ai anonte drejt dallimit mes modelit të universitetit të cilin e konsideronte “prodhim krishterë perëndimor i shekullit XII” dhe modelit e Kolegjit të cilin e shihte “të marrë nga modelet islame”, që ishte si bazament për shndërrimin më pas të disa fakulteteve në Universitete.<sup>110</sup>

Vlen të theksohet se shumica e Universiteteve të njohura në Evropë dhe Amerikë janë institucione kishtare, të cilat krahas mësimit krishterë, mësonin edhe shkencat e ndryshme. Numri i universiteteve ishte rritur shumë si rezultat i garës mes fraksioneve katolike dhe atyre protestante. Krahas tyre kishte edhe universitete tjera të themeluara dhe të menaxhuara nga studentët, profesorët dhe zejtarët. Mirëpo, kushtet dhe problemet e këtyre universiteteve dhanë mundësi që mbretërit dhe udhëheqësit kishtarë të cilët ishin financues dhe mbështetës të tyre të dominojnë ndaj tyre, në veçanti në atë që u quajt periudha e reformave fetare nga njëra anë dhe periudha e formimit të kombësive dhe sistemeve shoqërore lokale nga ana tjetër. Garat në mbështetjet e universiteteve mes tyre ishin “me shpresë që njohuritë shkencore dhe elita akademike t’u ofrojë mbështetje në luftën e tyre për ekzistencë. Elita politike dhe fetare dëshirojnë që universitetet të mbështesin pushtetin e tyre, studentët dhe mësimdhënësit dëshirojnë përfitimin e njohurive për avancim shoqëror dhe shoqëritë lokale dëshirojnë përmirësimin e kushteve të

<sup>110</sup> Walter Rueff, *Themes*, në: *A History of the University: vol. 1 Universities of the Middle Ages*, Edited by H. De Ridder-Symoens, Cambridge: UK. Cambridge University Press, Paperback Edition, 2003, fq. 8.

jetës".<sup>111</sup> E gjithë kjo çoi në përmirësimin e niveleve të arsimit, zhvillimin e mendimit dhe të shkencave.

Me kalimin e kohës, universitetet filluan gradualisht të pavarësohen nga udhëheqësit e tyre fetarë dhe çështjet e tyre të organizohen brenda sistemeve politike të kohës, në veçanti kur dimë se ndikimi i sistemit të manastireve dhe institucioneve fetare filloi të zvogëlohet.<sup>112</sup>

Në këtë kontekst, format e prezencës së fesë në arsimin shkollor dhe universitar në Perëndim janë të ndryshme. Ka prezencë në pronësi ligjore. P.sh. kisha katolike e kontrolluar nga Papa i Vatikanit posedon dhe menaxhon 1358 institucione për arsimin e lart në botë. 230 prej tyre janë universitete dhe fakultete në SHBA. Disa prej tyre konsiderohen universitete elitare si p.sh. Universiteti katolik në Uashington, Universiteti Georgtawn, Universiteti Noterdam. Krahas këtyre ka edhe 7500 shkolla, 625 spitale dhe shumë fondacione tjera humanitare.<sup>113</sup> Shumica e këtyre universiteteve janë laike ku ofrojnë mësim në të gjitha specializimet si në mjekësi, inxhinieri, e drejta ligjore, letërsi, shkencat shoqërore etj. Disa prej tyre universitete të specializuar në një drejtim si mjekësi, e drejta ligjore, inxhinieri. Kanë forma të ndryshme, disa janë institucione, universitete, studime të larta të specializuara në menaxhimin e institucioneve fetare ose arsimin e lart të krishterë, ku prej tyre dalin udhëheqësit fetarë krishterë, priftërinj dhe persona që marrin përsipër kujdesin fetar të njerëzve. Prej këtyre universiteteve fetare ka të tillë që quhen "Seminary", ku vetëm për fraksionin katolik në SHBA ka 189 universitete krishtere.<sup>114</sup>

## 5. Mendimi pedagogjik në periudhën e renesancës evropiane dhe filozofitë e saj

<sup>111</sup> Monroe, *A Text-Book in the History of Education*, fq. 14.

<sup>112</sup> *Ibid.*, fq. 417.

<sup>113</sup> Shpërndarjen e këtyre universiteteve dhe fakulteteve në vendet e botës shihet në websajtin e mëposhtëm: [https://en.wikipedia.org/wiki/Catholic\\_university](https://en.wikipedia.org/wiki/Catholic_university).

<sup>114</sup> [https://en.wikipedia.org/wiki/List\\_of\\_Roman\\_Catholic\\_seminaries](https://en.wikipedia.org/wiki/List_of_Roman_Catholic_seminaries).

### 5.1. Dukuria e “zhvillimit në jetën njerëzore”

Në historinë njerëzore ekzistojnë periudha kohore të cilat kanë ndikuar thellë në ndryshimin e botës. Rëndësia e secilës periudhë varet nga gjatësia dhe thellësia e ndikimit në periudhat tjera. Në secilën periudhë ka çështje me ndikim që përcaktojnë cilësitë dhe rëndësinë e asaj periudhe. Mirëpo, vetë procesi i periodizimit dhe përcaktimi i çështjeve të rëndësishme në to varen nga pikënisjet ideologjike nga të cilat fillojnë historianët. Ata zakonisht fillojnë nga pikëpamjet e tyre ndaj universit, jetës dhe njeriut. Ata të cilët nisen duke u bazuar në teorinë e “evolucionit”, flasin për njeriun e parë i cili është zhvilluar nga paraardhësit e tij kafshë, i cili ka filluar jetën e tij primitive, dhe i gjithë derti i tij ka qenë të përshtatet me ambientin ku jeton dhe të hulumtojë rreth kushteve për ekzistencë. Me kalimin e kohës ka zhvilluar gjuhën, ka zbuluar zjarrin, ka nënshtruar hekurin dhe bronzin dhe ka shpikur shkrimin. Historianë të tillë flasin për kohën e gurit, të bronzit, të hekurit dhe në disa pika të zhvillimit (si p.sh. zbulimi i zjarrit dhe shpikja e shkrimit) vërejnë raste të rëndësishme në historinë e njeriut. Ndërsa historianët të cilët si pikënisje marrin pikëpamjet fetare që besojnë në teorinë e “krijimit hyjnorë” të njeriut, zhvillimin e jetës së njeriut dhe periudhat e tij i shohin në një formë tjetër.

Mendimet e filozofëve, mendimtarëve dhe historianëve rreth çështjes së zhvillimit të jetës njerëzore janë të ndryshme që nga ekzistimi i njeriut deri në ditët e sotme. Disa prej tyre si pikënisje marrin pikëpamjet filozofike që shikojnë normat e të menduarit dominues, dhe njohja ku përfundon të menduarit. Këtë e ka propozuar filozofi francez August Kont (1798-1857) në tri periudhat e zhvillimit të të menduarit njerëzor: fetare, filozofike-metafizike dhe shkencore. Disa prej tyre si pikënisje kanë marrë pikëpamjet ekonomike materiale, siç ka bërë filozofi gjerman Karl Marksi (1818-1883), i cili jetën njerëzore e ka ndarë në pesë periudha: primitive, feudale, kapitaliste, socialiste dhe komuniste.

Historia njerëzore gjithashtu mund të kuptohet në dritën e mesazheve hyjnore. Si referencë në këtë ndarje merren tekste

e theksuara në librat hyjnorë. Duke filluar nga krijimi i Ademit, periudha para tufanit (Nuhit alejh'is-selam), periudha pas tufanit deri te koha e Ibrahimit, periudha e fëmijëve të Ibrahimit deri te Isa, periudha e Isait deri në shpalljen e Kur'anit dhe periudha e kohës së fundit (ahiri zeman) ku do të përfundon ekzistimi i jetës njerëzore për të ndodhur Kiameti.

Në disa forma të perceptimit të jetës njerëzore dhe ndryshimet që i kanë ndodhur vërejnë edhe ndryshimet e individit, duke pranuar si bazë, fazat e zhvillimit mendor të individit në ndjenjat, reagimet dhe zhvillimin mental, për të perceptuar fazat e zhvillimit të llojit njerëzor që nga fillimi i jetës deri në përfundimin e saj.

Prej mendimeve që janë paraqitur rreth komenteve për zhvillimin e jetës njerëzore është edhe ideja e “determinizmit” që përpiqet të bënë lidhje mes determinizmit të zhvillimit natyror dhe determinizmit së zhvillimit shoqëror, ekonomik dhe ideologjik. Kështu zhvillimi i shoqërisë njerëzore realizohet në përputhshmëri me domosdoshmërinë që i përngjanë ligjeve natyrore, edhe pse zbulimi i ligjeve të para është më i rëndë se zbulimi i ligjeve të dyta.

Prej këtyre mendimeve kemi edhe idenë e mendimtarit gjerman Spingler (1880-1936) rreth “rrotacionit historik”. Ai mendon se jeta e çdo civilizimi i ngjanë jetës së individit, ngase lind, rritet, plaket dhe vdes, pastaj e trashëgon dikush tjetër dhe kalon nëpër të njëjtat faza. Në bazë të kësaj, njerëzia njih civilizime të cilat kanë lindur, kanë udhëhequr dhe janë zhdukur. Kështu në bazë të kësaj vazhdon historia njerëzore.

Ekzistojnë forma tjera dhe të shumta për periodizimin e historisë së muslimanëve, duke filluar nga koha e shpalljes. Shumë herë flitet nga periudha arabe paraislame, më pas jeta e Muhammedit alejh'is-selam para shpalljes dhe pas shpalljes, periudha e katër hulefairr rrashidinëve, periudha e emevitëve, e abasitëve ku në të njëjtën kohë gjendej edhe periudha e fatimitëve në Egjipt, periudha e emevitëve në Andaluzi. Periudha e abasitëve njih dy pjesë: pjesa e pushtetit dhe fuqisë së udhëheqësve dhe pjesa e daljes në shesh të imarete-

ve dhe sulltanateve të pavarura. Me lindjen e shtetit të memalikëve, Rezidenca e hilafetit transferohet nga Bagdadi në Kajaro dhe e njëjta përfundon me lindjen e shtetit osman. Edhe pse ky sistem i periodizimit është më i njohur, historiani Imadudin Halil është i mendimit se problemi i këtij periodizimi mbështetet në parimin e “ndryshimi nga lart i familjeve dhe pushtetarëve si bazë për ndarjen kohore” dhe “hiperbolizimi i anëve politike dhe ushtarake të historisë duke zvogëluar hapësirat e anëve fetare, shoqërore dhe civilizuese”. Megjithatë, ai nuk është kundër që ky periodizim të jetë një nga pesë format e studimit të historisë islame. Këtë formë, ai e quan forma e udhëheqjes, të cilës i shtohen edhe katër forma tjera: përhapja, kundërsulmi, lëvizja e shoqërisë dhe të dhënat civilizuese.<sup>115</sup>

## 5.2. Zhvillimi i mendimit pedagogjik në periudhën e Renesancës

Mendimi pedagogjik në mesjetë ka përjetuar shumë probleme. Edhe krahas dominimit të sistemit fetar të krishterë në manastire dhe katedrale dhe kufizimin e ndikimit të pedagogjisë së Greqisë antike, megjithatë veprimet pedagogjike cilësohen si aristokrate, dominimin e besimit ndaj mendjes, kufizimin e lirisë së diturisë dhe dijetarëve, monopolin e komentimit të teksteve fetare. E gjithë kjo duke i bërë mendimet fetare krishtere të përshtatshme dhe të pranuar për fiset gjermane. Përveç kësaj kishte edhe shqetësim të madh të shumë prej prijësve fetarë nga dukuritë e çrregullimit administrativ, moral dhe fetar të kishës, gjë që arsimit në kisha ia humbi besueshmërinë.<sup>116</sup>

Me përfundimin e periudhës së mesjetës në Evropë në shekullin e XV, mendimi pedagogjik kalonte në një gjendje të vështirë. Thirrjet për reforma fetare ishin shtuar, sistemet e sundimit civil kishin filluar të përpiqeshin për t'u liruar nga

<sup>115</sup> Imadudin Halil, *Med'halun ila islamijet'il-ma'rifeti mea muhatatin mukterehin li islamijeti ilm'it-tarihi*, Herden: Instituti botëror për mendimin islam, botimi 2, 1991, fq. 63-65.

<sup>116</sup> Wil Dur'ant në librin e tij “Rrëfimi i civilizimit” rrëfen forma të çuditshme të çrregullimeve dhe devijimeve në kishë. Në mesin e këtyre devijimeve ishin “tregtia për poste në postin e Papës dhe Peshkopit, martesat e priftërinjve me të tjerë dhe ekzistimi i rasteve të prostitucionit mes vetë priftërinjve. Për më shumë lexo: Dur'ant, Wil, *Kissat'ul-hadareti*, përkthim: Muhamed Bedran, Tunuzi: El-Munadhdhame'tul-arabijetu li't-terbijjeti ve'th-the kafeti ve'l-ulumi, 1989, vëllimi 14, fq. 377-403.

vështirësitë e lidhjes fetare me kishën, dëshira për përdorimin e mendjes dhe përshtatshmërinë mes referencave fetare dhe trashëgimisë greke gjithnjë e më shumë rriteshin, rezultatet e kontaktit me kulturën islame filluan të marrin rrugën drejt sistemeve të arsimit vendas, gjuhët vendore filluan ta imponojnë veten në arsimin fetar dhe gjendja e shumë universiteteve në Evropë u stabilizua. E gjithë kjo u shoqërua me ngjarje shkencore, politike, fetare dhe gjeografike të cilat ishin ngjarje historike në historinë e shkencës dhe mësimin. Prej këtyre ngjarjeve veçojmë: shpikjen e shtypshkronjës nga ana e gjermanit Johan Gutenbergut më 1450, rënien e Kostandinopojës (Stambollit) në duart e muslimanëve osmanë më 1453, rënien e Granadës dhe largimi i muslimanëve nga Andaluzia më 1492, zbulimi i Amerikës më 1492 etj.

E gjithë kjo ndihmoi që Evropa të hyjë në një periudhë të re e cila u quajt “periudha e reformave fetare”. Reformat e Martin Luterit më 1521 ishin një pikë ndarëse, e cila nuk ishte me ndikim më pak se pika e ndarjes së kishës krishtere më 1054 në kishën perëndimore në Romë dhe atë lindore në Kostandinopojë. Periudha e reformave fetare arsimit i hapi horizonte të reja, të cilat kisha katolike më parë nuk i lejonte, në veçanti kur kishat protestante preferonin nënshtrimin ndaj sistemeve të pushteteve lokale, shfrytëzimin e gjuhëve vendore në arsimin fetar dhe leximin e teksteve të shenjta. Periudha e reformave fetare formoi nisjen e renesancës evropiane, e cila kishte filluar të rritet edhe më shumë në shekullin XVI. Këto kthesa përfshinin rritjen e kontrollimit të pushtetit civil ndaj arsimit, në vend të kishave, si dhe kthesa në qëllimet e arsimit nga qëllime fetare në qëllime materiale laike.

Vlen të theksohet se shumica e mendimtarëve evropianë kanë ruajtur lidhjet me fenë krishtere, ngase problemi i tyre nuk ishte me fenë krishtere, por me diktaturën dhe çrregullimin që kishte depërtuar në institucionin fetar, respektivisht në kishë. Kërkesat e reja të jetës, përfshirë zgjerimin e tregtisë, udhëtimet e jashtme gjeografike, në veçanti në dete, zhvillimi në arsimin universitar, që të gjitha këto përshpejtuan nevojën për shkencat natyrore, astronomike, matematikore, legjislati-

ve, mjekësore, politike e tjera në sferat e jetës praktike. E gjithë kjo nxiti shkencëtarët të zhvillojnë metodat e hulumtimit, zbulimit dhe eksperimentit, për të cilat në veçanti dëshmojnë zbulimet e shekullit XVII.<sup>117</sup>

Prej shenjave të zhvillimit mendor që mori rrugën drejt asaj që u quajt revolucioni mendor dhe revolucioni i industrisë, dhe u bënë lëndë për studim dhe hulumtim në universitete janë edhe shkrimet e Fransis Bekonit, shkrimet e Dekartit (1596-1650) dhe shkrimet e Galileut (1564-1642) në astronomi dhe fizikë. Kështu, në shekullin XVII, vazhdoi zhvillimi i shkencave të fizikës dhe matematikës, në shekullin XVIII të kimisë dhe në shekullin XIX të biologjisë.<sup>118</sup>

Wil Dur'ant sjell shembuj rreth një numri të librave të botuara në shekullin XVII në fusha të llojllojshme të mendimit pedagogjik. Si p.sh.: libri i Komineut në "edukatën ideale" më 1632, shkresa e Meltonit rreth "shkollës ideale" më 1644, enciklopedia e Tomas Stanlit në periudhën mes 1655-1662 në "Historinë e filozofisë", në të cilën katër vëllime ka veçuar për filozofinë arabe, libri i Fenilonit rreth "arsimimit të femrës" më 1687, libri i Xhon Lokut "Kujtesa në arsim" më 1693 etj. Shekulli XVII ka parë një interes të veçantë për gjuhën dhe shkencat arabe. Universiteti i Oksfordit kishte themeluar katedrën e gjuhës arabe. Partilo Dirbilo më 1697 në Francë kishte botuar enciklopedinë e madhe "biblioteka lindore", e cila kishte zbardhur historinë arabe dhe shkencat arabe dhe kishte kontribuar -siç thotë Dur'ant- në lëvizjen e ndriçimit të shekullit XVIII.<sup>119</sup>

Gjatë periudhës së renesancës evropiane u zhvilluan shumë shkolla dhe drejtime ideologjike, ku secila prej tyre kishte praktika pedagogjike, dhe secila prej tyre është mbështetur në pikëpamjet e saj ndaj natyrës njerëzore. Po ashtu lindi një grup i mendimtarëve, filozofëve dhe shkencëtarëve, ku secili prej tyre kishte ndikim në jetën ideologjike në kohën e tij, pas kohës së tij, dhe disa prej këtyre mendimeve janë të pranishme edhe sot e kësaj dite në mendimin bashkëkohor perëndimor.

<sup>117</sup> Po aty, vëllimi 28, fq. 245-248.

<sup>118</sup> Po aty, vëllimi 30, fq. 248.

<sup>119</sup> Po aty, vëllimi 33, fq. 178-179.

## Shembuj nga mendimtarët e renesancës evropiane:

### - Xhon Loku: (1632-1704)

Xhon Loku (John Locke) konsiderohet një nga filozofët e dalluar të shekullit XVII. Krahas kontributit të tij të vlefshëm në teorinë e “njohjes” përmes librit të tij “Ese mbi arsyen njerëzore”, në mendimin politik në librin e tij “Dy mesazhe qeverisë qytetare” dhe mendimin fetar në librin e tij “Logjiciteti i krishterizmit”, ai në mënyrë të drejtpërdrejtë ka kontribuar në zhvillimin e mendimit pedagogjik, në veçanti kur ai vetë është marrë me pedagogji dhe ka botuar një libër rreth përvojës së tij pedagogjike me titull “Mendime mbi edukatën”. Ishte libër i rëndësishëm nga fakti se flet për dimensione të rëndësishme pedagogjike si edukata familjare, shëndetësore, intelektuale, psikike dhe fetare.<sup>120</sup>

### - David Hume (1711-1776)

Drejtimi eksperimental në filozofinë e periudhës së shoqërisë qytetare u përforcua me shkrimet e filozofit britanik David Hume. Ai kishte kontribuar në zhvillimin e teorisë së “njohjes”, dhe kishte botuar një sërë librash, ku më të njohura janë: “Mesazh rreth natyrës njerëzore”, “Hulumtim mbi të kuptuarit njerëzor”, “Hulumtim mbi parimet etike” dhe “Diskutime rreth fesë natyrale”. Hume ishte i joshur për nga vënia e dyshimeve e një lloji të kufizuar. Ai me këtë përgatiti rrugën filozofëve të shekullit XIX si Konti, Xhon Stuart Mill, filozofëve tjerë si Spenser, Haksli dhe filozofëve realistë në shekullin XX. Hume ishte optimist në përparimin e shkencave. Ishte ndër të parët që shihnin mundësinë e zhvillimit të shkencave shoqërore, në veçanti shkencat ekonomike, politike, shoqërore dhe sjellja njerëzore. “Hume beson se vullneti njerëzor ndodhë sipas ligjeve psikologjike që mund të vërehen dhe të përshkruhen”. Rëndësia e kontributit të Hume në historinë e filozofisë moderne fshehët në dy aspekte: e para-

<sup>120</sup> Wiliam Kley Rajt, *Kitabu Tarih'il-felsefet'il-haditheti*, Përkthyes: Mahmud Sejid Ahmed, Beirut: Et-Tenviru li't-tibaati ve'n-Neshri ve't-tevzi'i, 2010, fq. 153-200.



zhvillimi i metodologjisë eksperimentale, psikologjike dhe epistemologjike dhe e dyta- përdorimi i kësaj metodologjie në fushën e etikës dhe shkencave shoqërore.<sup>121</sup>

#### - Volteri (1694-1778)

Derisa Hume ishte njëri nga personalitetet e dalluara në Britani, në të njëjtën kohë lind një personalitet tjetër i shoqërisë qytetare në Francë. Ai ishte Volteri, i cili “më së shumti kishte shkruar rreth letërsisë, thirrjes për liri dhe të menduar, luftimin e shtypjes politike, dhe besëtytnitë në shkencë dhe fe”. Ai së bashku me disa filozofë tjerë kishte arritur sukses që “pretendimet e kishës dhe të shtetit t’i vënë në pozicion të talljes dhe nënçmimit. Kështu që pushteti kishte humbur plotësisht besimin e popullatës, dhe kur nuk kishte më shpresë për përmirësimin e kushteve ekonomike, revolucionin e 1789 ishte i patjetërsueshëm”.<sup>122</sup>

#### - Zhan Zhak Ruso (1712-1778)

Ai ishte njëri nga personalitetet e shquara të shoqërisë qytetare. Ishte i njohur me teorinë e tij optimiste ndaj njeriut. Ruso “ishte i bindur se njeriu nga natyra e tij është i mirë”, por civilizimi është ajo që të keqën, varfërinë, robërimin, luksin dhe dëmbelinë e futë në jetën e njerëzve. Popullariteti më i madh i tij u arrit me librin e tij në filozofinë politike “Kontrata shoqërore”, i cili kishte ndikim të madh në zhvillimin e idesë mbi “shtetin”, në të cilin do të jenë të barabartë të gjithë qytetarët në të drejtat e tyre civile dhe politike. Rusoi po ashtu u bë njohur edhe në zhvillimin e mendimit pedagogjik. Ai kishte bindje se problemi i kohës në të cilën jetonte është problemi i arsimit publik. Ai ka kontribuar në zgjidhjen e këtij problemi duke dhënë propozime të caktuara në librin e tij “Emisi ose mbi edukatën”. Në këtë libër, Rusoi ofron një program praktik dhe teori arsimore që dallohej nga shumë prej teorive jopraktike. Bazamentet që i vendoi Rusoi ishin frymëzuese për shumë prej filozofëve të pedagogjisë së

<sup>121</sup> Po aty, fq. 217-223.

<sup>122</sup> Po aty, fq. 234.

mëvonshëm, në veçanti, Pestaloci (1746-1827), Herbarti (1776-1841) dhe Frebeli (1782-1852).<sup>123</sup>

### - Emanuel Kanti (1724-1804)

Emanuel Kanti u shfaq në Gjermani. Ai për shumë vite ishte mësimdhënës universitar. Kishte studiuar filozofitë logjike dhe eksperimentale dhe kishte filluar të bënë përpjekje për t'i ofruar ato përmes pikëpamjeve të veçanta të tij filozofike të cilat i quajti filozofia kritike. Ai në fushën e njohurive matematike, fizike dhe metafizike botoi librin e tij “Kritika e mendjes së pastër”. Më pas në sferën etike, boton librin “Kritika e mendjes praktike” dhe në sferën e biologjisë dhe estetikës librin “Kritika e fuqisë së të gjykuarit”. Është e qartë se Kanti ishte i interesuar për të zhvilluar teorinë rreth njohjes, ngjashëm me shumë prej filozofëve para tij, në veçanti Loku dhe Hume, mirëpo ai ishte dalluar nga të tjerët se kishte hulumtuar rreth njohjes reale dhe absolute, të cilën njeriu mund ta posedojë në matematikë dhe fizikë. Ai mendon se mendja e njeriut ndahet në tri fuqi. Ato janë: fuqia e njohjes, vullnetit dhe ndjenjës. Për secilën prej tyre ka shkruar nga një libër prej tri librave kritike. Kanti ishte i dalluar në sferën e mësimdhënies universitare. Ai ishte serioz, i sinqertë, kishte aftësi të veçanta në nxitjen e studentëve për mësim dhe për kritika ndaj drejtimeve filozofike.<sup>124</sup> Në veprat e Kantit ka punuar një numër i filozofëve gjerman si Fihte (1762-1815), Hegel (1770-1831) Shopenhauer (1788-1860), i cili kishte themeluar filozofinë idealiste gjermane.

### - Fridrih Niçe (1844-1900)

Niçe llogaritet themelues i nihilizmit në mendimin modern evropian. Ka ftuar në anashkalimin e gjitha vlerave që i ofrojnë mësimet kishtarë. Ka denoncuar demokracinë, pragmatizmin dhe socializmin, dhe ka shpresuar në kthimin e vlerave të vjetra aristokrate, të cilat shprehin vullnetin e fuqisë në artin e vjetër. Ka lavdëruar luftërat ngase edukojnë

<sup>123</sup> Po aty, fq. 237-242.

<sup>124</sup> Po aty, fq. 256-260.

njeriun për fuqi dhe trimëri dhe zhvillojnë shpirtin e dominimit. Ai mohon ekzistimin e kriterëve absolute në logjikë dhe etikë, edhe pse ai beson se filozofia e tij e veçantë është e vërteta absolute. Shkrimet e tij shprehin orientimet e tij raciste. Nuk është për t'u habitur kur dimë se nazizmi ka qenë bazë kulturore në mendimin e tij.

Niçe ishte i mendimit se problemi i edukatës nuk fshehët te fëmijët që kanë nevojë për edukatë, por në atë se sa burri dhe gruaja janë të shëndetshëm dhe të fuqishëm për të sjellë fëmijë të shëndoshë dhe të fuqishëm. Ai mes tjerash ka thënë: “Nuk mund të ngritët një popull, nëse paraardhësit e fëmijëve janë të prishur. Kjo gjë është e qartë gjatë tërë historisë për ata që dëshirojnë të shohin... populli i lirë dhe i lumtur nuk mund të formohet me avancimin e bujqësisë dhe industrisë, as me përhapjen e edukimit dhe arsimimit, as me shndërrimin e vendit në parajsë për nga pasuria dhe organizimi. Foshnja e cila bartë me vete shkaqet e jolumturisë duke qenë në barkun e nënës së tij, nuk mund të bëhet burrë i lirë dhe i fortë që do të kuptojë realitetin e jetës. Kujdesi për gjetjen e fëmijës së shëndoshë është më meritore se angazhimi për përgatitjen e arsimit dhe edukatës për fëmijën që nga jashtë është i përsosur, ndërsa shkatërrohet çdo përpjekje për të depërtuar në sëmundjen që ka depërtuar brenda tij që nga formimi”.<sup>125</sup>

### 5.3. Shembuj nga shkollat dhe drejtimit filozofike

Që nga kohërat e mëhershme, shoqëritë njerëzore kanë vërejtur nevojën për sistem të mendimeve, bindjeve, metodologjinë e kërkimit për urtësi, përcaktimin e sistemit të jetës dhe kriteret e sjelljes së njeriut. Ky sistem është njohur me termin “filozofi”. Kur e praktikojmë këtë filozofi në çështjet pedagogjike, atëherë kemi një filozofi pedagogjike ku detyra e saj do të përqendrohet në përcaktimin e qëllimeve, politikave dhe programeve të saj dhe kontrollon punën dhe sistemet e institucioneve pedagogjike.<sup>126</sup>

<sup>125</sup> Fridrih Niçe, *Hakedha tekël-leme Zeradisht (Kështu foli Zaratustra)*, Përkthyes: Filiks Faris, Bejrud: Dar'ul-kalem, fq. 12.

<sup>126</sup> Rreth rëndësisë së filozofisë për pedagogjinë, lexo:

Në vazhdim do të japim disa shembuj nga filozofitë dhe drejtimit pedagogjike:

### - Drejtimi skolastik (scholasticism)

Drejtimi më i njohur është drejtimi skolastik, i cili ka filluar në mesjetë, me qëllim të kthimit të vlerës të filozofitë e vjetra greke, në veçanti logjika krahasuese e Aristotelit dhe përputhshmërinë me pikëpamjet fetare. Në esencë kjo është metodologji filozofike dhe pedagogjike, të cilën e kanë pranuar shkollat katedrale, ku më pas është rritur dhe zhvilluar me propozimet e Toma Akuinit (1225-1274), ndërsa fuqinë e tij e ka kthyer pas kërkesës së Papës katolik Lion XIII në vitin 1879.<sup>127</sup>

Drejtimi skolastik është një mënyrë e të mësuarit të cilën e ka filluar një prift britanik me emrin Anselm në vitin 1100. Procesin mësimor e kishin marrë përsipër skolmenët në universitetet e mesjetës, të cilët në të njëjtën kohë ishin edhe udhëheqës fetarë. Ky drejtim ka vazhduar deri në vitin 1600, por këmbëngulësia e skolastikës për polemika vazhdon akoma të ketë ndikim në sistemet e arsimit bashkëkohor. Përmes këtij drejtimi, nxënësit nxiten për t'u përballuar me çështjet kontradiktore në gjësende, të cilat obligohen t'i mësojnë, me qëllim të arrijnë në pajtueshmëri mes gjërave të cilat shihen si kontradiktore. Prej tyre pritet që mendjet dhe përvojat e tyre nga njëra anë, dhe njohuritë e pranuar nga pushteti i papatëve kishtarë dhe mësuesve të tyre nga ana tjetër, t'i vënë në përdorim për formimin e argumenteve të tyre. Kjo shkollë ka bërë përpjekje të vë në pajtueshmëri mes mësimëve të ndryshme kishtarë dhe filozofive tjera, në veçanti asaj aristoteliane dhe platoniane të reja. Skolastikët kujdeseshin për logjikë të prerë dhe të vërtetën filozofike duke nxjerrë rezultatet në formë të kuptueshme, duke dhënë mundësi për testim përmes metodës së vrojtimit eksperimental.

Dale T. Snauwaert, *The Importance of Philosophy for Education in a Democratic Society*, *Journal of Peace Education and Social Justice*, Volume 6 No. 2, 2012 .fq. 73-84.

Për pozitën e filozofisë pedagogjike në veprimin pedagogjik, lexo:

Maxhid Arsan El-Kilani, *Felsefet'ut-terbijjet'il-islamijet: dirasetun mukareneton bi felsefat'it-terbevijjet'il-muasireti*, Amman: Dar'ul Fet'h, 2009, fq. 31-36.

<sup>127</sup> Rait, *Tarih'ul-felsefet'il-haditheti*, Vepër e cituar, fq. 37-44.

Filozofia skolastike u pranua me të madhe në kohën e Toma Akuinit, i cili ftonte që të mësohen të gjitha format e njohurive të mundshme në kohën e tij, duke bërë pajtueshmërinë mes referencave fetare dhe filozofike. Mirëpo, çështja e pajtueshmërisë nuk vazhdoi me suksesin e tij me hyrjen e shoqërisë evropiane në periudhën e renesancës në shekujt XIV dhe XV, pasi filozofët kishin filluar të luajnë një rol të dalluar në veprat e tyre të pavarura nga mësimet e kishës, në veçanti kur vetëm kishin shtuar leximin ndaj filozofisë hebreje dhe islame, shkencave natyrore, matematikës dhe vlerës së metodologjisë eksperimentale. Atyre u kishte bërë e qartë se “natyra nuk zbulon veten e saj përmes përdorimit të krahasimit logjik, dhe se -nga ana tjetër- mundet realizimi i zbulimeve të reja përmes metodave tjera”.<sup>128</sup>

### - Drejtimi humanist (Humanism)

Prej drejtimeve ideologjike që njeh historia evropiane është edhe drejtimi humanist. Shekujt XV dhe XVI kanë përjetuar ndryshime rrënjësore në mendimin evropian, duke kaluar nga referenca fetare në pikëpamjet laike, nga kolektiviteti në individualizëm dhe nga besëtytnitë në shkencë. Historianët këtë kthesë e konsiderojnë kalim nga skolasticizmi tradicional në humanizëm. Ky trend në besim, orientim dhe normë të jetës përqendrohet rreth interesave dhe vlerave të njeriut, duke e mohuar besimin e gjërave metafizike. Kjo shkollë beson në dinjitetin dhe fuqinë e njeriut si individ për t'u pavarësuar përmes rrugës së mendjes. Fjala “humanizëm” gjatë historisë ka pasur shumë kuptime, ndonëse kuptimi kryesor ishte përqendrimi ndaj interesave dhe vlerave të njeriut bazuar në referenca fetare që beson në metafizikë. Kuptimi i kësaj fjale më pas silllej rreth kuptimit të etikës e mbështetur në mendje, drejtësi, ushtrimin e qytetarëve për të folur, shkruar dhe bindur të tjerët. E gjithë kjo duke mësuar gjerësisht veprat klasike, në vend të mësimave fetare dhe metafizike.

Në rrethanat jostabile të shekullit XV, te filozofët u zhvillua ideja “e vërteta e dyanshme”, sipas së cilës nuk ka

<sup>128</sup> Po aty, fq. 42.

pengesë që një çështje të pranohet në sferën filozofike edhe pse ishte e papranueshme në sferën fetare. Pas emigrimit të shkencëtarëve nga Kostandinopoja me rënien e saj në duart e muslimanëve osmanë më 1453, hulumtimi për një filozofi të re u përshpejtua. Këta shkencëtarë me entuziazëm filluan të studiojnë filozofinë e vjetër greke, dhe kështu u përhap ideja e “pedagogjisë së lirë”. Kështu njeriu i shekullit XV u bë më human dhe më i kulturuar. E gjithë kjo përmes studimit të letërsisë klasike, për të cilën udhëheqësit e renesancës kishin besuar se ishte shprehje e qëllimit të autorëve original dhe pikëpamjet e tyre. Për këtë, letërsia klasike njihej edhe me emrin “humanizmi” dhe se hulumtuesi i cili e studionte me mënyrë të re njihej me emrin “hulumtuesi human”.<sup>129</sup>

Me fillimin e shekullit XVII, shkencëtarët filluan të kuptojnë mangësitë e filozofisë humane, ngase i mungonte metodologjia e përshtatshme për hulumtim filozofik. Kështu shumë prej shkencëtarëve filluan të zhvillojnë disa drejtime metodologjike: “metodologjia e hulumtimit eksperimental” i bazuar në vërtetim dhe eksperiment, siç veçoi Frensis Bekon (1561-1626), “Metodologjia e hulumtimit racional”, i cili ngrihej mbi argumentin matematikor dhe gjeometrik, siç kishte bërë Rëne Dekart (1596-1650), Spinoza (1632-1677) dhe Lajbnic (1646-1716).<sup>130</sup>

Humanizmi është një qëndrim filozofik dhe etik që kujdeset për qenien njerëzore si individ dhe si lloj. Ngrit vlerën e njeriut, shfrytëzon mendimin kritik dhe argumentimin eksperimental si zëvendësimi i gjendjes së njeriut për të cilën thërriste kisha krishtere si asketizëm në jetë, besim i verbër besëtytnitë e faljes etj. Humanizmi filloi t’ua mësojë artet e lira dhe studimet klasike, duke mbështetur fuqishëm idenë e lirisë dhe përparimit njerëzor. Ky drejtim gjatë historisë është shfaqur në forma të ndryshme si: humanizmi fetar, humanizmi etik, humanizmi laik etj. Veb-faqja elektronike e një fondacioni me emrin “Këshilli i Humanizmit laik” jep emrat e një sërë fondacionesh ekzistuese sot në botë, të cilat veproj-

<sup>129</sup> Po aty, fq. 43.

<sup>130</sup> Po aty, fq. 64, 95-96, 115-116.

në sipas këtij drejtimi në format e tyre të ndryshme.<sup>131</sup> Këtë drejtim sot e marrin disa lëvizje të cilët kanë qëndrim afetarë, besojnë në shkencë dhe mohojnë nevojën për shpallje dhe për gjërat metafizike për të kuptuar botën. Këto lëvizje njihen me emrin “shekullarizëm” ose “laicizëm”.

Xhim Herik ka paraqitur prezantimin e drejtimit humanist te filozofët, që nga periudha e grekëve, më pas në mesjetë, periudhën e renesancës në Evropë, duke përfunduar me fillimin e shekullit XXI. Ai ka përfunduar në një rezultat që mund të jetë e hiperbolizuar ku thotë se elementet e këtij drejtimi ishin të pranishme në mendimet e shumicës së filozofëve.<sup>132</sup> Ky autor, librin e tij e ka përmyllur me shtatë tekstet, të cilat prezantojnë parimet e drejtimit humanist. Këto parime janë përcaktuar në Konferencën e pesëdhjetë vjetorit të “Unioni Botëror për komunikim 2002” në Amsterdam të Hollandës. Këto parime u komunikuan me titullin “Komunikata e Amsterdami” duke theksuar se drejtimi humanist është drejtim “etik, racional, beson në demokraci, në të drejtat e njeriut, ruan baraspeshën mes të drejtës individuale dhe përgjegjësisë shoqërore, është alternativë e besimeve fetare metafizike, vlerëson kreativitetin artistik dhe është normë e jetës për çdo njeri në çdo vend”.<sup>133</sup>

Disa hulumtues mendojnë se mendimi perëndimorë i cili zhvillohet në Evropën perëndimore dhe Amerikë, vazhdon akoma të cilësohet me drejtimin humanist, të cilin e quajnë “Humanizmi liberal”. Ky mendim, në dimensionet e tij historike, ka paragjykime kundër tjetrit, në veçanti tjetrit historik siç janë indusët, kinezët dhe arabët, ose tjetrit modern siç janë afrikanët dhe banorët autoktonë të botës së re. Edhe krahas përpjekjeve të mëdha që janë bërë në shumë institucione perëndimore dhe institucionet e Kombeve të Bashkuara për të mbështetur pluralizmin dhe respektimin e tjetrit në botën bashkëkohore, prapëseprapë të gjitha këto përpjekje kanë dështuar. E gjithë kjo mund të jetë se filozofitë joperëndimore, në plan-programet shkollore dhe universitare, potencohen

<sup>131</sup> - <http://www.secularhumanism.org/index.php/13>

<sup>132</sup> Jim Herrick, *Humanism: An Introduction*. Amherst and New York: Prometheus Books, 2005, fq. 1-6.

<sup>133</sup> *Ibid.*, fq. 101-102.

kalimthi dhe nuk u kushtohet kujdesi metodologjik dhe filozofik, -që në fund të fundit- është shprehje e kulturës së tjetrit. E gjithë kjo, krahas asaj se filozofia humaniste perëndimore bën lidhshmëri historike me qëllim të zmadhimit të saj përmes kërkimit të rrënjëve në gjenialitetin e Greqisë së vjetër. Filozofia humaniste për shkak të pikënisjeve ideologjike mbi të cilat është themeluar politika perëndimore, iu ka nënshtruar shumë kritikave. Ajo ka përfunduar në dy luftëra botërore për një gjysmë shekulli. Ky drejtim, krahas paragjyqimeve perëndimore, ishte në prag të shkaktimit të çrregullimit në baraspeshën e ambientit dhe sistemet e jetës natyrore. Sidoqoftë, "Humanizmi" i cili më pas u bë drejtim filozofik, në periudhën e renesancës ka qenë vetëm çështje arsimore që thërriste në mbështetjen e metodologjisë pedagogjike me letërsinë klasike, retorikën dhe artet e lira.<sup>134</sup>

### - Drejtimi pozitivist

"Pozitivizmi" drejtim pedagogjik i themeluar nga Ogyst Konti (1798-1857). Ai dëshiroi që ky drejtim të jetë sistem filozofik i shoqërisë industriale, i cili vetëm kishte filluar të formohet. Ai ka propozuar të përdoret metodologjia praktike në studimin e ekonomisë, politikës dhe sjelljes shoqërore. Ky studim shkencor do të shpie në formimin e shoqërisë dhe vazhdimin e përparimit të saj. Drejtimi pozitivist i Kontit refuzon të jetë temë studimi çdo gjë që nuk i nënshtrohet shqisave në mënyrë të drejtpërdrejtë. Për drejtimin pozitivist ka pasur dy ligje. I pari: ligji historik apo logjik. Ky ligj përfshin tri shkallët e zhvillimit të mendimit në shoqëritë njerëzore: periudha teologjike, metafizike dhe shkencore. Konti ka sqaruar se si kjo çështje është e qartë në historinë evropiane dhe në jetën e çdo individi. Ndërsa ligji i dytë është ligj njohës i veçantë për sistematizim të niveleve që e sheh për zhvillimin e fushave të njohurive. Ky ligj fillon me matematikën, astronominë, fizikën, kiminë, biologjinë dhe sociologjinë. Konti ka kundërshtuar që psikologjia të llogaritet si shkencë.

<sup>134</sup> Michael A. Peters, *The Humanist Bias in Western Philosophy and Education*. *Educational Philosophy and Theory*, Vol. 47, Issue. 11, 2015, fq. 1128-1135.

- <http://www.tandfonline.com/doi/abs/10.1080/00131857.2014.991497>.



Ai ishte i mendimit se njohuria, në çdo shkencë është ngritur pjesërisht mbi shkencën paraprake. Sipas tij, shkenca më e zhvilluar dhe më e komplikuar është fizika shoqërore ose sociologjia, ngase ajo gjykon sjelljen e njerëzve në nivel të përgjithshëm. Pikëpamjet e tij në mënyrë të detajuar i ka sqaruar nën titullin “shoqëria pozitiviste”. Ai ka propozuar një koncept për një fe të re të cilën e ka quajtur fe e njerëzimit, ku adhurimin do të meritojnë personalitetet të cilët ofrojnë shërbim më të mirë për shoqërinë.<sup>135</sup>

Gjurmët e filozofisë pozitiviste në fushën e pedagogjisë shihen në metodologjinë e kërkimit pedagogjik, ngase “mënyrën e hulumtimit të cilën e kanë ofruar librat e sociologjisë në gjysmën e parë të shekullit XX kanë qenë të dominuara nga filozofia pozitiviste, edhe pse gjatë kësaj periudhe kishte mungesë të qartë të kësaj filozofie. Dominimi i kësaj filozofie në fushën e hulumtimit pedagogjik i dedikohet psikologut amerikan Skinner dhe filozofisë së tij rreth sjelljes “Behaviorizmit”, i cili kishte orientim të drejtpërdrejtë pozitivist. Skinner refuzon të gjitha praktikatat të cilat flasin për sjelljen e njeriut përmes faktorëve të brendshëm mental ose psikik, të cilëve u mungojnë dimensionet fizike. Ai nuk pranon asgjë përpos atyre shkencore që mbështeten në të vërejturit dhe eksperimente”.<sup>136</sup>

Praktikat e pozitivizmit në fushën pedagogjike shihen edhe në çështjen e “vlerave”. Sipas kësaj filozofie, vlerat janë mjete të shoqërisë për realizimin e qëllimeve. P.sh. vlerat morale janë ato që i pranon një shoqëri e caktuar në një kohë të caktuar, dhe se ato janë të dobishme për derisa realizojnë qëllime praktike për atë shoqëri. Këto vlera ndryshojnë dhe në vend të tyre sillen vlera tjera, varësisht nga gjendja dhe nevojat e shoqërisë. Sa i përket shkencës teorike, vlerat në filozofinë pozitiviste i takojnë fushës metafizike, që nuk i nënshtrohen eksperimentit, për këtë edhe nuk meritojnë të përfshihen në fushën e shkencave e as të mësohen. Vlerat mund

<sup>135</sup> Edward Craig, (Editor). *Concise Routledge Encyclopedia of Philosophy*. London and New York: Routledge, 2000, fq. 158.

<sup>136</sup> B. F. Skinner, *Science and Human Behavior*, New York: Pearson Education Inc., First published, 1953, reprint 2000, fq. 29.

të shprehin ndjenja individuale, por individit shumë shpejt përshtatet me kërkesat e shoqërisë.

### - Drejtimi pragmatik

Zhvillimin e idesë së “pragmatizmit” mund të gjejmë në veprat e një numri të filozofëve. Prej tyre më të dalluar ishin: Vilhem Xhemi (1842-1910), Çarl Pirs (1839-1914) dhe Xhon Djui (1859-1952). Hulumtimi i detajuar jep të kuptohet se ky drejtim ka ekzistuar edhe në veprat e filozofëve tjerë si Koven, Hegel, Hajdeger etj.<sup>137</sup> Duhet theksuar se Xhon Djui dallohet me atë se ka zhvilluar këtë drejtim dhe ka zbatuar praktikën në sferën e arsimit. Mendimet e tij pragmatike që nga fillimi i shekullit XX, kanë pasur ndikim të madh në sistemin arsimor amerikan. Këto mendime janë përhapur në shumë anë të botës. Filozofia pragmatiste mori edhe kuptimin e instrumentalizmit, funksionalizmit dhe operacionalizmit. Bazuar në atë se orientimi i përgjithshëm në filozofinë evropiane ishte i dominuar nga filozofia pozitiviste, atëherë shumica e drejtimeve filozofike nuk dilnin jashtë kornizave të kësaj filozofie, përfshirë edhe pragmatizmin.

Xhon Djui ka qenë i ndikuar nga studimet filozofike të “Hegelit”, studimet psikologjike të “Frobelit” dhe studimet rreth evolucionit të “Darvinit”. Filozofia e tij ishte vazhdim i Çarl Pirsit dhe Vilhem Xhemit në filozofinë e tyre të bazuar në dobi dhe përfitim ose që mund të vërehet përmes krahasimit.<sup>138</sup> Djui në librin e tij “Shkolla dhe shoqëria” e paraqet shkollën si shoqëri e vogël, ku nxënësit do të bëhen qytetarë të mençur dhe të dobishëm përmes prodhimit të gjërave në mënyrë të përbashkët. Në librin e tij “Demokracia dhe edukata” thekson se edukata është proces që ndihmon shoqëritë në ekzistimin e tyre dhe se shkolla është shoqëri ku realizohet pasurimi i eksperiencës dhe sistematizimit të nxënësve përmes aktiviteteve të përbashkëta. Nëse filozofia instrumentale i përngjanë pragmatizmit të Vilhem Xhemit me interesim

<sup>137</sup> Alan Malachowski, (Editor). *The Cambridge Companion to Pragmatism*, New York: Cambridge University Press, 2013.

<sup>138</sup> Xhon Djui, *El-Medresetu ve'l-muxhteme'*, Përkthyes: Ahmed Hasen, Bejrut: Daru mektebet'il-hajati. Botimi 2, 1978. Parathënia e librit në gjuhën origjinale, e datuar nga 1915.

fetar, instrumentalizmi i Djuit synon përmirësimin shoqëror. Qëllimi i edukatës sipas Djuit në mënyrë të shkurtër përfshin edukimin dhe trajnimin e njerëzve të përshtaten me rrethin ku jetojnë, dhe më pas -sa të jetë e mundur- rikonstruimi i këtij rrethi në atë mënyrë që përshtatet me dëshirat dhe nevojat e tyre.<sup>139</sup>

Do të mjaftojmë me këto katër shembuj rreth orientimeve dhe drejtimeve filozofike, të cila kanë ndikuar në teoritë dhe praktikatat e arsimit deri në gjysmën e parë të shekullit XX. Po ashtu mjaftojmë me theksimin e disa filozofive që kanë dominuar në këtë periudhë, si dhe përmbajtjet pedagogjike të këtyre filozofive në sferën e teorisë dhe praktikës.<sup>140</sup>

Ali Ismail dhe Hani Ferexh kanë vërejtur se përmbajtjet e filozofisë pedagogjike janë shpërndarë në tri modele: prezantimi i shkollave filozofike si: realizmi, idealizmi dhe pragmatizmi, përfshirë edhe përmbajtjet pedagogjike të këtyre shkollave, modeli i paraqitjes së filozofisë pedagogjike të një filozofi të caktuar si: Platoni, Loku, Rusoi e tjera dhe modeli i ashtuquajtur teoritë pedagogjike bashkëkohore të dala nga shkollat filozofike si p.sh. perenializmi i dalë nga filozofia idealiste, esencializmi i dalë nga filozofia realiste dhe progresivizmi i dalë nga filozofia pragmatiste.

<sup>139</sup> Po aty, Parathënia e librit në gjuhën origjinale, e datuar nga 1915.

<sup>140</sup> Seid Ismail Ali, Hani Ferexh, *Felsefet'ut-terbijjeti: ru'jetun tahlilijetun ve mendhurun islamijun*, Herend & Kajro: El-Ma'had'ul-alemijju li'l-fikr'il-islamijji, 2009, fq. 69-93.

## Pjesa e tretë: Filozofitë pedagogjike bashkëkohore dhe referencat e tyre perëndimore

### 1. Disa shembuj rreth filozofive pedagogjike bashkëkohore

Shumica e librave të filozofisë pedagogjike -edhe ato të botuara së voni- flasin për përmbajtjet pedagogjike të filozofive të vjetra tradicionale si p.sh. idealizmi, realizmi, natyralizmi, instrumentalizmi. Mirëpo, librat më të reja flasin për teoritë pedagogjike të cilat në të shumtën e rasteve kanë dalë nga filozofitë tradicionale. Ndërhyrjet e mendimeve potencohen gjatë bisedës së pozitës se secilit prej nxënësit, mësuesit, plan-programit mësimor dhe qëllimeve mësimore në mendimin pedagogjik dhe praktikat pedagogjike. Në secilën filozofi që llogaritet si e re dhe bashkëkohore potencohen dhjetëra emra të filozofëve, mendimtarëve dhe pedagogëve të cilët kanë pasur lidhje të afërt apo të largëta me filozofinë përkatëse. Përfshirë këtu se sa e ka pranuar apo kritikuar këtë filozofi, si dhe pozitivitetet dhe negativitetet. Prej filozofive që potencohen në këtë kontekst janë: filozofia progresive, filozofia perenialiste, filozofia ekzistencialiste, filozofia behavioriste, filozofia esencialiste, filozofia strukturaliste, filozofia analitike, filozofia linguistike, filozofia kritike, filozofia eklekticiste etj.

Vlen të theksohet se filozofitë pedagogjike në literaturë i gjejmë në formë të filozofive të pavarura që nuk kanë ndërhyrje mes vete, ose si teori konfliktuozë, ku secila përpiqet të rrënojë tjetrën. Kjo gjë dobëson të menduarit filozofik në pedagogji dhe përdorimin e pikëpamjeve filozofike në zgjidhjen e problemeve pedagogjike, gjë që i jep arsye disa hulumtuesve të flasin rreth falimentimit të mendimit në filozofinë pedagogjike.<sup>141</sup>

<sup>141</sup> Po aty, fq. 89.

- George Newsome, *Some Propositions Concerning the Teaching of Educational Philosophy*, në: *the Proceeding of the Twenty-First Annual Meeting of Philosophy of Education Society*, 1965, fq. 45.

Disa filozof përëndimorë kanë refuzuar mendimin se teoritë dhe praktikat pedagogjike dalin nga shkolla e një filozofie të caktuar. Ata sjellin shembuj se disa filozofë kanë formuluar mendime pedagogjike, bile ndoshta edhe i kanë praktikuar para se të formohen tek ata mendime filozofike të dalluara.<sup>142</sup> Çështja ka arritur deri në atë nivel sa disa të vënë në pikëpyetje edhe nevojën e pedagogjisë për filozofinë.<sup>143</sup>

Në disa raste është vështirë të dallohet filozofia, të cilës i përmbahet një mendimtar pedagogjik ose një shoqëri, nga filozofitë tjera, sepse ky mendimtar apo kjo shoqëri nuk i përmbahet elementeve të një filozofie të caktuar. Kur mendimtari ka njohuri të mjaftueshme rreth veçorive të secilës filozofi, atëherë është i aftë të vë secilën filozofi në vendin e duhur, me qëllim që të forcon pozitën dhe argumentin e tij. Ai ka mundësi që disa elemente t'i zgjedh nga njëra filozofi, ndërsa elemente tjera nga filozofitë tjera, varësisht nga ajo që e sheh të përshtatshme për trajtimin e rastit. Kështu filozofia e tij do të jetë eklekticiste, që plotëson nevojat aktuale pedagogjike, në veçanti në një shoqëri bashkëkohore multi-etnike dhe multi-konfesionale.

Prezenca e filozofisë pedagogjike nuk duhet të figurojë vetëm si temë për studim në një lëndë mësimore universitare ose si pjesë e një lënde mësimore, por duhet të jetë prezente në veprimin pedagogjik, shkollor dhe universitar, në studimin e shumicës së lëndëve pedagogjike dhe në bashkëveprim me shumicën e çështjeve arsimore shkollore. Plan-programi pedagogjik, programet për përgatitjen e mësimeve, vlerësimi pedagogjik dhe hulumtimi pedagogjik, që të gjitha mbështeten në filozofinë pedagogjike. Nuk është doemos që filozofia pedagogjike të shfaqet me këtë titull. Ajo mund të shfaqet edhe me tituj tjerë si: qëllimi i pedagogjisë, sistemi i bindjes, modeli njohës (paradigmë) vizioni i botës, ideologjia (shkolla) etj.

<sup>142</sup> Hook, Sidney. *The Scope of philosophy of education*, në: Christopher L. Lucas, (Editor), *What is Philosophy of Education?* New York: Collier Macmillan Ltd, 1969, Part 3 Chapter 6.

<sup>143</sup> Cahn, Steven M. *Philosophical Foundations of Education*, New York: Harpercollins College Div, (June 1970), fq. 369.

Kontradiktat mes filozofive, drejtimeve dhe pikëpamjeve pedagogjike mund të shihen në supozimet elementare të tyre ose në praktikimet e tyre në çështje të caktuara pedagogjike si: formimi i programeve, qëllimet pedagogjike, trajnimi i mësimdhënësve, administrata pedagogjike etj. P.sh. shohim kontradikta të qarta të filozofive pedagogjike rreth koncepteve të programeve pedagogjike, siç paraqiten në një libër.<sup>144</sup> Në këtë libër, njëri nga autorët flet për atë që quhet luftë mes pedagogëve për afër një shekulli rreth konceptit të fjalës program Secili koncept bazohet në ideologji pedagogjike, filozofi pedagogjike apo vizion të caktuar. Autori zgjedh katër koncepte kontradiktore: konceptin akademik që përqendrohet në sferën e njohjes, konceptin e “efikasitetit shoqëror” i cili përgatit nxënësit për plotësimin e nevojave të shoqërisë, koncepti “përqendrimi rreth nxënësit” që synon arsimimin sipas aftësive të veçanta të secilit individ dhe koncepti “formimi shoqëror”, i cili synon formimin shoqëror, që vepron me drejtësi dhe realizon kënaqësinë e të gjithëve. Më pas, autori krahason kuptimin e këtyre katër koncepteve sipas dhjetë autorëve që kanë shkruar në periudhën 1977-2008. Ai vëren se këto koncepte bien nën tituj të shumtë, që përfshijnë llojllojshmërinë e gjerë të njohur në filozofitë pedagogjike: humaniste, liberale, behavioriste, racionaliste, progresive, strukturaliste etj.

Kontradikta mund të shihen edhe në praktikat e niveleve administrative në veprimin pedagogjik, si: inspektorati qendror, lokal, inspektorë, mësimdhënës etj. E gjithë kjo ndikon në mundësinë e koordinimit dhe bashkëpunimit për realizimin e qëllimeve të veprimit pedagogjik në formën më të mirë. Shkak për këtë është se disa persona të këtyre niveleve administrative kanë sisteme të ndryshme të bindjes. Sistemet e bindjes së ndryshme të mësuesit mund të pengojnë mundësitë e bashkëpunimit për realizimin e qëllimeve të shkollës. Në këtë kontekst, një hulumtues ka bërë dallimin mes gjashtë bindjeve që dominojnë në mesin e mësimdhënësve sot. Ato

<sup>144</sup> Michael Stephen Schiro, *Curriculum Theory: Conflicting Visions and Enduring Concerns*, 2nd Edition, Volume 2, New York: SAGE Publications, Inc; 2nd edition (24 prill, 2013), fq. 4-8.

janë: fundamentalizmi fetar, njohës, vetërealizimi, teknologjia, akademia dhe rikonstruimi shoqëror.<sup>145</sup>

Një hulumtuese ka zbatuar këtë sistem të bindjes me mësimdhënësit dhe ka përfunduar se divergjencat nuk është domos të jenë të këqija. Ndoshta është e dobishme që të angazhuarit në shkollë të bartin llojllojshmëri në bindje dhe pikëpamje ideologjike. Problemi i kontradiktave shihet vetëm atëherë kur asnjëri nuk di bindjet e tjerëve, në bazë të së cilave përcaktohet mënyra e të menduarit dhe marrja e vendimeve.<sup>146</sup>

Më parë theksuam disa drejtime ideologjike dominuese këtyre ditëve, ku vërejmë prezencën e shumicës së filozofive pedagogjike të vjetra dhe të reja, por vërejmë edhe drejtime filozofike bashkëkohore, të cilat në formën që i shohim sot, nuk kanë ekzistuar më parë. Ne jemi tani në fillim të dekadës së tretë të shekullit XXI.

Në vazhdim, vetëm sa për ilustrim, do të japim pasqyrë të shkurtër rreth disa orientimeve:

### 1.1. Filozofia e arsimit global:

Prej filozofive të cila kanë marrë rrugën drejt teorive pedagogjike bashkëkohore dhe ka filluar të përhapet shumë e më shumë është edhe filozofia e arsimit global, i cili pothuaj po shkrinë dallimet në filozofitë pedagogjike mes popujve, me shpresë të nxjerr në shesh qytetarin global. Ka zëra aty-këtu për themelimin e një sistemi arsimor që në administrim dhe zbatim nuk njih kufij mes popujve. Disa shoqëri dëshirojnë të zbatojnë këtë sistem, me shpresë se do të ndihmon në zhvillim dhe do t'u bashkëngjiten shoqërive të përparuara. Nuk është më sekrete se Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe disa shtete evropiane, me arsyetime të ndryshme, ushtrojnë presione politike dhe ekonomike ndaj shoqërive tjera për të ndryshuar sistemet arsimore dhe kulturore.<sup>147</sup>

<sup>145</sup> Arthur Costa & Robert Garmston, *Cognitive Coaching: Developing Self-Directed Leaders and Learners*, 3rd Edition, Maryland: Rowman & Littlefield Publishers, 2015, fq. 177-184.

<sup>146</sup> Elena Aguilar, *Teacher Collaboration: When Belief Systems Collide*, California: Edutopia (George Lucas Educational Foundation), Pulished March, 22, 2016, shih the link: <https://www.edutopia.org/blog/educational-beliefs-collide-teachers-elena-aguilar>.

<sup>147</sup> Wicht Srisa-an, *Global Education for Asia in the Twenty-first Century*, *Asia-Pacific Journal of Cooperative Education*, Volume 3, No.1, 2002, fq. 1-4.

Prej koncepteve që bëjnë përpjekje parashikimin e orientimeve të arsimit në shekullin XXI është edhe koncepti “shoqëria e të mësuarit”, që shihet se është bërë dukuri botërore dhe “globale”. -Siç shihet- ky koncept ndërlihet me një koncept tjetër edhe më i përhapur siç është “shoqëria e njohjes”. Këtë koncept e promovojnë institucione rajonale dhe ndërkombëtare si: Organizata e bashkëpunimit dhe zhvillimit ekonomik,<sup>148</sup> Komisioni Evropian, UNESCO etj. Edhe pse kulturat vendase dhe institucionet kombëtare mbesin të jenë faktorë të fuqishëm në shumicën e shoqërive, por përzierja e njerëzve përmes turizmit dhe njohja me praktikatat tërheqëse janë bërë faktorë mësimi që çajnë kufijtë, gjë që mundësojnë shoqëri të të mësuarit global.<sup>149</sup>

## 1.2. Internacionalizimi i arsimit:

Edhe krahas asaj se këmbimi i përvojave dhe huazimi kulturor mes shoqërive, në veçanti në sferën e arsimit të lartë ka qenë dukuri e vjetër në histori, dhe se kjo dukuri është përsheptuar gjatë shekullit XX, ajo me përfundimin e shekullit XX është shndërruar në një lëvizje aktive që synon formimin e një kornize për të qenë referencë për të,<sup>150</sup> duke analizuar forcat që e mbështesin drejt përparimit përballë forcave që bëjnë përpjekje të shfrytëzojnë arsimin e lartë për qëllime kombëtare vendase.<sup>151</sup> Disa institucione janë marrë enkas për të sqaruar motivet e ndryshme të kësaj lëvizjeje, raportet e saj me globalizmin dhe përpjekjet e pajtueshmërisë që mund të bëjë shteti mes përshtatshmërisë me proceset e globalizmit të jashtëm dhe respektimi i shtetit ndaj prioriteteve historike dhe kulturore.<sup>152</sup> Lëvizja e internacionalizimit të arsimit përfshin përgjithësimin e arsimit të lartë duke përfshirë: plan-

<sup>148</sup> Organisation for Economic Co-operation and Development (OECD).

<sup>149</sup> Michael Kuhn, (Ed.), *New Society Models for a New Millennium: The Learning Society in Europe and Beyond*, New York: Peter LANG, 2007, fq. 223.

<sup>150</sup> Zha Qiang, *Internationalization of Higher Education: towards a conceptual framework, Policy Futures in Education*, Volume 1, Number 2, 2003, fq. 248- 270.

<sup>151</sup> Clark Kerr, *The Internationalisation of Learning and the nationalization of the purpose of Higher Education: two 'laws of motion' in conflict*, *European Journal of Education*, Vol. 25, No. 1, 1990, fq. 5-22.

<sup>152</sup> Carolin Kreber, *Different Perspectives on Internationalization in Higher Education, New Directions for Teaching and Learning*, Volume 2009, Issue 118, Summer 2009, fq. 1-14.



programet, tekstet mësimore, metodologjinë, referencat, hapjen e degëve të Universiteteve evropiane dhe amerikane bazë, në disa shtete tjera, caktimin e kriterëve ndërkombëtare për akreditim, sisteme ndërkombëtare për klasifikimin e Universiteteve etj.<sup>153</sup> Përpyekjet e lëvizjes së internacionalizimit të arsimit nuk janë të kufizuara vetëm në arsimin universitar, por ato përfshijnë edhe arsimin publik. Dukuria e “shkollave ndërkombëtare”, “plan-programeve ndërkombëtare” dhe “provimeve ndërkombëtare”, vetëm sa vijnë e shtohen. Literaturat që studiojnë këtë dukuri vetëm sa vijnë e shtohen në shtete të ndryshme.<sup>154</sup>

Organizata UNESCO është duke mbështetur internacionalizimin e arsimit. Në Raportin e saj të publikuar thotë: “Duhet ndihmuar shtetet për përforcimin e dimensionit internacional në arsim (plan-programet mësimore, përdorimi i teknologjisë, bashkëpunimi ndërkombëtar”. Duhet ofruar ndihmën për përforcimin e sistemeve arsimore kombëtare përmes mbështetjes së raporteve dhe bashkëpunimit mes ambasadave në nivel rajonal dhe përmes shteteve të cilat ballafaqohen me probleme të ngjashme. Po ashtu, duhet mbështetur aktivitetet për sjelljen e ligjeve që ofron UNESCO për shërbim të shteteve anëtare, si p.sh. realizimin e pajtueshmërisë mes ligjeve vendase kombëtare dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”.<sup>155</sup>

### 1.3. Arsimi në periudhën e postmodernitetit

Moderniteti, i cili gjatë shekujve XIV-XVII në kohën e Renesancës kishte kapluar tërë Evropën, dhe më pas kishte përfshirë edhe shtete tjera, kishte shkaktuar ndryshime rrënjësore në realitetin e tërë botës. Mirëpo, çështja e modernitetit

<sup>153</sup> Literatura rreth internacionalizimit të arsimit të lartë është e bollshme. Më të fundit janë:

- Darla K. Deardorff, & Lily A. Arasaratnam Smith, (Editors), *Intercultural Competence in Higher Education: International Approaches, Assessment and Application*, Internationalization in Higher Education Series, London and New York: Routledge, 1 edition, 2017.

- Hans De Wit, & Jocelyne Caceres-Avila, & Elspeth Jones, & Nico Jooste, (Editors), *The Globalization of Internationalization: Emerging Voices and Perspectives*, Internationalization in Higher Education Series, London and New York: Routledge, 1 edition, 2017.

<sup>154</sup> Simon McGrath, & Gu Qing, *Routledge Handbook of International Education and Development*, London and New York: Routledge, 1 edition, 2017.

<sup>155</sup> UNESCO, Arsimi, thesari i fshehur, Raport i Komisionit Ndërkombëtar të UNESCO-s e interesuar për edukimin dhe arsimin në shekullin e XXI, “Raporti Dilor”, Paris: Organizata UNESCO, 1996, fq. 42.

tetit kishte filluar të kritikohet fuqishëm, duke filluar nga fundi i dekadës së katër të shekullit XX dhe vazhdon edhe sot e kësaj dite. Ky angazhim kritik u njoh si përpjekje për të rrëzuar themelet mbi të cilat u ngrit moderniteti, në veçanti mbështetja e tepërt në bindjen logjike, metodologjinë shkencore dhe liria individuale. Këtë kritikë e shoqëroi përhapja e një filozofie alternativë, e cila kishte ardhur si reaksion ndaj filozofisë moderniste dhe anashkalim i saj. Për këtë, edhe është quajtur filozofia postmoderniste. Brenda kësaj filozofie përfshihen orientimet e filozofisë nihiliste, feministe, dekonstruktiviste etj.

Edhe pse postmoderniteti merr shumë nga filozofia strukturaliste, e cila mendon se çdo individ ka pikëpamjet e tij të veçanta rreth mendimeve dhe çështjeve, ngase nuk ka të vërteta konstante dhe absolute, dhe se çdo gjë cilësohet si relative,<sup>156</sup> vërehet se kjo filozofi është një kombinim i mendimeve dhe orientimeve praktike, të cilët nuk formojnë filozofi të dalluar me parimet dhe supozimet e saj, por pionierët e saj përpiqen që njerëzinë ta nxjerrin nga periudha e modernitetit në një periudhë tjetër që do të vendoste themelet për një botë të re ku do të dominonte pluralizmi në të menduar dhe komentime, dyshimi në çështjet që llogariteshin të sakta, kontradiktat në gjërat që llogariteshin të koordinuara dhe rrënimi i teorive të njohura mbi të cilat ishte ngritur kultura perëndimore qysh nga periudha e renesancës. Në këto rrethana, qëllimi i arsimit është mundësimi i studentëve për të shkaktuar shkëputje mes tyre dhe sistemeve të së vërtetës të cilat ishin zhvilluar në periudhën e modernitetit, qëllimi i institucioneve arsimore është zbulimi i raportit mes njohurisë dhe forcës, mësimdhënësi do të jetë dekonstruktiv i profesionalizuar dhe qëllimi plan-programit mësimor është tekst i hapur për lexim dhe lexim të gabuar përmes mjeteve dekonstruktive.<sup>157</sup>

#### 1.4. Arsimi në periudhën e Digimodernizmit

<sup>156</sup> Harvey Siegel, (Editor). *The Oxford Handbook of Philosophy of Education*, London: Oxford University Press, 1 edition, 2012, fq. 524-534.

<sup>157</sup> Stuart Parker, *Reflective Teaching In The Postmodern World: A Manifesto of Education in Postmodernity*, Buckingham: Open University Press, 1997, fq. 139-158.

Përpjekjet rreth zhvillimit të pikëpamjeve filozofike nuk janë ndalur. Ka shkrime edhe rreth post postmodernizmit. E gjithë kjo përmes analizimit të realitetit të cilin e ka imponuar teknologjia dhe interneti. Institucionet arsimore obligohen të ndjekin ndryshimet të cilat ndodhin në botë, të cilat studentët, ndoshta i dinë para mësuesve të tyre. Pikëpamjet kritike të postmodernitetit janë emërtuar me disa emra, në mesin e të cilave edhe emri “Digimodernizmi”.<sup>158</sup>

Digimodernizmi ua ka mundësuar studentëve, në veçanti atyre universitar, shfrytëzimin e teknologjisë digjitale për të zhvilluar njohuritë, mendimet, pikëpamjet, përvetësimin e tyre, shndërrimin, diskutimin, zëvendësimin dhe deponimin e tyre... dhe më pas formimin dhe shndërrimin e identitetit dhe shoqërive. Përdorimi i digjitalizimit ka çuar drejt një revolucioni të njohurive, të cilat ndoshta edhe kanë ndryshuar pozitën e universiteteve që cilësoheshin si mbrojtëse dhe referenca tradicionale të njohurive të besueshme.<sup>159</sup>

### 1.5. Filozofia e arsimit për paqe

Disa hulumtues kanë vërejtur nevojën për filozofi pedagogjike që ofron “arsim për paqe”. Kjo filozofi bashkëvepron me divergjencat fetare, racore dhe dallimet në shtresat shoqërore dhe ekonomike. Sidomos në botën e sodit ku ekzistojnë faktorë të shumtë që bëjnë njerëzit të njohin njëri-tjetrin më shumë se çdoherë më parë. Mjetet e informimit dhe komunikimit, udhëtimi dhe turizmi ndërkombëtarë, imigrimi në shtete të ndryshme, misioni fetar e tjera, të gjitha këto faktorë kanë lehtësuar njohjen e njerëzve me fetë tjera, ndryshe nga ajo që e kanë njohur më parë, u kanë mundësuar të përfitojnë eksperiencën të drejtpërdrejtë që u ndihmojnë në njohjen e asaj se si shfaqen bindjet fetare të ndryshme në jetën e pasuesve të tyre, u kanë ofruar atyre të kenë njohuri të hollësishme rreth

<sup>158</sup> Alan Kirby, *Digimodernism: How New Technologies Dismantle the Postmodern and Reconfigure Our Culture*, London & New York: Bloomsbury Academic, 1 edition, 2009.

<sup>159</sup> John Traxler, *Modernity, mobility and the digital divides*, Paper presented at the 15th International Conference of the Association for Learning Technology at University of Leeds, England, with a theme: Rethinking the digital divide, Leeds, UK, 9-11 September 2008, fq. 123-130. Shih linkun: [https://www.researchgate.net/publication/306088626\\_Inclusion\\_in\\_an\\_age\\_of\\_mobility](https://www.researchgate.net/publication/306088626_Inclusion_in_an_age_of_mobility) [accessed Sep 2, 2017].

kuptimit dhe ndikimit të këtyre bindjeve, kështu që diversiteti fetar është bërë realitet në jetën bashkëkohore. Ky realitet, për disa njerëz, konsiderohet burim që kërcënon besimet e tyre, gjë që i ka bërë të hulumtojnë për burime të sigurisë. Për disa tjerë është sfidë që provon nivelin e besimit të tyre ose për të gjetur raporte të reja brenda pluralizmit, mundësinë e bashkëjetesës dhe jetesa në një ambient ku dominon siguria dhe paqja.<sup>160</sup>

### 1.6. Arsimi inter-religjioz

Hulumtuesit e theksuar në paragrafin paraparak, filozofinë pedagogjike të synuar për këtë qëllim e emërtuan me emrin “Bazat filozofike të arsimit inter-religjioz”. Në botën bashkëkohore në të cilën me të shpejtë përhapet dukuria e “globalizmit” është e domosdoshme të kemi arsim të përgjithshëm, si domos në periudhën e shkollimit të mesëm. Këtu do të përfshihen plan-programe ku do të ofrojnë ambient të domosdoshëm për arsimim inter-religjioz, ku njerëzit, pa marrë parasysh besimin e tjerëve, do të respektojnë njëri-tjetrin, dhe kështu do të realizohet qëllimi i arsimit për paqe.<sup>161</sup>

Edhe krahas dominimit të laicizmit në jetën e shumicës së shoqërive në botë, prapëseprapë orientimi fetar në filozofinë pedagogjike vazhdon të jetë prezent në diskutimet që zhvillohen rreth filozofive pedagogjike. Bile, -te disa hulumtues dhe mendimtarë në nivel akademik universitar, qendrave për hulumtim, studimeve të vendeve dhe studimeve politiko-shoqërore- ekziston një ndjenjë e rritur për nevojën e studimit të llojit arsimor fetar që shoqëritë e ndryshme ua ofrojnë nxënësve. Një libër bashkëkohor u mor enkas me këtë çështje, duke analizuar realitetin e arsimit fetar në 53 shtete të botës. Në libër paraqiten tre modele të prezencës fetare në plan-programet arsimore. Shtetet me tradita të forta fetare koncentrohen në fenë e shumicës së banorëve dhe merren me formimin e identitetit fetar të shoqërisë, duke mos u interesuar për

<sup>160</sup> Kathleen Engebreston, & Marian De Souza, & Gloria Durka, & Liam Gearon, (Editors), *International Handbook of Inter-religious Education*, London & New York: Springer, 2010, fq. 6.

<sup>161</sup> *Ibid.*, fq. 50.

fetë tjera. Shtetet që ndajnë fenë nga shteti pranojnë modelin e ndarjes që njohin fenë shumë pak, duke e lënë çështjen fetare në duart e institucioneve fetare dhe familjes, në këtë rast bëhet njoftim i thjeshtë për fetë ekzistuese në shoqëri. Lloji i tretë i shteteve nuk mësojnë një fe, as nuk mësojnë për shumicën e feve, por lejojnë arsimim rreth një numri të vogël të traditave fetare.<sup>162</sup>

Prezenca e fesë me të madhe në bisedat e politikave pedagogjike në botë, ka imponuar rishikimin e të kuptuarit të raporteve mes fesë dhe laicizmit. Letërsia e cila shprehë këtë ndjenjë është e shumtë. Sa për ilustrim potencojmë se së voni është botuar një libër, në të cilin kanë marrë pjesë një grup i mendimtarëve nga specializime akademike të ndryshme si: histori, filozofi, shkencat politike, sociologji etj.<sup>163</sup> Autorët kanë vërejtur një rizgjim fetar në jetën e përgjithshme, që ua imponon mendimtarëve rishikimin, jo vetëm rreth kuptimit dominues të laicizmit, por edhe njohjen me përmbajtjet e laicizmit dhe qëndrimin e laikëve, për të rishikuar kuptimin e çështjeve që ndërliidhen me fenë dhe laicizmin.

## 2. Referencat perëndimore të pedagogjisë

Udhëtimi ynë ideologjik na ka zbuluar disa dukuri, të cilat syri i inteligjentit nuk mund mos t'i vërejë. Këtu do të theksojmë vetëm dy dukuri: dukuria e “paragjykimit ideologjik” dhe dukuria e “pasigurisë pedagogjike”.

### 2.1. Dukuria e “paragjykimit ideologjik perëndimor”

Paragjykimi përfshin një problem, i cili nuk kufizohet vetëm në pikëpamjet e perëndimorëve ndaj tjerëve, por depërton thellë në realitetin e vetë shoqërisë perëndimore. Vlen të theksohet se një shoqatë amerikane për hulumtime, në vitin 2016 ka themeluar një revistë të specializuar rreth çështjeve të

<sup>162</sup> Derek Davis & Elena Miroshnikova (Editorë), *The Routledge International Handbook of Religious Education*, London: Routledge, 2013.

<sup>163</sup> Craig Calhoun & Mark Juergensmeyer & Jonathan BanAntwerpan, (Editorë), *Rethinking Secularism*, London: Oxford University Press, 1 edition, 12 gusht, 2011.

paragjykimeve, identitetit dhe diversitetit në arsim. E gjithë kjo, në emër të revistës ndërkombëtare për paragjykim, identitet dhe diversitetit në arsim.<sup>164</sup> Kjo revistë është gjysmë-vjetore, të cilën e boton një shoqatë amerikane në shtetin e Pensilvanisë. Kjo shoqatë është për menaxhim të resurseve të informacioneve.<sup>165</sup>

Abdulvehab Mesiri ka propozuar themelimin e një dege shkencore të specializuar me emrin “fikh’ut-tehajuz” (fikhu i paragjykimeve) duke thënë: “Paragjykimi është i pashmangshëm, por nuk është çështje përfundimtare. Është i pashmangshëm ngase nuk mund të tejkalohet, por nuk është përfundimtar. Përfundimtar është humaniteti i përbashkët (vlerat morale), që i paraprijnë çdo diversiteti apo paragjykimi”.<sup>166</sup> Mesiri ka theksuar disa shembuj rreth paragjykimeve të civilizimit perëndimor në jetën arabe dhe dominimin ndaj tyre.<sup>167</sup>

-Në të gjitha rastet-, paragjykimi ndërlidhet me mendjen e njeriut dhe mënyrën e tij në kuptimin e çështjeve. Procesi i kuptimit nuk është i rastësishëm. Paragjykimet kanë mundësi të sqarojnë dështimin e individit gjatë meditimit në alternativat e mundshme. Ka mendime të caktuara të cilat udhëheqin procesin e të menduarit në një mënyrë decisive.<sup>168</sup>

Perëndimi, përfshirë Evropën dhe Amerikën, në botën bashkëkohore, është burim i pjesës dërmuese të orientimeve filozofike pedagogjike. Shumica e këtyre orientimeve marrin nga filozofia pozitiviste, në format e ndryshme: racionale, shkencore, laike, humane, kritike, pragmatike etj. Perëndimi sot posedon institucione për presion dhe dominim politik dhe ekonomik, përfshirë këtu edhe institucionet e Kombeve të Bashkuara. E gjithë kjo mundëson që filozofia pozitiviste perëndimore me të gjitha rrymat e saj ideologjike dhe shtrirjet e saj pedagogjike, të përhapet dhe të rrënjoset edhe më

<sup>164</sup> *International Journal of Bias, Identity and Diversity in Education (IJBIDE)*.

<sup>165</sup> *Information Resources Management Association*.

<sup>166</sup> Abdulvehab El-Mesiri, *Fikh’ut-tehajuzi fi kitabi ishkalijjet’it-tehajuzi*, Hernden: IIMI, 1995, vëll. 1, fq. 21.

<sup>167</sup> Po aty, fq. 27-70.

<sup>168</sup> Jonathan Baron, *Thinking and Deciding*, London & New York: Cambridge University Press, 2007, fq. 137.

shumë. E gjithë kjo krahas asaj që mendimi pedagogjik përrëndimor ka paragjykime të qarta.<sup>169</sup>

Edhe në mesin e vet përrëndimorëve ka hulumtues që kanë vërejtur dukurinë e “paragjykimeve në mendimin përrëndimorë” në përgjithësi, duke theksuar disa nga këto paragjykime.<sup>170</sup> Në mesin e këtyre, kemi edhe shkrimin e një hulumtuesi me titull: Paragjykimi përrëndimor në revistat e psikologjisë pedagogjike. Publikimi është në webfaqen elektronike të Fakultetit Pedagogjik në Universitetin Minesota të Amerikës. Adresa e webfaqes: CEHD Vision 2020, që nënkupton Fakulteti Pedagogjik, zhvillimi njerëzor vizioni 2020. Hulumtuesi ka bërë hulumtime rreth publikimeve në tre revista më të njohura ndërkombëtare në fushën e psikologjisë pedagogjike. Aty ka gjetur paragjykime shqetësuese në studimet përrëndimore. Ai ka vërejtur se ajo që gjendet në këto studime përshtatet vetëm për botën përrëndimore. Ai ka theksuar disa shembuj rreth paragjykimeve që rrezikojnë besueshmërinë e rezultateve të hulumtimit, dyshimin e mundësisë së rishikimit të hulumtimit ose përgjithësimin e rezultateve.<sup>171</sup>

Sistemet pedagogjike dominuese në shtetet e botës arabe dhe islame, që nga fillimi ishin zgjatje e sistemeve pedagogjike përrëndimore. Këto sisteme kanë paragjykime ndaj nevojave dhe interesave të këtyre shteteve. E gjithë kjo përfshihet në plan-programet e arsimit publik, arsimit deridiplomik, politikave arsimore, sistemet e vlerësimit dhe miratimit, metodologjinë e hulumtimeve pedagogjike etj. Këto programe dhe sisteme kanë mbështetje të madhe nga Përrëndimi, ngase konsiderohen mjet elementar për dominim ideologjik në arsim. Sa i përket prodhimit të sistemeve të arsimit, ato thellojnë: shtrembërimin zhvillimor, të qenët konsumatorë, pasimin

<sup>169</sup> Fet'hi Melkavi, “Et-Tehajjuzu fil-fikr’it-terbevijj’il-garbijji”, Revista Islamizimi i diturive, nr. (37-38), 2004, fq. 181-202.

<sup>170</sup> Michael A. Peters, *The Humanist Bias in Western Philosophy and Education*, *Educational Philosophy and Theory*, Vol. 47, Iss. 11, 2015, fq. 1128-1135.

<sup>171</sup> Steve Yussen, *The publication Gap: Western Bias*, *Educational Psychology Journal*, College of Education and Human Development (CE-HD VISION 2020 BLOG), Posted Apr 22, 2016. Shih linkun:

- <https://cehdvision2020.umn.edu/blog/western-bias-educational-psychology/>.

- <https://glasgowguardian.co.uk/2016/09/21/western-bias-in-education/>.

ekonomik, dallimin në shtresa shoqërore dhe tëhuajësimin e gjeneratave të reja nga kultura dhe identiteti i tyre.<sup>172</sup>

Duhet theksuar se biseda rreth paragjyqimit në mendimin pedagogjik perëndimor nuk nënkupton ftesë për bojkotim ideologjik me Perëndimin në sferën e reformave pedagogjike. Kjo është ftesë për formimin e një vizioni të përgjithshëm rreth mendimit pedagogjik perëndimor, që u mundëson pedagogëve muslimanë të jenë të vetëdijshëm rreth veçorive të këtij mendimi dhe të zhvillojnë një metodologji të përshtatshme për bashkëveprim me ata.<sup>173</sup>

## 2.2. Dukuria e “pasigurisë pedagogjike”:

Në gjysmën e dytë e shekullit XX ka pasur kritika të shumta ndaj filozofive pedagogjike që kanë dominuar në botën perëndimore, praktikata e të cilave janë shtrirë në shumicën e vendeve të botës. Këto kritika janë mbështetur edhe nga disa orientime ideologjike dhe pedagogjike të cilat janë koncentruar në problemet të cilat i ka sjellë modernizmi perëndimor, si p.sh.: rritja e dallimeve mes shoqërive, rritja e kujdesit më shumë për çështjet se sa për njeriun, orientimi i pedagogjisë për të qenë në shërbim të shoqërisë kapitaliste dhe institucioneve të saj të egra etj.

Autorët e librit “E ardhmja e institucioneve arsimore në kohën e digjitalizimit”<sup>174</sup> kanë vërejtur se sistemet momentale të arsimit të rregullt kanë mbetur të ngjashme ashtu siç kanë qenë gjatë dy shekujve të kaluar, duke potencuar se sistemet arsimore shumë ngadalë ndryshojnë. Në dy dekadat, pra në vitet e gjashtëdhjeta dhe shtatëdhjeta të shekullit XX janë shfaqur zhvillime të shumta në qëllimet dhe metodat e arsimit,<sup>175</sup> që jepen shenjë se do të ndodhin ndryshime rrënjësore në realitetin arsimor dhe institucionet e tij, përfshirë këtu

<sup>172</sup> Ali, Seid Ismail, “*Ishkalijet’ut-tehajuzi fi’t-ta’limi*”, në: *Ishkalijet’ut-tehajuzi, ru’jetun ma’rifijetun ve davijetun li’l-ixhtihadi*, Hernden, Virxhinija: IIMI, botimi 2, 1997, fq. 439-470.

<sup>173</sup> Melkavi, “*Et-Tehajuz fi’l-fikr’it-terbevijj’il-garbijji*”, vepra e cituar, fq. 181-202.

<sup>174</sup> C.N. Davidson, & D. T. Goldberg, *The Future of Learning Institutions in the Digital Age*, Cambridge, MA: MIT Press (MacArthur Foundation Report on digital Media and Learning), 2010.

<sup>175</sup> Autori i këtij libri në periudhën 1966-1978 ka punuar në fushën e arsimit shkollor, trajnimin e mësimit nënësve dhe përgatitjen e programeve shkollorë në kuadër të Ministrisë së Arsimit. Më pas ka punuar në arsimin universitar në sferën e përgatitjes së mësimit nënësve deri në vitin 1996.



edhe zhdukjen e klasave shkollore dhe vetë shkollave.<sup>176</sup> Megjithatë, shkollat dhe klasat e tyre mbetën stoike, edhe krahas ndryshimeve të mëdha që i goditën sistemet e jetës shoqërore në industri, teknologji, administratë etj.

Edhe krahas ndryshimeve dhe inovacioneve të shumta që ndodhën në arsimin perëndimor në shekullin e XX, megjithatë ka dominuar një sistem arsimor tradicional që u përballoi sfidave të kohës, derisa disa shoqëri ndjenin se arsimit nuk ka nevojë të ndryshohet, përpos me disa ndërhyrje zbukuruese kohë pas kohe. Mirëpo, në gjysmën e dytë e shekullit XX pati kritika të ashpra ndaj këtij sistemi dhe prodhimeve të tij, derisa arriti në atë nivel të dyshohet në vlerën e institucioneve. Kemi vërejtur gjenerata të reja që kanë ngritur zërin në protesta kundër modeleve pedagogjike dhe llojeve të institucioneve të imponuara.<sup>177</sup>

Duke sqaruar pasigurinë pedagogjike në mendimin perëndimor, edhe pas hyrjes në shekullin XXI, do të sjellim një shembull rreth projekteve të ndryshimit pedagogjik në botën perëndimore. Kah fundi i viteve të nëntëdhjeta të shekullit XX, u publikua libri "Udhërrëfyesi ndërkombëtar për ndryshime pedagogjike" në dy vëllime të mëdha me gjithsej 1365 faqe. Në përpilimin e këtij libri kanë marrë pjesë 80 hulumtues nga vende të ndryshme të botës.<sup>178</sup> Katër redaktorët e librit kanë vërejtur se në periudhën e fundit të shekullit XX ka pasur interesim të madh rreth realitetit të arsimit dhe domosdoshmërinë e ndryshimeve, derisa ndryshimet pedagogjike ishin ofruar në programet e politikave kombëtare, jo vetëm si prioritet në nivel të politikave, por në lajmet e përgjithshme kryesore.

Pas sqarimit që bëhet në parathënien e këtij libri referues për sferat e përpjekjeve të ndryshimeve pedagogjike në shumë prej vendeve të botës, potencohet se rezultatet e këtyre

<sup>176</sup> - Paul Goodman, *Compulsory Miseducation*, Harmandsworth & New York: Penguin Education specials, 1964.

- Ivan Illich, *Deschooling Society*. London: Penguin Education/ Penguin Books, 1973.

<sup>177</sup> Edgar Faure, *Learning to be: The world of education today and tomorrow*, Paris: Unesco, (First edition was in 1972), Seventh impression, gusht 1982, fq. xix.

<sup>178</sup> Andy Hargreaves, & Ann Lieberman, & Michael Fullan, & David Hopkins, *International Handbook of Educational Change*, (2 Volumes), London: Kluwer Academic Publishers, Springer, 1998.

përpyekjeve kanë përfunduar në një gjendje ku mësimdhënësit dhe administratorët që veprojnë në fushën pedagogjike të ndjejnë se sistemet me të cilat veprojnë, jo vetëm që janë të ndërlikuara, por përkeqësohen në formë të pakontrolluar, dhe se ky pakontrollim është çështje e trashëguar në shoqëritë dhe organizatat në të cilat shpërndahen informacionet dhe merren vendimet me shpejtësi. Po ashtu, këto janë rezultat i politikave që formohen dhe ndryshojnë vazhdimisht nga grupe me interesa të kundërta dhe konflikte ideologjike që kanë për qëllim përfitimin e mendjeve të të rinjve. Në disa raste edhe si rezultat i “pasigurisë artificiale” të cilën e prodhojnë disa qeveri për të shkaktuar frikë, arsyetim për ndërhyrje dhe mbajtjen e pedagogëve dhe të tjerëve në gjendje jostabile dhe jo të baraspeshuar.

Vlen të theksohet se ndryshimet e vërteta gjatë tre dekadave të fundit të shekullit XX ishin të rralla dhe nuk kishin ndikim të vërtetë as nuk kishin trajtuar esencën e çështjeve të cilën e mendonin mësimdhënësit. Ato ishin të kufizuara në çështje formale si: radhitja e temave mësimore, niveli i arritjes së nxënësve në shkolla të ndryshme, shpërndarja e nxënësve brenda shkollës në bazë të aftësisë, gjinisë dhe etnitetit. Ndryshimet të cilat po ndodhin në fillim të shekullit XXI, vazhdojnë mësimdhënësve t’u sjellim shqetësim.

Në dritën e gjithë kësaj, redaktorët e librit kanë prezantuar “një grup të teorive dhe strategjive për ndryshim pedagogjik, të cilat mund të ndihmojnë për bashkëveprim me këtë ambient të ndërlikuar dhe të përmbushur me kontradikta dhe çrregullime”.<sup>179</sup>

Pas dhjetë viteve nga publikimi i librit, redaktorët sjellin një libër tjetër me të njëjtën tematikë. Edhe ky libër ishte po ashtu voluminoz, ngjashëm me të parin, në numrin e faqeve (1077 faqe), tematikat që trajtonte, numrin e hulumtuesve pjesëmarrës në përgatitjen e kapitujve dhe temave dhe përfaqësimin e shumë vendeve të botës.<sup>180</sup> Ky libri i dytë përfshinte

<sup>179</sup> Ibid., fq. 1-5.

<sup>180</sup> Andy Hargreaves & Ann Lieberman & Michael Fullan & David Hopkins, *Second International Handbook of Educational Change*, (Springer International Handbooks of Education), Dordrecht Heidelberg London New York: Springer Science+Business Media B.V., 2010.

hetimin e ndryshimit pedagogjik që kishte ndodhur në dhjetë vitet e para të shekullit XXI. Redaktorët kishin përfunduar se ndryshimi pedagogjik, strategjitë reformuese dhe orientimet e hulumtimit ishin më voluminoze, më të shtrënguara, më të komplikuar dhe më lajkatare.

Duke sqaruar këto katër veçori, redaktorët, në parathënien e librit, tregojnë frustrimin i cili vije si rezultat i dështimit në shpërndarjen e rezultateve të ndryshimit, dobësimin në rregullimin e procedurave përmes sistemit arsimor dhe koha e shkurtër për zbatim që nuk mund të shfaqen rezultatet. Ata kanë sqaruar se përpjekjet për ndryshim pedagogjik në dekadën e parë të shekullit XXI janë mbështetur në dokumente, numra dhe statistikat e testimeve, të cilat e kanë lënë anash eksperiencën dhe fuqinë për meditim dhe vendim të shëndoshë. Edhe pse këto dokumente “të forta”, mësimdhënësve u kanë ofruar dobi për të njohur nxënësit dhe grupet që kanë nevojë për ndihmë më shumë se tjerët, megjithatë entuziazmi për arsimim dhe përmirësim në bazë të këtij themeli ka nxjerrë disa rreziqe dhe negativitete. Kështu, qëllimet pedagogjike që kanë dalë si rezultat i bazuar në këtë arsimim nuk janë të përshtatshme me qëllimet e shoqërisë së synuar, as nuk realizojnë qëllime më të rëndësishme të cilat dallohen me cilësi të lartë dhe praktika kreative. Sa i përket mundit të harxhuar përmes novacioneve dhe ndryshimeve pedagogjike, ata janë marrë shumë me zvogëlimin e boshllëqeve mes grupeve të nxënësve dhe shkollave.

Shumica e programeve për ndryshim janë mbështetur në kontrollin administrativ qendror, i cili vije nga lartë, me kushte, cilësi dhe modele për vlerësim, të cilat kërkojnë ndryshim të shpejtë që ndoshta ndikimi nuk është i vazhdueshëm dhe orienton aktivitetet arsimore për të qenë në shërbim të testimeve. E gjithë kjo duke qenë në dijeni se rezultatet e vazhdueshme mund të jenë të sigurta vetëm nga zhvillimi i vërtetë pedagogjik i cili realizohet me iniciativa dhe mund empirik.

Këto orientime qendrore për reformime pedagogjike në Britani kanë tërhequr nga plan-programet mësimore

kreativitetin dhe nevojat elementare të zbulimit dhe zhvillimit të fëmijët, duke orientuar energjinë e mësimeve drejt testimeve qeveritare, deri në atë nivel sa që organi i veçantë shqyrtues pranë qeverisë së Britanisë ka theksuar të njëjtat rezultate.<sup>181</sup>

Dukuria e “pasigurisë pedagogjike” është përsëritur në shumë shkrime, në veçanti në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Një hulumtues ka theksuar vërejtjet e tij rreth strategjive të reformimit arsimor, të cilat kanë ardhur në forma të vazhdueshme në shkollat amerikane, dhe atë gjatë katërdhjetë viteve të kaluara. Megjithatë, shumë pak prej tyre kanë thyer barrierat e sistemit dhe kanë ndikuar në mënyrë të thelluar. E gjithë kjo në kohë, kur raportet e vazhdueshme zbulojnë gjendjen shqetësuese dhe problemet e mëdha në shkollat amerikane. Dallimet që shpesh në ironi rreth çështjeve të reformimit në shkolla janë të shumta, së paku duke shikuar çështjen nga këndvështrimi ndërkombëtar. E gjithë kjo kërkon parashtrimin e pyetjeve rreth strategjive efikase për reforma dhe nënshtrimin e këtyre strategjive ndaj rrethanave politike, kulturore, institucionale dhe individuale.<sup>182</sup>

“Viteve të gjashtëdhjeta dhe shtatëdhjeta mendonim se kemi disa përgjigje rreth strategjive të reformimit praktik. Më vonë u bë e qartë se këto strategji janë mendime dhe eksperimente të pjesshme me rezultate të kufizuara. Në vitet e tetëdhjeta, në shumicën e shteteve të botës dominoi një orientim më i përgjithshëm për reforma në arsimin shkollor. Në të shumtën rasteve, përfshinte pjesëmarrjen e fuqishme të shtetit me përpjekje për të realizuar decentralizimin në marrjen e vendimeve. Mësimi i nxjerrë nga vitet e tetëdhjeta ishte se ristrukturimi, më shumë ishte ëndërr se sa realitet. Sa i përket përpjekjeve për reformim të arsimit në vitet e nëntëdhjeta,

<sup>181</sup> Andy Hargreaves, & nn. Lieberman & Michael Fullan & David Hopkins, *Second International Handbook of Educational Change* (Springer International Handbooks of Education), Dordrecht Heidelberg London New York: Springer Science+Business Media B.V., 2010, Volume one, fq. xii-xviii.

<sup>182</sup> PER. DALIN, *Developing the Twenty-First Century School: A Challenge to Reformers* në: Hopkins David, (Ed.), *The Practice and Theory of School Improvement* (Handbook of Educational Change) Dordrecht The Netherlands: Springer Academic Publishers, 2005, fq. 25-39.

është bërë e qartë se realisht kjo sferë është sferë me dyer të hapura”.<sup>183</sup>

Organizata UNESCO është kujdesur për çështjen e arsimit në botë. Studimin e gjendjes reale të edukimit dhe arsimimit në shtetet e botës ia ka besuar disa komisioneve, të cilat kanë nxjerrë një grup të dokumenteve dhe raporteve të cilat zbulojnë të metat e shumta në normat e arsimit që dominojnë në botë, si dhe mendimin pedagogjik që udhëheqin këto norma. E gjithë kjo përforcon dukurinë e “pasigurisë” në praktikat pedagogjike në anët e botës. Në raportin e vitit 1972 të UNESCO-s rreth arsimit, redaktorët e raportit kanë shprehur befasinë e tyre kur kanë kuptuar se problemet e arsimit, si: dështimi në realizimin e qëllimeve dhe përshtatja e gabueshme e nxënësve, nuk përfshin vetëm shtetet në zhvillim. Në pikëpamje arsimore nënkuptohet se arsimit në vendet e ashtuquajtura “shtete të përparuara” përballet në mënyrë të befasueshme me një gjendje të prapambetur. Përshtatshmëria e gabueshme dhe dështimi në këto vende, së paku relativisht, janë simptoma dalluese të nxënësve siç janë të gjithë njerëzit. Kjo gjendje është e ngjashme me atë që gjenden në vendet e okupuara më herët. Nxënësit në këto vende janë prodhim i arsimit sipas modelit perëndimor, të cilin në mënyrë të detajuar, e kanë importuar këto vende”.<sup>184</sup>

Prej dokumenteve të UNESCO-s është edhe ai i vitit 2015, i cili bartë titullin: “Rishikimi në edukim dhe arsimim: drejt një çështje të përbashkët ndërkombëtare”.<sup>185</sup> Ky dokument mbështet vizionin e UNESCO-s që e ka paraqitur të botuar në dy vepra: “Mëso që të jesh: bota e arsimit sot dhe nesër- raport i Fo” (1972) dhe “Arsimimi: thesari i fshehur- raport i Delor” (1996)!

Çështja epiqendër në këtë dokument është koncepti “zhvillimi i vazhdueshëm”, i cili nuk është realizuar përmes praktikave të drejtimit ekonomik dhe drejtimit pragmatik. Këto dy drejtime, nuk kanë ndaluar rritjen e “dobësisë së gjend-

<sup>183</sup> Ibid., fq. 26.

<sup>184</sup> Edgar Faure, *Learning to be: The world of education today and tomorrow*, Paris: Unesco, (First edition was in 1972). Seventh impression, gusht 1982, xxviii.

<sup>185</sup> UNESCO. *Iadet'ut-tefikiri fi't-terbijjeti ve't-ta'limi: nahve salihin mushterekin alemijjin*, Paris: UNESCO, 2015.

jes, pabarazisë, robërimit, dhunës në botë brenda një shoqërie dhe mes shoqërive". E gjithë kjo ka bërë që komisioni, i cili ka përgatitur raportin të vërtetojë se "rishikimi i qëllimeve të edukimit dhe arsimimit dhe organizimi i të mësuarit është e nevojshme këtyre ditëve më shumë se në çdo kohë më parë.... nevojë e rritur për të bërë pajtimin mes tri elementeve të sjelljes shoqërore: shoqëria, shteti dhe tregu". Për këtë, dokumenti i lartëcituar kërkon tejkalimin e dy drejtimeve: atë pragmatik dhe ekonomik të ngushta dhe propozon "orientim të përgjithshëm human, që mundet dhe duhet të kontribuojë në realizimin e modelit të ri zhvillimor..... që ngrit vlerën e njerëzve, ku shpeshherë ndaj tyre zbatohen dallime, siç janë: gratë, vajzat, banorët autoktonë, personat me nevoja të veçanta, emigrantët, pleqtë dhe banorët rezidentë në shtetet që janë në gjendje konflikti".<sup>186</sup>

## Përmbyllje

Shpresojmë që ky kapitull me tre nënkapitujt e tij të kishte ofruar një pasqyrë të përgjithshme rreth asaj që përfshin titulli i kapitullit rreth konceptit të "mendimit pedagogjik", pozitën e konceptit në konceptet tjera që kanë lidhje mes veti, zhvillimin historik të këtij koncepti, përmbajtjen, lidhshmërinë me filozofitë dhe teoritë pedagogjike dhe pozita e gjithë kësaj në mendimin pedagogjik islam.

Tema e parë në këtë kapitull ka bërë dallimin mes konceptit "mendimi pedagogjik" dhe konceptit "trashëgimia pedagogjike", si dhe mes teorisë pedagogjike dhe filozofitë pedagogjike. Ka ofruar një pasqyrë rreth prezencës së mendimit pedagogjik në shkrimet e reja dhe bashkëkohore në gjuhën arabe, dhe në disa gjuhë të tjera, në veçanti në gjuhën angleze dhe gjuhët e popujve islamë. Më pas ka sqaruar pozitën e mendimit pedagogjik islam në përpjekjet e ngritjes civilizuese të umetit musliman, si dhe sulmet që iu janë bërë dhe vazhdojnë t'i bëhen që nga fillimi i shekullit XXI.

<sup>186</sup> Po aty, fq. 9-10.

Mendimin pedagogjik islam të cilin e synojnë shkrytarët në përgjithësi është një sferë e veçantë e sferës së përgjithshme, e që është mendimi pedagogjik njerëzor. Për këtë, e pamë të arsyeshme të veçojmë një temë të detajuar relativisht rreth zhvillimit të mendimit pedagogjik në civilizimet e vjetra njerëzore si në Egjipt, Irak, Kinë, Greqi, dhe prezencën e tij në kontekstin fetar hebraik dhe të krishterë, si dhe në historinë e mesme dhe të re evropiane. Paraqitëm shembuj të mendimtarëve të periudhës së renesancës evropiane. Në fund, dhëm disa informacione rreth drejtimeve dhe orientimeve filozofike tradicionale në mendimin pedagogjik të kohës së re.

Pasi nënkapitulli i dytë ka ndjekur disa stacione të zhvillimit të mendimit pedagogjik njerëzor në kontekst historik, na mbetet të flasim për mendimin pedagogjik njerëzor bashkëkohor, filozofitë që e gjykojnë dhe referencat perëndimore të këtyre filozofive. Kjo ishte përmbajtja e nënkapitullit të tretë në këtë kapitull.

Qëllimi ynë nga ky detajim në këtë kapitull ishte të përgatisim rrugën për kapitujt e tjerë të këtij libri, ku do të përfshihet në mënyrë të veçantë mendimi pedagogjik islam në kontekstin historik. Për këtë, kapitulli i dytë do të flet rreth trashëgimisë pedagogjike islame. Më pas do të përfshihen burimet, qëllimet, tematikat dhe veçoritë e pedagogjisë islame në katër kapitujt që pasojnë. Në kapitullin e shtatë do të përmbysim librin me bisedën rreth realitetit të mendimit pedagogjik bashkëkohor islam dhe mënyrat e ngritjes së tij.

Mendojmë se prezantimi i kapitullit të parë në këtë formë do të jetë e dobishme për pozitën e mendimit pedagogjik islam në arritjet e civilizimit njerëzor në kontekstin historik dhe bashkëkohor. Muslimanët gjatë historisë kanë dhënë një kontribut të madh në zhvillimin e mendimit pedagogjik. Po ashtu mendojmë se rikonstruktimi i mendimit pedagogjik islam në dritën e sfidave aktuale, do të jetë mjet për kthimin e prezencës së muslimanëve në arenën e botës bashkëkohore, jo vetëm për atë se mendimi pedagogjik islam është mjet vetëm për formimin e gjeneratave të umetit islam, por edhe për

atë se ky mendim është më i përshtatshëm për të qenë mendim pedagogjik botëror.



## KAPITULLI I DYTË TRASHËGIMIA PEDAGOGJIKE ISLAME

### *Parathënie*

*Pjesa e parë: Koncepti “et-turath – trashëgimi”, zhvillimi, tematikat dhe institucionet e saj*

Koncepti “trashëgimia pedagogjike”

Polemikat e vjetra dhe të reja rreth trashëgimisë pedagogjike islame

*Pjesa e dytë: Disa të dhëna rreth zhvillimit të trashëgimisë pedagogjike islame*

Zhvillimi në shkencën e tefsirit

Zhvillimi në përgjegjësitë arsimore

Zhvillimi në pozitën e mësuesit dhe profesionin e mësimdhënies

Zhvillimi në raportin e dijetarëve me pushtetarët

Zhvillimi në marrjen e pagës për mësimdhënie

Zhvillimi në institucionet arsimore

Zhvillimi në orientimet dhe shkollat ideologjike në trashëgiminë e pedagogjisë islame

*Pjesa e tretë: Mendimtarët pedagogë të trashëgimisë pedagogjike, veprat dhe shkollat e tyre*

Mendimtarët pedagogë dhe veprat e tyre

Shkollat e trashëgimisë pedagogjike

*Pjesa e katërt: Literatura e trashëgimisë pedagogjike islame në shkrimet bashkëkohore*

Përpyekjet e përbashkëta hulumtuese

Disertacionet pedagogjike universitare

Trashëgimia pedagogjike në revistat periodike

Trashëgimia pedagogjike islame në librat e publikuara

*Përmbyllje*

# **KAPITULLI I DYTË**

## TRASHËGIMIA PEDAGOGJIKE ISLAME



## Parathënie

Kur bisedojmë rreth “Trashëgimisë pedagogjike islame” në një libër rreth “Mendimit pedagogjik islam”, me këtë, ne nënvizojmë rëndësinë e trashëgimisë në zhvillimin e mendimit bashkëkohor. Mendimin të cilin e synojmë është më i gjerë dhe më gjithëpërfshirës se trashëgimia. Trashëgimia është burim i mendimit, i cili është eksperiencë njerëzore e formuar nga përpjekjet e dijetarëve musliman në teori dhe praktikë. Pozita e trashëgimisë përcaktohet vetëm pas hulumtimit në tre burimet tjera: Kur’ani, suneti pejgamberik dhe përvoja njerëzore bashkëkohore. Kur’ani dhe suneti pejgamberik janë referencat të cilat gjykojnë vlerësimin tonë ndaj trashëgimisë dhe eksperiencës njerëzore bashkëkohore. Eksperienca njerëzore në të kaluarën (trashëgimia) dhe eksperienca njerëzore bashkëkohore janë dy burime të rëndësishme për të kuptuar intencat e Kur’anit dhe sunetit pejgamberik. Prej këtu, vërejmë një përplotësim mes këtyre katër burimeve: Kur’ani Famëlartë, suneti pejgamberik, trashëgimia islame dhe eksperienca njerëzore bashkëkohore.

Andaj, është e dobishme të përkujtojmë këtë dallim mes trashëgimisë pedagogjike në të kaluarën dhe mendimit pedagogjik bashkëkohor, në veçanti kur vërejmë se shumë prej librave të cilat janë shkruar me titull: “Mendimi pedagogjik islam”, në realitet kanë qenë rreth trashëgimisë pedagogjike islame.

Nëse trashëgimia pedagogjike islame është temë hulumtimi dhe vlerësimi në dritën e Kur’anit dhe sunetit pejgamberik, atëherë është e një rëndësie të veçantë ta hulumtojmë atë në mënyrë objektive, pa ia humbur vlerën e merituar, as pa i dhënë më shumë se sa meriton. Kjo trashëgimi në kohën e saj ka qenë mendim pedagogjik, dhe nuk është doemos që vlera e saj në kohën e saj të jetë e barabartë me vlerën e saj në kohën tonë. Kemi vërejtur se shumë studime bashkëkohore rreth trashëgimisë nuk kanë qenë vlerësime objektive, as gja-

të sqarimit të vlerës për kohën e saj, e as gjatë sqarimit të vlerës për kohën tonë, por në shumicën e rasteve kanë ngritur dhe kanë madhëruar vlerën e saj dhe e kanë krahasuar (ose përfruar) me mendimet dhe praktikatat e kohës sonë.

Trashëgimia pedagogjike islame përfshin përpjekjet e dijetarëve të umetit islam gjatë tërë historisë dhe në të gjitha trojet islame. Trashëgimia shpreh përpjekjet e këtyre dijetarëve në kuptimin e intencave të islamit nga tekstet bazë në Kur'an dhe sunetin pejgamberik dhe dokumentimin e praktikave të shoqërisë islame në fushën e mësimnxënies, mësimdhënies, edukimit dhe këshillimit në dritën e përpjekjeve për të kuptuar këto tekste dhe për t'i zbritur ato në jetën reale në kohë dhe vend. Edhe pse trashëgimia islame -në shumë prej temave, si fikhut, tefsirit, hadithit, poezisë, letërsisë, gjuhës, historisë, tesavufit- është shkruar që të jenë tema për arsimim, por në kuptimin e trashëgimisë pedagogjike do ta përkufizojmë vetëm në disa shkrime të caktuar që përfshijnë temat si: rregullat e kërkimit të diturisë, rregullat e dijetarit dhe nxënësit. Shkrime që përfshijnë përmbajtje si: vlera e diturisë dhe mësimi, pozita e mësimdhënësit, metodat e mësimdhënies, institucionet arsimore, arsimimi i fëmijëve, mësimi i Kur'anit, shkrime që janë të përafërta me disa tema bashkëkohore të cilat ndërlidhen temat pedagogjike me temat psikologjike p.sh. psikologji pedagogjike, teoria e arsimit, motivet e mësimi dhe ndikimi me personalitetin. E gjithë kjo, qoftë në libra që bartin tituj si këto apo janë tituj të kapitujve në librat e fikhut, historisë, letërsisë, tesavufit, filozofisë etj.

Trashëgimia pedagogjike islame është e ngjashme me gjitha sferat e trashëgimisë islame. Jo vetëm trashëgimia e shekullit të parë hixhri, as trashëgimia e tre shekujve të parë hixhri, por trashëgimi që përfshin një periudhë prej më shumë se trembëdhjetë shekuj. Pastaj, nuk është trashëgimi që përfshin vetëm mësimin e Kur'anit, fikhut dhe dispozitat e sheriatit, por përveç kësaj përfshin gjitha llojet tjera të mësimi të cilat i kanë zbatuar shoqëritë islame, përfshirë gjuhën, letërsinë, astronominë, mjekësinë etj. E gjithë kjo krahas profesioneve të bujqësisë, industrisë, ndërtimitarisë, arteve të luftës etj.

Edhe pse hulumtimi në trashëgiminë pedagogjike islame ka një pozicion të rëndësishëm në studimet shkencore akademike, në programet studimore dhe hulumtimet shkencore, ngase është temë që ndihmon në zhvillimin historik dhe ndihmon në përforcimin e identitetit kombëtar dhe fetar, megjithatë interesimi ynë në këtë libër synon që kjo trashëgimi, krahas burimeve tjera, të jetë burim për të cilin kemi nevojë për formimin e mendimit pedagogjik islam bashkëkohor. Kështu do të tejkalohet trashëgimia, dhe për realizimin e intencave islame do të merret drejtpërdrejtë nga tekstet bazë nga Kur'ani dhe suneti peygamberik, si dhe do të merren parasysh kuptimet e dijetarëve islam ndaj këtyre intencave. Këto kuptime gjenden në trashëgiminë islame. E gjithë kjo krahas bashkëveprimit të drejtë me përvojën njerëzore bashkëkohore, duke bërë analiza kritike me qëllim të përfitimit të urtësive dhe duke synuar formimin e modeleve që cilësohen si origjinale dhe kreative dhe shpijnë drejt zhvillimit të realitetit aktual dhe parashikimet për të ardhmen.

Umeti islam ka jetuar në një sipërfaqe bukur të madhe, duke përfshirë popuj, etnitete dhe gjuhë të ndryshme, llojllojshmëri në mbretëri dhe sisteme politike, dhe se gjuha e shkencës në të shumtën e rasteve ka qenë gjuha arabe, megjithatë ajo që është shkruar në temat edukatës dhe arsimit në gjuhët joarabe nuk ishte e paktë. Për këtë, ne në këtë kapitull vetëm do të japim ca shenja dhe do të ftojmë që të zbulohet dhe studiohet.

## Pjesa e parë: Koncepti “Et-turath – trashëgimi”, zhvillimi, tematikat dhe institucionet e saj

### 1. Koncepti “trashëgimia pedagogjike”

Trashëgimia ka lidhshmëri të ngushtë me historinë. Çdo popull ka historinë e vet. Në kuadër të historisë formohet trashëgimia. Trashëgimia është veçori që ndikon në ekzistimin dhe identitetin e një populli, si dhe është element i rëndësishëm i tij. Popujt të cilat janë formuar vonë, përpiqen të bëjnë histori për vete dhe të zbulojnë trashëgiminë e tyre.

Shprehja “turath-trashëgimi” është përmendur edhe në Kur’anin Famëlartë. Fjala turath- trashëgimi ka kuptimin e pasurisë së trashëguar. Në aspektin terminologjik: me shprehjen “turath-trashëgimi” nënkuptohet pasuri materiale apo shpirtërore që e lënë baballarët pas vdekjes së tyre për fëmijët ose atë që e lënë gjeneratat e para të një populli për gjeneratat që vijnë pas. Trashëgimia është fruti që është prodhuar nga mendja e njeriut ose është arritur nga angazhimi i njeriut në çështjet e ndryshme të jetës materiale apo shpirtërore. Pra. Trashëgimia, përveç çështjeve materiale si pasuri, tokë, shtëpi etj., ajo përfshin edhe çështjet mendore dhe shpirtërore si gjuhën, fenë, mendimet, traditat etj.

Trashëgimia e mendimit islam përfshin: mendimet, fjalët, veprat e trashëguara, eksperiencat dhe praktikat të cilat na i kanë lënë dijetarët musliman, gjeneratë pas gjenerate, përgjatë tërë kohës dhe vendit. Trashëgimia është prodhim i shoqërive islame në shkencat fetare, si: tefsir, hadith, fikhul ibadat, e drejta civile islame, e drejta penale islame, e drejta ekonomike, politike shoqërore etj., shkencat e gjuhës dhe letërsisë, shkencat natyrore dhe aplikative, ashtu siç e gjejmë në forma të ndryshme të mendimit njerëzor në librat e shkruara të trashëgimisë.

Në kohën e Muhammedit alejh'is-selam dhe të hulefairra-shidinëve<sup>187</sup> pjesa dërmuese e trashëgimisë ishte gojore, ngase transmetohej duke u transmetuar me sened-zinxhirë të pakëputur. Trashëgimia e shkruar ka filluar të shtohet me shpejtësi me fillimin e regjistrimit, e cila ka filluar në periudhën e emevitëve dhe është zgjeruar edhe më shumë në periudhën e abasitëve. Çështja e regjistrimit është zgjeruar edhe më shumë, ku krahas shkencave fetare, ka përfshirë edhe llojet tjera të shkencave. Librat e shkruara ishin të ndryshme. Kishte libra të letërsisë, poezisë, gjuhësisë, historisë. Kishte libra të veçanta për mjekësi, matematikë, inxhinieri, astronomi, farmaci etj. Çështja e përkthimit nga trashëgimia perse dhe greke ka përfshirë lloje të ndryshme të shkencave, ku shkrimi dhe përkthimi e ka arritur kulmin e lulëzimit, përafërsisht me përfundimin e shekullit të tretë hixhri.

Shkrimet e shumta dhe llojllojshmëria e tematikave e bënë të nevojshme që disa dijetarë të marrin përsipër regjistrimin e emrave të autorëve dhe veprave të tyre. Ky lloj regjistrim ka vazhduar gjatë tërë historisë islame. Në vëllimin e parë të librit "Keshfudh dhununi an esamil kutubi vel fununi" vërejmë parathënien e Shihabudin el Husejni el Merashi en Nexhefi në të cilin thekson një numër të librave të specializuara duke sqaruar titujt e libra dhe emrat e autorëve, duke filluar nga shekulli i tretë hixhri. Ai ka potencuar afër 40 libra, duke filluar me librin "Ehbarul muelifine vel muelifati" të autorit Ahmed ibn Ebi Tahir Tajfur el Bagdadi (v. 280h/893), në të cilin autori kishte regjistruar trashëgiminë e shkruar deri në kohën e tij.

Librat më të njohur në këtë fushë janë:

- Libri "El-Fihrist" i autorit Ibn Nedim (vd. 380 h./990), në të cilin autori sqaron gjendjen në të cilën ishte trashëgimia islame në gjysmën e dytë të shekullit të katërt hixhri.

- Libri "Miftah'us-seadeti ve misbah'us-sijadeti" i Ahmed ibn Mustafa ibn Halil i njohur me emrin Tashkupri Zade (v. 968 h./1560)

<sup>187</sup> Në kohën e Ebu Bekrit, Omerit, Othmanit dhe Aliut radijallahu anhum, e cila ka zgjatur diku 30 vite pas vdekjes së Muhammedit alejh'is-selam.



- Libri "Keshf'udh-dhununi an esam'il-kutubi ve'l-fununi" i autorit Haxhi Halife (v. 1067 h./1656)

- Libri "Ebxhed'ul-ulumi ve'l-veshj'il-merkumi ve's-sehab'il-merkumi" i autorit Sadik ibn Hasan Han El-Kanuxhi i botuar më 1296 h./1879.

Vlen të theksojmë këtu se trashëgimia islame, përfshirë edhe atë të veçantë në fushën e edukatës dhe arsimit, ka njo-hur llojllojshmëri të gjerë. E gjithë kjo si rezultat i drejtimeve dhe shkollave të shumta pedagogjike si p.sh.: shkollat e fukahave (juristëve), të muhadithëve, filozofëve, sufistëve, historianëve, letrarëve etj. Secila shkollë, me kalimin e kohës, ka përjetuar zhvillim dhe dallime në qëllime dhe metoda.

Pra, trashëgimia është mendim njerëzor. Përderisa është mendim, ajo është vepër që e kryen njeriu dhe është emër i fryteve të kësaj vepre. Edhe pse ekzistojnë referenca dhe forma që kontrollojnë motivet dhe intencat e veprimit njerëzor, të cilat nuk kufizohen në kohë dhe vend, reagimi ndaj këtyre motiveve dhe intencave janë të kufizuara me rrethanat e kohës, vendit dhe eksperiencës njerëzore. Në rastin e trashëgimisë islame, referencë kontrolluese janë ajetet kur'anore dhe suneti pejgamberik. Edhe krahas asaj se trashëgimia themelohet mbi të kuptuarit e teksteve konstante dhe zbritjen e tyre në realitetin që ndryshon, megjithatë Kur'ani dhe suneti pejgamberik nuk llogariten trashëgimi. Për këtë, të kuptuarit e këtyre teksteve konstante, të kuptuarit e realitetit që ndryshon dhe mendimi njerëzor i përfaqësuar nga ixhtihadi i dijetarëve dhe mendimtarëve, të cilën përpiqen që tekstet e shenjta t'i zbresin në jetën reale, e gjithë kjo do të vazhdojë të jetë në ndryshim dhe zhvillim e sipër. Këtë mendim, kur një gjeneratë ia trashëgon gjeneratës që vije pas, ai më tani është trashëgimi.

Në trashëgiminë islame, mendimi njerëzor është lidhur me zbritjen e ajeteve të para kur'anore te Muhammedi alejh'is-salam. Këto ajete kanë përfshirë urdhrin për lexim në emër të Allahut. Ky lexim është përkufizuar në dy lloje që kompletojnë njëra tjetrën: lexim i krijesave që duken dhe lexim i teksteve të shkruara. Kështu meditimi dhe mendimi në ajetet

që flasin rreth krijimit në horizonte dhe në vetë njeriun, si dhe meditimi në ajetet e shkruara me laps, janë shkenca, respektivisht dituria që Allahu kërkon prej robërve të tij ta mësojnë atë. Pra, kemi urdhër për shkrim, i cili do të jetë lëndë për lexim dhe mbështetje në shkrim dhe lexim në vend të transmetimit gojor. Me këtë do të bëhet një ndërprerje historike me analfabetizmin që dominonte te shumica e arabëve. Kështu dituria, mësimi, mësimdhënia dhe mësimnxënia do të jetë lëndë e mendimit njerëzor, të cilin çdo gjeneratë ia trashëgon gjeneratës që vije pas, dhe për këtë të dytën, në kuptimin e gjerë të pedagogjisë, bëhet trashëgimi pedagogjike. Në rastin e trashëgimisë së pedagogjisë islame, xhamia ishte institucioni që përhapte dituri, dhe aty formoheshin grupet për arsimim dhe edukim. Ajetet kur'anore dhe suneti pejgamberik ishin lënda bazë që mësoheshin në këto grupe. Nga transmetimi, kuptimi, diktimi dhe praktikimi në jetë kanë lindur shkencat e fikhut (jurisprudencës), shkencat e Kur'anit, shkencat e hadithit dhe të gjitha shkencat tjera.

Trashëgimia pedagogjike islame, në kuptimin e tij të ngushtë është mendimi të cilin e kanë regjistruar edukatorët dhe dijetarët muslimanë gjatë historisë. Këtu përfshihet çdo gjë që ndërlidhet me diturinë, arsimin dhe edukatën, si dhe çdo gjë që ndërlidhet me to, përfshirë parimet, praktikat dhe institucionet pedagogjike. Ky regjistrim mund të jetë në një libër të veçantë ose tema të edukatës, moralit dhe etikës të shpërndara në librat e fikhut, letërsisë, historisë, tesavufit, filozofisë, mjekësisë etj. Edhe krahas asaj se sot në duart tona kemi burime të shumta të kësaj trashëgimie, mund të thuhet me siguri se një pjesë e madhe nuk ka arritur deri te ne. E gjithë kjo për shkak të pakujdesjes, mosvlerësimit të drejtë, shkatërrimit për shkak kushteve natyrore dhe kalimit të kohës, shkatërrimit të qëllimshëm me djegie ose hedhje në ujë si rezultat i mospajtimeve dhe përçarjeve fraksionale ose për shkak shkatërrimeve si pasojë e luftërave etj.

Trashëgimia islame ka njohur shkrime të cilat bartin tituj të qartë dhe të drejtpërdrejtë rreth diturisë, mësuësit, mësimdhënies dhe mësimnxënies. Në mesin e këtyre librave janë

edhe librat: “Adab’ul-mual-limine” i autorit Ibn Sehnun (v. 256 h./870), libri “Er Risaletul mufesaletu liehvalil muteal-limine” dhe “Ahkam’ul-mual-limine ve’l muteal-limine” të autorit El-Kabisij (v. 403 h./1012), libri “Ta’lim’ul-muteal-lim tarikat teal-lumi” të autorit Ez-Zernuxhi (v. 620 h./1223).

Ekzistojnë edhe libra tjerë jo më pak të rendësishëm që në brendinë e tyre kanë përfshirë çështje të arsimit, duke trajtuar programet, veprat e shkruara, metodat dhe institucionet. Prej këtyre librave kemi:

- libri “El-I’lamu bi menakib’il-islami” i autorit Ebu’l-Hasen El-Amiri (v. 381 h./991) është libër në fushën e akaidit dhe krahasim mes feve. Në të ka përfshirë besimin, adhurimet, legjislacionet, sistemet politike, ekonomike, shoqërore të çdo feje. E gjithë kjo, krahas sistematizimit të shkencave, përfshin llojet, rëndësinë dhe domosdoshmërinë e specializimit gjatë studimit të tyre. Po ashtu, ka folur për mësimdhënësit, cilësitë e tyre etj.

- libri “Mukaddimetu Ibn Haldun” i autorit Ibn Haldun (v. 808 h./1405). Ky libër është në fushën e historisë dhe sociologjisë, por ka trajtuar në mënyrë të detajuar temat si: vlera e diturisë dhe dijetarëve, temat e arsimit, metodat dhe mënyrat e mësimin, duke potencuar se si duhet të jetë dhe duke përkrahur gjendjen ekzistuese të kohës së tij.

Disa libra të trashëgimisë në titujt e tyre përmbajnë shprehje rreth arsimit, por në brendinë e tyre nuk flasin për arsimin në kuptimin e tij të ngushtë. Shembull për këtë kemi librin “El-Menhexh’ul-kavimu bishherhi mesail’it-ta’alimi” të autorit Ibn Haxher El-Hejtemi. Ky libër është në fikhun shafi’, i cili përbëhet nga teksti e Fekihut Abdullah ibn Abdurrahman Bafal El-Hadremi i njohur si “Belhaxh El-Hadremi” (v. 918 h./1512) dhe komenti i Ibn Haxher El-Hejtemi (v. 974 h./1566). Ky libër posedon një parathënie të shkurtër prej një faqe. Më pas vijnë tematikat e fikhut, duke filluar me pastrimin, namazin, xhenazet, zeqatin, agjërimin, i’tikafin, haxhin, umren, shitblerjen, vakëfin, faraidin-trashëgiminë etj. Ngjashëm me këtë është edhe libri “Kitabu ta’lim’is-sibjani” i au-

torit Abdurrahman Es-Salimij. Edhe ky libër përmban vetëm tematika të fikhut ibadij.

Librat e trashëgimisë që ngërthejnë arsimin në kuptimin e tij të ngushtë në titujt dhe përmbajtjet (si: vlera e diturisë, rregullat e mësuesit dhe nxënësit, programet mësimore, metodat mësimore, institucionet arsimore etj.) janë të pakta. Shumicën e asaj që është shkruar rreth këtyre temave në trashëgiminë islame e gjejmë të shpërndarë në librat e hadithit, fikhut, historisë, letërsisë, tesavufit etj. Kur shkruhet biografia e ndonjë personaliteti të caktuar të trashëgimisë islame vërejmë se pjesa më e rëndësishme në biografi është theksimi i mësuesve të tij nga të cilën ka mësuar dhe nxënësit të cilët kanë mësuar nga ai. Në pjesën më të madhe të librave të hadithit vërejmë një kapitull me titullin: “Kitab’ul-ilm-i- Pjesa e diturisë”, në të cilin autori thekson ajetet kur’anore dhe hadithet pejgamberike që flasin rreth vlerës së diturisë, arsimit dhe nxitjen për kërkimin e diturisë. Në librat e fikhut gjejmë sqarime rreth dispozitave dhe fetvave të veçanta rreth asaj se çka lejohet e çka jo për mësuesin dhe nxënësin si dhe lëndët arsimore. Në librat e historisë potencohen institucionet arsimore, theme-luesit e tyre dhe vakëfet që janë lënë për financimin e tyre. Në librat e tesavufit ka sqarime rreth natyrës së raporteve mes muridit-nxënësit dhe shejhit-mësuesit, metodat e edukimit të zemrës, pastrimit të shpirtit dhe gjendjet e njeriut në raport me Zotin etj.

Ai që ndjek me vëmendje atë që është studiuar rreth trashëgimisë te shumica e atyre që kanë shkruar në këtë fushë, qofshin prej të mëhershmeve ose të mëvonshmeve, do të vërejnë se një numër i këtyre dijetarëve të cilën kanë dhënë kontribut të madh në formimin e trashëgimisë pedagogjike si p.sh.: El-Shevkani, El-Gizi, El-Busi e tjerë, nuk është kushtuar kujdesi i mjaftueshëm, siç ishte rasti me të tjerët si: Ibn Sehnuni, El- Kabisi dhe El-Gazali. Po ashtu, do të vërejnë se disa referencave të specializuara të trashëgimisë në fushën e pedagogjisë, u është kushtuar kujdes dhe studim më i madh, se sa kujdesi ndaj disa çështjeve arsimore të përfshira në lloje tjera të referencave si p.sh.: librat e historisë, fikhut, udhëpër-

shkrimeve etj. Kjo e vërteton domosdoshmërinë e studimit të trashëgimisë pedagogjike, përfshirë përmbajtjet, shkollat dhe tematikat e llojllojshme.

Studimet bashkëkohore të mendimit pedagogjik janë zgjeruar shumë dhe janë bërë të llojllojshme. Ka studime të cilat merren me personalitete që kanë shkruar enkas rreth arsimit ose paraqesin mendimet e tyre pedagogjike, si dhe atë që posedojnë prej programeve, eksperiencave dhe metodave mësimore. Studimet e trashëgimisë pedagogjike disa herë përfshijnë një çështje prej çështjeve të arsimit si: plan-programet, metodat mësimore, format e edukimit, ndarja e diplomave mësimore, vakëfet e ndara për arsimim etj. Këto studime, përfshijnë edhe eksperiencën e dalluar pedagogjike të shkollave dhe drejtimeve të ndryshme, si: fikh, sufizëm, filozofi, histori e tjera, ose eksperiencën në një kohë të caktuar apo vend të caktuar.

## 2. Polemikët e vjetra dhe të reja rreth trashëgimisë pedagogjike islame

Për nga aspekti kohor, nuk ka ndonjë rregull të saktë që dallon të vjetrën nga e reja. Periodizimin kohor, të cilin e kanë përdorur evropianët për historinë evropiane: të vjetër, të mesme dhe të re ose i vjetër, i ri dhe bashkëkohor, të cilin e kanë përdorur edhe disa hulumtues arab, në veçanti në studimet e letërsisë dhe të historisë, nuk qëndron fare, për përcaktimin e ndarjes kohore mes e vjetër dhe e re ose e mëhershme dhe e mëvonshme në trashëgiminë islame. Më parë është propozuar kriteri kohor për ndarjen e kohës, i cili ka kufizuar tre shekujt e parë si më të mirët në historinë islame, bazuar në hadithin e saktë: “Njerëzit më të mirë janë ata të shekullit tim, më pas ata që vijë pas tyre dhe më pas ata që vijnë pas tyre”.<sup>188</sup> Bazuar në këtë hadith, imam Dhehebiu duke caktuar vijën ndarëse mes tre shekujve të parë për të hershmit (el-mutekaddimin) dhe pjesa tjetër për të mëvonshmit

<sup>188</sup> El-Buhari, Ebu Abdullah Muhamed ibn Ismail (v. 256h./870). Sahih'ul-Buhari, botimi i parë, 1998, hadithi nr. 3651, fq. 697.

(el-muteehhirin) ka thënë: “vija ndarëse mes të mëhershmit dhe të mëvonshmit është fundi i shekullit të tretë hixhri”<sup>189</sup>

Në trashëgimi kemi shembuj që bëjnë këtë ndarje dhe atë në tematika të ndryshme të trashëgimisë, si: fikh, tefsir, hadith, letërsi, histori etj. Kjo çështje ka marrë një hapësirë më të madhe të interesit, në veçanti te dijetarët e hadithit. Në veçanti duke bërë ndarjen mes “të mëhershmit” dhe “të mëvonshmit”, jo vetëm për nga koha, por edhe për nga metodologjia e seleksionimit si “të saktë” dhe “të dobët”, i cili bazohet në sened-zinxhirë dhe rrethana, metodologji të cilin e kanë pranuar muhadithët dhe kritikuesit e hadithit në periudhën e transmetimit ose metodologjinë e cila mjafton vetëm me meditim në senedin-zinxhirin e hadithit për pranimin e hadithin, siç kanë bërë shumë prej të mëvonshmëve, në veçanti dijetarët e fikhut dhe usulit. Kësaj i shtohet edhe ajo se ata që bazohen në hadithin tjetër ku thuhet: “Shembulli i umetit tim është sikur shembulli i shiut. Nuk dihet se fillimi apo fundi i tij është hajr”<sup>190</sup>, nuk përjashtojnë mundësinë që el-hajrije (më të mirët) mund të jenë edhe pas tre shekujve të parë.

Mendimet e mendimtarëve bashkëkohorë rreth trashëgimisë në përgjithësi dhe trashëgimisë pedagogjike në veçanti, janë të ndryshme. Disa e rrisin aq shumë saqë thonë se “të mëhershmit nuk kanë lënë asgjë për të mëvonshmit” që do të thotë se kanë shterur të gjitha çështjet. Disa të tjerë e zhvlerësojnë rëndësinë e kësaj trashëgimie me argumentim se çdo kohë ka diturinë e saj, i cili humb vlerën me kalimin e kohës. E vërteta nuk është as në atë anë, e as në tjetrën. Kjo çështje, nga njëra anë kërkon studim objektiv dhe të matur, dhe nga ana tjetër përcaktimin e qëllimit të studimit.

Dallimi mes vlerës së të vjetrës dhe të rejes nuk është çështje e re. Kjo shihet shumë herët. Po ashtu, shihet domosdoshmëria e vlerësimit të kësaj vlere duke u bazuar në kriter tjetër, jo atë të kohës. Në lidhje me këtë, Muberrid (v.

<sup>189</sup> Dhehebiu, Shemsudin Muhamed ibn Ahmed ibn Othman (v. 748h./1347). Mizan’ul-’itidali fi nekd’ir-rihali, Recensent: Muhamed El-Bexhavi, Bejrut: Dar’ul-ma’rife, 1963, vëll. 1, fq. 4.

<sup>190</sup> Et-Tirmidhij, Ebu Isa, Muhamed ibn Isa ibn Sure (v. 279 h./892). Xhamiut Tirmidhij, botimi i parë, Riad: Bejt’ul-efkar ed-devlije, 1999, hadithi nr. 2869, fq. 459.

285h./898) në librin e tij “El-Kamil” thotë: “Jo për shkak se i takon të mëhershmeve, i jepet vlerë thënies, e as se i takon të mëvonshmeve, zhvlerësohet ai që ka mendim të drejtë. Secilit i jepet ajo që meriton”.<sup>191</sup> Njëanshmëria në përcaktimin e vlerës së të vjetrës dhe të rejës ka vazhduar gjatë historisë. Kështu vërejmë se Tahir ibn Ashur (v. 1393h./1973) thotë: “Njerëzit rreth asaj që kanë thënë të mëparshmit janë ndarë në dy grupe: grupi i parë nuk del nga ajo që kanë thënë të parët, duke llogaritur fjalët e tyre si të padiskutueshme, dhe grupi i dytë që ka marrë kazmën dhe dëshirojnë të prishin çdo gjë që kanë ndërtuar ata. Në qëndrimin e të dy grupeve ka dëm të madh. Ka një gjendje tjetër që është e dobishme. Ajo gjendje është, të marrim në konsideratë atë që e kanë thënë të mëhershmit, ta pastrojmë dhe të shtojmë, e assesi ta rrënojmë apo ta zhdukim. Duhet pasur në dijeni se injorimi i mirësive të tyre është mosnjohje ndaj të mirave, si dhe mohimi i veçorive të të parëve nuk është prej vetive të mira të umetit”.<sup>192</sup>

Disa libra të trashëgimisë zbulojnë se disa tekste i japin përparësi të vjetrës vetëm e vetëm se është e vjetër, duke e pamundësuar ngritjen e çdo gjëje që është e re. Shembull për këtë kemi atë që e transmeton Enbari (v. 577h./1181) se Ebu Amr ibn Ala’ (v. 254h./868) thoshte: “Ne në krahasim me ata që ishin para nesh jemi si qepa në mesin e hurmave të gjata”.<sup>193</sup> Në shekullin e shtatë hixhri ka ndodhur që disa dije-tarë, të cilët ligjëronin në Fakultetin Mustensirije në Bagdad, në mesin e të cilëve ishte edhe dekani i Fakultetit Ibn’ul-Xhevzi, kishin filluar të përdornin për literaturë bazë librat të cilat vetë i kishin përpiluar. Në vitin 645h./1246 ishte kërkuar prej tyre të heqin dorë nga kjo çështje dhe të kthehen në librat e të mëparshmeve. E gjithë kjo në shenjë respekti dhe nderi ndaj të mëparshmeve. Këtë çështje e kishte pranuar edhe Ibn’ul-Xhevzi.<sup>194</sup>

<sup>191</sup> El-Muberrid, Ebu’l-Abas Muhammed ibn Jezid (v. 285h./898). El-Kamilu fi’l-lugati ve’l-edebi, Recensent: Abdulhamid Hindavi, Rijad: Vezaret’ush-shu’un’il-islamijjeti, (1419h./1998), vëll.1, fq. 79.

<sup>192</sup> Ibn Ashur, Et-Tahriru ve’t-Tenviru, vepër e cituar, vëll.1, fq. 7.

<sup>193</sup> El-Enbari, Ebu’l-Berekat Kemaluddin ibn Abdurrahman (v. 577h./1181). Nez’het’ul-elbai fi tabakat’il-udebai, Recensent: Ibrahim Samurzi, Zerka: Mektebet’ul-Menar, 1985, fq. 32

<sup>194</sup> Naxhi Ma’ruf, Tarih’ul-Mustansirije, Bagdad: Metbeat’ul-Ani, botimi i parë, 1959, fq. 83.

Prej personaliteteve që preferojnë librat e të mëhershmeve është edhe Ebu Is'hak Shatibij, i cili është i mendimit se kërkuesi i diturisë nga librat duhet: “të përdorë librat e të mëparshmeve të fushës së synuar, sepse ata janë më të saktë se të vonshmit. Të mëvonshmit nuk janë të thelluar në njohuri siç janë të mëhershmit. Mjaftojnë për këtë dijetarët e çdo shkence, qofshin praktike apo teorike. Veprat e të mëhershmeve -në përmirësimin e dynjasë dhe ahiretit- janë në të kundërtën e të mëvonshmeve. Shkencat e tyre janë më të sakta. Saktësia e sahabëve në shkencat islame nuk është e ngjashme me saktësinë e tabiinëve, as tibiinët nuk janë si etbautabiinët dhe kështu me radhë”.<sup>195</sup>

Preferimi i librave të të mëhershmeve ka vazhduar për shekuj, derisa institucionet arsimore filluan të caktojnë librat që detyrojnë mesimdhënësit t'i përdorin ato, e jo tekste tjera. Prej argumenteve që përdornin ata që obligonin tekste të caktuar është edhe ajo se disa shkencë janë trajtuar mjaftueshëm dhe nuk ka nevojë për thellime të më shumta dhe disa të tjera janë regjistruar saqë nuk ka nevojë për ixhtihad! Shembull për këtë kemi dekretin të cilin e lëshon sulltan Sejidi Muhammed ibn Abdullah në vitin (1192 h./1778) rreth reformave në arsim duke përfshirë plan-programet mesimore në Universitetin El-Karavijin dhe institucionet përcjellëse të tij. Në kapitullin e tretë të dekretit ku flitet për mesimdhënësit thuhet: “Kemi urdhëruar të mos mësohen tekste tjera përveç “Librit të Allahut-Kur'anit” me koment, librit “Delail'ul-hajrati” dhe salavate ndaj të Dërguarit të Allahut. Prej librave të hadithit “El-Mesanid” dhe “El-Buhari ve Muslim” dhe librat tjerë Es-Sihah. Prej librave të fikhut: “El-Mudevveneh”, “El-Bejan”, “Et-Tehasil”, “Mukaddimetu ibn Rushd”, “El-Xhevahiru Ibn Shas”, “En-Nevadir”, “Er-Risaletu Ibn Ebi Zejdit” dhe libra tjerë të të mëhershmeve. Kush dëshiron të mësojë ilmulkelamin (apologjetikën) libri “Akidetu ibn Ebi Zejd” është e mjaftueshme. Kush dëshiron të mëson “ilmul-usulin”, ajo më

<sup>195</sup> Esh-Shatibij, Ebu Is'hak Ibrahim ibn Musa, (v. 790 h./1388). El-Muvafekatu fi Usul'ish-sheriat, Koment: Abdullah Draz, Beirut: Dar'ul-kutub'il-ilmijeti, 2004, fq. 57.



tani është çështje e përmbyllur, ngase “divanet-librat e fik-hut” janë shkruar dhe nuk ka më nevojë për ixhtihad”.<sup>196</sup>

Përballë këtij qëndrimi ndal librave të të mëhershmeve në arsim, ka pasur po ashtu një qëndrim tjetër të hershëm, i cili ndjente nevojën për të vazhduar reformat dhe librat autoriale, duke refuzuar kështu thënien: “i pari nuk i ka lënë asgjë të fundit”. Shembull për këtë kemi atë që e transmeton Jakut Hameviu nga Ebu Amr Xhahidh (v. 255 h./869) se ka thënë: “Nëse dëgjon dikë duke thënë: i pari nuk i ka lënë asgjë të fundit, dije se ai dëshiron të mos kesh sukses”.<sup>197</sup> Ibn Abd Rabo (v. 328h./940) aspak nuk u luhat duke gjykuar për veçoritë pozitive të shkrimeve të reja ndaj atyre të mëhershme duke thënë: “Kam vërejtur se të fundit e çdo gjenerate, qofshin shkruet të urtësive apo autorë të librave të ndonjë fushe, përdorin fjalë më tërheqëse, tekst më të lehtë dhe metodë më të qartë se sa të parët, ngase i fundit përcjell atë që është shkruar, ndërsa i pari është fillues”.<sup>198</sup>

Ibn Maliku në parathënien e librit të tij “Tes’hil’ul-fevaidi ve tekmi’ul-mekasidi” ka komentuar nevojën për vazhdimin e përpilimit të librave, duke mos mjaftuar vetëm me atë që e kanë shkruar të mëhershmit, duke thënë: “Nëse shkencat janë dhurata hyjnore dhe aftësi profesionale, atëherë nuk është larg mendjes që diç e tillë të jetë e rezervuar për disa nga të mëvonshëm dhe të kuptojnë atë që ishte e vështirë për të mëhershmit”.<sup>199</sup>

Haxhi Halife, thënien e Ibn Malikut e ka transmetuar tekstualisht dhe është zgjeruar në mbështetje të mendimit të tij rreth nevojës për vazhdim në përpilimin dhe shkrimin e teksteve, pa caktuar kohën si kriter të vetëm për vlerën e diçkaje duke thënë: mos u mashtro me thënien: “nuk ka lënë i pari asgjë për të fundit”, por fjala e saktë është: “sa e sa ka

<sup>196</sup> Mihdad, Zubej. “Ssultan Sejidi Muhamed Abdullah El-Alevi raidu islah’it-ta’limi bixhamii Karavijine”, Mexhel-letu da’vet’il-haki, Vezaret’ul-evkafi, nr. (367) Maj-Qershor 2002.

<sup>197</sup> El-Hamevi, Shihabudin Jakut ibn Abdullah El-Hamevi (v. 626 h./1229). Mu’xhem’ul-udeba’: Irshad’ul-erib ila ma’rifet’il-edib, Recensent: Ihan Abas, Bejrut: Dar’ul-garb’il-islami, 1993, vëll. 5, fq. 2103.

<sup>198</sup> Ibn Abd Rabo, Shihabudin Ahmed ibn Muhamed El-Endelusi (v. 328 h./940). El-Akd’ul-Ferid, Bejrut: Dar’ul-kutub’il-ilmijjeti, botimi i parë, 1404 h., vëll. 1, fq. 4.

<sup>199</sup> Ibn Malik, Xhemaludin ibn Malik Et-Tajj (v. 672 h./1273). Tes’hil’ul-Fevaidi ve tekmi’ul-mekasidi, Recensent: Muhamed Kamil Berekat, Kajro: Dar’ul-kitab, 1968, fq. 2.

lënë i pari për të fundit”, ngase, për diçka mund të gjykohet se është e mirë apo e keqe, për shkak të mirësisë së tij apo jo-mirësisë, e jo për shkak se është e vjetër apo e re! Thuhet: nuk ka fjalë më të dëmshme për shkencën se sa thënia: “nuk ka lënë i pari asgjë”, ngase vdes shpresat nga kërkimi i diturisë dhe mbështet abstenimin dhe heqjen dorë nga ajo, kështu që i fundit merret vetëm me atë që e ka ofruar i pari. Kjo është shumë e rrezikshme dhe thënie jo e shëndoshë. Nëse të mëhershmit kanë qenë të suksesshëm në nxjerrjen e bazave dhe përgatitjen e tyre, të mëvonshmit kanë qenë të suksesshëm në ndarjen e këtyre bazave në degë dhe forcimin e tyre”.<sup>200</sup>

Shumë prej shkencëtarëve kanë vërtetuar domosdoshmërinë e përdorimit të kritikës metodologjike për të sqaruar vlerën e cilësdo tematikë të trashëgimisë në sferën e hadithit, fikhut, tefsirit, letërsisë, historisë, arsimimit etj. Ndoshta çështje me të cilën muslimanët janë bërë të njohur kur bëhet fjalë për çështjet e kritikës metodologjike është ajo të cilën e kanë zhvilluar muhadithët rreth metodave tepër precize në kritikën e senedit-zinxhirit dhe metnit-tekstit të hadithit. Kështu ata kanë pranuar nivelet e transmetuesve të ndarë në: el-muhaddith, el-hafidh, el-huxheh, emir’ul-mu’minin në hadith. Po ashtu në: daif, vedda’, mudel-lis, kedhab. Vetë hadithi ndahet në disa shkallë: sahih, hasen, daif. Ekzistojnë edhe detaje tjera në shkencën e Mustelah’ul-hadithit, el-xherhu ve’t-ta’dilu, el-ilelu etj. Sa i përket historisë, Ibn Halduni ka përshkruar metodologjinë e historianëve, të cilët kanë qenë para tij dhe ka refuzuar disa transmetime të tyre duke u mbështetur në atë që është e njohur për nga natyra dhe realiteti. Sa i përket sistemeve të arsimit, Shevkaniu ka sulmuar fuqishëm dijetarët imitues, të cilët kanë braktisur ixhtihadin, duke lënë jashtë përdorimit Kur’anin dhe sunetin pejgamberik, ngase mbështeteshin te dijetarët dhe librat e medhhebeve.

Vensherisi në librin “El-Mi’jar’ul-mu’rebu” ka folur rreth gjendjes së arsimit në përgjithësi,<sup>201</sup> duke përfshirë edhe dije-

<sup>200</sup> Haxhi Halife, Mustafa ibn Abdullah El-Kostantini Er-Rumi (v. 1067 h./1657). Keshf’udh-Dhununi an esam’il-kutubi ve’l-fununi, Bejrut: Daru ihja’it-turath’il-arabijji, (1360 h./1941), vëllimi i parë, fq. 39.

<sup>201</sup> Ebu’l-Abas Ahmed ibn Jahja El-Vensherisi, (v. 914 h./1508). El-Mi’jar’ul-mu’reb ve’l-xhami’ul-mugreb an fetava ifrikija ve’l-endlusi ve’l-magrib, Ribat: Vizaret’ul-evkaf, 1981, vëll. 2, fq. 479-482.

tarët e pushtetarëve, mospajtimet në librat e tefsirit, sëmund-ja e imitimit dhe fanatizmi për medhhebet.

Sa i përket kritikave ndaj poezisë dhe poetëve, kritikant ndaj poezisë së vjetër ishin temë boshte në mekamet e Ibn Sheref Kajrevanit (v. 460 h./1068). Pasi dha shenjë se njeriu nga natyra kapet për të vjetrën dhe nuk dëshiron të hulumtojë të rejën, sqaroi se një pjesë e madhe e poezisë së vjetër - edhe pse është shumë e bukur- prapëseprapë nuk është pa të meta. Ai ka sjellë disa mangësi nga poezitë e poetëve të njohur në periudhën e xhahilijetit dhe periudhën islame. Në mesin e tyre ka përmendur: Imr'ul-Kajsin, El-Ferzedekun, Zuhejrin, Besharin, El-Mutenebiun etj.<sup>202</sup>

Tekstet e lartë-cituara dhe të ngjashme me to japin shenjë rreth dy çështjeve: e para- kjo kritikë drejtuar të së vjetrës, vërteton se e mëhershmyja nuk është kusht të jetë më e mirë se e mëvonshmyja, dhe e dyta- se kritika e drejtuar ndaj realitetit pedagogjik në një periudhë të caktuar flet për ndryshimin e realitetit aktual drejt një gjendje më të keqe se ajo që ishte para ndryshimit, dhe se e vjetra ishte më e mirë se e reja. Krahas asaj që u tha më lart, e gjithë ajo (çka ishte e vjetër dhe çka u bë e re) tanimë është bërë trashëgimi e vjetër. Me të bashkëveprimë sot, në atë mënyrë se sa mund të jetë e dobishme për kohën aktuale dhe për të ardhmen tonë.

Përpyekjet për reformim dhe zhvillim që kërkohen prej individëve, grupeve, dhe gjeneratave të këtij umeti, nuk lirojnë askënd nga përgjegjësia, pa marrë parasysh kohën dhe vendin. Të qenit e këtij umeti si më i mirë në kolektiv sipas fjalëve të Allahut: كُنْتُمْ خَيْرَ أُمَّةٍ أُخْرِجَتْ لِلنَّاسِ [Alu Imran: 110], nuk duhet nënkuptuar se çdo individ është në të njëjtin nivel të mirësisë. Në shekullin e Muhammedit alejh'is-selam, edhe pse jemi të bindur se sahabët janë gjenerata më e mirë, por kjo nuk do të thotë se të gjithë muslimanët ishin në të njëjtin nivel në të gjitha çështjet. Sikur që "el-hajrije- mirësia" mund të jetë në gjeneratë, ajo mund të jetë edhe tek individë, kriter

<sup>202</sup> Ibn Sheref El-Kajrevani, Muhamed ibn Ebu Seid (v. 460 h./1068). Resail'ul-intikad fi nakd'ish- shi'ri ve' sh-shuarai, Recensent: Hasan Husni Abdulvehhab, Bejrut: Dar'ul-kitab'il-xhedid, 1983, fq. 39-40.

është veprimi, përfitimi dhe arritjet e individit, e jo koha në të cilën ka jetuar.

Vlen të theksohet se trashëgimia pedagogjike islame është burim që detyrohemi të zhvillojmë metodologjinë e përshtatshme për bashkëveprim me te. Është më se e vërtetë se në këtë trashëgimi do të gjejmë:

- Shembuj ndriçues për të kuptuar intencat e Kur'anit dhe sunetit, të cilat -në shumë raste- janë iniciativa personale të dijetarëve, prijësve dhe popullatës së thjeshtë. Këto iniciativa paraqesin vlera të shëndosha të cilat vlejné të jenë motive për zhvillim pedagogjik, sot, nesër dhe pasnesër.

- Dispozitat dhe fetvatë e fikhut, për të cilat për nxjerrjen e tyre ka ndikuar realiteti shoqëror i cili ka dominuar asokohe, gjendja psikike e atij që ka nxjerr fetvanë dhe rrethanat e çështjes për të cilat fetvaja ka ardhur si përgjigje për te. Të gjitha këto çështje -në ç'farë do rast- nuk përfaqësojnë të menduarit tonë bashkëkohorë ndaj intencave të Kur'anit dhe sunetit në mësimnxënie dhe mësimdhënie.

- Praktikrat arsimore, individuale dhe kolektive të kritikuara nga vetë trashëgimia. Nëse ato nuk ishin të pranuar për kohën e tyre, me siguri se nuk do të jenë të pranuar as për kohën tonë.

Nëse trashëgimia pedagogjike llogaritet si çështje e vjetër, atëherë çka kemi ne diç të re në fushën e edukimit dhe arsimit? Me siguri se do të gjejmë:

- Shembuj ndriçues të përvojave dhe eksperimenteve në veprimin pedagogjik, në vende të ndryshme të botës, të cilat janë mbështetur në mendim ndriçues dhe vlera të mirëfillta, të cilat kanë realizuar shumë kërkesa për dinjitetin njerëzor dhe përdorimin e energjisë drejt progresit dhe përparimit.

- Sisteme dhe ligje në edukatë dhe arsim në vende të ndryshme të botës, të cilat janë formuar nën ndikimin e realitetit vendor shoqëror, ekonomik politik të atyre vendeve. Vlera e tyre shfaqet vetëm para atyre që i pranojnë si dhe ato nuk detyrohet t'i praktikojë pos atyre që i nënshtrohen atij realiteti. Megjithatë, ata synojné reformimin dhe zhvillimin.

- Edhe në eksperiencën bashkëkohore ka praktika arsimore individuale dhe kolektive, të cilat cilësohen si të çrregulluara ideologjikisht, të ulëta psikologjikisht, poshtëruese ndaj dinjitetit njerëzor dhe shkatërruese ndaj personalitetit të tij. Këto janë praktika të papranuara, të cilat gjenden te disa vende, si rezultat i injorancës dhe prapambetjes civilizuese ose korrupsionit dhe degradimit administrativ ose diktaturës politike të disa grupeve të cilat kanë gjetur interesat dhe përfitimet e tyre, në gjendjen e të cilave kanë dominuar këto praktika.

Mirësinë – el-hajrije, të cilën jemi duke e kërkuar për formimin e mendimit pedagogjik bashkëkohor islam, nuk mund ta gjejmë në të vjetrën në mënyrë absolute, e as në të rejtën në mënyrë absolute. Ajo është një çështje e baraspeshuar, në të cilën kompletohen elementet e të mirës, nga e vjetra dhe e reja. Në përpilimin e kësaj çështje, në mënyrë mahnitëse merr pjesë mendja e njeriut bashkëkohor musliman. E gjithë kjo, brenda intencave të cilat Allahu i dëshiron për njeriun duke bërë pastrimin e trupit, mendjes dhe shpirtit të tij, pastrim në jetën e tij individuale dhe raportet e tij shoqërore. Allahu dëshiron nga njeriu që të veprojë fuqishëm për të shfrytëzuar mundësinë e lejuar për të në këtë tokë, që përfshin zhvillimin e jetës dhe formimin e civilizimit. Kështu duhet vazhduar derisa të përfundojë jeta në këtë botë, dhe më pas kthimi të jetë tek Ai. Kush vepron mirë në këtë botë, atë e ka bërë për vete, por kush vepron keq, edhe atë e ka bërë për vete. Allahu nuk është i padrejtë ndaj robërve të Tij.

## Pjesa e dytë: Disa të dhëna rreth zhvillimit të trashëgimisë pedagogjike islame

Nuk është e tepërt nëse themi se gjendja e diturisë, mësimdhënies dhe mësimnxënies, në vazhdimësi është zhvilluar dhe ka ndryshuar. E gjithë kjo duke iu përgjigjur risive të kohës dhe vendit, si dhe duke iu përshtatur gjendjes civilizuese të shoqërisë. Kjo ishte e qartë gjatë transferimit të përcjelljes së diturisë nga forma gojarisht në formën e të shkruarit në libra, si dhe nga lindja e diturisë në formën e tij të përgjithshme, më pas në sistematizimin e tij në tema dhe kapituj, dhe më vonë ndarja e saj në degë dhe krejt në fund mëvetësimi i degëve në shkencë të veçanta.

Këtë e kemi vërejtur sa i përket mësimin të Kur'anit dhe sunetit pejgamberik, zhvillimin e shkencave të fikhut dhe usulit, tevhidit, akaidit, shkencave gjuhësore etj. Gjatë zhvillimit të shkencave kanë lindur shkencë të reja si: ilmul-kelam (apologjetika), tesavufi, filozofia, shkencat praktike dhe natyrore si: mjekësia, astronomia etj. Krahas gjithë kësaj janë zhvilluar edhe sisteme, metoda dhe mjete, si rezultat i zhvillimit të industrisë, zejtarisë dhe profesioneve të ndryshme.

Format e mësimin zhvilloheshin në mënyrë mekanike. Kjo ndodhte kur një person i ditur ulej për ta mësuar atë që nuk ishte i nivelit të tij ose kur ndonjë person që nuk dinte ndonjë çështje, vinte dhe e pyeste dikë që e dinte. Ky kontakt mes mësuesit dhe nxënësit ndodhte në çdo vend që jepej mundësia. Më pas rritej përvoja dhe lindnin çështje të reja, ku ishte e nevojshme që format mësimore të jenë më të organizuara. Si rezultat i saj, caktoheshin përgjegjësitë, themeloheshin institucionet dhe vinin iniciativa nga ana e dijetarëve dhe të pasurve për zbatimin e këtyre çështjeve. Më pas vinte në shprehje përkujdesi shtetëror, i cili merrte përsipër financimin për

ndërtimin e institucioneve dhe përgatitjen e tyre për qëndrimin e mësuesve dhe nxënësve. Kishte raste kur shteti caktonte kushte si p.sh mësimi i një medhhebi të caktuar apo edhe mësimi i një libri të caktuar në medhheb.

Është plotësisht normale zhvillimi i procesit mësimor gjatë historisë. Dukuria e komunikimit dhe kontaktit në përfitimin e njohurive dhe rritjes së eksperiencave kërkon nevojën për kuptimin e rëndësisë së këtij komunikimi nga gjenerata në tjetrën, si dhe organizimi i tij në një formë të përshtatshme në punën institucionale. Ky organizim më qartë shihet në procesin edukativo-arsimor, ngase arsimit është hallka lidhëse mes gjeneratave të umetit dhe transferimit të elementeve të formimit të tij ideologjik, psikologjik dhe shoqëror, në veçanti ajo që ndërlidhet me fenë, gjuhën dhe historinë, të cilat janë elementet bazë që formojnë identitetin e një populli dhe pikëpamjet e tij ndaj botës.

Me rëndësi në studimin e mendimit pedagogjik në periudhat islame është përcjellja e mënyrës, përmes së cilës ka bashkëvepruar mendja e muslimanit me çështjet edukativo-arsimore, gjetja e referencës gjyquese të këtij bashkëveprimi dhe vrojtimi i mënyrave që janë përdorur për zbritjen e ajetëve kur'anore dhe haditheve të Muhammedit alejh'is-salam në realitetin praktik në të cilin jetonte shoqëria. Mendimet dhe përpjekjet në lidhje me këtë zbritje ishin të ndryshme, dhe si rezultat i saj ka pasur zhvillim në çdo gjë që ndërlidhet me arsimin. Ka zhvillim edhe në përmbajtjet, metodat dhe institucionet arsimore, pozitën e mësuesit, përgjegjësinë e shtetit dhe familjes ndaj arsimimit, çështjet e shpërblimit dhe ndëshkimit dhe pagën për mësimdhënie. Të gjitha këto elemente iu kanë nënshtruar zhvillimit dhe ndryshimit, por jo doemos që ky zhvillim dhe ndryshim në të gjitha rastet ka qenë drejt të më së mirës.

Shumë lehtë mund të vërehen disa shenja të zhvillimit nga një gjendje në tjetrën, dhe atë në disa sfera. Kështu, trashëgimia islame në kohën e sahabëve dhe pjesën dërrmuese të kohës së tabiinëve, përcillej gojarisht. Më pas kjo përcjellje realizohej përmes shkrimit. Ibn Shihab Zuhri (v. 124 h./742)

ishte njëri nga dijetarët të cilët kishin dhënë kontribut në fillimin e kësaj kthese. Më pas shkrimi kishte kaluar në faza të ndryshme.

Sa i përket metodave mësimore, në fillimi përdorej metoda el-mudhakere-e mësimi bashkërisht mes mësuesit dhe nxënësit. Më pas, kjo kaloi në formën e shkrimit të librave. Shembuj më të njohur për këtë ndryshim kemi atë që ka ndodhur mes Imam Ebu Hanifes (150 h./767) dhe nxënësve të tij. Ndryshim ka ndodhur edhe në formën e ligjërimit. Në fillim realizohej gojarisht, më pas me anë të diktimit për ta shkruar, dhe në fund duke lexuar ndonjë libër bashkërisht. Edukimi i fëmijëve në esencë ishte një lloj edukimi, pastrimi, formim të personalitetit dhe formim të identitetit, që realizohej përmes mësimi të gjuhës, çështjeve elementare të fesë dhe virtytet morale. E gjithë kjo i paraprinte mësimi të degëve të ndryshme të diturisë. Kështu edukimi i paraprinte arsimit. Sa i përket zhvillimit të shkencave gjuhësore, në fillim mësohej theksimi i drejtë i fjalëve gojarisht, më pas mësoheshin format e të folurit të drejtë sipas rregullave të sintaksës dhe morfologjisë. Sa i përket tematikave shkencore, ato janë filluar me nxënien e Kur'anit përmendësh, më pas nxënia e haditheve pejgambërike përmendësh, më pas edhe mësimi përmendësh i shkencave tjera. La pasur zhvillim edhe në institucionet edukativo-arsimore. Në fillim ishin mektebe në dhe afër xhamive. Më pas kuvendet e edukimit në shtëpi dhe pallatet e udhëheqësve. Më pas shkollat e specializuara të ngjashme me universitetet sot. Më pas janë themeluar shtëpitë e urtësisë ose shtëpitë e shkencës, në të cilat vepronin dijetarët e dalluar dhe hulumtonin rreth çështjeve të specializuara që janë të ngjashme me qendrat për hulumtim në ditët e sodit. Ka pasur zhvillim të qartë edhe në normat dhe format e shkrimit të librave. Librat në fillim ishin tekste (el-mutun) të përpiluara nga ana e autorit në atë formë që plotësonte nevojat e nxënësve. Më pas këto tekste kishin nevojë për sqarime dhe komentime. Kur sqarimet dhe komentimet janë bërë shumë të mëdha dhe atë në disa vëllime, atëherë ka pasur nevojë për shkurtime (el-muhteser) të këtyre sqarimeve. Për të lehtësuar nxënien e



këtyre shkurtimeve, ato janë përpiluar në formë të poezive (mendhumat shí'rijeh).

Pa dyshim se zhvillimi nuk ka qenë gjithnjë linjë në të njëjtin drejtim. Nëse shkurtime dhe shkrimet në formë të poezive ishin përpjekje e mëvonshme për lehtësim të librave gjerë e gjatë të komentuara, ndonjëherë ndjehej nevoja për komentimin e këtyre shkurtimeve dhe formave poetike në libra të zgjeruara. Po ashtu, zhvillimi nuk nënkupton që në të gjitha rastet të hiqet dorë nga diçka dhe të zëvendësohet me diçka tjetër, por në disa raste ishte shtesë ndaj asaj që ishte më parë.

## 1. Zhvillimi në shkencën e tefsirit

Zhvillimi në trashëgiminë edukativo-arsimore të çdo pulli -së paku në ndonjë dimension- ndërhyjnë me tematikat e edukatës dhe arsimit. Kështu kanë lindur shkenca të cilat më parë nuk ekzistonin në formë të qartë. Çdo shkencë ka lindur dhe më pas është zhvilluar. Historia islame na mëson se -në fillim- lënda e Kur'anit ishte temë mësimi dhe arsimit. Më pas lindën shkenca që ndërlidheshin drejtpërdrejtë me Kur'anin dhe u zhvilluan ato. Kështu, p.sh. shkenca e tefsirit ka filluar me transmetim gojor nga sahabët e njohur si: Abdullah ibn Abasi, Abdullah ibn Mes'udi dhe Ubej ibn Ka'bi. E gjithë kjo duke pasur në konsideratë se me ta janë takuar shumë prej tabi'inëve. Këto transmetime gojore përmbanin komente të disa ajeteve kur'anore, qoftë si transmetim nga Muhammedi alejh'is-salam ose njohje nga ana e sahabëve me kontekstin dhe rrethanat në të cilat kanë zbritur këto ajete. Më pas, vjen një periudhë tjetër e tefsirit kur shoqëria islame kishte nevojë për komentimin e Kur'anit komplet sipas një metodologjie që përfshin kuptimet gjuhësore dhe transmetimet e ndryshme. Themelin e kësaj periudhe e ka vënë imam Taberiu (v. 310h./922) ka fundi i shekullit të tretë hixhri.

Ka shekulli i katërt hixhri filluan të shfaqen komentime të llojllojshme në metodologji dhe qëllime. Këto komentime ngërthenin detajime gjuhësore, historike, legislative, apolo-

gjetike, gjë që shpreh llojllojshmërinë e drejtimeve shkencore dhe metodologjike të shkollave të jurisprudencës islame, fraksioneve apologetike, trendeve sufiste etj. Edhe pse disa prej këtyre komenteve merrnin si referencë gjitha thëniet dhe ixhtihadet e mëhershme, duke mbështetur ndonjërin prej këtyre thënieve, ose duke shtuar diçka, megjithatë silleshin rreth teksteve të transmetuara, kuptimit të fjalëve, stileve gjuhësore dhe disa çështjeve në fikh dhe akaid që nuk marrin pjesë në esencën e intencave kur'anore, të cilat Kur'anin e konsiderojnë dritë dhe mëshirë për njeriun, i mundësojnë atij realizimin e kuptimit të saktë të adhurimit, hilafetit (mëkëmbjes) në tokë dhe përparimit civilizues (el-umran).<sup>203</sup>

Këto kuptime u kristalizuan edhe më qartë në dy shekujt e fundit. Atëherë, kur disa mendimtarë dhe reformues filluan të ndjejnë vështirësitë e prapambetjes në të cilën kishin arrihur muslimanët në sfera të ndryshme, si dhe filluan të ndjejnë nevojën e popullatës për aktivizimin e Kur'anit në jetën e tyre. Kështu, në këtë sferë, përpjekjet e Muhamed Abduhësë, Reshid Ridasë, Ebu'l-Kelam Azadit, Abdulhamid ibn Badisit, Tahir ibn Ashurit, Sejjid Kutubit janë shembuj të këtij orientimi reformues në komentimin e Kur'anit. Orientimet më të rëndësishme të komentimit bashkëkohor sot janë: komentimi i Kur'anit me Kur'an, komentimi tematik, bashkimi mes kuptimit të ajeteve të shkruara dhe botës së studiuar, unifikimi struktural i Kur'anit etj.

Në gjysmën e dytë të shekullit XX u shfaqën lexime të reja të Kur'anit. Këto lexime për bazë kishin metodologjitë e reja perëndimore, të cilat bartnin orientime ideologjike që përpiqeshin të bëjnë shkëputje me trashëgiminë islame. Këto përpjekje bartnin tituj të shumtë, si: analizim i diskursit, aspektet gjuhësore, komentimi (te'vil), hermeneutika strukturale etj. Prej personave që u morën me këto lexime dhe komentime të

<sup>203</sup> Një prezantim i shkurtër i zhvillimit të tefsirit nuk është i mjaftueshëm për të kuptuar periudhat, modelet dhe metodologjitë e zhvillimit të saj. Për këtë, është e preferuar të lexohet ndonjë libër i specializuar në këtë çështje si p.sh.:

Muhamed Husejin Dhehebi, *Et-Tefsiru ve'l-mufessirune: bahthun tafsilijjun an nesh'et'it-efsiri ve tetavvurihi ve elvanihi ve medhabihibi, mea ardin shamilin lieshher'il-mufessirine ve tahlilin kamilin liehemmi kutub'it-efsiri min asrin nebiji alejh'is-selam ila asr'il-hadir*, Kajro: Mektebetu Vehbeh, 1976, në tre vëllime.

reja përmendim: Nasr Hamid Ebu Zejd, Muhamed Arkun, Muhamed Shehrur etj.

Ngjashëm me këtë ka pasur edhe në zhvillimin e shkencave të hadithit, fikhut, usulit, për të cilat preferohet leximi i literaturës së veçantë për to.

## 2. Zhvillim në përgjegjësitë arsimore

Tekstet e trashëgimisë pedagogjike islame flasin se në fillim të historisë islame, arsimimi i fëmijëve ishte përgjegjësi elementare e familjes. Në këtë rast, ose vetë përgjegjësit në familje mësonin fëmijët e tyre ose paguanin dikë për t'ua mësuar ato. Libri "Adab'ul-mual-limine" i Ibn Sehnunit (v. 256 h./870), i cili mund të llogaritet si libër më i vjetër i specializuar në çështjet e arsimit, sikur për nga titulli, ashtu edhe për nga përmbajtja, flet për kontrata mes mësuesve dhe përgjegjësve të fëmijëve, si dhe për dispozita të caktuara që ndërlidhen me kushtet e këtyre kontratave. Disa prej këtyre dispozitave, Ibn Sehnuni ia ka mbështetur Imam Malikut (v. 179 h./795). Bisedat rreth këtyre kontratave kanë vazhduar përmes Zeman Sehnunit (v. 240 h./854) dhe djalit të tij Muhammed ibn Sehnunit (256 h./870), El-Kabisiut (v. 403 h./1012), deri në periudhën e Ibn Haxher El-Hejtemiut (v. 973 h./1565) në shekullin e dhjetë hixhri/ gjashtëmbëdhjetë sipas erës së re. Këtë çështje e vërteton El-Kabisiu, i cili në mënyrë të qartë tregon se "udhëheqësit islamë në fillim të Islamit. Nuk na ka arritur se ndonjëri prej tyre ka emëruar mësues që do t'ua mësonte njerëzve fëmijët e tyre që nga vegjëlja në mekteb, duke u caktuar atyre pagë si kundërvlerë për punën e bërë", siç kishin bërë në sfera tjera.<sup>204</sup>

Edhe pse gjejmë rekomandime të qarta nga disa prej halifëve dhe emirëve (prijësve) për përgjithësimin e arsimit dhe sigurimin e shpenzimeve nga arka e shtetit, duke filluar nga Omer ibn Hatabi, më pas disa nga halifët emevitë dhe abasitë, megjithatë diskutimi fikhor ka vazhduar që vërtetojë

<sup>204</sup> El-Kabisij, Ebu'l-Hasen Ali ibn Halef (v. 403 h./1012). *Er-Risalet'ul-Mufessaletu li ehval'il- muteal-limine ve ahkam'il-mual-limine ve'l-muteal-limine*, Tunizi: Esh-Sheriket'ut-tunisijetu. Botimi i parë, 1986, fq. 98.

përgjegjësinë e prindërve në lidhje me këtë çështje. Kështu vërejmë se Bedrudin Guziju në shekullin e dhjetë hixhri/gjashtëmbëdhjetë të erës së re thotë: “Imam Shafiu dhe shoqët kanë thënë: baballarët dhe nënat (prindërit) -dhe përgjegjësit tjerë- obligohen t'i mësojnë të vegjlit që i kanë nën përkujdesje rreth çështjeve me të cilat obligohen pas arritjes së kohës së pubertetit... thuhet ky lloj i arsimit është mustehab (i preferuar)... mendimi i saktë është se ai është obligativ. Mustehab është pjesa më shumë se kjo, siç janë mësimi i Kur'anit, fikhut, gjuhës etj. Për pagesën rreth mësimin të asaj që është obligative dhe asaj që është mustehab duhet bërë nga pasuria e fëmijëve, po nëse nuk kanë, atëherë nga ana e atyre që obligohen me financim ndaj fëmijëve siç janë babai dhe paraardhësit e tij, pastaj nëna dhe paraardhësit e saj”.<sup>205</sup>

Përhapja e Islamit në vende të ndryshme është shoqëruar me themelimin e institucioneve arsimore, me llojet dhe nivelet e ndryshme. E gjithë kjo pas kalimit të arsimit nga xhamia në mektebe ose medrese për shkak të rritjes së numrit të nxënësve, si dhe për shkak të lindjes së shkencave, për të cilat mendonin se nuk preferohet të mësohen në xhami për shkak të diskutimeve dhe polemikave që mund të lindin si p.sh. *ilmul-kelam* (apologjika) logjika, filozofia etj.

Edhe pse në trashëgiminë islame ka të dhëna që flasin për disa raste kur disa halifë apo emirë kanë kuptuar përgjegjësinë e tërë dhe përgjegjësinë e shtetit ndaj përhapjes së arsimit dhe plotësimin të nevojave për te, si: shkencat, mësuësit, institucionet islame, megjithatë zbatimet praktike që i zbulon trashëgimia pedagogjike islame vërteton se në të shumtën e rasteve, familja ishte ajo që bartte përgjegjësinë e arsimit të fëmijëve.

Është e vërtetuar se përgjegjësia e prindërve ndaj arsimit ishte e pranishme që nga fillimi. Këtë e kemi argumentuar në një vend tjetër ku vetë halifët e drejtë ua kanë mësuar të tjerëve atë që e dinin, i dërgonin disa nga sahabët në vende të ndryshme për t'i mësuar njerëzit, i angazhonin përgjegjësit

<sup>205</sup> El-Guzij, Ebu'l-Berekat Bedrudin Muhamed ibn Muhamed (v. 984 h./1576. Ed-Durrin Nedidu fi edeb'il-mufidi ve'l-mustefidi, recensent: Nesh'etu Ibn Kemal El-Misriju, Kajro: Mektebet'ut-tevijjet'il-islamijjeti, 2009, fq. 111-112.

nëpër krahina të ndryshme të shtetit për lehtësimin e arritjes së arsimimit dhe financimin e atyre që angazhoheshin vetëm me kërkim të diturisë. Ekzistojnë shumë të dhëna të transmetuara që flasin për interesimin e prijësve në periudhën emevite dhe abasite nga një prijës në tjetrin, qoftë në nivel të shtetit apo në nivel lokal. Shembull për këtë kemi kujdesin e Omer ibn Abdulazizit për domosdoshmërinë e kujdesit të udhëheqësve nëpër krahina për mësimdhënie dhe mësimnxënie. Transmetohet se Omer ibn Abdulazizi, i dërgoi një letër prefektit të Humsit duke i thënë: *“Kur të arrijë kjo letër, hulumto personat që i janë përkushtuar mësimi, janë mbyllur në xhami dhe kanë hequr dorë nga të mirat e dynjasë, secilit prej tyre i jep nga 100 dinarë nga arka e shtetit, me qëllim që të kryejnë disa nga nevojat e tyre. Punë më e mirë është ajo që përshpejtohet. Es-selamu alejkum”*.<sup>206</sup>

Po ashtu kemi rastin e Velid ibn Abdulmelikut, i cili përkujdesej për jetimët, i financonte ata dhe u siguronte atyre edukatorë, njëjtë siç u jepte fukahave. Dhehebiu ka thënë: *“Ai (Velidi) i bënte synet jetimët, u siguronte edukatorë, të mosshuarve u siguronte shërbëtorë, të verbërve u siguronte persona që i udhëhiqnin, ka zgjeruar dhe rikonstruktuar xhaminë e Muhammedit alejh’is-selam, ka mbështetur financiarisht fukahatë, të varfrit dhe të dobëtit, ua ka ndaluar kërkimin prej njerëzve duke u caktuar sa u mjafton dhe ka kontrolluar pasurinë e shtetit në formën më të mirë”*.<sup>207</sup>

Vërehet se përgjegjësia e prindërve ndaj arsimimit të fëmijëve, në veçanti në periudhën e moshës parashkollore ishte si rezultat i iniciativave vendore në shoqërinë islame. E gjithë kjo si zbatim i këshillave islame për kërkim të diturisë dhe përgjegjësisë për përkujdesje nga ana e prindërve. Për këtë, u përhapën mektebet në lagjet e qyteteve, fshatrave dhe vendet tjera. E gjithë kjo formoi një alternativë për financimin e shtetit për këtë nivel të arsimit fillestar në të shumtën e rasteve.

<sup>206</sup> Ibnul Xhevi, El-Hafidh Xhemaluddin Ebu'l-Ferexh Abdurrahman (v. 597 h./1201). Siretu Omer ibn Abdulaziz El-Halifet'uz-zahid, Beirut: Dar'ul-kutub'il-ilmijjeti, botimi i parë, 1984, fq. 115.

<sup>207</sup> Dhehebi, Shemsudin Muhamed ibn Ahmed ibn Uthman ibn Kajmaz (v. 748 h./1347) Tarihi'ul-islami ve vefejat'ul-meshahiri ve'l-a'lami, Beirut: Dar'ul-kitab'il-arabijji, botimi i parë, 1987, vëll. 6, fq. 500.

### 3. Zhvillim në pozitën e mësuesit dhe profesionin e mësimitdhënies

Edhe pse mësuesi ka një pozitë të lartë në shoqëri, kjo pozitë disi është zbehur. Kështu me përhapjen e institucioneve arsimore dhe rritjen e numrit të nxënësve, rritej edhe nevoja për mësues. Në disa raste, me profesionin e mësimitdhënies janë marrë edhe disa persona joadekuat. Kështu figura e mësuesit në shoqëri humbi vlerën, derisa në disa raste merrej shembull për paaftësi.

Këtë çështje e ka vërejtur Xhahidhi dhe të tjerë, duke e sqaruar se kjo çështje është rezultat natyror i qëndrimit të gjatë me fëmijë. Xhahidhi thotë: "Mësuesit janë më të palumtur me fëmijët se sa barinjët me bagëtitë e tyre"<sup>208</sup> Xhahidhi mendon se "Allahu u ka ndihmuar nxënësve kur karakteret dhe aftësitë e tyre intelektuale i ka bërë të përafërta me aftësitë e mësuesve"<sup>209</sup> me siguri se me këtë shprehja ka pasur për qëllim përshtatjen e aftësisë së mësuesve me nivelin e nxënësve. Ekzistojnë shumë tekste nga trashëgimia që flasin për përshtatjen e gjuhës dhe sjelljes së të rriturve me gjuhën dhe sjelljen e fëmijëve. Ekzistojnë tekste të shumta që flasin se profesioni i mësuesisë së fëmijëve shkakton dobësi dhe mangësi në personalitetin e mësuesve dhe mosbesim ndaj tyre, derisa mësimitdhënia është llogaritur si diç jo e mirë që ulë nivelin e mësuesit. Si shkaqe për uljen e pozitës së mësuesit janë theksuar edhe të ardhurat e vogla që i merrte ai nga profesioni i mësimitdhënies.<sup>210</sup>

Mangësitë në përgjegjësinë e shtetit ndaj arsimit, mosobligueshmëria, mosplotësimi i kërkesave dhe mosorganizimi i mirëfilltë administrativ, kanë qenë shkaqe që kanë mundësuar që me arsim të merren persona të pakualifikuar. Në veçanti kjo është edhe më e theksuar nëse e gjithë kjo shoqërohet

<sup>208</sup> El-Xhahidh, Ebu Uthman Amr ibn Behr ibn Mehbub (v. 255 h./869). Resail'ul-Xhahidh, Bejrut: Dar'ul-xhil, 1991, vëll. 3, fq. 28.

<sup>209</sup> Po aty, fq. 37.

<sup>210</sup> Për këtë lexo më shumë:

Ibn Havkal, Ebu'l-Kasim Muhamed ibn Havkal En-Nesibi El-Mevsili (v. 367 h./967). Kitabu suret'il-erdi, Bejrut: Menshuratu dar'il-mektebet'il-hajati, 1992, fq. 120-121.

me mangësi nga ana e përgjegjësit gjatë kontrollimit të mësuesve dhe procesit arsimor, ngadalësimi në themelimin e institucioneve profesionale që menaxhojnë arsimin dhe organizojnë çështjet arsimore. E gjithë kjo, ka kontribuar në uljen e pozitës së mësuesit në shoqëri dhe zhvlerësimit të profesionit të mësimdhënies në disa vende.

Mospërgatitja profesionale e mësuesit në disa raste shfaqet edhe në mosnjohjen e tij me metodat e përshtatshme për mësimdhënie, gjë e cila ka ndikuar në uljen e pozitës së mësuesit dhe mosinteresimin e nxënësve për arsim. Në lidhje me këtë çështje, Ibn Halduni thotë: “Kemi vërejtur se shumë prej mësuesve të kësaj kohe nuk njohin metodat e mësimdhënies. Kështu ata u ofrojnë nxënësve në fillim të shkollimit të tyre çështjet e panjohura, duke kërkuar prej tyre të kujdesen në zgjidhjen e tyre dhe duke konsideruar këtë çështje si ushtrim për ta. Kështu ata përziejnë çështjet, duke ofruar çështjet e rënda, para se të jenë nxënësit të përgatitur për t’i kuptuar ato. Nxënësit këto çështje i llogarisin si të vështira, gjë që shkakton përtaci, mosprani dhe heqje dorë nga arsimimi. E gjithë kjo është si rezultat i arsimimit të keq nga ana e mësuesit duke mos përdorur metodat adekuate”.<sup>211</sup>

Është e nevojshme të theksohet këtu se ajo që u tha në lidhje me uljen e pozitës së mësuesit, në të shumtën e rasteve ka të bëjë me mësuesit e fëmijëve në mektebe. Ndërsa sa i përket edukatorëve të cilët angazhoheshin për edukimin e fëmijëve të udhëheqësve dhe të pasurve pozita e tyre ngrihej me ngritjen e pozitës së këtyre personaliteteve të veçanta. Xhahidhi ndoshta ka pasur për qëllim të vërtetojë ngritjen e pozitës së mësuesit me ngritjen e pozitës së përgjegjësve të nxënësve. Edhe mësuesit e mektebeve, sipas Xhahidhit janë në disa nivele. Ai thotë: “Mësuesit janë në dy grupe: disa prej tyre nuk merren me edukimin e fëmijëve të masës së thjeshtë, por merren me fëmijët e të veçantëve. Disa të tjerë, nuk merren as me fëmijët e të veçantëve, por merren me arsimimin e fëmijëve të mbretërve. Si mund të supozosh se personat si Ali

<sup>211</sup> Ibn Haldun, Ebu Zejd Abdurrahman ibn Muhamed El-Hadremi (v. 808 h./1405). *Mukaddimetu ibn Haldun*, Kajro, Nahdatu Misre li't-tibaati, botimi i katërt, 2004, vëll. 3, fq. 1110.

ibn Hamza Kisai, Muhamd ibn Mustenir dhe të ngjashëm me ta janë të paaftë?! Nëse kalojmë të mësuesit e mektebeve në fshatra, ata janë sikur edhe te çdo popull tjetër, ka të paaftë dhe jo të përgatitur mirë.”<sup>212</sup>

Shoqëria islame ka vërejtur zhvillim të qartë, atëherë kur arsimit u bë profesion me kushte dhe kriteret e caktuara. Këto kushte dhe kriteret dallonin sipas nivelit për ku kërkoheshin. Kështu edukatori që do të edukojë fëmijët e mbretërve, prijësve dhe të pasurve, kërkoheshin prej tij përgatitje e lartë, ku krahas thellimit të tij në dituri, rekomandimeve nga ana e dijetarëve të mëdhenj dhe autorizimit nga ana e tyre, prej tij kërkoheshin edhe cilësi të caktuara që përfshinin personalitetin e tij kulturor dhe pamjen e tij fizike. Trashëgimia islame njeh persona të specializuar në përgatitjen e mësuesve dhe edukatorëve, siç transmeton Jakut Hameviu. Nga mesi i këtyre trajnuesve theksojmë: Ahmed ibn Muhamed ibn Abdullah Sehelij. Në lidhje me të është thënë: “Është imam (prijës) në letërsi. Tërë jetën e ka kaluar duke studiuar dhe duke i mësuar edukatorët dhe mësuesit e Nisaburit”.<sup>213</sup> Trajnues tjetër kemi edhe Hasan ibn Mehran. Ishte njohës i madh i sekreteve të arsimimit dhe edukimit dhe personi më i njohur me metodën e gradualitetit deri në përfundim.<sup>214</sup>

#### 4. Zhvillim në raportin e dijetarëve me pushtetarët

Disa nga dijetarët dhe edukatorët, nuk pranonin as edukimin e fëmijëve të njerëzve të veçantë. Kështu imam Malik ibn Enesi (v. 179 h./795) ka refuzuar të shkojë që t'i mësojë dy fëmijët e halifes Mehdi (v. 169 h./785), Harunur-Reshid dhe Musa Hadi. Edhe kur erdhën së bashku me edukatorin e tyre tek Imam Maliku, ai refuzoi të lexojë para tyre, derisa ata të lexojnë para tij, sepse “banorët e Medinës lexojnë para dijeta-

<sup>212</sup> El-Xhahidh, Ebu Uthman Amr ibn Behr ibn Mehub (v. 255 h./869). *El-Bejanu ve't-Tebjiru*, Beirut: Dar'ul-xhili, (pa vit botimi), vëll. 1, fq. 250-251.

<sup>213</sup> El-Hamevi, *Mu'xhem'ul-udebai: Irshad'ul-eribi ila ma'rifet'il-edibi*, vepër e cituar, vëll. 2, fq. 491.

<sup>214</sup> Po aty, vëll. 4, fq. 1869.



rit, siç lexojnë fëmijët para mësuesit”.<sup>215</sup> Po ashtu Maliku ka refuzuar të shkojë të lexojë librin *El-Muvetta'* para Harunur-Reshidit, kur ky i fundit gjatë kohës kur ishte halife kishte shkuar në Medinë rrugës për në haxh. Maliku e bënte këtë duke menduar se kjo ulë vlerën e diturisë. Ibn Asakiri transmeton këtë ngjarje duke thënë: Haruni, Malikit i tha: dua të dëgjoj prej teje leximin e librit *El-Muvetta'*. Maliku iu përgjigj: Po o prijës i besimtarëve: Haruni tha: Kur? Maliku iu përgjigj: Nesër. Kështu Haruni u ul duke e pritur të nesërmen, ndërsa Maliku u ul duke e pritur në shtëpinë e tij. Kur u vonua, Haruni dërgoi një person dhe e thirri: kur erdhi, atij i tha: O Malik, të prita shumë sot. Maliku iu përgjigj: edhe unë o prijës i besimtarëve të prita shumë. Diturisë i shkohet, e nuk vjen. I afërmi juaj (kishte për qëllim Muhammedin alejh'issalam) ka sjellë diturinë. Nëse e ngrini vlerën e diturisë, ajo ngrihet, por nëse e ulni, ajo ulet”.<sup>216</sup>

Ky qëndrim nuk është i veçantë për Imam Malikun në lidhje me respektin që ia bënte diturisë, Medinës dhe banorëve të saj. Diç e ngjashme ka ndodhur edhe shumë herë nga dijetarë tjerë. Do të sjellim një shembull nga Andaluzia. Kështu, sulltani kishte kërkuar prej Ebu Sulejman Davud ibn Jezid Garnatit (v. 573 h./1177) t'ia mësojë fëmijët. Ai i është përgjigjur: “Pasha Allahun, nuk uli vlerën e diturisë, e as nuk shkoj te shtëpia e tij”.<sup>217</sup>

Interesimi i disa dijetarëve për të mirat e kësaj bote dhe kërkimi i pozitës dhe pasurisë prej pushtetarëve, ishte njëri ndër shkaqet e rënies së vlerës së tyre, jo vetëm në shoqëri, por edhe te udhëheqësit, bile edhe para vetes së tyre. Në lidhje me këto çështje, Ibn Hazmi ka folur rreth rreziqeve psikike duke thënë: “Nëse sprovohet me shoqërim të sulltanit, ai më është sprovuar me sprovat më të rënda, kështu që e vë në

<sup>215</sup> Dhehebi, Shemsudin Muhamed ibn Ahmed ibn Uthman (v. 748 h./1347). *Sijeru a'l'am'in-nubelai*, vepër e cituar, vëll. 2, fq. 491.

<sup>216</sup> Ibn Asakir, Ebu'l-Kasim Ali ibn Hasan ibn Hibetullah (v. 571 h./1175). *Keshf'ul-mugata fi fadl'il-Muvetta'*, Bejrut & Damask: Dar'ul-fikr, 1992, fq. 57-58.

<sup>217</sup> Xhelaludin Abdurrahman ibn Kemaludin Es-Sujuti (v. 911 h./1505). *Bug'jet'ul-vuati fi tabekat'il-lugavijjine ve'n-nexhati*, Kajro: Metbeatu Isa El Babi El-Halebi, botimi i parë, 1964, fq. 563.

rrezik fenë dhe veten e tij, duke u preokupuar me derte të ndryshme”.<sup>218</sup>

Është me rëndësi të dimë se shoqëria islame, edhe në këso rrethana dhe me ekzistimin e këtyre rasteve ishte e përmbushur plot me raste tjera të dijetarëve të cilët janë kujdesur në respektimin e diturisë, thellimin në te, pavarësinë e personalitetit të tyre, heqjen dorë nga interesat e kësaj bote, guximin gjatë raporteve me pushtetarët, kështu që me këto veprime kanë përfituar respekt dhe pozitë të madhe të njerëzisë, bile edhe te vet pushtetarët. Është drejtësi të përkujtojmë shembujt e shumtë të këtij grupi të dijetarëve mësues, sa herë që theksohet ekzistimi i rasteve që flasin për uljen e pozitës së dijetarëve dhe mësuesve.

Nëse llojlojshmëria në sjelljen e njerëzve shpreh karakterin e tyre, ekziston edhe një llojlojshmëri tjetër që reflekton ixhtihadet e dijetarëve në kërkim të së vërtetës gjatë sjelljes së fetvave. Të sjellim një shembull për këtë. Ekzistojnë shumë tekste që tërheqin vërejtjen nga afrimi me pushtetarët. Këtë qëndrim e kanë marrë disa dijetarë me qëllim të ruajtjes nga dobësia, nënshtrimi dhe hipokrizia. Ka transmetuar Ibn Abbasi se Muhammedi alejh'is-selam ka thënë: “Kush shkon te dyert e pushtetarëve, ai më është sprovuar”.<sup>219</sup> Megjithatë, vërejmë dijetarë tjerë, të cilët ishin të dalluar për nga dituria, nuk refuzuan ftesën e pushtetarëve nëse u drejtohej atyre, as nuk refuzonin dhuratat prej tyre. Mirëpo, qëndrimet e tyre sjellin shembuj me peshë në pavarësi, guxim dhe krenari. Kur ata kritikoheshin për shkak afrimit me pushtetarët, sqaronin dobitë dhe mirësitë që realizoheshin nga kjo çështje, si dhe humbja e mirësive sikur të mos e bënin.

Sidoqoftë, historia islame njih pushtetarë që cilësoheshin si të padrejtë dhe rrenacakë. Gjithashtu ka pasur dijetarë që iu kanë besuar atyre në gënjeshttrat e tyre, duke ua zbukuruar padrejtësinë dhe duke i ndihmuar ata nga frika e dënimit ose shpresa për përfitime. Tërheqja e vërejtjes nga afrimi të pushtetarët ka ndodhur në raste të tilla. Hadithin të cilin e trans-

<sup>218</sup> Ebu Muhamed Ali ibn Ahmed ibn Seid Ibn Hazm (v. 456 h./1064). Resailu Ibn Hazm El-Endelusi, Beirut: El-Muesseset'ul-arabijjetu, botimi i parë, 1983, vëll. 4. fq. 76.

<sup>219</sup> Et-Tirmidhi, Xhami'ut-Tirmidhi, vepër e cituar, kapitulli: el-fiten, hadithi nr. 2256, fq. 373.

meton Xhabir ibn Abdullahu se Muhammedi alej'h'is-selam ka thënë: *“Do të vijnë pushtetarë. Kush shkon tek ata, iu ndihmon në padrejtësinë e tyre dhe iu beson gënjeshtreve të tyre, nuk janë prej meje, as nuk jam prej tyre dhe nuk do t'më shohin te Havdi. Kush nuk shkon tek ata, nuk iu ndihmon në padrejtësinë e tyre dhe nuk iu beson gënjeshtreve të tyre, janë prej meje dhe jam prej tyre dhe do t'më shohin te Havdi”*.<sup>220</sup>

Qëndrimet e dijetarëve ndaj pushtetarëve ishin të ndryshme. Disa ishin më të butë dhe me raporte më të afërta, kurse disa tjerë ishin tepër të ashpër dhe larg tyre. Ekzistojnë shembuj të shumtë për secilin lloj të raporteve. Ibn Abdulberr në librin e tij *“Xhamiu bejan'il-ilmu ve fadlihi”* ka sjellë argumente të shumta në këtë drejtim, qofshin hadithe ose ngjarje. Prej tyre sjell hadithin të cilin e transmeton Muslimi në Sahihin e tij: *“Do të ketë në mesin tuaj pushtetarë. Do të pranoni prej tyre dhe do të kundërshtoni. Kush kundërshton, është rehatuar dhe kush urren ka shpëtuar, por ai që pajtohet dhe i ndjek ata, Allahu e largoftë atë”*.<sup>221</sup> Po ashtu nga A'meshi transmeton: *“Pushtetarë më të këqij janë ata të cilët janë më larg dijetarëve, ndërsa dijetarë më të këqij janë ata të cilët janë më afër pushtetarëve”*.<sup>222</sup> Në lidhje me ngjarjet e transmetuara në këtë çështje, Ibn Abdulberri thotë: *“E gjithë kjo vlen për pushtetarët e padrejtë. Ndërsa sa i përket pushtetarëve të drejtë, qëndrimi me ta dhe ndihma e tyre për të mirë është prej veprave më të mira. A nuk ke vërejt se si Omer ibn Abdulazizi shoqërohej nga një numër i madh i dijetarëve si: Urve ibn Zubejr, Ibn Shihab etj. Ibn Shihabi shkante tek Abdulmeliku dhe djemtë e tij më pas. Prej dijetarëve që kanë shkuar te sulltanët theksojmë: Sha'biu, Kubejsa ibn Dhuejbi, Hasani, Ebi Zenadi, Maliku, Evzaiu, Shafiu dhe shumë të tjerë. Kur dijetari shkon te pushtetari pa synuar ndonjë*

<sup>220</sup> En-Nisai, Ebu Abdurrahman Ahmed ibn Shuajb ibn Ali En-Nisai (v. 303 h./915). Sunen'un-Nesai, Riad: Bejt'ul-efkar 'id-devlijjeti, botimi i parë, 1999, hadithi nr. 4208, fq. 442.

<sup>221</sup> Ibn Abdulberr, Ebu Amr jusuf ibn Abdullah En-Nemri El-Kurtubi (v. 463 h./1071). Xhamiu bejan'il-ilmu ve fadlihi, Demam: Dar ibn'ul-Xhevzi, 1994, vëll. 1, fq. 634-635.

Hadithi është i saktë në:

Ebu'l-Husejn Muslim ibn El-Haxhaxh El-Kushejri Muslim, (v. 260 h./874). Sahihu Muslim, Riad: Bejt'ul-efkar 'id-devlijjeti, botimi i parë, 1998, hadithi nr. 1854, fq. 774.

<sup>222</sup> Ibn Abdulberr, Xhamiu bejan'il-ilmu ve fadlihi, vepër e cituar, vëll. 1, fq. 634.

interes, flet mirë dhe me dituri e argumente, atëherë kjo shkuarje është e mirë, me të cilën fitohet kënaqësia e Allahut. Megjithatë, në të shumtën e rasteve, këto vende janë sprovë, vështirë se mund të shpëtohet. Mjafton të merret në konsideratë fjala e Muhammedit alejh'is-selam: "... *Kush kundërshton, është rehatuar dhe kush urren ka shpëtuar, por ai që pajtohet dhe i ndjek ata, Allahu e largoftë atë*".<sup>223</sup>

Sikur që kishte në mesin e dijetarëve të ditur, të devotshëm dhe të drejtë, edhe në mesin e pushtetarëve ka pasur të ditur, të devotshëm dhe të drejtë. Ka pasur në mesin e pushtetarëve të tillë që kanë respektuar shumë dijetarët dhe janë ulur para tyre siç ulet nxënësi para mësuesit. Transmetohet nga Omer ibn Hatabi se ka thënë: Muhammedi alejh'is-selam ka thënë: "Allahu i do ata pushtetarë që rrinë me dijetarë, ndërsa urren ata dijetarë që rrinë me pushtetarë. Është kështu sepse, dijetarët kur rrinë me pushtetarët shpresojnë të mirat e kësaj bote, ndërsa pushtetarët kur rrinë me dijetarët shpresojnë ahiretin".<sup>224</sup>

## 5. Zhvillimi në marrjen e pagës për mësimdhënie

Ajetet kur'anore dhe hadithet pejgamberike kanë tërhequr vërejtjen që kërkimi i diturisë të bëhet mjet për përfitime materiale dhe arritje të pozitive. Për shkak të kësaj ndalese, disa dijetarë ishin të mendimit se është haram marrja e pagës për mësimdhënie. Mirëpo, shumë shpejt u bë e qartë vështirësia e bashkimit mes përfitimeve materiale dhe kryerja e një detyre publike. Ebu Bekri, pasi u zgjodh për halif, e panë atë Abdurrahmani dhe Omeri me disa gjera në duar duke shkuar në treg. Ata e kundërshtuan, ndërsa ai u arsyetua se dëshiron të përfitojë risk për financimin e familjes. E morën atë dhe shkuan në xhami. Aty u konsultuan me muslimanët tjerë rreth caktimit të pagës, që do t'i mjaftonte, me qëllim që të jetë i lirë dhe të merret me çështjen e menaxhimit të punëve

<sup>223</sup> Po aty, vëll.1, fq. 644.

<sup>224</sup> Ed-Dejlemi El-Hemedhani, Ebu Shuxha Shejrevejh ibn Sheredar ibn Shehrevejh (v. 509 h./???). El-Firdevsu bi me'thur'il-hitab, Bejrut: Dar'ul-kutub'il-ilmijjeti, botimi i parë, 1986, vëll. 1, hadithi nr. 566, fq. 155.

të shtetit dhe punët e muslimanëve.<sup>225</sup> Hilafeti, respektivisht udhëheqja e shtetit është post publik ku ndjehet nevoja që njeriu të jetë i lirë. Nevojat e njeriut që kryen këtë detyrë mbulohen nga arka e shtetit. Ngjashëm me këtë ka edhe shumë detyra tjera: gjykatës, inspektor, muezin, përgjegjësi i tregut etj.

Kur mësuesi ndante një kohë të caktuar brenda ditës ose brenda javës për t'i mësuar njerëzit, dhe me këtë vepër synonte shpërblimin e Allahut dhe përcjelljen e diturisë deri te të tjerët, vërejmë se shumë dijetarë kanë punuar pa pagë dhe se si rezultat i saj kemi shumë fakte që flasin për ndalimin e marrjes së pagës për mësimdhënie. Mirëpo, kur u ndie nevoja për përcaktim të tërësishëm për arsim, dhe se mësimdhënësi nuk kishte burim tjetër për financim, u ndie nevoja për marrjen e pagës. Nëse mësimdhënësi është i sinqertë dhe i përpiktë në punën e tij, atëherë marrja e pagës nuk humb vlerën dhe dinjitetin e tij në shoqëri, si dhe shpërblimin tek Allahu.

Edhe pse themelimi i shkollave dhe financimi i tyre mjaft i madh, duke u emëruar në to dijetarë të mëdhenj me paga të mira, shihej me admirim, në anën tjetër, disa dijetarë këtë çështje e mendonin si rast për hapjen e ngushëllimeve. Ata mendonin se me mësimdhënie mund të merren vetëm dijetarët e mëdhenj, të mëdhenj me diturinë dhe dinjitetin e tyre, e jo me pagën që marrin si kundërvlerë për punën e bërë. Në librin "El-Kanun" të Hasan El-Jusi në lidhje me këtë çështje thuhet: *"Dijetarëve të vendeve të Transoksanisë (Uzbekistani dhe pjesë nga Kazakistani dhe Kirgizistani) kur u erdhi lajmi se në Bagdad janë ngritur shkolla, hapën të pame (ngushëllimi) për diturinë. Ata thanë: me mësimdhënie merreshin personat me ideale të larta dhe kishte dobi prej tyre, por nëse për këtë punë ka pagesë, atëherë pas saj do të vrapojnë njerëzit e pandershëm dhe do të merret si shkas për ngritjen e tij"*.<sup>226</sup> Duke pasur parasysh gjendjen e shoqërisë dhe nevojën që të ketë mësimdhënësi që do të merreshin me arsimimin e nxënësve, duke iu siguruar pagat e tyre,

<sup>225</sup> Ebu Xhafer Muhamed ibn Xherir Et-Taberi, (v. 310 h./922). Tarih'ul-umemi ve'l-muluki, Beirut: Dar'ul-fikri, 1979, vëll. 4, fq. 54.

<sup>226</sup> Ebu'l-Mevahib El-Jusi, El-Hasan ibn Mes'ud (v. 1105 h./1693). El-Kanuni fi ahkam'il-ilmi ve ahkam'il-alimi ve ahkam'il-muteal-limi, Ribat: El-Muhakkik, 1998, fq. 306.

financimi i institucioneve, mjeteve mësimore dhe çdo gjë që ndërlidhet me arsimin, nuk mendojmë se gjendja për të cilën ka folur El-Jusi përfshin këtë nivel të nevojës.

Dijetarët kanë diskutuar dhe kanë polemizuar rreth dispozitës së marrjes së pagës për arsimim. Më pas kanë hyrë në detaje duke përfshirë shumë çështje. Disa prej tyre lejonin, e disa tjerë ndalonin. Disa të tjerë bënë dallimin mes mësimin të Kur'anit dhe shkencave tjera, si dhe dallimin mes mësimin të fëmijëve çështjet elementare të fesë dhe mësimin e të rriturve shkenca të veçanta. Po ashtu, arsimim me angazhim nga shteti ose arsimim me financim nga përgjegjësit e fëmijëve. Dispozita në fund përfundon si në vijim: dijetarët e medhhebit shaii, maliki dhe hanbeli kanë lejuar marrjen e pagës, ndërsa dijetarët e mëhershëm të medhhebit hanefi e kanë ndaluar, por të mëvonshmit, duke pasur parasysh nevojën e madhe, e kanë lejuar.

Dijetarët të cilët lejojnë marrjen e pagës për arsimim bazohen në shumë argumente, ndërsa argumentet që e ndalojnë një gjë të tillë i komentojnë në kontekste të veçanta që nuk mund t'ju rrinë përballë argumenteve që lejojnë. Krahas argumenteve që lejojnë, dispozita që lejon marrjen e pagës, që nga kohët e mëhershme, konsiderohej kërkesë për zhvillimin e shoqërisë dhe organizimin e çështjeve. Transmetohet nga sahabiu Abdullah ibn Mes'udi se ka thënë: "Njerëzit është patjetër të keni tri çështje: është patjetër të kenë emir që gjykon mes tyre, ngase sikur mos të kishte emir, do të hanin njëri tjetrin. Patjetër të ketë shitblerje të mus'hafëve, ngase sikur mos të ekzistonte kjo çështje, do të humbej interesi për librin e Allahut. Njerëzit patjetër të kenë mësues që do t'ua mësonte fëmijët, ku për punën e tij do të merrte pagë, ngase sikur mos të kishte mësues, njerëzit do të mbeteshin analfabetë".<sup>227</sup>

Sehnuni në librin "El-Mudevvenet'ul-kubra", të cilin e transmeton nga Malik ibn Enesi, ka caktuar një kapitull rreth pagesës së mësuesit. Ai ka theksuar, se nuk ndalohet pagesa e mësuesit me një sasi të caktuar të të hollave. Kjo pagesë

<sup>227</sup> Muhamed ibn Abduslam Et-Tunihij Ibn Sehnun (v. 256 h./870). Kitabu adab'il-mual-limine, Tunizi: Dar'ul-kutub'il-sharkijeti, 1972, fq. 82.

bëhet si kundërvlerë për kohën, mësimin e Kur'anit, një pjesë të tij ose për mësimin e shkrim-leximit etj. Në këtë libër po ashtu theksohet: transmetohet nga Ibn Veheb, nga Jahja ibn Ejub, nga El- Muthena ibn Sabah se ka thënë: e kam pyetur Hasan Basriun rreth mësuesit të fëmijëve me pagesë? Ai tha: nuk ndalohet. Transmeton Abdulxhebar ibn Omer të ketë thënë: Të gjithë ata që i kam pyetur prej Ehl'ul-Medines (dijetarët e Medinës) rreth marrjes së pagës për mësim, kanë thënë se nuk ndalohet. Transmetohet nga Ibn Luhej'ah nga Safvan ibn Selimi se: ua mësonte medinasëve librin, ndërsa ato për këtë punë e paguanin. Ibn Vehebi ka thënë: e kam dëgjuar Imam Malikun duke thënë: "Nuk ndalohet marrja e pagës për mësimin e fëmijëve librin dhe Kur'anin".<sup>228</sup>

Me sa duket, qysh në shekullin e katërt hixhri, çështja mori epilog përfundimtar ku lejohet marrja e pagës për mësimdhënie, pa pasur nevojë për argument. Kabisiu (v. 403 h./1012) ka thënë: "Zakonisht muslimanët ua mësonin fëmijëve e tyre Kur'anin, u sillnin atyre mësuesit më të mirë. Secili prind që kishte mundësi e bënte këtë për fëmijën e tij... po ashtu prindi nuk e linte këtë nga pakujdesi ose nënçmimi, në përjashtim të ndonjë prindi që nuk dëshironte të bënte mirë... ai prind që dëshironte që fëmija i vet të bëhej i ngritur, nuk bëhej koprrac në pagesën ndaj mësuesit për shkak të mësimin të Kur'anit fëmijës së tij. Të parët e muslimanëve nuk janë marrë me argumentim ndaj kësaj çështje. Kanë mjaftuar me dëshirën që Allahu e ka venduar në zemrat e tyre dhe kanë vepruar me të. Kjo u bë një traditë që e ka përcjellë gjeneratë pas gjenerate. Nuk dihet se dikush prej prindërve e ka lënë këtë çështje, duke mos pasur dëshirë ta bëjë ose nga pakujdesi. Kjo nuk është veti e muslimanit. Sikur të njihet dikush që e ka lënë fëmijën pa ia mësuar Kur'anin, do të llogaritet si i paditur dhe do të humbte vlerën në shoqëri".<sup>229</sup>

Kabisiu është i mendimit se paga e mësuesit ishte e lidhur me profesionin e tij. Kështu çdo person që ka një profesion, i përkushtohet atij, dhe për këtë meriton pagë. Mësuesi është

<sup>228</sup> Ebu Seid Abduselam ibn Seid Et-Tenuhi El-Kajrevani Sehnun (v. 240 h./854). El-Mudevvenetu kubra, Riad: Dar'ul-kutub'il-ilmijjeti, botimi i parë, 1994, vëll. 3, fq. 431.

<sup>229</sup> El-Kabisij, Er-Risalet'ul-mufessaletu li ahval'il-muteal-limine ...., vepër e cituar, fq. 92-94.

person me profesion, kështu që patjetër të jetë dikush që paguan pagën. Po nëse nuk ka kush të paguan për fëmijën që mësohet, ndërsa mësuesi këtë e bënë pa pagesë, në këtë rast shumëfishohet shpërblimi i tij tek Allahu. Në lidhje me këtë çështje, Kabisiu ka thënë: “Nëse mësuesi e mëson ndonjë fëmijë për hir të Allahut dhe duron për këtë çështje, shpërblimi i tij me lejen e Allahut do të shumëfishohet, ngase ky është profesioni i tij nga i cili mbijeton”.<sup>230</sup> Pastaj ka thënë: “Është vështirë të gjendet në mesin e njerëzve që në mënyrë vullnetare ua mëson fëmijët muslimanëve dhe merret vetëm me këtë çështje, duke hequr dorë nga kërkimi i riskut dhe nevojave tjera. Është vepër e mirë që muslimanët të angazhohen me pagesë dikë që ua mëson fëmijët e tyre”.<sup>231</sup>

Kabisiu është zgjeruar në këtë çështje derisa ka folur edhe për atë se në rast se prindi nuk ka mundësi të paguaj, kush obligohet të financojë arsimimin e fëmijës. Nëse babai i fëmijës vdes, atëherë obligohet përgjegjësi i fëmijës. “Nëse jetimi nuk ka përgjegjës, me çështjen e tij merret përgjegjësi shtetëror dhe bënë atë që ka bërë prindi apo përgjegjësi. Po nëse në ndonjë vend nuk ka përgjegjës shtetëror, atëherë ata që merren me çështjet e atij vendi duhet të merren edhe me çështjen e këtij jetimi. Nëse jetimi nuk ka pasuri, atëherë financimin e tij e merr nëna e tij, më pas më të afërmit e tij. Nëse del dikush në mënyrë vullnetare merr përsipër financimin e tij, ai do të shpërblehet për këtë vepër. Po nëse mësuesi këtë e bënë për hir të Allahut dhe duron, shpërblimi me lejen e Allahut do t'i shumëfishohet atij”.<sup>232</sup> Kjo këmbëngulje për domosdoshmërinë e gjetjes së personit për financimin e arsimimit të fëmijës në çfarëdo gjendje është e ngjashme me atë që sot e quajmë arsim obligativ.

## 6. Zhvillimi në institucionet arsimore

<sup>230</sup> Po aty, fq. 94.

<sup>231</sup> Po aty, fq. 98.

<sup>232</sup> Po aty, fq. 94.



Ndonëse në Gadishullin Arabik në periudhën paraislame kishte disa mësonjëtoare të pakta në numër, megjithatë atë që e solli Kur'ani dhe suneti peygamberik rreth vlerës së diturisë, mësim-nxënies dhe mësimdhënies, urdhrit për shkrim-lexim, kujdesi i Kur'anit për lapsin dhe fletën, e gjithë kjo shoqërinë islame e shtyri në një revolucion arsimor dhe edukativ kundër analfabetizmit dhe injorancës, gjë e cila çoi drejt përhapjes së mësimdhënies dhe mësimnxënies në çdo vend. Sa i përket zbritjes së Kur'anit deri te Muhammedi alejhi's-selam në mënyrë graduale sipas fazave të formimit gradual pedagogjik të umetit në sfera të ndryshme, e gjithë kjo kishte qëllime edukative dhe arsimore. Ngjashëm me këtë ishte edhe politika e Muhammedit alejhi's-selam në menaxhimin e çështjeve të umetit sipas udhëzimeve hyjnore. Xhamia ishte institucioni publik në të cilin realizoheshin shumica e çështjeve arsimore. Mektebet ishin mbështetje të xhamive në arsimimin dhe edukimin e fëmijëve. Në të shumtën e rasteve ishin të ngjitura me xhamitë ose afër tyre. Mësimi i Kur'anit dhe dispozitat e namazit ishin çështjet më të rëndësishme që mësoheshin aty.

Mirëpo, lidhshmëria e xhamisë me mektebet dhe vendet tjera mësimore, nuk ishte gjithnjë në të njëjtën gjendje. Imam Maliku ka dhënë fetva se nuk lejohet mësimi i fëmijëve në xhami, sepse "ata nuk mundën të ruhen nga papastërtitë, si dhe xhamia nuk është vend për arsimim".<sup>233</sup> Më pas ndodhën rrethana ku mësuesit e fëmijëve nuk kishin mundësi të gjejnë vende jashtë xhamive dhe filluan që mektebet t'i bëjnë brenda tyre. Mosinteresi për vendin e mektebeve vazhdoi në disa raste deri në atë pikë sa xhamitë filluan të përdoren si vende për mësimin e disa zanateve. Në librin "Tabakatu ulemai ifrikija" potencohet se një rrobaqepës kishte caktuar xhaminë për t'ua mësuar fëmijëve rrobaqepësinë".<sup>234</sup>

Në periudhën e sahabëve, në xhami, krahas mësimin të Kur'anit, mbaheshin edhe ligjërata rreth sunetit peygamberik, fikhut, letërsisë etj.

<sup>233</sup> Po aty, fq. 114.

<sup>234</sup> Ibn Temim Et-Temimi, Ebu'l-arab Muhamed ibn Ahmed El-Magribi El-Ifriki (v. 333 h./944). Tabakatu ulemai ifrikija ve kitabu tabakatu ulemai Tunuse, Bejrut: Dar'ul-kital Lubnani, 1970, fq. 68.

Në fillim të periudhës emevite u përhapën mexhliet edukative në pallatet e pushtetarëve dhe shtëpitë e prijësve dhe të pasurve. Këto mexhlise shprehnin lindjen e një lloji të ri të institucioneve arsimore, të veçanta për elitën. Mësimi në këto institucione përfshinte: shkencat e Kur'anit, hadithin, gjuhën, poezinë, historinë arabe, etikën dhe rregullat e përgjithshme, menaxhimi i çështjeve të shtetit dhe forma tjera të bashkëveprimit me shtresat e njerëzve dhe ngjarjeve. Më pas, përvoja edukative u zhvillua edhe më shumë derisa u bë profesion i veçantë, me të cilin enkas merreshin edukatorët e mëdhenj.

Mexhliet e diturisë, respektivisht ligjëratat në xhami kanë vazhduar gjatë tërë historisë islame, në atë mënyrë që dijetari ulej para xhematit dhe mbante ligjëratat rreth temave të ndryshme, përfshirë: tefsirin, hadithin, fikhun etj. Krahas kësaj, në shtëpitë e dijetarëve të specializuar në transmetimin e hadithit, komentimin e Kur'anit, fukahave, myftinjve, letrarëve, prijësve të tesavufit u përhapën edhe mexhliet për ligjëratat dhe diktime. Në rast se shtëpia e dijetarit nuk kishte mundësi të përmbledh numrin e madh të nxënësve dhe atyre që dëgjonin ligjëratat, atëherë mexhlisi, respektivisht ligjëratat transferoheshin në sheshet publike.

Si rezultat i rritjes së vlerës së këtyre mexhliseve, domosdoshmërinë e zhvillimit të arsimit të shkencave specialiste dhe përhapjes së shkollave ideologjike dhe fraksionale, lindi ideja për themelimin e shkollave. Shkollat në esencë ishin vend për një dijetar të caktuar. Kështu që shkolla emërtohej me emrin e dijetarit, apo emrin e prijësit që urdhëronte ndërtimin dhe merrte përsipër financimin e saj. Shkollat e para të këtij lloji janë shfaqur në Nisabur. Më pas janë ngritur shkollat e rregullta, përafërsisht kah mesi i shekullit të pestë hixhri. Këto shkolla, me logjikën e ditëve të sodit u përngjajnë fakulteteve. Ato janë themeluar për të mësuar një fushë shkencore. Përgjegjësinë për këtë shkollë e merrte një dijetar, i dalluar dhe i njohur për nga dituria dhe vlera e tij. Një person të tillë, sot është i ngjashëm me titullin profesor specialist. Shkolla e Ebu Hafsit është ndërtuar nga ana e Ebu

Hafsit, i cili ka jetuar në periudhën (150-217 h./767-832) në Buhara. Ngjashëm me këtë është edhe shkolla El-Bejhekije në Nisabur, të cilën e ka themeluar imami dhe muhadithi Ebu Bekr Ahmed ibn El-Husejn El-Bejhekij, i cili ka jetuar në periudhën (384-458 h./994-1066). Po ashtu shkolla El-Sadirije në Damask, e themeluar në vitin 391 h./1001 nga ana e Imam Sadir ibn Abdullahut.

Që nga shekulli i katërt hixhri, shoqëria islame ka përjetuar një garë të madhe mes shkollave juridike (medhhebeve). Për këtë, në shumicën e këtyre shkollave, arsimit ka përfshirë vetëm njërin nga këto shkolla juridike. Secila shkollë kishte mësuesin e vet, i cili ishte i njohur për nga dituria, sjellja dhe përpikëria në njohuritë e medhhebit të tij. Krahas tij kishte edhe një numër të konsiderueshëm të cilët dëshironin të trashëgojnë diturinë e mësuesit të tyre. Këta nxënës ishin të ngjashëm me atë që sot i quajmë asistentë. Këto shkolla ishin të ngjashme me fakultetet e specializuara sot.

Në vitin 459 h./1067, Nidham'ul-Mulki, në Bagdad, për fikhun shafi'i, themeloi shkollën e quajtur En-Nidhamije. Në stilin e saj u themeluan edhe shumë Nidhamije tjera në vende të ndryshme. Shkollat Nidhamije ishin të specializuara për arsimimin enkas të medhhebit shafi'i. Qëllim i Nidham'ul-Mulkit nga themelimi i këtyre shkollave ishte t'ua mësojë njerëzve të vërtetat e Islamit sipas mësimeve të Ehlis-sunetit ve'l-xhema'ah. Kjo kishte ndodhur pasi sundimi i fatimitëve dhe ismailive ishte zgjeruar në Afrikën Veriore, Egjipt, Jemen, në shumë pjesë të tokave të Shamit, si dhe në Irak. Për këtë çështje shkollat Nidhamije ua mësonin njerëzve medhhebin shafi'i, i cili në atë kohë ishte medhhebi i dinastisë së selxhukëve.

Shkollat Nidhamije përfaqësonin një stil administrativ, i cili më pas u ndjek gjatë themelimit të shkollave në gjithë anët e Botës Islame, ngase këto shkolla ishin të specializuara në një lloj të caktuar të arsimit. Këto shkolla ishin të dalluara për nga arkitektura dhe hapësirat që kishin, me klasa dhe shërbime të mira. Për financimin e mësuesve, të punësuarve dhe nxënësve në mënyrë të mjaftueshme, kishte vakëfe që

vinin nga prodhimet bujqësore dhe shitoreve për tregti. Në librin “Ed-Darisu fi tarih’il-medaris” të autorit En-Nuajmi ka të dhëna të argumentuara për qindra shkolla në tokat e Shamit, me sqarime të detajuara rreth themelimit, emrat e themeluesve, mësuesve, mësimeve të zhvilluar dhe vakëfeve të caktuara për to. Këto shkolla kanë qenë të klasifikuara në: shkolla të Kur’anit, shkolla të hadithit, shkolla të fikhut (medhhebeve) ku secila prej tyre ishte e specializuar në një shkollë juridike. Kishte edhe shkolla të mjekësisë. Përveç shkollave, kishte edhe vende tjera për arsimim të njohura me emrat: El-Hanikah, Er-Rebtu, Et-Tirbu dhe Er-Ribatu.<sup>235</sup>

Ndonëse shumica e shkollave emërtoheshin me emrat e mësuesve që ligjëronin në to ose në emër të prijësit që urdhëronte ngritjen e saj, megjithatë disa shkolla emërtoheshin edhe me emrat e vetive të vakëfeve që liheshin për financimin e saj. Kështu kemi shkollën El-Kamhije-grurit, të cilën e kishte themeluar Salahudini në vitin 566 h./1170 pranë xhamisë së Amr ibn Asit në Kajro. Kjo xhami ishte vakëf dhe vepronte sipas medhhebit maliki. Për këtë shkollë kishte lënë vakëf një fushë në Fejum, nga e cila prodhohej shumë grurë dhe u shpërndahej nxënësve dhe të punësuarve në te.<sup>236</sup>

Në anën tjetër, shoqëria islame ka njohur edhe shkolla për shumë medhhebe, ku krahas shkollave juridike janë mësuar edhe shkenca tjera. Shkollë më e njohur në këtë drejtim është shkolla Mustensirije në Bagdad, të cilën e kishte ndërtuar halifi Mustensir Bilah Abasi, i cili kishte udhëhequr në periudhën (623-640 h./1226-1242). Mësimi në këtë shkollë ka filluar në vitin 631 h./1234. Kjo shkollë ishte e ngjashme me një universitet sot, ngase në te kishte një numër të madh të shkollave të specializuara, në secilën shkollë kishte një numër të mësimeve dhe asistentëve. Në te kishte shkollë (fakultet) të kompletuar për fushën e fikhut (jurisprudencës islame)

<sup>235</sup> Abdulkadir Muhamed Ed-Dimeshkij El-Nuajmi, Ed-Darisu fi tarih’il-medarisi, Beirut: Dar’ul-kutub’il-ilmijeti, botimi i parë, 1990. Libri është botuar në dy vëllime. Në përmbajtjen e secilit vëllim mund të shihet numri i madh i shkollave dhe institucioneve tjera të cilat realizonin një lloj të caktuar të arsimit.

<sup>236</sup> El-Makrizi, Tekijudin Ebul Abas Ahmed ibn Ali ibn Abdulkadir, (v. 845 h./1441). El-Mevadihu ve’l-i’tibaru bidhikr’il-hutatit ve’l-athar’il-hutat’il-makrizijetu”, Kajro: Mektebet’ul-thekafet’id-dinijeti, botimi i dytë, 1987, fq. 364.

që ligjëronin dijetarë specialistë në katër medhhebet (shkollat juridike), kishte shkollë për shkencën e hadithit, shkollë për shkencat e Kur'anit, shkollë për mjekësi që udhëhiqej nga mjeku specialist dhe dhjetë mjekë të tjerë që vepronin së bashku me të, pleqësia (ose dekanati) për shkencat fizike dhe tjetër për letërsi arabe, drejtorë për librarinë që ngërthente 450.000 (katërqind e pesëdhjetë mijë) vëllime, drejtori të veçantë për çështjet administrative dhe financiare dhe çështjet e banimit në konvikt dhe ushqimit. Ishte e qartë se pranimi i studentëve bëhej sipas aftësive të tyre në shkrime dhe mësimdhënie. Aty studionin studentë nga gjitha vendet islame asokohe. Shkolla zbatonte sistemin e brendshëm, ku gjendeshin të gjitha kushtet si ato të banimit, qëndrimit, ushqimit, veshjes dhe çështjeve tjera.<sup>237</sup> Kjo shkollë, krahas gjithë kësaj, ofronte edhe shërbime tjera edukative dhe shoqërore, si p.sh. shkolla e veçantë për jetimët e vegjël, krahas xhamisë dhe elementeve të tjera të saj.

Shkolla Mustensirije nuk ishte shkolla e vetme në përfshirjen e specializimeve të ndryshme, respektivisht fakulteteve të ndryshme në universitet. Kështu edhe shkolla Salihije, të cilën e kishte themeluar mbreti Salih Nexhmudin Ejub në vitin 641 h./1243 dhe e kishte bërë vakëf për studimin e fikhut në katër medhhebet. Në lidhje me këtë, Makrizi ka thënë: “Mbreti Salih është i pari në Egjipt që ka organizuar studimin e katër medhhebeve në të njëjtin vend”.<sup>238</sup>

Kur fatimitët pushtuan Egjiptin në vitin 358 h./969, shkollat e tyre të fshehta i shndërruan në xhami, të cilat i kishin ndërtuar për atë që e quanin mexhlise të urtësisë (el-hikmeh). Në mesin e këtyre shkollave në Egjipt ishte edhe xhamia e Ez'herit, e cila ka vazhduar për afër dy shekuj si institucion i madh arsimor për përgatitjen e thirrësve dhe shpërndarjen e tyre në vende të ndryshme. Vazhdoi kështu derisa erdhi Salahudin Ejubi, i cili -akoma duke qenë ministër i halifit fatimit Adid- menjëherë filloi me ndërtimin e shkollave

<sup>237</sup> Ibn Kethir, Ebu'l-Fida El-Hafidh Ismail ibn Omer El-Dimeshkij (v. 774 h./1372). El-Bidajetu ve'n-nihajetu, Bejrut: Mektebet'ul-Mearif, botimi i shtatë, 1988, vëll. 13, fq. 159. Më gjerësisht në lidhje me këtë, lexo: Ma'ruf, Tarihu ulema'il-mustensirijjeti, vepër e cituar.

<sup>238</sup>El-Makrizi, El-Mevaidhu ve'l-î'tibaru....., Vepër e cituar, fq. 374.

sunite. Kështu ndërtoi shkollën Nasirije (sipas emrit Nasir Salahudin) për fukahatë (juristët) e medhhebit shafi'it. Në lidhje me këtë, Makriziu thotë: Ndërtimi i shkollës ishte “prej veprave më madhështore që ishin realizuar në shtet, e cila njëherit ishte edhe shkolla e parë që kishte vepruar në Egjipt”.<sup>239</sup> Më pas, me qëllim që të shlyej gjurmët e periudhës fatimite, kishte shpejtuar në themelimin e shkollave tjera. Prej këtyre shkollave ishin edhe: shkolla El-Kamhije për fukahatë e medhhebit maliki dhe shkolla Es-Sijufije për fukatë e medhhebit hanefi. Ministri i Salahudinit, Kadi El-Fadil kishte themeluar shkollën El-Fadilije, ndërsa mbreti El-Adil vëllai i Salahudinit kishte themeluar shkollën El-Adilije, dhe kështu me radhë. Makrizi ka dokumentuar emrat e dhjetëra shkollave, maristaneve dhe hanikaheve, duke potencuar edhe themeluesit, dijetarët dhe vakëfet e tyre.<sup>240</sup>

Nëse shkolla simbolizonte zhvillimin e arsimit islam, e cila ishte e ngjashme me fakultetin e specializuar rreth një shkençe dhe zhvillimin e saj, ose grup fakultetesh që janë të ngjashme sot me universitetet bashkëkohore, shoqëria islame ka njohur edhe një lloj tjetër të institucioneve arsimore, të cilat mund të llogariten si referenca në diskutimin dhe zhvillimin e disa forma të të kuptuarit dhe përgatitjen për marrjen e vendimeve në çështje të caktuara. Popullata i këtyre shkollave nuk ishin dijetarët dhe studentët, por ata ishin burime të njohurisë dhe konsultime të dijetarëve të mëdhenj me udhëheqësit shtetërorë (halifët dhe emirët). Disa prej këtyre institucioneve, të argumentuar në burimet e trashëgimisë islame janë njohur me emrin “Bejt’ul-Hikmeh” (Shtëpia e Urtësisë) ose “Dar’ul-Ilm” (Shtëpia e Diturisë).

## 7. Zhvillimi në orientimet dhe shkollat ideologjike në trashëgiminë e pedagogjisë islame

Trashëgimia pedagogjike islame nuk përfshin vetëm atë që ishte e njohur me emrin shkencat e sheriatit (shkencat e

<sup>239</sup> Po aty, vëll. 2, fq. 363.

<sup>240</sup> Po aty, fq. 362-414.

Kur'anit, hadithit dhe fikhut), por këto shkencë shoqëroeshin edhe nga fusha tjera shkencore, për të cilat rritej interesi dhe atë për shkaqet vijuese: lindja e fraksioneve dhe shkollave, për të cilat garonin dhe polemizonin dijetarët e tyre, si dhe rritja e volumit të diturisë deri në atë nivel sa që disa studentë specializoheshin vetëm në një shkencë, që i bënte ata të thelloheshin në te dhe ta zotëronin atë mirë. Shkak tjetër është edhe zhvillimi i anës materiale në shoqëri, gjë që ndikoi që disa dijetarë të tërhiqen nga të mirat materiale dhe të preferojnë misticizmin. Shkak tjetër është edhe bashkëveprimi me trashëgiminë e civilizimeve tjera me anë të përkthimit, si dhe kontakti i drejtpërdrejtë përmes udhëtimeve dhe vizitave dhe faktorëve tjerë.

Ky zhvillim çoi drejt daljes në skenë të dijetarëve të specializuar në shkencë të veçanta, deri në atë nivel sa që është bërë i dalluar në atë specializim dhe është bërë shkollë në vete. Për të mësuar prej tij, shkonin studentët nga gjitha vendet. Nga mesi i këtyre dijetarëve të specializuar në fusha të ndryshme kishte: El-Mukri' (dijetar i dalluar i leximit të Kur'anit), El-Muhaddith (specialist në fushën e hadithit), El-Mutekel-lim (specialist në fushën e apologetikës), El-Fekih (specialist në fushën e jurisprudencës islame), El-Edib (specialist në fushën e letërsisë), Et-Tabib (specialist në fushën e mjekësisë), El-Felekij (specialist në fushën e astronomisë), El-Sufij (specialist në fushën e edukimit shpirtëror), El-Muerrih (specialist në fushën e historisë) etj. Krahas dallimeve të tyre në specializime, në atë që kanë shkruar, shumë prej tyre kishin qëndrime unike rreth vlerës së dijes, mësimnxënies dhe mësimdhënies, rregullat e mësuesit dhe nxënësit, metodat e mësimdhënies, llojet e shkencave, institucionet arsimore, si dhe çështje tjera të njohura në trashëgiminë pedagogjike islame. Edhe krahas kësaj pike të përbashkët mes dijetarëve, metodologjitë në shkrimet e tyre ishin të ndryshme, deri në atë nivel sa që secili grup i dijetarëve kishte orientimin, rrymën, drejtimin dhe shkollën gjatë shkrimit në fushën e edukimit dhe të arsimit. Kështu kanë lindur shkolla të ndryshme, si: shkolla e fukahave, muhadithëve, historianëve, mjekëve, sufistëve, mutekeli-

mëve, filozofëve etj. Në këtë drejtim vërejmë se disa hulumtues bashkëkohorë, shkrimet në trashëgiminë pedagogjike islame i klasifikojnë në kuadër të asaj që e quajnë rryma,<sup>241</sup> orientime,<sup>242</sup> fusha.<sup>243</sup> Megjithatë, ekziston mundësia që disa dijetarë të përfshihen në dy shkolla a më shumë. Shumica e muhadithëve kanë njohur hadithin dhe fikhun. Disa letrarë kanë njohur letërsinë dhe apologetikën. Disa sufistë ishin edhe fekihë, ndërsa disa filozofë ishin edhe historianë.

Kur është për qëllim sqarimi se cila fushë shkencore ka qenë dominuese në shoqërinë islame në periudha kohore të ndryshme, mund të thuhet se lëvizja ideologjike dhe shkencore në ndonjë periudhë të caktuar, dominohej nga fikhu ose hadithi ose tesavufi ose filozofia. Është e njohur se në shekullin e dytë dhe fillimin e shekullit të tretë të hixhretit në mënyrë të dalluar ka dominuar fikhu. Në këtë periudhë lindën katër medhhebet e Ehli sunetit ve'l-xhemaah. Në skenë doli Ebu Hanife (v. 150 h./767), Malik ibn Enesi (v. 179 h./795), Muhamed ibn Idris Shafiu (v. 204 h./819) dhe Ahmed ibn Hanbeli (v. 241 h./855).

Nuk duhet harruar se një pjesë jo e vogël e metodologjisë së tyre juridike, në mënyrë mjaft të madhe mbështetej në hadith. Pjesa e shkruar e hadithit në fillim të shekullit të dytë, e cila u bë temë e rëndësishme për transmetim në shoqërinë islame, në shekullin e tretë është zhvilluar edhe më shumë. Kështu në këtë shekull, u bë aktiv klasifikimi i haditheve, ndarja e tyre në kapituj dhe pastrimi i tyre. Gjashtë koleksionet e hadithit: dy sahihat (Buhariut dhe Muslimit) dhe katër sunenet (Ibn Maxhes, Ebu Davudit, Tirmidhiut dhe Nesaiut) janë shkruar në këtë shekull. Imam Buhariu ka vdekur në vitin 256 h./870, Imam Muslimi në vitin 261 h./875, Ibn Maxheh në vitin 273 h./886, Ebu Davudi në vitin 275 h./888, Tirmidhiu në vitin 279 h./892 dhe Nesaiu në vitin 303 h./915.

<sup>241</sup> Organizata arabe për edukim, kulturë dhe shkencë, *El-Fikr'ut-terbeviij'ul-arabij'ul-islamijji: el-usulu ve'l-mebadiu*, Tunizi, 1987, fq. 582-716.

<sup>242</sup> Seid Ismail Ali, *Ittixhahat'ul-fikr'it-terbeviij'il-islamijji*, pjesa e pestë e enciklopedisë: Zhvillimi civilizues i pedagogjisë islame, Kajro: Dar'us-selam, 2010.

<sup>243</sup> Abdulemir Shemsudin, *El-Fikr'ut-terbeviiju inde Ibni Sehnun ve'l-Kabisij, dirasetun ve tahlil*, Bejrut: Esh-Sheriket'ul-alemijjetu li'l-kitabi, 1990.



Dallimi i zhvillimit kohor të themelimit të këtyre shkollave në trashëgiminë islame nuk është çështje e lehtë. Këto shkolla në të shumtën e rasteve ishin në të njëjtën kohë. Kështu, Ibn Sehnuni, përfaqësuesi më i dalluar i shkollës së fikhut ka vdekur në vitin 256 h./870. Kindiu, përfaqësuesi më i njohur i shkollës filozofike, ka vdekur në të njëjtin vit, pra më 256 h./870. Xhahidhi, përfaqësuesi më i njohur i shkollës së letërsisë, ka vdekur një vit më herët, pra më 255 h./869. Harith Muhasibi mund të llogaritet përfaqësues i shkollës sufiste, i cili ka vdekur në vitin 242 h./856. Të gjithë këta, kanë dhënë kontribut të dalluar në trashëgiminë pedagogjike.

Zhvillimi dhe ndryshimi janë veti elementare në mendimin njerëzor. Mendimi, në esencë është prodhim i mendjes njerëzore në dritën e interesimeve të veçanta të dijetarëve dhe mendimtarëve. Interesimet e fukahave si rasti i Ibn Sehnunit, i letrarëve si rasti i Xhahidhit, i filozofëve si rasti i Kindiut janë interesime të ndryshme, ndonëse që të tre kanë jetuar në të njëjtën kohë. Secili prej tyre ka pasur metodologjinë e vet dhe çështjet me të cilat është preokupuar. E gjithë kjo e arsyeton ekzistimin e mendimit pedagogjik fikhor, mendimit pedagogjik filozofik, mendimit pedagogjik letrar, mendimit pedagogjik sufist dhe kështu me radhë. Pastaj, përvojat e dijetarëve ndryshojnë dhe zhvillohen sipas rrethanave të kohës dhe të vendit. Kështu, rrethanat ndryshojnë, përvojat zhvillohen dhe në fund edhe rezultati po ashtu ndryshon.

Është e vërtetuar se zhvillim ka pasur në secilën shkollë, duke u bazuar çdo shkollë në atë paraprake. Kështu, Malik ibn Enesi, ka dhënë fetva në shumë prej çështjeve të fikhut të veçanta për çështjet e arsimit. Këto fetva i ka transmetuar nga ai Ibn Kasim, ndërsa i ka kontrolluar, përmirësuar dhe renditur Imam Sehnuni në librin “El-Mudevvenet’ul-kubra”. Kështu libri “El-Mudevvenet’ul-kubra” iu atribua Sehnunit. Më pas këtë libër e transmeton djali i tij Muhamed ibn Sehnun në librin “Adabul mualimine”. Pjesën më të madhe të çështjeve të këtij libri i ka përfshirë el Kabisiu në librin e tij “El-Risalet’ul-mufessaletu li ahval’il-mutekel-limine ve ahkam’il-mual-limine ve’l-muteal-limine”.

Libri i Kabisiut është një shembull i qartë i një forme të zhvillimit. Ky libër në esencë është përgjigje ndaj pyetjeve të cilat një njeri ia ka parashtruar Kabisiut. Këto pyetje në të shumtën e rasteve janë të fushës së fikhut. Në tekstin e parashtrimit të pyetjeve ka shprehje të cilat shpalosin gjendjen e arsimit të pyetësi dhe ai që përgjigjet. Këtu, shihet zhvillimi mes librit të Ibn Sehnunit dhe librit të Kabisiut. Materia e secilit libër shpalos çështjet e diskutuara në kohën e tij, ndonëse të dy librat i takojnë të njëjtës fushë, respektivisht fushës së fikhut gjatë trajtimit të çështjeve arsimore. Që të dy librat kanë folur rreth arsimit në mektebe, e jo në fazat tjera të arsimit.

Transmeton Ibn Sehnuni nga babai i tij se ka thënë: “Kam qenë prezent te Sehnuni kur ka gjykuar për hatme për një person, dhe atë sipas gjendjes materiale të njeriut. I është thënë atij: mendoj se mësuesi ka të drejtë t’u jep leje fëmijëve sot? Ka thënë: Njerëzit kanë vazhduar të veprojnë kështu...”. Kur është pyetur rreth dhuratave që i japin fëmijët mësuesit të tyre, ai nuk ka lejuar, përpos me lejen e prindërve të tyre. Në lidhje me gjendjen e njerëzve të kohës së tij, ka thënë: “Për këtë, dëshmia e shumicës së mësimeve nuk pranohet, sepse ata nuk janë duke e kryer obligimin e tyre, në përjashtim të atyre që i ka mbrojtur Allahu”.<sup>244</sup>

Ka edhe disa të dhëna që flasin për disa praktika të njerëzve në kohën e tyre. Është pyetur: a lejohet ajo që bëjnë njerëzit gjatë hatmes kur ua gjuajnë njerëzve frutat: ka thënë: “Nuk lejohet”.<sup>245</sup>

Ngjashëm me këtë thuhet edhe për librin e Kabisiut, ngase edhe ajo shpreh gjendjen e kohës së tij. Brenda e librit përfshin fetvatë rreth pyetjeve dhe çështjeve të kohës së tij, dhe se fetvaja përpilohej në atë mënyrë që tregonte gjendjen e përhapur mes njerëzve dhe kishte marrë format e traditës nga ana e masës. Në lidhje me çështjen e hatmes, ai thotë: “Pasi hatmeja ishte me mësimin e tërë Kur’anit, është bërë obligim ndaj atij që e ka kryer, nga ana e traditës së masës. Sipas traditës duhet pranuar si obligative. Edhe pse nuk është kushtëzuar

<sup>244</sup> Ibn Sehanun, *Kitabu Adab’il-mual-limine*, vepër e cituar, fq. 95.

<sup>245</sup> Po aty, fq. 99.

diçka e caktuar, ajo është obligative në çdo gjë që është përhapur në mesin e masës së thjeshtë dhe e kanë zbatuar atë”.<sup>246</sup>

Ngjashëm me këtë kemi edhe atë se ai jep fetva se është mekruh që mësuesi të merr dhurata gjatë festave të të krishterëve, si në festat e pashkëve dhe të tjera. Ai thotë: “Nuk lejohet për atë që e vepron, e as për atë që e pranon prej mësuesve. Kjo është madhërim i shirkut dhe madhërim i ditëve që shprehin kufër ndaj Allahut. Po ashtu është e urryer të merret diçka në festat e krishterëve dhe të hebrenjve. Fëmijët nuk duhet të gëzohet në këto festa. E gjithë kjo nuk pranohet nga ana e muslimanëve dhe u është e ndaluar. Mësuesi duhet të refuzojë të pranojë dhurata prej tyre në këto ditë, me qëllim që injoranti i tyre të kuptojë se është gabim dhe të heqë dorë, si dhe të turpërohet mendjelehti i tyre dhe ta braktisë atë”.<sup>247</sup>

Prej çështjeve që i ka diskutuar Kabisiu, për të cilën ka folur në mënyrë të qartë, dhe të njëjtën nuk e kemi gjetur tek Ibn Sehnuni e as te të tjerët është edhe ajo se ndonëse ekzistojnë shumë ajete dhe hadithe që nxisin në kërkim të ditorisë, flasin për përgjegjësinë e prindërve rreth arsimimit të fëmijëve dhe informacioneve rreth përgjithësimit të arsimit nga ana e udhëheqësve dhe dijetarëve, megjithatë arsimi në shoqërinë islame nuk ishte obligativ, e marrë përsipër nga ana e shtetit, por ishte çështje e mbetur në përgjegjësinë e prindërve. Kabisiu duke folur për përgjegjësinë e arsimimit të fëmijëve ka theksuar nivelet e përgjegjësisë, të cilat ai i rendit si më poshtë: babai, nëna, përgjegjësi, grupi i muslimanëve (xhemati), pushtetari. Duhet të jetë në atë mënyrë që mos të mbetet asnjë fëmijë pa arsimim. Siç shihet ky është formulim i parimit të obligueshmërisë së arsimit.<sup>248</sup>

Prej çështjeve të zhvillimit që kanë ndodhur në gjuhën dhe praktikën e trashëgimisë pedagogjike, dhe ka dalë si rezultat i llojllojshmërisë së shkollave ideologjike janë edhe disa çështje, të cilat i ka futur tesavufi në raportet edukative dhe arsimore mes shejhut-mësuesit dhe muridit-nxënësit. Nënshtrimi i plotë ndaj shejhut, zbatimi i verbët i urdhrave të tij dhe

<sup>246</sup> El-Kabisij, *El-Risalet'ul-mufessaletu....*, vepër e cituar, fq. 152.

<sup>247</sup> Po aty, fq. 153-154.

<sup>248</sup> Po aty, fq. 94.

besimi absolut ndaj pozitës së tij, nuk ishin çështje të njohura në fillim të Islamit, e as në praktikat asketike dhe tërheqjes në vete te tabiinët. Po ashtu, edhe termet e edukatës sufiste si: el-hadreh, et-tehali, et-texheli, el-muxhahedeh, el-shuhud, el-fenau, el-mekamatu, edh-dhahiru, el-batinu, er-rusumu, she-tahatu teel-luh, el-hulul, el-ittihadu e tjerë, që të gjitha ishin të reja, por ishin prezente me maturi te rasti i Muhasibiut (v. 243 h./857), Xhunejdit (v. 297 h./909), Xhilanit (561 h./1166), Suhraverdi Bagdadit (v. 632 h./1234) dhe në mënyrë ekstreme te Hal-laxhi (v. 309 h./921), Muhjidin ibn Arabiut (v. 638 h./1240), Ibn Seb'init (v. 660 h./1262) etj.

Nga rastet që folëm më sipër, mund të përfundojmë se ato nuk kanë përfshirë vetëm zhvillimin dhe ndryshimin nga një gjendje në tjetër, por po ashtu kanë përfshirë ndryshimin dhe llojllojshmërinë në ixhtihad dhe qëndrime. Kështu vërejmë se disa çështje kanë qenë temë diskutimi për disa shekuj. Pjesa dërrmuese e polemikave ishte si rezultat i hulumtimit në hadithet pejgamberike, ngase ndonëse çdo hadith ka kontekstin dhe rastin, megjithatë disa hadithe ishin në një drejtim dhe disa të tjerë në drejtim tjetër. Shumë mendime të dijetarëve anonimë janë drejt abstenimit në shenjë të ikjes nga e dyshimta (el-verau), ndërsa ikja nga e dyshimta në disa raste është zgjedhje personale ose fetva për një rast të veçantë. Edhe krahas asaj se gjendja e shoqërisë ndryshonte dhe zhvillohej, miratonin dispozita të caktuara, bazuar në parimin “gjërat në esencë janë të lejuara”, megjithatë shumica e dijetarëve të mëvonshëm, preferonin të mbesin te fetvatë e dijetarëve të mëhershëm. Nuk duhet harruar edhe atë se realiteti shoqëror dhe natyra e marrëdhënieve mes individëve dhe grupeve fillon në mënyrë të thjeshtë, pastaj vazhdon të komplikohet, gjë që kërkon nevojën për sjelljen e ligjeve dhe ndërtimin e institucioneve. Nuk mjafton që çështjet e njerëzve të lihen në ndërgjegjen e tyre fetare, por duhet rregulluar të drejtat dhe obligimet në formën më të mirë.

Medituesi rreth ngjarjeve të cilat i gjen në trashëgiminë pedagogjike, vëren një llojllojshmëri të gjerë në qëndrime dhe raste për nga afërsia ose largimi nga tekstet kur'anore dhe

pejgamberike. Në veçanti kur flitet për pozitën e mësuesit (në veten e tij, para nxënësve dhe shoqërisë), përgjegjësisë rreth arsimit (se a është përgjegjësi e familjes apo e shtetit), pagës për arsim (a lejohet apo jo?), raportit të mësuesit me pushtetarët (lejohet apo jo?) etj. Tekstet kur'anore të cilat ndërliken me diturinë, mësimdhënien, mësimnxënien, mjetet mësimore (fletushkat, librat, lapsat), procesi i leximit dhe shkrimit, metodat mësimore, tërheqja e vëmendjes, përkujtimi për meditim, meditim i rrëfimeve, shembujt, dialogu, gradualiteti e tjera, që të gjitha nxisin njeriun që dëshiron të udhëzohet me udhëzimin e Allahut, që të jetë në vazhdimësi në proces të mësimnxënies dhe mësimdhënies, në kërkim të shtimit të diturisë, konsiderimin e analfabetizmit, injorancës dhe diturisë së pakët si mangësi për njeriun, vënien e kërkimit të diturisë në përgjegjësinë e individit dhe përgjegjësinë e atij që është nën kujdesin e tij, bile edhe në përgjegjësinë e komshiut dhe mbarë shoqërisë. Kështu që çdo individ në shoqëri është bari dhe është përgjegjës për kopenë e tij.

Hadithet pejgamberike kanë ardhur për të sqaruar udhëzimin kur'anor me qëndrime, raste, shembuj, praktika, të cilat janë të shumta, të llojllojshme dhe të përgjithshme saqë tërë jeta e Muhamedit alejh'is-selam mund të sondërrohet në qëndrime arsimimi për shokët dhe umetin e tij.

Bazuar në atë që mund të kuptojmë nga ajetet kur'anore dhe hadithet pejgamberike rreth intencave islame, mund të vërejmë se trashëgimia pedagogjike islame -edhe krahas asaj se pamë forma të realizimit të këtyre intencave në jetën arsimore të shoqërisë islame- zbulon raste të dobësisë, prapambetjes dhe devijimit në praktika, ka shkaktuar përçarje, mospajtime të thella dhe luftëra të përgjakshme brenda vetë shoqërisë islame, si dhe paaftësi në përballimin e sfidave dhe fuqive ushtarake të jashtme.

Bazuar në intencat e Islamit, jemi këmbëngulës se Islami nuk lejon që në shoqërinë islame të mbetet një individ që pajtohet me injorancë për veten e tij ose hesht ndaj injorancës së tjetrit. Arsimi sipas Islamit është obligativ, ku muslimani do të mësojë nga dituria aq sa të jetë musliman i drejtë dhe i

denjë, ndërsa nga umeti duhet të gjenden individë ose grupe të cilët në mënyrë të përkryer mësojnë të gjitha shkencat teorike dhe praktike, që i sigurojnë umetit të gjitha kërkesat që mundësojnë përparimin dhe fuqinë, gjë që këtë umet e bënë ashtu siç dëshiron Allahu, umeti më i mirë në mesin e njerëzve, shembull i gjallë i vlerave të së mirës dhe drejtësisë, formë praktike e pastrimit të njeriut mëkëmbës në tokë dhe përparimi i tokës me shkencë dhe civilizim.

## Pjesa e tretë:

# Mendimtarët pedagogë të trashëgimisë pedagogjike, veprat dhe shkollat e tyre

### 1. Mendimtarët pedagogë dhe veprat e tyre

Më parë theksuam se trashëgimia pedagogjike në kuptimin e gjerë përfshin çdo gjë që është shkruar prej qëndrimeve, dhe se përmbajtjet e trashëgimisë mund të jenë temë arsimimi, ndërsa në kuptimin e ngushtë përfshin çështjet që janë shkruar rreth mësuesit, nxënësit dhe arsimit. Sipas kuptimit të parë, çdo gjë që është shkruar rreth mexhliseve të diturisë në xhami, shtëpi apo diku tjetër, çdo gjë që është shkruar në fikh, hadith, tefsir, matematikë, astronomi, mjekësi e tjera, ai që ligjëron ndonjë shkencë dhe përreth tij nxënës që dëgjojnë dhe shkruajnë, e gjithë kjo llogaritet nga trashëgimia pedagogjike. Në bazë të kësaj, të gjithë dijetarët e umetit janë dijetarë të trashëgimisë pedagogjike, gjitha librat e tyre dhe librat që janë shkruar për ta janë literaturë e trashëgimisë pedagogjike. Sipas kuptimit të dytë, trashëgimia pedagogjike përfshin çdo gjë që është shkruar rreth rregullave të mësuesit dhe nxënësit, metodat mësimore, tematikat të cilat i ligjërojnë mësuesit dhe i mësojnë nxënësit, institucionet në të cilat zhvillohet mësimi, mjetet mësimore si letrat, lapsat, librat etj. Bazuar në këtë, mendimtarët pedagogë të trashëgimisë pedagogjike janë dijetarët të cilët kanë shkruar në këto tema të caktuara, po edhe nëse kanë shkruar libra tjera me përmbajtje tjera.

Disa hulumtues janë zgjeruar dhe kanë llogaritur mendimtarë pedagogë sipas kuptimit të gjerë, derisa edhe Omer ibn Hatabin, Ali ibn Ebu Talibin, Abdullah ibn Mes'udin, Malik ibn Enesin, Muhamed ibn Idris Shafiun, Halil ibn Ahmed Ferahidiun i kanë konsideruar mendimtarë pedagogë të trashëgimisë pedagogjike. Nuk ka dyshim se këta persona kanë pasur qëndrime arsimore shumë të rëndësishme, mirë-

po, ata nuk kanë lënë pas vete trashëgimi të shkruar të veçantë në edukim dhe arsimim. Disa prej tyre kanë qenë personalitete të dalluara në udhëheqësi, gjykatë dhe politikë. Disa të tjerë kanë qenë të dalluar në fetva ose transmetimin e haditheve ose në tefsir. Disa të tjerë kanë qenë të dalluar në gjuhë, letërsi dhe poezi. Çështja se ata nuk kanë shkruar libër rreth arsimit, nuk humb aspak vlerën e asnjërit prej tyre.

Është e njohur se fillimi i regjistrimit, respektivisht shkrimin në periudhën islame ishte me shkrimin dhe grumbullimin e haditheve, duke e transmetuar çdo gjë që ishte e mësuar përmendësh që të shkruhej në libra. Disa nga tabiinët janë marrë edhe me shkrimin e çdo gjëje që kanë dëgjuar nga sahabët, pa u marrë me ndarjen e tyre në kapituj, dhe në disa raste pa bërë dallimin mes haditheve pejgamberike dhe fjalët e sahabëve dhe tabiinëve (el-athar). Më pas, Malik ibn Enesi shkroi librin e tij "El-Muvetta'", duke i radhitur hadithet sipas temave të fikhut. Më pas filluan disa libra të hadithit të përfshijnë hadithe të cilat potencojnë vlerën e diturisë dhe dijetarëve, rëndësinë e kërkimit të diturisë dhe gjitha çështjet që ndërlidhen me diturinë, mësuesin dhe nxënësin, siç kishte bërë Imam Buhariu në Sahihun e tij dhe Imam Muslimi në Sahihun e tij. Imam Buhariu kishte shkruar aq larg sa që përmbajtjet rreth diturisë "Kitab'ul-ilmi" e kishte radhitur të tretin pas përmbajtjeve të shpalljes "Kitab'ul-vahji" dhe përmbajtjeve të besimit "Kitab'ul-imani". Më pas ka përfshirë përmbajtjet e fikhut "Kitab'ul-fikhi" dhe përmbajtje tjera derisa kishin arritur në 97 përmbajtje, respektivisht kapituj.

Këto hadithe dhe çështjet që ndërlidhen me to, si fjalët e sahabëve dhe tabiinëve kanë qenë si referencë elementare për shumë prej librave të shkruara më pas dhe të cilat përfshihen në atë që e quajtmë trashëgimi pedagogjike.

Është natyrshëm që njeriu si individ të anon drejt ndonjë lloji të caktuar të interesimeve. Kështu në këtë lloj bëhet i dalluar dhe i njohur, ngase çdo person e ka të lehtë në fushën për të cilën është krijuar. Kështu Muhammedi alejh'is-selam ka autorizuar disa nga disa sahabë për ndonjë çështje, duke llogaritur si më të thirrur për ndonjë çështje se sa të tjerët. Për



Muadh ibn Xhebelin ka thënë se është më i njohur rreth hallallit dhe haramit. Për Ubej ibn Ka'bin ka thënë se është më i njohur me leximin e drejtë të Kur'anit. Për Zejdin ka thënë se është më i ditur në fushën e trashëgimisë (el-feraid). Për Ebu Ubejden ka thënë se është i besueshmi (sekretari) i këtij umeti. Për Uthmanin ka thënë se është personi ma i turpshëm në mesin e sahabëve. Për Ebu Bekrin ka thënë se është më i mëshirshmi. Ndërsa për Omerin ka thënë se është më i rrepti kur është fjala për ligjet e Zotit.

Historia islame më pas njih një numër të madh të tabiinëve të cilët janë vendosur në vende të ndryshme të shtetit islam si në: Mekë, Medinë, Sham, Basra, Egjipt dhe vende tjera. Historianët kanë dalluar në secilin prej këtyre vendeve disa shtresa të dijetarëve në sferat e fikhut, hadithit, Kur'anit etj. Për shembull, nga shtresa e parë në Medinë kanë përfshirë shtatë persona nga tabiinët, në mesin e të cilëve edhe Seid ibn Musejib. Në shtresën e dytë Ibn Shihab Zuhrij. Në shtresën e tretë Malik ibn Enesi. Që të gjithë këta kanë mbajtur ligjërata publike dhe të veçanta. Përreth tyre ka pasur nxënës, ndonëse nuk kemi hasur që ndonjëri prej tyre të kishte shkruar shkrime të posaçme rreth çështjeve të arsimit.

Më pas, pas këtyre vërejmë disa nga tabiinët janë pyetur rreth disa çështjeve të arsimit, duke iu përgjigjur atyre. Më pas vjen dikush që transmeton përgjigjet e tyre të përfshira në libra dhe të njëjtat bëhen pjesë e rëndësishme e trashëgimisë pedagogjike. Kështu ishte rasti me Imam Malikun (v. 179 h./795) nga i cili një pjesë të fikhut të tij e kishte transmetuar Abdurrahman ibn Kasim (v. 191 h./807). Prej tij e kishte dëgjuar Abduselam ibn Seid i njohur me emrin "Sehnun" (v. 240 h./854). Sehnuni këtë e kishte regjistruar dhe ia kishte paraqitur Ibn Kasimit, gjë që ky i fundit e kishte lejuar. Këto shkrime u grumbulluan në librin "El-Mudevvenet'ul-kubra". Pjesën më të madhe të këtij libri e kishte transmetuar Ibn Sehnuni (v. 256 h./870) në librin e tij "Adab'ul-mual-limine".

Nga mesi i këtyre dijetarëve është edhe Imam Shafiiu (v. 204 h./819), i cili konsiderohet nga shtresa e katërt e fukahave të Mekës. Si libër i tij është i njohur libri "Xhema'ul-ilmi", i

cili nuk flet për çështje të arsimit, por flet për marrjen e diturisë nga burimet e tij. Atë që ka përfshirë në këtë libër janë çështje të usuli-fikhut. Në veçanti, pozita e sunetit me Kur'anin, mënyra e pranimet dhe refuzimit të informacioneve, argumenti i prerë dhe jo i prerë, çështjet e ixhtihadit, kijasit dhe ixhmasë, dituritë e përgjithshme dhe ato të veçanta.

Prej të parëve që kanë shkruar me tituj që ndërlidhen me kuptimin e ngushtë të trashëgimisë pedagogjike është Ebu Hanife (v. 150 h./767), i cili ka shkruar librin e tij "El-Alimu ve'l-muteal-limu". Ky libër është në formën e një transmetimi, të cilin e transmeton nxënësi "Ebu Mukatil" nga mësuesi "Ebu Hanife" me qëllim që të përfitohet nga mexhlisi i tij. Këtu janë përfshirë pyetje, të cilat i parashtron nxënësi duke kërkuar nga mësuesi fetva që sjellin dobi. "Dëshiroj të jem i ditur rreth çështjeve bazë të së vërtetës dhe të flas me te, ... nëse vjen ndonjë nxënës dhe kërkon diç prej meje, do t'ia sqaroj atij, në atë mënyrë që të jem i vetëdijshëm në atë që e them".<sup>249</sup> Temat e pyetjeve dhe përgjigjeve janë çështje rreth vlerës së diturisë, rukneve të besimit, njëshmërinë e fesë, divergjencat e legjislacioneve dhe shkaqet e mospajttimeve mes dijetarëve. Ajo që bie në sy në këtë libër, se përgjigjet e mësuesit janë të kufizuara dhe të shkurtra, sipas pyetjes. Kjo është një metodologji mësimore, përmes së cilës i jepet hapësira nxënësit të kupton përgjigjen, më pas ta zgjerojë atë, duke nxjerrë përgjigje të reja me qëllim që para se të kalojë në temë tjetër, të përfshijë temën nga gjitha anët.

Kështu pra, nga shekulli i dytë hixhri, shoqëria islame ka përjetuar një aktivitet të shtuar në regjistrimin e diturisë, përfshirë tematikat e ndryshme dhe degët e tyre, në atë mënyrë që janë bërë shkenca të veçanta dhe dijetarët janë dalluar me to. Ndonëse shumica e këtyre dijetarëve kanë qenë mësues, të cilët kanë shkruar lëndën dhe janë marrë me çështjen e të mësuarit apo diktimit para nxënësve, ku çështjet e shkruara dhe të diktuarat kanë qenë çështje që ndërlidhen me vlerën e diturisë, si dhe rregullat dhe dispozitat e mësimin, megjithatë

<sup>249</sup> En-Nu'man ibn Thabit Ebu Hanife, *El-Alimu ve'l-muteal-limu*, transmetimi i Ebu Mukatilit, Kajro: Mektebet'ul-Hanxhi, 1368 h./1949, fq. 9.

nuk kemi hasur një shkencë e veçantë e cila quhet shkencë mbi edukatën ose shkencë mbi arsimin, siç kemi hasur shkencën e fikhut, shkencën e hadithit, shkencën e matematikës, shkencën e historisë etj. Dijetarët të cilët kanë shkruar tekste të dalluara në temat e arsimit, të cilat përfshihen në trashëgiminë pedagogjike, ata janë dijetarë të njohur në specializimet e tyre në fikh, hadith, letërsi, histori etj.

- Në vazhdim do të sjellim emrat e mendimtarëve pedagogë të trashëgimisë pedagogjike islame dhe veprat e tyre, dhe atë sipas kuptimit të ngushtë të kësaj trashëgimie. Pra, mendimtarët pedagogë të cilët kanë shkruar vepra të veçanta rreth çështjeve të arsimit. Këto vepra njihen nga titujt e tyre dhe emrat e këtyre pedagogëve janë të dalluara dhe të njohura ngase janë përfshirë nga shumë studime bashkëkohore, dhe konsiderohen si shembuj të drejtpërdrejtë të trashëgimisë pedagogjike islame.

Emrat dhe veprat e tyre:

- Muhamed ibn Sehnun (v. 256 h./870) me veprën "Adab'ul-Mual-limine".

- Ibn Xhezar Kajrevani (v. 369 h./979) me veprën "Sijaset'us-sibjani ve tedbiruhum".

- Ebul Hasen Kabisij (v. 403 h./1012) me veprën "Er-Risalet'ul-mufessaletu li ahval'il-mual-limine ve ahkam'il-mual-limine ve'l-muteal-limine".

- Abdulkerim Sem'ani (v. 562 h./1167) me veprën "Adab'ul-implai ve'l-istimplai".

- Burhanuddin Zernuxhi (v. 593 h./1197) me veprën "Ta'lim'ul-muteal-lim tarikat'ut-ta'limi".

- Jahja ibn Sherefudin Nevevi (676 h./1277) me veprën "Adab'ul-alimi ve'l- muteal-limi ve'l-mufti ve'l-mustefti ve fadlu talib'il-ilmi".

- Bedrudin ibn Xhemaah (v. 733 h./1332) me veprën "Tedhkiret'us-samii ve'l-mutekel-limi fi edeb'il-alimi ve'l-mutekel-limi".

- Abdulatif ibn Abdurrahman Ganim (856 h./1452) me veprën "Shifa'ul-muteel-limi fi edeb'il-mual-limi ve'l-muteal-limi".

- Abdulbasit Almevi (v. 981 h./1573) me veprën “El-Muidu fi adab’il-mufidi ve’l- mustefidi”.

- El-Mensur bil-lahi Husejn ibn Kasimi (v. 1050 h./1640) me veprën “Adab’ul-ulemai ve’l-muteal-limine”.

- Ebu’l-Mevahibi Jusi (v. 1102 h./1691) me veprën “El-Kanunu ala ahkam’il-ilmi ve ahkam’il-muteal-limine”, si dhe shumë vepra tjera.

Në mesin e këtyre mendimtarëve pedagogë të trashëgimisë pedagogjike islame me plot të drejtë ka edhe shumë dijetarë tjerë, librat e të cilëve nuk kanë qenë të veçanta sikur librat e lartshënuara. Mirëpo, ata në librat e tyre kanë folur rreth çështjeve të arsimit, jo më pak se sa kanë folur të tjerët.

Prej këtyre veçojmë:

- Muhamed ibn Sa’d (v. 230 h./844) me veprën “Et-Tabekat’ul-kubra”.

- Harith Muhasibi (v. 243 h./857) me veprën “Risalet’ul-mustershidine”.

- Ebu’l-Hasen Amiri (v. 381 h./991) me veprën “El-I’lamu bi menakib’il-islami”.

- Ebu Hajjan Tevhidi (v. 414 h./1023) me veprën “El-Imtau ve’l-muannesetu”.

- Ebu’l-Ferexh Ibn Xhevzi (v. 597 h./1201) me veprën “Kitab’ul-kisasi ve’l-medhekkirine”.

- Shihabudin Jakut Hamevi (v. 626 h./1229) me veprën “Mu’xhem’ul-buldani”.

- Ebu’l-Abbas Ibn Ebi Usajbiah (v. 668 h./1269) me veprën “Ujun’ul-enbai fi tabekat’il-etibbai”.

- Muhamed ibn Ebu Bekr Ibn Kajjim (v. 751 h./1350) me veprën “Tuhfet’ul-mevdudi bi ahkam’il-mevludi”.

- Abdurrahman ibn Haldun (v. 808 h./1405) me veprën “El Mukaddimetu”.

- Abdulkadir Nuajmi (v. 978 h./1570) me veprën “Ed-Darisu fi tarih’il-medarisi”.

- Haxhi Halife (v. 1067 h./1657) me veprën “Keshf’udh-dhununi an esam’il-kutubi ve’l-fununi” .

Përzgjedhja jonë ndaj emrave të këtyre mendimtarëve pedagogë dhe veprave të tyre përfaqëson llojllojshmërinë dhe

shpërndarjen gjatë shekujve të historisë islame. Vërejmë se emrat e autorëve dhe titujt e veprave janë njohur në sferat e letërsisë, historisë, mjekësisë, gjeografisë, tesavufit, mirëpo secili libër prej tyre përfshin një pjesë ku flitet rreth çështjeve të diturisë, mësimnxënies, mësimdhënies, institucioneve mësimore, biografisë dhe moralit të dijetarëve (mësuesve).

## 2. Shkollat e trashëgimisë pedagogjike

Çështja e diturisë u zhvillua, duke përfshirë shumë tematika, derisa u dalluan dhe u mëvetësuan disa shkenca. Në secilën shkencë janë dalluar dijetarë të specializuar. Kështu në mesin e tyre kishte muhadithë, fukaha (juristë), mufesirë, mutekelimë, historianë, letrarë, sufistë etj. Shumica e mexhli-seve të diturisë kanë pasur në konsideratë rregullat dhe kushtet etike. Disa prej këtyre rregullave ishin të veçanta për dijetarët, ndërsa disa të tjera për nxënësit. Kishte edhe rregulla për përmbajtjet dhe tematikat mësimore për nga rëndësia, radhitja dhe klasifikimi për studim etj. Për të përkujtuar këto rregulla dhe për të nxitur në zbatimin e tyre, kemi hasur dijetarë nga specializime të ndryshme duke i shkruar ato në libra të veçanta, ose duke i vënë në kapituj brenda librave në specializimet e tyre.

Ndonëse, këta dijetarë referencë të përbashkët kishin Kur'anin dhe sunetin pejgamberik, megjithatë, metodologjitë në trajtimin e tematikave mësimore ishin të ndryshme. Fekihut (juristit) i intereson sqarimi i dispozitave të fikhut në çështjet arsimore dhe verifikimi i transmetimeve të dijetarëve të mëhershëm në këto çështje, rreth asaj që e kanë lejuar apo ndaluar. Muhadithit i intereson grumbullimi i haditheve që ndërliidhen me çështjet e arsimit, përpjekja për ndërliidhje mes tyre, analizimi i haditheve, të cilat mund të shihen si kontradiktore me vete, në disa raste nivelin e hadithit dhe mundësinë e veprimtimit me të. Historianit i intereson të jep një pasqyrë rreth biografisë së dijetarit, të cilin e studion, theksimi i dijetarëve nga të cilët ai ka mësuar, si dhe të nxënësve të tij, udhëtimet e tij gjatë kërkimit të diturisë, qëndrimi gjatë kër-

kimit të ditorisë, veprat e tij të shkruara apo ato të cilat ia ka diktuar etj. Secila shkollë ideologjike prej shkollave të trashëgimisë pedagogjike ka metodologjinë dhe praktikat e veta, gjë që e ka dalluar nga të tjerat.

Llojllojshmëria e shkollave pedagogjike dhe e kontributit të dijetarëve llogaritet shenjë e gjallërisë në performancën e mendjes së muslimanit. Kjo gjë ia ka mundësuar atij t'i përgjigjet nevojave të shumta të shoqërisë dhe të plotëson interesimet e tyre.

Hulumtuesit bashkëkohorë kanë bërë përpjekje për dallimin e këtyre librave ose kapitujve në kuadër të trashëgimisë pedagogjike islame dhe klasifikimin e tyre brenda metodologjisë së autorit në përpilimin e tekstit të tij. Kështu, autori mund të jetë fekih (jurist), i cili merret vetëm me sqarimin e dispozitave të fikhut që ndërliidhen me këtë çështje. Ai mund të jetë historian, i cili përcjell me vëmendje dhe grumbullon realitetin, plan-programet dhe praktikat arsimore në një periudhë të caktuar në një vend të caktuar. Ai mund të jetë muhadith, i cili transmeton hadithet pejgamberike të cilat ndërliidhen me arsimit dhe studion senedin (zinxhirin) e tyre. Ai mund të jetë sufist, i cili kujdeset për edukimin, pastrimin dhe orientimin e muridëve drejt ahiretit. Në këso raste, është lehtë klasifikimi i këtyre veprave në kuadër të shkollës së fikhut (juridike), shkollës historike, shkollës së hadithit, shkollës sufiste etj.

Ka mundësi të ndodhë që libri i fekihut, të cilin e llogarisim pjesë e trashëgimisë pedagogjike, metodologjia e shkrimit të tij të jetë akaidologjike-apologjetike, siç është rasti me librin "El-Alimu ve'l-muteal-limu" i fekihut Imam Ebu Hanife, ose të ketë metodologji usuliste siç është rasti me librin "Xhema'ul-ilmi" të fekihut Imam Shafiut, ose të ketë metodologji letrare siç ka shkruar filozofi dhe letrari Ebu Hajjan Tevhidi në librin "El-Imtau ve'l-muannesetu" rreth arsimit dhe mësuesit. Kështu, trashëgimia pedagogjike islame ka njohur këtë llojllojshmëri në metodologjinë e shkrimit. Hulumtuesit kanë dalluar këto metodologji, dhe librat së bashku me autorët i kanë klasifikuar në shkolla, rryma dhe fusha të veçanta.

Ne preferojmë që këto shkolla apo rryma t'i shohim si dukuri që flet për pasuri kulturore dhe llojlojshmëri të kontributit të mendjes së muslimanit dhe orientimeve të tij ideologjike. Është e qartë se Islami, i cili ishte referencë e dijetarëve muslimanë, është ai që ua ka mundësuar këtë pasuri dhe llojlojshmëri. Fushat e njohurive filluan të rriten shumë shpejtë në shoqërinë islame dhe jepnin mundësinë e theme-limit të sferave të reja të njohurive të panjohura më parë.

Meditimi në lindjen dhe periudhat e zhvillimit të këtyre shkencave nuk duhet të na largon nga realiteti se farat e gjitha këtyre shkencave gjendeshin në periudhën e Muhammedit alejh'is-selam. Ishte caktim i Allahut që jeta e Muhammedit alejh'is-selam me njerëzit të jetë e llojlojshme dhe të përfshijë shumë nga gjendjet shoqërore, në paqe apo luftë, pasuri apo varfëri, fuqi apo dobësim, jetën private apo familjare, raportet me besimtarët, ithtarët e librit dhe munafikët, udhëheqja e shtetit dhe praktikat politike, shitblerja, bujqësia dhe industria etj. çdo gjë që është transmetuar nga këto gjendje janë bërë tema për mësim, mësimnxënie dhe mësimdhënie.

Kur lindnin raste dhe qëndrime të reja në jetën individuale dhe shoqërore, dhe muslimanët ishin të kujdesshëm për të ditur se çka lejohet e çka jo, atëherë ata kishin nevojë për dikë që ju jep fetva, dhe kështu lindi shkenca e fikhut.

Kur fikhu i fukahave (juristëve) bazohej në ajetet kur'anore dhe hadithet peygamberike, atëherë ishte patjetër të merren në konsideratë ajetet dhe hadithet që ndërlihdeshin me këto raste dhe qëndrime, duke bërë përpjekje për të kuptuar domethëniet e tyre dhe zbritjen e tyre në rrafshin praktik. Në këtë rast kishte nevojë për vënien e kriterëve. Kështu lindi shkenca e usuli fikhut.

Hadithet peygamberike, ndodhitë e jetës së Muhammedit alejh'is-selam dhe gjurmët e sahabëve, në fillim transmetoeshin gojarisht, për shkak se ishin akoma të freskëta në aspektin kohor dhe mbështeteshin në besnikërinë e transmetuesve. Me largimin e njerëzve nga kjo gjendje, u ndie nevoja për regjistrimin e sunetit dhe më pas pastrimin e asaj që është regjistruar. Kështu lindi shkenca e hadithit. Çdo gjë që është

transmetuar nga Muhammedi alejh'is-selam, përfshirë fjalët, veprat dhe pëlqimet, kanë pasur nevojë për kontrollimin e transmetimeve dhe kuptimeve në bazë të kritereve të caktuara. Të gjitha këto përpjekje ishin objekt i shkencës së hadithit.

Me kontaktin e shoqërisë islame me popujt dhe civilizimet tjera, disa nga dijetarët bashkëvepruan me kulturën e këtyre popujve, dhe si rezultat i saj u shfaqën shkencat e logjikës, filozofisë, mjekësisë, astronomisë dhe shkencave tjera natyrore dhe aplikative.

Disa hadithe të cilën ulnin vlerën e kësaj bote dhe nxisinin drejt jetës së ahiretit, u bënë mbështetje për asketizëm. Kjo ndodhi në veçanti pas zhvillimit të jetës shoqërore dhe ngritjes së nivelit të jetës luksoze, gjë e cila bëri që disa njerëz të heqin dorë nga këto lukse duke e preferuar asketizmin, tërheqjen në vete dhe shpresimin e ahiretit. Kështu lindi tesavufi. Sjellja e sufistëve, e cila bazohej në dhikër, shoqërimin e shejhut në xhami, zavije dhe teqe me qëllim të përmirësimit të sjelljes, kontrollimit të epsheve, pajtimin me pak prej gjërave të kësaj bote, besim i plotë në aftësitë e shejhut dhe ndjekjen e këshillave të tij, u zhvillua, saqë në fund të përfundojë me lindjen e tarikateve, të cilat kanë sisteme dhe rregulla të caktuara. Disa praktika të tesavufit kanë mbetur në kuadër të normales sipas Ehl'us-sunetit ve'l-xhemaatit dhe i njoh me emrin "tesavufi sunit". Disa udhëheqës sufistë kanë zhvilluar disa norma në sjellje, ibadet, dhikr, ndërmjetësim, raportet mes shejhut dhe muridit dhe besimi i kërkuar ndaj tij. E gjithë kjo kaloi në atë që quhet "tesavuf bidat-i sajuar". Një pjesë e tesavufit është përzier me mendime filozofike nga trashëgimia persiane, indiane dhe greke, gjë që çoi në lindjen e si njihet "tesavuf filozofik". Disa sufistë, në çështjet e besimit dhe praktikave, kanë dalë jashtë normave të njohura dhe të pranuar në shoqërinë islame. Kështu ata jepnin komente të çuditshme të teksteve, supozonin se janë në një gradë të lartë mbi nivelin e njerëzve, dhe kështu kanë kaluar në dalalet-devijim.

Në Kur'an dhe hadithet pejgamberike janë theksuar shumë prej rrëfimeve të pejgamberëve dhe popujve të mëherëshëm. Këtyre u janë bashkëngjitur edhe transmetimet e ithta-



rëve të librit, gjurmët historike nga jeta e arabëve dhe popujve tjerë. Të gjitha këto janë bërë bazament për lindjen e historisë dhe shfaqjen e historianëve.

Letërsia, përfshirë këtu poezinë dhe prozën, ishte çështje për të cilën kishin shumë interes arabët para Islamit. Stili i lartë gjuhësor përdorej si mjet për informim dhe ndikim. Me përhapjen e Islamit në mesin e popujve joarab, u shfaqën gabimet në gjuhë. Kjo gjendje imponoi vënien e rregullave gjuhësore. Kështu lindën shkencat gjuhësore: sintaksa, morfologjia, stilistika etj.

Hadithet peygamberike përfshijnë shumë këshilla të mjekësisë preventive dhe trajtuese, përfshirë barërat, llojet e ushqimeve, ruajtjen nga ushqimi i tepërt etj. Disa dijetarë kanë grumbulluar praktikat e këtyre këshillave, duke ua shtuar atyre edhe përvojat mjekësore në trashëgiminë e popujve tjerë, derisa mjekësia u zhvillua shumë në shoqërinë islame. Librat e përkujdesjes shëndetësore dhe mjekësore kanë përfshirë kanë përfshirë përkujdesin ndaj fëmijëve, si dhe arsimimin e mjekëve dhe testimin e tyre.

Grumbullimi i materies së trashëgimisë pedagogjike islame në veprat e trashëgimisë, ka mundur të njohjen e një numri të madh të këtyre veprave, të cilat propozojmë të klasifikohen në kuadër të disa shkollave. Vlen të theksohet se ky numër i madh i librave (108 libra), për të cilat arritëm të bëjmë dallimin e përmbajtjes trashëgimore pedagogjike, nuk nënkupton se nuk ka libra tjera. Dera e hulumtimit në veprat e trashëgimisë islame është e hapur për të gjithë dhe mund të gjejnë diçka që është më e rëndësishme nga ajo që kemi gjetur.

Në tabelën numër 1 ka sqarim rreth titujve të këtyre librave, emrat e autorëve, vitet e vdekjes dhe shkollën në të cilën mund të klasifikohet libri.

Gjatë hulumtimit në përmbajtjen e këtyre librave, do të gjejmë se shumë prej tyre trajtojnë problematika të ngjashme. Gjithashtu do të gjejmë se një pjesë trajtojnë problematika që nuk i ka trajtuar dikush tjetër. Është e pritur që fikhu të jetë prezent në brendinë e shumë prej këtyre librave, ngase fikhu ishte ombrellë e shumë përmbajtjeve që më pas u bënë shken-

ca të mëvetësishme. Kështu fikhu përfshinte dispozita e ibadeteve: namaz, zeqat dhe haxh, dispozitat e të drejtës civile, ekonomike, tregtare, industriale e tjera, dispozita e të drejtës familjare: martesë, shkurorëzim, testament, trashëgimi e tjera, të drejtën e politikës shariatike: qeverisje, gjykatë, marrëdhënie ndërkombëtare etj.

Tabela nr. 1.

*Titujt e veprave të trashëgimisë pedagogjike islame  
(të radhitura sipas vitit të vdekjes së autorit)*

| Nr. | Titulli i librit  | Autori                           | Viti i vdekjes | Shkolla                  |
|-----|---|----------------------------------|----------------|--------------------------|
| 1   | <i>El-Edeb'ul-kebiru ve's-sagiru</i>  | Ebu Muhamed Abdullah ibn Mukafa  | 142 h./759     | Letrare                  |
| 2   | <i>El-Alimu ve'l-muteal-limu</i>  | Ebu Hanife Nu'man                | 150 h./767     | Apologjetike             |
| 3   | <i>Xhema'ul-ilmi</i>  | Muhamed ibn Idris Shafi          | 204 h./819     | Fikh (shafi)             |
| 4   | <i>Et-Tabekat'ul-kubra</i>  | Muhamed ibn Sead                 | 230 h./844     | Histori e përgjithshme   |
| 5   | <i>Kitab'ul-ilmi</i>  | Ebu Hajthme Zuhejr ibn Harb      | 234 h./847     | Hadith                   |
| 6   | <i>Risalet'ul-mustershidine</i>   | Harith ibn Esed Muhasibi         | 243 h./857     | Sufiste                  |
| 7   | <i>Risalet'ul-mual-limine</i>   | Amr ibn Behr Xhahidh             | 255 h./869     | Letrare                  |
| 8   | <i>Adab'ul-mual-limine</i>  | Muhamed ibn Sehnun               | 256 h./870     | Fikh (maliki)            |
| 9   | <i>Et-Tergibu fi'l-ilmi</i>   | Ismail ibn Jahja Mezni           | 264 h./877     | Fikh (shafi)             |
| 10  | <i>Ujun'ul-Ahbari</i>   | Ibn Kutejbe Dinuri               | 276 h./880     | Letrare                  |
| 11  | <i>Te'dibun nashiine edeb'id-dunja ve'd-din'il-Ikd'il-ferid</i>                                       | Ibn Abdrabo Endelusi             | 328 h./940     | Letrare<br>Letrare       |
| 12  | <i>Ihsa'ul-ulumi</i>  | Muhamed Farabi                   | 339 h./950     | Filozofike               |
| 13  | <i>El-Alimu ve'l-muteal-limu</i>  | Muhamed ibn Hiban Besti          | 354 h./965     | Hadith                   |
| 14  | <i>Resailu Ihvan'is-Safa</i>  | Ihavan'us-Safa                   | shek. 4 h.     | Filozofike               |
| 15  | <i>El-Muhaddith'ul-fasilu bejne'r-Ravi ve'l-Vajj</i>  | Hasen ibn Abdurrahman Ramhurmuzi | 360 h./971     | Hadith                   |
| 16  | <i>Ahlak'ul-ulemai</i>  | Ebu Bekr Axhurri                 | 360 h./971     | Fikh (shafi)             |
| 17  | <i>Rijadat'ul-muteal-limine</i>   | Ebu Bekr ibn Sini                | 364 h./975     | Hadith                   |
| 18  | <i>Sijaset'us-sibjani ve tedbiruhum</i>   | Ibn Xhezar Kajrevani             | 369 h./980     | Mjekësore                |
| 19  | <i>El-l'lamu bi menakib'il-islami - Resailul Amiri ve shedheratuh'ul-felsefije</i>                    | Ebu Hasen Amiri                  | 381 h./991     | Filozofike<br>Filozofike |
| 20  | <i>Ahkam'ul-mual-limine ve'l-muteal-limine</i>  | Ibn Ebi Zejd Kajrevani           | 386 h./996     | Fikh (maliki)            |
| 21  | <i>Er-Risalet'ul-mufessaleti li ahval'il-muteal-limine ve ahkam'il-mual-limine ve'l-muteal-limine</i> | Ebu Hasen Kabisi                 | 403 h./1012    | Fikh (maliki)            |

|    |  |                          |             |  |
|----|--|--------------------------|-------------|--|
| 22 | <i>Sherh'ul-alimi ve'l-muteal-limi li Ebi Hanife</i>   | Ebu Bekr ibn Furek       | 406 h./1015 | Apologjetike   |
| 23 | <i>Tabekat'us-sufijeti</i>   | Ebu Abdurrahman Sulemi   | 412 h./1021 | Sufiste  |
| 24 | <i>El-lmtau ve'l-muannesetu</i>  | Ebu Hajan Tevhidi        | 414 h./1023 | Letrare  |
| 25 | <i>Tehdhib'ul-ahlaki</i>   | Ibn Miskevejhi           | 421 h./1030 | Filozofike   |
| 26 | <i>Kitab'us-sijaseti</i>   | Reis Ibn Sina            | 428 h./1037 | Filozofike   |
| 27 | <i>El-Fihrist</i>  | Muhamed ibn Nedim        | 438 h./1047 | Historia e diturisë dhe shkencave  |
| 28 | <i>Edeb'ud-dunja ve'd-dini</i>   | Ebu Hasen Maverdi        | 450 h./1058 | Fikh (shafi)   |
| 29 | <i>-El-Ahlu ve's-sijeru<br/>-Meratib'ul-ulum</i>   | Ibn Hazm Endelusi        | 456 h./1064 | Letrare<br>Letrare   |
| 30 | <i>-Iktida'ul-ilm'il-amele<br/>-Tekjid'ul-ilmi<br/>-Er-Rihletu fi taleb'il-ilmi<br/>-El-kifajetu fi ilm'ir-Rivajeti<br/>-El Xhamiu li ahlak'ir-Ravi ve adab'is-Samii<br/>-El-Fekihu ve'l-muttefekihu</i> | Hatibu Bagdadi           | 463 h./1071 | Fikh-hadith<br>Hadith<br>Hadith<br>Hadith<br>Hadith-fikh<br><br>Fikh (hanefi)          |
| 31 | <i>-Xhamiu bejanil ilmi ve fadluhu - Edebul muxhalese</i>  | Ibn Abdulberr Kurtubi    | 463 h./1071 | Hadith<br>Hadith-fikh  |
| 32 | <i>Nasihah'ul-imami Baxhi li veledih</i>   | Ebu Velid Sulejman Baxhi | 474 h./1081 | Fikh (maliki)  |
| 33 | <i>Edh-Dheriatu ila ahkam'ish-sheriat</i>  | Ragib Isfahani           | 502 h./1108 | Fikh (shafi)   |
| 34 | <i>-Minhaxh'ul-muteal-lim<br/>-Ejjuhe'l-veledu<br/>-Ihja ulum'iddin</i>  | Ebu Hamid Gazali         | 505 h./1111 | Fikh (shafi)<br>Fikh (shafi)<br>Sufiste  |
| 35 | <i>Siraxh'ul-muluki</i>  | Ebu Bekr Tartushi        | 520 h./1126 | Histori e përgjithshme   |
| 36 | <i>El-Ilmau ila ma'rifeti usul'ir-rivajeti ve tekjid'is-semai</i>  | Kadi Ijad Jahsubi        | 544 h./1149 | Hadith-fikh  |
| 37 | <i>-Edebul imlai vel istimlai - Tiraz'udh-dhebebi fi edeb'it-talebi</i>  | Ebu Seid Sem'ani         | 562 h./1167 | Hadith<br>Hadith   |
| 38 | <i>-Dhemu men la ja'melu biilmih - Mexhlisani min mexhalisi Ibn Asakir</i>   | Ali ibn Hasen Ibn Asakir | 571 h./1175 | Fikh-hadith<br>Hadith  |
| 39 | <i>Telkin'ul-veled'is-sagir</i>  | Ebu Muhamed Ezdi         | 581 h./1185 | Hadith   |
| 40 | <i>Nihat'ur-rutbeti fi taleb'il-hisbeti</i>  | Ebu Nexhib Shejrezi      | 590 h./1194 | Profesion-zanat  |
| 41 | <i>Ta'lim'ul-muteal-limi turka't-teal-lumi</i>   | Burhanudin Zernuxhi      | 593 h./1197 | Fikh (hanefi)  |
| 42 | <i>-Telbisu iblis<br/>-Leftetul kebedi fi nasihat'il-veledi<br/>-Kitab'ul-kasasi ve'l-mudhekkirine<br/>-El-Muntehdimu fi tarih'il-umemi ve'l-muluki</i>  | Ebul Ferexh Ibn Xhevzi   | 597 h./1201 | Fikh-hadith<br>Letrare<br>Historia e diturisë dhe dijetarëve<br>Histori e përgjithshme |

|    |   |  |             |   |
|----|---|--|-------------|---|
| 43 | <i>Rihletu Ibn Xhubejr</i>  | Ibn Xhubejr Endelusi                     | 614 h./1217 | Histori e përgjithshme                            |
| 44 | <i>Mu'xhem'ul-buldani</i>   | Jakut Hamevi                             | 626 h./1229 | Histori e përgjithshme                            |
| 45 | <i>El-Kamilu fi't-tarihi</i>  | Ibn Ethir Xhezeri                        | 630 h./1233 | Histori e përgjithshme                            |
| 46 | <i>Muhadaret'ul-ebriari ve musameret'ul-ahjari</i>  | Muhjiddin ibn Arabi                      | 638 h./1240 | Sufiste   |
| 47 | <i>Edeb'ul-mufti ve'l-mustefti</i>  | Ebu Amr ibn Salah                        | 643 h./1245 | Fikh (shafi)                                      |
| 48 | <i>Inbah'ur-ruvati ala enba'in Nexhati</i>  | Xhemaludin Kifti                         | 646 h./1248 | Historia e diturisë dhe shkencave                 |
| 49 | <i>El Derari fi dhikra el dhera-ri</i>  | Kemaludin ibn Adim                       | 660 h./1262 | Letrare   |
| 50 | <i>Kavaidul ehkami fi mesalihil enami</i>   | Iz ibn Abduselam                         | 660 h./1262 | Fikh (shafi)                                      |
| 51 | <i>Kitabur revdatejni fi ahbar'id-devletejni: el-nurijjeti ve's-salahijeti</i>                                    | Ebu Shame Abdurrahman ibn Imsail Makdisi | 665 h./1267 | Historia e diturisë dhe shkencave                 |
| 52 | <i>Ujunul enbai fi tabekat'il-etibbai</i>   | Ibn Ebi Usajbiah                         | 668 h./1270 | Mjekësi   |
| 53 | <i>Adab'ul-muteal-limine</i>  | Ebu Xhafer Tusi                          | 672 h./1274 | Fikh (xhaferi)                                    |
| 54 | <i>-Adab'ul-alimi ve'l-muteal-limi ve'l-mufti ve'l-mustefti</i><br><i>-Et-Tibjanu fi adabi hamalet'il-Kur'ani</i> | Jahja ibn Sheref Nevevi                  | 676 h./1278 | Fikh (shafi)<br><br>Fikh (shafi)                  |
| 55 | <i>Vefejat'ul-ajani ve enbau ebna'iz-zemani</i>   | Ibn Hal-likan                            | 681 h./1282 | Histori e përgjithshme                            |
| 56 | <i>Terkiret'us-sami'i ve'l-mutekel-limi fi edeb'il-alimi ve'l-muteal-limi</i>                                     | Bedrudin Ibn Xhemaah                     | 733 h./1332 | Hadith  |
| 57 | <i>Nihajet'ul-erebi fi funun'il-edebi</i>   | Shihabudin Nuvejri                       | 733 h./1332 | Letrare   |
| 58 | <i>El-Med'halu ila tenmijet'il-a'amlu bi tahsinin nijati</i>  | Ibnul Haxh Abderi                        | 737 h./1336 | Fikh (maliki)                                     |
| 59 | <i>-Zeg'ul-ilmi</i><br><i>-Mesailu fi taleb'il-ilmi ve aksamuhu</i>   | Shemsudin Dhehebi                        | 748 h./1347 | Historia e diturisë dhe shkencave<br>Fikh (shafi) |
| 60 | <i>Kanatir'ul-hajrati</i>   | Ismail ibn Musa Xhitali                  | 750 h./1349 | Fikh (ibadi)                                      |
| 61 | <i>-Tuhfet'ul-mevduadi fi ahkam'il-mevludi</i><br><i>-Miftahu dar'is-seadeti</i>                                  | Ibn Kajim Xhevzije                       | 751 h./1350 | Mjekësore<br><br>Fikh (hanbeli)                   |
| 62 | <i>Tabekat'ush-shafijet'ul-kubra</i>  | Taxhudin Subki                           | 771 h./1369 | Historia e diturisë dhe shkencave                 |
| 63 | <i>Rihletu ibn Betuta</i>   | Muhamed ibn Betuta                       | 779 h./1377 | Histori e përgjithshme                            |
| 64 | <i>Tehrixh'ud-dilalat'is-sem'ijjeti</i>   | Ebul Hasan Huzai                         | 789 h./1387 | Profesion-zanat                                   |
| 65 | <i>Mukaddimetu ibn Haldun</i>   | Abdurrahman ibn Haldun                   | 808 h. 1405 | Histori e përgjithshme                            |

|    |  |                                |              |                                   |
|----|--|--------------------------------|--------------|-----------------------------------|
| 66 | <i>Subh'ul-A'sha fi sinaat'il-insha</i>  | Ahmed ibn Ali Kalkashendi      | 821 h./1418  | Letrare                           |
| 67 | <i>Tabekat'ul-mu'tezileti</i>  | Ahmed ibn Murteda              | 840 h./1436  | Histori e përgjithshme            |
| 68 | <i>Tarih'ul-Makrizi</i>  | Tekijuddin Makrizi             | 845 h./1441  | Histori e përgjithshme            |
| 69 | <i>El-Mustetrifu fi kul-li fenin mustedhrefin</i>  | Shihabudin Ibsihi              | 850 h./1446  | Letrare                           |
| 70 | <i>Shifa'ul-muteal-limi fi edeb'il- mual-limi ve'l-muteal-limi</i>   | Abdulatif ibn Ganim            | 856 h./1452  | Fikh (maliki)                     |
| 71 | <i>Bedai'us-silki</i>  | Ebu Abdullah ibn Ezrek         | 896 h./1491  | Historia e diturisë dhe shkencave |
| 72 | <i>El-Muz'hiru fi ulum'il-lugati ve envaiha</i>  | Xhelaluddin Sujuti             | 911 h./1505  | Letrare                           |
| 73 | <i>Xhevahir'ul-ikdejni fi fadl'ish-sherifejni</i>  | Nurudin Semhudi                | 911 h./1505  | Fikh (hanefi)                     |
| 74 | <i>Xhamiu xhevami'il-ihtisari ve't-tibjani</i>   | Muhamed ibn Ebu Xhumah Migravi | 920 h./1514  | Fikh (maliki)                     |
| 75 | <i>Risaletun fi adab'il-bahthi ve'l-munadhereti</i>  | Abdulbasit ibn Vezir           | 920 h./1514  | Apologetikë                       |
| 76 | <i>El-Lu'luun nadhimu fi revm'it-ta'limi</i>   | Zekerija Ensari                | 926 h./1520  | Fikh (shafi)                      |
| 77 | <i>Minjet'ul-muridi fi edeb'il-mufidi ve'l-mustefidi</i>   | Zejnudin Amili                 | 965 h./1558  | Fikh (xhaferi)                    |
| 78 | <i>Risalet'ul-adabi fi ilmi edeb'il-bejthi ve'l-munadhereti</i>  | Tashkupri Zade                 | 968 h./1561  | Apologetike                       |
| 79 | <i>Tehrirul mekali fi edebi ve ehkami ve fevaide jehntaxhu ilejha muedibul etfali</i>                        | Ibn Haxher Hejtemi             | 976 h./1568  | Hadith                            |
| 80 | <i>Ed-Darisu fi tarih'il-medarisi</i>  | Abdulkadir Nuajmi              | 978 h./1570  | Historia e diturisë dhe shkencave |
| 81 | <i>-El-Muidu fi adab'il-mufidi ve'l-mustefidi</i><br><i>- Muhtesaru tenbih'it-talibi ve irshad'id-darisi</i> | Abdulbasit el Almevi           | 981 h./1573  | Fikh (shafi)<br>Fikh (shafi)      |
| 82 | <i>Ed-Dar'un-Nedidu fi edeb'il-mufidi ve'l-mustefidi</i>   | Bedrudin Gazij                 | 984 h./1576  | Fikh (shafi)                      |
| 83 | <i>Adab'ul-ulemai ve'l-muteal-limine</i>   | Mensur bi'l-lahi Zejdi         | 1050 h./1640 | Fikh (zejdi)                      |
| 84 | <i>Keshf'udh-dhunini an esam'il-kutubi ve'l-fununi</i>   | Haxhi Halife Xhelebi           | 1067 h./1657 | Historia e diturisë dhe shkencave |
| 85 | <i>Ed-Delailu ve'l-levazimu</i>  | Dervish Mehruki                | 1086 h./1675 | Fikh (ibadi)                      |
| 86 | <i>El-Efnunu fi mebadi'il-ulumu</i>  | Ebu Zejd Abdurrahman Fasi      | 1096 h./1685 | Apologetike                       |
| 87 | <i>El-Kanunu ala ahkam'il-ilmi ve ahkam'il-muteal-limine</i>   | Jusi Merakishi                 | 1102 h./1691 | Fikh (maliki)                     |

|    |  |  |                                  |                                  |
|----|--|--|----------------------------------|----------------------------------|
| 88 | <i>-Gajet'ul-ihkami fi adab'il-fehmi ve'l-ifhami-komentimi i tij (Themer'uth-thimari sherhu gajet'il-ihkami)</i> | Autori: Omer Ahlavi<br>Komentuesi:<br>Senebavi | 1181 h./1767<br><br>1232 h./1817 | Apologjetike<br><br>Apologjetike |
| 89 | <i>Edeb'ut-talebi ve munteha'l-erebi</i>   | Muhamed ibn Ali<br>Shevkani                    | 1250 h./1834                     | Fikh<br>jomedhhebi               |
|    | Numri i veprave 110  | Dijetarët: 89                                  | xxx                              | Shkollat (110)                   |

**Vërejtje:** Ky numër (89) përfshin emrat e dijetarëve autorë. Në këtë numër përfshihen edhe emrat e dy dijetarëve: autorit Tahlavi dhe komentuesit Senebavi, kështu që numri i dijetarëve arrin në (90). Numri i veprave është (110), ngase disa dijetarë kanë më shumë se një vepër, titujt e të cilëve janë shfaqur krahas emrave të autorëve, si p.sh. Ibn Abdorabo, Hatib Bagdadi, Ibn Xhevzi, Ibn Asakir, Ibn Hazm, Amiri, Ibn Kajim, Dhehebi, Almevi dhe Gazali.

Shumë herët është shfaqur llojllojshmëria në mendime dhe diversiteti mes dijetarëve në lidhje me veprimin me tekstet kur'anore dhe hadithet pejgamberike, si dhe zbritja e tyre në praktikë sipas ndodhive dhe situatave. Këto diversitete dhe mospajtime ishin shkak për lindjen e medhhebeve në fushën e fikhut. Vërejmë një trashëgimi pedagogjike të çmuar në librat e këtyre medhhebeve. Kemi qenë të kujdesshëm të theksojmë tetë medhhebet që i ka njohur shoqëria islame gjatë historisë së saj. Këto medhhebe janë: hanefi, shafi, maliki, hanbeli, xhaferi (dymbëdhjetëshi), zejdi, dhahiri dhe ibadi. Këtyre u bashkëngjitet edhe një grup i dijetarëve të cilët jetën e tyre e kanë filluar në kuadër të ndonjë medhhebi të caktuar, ndërsa më pas kanë bërë ixhtihad duke u bazuar në argumentet bazë nga Kur'ani dhe suneti, pa iu përmbajtur asnjërit medhheb. Për këta persona kemi përdorur termin jomedhhebi.

Nëse medhhebet e fikhut përfaqësojnë shkolla ideologjike të llojllojshme brenda fushës së fikhut, vërejmë se disa shkolla ideologjike kanë qenë të dalluara, ngase krahas fikhut kanë përfshirë edhe ndonjë sferë tjetër. Kështu, shumë prej librave të hadithit përfshinin transmetimin e haditheve pejgamberike, mirëpo ngërthenin në vete edhe dispozita të

fikhut. Librat e tilla janë përfshirë në kuadër të shkollave që kanë bërë grumbullimin mes hadithit dhe fikhut. Sa i përket librave që kanë përfshirë vetëm transmetimin e haditheve, pa përfshirë dispozita të fikhut, i kemi vënë në kuadër të shkollës, të cilën e kemi quajtur shkolla e hadithit.

Trashëgimia islame njih një numër të madh të librave të historisë së përgjithshme. Një numër i tyre ka përfshirë të dhëna të mjaftueshme rreth mësimdhënies dhe mësimnxënies. Këto libra i kemi përfshirë në kuadër të shkollës të cilën e kemi quajtur shkolla historike. Disa libra të historisë kanë përfshirë vetëm historinë e diturisë, dijetarëve dhe institucioneve arsimore. Këto libra i kemi përfshirë në kuadër të shkollës: historia e dijes dhe dijetarëve.

Në anën tjetër, disa libra të trashëgimisë, për edukatën dhe arsimin janë kujdesur në kuadër të një shkolle të caktuar, si shkolla sufiste ose shkolla filozofike ose shkolla mjekësore ose shkolla apologetike, kështu që këto libra i kemi klasifikuar në kuadër të shkollës më të afërt prej tyre.

Në tabelën nr. 2 kemi një shpërndarje të shkurtër të materies së tabelës nr. 1, duke mjaftuar vetëm me theksimin e emrave të autorëve, për të sqaruar numrin e librave në kuadër të secilës shkolle prej nëntëmbëdhjetë shkollave.

*Tabela nr. 2*

*Emrat e autorëve (t radhitura sipas shkollave)*

| Emri i shkollës_1 | 3               | 4               | 5               | 6               | 7                       | 8                        | 9               | 10                  | 11                           |                  |                     |
|-------------------|-----------------|-----------------|-----------------|-----------------|-------------------------|--------------------------|-----------------|---------------------|------------------------------|------------------|---------------------|
| 1) Fikhu shafi    | Shafiu (204 h./ | Mezini (264 h./ | Axhuri (360 h./ | Maveri (450 h./ | Hatibi Bagdadi (463 h./ | Raghib Isfahani (502 h./ | Gazali (505 h./ | Ibn Salahu (643 h./ | Iz ibn Abidun selam (660 h./ | En Nevi (676 h./ | Es Sehmudi (911 h./ |

|                   |                           |                                |                  |                 |                  |                      |                   |                             |  |  |  |
|-------------------|---------------------------|--------------------------------|------------------|-----------------|------------------|----------------------|-------------------|-----------------------------|--|--|--|
| 2) Fikhu hane fi  | Zer nux hi (503 h./       |                                |                  |                 |                  |                      |                   |                             |  |  |  |
| 3) Fikhu mali ki  | Ibn Seh nun (256 h./      | Kajr eva ni (386 h.            | Ka bisi (403 h./ | Bax hi (474 h./ | Ab der i (737 h. | Ibn Ga ni m (856 h./ | Mig ravi (920 h./ | Jusi Me raki -shi (1102 h./ |  |  |  |
| 4) Fikhu hanb eli | Ibn Xhe vzi (597 h./      | Ibn Kaji m Xhe vzij e (751 h./ |                  |                 |                  |                      |                   |                             |  |  |  |
| 5) Fikhu ibadi    | Eë Xhit ali (750 h./      | Me hru ki (1086 h./            |                  |                 |                  |                      |                   |                             |  |  |  |
| 6) Fikhu zejdi    | Me nsur bil-lah (1050 h./ |                                |                  |                 |                  |                      |                   |                             |  |  |  |
| 7) Fikhu xhafari  | Tusi (672 h./             | Ami lij (965 h./               |                  |                 |                  |                      |                   |                             |  |  |  |
| 8) Fikhu dhah iri | Ibn Haz m (456 h./        |                                |                  |                 |                  |                      |                   |                             |  |  |  |
| 9) pa med hheb    | She vka ni                |                                |                  |                 |                  |                      |                   |                             |  |  |  |



|                                  |  |  |   |  |                                     |  |                                       |   |                         |                          |                         |
|----------------------------------|--|--|---|--|-------------------------------------|--|---------------------------------------|---|-------------------------|--------------------------|-------------------------|
|                                  | (125<br>0 h./                          |  |   |  |                                     |  |                                       |   |                         |                          |                         |
| 10)<br>Hadi<br>th                | Ebu<br>Hajt<br>hem<br>e<br>(234<br>h./ | Ra<br>mh<br>ur-<br>muz<br>i<br>(360<br>h./ | Hat<br>ib<br>Bag<br>dad<br>i<br>(46<br>3<br>h./   | Ibn<br>Ab<br>dul<br>-<br>ber<br>r<br>(46<br>3<br>h./ | Se<br>ma<br>ni<br>(56<br>2<br>h./   | Ibn<br>As<br>aki<br>r<br>(57<br>1 h.     | Ibn<br>Xhe<br>maa<br>h<br>(73<br>3 h. | Ibn<br>Hax<br>her<br>Hej<br>tem<br>i<br>(97<br>6 h. |                         |                          |                         |
| 11)<br>Hadi<br>th-<br>fikh       | Ibn<br>Hib<br>an<br>(354<br>h./        | Ibn<br>Sun<br>i<br>(364<br>h./             | Hat<br>ib<br>Bag<br>dad<br>i<br>(46<br>3<br>h./   | Ibn<br>Ab<br>dul<br>ber<br>r<br>(46<br>3<br>h./      | Ka<br>di<br>Ijad<br>(54<br>4<br>h./ | Ibn<br>As<br>aki<br>r<br>(57<br>1<br>h./ | Ezd<br>i<br>(58<br>1<br>h./           | Ibn<br>Xhe<br>vzi<br>(59<br>7<br>h./                |                         |                          |                         |
| 12)<br>Filoz<br>ofike            | Fara<br>bi<br>(339<br>h./              | Ihva<br>n'us<br>-<br>Safa<br>(she<br>k. 4. | Am<br>iri<br>(38<br>1<br>h./                      | Ibn<br>Mis<br>ke-<br>vej<br>h<br>(42<br>1<br>h./     | Ibn<br>Sin<br>a<br>(42<br>8<br>h./  |  |                                       |   |                         |                          |                         |
| 13)<br>Sufis<br>te               | Mu<br>hasi<br>bi<br>(243<br>h./        | Sule<br>mi<br>(412<br>h./                  | Gaz<br>ali<br>(50<br>5<br>h./                     | Ibn<br>Ara<br>bi<br>(63<br>8<br>h./                  |                                     |  |                                       |   |                         |                          |                         |
| 14)<br>Apol<br>o-<br>gjeti<br>ke | Ebu<br>Han<br>ife<br>(150<br>h./       | Ibn<br>Vez<br>ir<br>(920<br>h./            | Tas<br>hku<br>-pri<br>Zad<br>e<br>(96<br>8<br>h./ | Fas<br>i<br>(10<br>96<br>h./                         | Ta<br>hla<br>vi<br>(11<br>81<br>h./ | Sin<br>bav<br>i<br>(12<br>32<br>h.       |                                       |   |                         |                          |                         |
| 15)<br>Letra<br>re               | Ibn<br>Mu<br>kafa<br>(142              | Xha<br>hid<br>h<br>(255                    | Ibn<br>Kut<br>ejb<br>e                            | Ibn<br>Ab<br>do-<br>rab                              | Eb<br>u<br>Haj<br>an                | Ibn<br>Xh<br>evz<br>i                    | Ibn<br>Adi<br>m<br>(66                | Shi<br>hab<br>u-<br>din                             | El<br>Kal<br>ka-<br>sha | El<br>Ebs<br>hihi<br>(85 | Es<br>Suj<br>uti<br>(91 |

|  |                                  |   |   |  |  |                                     |   |                                      |   |   |  |
|--|----------------------------------|---|---|--|--|-------------------------------------|---|--------------------------------------|---|---|--|
|  | h./                              | h./   | Din<br>uri<br>(27<br>6<br>h./                           | o<br>(32<br>8<br>h./                         | Tev<br>hid<br>i<br>(41<br>4<br>h./             | (59<br>7<br>h./                     | 0<br>h./  | Nu<br>vejr<br>i<br>(73<br>3<br>h./   | ndi<br>(82<br>1<br>h./                      | 0<br>h./  | 1<br>h./                                 |
| 16)<br>Hist<br>ori e<br>përgj<br>ith-<br>shme                    | Ibn<br>Sea<br>d<br>(230<br>h./   | Tart<br>ushi<br>(520<br>h./                   | Ibn<br>Xh<br>evzi<br>(59<br>7<br>h./                    | Ibn<br>Xh<br>ube<br>jr<br>(61<br>4<br>h./    | Jak<br>ut<br>Ha<br>me<br>vi<br>(62<br>6<br>h./ | Ibn<br>Eth<br>ir<br>(63<br>0<br>h./ | Ibn<br>Hal<br>-<br>lika<br>n<br>(68<br>1<br>h./ | Ibn<br>Bet<br>uta<br>(77<br>9<br>h./ | Ibn<br>Ha<br>ldu<br>n<br>(80<br>8<br>h./    | Ibn<br>ul<br>Mu<br>rte<br>da<br>(84<br>0<br>h./ | El<br>Me<br>kriz<br>i<br>(84<br>5<br>h./ |
| 17)<br>Hist<br>ori e<br>ditur<br>isë<br>dhe<br>shke<br>ncav<br>e | Ibn<br>Ned<br>im<br>(438<br>h./  | Ibn<br>Xhe<br>vzi<br>(597<br>h./              | Kift<br>i<br>(64<br>6<br>h./                            | Eb<br>u<br>Sha<br>me<br>h<br>(66<br>5<br>h./ | Dh<br>ehe<br>bi<br>(74<br>8<br>h./             | Su<br>bki<br>(77<br>1<br>h./        | Ibn<br>Ezr<br>ek<br>(79<br>6<br>h./             | Nu<br>ajm<br>i<br>(97<br>8<br>h./    | Ha<br>xhi<br>Ha<br>life<br>(10<br>67<br>h./ |   |  |
| 18)<br>Mjek<br>ësi   | Ibn<br>Xhe<br>zar<br>(369<br>h./ | Ibn<br>Ebi<br>Usa<br>jbia<br>h<br>(668<br>h./ | Ibn<br>Kaj<br>im<br>Xh<br>evzi<br>je<br>(75<br>1<br>h./ |  |  |                                     |   |                                      |   |   |  |
| 19)<br>Profe<br>sion   | Shej<br>zeri<br>(590<br>h./      | Huz<br>ai<br>(789<br>h./                      |   |  |  |                                     |   |                                      |   |   |  |

### Vërejtje:

- Klasifikimi i emrave të autorëve si pjesë të këtyre shkolave është bërë sipas librave të autorëve të theksuara në tabelën nr. 1. Kështu p.sh. Muhasibiu është klasifikuar në shkollën sufiste sipas librit të tij "Risalet'ul-mustershidine" dhe kështu me radhë.

- Kjo tabelë është përpiluar sipas mendimit tim duke pasur parasysh pjesën më të madhe të përmbajtjes së librit. Mirëpo, materien të cilën e përfshin libri i theksuar në këtë tabelë, mund të vendoset në kuadër të dy shkollave a më shumë prej shkollave të potencuar në këtë klasifikim.

- Në tabelë përfshihen vetëm emrat e autorëve, veprat e të cilëve kemi arritur t'i shfletojmë, siç janë potencuar në tabelën nr. 1. Është më se e sigurt se ka edhe libra tjera që flasin rreth çështjeve të edukatës dhe arsimit, por nuk kemi arritur t'i gjejmë.

- Emrat e disa autorëve të theksuar në tabelë, mund të jenë të ngjashëm me emra tjerë që nuk janë në tabelë. Këtu është për qëllim autori i librit që është theksuar në tabelën nr. 1.

- Emrat e autorëve të theksuar para çdo shkolle në grafikën vertikale janë të radhitura sipas kalendarit hixhri të vdekjes.

- Emrat e disa autorëve janë theksuar në dy a më shumë shkolla, ngase ata kanë shkruar libra të ndryshme, ku disa prej tyre klasifikohen në një shkollë të caktuar, ndërsa tjerat në shkollë tjetër. Kështu p.sh. Ibn Xhevzi ka shkruar libra që mund të klasifikohen si libra të fikhut, hadithit, letërsisë, dhe historisë. Hatib Bagdadi dhe Ibn Abdalberr kanë libra që janë më afër fushës së fikhut, ndërsa kanë edhe libra tjera që janë më afër hadithit.

- Librat e historisë që përmbajnë materie që klasifikohen si libra të edukatës dhe arsimit janë dy llojesh: libra të historisë së përgjithshme dhe libra të historisë së dijes dhe dijetarëve. Pikërisht për këtë kemi bërë ndarjen e këtyre librave në dy shkolla. Ngjashëm me këtë janë edhe librat e hadithit, ku disa mjaftojnë vetëm me hadithe, ndërsa disa tjera përfshijnë edhe diç nga fikhu.

## Pjesa e katërt:

# Literatura e trashëgimisë pedagogjike islame në shkrimet bashkëkohore

Gjatë shekullit XX, shumë hulumtues, kanë prezantuar vepra të ndryshme rreth trashëgimisë islame. Në gjysmën e dytë të atij shekulli, interesimi i shumëfishua. Në veçanti me shfaqjen e universiteteve, institucioneve hulumtuese në nivel ndërkombëtar, rajonal dhe lokal, si dhe shfaqjen e gazetave dhe revistave në vende të ndryshme të botës arabe dhe islame. Trashëgimisë pedagogjike islame i takoi një pjesë e madhe e këtij interesimi. Ka pasur shumë krahasime ose përafrime me përvojën pedagogjike bashkëkohore, e cila në të shumtën e rasteve bazohet në mendimin perëndimor, përfshirë personalitetet, shkollat dhe praktikat.

Që nga vitet e tetëdhjeta të shekullit XX, është rritur numri e profesorëve universitarë, të cilët kanë shkruar rreth mendimit islam në të gjitha specializimet shkencore. Shkrimet e tyre ishin përshtatshmëri me kërkesat e reja akademike, në disa raste jo edhe shumë të thelluara në hulumtim ose reformim në mendim. Të këtij lloji, në veçanti janë disertacionet e magistraturës dhe doktoraturës të cilat i paraqesin studentët, dhe të njëjta më pas i publikojnë në formë të hulumtimeve në revistat universitare, të cilat janë shtuar për qëllime avancimi të anëtarëve të këshillit mësimor në universitete. Specializimet pedagogjike dhe psikologjike kishin një numër të konsiderueshëm të këtyre disertacioneve dhe hulumtimeve, të cilat -më pas- botoheshin në formë të librave. Pjesa dërrmuese e asaj që është shkruar rreth mendimit islam në sferën e pedagogjisë dhe psikologjisë ishte bisedë rreth trashëgimisë islame në këtë sferë: personalitetet, veprat, praktikat.

Është e drejtë të potencojmë se disa nga këto studime janë realizuar me qëllim të përfitimit nga trashëgimia për përmirësimin dhe reformimin e realitetit, përfshirë këtu edhe

zhvillimin e procesit pedagogjik sipas vizionit islam. Potenciam se një pjesë e madhe e kësaj literature ishte prodhim i punës individuale, një pjesë tjetër ishte pjesë e hulumtimeve shkencore të paraqitura nga ana e studentëve në programet e magistraturës dhe doktoraturës. Gjithashtu kishte edhe libra, tema të publikuara në revista shkencore, si dhe në rrjetet sociale. Në disa raste të rralla kanë marrë pjesë dy profesorë universitarë ose më shumë në përgatitjen e një teme shkencore për qëllime avancuese. Hulumtimet shkencore të përbashkëta të rralla janë një dukuri për keqardhje në vendet arabe. Në një libër tjetër kemi folur rreth gjendjes së hulumtimit në trashëgiminë pedagogjike islame, siç zbulojnë studimet bashkëkohore. Këto studime i kemi klasifikuar në katër lloje: përpjekjet hulumtuese të përbashkëta nga ana e institucioneve, disertacionet universitare, hulumtime në periodikët shkencorë dhe librat metodologjik të autorëve.<sup>250</sup>

## 1. Përpjekjet e përbashkëta hulumtuese

Sa i përket llojit të parë, kemi njoftuar rreth projektit të pedagogjisë arabe dhe islame, në të cilin kanë marrë pjesë tre institucione: Organizata Arabe për Edukim, Kulturë dhe Shkencë në Tunizi, Zyra e Edukimit Arab i Shteteve të Gjirit Arab në Riad dhe Kompleksi Mbretëror për Hulumtimet e Civilizimit Islam (Muessesetu Ali'l-Bejt) në Jordani. Rëndësia e kësaj pune fshehët në atë se hapësira e saj është e gjerë për të përfshirë shumë prej hulumtuesve ekspertë nga vende të ndryshme, si dhe planifikimi, mbikëqyrja dhe mbështetja e siguruar, e bëjnë të jetë më e përpiktë në realizimin e qëllimeve.

Këto tri institucione, që nga viti 1982 janë pajtuar të zbatojnë këtë projekt: “Me ekuivalencë dhe me bashkëveprim në planifikim, mbikëqyrje dhe financim, me qëllim që të finalizohet në formë shkencore, si për nga metodologjia, po ashtu për nga materia.... ky projekt është realizuar në mënyrë

<sup>250</sup> Fet'hi Hasan Melkavi, *Et-Turath'ut-terbeviyy'ul-islamijju: halet'ul-bahthi fihî, ve lemehatun min tetavvurihi ve kutufun min nususihi ve medarisihî*, Hernden: El-Ma'had 'ul-alemi li'l-fikr'il-islami, 1439 h./2018, pjesa e dytë, fq. 109-181.

kolektive, dhe ishte shembull më i mirë për bashkëpunim gjigant shkencor për punë të përbashkët shkencore”.<sup>251</sup>

Kumtesat e këtij projekti të përbashkët janë botuar në tri pjesë:

Pjesa e parë: Libri “El-Fikr’ut-terbevijj’ul-arabijj’ul-islami-ju: El-Ussulu ve’l-mebadiu”:

Ky libër përbëhet nga një vëllim dhe përfshin gjithsej 1052 faqe. Botues i tij është Organizata Arabe për Edukim, Kulturë dhe Shkencë. Në përpilimin e teksteve kanë marrë pjesë tetëmbëdhjetë mendimtarë profesorë. Libri përmban parimet e pedagogjisë islame në pesë kapituj:

Kapitulli i parë: Hyrje historike, ku ka përfshirë gjendjen e arabëve nga koha paraislame deri në fillim të shekullit XX dhe ka përfshirë tetë nënkapituj.

Kapitulli i dytë: Bazamentet teorike të mendimit pedagogjik islam. Ka përfshirë pesë nënkapituj që kanë folur rreth disa çështjeve të klasifikuara si më poshtë: hapësira-universi, njeriu, shoqëria, njohja dhe vlerat.

Kapitulli i tretë: Mendimi pedagogjik islam në Kur’an dhe sunet. Ka përfshirë tetë nënkapituj: dituria, dijetarët, mësimdhënia dhe mësimnxënia, zhvillimi mendor, edukata morale, edukata shoqërore, edukata emocionale dhe edukata fizike.

Kapitulli i katërt: ka përfshirë gjashtë nënkapituj të cilat kanë folur rreth kthesave civilizuese që kanë prodhuar mendimin pedagogjik islam. Ka sjellë të dhëna rreth klasifikimit të këtij mendimi, dhe në mënyrë të detajuar ka folur për katër rryma: rryma tradicionale, rryma racionale, rryma profesioniste dhe rryma sufiste.

Kapitulli i pestë: ka folur rreth tematikave të mendimit pedagogjik islam. Ka përfshirë gjithsej njëmbëdhjetë nënkapituj: roli shoqëror i edukatës, shteti dhe arsimit, qëllimet e edukatës, përmbajtja arsimore, arsimimi profesional, edukimi dhe kreativiteti, edukata estetike, edukata ambientaliste, arsimimi i femrës, kujdesi fëmijëror dhe edukata speciale.

<sup>251</sup> Muhjidin Sabir, *El-Fikr’ut-terbevijj’ul-arabijj’ul-islami-ju: el-ussulu ve’l-mebadiu*, Tunizi: Organizata Arabe për Edukim, Kulturë dhe Shkencë, 1987, fq. 7.

Shihet qartë se kjo pjesë e projektit ka përfshirë gjendjen e edukatës dhe arsimit në historinë islame në përgjithësi, ashtu siç e zbulon trashëgimia pedagogjike dhe mendimi pedagogjik siç kuptohet nga dy Burimet e tij bazë, Kur'ani dhe suniti pejgamberik. Kësaj i bashkëngjitet edhe një pjesë e mendimit pedagogjik bashkëkohor, dhe ashtu siç duhet të jetë sipas pikëpamjeve të disa hulumtuesve që kanë marrë pjesë në përpilimin e saj. Në metodologjinë e kësaj pjese janë përfshirë metoda deskriptive dhe pjesërisht ajo analitike dhe kritike. Në disa raste kemi edhe hiperbolizim gjatë gjykimit ndaj disa orientimeve, praktikave dhe shkollave ideologjike, të njohura në historinë islame. Në veçanti është theksuar hiperbolizimi gjatë dallimeve mes shkollës racionale dhe shkollës tradicionale, dallimi mes el-bejan (sqarim), el-irfan (njohje) dhe el-burhan (argumentim) si tri sisteme të ndryshme të njohjes, dhe dallimi mes popullatës së thjeshtë dhe elitës në shoqëri që kanë dominuar në disa periudha të historisë islame dhe reflektimet e kësaj çështje ndaj mendimit pedagogjik.<sup>252</sup>

## 2. Institucionet dhe praktikat pedagogjike:

Zbatimi i kësaj pjese është realizuar nën kujdesin e Komplotit mbretëror për hulumtime të civilizimit islam (Fondacioni i Alul Bejt) në Jordani. Kumtesat janë përfshirë në katër vëllime dhe janë publikuar në vitin 1989.<sup>253</sup>

Vëllimi i parë ka përfshirë nëntë kapituj: edukata arabe para islamit, edukata dhe institucionet arsimore nga koha e Pejgamberit alejh'is-selam deri në shekullin e katërt hixhri, arsimit në Andaluzi, arsimit në el megrib el arabi mes shekujve

<sup>252</sup> Lexo një shembull rreth asaj që e quajmë hiperbolizim në shprehjet e disa hulumtuesve rreth dallimeve mes shkollës racionale dhe asaj tradicionale në:

Muhamed Xhevad Rida, "Et Tejaratul kubra fil fikrit terbevijil arabijil islamij", Kapitulli i katërt i librit: El-Fikr'ut-terbevijij'ul-arabijij'ul-islamijju: el-usulu ve'l-mebadiu, Tunizi: Organizata Arabe për Edukim, Kulturë dhe Shkencë, 1987, fq. 582-716. Diskutimin rreth kësaj çështje lexoje në librin: Melkavi, Et-Turath'ut-terbevijij'ul-islamijju: halet'ul-bahthi fihi, ve lemehatun min tetavvurihi ve kutufun min nususihi ve medarisi, vepër e cituar, fq. 375-442.

<sup>253</sup> Abdulaziz Ed-Duri & Abas Ihsan (redaktorë), Et-Terbijjet'ul-arabijjet'ul-islamijjetu: el muessesatu ve'l-mumaresatu, Aman: Muessesetu Alu'l-Bejt, 1989-1990 në katër vëllime.

tre dhe pesë hixhri, arsimi te Fatimijinët, roli i mexhliseve në edukim islam deri në shekullin e pestë hixhri.

Vëllimi i dytë ka përfshirë pesë kapituj: historia e shkollave, në veçanti shkollat Nidhamije, institucionet arsimore në Irak në shekujt pesë dhe shtatë hixhri, shkollat te Mura-bitët dhe Muvahidët, në Andaluzi nga shekulli i pestë hixhri deri në rënien e Andaluzisë, shkollat në kohën e ejubitëve dhe memlukëve në tokat e Shamit.

Vëllimi i tretë ka përfshirë nëntë kapituj, ku ka përfshirë arsimin në Egjipt në kohën e memlukëve, arsimin në Magrib (pjesa veriperëndimore e vendeve arabe) në kohën e sedijëve dhe alevijëve, vakëfet dhe arsimi në kohën e ejubijëve dhe memlukëve, vakëfet në Bejt'ul-Makdis, arsimi mjekësor në Islam, edukimi sipas ibadive, hyrje në njohjen e braktisjes si diturisë në Jemen, Xhamia Karavijin, Xhamia Zejtun.

Ndërsa vëllimi i katërt ka përfshirë tetë kapituj ku është shkruar rreth tubimeve shenkitije dhe roli i tyre në përhapjen e diturisë, roli kulturor dhe pedagogjik i muslimanëve në Afrikën perëndimore nga shekulli i pestë deri shekullin e tetë hixhri, historia e arsimit islam në Afrikën perëndimore para okupimit, arsimi në Irak nga fundi i shekullit XIX deri në dekadat e para të shekullit XX, roli arsimor i Institutit El-Mekasid'ul-hajrijet'ul-islamijetu në Bejrut, arsimi në Hixhaz në shekullin e trembëdhjetë dhe gjysmën e parë të shekullit katërbëdhjetë hixhri, arsimi në Sudan në shekullin XIX dhe fillim të shekullit XX, dhe në fund, modeli islam i edukatës.

Pjesa e tretë: Personalitete të pedagogjisë arabe islame

Kjo pjesë përfshin katër vëllime. Përgatitjen dhe botimin e këtij libri e ka mbikëqyrë Zyra e edukatës arabe të Shteteve të Gjirit. Është botuar në vitin 1988.<sup>254</sup> Këtu janë përfshirë një numër i studimeve të specializuara për një numër të personaliteteve pedagogjike islame, përfshirë të gjitha shkollat ideologjike: fikhut, hadithit, filozofisë, sufizmit, shoqërisë, pra janë përfshirë: fukaha (juristë), edukatorë, letrarë, filozofë,

<sup>254</sup> Mekteb'ut-terbijjet'il-arabijji li duvel'il-halixhi. Min A'l'am'it-terbijjet'il-arabijjet'il-islamijeti, Riad, 1988-1989, katër vëllime.



etikologë, historianë etj. Në këtë studim janë përfshirë 42 personalitete, përfshirë edhe një numër të sahabëve.

Vëllimi i parë ka përfshirë dhjetë studime rreth personaliteteve islame pedagogjike që nga shekulli i parë hixhri deri ka fundi i shekullit të tretë hixhri. Vëllimi i dytë ka përfshirë studime të njëmbëdhjetë personaliteteve të shekujve të katërt dhe të pestë hixhri. Vëllimi i tretë ka përfshirë studime të dhjetë personaliteteve nga fillimi i shekullit të gjashtë deri në shekullin e tetë hixhri. Ndërsa, vëllimi i katërt ka përfshirë periudhën tjetër kohore, duke filluar nga mesi i shekullit të tetë hixhri deri në fillim të shekullit katërmëdhjetë hixhri. Në këtë vëllim janë përfshirë studime mbi njëmbëdhjetë personalitete pedagogjike.

### 3. Disertacionet pedagogjike universitare

Sa i përket disertacioneve universitare për studentët e ciklit të dytë dhe të tretë të studimeve, duhet theksuar se 35 vjetëshi i fundit i shekullit XX ka përjetuar themelimin e qindra universiteteve në vendet arabe. Kështu numri i universiteteve të regjistruara në Unionin e universiteteve arabe ka arritur 331. Ndërsa numri i universiteteve, si anëtare të plota në Unionin e universiteteve të Botës Islame ka arritur më shumë se 322. Është më se e vërtetë se numri i këtyre universiteteve është në rritje e sipër.

Instituti Botëror i Mendimit Islam ka mbikëqyrë përgatitjen e disa katalogëve në sferën e fushës pedagogjike dhe ekonomike në disa shtete. Si shembull përmendim katalogun të cilin e ka përgatitur Instituti Botëror i Mendimit Islam (zyra në Jordani), ku ka grumbulluar dhe analizuar hulumtimet të cilat janë realizuar në fushën e pedagogjisë islame në Jordani deri në vitin 2010.<sup>255</sup> Nga hulumtimi është vërejtur ekzistimi i më shumë se 200 temave të magjistraturës dhe doktoraturës në fushën e trashëgimisë pedagogjike, të mbrojtura vetëm në Universitetet e Jordanisë. Në vitin 1993, Instituti Botëror i

<sup>255</sup> Maxhid Zeki El-Xhelad, (përgatitje dhe redakturë), El-Bahth'ul-ilmiyyu fi't-terbijjet'il-islamijeti fi'l-Urdun: dirasetun tahlilijetun bibliografije, Aman: IBMI, 2011.

Mendimit Islam ka përgatitur një referencë të disertacioneve universitare rreth pedagogjisë islame, në universitetet e Egjiptit dhe të Saudisë.<sup>256</sup> Është vërtetuar ekzistimi i 175 temave universitare të mbrojtura në universitetet e Egjiptit dhe 83 tema të mbrojtura në universitetet e Arabisë Saudite, dhe atë deri në vitin 1993.<sup>257</sup> Katalogu i fundit rreth disertacioneve në fushën e pedagogjisë islame në universitetet e Egjiptit për periudhën 1990-2011 tregon për 170 tema të mbrojtura në magistraturë dhe doktoraturë, ku 20 prej tyre janë në temat e trashëgimisë pedagogjike islame.

Nuk mund të zgjerohem për të dhënë detaje rreth këtyre disertacioneve. Ato janë në forma të ndryshme. Disa flasin për kontributin e ndonjërit nga personalitetet pedagogjike islame. Disa flasin për shkollat e fikhut apo të akaidit. Disa të tjera për një periudhë të caktuar. Këto tema janë mbrojtur në fakultete dhe katedra të ndryshme si fikh, hadith, tefsir, filozofi, gjuhë, letërsi etj.

Prej këtyre disertacioneve, disa mund të klasifikohen si tema pedagogjike, si p.sh. shkrimet rreth Zernuxhit, Kabisit, Gazaliut, Almeviut, Ibn Sinait, Ibn Xhemaah etj. Po ashtu, kanë përfshirë dijetarë të njohur në fushat e fikhut, hadithit, historisë e tjera, por shkrimet e tyre kanë përfshirë çështje të qarta pedagogjike si p.sh. Ebu Hanife, Maliku, Xhahidhi, Ibn Halduni etj. Ajo që bie në sy se shumica e dijetarëve në historinë islame kanë shkruar rreth vlerës së diturisë, mësimnxënies dhe mësimdhënies, kanë ligjëruar, pa marrë parasysh se a bëhet fjalë për fikh, hadith, tefsir, gjuhë apo diç tjetër. Sipas këtij aspekti, shumicën e dijetarëve të umetit mund të konsiderojmë si pedagogë, sipas kuptimit të përgjithshëm të pedagogjisë. Shkrimet e tyre janë risi historike në konceptet e pedagogjisë dhe degët e saj, të cilat nuk ishin të qarta dhe të dalluara siç janë sot.

Disa disertacione universitare janë marrë me praktikat arsimore të veçanta për shkollat e fikhut (jurisprudencës

<sup>256</sup> Abdurrahman Nekib, (përgatitje dhe redakturë), Delilu mustahlesat-ir-resail'il-xhami'ijeti fi't-terbijjet'il-islamijjeti bi'l-xhamiat'il-misrijjeti ve's-saudijjeti, Hernden: Instituti Botëror i Mendimit Islam, 1994.

<sup>257</sup> Mustafa Rexheb, (redaktor), Delilu resail'it-terbijjet'il-islamijjet fi'l-xhamiat'il-misrijjeti min 1990-2010, Kajro: El-Hej'et'ul-misrijjet'ul-ametu li'l-kutubi, 2016.

islame) apo shkollat e akaidit (apologjetikës). Disa të tjera kanë folur për aspektet pedagogjike në ndonjë periudhë prej periudhave islame apo për ndonjë vend prej vendeve islame.

#### 4. Trashëgimia pedagogjike në revistat periodike

Bazuar në atë se nuk ka sisteme të rregulluara të përmbajtjeve që zbulojnë në mënyrë të përgjithshme temat, është e vështirë përmbledhja e gjithë asaj që është botuar rreth trashëgimisë pedagogjike në revistat shkencore. Disa prej revistave janë të veçanta për hulumtime pedagogjike që përfshijnë disa çështje të trashëgimisë, ndërsa disa të tjera janë revista universitare të përgjithshme që publikojnë tema të përgjithshme, në mesin e të cilave mund të ketë edhe tema pedagogjike që ndërliidhen me trashëgiminë.

Kemi arritur të shfletojmë të gjitha numrat e disa revistave që nga botimi i numrave të parë me qëllim që të dallojmë të veçantat për trashëgiminë pedagogjike islame. Atë që e kemi gjetur e kemi theksuar si të dhënë.<sup>258</sup> Kemi vërejtur se llojshmëria të cilën e potencuam rreth disertacioneve të studimeve të larta, e njëjta përsëritet edhe të temat e revistave. Ka tema që janë marrë me personalitete shkencore që kanë dhënë kontribut pedagogjik, si Ibn Sehnuni, Kabisiu, Gazaliu, Ibn Halduni etj. Ka tema që i bëjnë analizë dhe studim përmbajtjes edukative ose arsimore në librat e hadithit, fikhut, tesavufit, historisë e tjera, si: Tahlilu kitab'il-ilmu fi Sahih'il-Buhari. Ka tema që flasin për gjendjen arsimore në një vend të caktuar në një kohë të caktuar si vendet e Shamit në periudhën emevite, Egjipti në periudhën e fatimijëve. Ka studime për një përmbajtje të caktuar pedagogjike si: edukimi i fëmijës me anë të ndëshkimit fizik në mendimin pedagogjik islam.

#### 5. Trashëgimia pedagogjike islame në librat e publikuara

<sup>258</sup> Melkavi, *Et-Turath'ut-terbevijj'ul-islamijju*, vepër e cituar, fq. 161-164.

Në çerekun e fundit të shekullit XX, bota arabe dhe islame përjetoj një zgjerim të madh në arsimin publik dhe arsimin universitar. Nevoja për themelimin e fakulteteve pedagogjike në kuadër të universiteteve u rrit shumë. Këto fakultete bënë përgatitjen profesionale në profesionet pedagogjike si: mësimdhënës, drejtorë, inspektorë dhe gjërat që u nevojiteshin si: plan-programe mësimore dhe libra mësimorë. Me lirinë relative që ndodhi në disa shtete arabe dhe islame në këtë periudhë dhe me shfaqjen e rizgjimit islam, disa profesorë universitarë u aktivizuan në publikimin e veprave të tyre, qofshin këto vepra si disertacione universitare ose si tema të publikuara në revista periodike. Mendimi pedagogjik islam kishte një pjesë të theksuar në këtë sferë. Ajo që tërheq vëmendjen është se mendimi pedagogjik islam në të shumtën e rasteve ka përfshirë mendimin që ka qenë dominues në vendet e Botës Islame në periudha të ndryshme, gjë e cila, sipas neve, përfshihet në titullin “trashëgimi”.

Përkujtojmë se atë që treguam më parë rreth përpjekjeve të përbashkëta në studimin e trashëgimisë nga ana e Organizatës Arabe për Edukim, Kulturë dhe Shkencë, Zyra Edukative e Shteteve të Gjirit Persik, dhe Kompleksit Mbretëror për Hulumtime të Civilizimit Islam, së fundi janë publikuar në formë të librave nga ana e tre institucioneve.

Mahmud Kamber është bërë i njohur në fushën e trashëgimisë pedagogjike islame, ngase ka publikuar një numër të hulumtimeve dhe më pas i ka botuar në një libër prej tre vëllimeve nën titullin “Studime trashëguese në pedagogjinë islame”. Studimi i tij është dalluar me hulumtime analitike dhe kritike, gjë të cilën nuk e kemi gjetur te dikush tjetër.<sup>259</sup>

Duke pasur parasysh edhe dimensionin tregtar në publikimin e librave, shtëpitë botuese janë interesuar rreth librave dhe studimeve që ndërliidhen me pedagogjinë islame dhe me trashëgiminë pedagogjike islame. Shumë rrallë mund të gesh ndonjë shtëpi botuese apo librari, të mos ketë një apo më shumë libra në këtë tematikë. Nuk duhet harruar se disa

<sup>259</sup> Mahmud Kamber, *Dirasatun turathijjetun fi't-terbijjet'il-islamijjeti*, Doha: Dar'uth-the kafeti, tre vëllime, të botuar më 1985, 1987 dhe 1992.

librari kujdesen për tematikat pedagogjike më shumë se për tematikat tjera. E gjithë kjo, falë raporteve të ngushta që ka libraria apo shtëpia botuese me autorë të specializuar në fushën e pedagogjisë, ku publikon librat e tij.

Disa prej këtyre librave janë verifikim “tahkik” dhe studim i detajuar të një libri a më shumë të trashëgimisë pedagogjike islame, të cilat në esencë mund të jenë edhe disertacione universitare. Shembuj për këtë ka shumë, në mesin e të cilave edhe libri i Ehvanit.<sup>260</sup> Disa prej këtyre librave janë përzgjedhje e teksteve të caktuara të trashëgimisë pedagogjike, pa koment. Shembull për këtë lloj është libri i Muhamed Nasir.<sup>261</sup> Disa libra përfshijnë përzgjedhje të shkurtra nga disa libra të trashëgimisë, mirëpo këto përzgjedhje janë të klasifikuara sipas tematikave të trashëgimisë pedagogjike, si p.sh.: rregullat e mësuesit në veten e tij, në diturinë e tij, me nxënësit e tij, rregullat e nxënësve, parimet pedagogjike, parimet psikologjike...<sup>262</sup>

Disa prej këtyre librave janë projekt që përfshijnë një numër më të madh të librave të trashëgimisë, qoftë përmes verifikimit, studimit apo publikimit të teksteve. Në mesin e atyre që janë njohur në këtë sferë është edhe Abdulemir Shemsudin, i cili ka përgatitur (ose ka mbikëqyrë përgatitjen) e trembëdhjetë librave. Secili libër prej tyre është i veçantë për një referencë prej referencave të trashëgimisë si Sem’ani ose dy referenca si Ibn Sehnun dhe Kabisi, ose tre referenca si Xhahidh, Ibn Mukafe dhe Abdulhamid Katib. Siç potencon Shemsudini, këto libra kanë mbuluar fushat e pedagogjisë islame: të fikhut, filozofisë, letërsisë, apologjetikës etj.<sup>263</sup>

Si vepër enciklopedike në fushën e trashëgimisë së mendimit islam është edhe arritja e Muhamed Arabi Hatabi me titull: “Mevsuat’ut-turath’il-fikrij’il-arabij’il-islamijji”. Në këtë libër ka përfshirë tekste të trashëgimisë rreth arsimit,

<sup>260</sup> El-Ehvani, Et-Terbijjetu fi’l-islami, vepër e cituar, fq. 380.

<sup>261</sup> Muhamed Nasir, Fi’l-fikr’it-terbevij’il-arabij’il-islamijji, Kuvajt: Vekalet’ul-metbuati li’n-neshri, 1977. Këtu përfshihen dhjetë tekste të përzgjedhura.

<sup>262</sup> Fadil Abas Ali En Nexhadi, Adab’ul-alimi ve’l-muteal-limi fi’t-turath’il-arabij’il-islamijji, Damask: Dar’ul-Kalem, 2012, fq. 544.

<sup>263</sup> Këto libra janë botuar nga ana e shtëpive të ndryshme botuese, por si tërësi janë botuar nga shtëpia botuese Ikre’.

politikës, etikës, letërsisë, filozofisë, metodologjisë së hulumtimit etj.<sup>264</sup>

Seid Ismail Ali në shkrimet e tij rreth pedagogjisë është dalluar, ngase ka përfshirë dimensionin historik të arsimit në civilizimet njerëzore, trashëgiminë islame duke përfshirë personalitetet, veprat dhe rrymat, si dhe duke pasur në konsideratë edhe vetëdijen ndaj realitetit bashkëkohor dhe nevojave për reformim. Në lidhje me këtë çështje, ai ka publikuar dhjetëra libra. Prej tyre dy enciklopedi. E para rreth zhvillimit civilizues të pedagogjisë islame në mënyrë të përgjithshme<sup>265</sup> dhe e dyta rreth zhvillimit kulturor të arsimit në Egjipt.<sup>266</sup>

Në fund, edhe një herë përsërisim se në këtë pjesë të shkrimeve bashkëkohore rreth trashëgimisë pedagogjike islame, nuk kemi synuar të përfshijmë të gjitha shkrimet, ngase një gjë e tillë, edhe krahas dëshirës, është e pamundur. Ne kemi synuar -në kuadër të këtij libri- të japim të dhëna se ekzistojnë burime dhe referenca të rëndësishme në këtë tematikë, të cilat meritojnë të jenë të njohura. Megjithatë -në të njëjtën kohë- nuk mjaftojnë për të mbyllur derën para veprave analitike dhe kritike tjera, të cilat do të kenë në konsideratë arritjet e mëhershme dhe do të përpiqen të gjejnë vrima dhe zbrazëtira të cilat meritojnë përpjekje edhe më të mëdha të hulumtuesve.

## Përmbyllje:

Pasi trashëgimia pedagogjike islame konsiderohet si një nga burimet përmes të cilave përpiqemi të formojmë mendimin tonë pedagogjik, në këtë kapitull kemi bërë përpjekje të ofrojmë një pasqyrë të shkurtër rreth konceptit të kësaj trashëgimie, zhvillimit, personaliteteve pedagogjike, llojshmërisë së metodologjisë së librave dhe gjendjen e hulumtimit bashkëkohorë rreth tij. Vërejtëm se trashëgimia pedagogjike nuk ka përfshirë vetëm librat që janë marrë vetëm me

<sup>264</sup> Muhamed El-Arabi El-Hatabi, *Mevsuat'ut-turath'il-arabijj'il-islamijji*, Bejrut: Dar'ul-garb'il-islamijji, 1998, dy vëllime në 872 faqe.

<sup>265</sup> Seid Ismail Ali, *Mevsuat'ut-tetavvur'il-hadarijji li't-terbijjet'il-islamijjeh*, I-V, Dar'us-selam, Kajro, 2010.

<sup>266</sup> Seid Ismail Ali, *Mevsuat'ut-tetavvur'ith-the kafijji li't-ta'limi fi Misre*, I-V, Dar'us-selam, Kajro, 2010.

edukimin dhe arsimimin, por ka përfshirë shumë prej çështjeve që kanë shkruar dijetarët muslimanë në librat e tyre, përfshirë letërsinë, etikën, shkencat natyrore, personalitetet shkencore që kanë kontribuar në lëvizjen shkencore dhe institucionet në të cilat janë zhvilluar aktivitete shkencore. Kemi pasur mundësinë të shfletojmë disa nga librat e trashëgimisë, të punuar nga ana e hulumtuesve dhe publikuesve. Me siguri se atë që nuk kemi arritur ta shfletojmë, e që gjenden në bibliotekat në formë të dorëshkrimeve në vende të botës, është shumë më shumë se atë që e kemi shfletuar. Mos të harrojmë se një pjesë e madhe e trashëgimisë pedagogjike ka humbur ose është zhdukur, qoftë me qëllim apo nga pakujdesi.

Kuptimin e “trashëgimisë” e përkufizua në atë që kanë shkruar dijetarët islamë, duke filluar nga periudha e regjistrimit, duke pasur në konsideratë se Kur’ani dhe suneti peygamberik nuk janë pjesë e trashëgimisë. Vërejtëm se si zhvillimi i trashëgimisë pedagogjike është shoqëruar nga zhvillimi i shkencave në shoqërinë islame. Këto shkenca kanë lindur dhe janë zhvilluar në mexhliet e ilmit-diturisë. Të gjitha këto mexhliet -edhe krahas realizimit në vende të ndryshme dhe llojshmërisë së përmbajtjeve- kanë pasur mësues, nxënës dhe lëndë mësimore. Mësimi është organizuar sipas rregullave dhe kriterëve të caktuara, që kishin për qëllim orientimin e njeriut drejt sferave të mësimnxënies dhe mësimdhënies, formimin shoqëror, pastrimin psikik, moral të mirë. E gjithë kjo krahas vënies së kriterëve në bashkëveprimin shoqëror në jetën familjare, shoqërore, ekonomike, politike etj. Shkencat të cilat dijetarët i shkruanin dhe më pas ua mësonin të tjerëve ishte mendimi i tyre pedagogjik i kohës së tyre. Me ardhjen e kohës tjetër, ky mendim bëhej trashëgimi për gjeneratat e reja. Vjen gjeneratë e re e dijetarëve, të cilët bashkëveprojnë me trashëgiminë, por edhe ata japin kontributin e tyre duke përmirësuar apo shtuar si rezultat i kërkesave të kohës së tyre, dhe kështu zhvillohej mendimi dhe trashëgimia.

Dukuria e llojshmërisë në trashëgiminë pedagogjike islame ka marrë kahe të ndryshme. Pjesë e trashëgimisë janë

edhe përpjekjet e dijetarëve në përcaktimin e praktikave normative të arsimit dhe edukimit në shoqërinë islame. E gjithë kjo duke u mbështetur në Kur'an dhe Sunetin Pejgamberik, gjë e cila llogaritet si ixhtihad-përpjekje në zbritjen e teksteve për zbatim praktik. Pjesë e trashëgimisë është edhe përkrimi i praktikave mësimore, të cilat i ka vërejtur autori në kohën e tij. Kjo më pas është bërë burim historik i rëndësishëm rreth shkencave që janë mësuar, librat që janë lexuar dhe institucionet në të cilat është zhvilluar mësimi.

Llojshmërinë të cilën e kemi gjetur në trashëgiminë pedagogjike islame ka zbuluar një dukuri të rëndësishme. Kjo dukuri është se fusha e edukatës dhe arsimimit në historinë islame nuk ka qenë e kufizuar vetëm te një numër i dijetarëve të cilët kanë qenë të specializuar në arsim, por secili që kishte njohuri, merrej me arsimim, shkruante libra, u diktonte nxënësve, ku të gjithë këtë e bënte ose për hir të Allahut duke kërkuar shpërblimin e tij, ose duke synuar reformimin dhe përmirësimin e gjendjes së shoqërisë ose si profesion për të siguruar kafshatën e gojës. Në kuadër të kësaj llojshmërie rreth interesimeve të dijetarëve, kemi vërejtur se tematikat arsimore kanë përfshirë çështjet për të cilat kishte nevojë shoqëria islame si: Kur'ani, hadithi, akaidi, fikhu, letërsia, filozofia, mjekësia, pastrimi shpirtëror-etika, lufta në rrugë të Allahut etj. Secila prej këtyre shkencave kishte rrethanat në lindjen, zhvillimin dhe kontributin e saj në shoqëri. Duke përcjellë zhvillimin e këtyre shkencave, vërejtëm se kanë filluar gojarisht, më pas janë zhvilluar dhe janë regjistruar, nga mësimi me anë të përsëritjes në shkrim të teksteve, nga mbajtja e ligjërimin në diktimin e tyre. Vendet për mësim janë zhvilluar, ku nga xhamia dhe mektebi kanë kaluar në vende edukimi dhe shkolla. Nga shkrimi i teksteve në komentimin e tyre, abstraktimin dhe shkrimin në forma të poezisë. Është zhvilluar pozita e mësuesit dhe janë dalluar nivelet e mësuesve dhe edukatorëve. Pra, zhvillimi ishte një cilësi elementare në historinë e secilës shkencë dhe çështje metodologjike që ka nevojë të merret në konsideratë gjatë kuptimit tonë ndaj trashëgimisë pedagogjike islame dhe gjatë kuptimit tonë ndaj



mendimit pedagogjik islam, të cilin dëshirojmë ta formojmë sot dhe nesër.

Na u bë e qartë se trashëgimia pedagogjike islame është përfshirë në shumë hulumtime dhe studime bashkëkohore, shumica e të cilave ishin disertacione të paraqitura nga ana e studentëve të studimeve të larta, hulumtime të botuara në revista shkencore, të cilat i botojnë profesorët universitarë, që të llogariten si punime shkencore për avancim. Në shkallën e tretë të këtyre studimeve vijnë edhe librat e botuara nga ana e shtëpive botuese, ku disa prej tyre në esencë ishin disertacione universitare, hulumtime të botuara në revista periodike, nga të cilat një numër i tyre mund të bashkohen dhe të bëhen libër. Në vendin e katërt vijnë libra të cilat në esencë ishin projekt hulumtues të cilin e kanë realizuar tre institucione me bashkëveprim të përbashkët në planifikim, financim dhe botim. Ky projekt është i një rëndësie të veçantë, ngase mbulon në mënyrë të gjerë personalitetet pedagogjike dhe institucionet pedagogjike, mirëpo për shkak të mosinteresimit të mjaftueshëm për blerje, janë botuar në libra të veçanta.

Ky prezantim i shpejtë i trashëgimisë pedagogjike islame ka zbuluar shumë nga vetitë pozitive të cilat kanë reflektuar gjallërinë e mendjes së muslimanit dhe përgjegjësinë e shoqërisë islame ndaj arsimit. Në të njëjtën kohë ka zbuluar edhe gjendjen e shoqërisë islame, ndryshimet në të cilat kalonte gjendja e arsimit, zhvillimi, niveli dhe sistemet e institucioneve, pozita e mësimdhënësit etj. Mendojmë se për periudhat për të cilat jemi duke folur, shoqëritë njerëzore nuk kanë pasur një trashëgimi të tillë.

Është e vërtetë se zhvillimi në mendimin pedagogjik nuk ka përjetuar disa parime për të cilat burimet islame nga Kur'ani dhe suneti kanë udhëzuar drejt tyre si p.sh.: obligueshmëria e arsimit, zhvillimi i shkencave dhe teknologjisë praktike, vazhdimi i arritjeve kreative në fushën e arsimit, të cilat ishin shfaqur në shekullin e tretë dhe të katërt hixhri. Shoqëria islame në disa vende ka kaluar në rrethana që nuk kanë dalë nga e vjetra, kanë urreyer shkrimin dhe përpilimin e librave dhe përdorimin e librave të reja. Njeriu habitet se si

përhapja e diturisë, shpërndarja e institucioneve arsimore dhe zhvillimi i çështjes së transkriptuesve dhe shkruesve nuk ka qenë i mjaftueshëm për zbulimin dhe zhvillimin e shtypshkronjës?

Mbetet pyetja edhe më e rëndësishme, e cila flet për qëllimin që na shtyu të merremi me këso hulumtime dhe studime rreth çështjeve të trashëgimisë. Për këtë jemi përpjekur të hapim derën e përgjigjes në kapitullin e shtatë të këtij libri gjatë shqyrtimit të metodologjisë së bashkëveprimit me trashëgiminë pedagogjike islame. Çka do të thotë bashkëveprim? Kush janë ata që bashkëveprojnë? Cilat janë metodologjitë e bashkëveprimit? Kemi nxjerrë disa qëllime të hulumtimit në trashëgiminë dhe detyrat e tij në jetën bashkëkohore. Kemi tërhequr vëmendjen për disa vlera sekondare të trashëgimisë pedagogjike. Për këtë, edhe kemi propozuar të mbështetemi në disa parime të caktuara në përcaktimin e vlerës pedagogjike dhe aspekteve të mundshme për shfrytëzimin e tyre.

## KAPITULLI I TRETË

### BURIMET E MENDIMIT PEDAGOGJIK BASHKËKOHOR ISLAM

#### *Parathënie*

*Pjesa e parë: Kur'ani Famëlartë burim i mendimit pedagogjik*

1. Çështje të veçanta në Kur'an rreth diturisë, mësimnxënies dhe mësimdhënies
2. Tematikat e arsimit në Kur'an

*Pjesa e dytë: Suneti peygamberik burim i mendimit pedagogjik*

1. Prezenca e sunetit peygamberik në çështjet pedagogjike në trashëgimi dhe shkrimet bashkëkohore
2. Argumentimi i sunetit peygamberik në edukatë dhe arsim
3. Suneti peygamberik në shkencat që janë obligative të mësuarit e tyre
4. Mësimnxënia në sunetin peygamberik
5. Mësimdhënia në sunetin peygamberik

*Pjesa e tretë: Trashëgimia pedagogjike islame burim i mendimit pedagogjik bashkëkohor islam*

1. Trashëgimia si burim dhe argumentim
2. Çështja e anashkalimit të trashëgimisë dhe marrja drejtpërdrejt nga Kur'ami dhe suneti
3. Vlera e trashëgimisë pedagogjike islame si burim
4. Shembuj për përdorimin e materies trashëguese në çështje pedagogjike bashkëkohore

*Pjesa e katërt: Përvoja pedagogjike bashkëkohore burim i mendimit pedagogjik bashkëkohor islam*

1. Çka nënkuptojmë me përvojën pedagogjike bashkëkohore?
2. Mendimi pedagogjik dhe gjendja civilizuese e shoqërisë
3. Njeriu si qëllim dhe mjet i pedagogjisë
4. Bashkëveprimi me përvojën bashkëkohore është pikënisja për veprim
5. Referenca e përvojës bashkëkohore dhe domosdoshmëria e kohës

#### *Përmbyllje*

# **KAPITULLI I TRETË**

## **BURIMET E MENDIMIT PEDAGOGJIK BASHKËKOHOR ISLAM**

## Parathënie

Sipas kuptimit të veçantë institucional, me fjalën “edukatë” nënkuptohet atë që e ofrojnë institucionet e arsimit fillor, të mesëm dhe universitar. Ndërsa, sipas kuptimit të përgjithshëm shoqëror me “edukatë” nënkuptohet atë që e ofrojnë bashkërisht gjitha institucionet shoqërore dhe që synojnë formimin e personalitetit njerëzor në të gjitha dimensionet mendore, shpirtërore dhe shoqërore. Edukata me dy llojet e lartshënuara mbështetet në një referencë, të cilën shoqëria e pranon për gjykim dhe i orienton gjitha institucionet për të siguruar edukatën e nevojshme. Pasi Islami është referencë, atëherë gjitha sistemet dhe organet shoqërore (politike, ekonomike, shoqërore, morale, ligjore, administrative...) japin kontributin e tyre në edukimin e individit, arsimimin e tij, formimin e personalitetit të tij dhe kontrollimin e raporteve mes individëve sipas dispozitave dhe udhëzimeve islame, në kuadër të kuptimit tonë ndaj këtyre dispozitave dhe udhëzimeve.

Si rezultat i saj, cilësia e mendimit pedagogjik që mbizotëron në shoqëritë tona, mund të zbulon nivelin e prezencës ose mosprezencës së kësaj reference. Supozohet që kjo referencë të përcakton gjitha çështjet që ndërliidhen me mendimin pedagogjik, në veçanti burimet, intencat, karakteristikat dhe sferat e këtij mendimi.

Ne besojmë se Allahu ka krijuar njeriun dhe e ka dalluar nga gjitha krijesat me anë të mendjes, me të cilën dallon gjërat dhe veprat, kupton ekzistimin, karakteristikat dhe ndryshimet e tyre. Andaj, Allahu është burimi i parë i çdo gjëje që mund ta kupton njeriu. Allahu e ka zbritur Kur’anin udhëzim për njerëzit:

﴿وَلَقَدْ جِئْنَاهُمْ بِكِتَابٍ فَصَّلْنَاهُ عَلَىٰ عِلْمٍ هُدًى وَرَحْمَةً لِّقَوْمٍ يُؤْمِنُونَ﴾

*“Ne u sollëm atyre (mekasve) një libër (Kur’anin) që ua shkoqitëm në baza të diturisë, e që është udhërrëfyes e mëshirë për ata që besojnë”. [El-A’raf: 52].*

Kështu, ky Kur'an, me ajetet e tij që lexohen është burim udhëzimi. Allahu ka krijuar edhe krijesat tjera. I ka mundësuar njeriut të ecë mbi tokë dhe të shfrytëzon gjitha mjetet e vetëdijesimit dhe ndjeshmërisë siç janë: veshin për dëgjim, syrin për shikim dhe zemrat për mendim. Allahu thotë:

﴿أَفَلَمْ يَسِيرُوا فِي الْأَرْضِ فَتَكُونَ لَهُمْ قُلُوبٌ يَعْقِلُونَ بِهَا أَوْ آذَانٌ يَسْمَعُونَ بِهَا فَإِنَّهَا لَا تَعْيَى الْبَصَارَ وَلَكِنْ تَعْيَى الْقُلُوبَ الَّتِي فِي الصُّدُورِ﴾

*“A nuk udhëtuan ata nëpër tokë e të kenë zemra me të cilat do të kuptojnë, dhe veshë me të cilat do të dëgjojnë? Pse në të vërtetë sytë nuk verbërohen, por verbërohen zemrat në kraharor”. [El-Haxh: 46]*

Kur njeriu t'i përgjigjet urdhrin të Allahut duke ecur, medituar, menduar dhe hulumtuar këto krijesa, atëherë do të kupton detyrën dhe karakteristikat e tyre, si dhe nënshtrimin për atë që janë krijuar. Në këtë rast, këto krijesa -argumentet e Allahut që shihen- gjithashtu do të bëhen burim udhëzimi. Në fund të fundit, burimet janë fjalët e Allahut dhe krijesat e Tij, përmes së cilave njeriu udhëzohet në mendimin dhe sjelljen e tij.

Është plotësisht normale që Kur'ani të jetë burimi bazë i mendimit pedagogjik islam dhe gjitha sferave tjera të mendimit. Në Kur'an ka udhëzime të qarta pedagogjike të cilat flasin rreth mësimnxënies, mësimdhënies, edukatës, pastrimit shpirtëror, përgjegjësisë së prindërve në edukimin dhe arsimimin e fëmijëve, përgjegjësisë së autoriteteve shoqërore në përkujdesje ndaj anëtarëve të shoqërisë në të gjitha çështjet, përgjegjësinë e shoqërisë në sigurimin e resurseve të nevojshme njerëzore për mbrojtjen e shoqërisë, sigurimin e fuqisë dhe prosperitetit dhe përgjegjësinë e individit në mësimin e çështjeve të nevojshme për adhurim, qoftë adhurim drejtpërdrejt me Allahun ose në raport me njerëzit, për të realizuar lumturinë e tij në këtë botë dhe në ahiret. Në Kur'an ka ftesë për përfitimin e diturisë në horizontet natyrore, shoqërore dhe psikologjike, ngritje në nivelet dhe thellim në tematikat e tyre. Kjo gjë e detyron umetin të merr në konsideratë të gjitha mjetet e nevojshme për të kontribuar drejt realizimit të fuqisë, mbrojtjes, të qenit popull më i mirë, mesatar, të qenët me peshë dhe kryerjen e amanetit të hilafetit (mëkëmbësisë) në

Tokë. Me këtë, Kur'ani është referenca bazë në përcaktimin e filozofisë, qëllimeve dhe tematikave të pedagogjisë, rreth asaj që kërkohet për edukimin e individit, formimin e shoqërisë dhe umetit dhe realizimin e vullnetit të Allahut nga krijimi i njeriut dhe ekzistimi i tij në këtë botë.

Muhammedi alejh'is-selam, në periudhën e shpalljes, ka zbatuar në mënyrë praktike këto udhëzime kur'anore, në veçanti sa i përket formimit të personalitetit të njeriut musliman, formimin e shoqërisë së re islame në atë kohë dhe bashkëveprimet me çështjet e saj. Kështu, suneti peygamberik dhe sireja (jeta) peygamberike janë burim tjetër në kuptimin e ajeteve kur'anore dhe zbritjen e tyre në rrafshin praktik, marrë në konsideratë kohën dhe vendin e zbritjes së tyre. Këtu nuk do të futemi në polemikën rreth mundësisë së pavarësisë së sunetit në legjislacion. Mjafton të potencojmë tri çështje: e para: se vetë Kur'ani ka përcaktuar përgjegjësinë e Muhammedit alejh'is-selam në sqarimin e intencave kur'anore. E dyta: se Kur'ani ka urdhëruar bindjen ndaj Muhammedit alejh'is-selam, ngase ai është i mbrojtur (i pagabueshëm) i cili vepron vetëm me atë që Allahu ia shpallë atij, dhe, e treta: se suneti i Pejgamberit alejh'is-selam ka hapur dyert për shfrytëzimin e përvojave të ndryshme që gjenden në shoqëri, në çështjet për të cilat nuk ka ajete kur'anore, por janë pjesë e eksperiencës nga vetë jeta e Muhammedit alejh'is-selam, ose ndonjërit nga shokët e tij, ose ka qenë ixhtihad kolektiv, praktikimin e të cilës e ka mbikëqyrë Muhamedi alejh'is-selam si zbatim i parimit të shurasë (konsultimit). Ka raste kur ka zbritur shpallja për të përmirësuar qëndrime dhe praktika. Sipas këtij kuptimi, ne shohim sunetin e Muhammedit alejh'is-selam si burim sqarues ndaj udhëzimeve kur'anore dhe zbritje të dispozitave të tij në realitetin praktik. Kështu, Muhammedi alejh'is-selam ka qenë model dhe shëmbëlltysë në çështjet pedagogjike: tematikat, metodologjitë dhe mjetet pedagogjike.

Në periudhën e sahabëve, tabiinëve dhe gjeneratave që erdhën pas tyre, njerëzit duke u bazuar në Kur'an dhe sunet, dhe duke kuptuar intencat e tyre, filluan të bëjnë ixhtihad

rreth organizimit të çështjeve të tyre. Si rezultat i gjithë kësaj, ka lindur dhe është zhvilluar një trashëgimi e madhe, që përfshin përvojat e ndryshme dhe të llojllojshme, të cilat janë ndikuar nga grumbullimi i përvojave gjatë shekujve nga një gjeneratë në tjetrën, si dhe duke kontaktuar me përvojat e popujve të tjerë. Kështu, kjo trashëgimi është bërë burim i tretë, që ndikimi i saj vazhdon me vetëdije apo pavetëdije. Është e dobishme që ne të mendojmë në rëndësinë dhe vlerën e kësaj trashëgimie bazuar në disa kriterë, prej të cilave do të cekim tri:

- Lidhshmëria e kësaj trashëgimie me Kur'ani Famëlar-të dhe sunetin pejgamberik në dritën e kuptimit tonë bashkëkohor ndaj teksteve të tyre. Ngase, trashëgimia në esencë ishte rezultat i të kuptuarit e gjeneratave në dritën e kuptimit të Kur'anit dhe sunetit dhe se Kur'ani dhe suneti janë diskurs ndaj gjitha gjeneratave.

- Përshtatshmëria e kësaj trashëgimie me natyrën e problemeve bashkëkohore, ngase trashëgimia në esencë ishte përgjigje dhe reaksion ndaj nevojave të kohës, në të cilën është prodhuar kjo trashëgimi, si dhe bashkëveprim me problemet e saj.

- Lidhshmëria e kësaj trashëgimie me përvojat njerëzore bashkëkohore, ngase çështjet e edukatës dhe arsimit janë çështje elementare, jo vetëm për muslimanët, por për gjithë popujt. Po ashtu, urtësia është gjësend i humbur e muslimanëve. Çdo gjë që është e dobishme dhe është në posedim të popujve të tjerë, muslimanët janë më meritore për të.

Ky shikim ndaj trashëgimisë pedagogjike islame supozohet se do të shpie drejt zhvillimit të një metodologjie për bashkëveprim me të dhe përcaktimin e detyrave ideologjike, psikologjike dhe praktike që mund t'i kryej ajo. Nuk është e pamundur që në trashëgimi të gjejmë mendime pedagogjike të gjalla, që doemos duhet aktivizuar prezencën e tyre në mendimin tonë pedagogjik bashkëkohorë. Mund të ketë mendime që kanë qenë të përshtatshme për kohën e tyre, por nuk janë të përshtatshme për kohën tonë. Mund të kishin



qenë edhe mendime të gabuara që nuk kanë realizuar intencat e pedagogjisë islame ose së paku të disa prej tyre.

Ekziston edhe një burim i katërt i mendimit pedagogjik bashkëkohor islam. Ajo është përvoja njerëzore bashkëkohore, e cila mund të ngërthen çështje të dobishme. Allahu është Zot i botëve, Zot i të gjithë njerëzve. Mirësitë e Tij mund t'ia jep kujt të dojë prej njerëzve -musliman e jomusliman- përfshirë shkenca, njohuri dhe zbulime, të cilat janë si rezultat i shfrytëzimit të fuqive dhe mundësive që Allahu ua ka nënshtruar atyre. Të gjithë këtë e kanë arritur si rezultat i hulumtimit, eksperimenteve dhe angazhimit maksimal. Nuk është diçka e keqe që këto rezultate të jenë materie për hulumtim të muslimanit, analizimin kritik dhe përshtatshmërinë e asaj që është e dobishme. Disa mendime që zhvillohen dhe shfrytëzohen te ndonjë popull për qëllime të caktuara, të njëjtat mund të transferohen dhe të shfrytëzohen nga një popull tjetër për të njëjtat qëllime ose për qëllime të ndryshme. Ky bashkëveprim civilizues ka ndodhur edhe më herët në historinë e muslimanëve, gjë e cila shumë ndodhë edhe sot te të gjithë popujt. Bashkëveprimi dhe njohja mes popujve ka qenë intencë e Allahut në krijesat e Tij. Bashkëpunimi dhe përplohtësimi në sigurimin e dobive, shërbimeve dhe këmbimin e përvojave dhe eksperiencave janë prej rezultateve më të theksuara të kësaj njohje të synuar.

Në këtë kapitull, do të përfshijmë këto katër burime, aq sa lejon hapësira e tij.

## Pjesa e parë: Kur'ani Famëlartë burim i mendimit pedagogjik

Dituria në Islam është njohje që bazohet në argumente dhe fakte. Islami dëshiron që njeriu të mësojë, vetë të përfitojë dituri nga burimet e besueshme, me metoda dhe mjete të përshtatshme, e jo në mënyrë imituese.

Tematikat dhe përmbajtjet e diturisë janë të shumta dhe të llojllojshme. Ka dituri që ndërlidhen me çështjet metafizike, të cilat Allahu ia ka mësuar njeriut, si p.sh.: Tevhidi (besimi në një Zot), melaqet, çështjet e ditës së kiametit etj. Ka dituri që përfshijnë dispozitat që rregullojnë jetën e njeriut, në mënyrë individuale dhe kolektive, si adhurimet dhe veprimet e njerëzve njëri me tjetrin (el-ibadatu ve'l-muamelatu). Ka dituri që ndërlidhen me natyrën, ndodhitë dhe dukuritë e saj, si p.sh.: kimia, fizika, biologjia, astronomia, shkencat aplikative në çështjet e mjekësisë dhe bujqësisë, shkencat logjike në matematikë dhe gjeometri, si dhe shkenca tjera.

Në Kura'nin Famëlartë dhe sunetin pejgamberik gjejmë udhëzime që ndërlidhen me të gjitha këto dituri dhe shkenca. Është kështu sepse Islami është fe reale, që dispozitat dhe udhëzimet e tij ndërlidhen me të gjitha aspektet e jetës së njeriut dhe synon njeriut t'i mundëson të kontrollojë jetën në tokë me qëllim të realizimit të amanetit të mëkëmbjes dhe përparimit në te.

Kur'ani Famëlartë për muslimanin është burim i diturisë, mësimnxënies dhe mësimdhënies rreth fesë në të gjitha sistemet e saj dhe rreth njeriut për të cilin Allahu ka pëlqyer këtë fe si sistem jete në të gjitha aspektet e jetës dhe fazat e zhvillimit të tij. Në Kur'an janë bazat e dispozitave shariatike në çështjet dhe sistemet e besimit, adhurimeve, veprimit me njerëzit dhe moralit. Këto bazamente janë referenca për çështjet tjera që dallon nga to. Feja për muslimanin është sistem jete,

në të gjitha çështjet dhe sferat e saj. Disa prej këtyre bazamenteve përmbajnë shprehje të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë japin kuptimin e duhur, ndërsa disa të tjera, kuptimin e duhur e japin sipas shpirtit të tekstit e jo shprehjes, respektivisht me përmbajtjet përmes udhëzimeve, urdhrave dhe ndalesave që rregullojnë të gjitha çështjet e jetës. Disa prej këtyre bazamenteve i gjejmë të detajuara në mënyrë të përpiktë, siç është rasti në çështjet shoqërore dhe financiare, ngase këtu për qëllim është qëndrueshmëria dhe mosndryshimi. Disa të tjera janë të përgjithshme, që le hapësirë për ndryshim sipas risive dhe ndodhive të vendit, kohës dhe gjendjes, siç është rasti me sistemet politike dhe arsimore. Megjithatë, të gjitha legjislationet kanë intencë të caktuara që në esencë synojnë sjelljen e dobisë për njerëzit dhe largimin e dëmit prej tyre, sjelljen e dobisë për këtë jetë dhe jetën tjetër në ahiret.

Kur themi se Kur'ani Famëllartë është burim i mendimit njerëzor në të gjitha sferat e jetës së njeriut (politike, ekonomike, shoqërore, morale, pedagogjike etj.), kjo nuk nënkupton se do të gjejmë në të një sërë kapitujsh të specializuara në këto sfera, në atë mënyrë që do të gjejmë kapitull në politikë, kapitull në ekonomi, kapitull në pedagogji e tjera, por aty ka udhëzime që gjykojnë dhe orientojnë në këto dhe sfera tjera, që me anë të përkujdesit përplotësohen me aspektet mendore dhe psikike. Po ashtu, me anë të përkujdesit përplotësohen në fushat e raporteve në nivel të familjes, shoqërisë, umetit dhe mbarë njerëzisë.

Librat dhe hulumtimet të cilat janë marrë me mendimin pedagogjik në Kur'anin Famëllartë janë të shumta. Ngjashëm me te janë edhe librat dhe hulumtimet që janë marrë me mendimin pedagogjik në Kur'an dhe sunet. Disa prej shkrimeve kanë përfshirë edhe trashëgiminë që kanë lënë pas dijetarët e umetit rreth çështjeve që ndërlidhen me edukatën dhe arsimin. Ne këtu, nuk jemi të interesuar të shfletojmë përmbajtjen e këtyre librave, edhe krahas vlerës së tyre, shumë prej asaj që do të përfshihet në këtë kapitull, është përfshirë në libra tjera tonat më herët.

Do të shohim se vetë ajetet kur'anore dëshmojnë se Kur'ani është burim i edukatës dhe arsimit. Muhadithët nuk kanë harruar që çdo libër të hadithit ta fillojnë me ajete kur'anore që kanë lidhje me arsimin. Buhariu, shumë prej librave dhe kapitujve i fillon me ndonjë ajet kur'anor. Ky ajet kur'anor mund të jetë titull i librit apo kapitullit. Ndodhë që tema e hadithit të jetë një ajet kur'anor. Ky është një rregull, të cilin e kanë praktikuar edhe fukahatë. Imam Shafi'u, kapitullin e pastrimit në librin e tij "El-Umm" e ka filluar me ajetin kur'anor:

﴿ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا قُمْتُمْ إِلَى الصَّلَاةِ فَاغْسِلُوا وُجُوهَكُمْ وَأَيْدِيَكُمْ إِلَى الْمَرَافِقِ وَامْسَحُوا بِرُءُوسِكُمْ وَأَرْجُلَكُمْ إِلَى الْكَعْبَيْنِ ﴾

*"O ju që besuat! Kur doni të ngriheni për të falur namazin, lani fytyrat tuaja dhe duart tuaja deri në bërryla; fërkoni kokat tuaja, e këmbët lani deri në dy zogjtë". [El-Maide: 6]<sup>267</sup>.*

Sa i përket librave të trashëgimisë pedagogjike islame, shumica e tyre, kapitujt i fillojnë me ajete që ndërliiden me përmbajtjen e kapitullit, më pas me hadithe pejgamberike, me thënie të sahabëve dhe të dijetarëve. Dijetari i njohur Axhurri, librin e tij "Ahlak'ul-ulemai" e fillon me një përshkrim se si Allahu i ka veçuar dijetarët me dashurinë dhe mirësitë e Tij. Për këtë çështje sjell argumente nga Kur'ani dhe suneti. Ai në fillim sjell tetë ajete kur'anore dhe më pas sjell hadithe dhe thënie të sahabëve.<sup>268</sup> Dijetari Ibn Abdullberr shkruan në librin e tij "Xhamiu bejan'il-ilmu ve fadlihi" si përgjigje e një pyetje të parashtruar. Ai sqaron se përgjigja e tij është përgjigje ndaj fjalës së Allahut: ﴿وَإِذْ أَخَذَ اللَّهُ مِيثَاقَ الَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ لَتُبَيِّنُنَّهُ لِلنَّاسِ وَلَا تَكْتُمُونَهُ﴾ *"Dhe kur Allahu mori zotimin nga ata që iu pat dhënë libri: që gjithqysh t'ua publikoni atë njerëzve, e të mos e fshihni"* [Alu Imran: 187]. Më pas sjell hadithet pejgamberike.

Sa i përket publikimeve të reja, vërejmë qindra libra dhe hulumtime të cilat janë marrë me sqarimin e pozitës së diturisë, arsimit dhe edukatës në tekstet kur'anore dhe sunetin pejgamberik. Prej këtyre librave kemi librin me titull

<sup>267</sup> Muhamed ibn Idris Esh-Shafi (v. 204 h./819), *El-Umm*, Mektebet'ul-kul-lijjat'il-ez'herijjeti, botimi i parë, Kajro, 1961.

<sup>268</sup> Ebu Bekr Muhamed ibn El-Husejn El-Axhurri (v. 360 h./971), *Ahlak'ul-ulemai, Riasetu idarat'il-buhuth'il-ilmijjeti ve'l-iftai ve'd-da'veti ve'l-irshadi*, Riad, 1398 h./1978.

“*Usul’ut-terbijjet’il-islamijeh*”<sup>269</sup>, i cili përdorë klasifikimet e reja të koncepteve dhe termeve edukative dhe arsimore, por pothuaj nuk sjell asnjë ide pa e argumentuar me ndonjë ajet kur’anor. Një libër tjetër me të njëjtin titull, veçon një kapitull të tërë me titull “*Et-Te’sis’ul=kur’anijju li’t-terbijjeh*” dhe një kapitull tjetër rreth argumentimit pedagogjik të sunetit pejgamberik, duke u mbështetur për te në ajete kur’anore. Shumë libra gjejmë që flasin për ekzistimin e çështjeve pedagogjike të caktuara në Kur’an, si p.sh.: *El-Mebadiu’ en-nefsijjetu fi’l-Kur’an’il-Kerim*,<sup>270</sup> *Et-Terbijjetu iktisadijetu fi’l-Kur’an’il-Kerimi*,<sup>271</sup> *Esalib’ut-teshviiki ve’t-ta’zizi fi’l-Kur’an’il-Kerim*.<sup>272</sup> Edhe hulumtimet që janë bërë rreth çështjeve të mrekullisë shkencore në Kur’an, ka pasur libra të shkruara rreth mrekullisë pedagogjike në Kur’an.<sup>273</sup> Shembujt për këtë çështje janë të shumtë.

Për këtë, do të bëjmë përpjekje që kontributi jonë në këtë kontekst të përfshijë bisedën rreth Kur’anit Famëlartë, si burim i cili dominon ndaj burimeve tjera dhe u jep këtyre burimeve vlerën e tyre sekondare. Kështu, Kur’ani sa herë që kthehemi tek ai, mbetet i hapur për të përfituar prej tij dhe për t’u zgjeruar në inspirimin e intencave dhe udhëzimeve të tij.

Përmes theksimit të disa çështjeve dhe tematikave, të mundemi të kuptojmë diç nga vullneti i Allahut në temën e diturisë, arsimit dhe edukatës. Këto tema do të jenë si shembuj për çështjet dhe temat tjera të shumta që nuk mund të grumbullohen në kontekstin e këtij kapitulli.

<sup>269</sup> Halid ibn Hamid El-Hazim, *Usul’ut-terbijjet’il-islamijeh*, Daru aleem’il-kutubi, botimi i parë, Riad, 2000.

<sup>270</sup> Izet ibn Abis Esh-Shihri, “*Mebadi’ut-terbijjetin nefsijetin fi’l-Kur’an’il-Kerimi ve tatbikatuha et-terbevijjetu*”, (Disertacion doktore në Bazat islame të pedagogjisë, Universiteti Umm’ul-Kura, Mekë, 1436 h./2015.

<sup>271</sup> Sead ibn Hashim El Aljani, “*Et-Terbijjet’ul-iktisadijetu fi’l-Kur’an’il-Kerimi ve tatbikatuha fi’l-usreti ve’l-medreseti*”, (Disertacion doktore në Bazat islame të pedagogjisë, Universiteti Umm’ul-Kura, Mekë, 1427 h./2005.

<sup>272</sup> El-Husejn Xhernu Mahmud Xhelu, *Esalib’ut-teshviiki ve’t-ta’zizi fi’l-Kur’an’il-Kerimi* (seri e studimeve pedagogjike), Muesseset’ur-risaleti ve dar’ul-ulum’il-insanijeti, Bejrut, 1414 h./1994.

<sup>273</sup> Mustafa Rexheb, *El-l’xhaz’ut-terbevijju fi’l-Kur’an’il-Kerimi*, Xhidara li’l-kitab’il-alemijji ve Alem’ul-kutub’il-hadithi, Aman & Irbid, 2006.

## 1. Dituria, mësimnxënia dhe mësimdhënia në Kur'anin Famëlartë:

### 1.1. Kujdesi i Kur'anit për diturinë, proceset dhe mjetet e tij:

Kujdesi i Kur'anit ndaj diturisë shfaqet në atë se pesë ajetet e para të zbritura përfshijnë leximin, lapsin dhe arsimin. Kjo shihet në ajetet kur'anore:

﴿قُرْأًا بِاسْمِ رَبِّكَ الَّذِي خَلَقَ خَلَقَ الْإِنْسَانَ مِنْ عَلَقٍ اقْرَأْ وَرَبُّكَ الْأَكْرَمُ الَّذِي عَلَّمَ بِالْقَلَمِ عَلَّمَ الْإِنْسَانَ مَا لَمْ يَعْلَمْ﴾

*“Lexo me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi (çdo gjë). Krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur (në mitrën e nënës). Lexo! Se Zoti yt është më bujari! Ai që e mësoi (njeriun) të shkruajë me penë. Ia mësoi njeriut atë që nuk e dinte”. [El-Alek: 1-5]*

Në realitet, meditimi i thellë në këto ajete zbulon një fuqi marramendëse rreth mundësisë së udhëzimit të mendimit të njeriut, fillimit me një metodologji të re në furnizim nga shpallja hyjnore dhe bashkëveprimi me të. Shpallja kësaj radhe është e mbrojtur nga mundësia e ndryshimit, siç ishte rasti me shpalljet e mëhershme. Kjo shpallje përfundimtare dhe e mbrojtur, ajetet e para i fillon me dituri dhe arsim, sqarimin e burimeve dhe mjeteve, në atë mënyrë që me pak fjalë përfshin kuptime të shumta. Kështu, duhet patjetër të shkruhet shpallja me laps që të lexohet dhe të tubohen Kur'ani si libër dhe krijesat si libër dhe të lexohen së bashku. Pra, ekziston lexim nga dy burime, pra dy lexime, dhe se duhet njeriu ta mësojë atë që nuk e di nga dy burimet e diturisë: shpallja dhe krijesat, me mjetet e diturisë dhe metodat, përfshirë leximin dhe shkrimin.

Cilësimi i Kur'anit si libër është përsëritur disa herë. Leximi i asaj që është shkruar në libër është prej mjeteve më të rëndësishme të diturisë dhe arsimit. Arsimi, mësimdhënia dhe edukata janë komunikim njerëzor që realizohet përmes gjuhës. Kur'ani është libër i shkruar në një gjuhë e formuar nga materia dhe shkronjat e asaj gjuhe. Sureja El-Bekare fillon me fjalët e Allahut:

﴿الْم ذَلِكَ الْكِتَابُ لَا رَيْبَ فِيهِ هُدًى لِّلْمُتَّقِينَ﴾

“Elif, Lam, Mim. Ky është libri që nuk ka dyshim në te (sepse është prej Allahut) është udhëzues për ata që janë të devotshëm.” [El-Bekare: 1-2]. Sureja Junus fillon me fjalët e Allahut: ﴿الر تِلْكَ آيَاتُ الْكِتَابِ الْحَكِيمِ﴾ “Elif, Lam, Ra. Këto janë ajetet e librit të pance-nueshëm” [Junus: 1]. Sureja El-Hixhr fillon me fjalët e Allahut: ﴿الر تِلْكَ آيَاتُ الْكِتَابِ وَقُرْآنٍ مُّبِينٍ﴾ “Elif, Lam, Ra. Këto janë ajetet e librit, të Kur’anit të plotkuptueshëm” [El-Hixhr: 1]. Pra, ky libër është Kur’an që lexohet. Ibn Tejmije ka thënë: “Emri El-Kitab (libër) është emër i Kur’anit me pëlqimin e të gjithëve. Disa bëjnë dallimin mes Librit të Allahut dhe fjalëve të Tij. Shprehja “El-Kitab” është për qëllim ajo që është e shkruar në te, pra fjala. Mund të jetë për qëllim edhe ajo që shkruhet në te, si p.sh. fjala e Allahut: ﴿فِي كِتَابٍ مَّكْنُونٍ﴾ “Është në një libër të ruajtur” [El-Vakiah: 78]. Po ashtu fjala e Allahut: ﴿وَنُخْرُجُ لَهُ يَوْمَ﴾ “e në ditën e gjykimit, Ne do t’ia prezantojmë atij libër të hapur”, [El-Isra’: 13]<sup>274</sup>

Kujdesi i Kur’anit për diturinë shihet edhe në atë se shprehja “el-ilmu - dituria, shkenca” dhe derivatet e saj gjuhësore janë përmendur shumë. Sipas statistikave të autorit Muhamed Fuad Abdalbaki në librin e tij “El-Mu’xhem’ul-Mufehres”<sup>275</sup> dhe Ed-Damiganit në librin e tij “Kamus’ul-Kur’an”<sup>276</sup> numri i vendeve ku janë përmendur këto shprehje kanë arritur në 856. Një meditim i thellë në këto ajete kur’anore në këto vende zbulon një thesar të pakufizuar pedagogjik në të gjitha tematikat e pedagogjisë, përfshirë: qëllimet, parimet, përmbajtjet, metodat etj. Udhëzimet kur’anore pedagogjike e përfshijnë njeriun kur është i vogël dhe i rritur, si individ, anëtar i familjes, shoqërisë dhe umetit. Këto udhëzime merren enkas me mendjen, trupin dhe shpirtin e tij, duke përfshirë edhe moralin, raportet dhe sjelljet e tij. Udhëzimet pedagogjike ngrënë njeriun dhe sillen butë ndaj tij në atë

<sup>274</sup> Tekijudin Ebu’l-Abas Ahmed ibn Abdulhalim Ibn Tejmije, (v. 728 h./1328), *Dekaik’ut-tefsir: El-Xhamiu li tefsir’il-imami Ibn Tejmije*, Damask: Muessesetu ulum’il-Kur’an, bot. 2, 1984, vëll. 3, fq. 331.

<sup>275</sup> Muhamed Fuad Abdalbaki, *El-Mu’xhem’ul-mufehresu li elfadh’il-Kur’an’il-Kerim*, Darul fikri, Bejrut, 2000, fq. 596-611.

<sup>276</sup> El-Husejn ibn Muhamed Ed-Damigani, (ka jetuar në gjysmën e dytë të shekullit të gjashtë dhe gjysmën e parë të shekullit të shtatë hixhri), *Kamus’ul-Kur’ani “Islah’ul-vuxhuhi ve’n-nedhairi fi’l-Kur’an’il-Kerim”*, bot. 4, Dar’ul-ilmii li’l-melajine, Bejrut, 1983, fq. 330.

mënyrë që bëjnë bashkimin mes ngritjes dhe realitetit, gjithëpërfshirjes dhe baraspeshimit, specializimit dhe përplotësimit.

## 1.2. Gjerësia e tematikave të diturisë në Kur'ani Famëlartë

Prezantimi i ajeteve kur'anore, në të cilat potencohet fjala “el-ilmu- dituri, shkencë” dhe derivatet e tij, na bën të qartë gjerësinë e tematikave dhe sferave të diturisë.

Dituria përfshin:

- Çështjet e dukshme të gjësendeve, dukurive dhe gjendjeve në këtë botë, çështjet metafizike (el-gajb) dhe jetën e ahiretit.

- Diturinë e Allahut, të melaikeve, të Pejgamberëve dhe të njeriut, bile edhe atë që mund ta mësojnë edhe kafshët.<sup>277</sup>

- Bindjen e plotë (el-jekinu) dhe jo të plotë (gajr'ul-jekin).

- Atë që vepron sipas asaj që e di, si dhe atë që e pranon si bindje ose e mohon.<sup>278</sup>

- Format e diturisë dhe mësimnxënies, si: leximi, studimi, shkrimi, meditimi, mendimi. Mjetet e diturisë: lapsi, fleta, libri. Mënyrat e arritjes deri te ditura si të dëgjuarit, të parit dhe zemra (të menduarit).

- Nxitja për kërkimin e diturisë, vlerën e diturisë dhe dije-tarëve, qëllimet e diturisë, mësimnxënies dhe mësimdhënies dhe kërkimi për shtimin e diturisë.

## 1.3. Faktorët e procesit pedagogjik në Kur'anin Famëlartë

Mësimi, mësuasi dhe nxënësi janë tre faktorët më të rëndësishëm në procesin edukativo-arsimor. Në kontekstin e këtyre tre faktorëve, mësimi është mendim pedagogjik që del

<sup>277</sup> Bazaru në ajetin kur'anor: ﴿وَمَا عَلَّمْتُمْ مِنَ الْجَوَارِحِ مُكَلِّبِينَ تُعَلِّمُونَهُنَّ مِمَّا عَلَّمَكُمُ اللَّهُ فَكُلُوا مِمَّا أَمْسَكْنَ عَلَيْكُمْ وَاذْكُرُوا اسْمَ اللَّهِ عَلَيْهِ﴾

“Thuaju: “U janë lejuar të gjitha ushqimet e mira dhe ai (gjahu) i gjahtarëve (shtazëve) të dresuara që i mësoni ashtu si ju ka mësuar juve Allahu. Hani pra, atë që gjahtuan për juve dhe më parë përmendeni emrin e Allahut”. [El-Maide: 4]

<sup>278</sup> Taberiu gjatë komentimit të ajetit kur'anor: ﴿وَجَحَدُوا بِهَا وَاسْتَيْقَنَتْهَا أَنفُسُهُمْ ظُلْمًا وَعُلُوًّا فَانظُرْ كَيْفَ كَانَ عَاقِبَةُ الْمُفْسِدِينَ﴾ “Dhe, edhe pse bindshëm të besueshëm në to (se ishin nga Zoti), i mohuan në mënyrë të padrejtë e me mendjemadhësi, pra shikojë se çfarë ishte fundi i shkatërrimtarëve”. [En-Neml: 14] ﴿وَجَحَدُوا بِهَا﴾ ka thënë: El-xuhd është përgënjeshtrimi dhe mohim me pa të drejtë. ﴿وَاسْتَيْقَنَتْهَا أَنفُسُهُمْ﴾ e kanë ditur saktë dhe kanë qenë të bindur se është prej Allahut, por megjithatë nuk e kanë pranuar dhe kanë çuar inat!



si rezultat i procesit të mendimit në çështjet pedagogjike. Elementet e këtij të menduarit janë: konceptet, parimet, teoritë dhe praktikat, përreth të cilave sillen plan-programet edukativo-arsimore, përcaktohen detyrat e mësuesit, sqaron gjendjen e nxënësit dhe metodat e përshtatshme që ia lehtësojnë atij mësimnxënien.

Në përvojën pedagogjike islame, Kur'ani ka qenë lëndë mësimi që ia ka mësuar mësuesi nxënësve të vet. Allahu ia mësoi Xhibrilit alejh'is-selam Kur'anin, Xhibrili ia mësoi atë Muhammedit alejh'is-selam, ndërsa Muhammedi alejh'is-selam ia mësoi sahabëve. Muhammedi alejh'is-selam është Pejgamberi për të cilin u lut Ibrahim alejh'is-selam që Allahu nga pasardhësit e tij të dërgojë një Pejgamber që ua mëson Librin (Kur'anin).

﴿رَبَّنَا وَاجْعَلْنَا مُسْلِمِينَ لَكَ وَمِنْ ذُرِّيَّتِنَا أُمَّةٌ مُّسْلِمَةً لَّكَ وَأَرِنَا مَنَاسِكَنَا وَتُبْ عَلَيْنَا إِنَّكَ أَنْتَ التَّوَّابُ الرَّحِيمُ رَبَّنَا وَابْعَثْ فِيهِمْ رَسُولًا مِّنْهُمْ يَتْلُو عَلَيْهِمْ آيَاتِكَ وَيُعَلِّمُهُمُ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ وَيُزَكِّيهِمْ إِنَّكَ أَنْتَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ﴾

*“Zoti ynë, bëna neve dyve besimtarë të sinqertë ndaj Teje dhe nga pasardhësit tanë, njerëz të bindur ndaj Teje, na i mëso rregullat e ibadetit (adhurimit) tanë dhe falna neve, vërtet Ti je që falë shumë, je mëshirues!” Zoti ynë, dërgo ndër ta, nga gjiri i tyre të dërguar që t’u lexojë atyre ajetet Tua, t’u mësojë atyre librin dhe urtësinë, e t’i pastrojë (prej ndyrësisë së idhujtarisë) ata. S’ka dyshim se Ti je ngadhënjyesi, i dijshti”. [El-Bekare: 128-129]*

Allahu iu përgjigj lutjes së tij. Allahu thotë:

﴿لَقَدْ مَنَّ اللَّهُ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ إِذْ بَعَثَ فِيهِمْ رَسُولًا مِّنْ أَنْفُسِهِمْ يَتْلُو عَلَيْهِمْ آيَاتِهِ وَيُزَكِّيهِمْ وَيُعَلِّمُهُمُ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ وَإِنْ كَانُوا مِنْ قَبْلُ لَفِي ضَلَالٍ مُّبِينٍ﴾

*“Është e vërtetë se Allahu u dha dhuratë të madhe besimtarëve, kur ndër ta nga mesi i tyre dërgoi të dërguar që atyre t’u lexojë shpalljen e Tij, t’i pastrojë ata, t’ua mësojë Kur’anin dhe shariatit, edhe pse, më parë ata ishin krejtësisht të humbur”. [Alu Imran: 164].*

Ajetet që potencohen këtu janë ajetet kur’anore, ndërsa libri që është objekt mësimi nga ana e Pejgamberit për besimtarët është Kur’ani Famëlartë.

Më pas, ky kuptim vjen për herë të tretë, ku leximit, pastimit shpirtëror, mësimi të librit dhe urtësisë, t’i shton edhe

një kuptim tjetër që ka të bënë me vazhdimësinë dhe ripërtëritjen e diturisë. Allahu thotë:

﴿كَمَا أَرْسَلْنَا فِيكُمْ رَسُولًا مِّنكُمْ يَتْلُو عَلَيْكُمْ آيَاتِنَا وَيُزَكِّيكُمْ وَيُعَلِّمُكُمُ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ وَيُعَلِّمُكُم مَّا لَمْ تَكُونُوا تَعْلَمُونَ﴾

“(Sikurse plotësova mirësinë Time ndaj jush) Ashtu siç dërguam nga gjiri i juaj të dërguar t’u lexojë ajetet Tona, t’ju pastrojë, e t’ju mësojë librin dhe traditën, e edhe t’ju mësojë atë që nuk e dinit”. [El-Bekare: 151].

Gjatë komentimit të këtij ajeti, Ebu Hajan Endelusi në tefsirin e tij ka thënë: “*Ua lexon atyre ajetet e Allahut, i pastron ata dhe ua mëson atyre librin dhe urtësinë që nuk e dinin. I ka sjellë këto tri cilësi në formë të foljes në kohën e tashme, për të kuptuar ripërtëritjen, ngase leximi, pastrimi dh arsimimi, ripërtërihen vazhdimisht...*”.<sup>279</sup> Ragib ka thënë: “*A’lemtuhu (e informova) dhe al-lemtuhu (e mësova) në esencë janë një. Mirëpo, e para (e informova) ka për qëllim informim të shpejtë, ndërsa e dyta (e mësova) arrihet duke e përsëritur shumë derisa të ndikon tek nxënësi.*”<sup>280</sup>

Siç potencohet në librin “El-Mufredat” të Ragib Isfahanit, urtësia është “gjetja e të vërtetës përmes diturisë dhe mendjes. Urtësia nga ana e Allahut nënkupton: njohjen e çështjeve dhe krijimin e tyre në formën më të mirë. Ndërsa nga ana e njeriut nënkupton: njohjen e gjërave ekzistuese dhe kryerja e veprave të mira”.<sup>281</sup> Ibn Kajimi ka thënë: “mendim më i mirë që është dhënë rreth fjalës *el-hikmetu*-urtësi është mendimi i Muxhahidit dhe Malikut ku thonë se urtësia: është njohe e të vërtetës dhe veprimi i saj, si dhe ta qëllosh në fjalë dhe vepër. Më pas ka thënë: *el-hikmetu*-urtësia është ta veprosh atë që duhet, në mënyrën që duhet dhe në kohën kur duhet”.<sup>282</sup>

Përvoja pedagogjike islame është bazuar shumë në këto ajete, duke e konsideruar Muhammedin alejh’is-selam si model dhe shëmbëlltyrë në atë që ua mëson, metodat e mësimi,

<sup>279</sup> Muhamed ibn Jusuf ibn Ali El-Garnati Ebu Hajan El-Endelusi (v. 745 h./1344), *Tefsir’ul-bahr’il- muhit*, Dar’ul-kutub’il-ilmijej, bot. 1, vëll. 1, Bejrut, 1413 h./1993, fq. 618.

<sup>280</sup> Er-Ragib Isfahani, *Mufredatu elfadh’il-Kur’an*, vepër cituar, fq. 580.

<sup>281</sup> Ebul Kasim el husejin ibn Muhamed Er-Ragib Isfahani (v. 502 h./1108), *El-Mufredatu fi garib’il-Kur’an*, vëll. 1, Mektebetu Nezar, Kajro, pa vit botimi, fq. 167-168.

<sup>282</sup> Muhamed ibn Ebu Bekr ibn Ejub Ibn Kajim El-Xhevzije (v. 751 h./1350), *Medarixh’us-salikine bejne menazili ijake ne’buda ve ijake nestein*, vëll. 2, Dar’ul-kitab’il-arabijj, bot. 7, Bejrut, 2003, fq. 448-449.

natyrën e raporteve mes mësuesit dhe nxënësit etj. Allahu ka thënë:

﴿فَبِمَا رَحْمَةٍ مِنَ اللَّهِ لِنْتَ لَهُمْ وَلَوْ كُنْتَ فَظًّا غَلِيظًا لَفُتِنَا الْقُلُوبَ لَأَنْقَضُوا مِنْ حَوْلِكَ فَاعْفُ عَنْهُمْ وَاسْتَغْفِرْ لَهُمْ وَشَاوِرْهُمْ فِي الْأَمْرِ فَإِذَا عَزَمْتَ فَتَوَكَّلْ عَلَى اللَّهِ إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُتَوَكِّلِينَ﴾

*“Ti ishe i butë ndaj atyre, ngase Allahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do shkapërderdheshin prej teje, andaj ti falju atyre dhe kërko ndjesë për ta, e konsultohu me ta në të gjitha çështjet, e kur të vendosësh, atëherë mbështetu në Allahun, se Allahu i do ata që mbështeten”. [Alu Imran: 159]*

Po ashtu thotë:

﴿لَقَدْ جَاءَكُمْ رَسُولٌ مِنْ أَنْفُسِكُمْ عَزِيزٌ عَلَيْهِ مَا عَنِتُّمْ حَرِيصٌ عَلَيْكُمْ بِالْمُؤْمِنِينَ رَءُوفٌ رَحِيمٌ﴾

*“Juve ju erdhi i dërguar nga lloji juaj, atij i vije rëndë për vuajtjet tuaja, sepse është lakmues i rrugës së drejtë për ju, është i ndershëm dhe i mëshirshëm për besimtarët”. [Et-Tevbe: 128]*

Formën të cilën e kanë përshkruar ajetet kur'anore rreth përgjigjes së sahabëve ndaj mësimit dhe pranimit të diturisë nga Muhammedi alejh'is-selam, u bë model që duhet ta ndjekë çdo nxënës. Besimtarët duhet t'i përgjigjen Muhammedit alejh'is-selam në atë që e përcjell nga ana e Allahut, ngase pikërisht aty është jeta e tyre e vërtetë. Allahu thotë: ﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اسْتَجِيبُوا لِلَّهِ وَلِلرَّسُولِ إِذَا دَعَاكُمْ لِمَا يُحْيِيكُمْ﴾ *“O ju që besuat, përgjigjuni (thirrjes së) Allahut dhe të të dërguarit kur ai (i dërguari) ju fton për atë që ju jep jetë, (për fenë e drejtë).” [El-Enfal: 24]. Gjallërimi është të formosh jetë në trup. Jeta është fuqi përmes së cilës njeriu kupton, lëvizë dhe zgjedh. Fjala “jetë” mund të përdoret edhe për çështjet tjera, si p.sh.: Jeta e tokës me gjelbërim, jeta e mendjes me dituri dhe mendim të saktë. Kështu gjallëria përfshin mendjendritësinë me besim të drejtë dhe moral të mirë, veprat e mira, përmirësimin e individit dhe shoqërisë, si dhe vlerat dhe cilësitë e mira. Kështu trimëria është jetë, pavarësia është jetë, liria është jetë”<sup>283</sup>*

Nuk ka dyshim se ata që kanë besuar Muhammedin alejh'is-selam për Pejgamber, iu kanë përgjigjur urdhrin të Allahut për lexim me zbritjen e ajeteve të para në Kur'an. Ky urdhër ishte motiv për të mësuar çdo gjë që kërkon Kur'ani siç janë: kërkimi i diturisë, mësimi i proceseve dhe mjeteve të

<sup>283</sup> Ibn Ashur, *Tefsir'ut-tahriri ve't-tenvir*, vepër e cituar, vëll. 9, fq. 312-313.

diturisë siç janë: të shkruari e diturisë me laps dhe leximi i asaj që është e shkruar në Mus'haf. Allahu thotë:

﴿قُرْأً بِأَسْمِ رَبِّكَ الَّذِي خَلَقَ الْإِنْسَانَ مِنْ عَلَقٍ اقْرَأْ وَرَبُّكَ الْأَكْرَمُ الَّذِي عَلَّمَ بِالْقَلَمِ عَلَّمَ الْإِنْسَانَ مَا لَمْ يَعْلَمْ﴾

*“Lexo me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi (çdo gjë). Krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur (në mitrën e nënës). Lexo! Se Zoti yt është më bujari! Ai që e mësoi (njeriun) të shkruajë me pendë. Ia mësoi njeriut atë që nuk e dinte”. [El-Alek: 1-5]*

Gjithashtu përgjigjja e besimtarëve ndaj udhëzimit kur'anor që të caktohet një grup, i cili do të merret me mësim, dhe më pas çështjet e mësuar t'ua mësojnë atyre që nuk kanë pasur mundësi të mësojnë për ndonjë arsye, siç është lufta në rrugë të Allahut.

﴿وَمَا كَانَ الْمُؤْمِنُونَ لِيَنفِرُوا كَافَّةً فَلَوْلَا نَفَرَ مِنْ كُلِّ فِرْقَةٍ مِّنْهُمْ طَائِفَةٌ لِّيَتَفَقَّهُوا فِي الدِّينِ وَلِيُنذِرُوا قَوْمَهُمْ إِذَا رَجَعُوا إِلَيْهِمْ لَعَلَّهُمْ يَحْذَرُونَ﴾

*“Nuk është e nevojshme të dalin në luftë të gjithë besimtarët. E përse nga çdo grumbull i tyre të mos shkojë një grup për t'ua aftësuar në diturinë fetare, për ta mësuar popullin e vet kur të kthehet te ata, në mënyrë që ata të kuptojnë (e të ruhen)”. [Et-Tevbe: 122]*

Kur'ani i ka veçuar ata të cilët i përgjigjen kërkesave të Allahut dhe e dinë se Kur'ani është e vërtetë reale. Atyre u takon el-husna- më e mira dhe ecin mbi një dritë nga ana e Allahut, ndërsa të tjerët janë sikur të ishin të verbër. Këtu është motivimi më i mirë për t'iu përgjigjur Allahut dhe për të mësuar të vërtetën.

﴿لِّلَّذِينَ اسْتَجَابُوا لِرَبِّهِمُ الْحُسْنَىٰ وَالَّذِينَ لَمْ يَسْتَجِيبُوا لَهُ لَوْ أَنَّ لَهُمْ مَا فِي الْأَرْضِ جَمِيعًا وَمِثْلَهُ مَعَهُ لَافْتَدَوْا بِهِ أُولَٰئِكَ لَهُمْ سُوءُ الْحِسَابِ وَمَأْوَاهُمْ جَهَنَّمُ وَبِئْسَ الْمِهَادُ أَفَمَنْ يَعْلَمُ أَنَّ مَا أُنزِلَ إِلَيْكَ مِنْ رَبِّكَ الْحَقُّ كَمَنْ هُوَ أَعْيَىٰ إِنَّمَا يَتَذَكَّرُ أُولُو الْأَلْبَابِ﴾

*“Atyre që i janë përgjigjur Zotit të tyre u takon shpërblimi më i mirë, ndërsa ata që nuk iu përgjigjën Atij, ata do të japin si kompensim, sikur të ishte e tyre aq shumë sa e gjithë pasuria tokësore edhe një herë aq. Ata kanë llogarinë më të rëndë, vendstrehimi i tyre është xhehennemi që është shtrat i keq. A është i njëjtë ai që e di se ajo që t'ua shpall ty nga Zoti yt është e vërtetë, si ai që është i verbër? Vetëm njerëzit e arsyeshëm që kanë mendje të shëndoshë e kuptojnë të vërtetën”. [Er-Rra'd: 18-19]*

#### 1.4. Llojet e diturive (shkencave) në Kur'anin Famëlartë

Në Kur'anin Famëlartë ka shkencë, të cilat Muhammedi alejh'is-salam ua ka mësuar njerëzve, qoftë me fjalë, praktikë apo me shëmbëlltje të mirë. Në të ka shkencë, të cilat i takojnë fushave të shkencave natyrore, shoqërore dhe psikologjike, të cilat janë potencuar kalimthi, por duke kërkuar prej muslimanëve që t'i formojnë dhe zhvillojnë ato. Në të ka udhëzime metodologjike që orientojnë njeriun drejt formave, metodave dhe mjeteve të nevojshme për formimin e shkencave, në kuadër të kritereve dhe parimeve etike që përpjekjet e muslimanit në zhvillimin e këtyre shkencave i bëjnë të dalluara.

Këto ajete kur'anore, tregojnë se ilmi-dituria, shkencë, ka tri kuptime, të cilat mund t'i përfshijmë si më poshtë:

- Mësimi i shkencave tradicionale (en-naklije):

Ajetet e Kur'anit të lexuara janë shkencë që duhet mësuar. Këto ajete janë informim nga ana e Allahut rreth vetes, emrave, cilësive dhe veprave të Tij, kaderit që duhet ta dijë njeriu rreth çështjeve të fshehta që nga fillimi i krijesave deri në fund, ahiretit dhe ç'ka në të, historisë së peygamberëve dhe popujve dhe shumë prej krijesave të kësaj bote, të cilat nuk mund njeriu t'i njohë ato. Në këto ajete ka udhëzime dhe dispozita për çështjet që duhet njeriu t'i njohë rreth lidhjes me Allahun me adhurim dhe devotshmëri, ka sisteme të përgjithshme për menaxhimin e jetës së njerëzve në jetën familjare, shoqërore, ekonomike dhe politike. Në këto sisteme të përgjithshme, ka norma, të cilat e ftojnë njeriun të bën përpjekje për përfitimin e njohurive të detajuara të cilat rriten, zhvillohen dhe zgjerohen me anë të eksperiencës dhe përvojës njerëzore.

- Mësimi i shkencave natyrore:

Edhe pse Kur'ani është libër për udhëzim, shumë prej ajeteve të tij flasin për dukuri natyrore, të cilat ia tërheqin vëmendjen njeriut drejt fuqisë së Allahut dhe e nxisin njeriun për të njohur këto dukuri, për të kuptuar fshehtësitë dhe për të zbuluar shkencë të reja të dobishme. Hulumtuesi Zaglul Nexhar ka përfunduar se ajetet që flasin rreth shkencave

natyrore janë mbi 1000 (njëmijë). Vetëm rreth tokës flasin 461 ajete. Prej tyre 110 ajete kanë përmbajtje gjeologjike.<sup>284</sup>

Është mirësi e Allahut ndaj njeriut që atij ia ka mundësuar të ndjehet i qetë në atë që përputhet me natyrën e tij të pastër dhe në ajetet kur'anore, të cilat flasin për domosdoshmërinë e besimit në Allahun Krijues. E gjithë kjo duke menduar dhe meditar në botën natyrore përreth, përfshirë gjësendet, ngjarjet dhe dukuritë. Kësaj i shtohet edhe kërkesa kur'anore për nënshtrimin dhe shfrytëzimin e këtyre gjësendeve, ngjarjeve dhe dukurive në çështjet që i sjellin dobi në sferat e përparimit njerëzor, formimit të civilizimit, si dhe lehtësimin dhe zhvillimin e jetës.

- Mësimi i shkencave metodologjike:

Pa marrë parasysh se shkencat në të cilat thërret Kur'ani janë tradicionale apo natyrore, arritja deri tek ato është përmes një metodologjie të caktuar në mendim dhe hulumtim, përfitimi nga kapacitetet mendore në përfitimin e diturisë dhe shfrytëzimin e kësaj metodologjie në të kuptuarit e drejtë. Kapaciteteve mendore, Kur'ani i ka kushtuar një kujdes të veçantë. Shprehjet të cilat ndërlidhen me të menduarit si fikr, fikh, fehm, rushd, tedebbur, dhikr, fuad, nuha dhe lub, janë përmendur në 429 vende në Kur'an.

Metodologjinë të cilën e gjejmë në Kur'an bazohet në disa parime, që llogariten si pikënisje në sferat e mendimit, hulumtimit dhe sjelljes, të cilat i përmbahen disa kritereve dhe vlerave të caktuara që janë të drejtuara drejt objektivave. Këto parime ruajnë përpjekjet e njeriut gjatë të mësuarit nga paqartësia, mashtrimi dhe çrregullimi. Këto parime janë në dy nivele: e para: të përgjithshme që këto parime i lidhin me ruknet e imanit, islamit dhe sistemin e vlerave të larta në fenë e Allahut. E dyta: të pjesshme në të cilat parimet janë kritere dhe veçori të të menduarit, meditarit dhe përkujtuarit ose për hulumtim që synon përfitimin, testimin dhe shfrytëzimin e njohurive ose kritere për kontrollimin dhe orientimin e sjelljes.

<sup>284</sup> Zaglul Ragib El-Nexhar, Ajat'ul-kevni fi'l-Kur'an'il-Kerim, përkthyes Nadija El-Avedi. Shih linkun: <https://www.paldfq.net/forum/showthread.php?t=6248>.

Prej parimeve metodologjike në të menduarit është llojllojshmëria dhe përplotësimi në shfrytëzimin e llojeve të të menduarit, si të menduarit të përgjithshëm, shkencor, shkakpasoje, intencial, strategjik etj. Në parimet metodologjike të hulumtimit, është patjetër të theksojmë të mësuarit e parimit të referencave, që kërkon besueshmëri dhe objektivitet, parimit dhe argumentimit i cili kërkon bashkim të argumenteve praktike, racionale dhe tradicionale. Prej parimeve metodologjike në sjellje është të mësuarit e bashkimit të tri parimeve tjera: parimi i qëllimit (nijetit) duke u drejtuar me zemër tek Allahu, parimi i pasimit të rrugës së drejtë dhe të eksperimentuar sipas programit peygamberik dhe punës kolektive për realizimin e qëllimeve, dhe parimi i kreativitetit në zhvillim, ngritje, bamirësi dhe përpikëri.

Vlen të theksohet se disa nga këto parime janë stabile dhe të pandryshueshme, gjë që njeriut i jep besim në veten, metodën dhe shkencën, ndërsa disa parime tjera janë që ndryshohen dhe zhvillohen në metodat dhe llojet e të menduarit metodologjik, në mjetet e hulumtimit, në përshtatshmërinë e këtyre metodave dhe mjeteve me çështjet hulumtuese dhe shkencave të reja të cilave u përkasin këto çështje.

Prej **parimeve** që janë stabile dhe të pandryshueshme veçojmë:

- Domosdoshmëria e besimit në njëshmërinë e Allahut. Allahu ka thënë: ﴿فَاعْلَمْ أَنَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ﴾ “Atëherë, dije se nuk ka zot tjetër pos Allahut” [Muhamed: 19]

- Rregullimi i botës në formë të baraspeshuar dhe të matur në formën më të mirë. Allahu ka thënë: ﴿الَّذِي أَحْسَنَ كُلَّ شَيْءٍ خَلَقَهُ﴾ “Ai që përsosi çdo gjë që ka krijuar” [Es-Sexhde: 7]. Po ashtu ka thënë: ﴿إِنَّا كُلَّ شَيْءٍ خَلَقْنَاهُ بِقَدَرٍ﴾ “Ne çdo send kemi krijuar me masë të caktuar” [El-Kamer: 49].

- Stabiliteti i ligjeve të cilat Allahu i ka vënë në krijesat e tij, me qëllim që të mësuarit dhe nënshtrimi i tyre të jetë më i lehtë. Allahu ka thënë: ﴿سُنَّةَ اللَّهِ فِي الَّذِينَ خَلَوْا مِنْ قَبْلُ وَلَنْ تَجِدَ لِسُنَّةِ اللَّهِ تَبْدِيلًا﴾ “(Ky është) Ligji i Allahut edhe ndër ata që ishin më parë, e në ligjin e Allahut nuk mund të gjesh ndryshim” [El-Ehزاب: 62].

- Bindja se çfarëdo diturie që përfiton njeriu sipas metodologjisë së përshtatshme hulumtuese është dituri e pjesshme dhe relative, ku njeriu gjithnjë duhet të kujton fjalën e Allahut ku thotë: ﴿وَمَا أُوتِيتُمْ مِّنَ الْعِلْمِ إِلَّا قَلِيلًا﴾ “e juve ju është dhënë fort pak dije”. [El-Isra’: 85]. Si dhe t’i lutet Allahut: ﴿وَقُلْ رَبِّ زِدْنِي عِلْمًا﴾ “thua: “Zoti im, më shto dituri!” [Ta Ha: 114]

Metodologjia kur’anore është ajo që gjendet në shpalljen përfundimtare dhe të cilën Allahu e ka pëlqyer për njeriun. Kjo nënkupton se kjo metodologji do të plotëson nevojat e njeriut për elementet metodologjike, në rast se ata e mendojnë dhe meditojnë mirë, dhe atë për çdo kohë sado të jenë të zhvilluara përvojat e tyre dhe për çdo vend sado të jenë ndryshme ambientet e tyre. Kjo u determinon parimeve metodologjike të hapin dyert gjerësisht për fleksibilitet, ndryshim dhe zhvillim. Kjo nënkupton se nisja nga parimet metodologjike stabile jep mundësinë e zhvillimit të metodave dhe mjeteve, me të cilat realizohet kërkesa e Allahut drejtuar njeriut për ecje në tokë, shikim, hulumtim dhe studim. Shikimi dhe hulumtimi në horizontet e hapësirës në të kaluarën ishte drejtpërdrejtë përmes syrit, ku më pas u zhvillua dhe realizohej përmes teleskopit, i cili i mundëson njeriut t’i shohë gjërat shumë të largëta, mikroskopit, i cili i mundëson njeriut t’i shohë edhe gjërat shumë të vogla. Gjithashtu përmes mjeteve të reja analizohet edhe drita që zbulon natyrën, përbërësit dhe dimensionet kohore dhe vendore të sendeve. Ka edhe metoda tjera për shikim dhe hulumtim, të cilat janë zhvilluar deri në atë masë sa njeriut i është mundësuar të shohë në mënyrë të detajuar ngjarjet në momentin e ngjarjes, t’i dëgjon ato, pa marrë parasysh se sa larg është, si dhe të përsërisë shikimin e ngjarjes në mënyrë të detajuar në një moment të caktuar sado që të jetë larguar koha nga momenti i ngjarjes. Ngjashëm me këtë mund të thuhet edhe për metodat e ecjes mbi tokë, ku në fillim ishte ecje në këmbë dhe me kafshë, më pas u zhvillua me anë të anijeve, makinave, trenave dhe aeroplanëve.

## 1.5. Burimi i parë për mësimdhënie dhe mësimnxënie



Sipas Kur'anit, arsimimi i njeriut ka filluar me krijimin e tij. Allahu pasi e krijoi Ademin, e dalloi atë me dituri dhe ia mësoi emrat të cilat nuk ia kishte mësuar melaqeve. ﴿وَعَلَّمَ آدَمَ الْأَسْمَاءَ كُلَّهَا ثُمَّ عَرَضَهُمْ عَلَى الْمَلَائِكَةِ فَقَالَ أَنْبِئُونِي بِأَسْمَاءِ هَؤُلَاءِ إِنْ كُنْتُمْ صَادِقِينَ﴾ “E Ai (Zoti) ia mësoi Ademit të gjithë emrat (e sendeve), pastaj ato ua prezantoi engjëjve dhe u tha: “Më tregoni për emrat e këtyre (sendeve të emërtuara), nëse jeni të drejtë (çka mendoni)?” [El-Bekare: 31]. Me atë që Allahu, ia mësoi Ademit emrat dhe shfaqti vlerën e tij duke pranuar këtë arsimim ai e jo melaqet, me këtë Allahu e bëri si argument kur atyre u tha: ﴿إِنِّي أَعْلَمُ مَا لَا تَعْلَمُونَ﴾ “Ai tha: “Unë di atë që ju nuk e dini!” [El-Bekare: 30], që nënkupton se ju nuk e dini guximin e kësaj krijese për të qenë mëkëmbës në tokë. Në ajetet e sures El-Alek, Allahu shpreh mirësinë e tij ndaj njeriut kur i mundësoi atij të përdorë operacionet e mësimimit dhe arsimit siç janë leximi dhe shkrimi me laps. Me shkrim-lexim është mësuar njeriu në të kaluarën dhe vazhdon edhe sot e kësaj dite ta mësojë atë që nuk e di.

﴿قُرْأَ بِاسْمِ رَبِّكَ الَّذِي خَلَقَ خَلَقَ الْإِنْسَانَ مِنْ عَلَقٍ اقْرَأْ وَرَبُّكَ الْأَكْرَمُ الَّذِي عَلَّمَ بِالْقَلَمِ عَلَّمَ الْإِنْسَانَ مَا لَمْ يَعْلَمْ﴾

*“Lexo me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi (çdo gjë). Krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur (në mitrën e nënës). Lexo! Se Zoti yt është më bujari! Ai që e mësoi (njeriun) të shkruajë me pendë. Ia mësoi njeriut atë që nuk e dinte”.* [El-Alek: 1-5]

Kur'ani potencon se detyra e Muhammedit alejh'is-selam është t'ua mëson njerëzve librin dhe urtësinë, dhe se Allahu vazhdon t'ua mëson njerëzve gjatë të gjitha gjeneratave njerëzore atë që nuk e dinin:

﴿كَمَا أَرْسَلْنَا فِيكُمْ رَسُولًا مِّنكُمْ يَتْلُو عَلَيْكُمْ آيَاتِنَا وَيُزَكِّيكُمْ وَيُعَلِّمُكُمُ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ وَيُعَلِّمُكُم مَّا لَمْ تَكُونُوا تَعْلَمُونَ﴾

*“(Sikurse plotësova mirësinë Time ndaj jush) Ashtu siç dërguam nga gjiri i juaj të dërguar t'u lexojë ajetet Tona, t'ju pastrojë, e t'ju mësojë librin dhe traditën, e edhe t'ju mësojë atë që nuk e dinit.”* [El-Bekare: 151]

Kur'ani nuk pranon që njeriu të besojë diçka ose të veprojë diçka në mënyrë të trashëguar, pa qenë i bindur në te, vetëm e vetëm se të parët e tij prej baballarëve dhe gjyshërve kanë

pasur atë besim ose kanë vepruar atë vepër. Njeriu obligohet të mësojë çështjet duke u bazuar në burimet e diturisë dhe mjetet e tij. Mundet që prindërit dhe gjyshërit të mos kishin menduar mirë ose të mos ishin të udhëzuar.

﴿وَإِذَا قِيلَ لَهُمُ اتَّبِعُوا مَا أَنْزَلَ اللَّهُ قَالُوا بَلْ نَتَّبِعُ مَا أَلْفَيْنَا عَلَيْهِ آبَاءَنَا أَوْلُو كَانُوا آبَائِهِمْ لَا يَعْقِلُونَ شَيْئًا وَلَا يَهْتَدُونَ﴾

*E kur u thuhet atyre (idhujtarëve): “Pranoni atë që Allahu e shpalli”! Ata thonë: “Jo, ne ndjekim atë rrugë në të cilën i gjetëm prindërit tanë”! Edhe sikur prindërit e tyre të mos kenë kuptuar dhe të mos jenë udhëzuar në rrugën e drejtë (ata do t’i pasonin)? [El-Bekare: 170]*

Njeriu, nuk obligohet të mësojë vetëm shkencat fetare, siç janë: besimi, adhurimet, bashkëveprimi me tjerët dhe morali, por, Kur’ani insiston që njeriu të mësojë urtësinë e Allahut në krijesat e Tij, me qëllim që të kuptojë realitetin e botës natyrore, shoqërore dhe psikologjike, gjë e cila do t’i ndihmon për përparimin e jetës, formimin e civilizimit dhe ngritjen e nivelit të jetës. Andaj, të gjitha shkencat të cilat ka mundësi t’i mëson njeriu për realizimin e këtyre qëllimeve konsiderohen shkenca fetare.

### 1.6. Përgjegjësia e mësimit dhe mësimit

Drejtësia e Allahut përfshihet në ajetet kur’anore: ﴿كُلُّ نَفْسٍ بِمَا﴾  
﴿كَسَبَتْ رَهِيْنَةً﴾ “Secili njeri është peng i veprës së vet”. [El-Mudde-ththir: 38]. Po ashtu ajetin kur’anor: ﴿وَكُلُّهُمْ آتِيهٖ يَوْمَ الْقِيَامَةِ فَرْدًا﴾ “Dhe në ditën e kiametit secili do t’i paraqitet Atij i vetmuar” [Merjem: 95]. Kjo nënkupton se njeriu është i obliguar që vet të merr iniciativë për të mësuar. Para se të arrij në moshën e pjekurisë, përgjegjësia e arsimimit të tij është e prindërve. Allahu ka thënë: ﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا قُوا أَنْفُسَكُمْ وَأَهْلِيكُمْ نَارًا﴾ “O ju që besuat, ruajeni veten dhe familjen tuaj prej një zjarri” [Et-Tahrim: 6]. Po ashtu Allahu ka thënë: ﴿وَأْمُرْ أَهْلَكَ بِالصَّلَاةِ وَاصْطَبِرْ عَلَيْهَا﴾ “Urdhëro familjen tënde të falë namaz, e edhe ti vetë zbatoje atë” [Ta Ha: 132].

Nuk ka dyshim se fëmijët dhe nipat e mbesat janë mirësi e Allahut, dhe se lidhshmëria e ngushtë mes fëmijëve dhe

prindërve është natyrore. Kjo gjë imponon kujdesin e prindërve për arsimimin e fëmijëve çdo gjë që është e mirë dhe e dobishme. Fëmijët janë të prindërve, andaj, çdo mirësi dhe sukses i fëmijëve është sukses edhe e prindërve, në këtë botë dhe botën tjetër. ﴿وَاللَّهُ جَعَلَ لَكُمْ مِنْ أَنْفُسِكُمْ أَزْوَاجًا وَجَعَلَ لَكُمْ مِنْ أَزْوَاجِكُمْ بَيِّنٌ وَحَفْدَةً﴾ “Allahu krijoi për ju bashkëshorte nga vetë lloji juaj, e prej bashkëshorteve tuaja - fëmijë e nipa” [En-Nahl: 72]. Lutja e robërve të mirë të Allahut është që Allahu t’ju jep atyre pasardhës të mirë. ﴿وَالَّذِينَ يَقُولُونَ رَبَّنَا هَبْ لَنَا مِنْ أَزْوَاجِنَا وَذُرِّيَّاتِنَا فُرْقَةً أَغْنَيْنَ وَاجْعَلْنَا﴾ “Edhe ata që thonë: “Zoti ynë, na bën që të jemi të gëzuar me (punën) e grave tona dhe pasardhësve tanë, e neve na bën shembull për të devotshmit”. [El-Furkan: 74]. Pejgamberi i Allahut Zekerijai alejh’is-selam kur pa se fuqia e Allahut tejkalon shkaqet e dukshme, kërkoi prej Allahut diçka që llogaritej e pamundur. Ai kërkoi që Allahu atij t’i dhuron pasardhës të mirë, në kohë kur ai ishte i moshuar dhe gruaja e tij ishte sterile. ﴿هُنَالِكَ دَعَا زَكَرِيَّا رَبَّهُ قَالَ رَبِّ هَبْ لِي مِنْ لَدُنْكَ ذُرِّيَّةً طَيِّبَةً إِنَّكَ سَمِيعٌ﴾ “Aty në atë moment Zekerijai e lut Zotin e tij e thotë: “Zoti im, më falë edhe mua nga ana Juaj një pasardhës (fëmijë) të mirë, vërtet, Ti je dëgjues i lutjes”! [Alu Imran: 38]. Ai kishte njohuri, se pasardhësit e mirë nuk janë vetëm pjesë e stolisë së jetës së kësaj bote. ﴿الْمَالُ وَالْبَنُونَ زِينَةُ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا﴾ “Pasuria dhe fëmijët janë stoli e jetës së kësaj bote” [El-Kehf: 46], por - në rastin e Zekerijait- ishte mjet për vazhdimësinë e mirësisë dhe kryerjen e shërbimit të fesë së Allahut.

Porositë e Llukmanit drejtuar djalit të tij duke e këshilluar, mësuar dhe edukuar, kanë përfshirë çështje të besimit, adhurimit, dashurisë ndaj prindërve dhe sjellje psikologjike dhe shoqërore.

Në historinë e Ibrahimit alejh’is-selam ka shumë raste që flasin për mësimdhënie dhe mësimnxënie dhe të cilat ndër lidhen me pasardhësit. Lutja e Ibrahimit dhe Ismailit ishte e përbashkët. Kjo lutje përfshinte që pasardhësit e tyre të jenë musliman dhe Allahu prej pasardhësve të tyre të dërgojë një pejgamber që do t’i mëson ata. Në rrëfimin e Ibrahimit shihet se si ai ka porositur fëmijët e tij të mos heqin dorë nga besimi

në një Zot. Të njëjtë gjë e kishte bërë edhe Jakubi alejh'is-selam me fëmijët e tij. Kjo porosi e Jakubit alejh'is-selam shihet kur ai i pyeti ata se kë do të adhurojnë pas vdekjes së tij. Ata ia vërtetuan atij se do të adhurojnë Allahun dhe se do të jenë të kujdesshëm ndaj porosisë së tij.

﴿وَإِذْ يَرْفَعُ إِبْرَاهِيمُ الْقَوَاعِدَ مِنَ الْبَيْتِ وَإِسْمَاعِيلُ رَبَّنَا تَقَبَّلْ مِنَّا إِنَّكَ أَنْتَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ رَبَّنَا وَاجْعَلْنَا مُسْلِمَيْنِ لَكَ وَمِن ذُرِّيَّتِنَا أُمَّةً مُّسْلِمَةً لَّكَ وَأَرِنَا مَنَاسِكَنَا وَتُبْ عَلَيْنَا إِنَّكَ أَنْتَ التَّوَّابُ الرَّحِيمُ رَبَّنَا وَابْعَثْ فِيهِمْ رَسُولًا مِّنْهُمْ يَتْلُو عَلَيْهِمْ آيَاتِكَ وَيُعَلِّمُهُمُ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ وَيُزَكِّيهِمْ إِنَّكَ أَنْتَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ وَمَنْ يَرْغَبْ عَن مِّلَّةِ إِبْرَاهِيمَ إِلَّا مَن سَفِهَ نَفْسَهُ وَلَقَدِ اصْطَفَيْنَا فِي الدُّنْيَا وَإِنَّهُ فِي الْآخِرَةِ لَمِنَ الصَّالِحِينَ إِذْ قَالَ لَهُ رَبُّهُ أَسْلِمْ قَالَ أَسْلَمْتُ لِرَبِّ الْعَالَمِينَ وَوَصَّىٰ بِهَا إِبْرَاهِيمُ بَنِيهِ وَيَعْقُوبُ يَا بَنِيَّ إِنَّ اللَّهَ اصْطَفَىٰ لَكُمُ الدِّينَ فَلَا تَمُوتُنَّ إِلَّا وَأَنتُمْ مُّسْلِمُونَ أَمْ كُنْتُمْ شُهَدَاءَ إِذْ حَضَرَ يَعْقُوبَ الْمُوتَ إِذْ قَالَ لِبَنِيهِ مَا تَعْبُدُونَ مِن بَعْدِي قَالُوا نَعْبُدُ إِلَهَكَ وَإِلَهَ آبَائِكَ إِبْرَاهِيمَ وَإِسْمَاعِيلَ وَإِسْحَاقَ إِلَهًا وَاحِدًا وَنَحْنُ لَهُ مُّسْلِمُونَ﴾

*“Edhe kur Ibrahim dhe Ismaili, duke i ngritur themelet e shtëpisë (Qabesë - luteshin): “Zoti ynë, pranoje prej nesh, se me të vërtetë Ti je që dëgjon dhe di!” Zoti ynë, bëna neve dyve besimtarë të sinqertë ndaj Teje dhe nga pasardhësit tanë, njerëz të bindur ndaj Teje, na i mëso rregullat e ibadetit (adhurimit) tanë dhe falna neve, vërtet Ti je që falë shumë, je mëshirues!” Zoti ynë, dërgo ndër ta, nga gjiri i tyre të dërguar që t’u lexojë atyre ajetet Tua, t’u mësojë atyre librin dhe urtësinë, e t’i pastrojë (prej ndyrësisë së idhujtarisë) ata. S’ka dyshim se Ti je ngadhënjyesi, i dijsلمي. E kush largohet prej fesë së Ibrahimit përveç atij që e poshtëron vetveten. Ne atë e bëmë të zgjedhur në këtë botë, kurse në botën tjetër ai është njëri prej të lartëve. Kur Zoti i vet atij i tha: “Dorëzohu!” Ai tha: “Iu kam dorëzuar Zotit të gjithësisë!” E Ibrahim i porositi bijtë e tij me këtë (fe), e edhe Jakubi. (u thanë) “O bijtë e mi, Allahu ua zgjodhi fenë (islame) juve, pra mos vdisni ndryshe, por vetëm duke qenë muslimanë!” A ishit ju (ithtarë të librit) dëshmitarë kur Jakubit iu afrua vdekja, e ai bijve të vet u tha: “Çka do të adhuroni pas meje”? Ata thanë: “Do ta adhurojmë Zotin tënd dhe Zotin e prindërve tuaj: Ibrahimit, Ismailit, Is’hakut, një të vetmin Zot dhe ne, vetëm Atij i jemi dorëzuar!” [El-Bekare: 127-133]*

Allahu ka dërguar peygamberët me qëllim që të përmirësojnë gjendjen e popujve të tyre. Kështu, peygamberët urdhëronin me të mirë dhe ndalonin nga e keqja. Allahu sqaroi kujdesin e këtyre peygamberëve për përmirësimin e gjendjes

së popujve pas vdekjes së tyre. E gjithë kjo me qëllim që feja e Allahut të vazhdon në mesin e këtyre popujve edhe në gjeneratat e ardhshme. Kështu kujdesi i këtyre Pejgamberëve ka ardhur në formë të porosisë. Porosia zi zakonisht ndodh në rast kur vërehet ndarja, në veçanti kur ofrohet vdekja. Ky moment zbulon kujdesin e porositësit dhe dëshirën e tij të madhe që të dëgjohet dhe zbatohet porosia e tij, dhe në të njëjtën kohë është një moment kur të porositurit ndikohen nga fjalët e tij dhe qëndrojnë besnik ndaj tyre.

### 1.7. Kur'ani Famëllartë objekt mësimi

Kur'ani Famëllartë është libër i fundit i zbritur nga ana e Allahut. I është zbritur Muhammedit alejh'is-selam gradualisht në kohë të ndryshme. E gjithë kjo ishte me qëllim që Muhammedin alejh'is-selam dhe besimtarët t'i orienton se si të bashkëveprojnë me ngjarjet sipas asaj që Allahu e ka caktuar prej nevojave të njerëzve. Muhammedi alejh'is-selam urdhëronte shkruarit e shpalljes (vahjit) ta shkruajnë atë që u lexohej atyre. Më pas i urdhëronte ta lexojnë atë që e kanë shkruar. E gjithë kjo me qëllim që të bindet në saktësinë e asaj që e kanë shkruar. Vazhduan kështu derisa Kur'ani tërësisht u tubua edhe në zemra, pra i mësuar përmendësh, edhe i shkruar. Më pas, Kur'ani është përcjellë gjeneratë pas gjeneratë në mënyrë të besueshme derisa arriti te ne duke u përcjellë nga persona profesionistë. Kështu Kur'ani, në çdo kohë ishte lënda më kryesore për mësim.

Me fillimin e zbritjes së Kur'anit me pesë ajetet e para që flasin për lexim, shkrim dhe arsimim, i ka dhënë prioritet arsimimit në formimin e tërë fesë. Kështu u fillua një fushatë e përgjithshme për zhdukjen e analfabetizmit në shoqërinë islame. Kur'ani është libër udhëzimi për të gjithë njerëzit në të gjitha sferat e jetës. Për këtë, tematikat e tij kanë përfshirë pastrimin individual, jetën familjare dhe shoqërore, rregullimin ekonomik, organizimin politik, marrëdhëniet ndërkombëtare etj. Andaj, ishte plotësisht normale që Kur'ani të jetë objekt dhe lëndë mësimi me fjalët dhe tekstet e tij.

Në Kur'an potencohet se nga qëllimet e mesazhit kur'anor është edhe ajo që Muhammedi alejh'is-selam të merr përsipër leximin e ajeteve dhe mësimin e librit të tjerëve. Ajetet janë tekstet kur'anore, pra vetë Kur'ani. Punë të parë që ua mësonte Muhammedi alejh'is-selam shokëve të tij ishte t'ua lexon atyre atë që i shpallej nga ana e Allahut. Prej urtësive të Allahut ishte që Kur'ani të zbret gradualisht sipas rrethanave, ngjarjeve dhe rasteve. Kështu, Muhammedi alejh'is-selam ua lexonte shkruesve të shpalljes atë që i shpallej, ndërsa ata e shkruanin dhe e mësonin përmendësh. Më pas Muhammedi alejh'is-selam e sqaronte atë që kishte nevojë përfshirë urdhrat, ndalesat dhe udhëzimet. Këto i praktikonin dhe me këtë rritej kujdesi për Kur'anin në shqiptim dhe kuptim, si dhe në teori dhe praktikë. ﴿وَأَنْزَلْنَا إِلَيْكَ الذِّكْرَ لِتُبَيِّنَ لِلنَّاسِ مَا نُزِّلَ إِلَيْهِمْ وَلَعَلَّهُمْ يَتَفَكَّرُونَ﴾ "Ty ta zbritëm Kur'anin që t'u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur atyre, me shpresë se do ta studiojnë (Kur'anin)". [En-Nahl: 44]. Pas periudhës pejgamberike, Kur'ani Famëlartë ishte lënda e parë mësimore në praktikat mësimore në shoqërinë islame. Mësimi i Kur'anit për lexim, përmendësh, komentim dhe praktikim realizohej për shkak të përmbajtjeve edukative dhe këshilluese që posedonte. Më pas nga Kur'ani dolën shumë shkenca siç janë: tubimi i Kur'anit dhe regjistrimi i tij, shkenca e kiraeteve kur'anore, tertili dhe texhvidi i Kur'anit, forma e shkrimit të tij, komentimi i tij, mrekuilitë kur'anore, shkencat e bazave të tefsirit, el-muhkem ve'l-muteshabih, ajetet deroguese dhe të deroguara, ajetet mekase dhe medinase, shkaqet e shpalljes, ajetet e paqarta e tjera, të cilat të gjitha këto çështje janë përfshirë në libra të veçanta në kuadër të shkencave të Kur'anit. Në librin "El-Itkan" të Imam Sujutiut, potencohet se shkencat e Kur'anit ishin 80 shkenca të ndërthurura njëra me tjetrën. Ai në lidhje me këtë ka thënë: "Sikur t'i ndaja ato të ndërhyra njëra me tjetrën, shkencat e Kur'anit do të arrinin mbi 300 shkenca".<sup>285</sup>

Ndonëse Kur'ani (për lexim dhe mësim përmendësh) ishte lëndë mësimi për fëmijët në fillim të shkollimit, ai mbet lëndë

<sup>285</sup> Xhelaludin Abdurrahman ibn Ebu Bekr Es-Sujuti (v. 911 h./1505), *El-Itkanu fi ulum'il-Kur'ani, Vizaret'ush-shu'un'il-islamijeti ve'l-evkafi ve'd-da'veti ve'l-irshadi*, Riad, 1426 h., fq. 17.

kryesore në të gjitha fazat e ndryshme arsimore, derisa Kur'ani studiohet në specializime të ngushta në nivelet më të larta arsimore.

Vlen të theksohet se Kur'ani ishte dhe mbetet referencë për ruajtjen e gjuhës arabe. Ishte përzgjedhje e Allahut që gjuha arabe të jetë gjuhë e shpalljes së fundit drejtuar njeriut. Allahu ka marrë përsipër ruajtjen e teksteve dhe gjuhës së Kur'anit. Kush dëshiron të mësojë arabishten, mësues më i mirë për një gjë të tillë është mësimi i Kur'anit.

Mësimi i Kur'anit ka filluar gojarisht nga goja e Muhammedit alejh'is-selam. Më pas muslimanët përdorën të njëjtën metodë. Ata të cilët e kishin mësuar nga Muhammedi alejh'is-selam gojarisht, ua mësonin të tjerëve gojarisht. Abdullah ibn Mes'udi radijallahu anhu ka thënë: *"Pasha Allahun, kam marrë nga goja e Muhammedit alejh'is-selam shtatëdhjetë e ca sure. Pasha Allahun, shokët e Muhammedit alejh'is-selam e kanë ditë se unë isha më i dituri në librin e Allahut, edhe pse nuk isha më i miri në mesin e tyre"*.<sup>286</sup> Në librin *"Fet'h'ul-Bari"* në këtë hadith ka edhe një shtesë në të cilin Ibn Mes'udi thotë: *"Pjesën tjetër të Kur'anit e kam marrë nga shokët e tij (Muhammedit)"*.<sup>287</sup> Në librin *"El- Musned"* të Imam Ahmedit thuhet: *"Transmetohet nga Maid Jekrib se ka thënë: shkuam tek Abdullah ibn Mes'udi dhe kërkua të na e lexojë suren Ta Sin Mim. Ai tha: nuk e di. Shkoni tek ai që e ka mësuar nga Muhammedi alejh'is-selam, te Habab ibn El-Eret. Tha: Shkuam te Hababi dhe na i mësoi"*.<sup>288</sup>

Mësimi i Kur'anit përmendësh, gojarisht me zinxhirë (sened) të pandërprerë ka vazhduar ndër shekuj. Bazuar në atë se zbatimi i rregullave të leximit me texhvid në mënyrë të plotë është e pamundur pa u mësuar gojarisht, shumë prej muslimanëve vazhdojnë edhe sot e kësaj dite ta mësojnë përmendësh gojarisht dhe me sened të pandërprerë. Mësimi i Kur'anit përmendësh sipas mënyrës së drejtpërdrejtë gojarisht prej mësuesit deri te nxënësi ishte njëra nga mënyrat

<sup>286</sup> El-Buhari, Sahih'ul-Buhari, vepër e cituar, hadithi nr. 5000, fq. 994.

<sup>287</sup> Ibn Haxher, El-Hafidh ibn Ismail El-Buhari, Riad, El Muhakkik, 2001, vëll. 8, fq. 677.

<sup>288</sup> Ahmed ibn Hanbel Esh-Shejbani Ibn Hanbel, (241 h./855), *Musned El-Imam Ahmed*, vëll. 6, Dar'ul-Mearif, Kajro, Egjipt, 1985, hadithi nr. 3980, fq. 34.

përmes së cilave Allahu ka mbrojtur librin e Tij, Kur'anin Famëlar të nga falsifikimi dhe shtrembërimi. Leximi i Fatihasë dhe sureve tjera në namazet që falen me zë, në namazin e xhumasë dhe të bajrameve, ndihmojnë në përgjithësimin e të mësuarit të Kur'anit në mënyrë gojarisht.

Mësimi i Kur'anit është i lehtë për mësim përmendësh, për t'u kuptuar dhe për zbatim të udhëzimeve të tij. Udhëzimet e tij nuk janë angazhim me çështje të rënda, por janë udhëzime që përshtaten me natyrën e shëndoshë të njeriut të përgatitura për përparimin dhe zhvillimin e tokës, dhe mëkëmbësin në te me të mirë dhe me të drejtë, duke shpresuar mirësitë e pafundme të ahiretit. Pjesë e natyrshmërisë është edhe kënaqësia me të mirat e kësaj bote siç janë: pasuria, fëmijët, gratë, shëndeti etj.

### 1.8. Kriteret dhe rregullat e diturisë në Kur'anin Famëlar të

Në Kur'anin Famëlar të janë përmendur shumë shprehje të veçanta për kriteret dhe rregullat e diturisë:

- Pjesë e diturisë është edhe shkrimi i marrëveshjeve dhe dëshmimi ndaj saj. Kur shkruesi e shkruan kontratën, ai duhet të jetë i drejtë, besnik dhe i sqertë. Kur kërkohet dëshmia e dëshmitarit, ai nuk ka të drejtë ta refuzojë dëshminë ose ta fshehë atë. Allahu ka thënë: ﴿وَلْيَكْتُبْ بَيْنَكُمْ كَاتِبٌ بِالْعَدْلِ وَلَا﴾ *“Dhe nga gjiri juaj le të shkruajë një shkruesi i drejtë dhe të mos ngurrojë nga të shkruarit ashtu siç e ka mësuar Allahu”*. [El-Bekare: 282]. Po ashtu ka thënë: ﴿وَلَا تَكْتُمُوا﴾ *“Mos e fshihni dëshminë, sepse ai që e fsheh atë, ai është mëkatar me zemrën e vet. Allahu di atë që veproni”*. [El-Bekare: 283]

- Është drejtësi dhe objektivitet që njeriu, i cili posedon diç nga dituria të cilësohet se e posedon atë. Mosnjohja e ahiretit dhe pakujdesi ndaj saj nuk nënkupton se njeriu nuk di asgjë nga çështjet e kësaj bote. Allahu ka thënë: ﴿يَعْلَمُونَ ظَاهِرًا﴾ *“Edhe atë që dinë nga jeta e kësaj bote, është dije e cekët, por ndaj jetës së përjetshme (ndaj Ahiretit) ata janë plotësisht të verbëruar.”* [Er-Rrum: 7].



- Në çështjet e diturisë dhe mësimit, Kur'ani udhëzon muslimanin të përdorë shprehjet e përshtatshme për secilin rast. E gjithë kjo me qëllim që kuptimi i shprehjes të lexuesi apo dëgjuesi të mos del nga kuptimi i vërtetë i tij. Gjuha në fund të fundit është: “Fjalë që folësi shpreh qëllimin e tij. Kjo shprehje është vepër e gjuhës... andaj, shprehjet duhet të thuhën lehtë dhe drejtë nga gjuha. Kështu çdo popull ka gjuhën dhe terminologjinë e vet”.<sup>289</sup> Kur'ani është referencë gjuhësore në kontrollimin e termeve dhe përmirësimin e gabimeve që mund të depërtojnë në këto terme. Allahu thotë: ﴿قَالَتِ الْأَعْرَابُ آمَنَّا قُلْ لَمْ تُؤْمِنُوا وَلَكِنْ قُولُوا أَسْلَمْنَا وَمَا يُدْخِلُ الْإِيمَانَ فِي قُلُوبِكُمْ وَإِنْ تُطِيعُوا اللَّهَ﴾ “*Beduinët thanë: “Ne kemi besuar!” Thuaj: “Ju nuk keni besuar ende, por thoni: Ne jemi dorëzuar, e ende nuk po u hyn besimi në zemrat tuaja. E nëse e respektoni Allahun dhe të dërguarin e Tij, Ai nuk ju pakëson asgjë nga veprat tuaja, se Allahu është shumë mëkat-falës, shumë mëshirues.”* [El-Huxhurat: 14].

- Kriter në dituri dhe mësime është përdorimi i fjalëve në vendin e tyre, pa falsifikim dhe shtrembërim, me qëllim që të jep kuptim ndryshe nga ajo për të cilën përdoret fjala në esencë. Allahu ka mallkuar njerëzit të cilët kanë vepruar kështu. Allahu thotë: ﴿فَبِمَا نَقْضِهِمْ مِيثَاقَهُمْ لَعَنَّاهُمْ وَجَعَلْنَا قُلُوبَهُمْ قَاسِيَةً يُحَرِّفُونَ﴾ “*Për shkak se ata e thyen zotimin e tyre, Ne i mallkuam ata, dhe zemrat e tyre i bëmë të forta (të shtangura). Ata i ndryshojnë fjalët (në Tevrat) nga domethënia e tyre*” [El-Maide: 13]. Po ashtu ka thënë: ﴿وَمِنَ الَّذِينَ هَادُوا سَمَّاعُونَ لِلْكَذِبِ سَمَّاعُونَ لِقَوْمِ آخِرِينَ لَمْ يَأْتَوْكَ بِتُورٍ لَّا يُحَرِّفُونَ الْكَلِمَ مِنْ بَعْدِ مَوَاضِعِهِ يَقُولُونَ إِنْ أُوتِيتُمْ هَذَا فَخُذُوهُ وَإِنْ لَمْ تُؤْتَوْهُ فَاحْذَرُوا﴾ “*E as i atyre që janë jehudi, të cilët shumë i përgjigjen gënjeshtërs dhe shumë dëgjojnë (fjalën) një popull që nuk vjen te ti, ata janë që i mënjanojnë fjalët pas vënies së tyre në vendin e vet (nga ana e Allahut) e thonë: “Nëse u jepet kjo, pranoni, e nëse nuk u jepet, atëherë refuzoni”.* [El-Maide: 41]

- Pjesë e përpikërisë gjatë përdorimit të fjalëve është edhe dallimi mes diturisë dhe hamendjes apo paragykimit. Allahu ka thënë: ﴿قُلْ هَلْ عِنْدَكُمْ مِنْ عِلْمٍ فَتُخْرِجُوهُ لَنَا إِنْ تَتَّبِعُونَ إِلَّا الظَّنَّ وَإِنْ أَنْتُمْ إِلَّا﴾

<sup>289</sup> Ibn Haldun, *Mukadimetu Ibn Haldun*, vepër e cituar, vëll. 3, fq. 1128.

﴿تَحْرُصُونَ﴾ “*Thuaj: “A mos keni ndonjë fakt e të na e prezantoni atë neve?” Ju i mbështeteni vetëm hamendjes, në të vërtetë, vetëm gënjeni.*” [El-En’am: 148]

- Kriter në dituri dhe mësim është edhe argumentimi me:

- argument të shkruar, i cili është i besueshëm. Allahu

thotë: ﴿اتَّبُونِي بِكِتَابٍ﴾ “*Më sillni ndonjë libër.*” [El-Ehkaf: 4] ose me,

- argument material që i nënshtrohet shqisave. Allahu

thotë: ﴿أَرُونِي مَاذَا خَلَقُوا مِنَ الْأَرْضِ﴾ “*Më tregoni se çka krijuan ata në tokë.*” [El-Ahkaf: 4]. Po ashtu, thotë: ﴿وَجَعَلُوا لِلْمَلَائِكَةِ الَّذِينَ هُمْ عِبَادُ الرَّحْمَنِ﴾

﴿إِنَّا أَنشَأْنَاهُمْ خُلُقُهُمْ﴾ “*Edhe engjëjt që janë adhurues të Zotit i quajnë femra? A prezantuan ata në krijimin e tyre (melaqeve)?* [Ez-Zuhruf: 19]

- ose argument logjik. Allahu thotë: ﴿قُلْ هَاتُوا بُرْهَانَكُمْ إِن كُنْتُمْ﴾

﴿صَادِقِينَ﴾ “*Thuaj: ‘Sillni argumentet tuaja, nëse jeni të sinqertë!’*”

[En-Neml: 64] Po ashtu thotë: ﴿قُلْ أَرَأَيْتُمْ مَا تَدْعُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ أَرُونِي مَاذَا خَلَقُوا﴾

﴿مِنَ الْأَرْضِ أَمْ لَهُمْ شِرْكٌ فِي السَّمَاوَاتِ﴾ اتَّبُونِي بِكِتَابٍ مِنْ قَبْلِ هَذَا أَوْ أَنَادِرُهُ مِنْ عِلْمٍ إِنْ كُنْتُمْ صَادِقِينَ ﴿*“Thuaj: “Më thoni për ata që pos Allahut i adhuroni, më tregoni se çka krijuan ata në tokë dhe a kanë pjesëmarrje në (krijimin në) qiejt? Nëse e thoni të vërtetën, më sillni ndonjë libër para këtij ose ndonjë gjurmë të mbetur prej diturisë.*” [El-Ahkaf: 4]

- Kriter i diturisë dhe mësimi është edhe kujdesi për atë që i sjell dobi të realët njeriut, qoftë dobi materiale, logjike apo vepër e dobishme. Pyetja apo biseda jashtë kësaj është humbje e mundit dhe kohës së njeriut në çështje të pado-bishme. Kështu Kur’ani e udhëzonte Muhammedin alejh’is-selam gjatë përgjigjeve ndaj pyetjeve që i parashtroheshin. Allahu thotë:

﴿وَيَسْأَلُونَكَ عَنِ الرُّوحِ قُلِ الرُّوحُ مِنْ أَمْرِ رَبِّي وَمَا أُوتِيتُمْ مِنَ الْعِلْمِ إِلَّا قَلِيلًا﴾ “*Të pyesin ty për shpirtin; Thuaj: “Shpirti është çështje që i përket vetëm Zotit tim, e juve ju është dhënë fort pak dije.*” [El-Isra’: 85].

Po ashtu thotë:

﴿يَسْأَلُونَكَ عَنِ السَّاعَةِ أَيَّانَ مُرْسَاهَا قُلْ إِنَّمَا عِلْمُهَا عِنْدَ رَبِّي لَا يُجَلِّمُنَا لَوْفُهَا إِلَّا هُوَ نَقُلْتُ فِي السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ لَا تَأْتِيكُمُ إِلَّا بَغْتَةً يَسْأَلُونَكَ كَأَنَّكَ حَفِيٌّ عَنْهَا قُلْ إِنَّمَا عِلْمُهَا عِنْدَ اللَّهِ وَلَكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يَعْلَمُونَ﴾

“*Të pyesin ty (Muhammed) për çastin (e fundit) se kur do të ndodhë ai. Thuaj: “Atë e di vetëm Zoti im, kohën e tij nuk mund ta*

*zbulojë kush pos Tij (e sjell fundin pa e hetuar asnjë nga krijesat). Çështja e tij (se kur do të ndodhë) është preokupim i rëndë (për krijesat) në qiej e në tokë. Ai (çasti) nuk ju vjen ndryshe, vetëm befas. Të pyesin ty sikur ti di për të. Thuaj: “Për të di vetëm Allahu, por shumica e njerëzve nuk e dinë (pse është e fshehtë).” [El-A’raf: 187].*

### 1.9. Prioritetet e edukatës dhe arsimit në Kur’anin Famëlartë

Përfitimi i diturisë kërkon kohë dhe mund. Jeta e njeriut është e shkurtër dhe energjia e tij është e kufizuar. Disa shkenca dhe përvoja janë më të rëndësishme se disa të tjera dhe disa shkenca duhet mësuar para disa të tjerave. Për këtë, duhet shikuar atë që është më prioritarë se tjerat për nga rëndësia dhe koha. Në Kur’an ka ajete që udhëzojnë drejt përcaktimit të këtyre prioriteteve.

Shembuj të prioriteteve:

- Përfitimi i diturisë së dobishme: këtu përfshihen përmbajtjet që njeriu përmes tyre fiton për vete dhe u sjell dobi të tjerëve, në këtë botë dhe në ahiret. Këtu përfshihen disa lloje të përmbajtjeve. Disa prej tyre janë farz, ku asnjë musliman nuk guxon t’i anashkalojë ato, qofshin prej çështjeve të kësaj bote ose ahiretit. Ka disa tjera që janë farz kifaje, ku individ i ofron shoqërisë atë që shoqëria nuk lejohet të mos e posedojë prej shkencave, përvojave dhe aftësive.

- Përfitimi i devocionit ndaj Allahut: dijetarët dhe shkencëtarët të cilët kanë mësuar atë që është në Kur’an, pra ajetet që thërrasin për mendim, meditim, përkujtim, ajetet e shpresës dhe frikës, ajetet që nxisin për ecje, hulumtim dhe meditim në horizontet e botës natyrore, shoqërore dhe psikologjike, si dhe ajete tjera. Këta janë dijetarët që kanë pasur dobi nga këto shkenca dhe u kanë sjellë dobi të tjerëve, do të jenë më të nënshtruar ndaj Allahut dhe do të kenë më shumë frikë-respekt ndaj Tij. Allahu thotë: ﴿إِنَّمَا يَخْشَى اللَّهَ مِنْ عِبَادِهِ الْعُلَمَاءُ﴾ “*Po Allahut ia kanë frikën nga robërit e Tij vetëm dijetarët.*” [Fatir: 28]. Ky ajet ka ardhur pas kërkesës për të shikuar shembuj të ndryshëm nga fuqia e Allahut të shfaqura në kozmos. Ky ajet fton për bashkimin mes përfitimit të diturive në sferat gjeologjike, biologjike dhe shoqërore dhe devocionit ndaj Allahut.

Me këtë, dituria e vërtetë dhe e dobishme është ajo që shpie drejt këtij devocioni. Allahu thotë:

﴿أَلَمْ تَرَ أَنَّ اللَّهَ أَنْزَلَ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً فَأَخْرَجْنَا بِهِ ثَمَرَاتٍ مُخْتَلِفًا أَلْوَانُهَا وَمِنَ الْجِبَالِ جُدَدٌ بِيضٌ وَحُمْرٌ مُخْتَلِفٌ أَلْوَانُهَا وَغَرَابِيبُ سُودٌ وَمِنَ النَّاسِ وَالدَّوَابِّ وَأَلْأَنْعَامِ مُخْتَلِفٌ أَلْوَانُهُ كَذَلِكَ إِنَّمَا يَخْشَى اللَّهَ مِنْ عِبَادِهِ الْعُلَمَاءُ إِنَّ اللَّهَ عَزِيزٌ غَفُورٌ﴾

*“A nuk e sheh se Allahu lëshon nga qielli ujë, e Ne nxjerrim me të fruta, ngjyra e të cilëve është e ndryshme, e edhe nëpër kodra ka vija të bardha e të kuqe ngjyrash të ndryshme, e ka edhe shumë të zeza. Edhe nga njerëzit, nga gjallesat, nga kafshët po ashtu ka të ngjyrave të ndryshme. Po Allahut ia kanë frikën, nga robërit e Tij, vetëm dijetarët, Allahu është mbi gjithçka, është mëkat-falës.”* [Fatir: 27-28].

Bazuar në atë që u tha më lartë, prioritet i edukatës dhe arsimit është të realizohet ky lloj i diturisë dhe frikë-respektit. Nëse nuk realizohet frikë-respekti, atëherë dituria e përfituar është diç “nga dukuritë e kësaj bote, e që është dituri e përku-fizuar me disa çështje të cilat mund të jenë të dobishme për këtë botë dhe mosnjohje të çështjeve tjera që janë më të dobi-shme dhe që i bënë të kuptojnë se mosbindja dhe pakujdesi ndaj ahiretit i bën në mesin e atyre që nuk dinë. Allahu thotë: ﴿وَعَدَ اللَّهُ لَا يُخْلِفُ اللَّهُ وَعْدَهُ وَلَكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يَعْلَمُونَ يَعْلَمُونَ ظَاهِرًا مِّنَ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَهُمْ عَنِ الْغَيْبِ لَا يُخْلِفُ اللَّهُ وَعْدَهُ وَلَكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يَعْلَمُونَ لَا يَعْلَمُونَ ظَاهِرًا مِّنَ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَهُمْ عَنِ الْغَيْبِ لَا يُخْلِفُ اللَّهُ وَعْدَهُ وَلَكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يَعْلَمُونَ﴾ *“Premtimi i Allahut është (ky), Allahu nuk e thyen premtimin e Vet, por shumica e njerëzve nuk po dinë. Edhe atë që dinë nga jeta e kësaj bote, është dije e cekët, por ndaj jetës së përjet-shme (ndaj Ahiretit) ata janë plotësisht të pakujdesur.”* [Er-Rrum: 6-7]. Në këtë ajet, për mosnjohjen ndaj ahiretit është shprehur me fjalën pakujdesje (el-gafle)”<sup>290</sup>

- Gradualiteti dhe lehtësimi në arsim: të Dërguarit e Allahut ishin mësues më të mirë. Këtyre të Dërguarve që Allahu u ka dhënë libra, urtësi dhe pejgamberi, njerëzit i mësynë të jenë të përkushtuar (rebbanijjun). Të gjithë atë që e kanë mësuar nga libri që i largon nga shirku dhe atë që e kanë studiuar derisa e kanë kuptuar mirë, ia mbështesin Allahut. Ky lloj arsimimi përfshin lehtësimin e duhur dhe gradualitetin që rregullon dhe përmirëson çështjet e njerëzve.

<sup>290</sup> Ibn Ashur, *Tefsir'ut-tehriri ve't-tenvir*, vepër e cituar, vëll. 21, fq. 50.

Ai që pranon këtë dituri dhe përfiton prej tij, edhe do të veprojë sipas tij. Allahu thotë:

﴿مَا كَانَ لِبَشَرٍ أَنْ يُؤْتِيَهُ اللَّهُ الْكِتَابَ وَالْحُكْمَ وَالنُّبُوَّةَ ثُمَّ يَقُولَ لِلنَّاسِ كُونُوا عِبَادًا لِي مِنْ دُونِ اللَّهِ وَلَكِنْ كُونُوا رَبَّانِيِّينَ بِمَا كُنْتُمْ تُعَلِّمُونَ الْكِتَابَ وَبِمَا كُنْتُمْ تَدْرُسُونَ﴾

*“S’është e drejtë as nuk i takoi asnjë njeriu që t’i ketë dhënë Allahu librin, urtësinë dhe peygamberinë, e pastaj ai t’u thotë njerëzve: “Bëhuni rob të mi (adhuromëni mua) e jo të Allahut”! Por (ju thotë): “Bëhuni dijetarë të mësimëve të Zotit, ngase u keni mësuar njerëzve librin dhe e keni studiuar atë”. [Alu Imran: 79]*

Kurtubiu gjatë komentimit të ajetit ka thënë: “Rebbanijun janë ata që janë të përkushtuar ndaj Allahut dhe ua mësojnë njerëzve gjërat e vogla para se t’ua mësojnë ato madhore. Ai me këtë sikur pason metodën e Allahun në lehtësimin e çështjeve. Këtë kuptim e ka transmetuar nga Ibn Abbasi. Muberidi ka thënë: Rebbanijun janë ata të cilët menaxhojnë dhe përmirësojnë. Sipas kësaj, kuptimi është: menaxhojnë dhe përmirësojnë çështjet e njerëzve... Fjala Rebbani ka kuptimin e të diturit rreth fesë së Zotit dhe vepron sipas saj. Ngase, nëse nuk vepron sipas diturisë, ai nuk është i ditur. Rebbani është ai që bashkon diturinë dhe politikën, respektivisht menaxhimin”.<sup>291</sup>

## 2. Tematikat e arsimit në Kur’anin Famëlartë:

Kur’ani tejkalon kufijtë e të qenit vetëm lëndë për mësimnxënie dhe mësimdhënie. Ai merret me edukim në bazë të vlerave dhe udhëzimeve që rregullojnë tërë jetën e njeriut, duke përfshirë përparimin dhe progresin në këtë jetë duke i shfrytëzuar mirësitë e saj si dhe rregullimin e jetës së ahiretit me shpërblime dhe sevape të cilat i ka arritur njeriu me veprat e mira të tij që i ka vepruar. Kjo gjerësi dhe zgjatje e jetës së njeriut është objektivë e diturisë dhe arsimit sipas udhëzimeve kur’anore.

### 2.1. Mësimi i vizionit të përgjithshëm dhe detajimeve të pjeshme

<sup>291</sup> Ebu Abdullah Muhamed ibn Ahmed ibn Ebu Bekr El-Kurtubi (v. 671 h./1272). El-Xhamiu li ahkam’il-Kur’ani, vëll. 5, Muesseset’ur-risaleti, Beirut, 2006, fq. 184-185.

Hulumtimi rreth tematikave mësimore për të cilat mund të argumentojmë ekzistimin e tyre në Kur'an, na shpie drejt gjetjes së shumë tematikave të cilët përfshijnë në mënyrë të detajuar jetën e njeriut për këtë botë dhe për ahiret. Ndoshta edhe më e rëndësishme se kjo është edhe vrojtimi e çështjeve universale ose të përgjithshme të cilat flasin për llojet materiale, shoqërore dhe psikologjike të botës, për Zotin e gjitha botëve, për njeriun, përfshirë esencën, jetën dhe përfundimin, për këtë botë dhe botën tjetër ahiretin, lirinë e njeriut në zgjedhje, përgjegjësi, përdorimi i mendjes dhe shqisave në ixhtihad dhe reformim, përgjegjësinë individuale dhe kolektive, si dhe çështje tjera universale dhe të përgjithshme. Vrojtimi i këtyre çështjeve universale fton njeriun të hulumtojë në detajime në dritën e vizionit universal dhe të përgjithshëm.

Në anën tjetër, në Kur'an gjejmë mësimet të detajuara në çështjet e pjesshme, ku përfshihen çështje të hollësishme të veçanta për besim, adhurim, bashkëveprim mes njerëzve dhe dispozita që caktojnë të drejtat dhe obligimet. Në udhëzimet pedagogjike kur'anore gjejmë metodat e urdhrit dhe ndalesës, këshillimit dhe udhëzimit. Mësimet kur'anore janë edhe ftesat për gara në të mira, gjë që ndikon në edukimin e ndër-gjegjes, rritjen e dashurisë dhe mëshirës dhe pastrimin e raporteve familjare dhe shoqërore. Prej mësimëve kur'anore është edhe këmbëngulja në mejdanin e luftës, edukim për durim, kontrollim të bashkëveprimeve ekonomike dhe udhëzim për sistemet politike dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.

## 2.2. Mësimi i të menduarit për një jetë më të mirë:

Jeta nuk rri gjithnjë në të njëjtën gjendje, të cilën do ta mësojë njeriu dhe do të qetësohet në te. Jeta ndryshon dhe reformohet. Kjo e bënë njeriun të mendon për alternativa të cilat sjellin kushte më të mira. Ai nuk pranon jetën i nënçmuar dhe në errësi, por emigron ku në tokë do të gjejë strehim. Ai shkon në çdo cep të tokës për të kërkuar furnizimin. Kërkon rrugët e sigurisë, qoftë përmes pengesave që ndalon zullumqarët ose përmes rrethimit të fortifikatave të atyre që bëjnë çrregullime, nxisin përçarje dhe rrezikojnë sigurinë e shoqërisë.

### 2.3. Kërkim për shtimin e diturisë

Allahu nuk kënaqet që besimtari të ndërpresë kërkimin e diturisë, qoftë edhe pejgamber. Ai kërkon prej tyre që të shtojnë diturinë sa të jetë e mundur. Allahu ka kërkuar nga Musa alejh'is-selam që të mësohet nga një njeri që ishte më i dijshëm se ai. ﴿هَلْ أَدَّبْتُكَ عَلَىٰ أَنْ تُعَلِّمَنِي مِمَّا عَلَّمْتُ رَسُولًا﴾ “A pranon të vijë me ty, që të më mësosh nga ajo që je i mësuar (i dhuruar) ti: dituri të drejtë e të vërtetë?” [El-Kehf: 66]. Po ashtu, kërkoi nga Muhammedi alejh'is-selam të kërkojë prej Allahut t’ia shton diturinë, ﴿وَلَا تَعْجَلْ بِالْقُرْآنِ مِنْ قَبْلِ أَنْ يُقْضَىٰ إِلَيْكَ وَحْيُهُ وَقُلْ رَبِّ زِدْنِي عِلْمًا﴾ “Ti mos nxito me Kur’anin para se të përfundojë shpallja e tij te ti, dhe thuaj: “O Zot, më shto mua dituri!” [Ta Ha: 114].

### 2.4. Mësimi i metodave mësimore

Në Kur’anin Famëlartë ekzistojnë një numër shembujsh që flasin për metodat edukativo-arsimore si: këshillimi, udhëzimi, nxitja, frika, dialogu, rrëfimi, shembujt, demonstrimi etj. Pjesë e metodave mësimore është edhe mëshira. Allahu thotë: ﴿فَبِمَا رَحْمَةٍ مِنَ اللَّهِ لِنْتَ لَهُمْ وَلَوْ كُنْتَ فَظًّا غَلِيظَ الْقَلْبِ لَانفَضُّوا مِنْ حَوْلِكَ﴾ “Ti ishe i butë ndaj atyre, ngase Allahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do shkapërderdheshin prej teje.” [Alu Imran: 159]. Po ashtu thotë: ﴿عَزِيزٌ عَلَيْهِ مَا عَنِتُّمْ حَرِيصٌ عَلَيْكُمْ بِالْمُؤْمِنِينَ رَءُوفٌ رَحِيمٌ﴾ “Atij i vie rëndë për vuajtjet tuaja, sepse është lakmues i rrugës së drejtë për ju, është i ndershëm dhe i mëshirshëm për besimtarët” [Et-Tevbe: 128]. Sa i përket sferës së dialogut me të tjerët, duhet të realizohet me këshillim të mirë, derisa të dy palët të unifikojnë pikënisjen e dialogut dhe të mënjanojnë qëndrimet e mëparshme. Allahu ka thënë: ﴿وَإِنَّا أَوْ إِيَّاكُمْ لَعَلَىٰ هُدًى أَوْ فِي ضَلَالٍ مُّبِينٍ﴾ “E atëherë, ose ne ose ju jemi në rrugë të drejtë, apo në një humbje të dukshme!” [Sebe’: 24]. Po ashtu thotë: ﴿قُلْ لَا تَسْأَلُونَنِي عَمَّا أَجْرَمْنَا وَلَا نُسْأَلُ﴾ “Thuaj: ‘Ju nuk jeni përgjegjës për krimet tona, e as ne nuk përgjigjemi për atë që veproni ju.’” [Sebe’: 25]. Në kohën, kur Kur’ani cilëson qëndrimin e kundërshtarit për të cilin nuk do të japë përgjegjësi besimtari, si “vepër” pa etiketim të keq, vërejmë se cilëson qëndrimin e besimtarit, për të cilin

nuk do të japë përgjegjësi kundërshtari, si “krim”. Ibn Ashuri në tefsirin e tij ka thënë: “Kjo është formë e pjesëmarrjes së përbashkët me qëllim që të merren me veten, të shikojnë çështjet e tyre dhe mos të ngarkohen me dialogun e besimtarëve e të harrojnë veten e tyre. Këtu ka një nivel të lartë të drejtësisë, ngase besimtarët për veprat e tyre i paraqitën si “krime”, ndërsa veprat e të tjerave vetëm si “vepra”, ngase hulumtimi i mëvonshëm do të tregojë realitetin e të dy veprave”.<sup>292</sup>

Të gjitha urdhrat dhe ndalesat kur'anore e mësojnë njeriun të jetë i ndjeshëm dhe i kthjellët në lidhje me atë që e thotë dhe e vepron, duke u mbështetur në dituri të sigurt dhe argument që e mbështetë. Dëgjimi, shikimi dhe të menduarit do të jenë përgjegjës për atë që e bëjnë. Në Ditën e Kiametit, do të dëshmojnë të gjitha gjymtyrët e trupit për fjalët dhe veprat që kanë bërë. Allahu thotë: ﴿وَمَا كُنْتُمْ تَسْتَضِيئُونَ أَنْ يَشْهَدَ عَلَيْكُمْ سَمْعُكُمْ وَلَا أَبْصَارُكُمْ وَلَا جُلُودُكُمْ وَلَكِنْ ظَنَنْتُمْ أَنَّ اللَّهَ لَا يَعْلَمُ كَثِيرًا مِمَّا تَعْمَلُونَ﴾ “*Ju nuk fshiheshit (kur bënit mëkate) se do të dëshmojnë kundër jush të dëgjuarit tuaj, të pamurit tuaj dhe lëkurat tuaja, bile ju menduat se Allahu nuk di për shumë gjëra që ju i bënit.*” [Fusilet: 22]. Për këtë, Allahu ka ndaluar që njeriu të flet apo vepron diçka pa dituri. Allahu ka thënë: ﴿وَلَا تَقْفُ مَا لَيْسَ لَكَ بِهِ عِلْمٌ إِنَّ السَّمْعَ وَالْبَصَرَ وَالْفُؤَادَ كُلُّ أُولَئِكَ كَانَ عَنْهُ مَسْئُولًا﴾ “*Mos iu qas asaj për të cilën nuk ke njohuri, pse të dëgjuarit, të parit dhe zemra, për të gjitha këto ka përgjegjësi.*” [El-Isra': 36]. Në lidhje me këtë, Ibn Ashuri ka shtuar: “Ky është një nivel i lartë edukativ. Në të njëjtën kohë është një reformë e madhe mendore, që njeriut ia mëson të mos bën përzierjen mes çështjeve të ditura, të paragjykuara dhe të dyshuara. Është edhe reformë e madhe shoqërore që ruan shoqërinë nga rënia dhe hedhja e të tjerëve në dëme dhe shkatërrime për shkak të bazimit në argumente të supozuara dhe të dyshuara”.<sup>293</sup>

## 2.5. Mësimi i rregullave shoqërore

Sa i përket edukimit dhe arsimimit, në Kur'an ka forma të shumta të edukimit shpirtëror dhe shoqëror. Prej këtyre

<sup>292</sup> Ibn Ashur, Et-Tahriri ve't-tenviru, Vepër e cituar, vëll. 22, fq. 194.

<sup>293</sup> Ibn Ashur, vepër e cituar, vëll. 15, fq. 101.



formave janë: urdhërimi i besimtarëve dhe besimtareve për uljen e shikimit, ecja e qetë, pa mendjemadhësi, ulja e zërit në atë nivel që është e kërkuar dhe e pëlqyer.

﴿ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَدْخُلُوا بُيُوتًا غَيْرَ بُيُوتِكُمْ حَتَّى تَسْتَأْذِنُوا وَتَسَلِّمُوا عَلَىٰ أَهْلِهَا ذَلِكُمْ خَيْرٌ لَّكُمْ لَعَلَّكُمْ تَذَكَّرُونَ فَإِن لَّمْ تَجِدُوا فِيهَا أَحَدًا فَلَا تَدْخُلُوهَا حَتَّىٰ يُؤْذَنَ لَكُمْ وَإِن قِيلَ لَكُمْ ازْجِعُوا فَازْجِعُوا هُوَ أَزْكَىٰ لَكُمْ وَاللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ عَلِيمٌ ﴾

*“O ju që besuat, mos hyni në shtëpi të huaja pa kërkuar leje dhe pa përshëndetur njerëzit e saj. Kjo është më mirë për ju në mënyrë që të merrni mësim. Po nëse nuk gjeni aty asnjë, atëherë mos hyni në to derisa t’u jepet leje, e nëse u thuhet kthehuni, ju pra kthehuni. Kjo është më e ndershme për ju. Allahu di çdo gjë që veproni ju.”* [En-Nur: 27-28].

Ibn Ashuri ka thënë: “Prej qëllimeve më të mëdha të kësaj sure (surja En-Nur) është përfshirja legjislative e sistemit familjar... këto ajete flasin rreth sqarimit të rregullave të vizitës dhe mësimin e rregullave të kërimit të lejes gjatë hyrjes... këto ajete kanë ardhur për të përcaktuar mënyrën e kërimit të lejes dhe përfshirjen e tyre në rregullat e fesë, me qëllim që njerëzit të mos i minimizojnë ato... Prej rregullave tjera kemi edhe atë se njeriu nuk duhet të jetë barrë ndaj dikujt tjetër, e as të mos bëhet i urreyer dhe i padurueshëm. Vizitori dhe i vizituari duhet të ndjehen të kënaqur dhe të lumtur mes tyre. Kjo e ndihmon dhe siguron vëllazërinë islame”.<sup>294</sup>

## 2.6. Mësimi i vlerave familjare në pedagogjinë kur’anore:

Vlerat familjare janë degë e vlerave shoqërore, mirëpo, ato në Kur’an kanë një tretman të veçantë. Allahu ka caktuar që adhurimin ndaj tij ta shoqërojë me bamirësinë ndaj prindërve, dhe se mirësjellja ndaj tyre të mos lejojë të përfshihet me diç çka kundërshtohet me intencën e bamirësisë. Në lidhje me këtë, Allahu thotë:

﴿ وَقَصَىٰ رَبُّكَ أَلَّا تُعْبُدُوا إِلَّا إِيَّاهُ وَبِالْوَالِدَيْنِ إِحْسَانًا إِمَّا يَبُلُغَنَّ عِنْدَكَ الْكِبَرَ أَحَدُهُمَا أَوْ كِلَاهُمَا فَلَا تَقُلْ لَهُمَا أُفٍّ وَلَا تَنْهَرْهُمَا وَقُلْ لَهُمَا قَوْلًا كَرِيمًا ﴾

*“Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë që të mos adhuronit tjetër pos Tij, që të silleni me bamirësi ndaj prindërve. Nëse njërin prej tyre, ose që të dy, i ka kapur pleqëria pranë kujdesit tënd, atëherë mos u*

<sup>294</sup> Ibn Ashur, vepër e cituar, vëll. 18, fq. 196.

*thuaj atyre as "of - oh", as mos u bë i vrazhdë ndaj tyre, po atyre thuaju fjalë fisnike.*" [El-Isra': 23].

Porositë e Allahut drejtuar njeriut kanë përfshirë edhe përkujtimin e njeriut me disa vështirësi me të cilat ballafaqohet nëna në veçanti. Më pas falënderimin ndaj Allahut për mirësitë e Tij e ka shoqëruar me falënderimin ndaj prindërve për atë që kanë bërë për fëmijët e tyre. Allahu ka thënë: ﴿وَوَصَّيْنَا الْإِنْسَانَ بِوَالِدَيْهِ حَمَلَتْهُ أُمُّهُ وَهْنًا عَلَىٰ وَهْنٍ وَفِصَالُهُ فِي عَامَيْنِ أَنِ اشْكُرْ لِي وَلِوَالِدِكَ إِلَيَّ الْمَصِيرُ﴾ "Ne njeriun e kemi urdhëruar për (sjellje të mira) ndaj prindërve të vet, sepse nëna e vet atë e barti me mund pas mudi dhe pas dy viteve ia ndau gjirin. (E porositëm) Të jesh mirënjohës ndaj Meje dhe ndaj dy prindërve tu, pse vetëm tek Unë është kthimi juaj." [Lukman: 14].

Edukata kur'anore ndaj besimtarit e bënë që të përdorë fjalët më të buta dhe më të sinqerta për të shprehur raportet mes prindërve dhe fëmijëve. Kështu, Nuhi alejh'is-selam i drejtohet djalit të tij jobesimtar me fjalët e ngrohta atërore duke i thënë: ﴿يَا بُنَيَّ ارْكَب مَعَنَا وَلَا تَكُن مَعَ الْكَافِرِينَ﴾ "O djali im, hip bashkë me ne, e mos u bë me jobesimtarët!" [Hud: 42]. Mirëpo, djali i tij jobesimtar nuk posedon ndjenjat e djalit ndaj babait të tij, por e sfidon se nuk frikësohet, duke supozuar se do të mjaftojë të ngjitet në kodër dhe do ta mbrojë nga uji. Pasi ndërmjet tyre depërtoi vala e ujit dhe djali ishte në mesin e të fundosurve, ndjenja prindërore edhe një herë u nxit te babai. Kështu, Nuhi alejh'is-selam iu drejtua Allahut duke ia përkujtuar premtimin e Tij për marrjen e familjes me vete në anije ﴿قُلْنَا احْمِلْ فِيهَا مِنْ كُلِّ زَوْجَيْنِ اثْنَيْنِ وَأَهْلَكَ﴾ "Ne i thamë: "Ngarko në të çdo krijesë nga një çift edhe familjen tënde." [Hud: 40] dhe duke harruar përjashtimin në këtë kërkesë ﴿إِلَّا مَنْ سَبَقَ عَلَيْهِ الْقَوْلُ وَمَنْ آمَنَ﴾ "përveç për kë është marrë vendim i hershëm kundër tij, e (ngarkoje) edhe kush ka besuar." [Hud: 40]. ﴿فَقَالَ رَبِّ إِنِّي مِنَ الْهَالِكِينَ وَإِنَّ وَعْدَكَ الْحَقُّ وَأَنْتَ أَحْكَمُ﴾ "Nuhi e luti Zotin e vet, duke i thënë: "O Zoti im, djali im është i familjes sime, e premtimi Yt është i saktë, ndërsa Ti je më i drejti i të drejtëve." [Hud: 45]. Për këtë erdhi përgjigjja nga ana e Allahut duke përmirësuar konceptet, duke e qortuar dhe këshilluar të mos jetë prej injorantëve që kërkojnë atë për të cilën nuk posedojnë dituri. ﴿قَالَ يَا نُوحُ إِنَّهُ لَيْسَ مِنْ أَهْلِكَ إِنَّهُ عَمَلٌ غَيْرُ صَالِحٍ فَلَا

﴿تَسْأَلُنَ مَا لَيْسَ لَكَ بِهِ عِلْمٌ إِنِّي أَعِظُكَ أَنْ تَكُونَ مِنَ الْجَاهِلِينَ﴾ “(Zoti) Tha: “O Nuh, ai (djali) nuk ishte nga familja jote (për të cilën të premtova se do t’i shpëtoj), ai ishte punëkeq, e ti mos më kërko Mua atë që nuk di, Unë të këshilloj që të mos bëhesh nga injorantët.” [Hud: 46].

Nëse kjo është edukata kur’anore e prindit besimtarë që shprehë ndjenja të sinqerta prindërore, kjo ndjenjë përsëritet edhe në rastin e fëmijës në raport me prindin, respektivisht Ibrahimit alejh’is-selam me babain e tij jobesimtar. Ai e ftoi në braktisjen e adhurimit të çështjeve që nuk sjellin as dëm e as dobi, ia sqaroi atij rrugët e udhëzimit, insistoi në këshillim dhe shprehi keqardhjen për dëmin që do ta godet nëse vazhdon të jetë mik i shejtanit dhe armik i Rrahmanit (Allahut). Çdo shprehje e ftesës dhe këshillës ka filluar me fjalën “o baba”, që në vete ngërthen dashuri dhe mëshirë. Në anën tjetër, babai jobesimtarë është i zhveshur tërësisht nga këto ndjenja për t’ia kthyer djalit të tij besimtar duke përmendur emrin e tij dhe duke përmendur shprehjet e vrazhda dhe kërcënuese. ﴿يَا إِبْرَاهِيمُ لَبِنَ لَمْ تَنْتَهَ لِأَرْجَمَنَّكَ وَاهْجُرْنِي مَلِيًّا﴾ “Ai (babai) tha: “A ti, Ibrahim, i refuzon zotat e mi? Nëse nuk ndalesh (së fyeri ndaj zotave të mi), unë do të gurëzoj, ndaj largohu prej meje për një kohë të gjatë.” [Merjem: 46]. Megjithatë, Ibrahim i përfundoi bisedën me babanë e tij duke iu përgjigjur kërkesës së tij për largim, por me ndjenja të sinqerta dhe shpresë që Allahu do t’ia falë atij. ﴿قَالَ سَلَامٌ عَلَيْكَ سَأَسْتَغْفِرُ لَكَ رَبِّي إِنَّهُ كَانَ بِي حَفِيًّا﴾ “Ai (Ibrahimi) tha: ‘Qofsh i lirë prej meje! Unë do ta lus Zotin tim për të të falur ty, sepse ai (babai) ishte i kujdesshëm ndaj meje.’” [Merjem: 47].

## 2.7. Mësimi i edukatës intelektuale:

Sa e sa ajete kur’anore ka që flasin për edukatën intelektuale! Prej këtyre ajeteve ka të tilla që flasin për gjykimet logjike dhe supozimet teorike, të cilat ftojnë për të menduar mirë në dukuritë që flasin për njëshmërinë dhe krijimin hyjnor. Allahu thotë:

﴿قُلْ أَرَأَيْتُمْ إِنْ جَعَلَ اللَّهُ عَلَيْكُمُ اللَّيْلَ سَرْمَدًا إِلَى يَوْمِ الْقِيَامَةِ مَنْ إِلَهُ غَيْرَ اللَّهِ يُأْتِيكُمْ بِضِيَاءٍ أَفَلَا تَسْمَعُونَ قُلْ أَرَأَيْتُمْ إِنْ جَعَلَ اللَّهُ عَلَيْكُمُ النَّهَارَ سَرْمَدًا إِلَى يَوْمِ الْقِيَامَةِ مَنْ إِلَهُ غَيْرَ اللَّهِ يُأْتِيكُمْ بِاللَّيْلِ تَسْكُونُونَ فِيهِ أَفَلَا تُبْصِرُونَ﴾

*“Thuaj: “Sikur Allahu ta bënte natën e përhershme (t’ua zgjaste) deri në ditën e kiametit, ç’mendoni, cili zot pos Allahut do t’ju sillte juve dritë? A nuk merrni vesh?” Thuaj: “Më tregoni, nëse Allahu ua bën ditën të vazhdueshme deri në ditën e kiametit, cili zot pos Allahut do t’ju sjellë natë që të pushoni në të? A nuk shihni (sa po gaboni)?” [El-Kasas: 71-72]*

Ibn Ashuri ka thënë: “Kalim nga argumentimi me cilësitë e Tij se Ai është i vetëm, në argumentim me krijesat e Tij mahnitëse. Argumentim më i fuqishëm është se Ai si argument për njëshmërinë e Tij ka zgjedhur këtë krijesë të çuditshme që përsëritet çdo ditë dy herë. Këtë e kupton çdo person normal dhe në të njëjtën kohë është dukuria më e ndryshueshme në këtë botë... Ky argumentim është paraqitur në formën e diktimit nga ana e Muhammedit alejh’is-selam. E gjithë kjo me qëllim të përkujtimit të këtij argumentimi dhe se përfshin dy çështje kontradiktore. Nëse mendjet e tyre nuk mund të kuptojnë argumentimin e njëres prej këtyre dy çështjeve, çështja tjetër e kundërt do të duhej të jetë përkujtim për ta. Po nëse nuk mund të kuptojnë urtësinë e secilës prej tyre, atëherë, ndërrimi i ditës dhe natës dhe zëvendësimi i tyre pandërprerë, do të mjaftonte për argumentim”.<sup>295</sup>

Pjesë e edukatës intelektuale është edhe tërheqja e vëmendjes drejt dukurive kozmologjike për të menduar dhe medituar në fuqinë hyjnore dhe urtësitë praktike. Allahu thotë:

﴿فَلْيَنْظُرِ الْإِنْسَانُ إِلَى طَعَامِهِ أَنَا صَبَبْنَا الْمَاءَ صَبًّا ثُمَّ شَقَقْنَا الْأَرْضَ شَقًّا فَأَنْبَتْنَا فِيهَا حَبًّا وَعَبَبًا وَقَضَبًا وَرَزَقْنَاهَا وَنَخْلًا وَوَدَائِقَ غُلْبًا وَفَاكِهَةً وَأَبًّا مَتَاعًا لَكُمْ وَلِأَنْعَامِكُمْ﴾

*“Njeriu le të shikojë ushqimin e vet. Ne lëshuam shi të mjaftueshëm. Pastaj e çamë tokën sipas nevojës së bimës, Dhe bëmë që në të të mbijnë drithëra Edhe rrush e perime, Edhe ullinj e hurma, Edhe kopshte të dendura, Dhe pemë e kullosa. Si mjete gjallërimi për ju dhe për bagëtinë tuaj”. [Abese: 24-32]*

Në lidhje me komentimin e këtyre ajeteve, Ibn Ashuri ka thënë: “Ky është edhe një argumentim për të bërë më të afërt në kuptim formën e ringjalljes. Duke udhëzuar njeriun në këtë drejtim, ka kaluar në te për ta marrë njeriu në konsideratë atë që e ka lënë pas dore. Kështu u bë kalimi nga argumen-

<sup>295</sup> Ibn Ashur, vepër e cituar, 168-169.

timi rreth krijimit të njeriut në ajetin ﴿مَنْ أَيْ شَيْءٍ خَلَقَهُ﴾ “Po prej se e krijoi Ai atë?” [Abese: 18], në argumentimin me disa çështje tjera që janë të ndërlidhura me jetën e njeriut. E gjithë kjo për të thelluar argumentimin dhe për t’ia përkujtuar njeriut mirësitë e bimëve, nga të cilat varet jeta e njeriut dhe jeta e kafshëve. Qëllimi i gjithë kësaj është që njeriu të meditojë në llojet e ndryshme të ushqimeve dhe të argumenton me nxjerrjen e gjësendeve nga toka. Allahu kërkon të shihen llojet e ushqimeve edhe pse për qëllim është të shihen shkaqet e formimit dhe gjendjet e ndryshimit”.<sup>296</sup>

Kërkimi për hulumtim dhe ecje mbi tokë me qëllim të kërkimit të diturisë në shkencat natyrore dhe ligjet e Allahut, në ndryshimin, shndërrimin dhe llojllojshmërinë e qenieve të gjalla dhe gjërave të ngurta, në Kur’an është përsëritur shumë herë. Allahu thotë: ﴿فَلْيَنْظُرِ الْإِنْسَانُ إِلَى طَعَامِهِ﴾ “Njeriu le të shikojë ushqimin e vet.” [Abese: 24]. Allahu thotë: ﴿فَلْيَنْظُرِ الْإِنْسَانُ مِمَّ خُلِقَ﴾ “Le të shikojë njeriu se prej se është krijuar” [Et-Tarik: 5]. Allahu thotë: ﴿قُلْ انظُرُوا مَاذَا فِي السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ﴾ “Thuaj: “Vështroni me vëmendje çka ka (nga argumentet) në qiej e në tokë.” [Junus: 101]. Allahu thotë: ﴿قُلْ سِيرُوا فِي الْأَرْضِ فَانظُرُوا كَيْفَ بَدَأَ الْخَلْقَ﴾ “Thuaj: “Udhëtoni nëpër tokë e shikoni se si filloi krijimi!” [El-Ankebut: 20]. Si dhe ajete tjera të shumta kur’anore.

Pjesë e edukatës intelektuale është edhe kërkimi i argumenteve dhe fakteve në çështjet e supozuara, ofrimi i argumenteve dhe fakteve në atë që e prezanton dhe përkujdesi për urtësi. Më parë folëm për kuptimin e “urtësisë” sipas Ragib Isfahanit në librin “El-Garib” dhe Ibn Kajim Xhevzies në librin “El-Medarixh”.

## 2.8. Mësimi i shkencave shoqërore dhe psikologjike:

Ecja mbi tokë nuk duhet bërë vetëm për të parë dukuritë kozmologjike që shfaqen para syve, por për të menduar rreth atyre që kanë jetuar në te, për përfundimin e tyre, si ishin ligjet e Allahut në ndërrimin e fuqisë dhe dobësisë, ndryshimin dhe ndërrimin e popujve, ngritjen dhe shkatërrimin e

<sup>296</sup> Vepër e cituar, vëll. 30, fq. 129.

civilizimeve etj., me të cilat merret historia, sociologjia dhe politika. Në lidhje me këtë, Allahu thotë: ﴿قُلْ سِيرُوا فِي الْأَرْضِ فَانظُرُوا كَيْفَ كَانَ عَاقِبَةُ الَّذِينَ مِن قَبْلُ كَانَ أَكْثَرُهُم مُّشْرِكِينَ﴾ “*Thuaj: ‘Ecni nëpër tokë dhe shikoni se si ishte përfundimi i atyre që ishin më parë, shumica e tyre ishin jobesimtarë.’*” [Er-Rrum: 42].

Nëse ecja mbi tokë dhe hulumtimi në dukuritë, ngjarjet dhe ndryshimet është me qëllim që njeriu të vëren fuqinë e Allahut dhe urtësinë e Tij në krijesat, vërejmë se Allahu i ka premtuar njeriut t’ia bënë të mundur të shohë argumentet e Tij, jo vetëm në horizontet kozmike, por edhe në ato shoqërore dhe psikike. Kur’ani ka zbuluar gjendjen psikologjike të njeriut kur është në nënshtrim ose refuzim, udhëzim ose devijim, besim ose hipokrizi, modesti ose mendjemadhësi, koprraci ose bujari, trimëri ose frikë, dashuri ose urrejtje ndaj Allahut.

Allahu ka thënë: ﴿أَفَرَأَيْتَ مَنِ اتَّخَذَ إِلَهَهُ هَوَاهُ وَأَصْلَهُ اللَّهُ عَلَىٰ عِلْمٍ﴾ “*A e ke parë ti (Muhammed) atë që duke e ditur, dëshirën e vet e respekton si zot të vetin, atë Allahu e ka humbur.*” [El-Xhathije: 23].

Allahu ka thënë: ﴿أَرَأَيْتَ الَّذِي يَكْذِبُ بِالذِّينِ﴾ “*A e ke parë ti (a e sheh) atë, që përgënjeshton përgjegjësinë dhe llogarinë në botën tjetër?*” [El-Maun: 1].

Allahu ka thënë: ﴿أَرَأَيْتَ إِنْ كَانَ عَلَىٰ الْهُدَىٰ أَوْ أَمَرَ بِالْقَوَىٰ أَرَأَيْتَ إِنْ كَذَّبَ وَتَوَلَّىٰ﴾ “*Ç’mendon kur ai (robi) është në rrugë të drejtë? Ose ai (rob) urdhëroi për sinqeritet. A më tregon nëse ai përgënjeshton dhe zmbrapset (nga besimi).*” [El-Alek: 11-13].

Allahu ka thënë: ﴿أَلَمْ تَرَ إِلَى الَّذِينَ خَرَجُوا مِن دِيَارِهِمْ وَهُمْ أُلُوفٌ حَذَرَ الْمَوْتِ﴾ “*A nuk di për ata, të cilët nga frika prej vdekjes u larguan prej atdheut të vet, e të cilët ishin me mijëra.*” [El-Bekare: 243]

Allahu thotë: ﴿أَلَمْ تَرَ إِلَى الَّذِينَ يُزَكُّونَ أَنفُسَهُمْ﴾ “*A nuk ke kuptuar për ata që vlerësojnë vetveten?*” [En-Nisa’: 49].

Allahu thotë: ﴿أَلَمْ تَرَ أَنَّهُمْ فِي كُلِّ وَادٍ يَمِيمُونَ﴾ “*A nuk sheh se ata hidhen në çdo anë (sa lavdërojnë, sa përqeshin).*” [Esh-Shuara’: 225].

Allahu thotë: ﴿أَلَمْ تَرَ إِلَى الَّذِينَ تَوَلَّوْا قَوْمًا غَضِبَ اللَّهُ عَلَيْهِمْ﴾ “*A e dini për ata që kanë miqësuar një popull që Allahu ka shprehur mallkim kundër tyre.*” [El-Muxhadele: 14]

Allahu ka thënë:

﴿ أَلَمْ تَرَ إِلَى الَّذِينَ نَافَقُوا يَقُولُونَ لِإِخْوَانِهِمُ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْ أَهْلِ الْكِتَابِ لَئِنْ أُخْرِجْتُمْ لَنَخْرُجَنَّ  
مَعَكُمْ وَلَا نُطِيعُ فِيكُمْ أَحَدًا أَبَدًا وَإِنْ قُوتِلْتُمْ لَنَنْصُرَنَّكُمْ وَاللَّهُ يَشْهَدُ إِنَّهُمْ لَكَاذِبُونَ ﴾

“A nuk e ke ditur se ata që u bënë hipokritë, u thoshin vëllezër-  
ve të vet nga ihtarët e librit që nuk kishin besuar: Nëse ju dëboheni,  
edhe ne do të dalim me ju për çështjen tuaj, ne kurrë nuk do t’i  
bindemi askujt (t’ju luftojmë ose t’ju nënshtrojmë), e nëse luftoheni  
prej dikujt, ne gjithqysh do t’u ndihmojmë. Allahu dëshmon se ata  
janë rrenacakë!” [El-Hashr: 11]

Allahu ka thënë:

﴿ تَرَى كَثِيرًا مِّنْهُمْ يَتَوَلَّوْنَ الَّذِينَ كَفَرُوا لَبِئْسَ مَا قَدَّمْتُمْ لَهُمْ أَنْفُسُهُمْ أَنْ سَخِطَ اللَّهُ عَلَيْهِمْ وَفِي  
الْعَذَابِ هُمْ خَالِدُونَ ﴾

“I sheh shumë prej tyre që i miqësojnë ata që mohuan. E keq  
është ajo që i përgatitën vetes së tyre, ngase Allahu është i hidhëru-  
ar kundër tyre dhe ata përjetë janë në azab (në vuajtje të dënimit).”  
[El-Maide: 80]

Allahu ka thënë:

﴿ وَإِذَا سَمِعُوا مَا أُنزِلَ إِلَى الرَّسُولِ تَرَى أَعْيُنُهُمْ تَفِيضُ مِنَ الدَّمْعِ مِمَّا عَرَفُوا مِنَ الْحَقِّ يَقُولُونَ رَبَّنَا  
أَمَّا فَاكْتُبْنَا مَعَ الشَّاهِدِينَ ﴾

“Kur e dëgjojnë atë që i është zbritur të dërguarit (Kur’anin),  
prej syve të tyre rrjedhin lot, ngase e kanë kuptuar të vërtetën dhe  
thonë: “Zoti ynë, ne kemi besuar, pra na regjistro ndër ata që dësh-  
mojnë (ndër umetin e Muhammedit).” [El-Maide: 83]

Allahu ka thënë: ﴿ وَتَرَاهُمْ يَنْظُرُونَ إِلَيْكَ وَهُمْ لَا يُبْصِرُونَ ﴾ “Dhe nëse i  
thirrni për udhëzim, nuk dëgjojnë, e të duken se po të shikojnë ty,  
po ata nuk shohin.” [El-A’raf: 198]

Allahu ka thënë:

﴿ وَإِنْ يَرَوْا سَبِيلَ الرُّشْدِ لَا يَتَّخِذُوهُ سَبِيلًا وَإِنْ يَرَوْا سَبِيلَ العِغْيِ يَتَّخِذُوهُ سَبِيلًا ذَلِكَ بِأَنَّهُمْ كَذَّبُوا  
بِآيَاتِنَا وَكَانُوا عَنْهَا غَافِلِينَ ﴾

“Nëse shohin rrugën e shpëtimit nuk e marrin atë rrugë, e nëse  
e shohin rrugën e gabuar ata e marrin atë rrugë. Këtë (këtë verbë-  
rim të tyre), ngase ata i konsideruan të rreme faktet Tona dhe ngase  
i lanë pas dore ato”. [El-A’raf: 146]

Allahu ka thënë: ﴿ أَوَلَا يَرَوْنَ أَنَّهُمْ يُفْتَنُونَ فِي كُلِّ عَامٍ مَّرَّةً أَوْ مَرَّتَيْنِ ثُمَّ لَا يَتُوبُونَ وَلَا هُمْ  
يَتَذَكَّرُونَ ﴾ “A nuk e shohin ata se për çdo vit sprovohen një herë apo dy  
herë, e përsëri nuk pendohen e as nuk marrin mësim.” [Et-Tevbe:  
126].

## 2.9. Mësim për përdorimin e njohurive shkencore:

Në Kur'anin Famëlartë ekzistojnë ajete të cilat ftojnë njeriun që për fuqinë e Allahut të argumentojnë me fakte kozmologjike, disa prej të cilave ndryshojnë vazhdimisht dhe kërkojnë meditim dhe hulumtim. Allahu thotë: ﴿أَلَمْ تَرَ إِلَىٰ رَبِّكَ كَيْفَ ۖ مَدَّ الظِّلَّ وَلَوْ شَاءَ لَجَعَلَهُ سَاكِنًا ثُمَّ جَعَلْنَا الشَّمْسَ عَلَيْهِ دَلِيلًا﴾ “A nuk e sheh se si Zoti yt e zgjati (andej e kënde) hijen, e sikur të kishte dashur do ta linte në një vend, pastaj diellin e bëme rrëfytes të saj”. [El-Furkan: 45]. Forma pyetëse këtu është e përshtatshme për gjitha shtresat e dëgjuesve: për të pakujdesurin me qëllim që të mendon, për mohuesin, për të suksesshmin... në këtë ajet, ka mësim që mund ta kuptojnë mendjet e njerëzve pa marrë parasysht aftësitë e tyre”.<sup>297</sup>

Në këtë ajet ﴿كَيْفَ مَدَّ الظِّلَّ﴾ “se si Zoti yt e zgjati hijen” ka përkujtim për domosdoshmërinë e të mësuarit nga dukuritë kozmologjike dhe përdorimin e tyre në atë për çka janë krijuar. Çështja nuk përfundon vetëm të ndalesh dhe të meditosh në fuqinë e Allahut, por ajo kalon edhe në çështje tjera të shumta në rrafshin e shkencave natyrore. Ibn Ashuri ka bërë përpjekje për të sqaruar disa nga këto shkenca. Ai ka thënë: “Në ekzistimin e hijes ka çështje të imta që flasin për gjendjen e sistemit diellor. Hija është një pjesë e errësirës që vije si rezultat e qëndrimit të ndonjë sendi mes diellit dhe vendit ku bien rrezet. Kështu në vend bëhet hije sipas madhësisë së objektit. Ky dallim në sipërfaqen e hijes është shprehur në ajet me fjalën “el-medu- zgjatje”. Të gjitha këto janë argumente të shumta rreth urtësive të formimit hyjnorë dhe fuqisë së madhe. Kjo zgjatje e hijes rritet apo zvogëlohet sipas afërsisë apo largimit të gjësëndit nga rrezet. Sa më afër të jetë gjësëndi nga rrezet, hija është më e madhe dhe sa më larg të jetë gjësëndi nga rrezet, hija është më e vogël. Vazhdon kështu derisa gjësëndi të vendoset mbi diçka dhe në këtë rast rrezet bien vetëm mbi të, kështu që hija humbet pothuaj plotësisht. Kjo është për qëllim në fjalën e Allahut: ﴿وَلَوْ شَاءَ لَجَعَلَهُ سَاكِنًا﴾ “e

<sup>297</sup> Vepër e cituar, vëll. 19, fq. 39-43.



*sikur të kishte dashur do ta linte në një vend”, sikur të donte Allahu do ta bënte tokën të palëvizshme përballë rrezeve të diellit, në këtë gjendje, nuk do të ndryshonte madhësia e hijes së gjësendeve mbi tokë, ku hija do të mbetet në një gjendje dhe kështu do të humbnin shumë dobi. Fjala “delil” nënkupton udhëzues drejt rrugës. Sikur personi që njih vendin informon udhëtarin se në cilën pjesë të rrugës gjendet, po ashtu dielli kur shkakton hijen në forma të caktuara e informon personin për kohën e veprave për të realizuar ato. Zgjatja dhe tkurrja e hijes mundëson njohjen e kohëve të namazit dhe veprave të njerëzve. Po ashtu mundëson përfitimin nga ngrohja e rrezeve të diellit për të gjithë njëjtë. Pas gjithë kësaj ka një përfitim shumë të madh shkencor, të cilën e sqarojnë rregullat e sistemit diellor, lëvizja e tokës përreth diellit, shfaqja e dritës dhe errësirës. Hija është gjurmë e errësirës, ndërsa errësira është esenca e formimit të kozmosit, ku më pas ka shpërthyer drita me anë të diellit. Nga ndërrimi i errësirës dhe dritës janë formuar nata dhe dita, ku si rezultat i tyre janë formuar sistemi i stinëve vjetore dhe ekuatorit, dhe në bazë të saj dihen vendet e ngrohta dhe ato të ftohta”.<sup>298</sup>*

Shfrytëzimi i diturisë dhe njohurisë arrihet duke i ditur gjërat e dobishme dhe ato të dëmshme. Allahu ka qortuar disa njerëz që kanë mësuar atë që u sjell dëm e jo dobi.

﴿وَاتَّبِعُوا مَا نَزَّلْنَا عَلَى الْمَلَكَيْنِ بِبَابِلَ هَارُوتَ وَمَارُوتَ وَمَا يُعَلِّمَانِ مِنْ أَحَدٍ حَتَّى يَقُولَا إِنَّمَا نَحْنُ فِتْنَةٌ فَلَا تَكْفُرْ فَيَتَعَلَّمُونَ مِنْهُمَا مَا يُفَرِّقُونَ بِهِ بَيْنَ الْمَرْءِ وَزَوْجِهِ وَمَا هُمْ بِضَارِّينَ بِهِ مِنْ أَحَدٍ إِلَّا بِإِذْنِ اللَّهِ وَيَتَعَلَّمُونَ مَا يَضُرُّهُمْ وَلَا يَنْفَعُهُمْ وَلَقَدْ عَلِمُوا لَمَنِ اشْتَرَاهُ مَا لَهُ فِي الْآخِرَةِ مِنْ خَلَقٍ وَلَبِئْسَ مَا شَرَوْا بِهِ أَنْفُسَهُمْ لَوْ كَانُوا يَعْلَمُونَ﴾

*“(E hodhën librin e Zotit) E ndoqën atë që e thonin djajt në kohën e sundimit të Sulejmanit. Po Sulejmani nuk ishte i pafé, djajtë ishin të pafé, sepse u mësonin njerëzve magjinë. (ndoqën) Edhe çka u zbriti në Babil dy engjëjve, Harutit dhe Marutit. E ata të dy nuk i mësonin askujt (magjinë) para se t’i thonin: “Ne jemi vetëm sprovë, pra mos u bën i pa fé!” E, mësonin (njerëzit) prej atyre dyve atë (magji) me çka ndanin burrin prej gruas së vet, por pa lejen e Allahut me atë askujt nuk mund t’i bënin dëm dhe ashtu*

<sup>298</sup> Vepër e cituar, vëll. 19, fq. 40-43.

*mësonin çka u sillte dëm e nuk u sillte dobi atyre. E ata (jehuditë) e kanë ditur se ai që (hodhi librin) e zgjodhi atë (magjinë), ai në botën tjetër nuk ka ndonjë të drejtë (në mëshirën e Zotit). Po ta dinin, ata se për çka e shitën vetveten, ajo është shumë e keqe.” [El-Bekare: 102]*

Kur’ani dëshiron që besimtari të jetë gjithnjë në gjendje të përfiton dobi, qoftë për këtë botë apo për ahiret. Për këtë, Allahu ka ndaluar të qëndrohet në vendet ku përgatiten komplete dhe tradhti.

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا تَنَاجَيْتُمْ فَلَا تَنَاجَوْا بِالْإِيمِ وَالْعُدْوَانِ وَمَعْصِيَتِ الرَّسُولِ وَتَنَاجَوْا بِالْبِرِّ وَالتَّقْوَىٰ وَاتَّقُوا اللَّهَ الَّذِي إِلَيْهِ تُحْشَرُونَ﴾

*“O ju që keni besuar, kur bisedoni mes vete fshehurazi, mos bisedoni për çka është mëkat, armiqësi dhe kundërshti ndaj pejgamberit, por bisedoni për punë të ndershme e të matura dhe kini frikën Allahut, tek i cili do të tuboheni.” [El-Muxhadele: 9].*

Po ashtu ka ndaluar të ulet në ato vende ku bëhet kufër dhe tallje me fenë dhe besimin.

﴿وَقَدْ نَزَّلَ عَلَيْكُمْ فِي الْكِتَابِ أَنْ إِذَا سَمِعْتُمْ آيَاتَ اللَّهِ يُكْفَرُ بِهَا وَيُسْتَهْزَأُ بِهَا فَلَا تَفْعَدُوا مَعَهُمْ حَتَّىٰ يَخُوضُوا فِي حَدِيثٍ غَيْرِهِ إِنَّكُمْ إِذَا مَنَّ اللَّهُ إِنَّ اللَّهَ جَامِعُ الْمُنَافِقِينَ وَالْكَافِرِينَ فِي جَهَنَّمَ جَمِيعًا﴾

*“Juve u është shpallur në librin (Kur’anin) që, kur të dëgjoni se po mohohet Kur’ani i Allahut dhe po bëhet tallje me të, mos rrini me ata derisa të mos hyjnë në bisedë tjetër. Përndryshe, ju do të jeni si ata. Allahu do t’i tubojë tradhtarët dhe jobesimtarët që të gjithë në xhehenem.” [En-Nisa’: 140]*

## Pjesa e dytë: Suneti pejgamberik, burim i mendimit pedagogjik

Sipas dijetarëve të hadithit, sunet llogariten fjalët, veprat, informacionet dhe vetitë fizike dhe morale të Muhammedit alejh'is-salam. Sipas këtij definicioni, disa koleksione të hadithit janë titulluar me emrin sunen (shumësi i sunet) si p.sh.: Sunen en Nisai, Sunen Ebi Davud, Sunen et Tirmidhi, Sunen Ibni Maxheh etj.

Suneti sipas fukahave (juristëve), usulistëve dhe thirrësve është atë që e kanë përzgjedhur për qëllimet dhe interesimet e tyre. Usulistëve -për shembull- ju intereson çështja e buri-meve të legjislacionit. Kështu, suneti sipas tyre përfshin hadithet të cilat mund të përdoren si argument për dispozitat sheri-atike, ngase këto hadithe sqarojnë mënyrën se si e ka kuptuar Muhammedi alejh'is-salam fenë dhe mënyrën se si e ka këshilluar ai popullin e vet për të vepruar sipas këtyre vlerave. Sipas fukahave, suneti është njëri prej pesë dispozitave të shariatit: farz (vaxhib), sunet, mubah, mekruh dhe haram. Në disa kontekste, sunet është e kundërta e bidatit (rasisë-sajesës), andaj sunet është ajo që është në përputhshmëri me sheriatin, ndërsa bidat është ajo që bie ndesh me te.

Ne -në kontekstin e këtij kapitulli- me fjalën sunet kemi për qëllim argumentimi i transmetimeve të sakta nga Muhammedi alejh'is-salam që kanë përfshirë këshillime që ndërli-dhen me edukatën dhe arsimin.

Çështja e pedagogjisë dhe mendimit pedagogjik në sune-tin pejgamberik është përfshirë me të madhe në trashëgiminë islame, librat dhe hulumtimet bashkëkohore. Vërejmë se termet "ilm-dituri, shkencë", "teal-lum-mësimnxënie" dhe "ta'lim-mësimdhënie" kanë dominuar në titujt e këtyre vep-rave. Shumë prej haditheve pejgamberike janë klasifikuar nën tituj të shumtë të cilët kanë derivuar nga këto tre terme.

## 1. Prezenca e sunetit në çështjet pedagogjike në trashëgimi dhe shkrimet bashkëkohore:

Çështja e diturisë, mësimnxënies dhe mësimdhënies në sunetin pejgamberik është një temë e gjerë. Kur u klasifikuan hadithet në koleksionet e librave të hadithit sipas tematikave në libra dhe kapituj, vërejmë se “Kitab’ul-ilm” (Libri ose kapitulli mbi diturinë) është llogaritur si kapitull më i rëndësishëm në shumicën e librave të hadithit. Kështu, në librin “Sahih’ul-Buhari”, pozita e kapitullit të diturisë ishte e treta e radhitur, pas kapitullit të vahjit (shpalljes) dhe kapitullit të imanit (besimit). Në kapitullin e ilmit (diturisë) janë theksuar më shumë se njëqind hadithe. Në “Sahih’ul-Buhari” mund të hasim në qindra hadithe tjera që ndërlidhen me diturinë, mësimnxënien dhe mësimdhënien, mirëpo autori i ka theksuar në kapituj tjerë për shkak të lidhshmërisë me tematika tjera. Është e njohur se një hadith pejgamberik mund të ndërlidhet me shumë tematika dhe mund të përdoret si argument për më shumë se një dispozitë.

Prej këtyre haditheve potencojmë hadithin që ka transmetuar Buhariu dhe Muslimi nga Hudhejfe ibn Jemani radijallahu anhu se ka thënë: “Ishim me Muhammedin alejh’is-selam, i cili tha: “Numëroni se sa njerëz shqiptojnë Islamin”. Sipas transmetimit të Buhariut: “Shkruani se kush shqipton Islamin prej njerëzve”. Nuk ka dyshim se shkrimi, numërimi dhe regjistrimi janë mjete të diturisë dhe arsimit. Për këtë, ka mundësi që ky hadith të klasifikohet në kapitullin e ilmit. Megjithatë, Imam Buhariu dhe Imam Muslimi e kanë regjistruar në vende tjera. Hadithi është shumë i rëndësishëm në sigurimin e të dhënave dhe regjistrimeve statistikore të resurseve njerëzore në shoqëri, të cilat mund të shfrytëzohen për qëllime të ndryshme, në mesin e të cilave -për shembull- përcaktimi i numrit të atyre të cilët kanë mundësi të marrin pjesë në xhihad-luftë. Për këtë, imam Buhariu, këtë hadith e ka klasifikuar në kapitullin e xhihadit.<sup>299</sup> Shkak tjetër është

<sup>299</sup> El-Buhari, Sahih’ul-Buhari, vepër e cituar, kapitulli: El-Xhihadu ve’s-sijer, hadithi nr. 3060, fq. 586.

edhe kontrollimi i përparimit dhe rritjes së numrit të muslimanëve për të rritur ndjenjën e vetëbesimit dhe sigurisë. Për këtë, të njëjtin hadith, imam Muslimi e ka klasifikuar në kapitullin e imanit”.<sup>300</sup>

Edhe në librat e hadithit, në të cilat autorët nuk kanë veçuar kapitull të veçantë për diturinë si p.sh. “Es-Sunen’ul-kubra” të Bejhekiut, vërejmë se aty ka dhjetëra hadithe, të cilat ndërlidhen me diturinë dhe arsimimin, të cilat Bejhekiu i ka klasifikuar në kuadër të kapitujve të ndryshëm. Kështu hadithi i shpagimit të robërve në luftën e Bedrit me të mësuarit e fëmijëve të muslimanëve shkrim-leximin është klasifikuar në kuadër të kapitullit të plaçkës së luftës.<sup>301</sup> Hadithi që flet se Muhammedi alejh’is-selam ka përdorur vijat për të mësuar tjerët ndonjë ide ose për ta sqaruar një ide është përfshirë në kapitullin e xhenazeve.<sup>302</sup> Hadithi: “Nuk lejohet xhelozia përpos në dy raste.... një njeriut të cilit Allahu i ka dhënë urtësi dhe ai gjykon me te dhe atë ua mëson të tjerëve” është përfshirë të kapitulli: rregullat e gjykatësit.<sup>303</sup> Hadithi: “Kur vdes biri i Ademit, ndërpritën veprat e tij në përjashtim të tri rasteve: sadakaja rrjedhëse, dituria që është e dobishme dhe fëmija i drejtë që lutet për të” është përfshirë në kapitullin e vasije-teve (porosive)”<sup>304</sup> etj.

Disa libra të trashëgimisë janë marrë enkas me grumbullimin e haditheve pejgamberike dhe fjalët e sahabëve dhe tabi’inëve të cilat kanë lidhshmëri të drejtpërdrejtë me diturinë dhe arsimin. Prej këtyre librave kemi librin e Hafidh Ibn Abdalberr të titulluar “Xhamiu bejan’il-ilmu ve fadlihi”. Po ashtu Hatib Bagdadi në disa prej librave të tij, si p.sh. libri “Er-Rihletu fi taleb’il-ilmu”, dhe libri “El-Xhamiu li ahlak’ir-Ravi ve adab’us-sami’”. Sem’ani në librin “Edeb’ul-implai ve’l-istimlai”. Ibn Xhemaah në librin “Tedhkiret’us-sami’i ve’l-mutekel-limu fi adab’il-alimu ve’l muteal-limu”. Almevi në

<sup>300</sup> Muslim, Sahihu Muslim, vepër e cituar, kapitulli: El-Iman, hadithi nr. 149, fq. 83.

<sup>301</sup> Ebu Bekr Ahmed ibn El-Husejn El-Bejheki (v. 458 h./1066). Es-Sunen’ul-kubra, Bejrut: Darul kutubil ilmijeti, 1424 h./2003, hadithi nr. 12847, fq. 523.

<sup>302</sup> Po aty, hadithi nr. 6505, vëll. 3, fq. 514.

<sup>303</sup> Po aty, hadithi nr. 20163, vëll. 10, fq. 150.

<sup>304</sup> Po aty, hadithi nr. 12635, vëll. 6, fq. 456.

librin “Adab’ul-ulemai ve’l-muteal-limine”. Shevkani në librin “Edeb’ut-talebi ve munteha’l-erebi” dhe shumë të tjerë. Në kohë ku libra tjerë në brendinë e tyre kanë përfshirë një hapësirë të madhe të haditheve të cilat kanë lidhshmëri me diturinë, siç ka bërë Ebu Hamid Gazaliu në librin “Ihju ulum’id-dini”.<sup>305</sup>

Shumë prej autorëve të rinj janë interesuar rreth prezencës së diturisë, arsimit dhe edukatës në hadithet pejgamberike, për të cilat edhe kanë shkruar libra të dobishme. Disa prej këtyre librave kanë përfshirë vetëm një çështje arsimore, si p.sh.: vlerat,<sup>306</sup> ose metodat,<sup>307</sup> ose format.<sup>308</sup> Gjithashtu, edhe çështja e mrekullisë në sunetin pejgamberik ishte prezente.<sup>309</sup> Personat të cilat jetojnë në rrethana ku dominon shpirti i xhihadit, kanë hulumtuar rreth edukatës luftarake në sunetin pejgamberik.<sup>310</sup> Disa libra kanë përfshirë bazamentet e edukimit në sunetin pejgamberik, i cili kryesisht është libër rreth edukimit dhe arsimit,<sup>311</sup> ose kanë përfshirë çështje të diturisë dhe arsimit në jetën e Muhammedit alejh’is-selam.<sup>312</sup>

## 2. Argumentimi i sunetit pejgamberik në edukatë dhe arsim

Rreth çështjes së argumentimit të sunetit pejgamberik ka pasur shumë polemika. Rreth saj janë dhënë mendime të

<sup>305</sup> Autori i këtij libri ka bërë përpjekje të grumbullon librat e trashëgimisë islame, të cilat kanë qenë të veçanta për diturinë, arsimin dhe edukatën, ose kanë përfshirë kapituj ose pjesë me peshë rreth kësaj tematike. Numri i librave të cilat ka arritur autori t’i grumbullon ka arritur në 108 libra. Lexo: Fet’hi Melkave, *Et-Turath’ut-terbevijj’ul-islamijju: haletul bahthi fihi, ve lemehatun min tetavvurihi, ve kutufun min nususihi ve medarisih*, vepër e cituar, fq. 554-602.

<sup>306</sup> Mehdi Rizkullah Ahmed, & Shedi Adil ibn Ali, *El-Kijem’ul-islamijjetu fi siretin nebevijeh*, Xhamiat’ul-Meliki Saud, bot. 1, Riad, 2012.

<sup>307</sup> Ebu Gudeh, Abdulfetah. *Er-Resul’ul-mual-limu ve esalibuhu fi’t-ta’limi*, Mekteb’ul-metbuat’il-islamijeh, bot. 1, Haleb, 1992.

<sup>308</sup> Ahmed Fuad Aljan, *Turuk’ut-ta’lim’it-terbevijjeti fi sunetin nebevijeh*, Darul muslimi lin neshri vet zevii, Riad, 2000.

<sup>309</sup> Mustafa Rexheb, *El-Xhaz’ut-terbevijju fi sunetin nebevijeh*, Kefershejh: Darul ilmi vel imani lin neshri vet zevii, 2008.

<sup>310</sup> Ahmed Dajfullah Omer Ebu Semhedane, *Melamih’ut-terbijjet’il-xhihadijjeti fi sunetin nebevijjeti ve tatbika-tuha et-terbevijeh*, Temë e magistraturës në Degën e Usul’ut-terbijeh, Universiteti Islamik në Gaza, 2010.

<sup>311</sup> Abdulhamid Es-Sajd Ez-Zintani, *Usus’ut-terbijjet’il-islamijjeti fi sunetin nebevijeh*, Ed-Dar’ul-arabijjetu li’l-kitabi, bot. 2, Tripoli, Libi, 1993.

<sup>312</sup> Jusuf El-Karadavi, *Er-Resulu ve’l-ilmu, Dar’us-sahveti*, Kajro, 2001.

ndryshme. Disa prej tyre mendonin se suneti është aq i rëndësishëm saqë edhe më i vlefshëm se Kur'ani, ndërsa disa të tjerë mendonin se nuk ka nevojë për te dhe se mjafton Kur'ani. Polemikat kanë përfshirë edhe vërtetësinë e ndarjes së sunetit në suneti legjislativ dhe suneti jolegislativ. Po ashtu edhe ndarja e veprimeve të Muhammedit alejh'is-salam në disa lloje: veprime sipas shpalljes, veprime në fetva, veprime në gjykim, veprime në udhëheqjen e shtetit etj.

Ajo që na intereson këtu është dy çështje. E para: vërtetimi se Kur'ani ka gjykuar në mënyrë të qartë dhe të prerë rreth argumentimit të sunetit. Megjithatë, vetë Muhammedi alejh'is-salam ka treguar se ku duhet nënshtrim absolut. E dyta: aty ku muslimanëve u ka dhënë hapësirë për të shprehur mendimin dhe për të shfrytëzuar përvojën e tyre. Në çështjet e bujqësisë, sunet është domosdoshmëria e sigurimit të përvojës bujqësore të specializuar. Në çështjet e luftës sunet është konsultimi dhe zbatimi i mendimit që është më afër së të vërtetës. Kështu në luftën e Bedrit, para se të fillon lufta, Muhammedi alejh'is-salam u konsultua me sahabët rreth përballimit me kurejshët. Ai insistonte për të marrë mendim duke e përsëritur thënien: “jepni mendim o njerëz”, derisa e kuptuan ata të cilët i kishte për qëllim me këtë fjalë dhe i dhanë mendim se duhet përgatitur për luftë. Po ashtu pranoi propozimin e një sahabiut rreth zgjedhjes së vendit dhe pozicionit të duhur në mejdanin e luftës. Pas luftës, u konsultua rreth plaçkës së luftës dhe robërve, rreth së cilës kishte mendime të ndryshme dhe u përcaktua për njërin prej këtyre mendimeve. Suneti që duhet zbatuar në këto tri raste është zbatimi i parimit të konsultimit dhe hulumtimi i përvojës më të mirë në çdo rast.<sup>313</sup>

Kur'ani Famëlartë është referenca për vërtetimin e argumentimit të sunetit peygamberik në edukim dhe arsimim, si

<sup>313</sup> Polemikat rreth argumentimit të sunetit lexoi në:

Muhamed Selim El-Ava, *Es-Sunnet'ut-teshri'ijetu ve gajr'ut-teshri'ijeh*, Mexhel-let'ul-muslim'il-muasir, 1974, fq. 29-49.

Jusuf El-Karadavi, *El-Xhanib'ut-teshri'ijju fi sunetin nebevijeh*, Mexhel-letu merkezi's-sunnet'in- nebevijeh, nr. 3, 1408 h./1988, fq. 17-105.

Abdulgani Abdulhalik, *Huxhxhijet'us-sunneh*, El-Ma'had el-alemi li'l-fikr'il-islami & Dar'ul-Vefa, Hernden & Kajro, 1407 h./1987.

dhe në të gjitha tematikat dhe çështjet tjera në jetën e muslimanit. Kur'ani, në shumë ajete, në forma të ndryshme, krahas bindjes ndaj Allahut ka theksuar edhe bindjen ndaj të Dërguarit të tij, Muhammedit alejh'is-selam. Prej këtyre ajeteve theksojmë:

﴿وَأَطِيعُوا اللَّهَ وَالرَّسُولَ لَعَلَّكُمْ تُرْحَمُونَ﴾ “E bindjuni Allahut dhe të dërguarit, ashtu që të mëshiroheni” [Alu Imran: 132]

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا أَطِيعُوا اللَّهَ وَرَسُولَهُ﴾ “O ju që besuat, respektojeni Allahun dhe të dërguarin e Tij” [El Enfal: 20]

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا أَطِيعُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا الرَّسُولَ﴾ “O ju që besuat, bindjuni Allahut, respektoni të dërguarin” [En Nisa': 59]

﴿مَنْ يَطِيعِ الرَّسُولَ فَقَدْ أَطَاعَ اللَّهَ﴾ “Kush i bindet Pejgamberit, ai i është bindur Allahut” [En Nisa': 80]

﴿قُلْ أَطِيعُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا الرَّسُولَ فَإِن تَوَلَّوْا فَإِنَّمَا عَلَيْهِ مَا حُمِّلَ وَعَلَيْكُمْ مَا حُمِّلْتُمْ وَإِن تُطِيعُوهُ﴾  
﴿تَهْتَدُوا وَمَا عَلَى الرَّسُولِ إِلَّا الْبَلَاغُ الْمُبِينُ﴾ “Thuaj: “Respektojeni Allahun dhe respektojeni të dërguarin!” Nëse ata refuzojnë, atëherë atij i takon përgjegjësia me çka është i ngarkuar ndërsa juve përgjegjësia me çka jeni të ngarkuar, nëse i bindeni atij, atëherë keni gjetur të vërtetën. I dërguari ka obligim vetëm komunitimit e qartë” [En Nur: 54]

﴿وَأَقِيمُوا الصَّلَاةَ وَآتُوا الزَّكَاةَ وَأَطِيعُوا الرَّسُولَ لَعَلَّكُمْ تُرْحَمُونَ﴾ “Falni rregullisht namazin, jepni zeqatin dhe respektoni të dërguarin në mënyrë që të mëshiroheni” [En Nur: 56]

Kur'ani potencon se atë që e flet Muhammedi alejh'is-selam është shpallje nga ana e Allahut. Nuk ka mospajtime se Kur'ani është shpallje nga ana e Allahut drejtuar Muhammedit alejh'is-selam, por ka shpallje që nuk është në Kur'an, ku përfshihen sqarime të dispozitave dhe këshillave që gjenden në Kur'an. Po ashtu, Kur'ani ka theksuar domosdoshmërinë e pasimit të Muhammedit alejh'is-selam në çdo gjë që këshillon apo gjykon.. Allahu ka thënë:

﴿قُلْ إِنْ كُنْتُمْ تُحِبُّونَ اللَّهَ فَاتَّبِعُونِي يُحْبِبْكُمُ اللَّهُ وَيَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ وَاللَّهُ غَفُورٌ رَّحِيمٌ﴾  
“Thuaj: “Nëse e doni Allahun, atëherë ejani pas meje që Allahu t'ju dojë, t'ju falë mëkatet tuaja, se Allahu është që fal shumë, mëshiron shumë” [Alu Imran: 31]



﴿فَلَا وَرَبِّكَ لَا يُؤْمِنُونَ حَتَّىٰ يُحَكِّمُوكَ فِيمَا شَجَرَ بَيْنَهُمْ ثُمَّ لَا يَجِدُوا فِي أَنفُسِهِمْ حَرَجًا مِّمَّا قَضَيْتَ﴾  
 “Për Zotin tënd jo, ata nuk janë besimtarë (të asaj që të zbriti ty as të asaj para teje) derisa të mos zgjedhin ty për të gjykuar në atë konflikt mes tyre, e pastaj (pas gjykimit tënd) të mos ndiejnë pakënaqësi nga gjykimi yt dhe (derisa) të mos binden sinqerisht” [En Nisa’: 65]

﴿وَمَا آتَاكُمُ الرَّسُولُ فَخُذُوهُ وَمَا نَهَاكُمُ عَنْهُ فَانْتَهُوا وَاتَّقُوا اللَّهَ إِنَّ اللَّهَ شَدِيدُ الْعِقَابِ﴾  
 “Çka t’ju japë Pejgamberi, atë merreni, e çka t’ju ndalojë, përmbahuni dhe kini frikë Allahun, se Allahu është ndëshkues i ashpër” [El Hashr: 7]

﴿فَلْيَخْذِرِ الَّذِينَ يَخَالِفُونَ عَنْ أَمْرِهِ أَنْ تُصِيبَهُمْ فِتْنَةٌ أَوْ يُصِيبَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ﴾  
 “le të ruhen ata që kundërshtojnë rrugën e tij (të të dërguarit) se ata do t’i zëndonjë telashe, ose do t’i godasë dënimi i idhët” [En Nur: 63]

Arsimimi i Muhammedit alejh’is-selam nuk përfshin vetëm arsimimin e besimtarëve që ishin përreth tij, por është i vazhdueshëm dhe përfshin gjithë besimtarët musliman që vijnë pas, pa marrë parasysh vendin dhe kohën. Kur bëhet fjalë për arsimimin e besimtarëve, ajeti kur’anor ka ardhur në formën e kohës së tashme ﴿يَتْلُو عَلَيْكُمْ آيَاتِنَا وَيُزَكِّيكُمْ وَيُعَلِّمُكُمُ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ﴾  
 “t’u lexojë ajetet Tona, t’ju pastrojë, e t’ju mësojë librin dhe traditën, e edhe t’ju mësojë atë që nuk e dinit” [El-Bekare: 151]. Ebu Hajani në librin e tij “Tefsirul behril muhiti” duke komentuar ajetin kur’anor ﴿يَتْلُو عَلَيْكُمْ آيَاتِنَا وَيُزَكِّيكُمْ وَيُعَلِّمُكُمُ﴾  
 “t’u lexojë ajetet Tona, t’ju pastrojë, e t’ju mësojë” ka thënë: foljet kanë ardhur në kohën e tashme që të jep kuptimin e vazhdimësisë dhe ripërtëritjes, ngase leximi, edukimi shpirtëror dhe arsimimi ripërtërihen në vazhdimësi”.<sup>314</sup> Arsimimi i vërtetë që le gjurmë në psikën e nxënësit ka nevojë për përsëritje të shumtë. Siç potencohet në librin “el Mufredat” të Ragib el Esfehaneit ku thuhet: “E’lamehu dhe al-lemehu – e mësoi atë në esencë janë një, me dallim se forma e’leme non-kupton informacionin e marrë në mënyrë të shpejtë, ndërsa al-leme është i veçantë për arsimimin që merret me përsëritje të shumta derisa të le gjurmë në psikën e nxënësit”.<sup>315</sup>

<sup>314</sup> Ebu Hajjan El-Endelusi, *Tefsir’ul-bahril muhit*, vepër e cituar, vëll. 1, fq. 618.

<sup>315</sup> Ragib Isfahani, *El-Mufredatu fi garib’il-Kur’ani*, vepër e cituar, fq. 446.

Në vetë sunetin e Muhammedit alejh'is-selam ka shumë hadithe që flasin për argumentshmërinë e këshillave të Muhammedit alejh'is-selam. Në Sunenin e Ebu Davudit transmetohet thënia e Muhammedit alejh'is-selam: “Më është dhënë mua libri dhe diç ngjashëm me të. Të mos ulet dikush në kolltukun e tij dhe të thotë: kapuni për Kur'anin, çka të gjeni në te hallall, llogariteni për hallall dhe çka të gjeni në te haram, llogariteni për haram. Nuk është hallall për ju mishi i gomarëve shtëpiak, as mishi i kafshëve që kanë dhëmbët e syrit të mëdhenj ...”.<sup>316</sup>

Ekzistojnë të dhëna në sunet që flasin për shpejtimin e sahabëve në marrjen dhe praktikimin e këshillave të Muhammedit alejh'is-selam. Në disa raste kanë kërkuar edhe sqarime rreth disa çështjeve. Kështu, gjatë çlirimit të Hajberit, sahabët i goditi uria. Ata filluan të therin gomarët shtëpiak të cilët i kishin gjetur jashtë fortifikatave të Hajberit me qëllim që t'i hanë, mirëpo Muhammedi alejh'is-selam i ndaloi dhe ata hoqën dorë. Në lidhje me këtë çështje, Imam Buhariu transmeton nga Selemete ibn Ekva' ku thuhet: “Kur arriti mbrëmja e ditës së çlirimit, ndezën zjarre të shumta. Atëherë, Muhammedi alejh'is-selam tha: Ç'janë këto zjarre? Çka po zini me to? Thanë: Mish. Tha: çfarë mishi? Thanë: mish të gomarëve të butë (shtëpiak). Ai tha: derdhni ato dhe thyeni. Një njeri tha: O i Dërguari i Allahut, a mund t'i derdhim dhe t'i lajmë enët? Tha: po, kështu.<sup>317</sup> Në një transmetim tjetër: thanë: a t'i derdhim enët dhe t'i lajmë? Tha: Lajini”.<sup>318</sup> Kështu, heqja dorë nga të thyerit dhe pranimi që t'i lajnë enët ishte ose shpallje ose ixhtihad (vendim) nga vetë Muhammedi alejh'is-selam.

Muhammedi alejh'is-selam urdhëron dhe ndalon me anë të shpalljes. Atë që ai e ka bërë haram, ajo është haram. Është vërtetuar ndalimi i konsumimit të mishit të gomarëve shtëpiakë me hadithe mutevatire në dy sahihat (Buhari dhe Muslim) dhe koleksione tjera.

<sup>316</sup> Sulejman ibn El-Esh'ath Es-Sixhistani Ebu Davud, (v. 275 h./888), *Sunenu Ebi Davud*, Bejt'ul-efkar'id-devlijeh, bot. 1, hadithi nr. 4604, Riad, 1999, fq. 503.

<sup>317</sup> El-Buhari, *Sahih'ul-Buhari*, vepër e cituar, hadithi nr. 4196, fq. 796.

<sup>318</sup> Po aty, hadithi nr. 2477, fq. 468.

Në një hadith të transmetuar nga Ebu Davudi se sahabët e pyetnin Muhammedin alejh'is-selam rreth pastërtisë, ndërsa ai iu përgjigjej. Mes tjerash, ai ka thënë: “Unë për ju jam në pozitën e prindit, u mësoj juve”.<sup>319</sup>

Më parë gjatë këtij kapitulli potencuam disa ajete kur'anore që flasin rreth Muhammedit alejh'is-selam në cilësinë e mësuesit dhe për disa cilësi të mësimdhënies. Këtu potencojmë se sahabët radijellahu anhum kanë vërejtur këto cilësi dhe kanë vlerësuar se nuk kanë parë mësues më të mirë se Muhammedi alejh'is-selam, e as mësimdhënie më të mirë se mësimdhënia e tij. Muhammedi alejh'is-selam është dërguar për Pejgamberin në mesin e popullit të tij, të cilët e dinin moralin dhe besnikërinë e tij. Ai u fliste në gjuhën e tyre dhe ua sqaronte mësimet islame. ﴿وَمَا أَرْسَلْنَا مِنْ رَّسُولٍ إِلَّا بِلِسَانِ قَوْمِهِ لِيُبَيِّنَ لَهُمْ﴾ “Ne asnjë nga të dërguarit nuk e dërguam ndryshe vetëm në gjuhën e popullit të vet, ashtu që ai t’u shpjegojë atyre (në atë gjuhë)”. [Ibrahim: 4], pasi që ky i Dërguar ishte njëri nga mesi i tyre, u fliste me gjuhën që e kuptonin, në këtë mënyrë detyra e tij ishte më e lehtë për të përcjellë mesazhet dhe për të ndikuar tek ata. Kështu, ata e deshën dhe e morën për model dhe shëmbëlltyrë për jetën e tyre. Për këtë, ai ishte mësues dhe edukator, bile ishte mësuesi dhe edukatori më i mirë që mund ta imagjinon njerëzia. Natyrisht, në këtë kontekst, ne nuk harrojmë se Allahu e ka përgatitur këtë Pejgamber të jetë me këtë moral dhe këto cilësi, dhe se mesazhi i tij është mesazh i drejtë dhe i mëshirshëm që nxjerr njerëzit nga errësirat e injorancës, politeizmit, padrejtësisë dhe shtypjes.

Në lidhje me këtë, imam Muslimi në Sahihun e tij nga Muavije ibn el Hakem es Sulemi ka thënë: Derisa isha duke u falë me Muhammedin alejh'is-selam, një njeri teshtiu. Unë thash: Jerhamukellahu (Allahu të mëshiroftë). Njerëzit filluan të më shikojnë. Thash: ç’keni, çka më shikoni? Filluan me duart e tyre t’ju bien kofshëve. Kur vërejta se ata dëshirojnë t’më heshtin, unë heshta. Pasi përfundoi Muhammedi alejh'is-selam nga namazi, as nuk më ofendoi, as nuk më qortoi e as nuk më shau. Ai tha: Gjatë namazit nuk lejohet të

<sup>319</sup> Ebu Davud, Sunenu Ebi Davud, vepër e cituar, hadithit nr. 8, fq. 25.

fliten fjalë të rëndomta. “Në namaz ka tesbih, tekbir dhe lexim të Kur’anit”. Nuk kam parë mësues para tij e as pas tij që mëson më mirë se ai.<sup>320</sup>

Allahu e ka përzgjedhur Muhammedin alejh’is-selam që të jetë bartës i mesazhit të Tij të fundit për mbarë njerëzinë. Ai ka morë përsipër përgatitjen e tij për të përcjellë mesazhin dhe për të bartur vështirësitë dhe detyrat. ﴿اللَّهُ أَعْلَمُ حَيْثُ يَجْعَلُ﴾  
 ﴿رَسُولَهُ﴾ “Më së miri Allahu e di ku ta vërë dërgesën (risalen) e vet”. [El En’am: 124] Atij iu bë i dashur meditimi dhe adhurimi larg syve të njerëzve. Ai me natyrën e tij të pastër iu largua besimeve, devijimeve dhe praktikimeve të periudhës së injorancës. Kështu, ai para shpalljes, në mesin e njerëzve ishte i njohur si “i singerti besnik”. Më pas erdhi periudha e peygamberisë. Në këtë periudhë, Allahu e mësonte dhe e orientonte me anë të shpalljes dhe me mësimet që ia jepte besniku i shpalljes Xhibrili alejh’is-selam. Andaj, Kur’ani është i shpallur nga ana e Allahut. ﴿وَالَّذِينَ آتَيْنَاهُمُ الْكِتَابَ يَلْعَمُونَ أَنَّهُ مُنَزَّلٌ﴾  
 ﴿مِن رَّبِّكَ بِالْحَقِّ﴾ “Atyre që u dhamë librin e dinë se ai (Kur’ani) është i zbritur prej Zotit tënd saktësisht” [El En’am: 114] Atë e ka zbritur shpirti i shenjtë Xhibrili prej Allahut në zemrën e Muhammedit alejh’is-selam. ﴿قُلْ نَزَّلَهُ رُوحُ الْقُدُسِ مِن رَّبِّكَ بِالْحَقِّ﴾  
 “Thuaj: “Atë (Kur’anin) e solli “Ruhul Kudus” - shpirti i shenjtë - plot vërtetësi nga Zoti yt” [En-Nahl: 102]. ﴿قُلْ مَنْ كَانَ عَدُوًّا لِجِبْرِيلَ فَإِنَّهُ نَزَّلَهُ عَلَيَّ﴾  
 ﴿فَلْيَكُفُّوا عَنِّي﴾ “Thuaj: “Kush është armik i Xhibrilit (është armik i Allahut), e ai me urdhrin e Allahut e zbriti Kur’anin në zemrën tënde”. [El-Bekare: 97]. Xhibrili është tepër i fuqishëm dhe ia ka mësuar Muhammedit alejh’is-selam Kur’anin. ﴿عَلَّمَهُ﴾  
 ﴿شَدِيدُ الْقُوَى﴾ “Atë ia mësoi Ai, fuqiforti, (Xhibrili)” [En Nexhm: 5]. Allahu ia zbriti të Dërguarit të Tij Kur’anin që ajetet e tij t’ua lexon sahabëve dhe t’ua mëson shkencat dhe dispozitat e tij. ﴿كَمَا أَرْسَلْنَا فِيكُمْ رَسُولًا مِّنكُمْ يَتْلُو عَلَيْكُمْ آيَاتِنَا وَيُزَكِّيكُمْ وَيُعَلِّمُكُمُ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ وَيُعَلِّمُكُم مَّا لَمْ تَكُونُوا تَعْلَمُونَ﴾  
 “Ashtu siç dërguam nga gjiu i juaj të dërguar t’u lexojë ajetet Tona, t’ju pastrojë, e t’ju mësojë librin dhe traditën, e edhe t’ju mësojë atë që nuk e dinit” [El-Bekare:

<sup>320</sup> Muslim, *Sahihu Muslim*, vepër e cituar, hadithi nr. 537, fq. 217.

151] Kështu, Allahu e mëson Xhibrilin, Xhibrili e mëson Muhammedin alejh'is-selam, Muhammedi i mëson sahabët, sahabët i mësojnë tabiinët dhe kështu gjeneratë pas gjenerate. Pra, e tërë feja e Allahut është dituri dhe arsimim.

Nëse detyra e Muhammedit alejh'is-selam ka qenë arsimimi, atëherë e gjithë ajo që është potencuar në sunet përfshirë arsimin, sqarimin, kumtimin, edukimin dhe pastrimin llogaritet burim elementar i mendimit pedagogjik, në qëllimet, përmbajtjet dhe metodat e tij. Atëherë, cilat janë shkencat të cilat Muhammedi alejh'is-selam mori përsipër t'ua mëson njerëzve ose i ka ftuar që t'i mësojnë nga burimet e tyre?

### 3. Suneti peygamberik rreth shkencave që obligativisht duhet mësuar ose duhet mësuar të tjerëve

Nuk është e lehtë të përfshihen rastet që mund t'i gjejmë nga arsimimi dhe edukimi pedagogjik. Detyra elementare e Muhammedit alejh'is-selam ishte sqarimi i dispozitave dhe këshillave që gjenden në librin e Allahut, kumtimi dhe mësimi i njerëzve. E gjithë jeta e tij ishte arsimim. Bile çdo fjalë që e flet, çdo lëvizje që e bën dhe çdo qëndrim, mendim apo gjykim ishte arsimim. Ndonëse, Kur'ani ka përfshirë disa faqe ku flet për rrëfimin e të Dërguarit të Allahut, Ibrahimit alejh'is-selam, dhe se në rastin e ndarjes së plotë nga jobesimtarët dhe distancimi i tij nga ajo që ata adhurojnë, është shëmbëlltë për besimtarët<sup>321</sup>, megjithatë ajo që potencohet në Kur'an rreth vetive të Muhammedit alejh'is-selam dhe ajo që është ruajtur në sunetin peygamberik rreth detajimeve të jetës së tij, e ka bërë atë të jetë shëmbëlltë e mirë për besimtarët në çdo çështje. ﴿لَقَدْ كَانَ لَكُمْ فِي رَسُولِ اللَّهِ أُسْوَةٌ حَسَنَةٌ لِّمَن كَانَ يَرْجُو اللَّهَ وَالْيَوْمَ الْآخِرَ وَذَكَرَ اللَّهَ كَثِيرًا﴾

<sup>321</sup> Kjo përfshihet në ajetin kur'anor:

﴿قَدْ كَانَتْ لَكُمْ أُسْوَةٌ حَسَنَةٌ فِي إِبْرَاهِيمَ وَالَّذِينَ مَعَهُ إِذْ قَالُوا لِقَوْمِهِمْ إِنَّا بُرَاءُ مِنْكُمْ وَمِمَّا تَعْبُدُونَ مِن دُونِ اللَّهِ كَفَرْنَا بِكُمْ وَبَدَا بَيْنَنَا وَبَيْنَكُمُ الْعَدَاوَةُ وَالْبَغْضَاءُ أَبَدًا حَتَّى تُؤْمِنُوا بِاللَّهِ وَحَدُّهُ﴾

*"Ju e keni shëmbullin më të mirë të Ibrahimit dhe të ata që ishin me të, kur i thanë popullit të vet: "Ne tërhiqemi prej jush dhe prej asaj që adhuroni, pos Allahut, nuk besojnë tuajën, prandaj ndërmjet nesh e jush është e hapët armiqësia e urrejtja derisa ta besoni vetëm Allahun, Një!"*. [El Mumtehine: 4]

*Allahut, kuptohet, ai që shpreson në shpërblimin e Allahut në botën tjetër, ai që atë shpresë e shoqëron duke e përmendur shumë shpesh Allahun.*" [El Ehzab: 21] Këtu do të mjaftojmë vetëm me disa shembuj.

Leximi i sunetit pejgamberik është i lidhur me interesimin dhe specializimin e lexuesit. Politikani, ekonomisti, psikologu dhe gjithë specialistët tjerë e lexojnë sunetin në mënyrën e tyre. Secili e lexon duke kërkuar atë që i nevojitet ne specializimin e tij. Ndoshta ai nxjerrë dhe kupton nga suneti atë që nuk mund ta kupton dikush tjetër. Ai përpiqet të nxjerr mësimet e një hadithi të caktuar rreth një çështje të specializimit të tij. Ndoshta ai sheh në hadith diç që mund të llogaritet si mrekulli në sunetin pejgamberik. Hulumtuesi mund të zhytet aq thellë në kuptimin e hadithit dhe në krahasime saqë e ngarkon hadithin më shumë se sa mund të bartë.

Shumica e shkencave kanë anën teorike dhe atë praktike. Disa shkencë në esencë llogariten si bazë teorike të shkencave tjera, tek të cilat dominon ana aplikative praktike. Dijetarët specialistë kanë hasur prezantimin e sunetit pejgamberik në shkencat teorike dhe praktike. Kështu, p.sh. psikologjia llogaritet bazament teorik i shkencave pedagogjike. Vërejmë se një specialist ka shkruar një libër prej dhjetë pjesëve duke folur rreth prezencës së sunetit pejgamberik në psikologji. Këto dhjetë pjesë janë: motivet e sjelljes, reagimet, kuptimi shqisor, mendimi, mësimi, dituria natyrore, zhvillimi, personaliteti, shëndeti psikik dhe trajtimi psikik. Autori i ka vërtetuar me hadithe pejgamberike disa tematika të cilat janë pjesë e psikologjisë në kuadër të këtyre dhjetë pjesëve.<sup>322</sup> Mund të hasim hulumtime të specializuara të cilat kanë përfshirë vetëm një tematikë prej tematikave të psikologjisë si p.sh.: pikëpamjet dhe ëndrrat<sup>323</sup>, mjekësia psikologjike<sup>324</sup> etj.

<sup>322</sup> Muhamed Othman Nexhati, *El-Hadith'un-Nebeviji ve ilm'un-nefs*, Kajro: Darush shuruk, bot. 5, 2005.

<sup>323</sup> Abdullah Muhamed Emin Junus El Omeri, *Er-Rua ve'l-ahlamu fi sunetin nebevijetin: dirasetu ve xhem'un ve tasnifun ve tehrixhun*, Aman: El-Xhamiat'ul-Urdunijetu, 1996. Gjithashtu shih:

Muhamed ibn Abdulaziz El-Xhem'an, *Er-rua ve'l-ahlamu fi hedj'is-sunetin nebevijeh'*, (temë magistrature në degën e kulturës islame, Fakulteti Pedagogjik, Universiteti e Mbretit Saud, Riad, 1430 h./2009).

<sup>324</sup> Ramadan Is'hak Ez-Zejan, *Et-Tibbu nefsiju fi dav'is-sunetin nebevijeh*, (temë magistrature e pabotuar, Fakulteti i Bazave të Fesë dhe Edukimit, Universiteti Umm Durman El-Islamijeh, Sudan, 1990).

Këtë lloj të hulumtimeve e hasim shumë në revistat periodike shkencore të specializuara. Po ashtu mund të gjejmë edhe shumë tema universitare të nivelit master dhe doktoraturë.

Specialistët në ekonomi i hasim se si flasin për ekonominë islame, ku si referencë kanë Kur'anin dhe sunetin. Në këtë sferë, janë publikuar shumë libra dhe hulumtime. Mund të ndodhë që të përfshihen hadithet dhe të klasifikohen sipas kapitujve të ekonomisë bashkëkohore siç kishte bërë Mundhir Kahf.<sup>325</sup> Mund të theksohet prania e sunetit pejgamberik në ekonomi.<sup>326</sup> Por mund të jenë libra në edukatën ekonomike në islam, të cilat përfshijnë tekste nga Kur'ani dhe suneti pejgamberik.<sup>327</sup>

Rreth këtyre shkencave hasim në këshilla pejgamberike që përcaktojnë çështjet që duhet t'i mëson muslimani prej tyre si dhe mënyrën se si të bashkëveprojë me to.

Prezenca e shkencave eksperimentale në sunetin pejgamberik nuk është më e vogël se prezenca e saj në sferat shkencore tjera si p.sh. psikologji, ekonomi etj. Jusuf Karadavi, për shkencat eksperimentale ka sjellë shembull mjekësinë për të zbuluar këtë prani të sunetit. Ai ka theksuar hadithet pejgamberike që ndërlidhen me disa parime të cilat mund të jenë bazament për "mjekësi të drejtë shkencore". Ai ka potencuar shtatë parime, të cilat i ka praktikuar shoqëria islame. Ato janë:

- Vlera e trupit
- Domosdoshmëria e kërkimit të mjekimit
- Hapja e derës së shpresës për shërim

<sup>325</sup> Mundhir Kahf, *En-Nusus'ul-iktisadijjetu mine'l-Kur'ani ve's-sunneh*, Xhidë: Merkez li neshr'il-ilmiji, 2009. Është një libër voluminoz prej 1026 faqeve. Autori këtu ka përmbledhur ajetet dhe hadithet të cilat i ka llogaritur se ndërlidhen me ekonominë dhe të njëjtat i ka ndarë sipas kapitujve: sjellja në ekonomi, themelet e aktivitetit ekonomik, parimet dhe rregullat elementare të sistemit ekonomik, teoria e konsumimit dhe sjellja e konsumatorit, teoria e prodhimit, sistemi tregtar, teoria e ekonomisë së përgjithshme, roli ekonomik i shtetit, financat e përgjithshme dhe çmimet. Secili kapitull ka edhe pjesët e veta.

<sup>326</sup> Kemal Hatab, *Et-Teal-lim'ul-iktisadijjetu fi sunetin nebevijetin*, temë e prezantuar në Konferencën e sunetit pejgamberik në studimet bashkëkohore, të cilin e ka organizuar Universiteti i Jermukut në Jordani në periudhën: 17-18/4/2007, i cili mund të gjendet në linkun e mëposhtëm:  
<https://www.ahlalhdeth.com/vb/showthread.php?t=98045>.

<sup>327</sup> Kinda Hamid Et-Turkavi, *Et-Terbijjet'ul-iktisadijjetu fi'l-Islami ve ehemijjetuha li'n-nesh'ul-xhedidi*, Daru ihja li'n-neshr'il-elektroni, 2010. Numri i haditheve të cilat janë përfshirë në disa aspekte të edukatës ekonomike ishte 111 hadithe, ndërsa numri i ajeteve të cilat i ka përdorur autori ishin 90 ajete.

- Pranimi i ligjit të Allahut në sëmundje
- Luftimi i mjekësisë së fallxhorëve dhe magjistarëve
- Përgjegjësia e mjekëve për gabimet e tyre
- Lejimi i kërkimit të ndihmës nga mjeku jobesimtar

Karadavi thekson se Muhammedi alejh'is-salam ishte në pozitën e shëmbëlltyrës më të mirë. Ai e ka vlerësuar mjekësinë e ngritur mbi shkencë dhe eksperiencë. Karadavi, për secilin prej këtyre parimeve ka sjellë argumente nga hadithet e sakta të Muhammedit alejh'is-salam. Ai është i mendimit se këto parime ishin të mjaftueshme për të dhënë një pasqyrë rreth qëndrimit të Muhammedit aleh'is-salam ndaj mjekësisë, qëndrim i cili i ka qenë për disa shekuj para periudhës së renesancës në Perëndim. Në bazë të këtyre parimeve, në Botën Islame ishte ngritur mjekësi teorike dhe praktike, librat e të cilës ishin referencë për Evropën dhe më gjerë për disa shekuj. Mjafton të theksojmë librin “El-Kanun” të Ibn Sina (Avicena), “El-Havi” të Rraziut dhe “El-Kul-lijjatu” të Ibn Rushdit.<sup>328</sup>

#### 4. Mësimnxënia në sunetin pejgamberik

Sa i përket shkencave pedagogjike, vërejmë se suneti pejgamberik ishte prezent në shumë sfera, si p.sh.: mësimnxënia ose kërkimi i diturisë është obligim, nijeti (qëllimi) në kërkimin e diturisë, durimi ndaj vështirësive të kërkimit, kërkimi i shtimit të diturisë, sqarimi i diturisë obligative, arsimit obligativ, mjetet dhe metodat mësimore, sqarimi i pozitës së dijetarëve dhe respektimi i tyre, regjistrimi i diturisë, raste të shumta praktike ku Muhammedi alejh'is-salam ishte mësues dhe shumë çështje tjera.

Hadithi: “Kërkimi i diturisë është obligim për çdo musliman”<sup>329</sup> është bërë i njohur. Është diskutuar shumë rreth tij,

<sup>328</sup> El-Karadavi, Er-Resulu ve'l-ilmu, vepër e cituar, fq. 57-60.

<sup>329</sup> Sujuti ka thënë: Për këtë hadith kam grumbulluar pesëdhjetë rrugë të transmetimit dhe kam gjykuar se është sahih ligajrihi. Asnjë hadith nuk e kam llogaritur si sahih (të saktë) pa e pasë thënë dikush tjetër para meje se është i saktë, përveç këtij hadithit”. Sehavii ka thënë: “Për këtë hadith ka dëshmitar tek Ibn Shahini. Transmetuesit janë të besueshëm që transmetojnë nga Enesi, nga i cili e transmetojnë diku njëzet tabiinë”. Shih:



qoftë për senedin (zinxhirin) apo për kuptimet e tij. Pa marrë parasysh gjithë atë që është thënë rreth tij, hadithi mund të kuptohet në dritën e intencave të përgjithshme të Islamit, të cilat kërkimin e diturisë e bëjnë farz ajn (obligativ për çdo individ) apo farz kifaje (obligim kolektiv që nëse disa e mësojnë, të tjerët lirohen nga obligueshmëria) dhe e obligojnë shoqërinë islame për sigurimin e kushteve për gjërat që duhet mësuar në të dy rastet, ku përmes tyre plotësohen nevojat e individit, shoqërisë dhe njerëzisë rreth çështjeve të fesë dhe jetës së kësaj bote. Pritet që të hasim në tri lloje të shkencave:

E para- shkenca të cilat janë obligative për çdo person, përfshirë qëllimet, përmbajtjet, mjetet dhe metodat, siç janë çështjet e besimit dhe adhurimeve (el-akaidu ve'l-ibadatu).

E dyta- shkenca që zhvillohen dhe reformohen në aspektin e obligimit ajn apo kifaje, si p.sh. çështjet e të drejtës civile, ekonomike, shoqërore, pedagogjike, shkencave natyrore, mjekësore, inxhinierike etj.

E treta- shkenca të reja që nuk kanë ekzistuar më parë, por mund të jenë të nivelit farz ajn ose farz kifaje si p.sh. disa degë të matematikës, informatika, fizika teorike, astronomia, kozmosi etj.

Në anën tjetër, obligueshmëria e arsimimit për çdo musliman theksohet në një numër të haditheve të cilat nxisin për kërkimin e diturisë dhe sqarojnë vlerën e diturisë dhe dijetarëve. Në mesin e tyre kemi hadithin në të cilin Muhammedi alejh'is-selam thekson se arsimimi dhe përfitimi i diturisë ka nevojë për nijet, dëshirë dhe përpjekje. Ai thotë: "O ju njerëz, mësoni, ngase dituria arrihet përmes mësimit dhe të kuptuarit arrihet përmes përpjekjeve për kuptim. Atij që Allahu ia dëshiron të mirën, ia mundëson ta kuptojë fenë".<sup>330</sup> Muhammedi alejh'is-selam thekson se kush ka nijet të pastër dhe

Muhamed Abdurauf El-Menavi, *Fejd'ul-Kadir sherh'ul-xhami'is-sagiri min ehadith'il-beshir'in-nedhiri*, El Hafidh Xhelaluddin Es-Sujuti, Bejrut: Darul ma'rifeti, bot. 2, 1972, hadithi nr. 5264, vëll. 4, fq. 267. E ka verifikuar Albani. Shih: Muhamed Nasirudin El-Albani, *Sahih'ul-xhami'is-sagiri ve zijadatuhu (el-fet'hu'l-kebir)*, Damask, El-Mekteb'ul-islamijju, bot. 3, (1408 h./1988), hadithi nr. 3913, fq. 727.

<sup>330</sup> El-Hafidh Ebu'l-Fadl Ahmed ibn Ali El-Askalani Ibn Haxher, (v. 852 h./1448), *Fet'hu'l-Bari bisherhi Sahih'il-Buhari*, Riad, Daru Tajbe, 2005, vëll. 1, fq. 184. Ibn Haxheri ka diskutuar transmetimin e hadithit dhe ka thënë: "Isnadi i tij është hasen. Ai përforcohet me transmetime nga forma tjera".

bënë përpjekje në kërkimin e diturisë, Allahu do t'ia lehtëson atij rrugën për në xhenet, duke sqaruar edhe vlerën e tubimit për mësim dhe studim. Ai thotë: “kush merr një rrugë përmes së cilës kërkon dituri, Allahu atij do t'ia lehtëson rrugën për në xhenet. Çdo grup që tubohet në ndonjë shtëpi të Allahut (xhami) ku lexojnë librin e Allahut dhe e studiojnë mes vete, atyre do t'ju zbresë qetësia, do t'i mbulon mëshira, do të mbështeten nga melaiket dhe Allahu do t'i përmend në mesin e njerëzve të veçantë të tij”.<sup>331</sup>

Si rezultat i nxitjes së Muhammedit alejh'is-selam ndaj sahabëve për mësim ishte edhe ajo se ata ishin tepër të kujdesshëm që askujt të mos i ik diçka nga ajo që ua mëson i Dërguari i Allahut. Në lidhje me këtë kemi tregimin e Omer ibn el Hatabit radijellahu anhu, i cili banonte në vende të larta të Medinës. Kështu që ky dhe një sahabi tjetër prej ensarëve me rend zbritnin te Muhammedi alejh'is-selam dhe secili i tregonte tjetrit atë që e kishte mësuar nga Muhammedi alejh'is-selam. Omeri thotë: “Isha unë dhe një komshi ensarit në vendin Benu Umeje ibn Zejd, që gjendej lart në Medinë. Me rend zbrisnim te Muhammedi alejh'is-selam. Ai një ditë e unë një ditë. Kur unë zbrisja, ia sjellja atë që e mësoja atë ditë, e kur ai zbriste e bënte të njëjtën”.<sup>332</sup>

Kjo përkujdesje për kërkimin e diturisë nuk ishte vetëm te sahabët. Edhe tabi'inët dhe ata të cilët kanë ardhur më pas ishin të kujdesshëm dhe të zellshëm për të kërkuar çdo gjë që është transmetuar nga Muhammedi alejh'is-selam. Ata kanë kaluar në vende të ndryshme të Botës Islame duke kërkuar njerëz që do t'ua mësojnë qoftë edhe një hadith nga Muhammedi alejh'is-selam. Hatib Bagdadi ka veçuar një libër të plotë rreth udhëtimit në kërkim të hadithit. Ai ka sqaruar kujdesin e muslimanëve ndaj hadithit, isnadit, qëllimet e udhëtimit te muhadithët, dobitë që i sjell udhëtimi në zhvillimin shkencor të muhadithët për shkak të përkujtimit

<sup>331</sup> Muslim, *Sahihu Muslim*, vepër e cituar, hadithi nr. 2699, fq. 1082.

<sup>332</sup> El-Buhari, *Sahih'ul-Buhari*, vepër e cituar, hadithi nr. 89, fq. 43.

mes tyre. E gjithë kjo krahas verifikimit, kontrollimit, mësimit përmendësh dhe përhapjes së diturisë.<sup>333</sup>

Transmeton Hatib Bagdadi në librin “Er-Rihletu fi taleb’il-hadithi” me sened deri te Jezid ibn Haruni se Hamad ibn Zejdit i ka thënë: “O Ebu Ismail, a i ka përmend Allahu dijetarët e hadithit në Kur’an? Ai ka thënë: Po. A nuk ke dëgjuar fjalën e Allahut:

﴿فَلَوْلَا نَفَرَ مِن كُلِّ فِرْقَةٍ مِّنْهُمْ طَائِفَةٌ لِّيَتَفَقَّهُوا فِي الدِّينِ وَلِيُنذِرُوا قَوْمَهُمْ إِذَا رَجَعُوا إِلَيْهِمْ لَعَلَّهُمْ يَحْذَرُونَ﴾

“E përse nga çdo grumbull i tyre të mos shkojë një grup për t’u aftësuar në diturinë fetare, për ta mësuar popullin e vet kur të kthehet te ata, në mënyrë që ata të kuptojnë (e të ruhen).” [Et-Tevbe: 122].

Kjo përfshin çdo njeri që udhëton për kërkimin e diturisë dh kuptimin e fesë, dhe më pas kthehet për t’ua mësuar atë të tjerëve”.<sup>334</sup> Recensenti i këtij libri, Nuredin Itr është i mendimit se atë që e sjell Hatib Bagdadi në libër sillel rreth dy teksteve. Teksti i parë, ajeti kur’anor: ﴿فَلَوْلَا نَفَرَ مِن كُلِّ فِرْقَةٍ...﴾ “E përse nga çdo grumbull i tyre të mos shkojë një grup...”, ndërsa teksti i tjetër është hadithi i lartë-cituar Imam Muslimit: “Kush merr një rrugë përmes së cilës kërkon dituri....”. Për këtë, recensenti këto dy tekste i ka bërë si fillim të librit.

## 5. Mësimdhënia në sunetin peygamberik

Shumë hadithe peygamberike përfshijnë më shumë se një tematikë. Disa hadithe përfshijnë nxitjen për mësimnxënie dhe mësimdhënie, ngase që të dy çështjet në fund janë një proces që ka dy palë. Në mesin e këtyre haditheve kemi hadithin të cilin e transmeton Taberaniu nga Ebu Bekrete se ka thënë: Kam dëgjuar Muhammedin alejh’is-selam duke thënë: “Bëhu mësues ose nxënës ose dëgjues ose dashamirë i diturisë, por mos u bë i pesti e të shkatërrohesh” Atau ka thënë: më tha Mis’ari: të pestën e ke shtuar, nuk ka qenë te ne. E

<sup>333</sup> Ebu Bekr Ahmed ibn Ali ibn Thabit El-Hatib El-Bagdadi, (v. 463 h./1071), *Er-Rihletu fi taleb’il-hadithi*, Bejrut: Dar’ul-kutub’il-ilmijeh, bot. 1, 1975.

<sup>334</sup> Po aty, fq. 87.

pesta është të urresh diturinë dhe dijetarët”.<sup>335</sup> Ngjashëm me këtë është edhe hadithi të cilin e transmeton Ibn Maxhe nga Ebu Hurejreja se Muhammedi alejh’is-selam ka thënë: “Sadaka më e mirë është të mësojë njeriu diçka dhe të njëjtin t’ia mëson vëllait të tij musliman”.<sup>336</sup>

Në mesin e haditheve që ndërliidhen me arsimimin përfshihen edhe hadithet që flasin për pozitën e mësuesit, respektimi i tij, vlerën e tij. A është vlera e mësuesit sepse ai kryen punë që e ka kryer i Dërguari i Allahut? Në Sahihun e Muslimit transmetohet se Muhammedi alejh’is-selam ka thënë: Allahu nuk më ka dërguar kokëfortë dhe inatçor, por më ka dërguar mësues lehtësues”.<sup>337</sup>

Hadithet rreth arsimimit janë të shumta. Ka hadithe që detyrojnë shoqërinë sigurimin e arsimit për të gjithë, derisa obligojnë fqinjën që posedon dituri, t’ia ofron atë fqinjëve që nuk e posedojnë. Në lidhje me këtë, imam Taberaniu transmeton nga Muhammedi alejh’is-selam se ka thënë: “Ç’është puna e atyre personave që fqinjët e tyre nuk i mësojnë, nuk i këshillojnë, nuk i urdhërojnë për të mirë dhe nuk i ndalojnë nga e keqja?! Ç’është puna e atyre personave që nga fqinjët e tyre nuk mësohen dhe nuk këshillohen?! Pasha Allahun! Personat do të mësojnë, këshillojnë, urdhërojnë për të mirë dhe ndalojnë nga e keqja fqinjët e tyre dhe persona do të mësohen dhe këshillohen nga fqinjët e tyre ose do t’ua përshejtojnë dënimin. Më pas zbriti. Disa njerëz thanë: kë e kishte për qëllim? Tha? Fisin esh’ari. Ata janë popull i ditur dhe kanë fqinjë beduinë që nuk dinë. Kjo çështje iu arriti esh’arijve. Atëherë, shkuan te Muhammedi alejh’is-selam dhe thanë: O i Dërguari i Allahut, disa i ke përmendur për të mirë, ndërsa neve na ke përmendur për të keq. Ç’është puna jonë? Tha? Personat do të mësojnë, këshillojnë, urdhërojnë për të mirë dhe ndalojnë nga e keqja fqinjët e tyre dhe persona do të

<sup>335</sup> Nurudin ibn Ebu Bekr El-Hejthemi, (v. 807 h./1404). *Mexhme’uz-zevaidi ve menbe’ul-fevaidi*, Damask: Dar’ul-Me’muni li’t-turathi, 1991, hadithi nr. 501, vëll. 2, fq. 240. El-Hejthemi ka thënë: E ka transmetuar Taberaniu në tre libra. E ka transmetuar edhe El-Bezari. Transmetuesit janë të besueshëm”.

<sup>336</sup> Ibn Maxhe, Ebu Abdullah Muhamed ibn Jezid (v. 273 h./886), *Sunenu Ibni Maxhe*, bot. 1, Bejt’ul-efkar’id-devlijjeti, Riad, 1999, hadithi nr. 243, fq. 41.

<sup>337</sup> Muslim, Sahihu Muslim, vepër e cituar, hadithi nr. 1478, fq. 592.

mësohen dhe këshillohen nga fqinjët e tyre ose do t'ua përshpejtoj dënimin në këtë botë. Thanë: O i Dërguari i Allahut, t'i vetëdijesojmë të tjerët? E përsëriti të njëjtën para tyre. Edhe ata e përsëritën duke thënë: t'i vetëdijesojmë të tjerët? Prapë, Muhammedi alejh'is-selam e përsëriti të njëjtën fjalë. Ata thanë: Na jep kohë një vit. Ai u dha kohë një vit, që t'i arsimojnë dhe këshillojnë."<sup>338</sup>

Ka disa hadithe të cilat ndërliken me metodat të cilat i ka përdorur Muhammedi alejh'is-selam ose ka kërkuar të përdoren. Këtu përfshihen shfrytëzimi i ngjarjeve, rasteve dhe qëndrimeve për të ofruar diturinë e përshtatshme. Me rastin e marrjes së diellit, imam Buhariu në Sahihun e tij transmeton nga Mugire ibn Shu'be se ka thënë: U mor dielli në kohën e Muhammedit alejh'is-selam, ditën kur vdiq Ibrahim djali i Muhammedit alejh'is-selam. Njerëzit thanë: U zu dielli për shkak të vdekjes së Ibrahimit. Ndërsa Muhammedi aleh'is-selam tha: Dielli dhe hëna janë dy argumente të Allahut. Ato nuk zihen për vdekjen e as për lindjen e askujt. Kur të shihni diç të tillë, faluni dhe lutuni Allahut".<sup>339</sup>

Me këtë kemi përmirësim të bindjeve të kota që dominonin në periudhën e xhahilijetit, ku në mesin e këtyre bindjeve ishte edhe ajo se dukuritë e diellit, hënës dhe yjeve ndikojnë në jetën e njerëzve, në veçanti në lindje apo vdekje.

Ka prej haditheve që përfshijnë përgatitjen e nxënësve, e cila në didaktikë njihet si faza e evokimit. Në këtë fazë përgatitja bëhet përmes parashtrimit të ndonjë pyetje, sjellja e butë me ta, shprehja e mirëseardhjes, moszgjatja me ligjëratë, marrja parasysh e dallimeve dhe kapaciteteve vetjake të nxënësve, mospërfshirja e tërë shkencës për njëherë, gradualiteti në prezantimin e temës etj.

Ka prej haditheve që përfshijnë sqarimin e çështjeve duke përdorur mjetet mësimore të përshtatshme, të cilat ndihmojnë në kuptimin e njësisë mësimore siç janë shenjat, simbolet,

<sup>338</sup> El-Hejthemi, *Mexhme'uz-zevaidi ve menbe'ul-fevaidi*, vepër e cituar, vëll. 1, fq. 164. Ka thënë: "E ka transmetuar Taberaniu në librin El-Kebir. Në mesin e transmetuesve është edhe Bukejr ibn Ma'ruf". Buhariu ka thënë: "Hedhe atë". Imam Ahmedi në një transmetim e ka verifikuar, ndërsa sipas transmetimit tjetër e ka llogaritur si të dobët. Ibn Adiu ka thënë: "Shpresoj të mos anashkalohe".

<sup>339</sup> El-Buhari, *Sahih'ul-Buhari*, vepër e cituar, hadithi nr. 1043, fq. 207.

vizatimet dhe mjetet tjera ilustrative. Në lidhje me këtë kemi hadithin të cilin e transmeton imam Buhariu nga Abdullah ibn Mes'udi radijallahu anhu, i cili ka thënë: Muhammedi alejh'is-selam bëri një katror. Më pas në mes të tij bëri një vijë dhe e nxori jashtë katrorit. Bëri edhe një vijë në mes brenda katrorit dhe ca vija tjera afër vijës që ishte në mes dhe tha: katrori është njeriu. Vija që është jashtë katrorit është shpresa e njeriut, vija që është në mes brenda është jetëgjatësia e tij. Ndërsa vijat e shkurtra janë sprovat që e godasin. Nëse ndonjërisë i ikë, do ta godet tjetra. Po nëse tjetrës i ikë, do ta godet tjetra.”<sup>340</sup>

Mund të themi se nga disa raste të arsimit pejgamberik mund të nxjerrim metodën e demonstrimit shkencor, sidomos kryerja në përpikëri e punës nga ana e zanatçinjve të ndryshëm. Transmetohet në Sunenin e Ibn Maxhes nga Ebu Seid Hudari se Muhammedi alejh'is-selam kaloi pranë një personi që ishte duke rrjepur një dele. Muhammedi alejh'is-selam atij i tha: largohu të të mësoj si rrjepët. E shtyri Muhammedi alejh'is-selam dorën mes lëkurës dhe mishit derisa arriti te nënsqetulla dhe tha: “O njeri, kështu rrjep”. Pastaj shkoi Muhammedi alejh'is-selam ua fali namazin njerëzve dhe nuk mori abdest”.<sup>341</sup>

Pa dyshim se sahabët kanë mësuar nga Muhammedi alejh'is-selam shumë vepra, të cilat i kanë parë duke i vepruar ai. Muhammedi alejh'is-selam i këshillonte për t'i praktikuar ato. Prej këtyre haditheve kemi edhe hadithet në vijim: “Faluni ashtu siç më keni parë duke u falur”.<sup>342</sup> Thënia e tij: “Merrni prej meje rregullat e haxhit”.<sup>343</sup> Kur shihte Muhammedi alejh'is-selam dikë që bënte ndonjë vepër që nuk e njihnte mirë, e këshillonte atë duke ia treguar anët e dobëta dhe mangësitë. Hadithi i “atij që nuk dinte të falej”<sup>344</sup> është shembull për këtë çështje.<sup>345</sup>

<sup>340</sup> Po aty, hadithi nr. 6417, fq. 1233.

<sup>341</sup> Ibn Maxhe, Sunenu ibn Maxhe, vepër e cituar, hadithi nr. 3179, fq. 346. Shih: Ebu Davud, Sunenu Ebi Davud, vepër e cituar, hadithi nr. 185.

<sup>342</sup> El-Buhari, *Sahih'ul-Buhari*, vepër e cituar, hadithi nr. 6008, fq. 1164.

<sup>343</sup> Muslim, *Sahihu Muslim*, vepër e cituar, hadithi nr. 1297, fq. 512.

<sup>344</sup> Transmetohet nga Ebu Hurejre se Muhammedi alejh'is-selam hyri në xhami. Pas tij hyri edhe një njeri dhe u fal. Ai e përshëndeti Muhammedin alejh'is-selam me selam. Muhammedi ia ktheu selamin dhe i tha:

Vërejmë se metodat e ndryshme dhe të llojllojshme që i praktikonte Muhammedi alejh'is-selam gjatë mësimit të sahabëve, në esencë, kishin për qëllim formimin e personalitetit të muslimanit me moral të mirë, ngase kompletimi i virtyteve morale është qëllim i dërgimit për Pejgamber. Muhammedi alejh'is-selam ka thënë: “Jam dërguar që të kompletoj virtytet morale”.<sup>346</sup> Po ashtu thënia: “S’ka gjë më të rëndë në peshore Ditën e Kiametit se sa morali i mirë”.<sup>347</sup> Në një transmetim të Tirmidhiut se Muhammedi alejh'is-selam ka thënë: “Më i dashur tek unë dhe më afër meje në pozitë Ditën e Kiametit do të jenë ata që kanë moral më të mirë”.<sup>348</sup>

“Çohu falu se nuk je falur”. Njeriu u fal përsëri si në herën e parë. Pastaj erdhi dhe e përhëndeti Muhammedin alejh'is-selam me selam. Muhammedi alejh'is-selam i tha: “Çohu falu se nuk je falur”. Kjo u përsërit tri herë. Në fund njeriu tha: “Pasha Atë që të ka dërguar me të vërtetën, nuk di të falem ndryshe, më mëso”. Muhammedi alejh'is-selam i tha: “Kur të ngrihesh për namaz, merr tekbir, pastaj lexo sa të mundesh nga Kur’ani. Pastaj bjer në ruku derisa të qetësohesh. Pastaj ngrihu derisa të drejtohesh në këmbë. Më pas bjer në sexhde derisa të qetësohesh. Më pas ngrihu nga sexhdeja derisa të qetësohesh ulur. Bëj kështu në gjithë namazin”. Shih: El-Buhari, *Sahih’ul-Buhari*, vepër e cituar, hadithi nr. 755, fq. 759.

<sup>345</sup> En-Nesai, *El-Muxhteba mine’s-suneni “Sunen’un-Nesai”*, vepër e cituar, hadithi nr. 1136, fq. 136.

<sup>346</sup> E ka transmetuar Ahmedi në Musnedin e tij. Shih: Ibn Hanbel, Imam Ahmed ibn Hanbel Esh-Shejbani (v. 241 h./855). *Musnedu Imam Ahmed*, Riad: Bejt’ul-efkar’id-devlijjeti, 1998, hadithi nr. 8939, fq. 655.

<sup>347</sup> E ka transmetuar Ebu Davudi në Sunenin e tij dhe Tirmidhiu në Xhamiun e tij. Shih:

Ebu Davud, *Sunenu Ebi Davud*, vepër e cituar, hadithi nr. 4799, fq. 523.

Et-Tirmidhi, *Xhami’ut-Tirmidhi*, vepër e cituar, hadithi nr. 2002, fq. 333.

<sup>348</sup> Et-Tirmidhi, *Xhami’ut-Tirmidhi*, vepër e cituar, hadithi nr. 2018, fq. 335.

## Pjesa e tretë:

# Trashëgimia pedagogjike islame, burim i mendimit pedagogjik islam

Botimit të librit “Zhvillimi i mendimit pedagogjik islam bashkëkohor”, i ka paraprirë botimi i një libri tjetër të të njëjtit autor, i përbërë nga tre vëllime rreth “trashëgimisë pedagogjike islame”, i cili në mënyrë të detajuar ka përfshirë trashëgiminë pedagogjike islame, gjendjen e hulumtimit bashkëkohor rreth saj, disa analiza të teksteve dhe shkollave të saj dhe propozimin e disa projekteve hulumtuese rreth saj. Në kapitullin e dytë të këtij libri, “Zhvillimi i mendimit pedagogjik islam bashkëkohor”, folëm për polemikat rreth të kaluarës dhe bashkëkohores në trashëgiminë pedagogjike islame, vëzhgimi i shenjave të zhvillimit në te dhe pikëpamjet analitike të literaturës së shumtë rreth saj. Atëherë, çka ka mbetur të flitet rreth trashëgimisë pedagogjike islame që materia e kësaj çështje të jetë pjesë e kësaj pjese të librit?

Për t’iu përgjigjur kësaj pyetjeje, jemi të detyruar të përkujtojmë dy çështje: e para: roli i këtij kapitulli është prezantimi i burimeve të mendimit pedagogjik islam bashkëkohor, në bazë të cilave dëshirojmë të ngremë formulimin e jetës tonë pedagogjike, në teori dhe praktikë, si dhe orientimin e tij drejt një të ardhme të synuar që do të jetë më e ndritshme se e kaluara dhe e tashmja jonë. E dyta: mënyra se si është prezantuar -dhe vazhdon të prezantohet- trashëgimia pedagogjike islame në jetën tonë pedagogjike bashkëkohore. Ndoshta nuk jemi shumë larg të vërtetës nëse themi se trashëgimia pedagogjike islame, -në rastin më të mirë- është prezantuar si lëndë mësimore për një grup të vogël të specialistëve në atë që quhet edukata islame, ose në historia e pedagogjisë, ose program studimor në këtë specializim. Hyrja bazë e kësaj prezence është përmes hyrjes historike, i cili riboton disa nga shkrimet trashëguese rreth realitetit të arsimit në disa peri-



dha, disa vende dhe disa shkolla, duke theksuar shumë pak disa dispozita krahasuese rreth lidhshmërisë së trashëgimisë pedagogjike islame me jetën pedagogjike të shoqërive islame bashkëkohore.

Për këtë, lindin dy pyetje tjera edhe më të forta dhe më të rëndësishme se pyetja e mëparshme. Këto pyetje janë:

- Çka mund të hasim në trashëgiminë pedagogjike islame që mund të llogaritet si burim i mendimit të pedagogjisë islame bashkëkohore?

- Atë që e hasim, si mund të përdorim për këtë qëllim?

Përgjigjja ndaj këtyre pyetjeve do të jetë edhe përmbajtja e kësaj pjese.

## 1. Trashëgimia si burim dhe argumentim

Theksuam më parë se shumë prej asaj që është shkruar rreth mendimit pedagogjik islam ishte bisedë rreth asaj se si ishte mendimi të një numër i dijetarëve, ose shkollave, ose kohëve, ose vendeve, gjë e cila i përket historisë islame. E gjithë kjo llogaritet në kuadër të asaj që e quajmë trashëgimi islame. Megjithatë, është patjetër të pranojmë se ajo trashëgimi "historike" sot është pjesë e projektit të mendimit pedagogjik islam bashkëkohor. Bazuar në këtë, vlerësimi i trashëgimisë dhe sqarimi i dobisë së saj në jetën tonë bashkëkohore është çështje e rëndësishme në bashkëveprim me trashëgiminë. Edhe më e rëndësishme është vënia e parimeve, në bazë të së cilave mund të gjykojmë ndaj trashëgimisë dhe sqarimin e vlerës së saj në formimin e mendimit pedagogjik islam bashkëkohor.

Nëse trashëgimi pedagogjike të cilën e kemi për qëllim në këtë kontekst është atë që e kanë shkruar dijetarët musliman rreth mendimit pedagogjik i cili dominonte në kohën e tyre, si dhe praktikat pedagogjike të cilat janë mbështetur në atë mendim, atëherë nuk ka dyshim se Kur'ani dhe suneti pejgamberik kanë qenë dy burimet kryesore të kësaj trashëgimie. Kjo shihet qartë kur vërejmë se shumë prej librave të trashëgimisë pedagogjike islame kanë filluar me ajete kur'anore,

të cilat ndërlidhen me temën në fjalë. Më pas, ajetet i pasojnë me hadithe pejgamberike. Në fund, ato i pasojnë me diç që e quajmë trashëgimi, pra fjalë të transmetuara nga sahabët, tabi'inët dhe tabi'i-tabi'inët deri në kohën e autorit. Me siguri se këto fjalë kanë qenë atë që e kanë kuptuar këta persona nga ajetet dhe hadithet, ose praktikat e tyre të cilat i kanë zbatuar. Ne, kur përshkruajmë referencat e trashëgimisë pedagogjike islame se ishin Kur'ani dhe suneti pejgamberik, duhet pranuar se disa tekste të trashëgimisë si referencë, përveç Kur'anit dhe sunetit, -si shtesë, e jo si zëvendësim- kishin edhe burime tjera: greke, persiane, indiane, të cilat ishin të njohura në kohën e autorit. Duhet kuptuar se përdorimi i këtyre referencave shtesë ishte rast i veçantë e jo dukuri e rregullt, pra ato nuk ishin burime bazë.

Nëse burimi bazë i trashëgimisë ka qenë Kur'ani dhe suneti pejgamberik në mënyrën që e potencuam, atëherë duhet përgjigjur pyetjeve të mëposhtme:

- E gjithë kjo a mjafton që trashëgimia të jetë referencë dhe të bëhet burim për ne sot?

- A detyrohemi që Kur'anin dhe sunetin pejgamberik ta shohim me sytë e trashëgimisë apo kemi mundësi që në mënyrë të drejtpërdrejtë të formojmë mendimin tonë nga ky burim kryesor, pa qenë trashëgimia së ndërmjetësues?

- Nëse lejohet që mendimin tonë pedagogjik bashkëkohor ta marrim drejtpërdrejt nga Kur'ani dhe suneti pejgamberik, atëherë në këtë rast, çfarë vlere ka trashëgimia pedagogjike islame?

## 2. Çështja e anashkalimit të trashëgimisë dhe marrja drejtpërdrejtë nga Kur'ani dhe suneti pejgamberik

Ajetet kur'anore vërtetojnë se Kur'ani është zbritur si udhëzim dhe argumente të qartë për orientim. Allahu thotë:

﴿شَهْرُ رَمَضَانَ الَّذِي أُنزِلَ فِيهِ الْقُرْآنُ هُدًى لِّلنَّاسِ وَبَيِّنَاتٍ مِّنَ الْهُدَىٰ وَالْفُرْقَانِ﴾

*“Muaji Ramazan është ai në të cilin (filloi të) shpallet Kur'ani, që është udhërrëfytes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshttra).”* [El-Bekare: 185]. Po ashtu,

për të qenë sqarim, udhëzim, mëshirë dhe shërim për muslimanët. Allahu ka thënë: ﴿وَنَزَّلْنَا عَلَيْكَ الْكِتَابَ تَبْيَانًا لِّكُلِّ شَيْءٍ وَهُدًى وَرَحْمَةً وَبُشْرَىٰ ۖ لِلْمُسْلِمِينَ﴾ “Ne ty ta shpallëm librin sqarim për çdo send, udhëzim e mëshirë dhe myzhde për muslimanët.” [En-Nahl: 89]. Të jetë po ashtu udhërrëfyes, udhëzim dhe mëshirë. Allahu ka thënë: ﴿هٰذَا بَصَائِرُ لِلنَّاسِ وَهُدًى وَرَحْمَةٌ لِّقَوْمٍ يُوقِنُونَ﴾ “Ky (Kur’ani) është dritë e dijes për njerëz, është udhëzues e mëshirë për një popull që beson bindshëm.” [El-Xhathijeh: 20]. Ajetet në këtë drejtim janë të shumta. Që të gjitha flasin për detyrat e potencuara në Kur’an. Pasi detyrat e ajeteve kur’anore janë të llojllojshme (sqarim, kumtim, shërim, mëshirë, përgëzim...) vërehet se udhëzimi është një cilësi e pandarë e të gjitha këtyre detyrave. Ata që udhëzohen me këtë Kur’an, Allahu edhe më shumë do t’ua shtojë udhëzimin. Allahu thotë: ﴿وَيَزِيدُ اللَّهُ الَّذِينَ اهْتَدَوْا﴾ “E Allahu u shton besimin atyre që u udhëzuan.” [Merjem: 76]. Muhammedi alejh’is-selam në gjithë atë që e kumton nga Zoti i tij dhe thërret në te, është në një udhëzim të drejtë. Allahu ka thënë: ﴿وَادْعُ إِلَىٰ رَبِّكَ إِنَّكَ لَعَلَىٰ هُدًى مُّسْتَقِيمٍ﴾ “E ti thirr te Zoti yt, se pa dyshim ti je në një rrugë të drejtë.” [El-Haxh: 67]. E kundërta e udhëzimit është devijimi. Allahu ka thënë: ﴿قُلْ مَنْ يَرْزُقُكُمْ مِّنَ السَّمَاءِ وَالْأَرْضِ قُلِ اللَّهُ وَإِنَّا أَوْ إِبْرَاهِيمَ أَوْ فِي ضَلَالٍ مُّبِينٍ﴾ “Thuj: “Kush ju furnizon nga qiejt e nga toka?” Thuj: “Allahu”. E atëherë, ose ne ose ju jemi në rrugë të drejtë, apo në një humbje të dukshme.” [Sebe’: 24]. Ata që nuk udhëzohen me këtë udhëzim janë të shurdhër që nuk dëgjojnë dhe të verbër që nuk shikojnë. Allahu thotë:

﴿وَلَوْ جَعَلْنَاهُ قُرْآنًا أَعْجَمِيًّا لَقَالُوا لَوْلَا فُصِّلَتْ آيَاتُهُ أَأَعْجَبِي وَعَرَبِيٌّ قُلْ هُوَ لِلَّذِينَ آمَنُوا هُدًى وَشِفَاءً وَالَّذِينَ لَا يُؤْمِنُونَ فِي آذَانِهِمْ وَقْرٌ وَهُوَ عَلَيْهِمْ عَمًى﴾

“Sikur Ne ta bënim Kur’anin në gjuhë të huaj, ata do të thoshin: ‘Përse nuk janë ajetet e tij të kuptueshme (të shkoqitura), a është ai (Kur’ani) në gjuhë të huaj, kurse ai (pejgamberi) është arab?’ Thuj: ‘Ai është për besimtarët udhëzues e shërues. E ata që nuk besojnë, në veshët e tyre kanë shurdhim, dhe ai për ta është verbërim.’” [Fussilet: 44].

Kur’ani ishte udhëzim, sqarim dhe ndriçim për ata që u është zbritur, e kanë kuptuar drejtë dhe janë udhëzuar me të,

gjatë veprimit dhe praktikimit, ngase ai ishte ﴿قُرْآنًا عَرَبِيًّا غَيْرَ ذِي عَوْجٍ﴾ “Duke qenë Kur’ani arabisht që nuk ka kundërthënie.” [Ez-Zumer: 28]. Kur’ani është ﴿كِتَابٌ فَصَّلَتْ آيَاتُهُ قُرْآنًا عَرَبِيًّا لِقَوْمٍ يَعْلَمُونَ﴾ “Libër që ajetet e tij janë të shkoqitura, duke qenë Kur’an arabisht për një popull që di ta kuptojë.” [Fussilet: 3]. Poashtu ﴿وَهَذَا كِتَابٌ مُّصَدِّقٌ لِّسَانًا عَرَبِيًّا﴾ “Edhe ky është libër që vërteton (librin e Musait), është në gjuhën arabe.” [El-Ehkaf: 12]. Ata ishin njohës shumë të mirë të gjuhës dh stilistikës arabe, ndërkohë, Kur’ani ishte i lehtë dhe i qartë në kuptim dhe dispozita. Ne besojmë se Kur’ani do të mbetet libër i hapur për udhëzim të vazhdueshëm të njerëzisë. Çdo gjeneratë, në të, gjen atë që u duhet për përmirësimin e gjendjes së tyre. Udhëzimet e tij nuk shterren kurrë dhe njerëzit nuk do të kenë nevojë për pejgamber të ri, të cilit do t’i zbres libër i ri.

Nuk është vërtetuar se Muhammedi alejh’is-selam ka pasur nevojë të komentojë tërë Kur’anin. Kanë qenë raste të kufizuara, në të cilat Muhammedi alejh’is-selam ka lexuar ajetin dhe më pas ka dhënë sqarim për te, ose është pyetur rreth ndonjë ajeti dhe e ka komentuar me shprehje, shembull ose ndonjë ajet tjetër, ose dikush prej sahabëve ka kuptuar diç nga Kur’ani në mënyrë jo të saktë, dhe Muhammedi alejh’is-selam e ka përmirësuar këtë kuptim. Shumë rrallë ka ndodhur që ndonjë hadith të komentojë ndonjë shprehje kur’anore. Niveli i lartë gjuhësor i sahabëve ishte i mjaftueshëm për të kuptuar drejtpërsëdrejti nga Kur’ani dhe për t’u udhëzuar me udhëzimet e tij.

Përdorimi i disa komentuesve të Kur’anit disa nga hadithet pejgamberike si sqarim të ajeteve kur’anore e shohim si të tepërt dhe jo në vendin e duhur. Shembull për këtë kemi komentimin e Imam Raziut<sup>349</sup> ndaj ajetit kur’anor: ﴿وَلَقَدْ فَتَنَّا سُلَيْمَانَ وَأَلْقَيْنَا عَلَى كُرْسِيِّهِ جَسَدًا ثُمَّ أَنَابَ﴾ “Ne e sprovuam Sulejmanin dhe e mbajtëm në postin e tij si një trup, e pastaj u rikthye në gjendjen e parë” [Sad: 34], me një hadith në “Sahih’ul-Buhari” se

<sup>349</sup> Fahrudin Muhamed ibn Dijaudin Omer Er-Razi, (v. 604 h./1207). Tefsir’ul-Fahr’ir-Razi “Et Tefsir’ul-Kebiru ose Mefatih’ul-Gajbi”, Damask, Dar’ul-Fikr, 1981, vëll. 26, fq. 208-209. Vërehet se Imam Raziu ka potencuar se komentimi i ajetit me hadithin e theksuar është thënie e dijetarëve autoritarë. Megjithatë ka potencuar komentime tjera që nuk ndërlidhen fare me hadithin.

Muhammedi alejh'is-selam ka thënë: Sulejmani i biri i Davudit alejhim'as-selam ka thënë: Sonte do të bëj marrëdhënie intime me shtatëdhjetë gra, ku secila prej tyre do të lind kalorës që do të luftojnë në rrugën e Allahut. Shoku i tij tha: In shaAllah (me lejen e Allahut). Sulejmani këtë fjali nuk e tha. Asnjëra grua nuk mbeti shtatzënë, përpos njëres e cila kishte lindur fëmijë jo të aftë fizikisht. Muhammedi alejh'is-selam ka thënë: Sikur të thoshte, do të luftonin në rrugën e Allahut".<sup>350</sup> Disa prej dijetarëve të mëvonshëm mohojnë lidhshmërinë e hadithit me ajetin. Për këtë bazohen në atë se Buhariu hadithin nuk e ka vënë në librin e tefsirit dhe se ajetin e komentojnë me komentime të ndryshme.<sup>351</sup>

Detyra e Muhammedit alejh'is-selam është leximi i ajeteve kur'anore ashtu siç kanë zbritur. Ky është kumtimi me të cilin është ngarkuar. Allahu thotë: ﴿يَا أَيُّهَا الرَّسُولُ بَلِّغْ مَا أُنزِلَ إِلَيْكَ مِنْ رَبِّكَ﴾ "O ti i dërguar! Komunikojë atë që t'u zbrit prej Zotit tënd." [El-Maide: 67]. Kujdesi i Muhammedit alejh'is-selam për kumtim e bënte që ta lëvizë gjuhën me qëllim që mos ta harroj. Për këtë, Allahu i zbriti atij:

لِنُعْجَلَ بِهِ إِنَّ عَلَيْنَا جَمْعَهُ وَقُرْآنَهُ ﴿لَا تُحَرِّكْ بِهِ لِسَانَكَ﴾

"Ti (Muhammed) mos e shqipto atë (Kur'anin) me gjuhën tënde për ta nxënë atë me të shpejtë! Sepse Ne e kemi për detyrë tubimin dhe leximin e tij!" [El-Kijame: 16-17]. Ibn Abasi në lidhje me këtë ajet ka thënë: "Bëje tubimin e tij në zemrën tënde dhe më pas ua lexon." ﴿فَإِذَا قَرَأْتَ فَاتَّبِعْ قُرْآنَهُ﴾ "E kur ta lexojnë atë ty, ti përcille me të dëgjuar leximin e tij." [El-Kijame: 18] Në lidhje me këtë ajet ka thënë: dëgjoje atë me vëmendje. Më pas duhet ta lexosh. Ka thënë: Kur vinte Xhibrili alejh'is-selam, Muhammedi alejh'is-selam e dëgjonte, po kur shkonte ai, Muhammedi alejh'is-selam e lexonte siç ia kishte lexuar Xhibrili".<sup>352</sup> Muhammedi alejh'is-selam e ka lexuar para njerëzve me shprehjen e tij të qartë arabe, ashtu siç i ka ardhur nga Besniku i shpalljes Xhibrili alejh'is-selam. Leximi i Kur'anit

<sup>350</sup> El-Buhari, *Sahih'ul-Buhari*, vepër e cituar, hadithi nr. 3424, fq. 659.

<sup>351</sup> Fadl Hasan Abbas, *Kisas'ul-Kur'an'il-Kerim*, Aman: Dar'un-Nefaisi li'n-neshri ve't-tevzi'i, bot. 3, 2010, fq. 652-657.

<sup>352</sup> El-Buhari, *Sahih'ul-Buhari*, vepër e cituar, hadithi nr. 7524, fq. 1860.

me gjuhën e Muhammedit alejh'is-selam është sqarim me kuptim të qartë. Allahu ka thënë: ﴿لَكُمْ إِنَّا عَلَيْنَا بَيِّنَاتٌ﴾ “Dhe pastaj është obligim yni që ta shkoqisim (sqarojmë) atë.” [El-Kijame: 19]. “Me “sqarim” këtu, nënkuptohet sqarim i fjalëve, e jo i kuptimeve, ngase sqarimi i kuptimit është i lidhur ngushtë me theksimin e fjalëve”.<sup>353</sup>

Jeta e Muhammedit alejh'is-selam me shokët e tij, mënyra e kumtimit të Kur'anit dhe zbritja e dispozitave dhe këshillave të tij në sfera të ndryshme të jetës: në raste të vështira dhe të lehta, në varfëri dhe pasuri, në luftë dhe paqe, në traditat e hajes, pijes, veshjes dhe banimit, me të vegjlit dhe të mëdhenjtë, me shokët dhe armiqtë, në çështjet e udhëheqjes, politikës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, në çështjet e veçanta të jetës personale, familjare dhe shoqërore, në të gjitha këto raste jeta e Muhammedit alejh'is-selam ishte model rreth asaj që dëshiron Kur'ani ta realizon në jetën e njerëzve. Sjelljet e Muhammedit alejh'is-selam në të gjitha këto raste dhe raste tjera me të cilat ballafaqohet njeriu në jetën e tij të zakonit dhe jo të zakonit, ishte edukim dhe pastrim shpirtëror për gjeneratën e sahabëve. Kjo edukatë dhe ky pastrim ka prodhuar një gjeneratë të dalluar dhe një model për pasim, ngase kishin kuptuar intencat e Kur'anit dhe intencat e sunetit.

Allahu kishte mundësuar që muslimanët të verifikojnë dhe regjistrojnë udhëzimet peygamberike në mënyrë të detajuar. E gjithë kjo përfshin atë që është e njohur me emrin *sunet* dhe *sire*. Është verifikuar në atë mënyrë që historia njerëzore nuk njih diç të tillë se ka ndodhur më parë e as se ka me ndodhur. Me anë të këtij verifikimi të detajuar, suneti është bërë burim i mundshëm për udhëzim me te në cilëndo sferë prej sferave të jetës. Nëse koncentrohemi në anën edukativo-arsimore, do të vërejmë se e tërë jeta e Muhammedit alejh'is-selam ka qenë edukim, arsimim dhe pastrim. Arsimim të tekstit kur'anor, dispozitave dhe këshillave të tij, stilistikën gjuhësore, rrëfimet dhe shembujt. Arsimim në metodat e mendimit dhe hulumtimit, format e prezantimit dhe

<sup>353</sup> Ibn Ashur, *Tefsir'ut-Tahriri ve't-tenviri*, vepër e cituar, vëll. 29, fq. 350.

shprehjes gojore. Edukatë praktike në mënyrën e bashkëveprimit dhe sjelljes. Pastrim moral i ndjenjave dhe zemrës. E gjithë kjo, si mund të mos jetë burim i mendimit pedagogjik islam, mendim të cilin e kanë formuar gjeneratat e umetit islam gjatë historisë dhe burim i mendimit pedagogjik bashkëkohor islam, të cilin dëshirojmë ta formojmë për sot dhe nesër?!

### 3. Vlera e trashëgimisë pedagogjike islame si burim:

Ne besojmë se Kur'ani është burim bazë i këshillave dhe dispozitave pedagogjike. Besojmë se suneti është burim sqarues e këtyre këshillave dhe dispozitave. Besojmë se veprimi sipas këtyre këshillave dhe dispozitave është çështje obligative. Besojmë se Kur'ani dhe suneti nuk janë pjesë e trashëgimisë. Për këtë, metodologjia e veprimit tonë me trashëgiminë si burim i mendimit pedagogjik do të jetë ndryshe nga qëndrimi jonë ndaj Kur'anit dhe sunetit pejgamberik.

Trashëgimia është element bazë për ngritjen e vetëdijet kulturore, civilizuese dhe shoqërore. Në veçanti trashëgimia pedagogjike e rrënjosur në mendim dhe praktikë, e cila në të shumtën e rasteve ndikon në formimin e personalitetit të individit dhe shoqërisë në formë të pavetëdijshme. Nëse trashëgimia pedagogjike islame për të cilën jemi duke folur është gjithë ajo që është shkruar nga ana e dijetarëve rreth mendimit dhe praktikës në sferën e edukatës dhe arsimit, e jo shpallja dhe suneti pejgamberik, atëherë është obligative hulumtimi analitik dhe kritik i trashëgimisë, për të bërë dallimin mes komponentëve të tij, mënyrën e veprimit dhe formulimit historik dhe bashkëkohor. Në këtë rast, studimi analitik dhe kritik pritet të nxjerr në shesh disa rezultate. Rezultati më i rëndësishëm është vërtetimi i llojshmërisë së gjerë në materien e trashëgimisë, shkollat dhe nivelet e tij, ndryshimi dhe zhvillimi i cili ka ndodhur në kohëra dhe vende të ndryshme dhe prezenca e disa elementeve metodologjike të cilat do të na ndihmojnë në përcaktimin e vlerës së trashëgimisë në jetën tonë pedagogjike bashkëkohore.

Ndoshta element metodologjik më i rëndësishëm është hulumtimi në trashëgimi në cilësinë e një prodhimi kohor dhe historik, së pari si procesi i regjistrimit dhe së dyti si shprehje e ngjarjeve dhe ndodhive në të cilat realizohet regjistrimi. Ngjarjet dhe ndodhitë shprehin gjendjen e shoqërisë njerëzore, progresin e botës -siç shprehej Ibn Halduni- dhe ndryshimet e ndryshme që i ndodhin këtij progresi. Nëse realiteti i trashëgimisë është i përzier me realitetin e historisë, atëherë, kjo do të përcaktojë formën të cilën trashëgimia mund të jetë burim i mendimit pedagogjik bashkëkohor. Në trashëgimi, ashtu si edhe në histori, ka ngritje dhe rënie, përparim dhe prapambetje. Andaj, është patjetër të kemi një referencë për të përcaktuar se çka mund të marrim e çka jo.

Më parë -në mënyrë të detajuar- potenciam metodologjinë e bashkëveprimit me trashëgiminë pedagogjike islame. Bëmë dallimin mes dy qëllimeve për bashkëveprim me këtë trashëgimi. Qëllimi i parë është realizimi i qëllimeve shkencore historike që është i veçantë për kuptimin e realitetit historik për të cilin flet historia përfshirë kohën, vendin dhe gjendjen, ose bashkëveprimi me trashëgiminë bëhet për qëllime shkencore teorike, që është i veçantë për kuptimin e materies së trashëgimisë dhe pozitën e saj në kontekstet e kohës dhe të vendit, dukuritë e përplotësimit njohës mes elementeve të saj, gjendjen e zhvillimit si përgjigje ndaj risive të kohës dhe zbulimin e disa faktorëve dhe ndikimeve të cilat kanë ndikuar në prodhimin e kësaj trashëgimie.

Qëllimi i dytë është realizimi i qëllimeve për veprim që është i veçantë për detyrat dhe zbatimin praktik të mendimeve që gjenden në trashëgimi dhe të cilat mund të kontribuojnë në ngritjen e jetës sonë pedagogjike bashkëkohore. Në këtë sferë, do të jetë e mundshme që trashëgiminë ta shfrytëzojmë për realizimin e qëllimeve të mëposhtme:<sup>354</sup>

1. Formimi i vetëbesimit, krenaria me identitetin dhe përkatësia ndaj një populli që ka histori. Për historinë e këtij populli flet vet trashëgimia për disa nga arritjet e tij, duke

<sup>354</sup> Detajet në lidhje me këtë çështje lexoi në:

Melkavi, Et-Turath' ut-terbeviyy' ul-islamijju: halet' ul-bahtih fihi, ve lemehatun min tetavvurihi ve kutufun min nususihi ve medarisihi, vepër e cituar, fq. 459-464.



theksuar se si ka kontribuar ky popull në zhvillimin e jetës njerëzore përmes arritjeve dhe zbulimeve shkencore. Kështu gjeneratat e mëvonshme nxiten për të kontribuar drejt civilizimit ashtu siç kishin kontribuar gjeneratat e mëhershme. Ndonëse, sistemet politike dominuese në shoqëritë e reja njerëzore i kanë marrë shumë nga veçoritë e këtyre shoqërive, megjithatë sistemi politik në cilindo shtet bazohet në sistemin arsimor i cili bën nxënësit të mburren me përkatësinë dhe identitetin e tyre, duke ua përkujtuar atyre arritjet për të cilat ftet trashëgimia.

2. Zbulimin e sekretit të fuqisë së shoqërisë islame në disa periudha dhe lidhshmërinë e kësaj fuqie me sistemin pedagogjik i cili dominonte asokohe. E gjithë kjo me qëllim të formimit të një plan-programi i cili do t'ju mundëson pedagogëve bashkëkohorë përfitimin prej saj, duke përdorur -në të njëjtën kohë- edhe analizën kritikuese ndaj kësaj trashëgimie, ngase ajo shprehë gjendjen e njohurisë shkencore të sistemit pedagogjik dhe gjendjen civilizuese që e përjetonte shoqëria asokohe. Gjendja e njohurisë dhe gjendja e civilizimit ishin në ndryshim të vazhdueshëm, herë në ngritje e herë në rënie. Për këtë, atë që e paraqet trashëgimia pedagogjike rreth ndryshimit dhe zhvillimit, do të jetë e rëndësishme për zbulimin e faktorëve të ngritjes apo ngeçjes civilizuese, si dhe mësimet që mund shoqëria bashkëkohore t'i përfitojë nga rezultatet e studimit të trashëgimisë për këtë qëllim.

3. Hulumtimi në trashëgimi rreth alternativave të mundshme në normat e arsimit bashkëkohor, të cilat shoqëritë islame i kanë përvetësuar nga eksperiencia perëndimore ose u janë imponuar atyre gjatë periudhës së kolonializmit dhe nuk ka pasur mundësi të lirohen prej tyre.

4. Kryerja e një detyre gjuhësore, e cila sqaron se si gjuha arabe ka pasur mundësi t'i ngërthejë risitë e njohurive njerëzore në periudhat historike, në të cilat janë shkruar. Kjo detyrë shtrihet në atë mënyrë që fjalët dhe formulimet gjuhësore do të jenë mjete për studimin e historisë dhe ideve dhe zhvillimin e terminologjisë. Nga ana tjetër, gjuha e trashëgimisë është një

referencë e rëndësishme në përpilimin e një fjalori bashkëkohor në terminologjinë e shkencave pedagogjike.

5. Kryerja e një detyre arsimore. Gjatë gjitha periudhave historike, mendja e njeriut ka qenë shumë e kujdesur për të formuar një fotografi ndaj gjësendeve dhe ndodhive, si dhe kuptimeve që bartnin ato. Për këtë arsye themelohen mezeje, të cilat prezantojnë disa nga arritjet trashëguese, qofshin sende të shkruara me llojet dhe mjetet e tyre, apo sende të gdhendura me format e tyre, apo sende të vizatuara me format dhe ngjyrat e tyre, apo rroba për veshje me llojet e tyre. Kështu, muzetë janë bërë vende të rëndësishme të cilat vizitohen nga hulumtuesit dhe studentët.

6. Kryerja e një detyre civilizuese reformuese. Trashëgimia pedagogjike islame bazohej në parimet islame, të cilat përpjekjet për zhvillimin e jetës dhe reformimin e mjeteve të saj e konsideronte farz në praktikë dhe një sunet (traditë) e zbatuar. Trashëgimia zbulon nivelin e realizuar të kësaj përpjekje dhe reformimi, duke i dhënë gjeneratës bashkëkohore mësim në përdorimin e eksperiencës historike për të vazhduar në reformim dhe kreativitet. Kështu marrin të dobishmen dhe e anashkalojnë të dëmshmen.

Ajo që bie në sy se pjesa dërrmuese e materies së trashëgimisë pedagogjike islame sillet rreth tri koncepteve kryesore, të cilat përbëjnë kushtet e procesit pedagogjik në të kaluarën dhe sot, ngase secila prej tyre ka vlerë të veçantë. Këto tri koncepte janë: arsimi, mësimnxënia dhe mësimdhënia. Ndoshta shkak për këtë është nxitja e tepërt për këto koncepte në Kur'an dhe sunetin pejgamberik. Gjeneratat e para të muslimanëve e kishin kuptuar vlerën e kësaj nxitjeje. Ata nxorën popullatën nga analfabetizmi që dominonte në mesin e arabëve në një popull që lexonte, shkruante dhe kishte arritje shkencore dhe civilizuese në të gjitha fushat. Duhet kuptuar se ky transferim nuk është realizuar përnjëherë, por me anë të kuptimit të zhvilluar dhe zbatimeve praktike.

## 4. Shembuj për përdorimin e trashëgimisë në çështje pedagogjike bashkëkohore

Në një vend tjetër zgjodhëm shtatë shembuj prej çështjeve të trashëgimisë pedagogjike islame, për të sqaruar rëndësinë e studimit të trashëgimisë dhe kuptimin e pozitës së saj në eksperiencën pedagogjike islame gjatë historisë, si dhe si mund që rezultatet e këtij studimi të reflektohen në praktikat tona pedagogjike bashkëkohore. Këto shtatë çështje ishin: pozita e mësuesit në trashëgiminë pedagogjike islame, plan-programet mësimore në trashëgiminë islame, metodat mësimore në trashëgiminë pedagogjike islame, letërsia dhe letrari në trashëgiminë islame, vendet mësimore në trashëgiminë pedagogjike islame, vakëfet me karakter mësimor në trashëgiminë islame dhe diplomat mësimore në trashëgiminë islame.

Mendojmë se është e dobishme në këtë pjesë të librit, lexuesi të rikujton atë që e theksuam më parë. Këtu do të mjaftojmë të theksojmë vetëm dy shembuj që kërkojnë konfirmim rreth gjendjes të cilën e zbulon trashëgimia pedagogjike islame dhe mënyrën se si duhet të bashkëveprojmë me trashëgiminë e veçantë për secilin prej tyre në jetën pedagogjike bashkëkohore. Këto dy shembuj janë: obligueshmëria e arsimit dhe pozita e mësuesit.

### 4.1. Obligueshmëria e arsimit

Parimin e obligueshmërisë së arsimit sot e kuptojmë si domosdoshmëri civilizuese të cilën e kërkon sheriati dhe ligji, pa marrë parasysh shfrytëzimin e trashëgimisë pedagogjike islame në të kuptuarit apo zbatimin e këtij parimi në një periudhë të caktuar. Është e qartë nga përvoja trashëguese se dijetarët muslimanë, nga ajetet kur'anore dhe suneti pejgamberik, kanë kuptuar parimin e obligueshmërisë së arsimit për çdo musliman, si dhe obligueshmërinë e prindërve për të siguruar mundësinë e arsimit për fëmijët e tyre. Disa halifë dhe emirë kanë zbatuar këtë obligueshmëri në provincat e tyre. Këtu janë përfshirë edhe dërgimi i mësuesve, sigurimin e nevojave financiare me qëllim që studenti të jetë i lirë për

kërkim të diturisë, sigurimi i kërkesave jetësore si banimi, ushqimi dhe veshja për studentët të cilët merren vetëm me studim. Disa prej dijetarëve, parimin e obligueshmërisë së arsimit e kanë kuptuar si përgjegjësi të prindërve, e jo të shtetit. Përgjegjësia e prindërve realizohet duke pasur dëshirë në shpërblimin e Allahut dhe duke u frikësuar prej dënimit të Tij. Pushtetari duhet të përpiqet të zbatoj këtë parim, ndërsa përgjegjësia e nxënësve, mësuesve dhe përgjegjësve të fëmijëve në zbatim, mbetet si bindje ndaj pushtetarit, e cila në të njëjtën kohë është edhe çështje sheriatike.

Parimi i obligueshmërisë së arsimit ndërlihet me shumë çështje të punës praktike dhe arsimore në shoqëri. Të gjitha këto çështje janë kuptuar në forma të ndryshme, ndërsa kuptimi i gjeneratave është zhvilluar me anë të zbatimit praktik. Përgjegjësia e shtetit në përgjithësimin e arsimit dhe zhdukjen e analfabetizmit, e drejta në arsim, pranimi i pagës për arsim, radhitja e lëndëve mësimore, përcaktimi e metodave të lejuara për edukim dhe kontrollimi i sjelljes, sistemi i diplomimit etj. Ka ndryshuar nga koha në kohë dhe iu ka nënshtruar ixhtihadeve të ndryshme. Kështu, çështja ka pasur nevojë për zhvillim derisa të stabilizohen disa parime të përgjithshme, të cilat kontrollojnë zbatimet praktike në arsim.

Nëse parimi i obligueshmërisë së arsimit të fëmijëve dhe përgjegjësia ndaj këtij arsimimi është theksuar në tekstet e trashëgimisë pedagogjike islame, atëherë, shteti a ka qenë i interesuar për zbatimin e këtij parimi apo çështja ka qenë përgjegjësi e prindërve? Siç duket, kjo çështje nuk ka qenë e kryer. Ajo ka ndryshuar me ndryshimin e rrethanave dhe pushtetarëve. Shpirti islam dhe intencat e tij, obligueshmërinë e arsimit në shoqëritë islame bashkëkohore e bëjnë parim elementar që kërkon sjelljen e ligjeve të nevojshme për zbatimin e tij. Në kuptimin tonë ndaj këtij parimi dhe domosdoshmërinë e zbatimit të tij, mund të mbështetemi në tre burime.

I pari: kuptimi bashkëkohor i ajeteve kur'anore dhe sunetit pejgamberik.

I dyti: zbatimi i mendimeve të gjalla të disa praktikave mësimore në trashëgiminë islame.

I treti: përdorimi i eksperiencave pedagogjike bashkëkohore të dobishme për popullin dhe bashkëveprim i urtë me risitë e kohës, vendit dhe situatave.<sup>355</sup>

#### 4.2. Pozita e mësuesit

Është e përshtatshme të theksojmë se pozita e mësuesit në trashëgiminë islame është lidhur me pozitën e Alimit (dijetarit), i cili ishte epiqendër e lëvizjes shkencore dhe arsimore në shoqërinë islame. Shprehja “el alim - dijetar” në trashëgimi është përdorur për cilësimin e personaliteteve të cilat kanë arritur suksese me vlerë në sfera të ndryshme shkencore, si në: hadith, fikh, tefsir, përfshirë edhe mjekësinë, filozofinë, matematikën, astronominë etj. të gjithë ata janë konsideruar dijetarë, ku shumica e tyre kanë qenë të njohur në më shumë se një shkencë. Shumica e këtyre dijetarëve kanë qenë mësues. Nxënësit kanë shkuar tek ata për të mësuar, janë ndje krenarë që kanë mësuar tek ata dhe janë mburrur që emrat e tyre si nxënës të lidhen me emrat e mësuesve të tyre. Për këtë, sa herë që shkruhet biografia e ndonjërit prej dijetarëve, gjendet edhe një pjesë e rëndësishme që flet për mësuesit dhe profesorët nga të cilët ka marrë dituri, dhe një pjesë tjetër po ashtu e rëndësishme që përfshin emrat e nxënësve. Kështu kur dijetari është alim dhe muhadith i specializuar në transmetimin e hadithit, është e drejtë që fjalët ndaj muhadithit të llogariten edhe fjalë ndaj mësuesit.<sup>356</sup>

Shikuar në atë që e dimë rreth shkollave pedagogjike, juridike, filozofike, sufiste<sup>357</sup>..., shprehja “shejh” në shkollën sufiste nënkupton personin që është i angazhuar me edukimin dhe arsimimin e muridinëve, respektivisht nxënësve. Gazaliu

<sup>355</sup> Ekzistojnë hulumtime të shumta të cilat përfshijnë çështje të caktuara të shkencave pedagogjike. Autorët për çdo çështje kanë grumbulluar tekstet nga Kur’ani, suneti pejgamberik dhe trashëgimia islame. Sa për ilustrim sjellim çështjen e obligueshmërisë së arsimit. Në lidhje me këtë, lexo:

El Ali, Salih. “Et Ta’limul ilzami fil Kur’ani ves suneti ve fikhil eimeti”, Mexhel-letu xhamiati Dimeshk li’l-ulum’il-iktisadijati ve’l-kanunijeh, vëll. 22, nr. 2, 2006, fq. 459-465.

<sup>356</sup> Librat e trashëgimisë që kanë folur rreth edukatës së dijetarit, mësuesit dhe nxënësit janë të shumta, sidomos në sferën e transmetimit të hadithit pejgamberik. Mësuesi këtu është i njëjti edhe muhadith siç theksohet në librin e Hatib Bagdadit “*El-Xhamiu li ahlak’ir-Ravi ve adab’is-sami’i*” dhe në librin “*Edeb’ul-ilmal ve’l-istimlai*” të Sem’anit etj.

<sup>357</sup> Melkavi, *Et-Turath’ut-terbevijj’ul-Islamijju: halet’ul-bahthi fihi, ve lemehatun min tetavvurihi ve kutufun min nususihi ve medarisih, vepër e cituar*, fq. 251-334.

ka thënë: “Sa i përket edukimit (te’dib) me këtë kemi për qëllim ushtrimi i tjetrit. Kështu është gjendja e shejhit sufist me nxënësit e tij. ai nuk mund t’i edukon ata përpos me përzierje me ta. Gjendja e tij është si gjendja dhe dispozita e mësuesit”.<sup>358</sup>

Trashëgimia pedagogjike islame, sa i përket pozitës së mësuesit, është bazuar në ajete kur’anore dhe sunetin pejgamberik. Kur’ani ka folur për Muhammedin alejh’is-selam në cilësinë e mësuesit. Vetë Muhammedi alejh’is-selam ka cilësuar veten e tij se është mësues. Sahabët në lidhje me të kanë thënë: nuk kemi parë mësues më të mëshirshëm se Muhammedi alejh’is-selam.

Të shumta janë ajetet kur’anore dhe hadithet pejgamberike që ngrenë vlerën e mësuesit dhe rrisin pozitën e tij. Të njëjtën gjë e ka bërë edhe trashëgimia, ka ngritur vlerën e diturisë dhe pozitën e dijetarëve, si dhe ka konfirmuar se njerëzit janë ose mësues ose nxënës. Po ashtu, në lëndën e trashëgimisë, gjejmë se pozitën e lartë të dijetarit dhe mësuesit në realitet e llogarisin si e vërtetë e natyrës njerëzore, të vërteta të realitetit shoqëror njerëzor të secilit popull, në secilin civilizim, si dhe gjë e shprehur në gjuhët e filozofëve dhe të urtëve nga çdo popull. Historia njerëzore ka njohur mësues në çdo shkencë dhe zanat. Këtë e ka potencuar Ibn Halduni duke thënë: “Për këtë, mbështetja në arsim në çdo shkencë apo zanat ishte te mësuesit e njohur, në të gjitha gjeneratat, në çdo vend dhe çdo kohë”.<sup>359</sup>

Nëse ky ishte një rregull i përgjithshëm në qëndrimin e trashëgimisë ndaj pozitës së mësuesit, në trashëgiminë pedagogjike islame gjejmë një përjashtim nga ky rregull, kur flet rreth rasteve kur mësuesi nuk ka gëzuar këtë pozitë të lartë. Këto raste dhe shkaqet që kanë çuar deri tek ato janë një temë e rëndësishme për hulumtim dhe studim. A kanë depërtuar në fushën e arsimit dhe arsimimit njerëz që nuk kanë merituar të jenë aty dhe kanë humbur pozitën e lartë të respektit

<sup>358</sup> Ebu Hamid ibn Muhamed El-Gazali, (v. 505 h./ 1111), *Ihjaw ulum’id-din*, Beirut, El-Mektebet’ul-asrijiyh, bot. 1, 2004, vëll.2, fq. 324.

<sup>359</sup> Ibn Haldun, *Mukadimetu Ibn Haldun*, vepër e cituar, fq. 925.

që e gëzonte mësuesi apo çështja është e kufizuar me një fushë të caktuar të arsimit që ka pasur rrethana të veçanta?

Vendet në të cilat depërtoi Islami ishin shumë të gjera. Aty flitej për ftesë në kërkimin e diturisë, mësimnxënies dhe mësimdhënies në të gjitha fushat. Në këso rrethana, ishte patjetër të themelohen institucione arsimore të të gjitha llojeve dhe niveleve dhe të ketë mësues që kryejnë detyrën e arsimit në to. Siç shihet, në disa vende, kjo çështje realizohej pa ndonjë plan të verifikuar, pa siguruar vendin e përshtatshëm dhe mësuesin e përgatitur. Kështu, institucioni dhe vetë mësuesi ishin jo në nivelin e duhur në aspektin material, shkencor dhe moral, çështje të cilat i kërkon dinjiteti i procesit arsimor. Në disa tekste të trashëgimisë kemi raste ku pozita e lartë e mësuesit ka imponuar që ai të lirohet nga disa përgjegjësi tjera, siç janë: përgjegjësia e xhihadit (luftës) dhe qëndrimi në roje të atdheut. Duke shfrytëzuar këto mundësi, disa të paaftë dhe të pandërgjegjshëm janë marrë me arsimim. Si rezultat i kësaj çështje, ekzistojnë tekste nga trashëgimia që përshkruajnë gjendjen e mjerueshme të arsimit dhe flasin për mësuesin duke e cilësuar se është shembull në paaftësi dhe marrëzi. Sidomos, kur dimë se mësuesi -në këso raste- merrte pagë shumë të vogël dhe detyrohej për të përdorur metoda për bashkëveprim me nxënësit dhe përgjegjësit e tyre, gjë e cila shkaktonte humbjen e dinjitetit para vetes dhe para njerëzve.

Është me rëndësi të vrojtohet se raste të tilla në të shumtën e rasteve ishin të veçanta për arsimin në mektebe, pra arsimin fillor, ngase këta mësues përshtateshin me nxënësit e tyre. Rëndësia e këtij vrojtimi është si rezultat i rëndësisë së periudhës arsimore. Ajo është periudha e fëmijërisë dhe periudha e arsimit bazik në fe, gjuhë, edukatë, shkathtësi jetësore, dhe edukim në moralin, vlerat dhe traditat e shoqërisë. Zakonisht në këtë periudhë, numri i fëmijëve është i madh, gjë që kërkon sigurimin e një numri të madh të mësuesve. Një edukim i mirëfilltë në këtë periudhë është përgatitje për periudhat tjera edukative, arsimore dhe praktike të jetës shoqërore.

Është tepër e rrezikshme që arsimi në këtë periudhë të lihet në mundësitë e përgjegjësve të fëmijëve, pa planifikim dhe inspektim nga administrata rajonale ose qendrore. Në veçanti kur kemi në konsideratë obligueshmërinë e arsimit, për të cilën nuk dyshojmë në ligjshmërinë e saj dhe rëndësinë e zbatimit të këtij parimi ndaj të gjithë fëmijëve. E gjithë kjo me qëllim të realizimit të çrrënjosjes së analfabetizmit në fazat e hershme të jetës së fëmijëve dhe me qëllim të realizimit të arsimit të përshtatshëm për atë që llogariten si farz ajn (obligativ) për secilin dhe farz kifaje (alternativ).

Atë që e ka verifikuar trashëgimia islame rreth dukurisë së rënies së pozitës së mësuesit në shoqëri, mund të jetë e veçantë për mektebet dhe mësuesit e fëmijëve, e jo për dijetarët e specializuar, të cilët ishin të dalluar në një shkencë të caktuar dhe janë dalluar me shkrimet e tyre shkencore të specializuara. Dijetarë të tillë, në mënyrë vullnetare mbanin ligjërata në xhami ose në shtëpitë e tyre. Kemi hasur se disa shkolla i ndërtonte vetë mësuesi, ose ndërtoheshin për të dhe në emrin e tij, duke ndarë për te vakëfe të mjaftueshme që ruante pozitën dhe dinjitetin e dijetarit mësues.

Sa i përket rasteve të mësuesve të fëmijëve, ku theksohet rënia e pozitës dhe dinjitetit të mësuesve në disa raste, ajo ishte e veçantë për disa persona që kishin pak dituri, ishin përtacë dhe të pandërgjegjshëm. Ka mund të ketë raste kur shoqëria nuk i ka ofruar kushte të nivelit që ruan dinjitetin e mësuesit, në këtë mënyrë ka ra pozita e tij para vetes, ku më pas pozita e tij para shoqërisë më nuk ishte e rëndësishme. Shkak tjetër ka mundur të jetë edhe pakujdesi i inspektorëve dhe papërgjegjësia e tyre në kontrollimin e mësuesve dhe procesit mësuesor, ku si rezultat i saj është edhe dobësia e institucioneve të cilët organizojnë procesin mësuesor.

Sot më e kemi të qartë se sigurimi i programeve të përshtatshme për përgatitjen e mësuesve dhe edukatorëve për periudhën e fëmijërisë, nuk është më pak e rëndësishme se programet e nevojshme për periudhat tjera. Thënë ndryshe, nevojat për të qenë mësues dhe edukatorë në periudhën e fëmijërisë, siç janë përgatitja psikologjike, shkencore dhe



praktike, kujdesi dhe respekti ndaj tij dhe nevojat e institucioneve arsimore të kësaj periudhe si planifikimi, këshillimi dhe inspektimi, janë shumë më të mëdha se ato që kërkohen në periudhat tjera.

Kështu, potenciam disa detyra që mund t'i kryen trashëgimia pedagogjike islame, gjë që i mundëson të jetë burim i mendimit pedagogjik bashkëkohor islam. Është e qartë se mendimi pedagogjik të cilin e kanë ofruar dijetarët muslimanë në shkrimet dhe praktikat e tyre, që nga periudha e regjistrimit deri para ndikimit të shoqërive islame me Perëndimin, në pjesën dërrmuese të tij është bazuar në Kur'an dhe sunetin pejgamberik. Si rezultat i kësaj, ky mendim -i cili për neve është trashëgimi pedagogjike- konsiderohet eksperiencë historike në kuptimin e teksteve kur'anore dhe pejgamberike dhe zbatimi praktik i tyre. Përvoja historike, gjithsesi është e dobishme edhe kur qëllon edhe kur gabon. Në Kur'an dhe sunetin pejgamberik ka udhëzime, të cilat duhet zbritur në jetën reale të njerëzve. Në to ka intenca të fesë dhe dobi për njerëzit, të cilat nëse nuk zbatohen do të sjellë dëm për gjithë ata që nuk i zbatojnë. Zbritja e këtyre udhëzimeve në jetën reale është përpjekje njerëzore, ku ndonjë herë do të ketë sukses, e herëve tjera do të ketë gabime dhe mangësi, që shpie në mosrealizimin e intencave dhe humbjen e dobive. Është shumë gjë e mençur që t'i kemi të qarta këto raste dhe të përpiqemi t'i largojmë ato.

Kur t'i kemi të qarta problemet të cilat i potencon trashëgimia pedagogjike islame dhe pasojat të cilat i ka sjellë moszbatimi i udhëzimeve kur'anore dhe pejgamberike, në këtë rast do të jemi mirënjohës ndaj trashëgimisë se na ka tërhequr vëmendjen ndaj tyre, me qëllim të mos përsëriten prapë. Megjithatë ndonjëherë vërejmë se materia e trashëgimisë nuk ka treguar në mënyrë të qartë mangësitë dhe gabimet, ngase detyra e tekstit të trashëgimisë ka mjaftuar vetëm duke përshkruar praktikat pedagogjike që dominonin në kohë dhe vend. Për neve sot, dhe për ata që vijnë pas neve mbetet të realizojnë analizimin dhe vlerësimin e këtyre teksteve të tra-

shëgimisë, me qëllim të zbulimit të problemeve shoqëruese dhe rezultateve negative në shoqërinë islame asokohe.

Me këtë, përfundojmë se aspak nuk ka dyshim në domosdoshmërinë e përfitimit nga trashëgimia pedagogjike islame, me qëllim që të marrim anët pozitive në programin kur'anor dhe pejgamberik në gjendjen e shoqërisë islame dhe risitë e saj, çka ka realizuar ky praktikim prej intencave dhe dobive, si dhe mësim nga mangësitë, paaftësitë dhe gabimet që kanë mundur të ndodhin.

## Pjesa e katërt:

# Përvoja pedagogjike bashkëkohore si burim i mendimit pedagogjik bashkëkohor islam

Në tre pjesët e mëparme të këtij kapitulli trajtuam në mënyrë të shkurtër tre nga burimet e mendimit pedagogjik islam bashkëkohor: Kur'ani Famëlartë, suneti pejgamberik dhe trashëgimia islame. Është koha të bisedojmë në mënyrë të shkurtër për burimin e katërt, respektivisht për përvojën bashkëkohore njerëzore.

Trashëgimia islame ishte përvoja e gjeneratave që kanë prodhuar këtë trashëgimi, përvoja në zbritjen e dispozitave në jetën reale, si dhe përpjekje për realizimin e intencave ndaj gjendjes së gjeneratave dhe rrethanave të kohës dhe vendit të tyre. Andaj, trashëgimia pedagogjike islame është përvoja e kësaj zbritjeje të dispozitave në jetën reale.

Ne, duke pasur në konsideratë përvojën në kohën tonë sot, vazhdojmë ndërtimin e përvojës bashkëkohore në realizimin e intencave të Islamit, dispozitave pedagogjike dhe zbritjen e tyre në jetën tonë reale. Mirëpo, fatkeqësisht, muslimanët gjatë tre shekujve të fundit janë ndalur dhe nuk kanë vazhduar në ndërtimin e kësaj përvoje. Në kohë, kur zhvillimet e një-pasnjëshme të cilat i arritën shoqëritë tjera çuan drejt ndërtimit të përvojave pedagogjike që siguruan përhapje në të gjitha shoqëritë, përfshirë edhe ato islame, të cilat vuanin nga dobësia, ngurtësia dhe kolonializmi.

Shoqëritë tona bashkëkohore islame, në sferën pedagogjike, e gjejnë veten sot ballë për ballë me përvojat bashkëkohore njerëzore. Andaj, kjo përvojë bashkëkohore pedagogjike a duhet të jetë pjesë e sfidave që gjithsesi duhet ballafaquar me to, dhe në të njëjtën kohë, pjesë e shanseve të ofruara që gjithsesi duhet shfrytëzuar?

## 1. Ç'nënkuptojmë me përvojë bashkëkohore pedagogjike?

Çështja e “përvojës” në mendimin pedagogjik vjen në disa sfera. Ajo mund të vjen në sferën e “edukimit me anë të përvojës”, pra, përvoja këtu është metodë prej metodave mësimore.<sup>360</sup> Mirëpo, në këtu me shprehjen përvojë, kemi për qëllim njohuritë që i përfiton individi apo shoqëria në atë mënyrë që çështja në mënyrë reale bëhet e njohur. Ajo është rezultat i bashkëveprimit të drejtpërdrejtë me gjësendet, ndodhitë dhe personat, përfshirë këtu edhe eksperiencën praktike, në bazë të së cilës përcaktohet sjellja e individit apo shoqërisë. Andaj, përvoja është ide ose njohje teorike dhe sjellje praktike. Për të ardhur deri te përvoja, kërkohet angazhimi i mendjes dhe shqisave. Përvoja në fund të fundit është dituri dhe vepër.

Përvojat pedagogjike në mënyrë të përgjithshme përfshijnë elementet e diturisë, të cilat i mëson nxënësi, përfshirë të vërteta shkencore, koncepte, parime dhe teori të veçanta për shkencën përkatëse. Po ashtu, përfshihet ndikimi në sjelljen e nxënësve dhe në gjendjen e shoqërisë, i cili vije si rezultat i procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Përvoja njerëzore bashkëkohore në sferën pedagogjike përfshin përvojën e shoqërisë njerëzore në të gjitha vendet e botës. Disa nga këto përvoja janë bërë globale saqë mund t'i hasësh në shumicën e vendeve të botës. Në të njëjtën kohë, vërejmë dallime dhe llojllojshmëri në këto përvoja, ku të gjitha janë në disponim për hulumtim, meditim dhe vlerësim. Deri te çështjet e përbashkëta dhe jo të përbashkëta, shoqëritë kanë arritur përmes parimeve ideologjike të cilat janë zhvilluar përmes përvojës dhe praktikës. Disa nga këto parime kanë arritur në gradën e stabilitetit, ndërsa disa tjera vazhdojnë të zhvillohen dhe të ndryshojnë, ku ndoshta do të vazhdojnë kështu edhe më tutje. Nëse njohim disa parime të cilat cilësohen si të qëndrueshme në orientimin e praktikave për

<sup>360</sup> Esma Beni Jusuf, Imad Sherifejn, “Et-Terbijjetu bi'l-hibreti ve mevkuiha fi't-terbijjet'il-islamijeh”, Dirasat (ulum'ush-sheriatu ve'l-kanun) botim i Universitetit të Jordanisë, vëll. 41, shtojca 2, 2014, fq. 836-853.

realizimin e intencave të caktuara, procedurat dhe mjetet vazhdojnë të ndryshojnë dhe të zhvillohen.

Përvoja bashkëkohore pedagogjike ngërthen në vete, në mënyrë të përgjithshme, filozofitë, sistemet dhe parimet pedagogjike, si dhe praktikrat e ngritura mbi to, të cilat sot, janë të shpërndara në shumicën e vendeve të botës. Edhe krahas dallimeve të shumta në filozofitë dhe praktikrat pedagogjike të cilat i vërejmë në shtetet e botës sot, elementet e përbashkëta mes tyre janë më të rëndësishme se sa format e dallimit dhe me ndikim më të thellë në të shprehurit e gjendjes pedagogjike në botë. Disa prej parimeve pedagogjike janë rrënjësor aq thellë në fushën e mendimit, deri në atë shkallë sa që nuk mund të gjesh kush t'i kundërshtojë ato, ndonëse disa shoqëri nuk i kanë zbatuar plotësisht për shkak të pamundësisë në sigurimin e kërkesave praktike.

Sa i përket bisedës rreth parimeve të mendimit pedagogjik islam sot, në mbështetemi në argumente nga Kur'ani dhe suneti pejgamberik, si dhe në forma të zbatimit praktik të ajeteve dhe haditheve nga trashëgimia islame. Mirëpo, -në realitet- mbështetemi në përvojat tona bashkëkohore pedagogjike, me vetëdije ose pa vetëdije. Parimet e mendimit pedagogjik islam për të cilat jemi duke folur ishin intenca, të cilat islami synonte realizimin e tyre. Gjatë periudhave të ndryshme, nga këto intenca realizoheshin nivele të caktuara, të cilat vareshin nga siguri i mundësive në shoqërinë islame dhe nga përvoja që e përfitonin brenda shoqërisë islame ose nga praktikrat e shoqërive tjera. Përvoja bashkëkohore pedagogjike zbulon para neve sot modele praktike të këtyre intencave, të cilat në disa aspekte i shohim më afër teksteve origjinale fetare.

Jemi të mendimit se nuk ka dëm të rishikojmë komentimin e teksteve nga Kur'ani dhe suneti sipas asaj që e zbulon zhvillimi i jetës njerëzore. Kjo ndoshta është formë e reformave në kuptimin e fesë. Po ashtu, nuk vërejmë se ka pengesë në shfrytëzimin e asaj që e shohim si të dobishme nga zbulimet, mendimet, programet mësimore dhe lehtësimet materiale të popujve tjerë. Mirëpo, duhet të zgjedhim me vetëdije dhe

mprehtësi, e jo në mënyrë të verbëruar. Për këtë duhet të praktikojmë një metodologji analitike kritike që bën dallimin mes të dobishmes dhe të dëmshmes, të përshtatshmes dhe jo të përshtatshmes.

Dëshirojmë të jemi të qartë në çështjen e përfitimit nga përvoja pedagogjike e shoqërive tjera. Ajo nuk është e njëjtë sikur përfitimi nga përvoja e të tjerëve në sferën e ndërtimitarisë dhe çështjeve materiale, të cilat çdo shoqëri mund të përdorë për qëllimet e saj. Importimi i përvojës në shkencat pedagogjike, ngjashëm me te edhe në shkencat shoqërore, psikologjike, ekonomike dhe shkencat tjera shoqërore dhe humane, ka nevojë për një kujdes të madh. Nuk ka rrugëdalje tjetër, përpos asaj që ne duhet të jemi ata që vendosim rreth asaj se çka duhet të marrim e çka jo, e jo eksperti i huaj i cili menaxhon dhe financon përcjelljen e përvojave të tij në shoqëritë tona, ai me kushtet e tij na e ndalon neve të bëjmë dallimin mes alternativave të mundshme për reformim dhe zhvillim, si dhe e shkatërron energjinë mendore të mendjeve tona, me qëllim që -në fund të fundit- shoqëritë tona të bien në gjendje të tjetërsimit dhe humbjes së identitetit.

## 2. Mendimi pedagogjik dhe gjendja civilizuese e shoqërisë

Përpyekja jonë për formimin e mendimit pedagogjik bashkëkohor islam synon përmirësimin e gjendjes dhe ngritjen e popullit tonë, i cili vuan nga prapambetja. Gjykimi ndaj një populli se është i prapambetur dhe se ka nevojë për ngritje është çështje relative. Në rastin e muslimanëve, gjykimi jonë për prapambetjen e tyre shihet në dritën e tri standardeve. I pari: niveli i krenarisë dhe udhëheqjes të cilën e ka dëshiruar Allahu për ta. I dyti: posedimi i mundësive për ngritje dhe i treti: ngritja e shumë popujve tjerë dhe përparimi i tyre civilizues, në aspektin material dhe shpirtëror.

Përpyekja jonë nisët nga supozimi se çrregullimi në mendimin pedagogjik dhe praktika pedagogjike -në masë të madhe- kanë kontribuar për ardhjen deri në këtë gjendje prapambetje. Gjatë tre shekujve të fundit, në mesin e muslimanëve ka

dominuar një gjendje e prapambetjes dhe mbyllje në konceptet e arsimit dhe edukatës. Është përhapur analfabetizmi, ka humbur liria dhe me këtë, popullata ka humbur atë që sistemi pedagogjik të kishte mundësinë e formimit të elementeve të fuqisë, shpirtin reformues dhe motivet kreative. E gjithë kjo ka ndodhur, në kohë kur popujt tjerë garonin në fushat e zbulimit, prodhimit dhe kreativitetit. Posedonin forma të reja të shkaqeve të fuqisë, dominimit dhe përparimit, gjë që shoqëritë islame nuk kishin mundësi të përfitojnë prej tyre në paqe, e as t'u përballojnë atyre në luftë.

Mirëpo, saktësinë e këtij supozimi duhet shqyrtuar. Në çfarë mase gjendja pedagogjike e shoqërisë, reflekton përgatitjen e saj për ngritje apo drejtimin e saj drejt prapambetjes? Përgjigjja ndaj kësaj pyetje kërkon meditim në natyrën e shoqërisë bashkëkohore njerëzore, në të cilën ndërhyjnë aktivitetet ndikuese në atë mënyrë që është vështirë të bëhet ndarja e prerë mes ndikimeve të veçanta të secilit aktivitet. Kështu për shembull, mendimi pedagogjik nuk është i pavarur nga realiteti shoqëror me ndikimet e tij politike, ekonomike, mediatike etj. Ndoshta kjo formë e ndërhyrjes së faktorëve ndikues nuk ka qenë dukuri në periudhat e mëhershme historike. Kjo ndërhyrje e faktorëve ka nevojë për analizim të hollësishëm, i cili ngritët mbi të dhëna të sakta dhe realitete praktike në shoqëritë e botës, me qëllim të kuptimit të secilit faktor ndikues, madhësinë e ndikimit dhe orientimin e tij.

### 3. Njeriu si qëllim dhe mjet i pedagogjisë

Biseda rreth gjendjes pedagogjike të shoqërisë ka përshtirë mendime të caktuara, të cilat si zakonisht i atribuohen shkencave shoqërore, psikologjike dhe pedagogjike. Këto mendime janë bërë parulla të cilat përdoren nga ana e politikanëve dhe gazetarëve. Sa për shembull potencojmë thëniet: “Njeriu është qëllim dhe mjet i pedagogjisë” dhe “Pedagogjia është sëmundje dhe ilaç”.

Nuk ka kundërshtim se pedagogjia është mjet për realizimin e humanitetit të njeriut dhe ia mundëson atij të lirohet nga prangat e injorancës dhe paaftësisë. Andaj, çdo sukses i arsimit është i varur me atë se sa nxënësit përfitojnë vetëdije dhe vetëbesim në veten e tyre dhe sa janë në gjendje të bartin amanetin. Kur'ani e ka thënë këtë të vërtetë, atëherë kur e ka shpallur Ademin mëkëmbës në tokë dhe më pas ia mësoi emrat, të cilat do t'i ndihmojnë për bartjen e këtij amaneti. Po ashtu, Kur'ani e ka thënë këtë të vërtetë, kur Allahu zgjodhi që fillimi i shpalljes të Muhammedi alejh'is-selam të jenë ajetet e leximit, diturisë dhe lapsit.

Në kulturën bashkëkohore është përhapur thënia se arsimi është mjet të cilin e përdorë shoqëria me qëllim të zhvillimit në sfera të ndryshme: politike, ekonomike, shoqërore etj. Përhapja e kësaj thënie është bërë aq e njohur saqë ai që e dëgjon dhe e lexon, nuk ka nevojë për të hulumtuar rreth burimit dhe besueshmërisë së saj. Sikur të kërkoje në internet ndonjë shprehje me këtë kuptim si p.sh.: "Arsimi është makina e zhvillimit" dhe "Arsimi është makina e përparimit", do të vëreje se ato, krahas pedagogëve, përsëriten shumë edhe nga ana e pushtetarëve, politikanëve, mendimtarëve dhe mediaticëve. Kjo, a nënkupton se arsimi është ai që ndërton shoqërinë dhe formon veçoritë e saj, apo shoqëria është ajo që imponon arsimin që dëshiron? S'ka fjalë se kjo pyetje është shumë e rëndësishme për të kuptuar raportin mes arsimit dhe politikës.

Arsimi aktual në shumicën e shoqërive bashkëkohore shihet qartë se është nën ndikimin e politikës. Përcaktimi i sistemeve arsimore, menaxhimi, periudhat, llojet dhe financimi, edhe nëse është i mbështetur në të dhëna shkencore dhe psikologjike, në fund është vendim politik. Përzgjedhja e lëndëve mësimore, programi i çdo lënde, metodat mësimore të cilat i përdorin mësuesit, përfshirë edhe fjalët që i përdorin, lirinë që e gëzojnë nxënësit e tjera, të gjitha këto realizohen përmes vendimeve administrative politike. Procesi edukativo-arsimor është proces politik, edhe nëse mësuesit dhe nxënësit nuk kanë vetëdije të plotë rreth dimensionit politik në punën e tyre. Një analizim i tillë, bëri që Paolo Freire



(1921-1997) të vërejë se arsimit shtetëror është mjet politik për dominim dhe pushtim dhe se ai është i ngjashëm me “arsimin e të pushtuarve”,<sup>361</sup> ngase ky lloj arsimit sjell ndjenjat e pamundësisë dhe humbjes së shpresës. Me këtë, shoqëria do të humbas elementin më të rëndësishëm të zhvillimit dhe përparimit.

Sipas mendimit të Freires kjo nënkupton se shoqëria në pamjen e saj politike është ajo që formon arsimin për realizimin e qëllimeve të saj. Andaj, arsimimi është “proces politik. Kur të zbulojë mësuesi se është aktivist politik, atëherë do të kuptojë se është duke vepruar për një interes të caktuar dhe kundër një interesi tjetër. Në fund do të kuptojë se duhet të jetë konsistent në punën e tij, kështu që nuk duhet nxënësve t’ju flet për ëndrrat e lirisë, ndërsa në ditën e nesërme zbaton ndaj tyre metodën e mbylljes së gojës”.<sup>362</sup>

Pedagogjia ka nevojë për liri që i jep mundësi iniciativave dhe shpërthen energjitë. Në rast të mungesës së lirisë, do të dominojë diktatura, do të vdes kreativiteti dhe do të sundojë kultura e nivelit më të ulët që çështjet e shoqërisë i lenë në të njëjtën gjendje, në kohë kur çdo gjë përreth tij lëvizë, ndryshon dhe zhvillohet. Në shoqëritë diktatoriale mund të ndodhë të importohet filozofia dhe plan-programet pedagogjike, ku në këtë rast do të dominojë invadimi ideologjik dhe arsimor, i cili do të deformojë identitetin e shoqërisë, dhe kështu, arsimit do të bëhet mjet për shkatërrim, e jo për zhvillim.

Duhet pasur parasysh se ndikimi i synuar i procesit edukativo-arsimor nuk është vetëm ndryshimi i individit, por duhet parë ndryshimin që e sjell në shoqëri, ngase ndryshimi i kërkuar është ndryshimi kolektiv. Ndonëse e mira që sjell ndryshim tek individit, do të mund të ketë ndikim në përmirësimin e përgjithshëm dhe do të realizojë ndryshimin e vërtetë në shoqëri.

Në Kur’anin Famëlartë biseda rreth ndryshimit është në formën: o popull. Pra, grup i njerëzve që formon shoqërinë. Kur ky popull përjeton mirësitë dhe begatitë e Allahut,

<sup>361</sup> Paolo Frairi, *Ta’lim’ul-mekhurine*, përkthyes: Nur Avad, Dar’ul-kalem, Bejrut, 1980, fq. 35.

<sup>362</sup> Paulo Freire, & Ira Shor, *A Pedagogy for Liberation: Dialogues on Transforming Education*, Bergin & Garvey Pub, Inc. 1987, fq.46.

Allahu nuk do t'ua ndryshojë atyre këtë gjendje për derisa nuk devijojnë nga rruga e vërtetë dhe të humbin arsyet për shkak të të cilave kanë merituar këto begati. Në lidhje me këtë, Allahu thotë:

﴿ذَلِكَ بِأَنَّ اللَّهَ لَمْ يَكُ مُغَيِّرًا نِعْمَةً أَنْعَمَهَا عَلَىٰ قَوْمٍ حَتَّىٰ يُغَيِّرُوا مَا بِأَنْفُسِهِمْ وَأَنَّ اللَّهَ سَمِيعٌ عَلِيمٌ﴾

“Këtë (masë ndëshkuese) e bëri ngase Allahu nuk ishte ndryshues i një begatie, të cilën ia ka dhuruar një populli, derisa të ndryshojë ai vetë në vetvete (të bëhet përbuzës i së mirës) dhe ngase Allahu dëgjon (çka thonë) dhe di (çka punojnë).” [El-Enfal: 53]. Kur ndryshimi të ndodh drejt më të keqes, atëherë realizohet ligji i Allahut në zëvendësimin e këtij populli me një popull tjetër. ﴿وَإِن تَتَوَلَّوْا يَسْتَبَدِلْ قَوْمًا غَيْرَكُمْ ثُمَّ لَا يَكُونُوا أَمْثَالَكُمْ﴾ “Po nëse ju i ktheni shpinën, Ai do t’ju zëvendësojë me një popull tjetër, që nuk do të jetë si ju”. [Muhammed: 38]. Kështu, si rezultat i veprave të tyre, ndryshimi bëhet ligj që realizohet ndaj njerëzve me caktimin e Allahut. ﴿إِنَّ اللَّهَ لَا يُغَيِّرُ مَا بِقَوْمٍ حَتَّىٰ يُغَيِّرُوا مَا بِأَنْفُسِهِمْ﴾ “Allahu nuk e ndërron gjendjen e një populli (nuk ua largon të mirat) përderisa ata ta ndryshojnë veten e tyre.” [Er-Rra’d: 11].

Ndryshimi i vetvetes është proces pedagogjik që drejton njerëzit drejt një gjendje më të mirë. Paaftësia dhe çrregullimi pedagogjik mund të bëhet mjet që njerëzit t’i çojë drejt një gjendjeje të keqe. Në fund të fundit, njeriu është përgjegjës para Allahut për shfrytëzimin e energjive dhe aftësive të tij, për realizimin e vullnetit të Allahut në përmirësim dhe reformim. Në llogaridhënie para Allahut, nuk do të mund të ndër-mjetësojë as person, as institucion, e as sistem ndaj ndonjë individi për shkak të moskryerjes së obligimit për ndryshim dhe reformim. ﴿وَكُلُّهُمْ آتِيهِ يَوْمَ الْيَوْمِآةِ فَرْدًا﴾ “Dhe në ditën e kiametit secili do t’i paraqitet Atij i vetmuar.” [Merjem: 95]. Të gjitha proceset e ndryshimeve shoqërore, ngritjeve civilizuese dhe zbulimeve shkencore, në hapin e tyre të parë fillojnë me një ide të një individ. Më pas, kjo ide shndërrohet në plan pune përreth se cilës bashkohen individë të tjerë. Më pas, kjo bëhet rrymë që përballon gjendjen aktuale duke i nënshtuar dhe tejkaluar gjitha pengesat në rrugë.

Nëse rrëfimet e pejgamberëve në Kur’an janë shembuj për ndryshimet që kanë sjellë me ndihmën e Allahut, në shoqëri-

të e tyre, ekzistojnë edhe rrëfime tjera në Kur'an që janë shembuj për procese të ndryshimeve, të cilat i kanë realizuar mbretër dhe reformatorë, duke shfrytëzuar përvojat që Allahu ua ka mundësuar në ndryshim dhe reformim. Ekzistojnë edhe shembuj tjerë për individë që kanë ngritur zërin përballë devijimeve mbizotëruese. Me këtë, janë bërë model për përpjekje reformuese, ku një individ është përballur me tërë shoqërinë, siç ishte rasti i besimtarit nga familja e faraonit. [Gafir: 28-33] dhe besimtari nga familja El-Jasin [Jasin: 20-27].

#### 4. Bashkëveprimi me përvojën njerëzore bashkëkohore është pikënisja për veprim:

Kur flitet për përpjekjet reformuese, vërejmë të tillë që flasin në forma të ndryshme rreth kësaj pikënisje. Disa ftojnë që të fillohet me udhëzimet kur'anore dhe Pejgamberike në formimin e gjendjes që dëshirojmë (politike, ekonomike, pedagogjike, ...). Ka të tillë që ftojnë të fillohet me gjendjen e realitetit aktual në shtete tjera, ngase ata mendojnë se realiteti në këto shtete është alternativë e vuajtjeve në vendin tonë. Megjithatë, polemikat rreth kësaj çështje janë teorike mbi të cilat nuk ngritët ndonjë veprim serioz. Në përpjekjet tona për të prerë në këtë çështje themi: nuk ka mundësi praktike transferimi përnjëherë i shoqërisë, nga një gjendje në gjendje tjetër. Ndryshimi është proces, e jo rezultat. Forma në të cilën dëshirojmë të përfundojë ndryshimi nuk është formë e kompletuar në veçori dhe elemente, por është formë që në vazhdimësi është në zhvillim e sipër, ku secili element ndikohet nga arritjet e mëparshme dhe do të ndikon në arritjet e mëvonshme.

Megjithatë, themi se dispozita dhe këshillat kur'anore dhe pejgamberike do të na ndihmojnë fuqishëm në kuptimin e gjendjes reale. Na ftojnë të vazhdojmë në ndryshim dhe avancim nga një gjendje në tjetrën, krahas vazhdimit në rritjen e arsimit cilësor, zhvillimit të përvojës dhe eksperiencës, zhvillimit të bashkëveprimit me risitë e kohës dhe përpjekjet për të ngritur gjendjen e popullit në pozitën e popullit udhëheqës. Sa i përket përvojave njerëzore që i gjejmë te popujt e

tjerë, duhet marrë në konsideratë, për të parë se çka u ka sjellë dobi atyre e çka i ka dëmtuar.

Duhet kuptuar se transferimi i plotë i një përvoje të caktuar, nga ana praktike është e pamundur. Mandej, ajo çka është e dobishme për një popull dhe ambient të caktuar, mund të jetë e dëmshme për një ambient tjetër, në veçanti kur dimë se sistemet pedagogjike dallojnë nga një shoqëri në tjetrën. Sado që të vërejmë elemente të përbashkëta mes sistemeve pedagogjike në shoqëritë e ndryshme, duhet kuptuar se secili sistem ka parimet e veta me të cilat dallon nga parimet e sistemit tjetër. Secili sistem në formimin e tij, si pikënisje merr vizionin e veçantë të shoqërisë të cilit i shërben, duke bërë përpjekje për realizimin e qëllimeve të shoqërisë.

Kur të interesohemi për jetën tonë pedagogjike, ashtu siç interesohemi për çdo anë të jetës sonë të përditshme, atëherë duhet filluar nga realiteti të cilin jemi duke e përjetuar, me qëllim që ta kuptojmë atë ashtu siç është, si dhe duhet përcaktuar formën e saj ashtu siç shpresojmë të jetë. Metodologjia jonë në bashkëveprim me realitetin, nuk është metodologji historike që merret me të kaluarën, e as metodologji usuliste që nxjerr dispozita nga tekstet, por është metodologji empirike, që merret me realitetin objektiv siç është tash, me qëllim të realizimit të ndryshimit që dëshirojmë ta sjellim, për të arritur në një gjendje më të mirë në ditët e ardhshme. Gjatë kuptimit tonë ndaj gjendjes reale dhe përpjekjeve tona për ndryshim, do të kemi në konsideratë tekstet nga Kur'ani dhe suneti, të cilat na mbështesin me parime, dispozita dhe këshilla, si dhe do të mbështetemi në mësimet e përvojës historike të cilat gjenden në trashëgimi. Por, pikënisja është gjendja jonë reale: ne-këtu-tash.

Historia njerëzore gjatë shekujve është e hapur për gjithë njerëzit që të marrin mësim prej tyre. Kur'ani Famëlartë shumë shpesh e ka potencuar ftesën për ecje dhe udhëtim mbi tokë. Ka kërkuar meditim në gjendjen e popujve të tjerë, në veçanti shkatërrimi që i ka goditur këto popuj.<sup>363</sup> Po ashtu,

<sup>363</sup> Kur'ani shumë shpesh ka potencuar ftesën për ecje dhe udhëtim mbi tokë, me qëllim të meditimit rreth përfundimit të popujve të mëparshëm. Kjo ftesë vjen në kontekst të meditimit në ligjet e Allahut, e ndërli-

gjendja momentale njerëzore është e hapur për mësim më shumë se historia. E kaluara historike dhe e tashmja, vërtetohen se përfitimi i diturisë dhe njohjes, si dhe arritja të zbulimi dhe kreativiteti, kanë qenë në disponim për të gjithë popujt. Kjo mund të arrihet si rezultat i kuptimit të ligjeve, marrjes në konsideratë të shkaqeve dhe përpjekjeve për realizimin e qëllimeve të caktuara në tokë, përmes plan-programeve të përshtatshme. Historia dhe e tashmja gjithashtu vërtetojnë dukurinë e komunikimit, bashkëveprimit dhe armiqësisimit, duke marrë dhe duke dhënë, në paqe dhe luftë, e gjithë kjo duke realizuar një nga intencat e krijimit hyjnor e që është njohja mes popujve dhe fiseve, si dhe realizimin e rezultatit që del nga kjo njohje e që janë shanset e bashkëveprimit dhe këmbimit të përvojave dhe interesave.

Trashëgimia islame transmeton shumë raste në të cilat shoqëria islame ka marrë përvoja të rëndësishme nga ambienti që mbizotëronte në periudhën paraislame, si dhe nga sistemet të cilat mbizotëronin në vendet dhe shtetet tjera pas ardhjes së islamit. Shoqëria islame e ka marrë përvojën nga të tjerët dhe e ka zhvilluar që të jetë më e përshtatshme dhe më e lidhur me realitetin dhe nevojat e saj. Shembull për këtë kemi idenë e regjistrimit, e cila ishte e njohur në vendet përreth, por jo edhe tek arabët. Këto regjistrime në fillim nuk ishin shkruar në gjuhën arabe, por në vendet e shoqërisë islame ishin të shkruara në gjuhën që ishte dominuese në çdo vend, gjuha romake në Sham, persiane në Irak dhe kopte në

hur me përfundimin e përgënjeshtresve. ﴿فَسِيرُوا فِي الْأَرْضِ فَانظُرُوا كَيْفَ كَانَ عَاقِبَةُ الْمُكْذِبِينَ﴾ "Dhe udhëtoni nëpër tokë dhe shikoni si qe përfundimi i atyre që përgënjeshtroan" [Alu Imran: 137], si dhe ajeti: ﴿فَلَنْ سِيرُوا﴾ في الأرض في انظروا كيف كان عاقبة المكذبين" Thuaj: "Eci nëpër tokë e mandej shikoni se si qe përfundimi i gënjeshtarëve" [El-En'am: 11], ose përfundimin e atyre që kanë refuzuar udhëzimin dhe kanë preferuar devijimin ﴿فَسِيرُوا فِي الْأَرْضِ فَانظُرُوا كَيْفَ كَانَ عَاقِبَةُ الْمُكْذِبِينَ﴾ "Dhe udhëtoni nëpër botë dhe shikoni se si ishte fundi i gënjeshtarëve" [En-Nahl: 36], ose përfundimin e kriminelëve ﴿فَلَنْ سِيرُوا فِي الْأَرْضِ فَانظُرُوا كَيْفَ كَانَ عَاقِبَةُ الْمُجْرِمِينَ﴾ Thuaj: udhëtoni nëpër botë dhe shikoni se si ishte fundi i kriminelëve" ose përfundimin e politistëve të cilët kanë shkaktuar shfaqjen e çrregullimeve në tokë dhe deti ﴿ذَلِكَ جَزَاءُكُمْ بِمَا كَفَرُوا وَهَلْ نُجَازِي إِلَّا الْكُفُورَ وَجَعَلْنَا بَيْنَهُمْ وَبَيْنَ الْفُرَى الْبَارِئِينَ فِيهَا فَرَى ظَاهِرَةً وَقَدَرْنَا فِيهَا السَّيْرَةَ﴾ فيها لئلاي وأياها آمينين ﴿

**"Atë dënim ua dhamë atyre për shkak se nuk besuan, e Ne nuk dënojmë, përveç mohuesit. Dhe, në mes tyre dhe mes fshatrave të bekuara (në Sham), ju bëmë fshatra të njëpasnjëshme dhe ju bëmë udhëtim të përshtatshëm. Udhëtoni të sigurt nëpër to natën e ditën". [Sebe': 17-18].**

**Mendojmë se kjo ftesë kur'anore është ftesë për të lexuar historinë dhe për të marrë mësim prej saj.**

Egjypt. Shoqëria islame që nga fillimi kishte përdorur mone-dhën e cila ishte në përdorim para islamit, pra dinari romak dhe dirhemi persian, përfshirë edhe mbishkrimet, vizatimet dhe simbolet joarabe dhe joislame që gjendeshin në to. Shoqëria islame i ka përdorur ato deri në periudhën e halifit Abdulmelik ibn Mervan.

Nëse marrja e mësimëve nga rrëfimet e të së kaluarës janë në disponim të njeriut të sotëm, përse rrëfimet dhe ndodhitë e sotme mos të japin mundësi për të marrë mësim?! Kur ndonjë hulumtues hulumton sistemin pedagogjik të ndonjë shteti të huaj, ai zbulon elementet, ligjet dhe praktikat e këtij sistemi. Bazamentet, parimet dhe detyrat e këtij sistemi i vë në shërbim të shtetit të tij. ai, rezultatet e këtij hulumtimi i parqet në një raport të shkruar, i cili është i ilustruar me disa fotografi, histograme dhe video, me qëllim që personi i cili lexon raportin të shoh ecurinë e këtij sistemi, mekanizmat e veprimit, anët pozitive dhe negative dhe dobinë e shpresuar nga ky hulumtim. Për ndryshe çka është dobia e hulumtimit dhe studimit nëse nuk ka ndonjë qëllim, të cilin hulumtuesi dëshiron ta realizon për veten e tij, për institucionin që ka kërkuar ta bënë atë dhe e ka financuar, si dhe për shoqërinë të si cilës i shërben institucioni? A nuk është mësimi dhe njohja e pozitiviteteve, të cilat mund të jenë të dobishme dhe negativiteteve, të cilat duhet shmangur, qëllimi më i rëndësishëm?!

## 5. Referenca e përvojës bashkëkohore dhe obligimi i kohës:

Allahu kur rrëfen ngjarjet e të së kaluarës, përfshirë Pej-gamberët, popujt dhe personalitetet, Ai përmes meditimit në ligjet e Allahut në jetë dhe në njerëz, dëshiron të na mëson domosdoshmërinë e marrjes së mësimit nga këto rrëfime në jetën tonë. Është e pakuptimtë që rrëfimet kur'anore të marrin një të tretën 1/3 e Kur'anit pa ndonjë mesazh. Metodologjia kur'anore gjatë sjelljes së rrëfimeve është se ato ofrojnë detajime të cilat janë të mjaftueshme për mësim. Nuk janë me rëndësi detajet e rrëfimit, por me rëndësi është që rrëfimi

të realizon detyrën e tij në marrje të mësimit, këshillimit dhe përkujtimit. Allahu thotë:

﴿لَقَدْ كَانَ فِي قَصَصِهِمْ عِبْرَةً لِأُولِي الْأَلْبَابِ مَا كَانَ حَدِيثًا يُفْتَرَىٰ وَلَكِن تَصْدِيقَ الَّذِي بَيْنَ يَدَيْهِ وَتَفْصِيلَ كُلِّ شَيْءٍ وَهُدًى وَرَحْمَةً لِّقَوْمٍ يُؤْمِنُونَ﴾

“Në tregimet e tyre (të dërguarve dhe të Jusufit me vëllezër) pati mësim e përvojë për të zotët e mendjes. Ai (Kur’ani) nuk është bisedë e trilluar, por vërtetues i asaj që ishte më parë (librave të shenjtë) dhe sqarues i çdo sendi, e edhe udhërrëfytes e mëshirë për një popull që beson.” [Jusuf: 111].

﴿وَكُلًّا نَّقُصُّ عَلَيْكَ مِنْ أَنْبَاءِ الرُّسُلِ مَا نَقَّبْتُ بِهِ فُؤَادَكَ وَجَاءَكَ فِي هَذِهِ الْحَقُّ وَمَوْعِظَةٌ وَذِكْرَىٰ لِلْمُؤْمِنِينَ﴾

“Të gjitha këto që t’i rrëfyem ty nga lajmet e Pejgamberëve, janë që ta forcojnë zemrën tënde, dhe në to të ka ardhur e vërteta e këshilla, si dhe përkujtime për besimtarët.” [Hud: 120].

Edhe në sunetin peygamberik ka rrëfime, ku disa prej tyre ndërlihen me rrëfimet kur’anore, me qëllim që t’na orienton drejt pikës së mësimit në rrëfim, siç është rasti i rrëfimit të “mbretit, magjistarit, priftit dhe fëmijës”,<sup>364</sup> e cila jep detaje të rrëfimit të “as’hab’ul-uhdud” e potencuar në Kur’an:

﴿قُتِلَ أَصْحَابُ الْأُخْدُودِ ذَاتِ الْوُقُودِ إِذْ هُمْ عَلَيْهَا قُعُودٌ وَهُمْ عَلَىٰ مَا يَفْعَلُونَ بِالْمُؤْمِنِينَ شُهُودًا وَمَا نَقَمُوا مِنْهُمْ إِلَّا أَنْ يُؤْمِنُوا بِاللَّهِ الْعَزِيزِ الْحَمِيدِ﴾

“Mallkuar qofshin ata të zotët e hendeqeve, Të zjarrit me plot lëndë djegëse, Kur ata rrinin ulur rreth tij, Dhe dëshmonin atë që bënë me besimtarët. E nuk patën pse t’i urrejnjë, përveç që e besuan Allahun, ngadhënjyjesin, të lavdëruarin.” [El-Buruxh: 4-8].

Disa prej rrëfimeve peygamberike, nuk është patjetër të ndërlihen me ndonjë ngjarje kur’anore ë mënyrë të drejtpërdrejtë, siç është rasti me rrëfimin e “qelit, të verbrit dhe të sëmurit në lëkurë”<sup>365</sup> dhe rrëfimit “Ibrahimi, Sara dhe mbreti tiran”. Që të dy rrëfimet janë të transmetuar nga Buhariu në “Sahih”.<sup>366</sup> E gjithë kjo me qëllim të shfrytëzimit të këtyre rrëfimeve për mësim dhe këshillime në jetën tonë bashkëkohore.

<sup>364</sup> Muslim, *Sahihu Muslim*, vepër e cituar, hadithi nr. 3005, fq. 1201.

<sup>365</sup> El-Buhari, *Sahih’ul-Buhari*, vepër e cituar, hadithi nr. 3464, fq. 666.

<sup>366</sup> El-Buhari, *Sahih’ul-Buhari*, vepër e cituar, hadithi nr. 3385, fq. 641.

Përvoja pedagogjike bashkëkohore është përshkrim i asaj që mund ta gjejmë te ne dhe të tjerët, prej parimeve dhe sistemeve pedagogjike të cilat sqarojnë dobitë për shoqëritë bashkëkohore. Kështu, këto shoqëri përzgjedhin ato dhe në bazë të tyre realizojnë praktikën edukativo-arsimorë. Kjo përvojë - në realitet - është përvojë që gjatë kohës ripërtërihet dhe zhvillohet, ndërsa në bazë të vendit është e llojllojshme dhe e ndryshme. Në këtë përvojë mund të ketë elemente të rëndësishme, për dobitë e të cilave janë të pajtimit shumë shoqëri, me kalimin e kohës mund të stabilizohen, ose të shfaqen mospajttime deri në nivel të qëndrimeve të kundërta, bazuar në mospajtimet dhe qëndrimet e kundërta në pikënisjet ideologjike. Për këtë, në përvojën pedagogjike bashkëkohore, nuk ka diç që merret kallëp pa hulumtuar anët pozitive dhe ato negative. Ashtu siç vërejtëm nevojën e trashëgimisë pedagogjike islame për analizë kritike me qëllim të hulumtimit të asaj që është e dobishme, vërehet edhe nevoja për analizim kritik të përvojës njerëzore bashkëkohore në sferën pedagogjike.

Pedagogu bashkëkohor musliman është ai që përpiqet të njohë shkencat pedagogjike bashkëkohore, të kupton sistemet, parimet dhe teoritë nga burimet e tyre bazë, zbulon ndikimet pozitive dhe negative që i kanë sjellë praktikën pedagogjike bashkëkohore në shoqëritë e ndryshme, merr në konsideratë pozitën e këtyre shkencave dhe praktikave në raport me intencat pedagogjike islame, që krejt në fund të përcakton se çka mund të jetë burim i mendimit pedagogjik bashkëkohor islam.

Shkencat pedagogjike bashkëkohore përfshijnë një sferë të gjerë dhe ngërthejnë specializime të shumta. Kështu kemi: filozofinë e pedagogjisë, historinë e pedagogjisë, menaxhimi pedagogjik, didaktika dhe metodika, ekonomia pedagogjike, psikologjia pedagogjike, sociologjia pedagogjike, dokimologjia etj. Është e vështirë që një hulumtues t'i përfshin gjitha këto disiplina pedagogjike. Mjafton që hulumtuesi të njohë mirë specializimin e tij shkencor bashkëkohor dhe të ketë njohuri rreth specializimeve tjera pedagogjike, në atë mënyrë që të ketë mundësi që specializimin e tij ta përdorë për punë



pedagogjike. Në këtë kontekst, vlen të theksohet se shkencat bashkëkohore në vazhdimësi janë në ndryshim, zhvillim dhe reformim. Kjo gjë ia imponon specialistit që në mënyrë të vazhdueshme të përcjell zbulimet e reja në specializimin e tij dhe të ndjek zhvillimet që ndodhin në te.

Megjithatë, kjo sasi e njohjes dhe përcjelljes, pedagogun bashkëkohor musliman nuk e liron nga përgjegjësia që të ketë njohuri të mjaftueshme rreth intencave pedagogjike në Kur'an, sunetin pejgamberik dhe trashëgiminë pedagogjike islame -së paku- rreth asaj që ka lidhje të drejtpërdrejtë me specializimin e tij të ngushtë.

Pedagogu bashkëkohor musliman -mbi gjithë këtë- nuk është i interesuar vetëm për zhvillimin e mendimit pedagogjik islam për të përmirësuar dhe reformuar gjendjen e shoqërisë së tij, por gjithashtu, ai është i interesuar për të paraqitur vizion pedagogjik dhe përvojë pedagogjike që do të kontribuon në përparimin e mendimit pedagogjik, që është i dobishëm për secilën shoqëri bashkëkohore. Me këtë ai bëhet element i rëndësishëm i prezencës islame në civilizimin bashkëkohor njerëzor dhe kontribues islam në orientimin dhe udhëzimin e saj.

Ky vizion rreth detyrave që e presin pedagogun musliman bashkëkohor është “obligim kryesor i kohës”. Ky pedagog është personi i kësaj kohe dhe çdo kohë ka detyrat e saj. Imam Ibnu Kajim Xhevzije në librin e tij “El-Xhevab’ul-Kafi” thotë: “Niveli më i lartë, më i vlefshëm dhe më i dobishëm i mendimit është ajo që është për Allah dhe për Ditën e Kiameetit. Ajo që është për Allah ndahet në disa lloje, ..., lloji i pestë: mendimi në obligimet dhe detyrat e kohës, duke e orientuar tërë interesimin në te. Njohës i mirë është ai që shfrytëzon kohën e tij. Nëse e humb kohën, i kanë ikur të gjitha të mirat. Të gjitha të mirat lindin nga shfrytëzimi i kohës. Nëse e humb kohën, nuk mund ta kthesh atë asnjëherë”.<sup>367</sup> Të njëjtën e ka përsëritur në librin “Medarixh’us-salikine ila Ijjake na’budu ve Ijjake nesteinu” duke thënë: “Veprimi më i mirë

<sup>367</sup> Ibn Kajim El-Xhevzije, Ebu Abdullah Muhamed ibn Ebi Bekr ibn Ejub (v. 751 h./1350), *Ed-Dau ve'd-Devau (El-Xhevab'ul-Kafi lime seele and devai'sh-shafi)*, Xhidë: Mexhme'ul-fikh'il-islami, Mekë: Daru alem'il-fevaidi, 1429 h./2008, fq. 356-358.

në çdo kohë dhe gjendje është t'i jepet prioritet kënaqësisë së Allahut në atë kohë dhe gjendje dhe të merret me obligimin parësor dhe detyrat e asaj kohe... Ky është personi që në mënyrë reale dhe të sinqertë zbaton ﴿إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ﴾ “*Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm te Ty kërkojmë ndihmë*” [El-Fatiha: 5].<sup>368</sup>

## Përmbyllje:

Në këtë kapitull u fol rreth katër burimeve, në të cilat mund të mbështetemi në ndërtimin e mendimit pedagogjik islam. Katër burimet ishin: Kur’ani Famëlart, suneti pejgamberik, trashëgimia pedagogjike islame dhe përvoja pedagogjike bashkëkohore. Ndoshta është e përshtatshme tani të pyesim: ku është mendimi pedagogjik bashkëkohor islam?

Theksuam disa shembuj rreth çështjeve të diturisë, mësimdhënies dhe mësimnxënies në Kur’anin Famëlartë. Qëllimi jonë në sjelljen e këtyre shembujve nuk ishte sjellja e gjitha rasteve në Kur’an, ngase i tërë Kur’ani është dituri dhe ftesë për mësimnxënie dhe mësimdhënie. Kemi mundësi të flasim për çështje tjera të shumta dhe tema tjera të shumta. Sikur të flisnim për mjetet mësimore dhe të zgjidhnim fjalën “ketebe-shkroi” dhe çështjet që ndërlidhen me te si gazetë, regjistër, laps dhe penë do të ishte një dëshmi e madhe rreth interesimit të Kur’anit për mjetet mësimore. Ngjashëm me te është edhe sikur të zgjidhnim fjalë “kare’e-lexoi” ose fjalën “derese-mësoi”, ose çështjen e nderimit hyjnor ndaj dijetarëve dhe çështje tjera që ndërlidhen me tematikat e diturisë, proceseve dhe mjeteve të saj të theksuara në Kur’an.

Na u bë e qartë se tematika e diturisë, mësimnxënies dhe mësimdhënies në sunetin pejgamberik është me rëndësi. Dijetarët e hadithit këto çështje i kishin regjistruar në librat e tyre. Më pas librat e trashëgimisë ishin kujdesur shumë për to, ku kishin transmetuar hadithe dhe fjalët e sahabëve, tabi’inëve dhe dijetarëve më pas që ndërlidheshin me to. U bë e qartë se suneti pejgamberik është argument në dispozitat dhe këshillimet që ndërlidhen me to në sferën edukativo-

<sup>368</sup> Ibnu Kajim El-Xhevizje, *Medarixh’us-salikine*, vepër e cituar, vëll. 1, fq. 110-111.

arsimore, njëjtë sikur që është argument në të gjitha shkencat tjera. Mjaftuam me theksimin e tre koncepteve të cilat janë potencuar në sunetin peygamberik: dituria, mësimnxënia dhe mësimdhënia, ngase këto tre koncepte ishin dhe vazhdojnë të jenë konditat e edukatës dhe të arsimit në të gjitha shoqëritë.

Besojmë bindshëm se në sunetin peygamberik do të gjejmë dispozita dhe këshilla të cilat janë sqarim i asaj që është potencuar në Kur'an nga njëra anë, dhe zbritje në jetën reale dhe praktike në shoqëri nga ana tjetër. Gjithashtu besojmë se ajo që është theksuar në Kur'an dhe ajo që ka ardhur si sqarim praktik në sunetin peygamberik llogariten si parime të përgjithshme të bashkëveprimit në të gjitha çështjet edukative dhe arsimore. Vërtetojmë se këto parime janë të përgjithshme dhe universale, të cilat përputhen me natyrën e pastër njerëzore, dhe japin hapësirë për zhvillimin e përvojave dhe eksperimenteve njerëzore të zhvilluara për përdorimin e tyre në punën pedagogjike në dritën e këtyre parimeve. Andaj, si mund që suneti peygamberik të mos jetë burim i mendimit pedagogjik bashkëkohor?!

Theksuam një sërë detyrash që mund t'i kryen trashëgimia pedagogjike islame. Ku në bazë të saj mund të jetë burim i mendimit pedagogjik islam bashkëkohor. Ishte e qartë se mendimi pedagogjik, të cilin e kanë paraqitur dijetarët musliman në shkrimet dhe praktikat e tyre, që nga periudha e regjistrimit deri para ndikimit të shoqërive islame me perëndimin, në të shumtën e rasteve bazohej në Kur'an dhe sunetin peygamberik. Si rezultat i saj, ky mendim -i cili është trashëgimi pedagogjike- më pas u bë përvojë historike në të kuptuarit e teksteve dhe në zbatimin praktik të tyre. Përvoja historike është patjetër të jetë e dobishme, kur e qëllojnë dhe kur gabojnë. Në zbritjen e mësimëve kur'anore dhe udhëzimeve peygamberike në jetën reale të njerëzve, si dhe në rezultatet e kësaj zbritjeje në realizimin e intencave të fesë dhe dobive për njerëzit, ka mësim të shumta, ku moszbatuesi i këtyre mësimëve dhe udhëzimeve do të jetë i humbur. Për derisa kjo zbritje në jetën reale është përpjekje njerëzore, ku ndonjëherë do të jetë e qëlluar, e ndonjë herë e gabuar dhe e mangët që

shpie në humbjen e dobive, është urtësi që t'i mësojmë këto raste me qëllim që të heqim dorë prej tyre.

Kur të mësojmë problemet të cilat i potencon trashëgimia pedagogjike islame, për të cilat shkak mund të jetë paaftësia për t'u udhëzuar me Kur'an dhe sunetin pejgamberik, do të jemi mirënjohës ndaj kësaj trashëgimie që na ka tërhequr vëmendjen ndaj saj, me qëllim që mos të përsëritet i njëjti gabim dhe e njëjta mangësi. Megjithatë, mund të vërejmë se trashëgimia nuk i ka potencuar qartë mangësitë dhe gabimet, ngase detyra e trashëgimisë ka mjaftuar vetëm me përshkrimin e asaj që ka dominuar prej praktikave edukative dhe mësimore në kohë dhe vend. Për neve mbetet, si dhe për ata që vijnë nesër analizimi dhe vlerësimi i këtyre teksteve të trashëgimisë për të zbuluar problemet dhe rezultatet negative të shoqërisë islame asokohe.

Me këtë, përfundojmë në atë se s'ka dyshim në domosdoshmërinë e përfitimit nga trashëgimia pedagogjike islame, me qëllim që të marrim anët pozitive dhe të urta në metodologjinë e zbritjes së ajeteve dhe udhëzimeve pejgamberike në gjendjen e shoqërisë islame, dobite dhe intencat që i ka sjellë kjo zbritje si dhe mësimet që duhet marrë nga paaftësia, pamundësia dhe mangësia që kanë mundur të shoqërojnë atë.

Në sferën e përvojës pedagogjike bashkëkohore, mund të vërtetojmë pamundësinë e një hulumtuesi në mendimin pedagogjik islam, të posedon përvojë të mjaftueshme në të gjitha disiplinat pedagogjike, bazat filozofike, psikologjike, shoqërore dhe njohëse të këtyre disiplinave. Këto disiplina janë ndarë saqë janë bërë specializime në vete, ku sfera e secilës prej tyre është zgjeruar shumë dhe temat janë bërë të shumta. Për këtë, përdorimi i përvojës pedagogjike bashkëkohore dhe përfitimi prej saj -si burim i ndërtimit të mendimit pedagogjik islam bashkëkohor- kërkon kontributin e disa hulumtuesve nga specializimet e ndryshme pedagogjike në përpjekje të përbashkëta hulumtuese, të cilat i realizojnë institucionet duke siguruar mbështetje administrative dhe financiare, dhe në të njëjtën kohë posedojnë vizion të ngritjes civilizuese islame.

Ishim të mendimit se përvoja njerëzore bashkëkohore në sferën arsimore është pika e fillimit të përmirësimit dhe reformimit të synuar. Duhet theksuar se ecuria e përmirësimit dhe reformimit në çdo hap mbështetet në referencën gjykuese që përcakton intencat pedagogjike në islam. Kjo referencë është Kur'ani dhe suneti peygamberik, dhe -në të njëjtën kohë- e tërheq me vete edhe përvojën e trashëgimisë pedagogjike islame. Megjithatë, mbështetja në këtë referencë nuk mund të realizohet në formën më të mirë, përpos nëse lexojmë këto tekste me vëmendje dhe meditim, gjë që do të na mundëson të gjejmë aty udhëzime për përmirësimin dhe reformimin e realitetit pedagogjik bashkëkohor, si dhe do të na ndihmon për të vlerësuar përvojat njerëzore që i ngërthen.

## KAPITULLI I KATËRT INTENCAT E MENDIMIT PEDAGOGJIK ISLAM

*Hyrje*

*Pjesa e parë: koncepti “intencat edukative” dhe lidhshmëria e tyre me objektivat edukative*

*Pjesa e dytë: sfondi i intencave dhe i objektivave edukative*

*Pjesa e tretë: klasifikimi i intencave edukative*

E para: intencat edukative për këtë botë

E dyta: intencat edukative synuese dhe ato instrumentale

E treta: klasifikimi i intencave edukative sipas tematikave shkencore

E katërta: klasifikimi i objektivave edukative sipas institucioneve të edukimit në shoqëri

E pesta: intencat edukative sipas tipologjisë së arsimit

*Pjesa e katërt: Intencat elitare kur'anore dhe manifestimet e tyre edukative*

E para: intencat edukative të tevhidit (njëshmërisë)

E dyta: intencat edukative për pastrim (shpirtëror)

E treta: intencat edukative për prosperitet

*Pjesa e pestë: implementimi i intencave edukative*

E para: implementimi, veprimi dhe vepruesi

E dyta: implementimi i intencave ka nevojë për ekspert të intencave

E treta: realiteti i trajtimit intencional në punën edukative

*Pjesa e gjashtë: korrigjimi i intencave edukative*

E para: saktësia dhe efikasiteti i mendimeve

E dyta: korrigjimi edukativ kur (ajo ide edukative) kryeson

E treta: sistemi i kualitetit në arsim

E katërta: konceptet islame korrigjuese

*Përfundimi*

# **KAPITULLI I KATËRT**

## **INTENCAT E MENDIMIT PEDAGOGJIK ISLAM**





## Hyrje

Interesimi për intencat e sheriatit është shtuar dukshëm në tri dekadat e fundit. Përpyetje serioze janë bërë për themelimin e konceptit “të intencave” në Kur’anin fisnik dhe për reformimin (islam) brenda kufijve të intencave. Gjithashtu, është bërë klasifikimi dhe aplikimi i intencave në fusha të ndryshme shkencore dhe për problemet bashkëkohore të mendimit islam. Për tematikën e “intencave” janë publikuar shumë libra dhe studime, janë organizuar shumë konferenca dhe janë themeluar një sërë qendrash për hulumtime dhe studime intenciale. Kjo e shtyri Rejsunin që këto përpyetje t’i cilësojë si tutor i zgjimit intencial.<sup>369</sup>

Intenca të mendimit edukativ janë pikërisht ato intenca të cilat Islami synon t’i realizojë në sferën edukative. Islami është shkollë për arsimim dhe edukim, dhe atë jo vetëm për t’i mësuar doktrinat besimore dhe adhurimet, por për t’i mësuar edhe bazat e politikës, të ekonomisë, shoqërisë dhe të aspekteve të tjera të veprimtarisë njerëzore. Allahu i Lartësuar është Zoti i botëve dhe i njerëzve në tërësi: i zotëron, i edukon, i pastron (shpirtërisht) dhe i zhvillon nga një stad në tjetrin deri në përsosmërinë (relative) të kërkuar prej Tij. Ai, i Lartësuar, është Zoti që ia mësoi Ademit emrat dhe ua mësoi peygamberëve përmbajtjet e shpalljeve me të cilat i dërgoi te njerëzit. Peygamberët u dërguan te popujt e tyre si mësues. Muhammedi a.s. është rezultat i lutjes së Ibrahimit a.s. i cili u lut që të ketë dikush i cili do t’ua lexojë pasardhësve të tij ajetet e Zotit, t’ua mësojë librin dhe urtësinë dhe t’i pastrojë (nga ligësitë).

Ky arsimim, në të gjitha sferat, format dhe tematikat e veta, është për ta realizuar qëllimin e Allahut të Lartësuar për ekzistimin dhe sjelljen në jetë të njeriut, pra ta besojë Atë të Vetëm dhe ta pranojë vetëm Atë për Zot. Pastaj përmes

<sup>369</sup> Ahmed Rejsuni, *El-Fikr’ul-mekasidijju: kavaiduhu ve fevaiduhu*, Menshuratu Xheridet’iz-Zemen, Ribat, 1999, fq. 7

nënshtrimit ndaj Tij të arrihet te pastrimi (shpirtëror), bartja e amanetit, mëkëmbja (e drejtë) në tokë dhe mirëqenia.

Ky është vështrimi i përgjithshëm, kurse nëse shihen në hollësi, atëherë intencat e mendimit edukativ islam shëmbëllehen dhe përfaqësohen me zhvillimin e njohjes së domosdoshme për zhvillimin, edukimin dhe arsimimin e njeriut në të gjitha etapat e jetës, dhe për aftësimin e tij për bartjen e përgjegjësive ndaj Zotit, ndaj vetes, ndaj familjes, ndaj shoqërisë, ndaj ambientit dhe ndaj pjesës tjetër të botës. Pastaj kërkohet vënia në funksion e kësaj njohjeje brenda proceseve të zhvillimit edukativ dhe arsimor, ku burim orientues në përfitim dhe funksionalizimin e kësaj njohjeje është Kur'ani Fisnik. Fondamentet e ushtrimit praktik të arsimit, të pastrimit (shpirtëror) dhe të edukimit të cilat i ka sjellë Kur'ani janë vetë suneti pejgamberik në formën e një metode shkencore të fituar nga sahabët dhe të mbetur si yrnec shembullor për gjeneratat e ardhshme. Kur'ani dhe suneti do të mbeten burim i udhëzimit dhe program i punës deri në kiamet.

Mbase është e udhës të sqarohet se mendimi edukativ islam të cilin kërkojmë ta përkufizojmë kur është fjala për pozitën e intencave kur'anore në procesin edukativ apo në manifestimet edukative të këtyre intencave, nuk synon domosdoshmërisht praktikën pedagogjike artistike që zbatohet në nivel të shkollës, të librit shkollor apo të metodave arsimore, por synon ndërtimin e lidhjes së parimeve të përgjithshme islame me shkencat pedagogjike dhe psikologjike moderne, dhe atë përmes metodologjisë së integritit kognitiv (njohës), duke e cilësuar atë si një kornizë referuese për metodologjinë islame.<sup>370</sup> Prandaj zgjodhëm të flasim për intencat e larta (kur'anore), sepse ato e dirigjojnë vizionin në gjithë procesin tonë arsimor brenda kornizave të përgjithshme ideologjike (islame) dhe brenda themeleve të tyre psikologjike, filozofike dhe shoqërore. Kur jemi këtu, duhet thënë se ajo që duhet është strukturimi i një metode për vështrimin e përgjithshëm dhe jo gjetja e alternativave për hollësitë dhe imtësitë specifi-

<sup>370</sup> Fet'hi Hasen Melkavi, *Menhexhijet'ut-tekamul'il-ma'rifij: mukaddematun fi 'l-menhexhijet'il-islamijeh*, Harden: El-Ma'hedu 'l-Alemijju li 'l-fikri 'l-islamijji, botimi II, 2016, fq. 177

ke të punës pedagogjike të përditshme. Me këtë rast nisemi nga supozimi se pedagogu që zotëron metodën e vështrimit të përgjithshëm mund të bëjë edhe analizë kritike të gjendjes arsimore dhe të elementëve të saj. Po ashtu, mund të japë kontribut në gjendjen faktike, të ristrukturojë, të ndryshojë dhe të rregullojë atë. Këtu del në pah rëndësia e vështrimit intencial në sferën e reformimit dhe ripërtëritjes.

Funksionalizimi i konceptit të “intencave” në sferën e arsimit kërkon që biseda për praninë e intencave në fushat e jurisprudence, sidomos në fushën e adhurimeve dhe të marrëdhënieve mes njerëzve, të zhvendoset nga aty në drejtim të funksionalizimit të intencave në të gjitha llojet e shkencave moderne të cilat vazhdojnë të zgjerohen dhe të degëzohen pareshtur, veçanërisht në disiplinat e zbuluara në shekujt e fundit, gjegjësisht në disiplinat shoqërore, humane, natyrore dhe aplikative. Në të shumtën e rasteve nuk kemi problem në studimin e këtyre disiplinave, por nuk kemi vetëdije të mjaftueshme për rreziqet që këto disiplina e kanosin vështrimit tonë të përgjithshëm dhe metodave tona të të menduarit. Po ashtu, nuk e spikatim rëndësinë e madhe që kërkon forma jonë e të menduarit për të prosperuar në sferën e qytetërimit përmes kontributit në zhvillimin shkencor dhe epistemologjik në botën bashkëkohore.

Realisht ne e ndiejmë paksa të domosdoshme të themi se mendimi që kërkojmë ta ndërtojmë nuk do të jetë mendim islam derisa nuk është mendim intencial në tematikën, metodën dhe zbatimin e tij, prandaj edhe mendimtari nuk do të llogaritet mendimtar islam në fushën e edukimit derisa të zotërojë botëkuptimin intencial, metodën intenciale dhe ta aplikojë këtë metodë në projektimin dhe procesin pedagogjik, paralel me nivelet tjera të projekteve edukative.

Në këtë pjesë do të flasim përmbledhtazi për konceptin e “intencave” dhe lidhjes së tij me objektivat që përfliten nëpër institucionet edukative. Për këtë përkufizim do të mbështemi në sfondin kur’anor, duke i shoqëruar kësaj edhe lëndën e trashëgimisë islame për intencat, rendin e saj dhe mënyrën e vënies së tyre në funksion.

## Pjesa e parë: Koncepti “intencat edukative” dhe lidhja e tyre me objektivat pedagogjike

Në shkrimet pedagogjike janë të njohura disa shprehje hyrëse për këtë çështje, si p.sh. pedagogjia ka tri elemente kryesore: programin arsimor, mësuesin dhe nxënësin. Programi arsimor ka tre komponentë kryesorë: objektivat, përmbajtjen, metodat dhe planifikimin arsimor. Vërejmë se objektivat e arsimit janë komponenti që i përcakton edhe komponentët tjerë në procesin edukativo-arsimor, prandaj konsiderohen pika nismëtare e planifikimit edukativo-arsimor. Pra, objektivat në mendimin pedagogjik janë temë bosh-te rreth së cilës sillet i gjithë mendimi që rrjedh në punën pedagogjike përgjatë etapave dhe proceseve të tjera pedagogjike. Për këtë arsye, çështja e objektivave nuk u takon vetëm punëtorëve të institucioneve edukative, por është një brengë që e kaplon gjithë shoqërinë. Kjo tregon se objektivat pedagogjike kanë nivele të ndryshme zhvillimore, kurse shoqërisë i takon të përcaktojë se çfarë dëshiron nga institucionet arsimore.

Objektivat që i përcakton shoqëria përmes vendimmarrësve në administratën qendrore janë objektiva të përgjithshme, pastaj shoqëria (shteti) kërkon nga institucionet arsimore realizimin e tyre, të cilat përgjithësisht preokupohen me çështje të zhvillimit politik, social dhe ekonomik. Institucionet arsimore vendosin objektiva të përgjithshme në nivel më të ulët sesa niveli i objektivave edukative të shoqërisë (shtetit), pastaj kërkon prej pedagogëve (mësuesve) t'i realizojnë këto objektiva pedagogjike në shkolla dhe në mësonjëtorë. Mësuesit, secili në drejtimin e vet, përcaktojnë objektiva në procesin mësimor dhe kërkojnë nga nxënësit apo studentët realizimin e tyre, e kështu me radhë.

Për t'i dalluar objektivat pedagogjike në secilin nivel, pedagogët shpeshherë përdorin terma të caktuar të cilët njihen

sadopak gëzojnë shtrirje në këtë sferë. Megjithatë, disa pedagogë insistojnë përdorimin e termave specifikë të tyre dhe ofrojnë përkufizim procedural të tyre. Ndonjëherë semantika e këtyre termave ndalon vetëm në kontekstin që përdoren. Këtu vjen në shprehje dallimi mes “objektivave edukative”, të cilat kërkohen nga shoqëria dhe lidhen me sistemin e doktrinës dhe të vlerave (shtetërore), nga “objektivat arsimore” të cilat institucionet arsimore kombëtare kërkojnë t’i realizojnë. Ndonjëherë përdoren disa terma të caktuar, si p.sh. “objektivat” pedagogjike apo “intencat” pedagogjike me kuptim të objektivave më të larta që kërkon shoqëria të realizohen te anëtarët e shoqërisë. Pastaj bëhet dallimi mes objektivave pedagogjike të përgjithshme dhe objektivave pedagogjike të veçanta. Disa pedagogë i përdorin termet: objektiva, synime apo intenca me sfond fetar-teologjik duke e zgjeruar rrethin e studimit të objektivave pedagogjike në sferën e asaj që kërkon Krijuesi nga njeriu. Gjithashtu, këto terme të njëjta përdoren me sfond legjislativ pozitivist, ku objektivat pedagogjike kufizohen vetëm në atë që kërkon shoqëria nga anëtarët e saj. Në këtë rast, pranë termit “objektiva-synime” apo “objektiva intenciale” shfaqet term (tjetër) që i përgjigjet atij, si p.sh. termi “objektiva-instrumente” apo “objektivat instrumentale”.

Pedagogët, njëri pas tjetrit folën për nivelet e objektivave pedagogjike, dhe kështu mbërritën në formën që dëshirojnë të spikatet në sjelljet e nxënësve si rezultat i mësimi të një tematike të caktuar në kohë të caktuar, prandaj e përdorin termin “objektiva bihevisoriste”. Ndoshta duhet që këto objektiva bihevisoriste të vijnë në shprehje në nivele tjera përgjatë realizimit të procesit edukativ dhe të quhen “kompetenca arsimore”. E këtille është situata në të gjitha nivelet e shumicës së aktiviteteve njerëzore. Studiuesit e interesuar mbase mund të pajtohen për një nivel të caktuar si niveli më lartë, të cilit pastaj do t’i përshtatet realizimi praktik, do të trajtohet si një standard për matjen e kualitetit dhe përmes tij do të zbulohen indikatorët e caktuar.

Ne zgjodhëm që titulli i kësaj pjese të fillojë me fjalën “intenca” dhe me ndonjë fjalë tjetër, si p.sh. termi “objektiva”

i cili zakonisht përdoret në mendimin dhe në praktikën pedagogjike, apo termi “synime” i cili përgjithësisht përdoret për objektivat përfundimtare. Jemi përcaktuar për këtë përzgjedhje për tri arsye:

Dëshira që procesi pedagogjik të bashkëveprojë me metodologjinë intenciale, dhe kështu të zgjerohet rrethi i intencave që kërkon ky proces. Krejt kjo mund të fillohet me sjelljet e drejtpërdrejta të nxënësve, të vazhdojë me formësimin e personalitetit të tyre, duke marrë në konsideratë arritjet e jetës private dhe të përgjithshme, dhe për të përfunduar me ndryshimin e kërkuar në shoqëri dhe kontributin që umeti jep në orientimin e qytetërimit njerëzor.

Dëshira që tematikat e mendimit pedagogjik islam të bashkëveprojnë me metodologjinë intenciale, në mënyrë që rrethi i intencave të zgjerohet edhe më shumë, nga kuptimi tradicional i dispozitave shariatike në mendimin e ndërtimit social dhe kulturor. Me këtë metodologji, fikhu intencional është fikhi në adhurime, në marrëdhëniet ndërnjerëzore, në sferën politike, ekonomike, pedagogjike dhe në sfera të tjera shoqërisë njerëzore bashkëkohore. Në këtë mënyrë, intencë e jona është ekzistimi i një fekihi pedagogjik, politik, ekonomik dhe i një fekihi i çdo sferë të aktiviteteve të shoqërisë bashkëkohore (pra të ketë ekspertë për çdo fushë të nevojshme).

Dëshira për të krijuar një vetëdije të mjaftueshme se intencë e procesit pedagogjik është vetë njeriu, të cilin Allahu e ka krijuar mëkëmbës në këtë botë për të jetuar sipas intencave që ka përcaktuar Vetë Krijuesi i tij. Gjithashtu, të gjithë ata që kanë qenë pjesë e këtij procesi (edukativ) do të japin llogari në Botën Tjetër para Allahut të Madhërishëm, ku secili do të shohë intencën (qëllimin) e asaj që ka vepruar në këtë botë. Studimi i “intencave” dhe hulumtimi i metodës së tyre nuk është i kufizuar vetëm për profesionistët e usulit (të bazave të shariatit) apo në shkencat tjera fetare, por është një metodë e të menduarit e cila u hyn në punë edhe profesionistëve të disiplinave të tjera shkencore, veçanërisht disiplinave pedagogjike, psikologjike dhe reformuesve në përgjithësi.

Shprehja “mekasid” (intenca) u referohet edhe kuptimeve të fjalëve të tjera. Më parë, në librin tonë “Menhexhijet’ut-tekamul’il-ma’rifijji: mukaddematun fi’l-menhexhijet’il-islamijeh” (Metodologjia e përsosmërisë kognitive: hyrje në metodologjinë islame), e sqaruam lidhshmërinë e intencave me parimet dhe vlerat, ku e pamë se intencat janë parime që e dirigojnë të menduarit metodologjik, hulumtimin metodologjik dhe sjelljen metodologjike.<sup>371</sup> Gjithashtu, lidhshmërinë e intencave me vlerat e sqaruam në librin “Mendhumetu el-kijemi el-ulja: et-tevhidu ve et-tezkijetu ve el-umranu” (Hierarkia e vlerave më të larta: njësimi, pastrimi dhe ndërtimi),<sup>372</sup> ku e pamë se vlerat janë një sistem standardesh të cilët e plotësojnë njëri-tjetrin përgjatë themelimit të një botëkuptimi gjithëpërfshirës i cili e dirigjon ekzistencën njerëzore në realizimin e detyrës së mëkëmbjes në tokë. Këto janë standarde që i japin drejtim sjelljes së njerëzve në nivel individual dhe shoqëror. Këto standarde e ndërtojnë kulturën lëndore dhe kuptimore të njerëzimit, së cilës i japin udhë përmes shpalljes hyjnore dhe shëmbëlltyrës pejgamberike. Kështu, vlerat fisnike diriguuese janë: njëshmëria e Zotit, rregullimi i jetës në univers dhe pastrimi (shpirtëror) i njeriut. Me këtë rast, vlerat janë vetë standardet që e edukojnë njeriun, i orientojnë sjelljen e tij, ia formojnë personalitetin dhe ngritin marrëdhëniet e tij me Zotin, me ambientin shoqëror dhe me ambientin natyror. Këto standarde janë efektive derisa e arrijnë nivelin që intencat e Zotit kërkojnë nga njeriu.

Biseda që edukimi dhe arsimit kanë intencat e veta nuk është gjë e re, sepse kjo është thënë nga shumë studiues, p.sh. Ibn Halduni ka klasifikuar dy tipa shkencash: shkenca që janë intencë në vetvete dhe shkenca instrumentale të cilat janë mjet i shkencave tjera.<sup>373</sup>

Ne kemi parë shumë herë të flitet për këtë trilogji të vlerave të larta nga një njohës i mirë i usulit, i cili është profesor

<sup>371</sup> Melkavi, *Menhexhijet’ut-tekamul’il-ma’rifijji: mukaddimatun fi’l-menhexhijet’il-islamijeh*, vepra e cit., Kapitulli VII: El-Mebadiu ve ‘l-Kijem’ul-menhexhijeh, fq. 241-290

<sup>372</sup> Fet’hi Hasan Melkavi, *Mendhumet’ul-kijem’il-ulja: et-tevhidu ve ‘t-tezkijetu ve ‘l-umran*, Herden: El-Ma’hed’ul-alemijju li ‘l-fikr’il-islamijji, botimi II, fq. 2016, hyrja e librit.

<sup>373</sup> Ibn Haldun, *Mukaddimetu Ibn Haldun*, vepra e cit., vëllimi III, fq. 1114

Alvani, i cili mendon se ky sistem intencash dirigjon gjithçka në jurisprudencën dhe mendimin islam, pa të cilin jurisprudenca dhe mendimi ynë nuk janë islame. “Këto intenca të larta dirigjuese mund të ndihmojnë zhvillimin e një teorie kognitive të përgjithshme në të gjitha disiplinat shkencore të sheriatit, po ashtu edhe në disiplinat sociale...”<sup>374</sup> “Këto vlera janë pikërisht ato parime gjithëpërfshirëse kur’anore të cilat sigurojnë aktivizimin e sistemeve të tjera... sistemit fikhor dhe ligjor. Po ashtu, ky sistem riformon identitetin islam individual dhe social, dhe i kthen ato në një model dhe shëmbëllturyrë që përgatit universalizmin e ardhshëm të Islamit dhe mbizotërimin e Islamit si fe, sepse intencat e larta dirigjuese, qofshin në tërësisht apo pjesërisht, përfaqësojnë partneritete (të llojllojshme) njerëzore.”<sup>375</sup>

Gjithashtu, shohim se një nga njohësit bashkëkohorë të pedagogjisë i ka klasifikuar objektivat pedagogjike në dy nivele: i pari është niveli i intencave përfundimtare, ku thotë: “Objektivat edukative ndahen në dy grupe kryesore: objektivat që përfshijnë intencat përfundimtare, zbatimi i të cilave kërkohet në nivel individual, shoqëror dhe universal; dhe objektivat instrumentale të cilat përfshijnë mjetet dhe instrumentet aktive për realizimin e objektivave paraprake.”<sup>376</sup>

Disa ekspertë bashkëkohorë të pedagogjisë, intencat e sheriatit i lidhin me atë që e quajnë “kuptimi edukativ i sistemit të shtetit që e themeloi Pejgamberi a.s.”, prandaj praninë e këtyre intencave e kanë konsideruar dominuese në të gjitha format e marrëdhënieve brenda shoqërisë dhe shkak i “stabilitetit që kërkon veprimtaria edukative.”<sup>377</sup> Në këtë formë të kuptimit të intencave, gjëja më e rëndësishme është respektimi dhe çlirimi i individit, dhe ndërtimi i një modeli të personalitetit njerëzor, ku shteti dhe shoqëria ngarkohen ta trajtësojnë

<sup>374</sup> Taha Xhabir El-Alvani, “Min’et-ta’lili ila ‘l-mekasid’il-kur’anijet’il-ulja el-hakimeh”, revista “Islamijet’ul-ma’rifeti”, numër (46-47), (12), vjeshtë dhe dimër, 2006-2007, fq. 19

<sup>375</sup> Po aty, fq. 22

<sup>376</sup> Maxhid Arsan El-Kejlani, Ahdaf’ut-terbijjet’il-islamijeti: mukarenatun bejne ahdaf’it-terbijjet’il-islamijeti ve ‘l-ahdaf’it-terbeviyyet’il-muasereiti, El-Medinet’ul-Munevvereh, Mektebetu Dar’ut-Turathi, botimi II, (1408 h./1988), fq. 15

<sup>377</sup> Seid Ismail Ali, Nesh’et’ut-terbijjet’il-islamijeti (mevsuat’ut-tetavvur’il-hadarijji li ‘t-terbijjet’il-islamijeh – 2), Kajro, Dar’us-Salam, 2010, fq. 31



mirë dhe drejtë atë (personalitet), sepse ai do të jetë një tullë e ngrehinës së shoqërisë dhe e umetit. Këto intenca sjellin modelet më të përkryera të drejtësisë, të bamirësisë dhe të sigurisë së ndërsjellë për të arritur interesin shariatik të synuar nga bashkëpunimi.” Vetia e universalitetit dhe e gjithëpërfshirjes në intenca i orienton marrëdhënien në shoqëri kah modelet e qëndrueshme të cilat përftohen nga dispozitat e përputhshme me sistemin dhe intencat e shariatit. Qëndrueshmëria e këtyre intencave i ruan marrëdhëniet shoqërore nga dinamizmi dhe e siguron lëvizjen e shoqërisë përpara me hapa të sigurt.<sup>378</sup>

Shprehjet arabe që lidhen me intencat dhe objektivat pedagogjike janë pothuaj përgjegjëse me shprehjet në gjuhët tjera. Gjithashtu, vërehet se shprehjet e gjuhëve të dallohen saktësisht sipas nevojës që ka kërkuar një kohë e caktuar dhe kontributit që është dhënë në atëbotë. Në gjuhën angleze, për shembull, në arsim dhe në programet zhvillimore ekonomike dhe sociale përdoret këto shprehje, p.sh. *purpose*, *aim*, *goal*, *objektive*, *desired result* dhe të tjera, ku fjala *aim* dhe *purpose* tregojnë rezultatin e dëshiruar, kurse fjala *goal* dhe *objektive* nënkuptojnë ciklin e proceseve zhvillimore që çojnë tek objektivi përfundimtar. Fjala *aim* është më e përgjithshme për studentin e mjekësisë, kurse fjala *objektiv* është më precakte, sepse kur profesori, pasi ta ketë mbaruar ligjëratën e mëngjesit sot, dëshiron që me këtë fjalë t’u paraqesë saktë funksionet e organeve të aparatit të tretjes.<sup>379</sup>

<sup>378</sup> Po aty, fq. 31-32

<sup>379</sup> Pedagogët propozojnë që objektivi pedagogjik të cilësohet me këto pesë karakteristika të tubuara në akronimin SMART, të cilat janë: Specific – specifik, Measurable – i matshëm, Attainable – i realizueshëm, Realistic – realist, Timed – me kohëzuar.

## Pjesa e dytë: Rereferimi i intencave dhe i objektivave pedagogjike

Sfondi kur'anor i intencave pedagogjike shihet në të gjithë Kur'anin, sepse është libër që udhëzon në rrugën e drejtë dhe e drejton secilin që e ndjek këtë rrugë, qoftë individ, shoqëri apo umet. Në këtë botë e drejton të realizojë intencat e kësaj bote, si lumturinë, sigurinë dhe paqen, që pastaj rrugëtimi të përfundojë aty ku do Zoti në Botën Tjetër, pra në lumturinë dhe paqen e përhershme.

Megjithëse ne e shohim Islamin si një shkollë për njeriun dhe Kur'anin fisnik si metodë pedagogjike të kësaj shkolle, po ashtu në Kur'an i gjejmë edhe indikatorët e drejtpërdrejtë të intencave pedagogjike. Ajetet e para të zbritura nga Kur'ani janë ajete që flasin për dijen dhe edukatën: ﴿ افْرَأْ بِاسْمِ رَبِّكَ الَّذِي خَلَقَ ﴾ [El-Alek: 1]. Nga kjo kuptojmë se urdhri për lexim në fjalën e parë të Kur'anit nënkupton se leximi është themel i dijes dhe i arsimit në këtë fe përmbyllëse. Urdhri për lexim është dhënë dy herë në këto pesë ajete të para të shpallura:

Urdhri i parë për lexim: ﴿ افْرَأْ بِاسْمِ رَبِّكَ الَّذِي خَلَقَ ﴾ ﴿ ١ ﴾ خَلَقَ الْإِنْسَانَ مِنْ عَلَقٍ ﴿ ٢ ﴾

**“Lexo me emrin e Zotit tënd i Cili krijoi! E krijoi njeriun nga gjaku i ngjizur.”** [El-Alek: 1-2] Urdhri për lexim këtu nënkupton meditimin dhe përsiatjen në krijesat e Allahut të Lartësuar, ashtu që në ato të lexojmë urtësinë e krijimit, mënyrat e funksionimit, fitimin dhe ndërtimin e jetës dhe të tjera.

Urdhri i dytë për lexim: ﴿ افْرَأْ وَرَبُّكَ الْأَكْرَمُ ﴾ ﴿ ٣ ﴾ الَّذِي عَلَّمَ بِالْقَلَمِ ﴿ ٤ ﴾ عَلَّمَ ﴿ ٥ ﴾

**“Lexo se Zoti yt është më Bujari! I Cili e mësoi njeriun me laps. E mësoi atë që (njeriu) nuk e dinte.”** [El-Alek: 3-5]. Këtu me fjalën lexim synohet leximi i asaj që është shkruar me laps, prandaj shkrimi është themel i asaj që duhet të lexohet më vonë. Pra, ky lexim është i lidhur

ngushtë me shkrimin, sepse leximi dhe shkrimi janë themel i dijes, i arsimimit dhe i edukimit në kulturën njerëzore.

Dy urdhrat për lexim kanë ardhur bashkë njëri pas tjetrit, sepse secili lexim e ndihmon dhe e plotëson tjetrin.

Leximi që kërkohet këtu është leximi me emrin e Zotit (Rabbit), kurse Zoti i Lartësuar (gjegjësisht fjala Rabb) është Edukatori (Murebbi) i cili i krijuar njeriut një sistem edukativ dhe e ka vënë atë mbi bazat e dijes dhe të zgjuarsisë për t'i shërbyer njeriut, sepse Zoti e ka krijuar njeriun dhe e di se çfarë i duhet atij. Ky sistem i edukimit është i përgjithshëm, universal dhe hyn në punë të gjithë njerëzve në çdo kohë dhe në çdo vend, prandaj ky sistem, pa pikën e dyshimit, meriton dhe duhet të jetë fundament i të gjitha sistemeve tjera specifike të çdo populli dhe për çdo kohë.

Kushtetutë e plotë dhe e përkryer e edukimit është i gjithë Kur'ani. Allahu xh.sh. thotë: ﴿الرَّكِيَابُ أُحْكِمَتْ آيَاتُهُ ثُمَّ فُصِّلَتْ مِنْ لَدُنْ حَكِيمٍ خَبِيرٍ﴾ **"Elif, lam, ra. Libër që janë vënë me urtësi ajetet e tij dhe janë shkoqitur nga i Urti dhe i Gjithinformuari."** [Hud: 1] Fjala uhkimet do të thotë *vënie me urtësi të plotë*, pra është folje që ka rrënjën e njëjtë me fjalën *hikmetun* (urtësi), kurse *hikmeh* (urtësia) nënkupton përsosjen e gjërave duke i privuar nga të metat e mundshme që mund t'i prekin, e që te ajeti paraprak flet për faktin se ajetet (e Kur'anit) janë fjalë të përsosura, pa asnjë të metë dhe assesi nuk bien ndesh me realitetin, qofshin kuptimet apo fjalët e tyre... Fjala *fussilet* do të thotë shkoqitje dhe sqarim, fjalë e cila është përfutur nga fjala *fasl* që do të thotë ndarje të një gjëje nga gjërat tjera... kurse fundi i ajetit "...nga i Urti dhe i Gjithinformuari" nënkupton se ky Libër është nga i Cili cilësohet me urtësi të përkryer në krijim dhe në sqarim. Fjala *Habir* (i Gjithinformuar) do të thotë se Allahu di imtësisht çdo detal të gjërave, pra Hakim (i Urtë) është përball uhkimet (janë vënë me urtësi), kurse *Habir* (i Gjithinformuar) është përballë *fussilet* (janë shkoqitur me hollësi). Këtu shihet se dija dhe fuqia, sepse fuqia nuk vjen në shprehje pa dije."<sup>380</sup> Allahu i Madhërishëm thotë: ﴿

<sup>380</sup> Ibn Ashuri, Tefsiru et-tahriru ve et-tenviru, vefq. e cit., vëllimi XI, fq. 314-315

﴿ كِتَابٌ فَصَلَتْ آيَاتُهُ قُرْآنًا عَرَبِيًّا لِقَوْمٍ يَعْلَمُونَ ﴾ **“Libër, ajetet e të cilit janë shkoqitur hollësisht, janë bërë Kur’an arabisht për popullin që di.”** [Fussilet: 3]. Këto ajete janë sqaruar plotësisht, janë të qarta dhe gëzojnë objektiva të mirënjohura. Çdo ajet ka një objektivë të caktuar. Kur’ani është fjalë e lexuar dhe e kënduar, prandaj vetë emërtimi Kur’an është një nga vetitë e përsosura të këtij libri (sepse lexohet dhe del nga moda), dhe i drejtohet **“një populli që di”**, pra sikur Kur’ani ka zbritur vetëm për ata që dinë. E nëse dikush i kthen shpinën kuptimit të tij nga inati, atëherë cilësohet si popull që nuk di.”<sup>381</sup> Allahu xh.sh. thotë: ﴿ وَإِنَّهُ لَكِتَابٌ عَزِيزٌ \* لَا يَأْتِيهِ الْبَاطِلُ مِنْ بَيْنِ يَدَيْهِ وَلَا مِنْ خَلْفِهِ تَنْزِيلٌ مِّنْ حَكِيمٍ ﴾ **“...ai është libër aziz (i çmuar). Atij nuk i përshkruhet e kota nga asnjë anë, sepse është zbritje nga i Urti dhe i Falënderuari.”** [Fussilet. 41-42]. Fjala *aziz* do të thotë i çmuar, rrënja e kësaj fjala rrjedh nga fjala *izzeh* (krenari), prandaj gjëja e çmuar është ajo që mbrohet dhe ruhet nga çdo mangësi. Pra, Kur’ani e ka sqaruar përsosmërinë, kuptimet fisnike dhe ka sjellë prova të qarta, prandaj është *Aziz*. Një kuptim tjetër i fjalës aziz është se Kur’ani ngadhënjen dhe nuk ngadhënjehet, atë nuk e prek e kota, nuk përzihet e qarta me të paqartën dhe nuk mund t’i vishet e pavërteta në një mënyrë. Pra, qëllimi i këtij ajeti është se Kur’ani i ka përvetësuar brenda kontrollit të vet të gjitha anët që mund t’i sjellin ndonjë anomali, qoftë në ekzoterinë apo ezoterinë e tij.”<sup>382</sup>

Program i edukimit është ky Kur’an, prandaj objektivë e zbritjes së tij është udhëzimi i njerëzit në gjërat që i hyjnë në punë atij për çdo kohë dhe për çdo çështje të jetës së kësaj bote, dhe e udhëzon, po ashtu, për Botën e Përtejme:

Kur’ani është udhëzim i plotë dhe i përkryer që përbëhet nga komponentë të panevojshëm për diçka tjetër, prandaj ato duhet vetëm të aplikohen, të provohen, të fitohet eksperiencë prej tyre dhe të shfrytëzohen rezultatet e kësaj praktike. Allahu xh.sh. thotë: ﴿ وَنَزَّلْنَا عَلَيْكَ الْكِتَابَ بَيِّنَاتًا لِّكُلِّ شَيْءٍ وَهُدًى وَرَحْمَةً وَبُشْرَىٰ ۖ لِلْمُسْلِمِينَ ﴾ **“Ty ta zbritëm Librin si Sqarues për çdo gjë, udhë-**

<sup>381</sup> Po aty, vëllimi XXIV, fq. 230-231

<sup>382</sup> Po aty, vëllimi XXIV, fq. 308-309

**zim, mëshirë dhe përgëzim për çdo musliman.”** [En-Nahl: 89] Ky libër është sqarues i hollësishëm që ka arritur pikën e përsosmërisë, prandaj i ka nxitur lexuesit në kohën kur ka zbritur dhe në çdo kohë që të meditojnë në kuptimet e fshehura pas kuptimit të drejtpërdrejtë të ajeteve dhe në praktikën që fshihet pas praktikës së drejtpërdrejtë e cila përfaqësohej me Pejgamberin a.s. Zoti xh.sh. thotë: ﴿وَأَنْزَلْنَا إِلَيْكَ الذِّكْرَ لِتُبَيِّنَ لِلنَّاسِ مَا نُزِّلَ إِلَيْهِمْ وَلَعَلَّهُمْ يَتَفَكَّرُونَ﴾ **“Ne ta zbritëm ty Dhikrin (Kur’anin) që t’u sqarosh njerëzve atë që u është zbritur atyre, ndoshta ata do të mendojnë.”** [En-Nahl: 44] Kjo tregon se Kur’ani është udhëzim për mbarë njerëzimin në çdo kohë.

Kur’ani është mëshirë për gjithë njerëzit, që mos të zhyten në humbje përderisa e kanë nëpër duar këtë udhëzim. Allahu xh.sh. thotë: ﴿وَمَا أَنْزَلْنَا عَلَيْكَ الْكِتَابَ إِلَّا لِتُبَيِّنَ لَهُمُ الَّذِي اخْتَلَفُوا فِيهِ وَهُدًى وَرَحْمَةً لِّقَوْمٍ يُؤْمِنُونَ﴾ **“Nuk ta zbritëm Librin përveçse për t’u sqaruar atë që ata kishin mosmarrëveshje, udhëzim dhe mëshirë për një popull që beson.”** [En-Nahl: 64]

Kur’ani është dritë me të cilën njerëzit, nga errësitat e injorancës, politeizmit dhe të humbjes, dalin në dritën e sqarimit të padyshimtë dhe në udhën drejtë. Allahu i Lartësuar thotë: ﴿الرَّ كِتَابَ أَنْزَلْنَاهُ إِلَيْكَ لِتُخْرِجَ النَّاسَ مِنَ الظُّلُمَاتِ إِلَى النُّورِ بِإِذْنِ رَبِّهِمْ إِلَى صِرَاطٍ الْعَزِيزِ الْحَمِيدِ﴾ **“Elif, Lam, Ra. (ky është) Libër; Ne ta shpallëm ty që me urdhrin e Zotit t’i nxjerrësh njerëzit prej errësirës në dritë; (t’i nxjerrësh prej errësirës) në rrugë të Fuqplotit, të Falënderuarit.”** [Ibrahim: 1] Po ashtu, i Lartësuari thotë: ﴿يَا أَيُّهَا النَّاسُ قَدْ جَاءَكُمْ بُرْهَانٌ مِّن رَّبِّكُمْ وَأَنْزَلْنَا إِلَيْكُمْ نُورًا مُّبِينًا \* فَأَمَّا الَّذِينَ آمَنُوا بِاللَّهِ وَاعْتَصَمُوا بِهِ فَسَيُدْخِلُهُمْ فِي رَحْمَةٍ مِّنْهُ وَفَضْلٍ وَيَهْدِيهِمْ إِلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمًا﴾ **“O ju njerëz, juve ju erdhi nga Zoti juaj argument dhe Ne ju zbritëm dritë të qartë. Ata që i besuan Allahut dhe iu përmbajtën Atij (librit të Tij), Ai do t’i fusë në mëshirën (Xhennetin) e Tij dhe do t’i gradojë e do t’i udhëzojë për në rrugë të drejtë.”** [En-Nisa: 174-175].

Ai është program pune, skicë edukative graduale e cila u qëndron njerëzve pranë, lëviz paralel me ata hap pas hapi, u përgjigjet në çdo ndodhi dhe riformohet për çdo problem ri. Për këtë arsye Kur’ani nuk ka zbritur përnjëherë, që njerëzve

t'u thuhet: "ky është sistem i jetës suaj, andaj lexojeni dhe praktikojeni atë!" Gjithashtu, kjo është arsyeja që i zbriti një peygamberi nga mesi i tyre, që t'u flasë me gjuhën që kuptojnë. Kur'ani është projekti edukativ i cili zbriste me ajete apo me tufa ajetesh për tematika të caktuara. Pastaj Peygamberi a.s. ua lexonte sahabëve dhe i urdhëronte që t'i shkruajnë, t'i nxënë përmendësh dhe zbatojnë instruksionet e tyre. Allahu xh.sh. thotë: ﴿وَقُرْآنًا فَرَقْنَاهُ لِتَقْرَأَهُ عَلَى النَّاسِ عَلَىٰ مُكُتِّبٍ وَنَزَّلْنَاهُ تَنزِيلًا﴾ "Dhe (ta shpallëm) Kur'anin që Ne e ndamë pjesë-pjesë për t'ua lexuar njerëzve dalëngadalë dhe ashtu e shpallëm atë një pas një." [El-Isra: 106], pra e kemi zbritur atë të ndarë dhe gradualisht, pa e mbledhur menjëherë. Fjala *fe reknahu* nënkupton "i kemi ndarë ajetet nga njëri-tjetri" dhe i kemi sqaruar me saktësi gjërat që mund të përzihen, prandaj e ka edhe kuptimin "e kemi shkoqitur dhe sqaruar hollësisht". Këtu shihen dy motive: leximi i tij para njerëzve është motivi pse Allahu në këtë ajet e quajti Kur'an, kurse leximi i ngadalshëm dhe me maturi është motivi i dytë që synohej me foljen *fe reknahu*. Urtësia e gjithë kësaj është që fjalët dhe kuptimet e tij të nguliten thellë në shpirtin e dëgjuesve... gjithashtu, fjala *fe reknahu* mund të kuptohet si zbritje që u kushton rëndësi shkaqeve dhe ngjarjeve."<sup>383</sup>

Udhëzimi është objektivi (intenca) e përgjithshme e Kur'anit. Qartë duket se kjo objektivi e përgjithshme përbëhet nga një sërë intencash tjera të hollësishme dhe anësore. Semantika gjuhësore e intencës është plotësisht e qartë në gjuhën e Kur'anit dhe në stilet e shprehësisë gjuhësore që përdor ai. Megjithatë, ajo që duam të pohojmë këtu është se koncepti "intenca" nuk është një koncept i huaj që u zbulua nga studiuesit e hershëm apo të mëvonshëm, por është një koncept i ngulitur fort në tekstin kur'anor dhe në traditën peygamberike, prandaj ai ngërthen një mori kuptimesh të qartë të cilat sahabët i dinin bukur dhe mirë.

Ibn Kajjimi ka thënë: "Po t'i mendosh mirë e hollë legjislacionet (sheriatet) që Zoti i ka sjellë për njerëzit, do të shohësh se të gjitha synojnë sigurimin e interesave njerëzore sipas

<sup>383</sup> Po aty, vëllimi XV, fq. 231

mundësive. E nëse ato vijnë shprehje shumë interesa, atëherë u jepet përparësi më të rëndësishmeve dhe më fisnikeve. E nëse lihet pas dore një interesa, atëherë shmangen të këqijat e drejtpërdrejta (që pengojnë një të mirë) sipas mundësive. E nëse të këqijat bëhen shumë, atëherë mënjanojnë të këqijat më të mëdha dhe pastaj të tjerat me radhë. Në bazë të këtij parimi, i Urti Absolut i ka shpallur legjislacionet (shariatet) e Tij, duke i treguar njeriut se vetëm Ai është i Gjithëdijshtëm, i Urtë, i Gjithëmëshirshëm dhe Bamirësi (Absolut) ndaj tyre...<sup>384</sup>

“Kur’ani dhe tradita pejgamberike janë të mbushura me përlligje të dispozitave me urtësi dhe interesa. Me këto dya përlligjet edhe vetë krijimi. Gjithashtu, u kushtohet vëmendje formave të urtësive për shkakun e të cilave Allahu i ka legjitimuar ato dispozita dhe ata njerëz. Nëse kjo përlligje do të bëhej vetëm në njëqind apo dyqind vende në Kur’an dhe sunet, do t’i numëronim të gjitha, por kjo ndodh në mijëra vende dhe në mënyra të ndryshme. Ndonjëherë përmendet L-ja përlligjëse (lamu ta’lil), ndonjëherë përmes rrethanorit të shkakut (mef’ul li exhlihi), i cili tregon synimin e veprimit, ndonjëherë theksohet togu “min exhli (për shkak)” për të bërë përlligje të drejtpërdrejtë, ndonjëherë përmendet pjesëza kej (që), f-ja arsyetuese (fau ‘s-sebebijeh), inne (vërtet), ndonjëherë përdoret pjesëza leal-le e cila nënkupton përlligjen e një veprimi që nuk kapet nga kuptimi njerëzor, ndonjëherë paraqitet vetë shkak, ndonjëherë paraqiten disa cilësi (si përcaktorë) që përshtaten me dispozitat etj., pastaj Allahu i rendit sipas ligjit shkak-pasojë. Në disa raste të tjera Allahu u kërkon robërve të mendojnë, të meditojnë, të përsiatin dhe të logjikojnë në atë që iu shpall të Dërguarit dhe në vetë dispozitat me të cilat i ka ngarkuar ata, siç kërkon të mendohet dhe të shihen me kujdes krijesat bashkë me urtësitë që ka vënë në to, përfshirë këtu të mirat dhe dobritë brenda tyre... Kur’ani është i mbushur fund e krye me urtësi të krijimit dhe të

<sup>384</sup> Ebu Abdullah Muhammed bin Ebi Bekr bin Ejjub Ibn Kajjim Xhevzi, (vd. 751 h.), *Miftahu dar’is-seadeti ve menshuru vilajet’il-ilmi ve ‘l-idareh*, i përgatitur për botim nga Abdurrahman bin Hasen bin Kaid, Riad, Daru Alem’il-Fevaidi, 1432 h., fq. 912-915

urdhrave të dhëna, përfshirë këtu dobitë, të mirat dhe gjithçka që përfshijnë ajetet në këtë kontekst...".<sup>385</sup>

Në veprën "I'lam'ul-muvekki'ine", Ibn Kajjim Xhevziu flet për vetëdijen e sahabëve për çështjen e intencave dhe referimin e tyre në traditën pejgamberike, ku ndër të tjerash thotë: "Sahabët e kuptonin dhe e ndiqnin qëllimin e pejgamberit më mirë se çdokush tjetër, përpiqeshin me shumë zell për ta mësuar qëllimin dhe intencën e tij. Nuk ndodhte asnjëherë që dikush të shprehte dëshirën e vetë pasi të ishte caktuar synimi nga i Dërguari a.s. Ndonjëherë qëllimi i folësit kuptohet nga tërësia e fjalëve dhe ndonjëherë nga motivi i përgjithshëm. Përvetësimi i të parës është më i qartë për të zotët e kuptimit dhe të meditimit."<sup>386</sup>

Shkencat që lindën dhe u zhvilluan pastaj në shoqërinë islame u nisën nga kjo formë e të kuptuarit të drejtpërdrejtë të Kur'anit fisnik dhe nga sqarimi i drejtpërdrejtë i Pejgamberit a.s.. Pastaj u zhvilluan dhe u bënë disiplina shkencore dhe arte në vete. Kur'ani fisnik "është zbritur në gjuhën arabe dhe sipas stilit të gjuhës së tyre, prandaj të gjithë e kuptonin, i dinin kuptimet e morfemave dhe të sintagmave të tij. Zbriste pjesë-pjesë dhe ajet pas ajeti për të sqaruar njëshmërinë (në Zot) dhe detyrimet fetare sipas rasteve... Pejgamberi a.s. i sqaronte ajetet e përgjithshme, i dallonte ajetet deroguese nga të deroguarat, ua mësonte sahabëve dhe ata i përvetësonin. Po ashtu, sahabët mësuan edhe shkaqet e zbritjes së ajeteve sipas situatës... Pastaj kjo dije qarkulloi te tabi'inët pas tyre, pastaj te të tjerët me radhë duke u transmetuar gjeneratë pas gjenerate derisa mori formën e disiplinave të veçanta shkencore dhe u shënuar nëpër libra."<sup>387</sup>

Koncepti i "intencave" në Islam është i vjetër dhe lidhet me rregullat e usulit për të nxjerrë dispozitat sheriatike nga provat e tij. Këto rregulla ishin të qarta për sahabët dhe

<sup>385</sup> Po aty.

<sup>386</sup> Ibn Kajjim Xhevzi, Ebu Abdullah Muhammed bin Ebi Bekr bin Ejub (vd. 751 h.), *I'lam'ul-muvekki'ine an rabbi 'al-alemine*, me hyrje dhe koment të Mesh'ur bin Hasen Es-Selman, Demam, Daru Ibn'ul-Xhevzi, 1423 h., vëllimi II, fq. 386-387

<sup>387</sup> Po aty.



tabiinët, sepse ashtu i kuptonin nga Kur'ani dhe ashtu e jetonin sunetin e Pejgamberit a.s.

Imam Shafi'u i rrënjosi këto rregulla dhe i bëri shkencë më vete, të njohur me emrin usuli fikh. Një nga studiuesit modernë nga spikatur praninë e kuptimeve të ndryshme të intencave në atë që ka shkruar imam Shafi'u, gjë të cilën e ka provuar me disa shprehje të transmetuara nga një sërë dijetarësh, veçanërisht Imam'ul-Haremejn Xhujejni, i cili thotë se Shafi'u është i pari që e ka përdorur termin "intenca të sheriatit". Ibn Muhtari e komenton si të paqenë atë që transmeton Xhujejni nga libri "Er-Risaleh" i Imam Shafi'ut, të cilin sot e kemi në duar. Kjo ndoshta sepse ai ka transmetuar nga teksti i plotë i veprës "Er-Risaleh", e cila si e tillë nuk ka mbërritur deri te ne. Këtë (Ibn Muhtari) e argumenton vetë fjalët e Imam Shafi'ut, i cili thotë: "Më janë humbur disa libra të mi. Pastaj këtë e vërtetova nga vetë dijetarët, prandaj e shkurtova librin tim nga frika që të mos jetë shumë i gjatë dhe kam shkruar vetëm aq sa ka nevojë, pa u zhytur tërësisht në hollësi." <sup>388</sup> Megjithatë, Ibn Muhtari ka transmetuar nga Haxhevi se Malik bin Enesi "ka sinjalizuar disa rregulla të usulit në veprën "Muvetta'", kurse Serahsiu ka ardhur në përfundim se i pari që shkroi në shkencën e usuli fikhut është Ebu Hanifja, të cilin pastaj e ndoqën dy nxënësit e tij të dalluar, Ebu Jusufi dhe Muhamed bin Haseni, e pastaj Shafi'u. <sup>389</sup>

Siç duket, ndjekësit e çdo shkolle juridike (medhhebi) përpiqen që zanafillën e usuli fikhut ta lidhin me imamët e shkollës së tyre. Mirëpo, Ibn Halduni, mbase e ka shprehur mendimin e shumicës së dijetarëve kur ka ardhur në përfundimin se Imam Shafi'u është i pari që e shpiku shkencën e usuli fikhut, "sepse e shkroi veprën e tij të njohur "Er-Risaleh"... e pastaj kanë shkruar dijetarët hanefi për këtë problematikë, i vërtetuan disa rregulla dhe i trajtuan më gjerësisht ato." <sup>390</sup>

Shatibiu është studiuesi i parë që e nxori në skenë temën e intencave, dhe atë nga trajtesat e usuli fikhut, prandaj vepra

<sup>388</sup> Muhamed bin Idris Esh-Shafij, (vd. 204 h.), *Er-Risaleh*, i përgatitur për botim nga Ahmed Muhamed Shakir, Kajro, botimi Mustafa Babi 'l-Halebij, 1938 m., fq. 431

<sup>389</sup> Ahmed Veffar Ibn Muhtar, *Mekasid'ush-sheriat inde 'l-imam Esh-shafij*, Kajro, Dar'us-Selam, 2014, fq. 55

<sup>390</sup> Ibn Haldun, *Mukaddimetu Ibn Haldun*, vep. e cit., fq. 962

“El-Muvafekatu” është vepra themelore që ai shkroi për disiplinën e intencave.<sup>391</sup> Ai pohon atë që ka konkluduar Ibn Kajjimi se koncepti i “intencave” ishte i pranishëm edhe te sahabët, pra Shatibiu i përshkruan sahabët se “ata i njihnin intencat e shariatit, i përvetësuan, themeluan rregulla prej tyre dhe i vendosën fundamentet e tyre. Ata u njohën me idetë e hedhura për ajetet e Kur’anit dhe u angazhuan me shumë zell në realizimin e parimeve dhe të synimeve të tyre.”<sup>392</sup>

<sup>391</sup> Imam Shatibiu e ndau veprën “El-Muvaffekatu” në pesë kapituj, ku secili kapitull u quajt libër. Në librin e intencave trajtoi 62 çështje të intencave të Ligjvënësit dhe të personit të ngarkuar me detyrë. Kjo materie u shtri në 260 faqe nga gjithsej 936 sa ishte i tërë libri. Për këtë shih: Esh-Shatibij, *El-Muvafekatu fi usul’ish-sheriatit*, vep. e cit., fq. 219-479

<sup>392</sup> Esh-Shatibij, *El-Muvafekatu fi usul’ish-sheriatit*, vep. e cit., fq. 14

## Pjesa e tretë:

# Klasifikimi i intencave pedagogjike

Islami është feja të cilën e predikuan të gjithë pejgamberët te njerëzit. Çdo pejgamber sillte udhëzim dhe mëshirë për njerëzit, në mënyrë që t'u sigurohet mundësia e gjurmimit në çështjet ekzistenciale për të cilat nuk mund t'u ndihmonte askush. Më saktësisht, feja u mundësoi njohjen e Zotit, të universit dhe të vetë njeriut. Allahu i Lartësuar është Krijuesi, Furnizuesi dhe Planifikuesi Absolut. Universi me të gjitha gjërat, ndodhitë dhe fenomenet brenda tij është i krijuar dhe i përsosur me përpikëri sipas ligjeve që ka vënë Vetë Allahu. Njeriu u krijua më vonë në univers, por u krijua për të ndërtuar jetën në të dhe për të vënë gjithçka në shërbim të rrugës që na ka mësuar Krijuesi. Sheriatet (sistemet juridike) e fesë që u janë shpallur Pejgamberëve kanë ndryshuar në varësi të situatave që kanë kaluar gjeneratat e njerëzimit, në mënyrë që të jenë më të pranueshme për njerëzit dhe për t'ua lehtësuar atyre rrugët e udhëzimit. Megjithatë, shariatën e Muhammedit Allahu xh.sh. e bëri unik për mbarë njerëzimin, kurse Muhammedin a.s. e bëri përmbyllës të ciklit të pejgamberëve në tokë. Sheriati përmbyllës i Islamit është i inkorporuar në një Libër fisnik dhe plotë urtësi i cili përmban një sërë parimesh, programesh dhe domethëniesh udhëzuese, dhe atë në formë mjaft të qartë. Po ashtu, Libri i këtij sheriati (Kur'ani) ka disa karakteristika universale dhe të përsosura. Ka zbritur në një mënyrë të urtë graduale, të përshtatshme për t'u edukuar prej tij dhe plotësisht të aplikueshme. Pra, Kur'ani fisnik është libri i këtij udhëzimi të përsosur.

Intenca e përgjithshme e edukimit në Kur'an është udhëzimi i njeriut në një rrugë të përcaktuar këtë botë dhe përgatitja për botën tjetër, por çdoherë duke ditur se:

- Me fjalën *njeri* këtu synohet mbarë gjinia njerëzore, sepse sheriati islam nuk kufizohet vetëm në problematika që

kanë të bëjnë vetëm me muslimanët, por përfshin edhe raportet e grupet tjera jomuslimane të shoqërisë.

Udhëzimi nuk kufizohet vetëm në adhurimin që njeriu i bën Zotit të Lartësuar në sferat e sheriatit, por përfshin edhe adhurimin në sfera tjera të marrëdhënieve mes njerëzve, si në politikë, ekonomi, shoqëri dhe në fusha të tjera.

Mënyra e jetesës në të cilën udhëzon Kur'ani nuk është ngarkesë, as pranga që ngulojnë aktivitetin e njeriut dhe as dobësues i energjisë njerëzore, por janë një mori parimesh të përgjithshme të cilat Allahu i ka sjellë për lehtësim, mëshirë dhe shtesë, e që përmes këtyre t'i realizojë interesat dhe përfitimet e kësaj bote, të mos humbasë dhe të mos pikëllohet. Gjithashtu, ky udhëzim hap sferën e zhvillimit, të përparimit dhe të përpjekjes për të fituar eksperiencën e nevojshme njerëzore me të cilën do të menaxhojë punët e kësaj jete komfor këtyre parimeve dhe t'i perceptojë intencat nga të cilat janë përthithur këto parime.

Jeta e kësaj bote është jeta faktike që e jetojmë, por ajo qëndron përball jetës tjetër përfundimtare e cila premtohet në të ardhmen. Pozita e njeriut në Botën Tjetër varet nga aktiviteti dhe fitimi i tij në këtë botë. Për shkak të rëndësisë që ka kjo botë, Allahu xh.sh. ka sjellë disa legjislacione udhëzuese për aktivitetin e njeriut në të, në mënyrë që të realizohet dëshira e Allahut për ta pastruar njeriun dhe për ta zhvilluar jetën në të. Ata që fokusohen (tërësisht) në këtë botë tërheqin hidhërimin e Zotit, sepse ajo është e shkurtër dhe nuk meriton për ta bërë qëllim kryesor dhe jetik, veçanërisht nëse e krahasojmë me atë që pason në botën tjetër të përhershme.

- Në Botën Tjetër realizohet drejtësia absolute e Allahut të Lartësuar dhe secili shpërblehet sipas të mirave dhe të këqijave që ka bërë në këtë botë. Për këtë arsye kjo botë duhet marrë me seriozitet dhe me përgjegjësi. Pra, njeriu nuk duhet ta bëjë objektiv kryesor në këtë botë jetesën në të, duke lënë mënjanë Botën Tjetër, sepse Allahu xh.sh. thotë: ﴿اعْلَمُوا أَنَّمَا الْحَيَاةُ الدُّنْيَا لَعِبٌ وَلَهُمْ وَرِثَةٌ وَتَفَاحُرٌ بَيْنَكُمْ وَتَكَاثُرٌ فِي الْأَمْوَالِ وَالْأَوْلَادِ﴾ **“Punoni! Vërtet jeta e kësaj bote është lojë, dëfrim, zbukurim, mburrje mes jush dhe garë për të shtuar pasuritë dhe fëmijët.”** [El-Hadid: 20]

E në fund kënaqësitë e kësaj bote zhduken krejtësisht dhe mbetet vetëm llogaria për punët që janë vepruar në dynja.

Kjo është intenca e përgjithshme dhe universale që përftohet nga mesazhi islam. Çdo fjalë tjetër që thuhet për intencat e edukimit pas kësaj është vetëm sqarim dhe shkoqitje e hollësishme e kësaj intence. Po ashtu, bisedat tjera janë përpjekje për ta shprehur hollësisht këtë intencë dhe për ta zbritur atë në sistemin e përgjithshëm edukativ, i cili pastaj ndahet në institucionet e ndryshme shoqërore dhe humane, si në: familje, shkollë, universitet dhe në hapësirën sociale, dhe atë me aktivitete dhe angazhime të ndryshme në institucionet mediatike, politike, ligjore dhe të tjera.

## 1. Intencat edukative për këtë botë dhe për Botën Tjetër

Në paragrafin paraprak u bisedua për praninë e konceptit të “intencave” në përgjithësi, kurse sa u përket intencave të edukimit (pedagogjisë), ato janë të pranishme në çdo rast ku Kur’ani sqaron qëllimin e krijimit të njeriut dhe jetën e tij në këtë botë. Intenca më e lartë është adhurimi dhe ndërtimi i jetës. Allahu xh.sh. thotë: ﴿وَمَا خَلَقْتُ الْجِنَّ وَالْإِنْسَ إِلَّا لِيَعْبُدُونِ﴾ **“Nuk i kam krijuar xhinët dhe njerëzit përveçse për të Më adhuruar”** [Edh-Dharijat: 56] Gjithashtu, i Lartësuari thotë: ﴿هُوَ﴾ **“Ai ju krijoi nga toka dhe kërkoi të jetoni në të”** [Hud: 61] Allahu i Lartësuar e ka sqaruar se intencë (qëllim) është adhurimi dhe jetesa, e jo vetëm adhurimi në kuptimin e riteve, si namazi, agjërimi, zeqati, haxhi dhe forma tjera të dukshme. Secili adhurim ka intencat e veta. Intencë e namazit është largimi nga e shëmtuara dhe e urreyera. Intencë e agjërimit është durimi për të qenë i dëgjueshëm dhe arritja e devotshmërisë. Intencë e zeqatit është pastrimi i shpirtit nga koprracia, zhvillimi i pasurisë dhe përkujdesja për shoqërinë. Intencë e haxhit është që muslimanët t’i shohin të mirat e njëri-tjetrit...

Vërejmë se intencat e këtyre adhurimeve e kalojnë dimensionin individual të atyre që i veprojnë dhe shtrihen në sferën

e interesave të mbarë shoqërisë, madje vazhdojnë të zgjerohen derisa ta përfshin gjithë njerëzimin, ngase Kur'ani është ligjërim që i drejtohet gjithë gjinisë njerëzore dhe Allahu po ashtu është Krijuesi dhe Zoti i të gjithë njerëzve. Synimi i këtyre adhurimeve është edukimi i njeriut, formimi i personalitetit të tij dhe rregullimi i marrëdhënieve të tij me Zotin, me shoqërinë dhe me ambientin që e rrethon. Mund të konkludojmë se krejt ajo që zbulon sot njeriu me emërtime moderne në shkencat bihevorige, psikologjike, pedagogjike dhe sociale janë vetëm përpjekje për të zbatuar kuptimin e reformuar të teksteve të Kur'anit dhe të traditës pejgamberike të Muhammedit a.s.

Sa i përket intencës së ndërtimit të jetës është e qartë se kuptimet e kësaj intence janë të hapura për kapacitetin njerëzor që ta avancojë jetën në varësi të përvojave dhe eksperimenteve, çdoherë duke vënë në shërbim atë që Allahu ka krijuar për ata në këtë botë. Allahu xh.sh. thotë: ﴿وَلَقَدْ مَكَّنَّاكُمْ فِي الْأَرْضِ وَجَعَلْنَا

﴿لَكُمْ فِيهَا مَعَايِشَ قَلِيلًا مَّا تَشْكُرُونَ﴾ **“Ne ju mundësuam juve në tokë dhe për ju bëmë jetë në të. E pak nga ju falënderoni!”** [El-A'raf: 10]

Të gjitha gjërat, dukuritë dhe potencialet që janë në qiej dhe në tokë janë sfera të të menduarit për mënyrat se si krejt këto të vihen në funksion të zbulimit dhe krijimit të lehtësive lëndore. Po ashtu, të ndihmojnë në kuptimin e fakteve që lidhen me njeriun dhe me ndërtimin e jetës, ashtu që me këto të krijohen sisteme dhe ligje, dhe të rregullohen marrëdhëniet mes të njëjtave. Allahu xh.sh. thotë: ﴿وَسَخَّرَ لَكُمْ مَّا فِي السَّمَاوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ

﴿جَمِيعًا مِنْهُ إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِّقَوْمٍ يَتَفَكَّرُونَ﴾ **“Për ju nënshtroi krejt ç'ka në qiej dhe në tokë. Në këtë ka fakte për popull që mendon.”**

[El-Xhathije: 13] Në sferën e ndërtimit të jetës së kësaj bote, gjithashtu mund të vijmë në përfundim se ajo që zbulohet nga njeriu dhe që njihet me emërtimet si shkencë natyrore dhe aplikative janë vetëm përpjekje për një formë të re të të kuptuarit të teksteve të Kur'anit fisnik dhe të traditës pejgamberike të Muhammedit a.s. Megjithatë, ne kuptojmë se intencat e ndërtimit të jetës sot nuk kufizohen vetëm në aspektin lëndor apo në atë që sjell lehtësime (materiale) në jetën e njeriut, por ato (intencat) përmbajnë aftësinë për të ndërtuar

legjislacione dhe ligje që sigurojnë lirinë, drejtësinë dhe zhvillimin në aspektet e ndryshme shoqërore, politike, ekonomike dhe në shumë aspekte tjera që lidhen me shoqërinë dhe me përmirësimin e nivelit të jetesës.

Urtësi e Zotit është që njeriun e krijoj në formën më të mirë, si në aspektin trupor, ashtu edhe në atë shpirtëror. Kjo nënkupton se angazhimi i njeriut në këtë botë duhet shtrirë në sferën e adhurimit dhe të rregullimit të jetës. Kemi dy lloje të angazhimeve: i pari, angazhimi për mësimin e kërkesave të adhurimit dhe të rregullimit të jetës së kësaj bote, por me të cilat pastaj fitohet mirësia e botës tjetër. Kjo është një nga intencat pedagogjike. Angazhimi i dytë është mësimi i kërkesave të adhurimit dhe të rregullit të jetës, por të cilat i shërbejnë nevojave të kësaj bote. Edhe kjo është një nga intencat pedagogjike.

Për konceptin e adhurimit, Ragib Isfahani e ka sqaruar rëndësinë e gërshetimit të kuptimit të veçantë të riteve me kuptimin e përgjithshëm i cili ndërlidhet me çështjen e mëkëmbjes dhe jetesës së njeriut në tokë, andaj thotë: “Objektivi për të cilin u krijua njeriu është të adhurohet Allahu, të jetë mëkëmbës i Tij, të ndihmojë në emër të Tij dhe të ndërtojë jetën e kësaj bote (sipas rrugës së Tij). Siç ka spikatur Allahu i Lartësuar me urtësi në ajete të ndryshme nëpër Kur’an, ndër ato është ajeti vijues: ﴿وَمَا خَلَقْتُ الْجِنَّ وَالْإِنْسَ إِلَّا لِيَعْبُدُونِ﴾ **“Nuk kam krijuar xhinët dhe njerëzit përveçse për të Më adhuruar.”** [Edh-Dharijat: 56]<sup>393</sup>

Marrë parasysh se njeriu për nga natyra ndikohet nga gjërat e afërta dhe të shpejta, Allahu i Patëmetë ka premtuar se kush punon punë të mira, qoftë burrë apo grua, do ta shpërblejë me jetë të mirë në këtë botë krahas shpërblimit në Botën Tjetër. Allahu xh.sh. thotë: ﴿مَنْ عَمِلَ صَالِحًا مِّنْ ذَكَرٍ أَوْ أُنْثَىٰ وَهُوَ مُؤْمِنٌ فَلَنُحْيِيَنَّهٗ حَيَاةً طَيِّبَةً وَلَنَجْزِيَنَّهُمْ أَجْرَهُمْ بِأَحْسَنِ مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ﴾ **“Kush ka punuar një të mirë nga meshkujt apo femrat duke qenë besimtar, gjithsesi do t’i japin një jetë të mirë dhe do ta shpërblejmë me shpërblimin më të mirë për atë që kanë punuar.”** [En-Nahl:

<sup>393</sup> Ebu 'l-Kasim El-Husejn bin Muhamed bin El-Mufaddal Er-Ragib El-isfahani, (vd. 502 h.), *Tafsill'un-nesh'etejini ve tahsil'us-seadetejini*, Bejrut, Daru Mektebet'il-hajati, 1983, fq. 48

97]. Ky është premtim për të mirat në këtë botë, ndërsa shpërblimi më i madh është kënaqësia me atë që të është caktuar, optimizmi për të ardhmen, shëndeti dhe krenaria për qenin musliman. Kjo është një çështje e thukët ku njerëzit dallohen sipas brendisë së tyre shpirtërore, prandaj Allahu xh.sh. u jep robërve besimtarë sipas gradës së përkushtimit dhe shpresave që kanë në shpirtrat e tyre. Kush e kalit shpirtin, i sheh të mirat e saj.”<sup>394</sup> Për komentimin e frazës “jetë të mirë” Ibn Kethiri ka thënë: “Fraza *jetë e mirë* përfshin rehatinë nga çdo aspekt i mundshëm.” Pastaj thekson kuptime të ndryshme të sjella nëpër transmetime, si p.sh. bindje, lumturi, risk hallall, adhurim në dynja, angazhimi për nënshtrim dhe qetësia e fituar nga ky angazhim. Me këtë rast përfundon me këto fjalë: “E saktë është se *jetë e mirë* i përfshin të gjitha këto.”<sup>395</sup> Ebu Zehre, në komentimin e këtij ajeti fisnik, ka thënë se Allahu i Lartësuar “kur e thekson *jetën e mirë* nuk përmend shpërblim, por thotë se ajo është e lidhur ngushtë me angazhimin e mirë (të dobishëm) që buron nga zemra e shëndoshë. Pra, *jeta e mirë* këtu është fryt i punës së mirë, njësoj si prodhimi i mbjellë (kur mbillet mirë, korret mirë), d.m.th. sa herë të ketë punë të mirë, do të ketë edhe jetë të mirë.”<sup>396</sup>

Kjo është në këtë botë, kurse në Botën Tjetër Allahu nga mëshira dhe begatia e Tij do t'i shpërblejë ata besimtarë që bëjnë punë të mira dhe që i durojnë sprovat e kësaj bote, të cilët do t'i shpërblejë sipas punëve më të mira që kanë bërë në dynja. Këtë Zoti xh.sh. e bën në saje të mirësisë dhe bujarisë së Tij, i Cili i fal të këqijat dhe i shumëfishon të mirat.

Besimtari i cili vepron mirë nuk duhet që ambicia për jetë të mirë ta lidhë me dynjanë, të rehatohet tërësisht në të dhe të përpiqet të shtojë dëfrimet, sepse ajo është e shkurtër, e përkohshme dhe kënaqësitë e saj do të përfundojnë shumë shpejt. Prandaj, kujt i mjafton durimi karshi shmangies së përmendjes së Allahut, atëherë ﴿وَمَنْ أَعْرَضَ عَن ذِكْرِي فَإِنَّ لَهُ مَعِيشَةً ضَنْكًا

<sup>394</sup> Ibn Ashur, *Et-Tahriru ve 't-tenviru*, vep. e cit., komentimi i ajetit 97 të sures En-Nahl, vëllimi XIV, fq. 273

<sup>395</sup> Ibn Kethir, Ebu 'l-Fida Ismail bin Omer Ed-Dimeshkij (vd. 774 h.), *Tefsir'ul-Kur'an'il-adhim*, i përgatitur për botim nga Sami bin Muhamed Selame, Riad, Daru Tajjimetu li 'n-Neshri ve 't-tevzi'i', botimi II, (1420 h./1999), komentimi i ajetit 97 të sures En-Nahl, vëllimi IV, fq. 601

<sup>396</sup> Muhamed Ebu Zehre, *Zehret'ut-tefasiri*, Bejrut, Dar'ul-Fikr'il-Arabijji, botimi I, 1987, fq. 4265



﴿وَنَحْشُرُهُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ أَعْمَى﴾ **“Kush ia kthen shpinën përmendjes Sime, Ai (njeriu) do të ketë jetë të vështirë”** [Ta Ha: 124] dhe jo jetë të mirë, ndërsa kush e ndjek udhëzimin e Allahut të Lartësuar nga dëshira se ai është më i mirë dhe më i qëndrueshëm, i tilli do të shpërblehet me më të mirën e asaj që ka punuar.

Shkujdesi i njeriut për të fituar ahiretin buron nga ambicia për të mirat e dynjasë, por kjo i humb hisen e ahiretit. Prandaj, kush e do Botën Tjetër dhe punon qysh në këtë botë për atë, nuk ka gjë të keqe pse dëfrehet dhe jeton mirë. Ibn Ashuri ka thënë: “Shtimi i të mirave të dynjasë duke mos i lënë pas dore shkaqet e shpëtimit në Botën Tjetër është një sferë që meriton t’i kushtohet kujdes, pra nuk është punë e shëmtuar.”<sup>397</sup>

Intencat edukative ku gërshetohen të mirat e kësaj bote dhe të botës tjetër janë tipari themelor i edukimit islam, prandaj këto intenca meritojnë të jenë një ofertë e rëndësishme në fushën e kontributit pedagogjik-bashkëkohor-islam.

## 2. Intencat edukative synuese dhe intencat pedagogjike instrumentale

Standardi i klasifikimit të intencave edukative në synuese dhe instrumentale lidhet me standardin e klasifikimit të objektivave në objektiva të kësaj dhe të botës tjetër. Duket se shumica e literaturës pedagogjike bashkëkohore përputhet me objektivat që ndërlidhen me individin dhe me shoqërinë në vile të instrumenteve apo mjeteve, pra nuk janë intenca apo synime kryesore (madhore). Arsyeja e kësaj është se synimet dhe intencat madhore zakonisht janë me rreze më të gjerë veprimi dhe shprehin përjetimet e shpirtit dhe të ndërgjegjes dhe gjendjet sociale që vështirë se maten. Prandaj, kultura pedagogjike udhëheqëse anon kah mundësia e ekzistimit të këtyre objektivave në fushën e sjelljeve të qarta personale apo në fushën e përparimit të shoqërinë brenda kufijve politikë nacionalë. Në këndvështrimin fetar në përgjithësi dhe në atë islam në veçanti, objektivat lidhen me çështjet eskatolo-

<sup>397</sup> Ibn Ashur, *Et-tahriru ve et-tenviru*, vefq. e cit., ajeti 18 i sures el-A’la, vëllimi XXX, fq. 290

gjike, me fatin e njeriut pas vdekjes dhe me vetëdijen për Botën Tjetër.

Studiuesit kanë bërë hulumtime të ndryshme për të sqaruar objektivin e objektivave në edukim. Abdulhalim Fet'hulbabi konstaton se objektivat e shariatit qëndrojnë mbi tre themele: I pari është funksionimi i përgjithshëm i vënë nga Kur'ani për mëkëmbjen e njeriut në tokë; i dyti është përgatitja e njeriut për të vepruar apo punuar në ndërtimin e jetës në tokë dhe i treti është nevoja për ruajtjen e ekzistencës dhe të jetës së njeriut në tokë. Krejt këto mund të realizohen vetëm nëse bëhet realitet qëllimi i qëllimeve apo objektivi i objektivave, e ajo është "liria me kuptimin e çlirimit nga prangat që pengojnë apo kufizojnë të menduarit, lëvizjen dhe veprimin e njeriut, dhe të marrë vendime me vetëpëlqim. Kjo objektivë dallohet me dy tipare: tipari i parë është se kjo objektivë është e përgjithshme dhe universale, prandaj edhe i përshtatet synimeve dhe objektivave të të gjithë njerëzve. Tipari i dytë është se ajo është objektiv edhe për të gjitha objektivat pararendëse dhe nuk është mjet i objektivave pasuese."<sup>398</sup>

Mbi këtë bazën përcaktohen karakteristikat e kësaj lirie dhe të sferave të saj. Ajo është përgjegjësi personale dhe shoqërore, dhe qëllim universal. Të gjitha objektivat tjera për të cilat bëjnë fjalë studiuesit nën emrin "intenca të shariatit" konsiderohen objektiva instrumentale. Objektivat instrumentale janë objektivat e edukimit të cilat çojnë në realizimin e lirisë, kurse liria është objektivë universale humane e edukimit e cila u nevojitet mbarë njerëzimit, sepse ajo e çliron njeriun nga prangat që i kanë zënë frymën të menduarit dhe lëvizjes së njeriut. Kur të jetë arritur ajo, atëherë bëhen realitet edhe objektivat tjera, si p.sh. mësimi i Librit dhe i urtësisë, pastrimi i shpirtit, drejtimi subjektiv, fitimi dhe profesionalizmi, matja dhe peshimi i punëve, arsimimi, hulumtimi shkencor etj.

Më parë folëm për dallimin që Kejlani u bën objektivave të edukimit, dhe atë në objektiva synuese dhe objektiva instru-

<sup>398</sup> El-Bab Abdulhalim Sejjid Fet'hu, "El-Gajatu ve'l-ahdafu et-terbevijeti fi 'l-Kur'ani ve 's-sunneti", në: "Studimet e Konferencës Pedagogjike", kryeredaktor Fet'hij Hasen Melkavi, vëllimi II, fq. 1991, fq. 129-175

mentale, “ku asnjëri grup nuk mund ta shmang tjetrin”. Objektivat synuese (që janë synim në vete) pa mjetet mund të mbeten vetëm disa aspirata pothuaj të perealizueshme apo vetëm disa përpjekje (abstrakte) që nuk materializohen. Po ashtu, objektivat instrumentale që nuk kanë synime (përfundimtare) u mungojnë faktorët nxitës që fusin çdo gjë në veprim dhe synimet orientuese.”<sup>399</sup>

Për t'i dalluar këto dy tipa të objektivave, Kejlani mbështetet në qasjen kuptimore që ai ka ndaj tekstit kur'anor. Kur ajetet e Kur'anit flasin për intencat e krijimit, i vendosin ato në disa nivele të njëpasnjëshme varësie ku disa çojnë te të tjerat, dhe atë në formë graduale fillojnë nga objektivat instrumentale dhe përfundojnë te objektivat synuese. Këtë e shohim në shumë ajete të Kur'anit, veçanërisht në ajetet që flasin për momentet e krijesave të vëna në shërbim të njeriut.

Allahu i Lartësuar në fillim të sures En-Nahl thotë:

﴿وَالْأَنْعَامَ خَلَقْنَا لَكُمْ فِيهَا دِفْءًا وَمَنَافِعُ وَمِنْهَا تَأْكُلُونَ (5) وَلَكُمْ فِيهَا جَمَالٌ حِينَ تُرِيحُونَ وَحِينَ تَسْرَحُونَ (6) وَتَحْمِلُ أَوْقَالَكُمْ إِلَىٰ بَلَدٍ لَّمْ تَكُونُوا بِالْغَيْبِ إِلَّا بِشِقِّ الْأَنْفُسِ إِنَّ رَبَّكُمْ لَرؤُوفٌ رَّحِيمٌ (7) وَالْخَيْلَ وَالْبِغَالَ وَالْحَمِيرَ لِتَرْكَبُوهَا وَزِينَةً وَيَخْلُقُ مَا لَا تَعْلَمُونَ (8) وَعَلَى اللَّهِ قَصْدُ السَّبِيلِ وَمِنْهَا جَائِزٌ وَلَوْ شَاءَ لَهَدَاكُمْ أَجْمَعِينَ (9) هُوَ الَّذِي أَنْزَلَ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً لَكُمْ مِنْهُ شَرَابٌ وَمِنْهُ شَجَرٌ فِيهِ تُسِيمُونَ (10) يُنْبِتُ لَكُمْ بِهِ الرِّزْقَ وَالنَّيُّونَ وَالنَّخِيلَ وَالْأَعْنَابَ وَمِنْ كُلِّ الثَّمَرَاتِ إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَةً لِّقَوْمٍ يَتَفَكَّرُونَ (11) وَسَخَّرَ لَكُمْ الَّيْلَ وَالنَّهَارَ وَالشَّمْسَ وَالْقَمَرَ وَالنُّجُومَ مُسَخَّرَاتٍ بِأَمْرِهِ إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِّقَوْمٍ يَعْقِلُونَ (12) وَمَا ذَرَأَ لَكُمْ فِي الْأَرْضِ مُخْتَلِفًا أَلْوَانُهُ إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَةً لِّقَوْمٍ يَذَّكَّرُونَ (13) وَهُوَ الَّذِي سَخَّرَ الْبَحْرَ لِتَأْكُلُوا مِنْهُ لَحْمًا طَرِيًّا وَتَسْتَخْرِجُوا مِنْهُ حَبْلَةً حَلِيبَةً تَلْبَسُونَهَا وَتَرَى الْفُلْكَ مَوَاجِرَ فِيهِ وَلِتَبْتَغُوا مِنْ قَضَائِهِ وَلِعَلَّكُمْ تَشْكُرُونَ﴾

“Kafshët Ai i ka krijuar për ju. Njëpërmjet tyre ju siguron rroba të ngrohta dhe dobi të tjera. Prej tyre ju ushqeheni dhe shikoni pamje të bukura, kur i ktheni nga kullota dhe, kur i nxirrni në kullotë. Ato mbajnë barrët tuaja deri në vende të largëta, tek të cilat ju do të arrinit me mundim të madh; me të vërtetë, Zoti juaj është i Butë dhe Mëshirëplotë. (Ai ka krijuar) edhe kuajt, mushkat dhe gomarët, që ju t'i shaloni dhe t'i mbani për bukuri. Ai krijon edhe gjëra që ju nuk i dini. Allahut i takon që t'ju tregojë rrugën e drejtë, kur ka prej tyre edhe të shtrembra; sikur të donte Allahu, do t'i udhëzonte

<sup>399</sup> El-Kejlani, *Ahdafut-terbijjet'il-islamijeh, mukarenetun bejne ahdafit-terbijjet'il-islamijeti ve 'l-ahdafit-terbijjet'il-muasereti*, vep. e cit., fq. 15

të gjithë. Është Ai që zbret nga qielli shi, i cili ju siguron ujë për të pirë dhe bën që të rriten bimët, që shërbejnë si ushqim për kafshët. Njëpërmjet tij (ujit) rriten të lashtat, ullinjtë, palmat, rrushi dhe fruta të llojlojshme. Këtu ka vërtet tregues (të fuqisë hyjnore) për njerëzit, që kuptojnë. Ai ka bërë që ju ta shfrytëzoni natën dhe ditën, Diellin dhe Hënën. Edhe yjet janë vënë në shërbimin tuaj me urdhrin e Tij. Njëmend, në këto ka shenja për njerëzit që mendojnë. Ai ka krijuar në Tokë për ju çdo gjë me ngjyra dhe cilësi të ndryshme. Natyrisht që në këto ka shenja për njerëzit që ua vënë veshin. Është Ai që ju ka vënë në shërbim detin, që ju të hani prej tij mish të freskët dhe të nxirrni nga ai stolitë që mbani. Ti sheh se si anijet e çajnë atë, që ju të kërkon mirësitë e Allahut dhe të jeni mirënjohës.” [En-Nahl: 5-14]

Ne besojmë se Kur’ani udhëzon në formën e përsosur të dijës, të të kuptuarit dhe të menduarit. Këto ajete, në formë përsëritëse, i sqarojnë objektivat e krijesave të cilat Allahu i ka krijuar për të qenë në shërbim të njeriut mëkëmbës, prandaj thuhet “i ka krijuar ato për ju”, “jua ka nënshtruar juve”, “mbinë për ju” etj. Pastaj e sqaron motivin e nënshtrimit me L-në arsyetuese (lamu ta’lil) e cila flet për objektiva instrumentale të drejtpërdrejta, si p.sh. me frazat: “për t’u hipur atyre dhe zbukurim”, “për të ngrënë prej tyre”, “për të nxjerrë...”, “për të kërkuar...”. Më pastaj këto çojnë në objektiva të nivelit më të lartë, prandaj këto gjëra të nënshtruara për njeriun trajtohen tregues të mirësisë së Allahut për njeriun, të cilat e ndihmojnë të mendojë, të logjikojë dhe të përkujtojë: “për popull që mendon”, “për popull që logjikon”, “që të jeni mirënjohës”. Qëllimi i gjithë këtyre përligjjeve që u theksua në këto ajete është se Vetë Allahu i Lartësuar është qëllimi kryesor dhe intenca përfundimtare e krejt këtyre të mirave që i janë nënshtruar njeriut, pra t’u ndihmojnë njerëzve që ta njohin mirësinë e Allahut dhe të jenë mirënjohës. Në këtë mënyrë realizohet adhurimi për të cilin njerëzit janë krijuar, çdoherë sipas fjalës së Zotit të Madhërisëm: ﴿وَمَا خَلَقْتُ الْجِنَّ وَالْإِنْسَ إِلَّا لِيَعْبُدُونِ﴾ **“Nuk i kam krijuar xhinët dhe njerëzit veçse për të Më adhuruar.”** [Edh-Dharijat: 56] Ibn Ashuri ka thënë: “L-ja në fjalën *li ja’buduni* (për të Më adhuruar) është L e motivit,

pra “nuk i kam krijuar për ndonjë motiv tjetër veçse për motivin e adhurimit, pra të realizojnë vullnetin Tim dhe të Më adhurojnë”. Këtë vlerësim e jep edhe ajeti tjetër: **“Nuk dua prej tyre ndonjë furnizim apo të më ushqejnë”** [Edh-Dharijat: 57]. Ky konstatim vlen për çdo L (lam ta’lil), i cili vjen në Kur’an për të përligjur aktin e Zotit. Pra, Allahu nuk është i kënaqur nga ekzistenca e njeriut veçse kur ai ta pranojë si Zot të Vetëm dhe ta adhurojë vetëm Atë. Ndërsa detyrimet që Allahu ua ka ngarkuar robërve përmes gjuhës së pejgamberëve janë për të mirën e tyre në këtë dhe në Botën Tjetër, dhe për të arritur përsosmërinë e kësaj mirësie. Nuk ka asgjë të keqe se Allahu përmes legjislacioneve (të shpallura) të synojë përsosmërinë e njeriut dhe të vendosë sistem social për çdo kohë, madje kjo është edhe urtësia e krijimit, pra fjala “që të Më adhurojnë”, d.m.th. se Ai i krijoj që pastaj përmes sistemit të vënë nga Ai t’i zbatojnë obligimet sheriatike, qofshin urdhëresa apo ndalesa. Adhurimi që njeriu ia kushton Zotit s’është gjë tjetër veçse materializues i intencës së krijimit dhe zakonisht ndërmjetësues (mjet) për të arritur tek Ai.”<sup>400</sup>

Pa dyshim, besimi në gajb (të fshehën) është vetia e parë e besimtarëve të devotshëm të cilët evidentohen si të shpëtuar. Allahu xh.sh. thotë: ﴿الْم (1) ذَلِكَ الْكِتَابُ لَا رَيْبَ فِيهِ هُدًى لِّلْمُتَّقِينَ (2) الَّذِينَ يُؤْمِنُونَ بِالْغَيْبِ وَيُقِيمُونَ الصَّلَاةَ وَمِمَّا رَزَقْنَاهُمْ يُنْفِقُونَ (3) وَالَّذِينَ يُؤْمِنُونَ بِمَا أُنزِلَ إِلَيْكَ وَمَا أُنزِلَ مِنْ قَبْلِكَ ﴿Elif, Lâm, Mîm. Ky është Libri në të cilin nuk ka dyshim. Ai është udhërrëfyes për të devotshmit të cilët besojnë në të fshehtën, falin namazin dhe japin nga ajo që u kemi dhënë Ne; dhe për ata që besojnë në atë që të është shpallur ty (o Muhammed), në atë që është shpallur përpara teje dhe që me bindje i besojnë jetës tjetër. Ata janë udhëzuar në rrugë të drejtë nga Zoti i tyre dhe pikërisht ata janë të shpëtuarit.” [El-Bekare: 1-5] Jeta tjetër është e fshehtë dhe e përhershme. Nuk krahasohet asgjë e dynjasë me të, prandaj ajo është synimi dhe objektivi kryesor. Megjithatë, njeriut nuk mund të përfundojë atje

<sup>400</sup> Ibn Ashur, *Tefsiru et-tahriru ve et-tenviru*, vëfq. e cit., komentimi i sures Dharijat, vëllimi XXVII, fq. 25-27

veçse përmes dynjasë. Dynjaja është mjet, kurse ahireti mjet. Në rrugëtimin e dynjasë, për të arritur synimin e ahiretit, kërkohet angazhim dhe punë. Kështu që njeriu në një formë apo në një tjetër duhet ta kalojë atë, pastaj në varësi të punës në dynja korr rezultat në ahiret.

Trashëgimia islame është e mbushur plot me fjalë denigruese për dynjanë dhe asketizmin ndaj të mirave të saj. Bazuar në këtë trashëgimi, shumë muslimanë patën qasje të gabuar në kuptimin e tekstit kur'anor dhe të traditës pejgamberike të Muhammedit a.s.. Rezultat i kësaj mënyre të të kuptuarit ishte që shumë grupe të shoqërisë islame u përkushtuan vetëm ndaj mirësisë së ahiretit dhe menduan se fokusimi vetëm në adhurimet rituale dhe lutjet është mjeti (i vetëm) që çon në mirësinë përtejme. Ky mendim i cunguar apo i keqkuptuar i shtyri të heqin dorë nga puna produktive e cila u vyente atyre dhe të tjerëve në këtë botë, si dija, hulumtimi, fitimi material, agronomia, industria dhe kontributi i tyre i detyrueshëm i cili është hise që ata duhet t'ia japin shoqërisë dhe umetit... Këta u ngjajnë atyre që përpiqen të kryejnë detyrimin e tyre në sferat e angazhimit të kësaj bote duke pretenduar se qëllim i ardhjes në këtë botë është vetëm puna (pa adhurim). Këta të fundit nuk kanë aspirata për Botën Tjetër. Megjithatë duhet ditur se ajo që është dhënë në Kur'an dhe në sunet për asketizmin në dynja ka për qëllim obligimet e angazhimit në këtë botë të jenë në shërbim të ndërtimit të jetës, të mëkëmbjes, të krijimit të mundësisë dhe të endjes nëpër tokë për të gjurmuar, për të zbuluar, për të vënë drejtësinë dhe për të shmangur zullumin. Të gjitha këto i sjellin robët të mirat e ahiretit. Kënaqësia e kësaj bote nuk është gjë tjetër veçse siç e ka quajtur Zoti xh.sh. ﴿رِزْقَ اللَّهِ الّٰي اٰخَرَ﴾

﴿رِزْقَ اللَّهِ الّٰي اٰخَرَ﴾ **“stoli e Allahut të cilën e ka nxjerrë për robërit e Vet, dhe të mirat nga risku”** [El-A'raf: 32] Nuk ka asnjë të keqe që besimtarët të dëfrehen në dynja, siç ka thënë Allahu xh.sh. **“stoli e Allahut të cilën e ka nxjerrë për robërit e Vet”**. Pra, besimtari mund të dëfrehet me këto dhe me **“të mirat nga risku”**, njësoj siç dëfrehen njerëzit e tjerë. Kurse të mirat e ahiretit u takojnë vetëm besimtarëve dhe jo

të tjerëve. Allahu xh.sh. thotë: ﴿قُلْ مَنْ حَرَّمَ زِينَةَ اللَّهِ الَّتِي أَخْرَجَ لِعِبَادِهِ وَالطَّيِّبَاتِ وَالطَّيِّبَاتِ مِنَ الرِّزْقِ قُلْ هِيَ لِلَّذِينَ آمَنُوا فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا خَالِصَةً يَوْمَ الْقِيَامَةِ كَذَلِكَ نَفَصِّلُ الْآيَاتِ لِقَوْمٍ يَعْلَمُونَ﴾<sup>401</sup>

**“Thujaj: “Kush i ndaloi bukuritë dhe ushqimet e mira që Allahu i krijoi për robërit e Vet?” Thujaj: “Ato janë në këtë botë për ata që besuan, e në ditën e kiametit janë të posaçme për ta. Kështu i sqaron argumentet një populli që kupton.” [El-A’raf: 32]**

Puna në këtë botë është përgjegjësi e këtij (njeriu) të huaji dhe kalimtar, sepse kjo punë do ta çojë në synimin përfundimtar në Botën Tjetër.<sup>401</sup> Kush i kryen me sukses këto obligime, të cilat do të ngelen si punë të mira edhe pas vdekjes së tij dhe do të shfrytëzohen nga njerëzit e tjerë në dynja, ai do ta fitojë shpërblimin e tyre në ahiret, madje jo vetëm shpërblimin e punëve të veta, por edhe të atyre që kanë përfituar prej tyre. Shprehja “kalimtar i një rruge” për njeriun shpreh udhëtimin e shkurtër në dynja dhe thirrjen për ta investuar këtë kohë kaq të shkurtër në formën më të mirë. Me këtë rast vlen të rikujtohet shprehja e Pejgamberit a.s. për jetën e njeriut në këtë botë, ku thotë se njeriu është si udhëtari i cili ndalet të pushojë nën hijen e një peme, pastaj e le dhe ik për të vazhduar udhëtimin.<sup>402</sup> Gjithashtu, duhet të përkujtojmë se edhe vetë Pejgamberi a.s. në përditshmërinë e tij bënte atë që bënin njerëzit tjerë, pra të gjitha punët e dynjasë. Krahas kësaj ai jepte maksimumin e mundshëm për thirrjen, predikimin, arsimimin, sistemimin, menaxhimin, luftimin dhe xhihadit.

Dallimi mes intencave synuese dhe atyre instrumentale bëhet edhe më i madh kur bëhet diferencimi i shkencave mes njëra-tjetrës, sepse një sërë disiplinash shkencore nuk mësohen lehtë pa u mësuar disa të tjera. Ibn Halduni e ka folur gjërësisht për dy lloje të shkencave: “Shkenca që janë qëllim

<sup>401</sup> Muhammedi a.s. i ka thënë Ibn Omerit r.a.: “Bëhu në këtë botë si i huaj apo si kalimtar i një rruge!” Shih: - El-Buhari, Sahihu el-Buhari, vep. e cit., libri “Er-Rekaik”, Kapitulli “fjalët e Pejgamberit a.s.: bëhu në dynja si i huaj dhe si kalimtar i një rruge”, hadithi numër 6416, fq. 1232

<sup>402</sup> Imam Ahmedi transmeton nga Ibn Mes’udi r.a., e ai nga Muhammedi a.s., të ketë thënë: “Shembulli i dynjasë është si shembulli i një udhëtari i cili fle (pushon) nën hijen e një peme në një ditë vere, pastaj ik dhe lë atë.” Shih: Ibn Hanbel, Ebu Abdullah Ahmed bin Muhamed bin Hanbel bin Hilal bin Esed Esh-Shejbani (vd. 241 h.), *Musned’ul-Imam Ahmed*, i përgatitur për botim nga Shujb Arnauti dhe të tjerë, nën mbikëqyrjen e Abdullah bin Abdulmuhsin Turkij, Bejrut, Muesseset’ur-Risaleh, botimi I, (1421 h./2001), vëllimi VII, hadithi numër: 4208, fq. 253

në vetvete, si p.sh. disiplinat fetare si tefsiri (komentimi i Kur'anit), hadithi, fikhu, kelami apo si problemet filozofike natyraliste dhe teologjike. Dhe në llojin e dytë janë disiplinat instrumentale apo disiplinat shkencore që janë vetëm mjet i disiplinave të tjera, si p.sh. arabishtja (si gjuhë), matematika dhe disiplina të tjera (shariatike), apo siç janë logjika për filozofinë, madje edhe për ilmul-kelamin apo usulin sipas studiuesve të mëvonshëm. Sa u përket disiplinave shkencore që janë intenca në vetvete, mund të flitet gjerësisht për ato, për degëzimin e meseleve të tyre, për shpalosjen e argumenteve dhe vështrimeve etj. Kjo i jep më shumë mundësi studiuesit të këtyre disiplinave ta zotërojë më mirë materien dhe t'i qartësojë kuptimet e tyre të synuara. Kurse sa u përket disiplinave që janë mjet apo instrument i disiplinave të tjera, si p.sh. gjuha arabe, logjika dhe të ngjashme, ato duhet parë vetëm si mjete dhe aq." Megjithatë, Ibn Halduni nuk e ndalon që disiplinat shërbyese të jenë profesion i dikujt që të ngrihet dhe të avancohet, prandaj thotë: "Për këtë arsye, mësuesit nuk duhet të thellohen në këto disiplina shërbyese. Gjithashtu, duhet t'ua mësojnë nxënësve qëllimin e tyre dhe të mos e kalojnë (pra mos bëhen qëllim në vete). Megjithatë, kujt ia do ëndja të futet më thellë, le ta bëjë dhe le të ngrihet sa të dojë, qoftë rëndë apo lehtë, sepse secilit njeri i është lehtësuar ajo për të cilën është krijuar."<sup>403</sup>

Ne sot themi se profesionalizmi në mjekësi nuk nënkupton se studenti menjëherë do të fillojë të mësojë diagnostifikimin e sëmundjes dhe përshkrimin e ilaçit, por atij i duhet të fillojë me shumë disiplina tjera themelore si kimia dhe biologjia dhe pastaj mjekësinë. Po ashtu, sa i përket biologjisë së njeriut, studenti duhet të përvetësojë disa disiplina të tjera të hollësishme si citologjia, histologjia, anatomia, fiziologjia dhe të tjera. Studiuesi i shkencës së fizikës ka nevojë të dijë disiplinat matematikore. Studiuesit të inxhinierisë i duhen disiplinat e fizikës, të matematikës dhe të shkencave të materialit. Në këtë mënyrë disiplinat shkencore largohen nga

<sup>403</sup> Ibn Haldun, *Mukaddimetu Ibn Haldun*, vep. e cit., fq. 1114-1115



njëra-tjetra derisa bëhen disiplina shkencore të pavarura, megjithatë disa disiplina mbetet bazike për disa të tjera.

Tematikat e ndryshme të çdo shkencore klasifikohen në disa nivele, ku niveli më i ulët është themel i nivelit pasues apo është mjet për të arritur tek ai. Meqë studimi i mjekësisë fillon me studimin e disa shkencave natyrore, kjo nënkupton se studenti duhet të vazhdojë studimin e tyre derisa të bëhet mjek i përgjithshëm, pastaj hyn në studim shtesë për t'u bërë specialist në një degë të caktuar të mjekësisë (si në oftalmologji, ortopedi, urologji, kardiologji...). E njëjta është në inxhinieri, agronomi dhe të tjera. Pra, niveli i përgjithshëm është mjet për nivelin profesional.

Sot njihen sistemet arsimore për hierarkinë e arritjes së kualifikimit arsimor (marrjen e diplomës) në çdo disiplinë shkencore. Shumica e sistemeve universitare sot në botë e përcaktojnë fushën profesionale në nivel universitar (bekalorius), e cila pastaj është bazë për studimet e magjistraturës dhe të doktoratës. Mirëpo, që studenti të arrijë të regjistrohet në studimet universitare i duhet të kalojë dymbëdhjetë (12) vjet arsim të përgjithshëm, duke mësuar në çdo vit nivel të caktuar të disa disiplinave. Kështu duke u avancuar vit pas viti, nga niveli në nivel, derisa ta përfundojë arsimin e mesëm. Përgjatë këtij procesi jemi të vetëdijshëm, se posedimi i njohurive të caktuara për disa shkenca, jo domosdoshmërisht e bën të denjë atë për studimet universitare në një disiplinë shkencore të caktuar.

### 3. Klasifikimi i intencave edukative sipas tematikave shkencore

Nëse e llogaritim klasifikimin e shkencave në programet e edukimit bashkëkohor, atëherë do të shohim se intencat e edukimit në këto programe ndahen sipas grupeve kryesore të disiplinave shkencore: fetare, sociale dhe natyrore, pastaj secili grup ka nëndegë të vetat. Gjithashtu shohim se intencat e çdo grupi dhe çdo dege ndahen në një sërë nivelesh sipas klasifikimeve të zakonshme të objektivave të përgjithshme të

cilat i përcakton shoqëria për personalitetin e individit të nxënësit, dhe atë përcaktime intelektuale, shpirtërore, shoqërore dhe profesionale. Këto objektiva pastaj i përcaktojnë metodat e arsimit publik dhe i shpërndajnë tematikat e këtyre programeve nëpër lëndë mësimore. Në mesin e këtyre është grupi që quhet lëndë fetare ku bëjnë pjesë lëndët e Kur'anit, të sunetit, të fikhut dhe të tjera, grupi i shkencave shoqërore dhe humane ku bëjnë pjesë historia, ekonomia, filozofia dhe të tjera, pastaj grupi i shkencave natyrore dhe matematikore, si p.sh. kimia, fizika, algebra, inxhinieria etj.

Programet arsimore në çdo etapë të arsimit të përgjithshëm përbëhen nga disa nivele të caktuara të këtyre shkencave, dhe atë për të marrë njohuri dhe kulturë të përgjithshme. Pak më profesionalisht fillon në etapën më të lartë të arsimit të përgjithshëm, kurse në arsimimin universitar qarqet e profesionalizmit sa vijjnë e ngushtohen derisa studenti të diplomojë në një profesion shkencor të thelluar, si në teori ashtu edhe në praktikë. Kështu ai në fund del ekspert i tefsirit, i fikhut të një shkollë të caktuar juridike, i një disipline gjuhësore, i letërsisë, i edukimit, i ekonomisë, i kimisë, i mjekësisë, i inxhinierisë apo një drejtimi tjetër.

Me rëndësi është që këtu të ritheksojmë katër burimet e mendimit pedagogjik islam bashkëkohor, të cilat i theksuam më herët, e që janë: Kur'ani fisnik, tradita pejgamberike e Muhammedit a.s., trashëgimia islame dhe eksperiencia bashkëkohore. Kur'ani fisnik dhe shpjegimi i tij përmes traditës pejgamberike janë dy burime vendimtare, kurse trashëgimia islame është eksperiencë e gjeneratave të umetit se si i kanë kuptuar dhe si i kanë ushtruar intencat edukative të Kur'anit dhe të sunetit. Këto të fundit përbëjnë një eksperiencë historike të dobishme, si në aspektet pozitive ashtu edhe në ato negative. Ndërsa, eksperiencia edukative bashkëkohore është një pikë e rëndësishme nga e cila duhet nisur konstatimi i gjendjes faktike të shoqërisë ku jetojmë, nevoja dhe planifikimi për reformim dhe zhvillim. Arsimimi nëpër faza të ndryshme sipas kësaj metode luan një rol të rëndësishëm në

formimin e personaliteteve konstruktive dhe reformuese, dhe në përgatitjen e ekspertëve dhe profesionistëve.

Në situatën edukative të shoqërisë sonë bashkëkohore shohim se ekziston një filozofi edukimi, sistem edukativ, metoda edukative dhe institucione edukative. Gjithashtu, shohim se ekziston edhe një shkencë pedagogjike bashkëkohore që ngërthen teori dhe praktika të ndryshme të edukimit. Gjendja e edukimit në shoqërinë tonë ndikohen nga disa faktorë socialë, ekonomikë dhe politikë, ku trysni të brendshme imponojnë prioritete dhe mundësi vendore. Njashtu edhe trysnitë e jashtme të cilat lidhen me orientimet globale dhe me standardet ndërkombëtare. Megjithatë, krejt këto kanë potencial për projektimin e zhvillimit edukativ dhe arsimor, veçse duhet të merren në konsideratë, të caktohen objektivat edukative në nivele të ndryshme arsimore dhe në këtë frymë të caktohen edhe lëndët mësimore të domosdoshme bashkë me metodat dhe planin mësimor, që pastaj këto t'i realizojnë objektivat e kërkuara.

#### 4. Klasifikimi i objektivave edukative sipas institucioneve edukative në shoqëri

Në vështrimin islam, përgjegjësia e edukimit nuk kufizohet vetëm te institucionet arsimore sistematike (formale), siç janë shkollat dhe universitetet, por ajo bie mbi çdo institucion të shoqërisë, prandaj secili ka detyrën dhe përgjegjësinë e vet në edukim në kuptimin e përgjithshëm. Familja është institucion edukativ me plotë kuptimin e fjalës, madje detyra e saj edukative fillon para, përgjatë dhe pas institucionit shkollë. Fondamenti i rëndësishëm i edukimit në shkollë është pjesëmarrja e familjes, kurse arsimimi është vetëm pjesë e këtij edukimi. Në esencë, puna e universitetit është arsimimi dhe ushtrimi, kurse roli edukativ pastaj i jep një anë të rëndësishme në formësimin dhe kalitjen e personalitetit njerëzor. Mediat dhe institucionet mediatike e rritin ndikimin e tij në shoqërinë bashkëkohore, saqë ajo ndikon edhe nëpër aktivitetin e institucioneve të tjera. Kështu, hapësira sociale e

përgjithshme, sistemet politike, ligjore dhe ekonomike mbeten një terren i hapur për inkuadrimitin e ideve, orientimeve dhe stileve të veprimit. Pastaj, me vetëdije apo pa vetëdije, individi i përthith dhe i përvetëson.

Vetëdija e ekzistimit dhe e ndikimit të këtyre institucioneve në format e zhvillimit dhe formësimit të personalitetit, kërkon të bëhet dallim mes intencave që mund t'i realizojë çdo institucion, p.sh. familja është prehri ku njeriu rritet dhe zhvillohet fizikisht, mentalisht dhe emocionalisht në vitet e para të jetës. Zhvillimi që i ndodh individit në familje është shumë rëndësishëm, prandaj nuk duhet lënë që ky zhvillim të ndodh spontanisht apo tradicionalisht, por duhet krijuar vetëdija për intencat që mund të realizohen në këto sfera. Le të marrim shembull edukimin gjuhësor: e vërtetë është se fëmija e mëson gjuhën në mënyrë spontane dhe pa vetëdije të mjaftueshme të fëmijës, të prindërve dhe të anëtarëve tjerë të familjes në shumicën e rasteve. Megjithatë, në ato pak raste ku ekziston vetëdija për gjuhën, zhvillimi gjuhësor i orientuar në faza të hershme dhe i projektuar me metoda adekuate, ndoshta ndikon në jetën e individit përgjatë gjithë pjesës tjetër të jetës. E njëjta rritjen e fëmijës me traditat shoqërore të përshtatshme, për ndjesitë pozitive shpirtërore dhe për sjelljet të larta etike. Të gjitha këto janë intenca edukative të cilat realizohen në familje në vitet e para të jetës së njeriut, kurse efektet e tyre mbeten në të gjitha etapat pasuese të jetës. Mjeti më i mirë i rritjes dhe i zhvillimit të fëmijëve, ku do të realizohen këto intenca, është shembulli dhe modeli i mirë, gjë të cilën ia ofrojnë prindërit dhe anëtarët tjerë të familjes. E rëndësishme është që kjo të kryhet një formën të qëndrueshme dhe stoike, duke u ballafaquar me atë që mund të paraqesin institucionet tjera në formë të kundërt.

Intencat edukative që mund të realizohen në familje kërkojnë që familja të përgatitet për t'i dalë zot kësaj detyre. Rreziku qëndron në faktin se njeriu në formë të pavetëdijshme mund të përvetësojë dhe të ushtrojë forma të sjelljes, që pastaj lanë pasojë tek fëmijët. Siç thotë Zoti xh.sh.: ﴿بَلْ قَالُوا إِنَّا وَجَدْنَا آبَاءَنَا عَلَىٰ آثَارِهِمْ مُهْتَدُونَ﴾ **“Por thanë: ne i gjetëm baballarët tanë**

**në një fe, prandaj ne drejtohemi sipas gjurmëve të tyre.”**  
[Ez-Zuhruf: 22]

Disa shoqëri bashkëkohore sigurojnë shanse të ndryshme për përgatitjen e çifteve për ndërtimin e jetës bashkëshortore, për edukimin e fëmijëve para martesës, për trajnimin e prindërve se si t'i zgjidhin problemet bashkëshortore dhe familjare ose si t'i pengojnë të mos ndodhin ato probleme. Disa universitete ofrojnë kurse trajtuese dhe arsimore për edukimin prindëror (parenting), të cilat i përgatitin prindërit për të siguruar ambient edukativ të përshtatshëm për edukim dhe zhvillim të drejtë të fëmijëve.

Nuk ka hapësirë që të flasim gjerësisht edhe për detyrat dhe institucioneve tjera, megjithatë intencat edukative që duhet zbatuar janë të njëjta për secilin prej tyre. Mjafton të themi se intencat edukative në shkollë sipas vështrimit islam, duhet të shkallëzohen, të ndahen në tipa, të plotësohen nga viti në vit, të shpërndahen nëpër lëndë të tjera studimore dhe të përmbushen me intencat edukative të institucioneve të tjera, si familja, xhamia, lokali dhe të tjera.

Sa i përket xhamisë, intenca edukative që kërkohet të përmbushet nuk lidhet me kryerjen e namazit në përgjithësi, por me faljen e namazit me xhemat në formën e duhur, me përkushtim, me qetësi, me rend dhe në kohë. Namazi me xhemat ofron shanse të njohjes së ndërsjellë të xhematit, ndihmën e ndërsjellë që pastaj ata mund t'i ofrojnë njëritjetrit në shumë aspekte të veprimtarisë së përbashkët, ndërtimin e lidhjeve shoqërore dhe këmbimin e eksperiencave. Xhamia është ambient edukativ në sferën shpirtërore, etike dhe shoqërore. Në xhami ofrohet dije, mësim dhe përvetësim i leximit të Kur'anit, i shtyllave të fesë dhe i edukatës fetare. Krejt këto janë intenca edukative shumë të rëndësishme.

Hapësira e përgjithshme shoqërore është ambienti ku bashkëveprojnë institucione të ndryshme sipas natyrës së sistemit të përgjithshëm në shoqëri, sipas ideve që ka përvetësuar shoqëria dhe manifestimit të tyre në jetën politike, ekonomike, shoqërore, fetare, ligjore, mediatike dhe të tjera. Rëndësi të veçantë ka edhe pozita dhe qëndrimi i shoqërisë

ndaj influencuesve rajonalë dhe ndërkombëtarë. Krejt këto kanë efekte negative apo pozitive në modelin e zhvillimit të familjes dhe të sistemit arsimor. Efekti i këtyre influencuesve në edukimin e individit është arritja gjithëpërfshirëse e bashkëveprimit të këtyre forcave dhe influencuesve kontraktorë dhe konkurrues.

Nuk duam që të ngulitet në mendje se efekti edukativ në personalitetin e individit është rezultat i projeksionit të këtyre institucioneve, forcave dhe faktorëve, edhe pse në një masë ajo nuk mohohet, bile tekefundit individi nuk mban (krejt) përgjegjësinë e përfundimit të këtyre indikatorëve. Po ashtu, nuk duam që të ngulitet në mendje se edukimi shkollor është përgjegjës për mosfunksionimin e duhur të edukimit familjar, sepse përndryshe nuk do të kishte asnjë vlerë familja dhe ambienti i përgjithshëm shoqëror. Anarkia e orientimit politik dhe e funksionimit mediatik mund të shkatërrojë atë që ofron familja dhe shkolla. Fatkeqësisht, deri te ky rezultat mund të sjellë mërzia dhe dëshpërimi.

Mendimi pedagogjik islam të cilin kërkojmë ta zhvillojnë më tutje nis nga tri çështje të domosdoshme:

Vlera e ndikimit pozitiv të çdo institucioni, si familja, shkolla apo ndonjë institucioni tjetër, mund të jetë e fuqishme dhe ndikuese sa të mjaftojë për të ulur ndikimet negative të forcave të tjera.

Përgjegjësit e çdo institucioni mbajnë përgjegjësi, në dynja dhe në ahiret, për gjendjen edukative që është produkt i aktivitetit të institucionit të tyre.

Më në fund, vetë individi është përgjegjësi kryesor për edukatën e tij përgjatë jetës. Kur ai i nënshtrohet ndikimit të institucioneve të ndryshme, duke u ngritur dhe duke u pjekur, një ditë përsëri do të arrijë në fazën e pjekurisë dhe përgjegjësisë, gjë e cila do t'i hap rrugën përpara në jetë dhe do t'i ofrojë pavarësi, prandaj në ahiret do ta takojë i vetëm Zotin dhe do ta gjejë vetëm atë që ka punuar.

## 5. Intencat edukative sipas llojit të arsimit

Në pjesën paraprake thamë se edukimi ka dy kuptime: i pari është edukimi që lidhet me atë që fiton vetë individit përgjatë fazave të zhvillimit në jetë nga ajo që ofrojnë institucionet e ndryshme, përfshirë këtu edhe atë që fiton nga mundi personal. I dyti është edukimi i veçantë të cilin e ofrojnë institucionet arsimore përgjatë niveleve të ndryshme, i cili është i planifikuar dhe i rregulluar metodologjikisht. Të dy tipat e edukimit bashkëveprojnë në formësimin e personalitetit të individit nga njëra anë dhe e përgatitin atë të jetë anëtar aktiv në shoqëri nga ana tjetër.

Pedagogët, në varësi të lidhjes së edukimit me sistemin arsimor, kanë veçuar tre tipa të arsimit, por të gjitha marrin pjesë në ndërtimin e personalitetit dhe në përgatitjen e individit për të kontribuar dhe për të shërbyer në shoqëri. Secili nga tre tipat e arsimit gëzon intencat arsimore-edukative. Këto tre tipa të arsimit janë:

**Arsimimi sistemor (formal):** këtu bën pjesë arsimimi që ofron shkolla përmes programeve dhe metodave të caktuara, dhe e cila është në mbikëqyrje të plotë. Intencë themelore e këtij tipi të arsimit është fitimi i eksperiencave arsimore, si p.sh. informacionet, shkathtësinë dhe instruksionet. Ky arsimim realizohet përmes mësimin të tematikave të ndryshme shkencore brenda fazave të caktuara të cilat nxënësi duhet t'i kalojë për të arritur në fazën vijuese. Grupet e nxënësve janë me moshë dhe me përvojë shumë të afërt.

**Arsimimi josistemor (joformal):** ky arsimim cilësohet si shumë i saktë dhe i programuar, por realizohet jashtë shkolle. Format më të theksuara të këtij arsimimi janë profesionet, zanatet dhe artizanalet. Bazë e këtij arsimit është eksperiencia e mësuesit apo trajtuesit që kërkon të përçojë te nxënësi përmes trajnimit praktik, që edhe nxënësi t'i fitojë disa shkathtësi (manipulative). Arritja e këtyre aftësive kërkon nga nxënësi t'i kalojë disa faza dhe të ketë disa veti, veçanërisht të jetë elastik, i dëgjueshëm dhe i durueshëm. Disa trajnime mund të kenë edhe diploma apo certifikata, por disa të tjera nuk kanë. Këtu nuk kushtëzohet që nxënësit të jenë një moshë, pra disa mund të jenë fëmijë, disa të rinj dhe disa të rritur, mjafton

të kenë nevojë për arsimim. Intencë themelore e këtij arsimimi është posedimi i shkathtësive të nevojshme praktike për ta arritur këtë aftësi (praktike) ose për ta ngritur nivelin e saj.

Arsimi i pasistemuar (informal). Esenca e këtij arsimimi është se nuk i nënshtrohet asnjë programi të caktuar. Influenca e këtij arsimimi buron nga jeta dhe lëshohet në hapësirën e përgjithshme shoqërore, ku bëjnë pjesë media e shkruar, e dëgjuar dhe e shikuar. Po ashtu, këtu bëjnë pjesë programet argëtuese, programet drejtuese kulturore të përgjithshme, angazhimi humanitar, vendet e adhurimit, grupet dhe shoqëritë e ndryshme dhe të tjera. Arsimi të cilin e fiton vetë individit kryesisht nuk është arsimi informal, pra nuk ka objektiv të qartë nga këndi i individit, prandaj ndryshe quhet arsimim i rastësishëm. Megjithatë, sistemi politik qëllimisht i jep hapësirë (në formë paksa të kontrolluar) për një lloj opozitarizmi, lirie të mendimit dhe të shprehurit. Programet mediatike përkrahëse të politikave qeveritare dhe ato opozitare veprojnë në formë të menduar mirë dhe me synim të caktuar për të ndikuar te individët dhe te formësimi i ideve, i qëndrimeve dhe i orientimeve të tyre ideologjike dhe shpirtërore, madje edhe në disa veprimtari praktike. Individu mund të jetë i vetëdijshëm për ndikimin ideologjik, shpirtëror dhe praktik, dhe për drejtimit e këtij ndikimi, por edhe mund të mos jetë i vetëdijshëm mjaftueshëm për këtë. Si intencë themelore të këtij tipi të edukimit ne propozojmë vetëdijen e lidershipeve ideologjike, sociale dhe edukative në shoqëri. Këto bëhet fjalë për qarqe nga të cilat individ mund ta përfitojë një lloj edukimi, mund të orientohet tek ato, mund të trajnohet për ta perceptuar burimin e informacioneve, mund ta vërtetojë saktësinë dhe interpretimin e drejtë të tyre, dhe mbi të gjitha të jetë i vetëdijshëm për influencën edukative të padëshiruar. E rëndësishme është që individ, pasi të ketë arritur një lloj pjekurie të personalitetit dhe një lloj avancimi në përvoja, bëhet përgjegjës për qëndrimin e tij të pavarur, për idetë që ka përvetësuar dhe për qëndrimet që ka marrë. Krejt e papranueshme është që ai të mbetet si kashtë e thjeshtë që e merr era.



Ajo që na intereson në kontekstin e bisedës për intencat edukative të tre tipave të arsimit është që të ekzistojnë anët përgjegjëse të secilit tip, kurse individët që i janë nënshtruar këtij edukimi të gëzojnë një nivel të vetëdijes për intencat e këtij arsimit, për efektet e tij në personalitet, për mundësinë që ato krijojnë në zhvillimin e shëndoshë dhe të ekuilibruar dhe për avancimin e këtij zhvillimi deri në atë shkallë që i lejojnë aftësisë e tij. Gjithashtu, duhet qenë i vetëdijshëm për efektet e padëshiruara për personalitetin e individit, të cilat mbase mund të rezultojnë me mangësi në rrugët e realizimit të intencave të kërkuara, të krijojnë pengesa në përshtatjen e individit me ambientet arsimore të ofruara apo ndonjë pasojë tjetër. Përderisa arsimimi formal kujdeset për zhvillimin dhe edukimin e individëve në fazë të caktuar të jetës, proces që bëhet i organizuar dhe i programuar mirë, atëherë arsimit joformal dhe informal ushtrojnë edukimin në të gjitha fazat e jetës, përfshirë edhe fazën shkollore, kurse planifikimi dhe programet janë të pranishme në nivel të ulët apo së paku nuk duken.

## Pjesa e katërt: intencat elitare kur'anore dhe manifestimet e tyre edukative

Meqenëse Kur'ani fisnik është programi edukativ në shkollën islame, atëherë është e udhës të punohet në drejtimin e përcaktimit të intencave elitare kur'anore të ekzistimit të njeriut në këtë botë. Shumë studiues derdh mund të këtë drejtim përmes klasifikimit të ajeteve kur'anore në disa grupe dhe sipas tematikave që ato flasin.

Për shembull, Fazlur Rahman i ka klasifikuar tematikat e Kur'anit në shtatë grupe: Allahu i Lartësuar, njeriu, natyra, shpallja dhe pejgamberia, ahireti, e mira dhe e keqja dhe jeta shoqërore.<sup>404</sup> Marrë parasysh se vepra e Fazlur Rahmanit është ligjërim i akademisë perëndimore, edhe klasifikimi i tij i tematikave të Kur'anit është i përafërt me shtatë pyetjet të cilat studiuesit perëndimorë i parashtrajnë për vështrimin e botës (worldview).<sup>405</sup> Muhamed Gazali ka klasifikuar pesë tematika. E para: Allahu i Lartësuar dhe problemi i njëshmërisë (tevhidit); e dyta: universi i cili e tregon Krijuesin; e treta: tregimet e Kur'anit si mjet edukativ; e katërta: çështja e ringjalljes dhe e shpërblimit apo ndëshkimit, dhe e pesta: fusha e edukimit dhe e legjitimitimit.<sup>406</sup>

Ndërsa Karadavi i klasifikon në shtatë grupe, e ato janë: përmirësimi i doktrinës së besimit (akaidit), nderimi dhe fisnikërimi i njeriut, adhurimi dhe devotshmëria ndaj Zotit, pastrimi i shpirtit, formimi i familjes, ngritja e umetit faktik dhe ndërtimi i një bote humane dhe konstruktive.<sup>407</sup> Ekzistojnë klasifikime të ndryshme, secili sipas pikëpamjes që ka

<sup>404</sup> Fazlur Rahman, *Major Themes of the Qur'an*, With a new Foreword by Ebrahim Musa, Chicago: University of Chicago Press, 2009, see the table of content and the foreword of Ebrahim Musa, fq. xii-xiii.

<sup>405</sup> James W. Sire, *The Universe Next Door*, Downers Grove, Illinois: IVP Academic, 5th. Edition, 2009, fq. 22-23.

<sup>406</sup> Muhamed Gazali, *El-Mehavir'ul-halsetu li 'l-Kur'an'il-Kerim*, Kajro, Dar'ush-Shuruk, 2005, përmbajtja e librit.

<sup>407</sup> Jusuf, Karadavi, *Kejfe neteammelu mea'l-Kur'an'il-adhimi?* Kajro, Dar'ush-Shuruki, 2000, botimi III, fq. 71

autori për kuptimin e intencave të Kur'anit. Ndonjëherë autori është i ndikuar nga një brengë (universale), pakënaqësi shkencore apo reformuese, prandaj e gjen atë si mbështetje për mënyrën se si ai i kupton këto intenca.

Siç duket, shumica e këtyre klasifikimeve të intencave kur'anore më shumë ngjajnë me mënyrat e klasifikimit të ajeteve kur'anore sipas tematikave dhe me metodat e aplikimit të këtyre tematikeve, që pastaj të jenë të realizueshme edhe intencat për të cilat janë shpallur këto ajete. Sigurisht, intencat kur'anore, objektivat e paraqitjes së këtyre tematikave, motivet, shkaqet dhe urtësitë e synuara prej krejt këtyre janë të qarta nëpër ajetet kur'anore, prandaj janë të shfaqura me stilema të ndryshme kur'anore. Për normat juridike, Allahu e thekson dispozitën, pastaj e sqaron motivin dhe urtësinë. Po ashtu, e thekson tregimin bashkë me mësimet dhe urtësitë. Pra, është e lehtë të nxirren intencat nga teksti kur'anor. Më herët e theksuam atë që Ibn Kajjimi e sqaron në shumë vepra të tij për metodën kur'anore në shpjegimin e intencave të ajeteve kur'anore.<sup>408</sup>

Më herët e hulumtuam çështjen e përcaktimit të vlerave elitare në Kur'anin fisnik, e të cilat ishin tri vlera kryesore: tevhidi (njëshmëria), tezkija (pastrimi shpirtëror) dhe ndërtimi i jetës së kësaj bote. Sqaruam se këto vlera janë intencat elitare të Kur'anit fisnik dhe parimet e padiskutueshme, të cilat i udhëheqin njerëzit të cilët duan jetën e tyre ta drejtojnë me Kur'an. Gjithashtu konstatuam se këto tri vlera janë vlerat kryesore elitare, e pastaj prej tyre degëzohen nëngrupe të shumta të cilat gjenden edhe në Kur'an, si udhëzimi dhe orientimi në të gjitha çështjet e jetës individuale dhe shoqërore.<sup>409</sup>

Arsyet e mbështetjes në këtë sistem intencash, gjegjësisht me tri komponentë, janë shumë, por këtu do të paraqesim vetëm dy:

Ky sistem konsiderohet manifestimi më i rëndësishëm i unitetit të fesë hyjnore me të cilën u dërguan të gjithë pejgam-

<sup>408</sup> Shih: pjesën "Sfondi i intencave" të kësaj pjese.

<sup>409</sup> Melkavi, Mendhmet'ul-kijem'il-ulja: et-tevhidu ve 't-tezkijetu ve 'l-umranu, vep. e cit.

berët. Këto janë intencat e fesë së vetme hyjnore, edhe pse fetë kanë pasur aspekte juridike dhe legjislacione të ndryshme.

- Konstatimi i këtij sistemi dhe me këtë formë është rezultat i shkoqitjes (induksionit) të plotë të ajeteve të Kur'an-it fisnik.<sup>410</sup> Çdo prurje tjetër në emër të intencave do të përfshihet në një rën nga tri intencat paraprake. Imam Shatibiu për përcaktimin e thelbit të dijes shprehet kështu: "Ajo është fundamentale dhe e mbështetur... pra është fundamentale kategorike dhe dije e mbështetur te fondamenti kategorik. Në këtë mënyrë është sjellë edhe sheriat, i konservuar me fundamente dhe me degë, sepse kështu i mbron intencat me të cilat e siguron mirëqenin në të dy botët. Këto intenca, sipas Shatibiut, janë: domosdoshmëritë (darurijjatet), nevojat (haxhijjatet) dhe gjërat plotësuese (tahsinijajtet), bashkë me elementët që i plotësojnë dhe i përsosin këto. Këto janë fundamentet e sheriatit të vërtetuara me argument kategorik... Kjo është e këtillë, edhe pse bëhet fjalë për fundamente të diktuar dhe jo logjike. Fundamentet e qëndrueshme apo të diktuar shpeshherë janë më të dobishme për dijen kategorike, bile edhe për sheriatin në përgjithësi. Pra, dija fitohet nga studimi i përgjithshëm dhe i sistemuar i disa grupeve të njerëzve, pastaj të njëjtat njihen me arsye si tufë parimesh të përgjithshme dhe të vërtetuara, të paevitueshme dhe të pandryshueshme, vendimtare dhe të pacenueshme. Këto janë veçori të parimeve të përgjithshme logjike të cilat janë përfituar nga vetë ekzistenca. Kurse parimet e sheriatit janë të diktuar (nga Zoti) dhe jo të fituara nga logjika, prandaj janë të qëndrueshme dhe dallohen nga njëra-tjetra."<sup>411</sup>

Në vazhdim do të trajtojmë reflektimet e edukatës që del nga këto intenca elitare.

## 1. Intenca edukative të tevhidit (njëshmërisë)

<sup>410</sup> Taha Xhabir El-Alvani, *Mekasid'ush-sheriat, silsiletu kadaja islamijeh muasareh*, Bejrut, Dar'ul-Hadi, 2001, fq. 147

<sup>411</sup> Esh-Shatibiu, *El-Muvafekatu fi usul'ish-sheriat*, vep. e cit., hyrja e nëntë e librit, fq. 45

Kur e trajtuan temën e tevhidit studiuesit e akaidit (besimit), shumica e studimeve të tyre u fokusuan vetëm në çështjet e kelamit, ku mendimet e tyre morën trajtën e fraksioneve dhe drejtimeve të ndryshme, aq sa u humb vlera praktike e saj në jetën e besimtarit, ndërsa mënyra e paraqitjes së tevhidit në Kur'an lidhej drejtpërdrejt me jetën e njeriut besimtar, me Allahun e Lartësuar, me ndjesitë, me pasionet, me tendencat e njeriut dhe me ambientin e tij social dhe natyror. Në këtë mënyrë besimtari e kupton se tevhidi është “thelbi i eksperiencës fetare”<sup>412</sup> dhe e ndjen vlerën edukative dhe shpirtërore të tevhidit, pra i del parasysh në çdo ide që i vjen ndërmend, në çdo fjalë që e shqipton dhe në çdo lëvizje që bën. Allahu i Lartësuar të Cilin e adhuron besimtari është Një, i Vetëm dhe pa ortak. Allahu xh.sh. thotë: ﴿قُلْ إِنَّ صَلَاتِي وَنُسُكِي

**“Thuaj: namazi im, sakrifica ime, jeta ime dhe vdekja ime janë për Allahun, Zotin e botëve. 126. Ai nuk ka ortak. Me këtë jam urdhëruar dhe unë jam muslimani i parë.”** [El-En’am: 162-163]. Besimtari, kure e lexon këtë ajet, për asgjë nuk i drejtohet tjetërkujt përveç Allahut të Lartësuar.

Kur i mendojmë kuptimet e ajeteve kur'anore që flasin për tevhidin, shohim se ato janë shumë dhe me stilema të ndryshme shprehëse, gjë e cila na konfirmon se tevhidi është intenca më elitare dhe e lartë e Kur'anit, prandaj vetë Kur'ani pohon se thelbi i fesë hyjnore të cilën Allahu e solli për njerëzimin është tevhidi. Që kur e krijoi njeriun, Allahu u ka dërguar peygamberë njerëzve sa herë që e harronin këtë thelb apo devijonin prej tij. Allahu xh.sh. thotë: ﴿وَمَا أَرْسَلْنَا مِنْ قَبْلِكَ مِنْ رَسُولٍ

**“Nuk kemi dërguar para teje peygamber përveçse t'i shpallin atij se nuk ka zot tjetër përveç Allahut. Prandaj, Më adhuroni Mua!”** [El-Enbija: 25] Ibn Ashuri për këtë ajet ka thënë: “Këtu shfaqet kujdesi i Allahut të Lartësuar për ta eliminuar politeizmin nga shpirtërat e njerëzve dhe për t'i prerë rrugën atij, me qëllim të për-

<sup>412</sup> Ismail Raxhi El-Faruki - Lamia Faruki, *Atlas 'ul-hadaret'il-islamijeh*, i përkthyer në arabisht nga Abdulvahid Lu'lu'e, i redaktuar nga Rijad Nurullah, Rijad, Mektebet'ul-Akikan, botimi I, (1419 h./1998), fq. 98

mirësimin të arsyes së tyre duke i evituar të keqen më të madhe dhe mendimin më të ulët.”<sup>413</sup>

Koncepti i tevhidit është i pranishëm në disa besime të mbijetuara deri më sot, megjithatë në Islam është krejt ndryshe, si në botëkuptimin e Zotit Një dhe të Vetëm, ashtu edhe në efektet e këtij botëkuptimi ndaj marrëdhënies së Zotit të Vetëm me krijesat tjera ekzistuese në botë të cilat i ka krijuar Vetë. Gjithashtu, tevhidi (në Islam) është i veçantë edhe në konceptimin e realitetit të njeriut si mëkëmbës në tokë, në sistemin e marrëdhënies së njeriut me Krijuesin, të marrëdhënieve të njerëzve brenda shoqërisë dhe në raporteve të shoqërive me njëra-tjetrën.

Tevhidi në Islam nuk është thjesht një çështje pasive (e heshtur) e doktrinës logjike e cila bie në margjinën e besimeve njerëzore, por është një doktrinë lëvizëse dhe shtytëse e cila ka manifestime praktike të cilat i vendosin njeriut parime lidhëse me çdo sferë të jetës sociale, politike, ekonomike, artistike dhe të tjera. Po ashtu, ky tip i besimit vendos parime për jetën e njeriut si individ, për sistemet shoqërore të muslimanëve dhe për lidhjen e shoqërisë islame me shoqëritë tjera.

Me këtë rast, mjafton të paraqesim disa reflektime përmbledhëse të disa manifestime edukative të përgjithshme, duke spikatur se manifestimet edukative të synuara këtu lidhen me gjendjen intelektuale, shpirtërore dhe bihevioeriste të njeriut besimtar në raport me tevhidin. Gjendja intelektuale lidhet me metodologjinë e rezonimit, të meditimit dhe të përsiatjes, që pastaj të arrihet kuptimi (i duhur) dhe të ndërtohet vetëdija dhe perceptimi (i shëndoshë). Gjendja shpirtërore ka të bëjë me ndjenjat dhe përjetimet, përfshirë këtu edhe indikatorët e sinqeritetit, të dashurisë, të pëlqimit dhe qetësisë mendore, kurse gjendja bihevioeriste ndërldhet me format e sjelljes së ndërsjellë, me jetën praktike personale, profesionale dhe shoqërore. Disa nga këto reflektime janë këto:

1. Referimi dhe burimi i përbashkët. Allahu xh.sh. për vlerën madhështore që paraqet burimi i përbashkët dhe i vetëm (i feve) ka sjellë shembull (hipotetik) ku e krahason

<sup>413</sup> Ibn Ashuri, *Et-Tahriru ve 't-tenviru*, vep. e cit., komentimi i ajetit 25 të sures El-Enbija, vëllimi XVII, fq. 49

burimin e vetëm dhe burimet e shumta (nëse do të ishin). Allahu xh.sh. thotë: ﴿صَرَبَ اللَّهُ مَثَلًا رَجُلًا فِيهِ شُرَكَاءُ مُتَشَاكِسُونَ وَرَجُلًا سَلَمًا لِرَجُلٍ هَلْ يَسْتَوِيَانِ مَثَلًا الْحَمْدُ لِلَّهِ بَلْ أَكْثَرُهُمْ لَا يَعْلَمُونَ﴾ **“Allahu solli një shembull: Një njeri (rob) në posedimin e të cilit ishin ortakë pa marrëveshje mes vete dhe njëri (rob) që është thjesht në posedimin e një njeriu. A janë ata të dy të një lloji (të një gjendjeje)? Lavdërimi i takon vetëm Allahut, por shumica e tyre, nuk e dinë.”** [Ez-Zumer: 29] Kur njeriu vepron nën urdhrin e dyanshëm dhe kontradiktor, atëherë ortakët grinden dhe kundërshtohen për orientimet që duhet dhënë njeriut: njëri jep urdhër për punë, kurse tjetri urdhëron të mos punohet. Çështja nuk ndalon vetëm te mosrealizimi i një urdhri të caktuar, por efekti i shumë burimeve çon në rrënim shpirtëror, huti dhe dëshpërim. Ndër efektet edukative më të qarta të tevhidit është fakti se njeriut njeriu fiton qetësinë shpirtërore ku njësohen potencialet dhe përjetimet në një drejtim të vetëm, dhe pastaj ndjen kënaqësi dhe lumturi. Po ashtu, besimtari i këtillë cilësohet si aktiv, energjik dhe pozitiv. Gjithashtu, ky shpirt është i qetë dhe e kupton me shumë dashamirësi urtësinë e hises që Allahu i ka caktuar në këtë botë dhe atë që i ka rezervuar për Botën Tjetër.

*Ngritja e një vështrimit tevhidist për botën.* Ky është vështrimi i vetëm (pra tevhidi) i cili e shpëton besimtarin nga hutimi dhe dëshpërimi që e godet jobesimtarin. Vështrimi i njeriut për botën është përcaktues edhe i gjendjes intelektuale, shpirtërore dhe bihoveriste të njeriut. Po ashtu, është tutori kyç i gjendjes edukative. Në Kur'an shprehja “Zoti i botëve” paraqitet me kontekstet që tregojnë botët natyrore, shoqërore dhe shpirtërore. Shprehja “Bota e fshehtë (gajbit) dhe e dukshme” përsëritet me shprehjen “ru’jetun (vështrim)”, bashkë me fjalët e përfutuara prej saj dhe polisemitë e tyre, pavarësisht nëse bëhet fjalë për vështrim shqisor, i cili kërkon shikime, krahasime dhe përvoja precize, apo vështrim vizionar i cili kërkon të kap atë që fshihet pas dukurive të dukshme, të marrë mësim nga transformimet e epokave, të shteteve apo të popujve. Krejt kjo (me të dy vështrimet) e ndërton vizionin për botën dhe u përgjigjet pyetjeve që kërkojnë me ngulm të

njohin krijimin, Krijuesin, njeriun, natyrën, jetën, vdekjen, të mirën, të keqen, dijen dhe njohjen e gjërave në thelb... përgjigjet që i jep vështrimi i tevhidit e rehatojnë dhe e mbrojnë njeriun nga anarkia e doktrinave të ndryshme, për t'i orientuar potencialet dhe mundësitë e tij kah drejtimi pozitiv dhe konstruktiv.

*Formësimi i teorisë së njohjes.* Përderisa tevhidi (njëshmëria e Zotit) është thelbi i doktrinës së besimit dhe koka e besimit në të fshehtën (gajb), atëherë nuk mund të ketë alternativë në raport me botën e fshehtë, me gjërat, ndodhitë dhe fenomenet e asaj bote, pra vetëm Allahu Fuqiplotë është "Njohësi i hollësishtëm i botës së fshehur dhe i të dukshmes", prandaj vetëm Ai mbetet burimi i dijes dhe i njohjes. Teoria e njohjes te besimtari plotësohet me dy burime që s'kanë të tretë, e ato janë: shpallja të cilën Allahu ua ka shpallur pejgamberëve për botën e fshehur dhe vetë bota e dukshme e cila i ngërthen botën natyrore, shoqërore dhe shpirtërore. Kështu njohja e njeriut degëzohet në dy degë të mëdha: disiplinat e dijes së transmetuar, të cilat burim i kanë ajetet e shkruara të Zotit, dhe disiplinat e arsyes, të cilat burim i kanë ajetet (argumentet) pamore të Zotit në natyrë, në shoqëri dhe në botën shpirtërore. Te këto hasim dhjetëra degë të disiplinave shkencore themelore: sociale, humane dhe aplikative. Tevhidi, njëshmëria e Zotit të Lartësuar, kërkon plotësim dhe koordinim të gjithanshme të asaj që Allahu i ka dhuruar njeriut, prandaj mes burimeve të dijes nuk ka aspak hapësirë për kundërthënie dhe antagonizëm. Gjithashtu, tevhidi kërkon koordinimin e plotë edhe të mekanizmave të dijes. Kështu që, besimtari monoteist (muvehhid) të hulumtojë në laborator për të matur, llogaritur dhe eksperimentuar. Aty mund t'i përdorë të gjitha aftësitë e tij për të logjikuar, për të kuptuar dhe për të perceptuar. Mund të përshkruajë, të komentojë, të parashikojë dhe të kontrollojë. Me këtë rast besimtari llogaritet se është në mihrabin e adhurimit praktik, por çdoherë duke kërkuar ndihmën e Zotit për të hulumtuar dhe duke e falënderuar Atë për rezultatet e arritura. Me këtë gërshetim të përkryer të burimeve të dijes dhe të mekanizmave të saj, njeriu arrin një nivel të lartë



të pjekurisë edukative në personalitetin e tij, dhe atë përmes dy komponentëve: arsyes dhe shpalljes.

Aktivizimi dhe shpërthimi i potencialeve intelektuale dhe praktike të njeriut. Dëshmia e tevhidit “Nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe Muhammedi është i Dërguari i Allahut” është vetëm dera hyrëse në Islam dhe shtylla e parë e saj. Pastaj mbi bazë e saj ngrihen katër shtyllat tjera të Islamit. Me këto pesë shtylla, Islami bëhet realitet te individi dhe te shoqëria, dhe atë qoftë në besim, në adhurim apo në sistemin e të jetuarit. Po ashtu, në bazë të dëshmisë së tevhidit përcaktohen edhe gjashtë shtyllat e besimit (imanit). Kështu njeriu ngjitet në horizontet e ekuilibrit mes materies dhe shpirtit, ndërsa potencialet intelektuale, ndërgjegjësores dhe praktike gufojnë furishëm në hapësirat e dynjasë dhe të ahiretit, dhe kështu shpëton nga iluzionet mitologjike dhe shkon drejt bindjes shkencore. Me përmbushjen e shtyllave të islamit dhe të imanit krijohet vëllazëria mes besimtarëve në ngrehinën e një umeti të vetëm, e që pastaj kjo vëllazëri kontribuon në orientimin e përpjekjeve njerëzore në rrugën e realizimit të mëkëmbjes (halife) dhe të ndërtimit të jetës së kësaj bote.

*Adhurimi i sinqertë vetëm për Allahun.* Pra, kuptimet e tevhidit ndërliohen me njëri-tjetrin, nga Islami te imani, e pastaj kalojnë në ihsan (bamirësi), dhe kështu njeriut avancohet në stadet e tezkijes (pastrimit shpirtëror), ngritjes shpirtërore, drejtësisë sociale dhe ndërtimit kulturor. Në këtë mënyrë gërshetohen manifestimet e tevhidit në edukimin intelektual dhe shpirtëror, kurse efektet e tij shfaqen në sjellje dhe në praktikën e sferave të tjera (si në shoqëri dhe në kulturë). Kur jemi këtu, atëherë të gjitha format e aktivitetit njerëzor drejtohen kah adhurimi i sinqertë ndaj Allahut të Lartësuar. Pra, besimtari e përjeton praninë e Allahut në zemër, në çdo mendim që i përpunon mendja e tij dhe në çdo punë që e vepron.

*Ndjenja e lirisë dhe e krenarisë.* Adhurimi i sinqertë ndaj Allahut të Lartësuar i dhuron besimtarit ndjesinë se nuk është përgjegjës ndaj askujt tjetër përveç Allahut të Lartësuar dhe nuk kërkon të mirat prej askujt përveç Tij. Kështu njeriu çlirohet nga çdo kërkesë që mund t'i bëhet tjetërkuajt përveç

Tij dhe nuk është i shkapërderdhur duke marrë instruksione nga burime të ndryshme dhe nga padronë kontradiktorë. Më e rëndësishmja është se kjo ndjesi e çliron njeriun nga egot dhe epshet e veta të cilat i bëjnë pritë lirisë dhe aftësisë së tij për t'i vënë në funksion potencialet dhe mundësitë në opsionin më të denjë për dynjanë dhe ahiretin e tij. Kjo liri i dhuron vetëbesim, krenari dhe fisnikëri, sepse ai nuk ka nevojë t'i nënshtrohet asnjë presioni, nuk nënçmohet dhe nuk poshtërohet. Kjo edukatë e ndërtuar mbi liri e kalon çdo kuptim tjetër të lirisë, pavarësisht nëse kuptimet tjera të lirisë mbështeten në ligjin natyror apo në ligjin social.

*Bamirësia dhe perfeksionimi në punë.* Meqë parimi i tevhidit e lidh njeriun me Allahun e Vetëm, atëherë Ai e përcakton karakterin e kësaj lidhjeje. Prania e Allahut në zemrën e besimtarit dhe ndjesia se mbikëqyrjes së vazhdueshme nga ana e Tij e mbushin zemrën me dashuri dhe sinqeritet. Kështu njeriu i drejtohet Zotit të Lartësuar me fjalët dhe veprat më të mira të mundshme, përpiqet të mbërrijë në gradën e ihsanit (bamirësisë), në mënyrë që ihsani të jetë matës i kualitetit dhe i perfeksionimit të punëve. Ky matës është shumë më efektiv sesa matësit që i vendosin qarqet e sigurisë së kualitetit të lartë, të cilat zakonisht kanë të bëjnë me aspektet sasiore dhe lëndore të kësaj bote të përkohshme. Kështu, dimensionin edukativ shfaqet në çështjen e bamirësisë dhe të perfeksionimit të gjërave, i cili pastaj e nxit individin të kryejë punë shumë të suksesshme dhe, duke u mbështetur në stimuluesit e bamirësisë të individit dhe në menaxhimin e institucioneve me ihsan (bamirësi), i mundësohet shoqërisë aplikimi i programeve reformuese dhe i projekteve zhvillimore dhe avancuese.

*Motivues për vazhdimin e hulumtimit dhe shtimin e dijes.* Parimi i tevhidit (njëshmërisë së Zotit) lidhet me besimin në gjërat e fshehta. Besimtari sado të mbërrijë dituri për dukuritë e kësaj bote lëndore, përsëri beson në botët e fshehta dhe të pa-perceptueshme. Botët në të cilat njeriu jeton në këtë dynja (bota natyrore, shoqërore dhe shpirtërore) janë hapësira shumë më të gjera sesa ambienti që e rrethon atë, prandaj tregohet modest për dijen që posedon dhe vazhdon të hulumtojë

për të fituar më shumë dije, sepse vetëm Allahu e di gajbin absolut (të fshehën absolute), nga e cila mund t'i shpalosë atij që vrapon pas dijes dhe i trason shkaqet e fitimit të saj. Kurse, sa i përket gajbit relativ, ai ka të bëjë me shtimin e dijes rreth ekzoterisë së jetës së kësaj bote, dhe sigurisht arrihet me angazhim serioz. Krejt kjo i dhuron njeriut pasionin për vështrim më të thelluar dhe qasje më të gjerë ndaj problemeve përmes dijes dhe njohjes së horizonteve të kozmosit dhe jetës së njeriut. Po ashtu, kjo dije ia shpalos gjërat e panjohura dhe gjërave të cilat Allahu ia ka mundësuar njeriut t'i mësojë (përmes shpalljes).

Mungesa e mendimit intencial në sferën e arsimit fetar bëri që çështjet e besimit dhe të akaidit të jenë lëndë e diskutimit kelamist, gjegjësisht në grupet dhe fraksionet kelamiste. Në kohën kur çështjet e akaidit dhe të besimit ishin themelore dhe në fokus, krahas problemeve të tjera të fesë, si fikhu, usuli dhe tefsiri, botën islame e kishte kapluar regresi në shumë sfera të veprimtarisë arsimore dhe e kishte humbur sadopak gjallërinë, prandaj duhet që zgjimi intencial patjetër të arrijë te mësimi i akaidit, në mënyrë që pjesa e tevhidit të bëhet mjet për vënien e lidhjes me Zotin xh.sh. dhe me dijen që Ai Vetë na e ka mësuar. Po ashtu, Allahu (tevhidit) të jetë i pranishëm në zemrën e besimtarit, në mënyrë që zemra e tij të qetësohet me praninë dhe me përmendjen e Tij.

Pra, intencë këtu është orientimi i mësimi akaidor (besimor) kah synimet (intencat), duke u përqendruar në efektin e tij shpirtëror dhe intelektual, dhe duke e shmangur hulumtimin shterp dhe të pafrytshëm.

## 2. Intencat edukative të tezkijes (pastrimit shpirtëror)

Meqë tevhidi është një intencë kur'anore e cila në esencë lidhet me besimin në njëshmërinë e Allahut të Lartësuar, ndërsa efektet e tij manifestohen në drejtimin e lidhjes me Allahun Një dhe të Vetëm përmes adhurimeve në formë ritesh dhe sjelljesh, atëherë tezkija (pastrimi shpirtëro) është një intencë kur'anore e cila në thelb lidhet me njeriun të cilin

Allahu e bëri mëkëmbës në tokë, gjegjësisht me ndërgjegjen, me marrëdhëniet që krijon ai dhe me mënyrat e sjelljes së tij. Objektivë e tezkijes (pastrimit shpirtëror) është përmirësimi i realitetit njerëzor, dhe atë si individ, grup, umet dhe gjini njerëzore në përgjithësi. Po ashtu, objekt tjetër i tezkijes është përmirësimi i njeriut në aspektin material dhe shpirtëror. Pra, intencë e drejtpërdrejtë është ngritja e njeriut në nivelet e pastrimit, katarzimit dhe dëlirësimi të ndjenjave dhe përjetimeve shpirtërore në nivel të individit. Pastaj në pastrimin dhe zhvillimin e pasurisë, në avancimin dhe inkuadrimin e bamirësisë në marrëdhëniet familjare dhe shoqërore, ashtu që njeriu më lehtë ta realizojë reformimin në strukturën shoqërore dhe jetësore. Të gjitha këto intenca janë përfshirë në ajetet kur'anore ku trajtohet tezkija. Në vijim do të paraqesim disa shembuj të intencave edukative për tezkijen:

Themeli i manifestimeve edukative të intencës së tezkijes është gjendja shpirtërore e individit e cila reflekton në gjendjen intelektuale dhe praktike të tij. Mbi këtë bazë përpqemi të kuptojmë betimet e shumta të dhëna në Kur'an, ku Allahu betohet në krijesa të ndryshme, porse rrugën e shpëtimit e ka paraqitur përmes tezkijes, pastrimit të shpirtit njerëzor, kurse ai që nuk e realizon tezkijen, do të ketë fat të kobshëm dhe do të humbë. Me fjalën “shpirt human” nënkuptohet njeriu si trup, intelekt dhe shpirt, si individit dhe si grup, bashkë me krejt atë që i ofrohet atij përgjatë gjithë ymrit, qoftë pasuri, pronë apo ambient ku ai e kryen detyrën e mëkëmbjes. Sidoqoftë, boshti i tezkijes është ndërgjegjja njerëzore e cila është objekt i edukimit dhe zhvillimit. Allahu xh.sh. ka thënë: ﴿وَتَنفِسٍ وَمَا سَوَّاهَا فَأَلْهَمَهَا فُجُورَهَا وَتَقْوَاهَا (8) قَدْ أَفْلَحَ مَنْ زَكَّاهَا وَقَدْ خَابَ مَنْ دَسَّاهَا﴾ **“Pasha shpirtin dhe atë që e krijoi atë. Dhe e inspiroi se cilat janë të këqijat dhe të mirat për të. Ka shpëtuar ai që e pastroi, dhe ka dështuar ai që e poshtëroi.”** [Esh-Shems: 7-10]

Edhe pse tezkija (pastrimi shpirtëror) është intencë, ajo është edhe mjet për te intenca e shpëtimit. Këtë e shpreh fjala e Zotit xh.sh.: **“Ka shpëtuar ai që është pastruar”** [El-A'la: 14] Folja *tezekka*, në këtë formë gramatikore, nënkupton dhënien e mundit shtesë nga sa është e zakonshme për këtë

folje. *Felah* (shpëtim) do të thotë sukses në atë që njeriu kërkon, kurse shprehja *fevz* (ngadhënjim) përfshin të mirat e dynjasë që i shpreson nga Zoti xh.sh., shpëtim nga zjarri dhe hyrje në xhenet në Botën Tjetër, atëherë arrihet ngadhënjimi ﴿قَدْ أَفْلَحَ﴾ më i madh [el-fevz/ul-ekberu). Allahu xh.sh. thotë:

المُؤْمِنُونَ الَّذِينَ هُمْ فِي صَلَاتِهِمْ خَاشِعُونَ وَالَّذِينَ هُمْ عَنِ اللَّغْوِ مُعْرِضُونَ وَالَّذِينَ هُمْ لِلزَّكَاةِ فَاعِلُونَ وَالَّذِينَ هُمْ لِقُرُوبِهِمْ حَافِظُونَ إِلَّا عَلَىٰ أَزْوَاجِهِمْ أَوْ مَا مَلَكَتْ أَيْمَانُهُمْ فَإِنَّهُمْ غَيْرُ مَلُومِينَ فَمَنْ ابْتَغَىٰ وَرَاءَ ذَلِكَ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الْعَادُونَ وَالَّذِينَ هُمْ لِأَمَانَاتِهِمْ وَعَهْدِهِمْ رَاعُونَ وَالَّذِينَ هُمْ عَلَىٰ صَلَوَاتِهِمْ يُحَافِظُونَ أُولَٰئِكَ هُمُ الْوَارِثُونَ الَّذِينَ يَرِثُونَ الْفِرْدَوْسَ هُمْ فِيهَا خَالِدُونَ ﴿

*“Me të vërtetë, janë të shpëtuar besimtarët, të cilët janë të përu-lur në namazin e tyre, të cilët shmangen nga fjalët e kota, të cilët japin zeqatin, të cilët e ruajnë nderin e tyre (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme), përveçse me gratë e tyre ose me skllavet që kanë në zotërim - dhe, për këtë, nuk janë fajtorë, ndërsa ata që kërkojnë për-tej kësaj, pikërisht ata janë shkelës (të kufijve), - të cilët u përmba-hen amaneteve dhe detyrimeve të marra dhe të cilët i kryejnë rregu-llisht faljet.. Pikërisht ata do të jenë trashëgimtarët, që do ta trashë-gojnë Firdeusin, ku do të qëndrojnë përjetësisht.”* [El-Mu’minun: 1-11]

Siç ka filluar surja me pohimin e shpëtimit për besimtarët, ashtu ka përfunduar me mohimin e shpëtimit për jobesimtarët të cilët bashkë me Allahun adhurojnë edhe zot tjetër pa asnjë dëshmi. Allahu në fund të suren el-Mu’minun thotë:

﴿وَمَنْ يَدْعُ مَعَ اللَّهِ إِلَهًا آخَرَ لَا بُرْهَانَ لَهُ بِهِ فَإِنَّمَا حِسَابُهُ عِنْدَ رَبِّهِ إِنَّهُ لَا يُغْنِيهِ الْكَافِرُونَ﴾ **“Kush adhuron zot tjetër me Allahun, pa argument, llogaria do t’i bëhet te Zoti i tij. Vërtet nuk shpëtojnë jobesimtarët.”** [El-Mu’minun: 117]

Intenca edukative e tezkijes (pastrimit shpirtëror) është shtrirja e vështrimit dhe kërkimi i rezultatit i cili paraqet forma të ndryshme të shpëtimit në këtë botë dhe në Botën Tjetër.

*“Të tillët janë të shpëtuarit”,* pra ata të cilët e kanë arritur atë që e kanë kërkuar. Fjala *felah* do të thotë ngadhënjim dhe mirëqeni në dynja dhe në ahiret, kurse qëllimi në ajetin paraprak është shpëtimi nga ndëshkimi në ahiret.

Pastrimi i shpirtit që kërkon shpëtimin manifestohet edhe në pastrimin e pasurisë. Pasuria është sprovë dhe provim. Shpëtimi dhe ngadhënjimi në këtë provim arrihet përmes shpenzimit dhe pastrimit të pasurisë në format dhe masat e

duhura. Kështu njeriut ruhet nga koprracia e shpirtit, hyn në grupin e njerëzve të shpëtuar dhe e pret realizimin e premtimit të Allahut që t'ia kthejë këtë të mirë duke i shumëfishuar pasurinë e mbetur, duke i dhënë bereqet dhe duke ia shtuar. Allahu xh.sh. thotë:

﴿إِنَّمَا أَمْوَالُكُمْ وَأَوْلَادُكُمْ فِتْنَةٌ وَاللَّهُ عِنْدَهُ أَجْرٌ عَظِيمٌ (15) فَاتَّقُوا اللَّهَ مَا اسْتَطَعْتُمْ وَأَسْمِعُوا وَأَطِيعُوا وَأَنْفِقُوا خَيْرًا لِأَنْفُسِكُمْ وَمَنْ يُوقِ شُحَّ نَفْسِهِ فَأُولَئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ (16) إِنْ تُفْرَضُوا لِلَّهِ قَرْضًا حَسَنًا يَضَاعِفْهُ لَكُمْ وَيَغْفِرْ لَكُمْ وَاللَّهُ شَكُورٌ حَلِيمٌ﴾

*“Vërtet pasuritë dhe fëmijët tuaj janë fitne (sprovë). Tek Allahu gëzoni shpërblim të madh. Kini frikë Allahun sa të mundeni, dëgjoni, respektoni dhe shpenzoni në mirësi për veten tuaj! E kush i ruhet lakmisë së vetes, të tillët janë të shpëtuar. Nëse Allahut i huazoni diçka të mirë, Ai jua shumëfishon atë dhe ju falë. Allahu është Mirënjohës dhe i Butë.”* [Et-Tegabun: 15-17] Kur zë vend lakmia te njeriu dhe nuk ruhet nga pasojat e kësaj lakmie, atëherë fillon të merret me kamatë, kurse pasuria me kamatë nuk shtohet, nuk pastrohet dhe nuk shumëfishohet. Allahu xh.sh. thotë:

﴿وَمَا آتَيْتُمْ مِنْ رِبَا لِيَرْبُو فِي أَمْوَالِ النَّاسِ فَلَا يَرْبُو عِنْدَ اللَّهِ وَمَا آتَيْتُمْ مِنْ زَكَاةٍ تُرِيدُونَ وَجْهَ اللَّهِ فَأُولَئِكَ هُمُ الْمُضْعِفُونَ﴾

*“Dhe çka të jepni nga pasuria për të shtuar e rritur (me kamatë), në pasurinë e njerëzve, ajo nuk do të shtohet te Allahu, e çka të jepni nga sadaka (bamirësia) me qëllim që t'i afroheni Allahut, të tillët janë ata që u shumëfishohet (shpërblimi).”* [Er-Rum: 39] Pra, kështu atë e prek dështimi dhe shkatërrimi në dynja dhe ndëshkimi në botën tjetër. Allahu xh.sh. thotë:

﴿يَمْحَقُ اللَّهُ الرِّبَا وَيُرِي الصَّدَقَاتِ وَاللَّهُ لَا يُحِبُّ كُلَّ كَفَّارٍ أَثِيمٍ﴾

*“Allahu zhduk kamatën dhe shton lëmoshën, Allahu nuk e do asnjë besëprerë dhe mëkatar.”* [El-Bekare: 276]

Bazuar në lidhshmërinë mes tezkijes (pastrimit) si veprim dhe shpëtimit si rezultat, mund të hulumtojmë mjetet e arritjes te tezkija që pastaj kjo të çojë te shpëtimi. Këtu shohim se disa mjete i tejkalojnë ndjenjat njerëzore dhe e rregullojnë qasjen ndaj pasurisë, që pastaj të mbërrijnë deri te karakteristikat e shoqërisë. Shoqëri e shpëtuar është shoqëria në të cilën funksionon mirëfilli thirrja reformuese, pastrohet me thirrjen për punë të mira, urdhërim në të mirë dhe ndalim nga e keqja. Allahu xh.sh. thotë:

﴿وَلْتَكُنْ مِنْكُمْ أُمَّةٌ يَدْعُونَ إِلَى الْخَيْرِ وَيَأْمُرُونَ بِالْمَعْرُوفِ وَيَنْهَوْنَ عَنِ الْمُنْكَرِ وَأُولَئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ﴾

**“Le të jetë nga ju një grup (umet) që thërret në hair, urdhëron në të mirë dhe ndalon nga e keqja. Të tillët janë të shpëtuarit.”** [Alu Imran: 104] Nëse felahi (shpëtimi) është rezultat i urdhrit për të mirë dhe mirësi, i ndalimit nga e keqja dhe nga fesadi, atëherë shpëtimi nga shkatërrimi dhe humbja në dynja, para ahiretit, arrihet përmes zhvillimit të mirësisë në reformim. Allahu xh.sh. thotë:

﴿فَلَوْلَا كَانَ مِنَ الثُّرُوفِ مِنْ قَبْلِكُمْ أُولُو بَقِيَّةٍ يَنْهَوْنَ عَنِ الْفُسَادِ فِي الْأَرْضِ إِلَّا قَلِيلًا مِمَّنْ أَنْجَيْنَا مِنْهُمْ وَاتَّبَعَ الَّذِينَ ظَلَمُوا مَا أُتْرِفُوا فِيهِ وَكَانُوا مُجْرِمِينَ (116) وَمَا كَانَ رَبُّكَ لِيُهْلِكَ الْقُرَى بِظُلْمٍ وَأَهْلِهَا مُصْلِحُونَ﴾

*“E përse të mos ketë pasur nga breznitë që ishin para jush, të zotët e mendjes e të nderit që të ndalonin çrregullimin e kaosin në tokë, përveç një pakice, të cilët i shpëtuan (ngase frenuan nga të këqijat), e ata që ishin mizorë u dhanë pas kënaqësive si të shfrenuar, duke vazhduar të jenë mëkatarë. E Zoti yt nuk është që të shkatërrojë mizorisht vendet, nëse banorët e tyre janë punëmirë.”* [Hud: 116-117]

Reflektimi më i mrekullueshëm i edukatës shpirtërore dhe sociale është kur fjala tezkije (pastrim) në Kur’an paraqitet në rastin e konfliktit familjar. Ndonjëherë njeriu nervozohet dhe kështu shkaktohen grindje bashkëshortore të cilat çojnë deri në këputjen e lidhjes së ndërtuar me dashuri dhe mëshirë, madje ndoshta kjo mëri kalon edhe në familjet e të martuarve, gjë e cila pastaj përjashton mundësitë e afrimit dhe pajtimit. Pra, që këtu vjen në shprehje këshillimi kur’anor, sepse ofron shanse për pajtim dhe i ndërpret të gjitha motivet e pafrytshme të cilat mëtojnë të rrënojnë ngrehinën e ndërtuar me dashuri dhe mëshirë mes dy bashkëshortëve. I ka penguar të gjitha shkaqet e ndërprerjes së raporteve familjare, të ndarjes dhe të gjithçka që pengon kthimin e dashurisë dhe mëshirës. Tezkija (pastrimi) këtu nuk kufizohet vetëm në ndjenjat dhe mendimet e individit, por e kalon këtë dhe arrin te pastrimi dhe rregullimi i marrëdhënieve të shoqërisë dhe të të gjitha sistemeve të saj. Po ashtu, ofron trajtim të matur dhe të urtë për problemet e mundshme që ndodhin. Allahu xh.sh. thotë:

﴿وَإِذَا طَلَقْتُمُ النِّسَاءَ فَبَلَغْنَ أَجَلَهُنَّ فَلَا تَعْضُلُوهُنَّ أَنْ يَنْكِحْنَ أَزْوَاجَهُنَّ إِذَا تَرَاصُوا بَيْنَهُمْ بِالْمَعْرُوفِ ذَلِكَ يُوعَظُ بِهِ مَنْ كَانَ مِنْكُمْ يُؤْمِنُ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ ذَلِكَمْ أَزْكَى لَكُمْ وَأَطْرُ وَاللَّهُ يَعْلَمُ وَأَنْتُمْ لَا تَعْلَمُونَ﴾

*“Dhe kur i lëshoni gratë, e ato e përmbushin afatin e tyre (të pritjes), nëse pëlqejnë mes vete ashtu si kërkojnë rregullat, mos i pengoni që të marrohen për burrat e tyre. Me këtë këshillohet ai që prej jush e beson Allahun dhe botën tjetër, kjo është më e dobishme për ju, më e pastër, se Allahu e di, e ju nuk e dini.”* [El-Bekare: 232] Ibn Ashuri mendon se shprehja “më e pastër për ju” nënkupton më e përshtatshme për nderin (tuaj) dhe më e dobishme. Fjala zeka (pastrim) mban kuptimin e zhvillimit dhe të sigurimit. Ky ajet u shpall sepse burrat i shtypnin gratë (e shkurorëzuar) nga mllefi dhe ruajtja e krenarisë. Megjithatë, Allahu i mësoi se mosshtypja është më e ndershme, sepse nëse shtypja është shenjë e gabimit, atëherë lejimi për t’i kthyer është butësi, falje dhe relaksim i situatës.<sup>414</sup>

Në suren En-Nur edukimi shpirtëror dhe social përsëritet disa herë, ku me urtësi bëhet lidhja mes pastrimit të shpirtave të besimtarëve dhe shpëtimit të tyre. Përkuajtimi i tezkijes vjen në kontekst të sistemimit të marrëdhënieve që kanë të bëjnë me specifikat e shtëpisë dhe ruajtjen e nderit. Hyrja në shtëpi lejohet vetëm me kërkim leje. Arsyetimi i zotit të shtëpisë për pa gatishmëri për të pritur mysafirë është më mirë sesa të krijohet situatë e vështirë për mysafirin apo për të zotin e shtëpisë. Kthimi i vizitorit prapa është më e udhës për ndjenjat dhe për trajtimin jo të mirë. Kështu nuk krijohet ngushtim shpirtëror që pastaj të ndikojë negativisht në marrëdhëniet mes njerëzve. Ulja e shikimit mes burrave dhe grave është më mirë dhe më dëlirë për ndjenjat, më mbrojtëse për nderin që të mos dalldisen sytë aty, sepse kjo mund të sjellë rreziqe që dëmtojnë ndërgjegjen dhe shpirtin, dhe mund të shkaktojë paudhësi në sjellje. Allahu xh.sh. thotë:

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَدْخُلُوا بُيُوتًا غَيْرَ بُيُوتِكُمْ حَتَّى تَسْأَلُوا بِسْمِ اللَّهِ وَأَنْتُمْ عَلَىٰ أَهْلِهَا ذَلِكُمْ خَيْرٌ لَكُمْ لَعَلَّكُمْ تَذَكَّرُونَ (27) فَإِنْ لَمْ تَجِدُوا فِيهَا أَحَدًا فَلَا تَدْخُلُوهَا حَتَّىٰ يُؤْذَنَ لَكُمْ وَإِنْ قِيلَ لَكُمْ ارجِعُوا فَارجِعُوا هُوَ أَزْكَى لَكُمْ وَاللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ عَلِيمٌ (28) لَيْسَ عَلَيْكُمْ جُنَاحٌ أَنْ تَدْخُلُوا بُيُوتًا غَيْرَ مَسْكُونَةٍ

<sup>414</sup> Po aty, tefsiri i ajetit 232 të sures El-Bekare, vëllimi II, fq. 428



فِيهَا مَتَاعٌ لَكُمْ وَاللَّهُ يَعْلَمُ مَا تُبْدُونَ وَمَا تَكْتُمُونَ (29) قُلْ لِلْمُؤْمِنِينَ يَعْضُوا مِنْ أَنْصَابِهِمْ وَيَحْفَظُوا فُرُوجَهُمْ ذَلِكَ أَزْكَى لِهِمْ إِنَّ اللَّهَ خَبِيرٌ بِمَا يَصْنَعُونَ (30) وَقُلْ لِلْمُؤْمِنَاتِ يَعْضُنَّ مِنْ أَنْصَابِهِنَّ وَيَحْفَظْنَ فُرُوجَهُنَّ وَلَا يُبْدِينَ زِينَتَهُنَّ إِلَّا مَا ظَهَرَ مِنْهَا وَلْيَضْرِبْنَ بِخُمُرِهِنَّ عَلَى جُيُوبِهِنَّ وَلَا يُبْدِينَ زِينَتَهُنَّ إِلَّا لِبُعُولَتِهِنَّ أَوْ آبَائِ بُعُولَتِهِنَّ أَوْ أَبْنَائِهِنَّ أَوْ إِخْوَانِهِنَّ أَوْ بَنِي إِخْوَانِهِنَّ أَوْ نِسَائِهِنَّ أَوْ مَا مَلَكَتْ أَيْمَانُهُنَّ أَوِ التَّابِعِينَ غَيْرِ أُولِي الْإِرْبَةِ مِنَ الرِّجَالِ أَوِ الطِّفْلِ الَّذِينَ لَمْ يَظْهَرُوا عَلَى عَوْرَاتِ النِّسَاءِ وَلَا يَضْرِبْنَ بِأَرْجُلِهِنَّ لِيُعْلَمَ مَا يُخْفِينَ مِنْ زِينَتِهِنَّ وَتُوبُوا إِلَى اللَّهِ جَمِيعًا أَيُّهَا الْمُؤْمِنُونَ لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ ﴿

*“O ju që besuat, mos hyni në shtëpi të huaja pa kërkuar leje dhe pa përshëndetur njerëzit e saj. Kjo është më mirë për ju në mënyrë që merri mësim. Po nëse nuk gjeni aty asnjë, atëherë mos hyni në to derisa t’u jepet leja, e nëse u thuhet kthehuni, ju pra kthehuni. Kjo është më e ndershme për ju. Allahu di çdo gjë që veproni ju. Nuk është për ju ndonjë mëkat, nëse hyni në shtëpi të pabanuara, e që në to keni ndonjë përfitim. Allahu e di atë që e shfaqni haptas dhe atë që e mbani fshehtë. Thuaju besimtarëve të ndalin shikimet (prej haramit), të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre se kjo është më e pastër për ta. Allahu është i njohur hollësisht për atë që bëjnë ata. Thuaju edhe besimtareve të ndalin shikimet e tyre, të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre. të mos zbulojnë stolitë e tyre përveç atyre që janë të dukshme, le të vejnë shamitë mbi kraharorin e tyre dhe të mos ua tregojnë bukuritë e tyre askujt përveç burrave të vet, baballarëve të vet ose baballarëve të burrave të vet, djemve të vet ose djemve të burrave të vet, vëllezërve të vet ose djemve të vëllezërve të vet, apo djemve të motrave të veta, ose grave të tyre (që u përmenden) dhe robëreshave, të cilat i kanë në pronësinë e tyre, ose shërbëtorëve meshkuj të cilët nuk ndiejnë nevojë për femra ose fëmijët që nuk janë të pjekur për gra. Le të mos kërcasin me këmbët e tyre për të mos zbuluar fshehtësinë nga stolitë e tyre. Pendohuni të gjithë te Allahu, o besimtarë, në mënyrë që të gjeni shpëtim.”*  
[En-Nur: 27-31]

### 3. Intencat edukative të ndërtimit të jetës (në këtë botë)

Më herët e kuptuam se intenca e tevhidit lidhet me besimin në Një Zot të Vetëm, intenca e tezkijes lidhet me shpirtin, marrëdhëniet dhe sjelljet e njerëzve, kurse tani do të sqarojmë

se si ta plotësojmë përbërësin e tretë të sistemit të intencave kur'anore, e që është ndërtimi dhe sistemi i jetës në tokë dhe përbushja me përgjegjësi e detyrës së mëkëmbjes.

Në terminologjinë kur'anore fjala “umran” vjen nga rrënja *a'mere* me disa kuptime, ku ndër to është edhe kuptimi i jetës. Allahu xh.sh. thotë: ﴿بَلْ مَتَّعْنَا هَؤُلَاءِ وَأَبَاءَهُمْ حَتَّى طَالَ عَلَيْهِمُ الْعُمُرُ أَفَلَا يَرَوْنَ أَنَّا نَأْتِي﴾  
 ﴿الْأَرْضَ نَنْقُصُهَا مِنْ أَطْرَافِهَا أَفَهُمُ الْغَالِبُونَ﴾  
**“Por Ne u dhamë atyre dhe prindërve të tyre jetë të gjatë me kënaqësi (e ata u mashtruan). A nuk e vërejnë ata se Ne u pakësojmë tokën nga anët e saj, atëherë a mos ata do të jenë fitues (o të humbur)?”** [El-Enbija: 44]. Ndonjëherë jeta e njeriut është e gjatë dhe mbërrin moshën e thyer të pleqërisë. Allahu xh.sh. thotë: ﴿وَاللَّهُ﴾  
 ﴿خَلَقَكُمْ ثُمَّ يَتَوَفَّاكُمْ وَمِنكُم مَّن يُرَدُّ إِلَى أَرْذَلِ الْعُمُرِ لِكَيْ لَا يَعْلَمَ بَعْدَ عِلْمٍ شَيْنًا إِنَّ اللَّهَ عَلِيمٌ قَدِيرٌ﴾  
**“Allahu ju krijoi, pastaj Ai ua merr shpirtin. E ka prej jush që shtyhet deri në jetën më të vjetër, ashtu që të mos dijë asgjë nga çka ka ditur. Allahu është më i dijsلمي, më i fuqishmi.”** [En-Nahl: 70] Gjithashtu, vjen me kuptim të rritit të umres, veprim i cili e mban gjallë Mesxhidi Haramin me njerëz që e kryejnë umren në çdo kohë të vitit. Allahu xh.sh. thotë: ﴿وَأْتِمُوا الْحَجَّ وَالْعُمْرَةَ لِلَّهِ﴾  
**“Plotësojeni haxhin dhe umren për hir të Allahut!”** [El-Bekare: 196]. Disa herë paraqitet me kuptim të ndërtimit të xhamive. Allahu xh.sh. thotë: ﴿إِنَّمَا يَعْمُرُ﴾  
 ﴿مَسَاجِدَ اللَّهِ مِنْ آمَنَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ وَأَقَامَ الصَّلَاةَ وَآتَى الزَّكَاةَ وَلَمْ يَخْشَ إِلَّا اللَّهَ فَعَسَى أُولَئِكَ أَنْ﴾  
 ﴿يَكُونُوا مِنَ الْمُتَّقِينَ﴾  
**“E drjtë e ndërtimit të xhamive të Allahut është vetëm e atij që i ka besuar Allahut dhe ditës së fundit e që e falë namazin, jep zeqatin e nuk i frikësohet askujt pos Allahut. Të tillët do të jenë të udhëzuarit (në rrugën e drejtë).”** [Et-Tevbe: 18]. Po ashtu, fjala *umran* jepet me kuptimin e qëndrimit dhe vendosjes në tokë, me kuptimin e kultivimit të saj, të ndërtimit të kështjellave, të largimit nga jeta nomade dhe të shfrytëzimit të shkaqeve për të krijuar qytetërim dhe kulturë. Allahu xh.sh. thotë: ﴿أَوَلَمْ يَسِيرُوا فِي الْأَرْضِ﴾  
 ﴿فَيَنْظُرُوا كَيْفَ كَانَ عَاقِبَةُ الَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ كَانُوا أَشَدَّ مِنْهُمْ قُوَّةً وَأَنَارُوا الْأَرْضَ وَعَمَرُوهَا أَكْثَرَ مِمَّا عَمَرُوهَا﴾  
 ﴿وَجَاءَهُمْ رَسُولُهُمْ بِالْبَيِّنَاتِ فَمَا كَانَ اللَّهُ لِيَظْلِمَهُمْ وَلَكِنْ كَانُوا أَنفُسَهُمْ يَظْلِمُونَ﴾  
**“A nuk udhëtuan ata nëpër tokë e të shohin se si qe përfundimi i atyre që ishin para tyre?! Ata ishin edhe më të fortë se këta,**

ata e lëruan tokën dhe e rindërtuan atë më shumë se sa këta, e rindërtuan, atyre u patën ardhur të dërguarit e vet me fakte të qarta. Pra, Allahu nuk ishte që t'ju bëjë të padrejtë atyre, por ata vetvetes i bënë të padrejtë.” [Er-Rum: 9]. Disa njerëz në tokë ekzistojnë vetëm për të shkatërruar dhe jo për të ndërtuar. Allahu xh.sh. thotë: ﴿ظَهَرَ الْفَسَادُ فِي الْبَرِّ وَالْبَحْرِ بِمَا كَسَبَتْ أَيْدِي النَّاسِ لِيُذِيقَهُمْ بَعْضَ الَّذِي عَمِلُوا لَعَلَّهُمْ يَرْجِعُونَ﴾ “Për shkak të veprave (të këqija) të njerëzve, janë shquar në tokë e në det të zeza (bela, skamje, katastrofa, humbje e bereqetit etj.), e për ta përjetuar ata një pjesë të kësaj të keqeje që e bënë, ashtu që tërhiqen (nga të këqijat).” [Er-Rum: 41].

Fjala umran do të thotë jetë dhe angazhim për jetesë, një jetë që jetohet nga individi për një kohë të caktuar dhe jeta që e jeton umeti (populli) bashkë me gjurmët e tij sot dhe përgjatë historisë, pra gjithë jeta e njerëzimit derisa të përfundojë jeta e kësaj bote. Atëherë, cila është intenca e kësaj bote? Allahu i ka qortuar popujt që kërkojnë çfarëdo lloj jete, madje edhe nëse ajo jetë ka nënçmim dhe poshtërim. Allahu xh.sh. thotë: ﴿وَلَتَجِدَنَّهُمْ أَحْرَصَ النَّاسِ عَلَى حَيَاتِهِ وَمِنَ الَّذِينَ أَشْرَكُوا يَوَدُّ أَحَدُهُمْ لَوْ يُعَمَّرَ أَلْفَ سَنَةٍ وَمَا تَأْتِيهِمْ بِشَيْءٍ يَعملُونَ﴾ “Është e sigurt se njerëzit më lakmues për të jetuar, ti ke për të gjetur ata (jehuditë), bile edhe më lakmues se idhujtarët. Ndonjëri prej tyre dëshiron të jetojë njëmijë vjet, por edhe sikur të jetojë, ajo (jeta e gjatë) nuk do ta shpëtoj atë prej dënimit. Allahu sheh çka veprojnë ata.” [El-Bekare: 96] Jeta patjetër të ketë një objektivë (intencë) më të lartë. E nëse jeta nuk e ka këtë objektivë, atëherë vdekja është më e mirë. Allahu jetën e kësaj bote e ka krahasuar me zbritjen e shiut nga qielli, i cili u jep jetë gjërave pasi ishin të vdekura. Po ashtu, edhe jeta e kësaj bote e cila është pa objektivë të lartë, e mbushur me dëfrime dhe ahengje dhe e limituar për një kohë të shkurtër. Krejt kjo përfundon me vdekjen, ku pastaj vazhdon me jetën tjetër, të përhershme dhe pa vdekje. Allahu xh.sh. thotë:

﴿وَلَيْسَ سَأَلْتَهُمْ مَنْ نَزَّلَ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً فَأَحْيَا بِهِ الْأَرْضَ مِنْ بَعْدِ مَوْتِهَا لِيَقُولَنَّ اللَّهُ فُلِ الْحَمْدُ لِلَّهِ بَلْ أَكْثَرُهُمْ لَا يَعْقِلُونَ﴾ (63) وَمَا هَذِهِ الْحَيَاةُ الدُّنْيَا إِلَّا لَهْوٌ وَلَعِبٌ وَإِنَّ الدَّارَ الْآخِرَةَ لَئِي الْحَيَوَانِ لَو كَانُوا يَعْلَمُونَ﴾

**“Dhe nëse ti pyet ata: “Kush e lëshon shiun nga qielli dhe me të e ngjall tokën pas vdekjes së saj?” Ata thonë: “Allahu!” Thuaj: “Falënderimi i qoftë Allahut, por shumica e tyre nuk mendojnë”. Kjo jetë e kësaj bote nuk është tjetër vetëm se dëfrim e lojë, e jetë e vërtetë, padyshim është ajo e botës së ardhme (Ahireti), sikur ta dinin.” [El-Ankebut: 63-64]**

Ibn Ashuri, për fjalën lehvun (dëfrim, argëtim) dhe la'bun (lojë) thotë: “Lehvun janë gjërat me të cilat dëfrehen njerëzit... ose gjërat me të cilat e kalojnë kohën e tyre në këtë jetë, në të vend se të merreshin me angazhime konkrete. Kurse fjala leabun (lojë) nënkupton argëtim dhe ndjenja komode me këtë argëtim.”<sup>415</sup>


Atëherë, nuk ka asnjë vlerë kjo botë nëse jetohet si lojë dhe vetëm për argëtim. Patjetër të ketë një intencë më të lartë dhe më fisnike të cilën Allahu e kërkon nga jeta e njeriut në këtë botë. Meqenëse Bota Tjetër është e përhershme dhe e pafund, atëherë ajo është bota ku njerëzit do të shpërblehen për punën e bërë në dynja. Cila është detyra që Zoti e do nga njeriu në jetën e kësaj bote?

Intencë e jetës është angazhimi dhe puna në këtë botë, ku Allahu i ka mundësuar njeriut që të jetojë në të, e ka bërë mëkëmbës dhe ka kërkuar që të jetojë me dinjitet. Pra, ekziston një vazhdimësi dhe plotësim i ndërsjellë mes intencave të krijimit të njeriut në këtë botë, të cilat lidhen edhe me mundësinë e dhënë për mëkëmbje dhe ndërtim të jetës në tokë. Përmeshja e këtyre intencave nga ana e njeriut përbën kuptimin e adhurimit që bëhet me rite dhe me vepra ndërnjerëzore. Të gjitha këto janë punë që përpunohen me urdhëresën e Allahut të Lartësuar, dhe vetëm me këto njeriu drejtohet kah rruga e Zotit të Patëmetë.

Të gjitha këto angazhime apo punë jemi përpjekur t'i përmbledhim në skemën vijuese, e cila në tërësi shpreh mundësinë se si njeriu mund ta ndërtojë këtë jetë sipas intencave për të cilat u krijua nga Zoti i Vërtetë. Pasi adhurimi i Një Zoti të Vetëm është intenca e përgjithshme e ekzistencës, atëherë të gjitha përshkrimet tjera matëse për jetën e njeriut në tokë janë

<sup>415</sup> Po aty, komentimi i ajetit 63 të sures El-Ankebut, vëllimi XXI, fq. 31

vetëm për ta lehtësuar përmbushjen e kësaj intence të përgjithshme. Njeriu në tokë është mëkëmbës dhe e kryen detyrën me të cilën e ka ngarkuar Allahu, pra e ndërton (dhe e drejton) jetën në tokë **“ka kërkuar ta ndërtoni jetën në të”** [Hud: 61], kurse kjo detyrë kërkon që njeriut t'i jepet kjo mundësi, prandaj Allahu ka thënë: **“Ne ju kemi dhënë mundësinë në tokë.”** [El-A'raf: 10], d.m.th. toka të jetë e nënshtruar ndaj njeriut. Allahu xh.sh. thotë: **“A nuk e sheh se Allahu ju nënshtrroi gjithçka në tokë.”** [El-Haxhxh: 65]. Adhurimi në kuptimin më gjithëpërfshirës do të thotë angazhim për ndërtimin apo rregullimin e jetës në tokë dhe kryerjen e punëve të mira në të.



Puna e ndërtimit të jetës ngërthen edhe sistemimin e jetës materiale dhe kuptimore të njeriut. Ndërtimi (formimi) kuptimor (shpirtëror) manifestohet me stabilitet, vënie të drejtësisë, përdorim të konsultës, rregullim të sistemeve administrative dhe inspektuese të cilat ua lehtësojnë jetën njerëzve dhe ua heqin qafe vështirësitë. Ndërsa ndërtimi material manifestohet me ndërtimin e godinave, me hapjen e rrugëve, me kultivimin e tokës dhe me ndërtimin e fabrikave. Me plotësimin e ndërtimit kuptimor dhe material, të gjithë njerëzit jetojnë jetë të mirë dhe fisnike. Njerëzit e veçantë përpiqen vazhdimisht për mirëqenie të njerëzve të tjerë, kurse njerëzit e rëndomtë u kërkojnë të zgjedhurve më shumë të mira, më shumë mirëqenie dhe më shumë fuqi.

Duam të pohojmë se ndërtimi jetës njerëzore në terminologjinë kur'anore të cilën e potencuam në disa raste, është terminologjia të cilën e ka përdorur Ibn Halduni, ku sipas tij

kjo lidhet drejtpërdrejt me kuptimin e qytetërimit dhe të kulturës, prandaj nuk ka asgjë të keqe të lidhet kultura dhe mirëqenia në këtë botë (umran), kuptohet, duke i cilësuar të dyja si terma që flasin për jetën në shoqërinë njerëzore, dhe atë për dy aspektet e saj: për aspektin kuptimor (shpirtëror) dhe aspektin lëndor apo material.<sup>416</sup>

Në vazhdim do të përpiqemi t'i prekim disa intenca pedagogjike të ndërtimit të jetës në këtë botë:

Respektimi i sistemit dhe ligjit me vetëdije. Shumimi i njerëzve dhe i interesave të tyre ka çuar në sistemimin dhe administrimin e jetës në atë formë që të ruhen të drejtat e të gjithëve dhe të ketë siguri. Sigurisht, kjo kërkon respektim të ligjeve dhe të akteve legjislative qytetare, ku ndoshta njeriu ndjen një lloj kufizimi të të drejtës së tij të lëvizjes. Vlera kulturore, qytetëruese, jetësore dhe gjithçka që kërkon ky sistem, përmbush interesat e përgjithshme të shoqërisë. Kjo është një çështje edukative e cila nxitet dhe ndihmohet nga konstatimi shpirtëror që ekziston për jetën. Pastaj forcohet me mënyrat e zhvillimit edukativ në familje, me programet drejtuese në institucionet edukative, në media dhe të tjera.

Përmasat ligjore që kërkon jeta bashkëveprojnë ngushtë me aspektin kulturor të cilin e diktojnë traditat, zakonet, mënyrat e të menduarit logjik, shprehjet gjuhësore dhe sjelljet shoqërore të jetës private dhe publike. Në çështjen kulturore, aspekti edukativ ka dy anë: e para është zhvillimi, vlerësimi dhe respektimi sipas kuptimit të kulturës udhëheqëse në shoqëri, sidomos sipas elementëve të cilat e përbëjnë identitetin shoqërore dhe fetar. E dyta është vetëdija që përmban kjo kulturë, gjegjësisht elementët e dobësisë dhe të prapambetjes, elementët e bashkëpunimit për t'i trajtuar pjesët e dobëta dhe vënia e kufizimeve për t'i ndaluar efektet e tyre. Me gjasë, programet e zhvillimit edukativ në jetën kulturore kërkojnë vetëdijesim të mjaftueshëm për gërshetimin e kërkesave identitare dhe reformuese, bashkë me programet e bashkëpunimit dhe të angazhimit të përbashkët për t'i realizuar këto dy çështje paralelisht.

<sup>416</sup> Melkavi, *Mendhmet'ul-kijem'il-ulja: et-tevhidu ve't-tezkijetu ve'l-umranu*, vep. e cit., fq. 153

Ndërtimi i jetës kërkon sigurimin e shanseve për fitimin e dijes dhe të njohurive për të gjithë anëtarët e shoqërisë. Megjithatë, niveli i përfitimit të njerëzve nga shanset që ofron arsimit dallon. Disa njerëz i kuptojnë çështjet me lehtësi, kurse disa të tjerë nuk i kapin dot, prandaj çdoherë ekziston nevoja për institucione arsimore, trajnuese, hulumtuese dhe studimore, dhe për shanse bashkëvepruese mes njerëzve të niveleve të ndryshme në shoqëri. Intenca edukative e kësaj dukurie, e ndërtimit të jetës në tokë, manifestohet në ndjenjat modeste të çdo individi për dijen që posedon dhe në nevojën për të përfituar nga shanset e ofruara për ta shtuar dijen. Dallimi mes shoqërive në fitimin e dijes imponon bashkëpunimin dhe këmbimin e përvojave shkencore (njohëse), sepse kjo përmesh zhvillimin kulturor dhe përparimin në jetë.

Shanset e bashkëpunimit për të fituar dije, njohuri dhe përvojë në ngrehinën e jetës dhe të kulturën brenda shoqërisë, apo mes shoqërive, nuk e ndalojnë konkurrencën dhe garën për t'u dalluar. Dorëzimi para gjendjes aktuale të dijes, qoftë në nivel individual apo shoqëror, përfundon me regres dhe prapambetje, e cila pastaj reflekton me regres kulturor dhe jetësor. Parimi i bashkëpunimit për arsimim brenda grupit dhe angazhimi edukativ i përbashkët janë çështje të rëndësishme dhe të dobishme për ngritjen e nivelit arsimor të përgjithshëm. Po ashtu, sigurimi i stimuluesve të domosdoshëm për çdo institucion të shoqërisë dhe planifikimi që çdo institucion të japë më të mirën e mundur, duke prezantuar shoqëria në arenën e vlerave botërore dhe duke i dhënë gjëra të bukura qytetërimit botëror, krejt këto janë çështje të rëndësishme që i kërkojnë ndjenjat edukative individuale dhe grupe për të përmeshur identitetin e vet dhe për të vazhduar zhvillimin shkencore.

Intenca e jetës në këtë botë kërkon edukim në disa dimensione, bashkëjetesë me diversitetin dhe pranimin e divergjencës (si vlerë). Në Kur'an janë dhënë disa tekste që flasin për ndërtimin e xhamive, ku fjala umran përfshin ndërtimin e godinës së xhamisë, strukturës ndërtimore dhe përbërësit e saj, mirëpo ndërtimi (jetësimi) i saj bëhet me praninë në

namaz dhe me tubimet për punë të mira që bëhen në të, si: arsimimi dhe promovimi i interesave administrative dhe sistimore. Ngrija e tyre kërkon që ato të ruhet nga rrënimi duke ofruar potencialin e duhur për këtë mbrojtje. Megjithatë, ajo që tërheq vëmendjen është se Kur'an i fisnik e ka lidhur këtë mbrojtje me mbrojtjen e tempujve të adhurimit për jomuslimanët. Kështu konfirmon lirinë e besimit dhe shumësinë e feve. Allahu xh.sh. thotë: ﴿وَلَوْلَا دَفَعُ اللَّهُ النَّاسَ بَعْضَهُمْ بِبَعْضٍ لَهَيَمَتُ صَوَامِعُ وَبِيْعٌ وَصَلَوَاتٌ وَمَسَاجِدُ يُذَكَّرُ فِيهَا اسْمُ اللَّهِ كَثِيرًا وَلَيُنصَرِفَنَّ اللَّهُ مَنْ يَنْصُرُهُ إِنَّ اللَّهَ لَقَوِيٌّ عَزِيزٌ﴾ *“E sikur Allahu të mos i zmbrapste disa me disa të tjerë, do të rrënoheshin manastiret, kishat, havrat e edhe xhamitë që në to përmendet shumë emri i Allahut. E Allahu patjetër do ta ndihmojë atë që ndihmon rrugën e Tij, se Allahu është shumë i fuqishëm dhe gjithnjë triumfues.”* [El-Haxhxh: 40] Gjithashtu, edhe hadithi që flet për nxitjen që Zoti u bën besimtarëve për t'u ballafaquar me armiqtë për t'i mbrojtur faltoret. Hadithi nxit njerëzit që të ndihmojnë njëri-tjetrin në mbrojtjen e tokës nga shkatërrimi dhe dhuna, të ndihmojnë në sigurinë, mirëqenien dhe vënien e drejtësisë në të. Allahu xh.sh. thotë: ﴿وَلَوْلَا دَفَعُ اللَّهُ النَّاسَ بَعْضَهُمْ بِبَعْضٍ لَفَسَدَتِ الْأَرْضُ﴾ *“E sikur Allahu të mos nxiste njerëzit me njëri-tjetrin, do të shkatërrohej toka.”* [El-Bekare: 251].

Hadithi i saktë të përfshijë atë që kërkon vetëdija e muslimanit, të lidhë shpirtin me trupin. Edukimi shpirtëror nuk është i ndarë nga edukimi material, siç nuk ndahet shpirti i njeriut nga trupi, veçse kur përfundon jeta në këtë botë. Shpirti dhe trupi, secili veçmas, kanë nevojat e tyre edukative. Ebu Hurejre transmeton, se i Dërguari i Allahut ka thënë: “Kur del shpirti i besimtarit e takojnë dy melaqe dhe e ngrenë atë.” Hammadi ka thënë: “Përmendet se ky shpirt ka erë të mirë dhe theksohet edhe misku”. Tha: “Banorët e qiellit thonë: shpirti i mirë na erdhi nga toka. Zoti të bekoftë ty dhe trupin ku je duke jetuar!...”.<sup>417</sup> Shpirti jeton në trup përgjatë jetës së kësaj bote. Pa shpirtin, trupi nuk jeton dot në këtë jetë, madje shkatërrohet dhe nuk ka asnjë vlerë. E këtillë është edhe zemra, e cila jeton me Kur'an, kurse pa të shkatërrohet.

<sup>417</sup> Muslim, *Sahihu Muslim*, vep. e cit., Libri “El-Xhennetu”, Kapitulli: paraqitja e vendit të të vdekurit në xhenet ose në zjarr, hadithi numër 2872, fq. 1151



Kur'ani për zemrën është njësoj si shpirti për trupin. Daremiu transmeton një hadith mevkuf të sahabiut Abdullah bin Mes'ud, i cili ka thënë: “Zemra në të cilën nuk ka asgjë nga Libri i Allahut është e shkatërruar njësoj si shtëpia ku nuk banon askush.”<sup>418</sup> Po ashtu, në këtë vepër figuron edhe një hadith tjetër mevkuf i tabi'init Katade bin Deame Sudusi, i cili thotë: “Gjallëroni zemrat dhe shtëpitë tuaja me atë (Kur'an)!”<sup>419</sup>

Vlera e përpjekjeve edukative në udhëzimin e nxënësve aty ku synojnë të mbërrijnë intencat dhe objektivat edukative. Pasi ecja në rrugë të drejtë është objektivi edukativ, atëherë Kur'ani është shpirti i jetës së njeriut, kurse legjislacionet tjera janë burim i udhëzimit kah njeriu më i mirë në këtë dhe në botën tjetër. Udhëzimi manifestohet në zemra dhe në mendje, siç “hyn shpirti në trup dhe bëhet i gjallë pasi ishte i vdekur.”<sup>420</sup> Kur'ani është dritë, ndërsa besimi, udhëzimi, dija dhe gjithçka gjendet në të është dritë po ashtu. Njësoj shembullohet lajthitja, injoranca, mosbesimit dhe errësira. Allahu xh.sh. thotë: ﴿وَكَذَلِكَ أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ رُوحًا مِّنْ أَمْرِنَا مَا كُنْتَ تَدْرِي مَا الْكِتَابُ وَلَا الْإِيمَانُ وَلَكِن جَعَلْنَاهُ نُورًا نَّهْدِي بِهِ مَنْ نَّشَاءُ مِنْ عِبَادِنَا وَإِنَّكَ لَتَهْدِي إِلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ﴾

“Po kështu me urdhrin tonë Ne te shpallëm edhe ty shpirtin (Kur'anin). Ti nuk ke ditur ç'është libri (Kur'ani) as ç'është besimi, por Ne atë e bëmë dritë me të cilën e vëmë në rrugë të drejtë atë që dëshirojmë prej robërve tanë. Në të vërtetë, edhe ti udhëzon për në rrugë të drejtë.” [Esh-Shura: 52]

Shoqëritë njerëzore zhvillohen në aspektin kulturor dhe jetësor. Po ashtu, ngrihen përmes udhëzimit hyjnor, përmes pastrimit shpirtëror, instruksioneve morale dhe legjislacioneve shoqërore. Përvojat e këtyre shoqërive akumulohen përmes shkencave, njohurive dhe përvojave të cila këto shoqëri i transmetojnë nga njëra gjeneratë në tjetrën. Megjithatë, ngritja jetësore dhe zhvillimi kulturor bëhet sipas ligjeve të shoqërisë njerëzore, sipas karaktereve të kësaj shoqërie, ligjeve

<sup>418</sup> Ed-Daremij, Ebu Muhammed Abdullah bin Abdurrahman bin Fadli (vd. 255 h.), *Musned'ud-Daremij (Sunen'ud-Daremij)*, i përgatitur për botim nga Husejn Selim Darani, Rijad, Dar'ul-Mugni, 1420, Libri “Vlera e Kur'anit”, Kapitulli: “Teahud'ul-Kur'an”, vëllimi III, hadithi numër 3350, fq. 2073

<sup>419</sup> Po aty, vëllimi V, hadithi numër 3385) fq. 375

<sup>420</sup> Ibn Ashuri, *Et-Tahriru ve 't-tenviru*, komentimi i ajetit 52 të sures Esh-Shura, vëllimi 25, fq. 154

psikike dhe sociale të këtyre karaktereve dhe sipas ngjarjeve. Këto ligje mund të studiohen, ashtu që njerëzimi duhet të orientohet kah ngritja dhe zhvillimi i jetës njerëzore në bazë të këtyre ligjeve. Për këtë arsye duhet të sigurohet programe studimore për faza të ndryshme të jetës dhe për nivele të ndryshme shkencore, kuptohet, sipas ligjeve të zhvillimit dhe avancimit të çdo disipline shkencore. Këtë Ibn Halduni e ka pohuar dhe e ka përsëritur disa herë, bile ka bërë thirrje të studiohen ndryshmet dhe ngjarjet shoqërore në formë sistematike dhe metodologjike. Këtë e ka bërë që të mund të spikatim karakterin e gjërave dhe thelbin e ngjarjeve, prandaj ka thënë: “Në dallimin e të vërtetës dhe të pavërtetës së ngjarjeve është ligj që të shihet shoqëria njerëzore e cila është edhe vetë boshti i jetës së kësaj bote, në mënyrë që të shohim se cilat situata janë qenësore dhe pjesë e domosdoshme e karakterit të tyre...”. Kjo tek Ibn Halduni kërkon përcaktimin e disiplinës së ndërtimit të jetës bashkë me problemet që ndërlidhen me të. Gjithashtu, kjo “vlen për çdo disiplinë shkencore pozitive apo racionale.”<sup>421</sup> Për këtë arsye kërkohet thirrja për ndryshim dhe reformim në shoqëritë islame bashkëkohore, në mënyrë që t’i shmangin aspektet e regresit jetësor dhe kulturor, dhe atë duke u mbështetur në studimin e ligjeve të ndryshimit në shpirtin njerëzor dhe duke inkorporuar studimin e këtyre ligjeve (të dinamikës) në programet e të gjitha fazave arsimore.

Planifikimi i përmbushjes së intencave të përgjithshme të cilat lidhen me jetën e umetit kërkon jetësimin e një sistemi edukativ të përgatitur nga studiues profesionistë që mund të zhyten në thellësinë e problemeve dhe janë kreativë në çdo sferë të ngrehinës së shoqërisë dhe në rizgjim kulturor të umetit. Po ashtu, krejt kjo të bëhet me një vështrim vizionar dhe perspektiv. Kjo përgatitje nuk bëhet vetëm për një gjeneratë, e që të tjerat pastaj të mos kenë nevojë për të, por përgatitja vlen për të gjitha gjeneratat njëra pas tjetrës, në mënyrë që asnjë gjeneratë apo kohë të mos jetë pa profesionalizëm dhe profesionistë.

<sup>421</sup> Ibn Halduni, *Mukaddimetu Ibn Haldun*, vep. e cit., vëllimi III, fq. 332

# Pjesa e pestë: Aktivizimi dhe përforcimi i intencave edukative

## 1. Aktivizimi dhe funksionalizimi

Fjala *tef'ilun* (تَفْعِيل) është paskajorja e foljes *fa'ale* (فَعَّلَ), e cila do të thotë të aktivizosh apo të vësh në funksion potencialet, të jetë aktive dhe reale. Rrënja tregërmëshe e paskajores paraprake është *feale* (فَعَّلَ) e cila do të thotë: fuqia e një gjëse për të ndikuar. Fjala *failijjetu el-huttah* (فاعلية الخطأ) do të thotë: mundësia apo efikasiteti i projektit për t'i realizuar objektivat e parashikuara. Kurse *fa'ilijjet'ul-edai* (فاعلية الأداء) do të thotë: realizimi i qëllimit duke përdorur atë (mjedin) me kompetencë të përshtatshme.

Kujdesi për aktivizimin e idesë së intencave mbështetet në atë se “intencat nuk janë thjesht njohuri apo aventurë shkencore, as vetëm thellim filozofik në shariat, gjegjësisht në kup-time dhe caqe, por është njësoj si disiplinat tjera shkencore e cila prodhon aktivitetet dhe le gjurmë, shkencë që ka dobitë dhe përfitimet e veta.”<sup>422</sup>

Veprimi (fi'lun) është efekti që shkakton një indikator i caktuar. Njeriu mund të kryejë dy lloje të veprimeve: një lloj është veprimi instiktiv apo spontan, për të cilin as nuk lavdërohet dhe as nuk qortohet, dhe lloji i dytë është veprimi vullnetar, veprim që ngarkon me obligim dhe ndjell dispozita. Njeriu mund të realizojë një veprim të caktuar, i shtyrë nga egoja e tij, i cili i sjell përfitime atij apo të tjerëve, ose veprim që i përgjigjet urdhrin të Allahut dhe kërkon shpërblimin e Tij. Dispozita që e konstaton një punë të pranuar tek Allahu dhe e cila sjell sevap varet nga dy çështje: njeriu të veprojë me

<sup>422</sup> Er-Rejsuni, *El-Fikr'ul-mekasidijju, kavaiduhu ve fevaiduhu*, vep. e cit., fq. 90

nijet të përgjigjes ndaj urdhrit të Zotit dhe sipas trajtës që e ka urdhëruar Vetë Ai me tekst nga Kur'ani apo me traditën pejgamberike të Muhammedit a.s. Nijeti ka për qëllim objektivin që e synon njeriu me veprimin e vet, të cilin e pranon Zoti dhe në bazë të tij pastaj rrjedhin efektet e atij veprimi. Krejt ajo që është legjitimuar nga Allahu i Lartësuar ka për qëllim vënien e lidhjes mes njeriut dhe Allahut përmes veprave vullnetare, njësoj siç është i lidhur ai me aktet e detyrueshme. Për këtë kuptim, Shatibiu ka thënë: “Intenca e sjelljes së sheriatit është nxjerrja e personit të ngarkuar me detyrë nga ndikimi i egos dhe nënshtrimi vullnetar ndaj Allahut xh.sh., sepse tekefundit njeriu detyrimisht është rob i Allahut.”<sup>423</sup>

Nijeti në praktikën e njeriut është lidhësja e veprimit të njeriut me intencën sheriatike. Nijeti lidhet me të gjitha veprimet vullnetare të njeriut. Pra, “veprimi vullnetar ndjell dispozita sheriatike, qofshin ato veprime personale. Çdo detyrim, çdo lëvizje dhe çdo heshtje, qoftë individuale apo kolektive, ka një gjykim të caktuar nga sheriatu.”<sup>424</sup> Kjo nënkupton se çdo veprim vullnetar i njeriut ka një dispozitë tek Allahu.

Shatibiu u ballafaqua me problemin e pajtueshmërisë apo kundërthënies mes punëve dhe intencave në disa situata. Këtë problem e filloi me fjalët e Muhammedit a.s.: “Vërtet veprat vlerësohen sipas qëllimeve.”<sup>425</sup> Pra, në konsideratë merret akti që veprimin dhe nijetin i ka në përputhje me sheriatin, edhe nëse bie ndesh me një ‘nijet të saktë’, ngase të gjitha punët në përgjithësi kanë shpirtin e vet. Një punë që kundërshtohet me qëllimin dhe pajtohet me veprën, është një trup pa shpirt, sepse punët bartin me vete edhe qëllimet. Pra, intencat janë shpirti i punëve, prandaj nëse puna dhe qëllimi bien ndesh njëra me tjetrën, atëherë nuk mbetet as shpirti dhe as trupi.<sup>426</sup>

<sup>423</sup> Esh-Shatibij, *El-Muvafekatu fi usul'ish-sheriatu*, vep. e cit., fq. 318

<sup>424</sup> Po aty, hyrja e nëntë, fq. 45

<sup>425</sup> El-Buhari, *Sahih'ul-Buhari*, vep. e cit., libri “Fillimi i shpalljes”, Kapitulli “Si ishte fillimi i shpalljes te Pejgamberi a.s.”, hadithi numër 1, fq. 3

<sup>426</sup> Esh-Shatibij, *El-Muvafekatu fi usul'ish-sheriatu*, vep. e cit., fq. 325

Nijeti është veprim i cili çdo punë e bën pjesë të imanit të besimtarit, e afron besimtarin me Zotin dhe e paraqet atë si nuancë të adhurimit të tij. Disa adhurime janë individuale, disa kolektive dhe disa shoqërore. Hadithi i Pejgamberit a.s. “Besimi është shtatëdhjetë e disa degë: më e larta është “nuk ka zot tjetër pos Allahut” dhe më e ulëta është largimi i një pengese nga rruga.”, këtu shihet se largimi i një pengese nga rruga është pjesë e besimit i cili fillon me tevhidin “Nuk ka zot tjetër pos Allahut”, por që përmban edhe shumë kërkesa të tjera të tezkijes (pastrimit shpirtëror) të cilat lidhen me moralin, etikën dhe normat shoqërore, shtuar këtu edhe kërkesat jetësore, prandaj këto përfundojnë te largimi i pengesave nga rruga. Sigurisht, çështja e largimit të ndonjë pengese nga rruga nuk kufizohet vetëm te largimi i një ferre apo guri në rrugën rrënore në shkretëtirë apo majën e kodrës, por kjo përfshin hapjen e rrugëve për vetura, rrugë që do të lidhin fshatrat dhe periferitë me qytetet, të lehtësohet qarkullimi dhe të krijohen rrugë transportimi më të lehta, si p.sh. drejtimi i rrugëve, riparimi, drejtimi, zgjerimi, ndriçimi dhe pajisja e tyre me të gjitha gjërat tjera të nevojshme zhvillimore, të cilat do të ndihmojnë në ngritjen e gjendjes kulturore dhe jetësore në shoqëri. Fjala rrugë këtu mund të përfshijë rrugën tokësore, detare apo ajrore. Sigurisht, përzgjedhja e një shembulli të caktuar si një degë të besimit si p.sh. “largimi i një pengese nga rruga” nuk e ul vlerën e shembujve të tjerë, por jepet një shembull i caktuar si përfaqësues i nevojës dhe si indikator që besimtari të përsiatë shembujt e tjerë.

Ajo që na intereson në çështjen e aktivizimit, në fund të fundit, është “veprimi” i njeriut në sferën e vullnetit, lirisë dhe përzgjedhjes së tij, pra veprimi që lë gjurmë në jetën e tij dhe në jetën e njerëzve të tjerë, në natyrë dhe në ambientin ku jeton. Allahu xh.sh. i ka renditur efektet e kësaj dhe të Botës Tjetër, por efektet mund të jetë pozitive dhe të lëvduara apo negative dhe të shëmtuara.

Arsyeja është begatia me të cilën Allahu e ka dalluar njeriun që t'i shërbejë për ta përmbushur detyrimin e tij në këtë botë, prandaj njeriu është edhe përgjegjës për përdorimin dhe

funksionimin e saj për të cilin është krijuar, njësoj si begatitë tjera. Allahu xh.sh. thotë: ﴿وَلَا تَقْفُ مَا لَيْسَ لَكَ بِهِ عِلْمٌ إِنَّ السَّمْعَ وَالْبَصَرَ وَالْفُؤَادَ كُلُّ أُولَئِكَ كَانَ عَنْهُ مَسْئُولًا﴾ “Vërtet, dëgjimi, shikimi dhe zemra: të gjitha këto do të jetë përgjegjëse.” [El-Isra: 36] Nga urtësitë e ligjërimin hyjnor për arsyen është se për të nuk flitet me trajtën e emrit, pra askund në Kur’an arsyeja nuk është dhënë me emër, por me folje, sepse folja përfshin veprim, angazhim, ushtrim dhe lëvizje në jetën individuale dhe shoqërore. Pra, aktivizimi i arsyes detyrimisht kërkon ushtrimin e veprimit të përsiatjes në ajetet e shkruara dhe të krijuara të Zotit. Kërkon meditim, vështrim, mendim, përsiatje, rezonim, marrje mësim etj.

Profesor Alvani bën një ndërlidhje mes mbështetjes në “sistemin e intencave elitare-dirigjuese” dhe efektet që vijnë si rezultat i aktivizimit dhe materializimit të tyre. Nëse këto vihen në funksion, atëherë do t’u japin gjallëri dhe efikasitet “karakteristikave të sheriatit”. Sistemi i intencave të prezantuara në trashëgiminë e usulit dhe sistemi i intencave elitare (tevhidi, tezkija dhe umrani) të propozuara nga Alvani, nëse vihen në jetë bashkërisht atëherë në trashëgiminë e fikhut dhe të usulit do të shkaktojnë një reformim dhe kullim të fikhut tradicional, bashkë me efektet negative të cilat kanë krijuar një barrierë të madhe mes fikhut (jurisprudencës) dhe edukimit (pedagogjisë). Gjithashtu, Alvani konstaton se veçoritë e sheriatit të fundit janë themel dhe pikënisjes e sistemit të vlerave elitare. Nëse mbështetemi në këto vlera, atëherë “këto karakteristika (të sheriatit) mund t’i nxjerrin nga rrethi i virtyteve të thjeshta në rrethin e virtyteve efikase dhe praktike.”<sup>427</sup>

Shkenca e usuli fikhut (bazave të sheriatit) përfshin një sërë rregullash të cilat rregullojnë procesin e nxjerrjes së dispozitave juridike. Pastaj tematika e intencave u inkuadrua si fushë studimore e usuli fikhut, u zhvillua vetëdija për intencat shkallë-shkallë dhe u bë tutor i përpjekjeve të studiuesve për qasjen ndaj problemeve të reja përgjatë epokave të ndryshme historike. Nuk ka dyshim se realiteti i shoqërive

<sup>427</sup> El-Alvani, *Mekasid’ush-sheriat*, vep. e cit., fq. 142-143

islame sot lidhet ngushtë me sistemin botëror bashkëkohor, me presionet dhe shtypjet që bën ky sistem, madje edhe me probleme jo të zakonshme për jurisprudencën islame. Ajo që sot pritet nga përpjekjet e studiuesve të umetit është ajo të cilën Nexhari e quan “renesancë intenciale” në fikhun islam (jurisprudencën islame), ku roli i saj të jetë aktivizimi i intencave të sheriatit, duke i “riçliruar, i rikonstatuar dhe duke i riklasifikuar ato. Po ashtu, aktivizimi i intencave kërkon të konstatohet esenca e tyre në mënyrë çdo dispozitë të ngrihet mbi intencën e përshtatshme, të konstatohen edhe synimet, sepse mbi ato intenca do të sillen dispozita të realizueshme në realitet dhe që trajtojnë probleme reale. Umeti islam sot dëmtohet shumë si pasojë e pakujdesisë dhe mosvënies në funksion të intencave në të gjitha fazat e zhvillimit të tij.”<sup>428</sup>

S’ka dyshim se aktivizimi i intencave kërkon hulumtim profesional të mjeteve të cilat do ta realizojnë këtë aktivizim, p.sh. mbrojtja e arsyes është njëra nga pesë intencat për të cilën flasin më shumë usulistët. Realizimi i kësaj intence kërkon sigurimin e mjeteve të ndryshme, si: edukimin intelektual për të formuar një mendësi intelektuale dhe ndërtimin e një metode shkencore dhe arsimore. Ky edukim ngrihet mbi disa komponentë të rëndësishëm, si p.sh. adhurimi i meditetimit dhe vështrimit intelektual, refuzimi i dyshimit aty ku kërkohet bindja, vlerësimi i lartë i shpirtit kundrejt egos, refuzimi imitetimit të verbër të të parëve, ndjekja e ligjeve të Zotit në univers dhe në shoqëri, dhe shumë mjete të tjera.

Ndërtimi i një metode shkencore për studim dhe hulumtim, si dhe ndërtimi i dijes, provimi dhe funksionalizimi i saj, kërkon njohjen e llojeve të metodave dhe funksionin që mund të kryejë secila në vete. Ekzistojnë një sërë mënyrash të ndryshme për argumentimin logjik, eksperimental dhe induktiv. Përveç këtyre ka një sërë metodash tjera të ndryshme të cilat i përdorin studiuesit në metodat hulumtuuese, si metoda historike, përshkruese, empirike dhe të tjera. Përmes komponentëve logjikë të edukimit dhe përmes ndërtimit të

<sup>428</sup> En-Nexhhar, *Muraxheatun fi 'l-fikr'il-islamijji*, vep. e cit., fq. 137-138

metodave studimore dhe hulumtuese, procesi arsimor dhe edukativ mund t'i përcaktojë tipat e shkencave që mund të mësohen, bashkë me nivelin që kërkon çdo tip i arsimit. Gjithashtu, përmes këtyre bëhet shpërndarja e shkencave dhe tematikave sipas nivelit të domosdoshmërisë, të nevojës dhe të estetikës.

## 2. Aktivizimi i intencave kërkon fekih intencialist

Fekihu (juristi islam) në terminologjinë islame është studiuesi i dispozitave të sheriatit islam, i cili merret me problematikat që kërkojnë gjykim sheriatik, dhe ndoshta edhe mund të sjellë një gjykim për atë çështje, të japë fetva dhe të ofrojë një lloj të dijes për një çështje të caktuar. Në krejt këto çështje, fekihi i vërtetë është edhe intencialist, sepse kërkon që në vështrimin e tij juridik të inkuadrojë edhe intencat që përshtaten me dispozitat, kuptohet duke i realizuar ato që i afrojnë të mirat dhe i largojnë të këqijat. Fekihu intencialist, për ta arritur këtë duhet t'i ndjekë tri faza përgjatë studimit, e pastaj intencat e sheriatit mund të jenë funksionale në nxjerrjen e dispozitave të cilat trajtojnë problemet e shtruara. Trajtimi i duhur dhe i saktë bëhet përmes konstatimit të intencave, përfaqësimit të tyre të drejtë shkencor, përshtatjen e intencave me dispozitat dhe përshtatjen e synimeve të intencave duke i zbritur dispozitat në arenën e realitetit."<sup>429</sup>

Rëndësia e vetëdijes për këto faza buron nga njohja teorike dhe praktike e intencave të një çështjeje të caktuar, përmes së cilave fekihi kërkon të sjellë një gjykim. Po ashtu, duhet njohur se intencat janë të llojllojshme dhe të ndryshme në fuqi (për të sjellë dispozitë), prandaj nuk duhet ngatërruar ato që janë të domosdoshme, me ato që janë të nevojshme dhe estetike, apo e kundërta. Gjithashtu, rëndësia e intencave vjen nga dija se pështjellimet e realitetit mund të transformohen në rezultate të paparamenduara. Fekihu intencial, sipas Nexharit, i kupton mirë tri çështje: dijen për intencat e një problematike për të cilën kërkon të sjellë dispozitë, për

<sup>429</sup> Po aty, fq. 132-133.



nivelet dhe llojet e intencave të asaj problematike dhe për vlerësimin e objektivitetit të dispozitës së asaj problematike në dritën e pështjellimeve të realitetit kohor dhe vendor.

E rëndësishme dhe e re në trajtimin e Nexharit për aktivizimin e intencave është se ai jep shembuj për tri etapat, ashtu që zhytet në mendimin e dispozitave që ndërliken me jetën bashkëkohore dhe me problemet e saj në kontekstin lokal dhe universal, si p.sh.: problemi i përçmimit të krenarisë njerëzore, shuarja e natyrshmërisë së pastër njerëzore (fitres), rrënimi i sistemit familjar, promovimi i rreziqeve të ndotjes së ambientit dhe të tjera. Kjo do të thotë se fekihi intencionalist e një hollësisht problematikën për të cilën kërkohet të sjellë gjykim apo dispozitë. Mbase tematika mund të shfaq ndonjë interes apo nevojë të panjohur më parë, prandaj kërkohet riklasifikimi i intencave, dhe jo domosdoshmërisht t'i përmbahet renditjes tradicionale. Kështu, për një problematikë ndeshen intencat të ndryshme, ku fekihi detyrohet të vë ekuilibrin sipas fuqisë ndikuese të përpjekjes teorike dhe praktike për të ndjellë një të mirë apo për të shmangur një të keqe. Fuqia ndikuese e përpjekjes praktike mund të shfaqet një rezultat të caktuar, e që pastaj, në fund fare, interpretohet me një rezultat ndryshe, kurse fekihut intencionalist i takon të ndjekë perspektivën e intencës që ka përcaktuar, sepse realiteti mund të ketë një logjikë të specifike që bie ndesh me logjikën teorike të intencës. Kështu që, përmes vështrimit intencionalist fekihi duhet të shohë dhe hetojë logjikën praktike (të një realiteti të caktuar). Pikërisht ky është qëllimi i kush-tëzimit që muxhtehidi të jetë njohës i mirë i dispozitave të sheriatit, i gjykimeve dhe i pështjellimeve të realitetit.<sup>430</sup>

Nexhari, rëndësinë e kuptimit të realitetit e argumenton me një tekst të Shatibiut, ku flet për domosdoshmërinë e këtij tipi të të kuptuarit, pavarësisht vështirësive që dalin përpara. Pas kësaj thotë: "për t'i trajtuar këto vështirësi që hasen në sqarimin e transferimit të intencave, fekihi mund të trasojë rregulla dhe mënyra të cilat mund t'i ofrojnë ndihmën e zbulimeve të shkencave sociale, statistikore dhe psikike, si p.sh.:

<sup>430</sup> Po aty, fq. 136

njohjen e efekteve në transferimin e intencave, duke i dalluar teorikisht specifikat qenësore, rrethanore dhe reale të tyre. Gjithashtu, të ndiqen rrugën zbuluese të synimeve reale të intencave.”<sup>431</sup>

Kjo metodë të cilën e përdor Nexhari na hyn në punë aktivizimin e intencave në secilën sferë të jetës sociale. Fekihu intencalist nuk është fekih profesionist në një disiplinë shkencore fetare, por ai duhet të kuptojë një pjesë të fikhut praktik, edukativ dhe arsimor, një pjesë në praktikën politike, një pjesë të praktikës ekonomike... dhe kështu do të arrihen intencat në këto sfera. Pra, patjetër duhet të ketë një fekih intencalist të pedagogjisë, të politikës dhe të fushave të tjera.

### 3. Idetë mes efikasitetit dhe aktivizimit

Një tufë idesh të sakta në esencë, mund të mos jenë të vlefshme për praktikën në rrethana të caktuara të një kohe, të një vendi apo të një situatë të caktuar. Disa ide teorike kanë nevojë të kalojnë në praktikë dhe të zbatohen. Përderisa idetë janë produkt i të menduarit të njeriut, atëherë nga njeriu pritet që t'i praktikojë ato derisa të arrijë rezultatin dhe zotësinë e kërkuar.

Ideja, sado të jetë e saktë dhe kualitative, në momentin e zgjimit (kulturor) ajo duhet të jetë një ide e qartë, e përcaktuar, kreative, reformiste, aktive dhe të mbushur me besim dhe me fuqi iniciuese. Në rast të regresit, atëherë vetë ideja është e mjegullt, e paqartë dhe anon kah konservatorizmi, stagnimi, izolimi dhe dogmatizmi. Malik bin Nebij ka bërë një dallim mes idesë origjinale dhe idesë efektive: ide burimore nuk do të thotë se ajo është efektive, kurse ideja efektive nuk nënkupton se është edhe e saktë.

Efikasitet sipas Malik bin Nebiut është angazhimi i njeriut për të përbushur efikasitetin në ide, pavarësisht nëse këto ide janë të sakta apo të pasakta. Idetë që bëjnë historinë janë ide aktive, madje edhe nëse janë të pasakta. Ekzistenca e “një ideje burimore nuk nënkupton domosdoshmërisht se duhet të

<sup>431</sup> Po aty, fq. 137

jetë efikase çdoherë. Po ashtu, edhe një ide efikase jo domosdoshmërisht duhet të jetë e saktë. Përzierja e këtyre dyjave çon në gjykime të gabuara dhe sjell dëme të mëdha në historinë e popujve, veçanërisht kur kjo përzierje mbetet në dorën e profesionistëve dhe përdoret në luftën ideologjike si mjet për dhunimin e ndërgjegjes.”<sup>432</sup>

Disa ide e gjejnë efikasitetin vetëm pasi të marrin një frymëzim shpirtëror dhe të fitojnë një lloj shenjtërie. Malik bin Nebi mendon se qytetërimi i shekullit XX u arrit atëherë kur “Evropa e peshoi aktivitetin e shekullit XIX me këto tri fjalë: shkencë, përparim dhe qytetërim. Këto konsideroheshin ide të shenjta, prandaj lejuan të nguliten thellë brenda kufijve të parimeve të qytetërimit të shekullit XX, madje arritën të shtrihen edhe jashtë kufijve të saj në gjithë botën. Deri në Luftën e Parë Botërore këtyre ideve nuk u shpëtoi dhe nuk u bën ballë askush, sepse ishin tepër efektive, pavarësisht nëse ishin të sakta apo të gabuara. Pra, çdokush i nënshtrohet ligjit që është më efektiv dhe më i fortë.”<sup>433</sup>

Sipas Malik bin Nebiut, efikasiteti kufizohet në vështrimin, në karakterin e njeriut dhe në kuptimin tone ndaj tij. Ky vështrim “përfaqëson dy ekuilibra: njëri përfaqëson thelbin e asaj që njeriu është krijuar me perfeksion dhe tjetri përfaqëson qenien sociale të arrirë nga vetë shoqëria. Qartë duket se ekuilibri i fundit është ai që e përcakton efikasitetin e njeriut. Në të gjitha etapat historike, njeriu nuk mund të ndryshojë asgjë (fizikisht), por ajo që ndryshon nga njëra fazë në tjetrën është efikasiteti dhe aktiviteti i tij. Kjo na jep një trajtë të re të problemit të tij dhe na bën të pyesim: cilat janë rrethanat që i mundësojnë shoqërisë të krijojë te individit vlera të cilat i stimulojnë efikasitetin?”<sup>434</sup>

Megjithatë, Malik bin Nebi, duke u përpjekur t’i përgjigjet kësaj pyetjeje, e reformoi problematikën dhe sqaroi se shumica e reformave që kanë ndodhur përgjatë historisë, në fillim

<sup>432</sup> Malik Ibn Nebij, *Mushkilet’ul-efkari fi ‘l-alem’il-islamijj*, e përkthyer në gjuhën arabe nga: Bessam Berekeh dhe Ahmed Sha’bu, me redaktim të: Omer Meskavi, Bejrut dhe Damask: Dar’ul-Fikr’il-Muasir dhe Dar’ul-Fikr, 2002, fq. 102

<sup>433</sup> Po aty, fq. 105

<sup>434</sup> Malik Ibn Nebi, *Teemmulat*, Damask, Dar’ul-Fikr, 2002, fq. 135

kanë përjetuar stagnim dhe regres në shoqëri. Në këto rrethana individ i përjetoi një lloj stabiliteti dhe nuk mërzhitej sepse shihte diçka që e shtynte drejt ndryshimit të situatave që e rrethonin, sepse punët rridhnin pa pasur ai asnjë ndikim në to. “Kështu historia bëhet një vërshim i cili çon atje ku askush s’e di dhe lëviz tërësisht pa kontroll.” Në raste të caktuara nga historia e disa popujve ndodh pak më ndryshe, ku në esencë shoqëria kaplohet nga frika dhe ndjenja e rrezikut, “pavarësisht nëse ky rrezik është real apo vetëm ide që qarkullon nëpër mendje,” dhe kështu shfaqet nevoja për “shpëtim” e cila sundohet nga mërzia dhe tundet nga ndjenja e shpëtimit. Në këtë mënyrë, shoqëritë e tilla vendosin disa qëllime dhe disa barriera që duhet kaluar. Në të gjitha këto raste del individ i cili e drejton shoqërinë. Maliku thotë: “Kështu nis individ i cili para kësaj ishte i ngujuar nga stagnimi, nis sepse befas ndjen një shpërthim vetjak dhe shpirtëror i cili i çliron forcat e mbyllura brenda stagnimit, pastaj kështu e ndryshon rrjedhën e historisë. Këto janë kushtet psiko-sociale të cilat i lëvizin shoqëritë dhe i detyrojnë individët të përshtaten me ligjin e kësaj lëvizjeje, kuptohet për shkak të aftësive të fituara të cilat e formojnë atë që ne e quajmë ekuilibër shoqëror, gjegjësisht ekuilibrin i cili e përcakton efikasitetin e tyre para problemeve që u japin vlerë në shoqëri dhe në histori.”<sup>435</sup>

Kur flet Malik bin Nebiu për përplasjen ideologjike në botën islame, spikat faktin se shumë muslimanë të kulturuar provokonin me gjëra të reja dhe magjepsnin me logjikën e efikasitetit, por nuk i kushtonin kujdes faktit nëse këto përputheshin me normat e shoqërisë që kërkon të reformohet pa e humbur identitetin e vet. Të këtillët u dhanë pas imitimit të të tjerëve pa pasur asnjë koncept për shpikjen e këtij tjetrit, madje as për faktorët e shpikjes, për kostot e tij në të gjitha sferat që i imitonin. Ndoshta më mirë për ata do të ishte ta kishin zbuluar vetveten përmes faktorëve të tyre të veçantë, sesa t’i imitojnë ashtu verbërisht. Duhet spikatur faktin se ky imitim nuk është ai imitimi efektiv i çdo shoqërie dinamike,

<sup>435</sup> Po aty, fq. 135-138

siç vepruan për shembull japonezët, por fjala këtu ishte për imitimin i cili funksiononte brenda një kallëpi filozofik apriori kishte logjikë armiqësore ndaj Islamit... Bota e kulturuar në shtetet islame ishte arena ku duhej ngadhënjyer në luftën që e impononte nisma influencuese (perëndimore). Ideologjia islame, për t'u bërë ballë të gjitha ideve ndikuese (efektive) të shoqërive lëvizëse në shekullin XX, i duhet ta rikthejë efikasitetin e vet të veçantë, apo ta rimarrë përsëri vendin e vet në mesin e ideve që prodhojnë historinë."<sup>436</sup>

#### 4. Realiteti i trajtimit intencionalist të veprimtarisë edukative

Shumica e studimeve që flasin për aktivizimin e intencave në sferën pedagogjike kanë dhënë shumë kontribut në paraqitjen e kuptimit dhe të rëndësisë së intencave për shkencat sheriatike dhe për domosdoshmërinë e tyre tek fekihi dhe muxtëhidi, d.m.th. fokusi kryesor ka qenë te intencat e dispozitave sheriatike rreth adhurimeve dhe marrëdhënieve (familjare). Këtë pastaj e ndoqi biseda për rëndësinë dhe domosdoshmërinë e disiplinës së intencave. Në fund u bë fjalë edhe për aktivizimin e intencave në aktivitetin edukativ dhe në mënyrat e propozuara për ta siguruar këtë disiplinë.<sup>437</sup>

Kur studiuesi e përkufizon termin "aktivizim" të intencave të sheriatit brenda metodave studimore duke thënë: "Ky aktivizim përfshin mënyrën e shpërndarjes së këtyre intencave në metodat e ndryshme të lëndëve studimore në periudhën themelore dhe të mesme, duke vënë ato në korniza të lëndëve të ndryshme studimore dhe duke zgjedhur intencën e përshtatshme për çdo lëndë."<sup>438</sup> atëherë studiuesi ka për qëllim mësimin e lëndëve fetare dhe mënyrën e shpërndarjes së temave të intencave brenda tyre.

<sup>436</sup> Malik ibn Nebij, *Mushkilet'ul-efkari fi'l-alem'il-islamijj*, vep. e cit., fq. 109-110

<sup>437</sup> Shih, fq.sh.:

- Muhamed Buluz, *Mekasid'ush-sheriatu ve ahdafiha ve keffijjeti tef'ilaha fi'l-menahixh'id-dirasijeh*, Mexhelletu usuli 'd-dini, El-Xhamiatu 'l-Esmerijjetu 'l-Islamijeh, Libi, numër (2), 2017, fq. 168-246

<sup>438</sup> Muhamed Buluz, *Mekasid'ush-sheriatu ve ahdafiha ve keffijjeti tef'ilaha fi'l-menahixh'id-dirasijeh*, vep. e cit., fq. 180

Rëndësia e bisedës për aktivizimin e intencave edukative vjen nga spikatja jonë e mangësive në konceptin e përhapur për aktivizimin në disa shkrime bashkëkohore. Vetëdija e interesimit modern për tematikën e intencave dhe tërheqja e vëmendjes ndaj tyre duke i cilësuar si çështje të reformimit në studimin e disiplinave fetare, ndolli thirrjen për mësimin e këtij lëmi dhe ofrimin e tij në nivele të ndryshme brenda etapave të arsimit të përgjithshëm dhe universitar. Ky tip aktivizimi (i intencave) nuk e kalon kufirin e të qenit vetëm një lëndë studimore e re që u bashkëngjitet lëndëve të tjera. Me këtë nuk u ulim rëndësinë e këtij koncepti dhe domosdoshmërinë e forcimit të tij në metodat arsimore, megjithatë, në fund të fundit, ai mbetet problem arsimor i kufizuar në intenca, të cilat cilësohen vetëm si objekt studimi. Koncepti i “aktivizimit” rrallëherë mbërrin në një nivel më të lartë, gjegjësisht në thirrjen për të kaluar nga mësimi i temave të ndryshme të shkencave fetare, veçanërisht dispozitave fikho-re në sferën e adhurimeve dhe marrëdhënieve (familjare), në sferën e mësimin të këtyre dispozitave fikho-re bashkë me sqarimin e intencave të tyre, me urtësitë, motivet dhe shkaqet që i rrethojnë ato intenca. Sigurisht, ky koncepti i dytë gëzon shquarsinë dhe domosdoshmërinë e vet, pra ai u qaset intencave duke i cilësuar ato si një metodë (e veçantë) në procesin arsimor.

A mund të hedhin një hap tjetër në konceptin e “aktivizimit të intencave edukative dhe arsimore”, duke i vështruar intencat, synimet apo objektivat edukative si të ndërlidhura drejtpërdrejt me personalitetin e njeriut që e synojmë në veprimtarinë edukative, në disiplinat që mund t'i fitojë ky njeri dhe në imazhin ku shfaqen sjelljet e këtij njeriu në realitetin praktik, në jetën shoqërore dhe në situatën kulturore të shoqërisë për të cilën i aktivizojmë intencat edukative?

Intencat edukative për të cilat bëjmë fjalë janë intencat kur'anore që ndërlidhen drejtpërdrejt me çështjet edukative të cilat kërkojnë një gjykim. Gjykimi këtu nuk kufizohet te dhënia e fetvasë, pra duhet apo nuk duhet të veprohet për një çështje të caktuar edukative, por këtu synohet vënia e lidhsh-

mërisë mes intencave kur'anore dhe vetë procesit edukativ në shoqëritë tona islame, dhe atë në të gjitha shtyllat e këtij procesi edukativ, bashkë me filozofinë, sistemet, programet dhe metodat edukative, me atë që quhet edukim në fazat e ndryshme administrative dhe me krejt atë që reflektojnë te njeriu këto institucione edukative. Aktivizimi i intencave edukative fillon me formimin e vizionit edukativ-reformues, i cili do ta aktivizojë rëndësinë e edukimit në reformimin, ndryshimin dhe në renesancën kulturore të shoqërisë. E kush mund t'i japë formë këtij vizioni përveç fekihut dhe pedagogut intencialist?!

## 5. Vlerësimi i intencave pedagogjike

Fjala vlerësim (takvim) këtu ka disa kuptime, pra ndryshon në varësi të kontekstit. Ajo që na intereson neve me *fjalën vlerësim* (ndreqje) edukativ janë kuptimet që lidhen me disa procese të rëndësishme në veprimtarinë edukative. Pra, drejtimi i të shtrembëruarës nënkupton ndreqjen e saj, drejtimi i një gjëje nënkupton njohjen e vlerës së saj; drejtimi i programit nënkupton mësimin e rezultateve të atij programi; ndreqje e moralit nënkupton përmirësimin dhe rregullimin e tij; ndreqje e gabimit nënkupton përmirësimin e tij; rregullimi i punës së punëtorëve do të thotë të vlerësohen aftësitë e tyre në vazhdimësi, të shpërblehen me drejtësi dhe t'u përmbushen nevojat e trajtimit dhe të zhvillimit (profesional) etj. Kjo do të thotë se nevojiten një sërë sqarimesh për një situatë të caktuar, ku pastaj në dritën e tyre merret vendim i mëtutjeshëm për atë problematikë.

Procesi edukativ ka disa intenca dhe objektiva që kërkon t'i realizojë, kurse drejtimi apo ndreqja është shtylla themelore e këtij procesi, e cila ka për detyrë të zbulojë nivelin e realizimit të këtyre intencave dhe objektivave. Për ndreqjen e arsimit nevojiten tre procese të rëndësishme: mbledhja e informacioneve për rezultatin e arsimit, bashkë me treguesin e nivelit të realizimit të objektivave të vëna paraprakisht, pastaj nxjerrja e një gjykimi ndaj këtij rezultati dhe, në fund,

marrja e një vendimi të përshtatshëm për vepruar në dritën e këtij gjykimi.

### 5.1. Saktësia dhe efikasiteti i ideve

Vlera e ideve pedagogjike fshihet në saktësinë dhe efikasitetin e tyre paralelisht. Për ta konstatuar saktësinë dhe efikasitetin ekzistojnë disa standarde. Përgjatë historisë, mendimi metodologjik ka njohur një rregull të përgjithshëm për saktësimin, konstatimin dhe argumentimin e gjërave, e cila thotë: “Nëse je transmetues, atëherë të duhet saktësia, e nëse je pretendues atëherë argumenti.”, apo e thënë ndryshe nga Ibn Tejmija: “Disa është, ose transmetim i saktësuar, ose dije e provuar.”<sup>439</sup> Ky rregull i përgjithshëm mbështetet në tekstet e qarta të Kur’anit fisnik, të cilat janë të sakta në transmetim dhe argument për çdo pretendim. Historia islame, bazuar në tekstet e shenjta, ka themeluar shkencat tradicionale, racionale dhe praktike. Kjo histori, përmes transmetimit, nxori në shesh të palarat e shpikësve, gënjeshtarëve, trilluesve, të dobëtëve dhe të tjerëve. Kështu, historia zbuloi se për ngjarjet dhe ndodhitë duhet mbështetur dhe gjykuar sipas transmetimeve, fjalët duhet peshuar me prova dhe argumente logjike, kurse mjekësia duhet mësuar nga eksperiencia të provuara dhe me mjete praktike. Gjithashtu, në astronomi u zbuluan qendra vrojtuese, regjistra të vështrimeve dhe matjeve astronomike. Kështu ndodhi në çdo disiplinë shkencore.

Sot ne mund të kuptojmë shumë elemente dhe metoda të hulumtimit praktik në botën bashkëkohore nën dritën e këtij rregulli. Megjithatë, më shumë se çdoherë ndiejmë se idetë e hedhura në qarkullim jo domosdoshmërisht janë të sakta, veçanërisht pasi rrjetet sociale moderne keqpërdoren shumë, pra publikojnë dhe shpërndajnë anekënd botës pa e menduar apo konfirmuar saktësinë e publikimit, d.m.th. mund të keqpërdoret emri i një dietari për të publikuar mendime jo të

<sup>439</sup> Tekijjuddin Ahmed bin Abdulhalim bin Abdusselam ibn Tejmije (vdiq 728 h.), *Mexh’muat’ul-fetava*, vepër që u botua nën kujdesin: Amir El-Xhezzarit dhe të Enver El-Bazit, *Mensure, Dar’ul-vefai*, vëllimi XIII, (Kitabu mukaddimet’ut-tefsiri), (1426 h./2005), fq. 185



sakta, me të vetmin qëllim që të ngrihet ai që nuk meriton dhe të nëpërkëmbet autoriteti i atij që meriton lëvdatë.

Gënjeshtra, shpifja, hilja dhe shtrembërimi janë çështje të cila historia i ka njohur vazhdimisht. Kur'ani na ka shënuar disa shembuj të këtyre ligësive. Po ashtu, edhe historia e hulumtimit shkencore në epokën moderne, madje edhe sot, dëshmon shumë praktika të këtilla. Disa mendime dhe teori të njohura dhe të përhapura në shkencat bihevioeriste dhe sociale kanë qenë të ngritura mbi rezultate studimore që më vonë ka rezultuar si të falsifikuara dhe pa pasur asnjë lidhje me realitetin. Në artikullin e Malcolm Ashmore, në enciklopedinë "Tarikh'ul-bahthi fi'l-ulum'il-ixhtimaijeh", shkrimtari potencon se ka shumë rezultate të falsifikuara në hulumtimet e shkencave natyrore dhe në shkencat sociale, edhe pse në këtë të fundit më pak. Për praninë më të vogël të falsifikimeve, ai thotë se zbulimi i falsifikimeve në këtë sferë është më i vështirë."<sup>440</sup>

Do të na mjaftojë vetëm një mendim i tillë mbi të cilin u sollën shumë konstatime edukative në botë, pra fjala është për ide që kanë të bëjnë me një problem të rëndësishëm të psikologjisë dhe që gëzoi popullaritet të gjerë. Bazuar në hulumtime dhe studime praktike në psikologji, të zhvilluara nga psikologu britanik, Cyril Burt (1883-1971), për lidhshmërinë e inteligjencës njerëzore me trashëgiminë, më konkretisht në vitet e pesëdhjeta dhe gjashtëdhjeta të shekullit XX, ku më vonë sqaroi se rezultatet e këtyre hulumtimeve nuk ishin gjë tjetër veçse trillim, mashtrim dhe lojë me informatat, vetëm për të arsyetuar idetë raciste, kurse disa nga studimet praktike të pretenduara nga Burt nuk ekzistonin fare në realitet.<sup>441</sup>

Organizata Britanike e Psikologjisë i pranon akuzat drejtura Burtit, pavarësisht se disa studiues u përpoqën ta mbrojnë atë, megjithatë, edhe ata nuk e mohuan trillimin e të dhënave. Kështu Cyril Burt përmendet dhe cilësohet si studiues

<sup>440</sup> Ashmore, Malcolm. "Farud in Research", *The Sage Encyclopedia Social Science Research Methods*, edited by Michael S. Lewis-Beck and others, London: Sage Publication, 2004, fq. 403-404

<sup>441</sup> Bardford, Lisa. "Fraudulent and Misleading Data by Lisa Bradford", in: *The sage Encyclopedia of Educational Research measurement and Evaluation*, Edited by Bruce Frey, Teller Road: SAGE Publications Inc., fq. 708-712

mashtrues.<sup>442</sup> Është për t'u habitur se ajo që quhet *afëra e Burtit* ende vazhdon të jetë temë debati, pro dhe kundër, mes studiuesve profesionistë në psikologji, në filozofinë e shkencave, në histori, në etikë dhe në metodologjinë e hulumtimit shkencor. Përgjatë ndjekjes së një pjese të këtij debati në qarqet akademike kemi spikatur disa çështje, të cilat pohojnë rëndësinë e konstatimit të saktësisë dhe të vërtetësisë së këtyre mendimeve. Prej çështjeve që shpalosi debati për *afërën e Burtit* janë:

Disa mbrojtës të Burtit theksuan se problemet që u zbuluan në veprat e tij janë çështjet ku ranë ata që e akuzuan (me trillim).

Ata që u përpoqën ta mbrojnë dhe ta nxjerrin atë të pastër, kuptuan nga studimi analitik dhe i hollësishëm i prurjes së tij shkencore, nga jeta personale dhe nga paragjykimet e tij sociale se ai vërtet meriton të degradohet.

Faktorët e disa studiuesve që e akuzuan atë (Burtin) për hile dhe trillim nxitën dhe shtuan dyshimin edhe në disa metoda të tij shkencore.

I pamundur është që të shpërfilllet ndikimi i paragjykimëve personale të hulumtuesit.

- Ekzistojnë një sërë gjërash që e vënë në mëdyshje besnikërinë shkencore të tij, ndikimi i të cilave në asnjë mënyrë nuk mohohet edhe në rezultatet e studimit. Në hulumtimet e Burtit shihet edhe ajo që quhet ndikimi i Hawthornit, pra se rezultatet e hulumtimit do të anojnë në drejtimin që studimi kërkon të zbulojë ndikimin e vet, sepse pjesëmarrësit në hulumtim ndjejnë se janë bërë disa ndryshime në proceset e ambientit (hulumtues), me qëllim të arritjes në rezultate të caktuara.<sup>443</sup>

<sup>442</sup> Ridgway, Jim. Cyril, & Lodovic Burt. *The Routledge Encyclopedia of Educational Thinkers*, Joy A. Palmer Cooper, (Ed.) London and New York: Routledge Taylor & Francis Group. First published 2016, fq. 265-269.

<sup>443</sup> Një studiues u përpoq të analizojë momente të dy anëve të afërës së Burtit, dhe atë duke u zhytur në shkrimet që u përpoqën ta mbrojnë atë, prandaj iu kthye dy veprave: e para është vepra e një shkrimtari i cili u përpoq të studiojë çdo hollësi të afërës përmes studimit të jetës së Cyril Burtit, prandaj pati kaluar pesë vite për shkrimin e jetës së Burtit dhe ishte përpjekur të nxjerr të pastër nga çdo hile dhe trillim të u përshkruhet studimeve të tij. Megjithatë, ai u befusua kur kuptoi se krejt ajo për të cilën akuzohej Burti ishte e vërtetë. Ndërsa libri tjetër mori përsipër të zbulojë mangësitë e gjithë atyre që e akuzonin Burtin, por edhe ky nuk

A nuk nënkupton kjo se tymi është i përzier me zjarr përgjatë gjithë kësaj problematike?! Sigurisht kjo kërkon vërtetim dhe meditim më të theksuar.

Sa i përket zbulimit të efikasitetit dhe të ndikimit të mendimeve, ajo që na intereson neve është mendimi edukativ (pedagogjik) islam që e ofrojnë institucionet e edukimit dhe të arsimit, i cili duhet të mishërohet te nxënësit, më saktësisht në mendimet, përjetimet, fjalët dhe veprat e tyre. Po ashtu, i njëjti të shfaqet në realitetin e shoqërisë islame, në kulturën e tij të përgjithshme shpirtërore dhe materiale.

Shkalla e përvetësimit të këtyre mendimeve, realizimi i intencave edukative në nivelet e ndryshme të arsimit, arritja e objektivave të përgjithshme në nivelet e ndryshme administrative, në nivelet shkencore, në etapat e ndryshme studimore, në nivelin e nevojës së shoqërisë për këto institucione arsimore dhe në shumë segmente të ndryshme, krejt këto pastaj janë temë e një dege të veçantë të edukimit (pedagogjisë), pra të ndreqjes edukative (et-takvim 'ut-terbevij), ku mund t'u referohemi burimeve profesionale.

## 5.2. Përmirësimi edukativ i situatës rrjedhëse

Hierarkia e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në shumë vende arabe dhe islame ka administratë të veçantë për çështjet e përmirësimit edukativ, e cila kryesisht quhet administratë (drejtori apo sektor) i inspektimeve të përgjithshme. Në disa vende ekziston edhe një qendër specifike për përmirësimin edukativ e cila merret me çështje të hulumtimit dhe të trajnimit në fushën e përmirësimit edukativ. Megjithatë, ajo që bëjnë më shumë këto administrata është vlerësim dhe jo përmirësim. Literatura edukative e përcakton kuptimin e përmirësimit, duke e rregulluar një situatë të caktuar pasi të jetë mësuar reformimi për të cilin ka nevojë. Nevojën e zbulojmë përmes vlerësimit, dhe atë duke përdorur mjetet e ndryshme vlerësuese. Realisht, kontribut i çmuar jepet për

mohoi se disa procedurave të Burtit përgjatë studimit u mungonte kujdesi i duhur dhe se disa probleme që i përshkruhen atij janë të zakonshme në studimet e të tjerëve. Shih më hollësisht: Hattie, John. "The Burt Controversy: An essay review of Harnshaw's and Joynson's Biographies and Sir Cyril Burt", *Alberta Journal of Educational Research*, 37 (3), fq. 259-275.

përgatitjen shkencore dhe artistike të testeve dhe provimeve sipas asaj që ofrojnë institucionet nga eksperiencia vendore dhe ndërkombëtare, megjithatë kontributi më i madh derdhet në administrimin e testimit, në ruajtjen e pyetjeve që të mos mësohen paraprakisht, në pengimin e mashtrimit në sallat e provimit dhe në sfera të tjera të ngjashme. Mund të themi se pjesa më e madhe e këtij angazhimi vjen si rezultat i mosbesimit dhe shkeljes hipotetike të amanetit nga ana e njeriut.

Sesionet e provimeve të përgjithshme, në shumicën e shoqërive tona, konsiderohen si sezone dhe rrethana të jashtëzakonshme, dhe atë si rezultat i stresit që kalojnë studentët, i krizave që përjetojnë familjet e tyre, i rrezikut që mund ta prekë reputacionin e mbarë shoqërisë dhe si rezultat i vendimeve të rëndësishme që dalin nga rezultatet e provimeve për vazhdimësinë e studimeve universitare.

Mjafton t'i theksojmë këtu vetëm disa vërejtje të cilat mbasse e përshkruajnë gjendjen aktuale të përmirësimit (vlerësimit) pedagogjik në vendet tona:

Përmirësimi edukativ (pedagogjik), në shumicën e rasteve nënkupton përmirësimin e nxënësit në lëndën që e ka mësuar, por pak rëndësi u kushtohet elementëve tjetër të rëndësishëm në procesin edukativ, ku e rëndësishme do të ishte përmirësimi i efikasitetit të mësuesit, të metodave dhe lëndëve arsimore, të ambientit arsimor, të administrimit arsimor, të filozofisë edukative dhe të tjerave.

Pjesa më e madhe e mjeteve dhe e mekanizmave të përmirësimit (arsimor) i takojnë aspektit sasior në mësimin e tematikave shkencore. Këto mekanizma mbështeten në standardin themelor, i cili është kriteri me të cilin vlerësohet niveli i këtij arsimit, ku niveli më i lartë i arsimit është 100, dhe pastaj shihet suksesi i nxënësit në raport me këtë vlerësim. Duke e ditur se ekzistojnë një sërë kriteresh tjera shumë të rëndësishme, si p.sh. kriteri i zhvillimit dhe i përmirësimit me të cilin vlerësohet njohja e nxënësit para procesit arsimor dhe pas tij, bile me këtë mund të mësohen fazat e nivelit të zhvillimit dhe përparimit nga njëra fazë të tjetrën. Në mesin e këtyre kriteve është edhe kriteri i mesatares standarde të grupit të

nxënësve, përmes së cilit matet mesatarja e njohjes dhe e zhvillimit të nxënësve para dhe pas procesit arsimor. Me këtë matet arsimimi i individit duke e krahasuar me grupin.

Shumica e metodave dhe e mjeteve të përmirësimit (të vlerësimit) e matin sasinë e informacioneve, por pak kujdesen për matjen e kohës së implementimit të vlerave, të drejtimeve dhe të virtyteve. Këto anashkalohen me faktin se synimet e këtilla edukative i lihen familjes t'i ndjekë, me faktin se matja e nivelit të realizimit të këtyre objektivave është e vështirë dhe me faktin se këto objektiva maten metoda kualitative (jo sasiore), kurse ne nuk i posedojmë këto mjete të përshtatshme për ta arritur këtë objektivë.

Ajo që tërheq vëmendjen në rezultatet e përmirësimit (vlerësimit) është përkushtimi për njohjen e gjërave që nuk i zotëron nxënësi. Padyshim kjo është e rëndësishme, veçanërisht për shkak të ndikimit që ato kanë në projektimin e pozitave arsimore trajtuese për nxënësit si individë. Megjithatë, ndoshta më e rëndësishme mund të jetë ajo të cilën nxënësi e zotëron mirë dhe e cila mund të jetë një nxitës i potencialeve dalluese të tij. Kjo metodë mund të ofrojë shanse për kreativitet. Kështu mbase mund të gjejmë shumë studentë të cilët janë kreativë, por secili në sferën e vet, prandaj investimi i këtyre kreativiteteve është shërbim dhe zhvillim për mbarë shoqërinë. Në jetën e Pejgamberit Muhammed a.s. gjejmë shumë raste të tilla arsimore të cilat përmbajnë zbulimin e aspekteve dalluese të disa individë nga sahabët, ku pastaj i bënte thirrje shoqërisë t'i vendosë ato në funksion të gjithëve.

### 5.3. Sistemi i kualitetit në arsim

Koncepti i "kualitetit" karakterizohet me perfeksionimin e punës sipas cilësimeve të caktuara. Ky koncept daton qysh në lashtësi, madje ka qenë i njohur edhe në kulturat e lashta dhe kanë folur për të fetë. Kualiteti një stimulues i rëndësishëm në konkurrencën tregtare dhe industriale, e cila pastaj mori formën e një filozofie dhe një administrate të veçantë në Japoni që nga viti 1962. Kjo u shtri në sferën e administratës,

industrisë dhe të ekonomisë. Pastaj ky koncept kaloi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në vitet e shtatëdhjeta, kurse në vitet e tetëdhjeta u përhap edhe në shtetet evropiane dhe në vendet tjera. Literatura pedagogjike në dekadat e fundit e ka njohur konceptin e “kualitetit të arsim”, dhe atë të huazuar nga bota e industrisë. Koncepti i “kualitetit” depërtoi në sferën e pedagogjisë në vendet perëndimore si rezultat i nevojës së zhvillimit arsimor në dritën e ndryshimeve globale në tregjet e punës, llojlojshmërinë e resurseve njerëzore që kërkojnë këto tregje, orientimet e globalizmit dhe të trysnia e forcave mbizotëruese.

Ekzistojnë disa probleme me të cilat ballafaqohet thirrja që kërkon mbështetje në sistemin e kualitetit. Zbatimi i saj kërkon shpenzime shumë të mëdha për sigurimin e ambientit të duhur dhe të përshtatshëm me kualitetin e modeleve globale, si p.sh.: resurset materiale dhe njerëzore, dhe proceset e përgatitjes dhe trajnimit, të cilat nuk mund t’i sigurojnë shumë shoqëri, madje luftojnë për të siguruar minimumin e tyre në arsimin fillor. Këto e bëjnë konceptin e kualitetit të duket si një luks të paarrtshëm. Për këtë arsye, kriteret e kualitetit kërkojnë ekzistimin e kulturës së kualitetit në rrafshin social të përgjithshëm, sepse kështu mund të kërkohet zhvillimi i kriterëve të kualitetit ndryshe nga kriteret që i kushtëzojnë institucionet shtetërore.

Megjithatë, eksperiencia edukative bashkëkohore në këtë sferë është njëri nga burimet e mendimit edukativ bashkëkohor, i cili mund të konsultohet, të përfitohet prej tij dhe nga ai të zhvillohen kriterë që trajtojnë dimensione sasiore dhe cilësore në dritën e një kulture të veçantë të kualitetit e cila mbështetet në parimin e perfeksionimit dhe të përkryerjes me sfondin e tij islam.

#### 5.4. Konceptet islame që karakterizojnë rregullimin apo perfeksionimin

Metodave të perfeksionimit në praktikat edukative u mungon vështrimi në disa koncepte islame të cilave nuk është kushtuar kujdesi i duhur. Prej koncepteve të tilla është koncepti i perfeksionimit “itkan”, i përmirësimit “ihšan” dhe

i vetëkritikës apo vetëllogarisë “muhasabah”. Edhe pse në literaturën moderne të perfeksionimit gjejmë disa thënie për konceptin e “Mësimin e përkryer”, përsëri ky koncept anon kah ana sasiore dhe kah kriteri i cili përkufizohet si kulm i caktuar. Apo, për shembull, një numër i caktuar i studentëve (80 %) të mësojnë një sasi të caktuar nga maksimumi për të arritur (80 %). Pavarësisht dobisë së këtij tipi të vlerësimit, ende vazhdon të mbetet vlerësim sasior, sepse vendos kufirin e maksimumit që mund të arrihet. Ndoshta, koncepti islam për këtë drejtim të vlerësimit drejton kah koncepti i “ihsanit” me tri kuptime:

Dallimi i nivelit të kuptimit ihsan (përmirësim) nga nivelet tjera, duke e krahasuar me kuptimin e Islamit dhe të imanit, siç është dhënë në hadithin vijues: “Ky është Xhebraili, ka ardhur t’ua mësojë fenë njerëzve.”<sup>444</sup> Ihsani është ndjesia e njeriut për praninë e vazhdueshme të Allahut të Lartësuar në zemër, ndjesi e cila e bën ta adhuron Allahun sikur ta shikonte. Nuk ka dyshim se ngritja e besimtarit në këtë gradë e nxit të përpiqet që të arrijë në stad më të lartë të punës dhe të angazhimit, pra kjo e nxit më shumë se çdo mbikëqyrje tjetër.

Kuptimi i përmirësimit të vazhdueshëm në realizim dhe angazhim. Përgjatë mësimin nxënësi vjen se çdoherë ekziston një nivel më i lartë nga ajo që ka arritur çdo studiues, pra e di se ﴿وَفَوْقَ كُلِّ ذِي عِلْمٍ عَلِيمٌ﴾ “*mbi çdo të zot të dije ka një dijetar*” (Jusuf: 76], prandaj vazhdimisht lutet me lutjen që ka urdhëruar Allahu xh.sh.: ﴿قُلْ رَبِّ زِدْنِي عِلْمًا﴾ “**Thuaj: o Zot, ma shto mua diturinë!**” [Taha: 114]. Pas pajisjes me besim dhe me tekstet fetare në mendje dhe në ndërgjegje, kjo përfaqëson një shtesë tipologjike për çdo faktor tjetër të arsimimit. Pra, kërkimi i shtimit në dije është një vijë e cila nuk ka përfundim, por me të shkon paralelisht edhe procesi i zhvillimit, i ngritjes dhe i perfeksionimit.

Kuptimi i kreativitetit, i zbulimit dhe i shpikjes. Në rrugën e vazhdueshme të cilën e theksuam më herët, ka disa ndalesa përgjatë rrugës, të cilat kërkojnë ndonjëherë kërkohen nga

<sup>444</sup> El-Buhari, *Sahih’ul-Buhari*, Libri: besimi, Kapitulli: “Pyetja e Xhibrilil drejtuar Pejgamberit a.s. për imanin, Islamin, ihsanin dhe për dijen e kiametit”, hadithi numër 50, fq. 51

individit dhe ndonjëherë nga shoqëria. Pra, ekzistojnë probleme që kërkojnë zgjidhje, por ekzistojnë edhe pyetje të mërzitshme që kërkojnë përgjigje të cilat do ta heqin qafe atë bezdi. Nga ana tjetër, ekzistojnë edhe barriera që e pengojnë zhvillimin. Kontributi i kërkuar në këto situata fokusohet dhe kërkon nga individit përvjelje, thellim dhe përkushtim për të sfiduar situatën. Po ashtu, kërkon edhe nga shoqëria që të vendosë linjat e duhura për të mobilizuar aftësitë, për t'i zhvilluar ato dhe për të përgatitur një ambient shpirtëror dhe fizik më të përshtatshëm, i cili do t'i mundësojë hulumtuesit individual apo kolektiv që t'i qaset thelbit të problemit, dhe të vazhdojë të kërkojë zgjidhje derisa të zbulojë zgjidhjen e duhur apo mjetin e kërkuar. Në këto situata, besimtari ka parasysh shembujt udhëzues nga Kur'ani, si p.sh.: i dërguari i Allahut, Nuhi a.s., i cili e ndërtoi anijen larg detit, Jusufi a.s. i cili bëri projektin e shpëtimit ekonomik, Davudi a.s. i cili prodhoi parzmoret, Dhulkarnejni i cili u dallua në inxhinierinë e ndërtimitarisë dhe të minierave dhe të tjerë.

Në fund, vetëllogaria është njëra nga metodat e edukimit dhe të arsimimit. Kultura islame e njuh termin “muhasebeh” vetëllogari, i cili nënkupton që njeriu për një kohë të caktuar të ndalojë për ta zhvilluar veten për çdo ditë. E rishikon atë që ka vepruar dhe atë që nuk ka vepruar sot, duke u përpjekur t'i sjellë në kujtesë aspektet që i ndihmuan dhe që e penguan në këtë angazhim. Gjithashtu, i gjurmon edhe faktorët e përmirësimit, të cilat i shton, kurse shkaqet e përkeqësimit i pakëson. Shumica e literaturës së vetëllogarisë përkujtojnë momente nga skena e llogarisë në Botën Tjetër, pra njeriu e llogarit vetveten duke u përgatitur për atë ditë. Megjithatë, llogaria e atëhershme do të jetë për punët e dynjasë. Më herët e mësuam se qëllimi i krijimit të njeriut në këtë botë është adhurimi, ndërtimi i jetës së kësaj bote dhe se të gjitha veprat e njeriut mund futen brenda konceptit të “adhurimit”, kuptohet nëse kanë qëllim të mirë dhe bëhen siç duhet.



## Përfundimi

Vlera e mendimit edukativ islam nuk kufizohet vetëm në gjendjen në të cilën është shoqëria islame, por shtrihet dhe përfshin edhe përmasën kulturore-humane të këtij mendimi, përmasë të cilën e kërkon çdo shoqëri e botës në çdo kohë. Megjithatë, shoqëria islame nuk do të mund t'ua paraqesë këtë mendim të tjerëve përderisa ajo është duke e humbur vlerën e këtij mendimi. Vlera nuk nënkupton saktësinë, por vlefshmërinë për çdo kohë, çdo vend dhe çdo situatë. Po ashtu, si vlerë e këtij mendimi shihet edhe efekti dhe efikasiteti i tij në shoqërinë islame. Ky efikasitet është gjuha e ligjërrimit ndaj të tjerëve, kurse atij që i mungon kultura nuk mund ta japë këtë rezultat.

Efikasiteti i mendimit pedagogjik islam fshihet në shpirtin që përhapet në jetën dhe praktikën e shoqërisë islame, pikërisht ajo frymë e cila dijen dhe vlerat islame i kthen në dritë që e ndriçon botën bashkëkohore, të cilën e shikon kështu:

Vlerat islame i shikon si realitet aktiv në jetën e njerëzve në shoqëri.

Shtyllat e besimit të muslimanët si përgjigje ndaj pyetjeve përfundimtare që e kanë preokupuar mendimin e njeriut.

Imazhet e qytetërimit në realitetin e shoqërisë islame, të cilat i përfshijnë kërkesat e jetesës kuptimore, lirinë, drejtësinë dhe krenarisë, bashkë me kërkesat e jetesës materiale, lehtësimet dhe dobitë.

Problemet më të dukshme të arsimit fetar përfaqësohen në faktin se shumica e veprimtarisë arsimore-fetare rrjedh nga trashëgimia e saj e kaluar e cila transmetohet nga një vend në tjetrin pa u përshtatur me rrethanat e vendit të ri. Kështu që, nuk gjejmë praktikues më ndryshe nga ajo që është e shkruar dhe që e kanë provuar në jetë, prandaj jeta e tyre arsimore cilësohet si shumë konservatore, imituese dhe rezistuese ndaj reformimit.

Shumësia e aspekteve të stagnimit në realitetin e muslimanëve sot konfirmon se ata e kanë humbur bereqetin e lidhjes së fuqishme mes dispozitave sheriatike dhe intencave të tyre.

Muslimanët, ose i nxorën nga funksioni këto dispozita, ose i zbatuan dispozitat pa i marrë në konsideratë intencat e tyre. Në të dyja rastet, ata i kanë humbur intencat dhe dobitë që mund t'u sillnin ato dispozita. Kështu e mbushën jetën me veprime të gabuara të cilat mund t'i hiqnin qafe.

Në tekstet dhe instruksionet e asnjë feje apo kulture nuk gjejmë t'i jepet kaq rëndësi pastërtisë së njeriut: trupit, teshave, vendit, shtëpisë, rrugëve dhe të tjera, siç i japin tekstet dhe instruksionet islame, bile edhe jomuslimani kur i lexon këto tekste dhe udhëzime, pret që kur ta vizitojë një qytet (me muslimanë) të shohë aty pastërti, elegancë, estetike dhe bukuri mahnitëse. Pra, kur i shikon këto, atëherë kupton se ka hyrë në një qytet me muslimanë.

Atëherë, ç'do të thotë që mbeturinat të gjenden nëpër udhët dhe lagjet e shumë qyteteve arabe dhe islame, nga ku përhapen erëra të këqija, edhe pse punëtorët e pastrimit janë me shumicë?!

Në fund, sigurisht se programet e arsimit, në tematika dhe në faza, i përmbajnë këto tekste, madje shumica e njerëzve i kanë nxënë përmendësh ato. Pra, a nuk do të thotë kjo se një sërë problemesh të mëdha i karakterizojnë mënyrat dhe metodat tona të qasjes ndaj intencave të edukimit?!

## **KAPITULLI I PESTË**

### **TEMATIKAT E MENDIMIT EDUKATIV**

*Hyrje*

*Pjesa e parë: dialogu rreth mendimit dhe shkencës në tematikat edukative*

*Pjesa e dytë: skema e tematikave të përmbajtjes edukative*

E para: temat e ndërtimit të umetit

E dyta: temat e problemeve të ngritura

E treta: temat e pajisjes ideologjike të vizionit të përgjithshëm

E katërta: shkencat metodologjike

*Pjesa e tretë: disiplinat dhe tematikat e edukimit (pedagogjisë) në vështrimin islam*

E para: synimi me degëzimin shkencor

E dyta: themelimi i degëve të pedagogjisë

E treta: teoria pedagogjike dhe filozofia pedagogjike

E katërta: pozita e Islamit në disiplinat pedagogjike

*Pjesa e katërt: vlerat në disiplinat pedagogjike*

E para: domosdoshmëria e përkushtimit ndaj pozitës së vlerave në disiplinat pedagogjike

E dyta: supozimet e përkushtimit ndaj vlerave në disiplinat pedagogjike

E treta: mësimi i vlerave nëpër universitete

E katërta: edukimi me vlera

*Përfundimi*

# **KAPITULLI I PESTË:** TEMATIKAT E MENDIMIT BASHKËKOHOR PEDAGOGJIK



## Hyrje

Pothuaj të gjithë studiuesit e pedagogjisë janë dakorduar se shtyllat e veprimtarisë pedagogjike (elementët apo komponentët) janë katër: mësuesi, nxënësi, dija (programi pedagogjik) dhe mjediset edukative (institucionet si familja, shkolla, shoqëria...). Gjithashtu, shumica e tyre dakordohen se elementët e programit pedagogjik janë katër: qëllimet, përmbajtja, aktivitetet arsimore dhe vlerësimi. Programi pedagogjik ka zënë një vend të rëndësishëm në disiplinat pedagogjike derisa u bë disiplinë e veçantë shkencore e cila u quajt metodikë, në të cilën u shfaqën shumë libra, dhe atë në gjuhë të ndryshme. Librat e kësaj discipline u botuan me tituj të ndryshëm, ku disa reflektuan në titujt dhe emërtimet e programeve studimore universitare, apo e kundërta, si p.sh.: përpilimi i programit, bazat e programit, zhvillimi i programit, sistemet e programit, programi pedagogjik: bazat, komponentët, praktikat pedagogjike etj.

Në Kapitullin e mëparshëm folëm për intencat e edukimit, apo për atë që njihet si qëllimet e edukimit, bashkë me nivelet e ndryshme të tyre, të cilat cilësohen si *komponenti i parë* i programit pedagogjik. Folëm kalimthi për elementin e mjeteve pedagogjike, për aktivitetet arsimore dhe për vlerësimin pedagogjik me pretekstin e lidhjes së tyre të drejtpërdrejtë me intencat. Në këtë krye të pestë do të flasim për tematikat e mendimit pedagogjik, e që është *komponenti i dytë* i programit pedagogjik, duke e lidhur me kuptimin më të përhapur të programit dhe të përmbajtjes së programit pedagogjik bashkë me trajtimin që e shohim më të përshtatshëm me këtë.

Koncepti i “programit pedagogjik” përfshin disa kuptime. Pastaj koncepti u zhvillua paralelisht me mendimin pedagogjik dhe u sot kuptimi më i përhapur për këtë është: “Tërësia e eksperiencave nëpër të cilat kalon nxënësi brenda një plani të caktuar të cilin institucionet publike arsimore përkohë të zbatojnë.” Përkufizimi i programit (pedagogjik) me kuptimin

e eksperiencave pedagogjike nënkupton paraqitjen e anën aktive dhe gjallëruese të nxënësit në procesin arsimor. Ai nuk është thjesht genie njerëzore tek i cili hidhet dituri, të cilën e merr dhe e nxë në formë negative, por arsimi, në njërin nga kuptimet e tij, është interaktivitet mes nxënësit dhe ambientit arsimor i cili përgatitet për këtë qëllim. Pra, interaktiviteti përfshin pjesëmarrje të vetëdijshme dhe ndikim të ndërsjellë. Përderisa ndikimi (nga dikush) nënkupton ndryshimet që ndodhin te nxënësi, atëherë ndikimi (te dikush) paraqitet në disa situata, si p.sh.: gjendja të cilën nxënësi ia jep lëndës mësimore, gjendja e mësuesit kur e përshtat qëndrimin arsimor në dritën e përgjigjeve të nxënësit.

Kur flasim për lidhjen e përvojës arsimore të cilën e fiton nxënësi me rolin e tij aktiv në procesin arsimor, atëherë duhet të pohojmë se tri shtyllat e para të procesit edukativ (mësuesi, nxënësi dhe programi) janë interaktive, kanë ndikim të ndërsjellë dhe nuk mund të paramendohen të ndara nga njëra-tjetra. Ky tip dhe kjo shkallë e interaktivitetit lidhet me shtyllën e katërt (të procesit pedagogjik, d.m.th. me ambientin arsimor, pra, ky ambient ndikon në kulmin ku mund të mbërrijë interaktiviteti. Ky ambient arsimor përbëhet nga elementët njerëzorë, lëndorë, shpirtërorë dhe socialë. Vendi i arsimit dhe përgatitjet materiale janë pjesë e ambientit. Mësuesi, formimi i tij shkencor, profesional dhe shpirtëror janë pjesë e ambientit. Numri dhe tipat e studentëve janë pjesë e ambientit arsimor. Kultura shoqërore rrjedhëse në mjedisin arsimor janë pjesë e ambientit (arsimor). Gjendja politike, ekonomike dhe mediatike e shoqërisë janë pjesë e ambientit (pedagogjik). Mënyra e bashkëveprimit të shoqërisë me pjesën tjetër të botës është pjesë e ambientit edukativ.

Përvojat arsimore janë disa lloje: përvoja e drejtpërdrejtë e cila nënkupton bashkëpunimin personal me gjërat, me ngjarjet dhe me rastet. Megjithatë, shanset e këtyre eksperiencave që jepen në ambientet e arsimit tradicional janë të pakta. Kryesisht këto shanse shfaqen në aktivitetet shkencore, sportive, kulturore apo shoqërore, të cilat realizohen në aktivitetet shkollore shtesë, si në laborator, teatër, stadin dhe në vende

të tjera. Shumica e përvojave arsimore-shkolllore janë përvoja jo të drejtpërdrejta, të cilat nxënësi i dëgjon nga mësuesi apo i lexon nëpër libra, por me raste mund t'i zhvillojë edhe nëpërmjet filmave dhe videove që shfaqin një ngjarje reale (të asaj problematike).

Përvojat kanë nivele të ndryshme abstraktimit mendor dhe logjik. Ato mund të jenë shqisore, të cilat burojnë nga bashkëveprimi i shqisave njerëzore si shikimi, dëgjimi dhe prekja, por mund të jenë edhe përvoja të thjeshta të cilat transmetohen përmes gjuhës apo shenjave shprehëse.

Meqë programi, bashkë me katër komponentët e tij (qëllimet, përmbajtja, aktivitetet dhe vlerësimi), përfshin përvojat arsimore të cila nxënësi i fiton nga procesi arsimor, atëherë ku shfaqet përmbajtja e kësaj eksperience?

Përmbajtja zakonisht shfaqet në lëndët arsimore nga të cilat përbëhet programi arsimor. Përmes këtyre lëndëve nxënësi fiton përvojë në gjuhë, në gjërat lëndore, në marrëdhëniet shoqërore dhe shumë përvoja tjera. Kjo përvojë përfaqet në formën e informacioneve, njohurive, shkathtësive mendore dhe shkencore, në drejtimet shpirtërore dhe emocionale. Në Kapitullin e kaluar e pamë se intencat dhe qëllimet e edukimit fitohen nga informacionet, shkathtësitë dhe orientimet. Neve na ka mbetur të spikatim një sërë tematikash të caktuara në sferën e informacioneve, shkathtësive apo drejtimeve. Atëherë, cilat janë këto tematika?

Kështu, objekt i këtij kapitulli janë tematikat apo lëndët arsimore të cilat janë mjet i realizimit të synimeve dhe intencave edukative.



## Pjesa e parë: Dialogu rreth mendimit dhe dijes në tematikat pedagogjike

E shohim të udhës të flasim për tematikat e mendimit pedagogjik islam në dy aspekte. Aspekti i parë i përfshin grupet e mendimit dhe, i dyti grupet e dijes (shkencës). Aspektin e parë e kemi përdorur në librin tonë “El-Binau el-fikriju” (Struktura ideologjike). Aty kemi folur për sferat e veçanta dhe përgjithshme mes idesë dhe dijes. Gjithçka që rezultojnë nga procesi të menduarit është mendim (ide), kurse gjithçka që mëson njeriu është dije. Megjithatë, sfondi kur’anor në të cilin përpiqemi të mbështetemi, madje edhe në krejt atë që shkruajmë, ka bërë dallim mes mendimit dhe dijes. Pra, fjala mendim në Kur’an është dhënë vetëm në trajtë foljore, dhe atë duke iu atribuar njeriut. Mendimi, meditimi apo të menduarit janë veprim njerëzor. Në anën tjetër, fjala dije është dhënë në trajtë të foljes dhe të emrit, e cila i atribuohet Allahut, melaqeve, pejgamberëve dhe njerëzve. Duke e mbështetur në këtë, themi se:

Dija e Allahut të Lartësuar është dije e gjerë e cila përfshin çdo gjë,<sup>445</sup> pra është dije gjithëpërfshirëse.<sup>446</sup> Një pjesë e dijes së Allahut është absolute, e veçantë për Atë dhe nuk e di askush tjetër pos Tij.<sup>447</sup> Megjithatë, një pjesë e dijes së Tij ai ua tregon pejgamberëve që t’ua predikojnë njerëzve.<sup>448</sup>

<sup>445</sup> “Vërtet, Zoti juaj është Allahu i Cili nuk ka zot tjetër pos Tij. Ka përfshirë çdo gjë me dijen e Tij.” [Taha: 98]

<sup>446</sup> “Allahu i Cili ka krijuar shtatë qiej dhe nga toka njësoj si ato. Në mesin e tyre zbret urdhri, që ju ta dini se Allahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë dhe se Allahu përfshin me dijen e Tij çdo gjë.” [Et-Talak: 12]

<sup>447</sup> “Ai i posedon çelësat e gajbit (të fshehtës) të cilat nuk i di askush pos Tij. Ai di çka në tokë dhe det. Nuk bie asnjë gjethe pa e ditur Ai, bile as një kokërr në errësirat e tokës, as e njomë dhe as e thatë, përveçse (të jetë e shënuar) në një libër të qartë.” [El-En’am: 59]

<sup>448</sup> “Ai është që e di të fshehtë, por fshehtësinë e vet nuk ia zbulon askujt. Me përjashtim të ndonjë të dërguari që Ai do. Atëbotë Ai vë roje para edhe prapa tij (kur i shpall fshehtësinë), Për ta ditur (për t’u dukur) se ata kanë kumtuar shpalljet e Zotit të tyre, dhe se Ai ka përfshi atë te ata, dhe Ai e di sasinë e çdo gjëje që ekziston.” [El-Xhinn, 26-27]

Dija e melaqeve është ajo të cilën Allahu ua ka mësuar atyre dhe vepronë me atë siç janë urdhëruar.<sup>449</sup>

Dija e Pejgamberëve është dija të cilën Allahu ua ka mësuar atyre për ta kumtuar mesazhin e Tij dhe për t'i udhëzuar njerëzit.

- Dijsa e njeriut është dijsa të cilën Allahu ua ka mësuar njerëzve qysh në kohën e babait të njerëzimit, Ademit a.s.<sup>450</sup> Pastaj u dërgoi atyre pejgamberë dhe të dërguar për t'ua mësuar rrugën e drejtë.<sup>451</sup> Allahu e pajisi njeriun me mjetet e fitimit të dijes, i kërkoi të bëjë përpjekje për t'u ngritur në dije<sup>452</sup> dhe i mundësoi që një pjesë të dijes t'ua mësojnë edhe disa tipave të kafshëve.<sup>453</sup>

Shohim se fjala “dije” në Kur'anin fisnik shtrihet në të gjitha këto lloje të theksuara më parë, mirëpo fjala “mendim” është e përqendruar vetëm te njeriu, të cilin Allahu e dalloi nga të gjitha krijesat tjera me aftësinë e të menduarit dhe të meditimit. Të menduarit në Kur'an është potencuar në 18 vende, me gjashtë trajta fjalësh: يَتَفَكَّرُونَ (mendojnë), تَتَفَكَّرُونَ (mendoni), وَيَتَفَكَّرُونَ (dhe mendoni), تَتَفَكَّرُوا (të mendoni), يَتَفَكَّرُوا (të mendojnë), فَكِّرْ (mendo!). Konteksti ku është dhënë fjala “mendo!”, pra një herë në krejt Kur'anin, është kontekst i shëmtuar për atë që e përdor mendjen për të mos mbërritur te objektivi i saktë, por për t'iu përkushtuar të keqes dhe të devijimit. Në të gjitha vendet tjera, folja “mendoj” ka ardhur me kuptim të përsëritjes së veprës për të kërkuar qëllimin fisnik. Të gjitha përmbajnë thirrjen hyjnore për të mbërritur te synimi i saktë përmes procesit të të menduarit.


<sup>449</sup> “Thanë: I Lartësuar je Ti. Nuk dije pos asaj që na e ke mësuar. Vërtet Tij je i Gjithëdijshmi, i Urti.” [El-Bekare: 32]

<sup>450</sup> “Dhe ia mësoi Ademit të gjitha emrat” [El-Bekare: 31]

<sup>451</sup> “U thamë: zbritni që aty të gjithë, sepse do t'ju vijë nga Unë udhëzim. Kush e ndjek udhëzimin Tim, nuk do të ketë frikë për ta dhe nuk do të pikëllohen.” [El-Bekare: 38]

<sup>452</sup> “Thuaj: o Zot, shtoma mua diturinë!” [Taha: 114]

<sup>453</sup> “Të pyesin ty (Muhammed), ç'u është lejuar atyre? Thuaju: “U janë lejuar të gjitha ushqimet e mira dhe ai (gjahu) i gjahtarëve (shtazëve) të dresuara që i mësoni ashtu si ju ka mësuar juve Allahu. Hani, pra, atë që gjahtuan për juve dhe më parë përmendi emrin e Allahut. Kini drojë nga Allahu pse Allahu shpejt merr masa.” [El-Maide: 4]



Kur folëm për mendimin në librin “El-Bina’ul-fikrijj” (Struktura ideologjike), theksi ishte vënë mbi rezultatit e procesit të të menduarit, ku e sqaruan konceptin e “mendimit”, nivelet dhe skemat që përfaqësojnë burimet dhe tematikat e tij, rrugët e fitimit të mendimit, historinë, gjeografinë dhe kriteret e tij. Kemi bërë përpjekje për krijimin e një harte të përgjithshme të mendimit, e cila përfshin planet dytësore të burimeve, të mjeteve dhe të tematikave të mendimit.<sup>454</sup> Fjala harita (hartë) në kontekstin që e trajtojmë ne nënkupton paraqitjen planifikuese të një tufe elementësh të ndërlidhur me njëri-tjetrin, e cila sqaron llojin, sasinë dhe marrëdhëniet e këtyre elementëve me njëri-tjetrin.<sup>455</sup> Harta sqaruese në vijim

<sup>454</sup> Harita (plani/harta) në aspektin gjuhësor do të thotë renditje e gjërave, apo grumbullim i tyre në një skemë. Pra, në arabisht fjala *harita* është një enë nga lëkura apo e ngjashme, së cilës i shtrëngohet gryka. Shih: Mexh’me’ul-lugat’il-arabijeh, *El-Mu’xhem’ul-vesit*, Kajro: botimi II, 1972, fq. 250-251

<sup>455</sup> Harita (plani/harta) ka një tematikë të përcaktuar dhe të orientuar kah veçoritë e elementëve përbërës. Harta e globit sqaron vijat horizontale dhe vertikale (polet, meridianët etj.), kontinentet, oqeanet dhe lumenjtë. Harta gjeografike e një vendi pasqyron veçoritë e sipërfaqes tokësore, kodrat, luginat, fushat, shkretëtirat, lumenjtë, detet, liqenet dhe rrugët. Harta politike e një shteti pasqyron kufijtë, qytetet, ndarjet

pasqyron vendin e hartës (planit) së tematikave të mendimit brenda hartave tjera të strukturës ideologjike.

Ne, kur e rishikojmë mendimin dhe strukturën ideologjike në kontekstin e shkrimit të tematikave të mendimit pedagogjik, na intereson të theksojmë tri çështje. E para: të vazhdojmë të spikatim kuptimet e mendimit dhe të dijes në sfondin kur'anor. E dyta: të mendojmë në kuptimin terminologjik bashkëkohor të secilës dije dhe mendim, bashkë me pozitën e tyre në procesin edukativ dhe arsimor. E treta: objektivi i ligjërimit hyjnor me mendim dhe dije është njeriu i ngarkuar me obligim, qoftë në nivel individual, familjar, shoqëror apo umetor. Këta të gjithë janë të preokupuar me edukimin dhe arsimin. Ata janë baballarë, nëna, studentë, mësues, përpilues të programeve dhe librave, punëtorë në administratë dhe në trajnime të ndryshme nëpër institucione të arsimit publik dhe universitar.

Tematikat e mendimit pedagogjik, të cilat presim t'i meditojnë profesionistët, përmbajnë gjithçka përfshijnë shkencat, shkathtësitë dhe drejtimit e duhura të secilës nga pikat vijuese:

Përmbajtja e programeve kulturore familjare, edukative dhe prindërore, të cilat janë të përcaktuara për baballarët dhe nënat, që t'i mësojnë për rritjen dhe zhvillimin (e drejtë) të fëmijëve të tyre.

Përmbajtja e metodave dhe librave studimorë (shkollor apo universitar) brenda fushave profesionale shkencore dhe njohëse.

Rrugët dhe metodat e mësimdhënies së kësaj përmbajtje dhe vlerësimi i ecurisë së studentëve në dritën e qëllimeve arsimore të përcaktuara paraprakisht.

Kërkesat e ambientit arsimor dhe edukativ në familje, në shkollë dhe në universitet.

Natyra e njeriut, fazat e zhvillimit fizik, intelektual, shpirtëror dhe social. Po ashtu, procesi i mësimi, fitimi i dijes, i shkathtësive dhe i instruksioneve nga ana e nxënësit në fazat e ndryshme zhvillimore.

administrative dhe rrugët. Harta e motit pasqyron tufat e reve dhe shirave, drejtimit dhe shpejtësinë e erërave, temperaturat, lagështinë etj.

Të gjitha këto janë tematika të mendimit dhe të strukturës së mendimit pedagogjik. Qartë duket se përvetësimi dhe pajisja me këto nuk realizohet në një institucion apo në një fazë të vetme, por përgjatë gjithë jetës së njeriut. Pra, kjo përfaqëson eksperiencën jetike e cila nuk pushon përgjatë gjithë jetës. Institucionet arsimore, kur përpilojnë planin e fitimit të eksperiencës, ato bëjnë llogari detyrat që duhet realizuar arsimi formal, arsimi informal dhe arsimi joformal.<sup>456</sup> Në vazhdim do të përcaktohen tematikat e arsimit dhe edukimit të cilat mund të përfitohen në secilin nga tri llojet e arsimit të theksuara më lartë.

Harta e mëparshme e tematikave të mendimit propozon që temat e mendimit pedagogjik të klasifikohen në tri grupe: temat e ndërtimit të umetit, temat e ndërtimit të vizionit ideologjik dhe temat e problematikave të reja, siç do t'i sqarojmë më vonë.

Ndoshta është më e udhës të theksojmë se “mendimi” është term i papërshtatshëm në disa mjedise të profesionistëve të shkencave të shariatit, pra, më i përdorshëm tek ata është termi “dije”. Është e ditur se dallimi mes mendimit dhe dijes nuk lidhet me tematikën, por me nivelin e trajtimit, nga se tematika, në dy rastet (me të dy termat), është çështje që ndërlidhet me doktrinën (besimin), adhurimin ose marrëdhëniet familjare. Kur e trajtojmë tematikën rrjedhëse në nivel kulturor, atëherë termi “mendim” është më afër kuptimit të duhur. Kur e trajtojmë tematikën e njëjtë në sferën e dispozitave shariatike, atëherë termi “dije” është më afër kuptimit të synuar.

Sigurisht, esenca është dija për problemet shariatike, gjë e cila fitohet fillimisht, pastaj e njëjta është edhe ndihmesë edhe për mendimin. Nuk mund ta paramendojmë një mendimtar të pa pajisur me dije për çështjen (shariatike) që diskutohet në

<sup>456</sup> Arsimi formal ushtrohet në shkollë, në universitete dhe në institucionet e trajnimit profesional përmes një programi të caktuar që përfundon me diplomë. Arsimi informal realizohet përmes aktiviteteve dhe përvojave jetike në familje, media dhe përmes institucioneve shoqërore. Ky arsim bëhet në formë spontane, të paprogramuar dhe të pasynuar, prandaj nuk ka diplomë. Kurse arsimi joformal është arsimim i programuar dhe i synuar deri diku dhe realizohet në institucionet trajnuese ku zhvillohen aftësitë profesionale. Ky arsimim realizohet edhe në asociacione, në sindikata dhe në organizata nacionale.

qarqet kulturore dhe intelektuale. Bartësi i dijes mund të kontribuojë në sferën e dijes, të mendimit dhe të kulturës, kështu që, meriton të quhet dijetar, mendimtar dhe i kulturuar. Disa bartës të dijes i ofrojnë në formë të mirë dijet e mësuara dhe fetvatë, ndërsa kur ulen për diskutim apo debat në çështjet bashkëkohore, janë në konfuzion dhe të luhatur në qëndrime. Pra, nuk kanë aftësi që dijen (e mësuar përmendësh) ta përshtatin me situatat bashkëkohore për shkak të mangësive kulturore rreth realitetit dhe problemeve bashkëkohore dhe për shkak të paaftësisë për të bashkëvepruar në situata alternative, në skenarë të ofruar apo në forma të tjera të mendimit futurist dhe objektiv. Të tillët janë të papërgatitur të trajtojnë problemet e fikhut të përparësive dhe të krahasojnë problemet e kësaj natyre. Pra, krejt këto që u theksuan janë të domosdoshme që një dijetar të jetë edhe mendimtar. Botërisht njihet thënia se dija është e përqendruar në shtimin e informacioneve për një tematikë të caktuar, kurse mendimi është i fokusuar në zgjerimin e qarkut të saj kuptimore, kuptohet, pa e ulur vlerën e secilës prej tyre.

Ajo që bie në sy është fakti se tri dekadat e fundit shihet një prani e theksuar e mendimit, e organizimit të kurseve intelektuale (ideologjike), e përhapjes së librave ideorë të profesionistët e shariatit dhe e shfaqjes së personaliteteve të profilizuara në dijet shariatike që trajtojnë çështje të mendimit islam dhe i vënë ato në funksion të dijeve shariatike. Megjithatë, nevoja për idenë dhe kulturën në shoqëritë islame vazhdon të jetë e madhe, veçanërisht kur shihet shumësia e koncepteve ideologjike në këto shoqëri, të cilat cilësohen me atraktivitet dhe influencë, pavarësisht se mund të jenë kontraktore dhe të pambështetura në sfondin e mirëfilltë islam.

## Pjesa e dytë: Harta e tematikave të përmbajtjes pedagogjike

Tematikat e strukturës ideologjike të cilat i theksuam paraprakisht janë tematika edukative (pedagogjike), ku sipas rezonimit të tyre duhet ta zhvillojmë gjeneratat e umetit. Ky edukim intelektual (ideologjik) mbështetet në ekzistimin e një ambienti edukativ i cili siguron burime, metoda dhe praktika që lejojnë ndërtimin e një vizioni islam për botën. Ky është vizion i përgjithshëm i cili i mundëson individit të vetëdijeshet për vetveten, për mjedisin lëndor rrethues dhe për marrëdhëniet me të tjerët. Gjithashtu, ky vizion mundëson perceptimin e problematikave dhe tematikave të ngritura në sferën e mendimit njerëzor bashkëkohor dhe kuptimin e tyre brenda këtij vizioni, në mënyrë që procesi i perceptimit dhe i kuptimit të cilësohet si i qartë, i plotë dhe i përshtatshëm, veçanërisht në tematikat që ngjallin më shumë debat dhe ku njerëzit kanë mendime të ndryshme, veçanërisht të kulturuarit dhe tek elita intelektuale. Do të shohim se tri tematikat vijuese kanë një rëndësi të veçantë:

### 1. Temat e ndërtimit të umetit

Me këtë synohet gjuha, feja dhe historia. Këto tema konsiderohen rrënjë e përbashkët sipas niveleve të përshtatshme brenda programeve pedagogjike në faza dhe profile të ndryshme. Këto tema e ndërtojnë identitetin islam të përgjithshëm të individit, të shoqërisë dhe të umetit. Pastaj këto përcaktojnë marrëdhënien e këtij identiteti me identitetet dhe përkatësitë tjera dytësore, si p.sh. me atdhetarinë, nacionalizmin, fafesisninë, sektarizmin dhe me të tjera. Në vijim do të sqarohet secila prej këtyre tematikave.

Tematika e lidhshmërisë së gjuhës me mendimin është shumë e rëndësishme, mirëpo, në këtë kontekst, mjafton të flitet për rëndësinë e zhvillimit të aftësisë së njeriut që të mendojë në gjuhën e tij amtare, të shprehë me gjuhë të dëlirë mendimin e kultivuar i cili do të paraqesë identitetin dhe përkatësinë e tij, dhe do t'i mundësojë të ndikojë pozitivisht tek të tjerët. Gjuha, në këtë kontekst, nënkupton metodat e komunikimit dhe të bashkëveprimit gjuhësor me të cilat sigurohet dialogu, ligjërimi, shkrimi dhe të tjera. Vlera e mendimit që jep mendimtari fshihet në veprimin dhe ndikimin të të tjerët. E si mund të realizohet ky veprim apo ndikim pa komunikim të përshtatshëm gjuhësor? Para së gjithash, edukimi, bashkë me institucionet, mjediset dhe fazat edukative, fillimisht pritet të sigurojë ambient të përshtatshëm për komunikim me gjuhën amë.

Nuk e kemi mërzi ta pohojmë se ne shkrimin e nisim nga sfondi ynë fetar-islam. Islami, sipas vështrimit tonë, është sistem unifikues i përgjithshëm i cili në doktrinën e besimit (akaidit) i përfshin dhe u përgjigjet edhe pyetjeve të mëdha ekzistenciale. Gjithashtu, e përfshin sheriatin i cili hollësisht trajton sistemet e jetës politike, ekonomike dhe sociale. E përfshin etikën e cila i trajton gjerësisht standardet e katarzës personale dhe kolektive, tipat e sjelljeve dhe marrëdhënieve. Synim i fesë hyjnore është udhëzimi dhe mundësimi i njerëzimit të realizojë mëkëmbjen njerëzore në Tokë, të ndërtojë jetën e kësaj bote dhe kështu të realizojë adhurimin për të cilin është krijuar. Kjo pastaj do të na ndihmojë ta precizojmë kuptimin dhe qëndrimin tonë ndaj debatit të ngritur sot dhe dy shekuj më parë rreth pozitës së fesë në shtetin modern. Gjithashtu, na ndihmon për formësimin e qëndrimit fetar ndaj tipave të pjesëmarrjes në nivele të ndryshme të politikës. Kjo pikëpamje e Islamit, gjegjësisht besimi, jurisprudenca dhe etika islame janë edukim në vetvete dhe kërkon t'i realizojë intencat e Allahu të Lartësuar ndaj krijesave, prandaj sistemi edukativ nuk duhet ta shpërfill këtë (fe).



Historia, me këtë rast, nënkupton historinë e njeriut në planetin tokësor. Kjo histori përfshin përvojat dhe eksperiencat njerëzore të epokave të ndryshme duke marrë mësim prej tyre. Kur'ani fisnik ka një metodologji të vetën kur flet për historinë, për popujt dhe për pejgamberët, për përgjegjësinë e umetit islam në formësimin e pjesës së mbetur të historisë në Tokë. Ky vështrim i historisë ndoshta ndryshon nga kuptimi i historisë që jemi mësuar të shohim, bashkë me mënyrën e paraqitjes. Pra, kjo histori përfshin udhëtimin, eksperiencën dhe trashëgiminë njerëzore në Tokë, bashkë me idetë, kulturat dhe qytetërimet që e kanë shoqëruar atë. Historia në përgjithësi, bashkë me historinë e muslimanëve, posedon mendime të gjalla, të vdekura dhe vrasëse, prandaj duhet bërë dallim mes tyre dhe duhet ditur si t'u qasemi drejt atyre. Ndikimi edukativ i Kur'anit fisnik në krijimin e vizionit historik përfaqet në zgjerimin e perceptimeve dhe horizonteve të mendimit të muslimanit duke i përvetësuar ato për jetën e kësaj bote dhe duke e inkorporuar në të eksperiencën njerëzore.

## 2. Temat e problematikave të ngritura dhe të atyre që duhet ngritur

Mediumet bashkëkohore aktive u përcjellin njerëzve lajme dhe ngjarje nga çdo cep i botës. Përmes tyre nxisin problematika të caktuara dhe çështje të cilat përditësohen çdo ditë, ku zhvillohen diskutime të ndryshme rreth tyre dhe kërkohet nga edukimi intelektual (ideologjik) që të ndërtojë te individit një kuptim dhe një qëndrim ndaj tyre. Për shembull, në mesin e këtyre tematikave janë:

Kuptimi i përgjithshëm islam ndaj tjetrit joislam brenda shoqërisë muslimane dhe jashtë saj. Çlirimi i konceptit të “diversitetit”, të “bashkëjetesës” dhe të “aleancimit”. Gjithashtu, njohja e dispozitave të marrëdhënieve ndërshtetërore me shtetet, me organizatat dhe me të tjerat.

Problemet e gruas: të drejtat, detyrimet dhe puna e saj.

Problemet ekonomike, zhvillimi dhe bankat.

Problemet e mediave bashkëkohore dhe ndikimi i tyre në industrinë e mendimit të përgjithshëm, shkaktimi i anarkisë ideologjike, dallimi i lajmit të saktë nga përhapja e gënjeshtërs apo e qëllimeve të tjera për çfarë përhapen lajmet.

Këta janë shembuj vetëm nga disa problematika, por jo të gjithë. Ajo që duhet spikatur këtu është se edukata intelektuale islame patjetër duhet të krijojë tek individit dhe te turma një vizion për botën. Ky vizion duhet të jetë i përgjithshëm, të ndihmojë në kuptimin e këtyre problematikave, tematikave dhe të ngjashmëve, dhe të ndihmojë në marrjen e një qëndrimi islam përballë këtyre.

### 3. Tematikat e përgatitjes ideologjike të vështrimit të përgjithshëm

Qëllimi me këtë përgatitje është sigurimi i edukimit të ekuilibruar. Sa u përket tematikave të kësaj sfere, ato janë disa lloje. Çdo lloj kontribuon në një aspekt të rëndësishëm të edukimit ideologjik. Në vazhdim do t'i paraqesim disa lloje:

Shkrime në sferën e mendimit reformist dhe rizgjues: këto shkrime trajtojnë problemet e mendimit, të ndërtimit ideologjik, të procesit të menduarit, të llojeve dhe të niveleve të tij. Gjithashtu, trajtojnë studimet për historinë e kulturave njerëzore, kushtet e ngritjes së kulturave, shkaqet e rënies së tyre dhe të gjitha format e ngjashme të luftës ideologjike apo të huazimit kulturor dhe qytetërimor. Shkrimet që numërohen brenda këtij lloji janë ato të shkencave të dala nga historia, si p.sh. filozofia e historisë dhe historia e mendimeve. E rëndësishme në këto studime është spikatja e përmasës filozofike në histori, bashkë me shtrirjet e saj në aktualitet dhe në perspektivë, dhe formimi i një baze praktike të menduarit strategjik perspektiv.

Njohuri hyrëse për shkencat sociale dhe humane. Me këtë literaturë nuk synohen njohuritë profesionale për sociologjinë, ekonominë, politikën, komunikimin dhe për disiplinat tjera, por synohet përvetësimi i koncepteve, i ligjeve, i teorive, i praktikave dhe vënia e tyre në shërbim të

të menduarit të problemeve të ngritura dhe pjesëmarrja e tyre në zgjidhjen e mundshme të këtyre problemeve. Ndoshta, ndër shkencat, njohuritë e përgjithshme të së cilave na duhen në këtë kontekst, janë sociologjia, politika dhe masmedia.

Literatura dhe njohuritë hyrëse të shkencave dinamike: këtu kemi për qëllim shkencat metodologjike, menaxhimin dhe psikologjinë. Të rëndësishme në shkencat metodologjike janë praktikrat e tyre në të menduar, në hulumtim, në sjellje, përmbushjen metodologjike dhe në shkollat metodologjike. Në shkencat e menaxhimit janë të rëndësishme praktikrat e tyre për menaxhimin e kohës dhe të grupeve, kurse psikologjia i ngërthen problemet themelore në arsim, në zhvillim dhe në ndryshim.

E rëndësishme është të spikatet fakti se rrugët përmes së cilave ndërtohet ngrehina ideologjike janë të ndryshme dhe se ne duhet bërë kujdes që aktivitetet dhe efektet e kësaj rruge të koordinohen dhe të bashkëveprojnë. Përgjegjësi e individit është që të jetë i vetëdijshëm për bashkëveprimin inherent mes proceseve të natyralizimit dhe zhvillimit social. Po ashtu, mbi të bie përgjegjësia e funksionalizimit të arsimit intencional, e pastrimit shpirtëror duke pastruar qëllimin, e trasimit të mirëfilltë dhe e kreativitetit. Përgjegjësi e familjes, e kolektivit dhe e organizimit është forcimi i këtyre aspekteve të vetëdijes dhe i këtij funksionalizimi, aq sa të jetë i mjaftueshëm për të realizuar edukimin ideologjik (intelektual) dhe për të siguruar ambient të përshtatshëm për paraqitjen e këtyre efekteve dhe rezultateve të kërkuara.

Çfarëdo qoftë përmbajtja shkencore e mendimit njerëzor (në disiplinat shariatike, natyrore, sociale etj.), analiza e kësaj përmbajtje shpalos elementët të cilët janë të ravijëzuar në nivele të ndryshme, në masa sasiore të llojllojshme dhe me veçori kualitative. Mes këtyre elementëve ka një sërë marrëdhëniesh strukturale dhe funksionale. Tërësia e elementëve të kësaj përmbajtjeje shkencore përfaqet në një strukturë piramidale e cila ka një bazament dhe një kulm. Në bazamentin e secilës shkencë pozicionohen faktet e asaj discipline, ku çdo fakt shpreh diçka të përkufizuar mirë, me

gjithë emrin dhe cilësinë që përmban. Numri i fakteve është shumë i madh në çdo disiplinë shkencore. Është e lehtë spikatja e përshtatshmërisë mes shprehjes gjuhësore të një gjëje shqisore apo kuptimore nga njëra anë, me faktin (apo realitetin) e asaj gjëje apo atij kuptimi nga ana tjetër. Ky bazament përfaqëson themelin e parë të strukturës kognitive të një discipline. Po ashtu, ky është themeli i domosdoshëm për ecurinë e procesit edukativ-arsimor.

Kur ka shumë fakte, atëherë arsyeja njerëzore, faktet të cilat ngjasojnë me njëri-tjetrin i lidh me disa veçori duke u vënë atyre një emërtim të përbashkët i cili quhet koncept.<sup>457</sup> Emri njeri është një koncept që i përshtatet çdo individ, pavarësisht ngjyrës, gjuhës, etnisë etj.. Emri peshk përfshin konceptin që i shkon për shtati çdo gjallesë të detit që jeton në ujë dhe merr frymë me verza. Fjala shitblerje mbulon konceptin e dhënies së çdo malli me kundërvlerë. Pra, konceptet janë etapë apo nivel tjetër në piramidën shkencore, e cila qëndron mbi faktet, është më e përgjithshme dhe abstragim i fakteve. Marrë parasysh se konceptet shkencore të një discipline nënkuptojnë abstragimin e fakteve të asaj discipline, atëherë numri i tyre (koncepteve) në çdo disiplinë është më i vogël se numri i fakteve.

Njohja njerëzore vendos marrëdhëniet mes koncepteve, të cilat mund të jenë marrëdhënie të lidhura apo shkakore. Çdo marrëdhënie mund të marrë formën e një baze, parimi, ligji apo ekuacioni matematikor. Në marrëdhëniet tregtare, shitësi e paraqet mallin që kërkon blerësi, pra marrëdhënia mes shitësit dhe blerësit mund të marrë trajtën e një ligji, pra të ligjit të paraqitjes dhe të kërkesës. Në çdo disiplinë shkencore ka ligje të cilat i lidhin me njëri-tjetrin konceptet e asaj discipline. Kështu që, kimia, ekonomia, gjuha dhe çdo disiplinë tjetër kanë ligjet e veta, sepse çdo ligj në përbërjen e vet i fsheh shumë koncepte, prandaj ligjet janë më pak në numër sesa konceptet, por janë më të abstraguara dhe

<sup>457</sup> Përdorimi i termit koncept dallon në varësi të sferës njohëse: në logjikë është vështrimi logjik, në gjuhë është kuptimi terminologjik i cili mbulon një fushë semantike të përgjithshme. Shih: Suad Kurim, Ed-Diraset'ul-mefhumijjetu: mukarenetun tesavvurijjetun ve menhexhijjetun, revista "Islamiijet'ul-ma'rifeh". El-Ma'had'ul-alemijju li 'l-fikr'il-islamijji, numri 60, Rebiu Evel (1431 h./2010), fq. 65.

përfaqësojnë një shtresë më të lartë në strukturën piramidale të shkencës, gjegjësisht mbi shtresën e koncepteve.

Meriton të theksohet se faktet, konceptet dhe ligjet janë nivele përshkruese të cilat shprehin realitetin e gjërave ashtu siç janë, por nuk sqarojnë shkakun e ekzistimit të këtyre gjërave se për çfarë ekzistojnë. Sqarimi i kësaj (ekzistencës) përbën një nivel tjetër në strukturën kognitive (njohëse) të shkencës e cila përbën kulmin e saj. Krejt kjo pastaj përfaqësohet nga teoritë, ku çdo teori përbëhet nga një sërë parimesh të cilat e sqarojnë një dukuri të caktuar shkencore. Çdo disiplinë posedon një sërë teorish interpretuese, të cilat zakonisht janë më të abstraguara se struktura kognitive paraprake, prandaj numri i teorive në çdo disiplinë shkencore është më i vogël sesa numri i ligjeve, koncepteve apo fakteve. Përderisa funksioni i fakteve, i koncepteve dhe i ligjeve është përshkrimi, atëherë funksioni i teorive është interpretimi.

Mbase është me vend të theksojmë këtu thënien se piramida e njohjes, e cila do të paraqitet pas pak, paraqet një fotografi të qartësuar mirë të shprehjeve shkencore-njohëse dhe të marrëdhënieve të tyre në disiplinat natyrore, si fizika, kimia, botanika dhe të tjera. Megjithatë, kjo mund të vlejë edhe për shkencat tjera. Ndoshta dallimi është te vetë diferencimi i grupeve, i llojeve dhe i shembujve të çdo niveli. Ndodh që tipat dhe klasifikimet e fakteve të shkencave natyrore të jenë ndryshe nga ato të shkencave sheriatike dhe të shkencave sociale. Faktet e gjërave dhe të ndodhive në kozmos nuk janë të njëjta me faktet e mëdha ekzistenciale që ndërliken me esencën dhe fatin e kozmosit. Gjithashtu, ndërhyrja dhe dallimi mes njësive njohëse në këto nivele ndikohet nga shprehjet që siguron gjuha ndaj tyre. Termi “fact” në gjuhën angleze nuk përshtatet plotësisht me termin “hakikah” në gjuhën arabe. Kështu është situata edhe në emërtimet e niveleve të tjera njohëse.


Ekziston edhe një mënyrë tjetër për të shprehur nivelet e njohjes shkencore në çdo disiplinë. Në këtë mënyrë, format më të thjeshta të njohjes i shprehim me termin “bejanat” (të

dhëna). Ky term është ekuivalent me termin fakte në piramidën e njohjes. Tërësia e të dhënave të një tematike të vetme përbën atë që quajmë informacione, e që është një nivel më i lartë semantik dhe kuptimor i të dhënave. E nëse informacionet vihen në funksion të një qëllimi të caktuar, atëherë ato bëhen dije, pastaj kjo dije (ma'rifeh) formon një nivel të tretë, nivel i cili në fakt është shkalla më e lartë e kuptimit dhe e domethënies së informatave.

Në fund, objektiv i praktikave të njohjes dhe vënia e tyre në funksion të ngritjes së individit dhe të shoqërisë drejt horizonteve të hapura të vizionit ndaj botës, bashkë me përgjigjet ndaj dilemave të mëdha ekzistencialiste, hap mundësinë për një nivel të katërt që e kalon dijen, gjegjësisht në atë që e quajmë hikme (urtësi). Në vend të pasqyrimit të këtyre katër niveleve në një skemë piramidale të ngjashme si ajo e mëparshme, më mirë është të mendojmë për marrëdhënien mes tyre në një skemë e cila tregon nivelin e zgjerimit ideor në domethënie, në kuptim dhe në vlerë. Me këtë rast, të dhënat përbëjnë nivelin më të ngushtë, të cilat pasohen nga informacionet që kanë kuptim më të gjerë dhe vlerë më të lartë. Pastaj vjen dija (ma'rifeh) e cila ka semantikë më të gjerë dhe vlerë më të lartë se informacionet. E në fund vjen në shprehje urtësia në një horizont të hapur drejt më të lartës duke shprehur fushëveprimin e gjerë të pakufishëm.

Në vazhdim do të paraqitet një skemë e cila i sqaron katër nivelet e dijes në formë piramidale në të majtë, pastaj në një skemën tjetër përballë në të djathtë i sqaron katër nivelet tjera për funksionalizimin e dijen.<sup>458</sup>

<sup>458</sup> Tematikat, burimet dhe mjetet e strukturës ideologjike i kemi dhënë në formë të detajuar në librin tonë "El-Binau'l-fikriju". Shih: Fet'hi Hasan Melkavi, *El-Binau 'l-fikriju: mefhumuhu ve mustevejatuhu ve haraituhu*, Aman, El-Ma'hed'ul-alemijju li 'l-fikr'il-Islamijj, botimi II, 2018, fq. 157-203.



## 4. Shkencat metodologjike

Metoda, në formë të përgjithshme, është mënyra e të menduarit, hulumtimi apo praktika në një çështje të caktuar. Edukimi është proces dhe praktikë e shoqërisë për përgatitjen e bijve të saj, e cila kërkon meditim dhe hulumtim të objektivave, të tematikave dhe të metodave të saj. Pastaj, rezultatet e të menduarit, të hulumtimit dhe të praktikës bashkëveprojnë për të ndërtuar dijen pedagogjike dhe organizohen në një imazhin e pedagogjisë nga e cila degëzohen një sërë degëzimesh të cila i quajmë disiplina pedagogjike. Vetëm pas kësaj mund të themi se disiplinat pedagogjike janë disiplina metodologjike, sepse ato karakterizojnë metodat apo rrugët e ndërtimit të dijes së domosdoshme të pedagogjisë, kurse metodat, mënyrat dhe praktikatat e ushtrimit të kësaj dijeje e formojnë personalitetin e njeriut. Megjithatë, disa disiplina dallohen në esencë si disiplina metodologjike, kurse te disiplinat tjera shkencore dallohet vetëm një element i tyre si metodologjik (pra nuk janë metodologjike fund e krye).

### 4.1. Shkencat metodologjike të veçanta

Po të hulumtosh fjalën “metodë”, “metoda” dhe “metodologji”, do të shohësh se ato janë vendosur në titujt e

qindra librave, studimeve dhe artikujve. Gjithashtu, në të shumtën e rasteve do të hasen të shoqëruara me fjalën “hulumtim”, i p.sh.: metoda e hulumtimit, metodat e hulumtimit apo metodologjia e hulumtimit. Ndonjëherë këtyre frazave u shtohen edhe emrat e tematikave apo shkencave ku ushtrohen këto metoda (apo metodologji), si p.sh. metodat e hulumtimit në shkencat sociale, juridike, gjuhësore, fetare dhe të tjera. Termat “metodë” dhe “metodologji” përdoren në kontekste të ndryshme. Mund të përdoren për llojllojshmërinë e tipave të metodave, për përshkrimet dhe për kriteret që karakterizojnë funksionimin përkatës të tyre dhe konfirmojnë efikasitetin e tyre. Gjithashtu, këto terma përdoren për institucionet e specializuara për mësimin e metodave dhe hulumtimin e tyre. Krejt këto hyjnë në një disiplinë të dalluar dhe të veçantë, të quajtur metodologji, pra shkenca e cila studion metodat. Më shumë termi metodologji përdoret në sferat e hulumtimit (metodologjik).

E vërteta është se metodologjia mund të shtrihet edhe në mënyrat e të menduarit, llojet dhe veçoritë e tyre. Disa shkencë kanë veçori metodologjike të qarta, si p.sh. logjika në filozofi, usuli fikhu në shkencat sheriatike, kelami në akaid, dialektika në politikë, ngritja e procedurës gjyqësore në drejtësi dhe të tjera. Të gjitha këto shkencë kanë rregulla dhe kriterë të cilat mësohen, u mësohen të tjerëve dhe përdoren në sferat e tyre të veçanta, prandaj propozojmë të quhen disiplina metodologjike.

Për shembull, shkencë e usuli fikhut është shkencë metodologjike e veçantë, sepse është disiplinë që përcakton rregullat e nxjerrjes së dispozitave sheriatike përmes argumenteve të hollësishme. Kelami studion dhe hulumton problemet e akaidit (besimit), ofron argumente, i diskuton argumentet dhe kundërargumentet, i kritikon dyshimet dhe u përgjigjet me prova përkatëse. Logjika është disiplinë që studion rregullat dhe ligjet e përgjithshme të procesit të të menduarit të saktë të njeriu. Kurse disiplina e intencave të



shariatit është i zbulon motivet, synimet dhe interesat e tërësishme për të cilat janë dhënë dispozitat e shariatit.

Krejt këto disiplina shkencore metodologjike i zgjerojnë perceptimet logjike dhe e ndihmojnë atë për të menduar drejt. Këto e ndihmojnë studiuesin e papërvojë që të mos bie në gabim dhe të mos veprojë pa provë. Përmes këtyre disiplinave metodologjike plotësohen elementët e vështrimit logjik të drejtë në shkencat tjera, qofshin ato shkencat shariatike, sociale, psikike, natyrore, aplikative etj.

#### 4.2. Elementi metodologjik në çdo shkencë

Shumë shkencat përmbajnë elemente metodologjike, si në sferën e metodave hulumtuese për të arritur disa fakte të cilat ngrihen mbi prova logjike dhe eksperimentale, ashtu edhe në sferën e kritikës, krahasimit, ekuilibrit të fakteve dhe provave të cilat ndihmojnë në pranimin e dispozitave dhe në njohjen e realitetit ku synon hulumtimi, si është rasti në krahasimin mes feve, në fikhun krahasues dhe në pajisjen me thukëti, me saktësi të ekuilibruar dhe me përshkrim kuantitativ që bëhet me llogari dhe me numra. Gjithashtu, kështu hyn edhe zgjedhja e drejtë dhe praktikat që marrin në konsideratë përparësitë, intencat dhe synimet e gjëra etj.

Në çdo shkencë mund të veçojnë tri elementë. I pari është materia shkencore, gjegjësisht faktet, konceptet, ligjet, teoritë apo të dhënat, informacionet, dija dhe urtësia, siç u sqarua në skemën paraprake. I dyti është metoda shkencore, gjegjësisht mënyrat dhe rrugët e arritjes të materia shkencore. Metodatat e hulumtimit në tematikat shkencore janë disa lloje: metoda historike, përshkruese, eksperimentale, pra disa bëjnë përshkrim dhe krahasim, disa bëjnë hulumtim teorik dhe praktik etj.

Në elementin metodologjik të shkencave ndërfiten tri nivele metodologjike.

Niveli i parë ndërfitet me burimet dhe rrugët e përgjithshme për të fituar çdo informacion. Kjo hyn në krerët e teorisë së njohjes në vrojtimin intelektual të përgjithshëm i cili përvetësohet në hulumtuesi, dijetari apo nxënësi. Kjo

përmblihet, sipas vështrimit tonë islam, në modelin që e përvetësojmë nga “metodologjia e integritit kognitiv”, pra ky model mbështetet në shpalljen dhe botën si dy burime për të fituar dijen, kurse arsyeja dhe shqisa janë mjetet me të cilat nxirret dija nga këto dy burime.<sup>459</sup>

Niveli i dytë në elementin përbërës metodologjik të një shkence është vënia në punë e metodave të të menduarit dhe të hulumtuarit në çdo disiplinë shkencore. Në astronomi i përdorim vështrimet shqisore, observatorët dhe teleskopët. Në biologjinë qelizore i përdorim mikroskopët zmadhues, në agronomi inspektimin e terrenit, në kimi eksperimentin laboratorik, në histori kritikën e brendshme dhe të jashtme të transmetimit dhe të elementit arkeologjik. Në hadithin pejgamberik i përdorim metodat e kritikës së transmetimit dhe të trajtimit, të transmetuesve dhe të defekteve transmetuese. Në dispozitat sheriatike e përdorim metodën e usuli fikhut dhe të intencave. Kështu, çdo disiplinë posedon metodën themelore e cila është e afërt dhe e ndërlidhur me metodat tjera.

Pavarësisht se konceptet “shkencë”, “punë shkencore” dhe zbulim shkencor” përfaqësojnë tematikat e njohura në faza të ndryshme historike dhe te popujt të ndryshëm. Koncepti “shkencë” dhe “metodë shkencore”, në formën që i njohim sot, lindën dhe u zhvilluan qysh në shekullin XVII, ku shkenca nënkuptonte shkencat natyrore. Për këtë arsye, metoda shkencore mbështetet esencialisht në vrojtimet shqisore dhe në eksperiencat praktike, mirëpo aplikimi i kësaj metoda në sferat e shkencave humane dhe sociale e zgjeron qarkun e metodës shkencore për të përfshirë një numër më të madh të metodave, të mjeteve, të procedurave dhe të teknikave të cilat i grumbullojnë të dhënat kualitative dhe kuantitative dhe pastaj i analizojnë. Krahas eksperiencave shkencore të njohura, metodologjia shkencore njeh tipa të ndryshëm të hulumtimeve, si p.sh.: studimi i

<sup>459</sup> Melkavi, *Menhexhijjet'ut-tekamul'il-marifijj*, vep. e cit., kapitulli VI: Mesadir'ul-menhexhijjeti ve edevatuha, fq. 203-240

rastit, studimi i terrenit, hulumtimi etnografik, hulumtimi procedural, studimi përshkrues, analitik, krahasues etj.

Niveli i tretë i elementit metodologjik shkencor ndërlihet me tematikë të kufizuar të një disipline shkencore. Çdo disiplinë shkencore ka lindjen, zhvillimin dhe avancimin e saj, prandaj i hyn në punë metoda e hulumtimit historik. Çdo shkencë posedon çështje teorike dhe çështje praktike, ku secili prej tyre ka metoda të veçanta. Disa mesele kanë nevojë për studim përshkrues, kualitativ dhe thellues, kurse disa të tjera kanë nevojë për të dhëna që grumbullohen me krahasim kuantitativ, prandaj kërkojnë trajtim statistikor. Studimi hulumtues i disa meseleve ka nevojë për përdorim të një sërë mjetesh dhe metodat hulumtuese.

Elementi i tretë i strukturës shkencore është drejtimi, apo zakonet psikike dhe logjike të cilat i zhvillon njeriu për të pasur qasje të drejtë ndaj shkencës, praktikave shkencore dhe sjelljeve. Drejtimi lidhet edhe me aspektin emocional dhe sentimental të njeriut, dhe kështu formon idenë pozitive dhe negative për tematikën shkencore, e cila pastaj kjo ndikon në shkallën e mësimit dhe në mënyrën e funksionalizimit. Ndoshta kjo pastaj reflekton në personalitetin, në marrëdhëniet dhe në sjelljet e tij. Orientimet e njeriut shfaqen kah një tematikë e caktuar, gjegjësisht në dëshirën për ta hulumtuar atë tematikë dhe në kujdesin për të fituar më shumë njohuri në të. Orientimi kah tematika e caktuar ndikon edhe në metodën e të menduarit dhe të hulumtimit, sidomos në përfitimin e zakonit të vërtetimit, të përforcimit, të sqarimit dhe të dallimit të fakteve nga legjendat rrjedhëse dhe nga thashethemet e përditshme.

Po t'i vëmë veshin dialogut të një çështjeje të caktuar, atëherë do të shohim se orientimi psikik dhe logjik që kemi ndaj kësaj çështjeje ndikon në gjykimet apo dispozitat që i arrijmë, sidomos kur dihet se ky orientim formohet spontanisht, dhe atë si rezultat i përvojës së një personaliteti paraprak apo si rezultat i një ambienti të caktuar social. Ndonjëherë orientimet që dalin nga ambientet sociale

ndërthuren me vlerat që i ndërton ajo shoqëri dhe i përvetëson individi në mënyrë të pavetëdijshme.

Duket qartë se elementi i tretë i dijes nuk lidhet me vetë dijen, por me ndjenjat e nxënësit kundrejt dijes. Këtu paraqitet rëndësia e edukimit intelektual në njohjen e orientimeve të nxënësve në raport me tematikën e caktuar shkencore dhe zbulimin e orientimeve negative të pajustificueshme kundrejt tematikës e cila pamundëson arritjen e mësimit të kërkuar dhe pengon ndërtimin e gjykimit vlerësues të përshtatshëm. Pastaj pengon trajtimin e saj në dritën e shkaqeve që mund t'i posedojë.

Mendimi pedagogjik islam duhet t'u bëjë kujdes këtyre shkencave metodologjike dhe këtyre elementëve metodologjikë në shkencat e ndryshme, në mënyrë që angazhimi edukativ të mos fokusohet vetëm në mbledhjen e njohurive dhe informacioneve për gjërat, ngjarjet dhe dukuritë natyrore, sociale dhe psikike, apo vetëm në ruajtjen, sistemimin dhe njohjen e praktikave të cilat sjellin disa përfitime, por të shtrihet në sferën që këto njohuri dhe informacione të shndërrohen në mjete të vrojtimit logjik dhe të ndërtimit të personalitetit njerëzor në njërën anë dhe të kontribuojnë në avancimin e vetë shkencave, në praktikën e dy sferave të rëndësishme si zhvillimi social dhe zhvillimi ekonomik. Po ashtu, të kontribuojnë në rizgjim dhe kuptimin e realitetit dhe pozitës së umetit në kulturën bashkëkohore mbarënjëzore në anën tjetër. Gjithashtu, këto njohuri duhet të vihen në funksion të kuptuarit të intencave të fesë dhe të përmirësimit të fetarisë.

Mendimi pedagogjik në vështrimin islam nuk është një temë e veçanta e cila mësohet në formë të pavarur nga tematikat tjera shkencore në metodat e mësimdhënies, por është shpirti ku vlojnë të gjitha shkencat përmes atyre që ne i quajmë shkencat metodologjike apo elementi metodologjik i çdo shence. Ky element, në të njëjtën kohë, është synimi i kërkuar nga mësimi i këtyre shkencave dhe i këtyre tematikave. Kjo nuk është një temë vetëm e muslimanëve, por është tematikë dhe synim i arsimimit dhe i edukimit të

njeriut (në përgjithësi). Megjithatë, ne e spikatim duke marrë parasysh praninë dhe efektin e zbehtë të saj në praktikat arsimore dhe edukative në shtetet e Botës Islame.

Shpresojmë të jetë e qartë se dallimi mes grupeve të shkencave (si shkencat natyrore, aplikative, sociale, humane, sheriatike dhe grupeve të tjera shkencore) nuk nënkupton ndarjen e plotë mes tyre në arsyen njerëzore, por tregon se dallimi mes tyre është për të njohur më lehtë llojet dhe studimet e tyre, dhe për t'i organizuar më mirë programet mësimore. Pra, njeriu e ka të vështirë të mbledh të gjitha profesionalizmat e ndryshme në kohën kur shkencat janë avancuar aq shumë dhe janë thelluar në imtësi, përfshirë këtu edhe disiplinat e sheriatit.

Megjithatë, ne nuk gjykojmë se gjithçka në këto shkenca është e vërtetë dhe se faktet e tyre janë absolute. Pra, edhe në mesin e profesionistëve të niveleve më të larta nuk gjen asnjë të pretendojë se ato janë absolute. Sidoqoftë, asnjë shoqëri nuk mund të shlyejë klasifikimet profesionale të këtyre shkencave. Profesionalizmi dhe thellimi në nivelet më të thella të mundshme është garantues që vërteton se në këto shkenca ka përfitimet dhe interesat (shkencorë), të cilat duhet t'i arrijmë dhe të zbulojmë mangësitë e dëmet që t'i largojmë.

Treguam më parë se shkencat e ngritjes së umetit janë feja, gjuha dhe historia. Gjithashtu, pohuam se një pjesë e tyre patjetër duhet të jenë pjesë e programit arsimor të çdo anëtari të umetit. Disa, muslimani nuk mund t'i shmang assesi, sepse me ato muslimani është musliman, sepse dija e tyre është e domosdoshme, pavarësisht profesionalizmit në programet dhe nivelet arsimore. Ky nivel i edukimit dhe i arsimimit në shkencat e fesë, të gjuhës dhe të historisë mbase mund të jetë mjet metodologjik në përvetësimin e shkencave të tjera, në njohjen e rëndësisë dhe domosdoshmërisë së tyre, dhe në njohjen e metodave të bashkëveprimit me ato. Pastaj, një nivel më i lartë patjetër të ofrohet për profesionalizëm shkencor të përgjithshëm dhe të thukët në ndonjërin prej këtyre shkencave, siç është rasti me fakultetet e sheriatit dhe të studimeve islame nëpër universitete.

Dhënia përparësi ndonjërisë nga shkencat e sheriatit dhe të shkencave tjera nuk është çështje e gjykimeve të vlefshme të përgjithshme, sepse shoqëria muslimane ka nevojë për profesionalizmin e secilës shkencë, kurse favorizimi i ndonjë meseleje mbetet zgjedhje, prirje apo gatishmëri personale. Çdokujt i është lehtësuar ajo për të cilën është krijuar.

## Pjesa e tretë:

# Disiplinat dhe tematikat e pedagogjisë në vështrimin islam

### 1. Qëllimi me disiplinën shkencore (degëzimin)

Ku është qëllimi me termin “shkencë” në kontekstin e shkencave pedagogjike? Çfarë na shtyn që një tematike hulumtuese dhe studimore t’ia japim termin “shkencë” dhe ta trajtojmë atë disiplinë (degëzim) shkencore? Qëllimi me disiplinën apo degëzimin shkencor është fusha kognitive (field of Knowledge) e cila dallohet nga fushat tjera njohëse, apo disiplina akademike e cila bëhet tematikë e studimit shkencor profesional. Pavarësisht se lindja dhe pranimi i disiplinës profesionale u nënshtrohen një sërë mendimesh që ndryshojnë nga mendimet përreth. Një tufë prononcimesh shkencore janë pothuaj treguesi i mjaftueshëm për ta konsideruar një tematikë disiplinë shkencore. Në mesin e këtyre prononcimeve janë edhe këto:

Disiplina shkencore ka tematikën e vetë hulumtuese, pavarësisht se kjo tematikë mund të hulumtohet edhe nga një disiplinë tjetër shkencore.

Disiplina shkencore ka lëndën e njohjes profesionale ku nuk ndërhyjnë asnjë disiplinë tjetër shkencore.

Disiplina shkencore ka konceptet dhe teoritë që kontribuojnë në sistemimin e njohjes profesionale në formë aktive.

Disiplina shkencore ka terma të veçantë dhe gjuhë artistike që përshtatet me tematikën hulumtuese.

Disiplina shkencore ka zhvilluar metodat dhe mjetet hulumtuese profesionale që përshtaten me kërkesat e hulumtimit të tematikave të saj.

- Disiplina shkencore është një profesion ku marrin pjesë një grup i konsiderueshëm profesionistësh, të cilët

koordinohen në degët dhe programet studimore universitare, në qendra hulumtuese apo në sindikata profesionale, dhe kanë mbledhje dhe revista sistematike.<sup>460</sup>

Interesimi i joarabëve u shtua në dekadat e fundit për studimin e gjuhës arabe, prandaj u themeluan qendra për mësimin e gjuhës arabe për të huaj, pa pasur mësues profesionistë dhe metoda të veçanta për këtë qëllim. Megjithatë, interesimi i vazhdueshëm për këtë tip studimi nxiti zhvillimin e programeve për përgatitjen e mësimeve, u shfaqën problematika dhe probleme që u bënë objektiva të këtij hulumtimi shkencor. Pastaj u themeluan qendra profesionale, programe universitare, revista periodike dhe konferenca shkencore profesionale. Kështu kjo tematikë u bë disiplinë e mësimin të gjuhës arabe.

Nga disiplinat që u shfaqën viteve të fundit është edhe disiplina e intencave të shariatit, e cila u degëzua nga usuli fikhu. Disiplina e usuli fikhut është zhvilluar në thelb për të precizuar praktikën e fukahave në nxjerrjen e dispozitave shariatike. Sot gjejmë dhjetëra qendra hulumtuese profesionale në disiplinën e intencave të shariatit, e cila është bërë lëndë shkencore universitare në studimet e larta, kurse numri i profesionistëve që merren me intencat e shariatit shtohet ndjeshëm.

Migrimi i muslimanëve në shtetet evropiane dhe amerikane shkaktoi ndërveprim të theksuar mes muslimanëve dhe të tjerëve në këto shtete. Po ashtu, shtohet dukshëm edhe numri i atyre që hyjnë në Islam, prandaj nevoja e kërkon që disa thirrës të profilizohen për t'u kujdesur për këta muslimanë të rinj dhe për t'i zhvilluar metodat e thirrjes për jomuslimanët. Shohim se nevoja është bërë imediate për zhvillimin e programeve për trajnimin e

<sup>460</sup> Kemi hasur një sërë burimesh akademike që flasin për veçoritë e një discipline (degëzimi) shkencore dhe si dallohet ajo nga të tjerat. Po ashtu, kemi gjetur dallime të mëdha për ato që quhen veçori të rëndësishme të këtij objekti, por ajo ku këto veçori bëhen bashkë është hulumtimi i bërë nga Krishanan, nga Universiteti Britanik Southampton, i cili ka diskutuar hollësisht lindjen e sistemeve kognitive të pavarura dhe sistemeve kognitive të ndërthurura. Po ashtu, ka caktuar gjashtë veçori të sistemit kognitiv të pavarur. Shih: Armin Krishanan, *What are Academic Disciplines? Some Observations on the Disciplinarity vs. Interdisciplinarity debate*, Southampton: University of Southampton, National Center for Research Methods, Working Paper Series nr. 03/09, Janar 2009, fq. 9.



thirrësve në metodat e përhapjes së thirrjes në mesin e jomuslimanëve. Këto programe zhvillohen derisa bëhen disiplinë e veçantë profesionale ku mësimdhënia zhvillohet brenda kërkesave të veçanta, si në disiplinat tjera.

## 2. Themelimi i disiplinave të pedagogjisë

Edukimi përgjatë historisë njerëzore, madje edhe sot, është një proces shoqëror që u nënshtrohet rrethanave, nevojave, sfondeve dhe përparësive të shoqërisë, dhe lyhet me ngjyrën që sundon atë periudhë historike të shoqërisë. Ndonjëherë ngjyrimi është filozofik, ushtarak, fetar, etik, ekonomik, teknologjik apo diçka tjetër. Dy aspekte e tregojnë qenien e pedagogjisë proces shoqëror: aspekti i parë është se filozofia, feja, etika, ekonomia, teknologjia dhe sferat tjera që sundojnë në shoqëri ndikojnë në edukimin dhe ngjyrimin e tij. Aspekti i dytë është se pedagogjia është ajo që e mbush sferën e arsimit në shoqëri me këto tematika, e përhap, e zhvillon dhe e bën të rëndësishme në realitetin social. Ajo që i dirigjon këto dy aspekte bashkërisht është pikëpamja për botën që e ndërton shoqëria. Pikëpamja islame e cila ngrihet mbi besimin në Allahun e Lartësuar, në pejgamberët, në ringjalljen dhe në të gjitha doktrinat tjera besimore, është pikëpamje tevhidi në rend të parë. Teoria politike e cila e dirigjon aktivitetin politik në shoqëri, teoria ekonomike e cila e drejton aktivitetin ekonomik, teoria etike e cila i dirigjon marrëdhëniet sociale mes njerëzve dhe të gjitha teoritë tjera, kur nisin nga pikëpamja islame, bëhen tematika apo objektiva në veprimtarinë edukuese dhe komponentë të rëndësishëm në teorinë pedagogjike në të cilën mbështetet shoqëria muslimane. Të gjitha disiplinat që bashkëveprojnë me njeriun dhe shoqërinë njerëzore, të cilat njihen si shkencat humane dhe sociale, puqen në sferën e edukimit për t'u bërë objektiva për zhvillim, avancim, trajnim dhe arsimim.

Disiplinat pedagogjike janë disiplina dinamike si rezultat i dinamizmit të vazhdueshëm në shkencë. Këtu vijnë vështirësitë me të cilat ballafaqohet pedagogjia, pra kur

paraqitet një vështirësi si pasojë e asaj që ndodh përgjatë ndryshimit dhe dinamizmit në shkencë apo zbulime, atëherë kjo reflekton në programet, metodat, mënyrat dhe mjetet pedagogjike.

Kur flasim për rëndësinë e konceptit të “pikëpamjes” në mënyrën e bashkëveprimit me shkencat në programet edukative në shoqërinë islame, konstatojmë se ky koncept nuk është i veçantë për umetin dhe shoqërinë islame, por çdo shoqëri ka pikëpamje të ngjashme me doktrinën fetare, pavarësisht nëse pikëpamja buron nga një fe qiellore apo tokësore, apo edhe nëse është pikëpamje tipike jofetare. Individit në shoqëri kryesisht e përvetëson këtë pikëpamje, pajiset me të spontanisht dhe e ushtron atë në shoqëri në harmoni me realitetin dhe aspiratat e shoqërisë. Megjithatë, ndonjëherë rastis që dikush të ndikohet nga pikëpamja shoqërore, e beson atë dhe e pranon me vetëdije apo vihet në kërkim të komponentëve alternativë të kësaj pikëpamjeje. Për rëndësinë e kësaj pikëpamjeje në drejtimin e punës edukative në shoqëri, Agruis Constans ka thënë: “Çdo kulturë ka pikëpamjen ekzistenciale për botën apo një botëkuptim nga i cili kuptohet dhe ngrihet çdo gjë. Botëkuptimi sundues në një kulturë është ai që i përcakton vijat e saj, e formon ligamentin mes komponentëve të njohurive të saj, e dikton metodologjinë e saj dhe e dirigjon edukimin e saj. Ky botëkuptim formon kornizën njohëse dhe kriterin matës të saj. Botëkuptimi ynë për botën është i rëndësishëm, kurse ne nuk e kuptojmë botëkuptimin tonë derisa të ballafaqohemi me një botëkuptim alternativë...”<sup>461</sup>

Megjithatë, patjetër duhet bërë dallimin mes disiplinave pedagogjike si disiplina sociale ku tematikat nuk janë krejt të pavarura në vetvete, dhe disiplinave natyrore të cilat karakterizohen me studim të materies, gjegjësisht përbërjen, ndryshimet dhe dukuritë e saj. Kjo e fundit më lehtë i nënshtrohet eksperimentimit sesa dukuritë në disiplinat sociale. Për këtë arsye, pedagogjia përfshin eksperiencën

<sup>461</sup> Gross Robert dhe Gorge Stancio, *El-Ilmu fi mendhurih'il-xhedid*, e përkthyer nga Kemal Halajli, Silsiletu Alem'il-Ma'rifeh (134), Kuvajt, El-Mexhli's'ul-Vatanijju li'th-thekafeti ve'l-fununi ve'l-adabi, janar, 1978, fq. 15

njerëzore të fituara nga njeriu nga njeriu përmes përvojës, pastaj shumica e operacioneve sociale trashëgohen nga njëra gjeneratë në tjetrën. Praktika pedagogjike synon të ndërtojë personalitetin e njeriut sipas një kriteri për të realizuar synimet, qëllimet dhe vlerat e caktuara.

Edukimi është një tematikë që daton qysh në lashtësi. Popujt dhe fiset, qysh në kohët e lashta kanë njohur praktika pedagogjike të përdorura nga baballarët dhe nënat, të cilat i përdorin në formë funksionale sociale (d.m.th. si profesion). Pra, ka pasur edukatorë të përgjithshëm, mësues të veçantë për një temë të caktuar apo profesion të caktuar për përgatitjen e gjeneratave të reja në sferat e gjuhës së atij populli, të sistemit social dhe fetar, dhe në sferat e profesioneve apo zanateve që ishin të nevojshme për shoqërinë. Edhe pse shumica e formave, tematikave dhe e synimeve të edukimit kanë ndryshuar gjatë historisë, përsëri ajo që nuk ka ndryshuar deri sot është fotografia e përgjithshme e pedagogjisë, gjegjësisht ekzistimi i tri kushteve kryesore të arsimit dhe të edukimit: mësuesi, nxënësi dhe lënda mësimore.

Meqenëse zhvillimi përfshiu institucione të profilizuara për mësimin e të vegjëlve dhe të mëdhenjve, i zhvilloi tematikat e mësimdhënies, atëherë krahas me mësimin e gjuhës, të fesë, të sistemit social dhe të zanateve, u shfaqën edhe tematika mësimore të profilizuara në nivel të avancuar, si p.sh.: filozofia apo urtia e cila i përfshin shumicën e disiplinave logjike, praktike dhe aplikative. Pastaj shkencat filluan të diferencohen me tematikat, si p.sh.: poezia, letërsia, matematika, mjekësia, astronomia, fizika, kimia dhe gjeografia. Këtë e pasoi edhe diferencimi i disiplinave sociale bashkë me degët e tyre, si p.sh.: ekonomia, psikologjia dhe pedagogjia.

Pastaj secila disiplinë futet në hollësi të caktuara të disa tematikave derisa arrijnë të bëhen disiplina anësore. Në pedagogji, për shembull, nuk vazhdojmë të flasim më për pedagogjinë, por për disiplinat pedagogjike. Disa nga këto degëzime disiplinare janë specializime në hollësitë e disa

tematikave pedagogjike, si p.sh.: metodika, didaktika dhe menaxhimi në arsim. Disa nga këto degëzime janë interdisiplina, ku tematikat e tyre ndërthuren mes pedagogjisë dhe një shkence tjetër, si p.sh. menaxhimi në arsim me psikologjinë pedagogjike, me historinë e pedagogjisë, me filozofinë e pedagogjisë, me sociopedagogjinë dhe me të tjerat.

Meqenëse pedagogjia kryesisht përkufizohet në tematikën e saj, apo në metodat e arsimimit dhe të edukimit, atëherë disa tematika janë shkëputur në disiplina shkencore të pavarura brenda pedagogjisë, siç është rasti me edukimin artistik, edukimin trupor, edukimin shkencor, edukimin ideologjik, edukimin kulturor, edukimin universal dhe me të tjera. Disa disiplina pedagogjike janë të profilizuara në mësimin e një grupi të caktuar nxënësish, si p.sh. edukimi i fëmijës, mësimi i të mëdhenjve, edukimi i të zgjuarve dhe i atyre me nevoja të veçanta, edukimi prindëror dhe të tjera. Në vazhdim do të shohim disiplina të tjera specifike për ambientet dhe mjediset ku zhvillohet arsimi, si p.sh. edukimi familjar, edukimi në xhami, edukimi mediatic, edukimi në shtëpi dhe të tjera. Ka edhe shumë tipa të tjerë të edukimit, ku disa janë rezultat i aplikimit të një teorie të caktuar apo i një metode të caktuar në mësimdhënie.

Siç duket, procesi i degëzimit nuk ndalon, por tipat e edukimit vijnë si rezultat i zhvillimit në përdorimin e mjeteve dhe mekanizmave moderne në arsim, prandaj na u paraqit arsimimi përmes televizorit apo arsimimi televiziv, arsimimi në distancë dhe arsimimi përmes internetit (online).

E vërtetë është se çdo disiplinë pedagogjike është tematikë e vështrimit, e hulumtimit dhe e preokupimit shkencor në çdo shoqëri, megjithatë, secila disiplinë e gjen vendin e vet në praktikën edukative në aspektin e teorizimit dhe të ushtrimit të saj në dritën e filozofisë edukative të pranuar nga shoqëria. Më herët, në pjesën e parë, folëm për konceptin e “filozofisë edukative” dhe për “teorinë e edukimit”, por konteksti këtu e kërkon që të flitet për ato duke i cilësuar si dy disiplina pedagogjike.

Realisht, krejt ato që thamë për disiplinat pedagogjike janë bërë tematika të rëndësishme në mendimin pedagogjik bashkëkohor, mirëpo shkollat ideologjike ku përkojnë këto disiplina kanë bërë që realiteti i arsimit të dallojë shumë mes vendeve të ndryshme të botës. Sistemet e klasifikimit të nivelit arsimor e kanë zbuluar këtë dallim apo renditjen e tipologjisë së arsimit në botë e cila ka filluar të shfaqet viteve të fundit, madje ato kanë zbuluar edhe humbjen e shpresës në disa shtete për mosarritjen në pozita avancuese në sistemet e klasifikimit, si p.sh. në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Francë dhe në Britani. Këto shtete janë ato nga të cilat shumë shtete tjera të botës ende vazhdojnë të importojnë sistemet arsimore.

Shumica e disiplinave pedagogjike që mësohen në shtetet e Botës Islam janë po ato disiplina që mësohen botën perëndimore, sidomos në Evropën perëndimore dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Përgjegjësit e edukimit në shtetet islame, po t'i jepnin rëndësi dhe po ta studionin me kujdes atë që u detyrojnë disiplinat pedagogjike, atëherë do të shihnin se edhe ata posedojnë eksperiencën vendore që u mundësojnë studimin analitik dhe kritik të asaj që qarkullon në mendimin pedagogjik bashkëkohor, kuptohet në dritën e sfonteve vendore dhe fetare, kurse pastaj do të mund të zhvillonin disiplina pedagogjike shumë më përparimtare se ato që qarkullojnë në arenën bashkëkohore.

Sado të ketë karakter zyrtar filozofia edukative në një shoqëri islame, nuk do të ketë efektin e duhur përderisa vazhdon të importojë sisteme edukative, sepse këto sisteme edukative të importuara, bashkë me programet, metodat dhe interdisiplinat, i përkasin filozofisë së shtetit nga ku importohen. Pastaj, importimi bëhet proces i vazhdueshëm, sepse sistemet, teoritë dhe lëndët edukativo-arsimore në disiplinat e pedagogjisë ndryshojnë vazhdimisht. Kështu, procesi i importimit bëhet tutor i dogmatizmit dhe prapambetjes së vazhdueshme.

### 3. Teoria pedagogjike dhe filozofia pedagogjike

Pasi folëm në formë të përgjithësuar për disiplinat pedagogjike të cilat karakterizohen me aspekte të ndryshme në arenën e edukimit dhe të arsimit, kemi vendosur të bëjmë një sqarim shtesë për dy degë të pedagogjisë të cilat kanë pozitë të veçantë në mesin e disiplinave tjera pedagogjike. Ato janë: teoria pedagogjike dhe filozofia pedagogjike.

Pedagogjia është disiplinë sociale aplikative që nuk bie te disiplinat teorike, megjithatë, teoria pedagogjike është mjet i rëndësishëm që ndihmon të menduarit në meseletë e arsimit dhe mësimit përmes metodave të ndryshme. E sqaruar Kapitullin e parë marrëdhënien e filozofisë pedagogjike me teorinë pedagogjike dhe me praktikën pedagogjike. E rëndësishme është të spikatim se procesi pedagogjik përmban një sërë komponentësh, ndër të cilat janë: mësuesi, studenti, institucioni, metoda pedagogjike e cila kufizohet në katër komponentët e njohur, objektivat, përmbajtja, metodat dhe vlerësimi. Ekzistojnë një sërë teorish pedagogjike për secilin komponent. Teoria pedagogjike nuk është thjesht një teori, por një term gjithëpërfshirës që përmban një numër teorish të cilat trajtojnë atë që ndodh dhe që duhet të ndodhë në procesin e arsimit. Çdo teori pedagogjike bazohet në një filozofi pedagogjike e cila shpreh tërësinë e doktrinave të veçanta për ekzistencën, jetën, njohjen, vlerat dhe njeriun, pra për atë që quhet pikëpamje (për botën).

Sigurisht, se teoria pedagogjike e përgjithshme gëzon një pozitë boshtore në arenën e praktikës pedagogjike. Praktika pedagogjike është një proces kompleks, problematik dhe shumëdimensional, i cili duhet të merret në konsideratë. Pra, nuk është thjesht vetëm ajo apo mënyra që duhet të veprojnë pedagogët në procesin edukativ, por (praktika pedagogjike) përfshin sqarimin e shkaqeve që i shtyjnë ata të veprojnë në këtë sferë.<sup>462</sup> Teoritë e ndryshme në pedagogji përfaqësojnë shkollat e ndryshme ideologjike, ku njohja e tyre mbase

<sup>462</sup> Karl Aubrey, & Alison Riley, *Understanding and Using Educational Theories*, London: Sage Publications Ltd, 2nd Edition, 2019, fq. 2.

mund të ndihmojë në kuptimin më të thellë të asaj që ndodh në situata të ndryshme. Arsimi që synon fitimin e njohurisë, të shkathhtësive të domosdoshme për konkurrencën në tregun e punës, mbështetet në pikëpamjen ndryshe nga arsimi që përmbush nevojat e zhvillimit dhe avancimit individual. Në librat profesionalë dhe në teoritë edukative do të hasim kriteret të ndryshme për zgjedhjen e teorive për të cilat flet libri dhe për moszgjedhjen e të tjerave. Ka një numër i madh i hulumtuesve, i dijetarëve dhe i mendimtarëve të cilët kanë dhënë kontribute të çmuara në sferën e përgjithshme të pedagogjisë apo në një sferë specifike të saj.

Kriteret e klasifikimit të teorive pedagogjike janë shumë. Disa mbështeten në kriterin kohë, prandaj bën fjalë për teoritë tradicionale, moderne dhe postmoderne. Disa bazohen në kriterin psikologjik, prandaj flasin për teoritë bihevioriste, njohëse (gnostike) dhe strukturaliste. Disa mbështeten në kriterin social, prandaj bëjnë fjalë për teori të cilat bosht e kanë individin në shoqëri, tërësinë e shoqërisë apo mbarë shoqërinë njerëzore.

Nga shembujt e qartë e efektit të teorisë pedagogjike në formimin e sistemeve edukative dhe në praktikat edukative, sidomos në etapat e hershme të arsimit të përgjithshëm, është dallimi i madh mes një teorie që mbështetet në nevojën e shoqërisë për të ndërtuar sistemin edukativ nga një teori tjetër që mbështetet në nevojën e nxënësit si individ. Në literaturën pedagogjike botërore hasim kritikë për shumë mendime të përhapura si rezultat i lirive dhe të drejtave personale, të cilat sundojnë frymën e solidaritetit dhe ndjenjat emocionale ndaj fëmijëve, por e shpërfillin nevojën e shoqërisë për gjeneratat e reja të cilat e përvetësojnë gjuhën e umetit (popullit), bashkëveprojnë në nivel social, përfitojnë nga eksperiencat e suksesshme të më të mëdhenjve dhe i zhvillojnë përvojat e reja.

Shembull për këtë lloj kritike mjafton të theksojmë kritikën të cilën Eric Donald Hirsch, pedagogu amerikan në Universitetin Virginia, ia bëri teorisë pedagogjike të arsimit shkollor amerikan atëherë, i cili po degradohej vazhdimisht,

por bashkë me të degradohej arsimit i çdo shteti që kishte huazuar eksperiencën pedagogjike amerikane, siç ndodhi në Francë.

Hirsch mendon se shkak i degradimit të arsimit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në shtetet që kanë marrë sistemet e saj arsimore, u kthehet tri mendimeve të shterpëta. Ato janë: parimet e zhvillimit natyror, individualizmi dhe mendimi kritik. Sigurisht se ato janë instruksione tërheqëse, të pranueshme nga shumica dhe i përkrahin mendimet për të drejtat dhe liritë individuale të fëmijëve. Ai ka propozuar tre mendime tjera alternative dhe mendon se ato janë më të përshtatshme me shkencat bashkëkohore në zhvillimin kognitiv, në psikologjinë zhvillimore dhe në sociologji. Ato janë:

Arsimi i hershëm duhet të jetë social, ashtu që theksi të vihet në përvetësimin e aftësisë së gjuhës dhe të traditave në hapësirën sociale.

Çdo fëmijë në shoqërinë lokale duhet ta mësojë të njëjtën metodë.

Realizimi i barazisë në shanset që u mundësojnë fëmijëve mësimin e njohurive të cilat i posedojnë të mëdhenjtë e suksesshëm në shoqëri.

Hirsch mendon se ekziston dallim i madh mes përvetësimit të një metode arsimore të përbashkët për të gjithë studentët (apo nxënësit) siç veprohet në shkollat më të mira në botë, si Finlanda dhe Japonia, nga zhvillimi i metodave të ndryshme për çdo nxënë, siç janë praktikrat e dështuara aktualisht në Amerikë dhe në Francë.<sup>463</sup>

Sfera ku më shumë përfaqen efektet që dalin nga shkollat (rrymat) ideologjike aktuale në shoqëri është edukimi. Pra, synim i pedagogjisë në shoqëri është forcimi i imazhit të shoqërisë që kërkon ta ndërtojë pedagogjia, prandaj i gjithë potenciali mobilizohet për këtë, drejt saj orientohen individët dhe aktivizohen institucionet për ta realizuar këtë imazh. Synim i pedagogjisë mund të jetë sigurimi i ambientit të

<sup>463</sup> Eric Donald Hirsch, *Why Knowledge Matters: Rescuing our Children from Failed Educational Theories*, Cambridge, Mas: Harvard Education Press, 2016, fq. 7-11.



përshtatshëm për zhvillim të çdo individi në shoqëri, sa të ekzistojë mundësia, e kështu orientohen përpjekjet kah liria e individit dhe prania e të gjitha instruksioneve, zgjedhjeve dhe shpikjeve që sjell ajo (liria). Historia e pedagogjisë në shoqëri që kanë pranuar edukim ushtarak, shoqëri që janë mbështetur në epërsinë e zhvillimit ekonomik, shoqëri që janë mbështetur në edukimin fetar dhe etik dhe shoqëri që kanë gërshtetur një numër shembujsh dhe qëllimesh edukative. Pedagogjia në disa etapa ka qenë shumë konservatore, pra vetëm e bartte trashëgiminë dhe kulturën e një shoqërie nga njëra gjeneratë në tjetrën, kurse në disa etapa të tjera pedagogjia përfaqësonte përpjekjen për të lënë të lira potencialet e shpikjes, të zbulimit dhe të zhvillimit të sferave të reja të përparimit shkencor dhe kulturor.

Nuk ka asnjë dobi që sistemet edukative në shoqëritë islame të mbeten treg i teorive edukative që humbin rëndësinë dhe nevojën në vendet e veta. Pastaj, ide dhe përvoja edukative që mund të jenë të dobishme ekzistojnë edhe në shumë vende tjera të botës, përveç shteteve evropiane dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilat një kohë të gjatë kanë qenë kible e shoqërive islame për importin intelektual prej tyre. Në zhvillimet e bëra nga shumë mendimtarë dhe pedagogë muslimanë shohim filozofinë pedagogjike islame dhe teorinë pedagogjike islame shumë të frytshme. Kontributet e tyre asnjëherë nuk përjashtojnë mundësinë e vështrimit të eksperiencave njerëzore bashkëkohore në edukim, por në anën tjetër, ato janë të ndërtuara mbi ide të gjalla në trashëgiminë edukative islame, gjegjësisht të mbështetura në sfondin e orientimeve të shpalljes hyjnore dhe të udhëzimit pejgamberik, pastaj, në vartësi të intencave të tyre, këto instruksione zbriten në realitetin dhe rrethanat bashkëkohore.

#### 4. Vendi i Islamit në disiplinave pedagogjike

Shumica e shoqërive bashkëkohore islame kanë veçuar një lëndë mësimore apo më shumë në arsimin publik, të quajtur

pedagogji islame apo pedagogji fetare. Kjo lëndë (apo këto lëndë) gëzon peshë të caktuar në programin mësimor, e cila dallon nga njëri shtet në tjetrin. Në disa shtete islame ku përqindja e jomuslimanëve është e madhe caktohet lënda e edukimit etik, dhe aty mësohet nga pak prej secilës fe që njih ajo shoqëri. Në këtë rast, nxënësit e feve të ndryshme i gërshetojnë komponentët e përbashkëta të edukimit etik të cilët shprehin vlerat e përbashkëta.

Orientimet shekullariste në disa shtete islame insistojnë që të mos mësohet feja nëpër shkolla, sepse feja sipas vështrimit të tyre nuk është çështje e përgjithshme sociale, por është problem individual që i lihet familjes apo institucionit fetar.

Disa shoqëri islame fokusohen në mësimin fetar, prandaj ngrenë institucione të veçanta ku mbështeten lëndën dhe sistemet tradicionale të arsimit që njihen për shekuj me radhë, duke dashur të ruajnë identitetin, siç është rasti me arsimin e Ez'herit në Egjipt. Disa shoqëri të tjera u ngjajnë shoqërive të mëhershme në fokusimin që kanë për arsimin fetar, por një lloj arsimit më i hapur, pra bashkë me shkencat e sheriatit mësohen edhe shkencat e gjuhës arabe, disa shkencat sociale dhe natyrore, gjuhët e huaja etj. Kjo bëhet me qëllim të modernizimit të arsimit fetar. Meqenëse shumica e shoqërive muslimane sot mbështeten në sistemet e arsimit publik të zhvilluara nga administratat arsimore përgjatë epokës së kolonializmit. Pas largimit të kolonizatorit të drejtpërdrejtë, mbetën këto sisteme edukative për të kryer kolonizimin kulturor dhe edukativ. Këto sisteme i kushtojnë shumë pak kujdes edukimit fetar, për të mos thënë aspak. Megjithatë, shohim shtete islame të cilat lënë hapësirë për drejtime të ndryshme edukative-arsimore. Disa fokusohen në shkencat islame, por kjo dallon nga shteti në shtet. Nuk e mohojmë dot se në shtetet islame ekzistojnë tri lloje të institucioneve arsimore-fetare, të cilat zhvillojnë, si p.sh.: arsim të lashtë, arsim fundamental dhe arsim të përgjithshëm.

Kjo është e pranishme në arsimin publik, kurse sa i përket arsimin universitar, shumica e shteteve islame kanë fakultete dhe universitete të profilizuara në shkencat e sheriatit, apo

kanë katedra nëpër fakultete tjera të cilat kanë për detyrë nxjerrjen e ekspertëve të arsimit fetar në shkolla, përgatitjen e imamëve dhe hatibëve për në xhami, përgatitjen e ekspertëve në shkencat islame për të shërbyer në qarqet e gjykatave dhe të fetvave. Këtë e gjejmë në programet e fakulteteve të sheriatit dhe të studimeve islame, apo nëpër degë dhe katedra të studimeve islame nëpër fakultetet e adabeve (edukimit dhe letërsisë).

Pavarësisht se në këtë syth flasim për pozitën e Islamit në disiplinat pedagogjike, ne do të shohim se ajo që është folur për Islamin (në këtë drejtim), kryesisht ka të bëjë me tematika që ndërlidhen me shkencat islame (besimi, adhurimi dhe marrëdhëniet ndërnjerëzore) të cilat vazhdojnë të mësohen, por vështirë se mund t'i quajmë mendim pedagogjik islam. Gjithashtu, shohim se synimet e mësimi të këtyre tematikave përmbajnë pak zhvillim të mendimit pedagogjik islam. Megjithatë, disa studentë, si rezultat i prirjeve personale apo rrethanave të caktuara, mund të zhvillojnë veten në sferën e mendimit pedagogjik islam, edhe pse përqindja e këtyre studentëve është shumë e vogël.

Përderisa ekzistojnë shumë vepra bazike në botën perëndimore për mësimin universitar në fushën e disiplinave pedagogjike (si p.sh. hyrje në pedagogji, bazat e pedagogjisë, filozofia e pedagogjisë, metodat pedagogjike, psikologjia pedagogjike, teoritë e pedagogjisë dhe shumë disiplina të tjera pedagogjike), të cilat mësohen në gjuhë të huaj apo të përkthyer në gjuhën arabe, atëherë është e udhës të shihet qëndrimi i Islamit për këto libra apo vendi që ai zë në to.

Studimi i mendimit bashkëkohor perëndimor në çdo fushë shkencore (pedagogji, ekonomi, sociologji, politikë etj.) zbulon thellësinë e këtij mendimi në rrjedhën historike qysh në lashtësi, në Athinë dhe në Romë. Pastaj kalimthi jep disa sqarime për kulturën e vjetër egjiptiane, indiane apo irakiane. Pastaj lë në harresë epokën e errësirës evropiane,<sup>464</sup> historinë

<sup>464</sup> Historia perëndimore flet për shekujt e mesjetës me emrin "epoka e errësirave", e cila zgjati afërsisht dhjetë shekuj, nga rënia e Shtetit Romak Perëndimor deri në fillim të epokës së iluminizmit në Itali. Kjo është një periudhë historike e cila afërsisht fillon në vitin 500 dhe përfundon në vitin 1500. Shih: Charles Oman, *The Dark Ages (Quintessential Classics)*, Scotts Valley, California: CreateSpace, 2015.

tjetër të botës dhe kulturat tjera jashtë Evropës të cilat përjetuan një zhvillim të dukshëm shkencor, veçanërisht në kulturën islame, e që pastaj do të kalonte si epoka e iluminizmit në Evropë. Në këtë epokë u bënë shumë zbulime shkencore, gjeografike dhe reformime fetare, ku filluan të shfaqen dijetarë dhe studiues në sfera të ndryshme, dhe përfundoi me personalitetet pedagogjike të cilët me teoritë e tyre u dhanë trajtë praktikave bashkëkohore dhe moderne pedagogjike. Kjo është një lloj njëanshmërie e dukshme në mendimin pedagogjik perëndimor, njësoj siç veproi mendimi perëndimor edhe në fushat tjera shkencore.<sup>465</sup>

Ndoshta është e rëndësishme të spikatim faktin se lëndët në pedagogjinë islame dhe disertacionet universitare për personalitet pedagogjike islame janë bërë tematikë e studimit në një numër të konsiderueshëm të universiteteve.<sup>466</sup> Gjithashtu, vlen të theksohet se botimet moderne të disa librave metodologjikë në bazat e pedagogjisë (Textbooks on Foundation of Education) kanë shtuar disa paragrafë, ndonjëherë edhe një kapitull të plotë, për pedagogjinë islame, të cilat nuk kanë qenë të pranishme në botimet e mëhershme të këtyre librave.<sup>467</sup> Ky zhvillim reflekton sadopak gjurmët e pranisë islame të kufizuar në shoqëritë perëndimore, sesa përkushtimin e miliona muslimanëve në botë apo pranimin e kulturës islame dhe kontributet e thella në historinë e njerëzimit.

<sup>465</sup> Melkavi, "Et-Tehajjuzu fi 'l-fikr'it-terbevijj'il-garbijj", vep. e cit., fq. 181-202

<sup>466</sup> Në konsultimin e "Dissertation Abstract International (DAI)" në internet. Me titullin "Islamic education" gjejmë një sërë disertacione doktoratash. Nëse i jep saktë emrat e personaliteteve islame, do të gjesh hulumtime për kontributin pedagogjik të tyre si p.sh. për Ibn Tejmijen, Gazaliun, Ibn Haldunin dhe të tjerë.

<sup>467</sup> Robert McNergney, & Hoanne Herbert, *Foundation of Education: the Challenge of Professional Practicem*, Boston: Allyn and Bacon, Third Edition, 2001, fq. 152.

## Pjesa e katërt: Vlerat në disiplinat pedagogjike

### 1. Kujdesi i domosdoshëm për pozitën e vlerave në disiplinat pedagogjike

Më herët treguam se shkencë ka tri elemente, ku i pari ishte elementi i cili ndikon në ndjenjat, orientimet dhe vlerat e njeriut, po ashtu, në mënyrën e bashkëveprimit dhe të sjelljeve të tij. Në bazë të kësaj, vjen nevoja për të bashkëvepruar me këtë aspekt përmes vështrimit të etikës së njohjes shkencore dhe mënyrave të ndikimit të tyre në nivel të botëkuptimit logjik dhe shpirtëror tek ai që e mëson këtë lloj të dijes. Ndonjëherë efekti i dijes shfaqet në objektivat, gjegjësisht në përfitimet dhe dëmet që sjellin ato. Dihet se mënyra përmes së cilës mësuesi e paraqet lëndën shkencore ndikon në orientimin që do të kenë nxënësit ndaj asaj disipline dhe i ndihmon për përvetësimin e tematikës, madje ndoshta i dallon dhe i bën kreativ në atë fushë, apo është bazament për zgjedhjen e fushës së specializimit në etapat vijuese studimore.

Ekziston ndërthurje e madhe mes termave që kanë lidhje me këtë element shkencor, prandaj shohim përdorimin e shumë termave si “drejtimet”, “prirjet”, “vlerat”, “etika”, “ndjenjat”, “emocionet” dhe termat e tjerë. Jemi përcaktuar të flasim më gjerësisht për termin “vlera” i cili lidhet drejtpërdrejt me mendimin pedagogjik islam, qofshin këto vlera pjesë e një tematike studimore, objektiv edukativ i asaj pjese apo vlera që karakterizojnë ndërtimin e karakterit njerëzor të nxënësit, kuptohet si rezultat i mësimin nga ana e nxënësit të kësaj tematike. Vlerat janë gjëja më e rëndësishme që e formon personalitetin e njeriut, sidomos kur ato lidhen vlerat e besimit. Më saktë, vlerat e besimit e detyrojnë optimizmin në jetë dhe e nxisin të jetë aktiv në shoqëri, dhe

atë jo për ta promovuar veten, por për ta mbushur jetën me aktivitet dhe gjallëri, si ambientin, ashtu edhe shoqërinë. Gjithashtu, këto vlera e bëjnë të jetë nismëtar i të mirave, hulumtues, perfeksionues, shpikës dhe i pasionuar pas reformës, ndërtimit dhe përparimit. Personaliteti i pajisur me vlerat e besimit patjetër të reflektojë në marrëdhënien e individit me shoqërinë përreth, derisa të arrihen karakteristikat e bashkëpunimit, mëshirës dhe plotësimit të ndërsjellë mes individëve të cilët e formojnë trupin e umetit, e pastaj sistemi i vlerave të reflektojë në jetën e tyre përmes besimeve, adhurimeve dhe marrëdhënieve të cilat si të tilla e përforcojnë dimensionin shoqëror në jetën e umetit.

Gjëja më e rëndësishme që karakterizojnë vlerat në vështrimin pedagogjik islam është përcaktimi i saktë i synimeve që kërkon të zbatojë edukimi përmes sigurimit të plotësimit të ndërsjellë mes komponentëve të veprimtarisë pedagogjike, e që janë: njohja shkencore, mënyrat e të menduarit dhe të kërkimit të fitimit të saj dhe efekti etik i funksionalizimit të tyre. Po ashtu, pedagogjia kërkon t'i realizojë synimet përmes plotësimit të ndërsjellë në ndërtimin e personalitetit njerëzor sipas natyrshmërisë së pastër që ka falur Allahu në sferën logjike, etike dhe ndërgjegjësore.

Rëndësia e trajtimit të pozitës së vlerave në mendimin pedagogjik vjen nga nevoja e dallimit të lëndës studimore të përcaktuar nga metodat dhe programet pedagogjike nga faktet, konceptet, parimet, ligjet dhe teoritë që përcakton zakonisht kjo lëndë në dritën e përvojës reformuese nga njëra anë, dhe burimi që vlen të jetë sfond i gjykimit të kësaj lënde shkencore për nga pikëpamja logjike dhe vënia e tyre në funksion të qëllimeve praktike nga ana tjetër. Burimi këtij gjykimi nuk mund të jetë fshehur në vetë lëndën, pra patjetër të vijë nga jashtë. Në doktrinën fetare islame të mbështetura në tekstet e shpalljes hyjnore dhe në traditën pejgamberike mund të gjejmë formësimin e kësaj prapavije në botëkuptimin tonë për dijen shkencore dhe përcaktimin e objektivave tona të shariatit për t'i vënë ato në funksion.

Një shkak tjetër që sqaron rëndësinë e trajtimit të pozitës së vlerave në mendimin pedagogjik islam është fakti se shumë shkencë natyrore, shoqërore dhe humane, të cilat janë tematika të metodave studimore në shoqëritë islame, janë disiplina shkencore të zhvilluara në tre shekujt e fundit në Evropën perëndimore dhe në Amerikë. Këto disiplina, për nga natyra e formimit, mënyra e formësimit dhe metodat e funksionalizimit të tyre, nuk janë pa sponde (apo burime) të vlefshme në nivel të botëkuptimit dhe të funksionalizimit, sepse ato kanë trajtesa ideologjike dhe filozofike që kërkojnë nivel të lartë të vetëdijes dhe aftësisë së zberthimit (të çështjeve). Kjo sepse orientimi intelektual shekullar në perëndim e ka bërë dijen burim në vetvete, dhe atë jo vetëm në shkencat natyrore, por edhe në shkencat humane dhe shoqërore. Për këtë, Musejriu ka thënë: “Shkencat humane u shkëputën plotësisht nga ajo që ishin në epokën e renesancës evropiane, kështu që, çdo shkencë u bë burim në vetvete. Burimi i ekonomisë u bë ekonomia, burim i politikës u bë politika... Kjo realisht do të thotë shkëputje e plotë dhe gjithëpërfshirëse, apo thënë ndryshe kjo shkëputje quhet edhe si shekullarizim i tërësishëm, marksizëm i plotë i dijes dhe imponim i shembujve materialistë. Procesi i ndarjes apo shkëputjes e vërshoi edhe botën tonë islame, prandaj mund të themi se shkencat humane dhe natyrore të cilat mësohen nëpër universitetet e botës islame burojnë nga artikujt shekullarist që e kalojnë dimensionin e moralit dhe të njerëzisë. Nuk do të sigurohet vetëdija e plotë për vlerat e fshehta në këto shkencë përveçse përmes perceptimit të thellë të dimensioneve të përgjithshme dhe përfundimtare islame.”<sup>468</sup>

Çështja e pranisë së vlerave në programet e arsimit dhe në disiplinat shkencore është një çështje që ndërlihet me mendimin pedagogjik islam të kërkuar. Kjo është çështje orientimesh të cilën duam ta ngulitim thellë në shpirtat e të rinjve të umetit, pra fjala është për orientime intelektuale të

<sup>468</sup> Abdulvehhab El-Musejri, “Fi ehemmijjet’id-ders’il-ma’rifij”, në: Nahve nidhamin ma’rifijjin islamijj, i redaktuar nga Fet’hi Hasen Melkavi, Aman, Jordani: El-Ma’hed’ul-alemijju li’l-fikr’il-islamijj, 2000, fq. 59

mishëruara dhe për vlera shpirtërore të përvetësuar, jo për dije të ftohtë pa shpirt apo me shpirtin e atyre që e prodhojnë, kështu u vishet dogmatizmi dhe prapambetja. Nëse një ide pedagogjike është reformuese, atëherë ajo ka vlerë të veçantë në ndërtimin e personaliteteve të dalluara të umetit. Sa kemi nevojë për ide që ta lëvizin umetin në drejtim të përparimit, për ide që u sigurojnë të rinjve të umetit një imazh i cili e kënaq arsyen dhe zemrën e tyre, dhe kështu ata të bëjnë thirrje për ndryshim dhe përparim!

Tema e vlerave dhe e pozitës së tyre në pedagogji është një çështje që ngjalli kërkimin e institucioneve të shoqërisë në dy nivele: në nivel lokal dhe botëror. Pastaj kjo çështje lidhet me veprimtarinë pedagogjike, me filozofinë, me bazat teorike dhe me praktikën e saj. Siç shihet, kjo vjen nga ndryshimi i madh dhe i vazhdueshëm në sistemin e vlerave, të sjelljeve me vlerë dhe të etikës në institucionet e arsimit dhe në shoqërinë në përgjithësi.<sup>469</sup> Revista Botërore për Hulumtim dhe Zhvillim Përparimtar publikoi një hulumtim me titull: “Të rinjtë dhe vlerat etike në botën dinamike”, ku hulumtuesi Capel Def zbuloi se aspekte të sjelljeve joetike dhe josociale të rinjtë në përgjithësi dhe të nxënësit e shkollave në veçanti sa vijnë e shtohen dita-ditës.<sup>470</sup>

Në vitin 2016, në fjalorët e gjuhës angleze hyri një shprehje për situatën e re të krijuar, e cila filloi të përhapet në botë sot, pra situata e postrealitetit (post truth).<sup>471</sup> Kjo fjalë u zgjodh si fjalë e vitit (për vitin 2016), e cila shpreh humbjen e realitetit për shkak të përhapjes së gënjeshtërs, falsifikimit, mashtrimit dhe lajmeve të fabrikuara, e që e kundërta nënkupton kthimin e vlerave në jetën politike, mediatike dhe arsimore.<sup>472</sup>

<sup>469</sup> Ka një sërë studimesh për pozitën e vlerave në programet arsimore, në burimet teorike që mbështeten dhe në vlerësimin e pranisë së tyre në programet arsimore. Në mesin e studimeve që paraqesin një vështrim filozofik të mësimin të vlerave është: Alau Sahibu Asker Abbas, *Nehve ru'jetin felsefijetin terbevijetin li 'l-kijemi, Aman, Daru Gajdau li 'n-Neshri ve 't-Tevzi'i*, 2010.

<sup>470</sup> Kapil Dev, *Youth and moral values in a changing society, International Journal of Advanced Research and Development*, Issue 4; July 2017, fq. 164-167.

<sup>471</sup> Termi “post truth” është një veti e cila nënkupton situatën faktike ku të vërtetat objektive kanë më pak ndikim në formimin e mendimit të përgjithshëm nga ndjenjat dhe doktrinën personale. Këtë shprehje fjalorët gjuhësorë të Oksfordit e konsideruan si fjalë të vitit 2016. Shih: <https://www.chronicle.com/specialreport/The-Post-Truth-Issue/84>.

<sup>472</sup> *The Chronicle of Higher Education*, Special Report, January 11, 2017.



Gazeta britanike “The Gardian”, në muajin nëntor të vitit 2017 publikoi një artikull me titull “Ne tani jemi në një botë të postrealitetit me humbje të besimit dhe të përgjegjësisë, e kjo nuk do të përfundojë mirë.”<sup>473</sup>

Revista për çështjet ndërkombëtare e Institutit Mbretëror për Çështje Ndërkombëtare Britanike “Chatham House” publikoi një artikull me titull “Marrëdhëniet ndërkombëtare në epokën e politikës së postrealitetit”. Në artikull thuhet se ngjarjet botërore në vitin e kaluar (fjala është për vitin 2016) bënë të publikohen libra dhe raporte të shumta që flasin për atë se politika bashkëkohore është tjetërsuar nga epoka e arsyes dhe e fakteve në epokën e trazimit dhe gënjeshtërisë. Artikulli është sintezë e një sërë librash që u botuan së fundmi për epokën e postrealitetit. Autori i artikullit ka propozuar të kthehet vështrimi kah verifikimi i lajmeve të rrejshme, kah studimi i vlerave të fshehura pas drejtimeve nxitëse, raciste dhe nacionale, kah roli i mjeteve mediatike dhe i metodave të komunikimit në politikën ndërkombëtare bashkëkohore.<sup>474</sup>

## 2. Premisat e përkushtimit ndaj vlerave në disiplinat pedagogjike

Vlera e njeriut fshihet te shfaqja e vlerave dhe e parimeve të shëndosha që i japin atij vetëbesim dhe vetëdije për funksionin që ai gëzon në jetë. Marrë parasysh dhuntinë e vazhdueshme, njeriu i vlerave është si pema e bekuar, rrënjët i ka ngulitura thellë në tokë, degët e ngritura lart në qiell dhe jep fruta çdo kohë. Pa këto vlera njeriu bëhet i luhatshëm, i pavendosur, i paqëndrueshëm në parim dhe qëndrim, dhe lëkundet nga ëndjet dhe epshet dhe rrëzohet nga furtunat nxitëse mediatike, pra bëhet si një kashtë të cilën e lëkund era

<sup>473</sup> Nick Enfield, “We are in a post-truth world with eroding trust and accountability. It can’t end well”, *The Guardian*, Thursday 16 Nov. 2017.

<sup>474</sup> Rhys Crilly, *International Relations in the Age of ‘Post-Truth’ Politics*, *International Affairs*, Volume 94, Issue 2, 1 March 2018, fq. 417–425.

çdo anë. Kështu njeriut nuk do t'i rritet vlera më shumë se një kashtë, edhe nëse posedon pasuri të mëdha.

Pedagogjia nuk fokusohet vetëm në mësimin e vlerave të vegjëlve, sepse s'ka gjë më të rrezikshme që i kërcënon vlerat e shoqërisë sesa moscilësimi i të mëdhenjve me vlera të çmueshme. Me fjalët të mëdhenjtë këtu synohen baballarët dhe nënat, mësuesit, mësueset, profesorët, rektorët mjekët, inxhinierët, politikanët, gazetarët dhe të tjerët. A nuk dëgjojmë çdo ditë për probleme të korrupsionit pikërisht te këta?! A nuk dëgjojmë çdo ditë afera të ndryshme korruptimi te kryetarë, ministra, përgjegjës të mëdhenj nëpër shtete të ndryshme të botës?!

Aferat e korrupsionit paraqiten në forma të ndryshme, prandaj thuhet: korrupsion financiar, korrupsion administrativ, korrupsion moral... Në fakt, të gjitha llojet e korrupsionit janë korrupsion moral, sepse vjedhja e pasurisë, falsifikimi i dokumenteve dhe marrja e ryshfetit<sup>475</sup> janë veprime të ulëta morale. Ushtrimi i korrupsionit nga ana e përgjegjësit në marrëdhënie me nëpunësit, duke i ndërtuar me ta marrëdhëniet në bazë të nepotizmit dhe interesave personale, dhe duke lënë mënjanë aftësitë, përparësitë dhe të drejtat, krejt kjo është korrupsion moralo-etik. Profesionistët si mjekët, inxhinierët dhe kontraktuesit që merren me mashtrime në punët e tyre, të gjithë janë të përfshirë në korrupsionin moralo-etik. Çdo formë e korrupsionit buron nga mungesa e vlerave të mirëfillta.

Kur themi se më të mëdhenjtë në familje duhet të jenë model dhe shëmbëlltyrë, që më të vegjlit t'i ndjekin gjurmët e tyre dhe të pajisen me vlera të larta morale, atëherë me të njëjtën logjikë mund të themi se përgjegjësi në gjykim po ashtu mund të jetë shëmbëlltyrë dhe model, në mënyrë që anëtarët tjerë të shoqërisë të trasojnë rrugën e tij dhe të

<sup>475</sup> Ryshfet do të thotë dhënia e gjësë për një përfitim, për ta bërë diçka të ndaluar apo për të privuar diçka të detyruar. Shih: *Mexh'meu 'l-lugat'il-arabijeti. El-Mu'xhem'ul-vesit*, Stamboll, Dar'ud-Da'veti, 1989, vëllimi I, 347.

- Mexhdud-din Ebu Tahir Muhamed bin Ja'kub El-Fejruzabadi (817 h.), *El-Kamus'ul-muhit*, i redaktuar nga Mektebu Tahkik'it-Turathi fi Muesseset'ir-Risaleh, nën mbikëqyrjen: Muhamed Neim El-Areksusi, Bejrut, Muesseset'ur-Risaleti li 't-Tibaati ve 'n-Neshri ve 't-Tevzi'i, botimi VIII, (1426 h./2005), fq. 1288.

pajisen me vlera. Përgjegjësi në institucion mund jetë gjithashtu model dhe shëmbëlltyrë vlerash për nëpunësit. Çdo njeri i rritur mund t'i përkujtojë momentet pozitive dhe influencuese, bile mund ta ndryshojë edhe rrjedhën e jetës së tij për shkak të disa çështjeve apo për shkak të sjelljes së mirë etike që mund ta shohë te ndonjë ministër, mjek, profesor në universitet, vozitës i taksisë në rrugë etj.

Për këtë, tema e vlerave zë vendin kryesor në mendimin pedagogjik islam. Kjo temë, edhe pse është intencë dhe objektive e pedagogjisë, ajo gjithashtu është një nga manifestimet e mendimit pedagogjik islam, prandaj meriton t'i kushtohet vëmendje e veçantë dhe të shihet pozita e saj në sistemin pedagogjik, dhe atë në dritën e një sërë premisash, ku ndër të tjerash janë këto:

Vlerat, shembujt shembullorë, etika, virtytet, drejtimitet psikike (shpirtërore), aspektet emocionale dhe të ndërgjegjes, të gjitha këto janë të ndërthurua shumë me njëra-tjetrën.<sup>476</sup> Një ose më shumë prej këtyre koncepteve i gjejmë të pranishme në secilin rast kur flitet për objektivat e pedagogjisë në çdo etapë të historisë dhe në çdo shtet të botës. Kjo e konfirmon faktin se ato janë të lidhura me fitren (natyrshmërinë e pastër) njerëzore, e cila synon katarzën (pastrimin shpirtëror), forcimin, mësimin dhe edukimin e këtij karakteri të pastër njerëzor.

Problematika e vlerave dhe e etikës është përcaktuese dhe saktësuese e sjelljeve njerëzore, të cilat janë të lidhura me krenarinë njerëzore, e dallojnë llojin njerëzor nga krijesat tjera dhe e ndërlidhen me jetën individuale të njeriut, pra e mësojnë për rëndësinë e plotësimit të esencës etike me

<sup>476</sup> Disa hulumtues, për këtë fushë semantike kanë zgjedhur një shprehje të caktuar e cila i përfshin gjërat më të rëndësishme në një titull studimor, si p.sh. pedagogjia e vlerave, pedagogjia e ndërgjegjes apo pedagogjia etike. Shih:

- Omer Ibn Budhenineh, "Et-Terbijet'ul-vixhdanijetu min mendhurin islamijjin mukarrenin", (disertacion doktorate, Fakulteti i Usuli Dinit, Universiteti i Emrit "Abdulkadir" për Shkencat Islame, Kasnetije, Algjeri, 2017);

- Abbas Subhi Kenan, "Et-Terbijet'ul-ahlakijetu ve binau 'l-menhexh'it-ta'limijji fi Lubnan", (Disertacion doktorate në fushën e pedagogjisë, Universiteti Botëror i Shkencave, 2016).

qenësinë fizike.<sup>477</sup> Gjithashtu, këto vlera etike lidhen ngushtë edhe me nevojat e shoqërisë njerëzore dhe me jetën e përbashkët të tyre.

Problematika e vlerave i takon thelbit së asaj që e kanë legjitimuar fetë dhe filozofitë e ndryshme qysh kur ka filluar jeta njerëzore. Pastaj, këto problematika nuk u lihen bindjeve personale dhe orientimeve ideologjike individuale. Nuk janë kritere që përcaktohen nga metoda demokratike. Janë vlera që duhet t'u mbahen të gjithë anëtarët e shoqërisë duke ruajtur në nivel të lartë edhe liritë personale. Nuk është për t'u habitur se në vlerat dhe normat etike ekzistojnë kritere absolute të përgjithshme që pranohen njëzëri nga njerëzit e mençur, kuptohet për shkak të veçorive që përmbajnë në vetvete.

Përkushtimi ndaj çështjes së vlerave në arsim bëhet në dy segmente. I pari është segmenti negativ i cili vjen në shprehje gjatë trajtimit të kundërvajtjeve. I dyti është segmenti pozitiv i cili ngrihet mbi arsimimin e vlerave me qëllim të pengimit të kundërvajtjeve. Vërejmë se legjitimimet pedagogjike në temën e vlerave përmbajnë dy segmente paralelisht. Kemi dy tipa të këtyre legjitimimeve: tipi i parë i paraqet vlerat brenda objektivave pedagogjike të cilat kërkon t'i realizojë pedagogjia. Këtu kryesisht bëjnë pjesë tekstet strukturaliste të përgjithshme të cilave u mungojnë metodat e përshtatshme për vlerësim. Tipi i dytë paraqet sistemet, arsimimet e veçanta, dhe procedurat e domosdoshme edukative për të trajtuar kundërvajtjet që rastisin në këto sisteme dhe arsimime, qofshin në nivelin e nxënësve apo në nivelin e mësuesve. Ky tip vjen në shprehje në tekstet procedurale të caktuara dhe të qarta. Në sajë të këtyre dy segmenteve, që i kushtojnë vëmendje vlerave, segmenti pozitiv i cili përqendrohet në pajisjen me vlera është bazamenti kah duhet drejtuar përpjekjet edukative.

<sup>477</sup> Në veprën "Musnedu Ahmed", vep. e cit., vëllimi 40, hadithi numër 24392, fq. 357, i transmetuar nga nëna e besimtarëve, Aishja r.a., e cila ka thënë: "I Dërguari i Allahut a.s. thoshte: O Allah, Ti që ma zbukurove fizionominë, ma zbukuro edhe moralin!" Gjithashtu në "El-Musned", në librin "el-mukeththirine mine 's-sahabeti", transmetohet i njëjti hadith nga Abdullah bin Mesudi, vëllimi 6, hadithi numër 3823, fq. 373. Dijetarët e kanë nxjerrë si të saktë këtë hadith, por i kanë dhënë si të dobëta shumë transmetime.

Vlerat shprehin ndjenjat ndërgjegjësuere dhe emocionale në shpirtin e individit. Megjithatë, vlera përcaktohet me një element njohës i cili shpreh tematikën e vlerës. Gjithashtu, përcaktohet nga idetë dhe njohuritë e individit për tematikën. Në të njëjtën kohë, vlera përfaqet edhe në elementin e quajtur sjellje, sepse shpreh një veprim të cilin njeriu e bën apo nuk e bën me kënaqësi dhe me dëshirë. Kështu e shpreh segmentin pozitiv apo negativ të veprimit. Vlera ka tri elemente: elementi emocional, elementi njohës dhe elementi i sjelljes.

Vlerat dhe etika, në kontekstin e këtij hulumtimi, nuk fokusohet në çështjet e njohura si sinqeriteti, amaneti, besnikëria dhe vlerat tjera të përgjithshme, të cilat lidhen me sjelljet e individit me vetveten dhe me të tjerët, por bashkë me këto përfshijnë edhe grupe vlerash të tjera të ndërlidhura me jetën qytetare, si p.sh.: përgjegjësia sociale, respekti i të tjerëve, vlerat e kujdesit, përkatësia e përgjithshme në qarqe të ndryshme të nivelit të shoqërisë, të umetit dhe të mbarë njerëzimit. Gjithashtu, këtu përfshihen vlerat profesionale të ndërlidhura me funksionet dhe punët e veçantë, me bashkëveprimin me gjërat e ambientit jetësor, me mirëmenaxhimin e tyre, me investimin e tyre dhe me vlerat shkencore “akademike” që ndërlidhen me bazat e hulumtimit, me normat etike dhe me gjëra të tjera.

### 3. Mësimi i vlerave në universitete

Biseda për vlerat, për normat etike dhe për drejtimet në sferën pedagogjike, zakonisht bëhet në arsimin publik, sidomos në etapat e para të arsimit shkollor. Megjithatë, nuk i shpërfillim edhe aktivitetet e çmuara që u kushtojnë rëndësi vlerave në arsimin universitar.

Në këtë kontekst meriton të përmendet Shoqëria për Vlerat në Arsimin e Lartë (Society for Values in Higher Education), rrënjët e themelimit të së cilës kthehen në vitin 1923, por u zhvillua, mori formë dhe emrin aktual në vitin 1975, kur edhe mbajti konferencën vjetore ku paraqiti hulumtimet dhe studimet e bëra në këtë sferë. Organizoi

kurse trajnuese dhe punuese për problematikën e vlerave në arsimin universitar.<sup>478</sup> Nga boshtet që trajton Shoqëria janë tematikët që lidhen drejtpërdrejt me vlerat, si p.sh.: leksikoni i vlerave në arsimin universitar, kultura krahasuese dhe feja, kultura popullore, feja dhe dhuna, perspektiva e normave të përgjithshme morale, roli i vlerave në formësimin e praktikave arsimore universitare, aktivitetet e mësimin të vlerave, vlerësimi i mësimin të vlerave dhe të tjera. Konferenca e 95 e saj u organizua në periudhën nga 10 deri më 14 korrik 2019 në Universitetin Loyola të Çikagos. Temë e konferencës ishte “Kryqëzimi i aftësive: mungesa dhe konkurrenca në arsimin sipëror”. Shoqëria, në bashkëpunim me Universitetin Indiana, në vitin 2018 organizoi një takim pune për populizmin e ri dhe politikat ndarëse dhe diskriminuese.

Shoqëria në fjalë e publikon revistën periodike multidisiplinare me titull “Soundings”, ku publikohen artikuj dhe hulumtime për tematikat që ndërlidhen me të gjitha aspektet e vlerave njerëzore, si p.sh. vlerat estetike, etike, politike, ekonomike, shkencore dhe fetare. Gjithashtu, publikon edhe një revistë mujore digjitale me emrin “Forumi i vlerave në arsimin e lartë”. Kjo është revistë e njohur ndërkombëtarisht dhe posedon një forum të hapur për diskutimin e problematikës së vlerave të cilat ndikojnë në arsimin e lartë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Megjithatë, çështja e vlerave në arsimin e lartë nuk është problem lokal që lidhet vetëm me një shoqëri apo vetëm me praktikën fetare, por është një problematikë ndërkombëtare. Për këtë arsye, në vitin 1998 UNESCO publikoi një dokument enkas për këtë çështje, e cila e mban titullin “Deklarata Botërore rreth arsimit të lartë për shekullin XXI: vështrim dhe veprim”. Kjo deklaratë pohon se arsimit i lartë ka nevojë për zgjerim të harkut të llojlloshmërisë dhe për vetëdije më të lartë dhe më gjallëruese për zhvillimin social / kulturor, për zhvillimin ekonomik dhe për ndërtimin e perspektivës së gjeneratave të ardhshme të cilat duhet të jenë të pajisura me

<sup>478</sup> <https://www.svhe.org>.

shkathtësi, njohuri dhe me plot modele të reja. Deklarata sjell përfundimin se shoqëritë bashkëkohore në botë kalojnë një krizë të thellë në sferën e vlerave (faqja e dytë), prandaj në shumë klauzola e thekson domosdoshmërinë e përvetësimit të vlerave që lidhen me arsimin e lartë (klauzola e parë), zhvillimin e harqeve të përgjegjësisë etike (klauzola e dytë), përcaktimi i kriterëve etike (klauzola e katërt) dhe domosdoshmëria e marrjes në konsideratë të vlerave kulturore vendase (klauzola e njëmbëdhjetë) etj.<sup>479</sup>

Ne e trajtojmë problemin e vlerave në arsimin universitar, sepse libri ynë parimisht u drejtohet profesorëve universitarë dhe sepse shumica e atyre që punojnë në arsimin fillor apo të mesëm janë përgatitur nëpër universitete. Shoqëria Ndërkombëtare e Universiteteve, e cila bashkëpunon zyrtarisht me UNESCO, i kushton rëndësi tematikës së vlerave në përgjithësi dhe vlerave universitare në veçanti. Për këtë arsye, në deklaratën e dhënë për përkrahjen e vlerave akademike, Shoqëria në fjalë theksuar vlerat vijuese, si p.sh.: liria akademike, pavarësia e universiteteve, e drejta e dijes për të gjithë, respektimi i mendimit ndryshe, universitetet detyrohen të ofrojnë mendimin kritik në hulumtim për të gjetur të vërtetën. Shoqëria në fjalë, po ashtu, ka përkrahur vlerat etike që kanë të bëjnë me përgjegjësinë e universiteteve drejt shoqërisë, duke i cilësuar ato si institucione shoqërore, veçanërisht kur është në shprehje orientimi i arsimit, hulumtimi për t'u shërbyer shoqërive dhe zhvillimi i parimeve si liria, drejtësia dhe evoluimi, duke u shtuar këtyre edhe ruajtjen e dinjitetit njerëzor dhe solidaritetin mes njerëzve.<sup>480</sup> Kjo Shoqëri çdo vit organizon nga një konferencë për ndonjë problematikë të përgjithshme e cila në boshtet e saj përfshin domosdoshmëri të përmasat e vlerave të asaj problematike, kurse disa konferenca të tjera i përkushtohen tërësisht problematikës së vlerave.

Nga institucionet tjera botërore që merren me problematikën e vlerave është Rrejtja Global e Etikës

<sup>479</sup> UNESCO. *World Declaration on Higher Education for the Twenty-First Century: Vision and Action*. Paris: UNESCO, 1998.

<sup>480</sup> <http://www.unesco.org/iau/iau-mission.html>.

(gloethics.net), me seli në Gjenevë. Ka forum ndërkombëtar me personalitete të shquara nga vende të ndryshme të botës. Ky Rrjet siguron një platformë elektronike për mendimin dhe praktikat etike.<sup>481</sup> Ushtron aktivitete të llojllojshme në sferën e hulumtimit dhe të fitimit të dijes për etikën. Ndër synimet e saja të publikuara në faqen elektronike është që njerëzve mbarë botën t'u sigurojë të drejtën e mendimit dhe të sjelljes në çështjet etike, në mënyrë që kështu të sigurohet mbërritja te resurset njohëse në etikën aplikative. Rrjeti siguron një bibliotekë digjitale botërore e cila është lider në sferat e vlerave dhe etikës. U ofron individëve regjistrim falas për të pasur qasje në tekstet e plota të revistave, të enciklopedive, të librave elektronikë dhe të shumë burimeve tjera në bibliotekë.

Tematika e vlerave dhe e vetive emocionale dhe ndërgjegjësores është bërë objekt i shumë studimeve që e trajtojnë këtë tematikë nga kënde të ndryshme, gjegjësisht nga këndi filozofik, psikologjik, pedagogjik, social, politik, administrativ dhe nga shumë këndvështrime tjera. Kuptimi i tematikës së vlerave dhe pozita e tyre nëpër programet arsimore u përziën shumë, aq sa kjo përzierje krijoi konfuzion në çdo burim që ndikon në botëkuptimin, gjykimin dhe bashkëveprimin me to. Dikush shprehet se vlerat dhe normat etike janë çështje zakonore dhe relative të cilat ndryshojnë në varësi të ndryshimeve dhe novitetëve në jetën e njerëzve. Të tjerë thotë se vlerat morale nuk kanë lidhje me fenë, sepse ekzistojnë vlera dhe virtyte moral edhe te njerëzit e pafe. Disa të tjerë shprehen se avancimi është veti e përgjithshme, pra, ai që avancohen në formë, në dije dhe në kulturë posedon vlera që meritojnë vlerësim, prandaj vlerat e njerëzve të avancuar dhe të zhvilluar duhet përvetësuar dhe mishëruar para së gjithash. Po ashtu, disa studiues pohojnë se bota ka arritur një nivel komunikimi i cili i tejkalon vlerat e veçanta të shoqërive lokale. Kështu që, vlera funksionale janë vlerat globale që sigurojnë paqe, bashkëjetesë, barazi të plotë,

<sup>481</sup> www.globethics.net.



liritë e përgjithshme, të drejtat e njeriut, të fëmijëve, të burrave dhe të grave etj.

Këtë e shoqëroi edhe përhapja e shpejtë e ideve dhe mendimeve të tilla në arenën e hapur ndërkombëtare, kuptohet falë mekanizmave modernë të komunikimit. Megjithatë, çështja nuk ndalon te mendimet dhe te përhapja e tyre, paralel me to u shtuan ndjeshëm situatat e mërziës, pikëllimit dhe depresionit nga njëra anë, dhe situatat e radikalizmit, të armiçësisë dhe të gjitha format e krimit nga ana tjetër. Virtytet e larta të jetës, kriteret e sjelljes së mirë etike dhe konceptet “e vërtetë”, “drejtësi” dhe “e mirë” filluan të humbin nga praktika politike, ekonomike dhe sociale, dhe atë në të gjitha nivelet shkencore, regjionale dhe lokale, bile u ndezën luftëra me prova të rrejshme, u shfarosën shoqëri të plota për shkak të doktrineve dhe për shkak të përhapjes së fenomenit të postrealitetit që u theksua më herët në këtë kapitull.

Revista “Chronicle of Higher Education” (Kronika të Arsimit të Lartë), më datë 15 janar 2017, publikoi një libërth me gjashtë artikuj të titulluar “Problemi i postrealitetit”. Titujt e artikujve në këtë libërth ishin këto: “Kur e vërteta bëhet artikull tregtar”, “Një popull që s’di asgjë”, “Partia e doktrave”, “Komploti antiamerikan”, “Facebooku dhe gënjeshtria” dhe “Google dhe masa e humbur”.

Artikujt e libërthit flasin për dukuri të reja në arsimin universitar amerikan, si p.sh. ‘llastimi’ i studentëve, trajtimi i tyre si klientë, përhapja e universiteteve të padenja, fryrja e notave të studentëve, reflektimi i karakterit të marrëdhënies mes profesorit dhe studentit, dhe shumë dukuri të tjera akademike, të cilat i ka dokumentuar plotësisht njëri nga shkruarit e këtyre artikujve. Megjithatë, shkrimtari të gjitha këto i trajtoi si çështje dytësore krahasuar me një problematikë të përgjithshme shumë më të madhe se këto, e ajo është paraqitja e një defekti në konceptin e “atdhesimit”, ku shohim se sistemi arsimor dështon në përgatitjen e tyre për të realizuar detyrimet në jetën e përgjithshme. “Kështu zhyten në anarki si rezultat i indiferencës dhe i angazhimit

pasiv në burimet e dijes së ofruar nëpër media dhe rrjete sociale. Madje ka edhe më keq se kaq, kërkohet shmangia e njerëzve nga pjesëmarrja në politikë, e cila është detyrim qytetar, dhe inkuadrimi i tyre në luftën e paepur kundër mjeteve të komunikimit social duke sulmuar gjithçka, kurse në anën tjetër besojnë gjithçka (të drejtë dhe padrejtë).<sup>482</sup>

Në njërin nga punimet e Libërthit thuhet: “Universitetet nuk dështuan vetëm në përçimin e mesazhit dhe në arsimin e të rinjve, qofshin meshkuj apo femra, por dështuan edhe në ofrimin e bazave të njohjes kulturore mbi të cilën ngrihet praktika qytetare në procesin e zgjedhjes. Këto forma të dështimit kërcënojnë praninë dhe perspektivën e demokracisë amerikane.”<sup>483</sup>

Ky digresion të cilin e paraqet revista për dështimin e arsimit të lartë në Amerikë, mbase nuk e paraqet tërësisht të vërtetën e realitetit të arsimit universitar amerikan, sepse ka edhe përvoja dhe vlera pozitive apo negative, mirëpo, ky është një cytës i denjë për të provokuar vetëdijen tonë për mangësinë e vlerave në universitetet tona në botën arabe-islame. Po ashtu, është një ndihmës i mirë për të pasur qasje dhe për të përfituar nga eksperiencat e arsimit të vendeve tjera.

Shumë libra referues dhe metodologjikë u publikuan në sferën e vlerave për arsimin universitar, të cilat nuk është rasti t’i numërojmë, por do të theksojmë vetëm disa syresh të librave që u botuan së fundmi. Në hyrjen e një libri i cili flet për arsimin e vlerave në universitet, autorët thonë: “Objektiv i këtij libri është thirrja e universiteteve për të bartë përgjegjësinë e tyre në qasjen ndaj problemeve komplekse me të cilat ballafaqohet bota sot, sepse të diplomuarit e këtyre universiteteve janë përgjegjës, së paku pjesërisht, për këto probleme, duke e ditur se shoqëria investon resurse të mëdha në arsimin universitar me shpresë për një të ardhme më të mirë. Përderisa sektori i arsimit të lartë do të kryejë detyrën e vet, pra t’i japë trajtë të ardhmes, atëherë atij i takon të

<sup>482</sup> <https://www.chronicle.com/specialreport/The-Post-Truth-Issue/84>.

<sup>483</sup> Po aty.

ndryshojë edhe për mënyrën e të menduarit për objektivat dhe për përgjegjësitë para shoqërisë. Ky ndryshim i kërkuar, para së gjithash është problemi i vlerave.”<sup>484</sup> Megjithatë, autorët e pranojnë se mësimi i vlerave është i vështirë dhe se profesorët universitarë në shumë raste i marginalizojnë ato për shkak të vështirësisë së mbrojtjes së tyre në nivel personal dhe shoqëror.

Në një libër tjetër, dy autorët mendojnë se vlerat dhe virtytet e larta morale që mund ta drejtojnë jetën universitare në arsim dhe praktikë, ndikojnë dukshëm në ndërtimin e liderëve të së ardhmes, mirëpo në realitet, nëse i heqim anash disa institucione arsimore që dallohen në këtë drejtim, atëherë do të hasim shkelje drastike të praktikave të mira dhe shtim marramendës të sjelljeve pamoralshme. Për këtë arsye, libri në fjalë paraqet sqarime dhe porosi për të zbutur krizën morale që ka kapluar çdo cep të botës përmes arsimit të përshtatshëm në sferën e normave etike nëpër institucionet e arsimit të lartë.<sup>485</sup>

Megjithatë, nuk mohojmë se ekzistojnë lëndë speciale për mësimin e vlerave në gjuhën arabe, të cilat u mësohen studentëve, sidomos te studentët që përgatiten për arsimin publik.<sup>486</sup>

#### 4. Edukimi sipas vlerave (të virtytshme)

Edukimi sipas vlerave zë një pozitë qendrore në përpjekjet e reformimit pedagogjik në fenë islame. Ia vlen që këtu ta prekim vetinë e plotësimit dhe të marrëdhënies së ndërsjellë mes edukimit dhe vlerave. Edukimi është mjet për zhvillimin e vlerave, kurse vlerat janë drejtues të edukimit, pra, pedagogjia në vetvete është vlerë, në pedagogji ka vlera edukative dhe pedagogjia është sjellje me virtyte.

<sup>484</sup> Tony Harland & Neil Pichering, *Values in Higher Education Teaching* New York: Routledge, 2011.

<sup>485</sup> Divya Singh, & Christoph Stuckerlberger (editorë). *Ethics in Higher Education: Values-driven Leaders for the Future*. Geneva, Switzerland: Globethics. 2017.

<sup>486</sup> Maxhid El-Xhel-lad, *Teal-lum'ul-kijemi ve ta'limiha: tesavvurun nadhariijun ve tatbikiijun li taraiika ve istratixhijjeti tedris'il-kijemi*, Aman: Dar'ul-Musireh, botimi III, (1430 h./2010).

Pedagogjia e vlerave, pedagogjia mbi vlerat apo pedagogjia e virtytshme është pedagogji etike dhe stolisje me vlera dhe virtyte shpirtërore e praktike, si p.sh. sinqeriteti, besnikëria, stimulimi dhe shumë veti dhe vepra tjera të virtytshme. Përderisa arsimit është pjesë e pedagogjisë, atëherë përgatitja e nxënësve në frymën e virtyteve dhe normave etike duhet t'i paraprijë arsimimit, siç është shprehur Imam Ebu Hamid Gazali.<sup>487</sup> Veçse kjo edukatë duhet t'i përfshijë të gjitha vlerat në shoqërinë njerëzore, qofshin ato të natyrshme apo ato konvencionale. Jeta njerëzore ngrihet mbi marrëdhëniet sociale të cilat imponojnë të drejta dhe detyrime, prandaj ndërtohen sisteme, bëhen marrëveshje dhe vendosen detyrime. Krejt këto funksionojnë mbi bazën e ndjenjës së përgjegjësisë, të kujdesit dhe solidaritetit të ndërsjellë. Pedagogjia e vlerave vazhdon të zgjerojë qarkun e saj për të arritur vlerat e përgjegjësisë në jetë, për të realizuar mëkëmbjen e denjë në tokë, për ta ndërtuar drejt jetën materiale dhe shpirtërore, dhe për të përmbushur vlerat e bashkësisë njerëzore.

Mësimi i vlerave në programet dhe metodat e arsimit publik shihet nga këto tri pikëpamje:

Vështrimi i detyrës edukative të shkollës, duke e ditur se ajo përfshin mësimin e lëndëve të ndryshme mësimore, të paracaktuara sipas një programi zyrtar “të shpallur”, kuptohet, duke pasur në vetëdije edhe atë që quhet program i fshehur (hidden curriculum), i cili ndonjëherë është objektiv i praktikave arsimore dhe administrative të shkollës, si p.sh.: inkuadrimi i studentëve në diskutimin e disa meseleve për të marrë vendimin e duhur, zhvillimi i frymës së bashkëpunimit dhe i ndjenjës së përgjegjësisë së përbashkët në punë, reflektimi i ambientit ku sundon vlerësimi i ndërsjellë dhe respektimi i mendimit ndryshe, bashkëveprimi dhe reflektimi me gabimet. Këto praktika mund të realizohen në formë spontane duke e bërë zakon shoqëria shkollë, dhe

<sup>487</sup> Ebu Hamid Gazaliu për punën e mësuesit ka thënë: “Fillon me edukim dhe pastaj vazhdon me arsimim. Arsimimi ndodh vetëm pas edukimit, sepse ai që s’ka edukatë, nuk ka as dije.” Shih: Ebu Hamid Muhamed bin Muhamed El-Gazali (vdiq 505 h.), *Min’haxh’ul-muteal-lim*, i redaktuar dhe i komentuar nga: Taha Jasin, Damask, Daru Tajjibeh dhe Dar’un-Nahdah, botimi I, 2007, fq. 80.

si pasojë, edhe ndikimi pozitiv është spontan dhe pandjeshëm.

1. Lidhja e drejtpërdrejtë e lëndës shkollore me vlerat që mund t'i përmbajë ajo. Asnjë lëndë mësimore nuk mund të privohet nga këto raste të lidhjes së drejtpërdrejtë. Studimi i historisë flet për shkakun e rënies së disa sistemeve si rezultat i padrejtësisë dhe i keqpërdorimit të forcës dhe pasurisë. Pastaj këtu vjen në shprehje nevoja për vlerat e drejtësisë, të lirisë, të barazisë, të konsultës dhe të bashkëpunimit për ta përforcuar dhe për ta mbajtur sistemin shoqëror nga brenda, por edhe për ta mbrojtur atë nga armiku i jashtëm. Mësimi i shkencave natyrore ngërthen shumë shanse që nxisin kërshërinë shkencore, forcojnë frymën e hulumtimit dhe kërkimit, saktësojnë vërejtjet më të vogla, i përdorin drejt dhe i bëjnë funksionale resurset, e mbrojnë ambientin natyror dhe jetësor. Krahas këtyre, shkencat natyrore ofrojnë edhe shumë vlera të tjera që ndërlidhen me meditimin në sendet, ngjarjet dhe fenomenet të botës natyrore që na rrethon. Po ashtu, japin instruksione pozitive për hulumtimin shkencor dhe për vlerësimin e arritjeve të studiuesve.<sup>488</sup>

Mësimi i vlerave përmes lëndëve studimore të veçanta dhe përcaktimi i kohës së duhur për to në programin studimor. Ndonjëherë këto lëndë mund të programohen në nivel klase, semestri apo në nivel të ambientit studimor në tërësi. Këto mesele mund të shpërndahen në orët javore, mujore apo vjetore. Këto tipa programesh mund të sigurojnë dimensione vlerash dhe virtyte morale për problemet politike, ekonomike dhe shoqërore, e të cilat pastaj tregojnë praninë e arsimit shkollor në realitetin social vendor dhe ndërkombëtar. Rregullimi i këtyre çështjeve bëhet me projekte të paracaktuara, ku vështrimi logjik për tematikën

<sup>488</sup> Ekzistojnë një sërë kontributesh të çmuara të karakterizohen me inkuadrim të vlerave në programet arsimore-shkollore. Për këtë mund t'u kthehemi përvojave, propozimeve dhe programeve që i paraqesin librat, si:

- Halid Es-Samedij, *Idmaxh'ul-kijem'il-islamijjeti fi 'l-menahixh'id-dirasijeh*, Ribat: Organizata Islamike për Edukim, Shkencë dhe Kulturë, 2003.

- Halid Es-Samedij, *El-Kijem'ut-terbevijjetu fi 'l-mendhume't-it-terbevijeh: dirasetun li 'l-kijem'il-islamijjeti ve alijjatu ta'ziziha*, Ribat: El-Munedhdheme't-ul-Islamijjetu li 't-Terbijjeti ve 'l-Ulumi ve 'th-Thekafeh, botimi I, 2007

në fjalë bashkëvepron me aftësinë për të analizuar të dhënat dhe për të dhënë gjykime etike, bashkë me sjelljen praktike e cila përfundon me rezultate që lidhen drejtpërdrejt me vlerat dhe instruksionet e përcaktuara për çdo program.

Pedagogjia e vlerave mund të inkadrohet në çdo institucion edukativ, si p.sh. në familje, në shkollë, në media, në institucionet fetare, kulturore dhe sportive, por pa harruar përgjegjësinë e vetë individit për vetveten, sepse vetëm atëherë do të ketë vetëdije për domosdoshmërinë dhe rëndësinë e sjelljeve të virtytshme në formimin e personalitetit të tij dhe të detyrës që ai duhet të përmbush në shoqëri dhe në jetë.

Kur flasim për funksion e familjes në edukimin sipas vlerave, duhet të llogaritim se vlerat nuk kanë asnjë kuptim në qoftë se nuk janë veti të mishëruara në ndjenjat, në sjelljet dhe në veprat e njerëzve. Shoqëria njerëzore njih disa metoda të zhvillimit të cilat në esencë mbështeten në imitimim e fëmijës ndaj të rriturit, ku ndonjëherë imitimi është spontan, prandaj fëmijët rriten me vlerat dhe virtytet morale që i marrin dhe që i jetojnë në ambientin familjar. Nëse fëmija kërkon të trasojë një sjellje të caktuar (që nuk e sheh në familje), atëherë bie ndesh me vlerat rrjedhëse të familjes së vet, për këtë arsye ai duhet të paralajmërohet dhe të udhëzohet. Ka shumë raste brenda familjes kur prindërit u mësojnë fëmijëve virtyte të caktuara, duke i cilësuar këto virtyte si veçori dhe cilësi të anëtarëve të familjes apo të kulturës së shoqërisë, të cilat në thelb janë edhe veçori dhe virtyte njerëzore të lavdishme. Nuk ka dyshim se mishërimi praktik i virtyteve në realitetin e bërthamës familjare dhe të rrethit familjar më të gjerë, është mjeti natyror për përvetësimin dhe natyralizimin e vlerave të larta morale.

Familja është kështjella e fundit e vlerave, e identitetit dhe e përkatësisë së shoqërisë. Kur shohim sot sulmin e pashpirt që sot i vërsulet institucionit të familjes në kulturën botërore, atëherë shtrohet pyetja, se çfarë do të mbetet pas kësaj? Kush do ta kompensojë punën e familjes?

Arsimi sistematik në shkollë është përgjegjës për drejtimin, forcimin dhe plotësimin e edukimit familjar sipas virtyteve të larta morale. Virtytet janë shpirti i punës edukative dhe themel mbi të cilin ndërtohen programet, metodat dhe objektivat pedagogjike, sepse objekt i pedagogjisë është njeriu, kurse virtytet dhe vlerat janë cilësia themelore e njeriut i cili do ta inkuadrojë këtë cilësi në punët e veta. Vlerat dhe virtytet nuk janë thjesht një element i objektivave pedagogjike, por ato janë korniza e cila u jep objektivave të tjera vlerën, rëndësinë dhe efikasitetin e duhur.

Mësimi apo edukimi me virtyte në shkollë bëhet me natyralizimin e vlerave, të cilat shkolla i shndërron në kulturë teorike dhe praktike, ku marrin pjesë të gjithë të pranishmit në shkollë. Shkolla, çfarëdo metoda të përdorë për inkuadrimin e vlerave në programet arsimore, assesi nuk mund t'i shmang dy çështje themelore. E para: ekzistimin e një modeli praktik i cili mishërohet në sjelljet e mësuesit, si flet dhe si vepron. E dyta: dominimi i një kulture shkollë në veprimtarinë e shkollës, ku reflektohen vlerat morale, shoqërore dhe profesionale. Krejt kjo të reflektojë në ambientin fizik, në marrëdhëniet personale dhe shoqërore, në mënyrat e bashkëpunimit mes të gjithë atyre që janë në shkollë, bile edhe me sektorin administrativ dhe social. Përkushtimi i drejtorit të shkollës ndaj sistemit të vlerave dhe ndaj kulturës shkollë rrjedhëse është faktori më i rëndësishëm për mbarëvajtjen e rendit në shkollë dhe për mishërimin e këtyre vlerave (te nxënësit).

Në vitet e fundit janë shtuar thirrjet nga pedagogët, nga qeveritarët dhe nga shoqëritë lokale për domosdoshmërinë e mësimit të vlerave etike në shkollat publike në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, gjë e cila çoi në zhvillimin e programeve për edukimin me vlerat e larta etike. Rezultatet e vlerësimit të disa prej këtyre programeve tregojnë se edukimi sipas vlerave etike patjetër duhet të jetë pjesë themelore e jetës shkollë amerikane. Gjithashtu, u bë e qartë se teoritë natyraliste dhe shoqërore nuk çojnë kah përkushtimi i mjaftueshëm etik që njerëzit të binden për t'u dhënë

përparësi interesave të përgjithshme dhe për ta zbutur përqendrimin në vetë natyrën (fizike). Kjo ka shkaktuar një problem themelor në lidhje me mësimin e vlerave etike në shkollë, pra nuk ka asnjë bazë për ta shtuar besueshmërinë në këto programe. Për këtë arsye, studimi i theksuar më parë ka rezultuar se themeli i përshtatshëm për mësimin e vlerave është baza e besimit e cila ka burim fenë hyjnore.<sup>489</sup>

Në studimin e publikuar nga institucioni i specializuar për mësimin digjital (në distancë), të cilët kanë marrë mendimin e një sërë specialistësh të arsimit dhe të teknologjisë nga e gjithë bota për drejtimet dhe sfidat me të cilat ballafaqohet arsimit dhe teknologjia në vitin 2016, dhe në fund ka rezultuar se duhet kushtuar vëmendje inkuadrimit të vlerave etike në procesin arsimor.<sup>490</sup>

Në mesin e programeve pedagogjike ka program të veçantë i cili i trajton veçmas vlerat morale, prandaj disa profesionistë të këtij lëmi krijojnë programe të veçanta për vlerat, të cilat përmbajnë propozime për qasje ndaj vlerave në mënyra dhe metoda të ndryshme, si p.sh. inkuadrimi i vlerave në aktivitetet e përgjithshme shkollë, ndërthurja e tyre brenda tematikave të lëndëve studimore apo mësimi i tyre si lëndë studimore të mëvetësishme.<sup>491</sup>

Ndoshta, ndikuesi më i madh në shoqërinë bashkëkohore është media. Shoqërinë bashkëkohore në këtë dekadencë mediatike e kanë sjellë shumë mekanizma dhe institucione mediatike, të cilat kanë programe joshëse përgjatë 24 orëve dhe përgjatë gjithë javës. Pastaj, me kalimin në media digjitale dhe satelitore, krijuan në botë hipotetike në të cilët sot jetojnë njerëzit, kurse botën reale e kanë lënë pas dore. Këto u përhapën dhe ndikuan aq shumë, sa që individit ra pre e mendimeve dhe e lajmeve, e zgjedhjeve, e preferencave dhe e joshjeve që ofronin mediat. Krejt këto ofroheshin me mençuri dhe dinakëri, si p.sh.: ndërtimi i vlerave të caktuara

<sup>489</sup> Matthew Etherington, *Values Education: Why The Teaching Of Values In Schools Is Necessary, But Not Sufficient*, *Journal Of Research On Christian Education*, 2013, 22: 2, fq. 189-210.

<sup>490</sup> <https://www.goconqr.com/en/blog/the-importance-of-teaching-values-in-education>.

<sup>491</sup> El-Abdu El-Xhadir, Fejzal Fehd, *Ta'ziz'ul-kijemi fi menahixh'it-ta'lim'il-ammi: itarun ammun li 't-terbijjet'il-kijemijjeti*, Kuvajt: El-Merkez'ul-Arabijju li 'l-Buhuth'it-Terbevijjeti li Duvel'il-Halixhi, 2014



dhe rrënimi i disa të tjerave etj. Kjo realizohej gradualisht për të mos u hetuar rreziku i këtyre ndryshimeve, bashkë me ndërtimin e mjeteve mbrojtëse për të njëjtat.

Shoqëritë bashkëkohore kanë nevojë për atë që quhet edukim mediatik. Ky koncept duhet të zgjerohet ku pjesë të cilit do të jetë mësimi i individit, në mosha të ndryshme, metodat e bashkëveprimit me mjetet mediatike dhe komunikimi bashkëkohor. Edukimi mediatik nuk fokusohet vetëm në sferën e vetëdijesimit për rreziqet që kanosin mediat bashkëkohore, por përfshin edhe ushtrimin e metodave që i vënë në funksion mjetet mediatike pozitive të cilat japin lajme të sakta, reformojnë idetë dhe paraqesin modele të zgjedhura për t'i ngulitur thellë vlerat e larta morale.

Një sërë studimesh pedagogjike kanë trajtuar shkaqet e degradimit të vlerave morale në shkollat e shoqërive bashkëkohore të çdo vendi të botës, dhe shumica e këtyre studimeve kanë deklaruar se atë që studentët e marrin nga mjetet mediatike dhe rrjetet sociale është shkaku kryesor i degradimit të vlerave etike. Ndër to është edhe studimi krahasues “iberun thekafijetun” i cili ka trajtuar shkaqet e degradimit të vlerave morale. Ky studim është prezantuar në Konferencën Akademike-Pedagogjike të organizuar nga Instituti i Perëndimit dhe i Lindjes<sup>492</sup> në vitin 2016 në qytetin e Bostonit, në Filadelfi të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ku tre studiues: nga Turqia, Kina dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, morën mendimin e një numri të caktuar të mësuesve nga të tre shtetet përkatëse. Në fund erdhën në përfundim se erozioni i vlerave etike është bërë dukuri e dukshme në të tri shtetet dhe manifestohet në forma të ndryshme dhe me praktika e sjellje të gabuara, si p.sh. dhuna, egocentrizmi, tradhtia, paudhësia dhe neveria. Po ashtu, kanë dhënë përfundimin se këto sjellje të rinjtë dhe të nxënësit po rriten tej mase.

Gjithashtu, nga studimi është dhënë përfundimi se mësuesit e zgjedhur për anketim në të tre shtetet kanë rënë

<sup>492</sup> The West East Institute- WEI.

dakord se vlerat etike përrjetojnë një dobësim në rritje në shoqëritë e tyre shkollë dhe se dy shkaqet kyçe për këtë degradim janë: mediat dhe globalizmi. Ky studim tregon se edhe shumë studime të tjera të ngjashme, të bëra nëpër vende të ndryshme të botës, i kanë nxjerrë pothuaj rezultatet e njëjta.

Studimi porositi që domosdoshmërisht t'i kushtohet rëndësi familjes dhe shkollës. Këto dy institucione duhet të bashkëpunojnë domosdoshmërisht për t'i zhvilluar vlerat dhe virtytet e larta morale qysh në etapat e hershme të jetës së fëmijëve, sepse vitet e para kanë rëndësi të madhe në formimin zakoneve dhe të vlerave morale. Gjithashtu, studimi konstaton se duhet që patjetër në programet e përgatitjes së mësimeve të inkuadrohen procedurat dhe ushtrimet mësimore për kumtimin e vlerave morale në shkollë.<sup>493</sup>

Ndikimi i edukimit në familje dhe në shkollë cilësohet si edukim në fazën e fëmijërisë dhe të rinisë, kurse ndikimi edukativ i mediave i përfshin të dyja këto faza, bile edhe fazat vijuese. Gjithashtu, edhe institucione të tjera kanë ndikim në të gjitha fazat edukative, si p.sh. institucioni i xhamisë, i cili konsiderohet ambient ku mësohen virtytet e larta morale dhe pajisja me to, veçanërisht kur dihet fakti se vetë shkuarja në xhami kërkon rregulla edukative dhe morale, si në jetën shpirtërore, ashtu edhe në atë shoqërore. Në mesin e këtyre institucioneve bëjnë pjesë edhe organizatat e ndryshme humanitare dhe kulturore, klubet sportive, partitë politike dhe të tjera. Vlerat nuk janë specifike vetëm e një institucioni të caktuar, por ato ndërthuren me aspektet tjera të aktivitetit social.

Mësimi dhe arsimimi i vlerave përfaqëson një proces të vazhdueshëm përgjatë tërë jetës, i cili i synon të vegjlit dhe të mëdhenjtë, madje edhe të shtyrët në moshë. Thirrjet e

<sup>493</sup> Pervin Oya Taneri & Jie Gao & Rodger Johnson, *Reasons for the Deterioration of Moral Values: Cross-Cultural Comparative Analysis*, Boston, USA: *The 2016 WEI International Academic Conference Proceedings*, 2016, fq. 242-252.

Studimi i plotë mund të shihet në linkun vijues: <https://www.westeastinstitute.com/wp-content/uploads/2016/09/P.-O.-Taneri-J.-Gao-R.-Johnson.pdf>.

pejgamberëve a.s. u kumtoheshin të gjithë anëtarëve të shoqërisë: burrave, grave, fëmijëve dhe të tjerëve. Thirrjes së Muhammedit a.s. iu përgjigjën burrat, gratë dhe fëmijët. Kështu që, përgjegjësia për sjelljet e virtytshme fillimisht bie mbi të rriturit dhe pastaj mbi fëmijët (sadopak të formuar).

## Përfundim

Kjo pjesë kishte për qëllim të flasë për tematikat e mendimit pedagogjik islam. Këto tematika janë gjëja e parë që të bien ndërmend kur dëgjon apo lexon shprehjen “mendimi pedagogjik islam”. Sigurisht, kjo është përgjigjja e pyetjes “çfarë?” dhe e pyetjeve të tjera si “pse?” dhe “si?”. Pa dyshim se tematikat edukative mishërohen në përmbajtjen e disa shkencave që renditen në mesin e disiplinave pedagogjike apo të disiplinave specifike që mësohen në institucionet edukative-arsimore. Për këtë arsye filluam të bëjmë fjalë për marrëdhënien e mendimit me shkencën në tematikat pedagogjike, ku u përpoqëm të vendosim një skemë të prioriteteve brenda këtyre tematikave dhe dalluam një tip shkence të quajtur shkencë metodologjike, edhe pse në çdo disiplinë shkencore ekziston një element i quajtur elementi metodologjik i cili domosdoshmërisht duhet të mësohet.

Kur folëm për disiplinat pedagogjike dhe për degët e tyre, pak u ndalëm te ndërtimi i degëzimit shkencor profesional i cili paraqitet si disiplinë shkencore e veçantë. Pastaj kalimthi theksuam zhvillimin e degëzimit shkencor në studimet e historisë së mendimit dhe të shkencave, bashkë me dallimin që ka nga degëzimet e tjera dhe se çfarë duhet të plotësohet për t’u pranuar si disiplinë e mëvetësishme shkencore. Gjithashtu, kemi spikatur dy fusha të rëndësishme të mendimit pedagogjik: teorinë pedagogjike dhe filozofinë pedagogjike. Meqenëse krejt kjo është bisedë për disiplinat pedagogjike në përgjithësi, dhe atë brenda kornizës së mendimit pedagogjik islam, atëherë është e domosdoshme të

shtrohet dilema për pozitën e Islamit në disiplinat pedagogjike.

Në vazhdim zgjodhëm të flasim për pozitën e vlerave në disiplinat pedagogjike, dhe atë në sferat e teorizimit dhe praktikimit të tyre, duke u nisur nga vështrimi i lidhjes së drejtpërdrejtë të vlerave me specifikat e mendimit pedagogjik islam. Treguam rëndësinë e vlerave dhe për një sërë hipotezash të hedhura në këtë fushë. Pohuam faktin se vlerat nuk duhet të përqendrohen vetëm në arsimin publik për të zhvilluar gjeneratat e reja sipas sistemit të vlerave që ka adaptuar shoqëria, por vlerat duhet ta përfshijnë edhe arsimin universitar, sepse në këtë fazë shtohet vetëdija për vlerat dhe virtytet morale, sidomos kur është fjala për vlerat akademike dhe profesionale. Gjithashtu, kësaj mund t'i shtojmë edhe vetëdijen e domosdoshme që studentët duhet të kenë për këto vlera nëpër universitete, sepse të gjitha vendet të cilat do të marrin përgjegjësinë e tyre në shoqëri dirigojnë nga një sistem i caktuar i vlerave në qarqe të ndryshme të veprimtarisë jetësore.

Kjo është një përmbledhje e përgjithshme për këtë kapitull, kurse ne presim që lexuesi, kur t'i lexojë pjesët e këtij kapitulli, të ndjejë nevojën për trajtim më të hollësishëm, sepse çdo pjesë e kapitullit është temë në vete dhe ka rëndësi të veçantë, madje disa lexues mund të hetojnë se temat e këtij kapitulli janë edhe tituj të librave profesionalë të kësaj sfere. Mjafton që në këtë kapitull të mësohen tematikat e mendimit pedagogjik.

Në katër kapitujt e parë trajtuam hollësisht konceptet e mendimit pedagogjik islam, praninë e këtij mendimi në trashëgiminë islame, katër burimet themelore të këtij mendimi, gjë të cilën e kemi përsëritur në raste të ndryshme, dhe objektivat që mëton të përbush ky mendim. Pastaj erdhi ky kapitull, në të cilin janë trajtuar tematikat e mendimit pedagogjik islam, të cilat janë boshtet njohëse të këtyre objektiveve, por edhe për mjetet e realizimit të tyre. Na ka mbetur të flasim për veçoritë me të cilat mendojmë se dallohet mendimi pedagogjik islam, apo se duhet të dallohet.

Atëherë, këto do të jetë tematika e kapitullit të gjashtë dhe të ardhëm, ndërsa, nëse do Allahu, librin do ta përfundojmë me kapitullin e shtatë dhe të fundit, duke i dhënë një vështrim perspektiv asaj që ne e quajtm mendim pedagogjik islame, bashkë me atë që ne propozojmë për ta ndërtuar këtë mendim të shënuar.

## **KAPITULLI I GJASHTË: VEÇORITË E MENDIMIT PEDAGOGJIK ISLAM**

Hyrje:

**PJESA E PARË: VEÇORIA E INTEGRIMIT DHE E EKUILIBRIMIT TË NDËRSJELLË NË MENDIMIN PEDAGOGJIK ISLAM**

E para: Karakteri i kujdesit për personalitetin e njeriut  
E dyta: Veçoria e integritetit dhe e ekuilibrit të ndërsjellë në ndërtimin e elementëve të personalitetit

Elementi fizik

Elementi logjik

Elementi shpirtëror/psikik

E treta: Integriteti dhe ekuilibrimi në imitim dhe kreativitet

**PJESA E DYTË: VEÇORIA E REALIZMIT NË MENDIMIN PEDAGOGJIK ISLAM**

E para: Realizmi dhe idealizmi

E dyta: Disa manifestime të realizmit në mendimin pedagogjik islam

E treta: Realizmi në ndërtimin e një mendimi pedagogjik bashkëkohor islam

**PJESA E TRETË: KAPACITETI DHE SHRIRJET E MENDIMIT PEDAGOGJIK ISLAM**

E para: Shtrirja e mendimit pedagogjik islam në tematikat e veta: kapaciteti dhe integriteti

E dyta: Shtrirja e mendimit pedagogjik islam në kohë

E treta: Shtrirja e mendimit pedagogjik islam në hapësirë

E katërta: Shtrirja e mendimit pedagogjik islam te njeriu

**PJESA E KATËRT: MANIFESTIMET E INTEGRITETIT DHE TË EKUILIBRIMIT NË MENDIMIN PEDAGOGJIK ISLAM PËRFUNDIM**

# **KAPITULLI I GJASHTË:** VEÇORITË E MENDIMIT PEDAGOGJIK ISLAM

## Hyrje

Shumë libra dhe hulumtime të cilat trajtojnë veçoritë e Islamit apo veçoritë e ndonjë aspekti islam (si p.sh. veçoritë e kulturës islame, të pedagogjisë islame, të umetit islam, të mendimit islam etj.) flasim për veçoritë në formë të përgjithshme, si p.sh. veçoria e të qenit rob i Zotit, veçoritë mesatare, universale, të ekuilibruara dhe të tjera. Kryesisht shkak për këtë dallimin e këtyre veçorive është përpjekja për t'i nxjerrë ato nga teksti kur'anor dhe nga hadithi pejgamberik, pra Kur'ani e ka cilësuar umetin me disa veti dhe pastaj këto veti i janë dhënë atij, të cilat përbëjnë një referencë e cila meriton të merret si bazë për çdo bisedë rreth kësaj tematike. Veçorinë “rob i Zotit” e gjejmë në Kur'anin fisnik, ku Allahu xh.sh. thotë: ﴿وَلَكِنْ كُونُوا رَبَّايَيْنَ بِمَا كُنْتُمْ تَعْلَمُونَ الْكِتَابَ وَبِمَا كُنْتُمْ تَدْرُسُونَ﴾ “Bëhuni rob të mi (adhuromëni mua) e jo të Allahut!” por (ju thotë): “Bëhuni dijetarë të mësimave të Zotit, ngase e keni mësuar njerëzve librin dhe e keni studiuar atë.” [Alu Imran: 79], veçorinë e mesatarisë e gjejmë në ajetin: ﴿وَكَذَلِكَ جَعَلْنَاكُمْ أُمَّةً وَسَطًا﴾ “Dhe kështu ne ju bëmë juve umet të mesëm.” [El-Bekare: 143], cilësimin si të mirë e gjejmë në ajetin vijues: ﴿كُنْتُمْ خَيْرَ أُمَّةٍ أُخْرِجَتْ لِلنَّاسِ﴾ “Jeni umeti më i mirë i dalë për njerëzit”, [Alu Imran: 110] etj. Sigurisht se shkrimet e bëra në këtë fushë janë të vyeshme për atë që janë shkruar.

Në anën tjetër vërejmë se shumica e shkrimeve për veçoritë e dalluara në një aspekt të mendimit islam (si p.sh. në politikë, në ekonomi apo në pedagogji) flasin për veçoritë e Islamit dhe të umetit islam në përgjithësi, kurse aspektin kuptimor brenda kontekstit (politik, ekonomik apo pedagogjik) e trajtojnë shumë pak. Megjithatë, dihet se veçoritë e përgjithshme të Islamit do të reflektojnë në një aspekt të caktuar. Veçoritë e Islamit, në esencë, janë veçori të pikëpamjes islame, apo siç i ka quajtur Sejid Kutubi “ideja e Islamit për Allahun, për kozmosin, për jetën dhe për njeriun”. Kishte premtuar qysh herët se do të bëjë një



hulumtim për këtë, prandaj në vitin 1964 e publikoi librin me titull “Veçoritë dhe elementet e pikëpamjes islame”.<sup>494</sup> Pastaj prej tij morën shumë shkrimtarë për çështjen e veçorive të Islamit dhe për çdo rend tjetër të tij, sidomos mënyrën e paraqitjes dhe klasifikimit të veçorive si: “rebbanije” të qenët rob i Zotit, qëndrueshmëria, universalizmi, ekuilibri, pozitiviteti, realizmi dhe tevhidi (njëshmëria e Zotit).

Kur u kthehemi pjesës më të madhe të veprave të shkruara për tematikën e mendimit pedagogjik islam, shohim se evidentimi i veçorive të mendimit pedagogjik islam pothuaj është mbyllur brenda manifestimeve të këtyre veçorive të kulturës pedagogjike islame apo brenda veçorive të mendimit islam dhe të kulturës islame në përgjithësi, por pa i trajtuar më saktësisht reflektimet e këtyre veçorive në fushën e mendimit pedagogjik islam. Nuk preferojmë të përmendim asnjë prej këtyre librave, në mënyrë që të mos promovohen ato, por vetë lexuesi mund ta konstatojë këtë gjykim nëse i bie në dorë ndonjëri prej atyre librave.

Ne përpiqemi të trajtojmë tematikën e veçorive të mendimit pedagogjik islam duke u përqendruar në aspektin pedagogjik, pastaj reflektimet e tij në aspektet tjera, kuptohet duke u mbështetur në efektin që lanë praktikat pedagogjike në sjelljet e individit dhe të shoqërisë. Praktikrat pedagogjike ndërtohen mbi themele ideore të përcaktuara, prej të cilave është dallimi i njeriut nga krijesat tjera dhe nevoja e tij për edukim. Gjithashtu, bazë tjetër është udhëzimi edukativ që përfaqësojnë bazat e Islamit në Kur’an dhe në traditën pejgamberike të Muhammedit a.s. Themel tjetër është orientimi që jep reformimi në kuptimin e këtyre bazave, bashkë me zhvillimin e përvojës njerëzore, dhe domosdoshmëria e bashkëveprimit me ndodhitë dhe me novacionet sipas vetë kuptimit reformist.

Krahasuar me krijesat tjera, njeriu në fillim të jetës ka nevojë për kujdes edukativ më të gjatë. Edukimi i njeriut nuk nënkupton vetëm kujdesin për nevojat elementare si haja dhe kujdesi fizik, siç është rasti me krijesat tjera, por harku i

<sup>494</sup> Sejjid Kutub, *Hasais’ut-tesavvur’il-islamijji ve mukavvimatuhu*, Kajro: Dar’ush-Shuruki, 1988, fq. 5.

edukimit zgjerohet dhe përfshin edhe aspekte tjera, d.m.th. lidhet me doktrinën, me idetë, me sistemin e vlerave që kanë të bëjnë me jetën sociale, me zhvillimin e kësaj jete dhe me novacionet që ndodhin, e të cilat nuk kanë qenë të njohura për gjeneratat e mëhershme.

Edukimi në Islam, edhe pse mbështetet në disa parime të cilat cilësohen si të qëndrueshme, veçanërisht kur flitet për virtytet dhe vlerat morale themelore, përsëri një aspekt i këtyre parimeve do ta mbajë derën hapur dhe do të vazhdojë të ndryshojë dhe të evoluojë. Kjo duhet të ndodhë sepse Allahu e ka udhëzuar njeriun të mësojë shkencat e reja dhe të fitojë nga eksperiencat e reja. Allahu xh.sh. thotë: ﴿وَيُعَلِّمُكُم مَّا لَمْ تَكُونُوا تَعْلَمُونَ﴾ “Dhe (Allahu) ju mëson atë që nuk e dinit.” [El-Bekare: 151].

Ky kapitull paraqitet në tri pjesë. E para është veçoria e integritetit dhe e ekuilibrit në mendimin pedagogjik islam, ku diskutojmë tri tematika që flasin për mendimin pedagogjik islam, me theks të veçantë për personalitetin e njeriut, për tri elementet e këtij personaliteti (trupi, arsyeja dhe shpirti) dhe për kufijtë e integritetit dhe të ekuilibrit në raport me imitimin dhe kreativitetin. E dyta është veçoria e realizmit në mendimin pedagogjik islam. Edhe pjesa e dytë ka tri tematika: marrëdhënien mes realizmit dhe idealizmit, disa refleksime të realizimit në mendimin pedagogjik islam, dhe realizmit të cilin mëtojmë ta ndërtojmë në mendimin pedagogjik bashkëkohor islam. Pjesa e tretë është kapaciteti dhe shtrirjet e mendimit pedagogjik islam. Kjo temë është shtruar në katër tematika: shtrirja e mendimit pedagogjik islam në tematikat (e ndryshme), kapaciteti dhe integriteti, shtrirja e mendimit pedagogjik islam në rrafshin kohor, hapësinor dhe njerëzor.

# Pjesa e parë:

## Veçoria e integritit dhe ekuilibrit në mendimin pedagogjik islam

### 1. Natyra e kujdesit për personalitetin e njeriut

Mendimi pedagogjik islam synon të formojë njeriun si individ, si shoqëri dhe si umet, kuptohet për ta zbatuar qëllimin e Allahut të Lartësuar, pra për ta ndërtuar jetën në këtë botë me të mira dhe me gjëra të dobishme. Meqenëse njeriu është njësi e parë për ndërtimin e gjinisë njerëzore, atëherë imazhi i këtij personaliteti individual do të reflektojë në njësitë tjera të kësaj ngrehine.

Koncepti i “personalitetit” është një koncept qendror në teorinë pedagogjike dhe psikologjike, pavarësisht sfondeve të ndryshme të kanë. Në psikologjinë moderne, për këtë koncept është formuar një disiplinë e veçantë shkencore, e që është psikologjia e personalitetit. Kuptimi i konceptit të personalitetit ndryshon në varësi të teorive psikologjike, të elementëve të këtyre teorive dhe të nivelit të përkushtimit që këto u japin këtyre elementëve. Shumica e këtyre teorive përqendrohen në modelet e të menduarit, të ndjenjave dhe të sjelljeve të cilat e bëjnë këtë individ “njeri” ndryshe nga të tjerët. Kjo nuk do të thotë se personalitetet janë aq të ndryshme sa vetë numri i njerëzve, por mund të veçojmë një numër modelesh apo llojesh të personaliteteve, ku bëjnë pjesë shumica e njerëzve. Po ashtu, ka edhe një sërë faktorësh dhe indikatorësh që kontribuojnë në formimin e personalitetit të njeriut, disa janë të trashëguara dhe fillojnë me ardhjen e njeriut në këtë botë, kurse disa të tjera fitohen dhe zhvillohen paralel me njeriun në ambientin ku jeton. Disa veti, të cilat e pasqyrojnë karakterin e njeriut, mbeten me të gjatë tërë jetës, kurse disa të tjera ndryshojnë në varësi të përvojave dhe eksperiencave që ai i fiton.

Ekzistojnë metoda të ndryshme për klasifikimin e personalitetit. Ndonjëherë klasifikohet në bazë të cilësisë së përgjithshme fetare, e thuhet: personalitet islam. Ndonjëherë klasifikimi bëhet mbi bazën e potencialeve të ndikimit të njeriut tek të tjerët, ku ky tip quhet “personalitet tërheqës apo personalitet lider”. Disa herë klasifikohet mbi bazën e situatave të vështira shpirtërore që i ndodhin njeriut, prandaj quhet “personalitet i pa socializuar apo armiqësor”.

Dijetarët islamë kanë folur për personalitetin e njeriut, për llojet e tij, për aspektet e shëndetit dhe të sëmundjes së tij, veçanërisht për shpirtin njerëzor, pra e kanë trajtuar në sfera të ndryshme studimore, si në: fikh, kelam, tesavuf, filozofi dhe në disiplina tjera. Pavarësisht se disa dijetarë, sidomos filozofët dhe sufistët, i kanë përzier pikëpamjet e tyre për personalitetin me disa thënie filozofike, përsëri referenca apo sfondi kur'anor nuk mungon në kuptimin e shpirtit njerëzor.

Personaliteti i njeriut, në kuptimin që mbështetet në Kur'an, është vetë njeriu, pra është i gjithë njeriu: me trup, mendje dhe me shpirt. Ky është thelbi i tij, sepse kështu cilësohen me aftësinë e perceptimit, mendimit dhe moralit, dhe këtij njeriu i drejtohet ligjërimi obligues. “Kur'ani fisnik e personifikon shpirtin dhe e bën atë qenie e cila e përfaqëson njeriun para Allahut dhe para shoqërisë. Edhe vrasja e cila e prek njeriun është vrasje e shpirtit... në kisas (hakmarrje) llogaritet shpagimi “shpirt me shpirt”... kur i tërhiqet vërejtja njeriut dhe kur thirret për shpërblim, ligjërimi i drejtohet shpirtit. Pra, shpirti (nefsi) në Kur'an nënkupton njeriun e përgjegjshëm i cili do të merret në llogari. Ky (shpirti) është komponenti i cili krijon në njeriun veten apo unin me të cilin ai njihet pastaj me ndjenjat, me ndërjegjen dhe me perceptorët. Pra, shpirti është vetë njeriu. Për këtë arsye ishte edhe objekti i kumtit hyjnor dhe do të jetë objekt i përgjegjësisë, pra do të shpërblehet ose do të dënohet.”<sup>495</sup>

Sot hulumtimi për personalitetin, hollësisht dhe në formë të gjerë, bëhet në teoritë e psikologjisë moderne dhe në

<sup>495</sup> Abdulkerim El-Hatib, *Et-Tefsir'ul-kur'anijju li 'l-Kur'an*, Kajro: Dar'ul-Fikr'il-Arabijj, 1970, vëll. IV, (pjesa XIX dhe XX), komentimi i sures Ez-Zumer, fq. 1166-1167

shkollat e ndryshme të tyre: bihavioriste, njohëse, analitike dhe të tjera. Pasi thellimi në këto çështje nuk është temë e këtij kapitulli, atëherë mjafton që lexuesin ta drejtojmë në librat profesionistë të kësaj teme. Në mesin e këtyre librave është libri, strukturën e të cilit paraprakisht e kemi përgatitur ne, por e kanë realizuar dijetarët e psikologjisë islame bashkëkohore dhe e ka botuar Instituti i Botëror i Mendimit Islam.<sup>496</sup> Ajo që na hyn në punë në kontekstin e këtij kapitulli është biseda për personalitetin që e kërkon mendimi pedagogjik islam, që të merr formë përmes rrugës së natyrës pedagogjike, i cili edhe e siguron atë dhe metodat pedagogjike që i përdor.

Praktikat pedagogjike që i njeh historia islame përmbajnë shembuj të llojlloshëm të përpjekjeve që ndikojnë në formimin e personalitetit njerëzor në shoqërinë muslimane. Disa manifestime të këtyre përpjekjeve në shumë tekste të trashëgimisë islame flasin për punën e familjes me fëmijët, për punën e edukatorëve, të dijetarëve dhe të mësuesve me nxënës të llojlloshëm nëpër institucione të ndryshme. Pra, i mësonin tema të ndryshme me metoda të llojlloshme. Në trashëgiminë (islame) hasim disa praktika që burojnë nga tekstet e shpalljes hyjnore dhe nga tradita pejgamberike e Muhammedit a.s. në kuptimin e intencave dhe të instruksioneve të mësimdhënies. Po ashtu, hasim praktika ku kanë rënë motivet e nxënësve dhe të mësuesve për t'i përmbushur intencat dhe nuk u përmbahen siç duhet instruksioneve. Efekti i kësaj, në të dy rastet, ka reflektuar në formimin e personaliteteve të nxënësve, pastaj edhe në gjendjen e shoqërisë muslimane.

Nuk është e lehtë të gjykojnë modelet e edukimit që shënojnë nxënësin, të cilat i ka dhënë trashëgimia islame, sidomos në vitet e para të arsimimit nëpër mektebe. Shumë tekste të trashëgimisë islame tregojnë gjendjen e mektebeve dhe të mësuesve, degradimin e pozitës së tyre sociale dhe trajtimin e gabuar të fëmijëve. Sa u përket mexhliseve

<sup>496</sup> Nezzar El-Azi, *Esh-Shahsijjet'ul-insanijjetu fi 't-turath'il-islamijji*; Herndon: El-Ma'had'ul-Alemijju li 'l-Fikr'il-Islamijj, botimi I, 1998.

profesionale të të rriturve në fushën e fikhut dhe të hadithit, shumica e mësimeve të dhëna nga trashëgimia edukative islame flasin se si duhej të ishte, si p.sh.: normat edukative të vetë mësuesve ndaj nxënësve dhe ndaj mësimit, normat edukative të nxënësit ndaj mësuesit dhe ndaj shëmbëlltyrës, dhe shumë norma të tjera për mësuesin dhe për nxënësin. Megjithatë, shumë pak është përshkruar zhvillimi praktik i mësimit dhe kujdesi ndaj këtyre normave.

Ato pak raste që janë transmetuar, më shumë cilësohen si situata të veçanta sesa si model i përgjithshëm. Përpjekjet më të mëdha që janë dhënë për ndërtimin e personalitetit të nxënësit, më shumë janë në frymën edukative sesa arsimore. Edukimi ishte zanat i edukatorëve që punonin me fëmijët e halifëve, të sulltanëve dhe të udhëheqësve, pra, këto janë situata të veçanta.

Për të konfirmuar se formimi i personalitetit ishte çështje që ndërlidhej me arsimimin e veçantë të fëmijëve të mbretërve, Maverdi ka thënë se zgjedhja e mësuesit-edukatorit për këtë grup të nxënësve ishte detyrë e vështirë të cilën mund ta kryente vetëm një grup i dalluar i mësuesve, prandaj ai (Maverdi) u drejtohet mbretërve me këtë këshillë: “(Mbreti) duhet të përpiket të zgjedhë mësuesin dhe edukatorin (e fëmijës së vet) njësoj siç përpiket të zgjedhë bashkëshorten dhe kujdestaren, madje edhe më me zell, sepse fëmija i mëson virtytet morale, vlerat dhe zakonet, më mirë nga edukatori sesa nga mësuesi, sepse me të qëndron më gjatë dhe nga ai mëson vazhdimisht. Fëmija urdhërohej nga prindi në momentin kur i dorëzohej edukatorit dhe i kërkohet ta dëgjojë atë: duhet të lexojë Kur’an, të mësojë mirë gjuhën, të mësojë përmendësh poezi, të jetë i devotshëm dhe besimtar i mirë, të pajiset me virtyte të larta morale, ta njohë etikën dhe rendin e mbretërve...”<sup>497</sup>

Mendimi pedagogjik bashkëkohor që kërkojmë ta ndërtojmë për ta formuar personalitetin islam do të mbështetet në atë që e theksuam në kapitujt e mëparshëm,

<sup>497</sup> El-Maverdi, Ebu 'l-Hasan Ali bin Muhamed bin Habib (vdiq 450 h.), *Nesihat'ul-muluki*, i përgatitur për botim nga Hadr Muhamed Hadr, Kuvajt, Mektebet'ul-felah, botimi I, fq. 1983, fq. 171

gjegjesisht në burimet e këtij mendimi dhe në intencat e pikëpamjes islame, të cilat duhet përvetësuar për formimin e personalitetit i cili do të dallohet me mendim integruar dhe të ekuilibruar. Qysh në fillim duam të pohojmë se personaliteti islam që e kërkojmë nuk formohet në institucionet e edukimit dhe të arsimit, siç prodhohen mallrat nëpër fabrika, pra duke i krahasuar njerëzit me mallrat, sepse përgjithësisht mallrat kanë një kallëp të prodhimit, përveç atyre pak që dalin gabimisht, e pastaj largohen nga prodhimi.

Nuk njohim përvojë edukative ku personalitetet e nxënësve janë të njëjtë në gjithë shoqërinë e asaj kohe. Pra, nuk mund të ketë kopje personalitetesh plotësisht të njëjta, madje as në edukimin pejgamberik, sepse kjo nuk i përket karakterit njerëzor dhe as ligjit të Zotit në krijimin e njerëzve.

Kur e lexojmë jetën dhe traditën pejgamberike të Muhammedit a.s., shohim se si ai i cilësonte shokët me veti të veçanta nga njëri-tjetri, pavarësisht se edukimi pejgamberik ishte i njëjtë për të gjithë sahabët. Omeri r.a. ishte kolos, prandaj Pejgamberi a.s. e cilësonte si të pashoq.<sup>498</sup> Ebu Ubejde ibn Xherah r.a. cilësohej si besniku i umetit,<sup>499</sup> Ubej bin Ka'bi r.a. ishte lexuesi më i dalluar i Librit të Zotit,<sup>500</sup> Halid bin Velidi ishte Shpata e Hapur e Zotit<sup>501</sup> etj.

Prej kësaj kuptojmë se mendimi pedagogjik islam duhet të ofrojë shanse për përgatitjen e personalitetit të nxënësit, dhe atë në varësi të përgatitjeve që posedon personalitetit i tij dhe në varësi të mundësisë për ta dalluar atë në një aspekt ku do t'i shërbejë shoqërisë. Kështu përmbushet një nga objektivat e mendimit pedagogjik islam dhe manifestohet me formimin e personalitetit individual të muslimanit. Ky konsiderohet një element efektiv për realizimin e vullnetit të Zotit të krijesat: të mbajnë amanetin që e kanë pranuar dhe të kryejnë me dinjitet mëkëmbjen në tokë. Çfarë do të thotë dy objektivat?

<sup>498</sup> Muslim, *Sahihu Muslim*, vep. e cit., libri: Fedail'us-sahabeh, Kapitulli: "Nga virtytet e Omerit r.a.", hadithi: 2393, fq. 975

<sup>499</sup> Po aty, libri "Virtytet e sahabëve, virtytet e Ebi Ubejdes bin Xherah, hadithi: 2419, fq. 985

<sup>500</sup> Et-Tirmidhij, *Xhamiu 't-Tirmidhij*, vep. e cit., libri "El-Menakibu", Kapitulli: "Menakibu Muadh bin Xhebel ve Zejd bin Thabit dhe Ubej bin Kab ve Ebi Ubejde", hadithi: (3791), fq. 589

<sup>501</sup> El-Buhari, *Sahihu el-Buhari*, vefq. e cit., libri "Ushqimet", Kapitulli: "Ma kane 'n-nebijju a.s. la je'kulu hatta jusemma lehu", hadithi: 5391, fq. 1067

Çfarë rëndësie ka pedagogjia ideologjike në ndërtimin e personalitetit individual të muslimanit, në integrimin fizik, mendor dhe shpirtëror të këtij personaliteti dhe në formimin e ekuilibruar të tij mes dijes dhe punës, mes fesë dhe shkencës, mes idealit dhe realitetit, me dogmës dhe kreativitetit?

Objektivi i dytë që duhet ta synojë mendimi pedagogjik islam është ndërtimi i identitetit kolektiv të këtij individi. Ky identitet do ta forcojë përkatësinë në një shoqëri të caktuar, do ta zhvillojë fuqinë e veprimit me të tjerët në ndërtimin e identitetit dhe ruajtjen e tij, do ta forcojë punën e përbashkët për ta ngritur shoqërinë islame bashkëkohore dhe do ta shkaktojë rizgjim kulturor të kësaj shoqërie. Çfarë do të thotë ky objektivi? Si mund të realizohet edukimi ideologjik? Nuk ka kuptim anëtarësimi i individit në shoqëri pa i kryer detyrimet dhe funksionet e veçanta për të cilat ka nevojë shoqëria, por gjëja më e rëndësishme që individi mund t'ia japë shoqërisë është bashkëpunimi me anëtarët tjerë të grupeve shkencore dhe profesionale për të ta ngritur shoqërinë dhe umetin në një aspekt profesional. Po ashtu, të bashkëpunojë për të hulumtuar zbrazëtirat dhe lëshimet e umetit, në mënyrë që t'i përmirësojnë ato, t'i japë përparësi interesit të përgjithshëm para interesit personal dhe të mbajë mbi supë të gjitha përgjegjësitë tjera kolektive.

Dihet se disa individë individualisht veprojnë shumë mirë dhe dinë se ç'veprojnë. Këta e kuptojnë të tashmen dhe kërkesat e momentit, mirëpo nuk dinë të punojnë në grup, nuk e perceptojnë fotografinë e përgjithshme të realitetit shoqëror dhe nuk i kuptojnë veprimet që kërkojnë bashkëpunim dhe integrim. Nuk i perceptojnë dot caqet për ku lëviz apo duhet të lëvizë shoqëria. Për këtë arsye, mendimi pedagogjik islam e ka për detyrë ta përgatisë çdo individ të shoqërisë për të punuar në grup, dhe atë jo vetëm për të investuar potencialet e veta individuale, por bashkë me të tjerët t'i përmbushë kërkesat e punëve të domosdoshme kolektive.



Sigurisht që personaliteti islam të cilin kërkon ta formojë mendimi pedagogjik islam duhet të cilësohet me këto dy aspekte për të pasur një formën e vet të plotë. Ligjërimi kur'anor i drejtohet personalitetit individual të njeriut, "O ti njeri!". Meqenëse ai cilësohet si anëtar i kolektivitetit, ky personalitet ka edhe veçori të përbashkëta, prandaj thuhet "O ju keni besuar!". Ka folur (Allahu) për individin vepërmirë, të cilit Ditën e Kiametit do t'i jepet libri i punëve në anën e djathtë, dhe për individin vepërkeq, të cilit Ditën e Kiametit do t'i jepet libri i punëve në anën e majtë. Gjithashtu, ka folur për grupet me cilësi të ndryshme, si: besimtarët, jobesimtarët dhe mynafikët, të devotshmit dhe mëkatarët, të humburit dhe të udhëzuarit.

Ka prej tyre që cilësohen me veti të mira, qofshin burra apo gra. Allahu xh.sh. thotë: ﴿وَالصَّادِقِينَ وَالصَّادِقَاتِ وَالصَّابِرِينَ وَالصَّابِرَاتِ وَالْخَاشِعِينَ وَالْخَاشِعَاتِ وَالْمُتَصَدِّقِينَ وَالْمُتَصَدِّقَاتِ وَالصَّائِمِينَ وَالصَّائِمَاتِ وَالْحَافِظِينَ فُرُوجَهُمْ وَالْحَافِظَاتِ وَالذَّاكِرِينَ اللَّهَ كَثِيرًا وَالذَّاكِرَاتِ أَعَدَّ اللَّهُ لَهُمْ مَغْفِرَةً وَأَجْرًا عَظِيمًا﴾ **"Të sinqertit dhe të sinqertët, durimtarët dhe durimtare, të ndrojturit dhe të ndrojturat, sadakadhënësit dhe sadakadhënëset, agjëruesit dhe agjërueset."** [El-Ahzab: 35]. Gjithashtu, ka folur për individ besimtar-burrë: ﴿وَقَالَ رَجُلٌ مُؤْمِنٌ مِنْ آلِ فِرْعَوْنَ يَكْتُمُ إِيمَانَهُ﴾ **"Një burrë besimtar nga familja e Faraonit e fshihte besimin e tij"**, por edhe për individ besimtar-grua: ﴿وَمَرْيَمَ ابْنَتَ عِمْرَانَ...﴾ **"Dhe Merjemja, bija e Imranit..."** [Et-Tahrim: 11]. Në të njëjtën kohë ka theksuar edhe individë jobesimtarë, burra dhe gra: ﴿تَبَّتْ يَدَا أَبِي لَهَبٍ وَتَبَّ (1) مَا أَغْنَىٰ عَنْهُ مَالُهُ وَمَا كَسَبَ (2) سَيَصْلَىٰ نَارًا ذَاتَ (3) لَهَبٍ (4) وَامْرَأَتُهُ حَمَّالَةَ الْحَطَبِ (4) فِي جِيدِهَا حَبْلٌ مِنْ مَسَدٍ﴾ **"Iu thafshin duar Ebu Lehebit dhe iu thanë. Nuk i bëri dobi malli dhe ajo që fitoi. Do të hidhet në zjarrin me flakë. Dhe gruaja e tij që barte shkurre, e cila në qafë mbante një konop të dredhur."** [El-Mesed: 1-5]

## 2. Veçoria e veprimit integrues dhe të ekuilibruar në ndërtimin e elementëve të personalitetit

Studimet për personalitetin në përgjithësi dallojnë tre elementë të personalitetit të njeriut: I pari është elementi lëndor/fizik i cili karakterizon ndërtimin fizik të njeriut si individ, si p.sh. sasia, ngjyra dhe shenjat formale. I dyti është elementi logjik i cili karakterizohet me informacione, njohuri, me përvoja intelektuale dhe praktike, dhe me mënyrat e fitimit të krejt këtyre. I treti është elementi shpirtëror apo ndërgjegjësor i cili karakterizohet me prirjet, me ndjenjat, me moralin dhe me vlerat e njeriut që e cilësojnë sjelljen e tij. Këta elementë e plotësojnë njëri-tjetrin në personalitetin e njeriut, prandaj ata mund të ndahen me shumë vështirësi vetëm kur është në pyetje studimi i tyre.

Mendimi pedagogjik islam kujdeset për ndërtimin e një personaliteti islam ku të tre elementët e plotësojnë njëri-tjetrin: trupi, arsyeja dhe shpirti. Kjo nënkupton se njeriu jeton me këto tri elemente. Edukimi, në realitetin, nuk është vetëm përgatitje për jetë, por është vetë jeta ku nevojat e saj integrohen në aspektet që e ndërtojnë njeriun fizikisht, shpirtërisht dhe intelektualisht.

Nëse themi se tre elementët e njeriut janë trupi, arsyeja dhe shpirti, atëherë patjetër që çdo element kërkon kujdesin për mjetet e përshtatshme të zhvillimit, të edukimit dhe të dëlirësimit. Trupi kërkon të edukohet me mjetet e veta, arsyeja me mjetet e veta dhe shpirti me të vetat. Veçoria e integritetit në mendimin pedagogjik nënkupton që çdo element i njeriut të marrë hisen e vet edukative, zhvillimore dhe dëlirësuese, bashkë me mjetet e përshtatshme. Edhe eksperti i edukimit fizik, kur dëshiron ta ushtrojë një person të caktuar, duhet të jetë i vetëdijshëm se ky person ka nevojë edhe për edukim intelektual dhe shpirtëror, sepse ato kështu i krijojnë hapësirë njëri-tjetrit. Madje, ekspertët e secilit aspekt kanë nevojë të bashkëveprojnë për të hulumtuar mënyrat e përmbushjes së të gjitha aspekteve, sepse kështu kontributi i njërit u hyn në punë edhe të tjerëve, dhe anasjelltas. Këta elementë lidhen me njëri-tjetrin dhe kanë ndikim të ndërsjellë, prandaj asnjëri nuk mund ta shmang tjetrin.

Besimi ka nevojë për punë të mirë, prandaj nuk e shmangin dot njëri-tjetrin, sepse përshkrimet e punës së mirë janë pikërisht ato që i përcakton dhe i kërkon besimi. Këto dyja Kur'ani i ka lidhur shpesh, prandaj Allahu xh.sh. thotë: ﴿إِنَّ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ يَهْدِيهِمْ رَبُّهُمْ بِإِيمَانِهِمْ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهِمُ الْأَنْهَارُ فِي جَنَّاتِ النَّعِيمِ﴾

**“Ata që besuan dhe vepruan të mira, të tillët Zoti i tyre i udhëzon me besimin e tyre. Nën ta rrjedhin lumenj në xhenetet e Neimit.”** [Junus: 9]. Besimi i udhëzon besimtarët në punët e mira, të cilat e bëjnë të denjë atë që pastaj të hyjë në xhenetet e Neimit. Personi që kërkon ta përhapë besimin, assesi nuk mund ta shmangë argumentin (arsyen). Integrimi dhe plotësimi i veprimtarisë pedagogjike patjetër t’i drejtohet burrit dhe gruas paralelisht në shoqëri, sepse edukimi i njërit nuk ndodh pa edukimin e tjetrit, prandaj edukimi duhet të bëhet në varësi të detyrave të ndryshme që bart secili.

## 2.1. Elementi fizik i personalitetit

Pavarësisht se trashëgimia edukative islame ka folur për edukimin e nxënësit në aspektin fizik, gjegjësisht në formën që duhet të jetë, përsëri praktika pedagogjike për përgatitjen fizike nuk ka marrë hisen e vet në institucionet e arsimit të programuar të shoqërisë islame. Përgatitja bëhej vetëm si pjesë e praktikave sociale dhe tradicionale, apo si pjesë e kërkesave të përgatitjes për jetën praktike.<sup>502</sup> Nuk kemi gjetur në trashëgiminë pedagogjike islame shumë shembuj për ekzistimin e një kohe të caktuar për edukimin trupor në programin mësimor ose javor, apo shembuj për hapësirat dhe këndet e lojërave në edukimin në mektebe.<sup>503</sup>

<sup>502</sup> Gazaliu në “Ihjaw ulum’id-din” për domosdoshmërinë e krijimit të hapësirës për fëmijë që të relaksohen me ndonjë lojë pas lodhjes (në mekteb), ka thënë: “Fëmija duhet të lejohet të luajë me ndonjë lojë dëfruese pas të largohet nga mektebi, kështu do të pushojë nga lodhja, sepse ai nuk lodhet me lojë. Privimi i fëmijës nga loja dhe ngarkesa me arsim ia lodh zemrën, i dobëson arsyen dhe ia vështirëson jetën, i cili pastaj kërkon hile të shpëtojë nga ky tip i jetës.” Shih:

- Ebu Hamid Muhamed bin Muhamed El-Gazali (vd. 505), *Ihjaw ulum’id-din*, Beirut, Dar’ul-Ma’rife, libri: Rijad’un-Nefs, vëllimi III, fq. 73.

<sup>503</sup> Në trashëgiminë pedagogjike islame gjejmë disa reflektime për domosdoshmërinë e krijimit të hapësirës relaksuese për fëmijë. Shih:

- El-Gazali, *Ihjaw ulum’id-din*, vep. e cit. vëllimi III, fq. 73.

Ndoshta, më vonë, e kishte kërkuar nevoja të ndërtohen pranë shkollave këto objekte shtesë, të cilat dizajnoheshin sipas pikëpamjes paraprake, që të përmbajnë objekte shtesë enkas për avdes, për namaz, për ushqim, për gjumë dhe për aktivitete të tjera. Në veprën “Tarihu ulemai ‘l-mustensirijjeh”, duke transmetuar nga një numër burimesh të trashëgimisë (islame), thuhet se shkollat në kohën e halifit Mustensir (halif nga viti 623 h. deri në vitin 640 h.) kryesisht ishin gjithëpërfshirëse dhe i përmbanin të gjitha lëndët, si p.sh. mjekësi, ruajta e shëndeti dhe forcimi i trupit<sup>504</sup> Krahas këtyre mësohen edhe shkencat e Kur’anit, të hadithit, të gjuhës dhe të tjera. Ne presim që projektimi i shkollës të përmbajë edhe hapësira dhe vende për ruajtjen e shëndetit dhe për zhvillimin e trupit.<sup>505</sup>

Disa tekste të trashëgimisë na kujtojnë se banorët e Damaskut ditën e shtunë shkonin te një vend i quajtur “sheshi i gjelbër”. Aty zhvillonin tregti, kalonin ditën me dëfrime dhe lojëra. Kur vinte koha e namazit të akshamit, faleshin në xhami, pastaj ktheheshin nëpër shtëpi.<sup>506</sup> Transmetohet nga banorët e Saves, qytet në veri të Iranit momentalisht, se të rinjtë e tyre dilnin në pranverë pas namazit të xhumasë për të bërë ndeshje të arteve marciale.<sup>507</sup>

Meqë sipas metodave të zhvillimit social, edukata fizike është pjesë e mendimit pedagogjik islam, atëherë tema e kësaj lënde nuk ka qenë larg nga teorizimi i kësaj edukate, nga shpjegimi i saj dhe i llojeve të saj, dhe nga mbështetja e krejt kësaj në tekstet e sheriatit nga Kur’ani dhe sunenit. Komentuesit e Kur’anit janë ndalur në disa ajete ku flitet për vlerën që ka njeriu te Zoti për mirëmbajtjen e fizikut të vet. Kurtubiu në tefsirin e vet për ajetin ﴿وَصَوِّرَكُمْ فَاَحْسَنَ صُورَكُمْ﴾ **“Ju formësoi dhe i përsosi format tuaja”** [Gafir: 64], ka thënë:

- Ebu Ali Ahmed bin Muhamed Ibn Meskeveji (vd. 421), *Tehdhib’ul-ahlak*, studim dhe redaktim, Amad El-Hilali, Bejrut: Menshurat ‘ul-Xhumel, 2011, fq. 389. Ka thënë: “Loja i ngjan rehatisë. Rehatia nuk e plotëson lumturinë dhe nuk është shkak i saj, por krijon stabilitet trupor...”.

<sup>504</sup> Ma’ruf, Tarihu ulemai el-mustensirijjeh, vep. e cit., fq. 1.

<sup>505</sup> Po aty, fq. 1.

<sup>506</sup> Zekerija bin Muhamed bin Mahmud El-Ensari El-Kazevejni (vd. 682), *Athar’ul-biladi ve ahbar’ul-ibadi*, Bejrut, Dar Sadir, fq. 191.

<sup>507</sup> Po aty, fq. 389.

“Kuptimin e fjalës tasvir (formësim) e kemi sqaruar më parë, e që do të thotë formësim dhe dhënie trajtë. Nëse shtrohet pyetja: si i ka përsosur format tuaja? I thuhet: i ka bërë gjallesat më të bukura dhe më të hijshme, ngase njeriu nuk mund ta mendonte që forma e tij të jetë ndryshe nga krijesat tjera. Njeriu është në formën më të mirë, sepse është krijuar të jetojë i ngritur, kurse gjallesat tjera janë të kërrusura.”<sup>508</sup>

Nuk ka dyshim se forma e trupit është pjesa e dukshme e cila krijon përshtypje të caktuar për të. Njësoj qëndron puna edhe me gjuhën dhe me të shprehurit e tij. Allahu i Lartësuar për mynafikët thotë: ﴿وَإِذَا رَأَيْتَهُمْ تُعْجِبُكَ أَجْسَامُهُمْ وَإِنْ يَقُولُوا تَسْمَعُ لِقَوْلِهِمْ﴾ **“Dhe kur i shikon ata, të magjepsin trupat e tyre, ndërsa kur flasin, i dëgjon fjalët e tyre...”**. [El-Munafikun: 4] Imam Raziu në tefsirin e tij “Et-Tefsir’ul-kebir” për këtë ajet ka thënë: “Dije se fjala e Allahut “Dhe kur i shikon ata” nënkupton Abdullah bin Ubejin, Mugith bin Kajs dhe Xhed bin Kajs, të cilët kishin trupa dhe dukje të mahnitshme dhe të hijshme. Abdullah bin Ubejj ishte njeri trupmadh, i pashëm dhe orator, i cili kur fliste, Pejgamberi a.s. e dëgjonte fjalën e tij.”<sup>509</sup>

Ky ajet konfirmon se dukja fizike e bukur dhe oratoria në të shprehur ndikojnë në shpirtin e shikuesit apo të dëgjuesit, edhe kur nuk e dimë se çfarë fshihet pas këtij dëgjuesi apo shikuesi. Nëse realiteti i kësaj dukjeje dhe oratorie është i mirë, lum për të!

Nuk mund ta harrojmë faktin se në Kur’an ka shumë ajete që flasin për vlerën e posedimit të fuqisë dhe të mjeteve fizike. Kur Allahu u zgjodhi Beni Israilëve një mbret, të cilin ata e kërkonin sipas kritereve të tyre, Allahu xh.sh. i theksoi dy virtyte të tij: diturinë e bujshme dhe turpin e fortë. Ibn Ashuri në tefsirin e tij për ajetin “Dhe i shtoi atij (mbretit) dije të bollshme dhe trup të fortë.” [El-Bekare: 247], tha: “Cilësitë e nevojshme për udhëheqjen e një populli janë mendimi origjinal i kulluar dhe forca fizike, sepse me mendim të drejtë i siguron interesat e popullit, sidomos në kohë krizash kur

<sup>508</sup> El-Kurtubij, *El-Xhamiu li ahkam’il-Kur’an*, vep. e cit., vëllimi XXI, fq. 9.

<sup>509</sup> Er-Razi, *Et-Tefsir’ul-kebir “Mefatihul-gajbi”*, vep. e cit., vëllimi XXX, fq. 14.

mbarojnë këshillimet dhe ka divergjenca, kurse me forcë bëhet i qëndrueshëm në fushëbetejë, ndërsa qenia e tij i qëndrueshëm i jep qëndrueshmëri edhe ushtrisë.” Beni Israilët kërkuan nga i dërguari t’u sjellë një mbret për të luftuar në rrugën e Allahut. “Allahu u zgjodhi një mbret të pajisur me veti që i mundësojnë t’i udhëheqë ushtarakisht.”<sup>510</sup>

Në tefsirin “El-Menar”, për temën e njëjtë, shkruhet si vijon: “Këtu (në ajet) është mjaftuar me theksimin e kapacitetit të dijes me të cilën bëhet planifikimi (i punëve), kurse kapaciteti i trupit tregon për shëndetin dhe fuqinë që ndihmon në zhvillimin e mendimit të drejtë, në stimulimin e trimërisë, të forcës për të sfiduar, të krenarisë dhe të respektit.”<sup>511</sup>

Në jetën dhe në traditën peygamberike të Muhammedit a.s. ka shumë raste që konfirmojnë rëndësinë e pastërtisë së trupit, të petkut dhe të vendit, si në shtëpi dhe jashtë saj, sidomos kur grumbullohen njerëzit. Nga tekstet e tilla janë instruksionet peygamberike që emërtohen si *ligje të fitres*, si p.sh. pastrimi i mjekrës, misvaku, përdorimi i parfumit të përshtatshëm etj. Në hadithin vijues thuhet: “Rregulloni gjërat e udhëtimit dhe rregulloni teshat derisa të jeni të dalluar në mesin e njerëzve!”<sup>512</sup>

Megjithatë, pëlqimi i paraqitjes së bukur në dukje dhe në fjalë, bashkë me ndikimin e këtyre në shpirt, nuk duhet të ndodhë pa i rregulluar gjërat e brendshme dhe të vërtetat. Për këtë arsye, Muhammedi a.s. i ka mësuar shokët të mos kapen vetëm pas pamjes së jashtme. Një ditë, kur Muhammedi a.s. ishte me shokët e vet, e provoi ndikimin e dukjes tek ata. Aty pranë kaloi një njeri që dukej i pasur, ndërsa Pejgamberi a.s. i pyeti për atë, kurse ata e lavdëruan. Pastaj kaloi një njeri tjetër që dukej i varfër, për të cilin përsëri i pyeti sahabët, kurse ata nuk e lavdëruan. Me këtë rast Muhammedi a.s. tha: “Ky është më mirë se ta mbushësh

<sup>510</sup> Ibn Ashur, *Tefsir’ut-tahrir ve’ t-tenvir*, vep. e cit., vëllimi II, fq. 491.

<sup>511</sup> Muhamed Reshid Rida, *Tefsir’ul-menar*, Kajro: Metbeat’ul-Menar, 1350 h., vëllimi II, fq. 477.

<sup>512</sup> Ebu Davud, *Sunenu Ebi Davud*, vep. e cit., Libri: “El-Libasu”, hadithi: 4089, fq. 446.

tokën me atë tjetrin!”<sup>513</sup> Kështu i mësoi ata se mahnitja me dukjen nuk duhet të ndikojë dhe të bëhet kriter i vlerësimit të njerëzve. Shembulli që e sollëm këtu flet se te njerëzit është e zakonshme që forma e jashtme e njerëzve, trupi dhe teshat, lanë gjurmë në zemrat e tyre, edhe pse Allahu e di realitetin e njerëzve.

Këto instruksione kur'anore dhe peygamberike i kanë shtyrë ulematë të konstatojnë rëndësinë e dimensionit trupor në personalitetin e njeriut dhe kujdesin për të. Ibn Kajimi në veprën “Zad ‘ul-mead” ka ndarë një kapitull të titulluar: “Udhëzimi peygamberik për sportin”. Në të ka thënë: “Organizimi i lëvizjes dhe pushimit është vetë sporti.” Ka theksuar hollësi të ndryshme për shkakun që obligon sportin. Ka treguar dobitë, kohën dhe llojet e sportit. Ka folur për ushtrimin e zemrave dhe për ushtrimet tjera (trupore dhe shpirtërore). Ndër të tjera ka thënë: “Çdo organ ka ushtrimin e vet, pastaj ka theksuar kraharorin, dëgjimin, shikimin dhe gjuhën.” Po ashtu, ka thënë: “Ushtrimi i të ecurit duhet të bëhet gradualisht, pak e nga pak, ndërsa kalërimi, gjuajtja në shënjestër, dyluftimi dhe garat në vrap, janë sport i gjithë turpit dhe largues të disa sëmundjeve kronike.”<sup>514</sup>

Ajo që na intereson këtu është pohimi se mendimi pedagogjik islam që synojmë ta ngremë nuk mund ta shmangë përgatitjen e njeriut për të pasur trup të shëndoshë dhe të jetë i fortë për kryerjen e detyrave në jetën e tij personale, familjare dhe shoqërore. Forca dhe shëndeti janë çështje të natyrshme dhe kuptohen apriori. Gjithashtu, këto janë nevoja që njeriu t'i kryejë sa më lehtë adhurimet: namazin, agjërimin, haxhin etj. Njeriu detyrohet të përpiqet të fitojë furnizimin, gjërat që i duhen në profesion dhe të jetë pjesëmarrës në bartjen e barrës së xhihadit për kohën e vet etj.

Trupi në personalitetin e njeriut është themel i shëndetit dhe mbarëvajtjes së punëve tjera. Kjo nuk është cilësi e

<sup>513</sup> El-Buhari, *Sahih'ul-Buhari*, vep. e cit., libri: “En-Nikah”, hadithi numër: 5091, fq. 1009.

<sup>514</sup> Ebu Abdullah Muhamed bin Ebi Bekr bin Ejjub Ibn Kajjimi, (vd. 751 h.), *Zad'ul-mead fi hedji hajr'il-ibadi*. Tekstin e kontrollon: Shuajb Arnauti dhe Abdulkadir Arnauti, Bejrut, Muesseset'ur-Risaleti, botimi I, 2009, fq. 682-683.

përcaktuar me matës materialë, gjegjësisht me sasi dhe mënyrë, sepse njerëzit dallohen me potenciale të ndryshme në kryerjen e detyrave. Njeriu mund të jetë i fortë në një punë dhe i dobët në një tjetër. Dikush mund të dallohet në manifestimin e potencialet mendore dhe psikike sesa në aftësitë fizike, gjëra të cilat i forti s'mund t'i bëjë.

Për këtë arsye, sistemi pedagogjik duhet t'u sigurojë nxënësve shanse të ndryshme për forcimin e trupit, sepse dikush do të aftësohet për vrapim dhe kërcim, dikush për bartje, tërheqje dhe shtyrje, dikush do të posedojë shkathtësi të veçanta luftarake, dikush do të fokusohet në shqisën e shikimit, të dëgjimit dhe të folurit, apo në aftësitë fizike për lloje të ndryshme të profesioneve etj. Shoqëria ka nevojë për secilin prej tyre dhe çdokujt i është lehtësuar ajo për të cilën është krijuar.

Sistemi pedagogjik duhet t'i drejtojë njerëzit kah gjërat që i sigurojnë atij shëndet, dhe atë përmes udhëzimeve të shëndetshme për pastërtinë, ushqimin dhe pijen, në mënyrë që ta ruajë turpin nga gjërat që e dobësojnë apo ia zvogëlojnë aftësitë. Pra, ushqimi dhe pirja duhet të jenë nga gjërat që i ka lejuar Allahu, pa teprim dhe keqpërdorim, pa e lodhur trupin (me ushqim) dhe pa e dobësuar (pa të). Muslimani ka nevoja të veçantë në pastërti, gjegjësisht në pastrimin fizik të trupit, të petkut dhe të vendit.

## 2.2. Elementi logjik i personalitetit

Nuk do ta zgjasim bisedën për elementin logjik të personalitetit, sepse ka pasur, dhe vazhdon ta ketë, kryen e vendit në përpjekjet arsimore në historinë islame. Pavarësisht se tekstet e trashëgimisë pedagogjike islame më shumë kanë qenë të fokusuar në vlerën e dijes dhe të dijetarëve, në virtytet e mësuesit dhe të nxënësit, dhe në tematikat që ngërthenin instruksione kah formimi i personalitetit të njeriut, përsëri, praktikat shkencore kryesisht kanë qenë të përqendruara në lëndët mësimore, veçanërisht në mësimin, nxënien dhe komentimin e Kur'anit, në mësimin e hadithit me tekst dhe me zinxhir, në mësimin e disa shkencave të



gjuhës dhe të letërsisë, në mësimin e disa njohurive themelore të llogarisë dhe në shumë tematika të tjera.

E saktë është se elementi logjik lidhet me shkencat që i mëson nxënësi, mirëpo ai është edhe më i lidhur me metodën që i mëson këto shkenca, me logjikimin, me formën e të menduarit dhe me meditimin për ta fituar këtë kuptim, kuptohet në bazë të vetëdijes dhe të perceptimit të këtyre shkencave. Për këtë arsye, dijetarët kur flasin për intencat e sheriatit, ruajtjen e arsyes e kanë vënë pranë ruajtjes së jetës, ruajtjes së pasurisë, ruajtjes së prejardhjes dhe ruajtjes së nderit (apo krenarisë njerëzore). Bazë e efikasitetit të arsyes është përdorimi i mjeteve dhe i metodave të cilat kontribuojnë për aktivizimin e dijes, të menduarit dhe meditimit. Këto angazhime janë veçori të njeriut dhe tregues të vetëdijes së tij dhe të asaj që e rrethon. Për këtë arsye Kur'ani fisnik e ka cilësuar atë që ndalon së menduari për këto punë si gjallesat tjera, madje edhe më të lajthitur.<sup>515</sup>

Operationet e logjikës, të mendimit dhe të meditimit mund të jenë sfera pjellore në punën pedagogjike, kurse reflektimet e tyre shfaqen në formë të drejtpërdrejtë tek personaliteti i njeriut, dhe atë në dy aspekte: në aspektin logjik dhe shpirtëror. Këto nuk janë operatione të thjeshta arsimore të cilat qëndrojnë vetvetiu në lëndët pedagogjike të përcaktuara, por ato përbëjnë një metodë bashkëveprimi me lëndët e ndryshme mësimore. Në mësimin e tekstit kur'anor ka raste që ngjallin rrugën e drejtë dhe të urtë. Nga shembujt e tillë është se tregimet e pejgamberëve dhe të popujve të tyre jepeshin për të marrë mësim.<sup>516</sup> Mësime dhe urtësi ka edhe në

<sup>515</sup> Si reflektim këtij ajeti të Kur'anit: "A mendon se shumica e tyre dëgjojnë dhe logjikojnë?! Të tillët s'janë gjë tjetër veçse si kafshët, madje edhe më të lajthitur." (El-Furkan: 44), apo ajeti: "Ne krijuam shumë nga xhinët e njerëzit për Xhehennem. Ata kanë zemra që me to nuk kuptojnë, ata kanë sy që me ta nuk shohin dhe ata kanë veshë që me ta nuk dëgjojnë. Ata janë si kafshët, bile edhe më të humbur, të tillët janë ata të marrët." [El-A'raf: 179]

<sup>516</sup> Allahu (xh.sh.) thotë: "E sa e sa brezni para tyre kemi shkatërruar e që ishin më të fortë e më të shkathët se këta (idhujtarët kurejshitë). Ata brodhën andej e këndej nëpër tokë (për t'i ikur vdekjes). Por, a mos gjetën rrugëdalje? Në të gjitha këto, për atë që ka mendje të shëndoshë dhe që i ka vënë me vëmendje, ka argumente." [Kaf: 36-37] Po ashtu, Allahu i Lartësuar thotë: "Ne tregimet e tyre (të dërguarve dhe të Jusufit me vëllezër) pati mësim e përvojë për të zotët e mendjes. Ai (Kur'ani) nuk është bisedë e trilluar, por vërtetues i asaj që ishte më parë (librave të shenjta) dhe sqarues i çdo sendi, e edhe udhërrëfyes e mëshirë për një popull që beson." [Jusuf: 111]

kozmos.<sup>517</sup> Në mësimin e historisë ka momente që e vënë në punë arsyen për të menduar, për të marrë mësim dhe për të medituar rrjedhën dhe ecurinë e ngjarjeve në kohë. Gjithashtu, shkencat natyrore kanë momente për vështrim dhe meditim rreth krijimit të gjërave, bashkë me veçoritë dhe ndryshimet. Në operacionet eksperimentuese ekziston mundësia e mendimit dhe meditimit për parashikimin e ngjarjeve, për orientimin e tyre, dirigjimin me to dhe vënien e tyre në funksion.

Mund të themi se mësimi i çdo shkence ka hapësira të ruajtjes, të aktivizimit dhe të vënies së arsyes në funksion të fitimit të dijes, e cila pastaj siguron kënaqësinë e mësimit, dashurinë ndaj virtytit shkencor, e ndërton ndjenjën kritike përmes së cilës zbulohen mangësitë e dijes së deritanishme, e mbush trurin, i mbledh potencialet për bashkëveprim me mangësitë, kontribuon në zhvillimin dhe avancimin e dijes, dhe përmbush vullnetin e Allahut për të kërkuar më shumë dije.

Mundësia e zbulimit dhe e zhvillimit të shkencave bashkë me praktikatat industriale nuk është monopol i pjesëtarëve të një feje apo etnie dhe nuk kufizohet në një vend apo kohë të caktuar, sepse fuqia mendore është dhuratë hyjnore për të gjithë, kurse veprimi i saj shfaqet aty ku jepen shanset e zhvillimit dhe të avancimit. Përdorimi i trurit në të gjitha këto nënkupton ndërtimin e jetës në tokë dhe përmbushjen e vullnetit të Allahut të Lartësuar për mëkëmbje në të. Nga fillimi në fund, në të gjitha këto operacione fitohet besimi i thellë i besimtarit në fuqinë, në vullnetin dhe në urtësinë e Allahut të Lartësuar.

Mësimi i shkencave të ndryshme pa pasur njohuri për elementin logjik të personalitetit nuk mjafton për ndërtimin e këtij elementi, sepse mungesa e vetëdijes për të e pengon arritjen e objektivit të edukimit logjik në formë të drejtpërdrejtë në metodat dhe në praktikatat e arsimit. Për këtë arsye, ndër objektivat e edukimit duhet të jetë trajnimi i

<sup>517</sup> Allahu xh.sh. thotë: "Allahu e ndryshon natën dhe ditën. Në këtë ka mësim për ata që kanë sy." [En-Nur: 44]

nxënësve që të logjikojnë, të mendojnë dhe të meditojnë në numrin e sferave të shkencave natyrore, sociale dhe fetare. Prej këtyre, sa për shembull janë këto:

- Meditimi në dispozitat e ligjësuara nga Allahu i Lartësuar për të kuptuar urtësinë e përmbushjes së interesave dhe të shmangies së dëmeve, por mbi bazën e vullnetit të lirë dhe mendimit të lirë i cili stimulon aftësitë logjike të cilat çojnë te besimi vullnetar dhe bindja.

- Meditimi dhe marrja mësim nga ligji hyjnor i vënë në botën sociale, në ngjarjet historike, në ngritjen dhe në rënien e kulturave, dhe në tregimet e popujve të tyre.

- Mendimi dhe meditimi në imazhet e botës natyrore, në gjërat, në ngjarjet, në dukuritë dhe në shpalosjen e këtyre ligjeve, në eksperimentin dhe në funksionalizimin e tyre.

- Sqarimi, vërtetimi dhe trajtimi i lajmeve me mjete të përshtatshme sipas natyrës së gjërave dhe të ngjarjeve, sipas indikatorëve të sinqeritetit dhe sipas besueshmërisë së burimeve. Kjo arrihet përmes konfirmimit të lajmit të transmetuar, përmes provës së saktë dhe përmes përfitimit nga metodat dhe mjetet e eksperiencës njerëzore bashkëkohore. E krejt kjo bëhet me mësim të ndërsjellë, duke vijuar kërkimin e diturisë dhe shtimin e saj.

- Çlirimi i arsyes nga gjërat që e pengojnë funksionimin e shëndoshë të elementit logjik të personalitetit njerëzor, si p.sh. ndjekja e verbër apo dogma në çështjet e dynjasë, trajtimi i momenteve të kësaj bote pa sfond të shëndoshë (fetar), ndjekja e mëdyshjes dhe pasimi i epshit, dhe moskërkimi serioz në burimet e besimit dhe të bindjes.

- Refuzimi i autokracisë në të menduar dhe kufizimi i lirive të cilat shpesh bëhen monopol i pushtetit në administratën e shtetit, në shoqëri, në familje dhe në institucionet tjera. Pushteti absolut është i papranueshëm, sepse i dobëson potencialet e popullit, i pakëson mundësitë dhe i humb shanset.

Ndër punët më të rëndësishme për ta shmangur dobësimin dhe joefikasitetin e arsyes është vetëdijesimi për efektin që lanë disa media të cilat sot i kanë okupuar mendjet

e njerëzve me lajme, analiza dhe gjëra ndikuuese. Kështu puna përfundon me larje truri dhe me formim të mendësisë faraonike.<sup>518</sup>

Ajo që tërheq vëmendjen në metodën kur'anore për arsyen është se askund nuk ka folur për të me trajtë të ermit apo si organ të trupit të njeriut, siç ka folur për syrin dhe veshin, por çdoherë Kur'ani flet për arsyen duke e cilësuar si veprim, si folje dhe si praktikë e jetës individuale dhe shoqërore. Kjo është veçori me të cilën Allahu e ka dalluar njeriun nga krijesat tjera në botën e dukshme. Dijetarët janë në ujdi, siç ka thënë El-Ixhi, se kjo veçori është arsyeja përse Zoti e ka ngarkuar njeriun me detyrë dhe përgjegjësi.<sup>519</sup>

Funksioni i arsyes është logjikimi i shkencave dhe i njohurive, bashkë me kuptimin dhe perceptimin e tyre. Ndonjëherë arsyeja vjen me kuptim të shkencave dhe të vetë njohurive. Truri ka rëndësinë e vet në proceset e logjikës, të perceptimit dhe të vetëdijesimit me zbulimet shkencore. Mirëpo, Kur'ani konstaton se zemrat e vendosura në kraharorë janë ato që i kryejnë këto operacione (logjike). Allahu xh.sh. thotë: ﴿أَفَلَمْ يَسِيرُوا فِي الْأَرْضِ فَتَكُونَ لَهُمْ قُلُوبٌ يَعْقِلُونَ بِهَا أَوْ آذَانٌ يَسْمَعُونَ بِهَا فَإِنَّهَا لَا تَعْقَى الْأَبْصَارَ وَلَكِنْ تَعْقَى الْقُلُوبُ الَّتِي فِي الصُّدُورِ﴾ **“A nuk kanë ecur në Tokë që të kenë zemra me të cilat logjikojnë apo veshë me të cilët dëgjojnë. Nuk verbohën sytë, por verbohën zemrat që janë në kraharorë.”** [El-Haxh: 46]

Prandaj, kuptimi ynë për logjikën dhe logjikimin duhet të reflektojë në ndërtimin e pendimit pedagogjik islam, bashkë me kuptimin tonë ndaj praktika tona ndaj metodave të arsimit. Muhamed Reshid Rida, qysh në kohë të hershme, gjegjësisht qysh në shekullin XX, e ka spikatur praninë e zbehur të elementit logjik në personalitet e anëtarëve të këtij umeti, prandaj e ka tërhequr vërejtjen duke thënë: “Interesimi ynë për edukimin në shkollat e vendeve arabe duhet të jetë më i madh sesa interesimi i të tjerëve për ato, sepse neve na

<sup>518</sup> Duke iu referuar ajetit kur'anor që flet për Faraonin: “Faraoni tha: nuk ju tregon juve veçse atë që shoh unë vetë dhe nuk udhëzoi veçse në rrugën e drejtë.” [Gafir: 29]

<sup>519</sup> El-Ixhi, Ebu 'l-Fadl Adudud-din Abdurrahman bin Ahmed bin Abdulgar (vd. 756), *El-Mevakifu fi ilm'il-kelami*, Kajro: Mektebet'ul-Mutenebbi, fq. 146

ka munguar edukimi themelor, edukimi i grave, prandaj shohim nxënës me moral të prishur dhe në mendje rrotullojnë vetëm legjenda. Ne nuk e kemi përmbushur këtë detyrim, kurse shollat tona nuk janë kujdesur për edukimin psikik dhe as për edukimin logjik, i cili është edhe funksioni i parë. Me togun *edukim logjik* nuk nënkuptoj mësimin e shkencave që e zhvillojnë arsyen, por që në metodat arsimore të ndërfitet pavarësia e studentëve në të kuptuar dhe në gjykimin e problemeve, çlirimi i fakteve (nga dogmat) dhe të mos mësohet t'i marrin çështjet shkencore të gatshme dhe verbërisht.<sup>520</sup>

Kur'ani fisnik, kur flet për logjikën, e lidh atë që quhet edukim logjik me edukimin besimor. Kur'ani, kur e udhëzon njeriun për mbarëvajtjen në tokë, për vështrimin dhe meditimin e dukurive të kozmosit, si p.sh. lëvizjet e diellit dhe të hënës, ndërrimin e natës dhe të ditës, rënien e shiut, ringjalljen e bimëve, atëherë dijen dhe njohjen logjike me të cilën njeriu i mëson këto dukuri e konsideron thirrje për meditim në krijimtarinë (e Zotit) dhe në urtësinë e saj. Gjithashtu, këtë e konsideron shkak për ta thelluar besimin, për të besuar në dijen (besimore), në fuqinë dhe në urtësinë e saj. Allahu i Patëmetë është i informuar mirë për efektin e edukatës logjike në edukimin besimor dhe dogmatik. Allahu xh.sh. thotë: ﴿صُنِعَ اللَّهُ الَّذِي أَنْفَعَنَا كُلَّ شَيْءٍ إِنَّهُ خَبِيرٌ بِمَا تَفْعَلُونَ﴾ **“Krijimi i Allahut i cili e ka perfeksionuar çdo gjë. Vërtet Ai është i Gjithinformuar për atë që veproni.”** [En-Neml: 88]

### 2.3. Elementi shpirtëror-psikik i personalitetit

Më parë e theksuam se njeriu, sipas shumicës së mendimtarëve myslimanë klasikë dhe modernë, përbëhet nga trupi, mendja dhe shpirti. Kështu që, çdo edukim u drejtohet këtyre tre elementëve, prandaj edhe çdo mendim pedagogjik do t'i trajtojë dhe t'u kushtojë vëmendje këtyre. Më herët folëm për elementin fizik apo trupor dhe për elementin logjik, kurse tani shtrohet pyetja: çfarë është

<sup>520</sup> Muhamed Reshid Rida, *Mexhel-let'ul-Menar*, Kajro, 30 Sha'ban, gusht 1912, vëllimi 15, pjesa VIII, fq. 574

elementi shpirtëror? Cila është pedagogjia shpirtërore? Çfarë marrëdhënie ka ajo me pedagogjinë psikike?

Presim që çdo bisedë për edukimin shpirtëror në mendimin pedagogjik islam të vijë si bazë në dritën e bisedës së Kur'anit për shpirtin. Në Kur'an është dhënë fjala "Er-Ruh" me disa kuptime, ku prej tyre është kuptimi që lidhet me Allahun e Lartësuar, i Cili e filloi krijimin e njeriut nga balta, pastaj i fryu ruhun (shpirtin), ia mësoi të gjitha emrat, e ngarkoi me amanet, ia dha detyrën e mëkëmbjes në Tokë dhe ia dhuroi virtytin e fisnikërimit. Ndoshta ky kuptim i ruhut (shpirtit) është ai për të cilin është pyetur i Dërguari i Allahut a.s., që pastaj përgjigja të vijë nga ana e Allahut xh.sh. përmes këtij ajeti: **"Thuaj: shpirti (ruhi) është punë e Zotit tim, kurse juve nuk ju është dhënë dituri, veçse pak."** [El-Isra: 85] Në këtë përgjigje tregohet se fillimisht nuk duhet të zhytemi në asnjë çështje të gajbit që është specifike vetëm e Allahut. Megjithatë, trashëgimia islame ka shënuar shumë biseda të hollësishme për shumë çështje të cilat dijetarët i kanë konsideruar si të ndërlidhura me termin ruh dhe nefis (shpirtin), dhe marrëdhënien mes këtyre dyjave.

Në veprën "Kitab'ur-ruh" të Ibn Kajjimit gjejmë një materie të bollshme, ku në pjesën më të madhe e ka shkruar si përgjigje për shumë dilema, si: shpirti, jeta në berzah (varr), dënimi në varr, vendi i shpirtit pas vdekjes dhe pak sqarim është përpjekur të japë për dallimin mes ruhut dhe nefsit. Në librin në fjalë ka theksuar tre lloje të shpirtit: shpirti i qetë, shpirti i mallkuar dhe shpirti i prirë për keq, për të cilat flasin vetë ajetet kur'anore. Ndër të tjerash ka thënë: "Qëllimi me këtë paraqitje është spikatja e disa gjendjeve të shpirtit të keq, shpirtit mallkues dhe shpirtit të prirë për keq, bashkë me disa veti të përbashkëta dhe dallime mes tre llojeve të shpirtit. Po ashtu, ka paraqitur veprimet, ndasitë, objektivat dhe qëllimet e secilit shpirt. Pas krejt kësaj ka një paralajmërim, se çdo shpirt në vetvete ndonjëherë mund të jetë i prirë për keq, ndonjëherë mallkues dhe ndonjëherë i qetë. Te shumica e njerëzve sundon shpirti i prirë për keq, kurse shpirti i qetë është më i rrallë në racën njerëzore, por më i madh me vlerë

tek Allahu i Lartësuar. Për këtë Allahu xh.sh. ka thënë: ﴿يَا أَيُّهَا النَّفْسُ الْمُطْمَئِنَّةُ (27) ارْجِعِي إِلَىٰ رَبِّكِ رَاضِيَةً مَّرْضِيَّةً (28) فَادْخُلِي فِي عِبَادِي (29) وَادْخُلِي جَنَّاتِي﴾  
**“O ti shpirt i qetë, ktheu te Zoti yt i kënaqur. Hyr te robërit e Mi. Hyr në xhenetin Tim”** [El-Fexhr: 28-30]<sup>521</sup>

Në këtë rast, meriton të theksohet se fjala “ruh” në Kur’an jepet edhe me kuptime tjera, si p.sh. meleku i ngarkuar me shpallje, i cili është Xhibrili, si në ajetin **“Zbresin melekët dhe Ruhun në atë (natë) me lejen e Zotit të tyre për çdo çështje.”** [El-Kadr: 4]. Po ashtu, në Kur’an theksohet “Kështu të shpallëm ti një ruh (Xhibrilin) me urdhër tonë, e ti nuk dije ç’është Libri dhe as imani, por ne e bëmë atë dritë me të cilën drejtojmë kë të duam nga robërit tanë.” [Esh-Shura: 52]. Fjala ruh mund të vijë edhe me kuptim të fjalës së Allahut, si p.sh.: ﴿رَفِيعَ الدَّرَجَاتِ ذُو الْعَرْشِ يُلْقِي الرُّوحَ مِنْ أَمْرِهِ عَلَىٰ مَنْ يَشَاءُ مِنْ عِبَادِهِ لِيُنذِرَ يَوْمَ الْقِيَامِ﴾  
**“(Allahu) është Ngritësi i gradëve, pronari i Arshit që ia hedh ruhun (fjalën) me urdhër të Tij kujt të dojë nga robërit”** [Gafir: 15]. Fjala ruh mund të paraqitet edhe me kuptimin e mëshirës, si në ajetin në vazhdim: ﴿أُولَئِكَ كَتَبَ فِي قُلُوبِهِمْ﴾  
**“Të tillëve ua ka shkruar në zemrat e tyre besimin dhe i ka përkrahur me ruh (mëshirë) prej Tij.”** [El-Muxhadele: 22]

Redaktori i librit “Kitab’ ur-ruh” i Ibn Kajjimit thekson se trashëgimia islame flet për një sërë veprash që flasin për ruhun (shpirtin), prej të cilave “nuk dimë se ekzistojnë sot në bibliotekat e librave. Vetë Ibn Kajjimi, para librit “Kitab ‘ur-ruh”, ka pasur një vepër tjetër madhështore të quajtur “Er-Ruhu” dhe “En-Nefsu”, por ne nuk jemi ndalur tek ai, sepse nuk e dimë nëse është humbur në mesin e librave tjerë të çmuar të trashëgimisë së Ibn Kajjimit apo ende është i fshehur në ndonjë qoshe duke pritur që dikush ta zbulojë dhe t’ua promovojë njerëzve. Vepra “Kitab ‘ur-ruh” e Ibn Kajjimit është e vetja e këtij autori për këtë tematikë që sot e kemi në dorë.”<sup>522</sup>

<sup>521</sup> Muhamed bin Ebi Bekr bin Ejjub Ibn Kajjim Xhevziz (vd. 751). *Kitab ‘ur-ruh*, i përgatitur për botim nga Muhamed Exhmel, Mekë: Daru Alem’il-Fevaidi, 1432 h./2011, fq. 742

<sup>522</sup> Po aty, fq. 5

Megjithatë, edukata shpirtërore, sipas muslimanëve që shkruajnë për këtë, në përgjithësi nënkupton marrëdhënien e njeriut me Allahun e Lartësuar. Kjo marrëdhënie forcohet me thellimin e besimit në Allahun e Madhërishëm dhe me lidhjen e vazhdueshme me Të përmes adhurimeve të detyrueshme dhe vullnetare. Ky kuptim i edukimit shpirtëror nuk përbën asnjë problem kur llogaritet si pjesë e kuptimit të përgjithshëm të ibadetit në Islam, i cili i përfshin të gjitha punët e mira të kryera nga besimtari në emër të nënshtrimit ndaj Tij dhe të aspirimit të sevapit nga Ai, si p.sh.: ritet adhuruese dhe veprimet që lidhen me marrëdhëniet sociale, ekonomike, politike, pedagogjike, artistike dhe të tjera.

Sa u përket veprave të shumta që flasin për raportin mes shpirtit të vdekurve me të gjallët përmes ëndrrave dhe formave tjera të panjohura, ne preferojmë të mos tregojmë shumë interes të theksuar për këtë. Gjithashtu, përmbahemi dhe nuk zhytemi në meselenë e shpirtit kur flitet për Ademin a.s., ku Allahu xh.sh. thotë: ﴿فَإِذَا سَوَّيْتُهُ وَنَفَخْتُ فِيهِ مِنْ رُوحِي فَقَعُوا لَهُ﴾ “E kur e përsosa dhe i fryva nga ruhi (shpirti) Im, i ranë në sexhde.” [El-Hixhr: 29] dhe as për ruhun që flitet në rastin e Merjemes a.s., ku Allahu xh.sh. thotë: ﴿وَمَرْيَمَ ابْنَتْ عِمْرَانَ الَّتِي أَحْصَيْنَا فَرْجَهَا فَنَفَخْنَا فِيهِ مِنْ رُوحِنَا وَصَدَّقْتَ بِكَلِمَاتِ رَبِّهَا وَكُنْتِ مِنَ الْقَائِمِينَ﴾ “Dhe Merjemja, bija e Imranit, e cila e mbrojti nderin e saj, e atij (nderit apo organit) i frymë nga ruhu Ynë.” [Et-tahrim: 12]. Mjafton shpirti i njeriut dhe besimi se ky shpirt është nga Allahu. Gjithashtu, mjafton të dimë se shpirti ekziston kur njeriu është i gjallë në këtë dynja, dhe atë përmes funksioneve dhe manifestimeve të tij, dhe se shpirti i individit njerëzor ndahet nga trupi kur mbaron jeta e kësaj bote. Ky shpirt është besimtar i mirë apo mëkatar i keq.

Shkrimet bashkëkohore për edukatën shpirtërore dhe edukatën islame në mendimin islam kryesisht përzihen me edukatën psikike dhe edukatën etike. Të gjitha këto, edukata shpirtërore, edukata psikike dhe edukata etike shprehin atë që ne e quajmë pedagogji besimore, apo afrim tek Allahu i Madhërishëm përmes të gjitha llojeve të adhurimit të legjitimuara sipas sheriatit dhe përmes ngritjes në nivelet dhe



degët e ndryshme të besimit të cilat janë të shtrira në krerët e ndryshëm të besimit, të adhurimit dhe të marrëdhënieve mes njerëzve, siç është potencuar në hadithin e saktë për degët e besimit.<sup>523</sup>

Dijetarët, kur janë përpjekur t'i numërojnë degët e besimit, e kanë pasur patjetër t'i përfshijnë edhe meseletë e besimit, bashkë me gjashtë shtyllat e besimit, temat që lidhen me Allahun e Lartësuar, si: dashuria, frika dhe shpresa, meseletë e adhurimit, bashkë me shtyllat e Islamit: llojet dhe dispozitat, meseletë e marrëdhënieve mes njerëzve, si: respekti ndaj prindërve, ruajtja e raporteve familjare, urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqja, problemet e përgjithshme etj. Gjithashtu, i kanë përfshirës problemet e përgjithshme të umetit, si: gjykimin, pajtimin mes njerëzve, xihadin kundër armiqve dhe qëndresën në luftë; kanë përfshirë gjërat e përditshme, si: hajen, pijen dhe veshjen, veprimet estetike dhe sjelljen e mira, si: turpin, largimin e pengesave nga rruga, thënien "shëndet" atij që teshtin, moralin e mirë etj. Hafidh el-Bejhekiu i ka trajtuar hollësisht këto degë të besimit, derisa ka arritur te numri shtatëdhjetë e shtatë degë.<sup>524</sup>

Trashëgimia pedagogjike islame ngërthen një lëndë shumë të pasur për shpirtin e njeriut. Është shkruar shumë nën hijen e ajeteve fisnike të Kur'anit për të. Ndër to ishin ajetet që sqaronin llojet e shpirtave, gjendjet shpirtërore dhe sëmundjet e tyre. Disa libra të trashëgimisë (islame) kanë grumbulluar gjithë traditën pejgamberike dhe thëniet e sahabëve e tabi'inëve për këtë çështje. Gjithashtu, disa shkrime japin sqarime të hollësishme për marrëdhënien e shpirtit me arsyen, me zemrën dhe me ruhun. Nëpër këto libra shohim se shpesh janë dhënë edhe thënie filozofike për të cilat mendimi islam nuk ka pasur nevojë. Në përpilimin e

<sup>523</sup> Në "Sahihu Muslim" jepet ky hadith: "Besimi është shtatëdhjetë e disa degë apo gjashtëdhjetë e disa degë: dega më e lartë është "la ilahe il-Allah", kurse më e ulëta është largimi i një pengese nga rruga. Edhe turpi është pjesë e besimit." Shih: Muslimi, *Sahihu Muslim*, vep. e cit., Kitab: el-iman, Kapitulli: bejanu adedi shu'bi 'l-Imani, hadithi numër: 35, fq. 48

<sup>524</sup> El-Hafidh Ebu Bekr Ahmed bin El-Husejn bin Ali El-Bejheki (vd. 458 h.). *El-xhamiu li shu'bi 'l-Imani*, i përgatitur për botim nga Abdulalaj Abdulhamid Hamid, Riad: Mektebet'ur-Rushd, 2003. Shih vëllimin "El-Feharis", vëllimi XIV, fq. 710-728

këtyre shkrimeve kanë marrë pjesë fukaha, muhadithë dhe filozofë, mirëpo më shumë për shpirtin kanë shkruar dijetarët dhe studiuesit e sufizmit, kuptohe shpeshherë me dallime të mëdha në pikëpamjet e tyre sufiste.<sup>525</sup>

Nuk ka dyshim se shkencat që ulematë e Islamit i prezantonin nëpër hallkat dhe mexhliet e tyre arsimore e edukative nuk ishin synim në vetvete, por qëllimi ishte që pas mësimit të pasojë puna dhe angazhimi. Me fjalën punë këtu shënjohej puna dhe sjelljet e njeriut, qofshin ato të dukshme apo të brendshme, me zemër, me mendje dhe apo me gjymtyrë.

Në mesin e këtyre përpjekjeve edukative, u organizuan edhe hallka dhe kënde të sufizmit në të kaluarën dhe në kohët moderne, të cilat merreshin me edukimin shpirtëror dhe psikik. Këtij tipi të edukimit i kushtohej vëmendje më shumë se llojeve të tjera. Prej këtyre përpjekjeve u zhvillua një model (edukativ) në mendimin pedagogjik islam, i cili në të kaluarën dhe sot ka gëzuar një shtrirje të gjerë në shkollat e ndryshme të sufizmit: sufizmi i izolimit i cili e shmang bashkëpunimin me jetën publike dhe me problemet shoqërore, duke aspiruar shpëtimin individual, dhe sufizmi filozofik i cili fokusohet në disa botëkuptime që s'kanë lidhje me veprat dhe praktikat fetare. Të mos harrojmë atë më të rëndësishmin, sufizmi sunit i cili u përmbahet të gjitha dispozitave të sheriatit, i përmbahet parimit të ekuilibrit dhe

<sup>525</sup> Vështrë se mund të përblidhen librat e trashëgimisë të cilat trajtojnë temën e shpirtit të njeriut, prandaj ne do t'i sjellim vetëm disa sa për shembull, dhe atë duke i përzier nga shkolla të ndryshme ideologjike:

- Ebu Abdullah El-Harith bin Esed El-Muhasibij (vd. 243 h.), *Adab'un-nufusi*, i përgatitur për botim nga Abdulkadir Ahmed Ata, Bejrut, Muesseset'ul-Kutub'ith-Thekafijeh, botimi II, 1991.

- Ebu Alij El-Husejn bin Abdullah Ibn Sina (vd. 427 h.), *Risaletun fi ma'rifet'in-nefs'in-natikati ve ahvaliha, El-Memleket'ul-Muttehidedu*, Muessesetu Hendavi, 2017.

- Ebu Hamid Muhamed bin Muhamed El-Gazali (vd. 505 h.), *Mearixh'ul-kudsi fi medarixhi ma'rifet'in-nefsi*, Bejrut: Dar'ul-Afak'il-Xhedideh, botimi II, fq. 1975.

- Muhamed bin Baxheh El-Endelusi Ibn Baxheh, (vd. 533 h.), *Kitab'un-nefsi*, Damask: El-Mexhmeu 'l-Ilmijj'ul-Arabijju në Damask, 1960.

- Ebu 'l-Velid Muhamed bin Ahmed Ibn Rushd (vd. 595 h.), *Telhisu kitab'in-nefsi*, me redaktim të Alfred L. Abery, i lexuar për botim nga Muhsin Mehdij, i botuar nga Ibrahim Madkur, Kajro: El-Mexhliis'ul-A'la li 'th-Thekafeh, 1994. Libri është përmbledhje dhe sqarim i një libri të Aristotelit.

- Tekijjuddin Ahmed bin Abdulhalim Ibn Tejmije (vd. 728 h.), *Tezkijet'un-nefsi*, redaktim i Muhamed bin Seid Hahtani, Riad: Dar'ul-Muslim, botimi I, (1415 h./1994).

- Ibn Kjjim El-Xhevzije, *Kitab'ur-ruh*, vep. e cit., (libri është një vëllim).

të integritimit duke bartur njeriu të gjitha përgjegjësitë e veta individuale dhe shoqërore, kurse ngritjen dhe pastërtinë shpirtërore e pranon si mekanizëm për durimin dhe sfidën e ngarkesave të thirrjen në rrugë të Zotit, të urdhërimit në të mirë dhe të ndalimit nga e keqja.

Nga modelet e këtij tesavufi që u përmbahet dispozitave të sheriatit del edukimi shpirtëror i cili u drejtohet punëtorëve në arenën e reformimit islam bashkëkohor dhe anëtarëve të lëvizjeve islame. Përkujdesja për njerëzit, preokupimi me punët publike në sferat e mendimit dhe të politikës, dhe bashkëpunimi me ta për problemet shoqërore dhe gjërat përreth, ndoshta i ka bërë të jenë të shkujdesur ndaj vetvetes, të ndjehen të plogësht dhe zemërgurë, dhe të kenë moral të dobët. Kështu, ndoshta shejtani ua zbukuron disa njerëzve pakujdesinë ndaj disa detyrimeve sheriatike. Seid Havva u ka tërhequr vërejtjen anëtarëve të lëvizjeve islame që të mos arrijnë në këtë gjendje, prandaj ka potencuar se në thirrjen islame bashkëkohore patjetër të integrohen veçoritë e thirrjes së të parëve (selefiteve), të rrugës sunite dhe të të vërtetës sufite. Pastaj (Seidi) u ndal te realiteti sufist dhe te themelimi i ilm'us-sulum (disiplina e sjelljeve) dhe i tesavufit. Ai mendon se kjo disiplinë u themelua natyrshëm dhe shpreh kuptimin që dijetarët islamë e marrin nga tekstet burimore, gjegjësisht nga Kur'anë dhe tradita pejgamberike. Këta dijetarë, në Kur'an dhe në sunet hasën shumë thënie për zemrën, për besimin, për përjetimin, për sëmundjet e zemrës, për shërimin e këtyre sëmundjeve... po ashtu, hasën thënie për shurdhësinë dhe verbërinë e zemrës, për shëndetin dhe sëmundjen e shpirtit, për devotshmërinë dhe për mëkatimin e zemrës, për shpirtin njerëzor, për pastrimin e saj nga mëkatet dhe për kuptime të tjera të përafërta. Pra, ishte e zakonshme që ulematë e muslimanëve këto dhe kuptimet tjera që ndërliidhen me këtë problematikë t'i shënojnë në një regjistër të veçantë, dhe kështu të zhvillohet një disiplinë e veçantë me këtë tematikë. Kjo disiplinë ishte tesavufi apo ilmu-suluki."<sup>526</sup> Për këtë, Seid Havva mendon se është e

<sup>526</sup> Sied Hawva, *Terbijjetuna er-ruhijeh*, Kajro: Dar'us-salam, botimi VI, fq. 1999, fq. 17.

natyrshtme që krijohet nevoja për edukimin shpirtëror, i cili duhet të mësohet nga anëtarët e lëvizjeve islame bashkëkohore, ku vetë e ofroi eksperiencën personale në këtë sferë.

Këtu shkrimtari pohon edhe një herë tjetër se ai ofron një lloj të edukimit shpirtëror apo mistik që i përmbahet Kur'anit dhe sunetit, madje i përftuar prej tyre me qëllim të "çlirimit të tesavufit nga teprimet që të jetë i përshtatshëm për muslimanin që mos bjerë në injorancë. Krejt këtë me qëllim të arritjes në edukimin e lartë shpirtëror, real dhe të jetë në rrugën e drejtë, në rrugën e bazave dhe të degëve të sheriatit. Të mos jetë peng i detyrimeve tjera (jashtë sheriatit)."<sup>527</sup> Autori ka ofruar një sërë shkaqesh të këtij lloji të tesavufit, të cilën ai e quan *mësymje për te Zoti*, e në fund tha: "Mësymja për te Zoti i Lartësuar është detyrim me nivele të ndryshme i cili ndryshon në varësi të përgatitjeve. Lëvizja në këtë drejtim është domosdoshmëri, por në varësi të bindjes dhe të vullnetit janë edhe gradët atyre që trasojnë këtë rrugë."<sup>528</sup>

Sado që ne dimë për elementët e njeriut: trupin, shpirtin dhe zemrën, përsëri ne e dimë se njeriu është një qenie e vetme. Çdo punë që e vepron njeriu, kalon në një hierarki hapash ku merr pjesë mendja, zemra dhe trupi. Çdo punë fillon si ide që pastaj kalon në vendin e rezonimit nga jashtë, apo e zhvillon arsyeja nga përvojat e depozituara më parë. E në fund e konstaton se ideja është e saktë dhe se është e dobishme të thuhet. Në këtë mënyrë qetësohet zemra për saktësinë e orientimit. Zemra është vendi i qetësisë. ﴿الَّذِينَ آمَنُوا وَتَطْمَئِنُّ قُلُوبُهُمْ بِذِكْرِ اللَّهِ أَلَا بِذِكْرِ اللَّهِ تَطْمَئِنُّ الْقُلُوبُ﴾

**"Ata të cilët besuan dhe zemrat e tyre qetësohen me përmendjen e Allahut. A nuk qetësohen zemrat me përmendjen e Allahut?!"** [Er-Rra'd: 28] Me këtë rast trupi i njeriut nxitet për veprim dhe sjellje. Trupi i njeriut përbëhet nga një sërë gjymtyrës, si: syri, veshi, gjuha, dora, këmba etj. Vetëm atëherë, pra kur zemra e përjeton diçka, syri reagon, veshi dëgjon, gjuha flet, dora lëviz dhe këmba shpejton. Sa i përket përgjegjësisë për

<sup>527</sup> Po aty, fq. 12-13.

<sup>528</sup> Po aty, fq. 19-20.

veprim, ajo është e përbashkët mes secilit nga elementët, sigurisht duke ndjek secili veprimin e vet të duhur. Allahu xh.sh. thotë: ﴿وَلَا تَقْفُ مَا لَيْسَ لَكَ بِهِ عِلْمٌ إِنَّ السَّمْعَ وَالْبَصَرَ وَالْفُؤَادَ كُلُّ أُولَئِكَ كَانَ عَنْهُ مَسْئُولًا﴾ **“Dhe paso atë për të cilën nuk ke dije, sepse dëgjimi, shikimi dhe zemra, të gjitha, do të jetë përgjegjës për atë”** [El-Isra: 36] Njeriu, kur vepron një punë të keqe të caktuar, në fillim ta përpunojë në mendje, përjetojë në shpirt, t’ia do zemra dhe në fund përfundon me lëvizjet e gjymtyrëve të trupit.<sup>529</sup> Njësoj është edhe kur vepron një të mirë.

Shpirti i njeriut është vetë njeriu i unifikuar me këtë tërësi elementesh, por Kur’ani, kur i drejtohet shpirtit me detyrim dhe përgjegjësi, e dallon atë të dukshmin dhe të fshehtin. Pjesa e dukshme e njeriut është pjesa shqisore, ku çdokush mund të shohë veprimin e gjymtyrëve të trupit, kurse pjesën e fshehur njeriu mund ta mbajë vetëm për vete. ﴿وَإِنْ تُبْدُوا مَا فِي أَنْفُسِكُمْ أَوْ تُخْفُوهُ يُحَاسِبِكُمْ بِهِ اللَّهُ﴾ **“Dhe nëse e shfaqni atë që keni në shpirtat tuaj, apo e fshihni, për të do t’ju marrë në llogari Allahu.”** [El-Bekare: 284]. Allahu e di edhe atë që njerëzit e fshehin në kraharorët e tyre, ﴿قُلْ إِنْ تُخْفُوا مَا فِي صُدُورِكُمْ أَوْ تُبْدُوهُ يَعْلَمُهُ اللَّهُ﴾ **“Thuaj: nëse e fshihni atë që keni në kraharorët tuaj, apo e shfaqni, Allahu e di.”** [Alu Imran: 29] Kraharori është vendi i zemrës, Allahu xh.sh. thotë: “Vërtet nuk verbohën sytë, por verbohën zemrat që janë në kraharorë” [El-Haxh: 46] Nuk presim që shprehja “brendi e njeriut” të synojë këto gjymtyrë fizike të padukshme të trupit, si p.sh. mushkëritë, lukthi, zorrët, madje as pompa e gjakut që gjendet në pjesën e majtë të kraharorit e cila quhet zemër, por brendi është për qëllim atë që fsheh zemra, gjegjësisht operacionet (shpirtërore) që i kryen zemra, të cilat janë veprime kuptimore, si përcaktimi i nijetit dhe vendosmëria, vullneti, mendimi, reagimi shpirtëror me ndjenja dashurie apo urrejtjeje, bashkë me

<sup>529</sup> Shih:

- El-Buhari, *Sahih'ul-Buhari*, vep. e cit., Kibat: el-isti'dhan, bab: zena el-xhevarihi dune 'l-ferxhi, hadithi numër: 6243, fq. 1202. Hadithin e ka transmetuar Ebu Hurejre r.a. se i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “Allahu e ka caktuar për birin e Ademit fatin e tij (formën) e zinasë. E kupton se mundet ndryshe. Imoraliteti i syrit është shikimi, imoraliteti është gjuha, epshi aspiron dhe ndjen kënaqësi, kurse organi (gjenital) e vërteton krejt këtë ose e përgënjeshtron.” Shih: Muslim, *Sahihu Muslim*, vep. e cit., Kibat: el-kader, Bab: Kul-lu shej'in bikader, hadithi numër: 2657, fq. 1065.

përpunimin, kuptimin dhe meditimn e ideve, përmallimet e shpirtit dhe lidhjet e tij me Krijuesin dhe me shpirtrat tjerë.<sup>530</sup>

Ajetet kur'anore të cilat flasin për punët e zemrës janë shumë, në mesin e tyre janë ajetet që flasin për fitimin dhe llogarinë e zemrës. Allahu xh.sh. thotë: ﴿وَلَكِنْ يُوَاجِدُكُمْ بِمَا كَسَبْتُمْ﴾  
 ﴿“Por ju merr (në përgjegjësi) për atë që fituan zemrat tuaja.” [El-Bekare: 225] Më e rëndësishmja është përcaktimi i vullnetit të njeriut i cili bazohet në zemër, Allahu xh.sh. thotë: ﴿وَلَيْسَ عَلَيْكُمْ جُنَاحٌ فِيمَا أَخْطَأْتُمْ بِهِ وَلَكِنْ مَا تَعَمَّدَتْ قُلُوبُكُمْ﴾  
 “Nuk ju llogaritet gjynah juve për atë që keni gabuar (pa hiri), por gjynah është ajo (e keqe) që kanë pasur synim zemrat.” [El-Ahzab: 5]. Zemrat mund të pendohen, të kthehen apo të kenë frikë (Zotin), Allahu xh.sh. thotë: ﴿مَنْ حَٰثِيَ الرَّحْمٰنَ بِالْغَيْبِ وَجَآءَ بِقَلْبٍ مُنِيبٍ﴾  
 “Kush e ka frikë të Gjithëmëshirshmin në fshehtësi dhe vjen me zemër të penduar.” [Kaf: 33] Zemrat edhe mund të zbuten, ﴿اللَّهُ نَزَّلَ أَحْسَنَ الْحَدِيثِ كِتَابًا مُّتَشَابِهًا مَّثَانِيَ تَقْشَعِرُّ مِنْهُ جُلُودَ الَّذِينَ يَخْشَوْنَ رَبَّهُمْ ثُمَّ﴾  
 ﴿تَلِينَ جُلُودَهُمْ وَقُلُوبُهُمْ إِلَىٰ ذِكْرِ اللَّهِ﴾  
 “Allahu e ka zbritur fjalën më të mirë, një libër të ngjashëm e të përsëritshëm, me të cilin rrëqethen lëkurat e atyre që i frikësohen Zotit të tyre, pastaj lëkurat dhe zemrat e tyre zbuten me përmendjen e Allahut.” [Ez-Zumer: 23] Në zemrat e disa njerëzve Allahu ka frymëzuar butësi dhe mëshirë, prandaj thotë: ﴿وَجَعَلْنَا فِي قُلُوبِ﴾  
 ﴿“E në zemrat e tyre që e ndoqën atë bëmë butësi dhe mëshirë” [El-Hadid: 27] Njeriu mund të jetë edhe me zemër të ashpër ﴿وَلَوْ كُنْتَ فَحْلًا غَلِيظَ الْقَلْبِ لَانْفَضُّوا مِنْ حَوْلِكَ﴾  
 “E nëse do të ishe zemërashpër, do të largoheshin ata përreth.” [Alu Imran: 159]. Ka edhe njerëz zemërgurë, ﴿قَوْلِكَ لِلْقَاسِيَةِ قُلُوبُهُمْ مِنْ ذِكْرِ﴾  
 ﴿“Mjerë për zemërgurët ndaj përmendjes së Allahut” [Ez-Zumer: 22] Ata të cilët nuk besojnë ahiretin, zemrat e tyre neveriten nga përmendja e Allahut, ﴿وَإِذَا ذُكِرَ اللَّهُ وَحْدَهُ اشْمَأَزَّتْ قُلُوبُ الَّذِينَ﴾  
 ﴿“Dhe kur përmendet vetë Allahu, zemrat e atyre që nuk besuan në Ahiret neveriten.” [Ez-Zumer: 45]

<sup>530</sup> Hadithi i saktë i transmetuar nga Nëna e Besimtarëve, Ajshja r.a., e cila ka thënë: “E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut a.s. të thotë: “Shpirtrat janë ushtri të mobilizuara: çfarë pëlqehen prej tyre bashkohen, çfarë urrehen ndahen.” Shih: El-Buhari, *Sahih’ul-Buhari*, vep. e cit., Kitab: Ehadith’ul-enbijai, Bab: El-Ervahu xhunudun muxhennedetun, hadithi numër: 3336, fq. 636.

Ka shumë ajete që flasin për klasifikimet e njerëzve, të cilat i cilësojnë ata me sëmundje të zemrave. Allahu xh.sh. thotë: ﴿أَمْ حَسِبَ الَّذِينَ فِي قُلُوبِهِمْ مَرَضٌ أَنْ لَنْ يُخْرِجَ اللَّهُ أَضْعَافَهُمْ﴾ **“A mendojnë ata që kanë sëmundje në zemër se Allahu nuk do t’i nxjerrë mllefet e tyre.”** [Muhammed: 29]. Po ashtu: ﴿قَتَرَى الَّذِينَ فِي قُلُوبِهِمْ مَرَضٌ يُسَارِعُونَ فِيهِمْ يَقُولُونَ نَخْشَى أَنْ تُصِيبَنَا دَائِرَةٌ فَعَسَى اللَّهُ أَنْ يَأْتِيَ بِالْفَتْحِ أَوْ أَمْرٍ مِنْ عِنْدِهِ فَيُضْبِحُوا عَلَى مَا أَسْرَوْا فِي أَنْفُسِهِمْ نَادِمِينَ﴾ **“E ata që në zemrat e tyre kanë sëmundje, i sheh se ngarendin te ta (për miqësi) duke thënë: “Po frikësohemi se mos po na sillet ndonjë e keqe”. Po Allahu do të sjellë fitoren, ose diç tjetër nga ana e Tij, e atëherë do të pendohen për atë që e mbanin fshehtë në shpirtin e tyre.”** [El-Maide: 52] Njerëzit me zemra të sëmura janë dyfytyrëshit të cilët e shfaqin besimin dhe e fshehin mosbesimin. Allahu xh.sh. thotë: “Ka nga njerëzit që thonë: ﴿أَمَّا بِاللَّهِ وَبِالْيَوْمِ الْآخِرِ وَمَا هُمْ بِمُؤْمِنِينَ﴾ **“besuam në Allahun dhe në Botën Tjetër”, por në realitet ata nuk janë besimtarë.”** [El-Bekare: 8] Allahu xh.sh. thotë: ﴿ذَلِكَ بِأَنَّهُمْ آمَنُوا ثُمَّ كَفَرُوا فَطُبِعَ عَلَى قُلُوبِهِمْ فَهُمْ لَا يَفْقَهُونَ﴾ **“Kjo sepse ata besuan e pastaj mohuan. Kështu u vulosën zemrat dhe ata nuk kuptojnë.”** [El-Munafikun: 3]

“Edukatë-pedagogji shpirtërore” është term i përdorur në literaturën pedagogjike moderne dhe bashkëkohore, sidomos në literaturën që u drejtohet atyre që veprojnë në institucionet arsimore me sfond fetar, si p.sh. hartuesit e politikave të përgjithshme në këto institucione, mësuesit dhe nxënësit. Një retrospektivë për rregullat e të dhënave hulumtuese zbulon shumë libra metodologjikë dhe referencialë, hulumtime shkencore periodike dhe disertacione universitare, të cilat e trajtojnë edukatën shpirtërore nga sfonde të ndryshme fetare: islame, krishtere dhe budiste, nga këndi i filozofisë natyraliste, shekullare dhe të tjera. Disa studime të kësaj fushe bien në sferën e psikologjisë dhe të marrëdhënies së studimeve psikike me doktrinat fetare dhe ideologjike.<sup>531</sup>

<sup>531</sup> Është i rëndësishëm shqyrtimi i disa studimeve moderne që trajtojnë raportin e shëndetit psikik-shpirtëror me fenë dhe fetarinë, si p.sh. ajo që thuhet në librin “Ed-Dinu ve ‘s-sihhat’un-nefsijeh” (Feja dhe shëndeti psikik). Shih: Azad Ali Ismail, *Ed-Dinu ve ‘s-sihhat’un-nefsijeh*, Hernden: El-Ma’hed’ul-Alemijju li’l-Fikr’il-Islamijj, 2014.

Shumica e këtyre studimeve nisen nga vetëdija për natyrën e ndryshimeve të thella që ndodhin në sektorët publikë të arsimit dhe në arsimin universitar në dekadat e fundit. Ato janë ndryshime që e transformuan shoqërinë njerëzore në shoqëri teknologjike dhe digjitale, kurse arsimin e ka orientuar kah kërkesat e tregut të punës i cili ndryshon në formë marramendëse. Kjo ka sjellë që njeriu të humb mundësinë e zhvillimit të disa aspekteve të personalitetit të tij, si atë emocional, social dhe shpirtëror. Si kundër reagim i kësaj u zhvilluan iniciativa të rëndësishme në sferën e edukimit shpirtëror në arsimin shkollor, në arsimin universitar dhe nëpër institucionet profesionale të edukimit fetar, dhe atë përmes asaj që sot quhet arsim gjithëpërfshirës (Wholistic Education), i cili synon t'i ofrojë edukimin e duhur çdo elementi të përbërjes së njeriut (trupit, arsyes dhe shpirtit), apo përmes arsimit universal (Holistic Education) i cili vështron ndërthurjen e aspekteve të personalitetit të njeriut. Njeriu nuk kuptohet ndryshe përveçse nga tërësia e tij, i cili në realitet është më shumë se tërësia e komponentëve përbërës.

Termi “edukim shpirtëror” shfaqet në disa shoqëri islame dhe në legjislacionet edukative të cilat e cilësojnë atë si objektivë të arsimit. Neni katër i Ligjit të Edukimit dhe të Arsimit në Jordani, i cili është në fuqi ende, i definon objektivat e edukimit dhe arsimit kështu: “Formimi i rasteve (vendeve) ku fitohen virtytet dhe vlerat humane, i cili zhvillohet në aspekte të ndryshme të personalitetit të tij: në aspektin trupor, logjik, shpirtëror, emocional dhe shoqëror.”<sup>532</sup> Ndër objektivat e edukimit në Sulltanatin e Omanit është “Ndihma e nxënësve për zhvillim dhe integrim: shpirtëror, psikik, intelektual, etik, fizik dhe social.”<sup>533</sup> Në Algjeri, Këshilli i Lartë i Edukimit lëshoi një dokument për parimet e menaxhimit të edukimit, ku thuhet:

<sup>532</sup> Faqja zyrtare e Ministrisë së Edukimit dhe Arsimit në Jordani. Shih: <http://www.moe.gov.jo/ar/node/15782>.

<sup>533</sup> Ministria e Edukimit dhe Arsimit në Sulltanatin e Omanit. *Felsefet'ut-ta'limi fi sultanati Uman*, Meskat, Mexhli's'ut-Ta'limi fi Sultanati Uman, botimi I, 2017, fq. 20, me titullin: “En-Numuv'ul-mutekamilu li 'l-muteal-limi”.



“Sistemi edukativ algjerian kërkon të përmbushë qëllimet vijuese: i pari: ndërtimi i një shoqërie të konsoliduar, të përmbajtur, krenare me origjinën dhe e vendosur për të ardhmen e vet. Kjo shoqëri ndërtohet mbi: identitetin kombëtar të mishëruar në Islam: me besim, me sjellje dhe me kulturë, e cila duhet ta shprehë përmbajtjen e vet shpirtërore dhe etike, dhe të japë kontribut kulturor dhe human. Gjithashtu, duhet të forcojë rolin e vet si faktor unifikues i shoqërisë algjeriane...”.<sup>534</sup> Në Mbretërinë e Arabisë Saudite ka një tekst të drejtpërdrejtë për edukimin shpirtëror, i cili është formuar në trajtën e objektivit edukativ: “Sigurimi i veçorive të fazave zhvillimore psikike të çdo njeri, për çdo fazë. Ndiheja e individit për zhvillim të barabartë: shpirtëror, logjik, emocional dhe shoqëror. Konfirmimi i saj mbi me aspektin shpirtëror islam, ku ky aspekt të jetë orientuesi i parë i sjelljeve individuale dhe publike të individit dhe të shoqërisë.”<sup>535</sup>

Duket se edukimi shpirtëror ka filluar ta kthejë rëndësinë e vet në shumicës e shoqërive të botës. Faqja elektronike *arabic.rt.com* ka publikuar një raport për çështjet e edukimit shpirtëror dhe moral në shoqërinë bashkëkohore ruse, siç u diskutua në një tryezë të rrumbullakët të mbajtur në Këshillin Social-Rus me titull “Problematikat e zhvillimit shpirtëror, moral dhe kulturor të Rusisë”. Raporti e paraqet fjalimin e presidentit rus Putin në të cilin pohon “se i rëndësishëm është roli i familjes, i institucioneve arsimore dhe i organizatave shoqërore në edukimin e gjeneratave në zhvillim, dhe atë në aspektin shpirtëror dhe atdhetar. Duhet të krijohet një ambient ku do të sundojë toleranca dhe bashkëjetesa e ndërsjellë mes shoqërive të ndryshme etnike.”<sup>536</sup>

Literatura profesionale e edukimit shpirtëror në gjuhën arabe është shumë e madhe. Po ashtu, edhe në gjuhën arabe

<sup>534</sup> Këshilli i Lartë i Edukimit, El-Mebadi’ul-Ammetu li ‘s-sijasijjat’it-terbevijjeti ve islah’it-ta’lim’il-esasijj, Algjeri, 1998, fq. 33-34.

<sup>535</sup> Komisioni i Lartë i Politikës Arsimore – El-Emanet’ul-Ammetu. *Vethikatu sijaset’it-ta’limi fi ‘l-memleketi*, Riad: Ministria e Edukimit dhe e Arsimit në Mbretërinë e Arabisë Saudite, 1416 h. Neni numër 53, fq. 7

<sup>536</sup> <https://arabic.rt.com/news/629921> (08.10.2013)

kjo literaturë është e shpërndarë nëpër libra metodologjikë dhe referencialë, në studime periodike dhe në disertacione universitare. Meqenëse literatura e kësaj fushe në gjuhët e huaja p'ashtu është shumë e madhe, do t'i përmendim vetëm një numër të këtyre shkrimeve në gjuhën angleze.

Sa i përket edukimit shpirtëror islam, në vitin 2018 u publikua libri i studiueses muslimane amerikane me titull "Arsimimi i fëmijëve: hyrje etike, shpirtërore dhe universale e zhvillimit edukativ", ku ka folur për eksperiencën e saj në shkollat islame në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.<sup>537</sup>

Sa i takon sferës së edukimit shpirtëror të krishterë, në vitin 2018 u publikua një libër për sfidat bashkëkohore me të cilat ballafaqohet edukimi fetar dhe shpirtëror në eksperiencën e krishterë evropiane. Studimet e Librit pohojnë se zhvillimet shoqërore në nivelin lokal dhe global i orientojnë politikanët dhe vendimmarrësit që fenë dhe edukimin shpirtëror ta shohin si tematikë të rëndësishme në jetën e përgjithshme, veçanërisht kur dihet se studimet e trurit dhe të mësimit të njeriut hapin një sferë të re para fesë të që luajë një rol më të fuqishëm në metodat studimore moderne.<sup>538</sup> Ndërsa librat dhe studimet e veçanta për edukimin shpirtëror në shkollat dhe universitetet profesionale në fushën e studimeve fetare janë të shumta.

Në fushën e edukimit shpirtëror budist ekziston një institut për studime edukative në Universitetin e Kinës në Hong Kong, i cili ka përpiluar një program studimor model në edukimin shpirtëror, i cili ka zgjatur tre vite (2017-2020), dhe bart titullin: "Mëso për të qenë inspirues dhe i inspiruar!". Programi synon të zhvillojë vlerat budiste përgjatë arsimit shkollor në një numër të madh të shkollave pjesëmarrëse në këtë program.<sup>539</sup> Ky institut ka botuar një libër që flet hollësisht për teknikat dhe trajnimet e zhvillimit

<sup>537</sup> Ann El-Moslimany, *Teaching Children: A Moral, Spiritual, and Holistic Approach to Educational Development*, Herndon, VA: International Institute of Islamic Thought (1 Janar 2018).

<sup>538</sup> Arniika Kuusisto & Terry Lovat (Editorë), *Contemporary Challenges for Religious and Spiritual Education*, London and New York: Routledge, 2018.

<sup>539</sup> Joyce Miller, *Education and Learning: A Buddhist Perspective*, *Journal of the National Association of Teachers of Religious Education*, 29: 3, Summer 2007. Shih gjithashtu: <http://dhchenfoundation.com/initiatives/inspired-research-project-on-spiritual-educationhkier-cuhk/>.

të edukimit shpirtëror te fëmijët e familjeve budiste në shkollat australiane. Pavarësisht vetëdijes së autores se budizmi është fe, ajo ka propozuar gjerësisht në libër me trajnime dhe ushtrime për edukimin shpirtëror të fesë.<sup>540</sup> Feja budiste nuk ka mbetur e izoluar në shtetet aziatike, por përqaftuesit e saj kanë filluar të shfaqen edhe në kontinentet tjera. Krahas universiteteve budiste në Indi, Srilankë, Kinë, Japoni dhe Malajzi, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka pasur katër universitete deri në vitin 2015, të cilat janë universitete që ofrojnë diploma shkencore në profesione të ndryshme dhe, në të njëjtën kohë, i pajisin studentët edhe me arsim dhe edukatë shpirtërore të ndërtuara mbi parimin e filozofik dhe mbi parimin e praktikës budiste.<sup>541</sup>

Nga format e edukimit shpirtëror është edukimi që ngrihet mbi parimin filozofisë natyraliste, pa pasur referencë fetare. Po ashtu, janë edhe praktikat edukative të cilat lidhen me filozofinë natyraliste të Tagorës. Kjo filozofi edukative e fundit ngrihet mbi bazën e lirisë, të kreativitetit personal dhe të komunikimit aktiv me natyrën dhe me njeriun. Kjo synon të zhvillojë aftësitë e individit përmes besimit në nënën natyrë, në vëllazërinë njerëzore, në liri, në bashkëpunim, në dashuri dhe në mëshirë. Mësuesit, nëse do të mund të formonin sjellje të individëve në laboratorin e natyrës, atëherë ky do të quhej edukim shpirtëror.<sup>542</sup>

Meqenëse shumica e asaj që u theksua për edukimin shpirtëror lidhen zakonisht me doktrinën fetare, atëherë ekziston një model tjetër i edukimit shpirtëror në praktikën e botës sonë bashkëkohore, i cili realisht nuk mbështetet në konceptin fetar tradicional, por në parimin e shekullarizimit. Prej tyre e veçojmë atë që e ofron Instituti 3Q, i cili e prezanton vetveten se në fillim të edukimit shekullar dhe të trajnimit të inteligjencës shpirtërore, e kanë arritur përmes

<sup>540</sup> Sue Erica Smith, *Buddhist Voices in School, How a Community Created a Buddhist Education Program for State Schools*, Rotterdam: SensePublishers, 2013.

<sup>541</sup> Tanya Storch, *Buddhist-Based Universities in the United States: Searching for a New Model in Higher Education*, Lanham MD: Lexington Books, 2015.

<sup>542</sup> Prem Shankar Srivastava, *Spiritual Education in Tagore Philosophy*, *Scholarly Research Journal for Humanity Science and English Language*, An International Peer reviewed and Referred, VolIII, Issue VII, Dec-Jan, 2015, fq 1021-1030.

njësimit të trupit, të arsyes dhe të shpirtit. Gjithashtu, pohon se të gjithë njerëzit posedojnë një dimension natyror (fitri) të inteligjencës dhe se ai mund ta zhvillojë atë përmes eksperiencës personale, jo përmes doktrinës fetare. Modeli i tij i inteligjencës mbështetet në faktin se studimi shkencor-eksperimental i arsyes njerëzore zbulon tre lloje të inteligjencës: inteligjenca intelektuale, e cila funksionon në gjysmën e majtë të trurit; inteligjenca emocionale, e cila funksionon në gjysmën e djathtë të trurit, dhe inteligjenca shpirtërore, e cila bën një trajtim kompakt të gjithë trurit. Inteligjenca shpirtërore përfaqëson “spiritualitetin shekullar”. Instituti në fjalë ofron kurse trajnuese në faqet e internetit, ku edhe bëhet integrimi mes këtyre tre llojeve të inteligjencës. Përgjegjësit e Institutit mendojnë se ky trajnim i çliron plotësisht mundësitë e njeriut, i shton shanset e përmbushjes së aspekteve të personalitetit dhe rezultat i krejt kësaj është angazhimi në ngritje.<sup>543</sup>

Në fund, dimension i shpirtëror nuk është i rëndësishëm vetëm për formimin e personalitetit të individit në sferën pedagogjike, por është një dimension i rëndësishëm edhe në sferën e jetës ekonomike dhe politike, madje është filluar të shihet edhe si “kapital”. Në këtë fushë, në vitin 2016 është publikuar një libër me këtë titull “Kapitali shpirtëror: e përshpirtshmja në praktikën (e fituar) nga pikëpamja krishtere”. Libri përbëhet nga studime akademike që kontribuojnë në nderimin e teorisë së kapitalizmit shpirtëror. Libri synon të përforcojë idenë boshtore të ekonomisë etike e cila ka filluar të shfaqet diskutimet ekonomike bashkëkohore. Sqaron nevojën e mendimit revolucionar në politikat dhe praktikatat ekonomike, për të ndërtuar një bazament etik për t’i sfiduar krizat që përjeton sot bota në sferën ekonomike dhe financiare.<sup>544</sup> Vlen të theksohet se termi “kapitalizëm shpirtëror” ka nisur të bëhet temë e studimeve të llojllojshme

<sup>543</sup> <https://sqi.co/about-3q-institute/>.

<sup>544</sup> Samuel D. Rima, *Spiritual Capital: Spirituality in Practice in Christian Perspective* (Transformation and Innovation), New York: Routledge; 2016.

të pikëpamjeve të ndryshme fetare: islame, krishtere, induse, behaiste dhe të tjera.<sup>545</sup>

### 3. Integrimi dhe ekuilibri në ndjekje dhe në kreativitet

U bë e qartë se integrimi në mendimin pedagogjik islam është veçori e cila i trajton aspektet e ndryshme të cilat e përbëjnë personalitetin e njeriut, dhe atë me masë të përshtatshme me tematikat e pedagogjisë, me metoda dhe me të përshtatshme për çdo element dhe për çdo tematikë. Krejt kjo bëhet mbi bazën se këto elementë dhe tematika lidhen dhe ndikojnë njëra-tjetra. Në këtë mënyrë asnjëra nuk ta përjashtojë tjetrën në përkufizimin e personalitetit dhe të identitetit njerëzor. Personaliteti i njeriut është një tërësi e kompletuar dhe jo e lehtë për t'u shpërbërë në elementë, përveçse për qëllim studimi. Na u bë e qartë se integrimi në trajtimin pedagogjik nuk nënkupton domosdoshmëri barazi në sasi apo ngjashmëri në lloj, por nënkupton siguri të mendimit dhe të praktikës pedagogjike të cilat i shërbejnë objektivit dhe i plotësojnë nevojat.

Ekuilibrimi në mendimin pedagogjik islam ka të bëjë me masat dhe dimensionet relative të komponentëve të çdo vetie që dua t'ia japim këtij mendimi, në mënyrë që të mos teprojë apo të mos jetë pak, e kështu të çrregullohet. Pra, kështu sigurohen veti të cilat i përmbahen mesatares dhe janë të ekuilibruara. Këto na sqarojnë se ekuilibri lejon funksionalizimin e vetisë me të cilën dallohet një individ nga tjetri, dhe se veçoria e mbajtjes së ekuilibrit është një veti origjinale e çdo krijese të Zotit të Lartësuar. Kjo veti ndërtohet në karakterin dhe në natyrshmërinë njerëzore.

Tani duam të trajtojmë temën e lidhshmërisë, integrimit dhe ekuilibrit mes pasimit dhe kreativitetit. Pasimi apo ndjekja është fjalë tipike kur'anore e cila i drejtohet njeriut qysh në krijim, gjegjësisht qysh atëherë kur Allahu i

<sup>545</sup> Për ata që duan më shumë të thellohen në këtë tematikë (capital spiritual), le të hulumtojnë në disertacionet universitare, hulumtimet shkencore periodike dhe në librat e llojllojshëm referencialë.

Lartësuar i kërkon njeriut të zbresë dhe të banojë në Tokë, por me premtimin se do të delegojë (pejgamberë) të cilët do ta udhëzojnë kah edukimi, i cili do të jetë i domosdoshëm për banorët e Tokës. Allahu xh.sh. thotë: ﴿قَالَ اهْبِطَا مِنْهَا جَمِيعًا بَعْضُكُمْ لِبَعْضٍ عَدُوٌّ فَإِمَّا يَأْتِيَنَّكُمْ مِنِّي هُدًى فَمَنِ اتَّبَعَ هُدَايَ فَلَا يَضِلُّ وَلَا يَشْقَى﴾

**“Ai tha: zbritni prej saj të gjithë! Disa për disa prej jush janë armiq. Gjithsesi do t’ju vijë nga unë udhëzim. E kush e ndjek udhëzimin tim nuk do të devijohet dhe as dëshpërohet.”** [Taha: 123]

Kurse njeriut i mbetet vetëm ndjekja apo pasimi i udhëzimit për t’u larguar nga lajthitja në dynja dhe dëshpërimi në Ahiret. Thirrja e njeriut për të ndjekur të dërguarit e Zotit është bërë disa herë në librat e Tij, si p.sh. në Kur’an thuhet: ﴿اتَّبِعُوا مَا أُنزِلَ إِلَيْكُمْ مِنْ رَبِّكُمْ وَلَا تَتَّبِعُوا مِنْ دُونِهِ أَوْلِيَاءَ قَلِيلًا مَا تَذَكَّرُونَ﴾

**“Ndiqeni atë që ju është zbritur juve nga Zoti juaj dhe mos pasoni miq tjerë pos Tij! Pak kujtojnë.”** [El-A’raf: 3]

Allahu e ka këshilluar njeriun ta ndjekë rrugën e Tij të drejtë dhe të largohet nga çdo rrugicë tjetër, prandaj thotë: ﴿وَأَنَّ هَذَا صِرَاطِي﴾

**“Dhe kjo është rruga ime e drejtë, prandaj ndiqeni atë dhe mos ndiqni rrugë (tjera) se do t’jua ngatërrojnë rrugën e Tij. Me këtë ju ka këshilluar që të jeni të devotshëm.”** [El-En’am: 153]

Gjithashtu, u ka konfirmuar njerëzve se aspirata e dashurisë ndaj Allahut dhe e faljes së Tij lidhet me ndjekjen e të Dërguarit të Tij: ﴿قُلْ إِنْ كُنْتُمْ تُحِبُّونَ اللَّهَ فَاتَّبِعُونِي يُحْبِبْكُمُ اللَّهُ وَيَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ﴾

**“Thuaj: nëse jeni që e doni Allahut, atëherë më ndiqni mua që edhe Allahu t’ju do dhe t’jua falë mëkatet! Allahu është i Falës dhe i Mëshirshëm.”** [Alu Imran: 31]

Zoti i Madhërishëm u ka tërhequr vërejtjen njerëzve që të mos i pasojnë epshet e të devijuarve dhe devijuesve, ku thotë: ﴿قُلْ يَا أَهْلَ الْكِتَابِ لَا تَغْلُوا فِي دِينِكُمْ غَيْرَ الْحَقِّ وَلَا تَتَّبِعُوا أَهْوَاءَ قَوْمٍ قَدْ ضَلُّوا مِنْ قَبْلُ وَأَضَلُّوا كَثِيرًا﴾

**“Dhe mos i ndiqni epshet e një populli që ka lajthitur përpara dhe lajthit shumë (nga rruga e drejtë). Të këtillet kanë devijuar nga rruga e drejtë.”** [El-Maide: 77].

Njashtu, Krijuesi u ka sqaruar njerëzve se humbja më e keqe është ndjekja e epshit të njerëzve të paudhëzuar, ku thotë: ﴿فَإِنْ لَمْ يَسْتَجِيبُوا لَكَ فَاعْلَمْ أَنَّكَ بِلَيْبِئِهِمْ أَهْوَاءَهُمْ وَمَنْ أَضَلُّ مِمَّنِ اتَّبَعَ هَوَاهُ بِغَيْرِ هُدًى مِنَ اللَّهِ إِنَّ

﴿E nëse nuk të përgjigjen ty, atëherë dije se i ndjekin epshet e tyre. E kush mund të jetë më i humbur se ai që e ndjek epshin e vet pa udhëzim nga Allahu?!﴾ [El-Kasas: 50]

Në Kur'anin fisnik ka fjalë që lidhen me ndjekjen apo pasimin, si p.sh. التأمي (ndjekje) apo اقتداء (pasim). Ata të cilët e shpresojnë mirësinë e Allahut Ditën e Llogarisë në Ahiret janë nga grupi i njerëzve që Muhammedin a.s. e kanë shëmbëlltyrë. Allahu xh.sh. thotë: ﴿لَقَدْ كَانَ لَكُمْ فِي رَسُولِ اللَّهِ أُسْوَةٌ حَسَنَةٌ لِّمَن﴾  
﴿كَانَ يَرْجُو اللَّهَ وَالْيَوْمَ الْآخِرَ وَذَكَرَ اللَّهَ كَثِيرًا﴾  
**“Në të Dërguarin e Allahu ju keni shëmbëlltyrën më të mirë, për atë që shpreson Allahun, Ditën e Fundit dhe për atë që e përmend Allahun shumë.”** [El-Ahzab: 21]. Meqenëse Muhammedi a.s. ishte njeri i rrethohej me vështirësi dhe rahat, me fukarallëk dhe zengjillëk, bënte sabër dhe falënderonte, jetonte me njerëzit, hante nga ku hanin ata etj., prandaj ai mund të ndiqet dhe të merret model për formën e jetesës. Ky pasim dhe kjo ndjekje nuk realizohej dot nëse i Dërguari ishte melek.

Besimtarët e kanë shëmbëlltyrë edhe Ibrahimin a.s. bashkë me pejgamberët tjerë apo besimtarët. Fjala أسوة (shëmbëlltyrë) në këtë kontekst nënkupton diferencimin nga jobesimtarët, mosmiqësimin me ta dhe deklarimi i prerë për ndarje prej tyre derisa të besojnë në Një Zot. Allahu xh.sh. thotë: ﴿قَدْ كَانَتْ﴾  
﴿لَكُمْ أُسْوَةٌ حَسَنَةٌ فِي إِبْرَاهِيمَ وَالَّذِينَ مَعَهُ﴾  
**“Në Ibrahimin a.s. dhe ata që janë me të keni shëmbëlltyrë të mirë.”** [El-Mumtehineh: 4]. Fjala shëmbëlltyrë këtu lidhet me vetë aktin e pasimit. Allahu i Lartësuar i ka shpallur Muhammedit a.s. që të ndjekë fenë e Ibrahimit a.s.: ﴿ثُمَّ أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ أَن اتَّبِعْ مِلَّةَ إِبْرَاهِيمَ حَنِيفًا وَمَا كَانَ مِنَ الْمُشْرِكِينَ﴾  
**“Pastaj të shpallëm ty: ndiq fenë e pastër të Ibrahimit! Ai nuk ka qenë politeist.”** [En-Nahl: 123] Ndoshta qëllimi këtu me fjalë اتباع (ndjekje) është ndjekja e themelit të fesë dhe të njëshmërisë (së Zotit), e jo legjislacioni, sepse çdo pejgamber ka pasur një legjislacion dhe metodë pune të vetën. Po ashtu, Allahu ka porositur ndjekjen (me fjalën اقتداء) duke përmendur edhe Pejgamberët tjerë, me gjithë librat, urtësitë dhe begatitë që ua ka dhënë atyre duke i udhëzuar në rrugën

e drejtë. Pastaj Allahu i Lartësuar e ka sjellë udhëzimin me Pejgamberin e fundit, Muhammedin a.s.. Allahu xh.sh. thotë: ﴿أُولَئِكَ الَّذِينَ هَدَى اللَّهُ فَبِهِدَاهُمُ افْتَدَىٰ﴾ **“Të tillët i ka udhëzuar Allahu, andaj udhëzimin e tyre paso!”** [El-En’am: 90]. d.m.th. fjala *افتداه* do të thotë اتبع *ndiq* apo *paso*.<sup>546</sup> Ndjekja në rastin konkret nënkupton: “ndjekjen e punës që kanë punuar ata, të metodës që e kanë pasuar ata dhe të udhëzimit me të cilin janë udhëzuar ata.”<sup>547</sup> Ndjekja e të Dërguarit nënkupton dëgjueshmërinë ndaj gjithë besimit që ka sjellë ai, atë që ka thënë apo ka urdhëruar, atë që ka vepruar apo ka lënë, pra, ndjekja e fjalëve dhe veprave të tij, por me kusht që krejt kjo të bëhet me nijet të pasimit të tij.

Shohim se Kur’ani fisnik ka bërë ndërlihdje mes ndjekjes (pasimit), udhëzimit dhe rrugës së drejtë. Allahu xh.sh. thotë: ﴿فَمَنِ اتَّبَعَ هُدَايَ فَلَا يَصِلْ وَلَا يَشْقَىٰ﴾ **“E kush e ndjek udhëzimin Tim, nuk humb dhe nuk dëshpërohet.”** [Taha: 123] Po ashtu, Allahu i Lartësuar thotë: ﴿وَأَنَّ هَذَا صِرَاطِي مُسْتَقِيمًا فَاتَّبِعُوهُ﴾ **“Vërtet kjo është udha Ime e drejtë, andaj ndiqeni atë!”** [El-En’am: 153]. Ndjekja apo pasimi, me të gjitha shprehjet, nënkupton ndikimin nga të tjerët, beson si ai, e merr fjalën e tij dhe vepron qëllimisht si ai. Me këtë kuptim është përdorur koncepti i “tabi’inëve”, të cilët i ka cilësuar ajeti kur’anor vijues: ﴿وَالسَّابِقُونَ السَّابِقُونَ مِنَ الْمُهَاجِرِينَ وَالْأَنْصَارِ وَالَّذِينَ اتَّبَعُوهُمْ بِإِحْسَانٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمْ﴾ **“Pararendësit e parë nga muhaxhirët dhe ensarët, dhe ata të cilët i ndoqën këta me mirësi, me të tillët Allahu është i kënaqur, por edhe ata janë të kënaqur me Allahun.”** [Et-Tevbe: 100]. Pra, tabi’inët janë ata që i ndoqën sahabët: i trasuan gjurmën e tyre dhe ecën në rrugën e njëjtë. Ky pasim ishte shkak i konstatimit të virtytit të tyre, pra ndjekja e lavdishme.

Mirëpo, Kur’ani fisnik na tregon se ekziston edhe ndjekje jo e drejtë, e palogjikshme dhe e paarsyeshme. Ky tip i ndjekjes nënkupton pasimin e atyre që refuzuar ta ndjekin atë që e zbriti Allahu, e në vend të saj ndoqën traditën (e

<sup>546</sup> Ibn Kethir, *Tefsir’ul-Kur’an’il-adhim*, vep. e cit., vëllimi III, fq. 299.

<sup>547</sup> Ebu Xha’fer Muhamed bin Xherif Et-Taberij (vd. 310 h.), *Xhamiu ’l-bejan fi te’vil’il-Kur’an*, i redaktuar nga Ahmed Shakir, Bejrut, Muesseset’ur-Risaleh, 2000, vëllimi XI, fq. 519.



keqe) të baballarëve, madje edhe nëse baballarët e tyre nuk logjikonin aspak dhe nuk ishin të udhëzuar. Të këtillët janë si shurdhmecet që nuk logjikojnë. Allahu i Lartësuar thotë: ﴿وَإِذَا قِيلَ لَهُمُ اتَّبِعُوا مَا أَنْزَلَ اللَّهُ قَالُوا بَلْ نَتَّبِعُ مَا أَلْفَيْنَا عَلَيْهِ آبَاءَنَا أَوْلُو كَانُوا آبَائِهِمْ لَا يَعْقِلُونَ شَيْئًا وَلَا يَهْتَدُونَ (170) وَمَثَلُ الَّذِينَ كَفَرُوا كَمَثَلِ الَّذِي يَنْعِقُ بِمَا لَا يَسْمَعُ إِلَّا دَعَاءَ وَنِدَاءَ صُمُّ بِكُمْ عُمِّي فِيمَ﴾ “E kur u thuhet atyre (idhujtarëve): “Pranoni atë që Allahu e shpalli!” Ata thonë: “Jo, ne ndjekim atë rrugë në të cilën i gjetëm prindërit tanë!” Edhe sikur prindërit e tyre të mos jenë udhëzuar në rrugën e drejtë (ata do t’i pasonin)?” Shembulli i (i thirrësit të) atyre që nuk besuan është sikurse i atij (bariut) që u lëshon britmë atyre (bagëtive) që nuk dëgjojnë tjetër vetëm se britmë e zë (e nuk kuptojnë). Ata janë të shurdhër, memecë e të verbër, ata nuk kuptojnë.” [El-Bekare: 170-171]. Në ndjekje, në situatë të njëjtë janë të dy palët: ata që ndjekin dhe ata që ndiqen, pra për të dy palët ka dëshpërime Ditën e Kiametit dhe nuk dalin nga zjarri. Allahu i Madhërishëm thotë: ﴿إِذْ تَبَرَّأَ الَّذِينَ اتَّبَعُوا مِنَ الَّذِينَ اتَّبَعُوا وَرَأَوْا الْعَذَابَ وَتَقَطَعَتْ بِهِمُ الْأَسْبَابُ (166) وَقَالَ الَّذِينَ اتَّبَعُوا لَوْ أَنَّا كُنَّا كَرَّةً فَنَتَّبَرَأَ مِنْهُمْ كَمَا اتَّبَعُوا وَرَأَوْا الْعَذَابَ وَتَقَطَعَتْ بِهِمُ الْأَسْبَابُ (166) وَقَالَ الَّذِينَ اتَّبَعُوا لَوْ أَنَّا كُنَّا كَرَّةً فَنَتَّبَرَأَ مِنْهُمْ كَمَا اتَّبَعُوا وَرَأَوْا الْعَذَابَ وَتَقَطَعَتْ بِهِمُ الْأَسْبَابُ (166) وَقَالَ الَّذِينَ اتَّبَعُوا لَوْ أَنَّا كُنَّا كَرَّةً فَنَتَّبَرَأَ مِنْهُمْ كَمَا اتَّبَعُوا وَرَأَوْا الْعَذَابَ وَتَقَطَعَتْ بِهِمُ الْأَسْبَابُ (166) وَقَالَ الَّذِينَ اتَّبَعُوا لَوْ أَنَّا كُنَّا كَرَّةً فَنَتَّبَرَأَ مِنْهُمْ كَمَا اتَّبَعُوا وَرَأَوْا الْعَذَابَ وَتَقَطَعَتْ بِهِمُ الْأَسْبَابُ (166)﴾ “Dhe (sikur të shihnin) kur do të largohen ata që u prinin atyre që i ndiqnin (paria largohet prej atyre që u shkuan pas), e të gjithë e shohin dënimin dhe këputen lidhjet e tyre. E Ata, të cilët u patën shkuar pas do të thonë: “Ah, sikur të na lejohej një kthim (në dynja) e të largohemi prej tyre (prijësve) siç u larguan ata tash prej nesh!” Kështu Allahu do t’ju paraqesë veprat që janë dëshpërim për ta, e ata nuk kanë të dalë prej zjarrit.” [El-Bekare: 166-167]

Fjala اتباع (ittiba’ - ndjekje), në kuptimin e përgjithshëm, mbase nuk dallon nga fjala تقليد (imitim), siç e ka theksuar Shatibiu në veprën “El-Muvafekat” në shumë vende.<sup>548</sup> Gjithashtu, edhe imitimi është i mirë nëse është i drejtë dhe i arsyeshëm, apo i shëmtuar nëse është i paarsyeshëm dhe i padrejtë. Ibn Abdulbirri ka bërë dallim mes ndjekjes dhe

<sup>548</sup> Fjalët اتباع dhe اقتداء përdoren shpesh në veprën “Muvafekat” të Shatibiut me formë identike në shumë raste. Shembull për këtë është citimi vijues: “Argument i vërtetësisë së kësaj është se kjo nuk ndodh veçse me masë të caktuar të ndjekjes dhe të pasimit...”.

- Esh-Shatibiu, *El-Muvafekat fi usul’ish-sheriati*, vep. e cit., fq. 374, 877.

imitimit, duke e akuzuar imitimin, prandaj ka veçuar një kapitull të veçantë të quajtur “Jolegjitimiteti i imitimit dhe mohimi i tij, dallimi mes imitimit dhe ndjekjes.”<sup>549</sup> Këtë e interpretoi se imituesi (mukal-lid) kur thotë një mendim të tjetërkujt duke e ditur argumentin e tij, kjo nuk konsiderohet imitim (taklid), por ndjekje (ittiba’). Mirëpo, nëse e thotë mendimin e dikujt pa e ditur argumentin, atëherë ky është imitim i ndaluar. E ka theksuar hadithin e Muhammedit a.s. ku thotë: “Largohen dijetarët (vdesin), pastaj njerëzit kapen për kryesuesit injorantë. I pyesin dhe u jepet fetva pa dije. Kështu devijojnë vetë dhe i devijojnë të tjerët.” Pastaj (Ibn Abdulberri) ka thënë: “Krejt kjo është mohim i imitimit dhe mospranim i tij, kuptohet për atë që e kupton dhe i thërret mendjes. Ibn Abdulberri e ka transmetuar fjalën e Ebu Abdullah bin Huvezj Mindad Basrij Malikij, ku thotë: Taklid (imitim), në shariat do të thotë kthim te një fjalë që s’ka provë për thënien e saj. Kjo është e ndaluar në shariat, kurse ittiba’ (ndjekej) është thënia që ka argument.”<sup>550</sup>

Nuk ka dyshim se umeti islam është umet që ndjek atë që ka sjellë shpallja hyjnore, tradita pejgamberike dhe atë që na është mësuar nga tradita e halifëve të drejtë, por ndjekja të bëhet e mbështetur në dije dhe në udhëzim, sepse ndjekësi e sheh rrugën e drejtë të cilën e kanë trasuar të udhëzuarit para tij, prandaj edhe e ndjek atë.

Dukuria e ndjekjes lidhet shumë ngushtë me edukimin dhe arsimin, prandaj familja në jetën e njeriut konsiderohet institucioni më i vjetër edukativ dhe arsimor, sepse aty bëhet edukimi përmes ndjekjes dhe imitimit. Zakonet shoqërore janë burimi dhe baza e ndjekjes dhe e imitimit. Njerëzit përgjatë gjithë historisë i ndjekin pararendësit në shumë punë. Përdorimi i gjuhës është rezultat i ndjekjes, sepse bazë të funksionit ka përdorimin gjuhësor të çdo populli, gjeneratë pas gjenerate. Popujt dallohen me sjellje, ushqime, pije dhe veshje të ndryshme, si nga aspekti i ndjekjes, ashtu edhe ai i imitimit. Botërisht dihet se fëmijët i pasojnë prindërit në këto

<sup>549</sup> Ebu Omer Jusuf bin Abdullah El-Kurtubij Ibn Abdulberr (vd. 463 h.), *Xhamiu bejan'il-ilmî ve fadlithi*, i redaktuar nga Ebu El-Eshbal Ez-Zuhejri, Demam: Ibn El-Xhevzj, një vëllim, (1414 h./1994), fq. 975.

<sup>550</sup> Po aty, fq. 988-993.

çështje, po ashtu edhe në përkatësinë fetare, sektare dhe në shumë praktika sociale. Megjithatë, dukuria e ndjekjes dhe e imitimit nuk e pengon ndryshimin dhe zhvillimin e këtyre praktikave. Sa herë që rrethanat sjellin një praktikë të re, po atëherë kthehet edhe ndjekja apo pasimi përsëri.

Faktorët e ndryshimit nuk fokusohen vetëm në praktikat e zakonshme shoqërore, por ato hyjnë në punë edhe në reformimin apo rikuptimin e teksteve fetare dhe në mënyrën e përshtatjes së tyre me realitetin dinamik të jetës së njerëzve. Nevoja për reformim shfaqet në dy raste. E para: kur njerëzit largohen gradualisht nga gjendja praktike dhe shkencore që ka sunduar në një periudhë të caktuar kohore. Kjo mund të shoqërohet edhe me ndonjë devijim në të kuptuar dhe në praktikë, derisa feja bëhet e huaj siç ka filluar, prandaj shfaqet nevoja e ndreqjes së asaj që është prishur dhe kthimi në kuptimin burimor. Në këtë mënyrë duket sikur feja ka ardhur përsëri, siç thuhet në hadithin vijues: “Islami filloi i huaj dhe do të kthehet i huaj siç ka filluar. Lum për të huajt!”<sup>551</sup> Në një transmetim tjetër, në disa libra të hadithit, theksohet edhe një shtesë: i është thënë: “O i Dërguari i Allahut! Kush janë të huajt?” Tha: “Njerëzit që bëjnë mirë kur të tjerët prishen.”<sup>552</sup>

Kuptimi i hadithit pejgamberik lidhen me procesin e reformimit në fe, siç kërkohet në hadithin e reformimit: “Allahu, në çdo njëqind vjet dërgon në krye të umetit dikë i cili do ta reformojë fenë.”<sup>553</sup> Kuptimi i reformimit në gjuhën e trashëgimisë islame, deri në shekullin e dymbëdhjetë hixhri, ka qenë i kufizuar në kuptimin literal të këtij hadithi. Dijetarët filluan ta propozojnë emrin muxheddid (reformator) në çdo njëqind vjet të historisë islame, të cilët e përcaktonin në bazë të prurjeve të fushës së legjislacionit (fikhut) apo për atë që kthenin vëmendjen kah suneti duke

<sup>551</sup> Muslim, *Sahihu Muslim*, vep. e cit., Kitab: “El-Iman”, Bab: “Bejanu enne ‘l-islame bede’e gariben ve sejeudu garibe...”, hadithi numër: (145), fq. 83.

<sup>552</sup> Ebu Amr Othman bin Seid El-Mukri Ed-Dani (vd. 444 h.), *Es-Sunen’ul-varideti fi ‘l-fiteni ve gavailiha ve ‘s-saati ve eshratiha*, i redaktuar nga: Ridaull-llah bin Muhamed Idriz Mubarekfuri, Bejrut: Dar’ul-Asimeh, 1416 h., thënia e Pejgamberit a.s. “Islami ka filluar gabim...”, vëllimi III, fq. hadithi numër: 288, fq. 633.

<sup>553</sup> Ebu Davud, *Sunenu Ebi Davud*, vep. e cit., Kitab: “El-Melahim”, bab: “Ma judhkeru fi karn’il-mieti”, hadithi numër: 4291, fq. 469.

fshirë bidatin. Omer bin Abdulazizi është reformatori i njëqindshes së parë, Shafi'u i të dytës dhe të tjerë. Ibn Kethiri e ka komentuar fjalën e atyre që e konsiderojnë vetë atë si reformator, e tha: “Çdo popull pretendon për imamin e tyre se ky hadith e synon atë. Allahu e di më mirë, por duket se ky hadith i përfshin të gjithë bartësit e dijes që punojnë për të, dhe atë nga çdo grup (mund të jetë), pra ata që veprojnë punë në përputhje me Ligjvënësin. Gjithashtu, hadithi mund të përshtatet të vlen për çdo grup apo lloj të dijetarëve, si p.sh. për komentuesit, hadithologët, lexuesit (e Kur’anit), fukahatë, gramatikanët, gjuhëtarët dhe për çdo dijetar tjetër të dobishëm. Allahu e di më mirë!”<sup>554</sup>

Kuptimin e fjalës *texhdid* (ripërtëritje) e mori edhe fjala *ihja* (ringjallje), si në shprehjen “*ihjau ‘s-sunneh ve imatetu ‘l-bid’ah*” (ringjallja e sunetit dhe vdekja e bidatit). Pra, shprehjen “ringjallje e sunetit” e gjejmë në hadithin e Pejgamberit a.s.: “Kush e ngjall një sunet timin që është shuar, do të ketë shpërblimin e gjithë atyre që e veprojnë, pa u pakësuar aspak shpërblimet. E kush shpik një bidat devijues që s’e do Allahu e as i Dërguari, do të ketë mëkat njësoj si ai që e vepron, pa iu lehtësuar edhe barra që bie mbi njerëzit tjerë.”<sup>555</sup>

Gjithashtu, edhe termin “ringjallje të bidatit” e gjejmë qysh në kohë të hershme. Transmetohet se Abdullah bin Abbasi r.a., i cili ka thënë: “Nuk vjen një vit i ri pa shpikur njerëzit një bidat dhe pa e shuar një sunet. Kështu ringjallen bidatet dhe vdesin sunetet.”<sup>556</sup> Duket se Imam Gazaliu, kur vendosi t’i vë titullin veprës së tij më të rëndësishme “*Ihjau ulum’id-dini* (Ringjallja e shkencave të fesë)”, mendonte se “shkencat

<sup>554</sup> Ebu ‘l-Fida Ismail bin Omer Karshij Dimeshkij Ibn Kethir (vd. 774 h.), *El-Bidajetu ve’n-nihajeh*, Bejrut, Alem’ul-Kutubi (1424 h./2003), vëllimi XIX, fq. 42.

<sup>555</sup> Shihabuddin Ebu Muhamed Abdurrahman bin Ismail Ebu Shameh (vd. 665 h.), *El-Baith ala inkar’il-bidei ve ‘l-havadithi*, Mekë: Mektebet’un-Nahdat’il-Hadithet, botimi II, fq. 1981, shih: Et-Tirmidhij, *Xhamiu ‘t-Tirmidhij*, vep. e cit., Kitab: “El-Ilmu”, bab: “Ma xhae fi ‘l-ahdhi bi ‘s-sunneti ve ixhtinab’il-bidei”, hadithi numër: 2676, fq. 433.

<sup>556</sup> Dijauddin Ebu Abdullah Muhamed bin Abdulvahid El-Mekdisij (vd. 643 h.), *Ittibau ‘s-suneni ve ixhtinabu ‘l-bidei*, i redaktuar nga: Muhamed Bedruddin Kahvexhi dhe Mahmud Arnaut, Damask: Daru Ibn Kethir, 1987, fq. 24.

e fesë” në kohën e tij kishin marrë rrugën e shuarjes, prandaj shprehu dëshirën që të kontribuojë për t’i ringjallur ato.

Kurse situata e dytë e reformimit mund të jetë me forma të reja në kuptimin e intencës së tekstit sheriatik, sigurisht duke parë edhe arritjet e njerëzve për tematikën e këtij teksti, të cilat mund të jenë në fushën e mjekësisë, të administratës, agronomisë, industrisë, ndërtimtarisë dhe në fusha të tjera. (Reformimi) Mund të jetë edhe në fushën e mjeteve të arsimit, të thirrjes, të komunikimit, të bashkëveprimit dhe të tjerave. Po ashtu, në sistemet e marrëdhënieve mes shoqërive dhe shteteve, në përgatitjet luftarake dhe në llojet e xhihadit, dhe në gjithçka tjetër që nuk ka qenë e njohur më parë. Ky (reformim) jo domosdoshmërisht duhet të ndodhë përmes një trajte të re të dispozitave, sepse mund të bëhet edhe përmes përshtatjes së teksteve nga të cilat nxirren dispozitat e rasteve, të situatave dhe të gjendjeve të reja.

Mbase është e rendit të pohohet se termat “ibda”, “ibtida” dhe “bid’ah” mbajnë kuptim neutral mes shëmtisë dhe lëndvdatës, siç është përdorur në Kur’an, siç jepet nëpër fjalorët e gjuhës arabe dhe siç e kanë përdorur edhe sahabët. Në fjalorin “Lisan ‘ul-arab” fjala بَدَعَ me të gjitha derivatet e saja nënkupton “një gjë që është e para”... Në Kur’an thuhet: ﴿قُلْ مَا﴾  
**﴿قُلْ مَا كُنْتُ بِدْعًا مِنَ الرُّسُلِ﴾** **“Thuaj: nuk isha bid’an (i pari) nga pejgamberët”** [El-Ahkaf: 9], pra nuk isha i pari që u dërgova si pejgamber, sepse kishte edhe shumë të tjerë para meje... Fjala “el-bid’ah” do të thotë edhe diçka e re, pra diçka e re që u paraqit në fe pas plotësimit të saj... Ibn Ethiri ka thënë: “Bidati është dy lloje: bidat drejtues dhe bidat lajthitës. Bidati që bie ndesh me urdhrin e Allahut dhe të Pejgamberit a.s. është bidat i keq dhe i urryer, kurse bidati që bën pjesë në gjërat e përgjithshme, i cili është pjesë e gjërave vullnetare nga Allahu dhe nga i Dërguari, atëherë bie në rrethin e bidatit të lejuar dhe të pëlqyer, veçanërisht nëse ka të bëjë me veprimet si bujaria, zemërgjerësia, veprimi i punëve të mira dhe të tjera punë të lavdëruara... Për këtë Omeri r.a. ka thënë: “Sa bidat i mirë është ky...”. Fjala بَدِيَ do të thotë *shpikës*, pra

ka krijuar diçka pa model paraprak, kurse fjala *البيدع* (Shpikësi) është një nga emrat e Allahut të Lartësuar. Kesaiu ka thënë: fjala bidat përdoret për të mirë dhe për të keq.<sup>557</sup>

Megjithatë, kryesisht në trashëgiminë islame fjala bid'at është përdorur me konotacion të keq, sepse konteksti i dispozitës lidhej me shtim apo pakësim në fe apo në fetar. Me vetë faktin se kjo fjalë me këtë kuptim nuk mban mundësi tjetër veçse për të keq, nënkupton se kjo është përdorur për t'u ballafaquar me rrymat e devijuara dhe ato që e kanë tepruar (me bidate) në çështjet e besimit dhe të adhurimit. Ndoshta ka qenë reflektim i situatës së imitimit të verbër nga i cili lëngonte shoqëria islame në disa etapa.

Në kontekstin e bisedës sonë për mendimin pedagogjik islam dhe për rolin që ky mendim ka në ndërtimin kulturor të shoqërive dhe të umetit tonë islam, me vetëdije shprehim nevojën e një mendimi pedagogjik i cili i shtyn vendimmarrësit e veprimtarisë pedagogjike të sigurojnë më shumë mundësi për nxënësit, duke u nisur nga ajo që u ka mundësuar Allahu, gjegjësisht nga potencialet kreative (ib'daijeh). Këtë e konstatojmë nga domosdoshmëria për t'i kushtuar vëmendje këtij dimensionit të vyer të kreativitetit (ibda') dhe gjithë atyre veprimeve që lidhen me të, si reformimi, ringjallja dhe ripërtëritja. Kuptohet, ky kreativitet duhet realizuar pa e humbur kujdesin për ndjekjen (ittibain), për dispozitat, për instruksionet e në shpalljen hyjnore dhe për kuptimin e ndjekjes dhe të pasimit të traditës pejgamberike.

Tani paksa është rritur nevoja e interesimit për kreativitet (ibda') në pedagogjinë moderne, dhe atë për shkak të kritikës së vazhdueshme ndaj shkollës e cila ka formuar një trashëgimi historike dhe është mishëruar në ruajtjen e trashëgimisë së popujve, në bartjen e saj te gjeneratat e reja. Po ashtu, kjo hyn në punë për pajisjen e nxënësve me përshtatjen sociale në jetën bashkëkohore dhe për përcaktimin e rrugës ideologjike dhe politike, të cilat

<sup>557</sup> Ebu 'l-Fadl Xhemaluddin Muhamed Mukrem Ibn Mendhur (vd. 711 h.), *Lisan'ul-arabi*, Bejrut: Daru Sadir (15 vëllime), vëllimi VIII, fq. 2003, fq. 5-6.

sigurojnë rrugëtimin modern. Megjithatë, shkolla në fjalë, në të shumtën e rasteve, ka dështuar të krijojë një frymë të lirë dhe ruajtëse të krenarisë njerëzore, dhe ka refuzuar praktikat që u zënë frymën potencialeve të kreativitetit, të reformimit dhe të shpikjes te njeriu.<sup>558</sup>

Edukimi është një përgjegjësi kyçe, prandaj ai që e ndërton atë, ndikon në jetën e shumë anëtarëve të shoqërisë. Në këtë mënyrë ai mund të shkaktojë ndryshim pozitiv apo negativ. Pejgamberi a.s. u dërgua për të qenë udhëzues dhe mësues në të njëjtën kohë. Allahu xh.sh. thotë: ﴿لَقَدْ مَنَّ اللَّهُ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ إِذْ بَعَثَ فِيهِمْ رَسُولًا مِنْ أَنْفُسِهِمْ يَتْلُو عَلَيْهِمْ آيَاتِهِ وَيُزَكِّيهِمْ وَيُعَلِّمُهُمُ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ﴾ **“Allahu i ka begatuar besimtarët kur u dërgoi atyre pejgamber nga vetja e tyre, t’ua lexojë ajetet e Tij, t’i pastrojë (shpirtërisht) dhe t’ua mësojë Librin dhe urtësinë.”** [Alu Imran: 164] Po ashtu, thotë: ﴿كَمَا أَرْسَلْنَا فِيكُمْ رَسُولًا مِنْكُمْ يَتْلُو عَلَيْكُمْ آيَاتِنَا وَيُزَكِّيكُمْ وَيُعَلِّمُكُمُ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ﴾ **“Siç u dërguam juve një të dërguar nga mesi juaj, t’jua lexojë ajetet Tona, t’ju pastrojë, t’jua mësojë Librin dhe urtësinë, dhe t’jua mësojë atë që nuk e dinit.”** [El-Bekare: 151]

Çështja e leximit dhe e shkrimit në shoqërinë islame, qysh në fillim të shpalljes, ka qenë shkak i transformimit të asaj shoqërie në shoqëri të dijes, të mësimit dhe të edukimit me plotë kuptimin e fjalës.

Kjo mund të llogaritet risi (ibda’) në stilin e jetës ku shoqëritë nuk ishin adaptuar me një veprim të tillë, sidomos kur bëhet fjalë për një risi që mëtonte të bëjë lidhjen e njerëzve me Krijuesin e Madhëruar dhe ta drejtonte jetën e tyre sipas kushteve që shpallëshin, me të cilat do t’i fitonin të mirat dhe do t’i largonin të këqijat.

Shoqëritë islame sot vuajnë nga prapambetja në shumë sfera të jetës, qoftë ajo prapambetje në dritën e asaj që kërkon Islami, në krahasim me mundësitë dhe potencialet që posedon koha apo duke u krahasuar me popujt dhe shoqëritë tjera. Këtu mund të konstatojmë se, pa asnjë dyshim, dalja nga kjo situatë nuk mund të arrihet duke u përpjekur të

<sup>558</sup> Frajri, *Talim’ul-mekhurin*, vep. e cit., 1980.

mbërrihen të mëhershmit të cilët janë dy shekuj prapa. Dallimi i distancës aktuale mes të mëhershmeve dhe të mëvonshmeve është i madh, po ashtu, dallimi është shumë i madh edhe në shpejtësinë e lëvizjes dhe të përpjekjeve për ndryshim. Patjetër duhet një lloj tjetër i përpjekjeve, përpjekje kreative joimituese të cilat hedhin hapa në të ardhmen, veçanërisht kur dihet se umeti ka një thesar të vlerave etike të cilat, nëse mishërohen në realitet, nuk mund t'ia kalojë askush. Mendimi pedagogjik i bazuar në edukimin kreativ krijon hapësirë për potencialet, për mundësitë dhe për investimin e tyre në rizgjim dhe në garën kulturore. Po ashtu, ky mendim mund të na shpëtojë nga llumi dhe nga prapambetja.

Sigurisht se edukimi kreativ që kërkohet në arsim nuk përqendrohet vetëm në një lëndë mësimore apo në një tjetër, por nevoja për kreativitet është në të gjitha sferat, në: shkencat natyrore dhe aplikative, në shkencat humane dhe sociale, në gjuhët dhe në artet etj. Kriza jonë administrative, si në administratën shtetërore apo në administratën e institucioneve, ka nevojë për zgjidhje kreative. Njësoj qëndron puna edhe me krizën ekonomike, edukative dhe të tjera. Nuk mund të gjejmë një person kreativ në çdo gjë, por çdokush të jetë kreativ në një lëmë të caktuar. Krijimi i hapësirës për kreativitet në praktikën edukative (pedagogjike) i hap mundësitë kreative edhe në sferat tjera. Umeti ka nevojë për kreativitet në çdo sferë dhe të ndalojë së imituarit të tjerët sa të ketë mundësi.

Shoqëritë tonë asnjëherë nuk kanë hasur një ekspert të huaj kreativ për zgjidhjen e problemeve, i cili do t'ia kushtohet me gjithë mend zgjedhjes së një problemi, kuptohet nëse do të donte ta zgjidhte atë realisht. Megjithatë, në projektin e renesancës dhe epërsisë kulturore që kërkon të mbërrijë umeti islam, kreativitetet dhe zbulimet e popujve të tjerë mund t'ia shndërrojë në element trajnues dhe përgatitës për t'ia stimuluar potencialet kreative të anëtarëve të shoqërisë së vet.



Gjithashtu, edukimi kreativ nuk fokusohet vetëm në institucionet e arsimit tradicional, si në familje, në shkollë dhe në universitet, por krahas këtyre ka nevojë për institucione të një lloji tjetër, të cilat mishërohen në qendra hulumtuese shkencore ku sigurohen mjetet, mekanizmat dhe ambienti shpirtëror dhe fizik stimulues për kreativitet. Krejt kjo që u tha është mendim pedagogjik, por jo i pavarur nga mendimi administrativ, social dhe politik.

Studimet psikologjike tregojnë se mundësia e kreativitetit fillon qysh në fëmijëri. Shumica e pyetjeve të fëmijëve janë kreative dhe spontane, prandaj nëse sigurohen mundësitë e ruajtjes së kësaj aftësie, atëherë ajo do të vazhdojë të zhvillohet dhe të japë efektet e veta. Megjithëse shumica e praktikave edukative në familje, pastaj edhe në shkollë, nuk japin hapësirën e nevojshme për përkujdesjen ndaj kësaj aftësie e cila kërkon kohë, program dhe projekt të veçantë. Familja preokupohet me çështjet dhe problemet e nevojshme të jetës, prandaj nuk i mbetet kohë, durim dhe potencial psikik të merret me kreativitetet e fëmijëve, që në të shumtën e rasteve kjo quhet “shpërfillje e fëmijëve”. Njësoj është puna edhe me shkollën, ku mësuesit janë të lidhur me detyrimet e përcaktuara zyrtare si: lëndët, programet dhe përgjegjësitë e llojllojshme. Fatkeqësisht në situatë të tillë kemi edhe në etapat e mëtutjeshme, sepse zakonisht njerëzit, sidomos përgjegjësit administrativë, e shmangin barrën e pyetjeve që mund të krijojnë tollovi të rendit.

Hulumtuesi britaniko-amerikan, gjegjësisht eksperti i fushës së kuestionologjisë (disiplinës shkencore të pyetjeve), ka thënë: “Shkollat nuk arsimojnë përmes metodave që nxitin diskutim, sepse pyetjet e sfidojnë pushtetin, shkaktojnë problem në strukturën, në sistemin dhe në praktikat e institucionit apo, së paku, i nxisin të punësuarit aty që të mendojnë me metoda ndryshe të pazakonta për atë institucion... mësuesi që krijon më shumë hapësirë për pyetje duhet të distancohet nga detyrimi paraprak i asaj që është

përcaktuar në atë sezon studimi...".<sup>559</sup> Hulumtuesi paraprak transmeton nga neurologu John Kounios se ky i fundit ka thënë: "Truri i njeriut gjen mënyra për të pakësuar barrën logjike. Në mesin e këtyre mënyrave është absorbimi i gjithë asaj që e rrethon për çdoherë, por pa pyetje, apo duke i shpërfillur pyetjet. Kështu ne e ushtrojnë veprimtarinë tonë si piloti automatik, e shfrytëzojmë vetëm një pjesë të potencialit mendor, i realizojmë ca aktivitete të llojllojshme dhe i kryejmë detyrat e përditshme."<sup>560</sup>

Kur e kuptojmë këtë prirje natyrore te njeriu, atëherë e shohim se kemi nevojë të bashkëveprojmë me të sipas situatës nëpër të cilën kalojnë shoqëritë tona dhe umeti. Shoqëria që jeton me ndihmat e jashtme për shkaqe sigurie dhe ekonomike, e nuk prodhon ide dhe metoda që e pavarësojnë nga këto ndihma, një ditë do të mbetet pa gjetur se kush t'ia shtrin dorën e ndihmës. Institucioni prodhues dhe i suksesshëm në tregun e veçantë, nëse nuk vazhdon përditësimin dhe kreativitetin duke i zhvilluar prodhimet dhe duke planifikuar prodhime të reja, atëherë do ta humb tregun. Kurse institucioni i pasuksesshëm duhet të shpikë ide dhe metoda të reja për ta zhvilluar dhe për përmirësuar pozitën e vet, përndryshe do të dalë nga skena me humbjet më të vogla. Biznesmenët, administratorët dhe politikanët, të gjithë janë rezultat i sistemeve edukative dhe arsimore që dirigjohen nga një filozofi, nga sistemet, nga metodat dhe procedurat e ndryshme. Nëse duam të kemi politikanë, pushtetarë dhe ekonomistë kreativë, atëherë duhet që, qysh në fazat e hershme të arsimit, të hapim sferën e zhvillimit të kureshtjes, të diskutimit dhe të ambicies për hulumtim, zbulim dhe kreativitet. Pastaj e njëjta të jetë e hapur edhe në fazat vijuese.

Disa ekspertë të studimeve kreative mendojnë se ekziston një lidhje e ngushtë mes procesit të diskutimit dhe aftësisë së kreativitetit. Ambienti edukativ i cili i nxit nxënësit të parashtrajnë pyetje të vështira, i ndihmon ata më vonë që të

<sup>559</sup> Warren Berger, *A More Beautiful Question: The Power of Inquiry to Spark Breakthrough Ideas*, London: Bloomsbury Publishing, 2016, fq. 6.

<sup>560</sup> Po aty.

bashkëveprojnë me situatat praktike nëpër institucionet ku do të veprojnë dhe do t'u ndihmojë të formulojnë pyetje të sakta dhe të domosdoshme për ecurinë në rrugën e kreativitetit. Warren Burger për këtë çështje thotë: “Sa i përket kreativitetit, në të shumtën e rasteve mbështetet në mundësinë dhe dëshirën tonë për të bashkëvepruar me pyetjet e vështira që mund shtrojë imagjinata, kurse sa u takon personave brenda një institucioni të caktuar, të cilët përpiqen të jenë kreativë përmes hedhjes së ideve të reja, apo kur një person përpiqet të shprehë një pikëpamje tërheqëse dhe kreative, duhet të dijë se rruga e kreativitetit është një udhëtim hulumtues dhe gjurmues (jo vetëm ide momenti)... Të gjitha gjërat e jashtëzakonshme kreative dhe të njohura për praktikën dhe për artet, mund të kthehen në pyetje të llojit: pse? Çka nëse..? etj.”<sup>561</sup>

Psikologët i kanë kuptuar mirë aftësitë që posedojnë fëmijët. Gjithashtu, kanë spikatur se ata nuk mund ta fshehin ndikimin e plogështisë dhe shtrëngimit që ndodh në institucionet edukative tradicionale, si p.sh.: në familje, në shkollë, në zakonet shoqërore dhe në sistemet politike. “Këto aftësi dalin në shesh me disa pyetje që mund t'i parashtrijë fëmija. Fëmija para se të shkojë në shkollë insiston të shtrojë pyetje të njëpasnjëshme rreth një teme të caktuar për të mbërritur në thelb të problematikës, derisa i kërkohet që të heshtë. Mendja e tij është në një gjendje shembullore për t'u habitur, për të pyetur, për të gjurmuar dhe për t'u zhvilluar, mirëpo numri i pyetjeve ndryshon nga viti në vit në arsim, siç tregojnë studimet e realizuara nga “Instituti i Pyetjeve të Sakta”. Për këtë përgjegjës është sistemi edukativo-arsimor. Ndër shkaqet që kanë sjellë këtë (rënie të pyetjeve) është se porositë që fëmija i merr nga familja, nga mësuesit dhe nga fëmijët tjerë në klasë e frikësojnë se ai nuk di atë që duhet të dijë. Mësuesit e deklarojnë haptas se nuk kanë kohë t'u përgjigjen të gjitha pyetjeve të nxënësve, sepse ata e

<sup>561</sup> Warren Berger, *The Book of Beautiful Questions*, London: Bloomsbury Publishing, 2018. I huazuar nga hyrja e librit elektronik, të cilin mund ta huazoni nga faqja: <https://www.amazon.com/Book-Beautiful-Questions-Powerful-Connect/dp/163286956X>.

shfrytëzojnë kohën për të kryer detyrat e shumta të paracaktuara nga administrata.”<sup>562</sup>

Ekzistojnë shumë hulumtime që e lehtësojnë mënyrën e diskutimit apo parashtrimit të pyetjeve në programet arsimore, dhe funksionalizimin e tyre në zhvillimin e kreativitetit. Kjo zakonisht bëhet nëpër sistemet edukative me këto emërtime: arsimit i avancuar, individualizimi i arsimit, arsimit kreativ dhe shumë emërtime të tjera të cilat i bëjnë këto sisteme ndryshe nga ajo që njihet në arsimin tradicional. Digresioni i mëparshëm kur u bisedua për pozitën e kreativitetit në arsimin shkollor, nuk duhet të na bëjë të harrojmë se ekzistojnë edhe mendime edukative ndryshe. Kreativiteti nuk duhet të shihet si çështje e pavarur nga lëndët tjera mësimore, por si pjesë e çdo lënde, sepse kreativiteti në matematikë vjen në shprehje vetëm kur mësohet matematika. Po ashtu, duhet ditur se arsimit tradicional u ofron nxënësve një materie shkencore të rëndësishme e cila nuk mund të lihet pas dore, por gabim i madh është që çështjet novative dhe zhvillimore në arsim të paraqiten përmes mësimin të dyfishtë, tradicional dhe kreativ, sikur ato janë dy pole të kundërta, siç është rasti me shumë çështje të tjera antipode. “Është për të ardhur keq se historia e arsimit në shumë raste preferon njërin nga dy polet e kundërta. Situata në të cilën gjendet arsimit, ashtu merret edhe ana e njërit pol, kurse në realitet arsimit efektiv çdoherë është i ekuilibruar mes shtrëngimit dhe lirisë, mes të zakonshmes dhe zhvillimores, mes individuale dhe grupores, mes teorisë dhe praktikës, mes botës së brendshme të njeriut dhe botës së jashtme të tij. Po ashtu, është e gabuar që lavjerrësi i arsimit të luhetet mes dy anëve të kundërta, sepse e rëndësishme është që çdoherë të ndihmohen shkollat dhe studentët për të gjetur mesin e ekuilibruar. Nuk ka një model shembullor të përhershëm në veprimtarinë pedagogjike, por bëhet fjalë vetëm për prurje që janë të lidhura me krijimin e kushteve më të mira për njerëz realistë në shoqëritë reale, megjithatë duhet ditur se bota jeton në

<sup>562</sup> Berger, *The Book of Beautiful Questions*, *Ibid.*

dinamikë të vazhdueshme, prandaj kjo mbetet si çështje sfiduese vazhdimisht. E vërtetë është se eksperiencia pedagogjike çdoherë është personale, por problemet që e karakterizojnë këtë eksperiencë janë probleme të përgjithshme të cilat i gjejmë në çdo shoqëri dhe në formë të vazhdueshme.”<sup>563</sup>

Përderisa arsimi tradicional mban një dozë të konceptit të ndjekjes (ittibai), vlera dhe dobia e të cilit është e njohur, sepse është i lidhur me bazat ligjore (shariatike) të cilat cilësohen si fakte të padiskutueshme, atëherë arsimi i reformuar ka një hapësirë më kreative në mjetet, në reformimin e metodave të jetës bashkëkohore, në ballafaqimin me sfidat e ndryshme dhe në ofrimin e shanseve më të favorshme. Pikërisht këtu vjen në shprehje ekuilibri mes ndjekjes dhe kreativitetit.

<sup>563</sup> Ken Robinson & Lou Aronica, *Creative Schools: the Grassroots Revolution that's Transforming Education*, New York: Penguin Books, 2016, fq. 255-256.

## Pjesa e dytë: Veçoria e realizmit në mendimin pedagogjik islam

Ne flasim për veçoritë e mendimit pedagogjik islam të cilin duam ta kemi për jetën bashkëkohore. Kemi hasur se mendimi pedagogjik islam në tekstet tradicionale nuk e shpreh tërësisht “realitetin” e veprimtarisë pedagogjike që ka sunduar në shoqërinë islame, sepse më shumë ajo paraqet imazhin “ideal” të cilin ulematë e imagjinonin për praktikën e mësuesit dhe të nxënësit.

Megjithatë, trashëgimia islame përmban shembuj për atë që është realizuar në realitetin praktik në raste të veçantë. Mirëpo, përderisa shoqëria muslimane është shoqëri e shkencës, e mësimit dhe e arsimit, siç njihet imazhi real të cilin e kuptojmë nga Kur’ani dhe nga tradita pejgamberike, apo gjendja që duhet të jetë, atëherë duhet thënë se ne kemi hasur udhëzime të rëndësishme të disa halifëve që ua dërgonin valinjtë nëpër qytete të ndryshme, ku i urdhëronin të përmbushin këtë lloj arsimit, kurse harxhimet e tij i bart shteti. Kemi hasur edhe ulema, udhëheqës dhe pasanikë që garonin në ndërtimin dhe financimin e vatrave të dijes, bile ka pasur edhe familje që kanë shpenzuar gjithçka për arsimimin e bijve të vet. Disa dijetarë e kanë sakrifikuar gjithë jetën vetëm për studentët, gjë të cilën e kanë konsideruar se ashtu duhet të jetë, së paku sipas mendimit të tyre. Malik bin Enesit i thuhet në një rast: “A nuk është më mirë të bësh ibadet sesa t’i mësosh të tjerët?” Ai u tha: “Shpërndarja e diturisë është bamirësia më e rëndësishme. Unë që merrem me arsim, nuk mendoj se jam më poshtë se ti që merresh me adhurim.”<sup>564</sup>

Po! Shoqërisë islame përgjatë historisë nuk kanë munguar modelet ndriçuese që ishin afër kthimit të instruksioneve

<sup>564</sup> Edh-Dhehebij, *Sijeru a’lami en-nubela*, vep. e cit., vëllimi VIII, fq. 144.

kur'anore dhe peygamberike kah "realiteti" i gjallë dhe që shprehin formën "ideale" që kërkonte Islami ta zbatonte në shoqëri. Megjithatë, në anën tjetër shohim raste tjera në zona dhe në periudha të caktuara që ishin larg praktikave edukative të këtij modeli ideal, pa marrë parasysh nëse ishin shumë apo pak larg këtij modeli.<sup>565</sup> Kështu, realiteti edukativ në jetën e umetit filloi të mos i shpreh intencat e dijes dhe të arsimit sipas Islamit.

Për këtë arsye, realizmi për të cilin duam të bëjmë fjalë në këtë kontekst karakterizohet me këto katër çështje:

- Sqarimi i vazhdimit dhe i ndërprerjes në konceptin e "realizmit" dhe të "idealizmit".
- Realizmi i mendimit pedagogjik për tek i cili na udhëzojnë ajetet e Kur'anit fisnik dhe tradita peygamberike, dhe i cili synon të arrihet në realitetin e shoqërisë islame.
- Realizmi i mendimit pedagogjik që mund të zbatohet në shoqëritë islame bashkëkohore.
- Sqarimi i lidhshmërisë së realitetit pedagogjik me kohën, vendin dhe njeriun.

## 1. Realizmi dhe idealizmi

Realizmi është çështje që lidhet me realitetin, kurse realiteti është gjendje e individit ose e grupit, në vend dhe në kohë (të caktuar), bashkë me faktet praktike, me idetë dhe veçoritë që bart ky realitet. Realiteti është një përshkrim i jetës së njerëzve në shoqëri dhe shprehje e realitetit të gjendjes së tyre jetësore, të traditave dhe zakoneve, të situatës së tyre ekonomike, sociale, politike, edukative dhe të shumë situatave të tjera. Gjithashtu, realiteti është përshkrim i gjendjes së institucioneve dhe të rrethanave ndikuese të njerëzve. Mendimi realist apo "realizmi në mendim" në shoqëri është lidhshmëria që tematikat dhe metodat e këtij

<sup>565</sup> Shembuj të aspekteve shembullore dhe joshembullore mund t'i hasim në referenca të ndryshme. shih:

- Fet'hij Hasen Melkavi, *Et-Turath'ut-terbevij'ul-islamijju: halet'ul-bahthi fihî ve lemehatun min tetavvurihi ve kutufun min nususihi ve medarisihî*, vep. e cit., Kapitulli i pestë, fq. 335-373.

- Fet'hij Hasen Melkavi, *Meshruatun bahthijjetun fi 't-turath'it-terbevij'il-islamijj*, Herden: El-Ma'had'ul-Alemijju li 'l-Fikr'il-Islamijj, 2018, Kapitulli i parë, fq. 19-57.

mendimi kanë me jetën shoqërore, me çështjet, me problemet dhe me prapavijat që ka adoptuar një shoqëri. Realizmi e fokuson vështrimin në realitetin objektiv duke e cilësuar atë si burim të botëkuptimeve, të vlerave dhe sferë të vështrimit logjik dhe praktik.

Termi realizëm përdoret në teorinë apo drejtimin filozofik, letrar dhe artistik, në degëzimet shkencore dhe në sferat e jetës praktike. Teoria realiste beson se njohja që arrihet nga arsyeja njerëzore është një formë e realizmit të jashtë të pavarur nga perceptimi i tij. Ne i njohim faktet e kësaj bote përmes shqisave dhe përvojës praktike, sepse ky realitet bashkë me gjërat, ndodhinë dhe fenomenet dirigjohet nga ligje natyrore që cilësohen si statike dhe të zbulueshme nga njeriu. Mendimet e teorisë realiste datojnë nga filozofi grek, Aristoteli (vdiq 322 p.e.s.). Mendimi realist brenda kësaj teorie shpreh botën lëndore dhe nuk sheh vend për besimin në të fshehtën apo për metafizikën. Elementi lëndor te njeriu është themel i krijimit dhe i ndërveprimit të tij me faktorët e ambientit.

Përball realizmit në vështrimin filozofik është teoria apo drejtimi ideologjik që shpreh botëkuptimet idealiste. Mendimet idealiste i kthehen filozofit grek, Platonit, (vdiq: 347 p.e.s.). Filozofia idealiste ndërtohet mbi parimin se bota lëndore është forma të cilën e percepton arsyeja, se realiteti i saj gjendet në botën e ideve, jo në botën reale, dhe se njohja reale arrihet përmes intuitës, inspirimit apo arsyes absolute. Karakteri i kësaj filozofie është mendor dhe shpirtëror, kurse bota e vlerave të cilën mund ta perceptojë njeriu është bota e të vërtetave absolute, e ato janë: e vërteta, e mira dhe e bukura.

Të dyja filozofitë: e realizmit dhe e idealizmit, kanë ndjekësit në periudhat e mëvonshme. Përgjatë historisë këto dy filozofi janë kuptuar në mënyra të llojlojshme dhe në forma të ndryshme të manifestimeve teorike dhe praktike në



sfera të ndryshme të mendimin njerëzor, sidomos në fe, në politikë dhe në edukim.<sup>566</sup>

Siç ka kaluar kufijtë idealizmi duke vënë botëkuptime që nuk realizohen në realitet, ashtu ka kaluar kufijtë edhe realizmi me dimensionin filozofik, i cili mohon idealin më të lartë në të cilin thërret feja dhe në gjithë atë që s'ka lidhje me gajbin (të fshehtë), duke e bërë realitetin fizik si bazë të mendimit dhe të perceptimit.

Megjithatë, thirrja dhe referenca jonë në bisedën për realizmin dhe idealizmin nuk mbështetet në drejtimit dhe teoritë filozofike në kontekstet e tyre historike, madje as në kuptimet dhe praktikatat e tyre moderne që kanë mangësi dhe deformime të shumta.

Nëse në realizëm e trajtojmë atë që mund të zbatohet praktikisht në realitet, atëherë në idealizëm janë objektivat që kërkojmë t'i realizojmë në atë realitet. Pra, veprimtaria pedagogjike lëviz nga realiteti faktik kah ideali i shënjuar, apo nga zbritja e idealit të synuar në realitetin faktik. Kështu ne posedojmë një imazh logjik për individin dhe shoqërinë që duam ta edukojmë, prandaj ky ideal (model) të cilin kërkojmë ta sistemojmë dhe t'i japim trajtë, realizohet me masë të caktuar në realitet, e cila mund të jetë tipike si ideali (modeli), të ketë diçka më shumë apo më pak.

Fjala مثال (model) në gjuhë do të thotë: "kallëpi me të cilin maten gjërat e njëjta", pra mithal është sasia dhe forma e një gjëse që përfaqëson vetitë e saja, kurse مثالي (shembullor) nënkupton përshkrimin e çdo gjëse që është e kompletuar në llojin e vet, si p.sh. moral shembullor, tablo shembullore. E shumësi i fjalës مثال është أمثلة apo مُثُل.<sup>567</sup>

Kur'ani fisnik fjalën مَثَل bashkë me përfitimet e saj e ka dhënë dhjetëra herë, dhe atë me trajtën e emrit, të foljes, në njëjës dhe në shumës. Ndër shembujt e përdorimit të kësaj

<sup>566</sup> Për të parë më hollësisht manifestimet e filozofisë realiste dhe idealiste në filozofinë e edukimit ka shumë burime, sa për shembull shih këtë: NelNoddings, *Philosophy of Education*, Fourth Edition, New York and London: Routledge, 2016, Chapter1, fq. 1-22.

<sup>567</sup> Mexhmeu 'l-lugat' il-arabijeh. El-Mu'xhemu 'l-vesitu, Kajro: Mektebet'ush-shuruk'id-duvelijeh, botimi IV, 2004, fq. 854. Shih: Ibn Mendhur, *Lisan'ul-arabi*, vep. e cit., vëllimi XI, fq. 610.

fjale është ajeti kur'anor: ﴿مَثَلُ الَّذِينَ يُنْفِقُونَ أَمْوَالِهِمْ﴾ **“Shembulli (methel) i atyre që shpenzojnë pasurinë e tyre...”**. [El-Bekare: 261]. ﴿ضَرَبَ اللَّهُ مَثَلًا﴾ **“Allahu ka sjellë shembull...”**. [En-Nahl: 75], ﴿وَيَضْرِبُ اللَّهُ الْأَمْثَالَ لِلنَّاسِ﴾ **“Allahu u sjell shembuj njerëzve”** [En-Nur: 35], ﴿لَيْسَ كَمِثْلِهِ شَيْءٌ﴾ **“Nuk ka (shembull) si Ai asgjë...”**. [Esh-Shura: 11]. Këto fjalë në Kur'anin fisnik, në përgjithësi tregojnë përngjasimin e një gjëse që duam ta sqarojmë me një gjë tjetër të njohur dhe të zakonshme për t'i përafëruar kuptimet. Të gjithë fjalorët arabë nuk kanë asnjë divergjencë në këtë çështje.

Dobia e përdorimit të fjalës مثل “shembull” apo ضرب الأمثال “sjellje e shembujve” është e qartë për lexuesin dhe për dëgjuesin. Zemahsheri në veprën “El-Keshshaf” ka thënë: “Sjellja e shembujve nga arabët, nga dijetarët dhe nga të ngjashmit është një çështje që kërkon të shfaqë kuptimet e fshehta dhe të ngre perdet nga të vërtetat, në mënyrë që e imagjinuara të shihet në formë të reales, e supozuara në formë të së bindshmes, e fshehta në formë të së dukshmes... Për arsye që vetëm Ai i di, Allahu në Librat e Vet (në Kur'an dhe në librat tjerë të shenjtë) ka sjellë shumë shembuj. Këto janë të përhapur edhe në fjalët e Muhammedit a.s., të pejgamberëve tjerë dhe të njerëzve të urtë. Allahu xh.sh. thotë: ﴿وَتِلْكَ الْأَمْثَالُ نَضْرِبُهَا لِلنَّاسِ وَمَا يَعْقِلُهَا إِلَّا الْعَالَمُونَ﴾ **“Ato janë shembuj që ua sjellim njerëzve, kurse ato i logjikojnë vetëm dijetarët.”** [El-Ankebut: 43]<sup>568</sup>

Meriton të thuhet se “shembujt” në Kur'anin fisnik shprehin kuptimet e ngjarjeve dhe të karaktereve në jetën e njerëzve, në ligjet e kozmosit dhe në shoqëri.

Ne këtu flasim për personalitetin shembullor (idealist) të burrit ose të gruas, prandaj i numërojmë veçoritë e studentit shembullor, të mësuesit shembullor dhe të shkollës shembullore, ku vetia e shëmbëllimit (idealizmit) përdoret si virtyt dhe lëvdatë. Zakonisht paraqitet si “shembull” që duhet marrë si model dhe duhet ndjekur. Sigurisht, ky

<sup>568</sup> Ebu 'l-Kasim Xharull-llah Mahmud bin Omer Ez-Zemahsheri (vd. 538 h.), *Tefsir'ul-keshshaf*, i botuar nën kujdesin e Halil Me'mun Shejha, botimi III, Bejrut, Dar'ul-Ma'rifeh, 2009, vëllimi I, fq. 50-51.

“shembull” nuk është një imazh imagjinar larg mundësisë reale për realizim, por është një imazh real, prandaj ne e kemi patjetër të ndajmë binomin realizëm-idealizëm në veprimtarinë pedagogjike, sidomos në vënien e objektivave të edukimit dhe në orientimin e praktikës pedagogjike. Kur vëmë objektiva të larta për shoqërinë të cilën duam ta edukojmë, atëherë pikturojmë një formë (imazh) të asaj shoqërie, bashkë me strategjitë, metodat dhe mjetet e domosdoshme për realizimin e këtij imazhi përmes projekteve afatshkurte, afatmesme dhe afatgjata. Këto projekte patjetër të jenë reale, pra nuk duhet të jenë hipotetike, imagjinare dhe me mundësi shumë të vogla realizimi.

Gjithashtu, e kemi detyrim të theksojmë edhe ndarjen e domosdoshme të binomit realizëm-idealizëm kur flasim për dimensionin filozofik të Greqisë së Lashtë, sepse janë transmetuar kuptime kundërthënëse në mendimin perëndimor mesjetar dhe modern. Termat “idealizëm” dhe “realizëm” në kulturën bashkëkohore ndonjëherë përdoren në formën që s’kanë asnjë lidhje me përdorimin gjuhësor të tyre në gjuhën arabe, madje as me përdorimin kur’anor, sepse me termin “idealizëm” mund të synohet mendimi i ngritur mbi aspirata, supozime dhe ëndrra që nuk mbështeten në mundësinë e realizimit të tyre në realitet. Po ashtu, realizmi mund të mbajë edhe kuptimin e pranimi të realitetit dhe dorëzim ndaj tij, pra si të jetë një përcaktim hyjnor i pakthyeshëm, ndërsa njerëzit vetëm duhet të ambientohen me këtë, nuk duhet të përpiqen të rregullojnë apo të ndryshojnë asgjë nga ky realitet. (Pra, këto janë disa kuptime të realizmit në Perëndim).

## 2. Disa reflektime të manifestime në mendimin pedagogjik islam

Koncepti i realizmit mbështetet në mendimin pedagogjik islam, sepse universi me të gjitha gjërat, ndodhitë dhe fenomenet, ku pjesë e tij është edhe njeriu, janë të vërteta

objektive dhe jo supozime fiktive, ide hipotetike apo modele abstrakte. Prandaj, kjo edukatë fillon bashkëveprimin me njeriun ashtu siç është në karakter, në forcë, në dobësi, në ndjenja, në emocione, në frikë dhe në shpresë, veçse ky edukim synon ta çojë njeriun nga realiteti faktik i tij drejt imazheve të mundshme të përsosmërisë njerëzore.

Ky realizëm është një pjesë nga veçoria e realizmit në dispozitat, legjislacionet dhe instruksionet islame. Besimi është real sepse bën lidhjen e njëshmërisë së Allahut të Lartësuar me Provat e tij që dëgjohen dhe shihen. Adhurimet janë reale në mundësinë e zbatimit të tyre pa vështirësi. Po ashtu, rregullat e marrëdhënieve mes njerëzve janë reale sepse përmbushin interesat e njerëzve dhe ia heqin qafe atyre të këqijat. Të gjitha legjitimitet në Islam janë të mbështetura në parimin e lehtësimit, të largimit të vështirësisë dhe të gradualitetit. Nuk ka asgjë të pamundur, sepse legjitimitet islame kujdesen për faktorët dhe nevojat e llojllojshme dhe e pranojnë dobësinë njerëzore. Doktrinat e besimit, dispozitat praktike dhe të gjitha instruksionet tjera islame janë elementi i parë në formimin e njeriut në shoqërinë muslimane, madje janë themel në programet e mësimin në të gjitha fazat e jetës së njeriut.

Përderisa mendimi pedagogjik islam synon edukimin e njeriut, atëherë ky mendim beson se njeriu nuk është melaqe, i cili nuk gabon në asnjë urdhër të Zotit apo të veprjës pa asnjë gabim. Po ashtu, ky mendim e pranon se njeriu nuk është as kafshë që nuk logjikon dhe as send i ngurtë që nuk ndjen. Shtazët dhe sendet nuk janë ngarkuar me amanet apo me përgjegjësi siç është ngarkuar njeriu, por u nënshtrohen ligjeve që Zoti i ka vënë në univers dhe të gjitha i nënshtrohen njeriut, të cilat pastaj ai i vë në funksion të jetës së vet.

Allahu e ka nënshtuar Tokën për njeriun ﴿الَّذِي جَعَلَ لَكُمُ الْأَرْضَ﴾ ﴿فِرَاشًا﴾ "I Cili e bëri tokën për ju shtrat" [El-Bekare: 22], prandaj e ka shtruar dhe e ka nënshtuar për të ecur në të ﴿قُلْ﴾ ﴿سِيرُوا فِي الْأَرْضِ﴾ "Thuaj: ecni në Tonë!" [El-En'am: 11]. Gjithashtu,

e ka bërë Tokën djep për fitimin e riskut ﴿هُوَ الَّذِي جَعَلَ لَكُمُ الْأَرْضَ ذَلُولًا﴾  
 ﴿فَامْشُوا فِي مَنَاكِبِهَا وَكُلُوا مِن رِّزْقِهِ وَإِلَيْهِ النُّشُورُ﴾  
 “Ai është që juve tokën ua bëri të përshtatshme, andaj, ecni nëpër pjesë të saj dhe shfrytëzoni begatitë e Tij, meqë vetëm tek Ai është e ardhmja.” [El-Mulk: 15] Edhe kafshët e shtazët janë krijuar për njeriun, Allahu i Madhërishtëm thotë: ﴿وَالْأَنْعَامَ خَلَقْنَا لَكُمْ فِيهَا دِفْءٌ وَمَنَافِعُ وَمِنْهَا تَأْكُلُونَ \* وَلَكُمْ فِيهَا جَمَالٌ حِينَ تُرِيحُونَ وَحِينَ تَسْرَحُونَ \* وَتَحْمِلُ أَثْقَالَكُمْ إِلَىٰ بَلَدٍ لَّمْ تَكُونُوا بِالْغَيْبِ إِلَّا بِشِقِّ الْأَنْفُسِ إِنَّ رَبَّكُمْ لَرءُوفٌ رَّحِيمٌ \* وَالْخَيْلَ وَالْبِغَالَ وَالْحَمِيرَ لِتَرْكَبُوهَا وَزِينَةً وَيَخْلُقُ مَا لَا تَعْلَمُونَ﴾  
 “Edhe bagëtitë Ai i krijoi. Ka në to ngrohje,<sup>569</sup> përfitim dhe ushqeheni prej tyre. Është bukuri kur i vathoni dhe i lëshoni për kullotë. Ato bartin barrën tuaj atje ku do t’ia dilnit me shumë mundim. Vërtet, Zoti juaj është i Dhembshur, Mëshirëplotë.<sup>570</sup> Edhe kuajt, mushkat e gomarët, i krijoi për t’u hipur dhe si stoli. Ai krijon edhe çfarë ju nuk dini.” [En-Nahl: 5-8].

Për këtë arsye, mendimi pedagogjik islam e trajton njeriun ashtu siç është i përbërë: trup, arsye dhe shpirt, ku secili element kërkon kujdes të veçantë. Po ashtu, ky mendim i merr në konsideratë edhe emocionet, ndjenjat shpirtërore dhe kërkesat e tyre. Nuk e trajton në atë mënyrë që të mos ia njohë ndonjë pjesë të karakterit apo përbërjes së tij reale. Përderisa kjo edukatë refuzon që njeriu të trajnohet fizikisht dhe mendërisht vetëm për qëllime apo funksione të kësaj bote, njësoj refuzon që ai të shihet vetëm si qenie shpirtërore e përsosur.

Ky realizëm mbështetet në mendimin që buron nga Kur’ani dhe suneti, gjegjësisht në formën shembullore që ndërtojnë këto parime themelore, por sigurisht që kufizohen në varësi të mundësive të njerëzve për t’i aplikuar praktikisht ato. Pra, ky mendim i drejtohet realitetit, problemeve reale dhe nevojave shpirtërore, logjike dhe praktike që i përjeton shoqëria. Këto situata dhe nevoja nuk duhet t’i kalojnë mundësitë njerëzore, por duhet të bien brenda kërkesave faktike të realitetit njerëzor dhe të mos kenë probleme në

<sup>569</sup> Veshmbathje prej leshit të tyre.

<sup>570</sup> Që edhe ne të jemi të dhembshur e të mëshirshëm me kafshët e ngarkesës.

aplikim, atëherë është e lehtë spikatja e rezultateve të tyre, vlerësimi i shkallës së zbatimit dhe i krahasimit.

Realizmi, thënë thjesht, mund të zbatohet në realitet pa vështirësi dhe mund të madh. Pra, është e kundërta e imazhit ideal utopik i cili vështirë se përmbushet. Çështja reale nuk është ideale deri në atë nivel sa të kalon mundësitë e njeriut për ta realizuar. Po ashtu, nuk është as e vështirë për t'u realizuar, apo të jetë shumë e vështirë për zbatim. Kjo nuk do të thotë se çështja ideal duhet të përshtatet tërësisht me vendin, me vendin dhe me realitetin e shoqërisë, apo të përputhet tërësisht me imazhin aktual të shoqërisë. Mirëpo, e trajton realitetin për ta ngritur atë në një model më të mirë, pra në modelin që Allahu i Lartësuar e do për njerëzit, apo të jetë në shkallë më të lartë të mundshme.

Veçori e realizmit në mendimin pedagogjik islam është se lidhet me realizmin e mesazhit hyjnor në përgjithësi. Meqenëse Muhammedi a.s. u dërgua që mbarë njerëzimit t'ua mësojë Librin dhe urtësinë, dhe t'ua mësojë atë që s'e dinin për çështjet e ndryshme të jetës, atëherë edhe arsimit nuk është gjë tjetër veçse thënie (fjalë) që u drejtohen njerëzve për t'i mësuar dhe të veprojnë sipas tyre, kuptohet ato përshkruajnë jetën e plotë në realitetin e njerëzve. Për këtë arsye, Muhammedi a.s. nuk ishte "i dërguar mbret", siç dëshironin disa jobesimtarë, por ishte "i dërguar njeri" i cili bashkëjetonte me problemet e jetës njësoj si njerëzit tjerë: hante, pinte, flinte, zgjohej, përjetonte fukarallëk dhe zenginllëk, lehtësi dhe vështirësi, vdekje dhe jetë, fuqi dhe dobësi, dashuri dhe urrejtje, shpresë dhe frikë, qëndrueshmëri dhe luhatje. Po ashtu, e hetonte të mirën dhe të keqen, ndikimin dhe influencën etj. Të gjitha këto janë manifestime të realitetit të jetës njerëzore. Sistemi edukativ që mëton të zbatohet në shoqërinë islame është sistem edukativ real që vepron brenda kufijve të mundësive dhe potencialeve reale të njeriut, të cilat ia lejon natyrshmëria njerëzore (fitreja). Nuk kërkohet nga njeriu ajo që s'është në mundësinë dhe në formimin e tij natyror të krijuar nga Allahu i Lartësuar.

Veçori tjetër e realizmit është se lidhet me realitetin. Kuptimi i realitetit është një çështje themelore në sqarimin e dispozitave të sheriatit për problemet që lidhen me realitetin. Iman Ibn Kajjimi ka potencuar dy lloje të kuptimit, prandaj ka thënë: “Myftiu dhe sundimtari nuk mund të sjellin një fetva apo dispozitë të drejtë pa i kuptuar dy gjëra:

I pari është kuptimi i realitetit, shoshitja e hollësishme e tij duke formuar një shkencë e cila realisht do t’i kuptojë të gjitha elementet shoqëruese dhe shenjat që e rrethojnë atë problematikë.

I dyti është kuptimi i detyrimit në realitetit, pra kuptimi i dispozitës së Allahut të Lartësuar për këtë realitet, i sjellë në Kur’an dhe në sunet. Pastaj këto dy kuptime zbatohen njëri pas tjetrit. Kush kontribuon dhe jep gjithë mundin për këto kuptime, atëherë nuk do të privohet nga njëri apo të dy shpërblimet. Dijetari është ai që arrin ta njohë realitetin dhe ta kuptojë mirëfilli atë duke iu referuar gjykimit të Zotit dhe të Pejgamberit a.s..”<sup>571</sup>

### 3. Realizmi në ndërtimin e një mendimi pedagogjik islam-bashkëkohor

Mendimi pedagogjik, te çdo popull ndërtohet mbi mundësinë e ndryshimit të realitetit faktik në një realitet tjetër me përshkrime të ndryshme. Ligj i Zotit në jetën e njeriut është se ata nuk qëndrojnë statikë në një gjendje të vetme. Individit ndryshon në varësi të fazave të jetës, po ashtu, edhe gjeneratat përjetojnë rrethana të ndryshme nga gjeneratat pararendëse. Gjithashtu, gjeneratat gëzojnë mjete dhe kushte që s’i kanë gëzuar pararendësit, madje edhe besimi shtohet dhe pakësohet. Ndryshimi është një proces natyror dhe njerëzor i vënë në natyrën (fitren) e universit, prandaj ligji i Zotit funksionon në varësi të shkaqeve. Nëse njerëzit janë në një gjendje të mirë apo të keqe, Allahu nuk do t’ua ndryshojë gjendjen e tyre pa e ndryshuar ata vetë atë.

<sup>571</sup> Ibn Kajjimi El-Xhevzj, *I’lam’ul-muvekki’ine an Rabb’il-alemine*, vep. e cit., vëllimi I, fq. 165.

Allahu xh.sh. thotë: ﴿إِنَّ اللَّهَ لَا يُغَيِّرُ مَا بِقَوْمٍ حَتَّىٰ يُغَيِّرُوا مَا بِأَنْفُسِهِمْ﴾ **“Vërtet Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli pa e ndryshuar ata veten e tyre.”** [Er-Rra’d: 11] Pejgamberi a.s. ka paralajmëruar ndryshimin që do t’i ndodhë njerëzimit pas tij dhe i ka udhëzuar muslimanët se si të veprojnë, prandaj u ka thënë: “Kush do të jetë gjallë prej jush, do të shohë shumë mospajtime, kurse ju kapuni për traditën time dhe për traditën e halifëve të drejtë dhe të udhëzuar!”<sup>572</sup>

Kur flasim për realizmin si veçori e mendimit pedagogjik islam, na duhet të pohojmë se realizëm nuk nënkupton gjunjëzim para realitetit faktik apo para devijimeve nga forma ideale të cilën e kërkon Allahu i Lartësuar nga besimtarët që ta zbatojnë dhe të vazhdojnë të ngrihen drejt saj. Realizmi, sipas mendimit pedagogjik islam, mbështetet në formën standarde në të cilën duhet të orientohen përpjekjet e veprimtarisë edukative dhe të cilat janë të skicuara nga legjislatura islame për jetën e njeriut. Ai që i ka vënë këto norma legjislative është Krijuesi i Cili e di më mirë se çdokush se çfarë është më e dobishme dhe më e rëndësishme për njeriun. Askush nuk mund ta mohojë thënien se normat legjislative të vendosura nga Krijuesi për njeriun janë modeli shembullor të cilin mund ta arrijë njeriu dhe ku ai mund të ngrihet, sepse Allahu nuk kërkon prej tij diçka jashtë mundësive, por atë që e kërkon është e ngulitur në natyrën dhe karakterin e tij. Prandaj, si rezultat i kësaj që u tha, askush s’mund ta mohojë as pretendimin se ligjet e sheriatit janë reale.

Realizmi me këtë kuptim nuk bie ndesh me idealizmin, por është një formë e harmonizimit me ligjet hyjnore në jetën e njeriut dhe me dukuritë e botës natyrore, sociale dhe shpirtërore, pra me të vërtetat reale dhe jo me supozimet e paarsyeshme. Për këtë arsye na rehatohemi me thënien se “realizmi me këtë kuptim nuk është antipod e tendencës së ekuilibruar idealiste, e cila është ndërtuar mbi parimin e

<sup>572</sup> Ebu Davud, *Sunenu Ebi Davud*, vep. e cit., Kitab: “Es-Sunneh”, bab: “fi luzumi es-sunneh”, hadithi numër: 4607, fq. 504.

- Et-Tirmidhij, *Xhami’ut-Tirmidhij*, vep. e cit., Kitab: “El-Ilmu”, bab: “Ma xhae fi ‘l-ahdhi bi ‘s-sunneti ve ixhtinab’il-bidei”, hadithi numër: 2676, fq. 433.



fitres (natyrshmërisë) që kërkon të ngrihet dhe synon shembullin ideal. Pra, këtë e quajnë realizëm idealist apo idealizëm realist.”<sup>573</sup>

Nevoja për të pohuar rëndësinë e idealizmit në mendimin pedagogjik islam shtohet edhe më shumë në dritën reale bashkëkohore ku jetojnë shoqëritë tona në nivel lokal, rajonal apo global, ashtu që ndonjëherë vështirësohet përfytyrimi i çdo mundësie për ndryshimin e kësaj realiteti me mjetet e pasura në dispozicion, prandaj disa njerëz bëhen pesimistë dhe mendojnë se Zoti do të bëjë ndonjë mrekulli, jashtë ndërhyrjes njerëzore. Pavarësisht besimit absolut që kemi në fuqinë e Allahut për shkaktimin e mrekullive, ne jemi urdhëruar t’u përkushtohemi mjeteve dhe shkaqeve “reale” e të përshtatshme për të arritur objektivat e ndryshimit “real” që kërkojmë.

Realizmi në mendimin pedagogjik islam kërkon të kuptohet realiteti që bashkëvepron me këtë mendim, me efektet lëndore dhe kuptimore që veprojnë brenda tij, me imazhin e ri ku kërkon të mbërrijë realiteti faktik, me shanset e ofruara për arritjen e këtij ndryshimi dhe me pengesat që mund ta pengojnë atë. Realiteti edukativ që kërkojmë ta ndryshojmë nuk është një realitet i izoluar që mund të menaxhohet me lehtësi, por është pjesë e një realiteti shoqëror të caktuar që ka limitet e veta të veçanta. Pastaj kjo shoqëri është pjesë e realitetit të një shoqërie rajonale dhe ndërkombëtare.

Qartësia e objektivave që kërkon t’i zbatojë veprimtaria pedagogjike ndihmon në arritjen e gjendjes së balancuar psikike mes pesimizmit dhe optimizmit. Ndonjëherë njerëzit janë pesimistë si rezultat i gjendjes së keqe që kalon umeti apo si rezultat i vështirësisë së implementimit të modelit më të mirë edukativ për t’i trajtuar hallet e shoqërisë, kurse optimizmi është i lidhur ngushtë me vetëbesimin dhe krenarinë e përpjekjes këmbëngulëse në rrugën e suksesit. Nëse objektivat edukative paraqiten në formë realiste, atëherë ngjallen shpresat e nxënësve për mundësinë dhe

<sup>573</sup> Jusuf El-Karadavi, *El-Hasais’ul-ammetu li’l-islami*, Beirut: Muesseset’ur-Risaleh, bot. II, fq. 1983, fq. 158

forcohen stimuluesit e shtytësit për mundësinë e përmbushjes së këtyre objektivave.

Ashtu si realizmi i mendimit pedagogjik islam mishërohet në metodat arsimore dhe në objektivat pedagogjike, ashtu shfaqet edhe në elementët tjerë të programit pedagogjik, përfshirë këtu edhe përmbajtjen e lëndëve mësimore. Për shembull, tregimi mund të jetë pjesë e përmbajtjes apo metodë e paraqitjes së përmbajtjes. Disa tregime dhe romane flasin për legjenda apo gjëra të jashtëzakonshme, të cilat mbase janë atraktive dhe të dobishme në forcimin e të menduarit të nxënësve drejt një shembulli ideal, mirëpo ky atraktivitet dhe ky mendim do të jenë vetëm si një ëndërr e bukur, sepse së afërmi do të përplasen me jetën reale. Megjithatë, tregimet dhe romanet e shkruara nga Nexhib Kejlani dhe të ngjashmit do të jenë një materie edukative e dobishme. Në ato ka gjëra që kënaqin shpirtin, ringjallin ndërgjegjen dhe, në të njëjtën kohë, flasin për ngjarje dhe ndodhi të vërteta apo që mund të ndodhin prej së vërteti.<sup>574</sup>

Përdorimi i tregimeve dhe i romaneve të këtyre është një metodë edukative e përshtatshme, sepse e sintetizon atë që mund ta quajmë realizëm islam, i cili ndërtohet mbi mundësitë reale të njeriut, apo mund ta quajmë edhe idealizëm islam përmes së cilit arrihet një nivel i lartë i përsosmërisë njerëzore, kuptohet kur ai ngrihet shpirtërisht, moralisht dhe e mbush jetën me punë të mira dhe të dobishme për njerëzit.

Në edukimin e fëmijëve idealizëm konsiderohet edhe trajnimi i tyre gradual për kryerjen e veprave që përshtaten me moshën e tyre. Themel i këtij edukimi është butësia, nxitja, stimulimi, vendosmëria dhe nevoja në raste të përshtatshme.

Gjithashtu, pjesë e realizmit është prania e nxënësve me veçori të ndryshme. Objektivat pedagogjike nuk mund të realizohen njësoj te të gjithë. Ky nuk është kusht në çdo

<sup>574</sup> Romanet e Nexhib Kejlani janë të llojllojshëm, të cilat përmbajnë edhe ndodhi nga historia e vjetër islame, si p.sh.: *"Umeru jedheru fi 'l-kudsi"*, nga historia moderne në çdo skaj të botës islame, si p.sh. *"Amalikat'ush-shimal"*, në Indonezi si p.sh.: *"Adhrau Xhakarta"*, në Kinë islamike si p.sh.: *"Lejali Turkistan"*, *"Hajat'ul-elemi ve'l-emeli"*, *"Fi'l-Kura ve'l-erjaf"*, *"Meliket'ul-inebi"* dhe shumë romane të tjera.

veprimtari edukative. Përgatitjet dhe mundësitë e ndryshme të nxënësve është pikërisht ajo që u përgjigjet nevojave të ndryshme të shoqërisë, qofshin ato profesione, specializime apo zanate. Madje edhe në fushën e adhurimit të Allahut gjenden robër të Allahut të Lartësuar që janë të zgjedhur. Pra, edhe këto grupe të njerëzve nuk janë të një niveli të përkushtimit. Allahu xh.sh. thotë: ﴿ثُمَّ أَوْرَثْنَا الْكِتَابَ الَّذِينَ اصْطَفَيْنَا مِنْ عِبَادِنَا فَمِنْهُمْ ظَالِمٌ لِنَفْسِهِ وَمِنْهُمْ مُقْتَصِدٌ وَمِنْهُمْ سَابِقٌ بِالْخَيْرَاتِ بإِذْنِ اللَّهِ ذَلِكَ هُوَ الْفَضْلُ الْكَبِيرُ﴾

**“Pastaj Ne u lamë në trashëgim librin robërve Tanë që Ne i kemi zgjedhur; e prej tyre ka që janë dëmtues të vetvetes, ka që janë mesatarë, e ka prej tyre që janë me ndihmën e Allahut, të parët në punë të mira, kjo është ajo mirësia e madhe.”** [Fatir: 32]

## Pjesa e tretë:

# Kapaciteti dhe shtrirjet e mendimit pedagogjik islam

### 1. Shtrirjet e mendimit pedagogjik islam në tematika: kapacitet dhe integrim

Mendimi pedagogjik islam i përfshin të gjitha tematikat që synojnë formësimin e personalitetit të individit, ndërtimin e shoqërisë, mësimin e shkencave, profesioneve dhe zanateve të ndryshme. Po ashtu, kjo shkencë përfshin zhvillimin dhe trajnimin e njeriut në institucione, si p.sh.: familja, shkolla, universiteti, media dhe në institucionet tjera. Mendimi pedagogjik islam nuk cilësohet si i dalluar derisa në fitimin e njohurive të integrohen dy burime: shpallja dhe bota. Instruksionet e shpalljes hyjnore dhe të traditës pejgamberike nuk përqendrohen vetëm në ndërtimin e sjelljeve të njeriut me Zotin, me veten dhe me të tjerët, por ato plotësohen duke e drejtuar njeriun që të ecë drejt në Tokë, t'i shohë gjërat, ngjarjet dhe dukuritë e saj në sferën natyrore, sociale dhe shpirtërore, të zbulojë ligjet që i dirigjojnë këto procese dhe t'i vë në funksion të zbatimit të detyrës së mëkëmbjes dhe të ndërtimit të jetës në këtë botë.

Mendimi pedagogjik islam bashkëkohor e ka patjetër të zgjerohet për t'i njohur zhvillimet që kanë ndodhur në historinë e shkencave. Gjithashtu, në programet dhe në metodat e veta i përfshin edhe degëzimet e reja shkencore, prandaj këto programe dhe metoda mund të lejojnë formimin e disiplinave të reja shkencore. Meqenëse trashëgimia islame e njeh profesionalizmin në sfera shkencore të ndryshme (fikh, hadith, tefsir, histori, mjekësi, matematikë etj.), atëherë kjo trashëgimi dëshmon se ka pasur edhe të atillë që kanë pasur më shumë se një profesionalizëm, dhe atë si në shkencat

shariatike, shariatike-gjuhësore, shariatike-filozofike, shariatike-empirike etj.<sup>575</sup>

Përderisa ky gërshetim është shumë i vështirë te shumica e njerëzve sot, sepse shkencat janë zhvilluar në sfera të ndryshme, përsëri kjo nuk pengon realizimin e saj te një pakicë e dijetarëve. Kjo mundësi gërshetimi nuk nënkupton që dijetari të jetë profesionist në dy fusha apo më shumë në nivel të njëjtë të profesionalizmit, por njohja mund të jetë e mjaftueshme në një specializim dytësor sa për të ndihmuar specializimin kryesor. Ndoshta duhet të sigurohet një nivel i dijes në disa tematika për të mësuar temën kryesore të një specializimi.

Shkencat bashkëkohore sot kanë degëzime të reja që nuk sillen rreth një boshti profesional, por në disa profesione apo gërshetohen në të disa profesione.<sup>576</sup> Kjo është një dukuri dalluese e zhvillimit të shkencave, e cila përfaqëson atë që përgatitet në historinë e shkencave, gjegjësisht etapën e postprofesionalizmit. Dihet se shkencat në fillim patën një zhvillim të kufizuar, prandaj ishte e lehtë të mësohen tematikat e asaj shkence me të gjitha hollësitë e ndryshme, madje edhe një numër i shkencave tjera në të njëjtën kohë. Kjo ndodhi edhe me shkencat islame, pra ishte i lehtë mësimi i tyre dhe kishte shumë eruditë. Dijetarët e sahabëve dhe të tabiinëve, për shembull, njëri prej tyre ishte muhadith, fekih, gjeneolog, komentues, gjuhëtar etj., bile raste kur ishte fekih dhe mjek ose filozof e mjek dhe të tjera kombinime.

Mirëpo, zhvillimi në shkencat pas periudhës së tabiinëve filloi të njohë profesionalizmin individual. Kjo çështje ndodhi edhe me çdo shkencë tjetër në Evropë, si me urtësinë dhe me filozofinë. Pra, zhvillimi i shkencave rezultoi me një zgjerim të madh në secilën prej tyre, sa që u ndanë shkencat sociale nga shkencat natyrore. Pastaj, u ndanë shkencat sociale në degë shkencore profesionale, si p.sh.: sociologjia, ekonomia,

<sup>575</sup> Avvad El-Halef - Kasim Ali Sa'd, *El-Xhamiune bejne 'l-ulum'ish-sherijjeti ve 'l-ulum'it-texhribijeh*, Silsilat' uth-thekafet'il-islamijeh, Dubai, Khaizetu Dubai 'd-Duvelijjeti li 'l-Kur'an'il-Kerimi, botimi I, 2015.

<sup>576</sup> Studimet e ndërmjetme njohin shumë forma, ku secila formë ka termin e vet dallues, si fq.sh. shkencat interdisciplinare, shkencat ndërdisiplinare, shkencat multidisciplinare dhe të tjera.

psikologjia dhe të tjera. Filozofia më nuk mbeti ombrellë e të gjitha shkencave, por u bë disiplinë shkencore e pavarur.<sup>577</sup>

Siç e pamë rolin e integritit dhe kapacitetit në dy burimet e njohjes së shkencave njerëzore, po ashtu e shohim rolin e tyre (të integritit dhe kapacitetit) edhe në dy mjetet e fitimit të dijes, pra në arsye dhe në shqisë. Instruksionet e shpalljes hyjnore dhe të traditës pejgamberike mishërohen në mjetet e vetëdijesimit dhe të perceptimit të njeriut, dhe në domosdoshmërinë e përdorimit të këtyre mjeteve në rezonim, mendim dhe meditim nga njëra anë, dhe në vështrim, eksperimentim, krahasim dhe provim shqisor në anën tjetër.

Shkencat dhe njohuritë e fituara nga dy burimet e tyre përmes dy mjeteve do të jenë gjithëpërfshirëse për shkencat e sheriatit, të natyrës, të shpirtit, të mjekësisë, të matematikës, të astronomisë, të historisë, të ekonomisë dhe të shkencave tjera. Përderisa instruksionet e shpalljes janë burim i udhëzimit të përgjithshëm për njeriun në jetë, atëherë ato janë edhe udhëzim për të gjitha këto shkenca. Vërejmë se kapaciteti dhe integrimi njohës në mendimin pedagogjik islam synon fitimin e këtyre shkencave dhe funksionalizimin e tyre kur kuptojmë se ato ngrihen mbi tri vlera të larta: vlera e parë është tevhidi (njëshmëria) e cila karakterizohet me marrëdhënien e njeriut me Allahun e Lartësuar, bashkë me orientimin kah Zoti përmes adhurimeve rituale dhe ndërnjerëzore. Vlera e dytë është tezkija (pastrimi shpirtëror) i cili karakterizohet me pastrimin e ndjenjave, sjelljeve, raporteve dhe gjithçka posedon njeriu si individ dhe si shoqëri. Vlera e tretë është ndërtimi i jetës (imran) i cili karakterizohet me aspektin kuptimor të jetës njerëzore dhe rregullimin e saj me drejtësi, me solidaritet, me konsultim dhe me aspektin material duke ndërtuar mekanizmat e qytetërimit dhe të kulturës, zhvillimin e mjeteve të komunikimit dhe të shumë gjërave të tjera që i lehtësojnë

<sup>577</sup> Për të mësuar më shumë për fenomenin e shkencave interdisiplinare dhe manifestimet e tyre bashkëkohore, mund të ktheheni në librat profesionalë, si p.sh.:

- Rober Grodeman & Julie Thompson & Roberto Pacheco (Editorë), *The Oxford Handbook of Interdisciplinarity (Oxford Handbooks)*, London: Oxford University Press, 2 edition, (March 26, 2017).

shkaqet e jetës së individit, të shoqërisë, të umetit dhe të mbarë njerëzisë.

Në hollësitë e kapacitetit të mendimit pedagogjik islam, i cili kërkon fitimin dhe ushtrimin e këtyre shkencave, do të shohim se si disa prej tyre konsiderohet farzi ajn (detyrime individuale), si p.sh.: doktrinat e besimit, adhurimet, marrëdhëniet dhe morali, kurse disa konsiderohen farzi kifaje (detyrime kolektive), si p.sh. sigurimi i aftësive dhe i eksperiencave në sfera të ndryshme të zhvillimit ekonomik, ambientor, politik dhe social.

Kapacitetin dhe integrimin në mendimin pedagogjik islam do ta gjejmë kur të vështrojnë në sferat që gërshetojnë disa lloje të edukimit që i tejkalojnë metodat e zakonshme në shkolla dhe universitete, si p.sh. tematikat profesionale të shkencave, këshillat nëpër xhami, mësimet e arsimit “fetar” etj. Në mesin e këtyre, sa për shembull, i sjellim këto lloje edukimi:

- Edukimi shpirtëror dhe pastërtia e ndërgjegjes, e aspiratave dhe e ambicieve të individit musliman, në mënyrë që t'i kapërcejë faktorët e mundshëm të mërziisë dhe të pesimizmit. Kështu ai ngrihet në punë të larta dhe i trason pejgamberët, dijetarët, reformatorët dhe kreatorët me moral të lartë shpirtëror.

- Edukimi etik dhe bihaviorist në qarqet e sferës sociale, gjegjësisht me familjarët, me të afërmit, me fqinjët dhe me bashkëpunëtorët. Po ashtu, këtu kërkohet butësia e ndërsjellë, bashkëpunimi, ortakëria dhe angazhimi për përmirësim, për zhvillim dhe për këmbim të eksperiencave.

- Edukimi profesional dhe zejtar, i cili kërkon profesionalizëm, zotërim të mirë dhe zhvillim të domosdoshëm për t'i përmbushur kërkesat e shoqërisë njerëzore, për jetë të përbashkët, për zgjidhje të problemeve dhe për prodhim më të mirë, më të bollshëm dhe me lloje të ndryshme.

- Edukimi prindëror dhe krejt ajo që hyn në pajisjen e të rinjve në fillim të jetës së tyre para martesë, gjegjësisht përvetësimi i mënyrave të trajtimit mes bashkëshortëve: të

drejtat, obligimet dhe krejt ajo që hyn në edukimin dhe zhvillimin e fëmijës në fazat e ndryshme të jetës. Po ashtu, përfshihen shëndeti dhe sëmundja, kujdesi për pleqtë, për personat me nevoja të veçanta dhe për krejt atë që duhet në përkrahjen e programeve të arsimit shkollor dhe universitar. Pastaj kurset e veçanta në çdo çështje të theksuar.

- Edukimi ndërkombëtar dhe universal për t'i zgjeruar horizontet dhe njohuritë e muslimanit në fushën e sistemeve dhe të traditave botërore. Po ashtu, edhe me ndodhitë dhe me problematikat interesante. Mëson se si ta vështrojë gjithë këtë, si ta kuptojë, si të krijojë vetëdijen e përgjegjësisë në manifestimin e Islamit me parimet dhe me etikën e tij përmes raportit të tij me gjithë ata që ndërlidhen me të në një mënyrë.

- Edukimi mediatik në përdorimin e mjeteve mediatike në formë të përshtatshme, duke i vënë këto në shërbim të çdo muslimani dhe duke i bërë funksionale në paraqitjen e fjalës së mirë, të modelit shembullor, të lajmit të dobishëm dhe, në të njëjtën kohë, duke e shmangur gënjeshtren dhe përhapjen e së keqes. Nuk do të publikojë asgjë pa e vërtetuar dhe pa e konfirmuar vërtetësinë dhe dobinë e saj.

- Edukimi turistik. Në disa raste përhapen ndjenja negative të gabuara për lirinë e individit, që ai të vizitojë vendet që ia do qejfi dhe ku atë nuk e njeh askush. Mirëpo, udhëtimi në botën bashkëkohore është lehtësuar pa masë, prandaj është bërë shumë i kollajshëm dallimi i udhëtarit për nga gjuha, veshja dhe sjelljet. Për këtë arsye, edukimi turistik është bërë nevojë për vetëdijesimin e muslimanit, sepse ai (muslimani) duhet t'i zbatojë direktivat e fesë në mënyrë që të jetë model i përkryer për njerëzit kushdo qofshin ata, dhe atë jo vetëm me sjelljet dhe moralin e tij personal, por edhe në zbatimin e ligjeve qytetare dhe traditave sociale të cilat japin një përshtypje të keqe për atë që nuk i zbaton.

## 2. Shtrirja e mendimit pedagogjik islam në kohë

Mendimi pedagogjik lidhet me kohën, me vendin dhe me njeriun. Ndërlidhja me kohën nuk nënkupton fokusimin



vetëm në kohën e tashme, pra një sënduk i mbyllur, por detyrimisht nënkupton shtrirjen e kësaj të tashme në të shkuarën dhe në të ardhmen. Për të kaluarën e mendimit pedagogjik islam bëme fjalë kur e trajtuam tematikën e trashëgimisë islame në kapitullin e dytë të këtij libri. Kjo trashëgimi është memoria historike për eksperiencën edukative dhe arsimore, por pa qenë mendimi ynë bashkëkohor i mbyllur dhe i ngujuar në këtë eksperiencë. Kjo nënkupton që trashëgimia pedagogjike e umetit duhet të jetë objekt i analizës kritike, në mënyrë që të dallohet se çfarë mund të përfitohet dhe çfarë duhet të kalohet e që është e lidhur me rrethanat e kohës, të vendit dhe me mundësitë që i ofron ajo periudhë kohore?

Trashëgimia edukative në vetëdijen islame është ajo që kanë shkruar dhe kanë vepruar dijetarët në sferën e arsimit në xhami, mexhlise, shkolla dhe në institucione të tjera. Trashëgimi është edhe ajo që lidhet me kuptimin e ngjarjeve historike, qofshin ato ngjarje të shënuara në tregimet kur'anore për pejgamberët apo popujt e mëparshëm, apo ngjarje narrative të thëna nëpër librat e historisë.

Patjetër duhet të kuptohet arsyeja përse Allahu xh.sh. ka bërë që Kur'ani fisnik të përmbajë gjithë atë numër të madh të ndodhive dhe të tregimeve historike nga e kaluara. "Hapësira që ka zënë tregimi kur'anor në Librin e Allahut është e gjerë. Nuk mendojmë se ndonjë tematikë tjetër ka zënë vendin që ka tregimi. Hapësira që kanë zënë tregimet kur'anore në Kur'an nuk është më pak se çereku i tërësisë, në mos qoftë pak më shumë... Tregimi kur'anor synon të edukojë gjininë njerëzore me edukatën më të mirë dhe ta mbrojë atë nga të gjitha rrëshqitjet dhe rreziqet e mundshme."<sup>578</sup> Këto tregime nuk janë thjesht informime për popujt e mëhershëm, por janë funksionalizim dhe lidhje e tyre edhe me realitetin dhe me ardhmërinë e umetit islam. Prandaj, "tregimet e Kur'anit nuk synojnë vetëm t'i përmendin të parë dhe kaq, por çdo tregim përmendet për

<sup>578</sup> Abbas, *Kisas 'ul-Kur'an'il-kerimi*, vep. e cit., fq. 12.

shkak të një skene të ngjashme që përjeton umeti sot apo në të ardhmen.”<sup>579</sup>

Në tregimet kur'anore ka ngjarje, ndodhi dhe fakte nga jeta. Po ashtu, përmenden emra njerëzish dhe shtëpi, në të cilat sqarohen ligjet e Allahut të Lartësuar në raport me popujt, me faktet sociale, me karakterin e njeriut, gatishmërinë e tij logjike dhe shpirtërore për t'u udhëzuar dhe për të devijuar. Në ato sqarohen gjërat e përbashkëta të mesazheve të Allahut për të gjithë popujt dhe gjithçka lidhet me bazat e këtyre mesazheve hyjnore, si p.sh.: tevhidi (njëshmëria), pejgamberia, bota tjetër dhe gjithçka konfirmon mëshirën dhe drejtësinë e Zotit. Në krejt këtë ka hapësirë për mendim, meditim dhe për marrje mësimesh dhe nxjerrje urtësish. Allahu xh.sh. ka thënë: ﴿فَأَقْصِي الْقَصَصَ لَعَلَّهُمْ يَتَفَكَّرُونَ﴾ **“Rrëfe tregimet që të mendojnë!”** [El-A'raf: 176]. Po ashtu, thotë: ﴿لَقَدْ كَانَ فِي قَصَصِهِمْ عِبْرَةٌ لِّأُولِي الْأَلْبَابِ مَا كَانَ حَدِيثًا يُفْتَرَىٰ وَلَكِن تَصْدِيقَ الَّذِي بَيْنَ يَدَيْهِ﴾ **“Ne tregimet e tyre (të dërguarve dhe të Jusufit me vëllezër) pati mësim e përvojë për të zotët e mendjes. Ai (Kur'ani) nuk është bisedë e trilluar, por vërtetues i asaj që ishte më parë (librave të shenjta) dhe sqarues i çdo sendi, e edhe udhërrëfyes e mëshirë për një popull që beson.”** [Jusuf: 111]. ﴿نَحْنُ نَقُصُّ عَلَيْكَ﴾ **“Ne me të shpallur të këtij Kur'ani po të rrëfejme ty (Muhammed) me të bukurin rrëfim, edhe para tij ishe nga të painformuarit.”** [Jusuf: 3] ﴿كَذَلِكَ نَقُصُّ عَلَيْكَ مِنْ أَنْبَاءِ مَا قَدْ سَبَقَ وَقَدْ آتَيْنَاكَ مِنْ لَدُنَّا ذِكْرًا﴾ **“Po kështu, Ne të rrëfejme ty për disa nga ndodhitë që kanë kaluar më herët dhe nga ana jonë të dhamë ty shpalljen plot përkujtime.”** [Taha: 99] Mjafton të theksojmë udhëzimin e këtyre ajeteve për ndikimin e tregimeve në vetëdijesimin e njeriut, përkujtimin e tij dhe nxitjen e sjelljeve të mira. Po ashtu, po të vështrohen me vëmendje, do të shihet rëndësia e tregimit, sepse cilësohen si mjetet më të këndshme, më paralajmëruese dhe më edukative shpirtërisht. Tregimet

<sup>579</sup> Burhanuddin Ibrahim bin Omer bin Ibrahim Es-Suvejbenij El-Bikai, (vd. 885 h.), *Nadhm'ud-dureru fi tenasub'il-ajati ve's-suver*, Riad: Dar'ul-Kitab 'il-Islamijj, 1984, vëllimi I, fq. 390.

stimulojnë fuqinë ndikuese në zemra, në moral dhe në punë, pra, ndikimi i tyre krahasohet me ndikimin e metodave tjera edukative.

Në përgjithësi, tregimi ka specifika që e renditin ndër metodat më të rëndësishme të edukimit dhe të arsimimit të të gjithë popujve përgjatë gjithë historisë. Këtë vazhdojmë ta hasim në shkrimet moderne. Në një libër të botuar në 2019 me titull “El-Kuvvet’ul-mud’hixheh li rivajet’il-kisasi: el-kijadetu ve ‘t-tedrisu ve ‘t-teg’jiru bi tarikatin xhedidetin (Fuqia mahnitëse e tregimeve: udhëheqje, mësim dhe ndryshim me një metodë të re)” flitet për disa burime të cilat sqarojnë “se njerëzit i kujtojnë më mirë informacionet kur theksohen në formë të tregimeve sesa kur mësohen në formë të fakteve 22 herë.”<sup>580</sup>

Autori i këtij libri ka thënë: “Përgjatë historisë, mësuesit e mëdhenj kanë përdorur tregime, legjenda dhe shembuj, si p.sh. tregimi simbolik i Platonit për shpellën, tregimet e Kur’anit fisnik për pejgamberin Muhammed, tregimet e krijimit Vedas hinduese, shembujt e Mesihut, madje edhe romanet moderne të Hari Poterit... të gjitha janë tregime efektive dhe shumë influencuese. Ato mësojnë, bindin, ndërtojnë doktrina dhe rregulla të konvencionale. Shkaku i gjithë kësaj është se ato stimulojnë ndryshimet sentimentale të cilat i rritin ndjenjat emocionale, e ndërtojnë personalitetin që lidh lexuesin e tregimit me transmetuesin përmes përmbajtjes së paraqitur, i hapin dritaret para njohurive intuitave për masën e lexuesve dhe i vendosin në funksion resurset logjike të pavetëdijshme.”<sup>581</sup>

Lidhshmëria me kohën nënkupton atë që do të përthithë e tashmja nga perspektiva edukative, duke e cilësuar atë si rezultat që pretendon ky mendim. Kjo kërkon përcaktimin e karakteristikave të së ardhmes së synuar dhe projektimi i realizimit të saj. Është e natyrshme që veprimtaria pedagogjike të synojë kohën e ardhshme, por edukimi i gjeneratës aktuale të nxënësve dhe përgatitja e tyre duhet të

<sup>580</sup> Robert J. Garmston, *Astonishing Power of Storytelling: Leading, Teaching and Transforming in a New Way*. Thousand Oaks: Cal. Corwin and London: Sage Company, 2019, fq. 3-8.

<sup>581</sup> Po aty.

bëhet për jetën e tyre dhe të shoqërisë së tyre për kohën kur jetojnë.

Konsiderata ndaj realitetit faktik të kohës rrjedhëse, kuptimi i mirëfilltë dhe përlllogaritja e saj nuk nënkupton izolimin brenda kufijve të saj, por kjo është ndihmë dhe e lehtëson bashkëveprimin me të për ta ndryshuar atë, për t'i shpërbërë elementët dhe prangat e saj, e në fund do të mund të nis kah e ardhmja që synohet. Pa e kuptuar mjaftueshëm të tanishmen, vështirë se mund të përcaktohen karakteristikat e së ardhmes ku duhet lëvizur, veçanërisht kur dihet se përpjekja që kërkohet këtu nuk është vetëm për të përcaktuar se çfarë duhet të veprohet në të ardhmen, por duhet bërë përpjekje edhe për mjetet dhe metodat e domosdoshme me të cilat do të arrijmë te imazhi i shënjuar i së ardhmes.

Kuptimi i së tashmes ka nevojë për mjete kuptimore të sakta, si p.sh.: vështrim, numërim dhe shqyrtim, ashtu që të bëhet shkoqitje e hollësishme për pakicën dhe shumicën (e gjërave), për gjërat e njohura dhe të panjohura, për fenomenet dhe për ndodhitë. Sqarimet të bëhen me numra, me gjenealogji dhe me tabela sqaruese të të dhënave. Gjithashtu, të bëhet interpretim i shkaqeve dhe i faktorëve ndikues, bashkë me shkallën e ndikimit të secilës. Kërkohet përdorimi i metodave gjurmuese dhe i hulumtimit kualitativ për zbulimin e gjërave që nuk mund t'i zbulojnë metodat e hulumtimit kuantitativ me numra dhe me statistika. Po ashtu, duhet të përvetësohet mirë edhe përdorimi i metodave të hulumtimit shkencor. Mendimi pedagogjik bashkëkohor islam do të mbetet i mangët dhe jofunksional nëse nuk përvetësohet mirë përdorimi i metodave dhe i mjeteve për ta kuptuar të tashmen, për të bashkëvepruar me të dhe për ta parakuptuar progresin e saj.

E ardhmja, sipas vështrimit islam, është e hapur për jetën e njeriut dhe për atë që është provuar nga jeta e baballarëve dhe të gjyshërve. Pastaj, hyn në punë edhe ajo që përjetojnë fëmijët dhe nipërit. Përvojat e baballarëve dhe të gjyshërve, bashkë me mësimet dhe urtësitë që ngërthejnë këto përvoja, mund të jenë të dobishme për anëtarët e gjeneratës aktuale,

veçanërisht kur dihet se zhvillimi i individit në një familje është i shtrirë dhe ngërthen tri gjenerata apo më shumë, qofshin meshkuj apo femra. Pra, familja është një ambient edukativ i pasur që kontribuon në formimin social, psikik dhe emocional të personalitetit të individit. Ai që nuk e gëzon rritjen në këtë ambient, privohet prej saj.

Vetëdija edukative për rëndësinë e këtij ambienti kërkon zhvillimin e programeve orientuese të përshtatshme për të gjithë anëtarët e familjes, në mënyrë që të arrihet një investim edukativ i përshtatshëm dhe praktikat e individëve të mos bëhen spontanisht. Në mungesë të kësaj vetëdije dhe të këtij udhëzimi, problemi nuk kufizohet vetëm në humbjen e shanseve të mira edukative, por kjo mund të çojë në gabime shumë të mëdha. Programet e edukimit prindëror duhet ta përmbajnë edhe këtë tip vetëdijesimi edukativ dhe ta përforcojnë atë.

Qenia e kohës edukuese e hapur ndaj jetës së individit na e kujton ligjërimin e Allahut të Lartësuar drejtuar Muhammedit a.s. ku e thërret ta shtojë diturinë. ﴿ فَتَعَالَى اللَّهُ الْمَلِكُ ﴾ **“I lartë është Allahu, Sundues i vërtetë. Ti mos nxito me Kur’anin para se të përfundojë shpallja e tij te ti, dhe thuaj: “Zoti im, më shto dituri!”** [Taha: 114] Ky peygamber ishte njeriu më i dijshtëm, megjithatë, Allahu e mësoi që të kërkojë shtimin e diturisë. Natyrisht se ai që kërkon dije duhet të ndjekë disa metoda. Meqenëse arsimimi dhe edukimi i fëmijës është përgjegjësi e familjes, kur ai rritet këtë përgjegjësi vazhdon ta mbajë vetë. Duket se dituria nuk ka kulm ku merr fund, madje asnjë tematikë. Po ashtu, edhe njeriu asnjëherë nuk duhet reshtur së mësuari. Studimet psikologjike që merren me trurin dhe me marrëdhënien e tij me kujtesën, me rezonimin dhe me të menduarit tregojnë se truri i njeriut evoluon vazhdimisht. Kur lexon një fjali të shkruar, kur dëgjon një fjali të artikuluar, kur sheh një shpend në qiell, kur mendon një mesele, kur i bie ndërmend diçka apo diçka tjetër, çdoherë është në zhvillim e sipër. Studiuesit e këtij hulumtimi japin një shembull për këtë, ku thonë: “Kur ti e

lexon këtë fjali (të porsashkruar) tani, truri yt veçse ka ndryshuar nga gjendja paraprake. Nëse të njëjtën fjali e lexon nesër, ti mund të spikatësh përgjithësisht se kur dhe ku e ke lexuar atë (dje). E nëse e lexon atë pas një jave, atëherë do të të kujtohet se e ke lexuar atë në një vend më vonë, kurse nëse e lexon të njëjtën fjali në vitin e ardhshëm, atëherë do të ndjesh se fjalia është paksa e zakonshme dhe e natyrshme në një farë mënyre.”<sup>582</sup>

Kërkimi për shtim të diturisë përfshin çdo individ në shoqëri. Kryerja e denjë e adhurimeve kërkon njohjen solide të dispozitave të tyre. Pastaj dija e denjë ka nevojë për mënyrat e veprimit me këto dispozita. Dija dhe mësimi i mirëfilltë është në çdo profesion, duke filluar me profesionin e mësimdhënies ku nuk mjafton vetëm përvoja personale e mësuesit, por duhet të mësohen bazat, rregullat dhe metodat e mësimdhënies. Në të njëjtën kohë ka nevojë për këmbim të përvojave mes mësuesve dhe për kërkim të eksperiencave nga profesionistëve. Mësuesi i cili nuk e kryen mirëfilli detyrën, mund të dëmtojë dhe të mos ketë dobi. Mjeku që nuk e ndjek zhvillimin e disiplinave dhe të metodave mjekësore, më shumë mund të dëmtojë sesa dobi. Ndërtimtari që nuk i zotëron parimet e ndërtimtarisë dhe nuk vazhdon të kalitë përvojën dhe shkathtësitë e tij, mund të shkaktojë rrënimin e ndërtesës me gjithë banorët brenda saj. Kjo vlen për çdo profesion të mundshëm, prandaj Allahu xh.sh. thotë: ﴿وَقُلْ رَبِّ زِدْنِي عِلْمًا﴾ **“Thuaj: o Zot, ma shto diturinë!”** [Taha: 114] Ky ligjërim i drejtohet shkencëtarit të çdo profesioni që ta zhvillojë dijen dhe t’i përvetësojë të gjitha aftësitë dhe shkathtësitë ndërlidhëse.

Kur flasim për hapësirën kohore ku vepron mendimi pedagogjik islam, nuk duhet të harrojmë se koha përfshin jetën e individit dhe të gjeneratave, derisa të mbërrijë fundi i kësaj bote. Një fjalë të cilën e mëson njeriu apo ia mëson atë dikujt në momentet e fundit të jetës së tij në këtë botë mund

<sup>582</sup> Joshua Eyer, *How Humans Learn: the Science and Stories behind Effective Colledge Teaching*, Teaching and learning in Higher Education, Morgantown, WVA: West Virginia University Press, October 2018, fq. 6-7.

të jetë shkak i rëndimit të veprave të mira në peshoren e tij Ditën e Kiametit.

### 3. Shtrirja e mendimit pedagogjik islam në hapësirë

Lidhshmëria e mendimit pedagogjik islam me hapësirën nënkupton kujdesin e ndërveprimit mes këtij realiteti në një shoqëri të caktuar me realitetin e shoqërive tjera. Sistemet pedagogjike në botën bashkëkohore i kalojnë kufijtë vendorë dhe kohorë, sepse këtë e imponojnë rrethanat e endjes mes shteteve, mundësitë e komunikimit, bartja e lehtë e ideve, kërkesat e bashkëveprimit vullnetar apo të imponuar dhe ndikimi i ndërsjellë mes tyre.

Megjithatë, objektivi që kërkohet në një vend, mund të mos vlejë në një vend tjetër me të njëjtën mënyrë, shpejtësi dhe shkallë. Kjo ndodh, jo vetëm për shkak të mossigurimit të mundësive për përmbushjen e objektivave në vende të ndryshme, por për arsye të përparësive të ndryshimit në këto vende.

Objektivat në mendimin pedagogjik, në shumicën e vendeve sot, fokusohen te qytetari i vendit të vet. Shumica e objektivave përcaktohen në varësi të qytetarit të mirë, kurse është shumë e mundshme që cilësimet e qytetarit të mirë të ndryshojnë nga njëri shtet në tjetrin, bile ndonjëherë nga njëri vend në tjetrin brenda të njëjtit shtet. Kështu ndonjëherë ndodh që cilësimet të jetë kundërthënëse.

Ne e mësuam se realizmi i mendimit pedagogjik islam nënkupton që edukimi të kryhet brenda rrethanave dhe mundësive, prandaj edukimi mund të zhvillohet në tendë në mes të shkretëtirës, nën hijen e një druri ose në një kështjellë madhështore. Mund të përdoren mjetet e mundshme, si: tabloja e metaltë, papirusi, penat me bojë të bëra në shtëpi nga studenti apo mësuesi, fletët e ndryshme moderne, ngjyrat, dërrasat e drunjtja dhe magnetike, projektorët dhe mjetet teknologjike të ndryshme. Mësimi mund të realizohet me prezencë dhe në distancë, dhe atë në shkretëtirë, në periferi, në fshat dhe në qytet. Esenca është që të nxiten të

gjithë për të ecur në rrugën e kërkimit të diturisë dhe të edukimit, madje qoftë kjo dije edhe në Kinë.<sup>583</sup>

Resurset e dijes dhe të edukimit ndryshojnë nga njëri vend në tjetrin. Një vend mund të ketë një dijetar të cilit i drejtohet ai që ka nevojë ta marrë atë lloj të dijes, apo një institucion edukativ siguron ambient shkencor dhe edukativ të dalluar, prandaj dynden drejt saj të gjithë ata që duan të përfitojnë nga eksperiencia e këtij ambienti, pra familjet i dërgojnë edhe fëmijët e tyre atje.

Shoqëria muslimane çdoherë ka nevojë për eksperiencia specifike që nuk i posedon, prandaj i dërgon fëmijët e tyre në vende ku ofrohen këto eksperiencia për t'i fituar ato. Po ashtu, ndër të tjerash fitojnë edhe shkathtësinë e gjuhëve të huaja të cilat i duhet shoqërisë islame. Çështjet e këtilla janë farzi kifaje, kurse për individët që janë zgjedhur për këtë detyrë janë farzi ajn. Kjo përgatitje shkencore dhe edukative mbase i shërben shoqërisë islame për përgatitjen e ambasadorëve, të thirrësve, të mësuesve dhe të tregtarëve nëpër vende të ndryshme.

Mendimi pedagogjik islam është ai të cilin e zhvillon shoqëria muslimane me arsimim dhe me edukim në sfera të ndryshme jetike, si p.sh. në sferën e industrisë, agronomisë, administratës, teknologjisë apo në sfera të tjera. Nuk është pranueshme që shoqëria islame të mbetet prapa të tjerëve në fushën e dijes të cilën Allahu i Lartësuar i ka dhuruar njeriut. Kur në një vend sigurohet urtësia dhe përvoja, shoqëria islame mund të kërkojë njerëz të cilët e ofrojnë këtë urtësi dhe përvojë apo mund të dërgojnë një grup të zgjedhur prej bijve të vet për ta përvetësuar këtë lloj të dijes. Gjithashtu, shoqëria islame duhet të mbajë dy rrugë paralelisht, pra të shkojë për të fituar aftësi të veçanta dhe të njëjtat t'i sjellë në shoqërinë e vet. Pra, urtësia është një gjë e humbur për individin dhe

<sup>583</sup> Thënia e njohur e transmetuar: "Kërkoni diturinë qoftë edhe në Kinë", është gjykuar nga ekspertët e hadithit si hadith i dobët. Megjithatë, kushdo ta ketë thënë, ka pasur për qëllim vërtetimin për domosdoshmërinë e kërkimit të dijes sado larg qoftë ajo, kurse Kinën e ka menduar si vendin më të largët në botë atëherë.



shoqërinë islame, prandaj kudo ta gjejnë, ata janë më me përparësi për atë.<sup>584</sup>

Në biografinë e Muhammedit a.s. shihet se si i Dërguari i ka vënë në funksion eksperiencat e sahabëve të cilët zotëronin ndonjë lloj të dijes që njihje nëpër vende të ndryshme të botës. Hapja e hendekut përreth Medinës u bë me konsultë të Selman Farisiut, i cili tha: “O i Dërguari i Allahut, ne në Persi, ku kishim frikë nga kuajt sulmues, hapnim hendekë rrethues. Çfarë mendon, të hapim edhe ne, o i Dërguari i Allahut?”<sup>585</sup> Në rrethimin e Taifit, Selmani tha: “O i Dërguari i Allahut, sikur të vendosnim katapulta mbi kështjellën e tyre?! Ne në Persi vendosim katapulta mbi kështjella dhe i godasnim armiqtë, por edhe na sulmojnë me katapulta.” Pejgamberi a.s. e urdhëroi, dhe ai ndërtoi një katapultë me dorën e vet dhe e varën mbi kështjellën e Taifit. Thuhet se katapultën e solli Jezid bin Zem’ah bashkë me dy improvizime kafshësh (luftarake). Disa thonë se e solli Tufejl bin Amr, disa Halid bin Seid, për të cilin thonë se kishte përgatitur dy mjete me lëkurë të lopëve ku hynin muslimanët përgjatë luftës.<sup>586</sup> Pa dyshim, kjo përvojë nuk është njohur më përpara në shoqërinë islame të hershme. Pejgamberi a.s. i ka nxitur muslimanët që të mësojnë gjithçka që i duhet shoqërisë islame: shkencat, industrinë dhe zanatet që gjenden në vendet tjera.

#### 4. Shtrirja e mendimit pedagogjik islam te çdo njeri

Mendimi pedagogjik islam e përfshin edhe njeriun si individ, si grup dhe si umet, prandaj duhet bashkëvepruar me të mbi bazën e natyrës që ia ka falur Allahu Fuqiptotë, e

<sup>584</sup> Ekzistojnë tekste të ndryshme për këtë shprehje: “Urtësia është gjë e humbur për besimtarin”. Kjo transmetohet në shumë hadithe, por hadithologët e kanë cilësuar si të dobët. Ne e kemi sjellë këtu kuptimin pa e mbështetur në ndonjë hadith pejgamberik, sepse në esencë kuptimi është i saktë. Kur besimtari sheh dobi në ndonjë fjalë, atëherë përipiqet ta mësojë atë pavarësisht se kush e thotë apo kush e vepron atë. E njëjta vlen edhe për shoqërinë islame.

<sup>585</sup> Ebu Abdullah Muhamed bin Omer bin Vakid El-Vakidij, (vd. 207 h.). *Kitabu el-Megazi*, i redaktuar nga Marseden Jons, Bejrut, Alemu el-Kutubi, vëllimi II, fq. 445

<sup>586</sup> Ibn Kethir, *El-Bidajetu ve'n-nihajeh*, vep. e cit., Gazvetu et-Taif, vëllimi IV, fq. 400, shih: El-Vakidij, *Kitabu el-megazi*, vep. e cit., vëllimi III, fq. 927

që është natyrë e përbërë nga shpirti dhe trupi. Njeriu e ka të ngulitur në vetvete ngritjen drejt virtyteve dhe degradimin kah punët e ulëta. Njeriu mund të jetë burrë dhe grua. Burri dhe gruaja disa gjëra i kanë të përbashkëta dhe disa të ndryshme. Njeriu për nga natyra është civilis (qytetar), i cili jeton brenda një shoqërie, prandaj Allahu i ka shpërndarë njerëzit në popuj dhe në fise. Mendimi pedagogjik islam është shtrirë për t'i marrë në konsideratë të gjitha këto.

Ky mendim pedagogjik përfshin edhe dimensionin njeri për të kaluar edukatën personale, rajonale, fetare dhe sektare, që pastaj të përfshijë gjithë korpusin njerëzor si në sasi, ashtu edhe në lloj. Këtu përfshihen të gjitha grupet e njerëzve: të afërmit dhe të largët, të brendshmit dhe të jashtmit, miqtë dhe armiqtë.

Kjo nënkupton se duhet marrë në konsideratë edhe fakti se mendimi pedagogjik me të cilin karakterizohen nënat sot, ndoshta nesër mund të përcaktojë realitetin edukativ të fëmijëve. Mendimi pedagogjik për një grup të fëmijëve sot, sidomos për vajzat, mund të përcaktojë gjendjen edukative të të rriturve pas disa viteve. Ky mendim bashkëvepron me nxënësit sipas përgjegjësisë që bart secili prej tyre. Njerëzit gëzojnë aftësi dhe përgatitje të ndryshme, prandaj mendimi pedagogjik islam kujdeset që t'i japë secilit mundësinë e zhvillimit dhe të mësojë në fushën që mund ta bëjë më mirë. Ky realizëm u përgjigjet nevojave të shoqërisë në varësi të aftësive dhe të përcaktimeve.

Në Kur'an dhe në sunet ka shumë raste të bashkëveprimit me realitetin, madje edhe në situata ballafaquese me njeriun. Disa situata shprehin ngritjen e njeriut në gradën më të lartë njerëzore, siç është rasti me besimtarin në familjen e Faraonit: ﴿ وَقَالَ رَجُلٌ مُؤْمِنٌ مِنْ آلِ فِرْعَوْنَ يَكْتُمُ إِيمَانَهُ أَتَقْتُلُونَ رَجُلًا أَنْ يَقُولَ رَبِّيَ اللَّهُ وَقَدْ جَاءَكُمْ بِالْبَيِّنَاتِ مِنْ رَبِّكُمْ وَإِنْ يَكُ كَاذِبًا فَعَلَيْهِ كَذِبُهُ وَإِنْ يَكُ صَادِقًا يُصِيبْكُمْ بَعْضُ الَّذِي يَعِدُكُمْ إِنَّ اللَّهَ لَا يَهْدِي مَنْ هُوَ مُسْرِفٌ كَذَّابٌ ﴾ "Një njeri besimtar nga familja e faraonit që e fshehte besimin e vet, tha: "A doni ta mbytni një njeri vetëm pse thotë Zoti im është Allahu, derisa prej Zotit tuaj u ka sjellë argumente? Nëse ai është rrenës, për vete e ka rrenën, e nëse është i drejtë, juve do t'ju godit diçka nga ajo

që ai ju premton. S'ka dyshim se Allahu nuk udhëzon në rrugë atë që e tejkalon dhe është rrenës.” [Gafir: 28] Në raste të tjera njeriu bie në shkallë të dobësisë njerëzore, siç është tregimi i shigjetarëve në Betejën e Uhudit, ﴿وَلَقَدْ صَدَقَكُمُ اللَّهُ وَعْدَهُ إِذْ تَحُسُّوهُم بِأُذُنَيْهِ حَتَّىٰ إِذَا فُشِلْتُمْ وَتَنَازَعْتُمْ فِي الْأُمْرِ وَعَصَيْتُمْ مِمَّن بَعْدَ مَا أَرَاكُمْ مَا تُحِبُّونَ مِنْكُمْ مَن يُرِيدُ الدُّنْيَا وَمِنْكُمْ مَن يُرِيدُ الْآخِرَةَ ثُمَّ صَرَّفَكُمْ عَنْهُمْ لِيَبْتَلِيَكُمْ وَلَقَدْ عَفَا عَنْكُمْ وَاللَّهُ ذُو فَضْلٍ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ﴾

“Allahu përmbushi premtimin e vet ndaj jush, ngase me vullnetin e Tij i korrët ata (me shpata) deri kur u dobësuar dhe u përçatë ndërmjet vete, në çështjen e vendit (që u patë caktuar Pejgamberi) dhe pasi vërejtët atë që e dëshironit (prenë e luftës), e atëherë kundërshtuat (urdhrin e Pejgamberit). Pati prej jush që e deshën këtë jetë (ata që u ngutën pas presë) e pati prej jush që e deshën botën tjetër. Pastaj, për t’ju sprovuar u zmbropsi juve nga ata. Po Allahu u fali juve; Allahu është dhurues i madh ndaj besimtarëve.” [Alu Imran: 152] Në një rast të tretë tregohet qëndrimi real i të dy situatave, siç është tregimi i Jusufit a.s. me gruan e Mbretit, ﴿وَرَاوَدتُّهُ الْآتِي هُوَ فِي بَيْتِهَا عَنِ نَفْسِهِ وَغَلَّقَتِ الْأَبْوَابَ وَقَالَتْ هَيْت لَكَ قَالَ مَعَاذَ اللَّهِ إِنَّهُ رَبِّي أَحْسَنَ مَثْوَايَ إِنَّهُ لَا يُفْلِحُ الظَّالِمُونَ﴾

“E ajo, në shtëpinë ë së cilës ishte Jusufi, i bëri lajka atij dhe ia mbylli dyert e i tha: “Eja!” Ai (Jusufi) tha: “Allahu më ruajttë, ai zotëria im (e burri yt), më nderoi me vendosje të mirë (si mund t’i bëj hile në familje)”. S’ka dyshim se tradhtarët nuk kanë sukses.” [Jusuf: 23].

Disa edukatorë muslimanë preferojnë që objektiv kryesor në mendimin pedagogjik islam të jetë njeriu i mirë, jo vendasi i mirë.<sup>587</sup> Ndoshta nuk duket ndonjë dallim i madh, sepse vendasi është njeri në fund të fundit, por edhe njeriu është vendas në një shtet të caktuar. Mirëpo, bëhet edhe më e qartë kur shohim në qarqe e përkatësisë së individit. Njeriu është vendas në një shtet, individ në një shoqëri, shoqëria e tij është pjesë e umetit, kurse populli është pjesë e gjinisë njerëzore që mëkëmb Tokën. Vështrimi pedagogjik islam kërkon vetëdijesim të nxënësve në të gjitha këto qarqe. Për shembull, vetëdija për përkatësinë në një popull, konfirmon

<sup>587</sup> El-Kejlani, Ahfad’ ut-terbijjet’ il-islamijeh, vep. e cit., fq. 49. Autori ka thënë: “Njeriu i mirë dhe i dobishëm është ai për të cilin vepron edukimi islam”.

domosdoshmërinë e pranisë së konceptit “popull” dhe dallimin e tij mes popujve tjerë, veçanërisht në kohën kur njeriun bashkëkohor e ndjellin drejtime kundërthënëse, si për shembull identitetet dytësore lokale të cilat janë të mbyllura në një vend, etni dhe kulturë nga njëra atë, dhe shtypjet globale bashkë me të padëshiruarat e tyre nga ana tjetër.

Mendimi pedagogjik islam është i hapur për eksperiencat e llojllojshme që ndodh t'i sigurojë ambienti, pavarësisht se ky mendim kujdeset të ruajë karakterin e vet të veçantë. Njeriu më me shumë dije është ai i cili kërkon dijen që e ofrojnë të tjerët dhe e përvetëson. Pra, gjurmon te të tjerët “një fjalë që e drejton kah e mira apo e largon nga e keqja.”<sup>588</sup> Në historinë islame kemi hasur se kush i takon një shkollë juridike (fikhu) nuk pengohet të vështrojë apo lexojë dijen në shkollat tjera juridike. Njësoj edhe ai që i takon një shkollë filozofike, sufiste apo usuliste, nuk pengohet të lexojë apo mësojë nga shkollat tjera të cilat janë burim i dijes dhe i udhëzimit. Ibn Tejmije ka thënë: “Nëse një njeri e mëson fikhun (mirë) dhe stoliset me një edukatë dhe metodë të një populli besimtarësh, si p.sh. ndjekja e imamëve dhe dijetarëve, ai nuk duhet ta bëjë modelin e vet dhe të shokëve të vet si kriter...”.<sup>589</sup> Kjo nënkupton se thirrja e mësuesit drejtuar nxënësit duhet të jetë për studimin e burimeve të llojllojshme të dijes pasi ai të jetë plotësuar me elementët e identitetit dhe të personalitetit të cila do ta mbrojnë nga endja, llojllojshmëria dhe humbja nëpër drejtime kundërthënëse.

<sup>588</sup> Ebu Hamid Gazaliu transmeton nga Sha'biu, i cili ka thënë: “Nëse një njeri udhëton nga Shami deri në skaj të Jemenit për një fjalë të vetme e cila do ta udhëzonte në një punë të mirë dhe do ta largonte nga një punë e keqe, atëherë udhëtimi nuk do t'i shkonte kot”. Shih: El-Gazali, *Ihjaw ulum'id-din*, vep. e cit., “Fi feva'id'is-seferi ve fadlihi ve nijjetihî”, vëllimi II, fq. 245.

<sup>589</sup> Ibn Tejmije, Tekijjuddin Ebu 'l-Abbas Ahmed bin Abdulhalim bin Tejmije Harani (vd. 728 h.). *Mexhmuu 'l-fetava*, i redaktuar nga Enver El-Baz dhe Amir El-Xhezar, Mensure: Dar'ul-Vefa, botimi III, 2005, vëllimi XX, fq. 8.

## Pjesa e katërt:

# Manifestimet e integritit dhe të ekuilibrit në mendimin pedagogjik islam

Më përpara treguam për veçorinë e integritit në personalitetin njerëzor të cilit kërkon t'i japë trajtë mendimi pedagogjik islam. Gjithashtu, treguam disa shembuj të integritit në dy aspekte, por të mos harrojmë se integriti kërkohet në aspekte të ndryshme. Ka integritim të detyrueshëm në mesin e kërkesave që ngërthen edukimi i domosdoshëm i trupit, i arsyes dhe i shpirtit. Umeti ka nevojë të integrohet në sistemet pedagogjike, në disiplinat fetare, në disiplinat gjuhësore dhe në disiplinat historike, duke i cilësuar ato si disiplina të ngrehinës së umetit. Përgjatë rizgjimit të tyre kulturor ato kanë nevojë të integrohen në sistemet e veta edukative, në mënyrë që të përmbushen nevojat e fitimit të shkencave natyrore, aplikative, humane dhe sociale. Umeti ka nevojë të integrojë edhe elementët e fuqisë ekonomike, sociale dhe ushtarake. Në objektivat e edukimit (pedagogjisë) integrohen edhe sferat e informacioneve, të shkathtësive dhe të drejtimeve, kurse edukimi shpirtëror, social dhe etik integrohet në hapësirën kohore të gjithë jetës së njeriut, në fëmijëri, në rini dhe në pleqëri.

Integritimi në të gjitha situatat nuk nënkupton domosdoshmëri barazinë në sasi dhe as ndryshueshmëri në lloj, por nënkupton atë që realizon objektivin dhe atë që përmbush nevojën.

Koncepti "integritim" hyn në mendimin pedagogjik islam, dhe atë në disa sfera. Në shoqëri ka grupe të llojllojshme. Në çdo grup ka meshkuj dhe femra; fëmijë dhe të rritur. Në grupin e nevojave personale shohim se shumica e njerëzve janë të barabartë. Disa individë e kanë humbur ndonjë shqisë, si dëgjimin, shikimin, apo ndonjë organ si dora ose këmba.

Në sferën e profesionit ka njerëz të cilët merren me profesione tradicionale, si agronomia dhe tregtia, me artizanate si gdhendja dhe ndërtimi. Një pjesë e njerëzve veprojnë në procesin arsimor, si mjekësi, inxhinieri..., po ashtu, edhe profesionet moderne. Mirëpo, të gjithë kanë nevojë për edukimin dhe arsimimin.

Në këtë arsim dhe edukim integrohen gjërat e përbashkëta të çdo individi të shoqërisë dhe gjithçka e veçantë për çdo profesion. Arsimi nuk karakterizohet vetëm me informacione dhe dije shkencore, por e ndërlidh edukimin praktik me veprim të perfeksionuar mirë nga njëra anë, dhe duke iu përmbajtur etikës së punës nga ana tjetër.

Integrimi i kërkuar janë vetë përgjegjësitë edukative të institucioneve të ndryshme në shoqëri, sidomos të përgjegjësitë në familje, në shkollë, në media, në xhami dhe në vende të ndryshme. Pra, integrimi detyrohet ta ndihmojë aktivitetin edukativ të çdo institucioni, për atë që u ofron institucioneve të tjera, sepse këto institucione nuk kanë kundërthënie në edukimin që u ofrojnë individëve. Ekziston një lloj integrimi i kërkuar që e ofrojnë elementët e çdo institucioni. Në familje duhet të integrohet dhe të plotësohet detyra e babait dhe e nënës. Në shkollë duhet të integrohen përpjekjet e administratës shkollë në ndërtimin e klimës së përgjithshme në shkollë dhe përpjekjet e mësuesve për realizimin e detyrave arsimore-pedagogjike. Gjithashtu, kërkohet edhe integrimi i detyrës edukative të mësuesit, pra të ndërmerren mjete të llojllojshme edukative, si p.sh.: metodat e drejtpërdrejta, indirekte, lavdëruese, qortuese, shpërblyese dhe dënuese.

Mendimi pedagogjik islam për të cilin flasim lidhet drejtpërdrejt me problematikat e arsimit publik dhe atë universitar. Këto janë probleme të llojllojshme dhe të shumta të cilat ndërlidhen me mësuesin, me nxënësin, me librin, me administratën, me financimin dhe me probleme të tjera. Për shembull, nëse e marrim problemin e librit, shohim se si sot dikush përpiqet të mohojë vlerën e librit sot, me argumentin se dija që përmban libri është në evoluim të vazhdueshëm,

apo me pretekstin se burimet e mësimi janë shumë, e nxënësi mund përcaktohet vetë se në cilin burim do të hulumtojë. Në anën tjetër shohim se shumica e institucioneve të arsimit në shumicën e shteteve të botës vazhdojnë të mbështeten në libër, veçanërisht pasi u bë zhvillimi i librit bashkëkohor. Pavarësisht se libri vazhdon të ngërthejë një shkallë më të ulët të informacioneve dhe të njohurive, ai, krahas kësaj, është një udhëzues i disa llojeve të burimeve të tjera. Gjithashtu, ka edhe një model digjital të tij, prandaj integrimi për të cilin mund të flasim këtu është gërshetimi i librit si material bazik me format tjera të aktivitetit arsimor që mund t'ia shtojmë.

Ka një çështje tjetër që karakterizon librin, e që hidhet shpesh në qarqet e arsimit shariatik. Pra, disa profesorë në arsimin shariatik vazhdojnë të insistojnë në përdorimin e librave të vjetër, e veçanërisht në librat me shkurtesa dhe poemat, bile i shpërfillin shkrimtarët e librave modernë në shkencat e shariatit apo ata që i përdorin këto libra në mësimdhënie. Nëse librat e vjetër do të ishin ato që i kanë shkruar dijetarët e parë, si Shafiu, Maliku, Muhamed bin Haseni dhe të ngjashmit, atëherë do të ishte shumë e lehtë për t'i pranuar, mirëpo librat e vjetër që na jepen janë kryesisht libra të shkruar në etapa të mëvonshme dhe janë shkurtuar në forma të çuditshme. Pra, kryesisht janë përpjekje që grumbullojnë shumë mesele në pak fjalë. Kur u dobësua gjuha arabe te njerëzit, atëherë fjalitë u shndërruan në fjali qesharake, d.m.th. sikur autori nuk ka shkruar për t'u kuptuar, por vetëm për mbledhur dije."<sup>590</sup>

Autori i veprës "*Tarih'ut-teshri'i 'l-islamijj*" ka prekur materien e një teme të vetme, p.sh. temën e ujërave me të cilët lejohet pastrimi, dhe atë në tre libra të shkurtuar dhe në tre medhhebe. Kjo, siç e ka quajtur vetë autori, është një materie

<sup>590</sup> Muhamed El-Hudarij, *Tarih'ut-teshri'i 'l-islamijj*, Damask, Dar'ul-fikr, botimi VIII, 1967, fq. 317.

Disa profesorë e diskutojnë se ndoshta kjo vërejtje ka qenë e saktë për kohën kur Muhamed Hudarij e ka shkruar librin e cituar në këtë fusnotë, madje edhe më herët, por tani ka ndryshuar situata, sepse librat e përpiluar nga profesorët universitarë janë themelore. Sigurisht, se në disa universitete ka ndodhur ndonjë ndryshim nga ndonjë profesor, por profesorë të tjerë dhe universitete të tjera vazhdojnë të ruajnë poemat dhe sqarimet e tyre. Po ashtu, përdorin shembuj të vjetër që janë dhënë nëpër librat e trashëguara.

që nuk është shkruar për t'u kuptuar. Disa bëjnë thirrje vazhdimisht të lexohen librat e vjetër për të komunikuar me trashëgiminë e shkruar, kurse disa të tjerë kërkojnë të shkruhen libra të rinj në të cilët do të përdoret gjuha aktuale e sotme, në mënyrë që të thjeshtësohen çështjet për t'u kuptuar më lehtë dhe për t'i shprehur ato përmes tabelave, vizatimeve dhe diagrameve sqarues. Po ashtu, përdoren shembuj të njohur sot, pa pasur nevojë për interpretime dhe trajtime leksikore. Sot më pak flitet për çështjen e integritit mes objektivit të shkrimit me shkrimet e vjetra dhe objektivit të arsimit përmes paraqitjes së çështjeve shkencore me metoda dhe me libra të rinj. Ajo që shpresojmë është që të hasim studiues të atillë që pretendojnë se dera e ixhtihadit në shkrim është mbyllur dhe mjaftojnë ixhtihadet e studiuesve të mëhershëm, pa pasur nevojë për shtesë.

Kaq për integrimin, ndërsa sa i përket ekuilibrit, edhe kjo është një veçori origjinale në gjithçka ka krijuar Allahu i Lartësuar: ﴿ وَالْأَرْضَ مَدَدْنَاهَا وَأَلْفَيْنَا فِيهَا رَوَابِي وَأَنْبَتْنَا فِيهَا مِنْ كُلِّ شَيْءٍ مَوْزُونٍ ﴾ **“E tokën e kemi shtruar dhe në të kemi vuar kodra dhe kemi bërë që në të të mbijnë bimë të gjitha llojeve me masë.”** [El-Hixhr: 19]. Ekuilibrimi karakterizohet me masa dhe përmasa gjenetike të caktuara në gjërat e çdo krijese. Përcaktimi i Allahut të Lartësuar është që të ketë harmoni mes të gjitha elementëve përbërës të çdo gjëje dhe të çdo cilësie, madje të ketë edhe peshorja e jetës të jetë e ekuilibruar deri në një kader të caktuar nga Allahu i Madhërishëm.

Qeniet e gjalla jetojnë në tokë brenda atmosferës së saj me masë të caktuar të ajrit. Nëse prishet masa e ekuilibruar e ajrit, për shembull, nëse ulet përqindja e oksigjenit, jeta e njerëzve, e kafshëve dhe e bimëve menjëherë do të çrregullohet, madje ndoshta do të zhbëhen kushtet për jetë. Lëngjet e trupit të njeriut janë lëngje qelizorë dhe jashtë qelizorë, si p.sh. gjaku, lëngu i syrit, i veshit, pështyma, limfa dhe të tjera. Allahu i Madhërishëm i ka krijuar në formë të ekuilibruar në mënyrë që të mbahet trupi i shëndetshëm. E nëse prishet ky ekuilibër, shëndeti kthehet në sëmundje, mbase edhe në vdekje. Allahu e ka krijuar njeriun në formë të



ekuilibruar dhe çdo gjë e ka krijuar në formën më të bukur. Forma më e bukur shpreh identitetin fizik të njeriut, e që është fytyra. Madhësia e çdo organi në fytyrë, në raport me organet tjera është e ekuilibruar me masë të caktuar brenda asaj që thuhet “forma më e bukur”. Për këtë arsye, imazhi dallues i njeriut është imazhi i fytyrës dhe i kokës.

Për këtë arsye, nga njeriu kërkohet të ruajë ekuilibrin në çdo çështje dhe në çdo gjë. Ushqimi i përshtatshëm është ushqimi i ekuilibruar në lloj, si p.sh. të përbëhet me masë nga proteinat, sheqernat, yndyrat, vitaminat, kripërat, mineralet etj. Po ashtu, të ketë ekuilibër edhe në sasi, sepse pakësimi dhe shtimi mund të sjellin çrregullime. Të gjitha këto që potencuan vlejën edhe për vetitë logjike, shpirtërore dhe etike të njeriut. Çdo veti e njeriut mund të ketë shtim dhe pakësim të panevojshëm, kurse ekuilibri është ai që e shmang këtë çrregullim.

Ekuilibri nuk nënkupton barazi apo neutralizim në sasi të vetive, por secilës cilësi t’i sigurohet sasia e caktuar. Po ashtu, njerëzit dallojnë në sasinë që mund të përmbajë vetia e secilit njeri. Ekuilibrim nuk do të thotë jofunksionalizim i veçorisë dalluese të çdo njeriu nga njëri-tjetri, por secila veçori të jepet në masë të përshtatshme me të cilën duhet të pajiset njeriu, qoftë ajo veçori, moral apo adhurim i domosdoshëm. Transmetohet se një njeri i kishte shkruar Imam Malikut dhe e kishte qortuar për përkushtimin e madh ndaj diturisë dhe për përkushtimin e ulët ndaj adhurimit, e ai u përgjigj: “Allahu i ka ndarë punët siç i ka ndarë furnizimet. Ndoshta një njeri është i prirë për namaz dhe jo për agjërim, një tjetër për sadaka dhe tjetri për agjërim, dikush për xhihad dhe e dikush për përhapje të diturisë. Përhapja e diturisë është bamirësia më e madhe. E unë jam i kënaqur dhe i pajtuar me atë që më është dhënë nga Zoti. Unë jam aty ku duhet dhe ti je aty ku duhet. Shpresoj që të dy të jemi në rrugë të mbarë dhe të dobishme.”<sup>591</sup>

Çdo studim objektiv për Islamin zbulon se veçoria e ekuilibrit në Islam është pjesë e natyrshmërisë së pastër (e

<sup>591</sup> Edh-Dhehebij, *Sijeru a’lam’in-nubelai*, vep. e cit., vëllimi VIII, fq. 144

fitres) dhe e pranon arsyeja. Këtë nuk e gjejmë askund përveçse në Islam. Ky ekuilibër e mbron njeriun nga skajshmëria, si në teprimin apo shtimin e gjërave ku duhet mbajtur mesatarja, apo edhe në pakësimin e kësaj mase. Pakujdesia dhe pakësimi në çdo veti të mirë të personalitetit njerëzor nënkupton padëgjueshmëri, shpërfillje apo vjedhje në peshoren të cilën Allahu ka urdhëruar të mbahet me drejtësi. Allahu xh.sh. thotë: ﴿وَالسَّمَاءَ رَفَعَهَا وَوَضَعَ الْمِيزَانَ \* أَلَّا تَطْغَوْا فِي الْمِيزَانِ \*﴾  
**“Dhe qiellin e ngriti dhe e vendosi peshoren (ekuilibrin). Që të mos humbi në peshore. Dhe mbani peshën me drejtësi dhe mos e humbni peshoren!”** [Er-Rrahman: 7-9]

Shumica e veçorive me të cilat përpiqet njeriu të cilësohet, përgjithësisht paraqiten në formë të dy gjërave të kundërta, e njeriu vetë përcaktohet në njërën prej tyre, ndërsa e vërteta është opsioni i tretë, pra rruga që gërsheton këto dyja dhe cilësohet si rrugë e ekuilibruar dhe mesatare. Veçoria shpirtërore dhe ajo materiale janë në thelb te njeriu, pra nuk duhet të zgjedh njërën dhe të lë tjetrën, por duhet të gjejë një rrugë mesatare ku do të gërshetohen të dyja. E njëjta është situata edhe me të drejtat dhe me detyrimet, me ndjekjen dhe me kreativitetin, me përgjegjësinë individuale dhe me identitetin shoqëror etj.

Tema e mesatares ndonjëherë kuptohet në formë jo të duhur, si p.sh. kur drejtohet faji kah ndjekësi i sunetit kur është larg bidatit, kah ai që e tregon haptas të vërtetën duke shmangur heshtjen ndaj të pavërtetës ose kah ai që i përmbahet hallallit duke hequr dorë nga harami. Nuk ka mesatarizëm në këto raste kontradiktore, sepse mesatarizmi është i drejtë, i mirë dhe i saktë. Allahu xh.sh. na ka treguar në Kur'an se umeti islam është umeti i mesatarizmit dhe dëshmuar para njerëzve me virtytet, epërsinë, aftësinë për të drejtuar që gëzon. Ky umeti nuk do të cilësohej si umeti më i mirë nëse nuk do ta kishte besimin, urdhrin në të mirë dhe ndalimin nga e keqja.

Fukahatë dhe usulistët e kanë trajtuar temën e ekuilibrit dhe të baraspeshës qysh herët, dhe atë qysh kur Izz bin

Abdusselam e shkroi librin “Kavaid’ul-ahkam”, i cili flet për dobitë dhe dëmet. Dispozitat e sheriatit synojnë të ndjellin të mirat dhe të largojnë të këqijat, por të mirat dhe të këqijat, secila prej tyre ka nivelet e veta, por Allahu i Lartësuar ia ka lehtësuar njeriut rrugën e udhëzimin në të vërtetën nga vetë natyra: “Pra, dije se ofrimi i asaj që është mirë e më mirë dhe largimi i asaj që është keq e më keq, është i ngulitur në natyrën dhe karakterin e robërve nga Vetë Zoti i Madhërisëm.”<sup>592</sup> Pastaj ka vendosur një rregull të quajtur rregulli i baraspeshës apo ekuilibrit mes të mirave dhe të këqijave. Ka sqaruar hollësisht gjërat kundërthënëse mes të mirave dhe të këqijave, fërkimin e dy interesave dhe fërkimin e dy dëmeve, dhe se si duhet të përdoret baraspeshimi mes tyre për të sjellë mendimin e favorshëm.<sup>593</sup>

Përgjithësisht, shkenca e usuli fikhut e mban këtë baraspeshim, neutralizim dhe mesatarizëm përmes sjelljes së dispozitave, të cilat i përmbushin intencat e sheriatit duke ndjellë të mirat dhe duke i larguar të këqijat. Imam Shatibiu ka treguar në hyrjen e veprës “El-muvafekat” për vlerën dhe mirësinë e udhëzimit të njerëzve në rrugë të drejtë, e cila arrihet me dije dhe me arsimim. Kjo arrihet duke kontribuar në caktimin e “niveleve mes njerëzve të përgjithshëm dhe të veçantëve, mes masës dhe të zgjedhurve. I jepet haku ndjekësit dhe hulumtuesit, ndjekësit dhe edukatorit, nxënësit dhe profesorit, secilit i jepet merita e vet... secili vendoset në vendin e vet dhe i përmbahet rrugës mesatare e cila është sferë e drejtësisë dhe e mesatarisë. Në anën tjetër, ata që thyejnë këtë parim (të mesatarizmit) i nxjerr në rrugë të drejtë që të mos dalldisin në një anë ekstreme dhe utopike.”<sup>594</sup> Pastaj ka thënë: “Sheriati është funksional duke ngarkuar me detyrë në rrugën mesatare dhe më të drejtë, e cila nga secila anë merr hisen që i takon dhe nuk anon. Ndërhyt në fitimin e robit pa e vënë në vështirësi atë dhe pa e lënë krejt të lirë,

<sup>592</sup> Izzuddin Abdulaziz bin Ebi 'l-Kasim Es-Sulemij El-Mulakkab bi Sulltan'il-ulemai Ibn Abdusselam, (vd. 660 h.). *El-Kavaid'ul-kubra: kavaid'ul-ahkami fi islah'il-enami*. I redaktuar nga Nezhiz Hamad dhe Othman Damirij-jeh, Damask: Dar'ul-Kalem, 2000, fq. 9.

<sup>593</sup> Po aty, fq. 87-88

<sup>594</sup> Esh-Shatibi, *El-Muvafekatu fi usul'ish-sheriat*, vep. e cit., fq. 15

madje ai e ngarkon me një detyrë aq funksionale dhe të ekuilibruar robin, saqë përmes saj e arrin kulmin e drejtësisë dhe të baraspeshës te të gjithë robërit e ngarkuar me detyrë.”<sup>595</sup>

Në të shumtën e rasteve, vetinë e ekuilibritit e gjejmë të lidhur me vetinë e integritit. Allahu i Madhërishëm, kur kërkon nga njeriu të afrohet tek Ai me pasurinë që e ka furnizuar, duke synuar shpërblimin dhe sevapin në Botën Tjetër, Ai kërkon që përmes saj njeriut t’ia japë edhe hisen e vet në këtë botë. Ky është ekuilibrim në vënien e pasurisë në mes ekstremit të harxhimit të tërësishëm të saj për punët e ahiretit dhe ekstremit të harxhimit të saj në punët e dynjasë. Allahu xh.sh. thotë: ﴿وَابْتَغِ فِيمَا آتَاكَ اللَّهُ الدَّارَ الْآخِرَةَ وَلَا تَنْسَ نَصِيبَكَ مِنَ الدُّنْيَا﴾ **“Dhe me atë që të ka dhënë Allahu, kërko (ta fitosh) botën tjetër, e mos le mangut atë që të takon nga kjo botë, dhe bën mirë ashtu siç të ka bërë Allahu ty, e mos bën të këqija në tokë, se Allahu nuk i do çrregulluesit.”** [El-Kasas: 77] Hadithi peygamberik i cili ndërlidhet me këtë ajet e shton kuptimin e integritit dhe të plotësisimit. Hadithi sqaron se hisja e dynjasë plotësohet dhe integrohet me hakun e vetes, të familjes dhe të shoqërisë (vizitorëve). Në “Sahihun” e Buhariut transmetohet se Abdullah bin Amr ka thënë: “Më tha i dërguari i Allahut a.s.: “O Abdullah, më kanë treguar se agjëron ditën dhe falesh natë, a është e vërtetë?” I thashë: “Po, o i Dërguari i Allahut.” Tha: “Mos vepro kështu! Ndonjëherë agjëro e ndonjëherë mos agjëro, falu dhe fili, sepse ti ke hak edhe ndaj trupit, ndaj syrit dhe ndaj bashkëshortes...”<sup>596</sup> Në një hadith tjetër të shënuar po ashtu në veprën e Buhariut ka një shtojcë “dhe jepja secilit hakun e vet”, pra shtesë e konfirmuar nga vetë Pejgamberi a.s.<sup>597</sup>

<sup>595</sup> Po aty, 315

<sup>596</sup> El-Buhari, *Sahih'ul-Buhari*, vep. e cit., Kitab: “Es-Savm”, bab: “Hakk’ul-xhismi fi ‘s-savm”, hadithi numër: 1975, fq. 374

<sup>597</sup> Ebu Xhuhejfa r.a. tregon: “Pejgamberi a.s. vëllazëroi Selmanin me Ebu Derdain. Selmani i shkoi atij për vizitë dhe e gjeti (të shoqen e tij) Umm Derdan si mos më keq, kështu që e pyeti se pse ishte katandisur ashtu. Ajo i tha: “Vëllai yt, Ebu Derda, nuk tregon asnjë dëshirë e qëllim për (jetë të lumtur në) këtë botë.” Ndërkohë erdhi Ebu Derda dhe bëri për Selmanin diçka për të ngrënë. Selmani i kërkoi atij që të hante (bashkë me të), por ai i tha se agjëronte. Selmani i tha: “Unë nuk do të ha derisa të hash edhe ti.” Kështu, Ebu

Mbajtja e ekuilibrit në arsim dhe edukim arrihet duke i trajnuar dhe duke i udhëzuar mësuesit kah mesatarizmi, si në harxhimin e kohës, ashtu edhe në përkushtimin ndaj punëve, sepse ndonjëherë shumë gjëra i fusin në rrethin e gjërave të rëndësishme. Përkushtimi i tërësishëm në adhurim duke lënë pas dore punët e umetit dhe përkushtimi i tërësishëm ndaj punëve të umetit duke e lënë pas adhurimin, që të dyja llogariten veprime ekstreme dhe humbje të ekuilibrit. Pra, gërshetimi i të dy punëve tregon ekuilibrin e kërkuar. Kur dallohen punët e rëndësishme dhe më të rëndësishme në të njëjtën kohë dhe te personi i vetëm, atëherë vjen në shprehje ekuilibrimi i punëve përmes aktivizimit të parimit të favorizimit (të njëres ndaj tjetres).

Në shoqërinë bashkëkohore shihet një dyndje e burimeve dhe e mjeteve të informacionit. Kjo kryesisht ndodh në përpjekjet personale dhe institucionale të mësimit dhe të arsimit, gjë e cila e bën të detyrueshëm mbajtjen e baraspeshës për të fituar dituri përmes mjeteve dhe mekanizmave të rinj. Përdorimi i mjeteve sociale moderne të komunikimit mund të jetë burim i dijes, i së mirës dhe i thirrjes. Mirëpo, harxhimi shumë kohë për të ndjekur gjithçka paraqesin këto mjete është i tepërt, humbje kohe dhe harxhim energjie, prandaj mesataria është më mirë. Gjithashtu, edhe refuzimi i bashkëveprimit me këto mjete dhe paaftësia për t'i përdorur drejt ato në lehtësimin e shumë punëve është teprim dhe ekstrem tjetër.

Bazuar në këtë, mesatarja dhe ekuilibrimi i dy anëve ekstreme është zgjidhja më e mirë. Kjo metodë duhet të ndiqet në çdo çështje.

Rregullat fikhore dhe usuliste paksa e zbehën funksionin e tyre në problemet bashkëkohore të umetit dhe në natyrën Derda hëngri bashkë me të. Natën (kur kishte kaluar një pjesë e saj), Ebu Derda u ngrit (për të falur namazin e natës), po Selmani i tha të flinte dhe ai fjeti përsëri. Pas pak Ebu Derda u ngrit përsëri, por prapë Selmani i tha që të flinte. Kur erdhi pjesa e fundit e natës, Selmani i thirri Ebu Derasë të ngrihej këtë kohë dhe kështu ata të dy u falën. Pastaj Selmani i tha Ebu Derasë: "Zoti yt ka të drejtë mbi ty, vetja jote ka të drejtë mbi ty, familja jote ka të drejtë mbi ty, (secili ka hakun e vet mbi ty), kështu që duhet t'u japësh hakun e vet gjithkujt që ka të drejtë mbi ty." Ebu Derasai shkoi te Pejgamberi a.s. dhe i tregoi gjithë ndodhinë. Pejgamberi a.s. tha: "Selmani ka thënë të vërtetën.". Shih: El-Buhari, *Sahih'ul-Buhari*, vep. e cit., Kitab: "Es-Savm", bab: "Men akseme ala ehihi lijuftire fi 't-tetavvui, hadithi numër: 1968, fq. 373.

intelektuale të këtyre problemeve, prandaj Vekili e shkroi librin “Fikh’ul-evvelijjat (Jurisprudenca e përparësive)” dhe Sevseveh veprën “Fikh’ul-muvazenat (Jurisprudenca e ekuilibrimeve)”. Këto trajtesa usuliste nuk dallojnë shumë nga materia e librave tradicionalë të usulit. Këtu hyjnë edhe librat e Ibn Abdusselamit, Shatibiut, Ibn Tejmijes dhe të tjerëve. Më e udhës do të ishte që këto trajtime të jenë intelektuale, kulturore dhe pedagogjike. Themelimi fikhor dhe usulist i këtyre tematikave njafton si veprim për të pasur praktikat e veta në reformimin e mendimit dhe të realitetit, dhe zhvillimin e metodave dhe praktikave pedagogjike të cilat janë mjet i këtij reformimi. Ajo që formon ky themelim (transferim) i propozuar është fakti se jeta e njerëzve në shoqëritë bashkëkohore, veçanërisht në shoqëritë muslimane, është e dirigjuar nga ndërhyrje të shumta ku rregullat e fikhut dhe të usulit vazhdojnë të mos gjejnë rrugën e funksionimit. Ato që e menaxhojnë jetën e këtyre shoqërive janë sistemet, mendimet dhe teoritë politike, ekonomike, sociale dhe edukative të cilat u turren këtyre shoqërive nga çdo derë dhe dritare, madje u kërkohet edhe kapacitet dhe mirëpritje, gjë e cila është e kushtueshme për ekspertët, librat, studimet dhe këshilltarët.

Ka pasur mundësi që parimin e baraspeshës në vendet arabe dhe islame ta dirigjojë gjuha e mësimdhënies, e kështu arsimit në vendet arabe-islame të zhvillohej në gjuhën arabe dhe kjo të konsiderohej prioritet i padiskutueshëm. Pastaj të mësoheshin gjuhë të huaja në varësi të nevojës që do të kishte studenti në fazat e avancuara dhe në varësi të nevojës që do të kishte shoqëria për të bashkëvepruar në nivel shkencor dhe kulturor me shoqëritë tjera. Kështu mund të arrihet një lloj ekuilibri, mirëpo defekti i këtij ekuilibri është shndërruar në një dukuri shqetësuese, sepse jo vetëm se i është dhënë përparësi mësimi të gjuhëve të huaja për ata që kanë nevojë, por përparësi në vete është bërë arsimimi në gjuhë të huaj.

E njëjta mund të thuhet edhe për shtetet islame joarabe, të cilët tregojnë më shumë kujdes për gjuhën arabe sesa vetë arabët, sepse e konsiderojnë atë gjuhë të Kur’anit fisnik,

madje disa shpresojnë që së paku ta kenë atë si gjuhë të dytë zyrtare. Mirëpo, realiteti e tregon të kundërtën, sistemet arsimore atje zhvillojnë procesin arsimor në gjuhë të huaj (anglisht apo frëngjisht), dhe atë me prioritet, kurse arsimimin në gjuhën lokale e përdorin aq sa t'u duhet për të komunikuar më lehtë në përditshmëri me njerëzit.

Shoqëritë islame sot kalojnë një fazë të vështirë, të dobët, të prapambetur dhe të shkapërderdhur. Fatkeqësisht ato udhëhiqen nga thirrje të ekstremizmit sektar dhe politik ku përplasen interesat në varësi të krahinave dhe përkatësive. Prandaj, mendimi pedagogjik bashkëkohor islam duhet të imponojë një unitet të umetit dhe vlerësim të interesave të tij. T'i përafrojë pikëpamjet, të hapë horizonte bashkëpunimi dhe integrimi mes të gjithëve. Pavarësisht përparësisë së problemeve të ngritura në nivele të ndryshme atdhetare, sektare dhe politike, urtësi është që përkushtimi dhe interesi i këtyre problemeve të ekuilibrohet me problemet e unifikimit dhe të bashkimit të umetit, përforcimin e anëve të bashkëpunimit dhe të integritit të popujve (muslimanë) me njëri-tjetrin. Mund të pohojmë se shumica e problemeve nga të cilat lëngojnë vendet muslimane mund të zgjidhen vetëm me integrim dhe bashkëpunim të ndërsjellë.

Koncepti i ekuilibrit është kthyer në një temë intelektuale e cila sillet nëpër shkrimet intelektuale, kulturore dhe edukative. Edhe ky koncept, njësoj si konceptet tjera, lidhet drejtpërdrejt me konceptin e synimeve dhe me konceptin e përparësive, prandaj hasim libra të vyer me tituj si "Fikhu i ekuilibrave",<sup>598</sup> "Fikhu i përparësive" etj.<sup>599</sup>

## Përfundimi

Ky kapitull ka trajtuar veçorinë më të rëndësishme të mendimit pedagogjik islam. Lexuesi ka vënë re se veçoria e devotshmërisë, e mesatarizmit dhe e bamirësisë, në tërësi i

<sup>598</sup> Abdullmexhid Es-Sevseveh, *Fikh'ul-Muvazenat fi 'sh-sheriat'il-islamijeh*, Dubai, Dar'ul-Kalem, botimi I, 2004.

<sup>599</sup> Muhamed El-Vekili, *Fikh'ul-evvelijjat: dirasetun fi 'd-davabiti*, Herden: El-Ma'hed 'ul-Alemijju li 'l-Fikr'il-Islamijj, 1997.

referohen qenies së tyre pjesë e këtij sheriatit të fundit dhe përmyllës. Këto veçori duhet të ishin në koordinim me parimin e elasticitetit, të zhvillimit dhe të fuqisë së mësimave islame paralel me zhvillimin njerëzor në të gjitha çështjet sociale dhe ekonomike të jetës, dhe në rrethana dhe situata të ndryshme. Për këtë arsye, këto veçori ngërthejnë atë që ofron kredibiliteti dhe efikasiteti për çdo kohë dhe për çdo vend.

Këtu lexuesi do të shohë se shumë argumente në Kur'an, në sunet dhe shembuj nga historia, disa nga të cilët i kemi dhënë, kanë ardhur për të konfirmuar praninë e kuptimit të "realizimit" në mendimin pedagogjik islam dhe domosdoshmërinë e pajtueshmërisë së tekstit me realitetin. Si pasojë e kësaj, shumë qendra hulumtuese pedagogjike dhe intelektuale në të kaluarën dhe sot kanë vepruar dhe vazhdojnë të punojnë në nivel individual dhe shoqëror për të përmbushur këtë lidhje të fuqishme mes mendimit dhe sjelljes së njeriut. Arsyeja është esenca e cila cilësohet me perceptim, me mendim dhe me etikë, dhe asaj i kuptohet ligjërimi për ngarkim me detyrim. Mendimi pedagogjik islam synon të ndërtojë njeriun, gjegjësisht arsyen në vetë njeriun, dhe atë në nivel të individit, të shoqërisë dhe të umetit, që pastaj të përmbush vullnetin e Allahut të Lartësuar për mirëqenien e njeriut në këtë botë. Për këtë arsye fokusimi më i madh ka qenë te personaliteti i njeriut, te shumëkuptimësia e konceptit të këtij personaliteti sipas teorive të ndryshme psikologjike dhe te elementët apo përbërësit e personalitetit që dalin nga këto teori, e pastaj edhe te rëndësia e çdo elementi në vete.

Në këtë kapitull kemi bërë përpjekje të drejtojmë busullën dhe të japim shansin për përgatitje të personalitetit të nxënësit që të jetë i aftë t'i shërbejë shoqërisë. Po ashtu, ta përgatitë që ky nxënës të jetë element aktiv në përmbushjen e vullnetit të Zotit për të bartur amanetit dhe mëkëmbjen në tokë. Krejt kjo të arrihet përmes integritetit dhe kujdesit të plotë ndaj elementëve përbërës të njeriut, si trupi, arsyeja dhe shpirti. Trupi ka edukimin dhe mjetet edukuese të vetat. Arsyeja ka edukimin dhe mjetet edukuese të vetat, por edhe



shpirti ka edukimin dhe mjetet edukuese të vetat. Veçoria e integritit në mendimin pedagogjik nënkupton që secili element i njeriut të gëzojë nivelin e duhur të edukimit, të zhvillimit dhe të pastrimit, dhe atë përmes mjeteve të përshtatshme.

Fokusi ynë në këtë kapitull ka qenë te operacionet e logjikës, të menduarit dhe meditimit, të cilat mund të jenë sfera pjellore në punën pedagogjike dhe të shfaqin manifestimet në formë të drejtpërdrejtë te personaliteti i njeriut, gjegjësisht në dy aspekte: në aspektin logjik dhe në atë shpirtëror. Kjo është një metodë për bashkëpunim me lëndët e ndryshme mësimore. Vënia në funksion e arsyes në krejt këtë nënkupton ndërtimin e jetës së kësaj bote dhe përmbushjen e vullnetit të Zotit për mëkëmbje në Tokë. Kur'ani Fisnik e ka lidhur atë që konsiderohet edukim logjik dhe edukim doktrinar (besimor). E ka udhëzuar njeriun të ecë nëpër tokë, të vështrojë dhe të meditojë në kozmos, si p.sh. të meditojë në lëvizjet e diellit dhe të hënës, në ndryshimin e natës dhe të ditës, në zbritjen e shiut, në ringjalljen e bimëve në tokë etj. Trashëgimia edukative islame ngërthen një materie shumë të pasur për shpirtin e njeriut.

Folëm për veçorinë e integritit dhe të ekuilibrit në mendimin pedagogjik islam. Po ashtu folëm për integrimin, të cilit mendimi pedagogjik islam kërkon t'i japë formë në personalitetin e njeriut. Ky integrim apo plotësim arrihet me përmbushjen e kërkesave të domosdoshme të edukimit të turpit, të arsyes dhe të shpirtit. Ky integrim bëhet në sfera të ndryshme, i përfshin të gjitha grupet e shoqërisë dhe të gjitha profesionet. Kurse veçoria e ekuilibrit karakterizohet me sasisë dhe përmasat relative të elementëve çdo krijese. Përcaktim i Allahut të Lartësuar është që elementët formues të përshtaten për çdo gjë dhe për çdo veti.

Lexuesi vëren se veçoria e ekuilibrit në Islam është ngritur mbi natyrshmërinë e pastër (mbi fitren) dhe mbi atë që pranon arsyeja në formë të atillë që s'e gjejmë tjetërkund veçse në Islam. Ky ekuilibër mbron njeriun nga çdo pakujdesi

dhe mangësi në çdo punë. Mesataria dhe neutralizimi mes dy ekstremeve është zgjedhja më e mirë.

Fokusimi ynë i qartë ishte në temën e intencave të sheriatit, në aplikimin e rregullave të fikhut dhe të usulit në problemet bashkëkohore të umetit dhe të karakterit të tyre intelektual. Po ashtu, ishim të fokusuar në temën e marrëdhënies mes ndjekjes dhe kreativitetit, bashkë me integrimin dhe ekuilibrin e këtyre dyjave. Umeti islam e ndjek atë që ka sjellë shpallja hyjnore dhe tradita pejgamberike, por këtë ndjekej apo pasim e bën mbi bazën shkencore, udhëzuese dhe logjike, sepse kështu ndjekësi e sheh rrugën e drejtë që e trasuan të udhëzuarit e mëhershëm, e kështu e ndjek edhe ai.

Nga lexuesi pritet që t'i hedh një vështrim gjendjes së umetit sot dhe të shohë se si lëngon nga prapambetja në shumicën e sferave të jetës, pavarësisht se kjo prapambetje shihet nga pikëpamja islame si e tillë, nga krahasimi i gjendjes me mundësitë dhe potencialet që posedon umeti, apo nga krahasimi me popujt dhe shoqëritë tjera. Ky kapitull erdhi për të treguar gjërat e domosdoshme në këtë aspekt dhe domosdoshmërinë e gërshetimit të arsimit tradicional, i cili ndërthen një dozë të konceptit të ndjekjes, me arsimin modern i cili ndërthen hapësirën e kreativitetit në mjete dhe reformimit në metodat e domosdoshme të jetës sonë bashkëkohore. Me pak fjalë ky është qëllimi i shtjellimit tonë për mbajtjen e ekuilibrit mes ndjekjes dhe kreativitetit.

Folëm edhe për realizmin, për idealizmin dhe për manifestimet e realizmit në mendimin pedagogjik islam, të cilat lidhen me realizmin e mesazhit islam në formë të përgjithshme. Gjithashtu, bëmë fjalë për realizmin dhe ndërtimin e një mendimi pedagogjik bashkëkohor islam. Konstatuam se realizmi nuk nënkupton nënshtrim të plotë para realitetit aktual dhe as para devijimeve nga forma (e Islamit) të cilën Allahu do ta shohë të mishëruar te besimtarët dhe në të cilën besimtarët duhet të vazhdojnë të ecin për t'u ngritur, por është botëkuptimi i cili përshtatet me ligjet hyjnore në jetë dhe me fenomenet e botës natyrore, sociale

dhe shpirtërore, pra janë ato që cilësohen si fakte reale dhe jo si supozime të paarsyeshme. Kemi theksuar se edukimi mund të realizohet në rrethanat dhe mundësitë e ofruara, qoftë në një tendë në mes të shkretëtirës, nën hijen e një peme apo në një kështjellë madhështore. Lidhshmëria e realitetit me njeriun nuk nënkupton përqendrimin në realitetin e individit apo të krahinës, por nënkupton lidhjen me vetveten dhe me gjithë atë që e rrethon njeriun, si në sasi ashtu edhe në lloj. Mendimit pedagogjik islam bashkëkohor i takon që të jetë më e hapur për të mësuar zhvillimet e arritura në historinë e shkencave dhe të përfshijë programe dhe metoda për disiplinat e reja shkencore, në mënyrë që këto programe dhe metoda të lejojnë themelimin e disiplinave të reja shkencore.

## KAPITULLI I SHTATË

### REALITETI I MENDIMIT PEDAGOGJIK ISLAM DHE MËNYRAT E REFORMIMIT

Parathënie:

Pjesa e parë: Përshkrim i përgjithshëm i realitetit të mendimit pedagogjik islam dhe konteksti i tij historik dhe bashkëkohor

1. Plan-programet arsimore universitare
2. Hulumtimet dhe institucionet hulumtuese
3. Orientime politike dhe ekonomike
4. Konteksti historik i realitetit të mendimit pedagogjik islam
5. Kriza e arsimit është krizë globale

Pjesa e dytë: Referenca e mendimit pedagogjik bashkëkohor

1. Koncepti “referencë”, llojet dhe nivelet
2. Karakteristika të përgjithshme të referencës së mendimit pedagogjik perëndimor
3. Filozofitë në referencën e mendimit perëndimor

Pjesa e tretë: Vetëdijesimi për çështjen e reformave pedagogjike dhe përgjegjësitë e qarqeve pedagogjike

1. Prezenca e vizionit islam në reformat pedagogjike
2. Pasqyra e realitetit dhe ndryshimi i synuar
3. Formimi i vetëdijes me realitetin e mendimit pedagogjik bashkëkohor dhe pikënisjet e reformave
4. Qarqet pedagogjike dhe rëndësia e tyre në përpjekjet e reformimit pedagogjik

Përmbyllje:

# **KAPITULLI I SHTATË**

## **REALITETI I MENDIMIT PEDAGOGJIK ISLAM DHE MËNYRAT E REFORMIMIT**



## Parathënie

Përmbajtja e kapitujve ë mëparshëm ofroi disa të dhëna rreth disa elementeve, të cilat formojnë karakteristikat e realitetit të mendimit pedagogjik që mbizotëron në shumicën e shteteve islame. Gjithashtu ofroi disa të dhëna rreth shpresave të reformatorëve, të cilët synojnë ndryshimin e këtij realiteti dhe përmirësimin e mangësive në te. Në këtë kapitull, do të përpiqemi të ndalemi pak në gjendjen e mendimit pedagogjik islam siç e shohim ne dhe sipas rezultateve të studimeve dhe statistikave ndërkombëtare, rajonale dhe vendore. Më pas do të japim ca propozime të cilat i shohim si të domosdoshme për të dalë nga kjo gjendje në gjendjen të cilën e synojmë.

Biseda rreth realitetit të mendimit pedagogjik në shoqëritë islame është shumë e gjerë, ngase përfshin karakteristikat e përgjithshme që ndërthejnë sistemet e përgjithshme pedagogjike, bazat filozofike, politikat, teoritë dhe strategjitë. Po ashtu përfshin detaje rreth sistemit pedagogjik, komponentët, nivelet administrative dhe arsimore, institucionet, qarqet, plan-programet, metodat dhe mjetet mësimore, metodat për vlerësim etj. Bazuar në atë se supozojmë që lexuesi është i lidhur drejtpërdrejtë me këto detaje, ngase që të gjithë jemi rezultat i këtyre qarqeve pedagogjike bashkëkohore, qoftë në familje, shkollë, universitet apo institucione tjera shoqërore, andaj ne nuk do të përfshijmë gjitha këto detaje, të cilat në mënyrë të bollshme gjenden në revistat shkencore, disertacionet universitare, përfshirë edhe gazetatat ditore. Në vend të kësaj, do të merremi me disa çështje të cilat nuk vështrohen shumë në hulumtime dhe shkrimet bashkëkohore.

Ndoshta nuk mund të gjejmë mospajtime rreth asaj se çdo shoqëri duhet të ketë sistemin e saj arsimor, përmes së cilit përcaktohen cilësitë e njeriut që dëshirojnë të formojnë personalitetin e tij dhe të kontribuojnë në zhvillimin dhe

formimin e ardhmërisë së tij. Po ashtu nuk gjejmë mospajtime të mëdha rreth nevojës së shoqërive për bashkëveprim dhe bashkëkulturim, si dhe bashkëpunim për zhvillimin e disa përvojave të cilat janë të dobishme për të gjithë. Problemi është në atë se mendimi pedagogjik mbizotërues në sistemet arsimore zyrtare, në shumicën e shteteve islame është mendim pedagogjik i importuar në tërësi, ose i ndikuar nga sistemet pedagogjike perëndimore, në veçanti ato amerikane dhe evropiane. Problemi bëhet edhe më i ndjeshëm kur shoqëria humbë elementet e mendimit pedagogjik të veçanta për te, dhe në vend të saj merr mendimin pedagogjik të veçantë për një shoqëri tjetër program për edukimin e fëmijëve të saj. Kur shoqëritë islame përvetësojnë mendimin pedagogjik perëndimor, është e natyrshme që fëmijët dhe të rinjtë të zhvillohen sipas vlerave dhe traditave të mendimit perëndimor. Nëse mbetet te fëmijët dhe të rinjtë diçka nga vlerat dhe traditat islame -si rezultat i faktorëve tjerë- këto vlera do të jenë në gjendje konfrontimi dhe gara me vlerat perëndimore. Kështu do të shkapërderdhet personaliteti i muslimanit, do të dobësohen përbërësit e identitetit islam dhe do të zhduken karakteristikat e tij.

Problemi thellohet edhe më shumë kur sheh se si personat që marrin vendime politike dhe udhëheqësit e mendimit pedagogjik në shoqëritë islame injorojnë ose mohojnë njëanshmërinë e mendimit pedagogjik perëndimor. Këtë e mbështesin me argumente të pakuptimta, si p.sh. thënia se shkenca nuk njeh fe e as vatan, ose rëndësia e zhvillimit dhe kapja me të përparuarit, ose domosdoshmëria e modernizimit dhe dalja nga gjendja e prapambetjes etj. Gjitha këto arsyttime ishin argumente të sistemeve politike në Botën Islame dhe praktikat e tyre gjatë një shekulli, mirëpo rezultati ishte rritja e prapambetjes, pasimi i verbër, humbja e identitetit dhe pamundësia për prani efikase në arenën ndërkombëtare.

Krahas këtij përgjithësimi rreth gjendjes së mendimit pedagogjik dominues në Botën Islame sot, është patjetër të



kemi parasysh se ekziston edhe një burim tjetër i një pjesë të mendimit pedagogjik në disa vende të shteteve islame, ku konceptet, parimet, teoritë dhe praktikat pedagogjike i mbështet në trashëgiminë pedagogjike islame. Ne mendojmë se ekziston një problem real në të dy burimet. Edhe krahas asaj se trashëgimia pedagogjike islame është përvojë islame, megjithatë kjo përvojë duhet kuptuar në kontekst të kohës dhe vendit nga njëra anë, dhe vlerësimi i saj në bazë të referencës islame të cilën e përcakton kuptimi jonë bashkëkohor i intencave pedagogjike të ajeteve kur'anore dhe sunetit pejgamberik nga ana tjetër. Në dritën e këtij vlerësimi do të vërejmë se në trashëgimi ka shumë mendime “të gjalla” të cilat vazhdojnë të jenë të pranishme në realitetin tonë dhe janë bashkëkohore, ku nevoja për to ekziston edhe më tutje në shoqëritë tona dhe shoqëritë njerëzore në përgjithësi. Gjithashtu, në trashëgimi, do të gjejmë mendime, të cilat lehtë mund të dallohen se ishin gabim, ose kishte keqkuptim, ose praktikim të gabuar të intencave pedagogjike islame. Është pjesë e përgjegjësisë në vlerësim dhe guxim në kritikë të zbulohen këto çështje, ngase këto mendime, jo vetëm që mund të jenë “të vdekura”, por nëse vazhdon ndikimi i tyre në jetën praktike, mund të jenë edhe “vdekjeprurëse”.

Sa i përket problemit të burimit perëndimor të mendimit pedagogjik dominues në Botën Islame, përvoja njerëzore që e gjejmë në te, ka nevojë që së pari të kuptohet në dritën e sfondit ideologjik perëndimor dhe së dytë në dritën e nevojës së shoqërive tona dhe natyrën e problemeve të saj. Edhe pse vërejmë se disa nga këto përvoja janë të dobishme që meritojnë të studiohen, vlerësohen, përshtaten dhe zbatohen, disa tjera kanë mbështetje filozofike, kulturore dhe shoqërore, të cilat po që se zbatohen në shoqëritë tona, mund të shkaktojnë humbjen e identitetit dhe tjetërsimin. Në fund të fundit, problemi nuk fshehët në vetë burimin perëndimor, por në mënyrën e bashkëveprimit me te, ngase problemi real nuk është i veçantë me kulturën, natyrën dhe referencat perëndimore, por në mënyrën e bashkëveprimit me te.

Realiteti jonë pedagogjik në shoqëritë tona vazhdon të vuaj nga këto standarde të dyfishta, të cilat kanë filluar të shfaqen në shoqërinë islame që nga shekulli XIX. Edhe pse qysh nga fillimi i shekullit XX ka pasur dhe vazhdon të ketë zëra që me ngulje kërkojnë përplotësimin njohës mes reformimit të të kuptuarit të intencave pedagogjike islame dhe përfitimit nga përvoja njerëzore bashkëkohore, ku më pas duhet punuar për unifikimin e dy sistemeve arsimore, atë islame tradicionale dhe perëndimore bashkëkohore në një sistem, duke marrë të mirat e dy sistemeve dhe duke larguar dobësitë e tyre, megjithatë, ky dyfishim vazhdon të jetë e pranishme në forma të shumta, duke anuar drejt miratimit të përvojës perëndimore si bazë për çdo projekt dhe praktikë pedagogjike në shoqëritë tona dhe duke kufizuar shumë e më shumë arsimin fetar në orë të caktuara të arsimit publik dhe në fakultete dhe degë universitare për mësimin e “shariatit”.

Materia e këtij kapitulli shtrihet në tre pjesë. Në pjesën e parë kemi ofruar një përshkrim të përgjithshëm të realitetit të mendimit pedagogjik islam në kontekstin historik dhe bashkëkohor, duke u bazuar në atë që e zbulojnë plan-programet e arsimit universitar, rezultatet e hulumtimeve dhe institucionet hulumtuese dhe ndikimet politike dhe ekonomike. Realitetin e mendimit pedagogjik islam e shikojmë nën hijen e asaj që quhet krizë globale në arsim.

Pjesa e dytë vjen relativisht e zgjeruar dhe flet rreth problemit të referencës apo sfondit të mendimit pedagogjik bashkëkohor. Çdo mendim pedagogjik është patjetër të ketë një referencë të caktuar, nga e cila niset dhe në të bazohet. E shohim si të domosdoshme që pedagogët në shoqëritë tona islame të kuptojnë qartë referencën perëndimore të mendimit pedagogjik dominues në vendet perëndimore, ngase shumica e shoqërive tona mendimin pedagogjik e marrin nga përvoja bashkëkohore perëndimore, përfshirë referencat apo sfondin dhe praktikat. Është e njohur se mendimi pedagogjik perëndimor fillon duke theksuar thellësinë e tij historike qysh nga kohët e mëhershme, duke theksuar arritjet e filozofëve grekë. Mundet, kalimthi të theksohen disa nga civilizimet e

vjetra në Egjipt, Indi dhe Irak. Më pas flet për referencën fetare krishtere. Më pas tejkalon periudhat e errëta evropiane duke injoruar historinë e botës dhe civilizimet tjera jashtë Evropës gjatë kësaj periudhe, ku në këtë kohë ka kaluar periudha e artë e civilizimit islam, për të kaluar drejtpërdrejt te periudha e renesancës evropiane, periudha e zbulimeve shkencore dhe gjeografike. Kështu jep të dhëna rreth kontributit të shumë mendimtarëve dhe pedagogëve në Perëndim, përfshirë Evropën dhe Amerikën, duke injoruar tërësisht kontributet e mendimtarëve të popujve tjerë, në veçanti mendimtarët e civilizimit islam.

Pjesën e tretë e kemi veçuar për të biseduar rreth natyrës së vetëdijes rreth çështjes së reformave pedagogjike dhe përgjegjësitë e qarqeve pedagogjike në këto reforma. Këtu përfshihet theksimi i nivelit të prezencës së vizionit islam në reformat pedagogjike, kërkesat e ndryshimit të synuar në dritën e gjendjes reale dhe vetëdija ndaj pikënisjeve të reformave.

Kapitulli ka përfunduar me një përfundim, në të cilin shkurtimisht janë theksuar mundi dhe koha e nevojshme për reformim dhe përgjegjësinë e hulumtuesve dhe udhëheqësve pedagogjik në hulumtim rreth çështjes së reformave pedagogjike pa hequr dorë nga shpirti islam dhe bartja e amanetit.

# Pjesa e parë:

## Përshkrim i përgjithshëm i realitetit të mendimit pedagogjik islam dhe konteksti i tij historik dhe bashkëkohor

### 1. Plan-programet arsimore universitare

Ndoshta burim i parë për të njohur gjendjen e mendimit pedagogjik mbizotërues në vendet islame është hulumtimi rreth plan-programeve mësimore universitare. Është kështu ngase këto plan-programe zbulojnë gjendjen arsimore në mënyrë të qartë, sepse në to përfshihet njohja e studentëve universitarë dhe orienton mendimet e tyre drejt burimeve të njohjes. Këto njohuri dhe referencat e tyre ideologjike transferohen në mendimet e mësuesve të arsimit publik përmes praktikave mësimore. Le të marrim një shembull për këtë çështje nga pozita e personaliteteve me ndikim në mendimin pedagogjik, në të kaluarën dhe të tashmen. Do të vërejmë se studiuesit e pedagogjisë në universitetet arabe dhe islame, në nivele të ndryshme arsimore: deridiplomik, magistraturë dhe doktoraturë, obligohen të njohin kontributet e një numri të madh të personaliteteve perëndimore, përfshirë teoritë në specializimet e ndryshme pedagogjike, qoftë në filozofinë e pedagogjisë, bazat e pedagogjisë, historinë e pedagogjisë, psikologjinë pedagogjike, shkencat pedagogjike si: plan-programet, vlerësimi pedagogjik, metodat mësimore etj.

Vërejmë se emrat e këtyre personaliteteve përsëriten në lëndë të ndryshme pedagogjike, arritjet e tyre theksohen në përmbajtjet e këtyre lëndëve dhe përsëriten aq shumë sa që sjellin edhe bezdisje. Në anën tjetër, personalitetet pedagogjike islame mungojnë tërësisht nga përmbajtjet e këtyre lëndëve, deri në atë nivel, sa që nuk dinë asgjë rreth

Muhasibiut, Ibn Abdulberrit, Ibn Sehnunit, Kabisiut, Zernuxhiut, Ibn Xhemaas, Gazaliut, Ibn Haldunit, Shevkaniut dhe të tjerë, duke përjashtuar ata që kanë pasur mundësi të mësojnë lëndën: “Historia e pedagogjisë islame”, ose ata që kanë zgjedhur ndonjërin prej këtyre personaliteteve të jetë temë e diplomës universitare. A nuk është kjo manifestim i referencave apo sfondit perëndimor në përcaktimin e pikave historike të mendimit pedagogjik në botë?!

Është e vërtetë se në Botën Islame në çerekun e fundit të shekullit XX janë shfaqur disa programe rreth “pedagogjisë islame”, ku janë mbrojtur disa tema universitare rreth kontributit të personaliteteve nga trashëgimia pedagogjike islame, mirëpo kjo dukuri ka mbetur e izoluar në një rreth të caktuar, pa u kombinuar me programet e përgatitjes pedagogjike të lëndëve tjera universitare. Kështu që gjurmët e tyre nuk janë reflektuar në programet e specializimeve të ndryshme, të cilat kanë mbetur programe *copy past* e asaj që realizohet në universitetet perëndimore, përfshirë emrat, programet dhe kërkesat.

Është e dobishme lexuesi të mësojë se lënda: “Edukata islame” dhe tema të mbrojtura rreth personaliteteve pedagogjike islame, janë bërë temë studimi në shumë nga universitetet perëndimore.<sup>600</sup> Po ashtu, është e dobishme lexuesi të mësojë se botimet e reja të disa librave metodologjike rreth “Bazave pedagogjike - Foundations of Education” p.sh., kanë shtuar edhe disa pjesë rreth “Edukatës islame”, të cilat nuk ekzistonin në botimet e mëhershme të librave të njëjtë.<sup>601</sup> Ky zhvillim, ndoshta reflekton diç nga

<sup>600</sup> Gjatë kërkimit të abstrakteve të disertacioneve universitare (International Abstract Dissertation) në internet, lexuesi, nën titullin: Islamic Education, do të gjejë një numër të madh të disertacioneve. Nëse di të kërkon drejtë rreth personaliteteve islame në internet, do të disertacione rreth kontributit pedagogjik të Ibn Tejmijes, Ibn Haldunit etj. disa nga qendrat hulumtuese në Universitetet evropiane dhe amerikane publikojnë libra të veçanta rreth trashëgimisë pedagogjike islame. Shih fq.sh.

- Bradley, Cook. & Malkawi, Fathi (Editors). *Classical Foundations of Islamic Educational Thought: A Compendium of Parallel English-Arabic Texts*, Islamic Translation Series, Provo, UT.: Brigham Young University, (February 15, 2011).

<sup>601</sup> McNergney, Robert & Herbert, Joanne. *Foundations of Education: The Challenge of Professional Practice*. Third Edition. Boston: Allyn & Bacon, 2001, fq. 152.

gjurmët e prezantimit vendor islam dhe të kufizuar në shoqëritë perëndimore, më shumë se sa reflekton kujdesin dhe interesimin për miliona musliman në botë, ose pranim për madhësinë e civilizimit islam dhe kontributit të madh të tij në historinë njerëzore. Prania ideologjike dhe kulturore islame në Perëndim mund të jetë më me peshë se sa të gjithë muslimanët ku prania e tyre përkufizohet në strategjinë perëndimore si burim i materialit të papërpunuar dhe treg për prodhimet perëndimore.

## 2. Hulumtimet dhe institucionet hulumtuese

Hulumtimet të cilat i gjejmë në revistat e specializuara, disertacionet universitare dhe qendrat për hulumtime në institucionet vendore, rajonale dhe ndërkombëtare, mund të ndahen në tri lloje. Ajo që na intereson në këtë kontekst është lidhshmëria e këtyre hulumtimeve me referencat ideologjike islame. Sa i përket llojit të parë të hulumtimeve të cilat ndërlidhen me mendimin pedagogjik islam, ai në të shumtën e rasteve është i kufizuar në trashëgiminë pedagogjike islame, me një lidhje të dobët (ose të humbur) me realitetin pedagogjik bashkëkohor. Lloji i dytë i hulumtimeve përqendrohet rreth çështjeve parciais me natyrë artistike, ku hulumtuesi punon sipas një paradigme, me qëllim që të lejohet publikimi i tij ose të pranohet. Në këtë rast, shumë pak vërehet prezenca e vizionit të mendimit pedagogjik islam te hulumtuesi. Lloji i tretë është ai që e kryejnë institucionet politike ose ideologjike ose hulumtuese, ku përfshijnë hulumtime dhe raporte periodike rreth gjendjes së arsimit në vendet e ndryshme të botës. Atyre nuk u intereson shumë hulumtimi rreth burimeve të furnizimit pedagogjik, ngase çështje e padiskutueshme sipas tyre është se ata janë burim i gjendjes arsimore në botën bashkëkohore, dhe askush tjetër.

Shembuj të llojit të tretë janë hulumtimet dhe raportet të cilat i realizojnë institucionet ndërkombëtare si: Banka Botërore, UNESCO, institucione rajonale si p.sh. Fondacioni i mendimit arab. Kësaj i bashkëngjiten edhe ministritë e secilit

shtet dhe Qendrat vendore për hulumtim. Ajo që vërehet është se këto hulumtime dhe raporte përqendrohen në statistika në krahasim me realitetin e shteteve të përparuara. Shumë rrallë hasim në të dhëna cilësore të cilat flasin për identitetin ideologjik të shoqërive arabe, ose shanset që ofrojnë institucionet e arsimit të lartë në zhvillimin shoqëror dhe ekonomik. Raporti i Fondacionit të mendimit arab, ka shkuar aq larg saqë thotë se “daljet e arsimit të lartë nuk janë në lidhje të ngushtë me botën e punës”.<sup>602</sup>

Raporti i lartshënuar thekson se si rezultat i rritjes së numrit të institucioneve të arsimit të lartë, numri i të regjistruarve në arsimin e lartë është në rritje në Botën Arabe. Shkas për këtë rritje është “miratimi i shteteve të rajonit politika të hapjes dhe ligje që lejojnë sektorit publik dhe atij privat, vendor dhe të huaj themelimin e institucioneve të arsimit të lartë”. E gjithë kjo krahas programeve të veçanta në universitetet shtetërore që kanë për qëllim aspektin financiar, gjë e cila ka çuar drejt shtrenjtimit të arsimit. Megjithatë, është e vështirë të arrijmë në statistika të sakta rreth kësaj teme, ngase mungojnë të dhënat, të cilat sqarojnë numrin e institucioneve, llojet, programet e ofruara, numrin e studentëve dhe çështje tjera që lejojnë të japin një pasqyrë të saktë rreth institucioneve të arsimit të lartë në vendet arabe.<sup>603</sup> Si rezultat i kësaj gjendje kanë lindur shumë sfida, siç janë: raporti i universiteteve me qeverinë, mekanizmat e kontrollit dhe sigurimi i cilësisë.<sup>604</sup> Kjo gjendje nxitë pyetje rreth identitetit kombëtar dhe fetar të studentëve të këtij lloji të arsimit, sa do të kontribuojnë në daljen nga gjendja e prapambetjes, sidomos nëse kësaj ia bashkëngjesim edhe atë që theksohet në raport rreth programeve pedagogjike, ngase “numri i vogël i studentëve në programet pedagogjike në vendet arabe dhe numri i të diplomuarve, formon një sfidë në

<sup>602</sup> Muesseset’ul-fikr’il-arabiji. **El-Ibtikaru evil inditharu: el-bahth’ul-ilmij’ul-arabiju: vakiuhu ve tehadijjatuhu ve afakuhu.** Raporti i dhjetë arab për zhvillim dhe kulturë i vitit 2018, Bejrut: Muesseset’ul-fikr’il-arabiji, 2018, fq. 152.

<sup>603</sup> Po aty, fq. 143.

<sup>604</sup> Po aty, fq. 159-160.

vazhdimin e cilësisë së ulët të arsimit, në periudha të ndryshme”.<sup>605</sup>

Qëllimi i zhvillimit permanent dhe procedurat e këtij qëllimi janë bërë temë e rëndësishme në shoqëritë e ndryshme të botës. Institucionet e arsimit të lartë kanë filluar të interesohen për programe të ndryshme për realizimin e këtij qëllimi, si p.sh programi i arsimimit gjatë gjithë jetës, i cili realizohet përmes organizimit të kurseve të veçanta në përgatitjen artistike, zhvillimit administrativ dhe tjera që japin mundësinë e zhvillimit të shkathtësive dhe përvojave. E gjithë kjo, me qëllim që të përshtaten me ndryshimet e vazhdueshme në kërkesat e jetës shkencore. Raporti i Fondacionit të mendimit arab thekson se programe të tilla të cilat i ofrojnë universitetet arabe “kanë dështuar në lidhshmërinë e anëve kryesore të arsimit gjatë gjithë jetës dhe arsimit për edukim të vazhdueshëm”.<sup>606</sup>

Raporti i lartshënuar thekson se procesi mësimor shkollor dhe universitar vazhdon edhe më tutje të mbështetet në metodën e diktimit dhe mësimin përmendësh. Në procesin mësimor, mësuesi është faktor subjektiv dhe kryesor, ndërsa nxënësi faktor objektiv i cili pranon informacione, ... provimet realizohen vetëm duke mësuar njohuritë”. Metodatat mësimore, në vend të grumbullimit të informacioneve, duhet të përqendroheshin në elementet që ndërliqhen me proceset e mësimnxënies që mbështeten në të menduarit kritik, me qëllim të zhvillimit të shkathtësive të të diplomuarve dhe përgatitjes së tyre për kreativitet”.<sup>607</sup>

Edhe konkludimet që kanë dalë nga pjesa e parë rreth “realitetit të arsimit të lartë në shtetet arabe” ishin disa konkludime rreth disa çështjeve që mbështesin universitetet arabe “për të tejkaluar gjendjen aktuale dhe për të arritur në nivelet ndërkombëtare të arsimit të lartë dhe hulumtimit shkencor”.<sup>608</sup> Në kohë kur shteteve arabi iu mungoi bashkëpunimi në arsimin e lartë, disa prej këtyre shteteve

<sup>605</sup> Po aty, fq. 156.

<sup>606</sup> Po aty, fq. 159.

<sup>607</sup> Po aty, fq. 163.

<sup>608</sup> Po aty, fq. 167.



bëjnë marrëveshje bashkëpunimi dhe pranojnë plotësisht sistemet arsimore të shteteve tjera, siç është rasti i shteteve arabe të cilat kanë miratuar modelin evropian për arsim, i përfshirë në Marrëveshjen e Bolonjës për bashkëveprim evropian në arsimin e lartë.

Ajo që na intereson në këtë kontekst, njohja se problemet pedagogjike në vendet e Botës Islame janë të dyfishuar. Nga njëra anë janë të ndikuara nga problemet pedagogjike botërore, në një formë edhe më të madhe, dhe nga ana tjetër shpreh papërshtatshmërinë e mendimit pedagogjik të importuar, me natyrën, nevojat dhe problemet reale të shoqërive islame. Ekzistojnë disa probleme të veçanta të shoqërive islame, siç janë niveli i lartë i analfabetizmit. Organizata Arabe për Edukim, Shkencë dhe K

ulturë (ALESCO) ka njoftuar se përqindja e analfabetizmit në vendet arabe në fund të vitit 2017 ka arritur afër 21 %<sup>609</sup> për ata që janë mbi 15 vjeç, përballë përqindjes 13.6 % në nivel botëror. Kjo nënkupton se ekzistojnë 45 milion arabë analfabet. 13.5 % e arabëve nuk hyjnë në shkollë. Përqindja e analfabetizmit në Egjipt ka arritur në 25.8 %<sup>610</sup> dhe në Marok në 30 %.<sup>611</sup>

Ndërsa në nivel të Botës Islame, sipas Organizatës Islame për edukim, shkencë dhe kulturë (ICESCO), përqindja e analfabetizmit në vitin 2014 ka arritur në 50 %, prej tyre 40 % meshkuj dhe 65 % femra.<sup>612</sup> Kështu për shembull në Pakistan 42 % janë analfabet,<sup>613</sup> ndërsa në Afganistan 68 % e femrave dhe 40 % e meshkujve janë analfabetë.<sup>614</sup> Andaj, pritet që

<sup>609</sup> Shih webfaqen elektronike të organizatës: <http://www.aleco.org/newsite/2016-02-02-13-47-43/2114-2018-09-07-11-52-52.html>.

<sup>610</sup> Përqindja e analfabetizmit në Egjipt ka arritur në 25.8 % në përgjithësi. Në mesin e femrave ka arritur në 30.8 %, ndërsa në mesin e meshkujve në 21.1 %. Kjo sipas statistikave të vitit 2017. Shih gazetën "El Jevmus Sabiu" të datës 6 Korrik 2018. Shih formën elektronike në linkun: <http://tiny.cc/tmws6y>.

<sup>611</sup> Këtë e ka theksuar ministri Mustafa El Halfi, e publikuar më 31 Tetor 2017 në gazetën elektronike "Ilaf" e cila botohet në londër. Shih linkun: <https://elaph.com/Web/News/2017/10/1174739.html>.

<sup>612</sup> Sipas asaj që e transmeton faqja elektronike e Kanallit El Xhezirah të datës: 5.9.2014 në linkun: <http://tiny.cc/osws6y>.

<sup>613</sup> Sipas Gazetës pakistaneze Nation, ku përfshihet raporti i botuar më 2018. Shih linkun e formës elektronike të gazetës: <https://nation.com.pk/08-Feb-2018/literacy-rate-in-pakistan>.

<sup>614</sup> Këto të dhëna janë publikuar në statistikat e atlasit të botës. Shih linkun: <https://ar.actualitix.com/country/afg/ar-statistics-education-afghanistan.php>.

edukata dominuese në Botën Islame të jetë e paaftë për të trajtuar problemet vendore, e mos të flasim për kontributin e saj në trajtimin e problemeve botërore.

Është e dobishme realizimi i një studimi rreth literaturës së reformave pedagogjike në nivel të botës, për të hulumtuar rreth pozitës së hulumtuesve musliman në këtë literaturë, mendimit pedagogjik islam dhe metodologjisë reformuese, i cili do të ndihmon në zgjidhjen e problemeve, ose lehtësimin e tyre, jo vetëm në shoqëritë islame, por në të gjitha shoqëritë. A nuk kemi nevojë për një studim të tillë, që të bëhet e qartë mungesa e mendimit pedagogjik islam në arenën botërore, dhe për të përfunduar se Bota Arabe dhe Islame është vend për eksperimente dhe krahasimin e sistemeve pedagogjike përëndimore kur mbillen në vendet tona?!

### 3. Orientime politike dhe ekonomike

Arsimi publik në shoqëritë islame sot i nënshtrohet presioneve të mëdha nga ana e fuqive dominuese botërore, për ndryshimin e plan-programeve dhe largimin e teksteve për të cilat thonë se “nxisin urrejtje”, “nuk respektojnë tjetrin” dhe diktojnë “kulturën e terrorizmit”. Nën ndikimin e këtyre supozimeve, largohen tekste nga Kur’ani dhe suneti pejgamberik, ku në vend të tyre vendosen lëndë që flasin për paqe, ftojnë në dashuri, mirëpresin armiqtë, mohojnë veçoritë dhe kërcënojnë humbjen e identitetit. Këto presione nuk mjaftojnë vetëm me kërkesa politike të qarta, por japin edhe mbështetje financiare, ofrimin e përvojave dhe realizimin e trajnimeve për ndryshimin e plan-programeve. Këto presione gjejnë persona që i pranojnë ato, shpejtojnë në zbatimin e tyre dhe dalin në mbrojtjen e tyre.

Në kohë kur në botën bashkëkohore jashtë Botës Islame dhe brenda saj, hasen ftesa të shumta për realizimin e studimeve të gjera rreth plan-programeve arsimore në shtetet islame nën supozimin se ato nxisin urrejtjen dhe nxjerrin kuadro që ndihmojnë dhe zbatojnë terrorizmin, nuk gjejmë asnjë argument që e ofrojnë këto studime që flasin për

lidhshmërinë e këtyre plan-programeve me ekstremizmin, dhunën dhe nxitjen e urrejtjes. Është për t'u habitur, se në këtë periudhë kohore, nuk kemi vërejtur ftesa për studimin e plan-programeve të shkollave hebraike dhe krishtere, ose ndikimet e të së djathtës ekstremiste në SHBA dhe shtetet evropiane, të cilat mbështesin dukurinë e urrejtjes, ekstremizmit dhe dhunës.

Sa i përket arsimit universitar në shtetet islame sot, shembujt për mungesën e referencës së mendimit islam janë të shumta, gjë e cila hap udhën para fuqive të globalizmit dhe elementeve të saja perëndimore. Këto shembuj ndërliiden me sistemet dhe plan-programet arsimore, filozofinë e arsimit universitar, kriteret e cilësisë, sistemet e klasifikimit të universiteteve etj. Të gjitha këto vlerësohen sipas prezencës shkencore formale, sasisë, lehtësimeve materiale, të cilat janë përcaktuar në dritën e zhvillimit dhe miratimit në shoqëritë tjera, në kohë kur krahas mungesës së politikave të përshtatshme për zhvillim shoqëror, përparim kulturor dhe zhvillim ekonomik, janë anashkaluar edhe referencat islame me vlerë. Sistemet për pranim dhe miratim në vendet evropiane, e në veçanti ato amerikane janë bazë për përpilimin e sistemeve arsimore në shoqëritë islame.

Prej shembujve që flasin për presionet që ushtron globalizmi në lidhje me realizimin e cilësisë në arsim, kemi qëndrimin e UNESCO-s për trajtimin e cilësisë në arsimin e lartë ku kërkohen "kriteret mbi të cilat mund të bazohemi ndërkombëtarisht, që nënkupton veprim për pranim dhe besim reciprok, në atë mënyrë që programet kombëtare të sigurojnë cilësi me besueshmëri botërore".<sup>615</sup>

Shembull nga historia moderne për përvetësimin e sistemit arsimor të huaj tërësisht me titull, tekst dhe shpirt, nga ana e disa shteteve islame, në atë mënyrë që shpалosë pasimin ndaj tjerëve dhe tjetërsimin kulturor dhe arsimor, është edhe zbatimi i sistemit "LMD" për arsim të lartë në disa shoqëri. Duhet ditur se ky sistem -në esencë- është përpjekje

<sup>615</sup> Philip G. Altbach & Liz Reisberg & Laura E. Rumbley, *Trends in Global Higher Education: Tracking an Academic Revolution*, A Report Prepared for the 2009 World Conference on Higher Education, Paris: UNESCO, 2009, fq. 168.

për unifikimin e kriterëve cilësorë për arsimin e lartë në shtetet e Unionit Evropian, duke u bazuar në disa parime, ku më të rëndësishme janë: unifikimi i thirrjeve akademike, lehtësimi i lëvizjeve të studentëve, profesorëve dhe hulumtuesve, mbështetja e dimensionit evropian si përpjekje për të penguar dominimin amerikan. Megjithatë, këto shoqëri dhe shtete islame ishin më të shpejta në zbatimin e këtij sistemi dhe më të kujdesshëm ndaj tij, se sa vetë shtetet evropiane.

Fuqitë ndikuese më të rëndësishme drejt “globalizmit” dhe “internacionalizmit” dhe presionet politike që i ushtrojnë këto orientime këtyre ditëve, përfshihen në natyrën e ekonomisë botërore, e cila ngrihet mbi reklamimin e kulturës konsumuese shumë tërheqëse, e mbështetur nga fuqia dominuese politike, duke përdorur mjete informative me ndikim të madh. Në këtë gjendje, sistemi pedagogjik në shoqërinë bashkëkohore në vend se të jetë ndikues është bërë i ndikuar dhe në vend se të jetë mjet për ndryshimin dhe zhvillimin e shoqërisë në orientime të caktuara është i detyruar që të përshtatet me ndryshimet e njëpasnjëshme në shoqërinë moderne.

#### 4. Konteksti historik i realitetit të mendimit pedagogjik islam

Qysh nga lindja e saj, shoqëria islame ka nxituar për përfitimin e diturisë nga burimet e tij me mjetet që i kishte në disponim. Kështu kjo shoqëri ishte shoqëri e diturisë, mësimnxënies dhe mësimdhënies. Ajo në mënyrë të vazhdueshme përpiqej për të dalë nga analfabetizmi përmes mjeteve dhe metodave elementare për dituri dhe mësimnxënie, në veçanti leximi dhe shkrimi. Ai që pranonte Islamin, kërkohej prej tij të mësojë Kur’anin dhe sunetin e Muhammedit alejh’is-selam, duke përfshirë dispozitat dhe këshillat në çështjen e besimit, ibadetet, të drejtën civile dhe gjitha çështjet e jetës shoqërore, ekonomike, politike etj. Shoqëria ishte e detyrueshme të sigurojë të gjitha nevojat e shkencave dhe zanateve që kërkoreshin për rregullimin e

qyteteve, siç janë inxhinieria, administrimi, sistemimi i resurseve ekonomike siç janë: bujqësia, tregtia, dhe zanatet e ndryshme. Krahas saj, duhej të mësojnë çështjet e reja që e kërkonte nevoja për të ruajtur sigurinë e brendshme, krahas kërkesave për ruajtjen e sigurisë së jashtme, përfshirë gjitha mjetet e mbrojtjes dhe luftës.

E gjithë kjo ka nevojë për sistemim dhe menaxhim që siguron regjistrimin e çështjeve dhe sigurimin dhe menaxhimin e resurseve. Pasi shoqëria islame ishte në kontakt të vazhdueshëm me popujt e tjerë, qoftë në paqe apo luftë, kërkohej prej saj t'i zhvillon gjitha metodat e bashkëveprimit me kulturat tjera.

Gjitha këto ndryshime realizoheshin në periudhën peygamberike përmes rrugës së edukimit kur'anor dhe peygamberik, në formë graduale sipas rasteve dhe ngjarjeve që u ndodhnin individëve dhe shoqërisë. Pas periudhës peygamberike, tekstet nga Kur'ani dhe sqarimi praktik nga suneti peygamberik mbetën referenca kryesore për gjitha çështjet arsimore. Kuptimi i këtyre teksteve u zhvillua dhe lindi shkenca e fikhut dhe usuli fikhut. U përpiluan librat e fikhut dhe lindën shkollat juridike, të cilat i njohën si medhhebe juridike. U përpiluan edhe librat e akaidit (besimit) dhe çështjet e besimit dhe lindën shkollat akaidologjike, të cilat u njohën si shkolla kelamiste (apologjetike). U ndie nevoja për zhvillimin e gjuhës arabe. Kështu lindën shkenca në rregullat e gjuhës arabe si sintaksa dhe morfologjia, fjalorë dhe llojet e letërsisë dhe kritikës. Bazuar në atë se filluan të largohen nga periudha e gjuhës së Kur'anit dhe sunetit peygamberik, lindi nevoja për përpilimin e librave të tefsirit që bënin sqarimin e ajeteve sipas rasteve dhe intencave. Shkencat e historisë, astronomisë, inxhinierisë dhe mjekësisë nuk mungonin nga kjo lëvizje e vazhdueshme shkencore.

Në të gjitha këto shkenca, janë shkruar libra të shumtë. Kështu autori i secilit libër grumbullonte informacionet nga burimet, duke dhënë një mund të madh për të grumbulluar informacionet nga mësuesit e tij dhe duka kaluar dhe

udhëtuar nga një vend në tjetrin, pa kursyer fare jetën, mundin dhe pasurinë. Gjithë kësaj ia shtonte edhe përvojën dhe eksperiencën e tij personale.

Shkencat dhe përvojat e popujve të tjerë ishin prezentë në këtë lëvizje shkencore. Muslimanët kishin hyrë në këto shkenca pasi që i kishin pastruar sipas parimeve të besimit të tyre, i kishin shkrirë ë kulturën e tyre dhe i kishin shfrytëzuar për intencat e tyre. Përfitimi nga përvojat e popujve të tjerë e kishte shoqëruar shoqërinë islame që nga ditët e para. Muslimanët kishin mësuar idenë e hapjes së hendekut përreth Medinës si strategji luftime, gjë që ishte e panjohur për shoqërinë e re islame, por ishte e njohur te popujt e tjerë. Muslimanët mësuan përdorimin e artilerisë gjatë rrethimit të Taifit. Kush Muhammedi alejh'is-selam ndjeu nevojën për mësimin e disa gjuhëve të huaja, urdhëroi të mësohen ato. Omeri radijallahu anhu zbatoi sistemin e regjistrimit, gjë që nuk ishte e njohur në shoqërinë islame. Othman ibn Afani zbatoi idenë e shkrimit të mus'hafit dhe shpërndarjen e tij në qendrat islame. Abdulmelik ibn Mervani filloi shtypjen e valutës islame pasi muslimanët përdornin dinarin bizantin dhe dërhemin sasanit. Kështu ishte gjendja në të gjitha sferat e mundshme të përvojës njerëzore.

Kjo lëvizje e vazhdueshme shkencore ishte realizuar gjatë tre shekujve të parë të shoqërisë islame, e cila është themel i zhvillimit dhe përparimit civilizues në të gjitha fushat. Duhet theksuar se kjo shoqëri ishte zgjeruar dhe shtrirë gjeografikisht aq shumë sa që kishte përfshirë pjesë të mëdha të botës nga vendet e Azisë, Afrikës dhe Evropës. Si rezultat i kësaj shtrirje gjeografike dhe arritjeve shkencore kishte lindur një sistem islam botëror, që popujt të tjerë nuk kishin qare pa e pranuar atë dhe pa bashkëpunuar me të.

Krahas kësaj qartësie në çështjen e angazhimit permanent në dituri dhe mësim, si dhe kujdesit për përparimin e shoqërisë islame duke shfrytëzuar gjitha shkencat që ishin në disponim, në sfera të ndryshme, megjithatë, në disa rrethana, kjo çështje kishte stagnim. Në shekullin e katërt hixhri lindën disa dështime shkencore, të cilat dalë ngadalë filluan të rriten

në shekujt e mëvonshëm. Kështu, për shkaqe të ndryshme, filloi dukuria e imitimit. Një prej shkaqeve ishte mungesa e guximit të dijetarëve për të bërë ixhtihad, siç bënin dijetarët e mëhershëm. Këtë e bënin nga modestia, ose frika nga përballimi me kritikën e imituesve, ose dëshira për t'u përshatur me gjendjen politike dhe shkencore të njohur me fanatizmin medhhebor, si dhe të mjaftuarit e mësimin në një vend sipas medhhebit të pranuar dhe të legjitimuar me urdhrin e udhëheqësit. Në disa raste, shkak për te ishte frika se dijetari do të bie në konfrontime shkencore, të cilat përcillnin me vëmendje thëniet dhe qëndrimet e dijetarëve, duke kërkuar gjërat që mund të kritikohen ose duke gjykuar ndaj tij për devijim.

Në vend se të vazhdojnë me përpilimin origjinal dhe shkencor në fusha të ndryshme, ata filluan të kufizohen në komentimin e librave të të mëparshmëve, ose rishkrimin e librave të mëparshëm në formë më të shkurtër, ose radhitjen e tyre në forma të poezive me qëllim që të jetë sa më e lehtë për nxënie. E gjithë kjo ishte formë e stagnimit nga gjërat e reja dhe ngrirje në imitim. Kjo gjendje vazhdoi kështu, derisa popujt e tjerë, në veçanti në Evropë kishin filluar të ngritën dhe të posedon shkaqet e fuqisë dhe përparimit në fushat e shkencës, prodhimit dhe zbulimit. Kjo fuqi filloi të përdoret për luftimin e muslimanëve, copëtimin dhe nënshtrimin e tyre. Megjithatë, -në disa periudha- çështja me disa dijetarë kishte arritur deri në atë nivel sa që mohonin përdorimin e shkencave, përvojave dhe prodhimeve të cilat i kishin zhvilluar jomuslimanët, gjë e cila edhe më shumë kishte bërë ndarjen mes realitetit të shoqërisë islame dhe realitetit të shoqërive tjera.

Në realitet, vetëdija për problemin e prapambetjes shkencore ishte e hershme. Kjo vetëdije ishte shpërndarë në kuadër të disa grupeve të ndryshme. Disa prej tyre nuk patën sukses për të vazhduar përparimin. Disa të tjerë u vënë në shërbim të epsheve apo kërkesave të pushtetarëve. Disa ishin ngurtësuar në imitim, ose nga padija ose nga përtacia. Ndërsa disa i kishin dhënë prioritet kënaqësive të kësaj jete.

Do të sjellim vetëm dy tekste që flasin për prapambetjen që kishte goditur shoqërinë islame. Ebu Hamid Gazaliu ka thënë: “Udhërrëfyesit janë dijetarët, të cilët janë trashëgimtarët e Pejgamberëve. Ata janë bërë shumë të rrallë. Shumicën e tyre i ka mashtruar shejtani dhe kanë devijuar. Secili prej tyre kujdeset vetëm për interesin e tij, janë bërë në atë gjendje që të mirën e shohin si të keqe, ndërsa të keqen si të mirë. Kështu, flamuri i fesë u zhduk dhe udhëzimi në pjesët e tokës u shlye. Njerëzve u thonë se s’ka dituri përveç fetvasë së pushtetit. Gjykatësit kërkojnë ndihmën e tyre në raste kur ndodhin mosmarrëveshjet mes njerëzve, ose polemikat që kanë për qëllim mundjen e palës tjetër, ose fjali të stolisura që kanë për qëllim tërheqjen e masës së thjeshtë. Këta, përveç këtyre tri rasteve nuk gjejnë kurthe për në haram e as rrjetë për gjuajtje.

Sa i përket ahiretit dhe rrugës së selefijve të drejtë, të cilën Allahu në librin e Tij e ka quajtur fikh, urtësi, dituri, dritë, udhëzim dhe pjekuri, e gjithë kjo në mesin e krijesave është fshehur dhe harruar. Për derisa kjo çështje është bërë vrimë në fe, e pashë shumë të rëndësishme të merrem me përpilimin e librit “Ihjau ulum’id-din”, ku do të zbulohen metodat e imamëve të mëhershëm dhe do të sqarohen dituritë e dobishme të pejgamberëve dhe selef’us-salih”.<sup>616</sup>

Velijullahi ed Dehleviu sqaron gjendjen e shoqërisë islame pas shekullit të katërt hixhri duke thënë: “në mesin e tyre ndodhën gjëra, siç janë polemikat dhe mospajtimet në shkencën e fikhut dhe detajimet e tij. Po ashtu, ata u pajtuan me imitim, i cili kishte depërtuar thellë tek ata pa e hetuar fare. Kjo gjendje shkaktoi polemika mes tyre. Kur dikush prej tyre jepte fetva, tjetri e hidhte poshtë fetvanë e tij, kështu fjala nuk ndalej, përpos nëse kishte për atë çështje qëndrim të qartë të ndonjërit prej të hershmëve. Gjithashtu padrejtësia e gjykatësve..... gjithashtu padituria e njerëzve...në këtë kohë merreshin me fanatizëm... fitneja e këtyre polemikave dhe mospajtimeve ishte e afërt me fitnen e parë kur u kacafytën

<sup>616</sup> Ebu Hamid Muhamed ibn Muhamed El Gazali (d. 505 h./ 1111), *Ihjau ulum’id-din*, Beirut: Daru Ibn Hazm, bot. 1, 2005, fq. 8.



për pushtetin, ku secili i ndihmonte shokut të tij. Ashtu siç sollën kacafytjet e atëhershme mbretëri të padrejtë dhe ndodhi të shurdhra dhe qorre, edhe kjo solli injorancë, dyshime dhe iluzione. Pas tyre lindën dhe u zhvilluan gjenerata në imitim të pastër...secila gjeneratë që vinte pas tyre ishte me më shumë fitne dhe imitime, derisa përfunduan në mosangazhim për çështjet e fesë dhe të thonë: “ne kemi gjetur prindërit tanë në këtë gjendje, dhe ne me gjurmët e tyre udhëzohemi”. Tek Allahu drejtojmë ankesën dhe prej Tij kërkojmë ndihmë...”<sup>617</sup>

Nëse dy tekstet e mëparshme flasin për gjendjen e lëvizjes shkencore duke filluar nga shekulli i katërt hixhri, vallë kjo gjendje si ishte në shekujt e mëvonshme?!

Në fillim të shekullit trembëdhjetë hixhri, Sulltan Selimi i tretë (1203-1222 h./ 1789-1807) ishte përpjekur të qetësojë nivelin e luftërave me armiqtë e Shtetit Osman me qëllim të reformave të brendshme. Duke pasur parasysh epërsinë e evropianëve në sferën ushtarake dhe mjeteve të reja, kishte filluar të riorganizojë ushtrinë, të lirohet nga sistemi i mëhershëm dhe të përfitojë nga përvoja e evropianëve në arsimin ushtarak dhe prodhimet ushtarake. Mirëpo, personat me ndikim dhe me interes në shoqërinë osmane ndiqnin të gjitha përpjekjet për modernizim. Fuqitë që kundërshtonin modernizimin e ushtrisë ishin në disa fronte: sistemi i vjetër i ushtrisë, personat që kishin interesa nga gjendja e prapambetur dhe dijetarë të cilët kishin ndaluar përdorimin e armeve moderne, ngase ishin prodhim i jobesimtarëve.

Muhamed Ferid Beu në librin e tij rreth historisë së Shtetit Osman, ka regjistruar disa ngjarje të kësaj periudhe, duke përfshirë edhe rolin e dijetarëve në kundërshtimin e reformave. Rreth këtyre përpjekjeve dhe rezultateve të tyre, ai thekson: “Në këtë kohë vdes Myftiu, i cili e përkrahte sulltanin për përfshirjen e reformave ushtarake. Në vend të tij vjen Kadi asker Rumeli. Ai ishte me qëndrime të kundërta me myftiun paraparak. U bashkua me Mustafa Pashain, i cili

<sup>617</sup> Ahmed ibn Abdurrahim El-Faruki El-Hindi Ed-Dehlevi, i njohur si Shah Velijullah (vd. 1176 h./1762), *El-Insafu fi bejan'il-esbab'il-ihtilaf*, Beirut: Dar'un-Nefaisi, bot. 2, 1404 h., fq. 93-95.

ushtronte detyrën e sadrul a'dhamit (kryeministër) dhe disa prej dijetarëve për të shuar sistemin e ri ushtarak, duke thënë se është bidat dhe në kundërshtim me sheriatin. Për të realizuar qëllimet e tyre, filluan të mashtrojnë ushtarët..., në veshët e tyre kishte depërtuar se ata nuk janë këtu përveçse t'i detyrojnë të përfshihen në sistem dhe të veshin rrobat e perëndimorëve sipas modelit të të krishterëve, gjë që bie në kundërshtim me Kur'anin dhe sheriatin...". Autori më pas tregon se si është realizuar formimi i fuqive opozitare, duke ua ofruar protestuesve "emrat e gjithë atyre që përkrahnin reformat dhe projektin e sistemit ushtarak, përfshirë ministrat dhe personat me peshë. Kështu protestuesit kanë shkuar te shtëpitë e tyre, i kanë vrrarë dhe kanë sjellë kokat e tyre... kur dëgjoji Sulltani lajmin e protestave, menjëherë solli vendim për anulimin e sistemit të ri dhe lëshimin e ushtarëve të sistemuar. Protestuesit nuk mjaftuan me këtë, por vendosën shkarkimin e Sulltanit nga frika se do të kthehet për të realizuar projektin e tij. Për këtë u kishte ndihmuar myftiu, i cili në realitet ishte iniciatori kryesor i këtyre protestave. Ai solli fetva se çdo Sulltan që sjell sistemet e evropianëve dhe detyron popullatën për të pasuar ato, ai nuk meriton të jetë udhëheqës... protestat kishin zgjatur dy ditë, më pas u realizua shkarkimi i Sulltan Selimit të tretë".<sup>618</sup>

Ebu'l-A'la El-Mevdudi këto ngjarje historike i paraqet në formën e tij duke thënë: "Në fillim të shekullit XIX, Sulltan Selimi i tretë vërejti dobësinë e popullit osman. Ai filloi reformimin e sistemit administrativ, përhapjen e shkencave të reja, sistemimin e ushtrisë sipas modelit të ri dhe sjelljen e armatimit evropian. Mirëpo, sufistët injorantë dhe dijetarët e prapambetur, që nuk dinin gjë nga shkencat fetare dhe shpirti i tij, kundërshtonin reformat e Sulltanit. Sistemimin e ushtrisë sipas modelit perëndimor e llogaritnin si të pafe dhe veshjen e uniformës së re ushtarake e llogaritnin si përngjasim me të krishterët. Ata kundërshtuan edhe përdorimin e pushkës, sepse përdorimi i armëve të pafeve,

<sup>618</sup> Muhamed Ferid Bej El-Muhami Ferid, *Tarih'ud-devlet'il-alijet'il-uthmanijeh*, Beirut: Dar'un-Nefaisi, 1981, fq. 392-393.

sipas tyre ishte mëkat i madh... Ata me këto qëndrime i sollën dëm Islamit. Shejh'ul-islami Ataullah efendi kishte sjellë fetva se Sulltani i cili vepron "në kundërshtim me Kur'anin" nuk meriton të mbetet në pushtet. Krejt në fund, në vitin 1807 u shkarkua Sulltan Selimi. Kjo ishte hera e parë kur udhëheqësit fetarë me injorancën dhe errësirën e mendimit të tyre kishin paraqitur perceptim të gabueshëm se Islami është pengesë e përparimit....mirëpo, udhëheqësit fetarë turk të cilët ishin zero në shpirtin e të kuptuarit dhe ixhtihadit, injorant ndaj mësimëve të vërteta islame, kishin mbyllur sytë ndaj çdo ndryshimi dhe grusht-shteti... Sulltan Selimi e pasoi sulltan Mahmudin në pushtet. Ai u përpoq për reforma. Mirëpo, dijetarët përsëri e kishin kundërshtuar. Duke mposhtur shumë pengesa dhe vështirësi, sulltani në vitin 1826 arriti të promovojë organizimin e ri ushtarak në Turqi. Mirëpo, dijetarët vazhduan të thonë se gjitha këto reforma janë risi dhe bidat i keq, që ka për qëllim shkatërrimin e Islamit, se sulltani ka dalë prej fesë dhe se pjesëmarrja vullnetare në këtë ushtri me këtë model të ri është shkatërruese e besimit të muslimanëve".<sup>619</sup>

Muhamed Tahir ibn Ashur në mënyrë të detajuar ka sqaruar "prapambetjen e arsimit" dhe dukuritë e tij të shumta në Botën Islame. Ai shpreh vërejtjet e tij rreth kësaj çështje në veçanti për Tunizinë në fund të shekullit XIX dhe fillim të shekullit XX. Ai ka theksuar edhe kritikën që kanë dhënë shumë prej dijetarëve ndaj gjendjes arsimore në shekujt e mëparshëm. Prej tyre ka potencuar Kadi Ebu Bekr ibn'ul-Arabi, Ibn Halduni, ndërsa prej dijetarëve të kohës moderne që kanë sqaruar prapambetjen arsimore, ka theksuar shokun e tij Muhamed Huder Husejn.<sup>620</sup>

Ibn Ashuri që nga fillimi i jetës së tij shkencore është preokupuar me çështjen e arsimit. Ai ka studiuar gjendjen e prapambetjes së muslimanëve në këtë fushë, e cila manifestohej me probleme të shumta. Disa prej tyre ndërlihdeshin me mësuësin dhe metodat e tij mësimore. Disa

<sup>619</sup> Ebu'l-A'la El-Mevdudi, Nahnu ve'l-hadaret'ul-garbijjetu, Damask: Dar'ul-fikr, bot. 1, 1964, fq. 99-100.

<sup>620</sup> Ibn Ashur, Elejse's-subhu bikarib? Et-ta'lim'ur-arabijj'ul-islamijju: dirasetun tarihijjetun ve arauan ishlahijjetun, vepër e cituar, fq. 16-17.

ndërlidheshin me plan-programet mësimore. Mirëpo, ai kishte hetuar se problemi kryesor është prishja e sistemit arsimor në tërësi. Ai ka përcaktuar dy shkaqe të përgjithshme të prapambetjes: shkaqet e përgjithshme që kanë imponuar prapambetjen e muslimanëve pa marrë parasysh vendet dhe gjuhët e tyre,... dhe ndryshimi i shpejtë i sistemit të jetës shoqërore në vendet e ndryshme të botës, gjë që ka imponuar edhe ndryshimin e mendimeve, qëllimeve dhe vlerave mendore... E gjithë kjo është zhvilluar shumë shpejt, ndërsa muslimanët, në veçanti prijësit e shkencave islame, vazhdojnë në gjumë të thellë, gjë që ka qenë pengesë nga reformimi i programeve arsimore.”<sup>621</sup>

Ibn Ashuri ka përshkruar hollësisht gjendjen arsimore që dominonte në Universitetin Zejtun në fillim të shekullit XX. Në këtë përshkrim ka përfshirë gjendjen e profesorëve dhe studentëve, plan-programet dhe tekstet mësimore, afatin mësimor, mënyrat e vlerësimit, planin mësimor, përmbajtjet mësimore etj. Ai ka sqaruar problemet, ku disa prej tyre i ka konsideruar si shkaqe të prapambetjes në zhvillimin e shkencave dhe njohurive të muslimanët. Ai ka theksuar domosdoshmërinë e vrojtimit të problemeve nga të cilat vuajnë shkencat e trashëgimisë islame. Ka përcaktuar kërkesat e reformimit në sistemin, rregullat dhe parimet arsimore, si dhe në çdo shkencë racionale dhe tradicionale, duke përfshirë edhe reformimin e vet mësuesve. Shihet qartë se Ibn Ashuri ndjente vështirësinë e propozimeve të tij ndaj disa njerëzve. Këtë e kishte shprehur duhet thënë: “Ua përcjell këshillat e mia dhe jam i bindur se ka prej tyre që nuk dëshirojnë këshilla dhe ua shohin për të madhe atyre që thërrasin në përmirësimin e gjendjes. Megjithatë, atë që e thërret ndërgjegjja për obligueshmërinë e reformimit, qëndrimi i tyre nuk e bënë të dështuar. Për ata që dëmtohen ka argumente nga Kur’ani dhe historia”. Ai ndjente gjithashtu rëndësinë e bindjes së mësuesve për reformim dhe se ata mund të jenë pengesë në realizimin e tij duke thënë: “Çrregullimi më i madh që e vëren reformatori arsimor te

<sup>621</sup> Po aty, fq. 104-405.

mësuesit është urrejtja e sistemit, urrejtja e ligjeve dhe njohuritë e gabuara ndaj obligueshmërisë së kujdesit ndaj arsimit. Ata arsimin e shohin vetëm në një formë, të cilën e kanë njohur më parë, duke u arsyetuar se me këto forma kanë përparuar të parët tanë. Ky është arsyetim i atyre që luftojnë dhe urrejnë reformat. Demagogët kanë një arsyetim tjetër, ngase sjellja e ligjeve në arsim ua lidh duart mësuesve dhe ua ndalon shanset ku mund të përdorë aftësitë e tij për ngritjen e studentëve. Kjo është fjalë e drejtë që ka për qëllim të padrejtën. Duhet ditur se rregullat në arsim janë kritere përmes së cilave synohet siguria nga keqpërdorimi dhe mashtrimi dhe në të njëjtën kohë mualimi ka autorizim për të bërë ixhtihad. Me siguri se sjellja e ligjeve, mësuesve talentë ua shton edhe më shumë talentin e tyre.”<sup>622</sup>

Abdulhamid Ashak një prej hulumtuesve bashkëkohorë, ka vërtetuar disa shembuj që flasin për gjendjen e prapambetur arsimore në shoqëritë islame sot, të cilat kanë pasur rrënjët në periudha të ndryshme historike. Ai gjerësisht ka përshkruar gjendjen arsimore të vendeve të Magribit Arab, përfshirë gjendjen e brendshme dhe raportet e tyre me fuqitë e përparuara evropiane.<sup>623</sup> Më pas ka shprehur të kuptuarit e tij ndaj rrënjëve të krizës pedagogjike bashkëkohore duke thënë: “Gabojnë disa kur thonë se kriza e sistemit pedagogjik ka filluar me ardhjen e pushtetit turk në vendet islame, ose me arritjen e fushatës franceze në Egjipt, ose me okupimin anglez më pas, ose me okupimin francez ndaj Algjerisë. E vërteta është se kjo sëmundje është e vjetër. Premisat e krizës dhe çrregullimet kanë filluar shumë më herët. Mund të thuhet se problemi pedagogjik është shfaqur dhe zhvilluar me fillimin e periudhës së rënies, e cila si zakonisht fillon me zbehjen e civilizimit të muvehidëve. Që nga shekujt gjashtë dhe shtatë hixhri, sistemi pedagogjik arsimor nuk ka pasur mundësi të lirohet nga rënia dhe paaftësia që e kishte goditur. Që nga shekulli tetë hixhri kishte filluar gjendja arsimore të përkeqësohet dhe të priset

<sup>622</sup> Po aty, fq. 203.

<sup>623</sup> Abdulhamid Ashak, *Dau'l-atabi kadimun: el-meshru'ut-terbevij'ul-islamijju ve avaik'ut-texhdidi*, Ribat: Er-Rabitat'ul-Muhamedijeh, 2015, fq. 25-26.

gjë e cila kishte vazhduar deri në shekullin katërbëdhjetë hixhri. Arsimi kishte përfunduar në një gjendje të keqe dhe të dobët, e prapambetur nga nevojat e kohës, larg realitetit, sillej rreth imitimit, pajtohej me ngurtësinë, nuk dilte jashtë mendimeve të të parëve, qoftë në shpjegim, abstraktim, zgjerim ose radhitja në formë të poezive". Autori më pas thekson se fillimin e rënies e kanë theksuar shumë prej dijetarëve të trashëgimisë islame. Prej tyre ka potencuar: Ebu'l-Hasen El-Maverdi (v. 450 h./1058), Ibn Abdullberr (v. 463 h./1071), Hatib El-Bagdadi (v. 463 h./1071), Ebu Hamid Gazali (v. 505 h./1111), Ibn'ul-Arabi (v. 543 h./1148), Kadi Ijad (544 h./1149), Ibn Asakir (v. 571 h./1175), Ibn'ul-Xhevzi (v. 590 h./1194), Ibn Tejmije (v. 728 h./1328), Es-Subki (v. 771 h./1369), Esh-Shatibi (v. 790 h./1388), Ibn Haldun (v. 808 h./1405) etj.<sup>624</sup>

Kështu vërejmë se prapambetja e shoqërive islame ka filluar me devijimin na shpirti shkencor dhe reformues që e kërkon Islami dhe ka përfunduar me prapambeturi nga përfitimi i përvojave të nevojshme për bashkëveprim me zhvillimin në fushat e jetës. Në kohë kur disa popuj përfitonin njohuri dhe përvoja të reja, që ia shkonin asaj që ishte e njohur në shoqërinë islame, kjo e fundit vazhdonte në gjendjen e saj duke mbetur e prapambetur. Shembujt për këtë çështje janë të shumta në sferën e prodhimit dhe ndërtimitarisë, mjetet e luftës, institucionet arsimore etj. Realiteti i prapambetur i shoqërive bashkëkohore islame nuk është produkt vetëm i periudhës së re kohore, por, ekzistojnë elemente tjera të prapambetjes që kanë shoqëruar jetën shoqërore islame nga periudhat e mëhershme. Çdo përpjekje reformuese në realitetin pedagogjik islam është e domosdoshme, këtë çështje ta marrë parasysh.

## 5. Kriza e arsimit është krizë globale

Është e drejtë të thuhet se problemet bashkëkohore pedagogjike nuk janë vetëm probleme të Botës Islame. Nga

<sup>624</sup> Po aty, fq. 43-58.

ajo që u tha më herët vërejtëm se hulumtimet dhe studimet që flasin rreth realitetit arsimor në botë shprehin shqetësimin e madh, ngase shumë përpjekje të njëpasnjëshme për reformim dhe ndryshim kanë dështuar në realizimin e qëllimeve, kështu që problemet arsimore vazhdojnë të ripërtërihen. Ndoshta shkak për këtë çështje është se institucionet arsimore -në esencë- angazhohen për sigurimin e njohurive për nxënësit, në kohë kur njohuritë rriten dhe ripërtërihen shumë shpejtë. Kjo rritje dhe ripërtëritje ndodh jashtë institucioneve arsimore, respektivisht në qendrat e mendimit dhe hulumtimit. Kalimi i këtyre njohurive në plan-programet mësimore dhe përgatitja e mësimdhënësve merr kohë, kështu që arritja e njohurive të nxënësit vonohet. Kjo njohuri, ndoshta më parë arrin të mjetet e informimit.

Nëse mendimi bashkëkohor pedagogjik në Botën Islame vuan nga kriza të caktuara, vallë këto kriza a janë të ndërlidhura me realitetin e mendimit pedagogjik dominues në botë sot? Përshtypja e përgjithshme që mund të verifikohet në mënyrë empirike nga analizat hulumtuese që realizohen ndaj statistikave dhe raporteve zyrtare, atyre vendore dhe ndërkombëtare, është se gjendja arsimore në botën bashkëkohore, si dhe mendimi pedagogjik që përcakton cilësitë e kësaj gjendje, janë formuar nën ndikimin e referencës dhe sfondit ideologjik perëndimor. Kjo çështje, procesin e edukatës dhe arsimit -jashtë perëndimit- e ka futur në disa kriza që kanë të bëjnë me identitetin kombëtar dhe fetar. Mirëpo, kjo nuk nënkupton se edhe vetë burimet perëndimore nuk vërejnë këtë krizë, e as nuk zbulojnë manifestime tjera të krizës edukativo-arsimore në vetë Botën Perëndimore, duke folur për një krizë botërore në arsim.

Është e dobishme të nxjerrim në dritë disa manifestime të krizës arsimore në botën bashkëkohore. Sidomos kur dimë se mendimi rreth gjendjes dhe çështjeve të botës nuk është çështje e re. Formimi i perandorive në historinë e vjetër nuk ishte diç tjetër, pos rezultat i këtij mendimi. Shumica e popujve në kohët e vjetra synonin daljen jashtë kufijve të

tyre. Për këtë, vizatonin harta dhe fotografi të botës së njohur dhe i shfrytëzonin për qëllime lufte apo paqe.

Gjendja e botës është çështje për të cilën muslimani është patjetër t'ia kushton vëmendjen e nevojshme. Ajo që bie në sy se mendimi rreth gjendjes së botës, te muslimanët ekzistonte që nga kohët e hershme, përfshirë këtu edhe periudhën mekase të zbritjes së Kur'anit. Ajetet kur'anore të sures Er-Rrum potencojnë këtë çështje duke thënë:

﴿الْمُغْلِبَتِ الرُّومِ فِي أَدْنَى الْأَرْضِ وَهُمْ مِّن بَعْدِ غَلَبِهِمْ سَيَغْلِبُونَ فِي بَضْعِ سِنِينَ لِلَّهِ الْأَمْرُ مِنْ قَبْلُ وَمِن بَعْدِ وَيَوْمَئِذٍ يَفْرَحُ الْمُؤْمِنُونَ بِنَصْرِ اللَّهِ يَنْصُرُ مَن يَشَاءُ وَهُوَ الْعَزِيزُ الرَّحِيمُ﴾

“Elif, Lam, Mim. Bizantinët (rumët) u mundën, në tokën më afër (tokës së arabëve), por pas disfatës së tyre, ata do të ngadhënjejnë, brenda pak viteve. Çështja është vendim i Allahut, fillim e mbarim (për disfatë dhe për fitore). E atë ditë (kur do të fitojnë bizantinët) besimtarët do të gëzohen, për ndihmën e Allahut. Ai ndihmon atë që do dhe Ai është i gjithëfuqishëm, mëshirues” [Er-Rrum: 1-5]

Sot, në botë ekzistojnë disa çështje të cilat nuk janë të veçanta për një popull apo për një shoqëri, si p.sh.: ndryshimet klimatike, ndotja e ambientit, të drejtat e pronësisë ndërkombëtare, medikamentet mjekësore, llojlojshmëria biologjike, ndikimi i ndryshimeve gjenetike te kafshët dhe bimët etj. Të gjitha këto çështje janë problematika shkencore botërore. “Shkencëtarët në specializime natyrore dhe shoqërore e kanë bërë të zakonitë mendimin rreth këtyre çështjeve në nivel botëror. Gjatë krahasimit mes specializimeve, mund të thuhet se kjo dukuri më së shumti theksohet në specializimet shkencore natyrore. Kështu, tematikat dhe grupet specializuese janë bërë botërore. Edhe trajnimi i specialistëve është bërë mjet për shpërndarjen ndërkombëtare të aftësive, gjë që bën që çdo doktorant të jetë projekt emigrimi në të ardhmen”.<sup>625</sup>

Kur flasim për globalizimin dhe internacionalizimin arsimor, do të vërejmë se shumë prej hulumtimeve dhe studimeve flasin për krizë botërore në arsim. Kur flasim për

<sup>625</sup> Sari Hanefi, “Esemetu ve te’sil’ul-ulum’i-il-ixhtimajjeh”, Revista El-Mustakbel’ul-arabijj, nr. 451, shtator 2016, fq. 45-64.



gjendjen arsimore në Botën Islame dhe vuajtjet e saj nga krizat, është e drejtë të thuhet se problemet pedagogjike bashkëkohore nuk përfshijnë vetëm shtetet e Botës Islame.

Që nga mesi i shekullit XX vërejmë bisedë të pandërprerë rreth krizës botërore në edukim dhe arsimim. Për këtë krizë flasin studimet, librat, raportet dhe gazetatat. Ideja e ekzistimit të krizës botërore të re në arsim është përsëritur në shkrimet e Filip Kombs qysh në librin e tij të botuar më 1968, në të cilin ka përfshirë kumtesat e Konferencës Ndërkombëtare rreth krizës arsimore në botë në vitin 1967.<sup>626</sup> Më pas edhe në librin e tij të botuar më 1985 me titull "Problemi botëror në arsim: vizion nga vitet e tetëdhjeta".<sup>627</sup> Theksimi i kësaj tematike është përsëritur në shumë libra, hulumtime dhe raporte të botuara nga organizata botërore si p.sh.: UNESCO dhe Banka Botërore. Kjo temë është përfshirë edhe në shumë konferenca ndërkombëtare që ndërldheshin me arsimin, në të cilat përsëritej theksimi se sistemet e arsimit publik në shumë nga shtetet e botës janë më pak efikase dhe më dobët të ndërldhura me realitetin.

Literatura zakonisht flet për probleme të caktuara në sistemet arsimore në shtetet e pasura, ku në veçanti përfshijnë zhvillimin e programeve, përgatitjen e mësimsdhënësve, lidhshmërinë e rezultateve arsimore me tregun e punës, ndikimi i zhvillimit teknologjik, llojshmëria e rritur në sfodin e nxënësve etj. Një pjesë e madhe e përqendrimit orientohet në dallimet mes gjendjes arsimore në shtetet e pasura dhe shtetet e varfra. Në veçanti këtu përfshihen: dukuria e mosregjistrimit në shkolla, resurset e dobëta, financimi i dobët i arsimit, problemi i arsimimit të femrave, ndikimi i ndihmave nga jashtë, dështimi i eksperimenteve zhvillimore etj. Do të vërejmë se çelësi i trajtimit të krizës arsimore botërore është bashkëpunimi ndërkombëtar. Kjo -në esencë- nuk nënkupton këmbimin dhe

<sup>626</sup> Phillip H. Coombs, *The World Educational Crisis: A Analysis System*, New York and Oxford: Oxford University Press, 1968.

<sup>627</sup> Phillip H. Coombs, *The World Crisis in Education: The view from the Eighties*, New York and Oxford: Oxford University Press, 1985.

zhvillimin e përvojave, aq sa nënkupton ofrimin e përvojave nga shtetet e pasura te shtetet e varfra.

Literatura në fjalë zbulon raportet reciproke mes krizës arsimore dhe çështjeve shoqërore, ekonomike, politike dhe kulturore, duke i vënë këto raporte në kontekst botëror. Në lidhje me këtë do të sjellim si shembull një grup studimesh të përfshira në një libër të botuar më 2015, ku bazuar në studime shkencore, paraqet forma të diskutive të ndryshme rreth sqarimit të krizës arsimore në vendet e botës. Libri përfshin katërmbëdhjetë studime rreth arsimit në shtete të ndryshme nga Evropa, Azia dhe Afrika. Në të janë përfshirë arsimiti shkollor, arsimiti universitar, menaxhimi i arsimit, financimi i arsimit, ndikimi i përparimit teknologjik, migrimi, çështjet e globalizmit dhe multikulturalitetit në arsim, përgatitja e mësimeve të mësuara, dhuna në shkollë etj.<sup>628</sup>

Raporti i UNESCO-s rreth orientimeve botërore të arsimit të lartë i botuar më 2009, në përfundimin e tij thekson lidhshmërinë mes ekonomisë dhe arsimit të lartë. Raporti sqaron se lidhshmëria mes ekonomisë dhe arsimit të lartë vazhdon në formimin e dallimit mes shteteve, ngase, “sfida e madhe që na pret është ndarja jo e barabartë e kapitalit njerëzor dhe pasuritë, ku disa shteteve u jepet leje që plotësisht të përfitojnë nga shanset e reja, në kohë kur shtete tjera devijojnë shumë e më shumë”.<sup>629</sup>

Në abstraktin e raportit të përfshirë në këtë libër ka detajime rreth krizës financiare që kërcënon botën në formë të përgjithshme, ku do të ketë pasoja të mëdha në arsimin e lartë, disa prej të cilave mund të shihen edhe tash, ndërsa disa të tjera akoma nuk janë të qarta. Natyrisht se shtetet në zhvillim do të ndikohen më shumë. Mirëpo, “askush nuk e di thellësinë dhe gjerësinë e krizës. Megjithatë, shumica e ekspertëve dyshojnë në riparim të shpejtë. Si pasojë e saj, shihet se arsimiti i lartë do të hynë në rënie të rëndësishme.

<sup>628</sup> Pella Calogiannakis, & Nikos Papadakis, & Amalia Ifanti, (Editorë), *Crisis in Education: Socio- Economic, Political and Cultural challenges*, Nicosia, Cyprus: HM Studies. 2015.

<sup>629</sup> Philip G. Altbach, & Liz Reisberg, & Laura E. Rumbley, *Trends in Global Higher Education: Tracking an Academic Revolution*, A Report Prepared for the 2009 World Conference on Higher Education, Paris: UNESCO, 2009, fq. 171.

Nuk ka dyshim se arsimit i lartë do të hynë në një periudhë krize, që nuk ka ekzistuar që nga Lufta e Dytë Botërore, në kohë kur ndikimi i plotë akoma nuk është i qartë.”<sup>630</sup>

Është me rëndësi të theksohet se literatura rreth krizës botërore në arsim -kur flet rreth shoqërive islame- kujdeset vetëm për anët statistikore, duke i krahasuar me shoqëritë tjera, ndërsa nuk kujdeset fare për manifestimet e krizës që ndërlidhet me veçoritë ideologjike dhe kulturore të këtyre shoqërive.

Megjithatë, nuk mohojmë se disa raporte të organizatës ndërkombëtare për edukim, shkencë dhe kulturë (UNESCO) kanë tërhequr vëmendjen ndaj kësaj çështjeje. Në raportin e publikuar nga UNESCO në vitin 2009, në mënyrë të detajuar është folur për krizën edukativo-arsimore në botë, në kontekst të kthesave ekonomike dhe teknike në të cilën është duke kaluar bota. E gjithë kjo krahasim sqarimit të gjendjes arsimore në vendet në zhvillim në krahasim me vendet e pasura, dhe atë në sferën e shkathtësive teknike dhe gjuhësore. Raporti, nuk ka harruar të theksojë edhe rrezikun që kërcënon veçoritë kulturore të shoqërive. Ai ka folur rreth asaj që e ka quajtur konflikt për arsim të lartë. Në të thuhet: “Qysh nga mesi i shekullit XX, detyra shoqërore tradicionale e arsimit të lartë iu ka nënshtuar presioneve të shtuara. Universitetet të cilat tradicionalisht shihen si institucione kulturore kryesore që të jenë përgjegjëse për përparim kulturor dhe shoqëror të përgjithshëm, janë bërë të detyruara në formë të shtuar që të bashkëveprojnë me disa presione të reja të sqaruara në raport. “Tregu” i arsimit të lartë ka imponuar presion të madh ndaj përgjegjësisë së tij shoqërore. Në shumë pjesë të botës, do të vazhdojnë polemikat rreth detyrës bazike dhe prioriteteve të arsimit të lartë. Do të rriten pengesat të cilat përpiqen të ruajnë aktivitetet që shërbejnë interesin e përgjithshëm të shoqërisë në përballimin e prangave të shtuara financiare dhe kërkesat e tregut. Kështu, çdo shoqëri do të përballet me sfidat e balancimit mes nevojave dhe prioriteteve vendore me kriteret, praktikën dhe

<sup>630</sup> Ibid., page xx, from the Executive Summary of the Report.

pritjet e caktuara në nivel ndërkombëtar. Hulumtimet, do të përqendrohen më shumë për nevojat dhe prioritetet arsimore vendore apo do të anojnë më shumë për të ndjekur çështjet më tërheqëse të revistave ndërkombëtare dhe donatorëve?<sup>631</sup>

Edhe krahas ekzistimit të elementeve të përbashkëta të krizës edukativo-arsimore në vendet e botës, duhet theksuar se çdo shtet ka problemet e tij të veçanta. Problemet arsimore të secilit shtet mund të dokumentohen. Në revistën amerikane Chronicle of Higher Education (Realiteti i arsimit të lart) ka të dhëna permanente rreth problemeve të ndryshme arsimore si: çështjet administrative, financimi, programet, dhuna, sjellja etj. Në Britani, faqja elektronike e njohur me emrin The Conversation (Konverzacioni) e datës 20 Shkurt 2019 ka publikuar një Raport të gjatë me titull: “England’s school system is in crisis” (Sistemi shkollor i Anglisë është në krizë), ku përfshihet një numër i problemeve si: mungesa e mësimdhënësve, mësimi për provime, joekuivalenca mes mundësive për regjistrim në shkolla, ku disa kanë pagesa të larta që u mundësohet vetëm të pasurve dhe shkolla tjera ku hyjnë masa e thjeshtë dhe nuk ka arsim cilësor. Raporti ka folur edhe për universitetet britanike, duke potencuar se vuajnë nga kriza të rrezikshme financiare, gjë që ka bërë të pranojnë student pa kushte. Kjo gjë ka shndërruar studentët në punëtorë dhe myshteri. Universitetet kanë filluar të reklamojë veten si më tërheqëse për nga “mundësia për punësim” me qëllim të bashkëveprimit me krizën e mungesës së shanseve të mundshme në tregun e punës. Raporti ka përfshirë edhe rritjen e notave, duke u dhuruar një numri të madh të studenteve notat më të larta”.<sup>632</sup>

Revista britanike “The Gardian” (Gardian) më datë 18 prill 2019 ka publikuar një artikull të gjatë rreth krizës arsimore në Britani. Ka përfshirë disa tema, si: mungesa e numrit të mësimdhënësve, dëshirën për braktisjen e punës për shkak të lodhjeve të tepërta, mungesa e financave në arsim, gjë që ka

<sup>631</sup> Ibid, fq. 170.

<sup>632</sup> <https://theconversation.com/englands-school-system-is-in-crisis-could-labours-nationaleducation-service-be-the-solution-111555>.

çuar drejt mungesës së shërbimeve shkollore, rritja e numrit të nxënësve në një klasë, dhuna e nxënësve ndaj mësuesve etj. Raporti ka theksuar se rreth 26 % e mësimeve të mësuara me përvojë me më pak se pesë vite kanë braktisur profesionin e mësimit para vitit 2024, ngase kërkohet prej mësuesit të punojë 60-70 orë në javë, jo për t'i mësuar nxënësit, por për t'ua mundësuar të arrijnë notat gjatë provimeve.<sup>633</sup>

Në Raportin e Bankës Botërore të publikuar në faqen elektronike të saj më datë 22 Janar 2019 thuhet: “Bota përballet me krizë në arsim. Edhe krahas rritjes së madhe në shanset për arsimim, regjistrimi në shkollë, nuk nënkupton marrjen e diturisë. Mijëra miliona fëmijë të cilët regjistrohen në shkollë në të gjitha anët e botës, arrijnë moshën e pubertetit pa i mësuar disa shkathtësi elementare të cilat i kërkon jeta bashkëkohore, as nuk përfitojnë njohuri që u duhet për të njohur me përpikëri një profesion të përshtatshëm, ose formimin e familjes dhe edukimin e drejtë të fëmijëve. Raporti thekson se problemi kryesor në sigurimin e arsimit shkollor është ekzistimi i mësuesit të mirë. Nëse kriza e mësimit në esencë është krizë mësimore, atëherë nxënësit kanë nevojë për mësues të mirë. E gjithë kjo, krahas rëndësisë së teknologjisë bashkëkohore për përmirësimin e arsimit”.<sup>634</sup>

Vërejmë se pjesa dërrmuese e asaj që publikohet rreth krizës arsimore në botë i takon krahasimeve mes shteteve të dalluara në hyrjet financiare mesatare. Çështja që mbështeten rreth gjendjes arsimore në botë është informacionet që mund të sigurohen nga shoqëritë që marrin pjesë në provimet ndërkombëtare. Si p.sh. testimi PISA<sup>635</sup> dhe testimi TIMSS<sup>636</sup>. Gjithashtu, mbështetja realizohet në të dhënat e shteteve të ndryshme që i siguron Banka Botërore. Ka raste kur nuk ka shkollë, por ka raste edhe kur ka shkollë, mirëpo, nxënësit i

<sup>633</sup> <https://www.theguardian.com/education/2019/apr/18/english-schools-will-see-super-sized-classes-warns-teachers-union>.

<sup>634</sup> <https://www.worldbank.org/en/news/immersive-story/2019/01/22/pass-or-fail-how-can-the-world-does-homework>.

<sup>635</sup> Programme for International Student Assessment.

<sup>636</sup> Trends of International Mathematics and Science Study.

braktisin ato pa përfituar edhe çështjet elementare arsimore. Ka raste kur nxënësit përfundojnë arsimin shkollor pa u ofruar atyre shkolla arsim të mirë. Arsimi i mirë në studime të tilla përfshin shkathtësitë e leximit, shkrimin, llogaritjes, përdorimin e teknologjisë dhe përfitimin e shkathtësive të jetës.

Banka Botërore më 2014 ka publikuar një libër rreth rezultateve të vlerësimit të 22 programeve reformuese pedagogjike në 11 shtete në Azi, Afrikë dhe Amerikën Jugore. Titulli i librit ishte: “Bërja e shkollave të punojnë: argument i ri rreth përgjegjësisë në programet e reformave”. Libri ka përshkruar rreziqet me të cilat përballet arsimi cilësor në botë për shkaqe që nuk ndërliken me resurset e pakta. Jep të dhëna rreth rasteve ku janë zhvilluar politikat arsimore, mirëpo nuk ka përfunduar në përmirësimet e shprehura. Libri gjithashtu ka sqaruar sasinë dhe çmimin e këtij dështimi. Sipas tyre shkak kryesor për dështimin është dobësia e përgjegjësisë mes palëve që ofrojnë shërbime pedagogjike nga njëra anë, si dhe inspektorët dhe mësuesit nga ana tjetër. Libri ka vërtetuar se pedagogjia e cila është “epiqendra e formimit të kapitalit njerëzor” është në një krizë të vërtetë. Në veçanti 56 % e fëmijëve të botës janë më pak se gjysma e asaj që mund ta kryejnë sikur të sigurohej për ta arsimi i mirë.<sup>637</sup>

Vërehet se pjesa dërrmuese e asaj që e publikojnë institucionet ndërkombëtare rreth krizës arsimore në botë, si dhe pjesa dërrmuese e rekomandimeve të konferencave ndërkombëtare që ndërliken me reformat arsimore në botë, gjatë gjysmë shekulli, vazhdojnë të sillen rreth të njëjtës çështje të cilën e kishte rekomanduar konferenca ndërkombëtare e mbajtur më 1967 në Williamsburg/ Virxhinia të SHBA-ve, ku krizën arsimore në botë në mënyrë të shkurtër e kishte përshkruar se përfshihet në prapambetjen e shteteve të varfra dhe në zhvillim në krahasim me shtetet e pasura dhe të përparuara. Andaj, është e patjetërsueshme që

<sup>637</sup> <http://documents.worldbank.org/curated/en/483221468147581570/Making-schools-work-new-evidence-on-accountability-reforms>.

shtetet në zhvillim të përfitojnë nga arritjet e shteteve përparimtare dhe se shtetet përparimtare është e domosdoshme të ofrojnë mbështetje pedagogjike shteteve në zhvillim në atë mënyrë që vërehet shpirti dominues dhe koncentrimi perëndimor.

Raporti i konferencës së përmendur më lartë ka theksuar shkaqet që bën udhëheqësit pedagogjik dhe mësimdhënësit në vendet në zhvillim të kuptojnë shpejt dhe qartë të heqin dorë nga “folklori dhe pengesat tjera” që i ndalon të ndjekin një drejtim pedagogjik të ri për vendet e tyre. Megjithatë, autori i qetëson këta udhëheqës pedagogjik se nëse e bëjnë këtë, nuk është larg ajo ditë kur mund të drejtohen inovacionet pedagogjike nga popujt e varfër te popujt e pasur.

Raporti ka vërtetuar se çdo strategji për zhvillim pedagogjik në çdo vend duhet të ketë në llogari se çdo shoqëri -sido që të jetë gjendja e saj, e pasur apo e varfër- duhet vetë të vendosë për çështjen pedagogjike, mirëpo, -në të njëjtën kohë- autori thekson se asnjë shoqëri nuk mund ta realizojë këtë në vete. Megjithatë, rekomandimi i parë i kësaj konference ishte se arsimit është preokupimi kryesor i gjithë popujve në botë, por planet pedagogjike nuk mund të jenë tërësisht të suksesshme përpos me krahasim me sistemet dhe planet pedagogjike të shteteve tjera.

## Pjesa e dytë: Referenca (El merxheijeh) e mendimit pedagogjik bashkëkohor

Nuk diskutohet çështja se realiteti pedagogjik bashkëkohor në Botën Islame është i ngjyrosur me ngjyrën e mendimit pedagogjik dominues në botë. Në te dominon mendimi perëndimor përfshirë konceptet, teoritë dhe praktikat e tij. Më e rëndësishme se e gjithë ajo që u tha më lartë janë referencat ideologjike. Andaj, është e dobishme të zgjerohemi në analizimin e referencës filozofike dhe praktike të mendimit pedagogjik dominues perëndimor, me qëllim që të ndihmojë në kuptimin tonë ndaj realitetit të mendimit pedagogjik bashkëkohor në Botën Islame, si dhe në formimin e vizionit ndaj mënyrës së bashkëveprimit me këtë referencë perëndimore gjatë përpjekjeve tona për reformimin e realitetit tonë pedagogjik.

Nuk ka mendim pedagogjik që nuk ka referencë nga e cila niset dhe vë kornizat në kuadër të kufijve të saj filozofik, kulturor dhe shoqëror. Andaj, pritet që mendimi pedagogjik, teorikisht dhe praktikisht, në çdo shoqëri të ngjyroset me ngjyrën e referencës ideologjike dhe kulturore të veçantë për këtë shoqëri, si dhe ngjyrën e vlerave, traditave dhe zakoneve dominuese në te. Kjo është shprehje e një paragjykimi që nuk mund t'i ikësh, ngase në gjendje normale nuk pritet që pedagogjia të orientohet drejt shuarjes së vlerave të shoqërisë, ose zhvlerësimin e traditave dhe zakoneve. Këto vlera dhe tradita mbështesin shoqërinë dhe bën studentët të kujdesen dhe të mburren me to. Detyra e mësimdhënësit dhe edukatorit është që të kultivojë ato dhe të organizojë qëndrimin pedagogjik, i cili u jep nxënësve mundësinë e të kuptuarit, mendimit dhe krahasimit, gjë e cila u mundëson të përvetësojnë vlerat e shoqërisë së tyre si rezultat i bindjes, si dhe u mundëson të zbulojnë problemet të cilat mund të



devijojnë nga këto vlera. Krejt në fund, në të ardhmen, do t'ju mundësojë kryerjen e detyrës në formimin dhe zhvillimin e shoqërisë dhe ruajtjen e identitetit.

Rëndësia e referencës në mendimin pedagogjik islam shfaqet në konceptin të cilin do ta sqarojmë më vonë. Ai është bazament i besimit, vlerave dhe mendimeve të cilat i formon individi apo shoqëria rreth vetes, jetës dhe universit. Në të njëjtën kohë përcakton standardet për qëndrimet dhe sjelljet në çështjet anësore, ngase posedon vendosmërinë dhe ndikimin e thellë që është i fshehur në mendjet dhe zemrat e tyre. Kur njerëzit pajtohen për referencat, atëherë ajo ka fuqi të madhe në formimin e elementeve të pajtueshmërisë mes përbërësve shoqërorë. Shkaqet e konflikteve dhe hasmërive, në të shumtën e rasteve janë si rezultat që ndërliken me referencat. Kështu, unifikimi i referencave është siguresa e shoqërisë nga mosmarrëveshjet dhe konfliktet.

Rëndësia e referencës shihet edhe në lidhshmërinë e fortë që ka me filozofinë pedagogjike, përfshirë politikat, programet dhe praktikat e saja. Krejt në fund, referenca është vizioni i botës që ofron perceptimin dhe të kuptuarit tonë ndaj njeriut, i cili është objekt i pedagogjisë. Andaj, personaliteti i njeriut me dy anët e tij, atë logjik dhe psikik, si dhe përgatitja e tij natyrale për të mësuar dhe për të përfituar njohuri, format, programet, metodat më efikase në mësimnxënie dhe mësimdhënie, lënda e cila i nevojitet njeriut, si dhe çështjet tjera si bazat filozofike, psikike, shoqërore dhe njohëse të pedagogjisë, që të gjitha përcaktohen në dritën e referencës.

Në kapitullin e parë të këtij libri trajtuam temën e filozofive dhe referencave bashkëkohore të mendimit pedagogjik perëndimor. Në këtë pjesë të këtij kapitulli do të trajtojmë konceptin e referencës. Shkurtimisht, do të theksojmë llojet dhe nivelet e referencës, do të sqarojmë disa veçori të përgjithshme të referencës së mendimit perëndimor, do të sqarojmë se ç'synohet me disa prej këtyre filozofive dhe disa përfaqësime në mendimin pedagogjik bashkëkohor. Me këtë kemi për qëllim të kontribuojmë në të kuptuarit e

mendimit pedagogjik dominues në shoqëritë islame në kohën e sotme, si dhe të lehtësojmë rrugët e rikthimit të mendimit pedagogjik bashkëkohor islam në referencën e tij, me qëllim që të kryen rolin e tij në reformat pedagogjike dhe në reformat e përgjithshme të shoqërive tona bashkëkohore islame.

## 1. Koncepti “referencë -el-merxheijeh”, llojet dhe nivelet

Shprehja el-merxheijeh<sup>638</sup> rrjedh nga fjala trekonsonantore rexhea që ka kuptimin e kthimit. Prej saj del fjala ruxhu’u dhe merxhe’u që nënkupton kthim tek ai, pra kthim i idesë, tematikës apo çështjes në esencën e saj apo gjendje që mund të krahasohet me te. Në Kur’anin Famëlartë, shprehjet ruxhu’un, avdetun dhe reddun kanë kuptime të përbashkëta në sqarimin e disa kuptimeve që ndërliidhen mes veti. Do të zgjedhim fjalët “rexhea” dhe “redde” për të theksuar lidhshmërinë me el-merxheijeh-referencë. Allahu thotë: إِنَّ إِلَىٰ ﴿كَلَّا إِنَّ الْإِنْسَانَ لِرَبِّهِ لَكَنَّا كَافٍ﴾ “Jo, është e vërtetë se ai i kalon kufijtë, për shkak se e ndien veten të pavarur. Po kthimi është vetëm te Zoti yt” [El-Alek: 6-8]. Si mund njeriu të heq dorë nga Zoti i tij, kur ai është i nevojshëm dhe i varfër për Të?! “Heqja dorë është joreale, ngase njeriu ka nevojë për Të në çështjet më të rëndësishme të jetës së tij, duke mos e ditur se çka mund t’i sjell Zoti atij. Nuk duhet të mashtrohet me pasuri false në këtë jetë. Është shprehja “er-rruxh’a” që në ajet është përdorur sipas kuptimit alegorik të tij, e që nënkupton nevojën për t’u kthyer tek Ai”.<sup>639</sup>

Rreth rrëfimit të Jusufit alejh’is-selam në Kur’an theksohet:

﴿وَقَالَ الْمَلِكُ ائْتُونِي بِهِ فَلَمَّا جَاءَهُ الرَّسُولُ قَالَ ارْجِعْ إِلَىٰ رَبِّكَ فَاسْأَلْهُ مَا بَالُ النَّسُوءِ الَّذِي قَطَعْتَ  
أَيْدِيَهُنَّ إِنَّ رَبِّي بِكَيْدِهِنَّ عَلِيمٌ﴾

“E mbreti tha: “Ma sillni mua atë (Jusufin)!” Dhe kur i shkoi atij (Jusufi) i dërguari (i mbretit), ai i tha: “Kthehu te zotëriu yt dhe pyete atë: Ç’është puna e grave që i prenë

<sup>638</sup> Në gjuhën shqipe mund të përdoret si referencë, sfond dhe begraund. Ne preferojmë përdorimin e fjalës referencë. (v.fq.)

<sup>639</sup> Ibn Ashur. **Tefsirut tehriri vet tenviri**, vepër e cituar, vëll. 30, fq. 446.

duart e tyre? Vërtet, Zoti im e di shumë mirë dredhinë e tyre". [Jusuf: 50] Është patjetër të zbulohet e vërteta dhe personi akuzues të pranojë pafajësinë e të akuzuarit. Kërkohej që i dërguari të "kthehet-je'udu" te mbreti para se të pranojë Jusufi kërkesën e tij për prezantim për të "rishikuar-muraxheah" çështjen e akuzës dhe të vërtetohet nga pafajësia nga gjuha e vet atij që ka akuzuar, kështu gjërat kthehen në vend. Shprehja el-merxhei'jjeh -në kontekstin për të cilin jemi duke folur- nënkupton kthim (el-avdetu ve'r-reddu). Fjala er-reddu sqarohet plotësisht në disa ajete kur'anore. Si p.sh. ﴿فَإِنْ تَنَازَعْتُمْ فِي شَيْءٍ فَرُدُّوهُ إِلَى اللَّهِ وَالرَّسُولِ﴾ "Nëse nuk pajtoheni për ndonjë çështje, atëherë kthejeni atë tek Allahu (te libri i Tij) dhe tek i dërguari" [En-Nisa': 59]. Po ashtu: ﴿وَلَوْ﴾  
 ﴿رُدُّوهُ إِلَى الرَّسُولِ وَإِلَى أُولِي الْأَمْرِ مِنْهُمْ لَعَلِمَهُ الَّذِينَ يَسْتَنبِطُونَهُ مِنْهُمْ﴾  
 "E sikur t'ia linin (kthenin) atë (përhapjen lajmit) Pejgamberit dhe përgjegjësve të tyre, ata do dinin të nxjerrin përfundime (se si do të duhej shpallur)". [En-Nisa': 83]. Fjala "er-reddu" këtu nënkupton lënien e çështjes në duart e atij që është në pozicion më të madh se qëndrimet e atyre që nuk kanë pajtime në të kuptuarit e dispozitës.

"Bazuar në këtë, përdorimi i fjalës "rexhea" nga e cila kanë dalë edhe fjalët: "el-merxheu" dhe "el-merxhei'jjeh" në këtë kuptim në mendimin arab dhe islam bashkëkohor, nënkupton se të kthyerit tek ai, është bazament dhe parim universal gjithëpërfshirës, që ndërpret mosmarrëveshjet dhe përfundon konfliktin. Në të shumtën e rasteve, pas ndonjë mosmarrëveshje ose konflikti në ndonjë çështje anësore, bëhet kthimi në bazament."<sup>640</sup> Shihet qartë se kthimi në esencë për të mënjeluar mosmarrëveshjen nuk është pjesë e elementeve të mosmarrëveshjes. Ajo është "merxhe'ijjeh-referencë" e përbashkët e palëve, ngase shpreh identitetin origjinal që i bashkon ata dhe qenien civilizuese që i dallon ata.

Në rrethin e shkencave islame, në të kaluarin dhe të tashmen, njerëzit vazhdojnë të kenë mendime të ndryshme

<sup>640</sup> Shibar, Seid. "Fi mefhumil merxheijeti vestī'malatil fikril arabiji vel islamijil muasiri" **Mexheletu dirasatun mustalahijetun** (Maroko), nr. (2), 1423 h./ 2002, fq. 86.

rreth “el-merxhe’ijjeh- referencës” ku do të kthehen për mënjanimin e mospajtimeve në mendime, ose dispozitën rreth ndonjë çështje. Ka disa që nuk pranojnë referencë tjetër veç Kur’anit, disa të tjerë thonë se suneti pejamberik sqaron Kur’anin, disa tjerë pranojnë veprimet e sahabëve dhe banorëve të Medinës si referencë, disa i japin përparësi përvojës historike e përfshirë në trashëgimi, disa tjerë dispozitat juridike të veçanta i shohin vetëm përmes medhhebit apo imamet të medhhebit.

Këto mospajtime rreth referencës ishin shkak për lindjen e rrymave ideologjike, ku pasuesit e tyre kaluan në fanatizëm dhe shkaktoi humbjen e unitetit të muslimanëve. Duhet ditur se Allahu përmes shpalljes dhe udhëzimit pejgamberik duke i zbritur ato në jetën reale, deshi të jenë referencë për mbarë muslimanët, nga e cila mund të heqë dorë vetëm i humburi. Edhe më shumë se kaq, Allahu deshi të jetë një referencë që do të bashkonte besimtarët dhe ithtarët e librit në një fjalë të përbashkët. Allahu thotë: ﴿قُلْ يَا أَهْلَ الْكِتَابِ تَعَالَوْا إِلَى كَلِمَةٍ سَوَاءٍ بَيْنَنَا وَبَيْنَكُمْ أَلَّا نَعْبُدَ إِلَّا اللَّهَ وَلَا نُشْرِكَ بِهِ شَيْئًا وَلَا يَتَّخِذَ بَعْضُنَا بَعْضًا أَرْبَابًا مِنْ دُونِ اللَّهِ﴾

“Thuaju (o i dërguar): “O ithtarë të librit (Tevrat e Inxhil), ejani (të bashkohemi) te një fjalë që është e njëjtë (e drejtë) mes nesh dhe mes jush: Të mos adhurojmë, pos Allahut, të mos ia bëjmë Atij asnjë send shok, të mos e konsiderojmë njëri - tjetrin zota pos Allahut”. [Alu Imran: 64]. Legjislativja e Medinës të cilën e përpiloi Muhammedi alejh’is-selam në “Kartën e Medinës” ishte referencë për gjithë ata të cilët ishin në Medinë, muslimanë dhe të tjerë.

Përcaktimi e referencës është përpjekje për një çështje universale dhe gjithëpërfshirëse, në të cilën do të përfshiheshin pikat e përbashkëta të pranuar nga të gjitha grupet e shoqërisë. Ajo është korniza gjithëpërfshirëse, e cila realizon interesat më të mëdha të mundshme dhe largon dëmet më të mëdha të mundshme, pa anuluar dallimet parciale në medhheb dhe shkolla ideologjike.

Kështu, referenca është term që thekson besimet, parimet dhe vlerat që formojnë një referencë vendimmarrëse, tek e cila do të bazohet në rast të gjykimit ndaj ndonjë qëndrimi,

mendimi dhe sjellje, se është e saktë apo e gabuar. Në këtë mënyrë, referenca përfaqëson një autoritet, e cila gjykon në rast mospajtimi, ose përfaqëson një kornizë reference në të cilën mbështeten procedurat dhe hapat praktikë në çështjet e përgjithshme politike, ekonomike, shoqërore, edukativo-arsimore, juridike etj.

Referenca mund të jetë në nivele të ndryshme. Ka referencë universale që shpreh besimet dhe vlerat e veçanta të një populli, identitetin dhe karakteristikat. Referenca e këtij niveli ndonjëherë njihet edhe me emrin vizioni universal ose vizioni i botës, i cili përcakton bindjet e veçanta rreth botës natyrore, shoqërore dhe psikologjike, si p.sh.: origjina e universit, jetës dhe njeriut, vlerat e sjelljes, çështjet e njohjes, jeta dhe vdekja, e mira dhe e keqja, historia, kultura dhe civilizimi.

Referenca e këtij niveli më të lartë; niveli i besimit apo filozofisë universale: “është ideja substanciale e cila formon bazament për gjitha mendimet, në një model të caktuar, shtyllë përfundimtare dhe e palëvizshme, që vizioni ndaj botës nuk mund të ngrihet pa te... Parim i vetëm, tek i cili kthehen gjitha çështjet... Prej këtu, mund të thuhet se referenca është absolutja e mëvetësishme, që i tejkalon të gjithë individët, çështjet apo dukuritë, i cili i jep botës stabilitet, rregullim dhe kuptim, si dhe përcakton të lejuarën dhe të ndaluarën”.<sup>641</sup>

El-Mesiri këtë nivel të referencës e quan “referencë përfundimtare”. Ai bën dallimin mes dy llojeve.

**Lloji i parë:** referencë përfundimtare tejkaluëse, jashtë botës materiale. Element themelor në te është ekzistimi i Zotit Krijues “i Vetëm, i pastër nga vetitë e natyrës dhe historisë, i Cili i lëviz ato dhe nuk gjendet në to”. Sa i përket njeriut, ai ndonëse është pjesë e natyrës, ka një tretman të veçantë që tejkalon natyrën dhe nuk shkrihet në te. “Njeriu është i krijuar nga Allahu, i është dhuruar shpirti nga ana e Tij, e ka nderuar, ia ka besuar botën dhe e ka bërë mëkëmbës në te. Kjo nënkupton se njeriu është epiqendra e botës pasi mori

<sup>641</sup> Abdulvehab El-Mesiri, *El-Felsefat'ul-madijjetu ve tefkik'ul-insani*, Damask, Dar'ul-fikr, 2007, fq. 36.

përsipër amanetin dhe mëkëmbësinë. Për këtë, ai ka një tretman të veçantë të pavarur brenda sistemit natyror. Gjithashtu, kjo nënkupton se humaniteti i njeriut dhe substanca njerëzore janë të lidhura ngushtë me elementin hyjnor brenda tij”.

**Lloji i dytë** i referencës përfundimtare është referenca përfundimtare e fshehtë. Edhe kjo gjithashtu jep vizion ndaj botës, i përfshirë në brendinë e tij. “Bota mjafton për komentimin e tij, pa pasur nevojë të mbështetemi diku tjetër jashtë sistemit natyror... në kuadër të referencës së fshehtë, në univers nuk ka përpos një substance, një materie nga e cila është formuar çdo gjë...mendojmë se gjitha sistemet materialiste sillen në kuadër të referencës së fshehtë. Prej këtu, theksimi ndaj materializmit ishte si element i panteizmit materialist.” Njeriu në referencën përfundimtare të fshehtë “është qenie natyrore, jo e pavarur brenda sistemit natyror, i përfshirë në te. Kështu bie referenca njerëzore dhe mbetet natyra/materia referencë përfundimtare.”

Ka edhe një formë tjetër të referencës përfundimtare të fshehtë. Kjo formë është forma e “panteizmit shpirtëror”, i cili beson në një Zot, por që gjendet brenda ekzistencës, i fshehtë në te. Ai është “Zot që gjendet brenda krijesave të Tij, i përzier me ta dhe plotësisht i shkrirë në to, në atë mënyrë që nuk ka ekzistencë të mëvetësishme, as nuk mund të ekzistojë pa to... Ai vetëm me emër është Zot, ndërsa në realitet ai është natyra/materia.”<sup>642</sup>

Referenca mund të jetë në disa lloje. Mund të përfaqësohet në ligje dhe legjislative të pranuar nga anëtarët e një shoqërie apo shteti për menaxhimin e çështjeve të tyre. Në këtë mënyrë ajo bëhet Kushtetuta e Shtetit dhe ligjet që dalin prej saj. Kjo kushtetutë është referenca e këtij shteti.

Lloj tjetër i referencave janë edhe dokumentet e kontratave të veçanta mes individëve, grupeve apo shteteve, ose ndonjë kuvend të cilit i besohet përgjegjësia e nxjerrjes së fetvave fetare apo ligjore. Ekzistojnë edhe referenca të veçanta për secilin profesion. Referenca mund të jetë edhe në formë të

<sup>642</sup> Po aty, fq. 37-39.

mendimeve dhe ixhtihadeve të ndonjë personaliteti shkencor, ose mendor, ose politik apo në ndonjë libër që përmbledh këto mendime. Imam Shafi'u është referencë në medhhebin shafi'. Platoni referencë në filozofinë idealiste. Frojdi është referencë në psikologjinë analitike. Darvini është referencë në evolucion e kështu me radhë. Kur'ani është referenca më e lartë e muslimanëve. Inxhili (Dhiata e Re) është referenca më e lartë e të krishterëve. Libri "Pasuria e popujve" e autorit Adam Smithit (vd. 1790) është referencë në ekonominë moderne, dhe kështu me radhë.<sup>643</sup>

Gjatë tërë historisë, popujt e ndryshëm të botës kanë pasur zakon të përcaktojnë veçoritë fetare apo historike të cilat i kanë konsideruar si referencë për sistemet e brendshme dhe marrëdhëniet e jashtme. Mirëpo, -që nga mesi i shekullit XX- popujt e botës kanë hyrë në një periudhë, ku veçoritë e tyre kanë filluar të shuhen përballë "legjitimitetit ndërkombëtar", e cila cilësohet si referencë që nuk mund të tejkalohet. Legjitimiteti ndërkombëtar në fillim ishte në formë të disa vendimeve politike dhe ushtarake. Mirëpo në mënyrë graduale, ajo u bë parim në të drejtat e njeriut, kultura e popullsisë, shoqëria civile, të drejtat e gruas, koncepti "familje" etj. Me këtë, "referenca" e legjitimitetit ndërkombëtar është bërë "vlera ndërkombëtare" që duhet pranuar me dashje ose padashje. Çështja më e rrezikshme se gjithë këto është se ajo është bërë tematikë e luftës ideologjike, e cila shoqëron format tjera të luftës, ose alternativë "e butë" e formave tjera të luftës. Qëllimi i saj është përfitimi i zemrave dhe mendjeve, ndërsa funksioni i saj përfshin fushat arsimore, mediatike, konferencat rajonale dhe ndërkombëtare. Fuqitë e mëdha në botë përpiqen të shtrijnë parimet dhe vlerat e saj, si dhe t'ua imponojnë shteteve të dobëta.<sup>644</sup>

<sup>643</sup> El-Meraxhiu-literatura janë librat të cilat i konsulton hulumtuesi apo autori. Këto libra, ai i potencon në fund, te literatura e konsultuar

<sup>644</sup> Fet'hi Hasen Melkavi, "Es-Siratu ala merxhe'ijjet'il-kijemi fil'alem'il-muasiri", kumtesë shkencore e paraqitur në Konferencën IV të Qendrës për Studime të Legjislacionit Islam dhe Etik, Universiteti Hamed ibn Halife, Doha, Katar, 2-3 prill 2016.

Në përgjithësi, referenca ideologjike në nivelet se saja anësore, -në esencë- linden nga referenca universale. Kjo referencë është vizioni ndaj botës dhe perceptim universal, ku sfera e saj nuk përfshin vetëm dimensionin e besimit, por shtrihet për të përfshirë sistemin e jetës dhe çdo gjë që ndërlidhet me të si pushteti, ekonomia, juridiku, edukata, mediatika etj. Ajo përcakton programin e të menduarit, studimit dhe hulumtimit, si dhe bashkëveprimin me idetë, gjësendet dhe ndodhitë.

Viteve të fundit janë shtuar polemikat politike dhe mediatike rreth termit “referenca islame - el-merxhe’ijet’ul-islamijeh”, dhe atë në kontekst të bisedës rreth shtetit modern të cilin shoqëritë arabe dhe islame përpiqen t’i formojnë. Ekzistojnë rryma, të cilat pasojnë gjurmët e perëndimorëve në formimin e shtetit civil, ku ndajnë fenë nga jeta, dhe në këtë mënyrë çështjet politike, ekonomike dhe shoqërore janë të pavarura nga dispozitat fetare. Këto rryma janë ndikuar nga koncepti “shteti civil” përballë konceptit “shteti fetar”, sipas kuptimit kishtar të cilin e ka njohur Evropa. Ka edhe rryma tjera, të cilat mendojnë se nuk ka problem që shtetit të jetë “civil”. Kjo nënkupton që shteti të jetë “joushtarak” dhe “jofetar” sipas kuptimit evropian të theksuar më lartë, por me kusht që të qenët “shtet civil” të mos largon fenë nga jeta e përgjithshme. Në shoqëritë islame, feja është identiteti origjinal dhe dalluese e identitetit të përgjithshëm dhe civilizues. Për këtë, “referenca islame” është patjetër të jetë themel për çdo legjislativ civile. Sa i përket shtetit fetar të njohur në Evropë, në mesjetë, është diçka krejt ndryshe nga legjislacioni islam dhe referenca islame.

## 2. Karakteristika të përgjithshme të referencës së mendimit pedagogjik perëndimor

Pjesa dërrmuese e shoqërive islame sot, mendimin e tyre pedagogjik, përfshirë konceptet, parimet dhe praktikat e marrin nga përvoja perëndimore bashkëkohore. Andaj, e



ndejmë të domosdoshme të jemi mirë të vetëdijshëm rreth referencës së mendimit pedagogjik dominues në shtetet perëndimore, me qëllim që të kemi të qartë rrezikun e mundshëm nga importimi i këtij mendimi. Meditimi i thellë rreth referencës së mendimit perëndimor në përgjithësi dhe mendimit pedagogjik perëndimor në veçanti, duhet të jetë në nivel të vetëdijes, përgjegjesisë dhe objektivitetit.

Dihet se mendimi pedagogjik perëndimor fillimin e tij e sheh në thellësinë historike nga kohërat e lashta, duke e ndërlidhur me arritjet e filozofëve grek. Mund të hasim aty-këtu disa të dhëna kalimthi rreth disa civilizimeve të vjetra si në Egjipt, Indi dhe Irak. Më pas, historia e mendimit pedagogjik tejkalon periudhën e errësirave evropiane, duke injoruar historinë dhe civilizimet e botës jashtë Evropës, gjatë kësaj periudhe, ku në të njëjtën kohë ishte periudha e artë e civilizimit islam, për të kaluar drejtpërdrejt në periudhën e renesancës, periudhën e zbulimeve shkencore dhe gjeografike. Këtu theksohet kontributi i Bekonit, Dekartit, Hjumit, Volterit, Frobellit për të arritur te personalitetet e shekullit XX, si: Djui, Frojdi, Pestaloci, Pijazhe, Watsoni, Maslo, Blumi, Tajleri, Skeneri, Ozbili, Bruneri etj.

Koncepti “perëndimor” sot, në dimensionit e tij gjeografik, përfshihet në shtetet e Evropës dhe SHBA-ve, si dhe në disa shtete tjera si Kanadaja dhe Australia. Mendimi perëndimor deri në gjendjen e tij bashkëkohore ka arritur përmes një rrugëtimi të zhvillimit historik, ku ngjarjet nuk kanë përfshirë vetëm vendet e lartpërmendura, por si rezultat raporteve politike dhe ushtarake, ndikimi i mendimit perëndimor është shtrirë edhe në shumë shtete të botës, pa marrë parasysh se këto raporte kanë qenë në periudhën e kolonializmit dhe luftërave apo raporteve të dominimit politik dhe ekonomik. Dikush mund të jep vërejtje ndaj ekzistimit të termit “perëndimor” në shprehjen “mendimi pedagogjik perëndimor” duke argumentuar se mendimi pedagogjik dominues në perëndim sot, është rezultat i zhvillimit në përvojën njerëzore përmes periudhave dhe rasteve historike të njëpasnjëshme, ku kanë marrë pjesë popuj të ndryshëm.

Në veçanti kur kemi mundësi, që gjatë këtyre periudhave të dallojmë kontributet e grekëve, civilizimeve të vjetra në Egjipt, Irak, Persi, Indi dhe Kinë. E gjithë kjo, krahas udhëzimeve të pejgamberëve dhe pasuesve të tyre gjatë historisë, duke përfshirë edhe arritjet e civilizimit islam, përfshirë mendimin edukativ dhe arsimor në Bagdad, Damask, Kajro, Kordobë, Granadë etj. Më pas edhe zhvillimet e periudhës së renesancës, ku si rezultat i saj ka lindur modernizmi, duke arritur deri te përvoja pedagogjike bashkëkohore, ku mund të dallojmë kontributet e mendimtarëve nga vendet e ndryshme të Botës.

Edhe pse kjo vërejtje është me të drejtë, por ne do ta tejkalojmë, për të tërhequr vërejtjen rreth dy çështjeve. E para: perëndimi -ai evropian dhe amerikan- supozojnë se ata janë prodhuesit e mendimit bashkëkohor në shkencat pedagogjike dhe fushat tjera. E dyta: shumica e vendeve të botës sot, në Azi, Afrikë dhe Amerikën Jugore, përfshirë edhe shtetet arabe dhe islame, e pranojnë këtë supozim të perëndimorëve, duke marrë mendimin dhe praktikën nga prodhimi i mendimit perëndimor me dëshirë apo pa dëshirë!

Këtu shpejtojmë për të dhënë vërejtjen tonë rreth dallimit të ndikimit të mendimit pedagogjik perëndimor në Perëndim dhe ndikimit të këtij mendimi në vendet që marrin këtë mendim nga Perëndimi. Marrja -në të shumtën e rasteve- përfshin formën jo substancën, pamjen e jashtme, jo shpirtin. Në substancë dhe shpirt ekzistojnë disa anë pozitive të cilat mungojnë gjatë marrjes dhe importimit.

Në Botën Arabe hasim në institucione të shumta të cilat kujdesen për përkthimin e mendimit perëndimor në gjuhën arabe, duke tërhequr vërejtjen për domosdoshmërinë e kulturalizmit, vetëdijesimit për gjendjen ideologjike dhe kulturore në botë dhe bashkëveprimin me te. Kësaj vërejtje, - në të shumtën e rasteve- i mungon sqarimi i përgjithshëm rreth asaj që përzgjidhet për përkthim për nga referenca ideologjike në të cilën mbështetet apo kritika drejtuar asaj nga vet qarqet perëndimore.

Vlen të theksohet këtu se ne nuk kundërshtojmë çështjen e përkthimit, e as qëllimet e saj për bashkëveprim dhe bashkëkulturim. Mirëpo, është patjetër këtu të theksojmë dy vërejtje. E para: kulturalizimi është bashkëveprim nga dy anë, ku secili ka identitetin e tij që dallon dhe kontributin që ofron. Kështu që lëvizja e kulturalizimit arrihet nga dy anë. Atë që vërejmë se bashkëveprimi i praktikuar nga elita e kulturuar në Botën Arabe dhe Islame është duke ecur në një drejtim, pra nga Perëndimi drejt nesh, qoftë në sferën ideologjike dhe kulturore apo në sferën shkencore dhe teknologjike, gjë që na ka bërë të jemi në pozitën e pranuesit. E dyta: këtë pozitë të pranuesit, kjo elitë e kulturuar e arsyeton se ne jemi duke dalë nga një gjendje e prapambetur nga e cila vuan populli. Andaj, na kemi nevojë të marrim nga parimet e modernitetit, racios dhe shkencës ashtu siç ka marrë Perëndimi me qëllim që të përparojmë siç kanë përparuar. Duhet theksuar se ne që dy shekuj që marrim nga Perëndimi çdo gjë, por asgjë nuk është realizuar nga modernizmi i Perëndimit, e as nuk kemi ndërtuar gjë nga elementet e modernizmit tonë. Nuk kemi dalë nga prapambeturia dhe jemi në situatë të humbim çdo gjë nga elementet e ekzistimit tonë ideologjik dhe arritjeve tona kulturore.

Me sa duket, filozofitë, teoritë, shkollat ideologjike dhe programet e reja të zhvilluara në Perëndim, në disa raste zbukurohen me fjalë dhe u jepet një pamje që e bën të pëlqyer, kur merret parasysh dallimi me teoritë e mëparshme. Mirëpo, duhet të kemi parasysh se këto filozofi janë zhvilluar dhe vazhdojnë të zhvillohen si teori dhe kundërteori. Kështu, filozofia natyrale në mendimin perëndimorë është reagim ndaj filozofisë metafizike, filozofia pozitiviste reagim ndaj filozofisë normative, filozofia laike reagim ndaj filozofisë fetare, filozofia postmoderniste reagim ndaj asaj moderniste, filozofia dekonstruktualiste reagim ndaj asaj strukturaliste etj. Duhet pasur parasysh se çdo filozofi apo shkollë që zhvillohet në Perëndim, nuk zhvillohet nga hiçi, por është patjetër të ketë një bazë ku mbështetet, ose

diç që e kundërshton. Te filozofitë e reja mund të dallojmë elementet e esencës, për të vërejtur se mes të rejave dhe të vjetrave ka ndërhyrje, pa e humbur asnjëra prej tyre vetë referencën.

Shembull që vërteton lidhshmërinë mes një filozofie dhe asaj që gjendej para saj, kemi thënien e R. Garodit rreth filozofisë strukturaliste, e cila ka ardhur pas ekzistencializmit: “Kemi një filozofi, e cila është para shuarjes. Ajo është filozofia ekzistencialiste, e cila ka zgjatur më shumë se tre dekada. Ekzistencializmi ka viktimizuar racionalen dhe objektiven... kështu që ekzistencializmi nuk është vetëm perceptim ndaj botës, por shkallë dhe modë sundimi, duke hequr dorë nga tradita për vite të tëra. Mirëpo, kur u paraqit çështja e formimit, u zbulua paaftësia e ekzistencializmit, dhe atë në aspektin teorik dhe praktik në të njëjtën kohë.”<sup>645</sup>

Historia dhe feja kanë ndërhyrje në zhvillimin e mendimit perëndimor. Historia e fesë në veçanti, ka përjetuar ngjarje dhe rrethana, të cilat kanë pasur rezultate të thella në përcaktimin e natyrës së mendimit pedagogjik perëndimor dhe qëndrimit të saj ndaj fesë dhe referencës fetare. Pas një konflikti të gjatë mes autoriteteve fetare dhe autoriteteve politike në Evropë, më në fund Kisha u detyrua që fenë ta konsiderojë çështje personale dhe familjare që ndërlihet me raportin me Zotin, duke i lënë besimtarët të kenë të drejtë të rregullojnë sistemin e jetës së tyre dhe të sjellin ligjet në përputhshmëri me përvojën dhe eksperiencën e tyre. Kështu autoriteti politik mori për sipër çështjet e sundimit, ekonomisë, jurisprudencës dhe edukatës. Te feja ndodhi ky ndryshim, ku nga pozita sistem jetë në të gjitha sferat u shndërrua në çështje personale, dhe atë në kohë kur u bënë zhvillime të mëdha në konceptet “liri”, “individualizëm”, “materializëm”, të shoqëruara me të ardhura të mira ekonomike dhe përparim shkencor. E gjithë kjo reflektoi në pikëpamjet ndaj fesë. Kështu, sipas perëndimorëve, lirimi

<sup>645</sup> Rozhe Garodi, *El-Bunjevijjetu: felsefetu mevt'il-insani*, përkthim: Xhorxh Tarabishi, Bejrut: Dar'ut-Taliati, bot. 1, 1979. Origjinali në frëngjisht i botuar më 1969, fq. 14.

nga feja në jetën e përgjithshme është shkak për përparim, në kohë kur mbështetja në fe në shoqëritë joperëndimore merret si shkak për prapambeturi.

Vlen të theksohet se ky prezantim i pozitës së fesë në civilizimin perëndimor bashkëkohor është refuzuar nga disa perëndimorë tërësisht. Ata janë përpjekur të riformulojnë të kuptuarit historik të zhvillimit të civilizimit perëndimor, cilësimit të tij me talent të veçantë dhe riformulimin e historisë së Evropës sipas këtij bazamenti, duke përfshirë: mosmarrjen e Perëndimit nga civilizimet tjera, mohimin e shpirtit kolonialist në mendje, ndjenja dhe praktika te perëndimorët, mohimi i ekzistimit të periudhave të errëta në historinë evropiane, mosqëndrimin të kishës përballë shkencës dhe konsiderimi i luftërave të kryqëzatave me muslimanët luftëra në mbrojtje. Do të vërejmë se këto përpjekje arrogante që bartin shpirtin dominues sqarojnë sjelljen e Perëndimit përballë popujve tjerë.<sup>646</sup>

Shpirti dominues dhe arrogant i perëndimorit, qoftë i përfaqësuar në dimensionin fetar, ose përparimin shkencor, ose epërsinë civilizuese, ka formuar tek ai përkujtim historik dhe kulturë të përgjithshme, e cila trashëgohet gjeneratë pas gjenerate tek ata. Ndikimi i kësaj kulture rritet edhe më shumë duke parë ai realitetin e prapambetur nga e cila vuajnë shumë nga shoqëritë joperëndimore, në veçanti shoqëritë islame. Kultura e perëndimorëve është mbështetur edhe më shumë me kulturën që ka lindur në shoqëritë islame, të cilat vuajnë nga tjetërsimi, mosbesimi në vetvete dhe lidhshmëria e përparimit vetëm sipas modelit të përvojës perëndimore.

Çështje më e rrezikshme që ka dalë si rezultat i kësaj është formulimi i njohurive në programet pedagogjike në formë të stilit dominues, ku ngrit vlerën e Perëndimit, në kohë që

<sup>646</sup> Shembull për këto përpjekje kemi edhe librin e botuar më 2015, për të cilin kishte reagime të ndryshme. Ky libër thellon ndjenjën e superioritetit të racës së bardhë, duke kufizuar zhvillimin civilizues në historinë e botës vetëm në përvojën evropiane dhe shtrirjen amerikane. Përmbajtja e këtij libri mbështet formën e të menduarit, që ka filluar të përhapet në Perëndim, përfshirë ndjenjat e urrejtjes ndaj refugjatëve, dukurinë e islamofobisë, sulmet ndaj xhamive, si dhe veprime tjera përballë joperëndimorëve. Këto janë të dhënat e librit: Rodney Stark, *How the West Won: The Neglected Story of the Triumph of Modernity*, Wilmington, DE: Intercollegiate Studies Institute, 2015.

nënvlerëson afrikanët dhe aziatikët, të gjithë besimin e vë në fuqinë e njeriut perëndimor, duke theksuar paaftësinë dhe prapambetjen të të tjerët. Kështu vendet perëndimore janë të përparuara dhe të civilizuara, ndërsa vendet tjera janë të prapambetura. Të gjitha projektet zhvillimore që synojnë përparimin në vendet joperëndimore dështojnë, për derisa ato kapen për kulturën e tyre tradicionale me sfond fetar.

Është shumë lehtë të hasim referencën e mendimit pedagogjik perëndimor në vizionin e tij ndaj rolit të edukimit dhe arsimit në riformulimin e shoqërive tjera përmes modelit evropian. Kështu është patjetër të kemi laicizëm për të zgjidhur problemet e fesë, është patjetër të marrim kredi për të zgjidhur problemet ekonomike, është patjetër të kemi treg të lirë për të realizuar zhvillim ekonomik, është patjetër të kemi demokraci dhe sistem shumëpartiak për të zhvilluar realitetin politik dhe është patjetër të kemi sistem arsimor i bazuar në skeletin arsimor në shkolla dhe universitete. Fokusimi në arsim do të jetë në shkenca, matematikë, gjuhë të huaja dhe informatikë do të jetë mjet i shpejtë për përparim. Këto shkenca janë epiqendra e interesimeve. Ndërsa sa i përket lëndëve që formojnë popullin, siç janë: feja, historia dhe gjuha, këto janë veçori, të cilave u jepet përkujdesi anësor.

Çështja e të kuptuarit të referencës perëndimore në formimin e programeve pedagogjike, nuk përfshijnë vetëm lëndët mësimore. Ato kujdesen edhe për format e të menduarit dhe orientimet psikologjike. Kështu, metoda induktive eksperimentale, i cili bazohet në përvojën sensuale, vrojtimin dhe eksperimentin praktik është bazë e prodhimit njohës. Kjo metodë ishte bazament e kalimit të Evropës nga periudha e errësirës në periudhën e dritës, më pas realizimin e përparimit industrial, zhvillimin e mjeteve të prodhimit dhe mjetet e komunikimit dhe transportimit. Andaj, shkenca e cila meriton të kujdesemi për te, sipas referencës perëndimore, është ajo që vërtetohet përmes eksperimentit dhe vrojtimit sensual. Për këtë, shkencat e vërteta janë: fizika, kimia dhe të ngjashme. Ndërsa shkencat shoqërore, ato

vetëm në mënyrë alegorike quhen shkencë. Ato sot janë në gjendje të prapambetur dhe një ditë mund t'u bashkëngjiten shkencave të vërteta dhe mund të ngritën vetëm në baza shkencore eksperimentale dhe atë përmes periudhave të zhvillimit shkencor. Ndërsa sa i përket formave të mendimit dhe hulumtimit që kanë lidhshmëri me dimensionet metafizike, ato më vetëm nuk kanë vend në programet mësimore.

Ajo që bie në sy se pedagogët perëndimorë kanë harxhuar dhe vazhdojnë të harxhojnë mund të madh në formimin pedagogjik në bazë të shkencës eksperimentale.<sup>647</sup> Megjithatë, kanë lindur rryma tjera në hulumtimin pedagogjik që vërtetojnë se fusha e pedagogjisë është njëjtë sikur fushat tjera të shkencave shoqërore, ku nuk lejohet për të të përdoret metoda shkencore që përdoret për shkencat natyrore. E gjithë kjo për shkak të dallimeve substanciale mes trajtimit të materies në bazë të ligjeve statike dhe në mënyrë që është lehtë kontrollimi i eksperimentit ndaj saj dhe trajtimit të sjelljes së njerëzve sipas ligjeve jo të njohura plotësisht. Për këtë, kanë lindur metodologji për hulumtim pedagogjik dhe shoqëror që bazohet në përshkrimin e gjendjes së dukurive dhe rasteve në vend të përshkrimit të sasisë, mbështetet në formulimin e hipotezave në vend të testimit të tyre dhe pranon dallimin mes bashkëveprimit me çështjet materiale në shkencat natyrore dhe sjelljes njerëzore në shkencat humane dhe shoqërore.<sup>648</sup>

<sup>647</sup> N. L. Gage, *The Scientific Basis of the Art of Teaching*. New York: Teacher College Press, Columbia University, 1977. Shih gjithashtu:

- Rena Subotnik & Herbert Walberg, *The Scientific Basis of Education Productivity*, Research in Educational Productivity, Charlotte, North Carolina: Information Age Publishing, 2006.

- Lilla Estella Appleton, *A Comparative Study of the Play Activities of Adult Savages and Civilized Children; An Investigation of the Scientific Basis of Education*, Victoria, Australia: Leopold Classic Library, 2017.

<sup>648</sup> Shikoni për shembull revista të specializuara si p.sh.: International Journal of Qualitative Studies in Education, and related textbooks such as:

- Vincent Anfara, & Norma Mertz (Eidorë), *Theoretical Frameworks in Qualitative Research*, Los Angeles and London: Sage Publication, Inc. 2015.

- Alecia Mackson & Lisa Mazzei, *Thinking with Theory in Qualitative Research: Viewing Data across Multiple Perspectives*, London and New York: Routledge, 2011.

### 3. Filozofitë në referencën e mendimit perëndimor

Gjuha e mendimit perëndimor është e mbushur përplot me koncepte dhe terme, ku disa prej tyre cilësohen si filozofike, metodologjike ose të shkollës ideologjike. Në vazhdim do të sqarojmë disa nga format e shumta në referencat e përgjithshme në mendimin pedagogjik perëndimor:

#### 3.1 Laicizmi (shekullarizimi) në referencën e mendimit perëndimor:

Laicizmi është një ndër mendimet që është lidhur ngushtë me referencën e mendimit perëndimor. Ky mendim, i cili është bërë parim, jo vetëm në kuptim dhe praktikë në jetën perëndimore, por edhe në kuptimin e gjendjes dhe komentimit të shoqërive tjera, duke përcaktuar edhe format e bashkëveprimit me to. Me sa duket, laicizmi si koncept, në shtetet perëndimore, nuk ka një kuptim. Në kohë kur kuptimi esencial i këtij koncepti ishte ndarja e fesë nga sistemet e jetës së përgjithshme si në politikë, ekonomi e tjera, duke pranuar nevojën për fe në raportet personale dhe edukimin shpirtëror ky kuptim në praktikë merr forma dhe mënyra të ndryshme në vendet evropiane.

Shoqata Kombëtare për Shekullarizim (National Secular Society)<sup>649</sup> në webfaqen e saj përcakton tre parime të laicizmit përmes të cilave do të mbrojnë dhe mbështet liritë, të cilat duhet t'i posedojnë njerëzit. Këto parime janë: "Ndarja e institucioneve fetare nga institucionet shtetërore, në atë mënyrë që feja do të jep kontributin e saj në jetën e përgjithshme, pa pasur dominim, liria e individit për të praktikuar fenë dhe besimin e tij, sipas ndërgjegjes së tij, pa dëmtuar të tjerët, ose ndryshimin e besimit të tyre, ose detyrimit për mosbesim në asnjë fe dhe realizimin e barabarësisë, në atë mënyrë që ekzistimi ose mosekzistimi i

<sup>649</sup> Shoqata Kombëtare për Shekullarizim është themeluar në vitin 1866 në Britani dhe atë në formë të shoqatës jofitimprurëse. Ajo thërret në ndarjen e fesë nga shteti, anulimin e Kishës Angleze, duke e konsideruar shekullarizmin apo laicizmin si mjet më të mirë për formimin e një shoqërie të drejtë, në të cilën do të jetojnë qytetarët -qofshin me fe të ndryshme apo pa fe fare- të barabartë në të drejta dhe obligime.



bindjes fetare të mos jetë shkak për realizimin e dobisë apo largimin e dëmit”.<sup>650</sup>

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në shtetet evropiane, laicizmi është pranuar në mënyrë kushtetutare, ku institucionet politike dhe ato fetare janë të ndara, dhe secila vepron në sferën e veçantë të saj. Pushteti politik është neutral në besim apo mosbesim fetar. Legjislativet dhe politikat në shtet merren sipas kërkesave të jetës, pa pasur referencë të caktuar fetare. Çdo ndërhyrje nga pushteti fetar në çështjet e shtetit, ose caktimin e fesë si pikë reference apo burim të legjislacionit, është në kundërshtim me parimin e laicizmit dhe shteti ia humbë legjitimitetin.

Në konceptin e laicizmit, mund të dallojmë tre lloje: politik, filozofik dhe kulturoro-shoqëror. Laicizmi në dimensionin e tij politik është pranuar në formë të gjerë në Perëndim, qoftë nga fetarët apo jofetarët. Ky lloj jep të drejta të barabarta të gjitha grupimeve fetare, si dhe atyre që nuk kanë fe. Këto dy grupe njerëzish mendojnë se laicizmi, nuk është vetëm mbrojtje e shtetit, por gjithashtu është edhe mbrojtje e fesë.

Ishte plotësisht e natyrshme që parimi i laicizmit dhe praktikat e tij në Perëndim të reflektohen në arsim në përgjithësi, ndërsa në arsimin publik të kontrolluar nga shteti, në veçanti. Me lindjen e parimit të laicizmit në shekullin XIX në SHBA dhe Britani, ka lindur edhe termi “arsim laik”. Ky lloj arsimit ka hasur në mbështetje të madhe nga autoritetet kishtarë në zgjidhjen e problemit të garës rreth ofrimit të arsimit fetar prej grupeve të ndryshme fetare krishtere, ngase këto grupime preferonin arsimim shkollor neutral dhe objektiv, me qëllim që asnjë arsimimi fetar të mos ndikon në bindjet fetare të nxënësve. Kështu, programi mësimor i pastër nga çdo arsimim fetar do të jetë më i mirë se një program që përdorë bindje të veçanta krishtere sipas vizionit të një grupimi tjetër krishterë. Kështu, thirrësit në laicizëm gjetën shansin për largimin e gjitha formave të

<sup>650</sup> <https://www.secularism.org.uk/what-is-secularism.html>.

Vlen të theksohet se motoja e Shoqatës është: “Sfidimi i privilegjeve fetare” (Challenging Religious Privilege”).

mësimi fetar apo praktikave fetare nga programi mësimor publik. Si rezultat i kësaj, secili grupimi krishterë, themeloi shkolla të veçanta, ku përfshinte arsim fetar të veçantë me bindjet e këtij grupimi.

Megjithatë, çështja e arsimit fetar dhe përmbajtjeve fetare në disa tematika shkencore, ka qenë dhe vazhdon ende të jetë temë diskutimi ligjor. Gjyqet nxjerrin vendimet e tyre sipas komentimeve tyre të ndryshme ndaj parimeve ligjore. Gjyqet në SHBA akoma nuk kanë arritur në zgjidhje përfundimtare të kësaj problematike. Derisa thirrjet pro dhe kundra fesë në shkollat publike në gjyqet e SHBA-ve janë të vazhdueshme, lutjet ditore fetare në shkollat britanike vazhdojnë edhe sot e kësaj dite. Kjo dukuri është edhe në disa shtete evropiane. Vërehet se një numër i vogël i shkollave në SHBA ofrojnë lëndë mësimore rreth fesë, në kohë, kur një lëndë e tillë mësohet në shumicën e shkollave të Evropës. Kusht në këtë rast është që “arsimi rreth fesë” të jetë i baraspeshuar, objektiv, i drejtë dhe neutral. Kjo nënkupton që feja mos të mësohet se është e vërtetë, ose një fe më e vërtetë se tjetra.

Laicizmi dhe domosdoshmëria e miratimit të tij në arsimin publik, qysh nga mesi i shekullit XX, filloi të merr mbështetje të madhe nga thirrësit e shoqërisë liberale, në veçanti në nivel akademik dhe ligjor, ngase ata shohin fenë në kundërshtim me shpirtin e shoqërisë së hapur dhe kulturës shkencore.<sup>651</sup>

Dekadat e fundit të shekullit XX përjetuan një rritje të shfaqjes së fesë në jetën publike, në shumicën e vendeve të botës, përfshirë këtu fetë e ndryshme. Shumica e formave të kësaj shfaqjeje realizohej përmes praktikimeve paqësore, ndërsa në raste të rralla shoqërohej me praktika që përfshinin urrejtje, dhunë dhe nxitje të çrregullimeve. Këto raste ishin shfrytëzim i ndjenjave fetare për qëllime politike.

Emigrimi në Perëndim, në veçanti në shtetet evropiane ka pasur ndikim relativ në çrregullimin e shoqërisë homogjene laike. Disa hulumtues në Evropë janë të mendimit se shndërrimi i këtyre shteteve në shoqëri multikulturore dhe multifetare mund të sfidojnë tezën laike, e cila priste

<sup>651</sup> Ibid, page 402-403.

zhdukjen graduale të pushtetit fetar dhe ndikimit të saj në jetën publike, duke u kufizuar vetëm në rrethin e veçantë të saj.<sup>652</sup>

Për këtë, literatura e rritur rreth pranisë në rritje të fesë ka filluar të flasë rreth hyrjes së botës në “periudhën paslaike”, duke rikthyer feja fuqinë e saj ndikuese në shoqëri. Në të njëjtën kohë, literatura thekson se zvogëlimi i konceptit laik formon një sfidë ndaj legjitimitetit nga e cila shtetet demokratike mbështesin pushtetin e tyre. Si rezultat i gjithë kësaj, janë shfaqur zëra që thërrasin rishqyrtimin e metodologjisë laike, bile edhe lirimin prej saj, duke sjellë në vend të saj parimin që bën përcaktim të ri të raportit mes fesë dhe shtetit.<sup>653</sup>

Sidoqoftë, ata që thërrasin për të përfituar nga përvoja laike perëndimore në jetën e popujve musliman, në sferën edukativo-arsimore dhe sferat tjera, injorojnë dallimet substanciale mes natyrës së krishterizmit dhe islamit dhe rrethanat që kanë çuar drejt lindjes së laicizmit. Ata injorojnë se islami nuk ka pushtet fetar sipas kuptimit evropian, që të kërkohet ndarja e saj nga pushteti politik.

Ndikimi i referencës ideologjike perëndimore reflektohet edhe në pozitën e vlerave morale në sistemin e edukimit dhe procesin e përshtatshmërisë shoqërore, që pedagogjia përpiqet ta orientojë. Plan-programet pedagogjike në Perëndim janë reflektim i realitetit të shoqërisë perëndimore dhe vlerave shoqërore dhe morale që mbizotërojnë në te. Andaj, vetëdijesimi rreth pozitës së vlerave në mendimin pedagogjik islam është i domosdoshëm. Vlerat udhëheqin, orientojnë dhe ngrenë shoqërinë. Ato, për nga pozita dje

<sup>652</sup> Adil Usturali, *A Conceptual Analysis of Secularism and Its Legitimacy in the Constitutional Democratic State*, Policy Brief Series, Fox International Fellowship, 2015. See the link: <https://foxfellowship.yale.edu/sites/default/files/files/Adil%20Usturali%20-%20PolicyBrief.pdf>.

<sup>653</sup> Rreth raportit të laicizmit me fenë, në mënyrë të detajuar lexo literaturën e veçantë, si p.sh.: Steven Kettell, *Secularism and Religion*, Oxford Research Encyclopedias (Politics), Online Publication, Jan 2019.

Shih linkun:

<https://oxfordre.com/politics/view/10.1093/acrefore/9780190228637.001.0001/acrefore9780190228637-e-898>.

Shih gjithashtu: Rajeev Bhargava, *State, religious diversity and the crisis of secularism*, Open Democracy: free thinking for the world, 22 march 2011.

Shih linkun: <https://www.opendemocracy.net/en/states-religious-diversity-and-crisis-of-secularism-0>.

rëndësia që kanë, formojnë referencë të dalluar plotësisht nga gjitha referencat tjera.

### 3.2. Globalizmi dhe internacionalizmi

Termi “Globalizëm” -në esencë- ishte për të përshkruar ndryshimet që ndodhnin në ekonominë botërore viteve të tetëdhjeta të shekullit XX. Ky term, shumë shpejt kaloi për të përshkruar ndryshimet në sferat politike, kulturore dhe pedagogjike, që në mënyra të ndryshme ndikojnë te një pjesë e madhe e banorëve të botës. Ajo që na intereson këtu është raporti i globalizmit me edukatën dhe arsimin.

Termi “globalizimi i arsimit” nënkupton ndikimin e rrjeteve, institucioneve dhe proceseve botërore në politikat dhe praktikat arsimore vendase. Gjitha këto rrejte, institucione dhe procese kanë strukturë të kontrolluar nga lartë që i tejkalon sistemet shkollore kombëtare vendore. Çka ndodhë në to realizohet në nivel botëror dhe në mënyrë shumë të shpejtë. Shoqëritë detyrohen të zgjedhin politika të cilat vijnë nga globalizmi, me shpresë që të garojnë në nivel ekonomik dhe prezencë botërore, në disa raste edhe nënshtrim ndaj presioneve politike dhe ekonomike. Prej institucioneve botërore, të cilat ndikojnë në politikat pedagogjike janë: Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillimor (OECD), Banka Botërore, Organizata UNESCO, Organizata Botërore për Tregti (WTO), Marrëveshja e Përgjithshme për Tregti dhe Shërbime (GATS), Organizatat Qeveritare Ndërkombëtare (IGOs), Organizatat Joqeveritare (NGOs), si: Organizata e të Drejtave të Njeriut, ambientit dhe Organizatat feministe.<sup>654</sup>

Joel Spring në librin e tij “Globalizimi i arsimit” mendon se drejtimet më të rëndësishme drejt të cilave orientohet pedagogjia janë dhënia e formës institucionale globale, ekonomizimi i arsimit dhe gjithëpërfshirja e gjuhës angleze si gjuhë bazike në organizatat e lartpërmendura. Këto institucione ndërkombëtare ushtrojnë presione të mëdha ndaj sistemeve pedagogjike kombëtare për të përvetësuar politika

<sup>654</sup> Spring, Joel. *Globalization of Education: An Introduction*. New York: Routledge, 2015, fq 1-2.

pedagogjike të caktuara. E gjithë kjo, me qëllim që të formohet sjellje e përshtatshme njerëzore për sferat e punës dhe qëllimeve të këtyre organizatave, tregjet e punës ku do të përdoren teori ekonomike të veçanta për kapitalin njerëzor, me supozim se ekonomitë e kapitalit njerëzor në edukim dhe arsimim shfrytëzohen për përgatitjen e punëtorëve më të përshtatshëm për zhvillimin ekonomik, duke zvogëluar dallimet e hyrjeve dhe duke rritur shanset për punësim.<sup>655</sup>

Autori, rreth arsimit global ka theksuar dhjetë përbërës. Prej tyre është edhe ajo se popujt pranojnë sisteme dhe praktika të ngjashme arsimore, duke përfshirë: programet, sistemin shkollor, metodat mësimore, sistemet e arsimit universitar, përgatitja e mësimdhënësve, zhvillimin e prodhimeve për tregun pedagogjik si: testimet, programet mësimore, lëndët mësimore, programe të arsimit elektronik, përgjithësimi i gjuhës angleze në programet e arsimit vendor si gjuhë e tregtisë ndërkombëtare dhe përgjithësimi i modeleve të globalizimit në arsimin fetar ose arsimin rreth fesë.<sup>656</sup>

Ekziston kritikë drejtuar orientimit për globalizimin e arsimit dhe politikave të tij. Arsimi për ekonomizim të njohurisë nuk realizon asnjë dobi kur nuk sigurohen shanse të përshtatshme për arsim. Shumë prej punëve, njohuritë për to janë bërë rutinë dhe të zakonata, ku kërkohen punëtorë me më pak shkathtësi. Sa i përket arsimit për arritjen e shkathtësive të larta, kjo tanimë nuk sjell të ardhura më të mëdha për të punësuarit. Një prej rreziqeve që ka hapur globalizimi i arsimit është edhe emigrimi i punëtorëve, në veçanti në sferën e programimit kompjuterik. Ekzistimi i një numri të madh të indianëve në këtë sferë, ka sjellë ndalimin e rritjes së rrogave në SHBA dhe humbjen e resurseve të kapitalit njerëzor në Indi. Rrezik tjetër është edhe dukuria e harxhimit mental (brain waste). Të diplomuarit më të mirë në programet arsimore nuk gjejnë vende punë të përshtatshme me aftësitë e tyre, gjë e cila ka çuar drejt uljes së zhvillimit të

<sup>655</sup> Ibid, fq. 32.

<sup>656</sup> Ibid, fq. 49.

hyrjeve të të diplomuarit e universiteteve në vendet industriale, duke i detyruar të pranojnë punë që nuk kërkojnë nivele të larta në arsim.<sup>657</sup>

Dukuritë e ekonomizimit të arsimit manifestohen në referencën në të cilën mbështetet sot ekonomia. Tregu është bërë simbol i ekonomisë, ndërsa njohuria është bërë mall në këtë treg. Tregu është bërë e shenjtë që posedon të njëjtat veçori të shenjtërimit që ia japin besimtarët Zotit. Së fundi, rreth kësaj tematike, është botuar një libër i një profesori në Universitetin e Harvardit, me titull: “Tregu si Zot”.<sup>658</sup> Në këtë libër, autori ka përshkruar elementet e të shpallurit tregun për Zot, duke krahasuar pikat e përbashkëta të shenjtërimit në krishterizëm dhe Islam. Më pas autori komenton problemet e botës bashkëkohore duke u bazuar në atë që ka arritur tregu në gjendjen e tij të shenjtë. Mes këtyre problemeve ka potencuar: zgjerimin i dallimeve, varfërinë, ngrohjen globale etj. Bota sot ka ra në shkencën e “shenjtërisë së ofertës dhe kërkesës”. Tregu është i plotfuqishëm, prezent në çdo vend, di çmimin e çdo gjëje, përcakton rezultatet e çdo veprimi, ngritë popujt dhe shkatërron tjera dhe s’ka gjë që shpëton nga të qenët mall. Vetën e ka imponuar si fe që ka besimin, Pejgamberët, simbolet, vlerat, rendin botëror dhe entuziazmin për shndërrimin e botës në mënyrën e tij për jetë.

Modeli i arsimit për ekonomi është bërë traditë e zakonshme në pedagogjinë perëndimore. Mendimet pedagogjike të saj janë shpërndarë në botë. Ky lloj arsimit është i përgatitur për shoqërinë laike, i cili synon zhvillimin ekonomik ose barabarësinë ekonomike, në kohë që nuk është i interesuar fare për qëllimet që ndërlidhen me fenë ose vlerat me referencë fetare apo me dimensionin shpirtëror të njeriut.

Nëse koncepti “globalizim” në esencë është shprehje ndaj kontaktit të vazhdueshëm mes shteteve në sferat e komunikimit, tregtisë dhe mendimeve politike, ai është i

<sup>657</sup> Ibid, fq. 54.

<sup>658</sup> Harvey Cox, *The Market as God*, Cambridge, MA: Harvard University Press, 2016.

Njoftim rreth librit lexo në webfaqen “Amazon” në linkun e mëposhtëm: <https://www.amazon.com/Market-as-God-Harvey-Cox/dp/0674659686>.

lidhur edhe me një koncept tjetër, me “internacionalizmin”, i cili shpreh lëvizjen e kompanive tregtare dhe institucioneve shërbyese mes shteteve të ndryshme, bazuar në rëndësi gjithnjë më të madhe të tregtisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, përfshirë marrëveshjet, koalicionet dhe projektet e përbashkëta. Simboli “internacional” është bërë metodë për tërheqjen e myshterinjve për mallra dhe shërbime, po edhe nëse nuk posedojnë asnjë cilësi internacionale.

Përhapja e shkollave internacionale “perëndimore” në shumë prej shteteve në Azi, Afrikë dhe Amerikën Jugore, si dhe hapjen e degëve të universiteteve perëndimore në këto vende<sup>659</sup> janë shembuj për internacionalizimin e shërbimeve pedagogjike perëndimore në shumë sfera, si: arsimi i rregullt dhe arsimi jo i rregullt, çdo gjë që ndërlidhet me arsimin si: plan-programet, tekstet mësimore, testimet, ushtrimet, konsulentat, financimi etj. Ekzistojnë studime rreth dukurisë së përhapjes së shkollave internacionale dhe ndikimeve të tyre. Prej tyre kemi studimin që është realizuar rreth kësaj dukurie në dhjetë shtete të Azisë. Studimi ka rezultuar ndryshime të thella në sistemet arsimore në këto shtete. Këto shkolla kishin formën e institucioneve internacionale dhe tregut botëror. Rezultat i kësaj ishte se shumë prej familjeve të pasura kanë filluar këto shkolla t’i trajtojnë si zgjedhje e dëshiruar, duke kërkuar mënyra për regjistrimin e fëmijëve në to. Shtetet të cilat kanë këso shkolla kanë pranuar zhvillimin e politikave që ndërthejnë lëshime ku u lejojnë tregjeve ndërkombëtare arritje deri të sistemet e arsimit kombëtar. Këto lëshime kishin ndikime në zgjerimin e dallimeve të shanseve për të rinjtë në cilësinë arsimore dhe lëkundjen e shpirtit kombëtar dhe identitetit kombëtar. Nxënësit në shkollat internacionale kalojnë një jetë shoqërore ndryshe nga ajo që kalojnë nxënësit e shkollave kombëtare. Kjo është për arsye se fuqia për pagesën e lartë të shkollimit në shkollat internacionale ua ka mundur nxënësve të

<sup>659</sup> Shtetet e siudhesës arabe janë shembull i qartë për numrin e madh të këtyre shkollave internacionale (perëndimore) dhe degët e universiteteve perëndimore.

kalojnë në këto shkolla. Kështu, problemit nga pamundësia e barabartë për regjistrim i shtohet edhe problemi i dallimit në normat e jetës shoqërore.<sup>660</sup> Hulumtuesi ka përzgjedhur për titull të hulumtimit të tij fjalën *Stealth Marketization*, me qëllim që çështjes së përhapjes së shkollave internacionale në vendet e ndryshme të botës t'i jep kuptimin e depërtimit në qetësi dhe fshehurazi.<sup>661</sup>

Me shkolla internacionale kemi për qëllim shkollat që ndërlidhen me rrjetet tregtare të huaja të shpërndara në shoqëri të ndryshme ose shkollat e veçanta kombëtare që ofrojnë programe të huaja si p.sh.: programi amerikan SAT<sup>662</sup> ose programi britanik IGCSE<sup>663</sup> ose shkolla e mesme internacionale.<sup>664</sup> Bazuar në atë se kërkesa për këto programe të huaja është e madhe, disa nga shkollat e veçanta nuk mjaftojnë vetëm me ofrimin e një programi, por i ofron që të gjitha. Këto programe, gjatë tre dekadave të fundit janë përhapur me të madhe në shtet arabe dhe islame.

Rryma e globalizmit dhe internacionalizmit, përmes zhvillimit të shpejtë të sistemeve informative dhe mjeteve moderne të komunikimit, është përforcuar deri në atë masë sa që është vështirë të rezistohet. Para shoqërive, nuk ka rrugëdalje tjetër pos kërkimit të strategjive efikase për bashkëveprim me to, duke rritur disa përfitime pozitive dhe duke minimizuar ndikimin e tij negativ në përbërësit e identitetit ideologjik të shoqërisë dhe injorimin e veçorive kombëtare. Institucionet pedagogjike në veçanti janë më të përgatitura se sa tjerat për zhvillimin e strategjive të nevojshme për mbrojtjen e nxënësve kundër çështjeve që rrezikojnë identitetin e tyre civilizues, u mundësojnë përfitimin e mendimit analitik kritikues, vetëbesimin, orientimet pozitive dhe vlerat morale.

<sup>660</sup> Hyejin Kim & Erik Mobernd, *Stealth Marketization: How International School Policy is Quietly Challenging Education Systems in Asia*, *Globalization, Societies and Education*, Online Journal, Published online, 25 Jan 2019, DOI: 10.1080/14767724.2019.1571405.

<sup>661</sup> Ibid.

<sup>662</sup> Scholastic Aptitude Test.

<sup>663</sup> International General Certificate for Secondary Education.

<sup>664</sup> International Baccalaureate.



Rryma e globalizmit dhe internacionalizmit -përfshirë edhe arritjet informatike dhe mjetet e komunikimit- kanë dhënë mundësinë për hapjen e kulturave në atë mënyrë që i mundëson dominimin e kulturës më të fortë ndaj të tjerave. Në anën tjetër, aspekti politik dhe ai ekonomik i globalizmit dhe internacionalizmit janë duke bërë presione për përcaktimin e filozofisë, politikave dhe programeve të arsimit, gjë që këto presione mund të çojnë drejt pranimit që shpreh dobësinë, mosbesimin në vetëvete dhe pamundësinë për rezistimin e ndikimeve negative. Mirëpo, -në të njëjtën kohë- rryma e globalizmit është një shans për të vërtetuar prezantimin ideologjik dhe kulturor dhe për të shndërruar orientimin e tij për realizimin e shumë përfitimeve dhe për të kontribuar në vetëdijësimin e përparimit dhe civilizimit njerëzor.

### 3.3. Modernizmi dhe postmodernizmi

Modernizmi është vizion i ri ndaj botës që ka shoqëruar ndryshimet që ka përjetuar Evropa që nga fillimi i Renesancës. Kjo gjë ka ndodhur në emër të reformave fetare, liritimit nga dominimi i Kishës, angazhimit të mendjes në hulumtim dhe zbulim shkencor, besimit në idenë e përparimit dhe përhapjen e parimeve të lirisë dhe demokracisë. Pra, modernizmi është dukuri historike dhe gjendje njerëzore, e cila është manifestuar në mendim dhe filozofinë logjike nga njëra anë, dhe në realitetin shoqëror në sferat politike, shoqërore dhe ekonomike nga ana tjetër. Mendimet e historianëve rreth fillimit të periudhës së Renesancës evropiane janë të ndryshme. Disa thonë se ka filluar me zbulimin e shtypshkronjës në Gjermani më 1453 nga ana e Rotenbergut, ndërsa disa të tjerë thonë me Revolucionin francez më 1789. Në këtë kohë janë zhvilluar vlerat e lirisë, individualizmit dhe të qenët të njeriut epiqendër në vend të Zotit dhe është dalluar me besim në mendje, shkencë dhe bindje.

Sa i përket postmodernizmit edhe ajo është vizion ndaj botës, e cila është zhvilluar në gjysmën e dytë të shekullit XX.

Postmodernizmi shpreh një periudhë të re në historinë e civilizimit perëndimor. Është formuar si rezultat e ndjenjës së dështimit të së ardhmes që kishte premtuar modernizmi, pra, ishte reaktion përballë tij. kjo ndjenjë u përforcua, pas shkatërrimit të cilin e kishin shkaktuar në Evropë dy luftërat botërore, e para dhe e dyta. Filozofët dhe mendimtarët kishin humbur besimin në projektin politik dhe ekonomik, duke u zhvilluar idetë e dyshimit, egocentrizmit dhe relativizmit. Filozofia e postmodernizmit mohon ekzistimin e realitetit absolut dhe minimizon rëndësinë e pushtetit, institucioneve dhe feve që flasin për të vërteta objektive dhe shfaqin fundin e pozitivizmit.

Vlen të theksohet se as filozofia e modernizmit e as ajo e postmodernizmit nuk kanë vetëm një formë. Secila prej tyre ka mendime të llojllojshme dhe dallime mes orientimeve të mendimtarëve.

Ajo që na intereson nga modernizmi dhe postmodernizmi është dallimi në manifestimin e secilit prej tyre ndaj teorive dhe praktikave pedagogjike. Nëse pedagogët modernistë duhet të ushtrojnë pushtetin për përcjelljen e njohurive objektive dhe të paanshme deri te nxënësit, pedagogët e postmodernizmit u ndihmojnë nxënësve për formimin e njohurive. Sipas modernizmit, nxënësit duhet të mësojnë kulturën e përbashkët të shoqërisë së unifikuar, në kohë kur postmodernizmi këtë e konsideron rrugë për të shtrirë kulturën dominuese. E gjithë kjo duke pasur në konsideratë se kulturat anësore kanë vlerat dhe besueshmërinë e tyre dhe se ndjekësit e tyre duhet të rezistojnë ndaj centralizmit të kulturës evropiane.

Natyra e njeriut cilësohet me atë se ka vendosmëri ideologjike, gjë e cila mund të njihet në mënyrë objektive. P.sh. aftësia njerëzore mund të shihet përmes testeve të aftësisë. Përparimi i individit dhe shoqërisë realizohet si rezultat i të mësuarit të praktikimit të njohurisë objektive. Filozofia e postmodernizmit nuk beson në qenien e vërtetë e as në substancën natyrore të njeriut. Qenia është formim shoqëror, ndërsa arsimimi është mjet për të formuar qenien e

jo për ta zbuluar. Përparimi i individit dhe shoqërisë realizohet kur t'i jepet mundësia për të arritur te qëllimet që ka zgjedhur për veten e tij.

Modernistët tradicionalë janë të mendimit se pedagogët janë autoritet legjitim për përcaktimin e vlerave dhe se ata duhet t'i ushtrojnë nxënësit për vlerat e përgjithshme. Ndërsa, modernistët liberalë janë të mendimit se pedagogët duhet të jenë neutral kur bëhet fjalë për vlerat, ndërsa mësuesit mjafton t'iu ndihmojnë nxënësve për t'ua sqaruar vlerat të cilat duhet t'i përvetësojnë. Pastaj vlerat janë të ndara nga të vërtetat. Vlerë më e rëndësishme në filozofinë moderniste është logjikshmëria dhe progresi. Filozofia postmoderniste beson se pedagogjia duhet t'iu ndihmojë nxënësve në formimin vlerave të llojllojshme të personalitetit, të cilat janë të dobishme për secilin prej tyre në kontekst të kulturës së tyre anësore. Nuk ka vlera të dobishme në mënyrë absolute, as nuk ka problem që mësuesit të shpallin vlerat e tyre, ngase praktikisht një gjë e tillë është e pamundur. Vlerat e rëndësishme në arsim përfshijnë përpjekjet për diversitet, tolerancë, liri, kreativitet, largpamësi dhe vlerësimin e emocioneve.<sup>665</sup>

Mund të thuhet se polemikat rreth modernizmit dhe postmodernizmit në sferën pedagogjike në shoqëritë islame, mund të jenë të pakuptimta, ngase këtyre shoqërive nuk u intereson transferimi nga modernizmi në postmodernizëm, ngase që të dy filozofitë janë të veçantë për mendimin perëndimor. Shoqërive tona islame u duhet formimi i një filozofie pedagogjike që buron nga vizioni jonë islam ndaj botës, udhëzimet që jep ky vizion përfshirë elementet e sistemit njohës të bazuara në sistemin e besimit dhe të vlerave. Atë që e zgjedhim prej elementeve të sistemit njohës në sferën pedagogjike, qoftë në programe mësimore, plan-programe apo sisteme për menaxhim, mund të jetë më afër të mendimeve të modernizimit. Sa i përket lëvizjes postmoderniste, shumë prej mendimeve të tyre nuk janë diç e

<sup>665</sup> Dennis McCallum, *Comparing Modernist and Postmodern Educational Theory*. Shih linkun: <https://www.xenos.org/essays/comparing-modernist-and-postmodern-educational-theory>.

re, por janë pjesë e njohur dhe zhvillim i domosdoshëm në mendimet e modernizmit. Pastaj, lëvizja postmoderniste, momentalisht, nuk përfshin një sistem të fuqishëm me shenja të qarta, në atë mënyrë që mjaftën për të formuluar themele filozofike, psikologjike dhe shoqërore për pedagogjinë e synuar. Çështja më e rrezikshme tek ajo është mangësia në perceptimin e natyrës njerëzore dhe lënia pas dore e identitetit të përkatësisë ideologjike përmbledhëse dhe kërcënimi i sistemit të vlerave.

Me zhvillimin e shoqërive islame dhe përpjekjet e tyre për të dalë nga kjo gjendje prapambetjeje drejt një të ardhme ku këto shoqëri do të japin një kontribut efikas në formimin dhe vetëdijesimin e civilizimit njerëzor, biseda jonë rreth modernizmit nuk do të përfshijë modernizmin evropian të shekullit XV dhe më pas, si dhe ndodhitë dhe zhvillimet që kanë ndodhur më pas, por do të jetë bisedë rreth një modernizmi të veçantë për neve, tash dhe këtu.

### 3.4. Filozofia humaniste dhe filozofia materialiste

Zgjedhëm të bashkojmë mes dy filozofive, asaj humaniste dhe materialiste për shkak të lidhshmërive të thella që kanë mes vete. Që të dy filozofitë përfaqësojnë disa elemente themelore të referencës në mendimin perëndimor. Me parimin e humanizmit kemi për qëllim, kryerja e punëve nga vetë njeriu, pa pasur nevojë për Zot. Për këtë, motoja e Shoqatës Humaniste Amerikane ishte: “Mirësi pa pasur nevojë për Zotin”<sup>666</sup> dhe besimi në njeriun në vend të Zotit.

Është e domosdoshme të bëjmë dallimin mes termit “njerëzore-humaniste” që ka për qëllim kujdesin e njeriut për njerëzit tjerë dhe shprehjes “humanizëm” si filozofi përparimtare dhe vizion ndaj botës, ku njeriu nuk ka nevojë për besim në Zotin apo për dikë prej besimeve jashtënatyrore. Sipas kësaj filozofie njeriu është i fuqishëm dhe përgjegjës ndaj jetës morale dhe synon bamirësinë e përgjithshme.

<sup>666</sup> *Good without A God.*

Një studim ka argumentuar me tekste dhe shprehje nga burimet zyrtare të Shoqatës së lartpërmendur që sqaron “bindjet e humanizmit” në politikë, arsim, media, art etj. Nga këto tekste shihet se bindjet e tyre ndërlidhen me ateizëm, evolucionizëm, materializëm, me të drejtën e abortimit, eutanazinë (vrasja e mëshirshme), suicidin (vetëvrasja), shkurorëzimi, martesë me gjininë e njëjtë dhe lirinë seksuale.

Ajo që na intereson këtu janë pasojat që lë kjo filozofi në sferën pedagogjike. Është e njohur se filozofia dominuese në arsimin publik dhe atë universitar është filozofia humaniste. Qëndrimi laik zyrtar në shkollat amerikane ndalon ritualet fetare në aktivitetet shkollore, mirëpo u lejon nxënësve dhe studentëve të formojnë klube të ndryshme ku mund të diskutojnë çfarëdo tema. Megjithatë, ata duhet fuqishëm të mbrojnë të drejtën e tyre në mbledhjet vullnetare në shkolla, para ose pas orarit mësimor për të realizuar diskutime fetare. Mund të thuhet se çdo arsim bazik prej parimeve të humanizmit është miratuar nga vendimet zyrtare të Shoqatës Kombëtare për Arsim (NEA).<sup>667</sup>

Dihet se shumica absolute e pedagogëve në Amerikë dhe Botën Perëndimore besojnë në filozofinë humaniste. Gjithashtu janë edhe stafi arsimor në fakultete dhe universitete. Si ta janë edhe shumica e mësimitdhënësve në shkollat fillore dhe të mesme, po edhe nëse një numër i madh i tyre për shkaqe personale, shoqërore apo praktike, ruajnë lidhjet me kishat krishtere dhe sinagogat hebreje.<sup>668</sup>

Rreth filozofisë humaniste do të mjaftojmë duke theksuar deklaratën e “Manifesto”, në botimin e tretë të botuar më vitin 2000 me titull: “Deklarata e filozofisë humaniste për vitin 2000: ftesë për filozofi humane planetare”.<sup>669</sup>

Këtë deklaratë e ka shkruar Paul Kurtz, ndërsa e kanë nënshkruar 120 mendimtarë dhe akademikë nga vendet e Azisë, Afrikës, Amerikës dhe Evropës. Në mesin e tyre kishte edhe tre personalitete nga Bota Islame: Teslime Nisrin nga

<sup>667</sup> <https://www.gospelway.com/religiousgroups/humanism.php>.

<sup>668</sup> Morris B. Storer (Editor), *Humanist Ethics*, New York: Prometheus Books (August 1, 1979).

<sup>669</sup> Paul Kurtz, *Humanist Manifesto 2000: a Call for A New Planetary Humanism*, Amherst: NY: Prometheus books, 2000, fq. 1-76.

Bangladeshi e njohur me shkrimet e saja kundër Islamit, Sadik El-Adhm nga Siria, i cili është deklaruar si laik dhe ka shkruar disa libra në mesin e të cilave edhe librat: “Nakd’ul-Fikr’id-dini – Kritika e mendimit fetar” dhe “Difaan anil-madijeti ve’t-tarih – në mbrojtje të materializmit dhe historisë” dhe Murad Vehbe nga Egjipti, i cili është i krishterë laik që ka mohuar të vërtetën absolute për të cilën flasin fetë. Në librin e tij “Mulak’ul-hakikat’il-mutlakati - Pronarët e të vërtetës absolute” ka theksuar humnerën në të cilën e ka futur filozofia njeriun, si dhe dështimin e saj për të arritur deri tek e vërteta absolute.

Në anën tjetër, filozofia materialiste është e lidhur ngushtë me filozofinë humaniste. Kur vërejmë se njeriu është i kujdesshëm për të jetuar jetën pa dhembje, i posedon nevojat e tij siç janë: pasuria, pronësia dhe pozita shoqërore që e bëjnë atë të lumtur, ndjen siguri shoqërore dhe politike, dhe jeta e tij kufizohet në ekzistimin e këtyre çështjeve materialisht dhe shoqërisht, pa pasur nevojë për diçka tjetër, e gjithë kjo shpreh perceptimin material të jetës. Mirëpo filozofia materialiste është diçka tjetër. Ajo është perceptim ndaj jetës, dhe se çdo gjë që nuk është e prekshme dhe logjike, nuk mund edhe të njihet.

Bindjet materialiste sot kanë arritur në një pozitë përparimtare, deri në atë nivel ku imponon klasifikimin e tij nga të qenit “filozofi materialiste” në një pozitë tjetër “materializmi shkencor”.

Nuk ka dyshim se ekzistojnë disa dimensione materialiste në jetë që njeriun e bëjnë të lumtur. Po ashtu nuk ka dyshim se besimi i njeriut në veten e tij për të zgjedhur problemet tij vetë është çështje e mirë. Kështu, pedagogjia duhet t’i mundëson njeriut të ndjen lumturinë dhe vetëbesimin. Nuk duhet harruar se në brendinë e njeriut ka edhe elemente tjera që nuk mund të injorohen, as praktikat pedagogjike -sa do që të jenë të rrepta- nuk mund t’i çrrënjosin atë. Në materie ka diçka më shumë se materie. Në brendinë e njeriut ka diçka më shumë se të qenët individ dhe qenie shoqërore. Filozofia materialiste dhe ajo humane nuk mjaftojnë për të plotësuar

ndjenjën e njeriut për vetëplotësim dhe synim ndaj horizonteve tjera jashtë vetes dhe jashtë rrethit të tij material. Natyra njerëzore, edhe te fëmijët parashtron ca pyetje më shumë se sa të mësuesit e tyre.

Arsimi i ndikuar nga bindjet materialiste apo humaniste, e bënë nxënësin të ndjenë se ai duhet të bindet në disa çështje, kundër vullnetit të tij dhe se duhet nxënësit t'i orienton drejt shqetësimit dhe hamendjes, ndoshta edhe drejt humbjes, papërgjegjësisë dhe nihilizmit.

### 3.5 Strukturalizmi dhe dekonstrukturalizmi

Është e përshtatshme që fjalën tonë rreth kësaj tematike ta fillojmë duke bërë dallimin mes strukturalizmit dhe strukturës mësimore (el-binaije). Hulumtuesit, termin “strukturalizëm” e mbështesin në dyfishimin e shprehjes dhe kuptimit. Njëjtë siç ka ndodhur në gjuhën arabe sipas Abdulkadir Xhurxhanit (400-471 h./1010-1078) rreth teorisë së strukturës (En-Nadhmu). Këtë gjë, në periudha të ndryshme, e kanë zbuluar disa evropianë. Më e njohur është zbulimi i gjuhëtarit zviceran Ferdinan Di Soser (1857-1913) në fillim të shekullit XX, të cilit i atribuohet themelimi i teorisë strukturale në gjuhë. Atë në këtë çështje e ndjek Klod Livi Stervas (1908-2009), të cilit i atribuohet strukturalizmi në sociologji dhe antropologji. Ka edhe hulumtues tjerë strukturalist në sfera dhe specializime të ndryshme.

Sa i përket termit “el-binaije – struktura mësimore” është e veçantë për përshkrimin e procesit të mësimnxënies njerëzore. Sipas teorisë së strukturës mësimore dhe mësimit të gjuhës, mësimnxënia nuk realizohet duke i ofruar njohuritë e reja deri të nxënësi përmes grumbullimit të njohurive, por realizohet përmes bashkëveprimit të njohurisë së re me strukturën mentale të nxënësit që gjendet më parë. Ky bashkëveprim riformulon strukturën mentale sa herë që hyn në te njohuri e re. Hulumtuesi më i rëndësishëm që ka sjell teorinë e strukturimit mësimor është psikologu zviceran Zhan Pijazhe (Jean Piaget) (1896-1980), në veçanti në librin e tij “Epistemologjia formuluese”. Andaj, strukturalizmi është

teori mbi strukturën e tekstit, ndërsa struktura mësimore është teori mbi strukturën mentale dhe mësimnxënien e njeriut.

Struktura mësimore ka pozitivitetet dhe negativitetet e saj. Në kontekstin të cilin jemi duke biseduar, nuk ka ndonjë rëndësi të veçantë. Në jemi duke biseduar për strukturalizmit, që filozofia dekonstrukturale ka ardhur për ta rrëzuar atë.

Strukturalizmi është shkollë ideologjike që mendon se dukuritë shoqërore, letrare dhe psikologjike në esencë janë strukturë me elemente të caktuara, për kuptimin e të cilit nuk ka nevojë për faktorë tjerë jashtë kësaj strukture, si p.sh.: orientimet e studiuesit, referenca e tij ideologjike etj. Si themelues i teorisë strukturaliste në formën që ka përfunduar në shekullin XX njihet gjuhëtari zviceran Ferdinan Di Soser të përfshirë në librin e tij “shkenca e përgjithshme e gjuhës”. Soser në librin e tij ka përdorur shprehjet “sistem” dhe “strukturë”. Përkthyesi i këtij libri ka zgjedhur shprehjen “i përbërë” në njërin nga përkthimet e librit të Soserit me titull “shkenca e përgjithshme gjuhësore”,<sup>670</sup> ndërsa në përkthimin tjetër të librit me titull “Gjuhësimet e përgjithshme” është përdorur shprehja “strukturë”.<sup>671</sup>

Soser kishte kuptuar rëndësinë e studimit të gjuhës në një formë ndryshe nga ajo që e dinin studiuesit më parë. Ata koncentroheshin në metodologjinë historike në studimin e gjuhës. Ai flet për rëndësinë e gjuhës dhe domosdoshmërinë e studimit të saj, si çështje që nuk iu intereson vetëm gjuhëtarëve. Është kështu për arsye se “prej çështjeve që nuk dyshohet është se çështjet gjuhësore u interesojnë gjithë atyre që studiojnë tekstet, si historianët, gjuhëtarët dhe hulumtues tjerë. Nuk ka dyshim se shkenca e gjuhës ka rol në kulturën e përgjithshme. Në jetën individuale dhe shoqërore, gjuha llogaritet më e rëndësishme se çdo çështje tjetër. Për këtë, gjuha nuk duhet të jetë e kufizuar vetëm në mesin e një elite

<sup>670</sup> Soser, Ferdinan. *Ilm'ul-lugat'il-am*, Bagdad: Daru Afakin Arabijeh, 1985. Libri është një sërë ligjëratash që ka mbajtur në Universitetin e Gjenevës, ndërsa në vitin 1985 dy nga studentët e tij i kanë grumbulluar dhe publikuar në libër.

<sup>671</sup> Ferdinan Soser, *Durusun fi'l-elsinijet'il-ameti*, Tunizi: Ed-Dar'ul-arabijetu li'l-kitabi, 1985.



të vogël të ekspertëve, ngase ajo është e rëndësishme për të gjithë në çdo formë”.<sup>672</sup>

Më pas, strukturalizmi filloi të bashkëveprojë me specializimin në të cilin zbatohet, nga fakti se është sistem i komplikuar i përbërë nga pjesët e ndërlydhura mes vete. Pastaj shndërrohet në metodologji për analizimin e aktivitetit njerëzor dhe prodhimeve të tij në mënyrë të përgjithshme, sidomos në kulturë. Straus mendon se sistemet kulturore janë prodhim i një përbërje konstante të mendjes së njeriut. Ekzistimin e këtij skeleti konstant e ka argumentuar përmes analizave të tij rreth afërsisë, legjendave, artit, fesë, traditave etj.

Garodi ka bërë dallimin mes strukturalizmit si metodologji për hulumtim nga njëra anë dhe bindjes dogmatike të përgjithshme nga ana tjetër. Ai pranon si të ligjshme strukturalizimin si metodologji, ndërsa refuzon dimensionin e bindjes duke thënë: “Koncepti i “strukturalizmit” në ditët e sodit bartë në vete filozofi që në natyrën e saj dogmatike përfaqëson arritjen në filozofinë e vdekjes së njeriut; në filozofinë pa qenie.”<sup>673</sup> Ai shton duke thënë: “Ne pranojmë legjitimitetin e strukturalizmit si metodologji shkencore për analizimin e një niveli të caktuar të realitetit njerëzor dhe shoqëror, ndërsa heqim dorë nga strukturalizmi kur pretendon se është filozofi që realitetit njerëzor i jep një analizim gjithëpërfshirës. Strukturalizmi në rastin e parë është një mjet nga i cili nuk mund të heqim dorë, ndërsa në rastin e dytë është tjetërsim sterilizues”.<sup>674</sup>

Garodi mendon se gjenerata e strukturalistëve që ka ardhur pas Strausit nul luhaten për të shkuar aq larg në strukturalizëm që imagjinon një histori që nuk ka vend për njerëzit në te. Vëren se ata shfaqin nëpërmjet Foko, pasi Niçe shpalli Zotin si të vdekur, ajo që vërehet në ditët tona nuk është mungesa apo vdekja e Zotit, aq sa është fundi i njeriut dhe se njeriu do të zhduket”.<sup>675</sup> Pionierët e strukturalizmit

<sup>672</sup> Soser, *Ilm'ul-lugat'il-am*, vepër e cituar, fq. 25

<sup>673</sup> Garodi, *El-Bunjevijetu: felsefetu mevt'il-insani*, vepër e cituar, fq. 13.

<sup>674</sup> Vepër e cituar, fq. 17.

<sup>675</sup> Vepër e cituar, fq. 29-30.

sipas Garodit ishin: Marksi, Frojdi dhe Di Soser. Marksi ishte i pari që zbatoi metodologjinë strukturale gjatë analizimit të tij të kapitalit. Për këtë, ai mendon se “marksizmi në esencë, në të njëjtën kohë lejon dy çështjet: strukturalizmin dhe aktivitetin njerëzor, ngase metodologjinë strukturale e bënë element të domosdoshëm prej elementeve të metodologjisë dialektike”.<sup>676</sup>

Strukturalizmi me gjitha llojet e saj, në Botën Arabe është shfaqur në vitet e shtatëdhjetat shekullit XX, dhe atë përmes disa studentëve arab që kanë studiuar në Evropë dhe përmes disa përkthimeve të disa veprave nga gjuha frënge në gjuhën arabe. Prej personaliteteve më të njohura në strukturalizëm, që kanë shkruar për te dhe kanë përkthyer disa vepra në gjuhën arabe janë: Xhabir Asfur, Kemal Ebu Dib, Zekerija Ibrahim, Salah Fadl, Juna El-Id, Muhamed Benis, Muhamed Miftah, Muhamed Berade etj. Ata gjetën disa institucione kulturore dhe mediatike që u kushtonin kujdes të veçantë dhe ua reklamonin veprimet e tyre.

Sa i përket dekonstrukturalizmit, sipas “Enciklopedisë Britanike” definohet si formë e analizimit filozofik dhe kritikës letrare. Është zhvilluar nga veprat e Deridas duke filluar nga vitet e gjashtëdhjeta të shekullit XX, i cili ka përfshirë çështjet e dallimeve dhe kundërthënieve të ideologjisë esenciale në filozofinë perëndimore përmes kontrollimit të gjuhës dhe logjikës në tekstet filozofike dhe letrare. Dekonstrukturalizmi në vitet e tetëdhjeta të shekullit XX, në mënyrë të zgjeruar përdoret për përpjekjet teorike të cilat harxhohen në sfera të ndryshme në shkencat humane dhe shoqërore, duke përfshirë: filozofinë, letërsinë, psikanalizën, teologjinë, studimet feministe, çështjet e anomalive seksuale, teorinë politike dhe historinë. Kah fundi i shekullit XX, dekonstrukturalizmi filloi të përdoret në disa raste në diskutimet dialektike rreth orientimeve ideologjike, në atë formë që përfshin kuptimin e poshtërimin, nihilizmit dhe dyshimin në përdorimet popullore. Ky term filloi të

<sup>676</sup> Vepër e cituar, fq. 127.

nënkupton kritikë dekonstrukturaliste të traditave dhe metodave tradicionale të të menduarit.”<sup>677</sup>

Simon Strik është i mendimit se dekonstrukturalizmi është hyrje teorike dhe metodologjike për të arritur deri te qëllimi i synuar. Ai përmban lexim të hollësishëm dhe përshkrim të detajuar për zbulimin e kuptimit të caktuar të tekstit. Mirëpo, dekonstrukturalizmi -në fund- u bë hyrje për të bërë çështjet si të panjohura për neve dhe shpërbërjen e tyre që i bënë diç ndryshe. Strik ka përfunduar se “dekonstrukturalizmi në kontekstin e studimeve amerikane është punë që e kryejnë këto studime për të bërë veten dhe tematikat e saja diç të panjohura dhe të vështira, si dhe për të shpartalluar strukturën përmes së cilës zbatojmë formimin e kuptimit. Është vepër e nevojshme për t’iu shmangur pranimin e çdo kuptimi të caktuar të kulturës. Është vepër e nevojshme për të ruajtur pikëpamjet ndaj kulturës dhe politikës, që cilësohet me ndryshim, komplikim, histori, diversitet dhe nevojë për riformulim herë pas here.”<sup>678</sup>

Prezantimi i mendimeve të dekonstrukturalizimit, sidomos në kopjen që e paraqet Derida, në shkrimet perëndimore iu ka nënshtruar shumë kritikave dhe kritikave të kritikave. Një polemizues i Deridas rreth asaj çka është thënë ndaj tij, në mënyrë të shkurtër e ka përshkruar me sa vijon: “Ai është shejtan, peron që bënë rrëmujë në anët e rrugës, flet për relativitetin, është nihilist, shkatërrues i traditave dhe institucioneve, i bindjeve dhe vlerave, ai kujdeset vetëm për tallje ndaj filozofisë dhe realitetit, shpartallimin e gjithë çështjeve të shndritshme, që në vend të saj të sjell romane të egra pa kuptim dhe pa përgjegjësi.”<sup>679</sup>

Hamude, në librin e tij “El-Merajal-Muhadebetu” ka studiuar në mënyrë të detajuar strukturalizmin dhe dekonstrukturalizmin në referencat e tyre perëndimore dhe arabe. Ai ka përfunduar se strukturalizmi në fillim kishte për

<sup>677</sup> <https://www.britannica.com/topic/deconstruction>.

<sup>678</sup> Simon Strick, “Structuralism/Deconstruction” në: Antje Dallmann Eva Boesenbery and Martin Klepper (Editorë), *Approaches to American Cultural Studies*. London: Routledge; 1 edition, 2016, fq. 154.

<sup>679</sup> J. D. Caputo (Editor), *Deconstructing in a Nutshell. A Conversation with Jacques Derrida*, New York: Fordham University Press, 1997, fq. 36.

qëllim “ndriçimin e tekstit, gjë e cila nuk është realizuar” në vend se të “ofrohet” apo “ndriçohet” teksti, strukturalizmi është përdorur si gjuhë kritike që ka mbyllur tekstin dhe ka dështuar në realizimin e kuptimit. Ata në realitet, janë angazhuar me formën e tekstit dhe harruan brendinë dhe kuptimin e tij. U morën me përcaktimin e paraqitjes, sistemeve dhe se si vepron, por e injoruan se “çka nënkupton teksti”, më pas, pas kalimit të kohës, zbuluan se modeli gjuhësor, në mënyrë të domosdoshme, nuk i përshtatet paraqitjes dhe sistemeve jogjuhësore, ku krejt në fund, strukturalistët u shndërruan në burgosës të gjuhës”.<sup>680</sup>

“Strategjia e dekonstrukturalizmit është themeluar duke refuzuar të qenët e kritikës si shkencë, dyshimin në të gjitha sistemet, rregullat dhe traditat dhe shndërrimi në pafundësinë e kuptimit...në vend të saj dekonstrukturalistët sollën modelin e vetleximit dhe rebelimin ndaj përfundimit apo mbylljes së tekstit. Ata gjithashtu edhe “të qenët e kritikës së shkencë” e zëvendësuan me “letrarizimi i gjuhës kritike”. Ata kështu, paqartësisë së kuptimit, ia shtuan edhe gjuhën kritike, i cili synon tërheqjen e vëmendjes drejt saj, larg tekstit. Kështu, krejt në fund, dekonstrukturalistët përfunduan në të njëjtën pikë që kishin përfunduar konstrukturalistët, e që është mbyllja e tekstit.”<sup>681</sup>

Disa hulumtues kanë bërë lidhshmërinë mes strukturalizmit dhe teorisë së strukturës (En-Nadhmu) të Abdulkahir Xhurxhanit në librin e tij “Delail’ul-I’xhazi”. Kjo teori është krejt ndryshe nga strukturalizmi. En-Nadhmu sipas Abdulkahirrit është “të vësh fjalën në vendin e duhur sipas rregullave sintaksore, të veprorsh sipas rregullave të saj duke njohur mirë metodat, pa lejuar devijim dhe duke pasur në konsideratë shenjat e pikësimit, pa anashkaluar asgjë prej tyre”. “Nuk dimë se ka diç që dëshiron poeti apo shkrimtari me strukturën e fjalëve të tij, pos që të shikon format dhe dallimet, duke caktuar për secilën fjalë pozitën e tij dhe duke e vendosur atë aty ku e ka vendin... kjo është mënyra. Nuk

<sup>680</sup> Abdalaziz Hamude, *El-Merejal Muhadebetu: mine'l-bunjevjeti ile't-tefkikijeti*, silsiletu Alem'il-Me'rifeti nr. 232, Kuvajt: El-Mexhlis'ul-vatanijju li'th-the kafeti ve'l-fununi ve'l-adabi, Prill 1998, fq. 7.

<sup>681</sup> Po aty, fq. 8.

kam hasur në diç që saktësia apo gabimi t'i atribuohet strukturës (En-Nadhmu).<sup>682</sup>

Sa i përket strukturalizmit, ai tekstin e ndanë nga autori dhe çdo gjë që i përket autorit duke përfshirë: historinë, mendimin, qëllimet që synon autori, si dhe rrethanat që e shoqërojnë autori dhe përpilimin e tekstit. Kuptimet e tekstit janë të llojllojshme dhe të ndryshme sipas lexuesve. Nuk prish punë të kundërshtohen skajshmërisht. Me këtë, kuptimi i tekstit nuk ka asnjë referencë.

Mësuam më parë se “el-binajetu – struktura mësimore” ishte term i veçantë për procesin e të mësuarit njerëzor. Atë e ka zhvilluar Zhan Pijazhe, duke bërë përpjekje për të përshkruar atë që i ndodhë individit gjatë procesit të të mësuarit, si dhe praktikat që dalin nga metodat mësimore. Këto praktika, nuk kanë marrë në konsideratë se nxënësi në shkollë nuk është i vetëm, por është pjesë e një strukture shoqërore që ka ndikim të rëndësishëm. Ka lloje të njohurive të rëndësishme që nxënësi ka nevojë t'i mëson në mënyrë të drejtpërdrejtë, si të dhëna përfundimtare. Të gjithë nxënësit nuk mësojnë në të njëjtën formë. Nëse teoria e strukturës mësimore jep sqarim për disa anë të mësimnxënies, ajo është e pamundur për të dhënë sqarime në anë tjera.

Nëse strukturalizmi në esencë ishte metodologji për analizimin e gjuhës, atëherë supozohet që praktikat themelore të kësaj metodologjie, në sferën pedagogjike, të jenë në të mësuarit e gjuhës. Mirëpo, që nga vitet e pesëdhjeta të shekullit XX, strukturat gjuhësore u bënë temë shqetësuese, ku konceptet e saja u konsideruan si të ngushta, sidomos pas asaj që ofroi Naum Çomski rreth tyre. Bazuar në atë se strukturalizmi shumë shpejt u shndërrua në dekonstrukturalizëm, atëherë edhe praktikat pedagogjike shumë shpejt u orientuan drejt dekonstrukturalizmit. Këtu u përfshin gjitha çështjet që supozohet të kanë lidhshmëri me pedagogjinë, qoftë përmes formimit të referencës ideologjike në formimin e shkencave të ndryshme, apo rreth pikënisjeve

<sup>682</sup> Abdulkahir ibn Abdurrahman El-Xhurxhani (vd. 474 h./1081), *Delail'ul-l'xhaz*, Kajro: Mektebet'ul-Hanxhi, 1404 h./1984.

ideologjike të pedagogëve dhe lidhshmërisë së saj me etikën pedagogjike apo gjendjen psikologjike dhe ideologjike të nxënësve.

Në parathënien e librit të tyre rreth Deridas dhe arsimit, redaktorët e librit kanë vërejtur se mendimet e Deridas më së shumti përfaqësojnë dekonstrukturalizmin. Sidomos mendimet që ndërlidhen me arsimin kanë hasur në kundërshtim, dhe se shumë prej ekspertëve në filozofinë pedagogjike, teorinë pedagogjike dhe ekspertët e programeve pedagogjike kanë shkruar për të mposhtur mendimet e tij. megjithatë, këto mendime kanë hasur në interesim jo të vogël. Mendimet e dekonstrukturalizmit janë pranuar në katedrat e gjuhës angleze në titullin "Teoria e leximit dhe shkrimit", si dhe i praktikat mësimore të letërsisë.<sup>683</sup>

Në përgjithësi, Derida, projektin e tij të dekonstrukturalizmit e llogarit në esencë si projekt pedagogjik. P.sh., ai kur kërkon hulumtimin në një fushë studimore të caktuar si filozofia, ai kërkon nxjerrjen e kësaj fushe nga muret që e kanë vënë studimet tradicionale në universitete. Filozofia "duhet t'i lejohet asaj të luaj vetë një rol më të rëndësishëm në të menduarit, në prezantimin e saj, në të mësuarit e saj dhe në zhvillimin e saj. Kjo është pikërisht që formon ligjësimin e lidhjes mes pedagogjisë dhe dekonstrukturalizmit, ngase ky legjitimitet është themeluar në bazë të asaj se pyetja për dekonstrukturalizmin në realitet është pyetje për pedagogjinë, po që se kuptojmë në mënyrë pozitive natyrën e dekonstrukturalizmit. Pra, çështja nuk është çështje rregullash gjuhësore në fjali, e që është temë mësimi, por është raport me tjetrin i cili mësohet dhe si mësohet. Kjo çështje, transferon shumë prej pyetjeve nga niveli teknik dhe procedural në lidhshmërinë e thellë me çështjet morale, politike dhe fundin e jetës, historisë dhe njerëzisë. Njohuria filozofike depërton në të gjitha sferat e njohurisë.<sup>684</sup>

<sup>683</sup> Denise Egea-Kuehne - Get J. J. Biesta, *Derrida and Education*, po aty, fq. 2.

<sup>684</sup> Didier Cahen, "Derrida and the question of education: a new space for philosophy", në: Gert J.H. Biesta & Denise Egea-Kuehne (Editorë), *Derrida & Education*, London, UK; Routledge International Studies in the Philosophy of Education, 2001, fq. 12-30.

Në fund të bisedës rreth referencave të mendimit pedagogjik perëndimor, vlen të theksohet se ne nuk jemi përpjekur të përfshijmë të gjitha manifestimet e referencës perëndimore të mendimit pedagogjik, si dhe ndikimet e tyre në mendimin pedagogjik të shoqërive islame. Ka edhe filozofi tjera që përputhen me filozofitë e lartpërmendura në disa elemente dhe në disa tjera dallojnë mes tyre. Mirëpo, është me rëndësi të vërejmë se sistemet pedagogjike perëndimore, qoftë në Amerikë apo Evropë, është e vështirë të klasifikohen në kuadër të një shkolle. Kështu p.sh. themi se sistemi pedagogjik në Amerikë është sistem modern, ose postmodern ose laik ose human. Të gjitha këto cilësi gjenden bashkërisht në sasi të madhe. Megjithatë, po ashtu është me rëndësi të përqijemi të bëjmë dallimin në cilësinë gjithëpërfshirëse të referencës së mendimit pedagogjik perëndimor. Në kontekst të bisedës rreth mendimit pedagogjik islam, ajo që na intereson është lidhshmëria e kësaj reference me fenë përmes laicitetit, si dhe lidhshmërisë me normat e jetës përmes materializmit.

Përpjekja jonë për të bërë dallimin e elementeve të referencës së mendimit perëndimor në përgjithësi dhe mendimit pedagogjik perëndimor në veçanti, nuk është përpjekje për të gjetur shkëputje të raporteve me këtë mendim, po është përpjekje për të kuptuar përfaqësimet e kësaj reference në detajimet e mendimit pedagogjik, përfshirë: filozofinë, politikën, plan-programet, sistemet e menaxhimit dhe kriteret për vlerësim. Ky lloj kuptimi na ndihmon në zhvillimin e metodologjisë së bashkëveprimit me këtë mendim dhe ndërveprim me sistemet, veçoritë, pasojat që mund të vijnë nëse i huazojmë ato për politikën dhe planet tona pedagogjike, si dhe thellimin e të kuptuarit tonë ndaj paqartësive që sjell ky huazim para përpjekjeve për reformim pedagogjik në shoqëritë tona. Ne jetojmë në një realitet botëror tepër të rëndë, ku nuk lejohet injorimi i të dhënave dhe elementeve të tij, as nuk sjellin dobi përpjekjet e izolimit dhe tërheqjes në vete për të cilin ftojnë disa njerëz të dobët dhe të paaftë.

Shpresojmë që kuptimi ndaj mendimit pedagogjik bashkëkohor të na ndihmon në përcaktimin e asaj që mund të kuptohet nga realiteti i mendimit pedagogjik bashkëkohor islam, si dhe ambiciet që shpresojmë të kalojë ky realitet, bazuar në referencën e lartë, dhe kontributin për riformulimin e personalitetit islam në shoqërinë dhe umetin islam. E gjithë kjo me qëllim për të realizuar vullnetin e Allahut për ngritjen e përparimit dhe civilizimit njerëzor të bazuar mbi shpalljen hyjnore dhe udhëzimet pejgamberike, prezantimin efikas në arenën ndërkombëtare dhe udhërrëfimin e civilizimit njerëzor.

Është normale dhe natyrore që çdo shoqëri të ketë referencën e saj pedagogjike, e cila përcakton elementet e mendimit pedagogjik të veçantë për te. Problemi fillon, atëherë kur shoqëria humb këto elemente dalluese, dhe merr mendimin pedagogjik të veçantë për një shoqëri tjetër si lëndë për edukimin e bijve të saj. Kur shoqëritë islame përvetësojnë mendimin pedagogjik perëndimor, atëherë është normale që bijtë dhe bijat e saja të zhvillohen sipas vlerave dhe traditave të mendimit perëndimor. Po nëse te bijtë dhe bijat e saja mbetet diçka nga vlerat dhe traditat islame -si rezultat i faktorëve tjerë- me siguri se do të jenë në një gjendje konflikti dhe gara me vlerat perëndimore. Kjo gjendje do të rezultojë shkatërrimin e personalitetit të njeriut musliman, do të dobësohen përbërësit e identitetit islam dhe do të zhduken veçoritë e saj.

Problemi do të thellohet edhe më shumë kur vëren se si politik-bërësit dhe prijësit e mendimit pedagogjik në shoqëritë islame, injorojnë apo mohojnë ekzistimin e referencës së mendimit pedagogjik perëndimor në plan-programet mësimore. Në të njëjtën kohë, shtiren se nuk vërejnë dukuritë e njëanshmërisë së këtij mendimi.<sup>685</sup> Ata bazohen në argumente të dobëta, si p.sh.: thënia se shkenca nuk ka fe e as vatan, ose rëndësia e zhvillimit dhe kapja me shoqëritë përparimtare, ose domosdoshmëria e modernizimit dhe dalja nga gjendja e prapambetjes, si dhe arsyetime tjera,

<sup>685</sup> Melkavi, "Et-Tehajjuzu fil-fikr'it-terbevij'il-garbijj", vepër e cituar, fq. 181-202.



të cilat sistemet politike në Botën Islame i kanë përdorur si argumente për praktikat e tyre gjatë një shekulli, por rezultati i gjithë kësaj ishte rritja e prapambetjes, imitimi, humbja e identitetit dhe paaftësia për prezantim efikas në arenën ndërkombëtare.

Referenca jonë për reformimin e synuar nuk është historia, as historia jonë e as historia e të tjerëve. Po nëse në këtë histori ka mësim, atëherë këto mësimë është patjetër të jenë element i referencës. Referenca jonë nuk është realiteti bashkëkohor i të tjerëve. Po nëse ky realitet bashkëkohor është faktor për presion, atëherë me këtë faktor duhet të veprojmë me mënyrë të përshtatshme. Referenca jonë është një grup parimesh dhe vlerash që formojnë identitetin tonë. Pikënisja jonë është nga këto parime dhe vlera. Në to mbështetemi në çdo element të planifikimit për ndryshimin e gjendjes reale dhe përgatitjen për të ardhmen, si dhe në çdo hap gjatë ecjes drejt zbatimit të këtij planifikimi.

Referenca jonë është vizioni universal ndaj botës natyrore, shoqërore dhe psikologjike, si dhe identiteti i veçuar për neve e formuar nga kjo referencë. Ajo përcakton se: kush jemi ne? Dhe çka dëshirojmë?

## Pjesa e tretë: Vetëdijësimi për çështjen e reformave pedagogjike dhe përgjegjësitë e qarqeve pedagogjike

### 1. Prania e vizionit islam në reformat pedagogjike

Çereku i fundit i shekullit XX, në veçanti pas humbjes së arabëve në vitin 1967, përjetoi një vetëdije të rritur për nevojën rreth një vizioni islam për reformat në arsimin publik dhe atë universitar. Në këtë kohë aspekti kombëtar përjetoi dobësim në shumicën e shteteve islame. Lindi një gjendje e re e cila u njoh si “Rizgjimi islam” dhe u themeluan disa institucione pedagogjike me kahe islame. Në vitin 1977 u mbajt Konferenca e Parë rreth arsimit islam në Mekë. Më pas, në vende të ndryshme islame, u mbajtën edhe shumë konferenca të veçanta rreth reformimit të arsimit. U themeluan disa universitete islame dhe u shfaq lëvizja e islamizimit të diturisë. Kjo lëvizje nxiti interesimin rreth arsimit të dyfishtë, atë fetar dhe atë laik, duke kritikuar që të dyja sistemet, dhe duke ftuar për unifikimin e tyre në Botën Islame përmes një sistemi të kompletuar, duke marrë anët pozitive të të dy sistemeve dhe duke mënjanuar anët negative të të dyjave. Kështu, dominoi një gjendje optimizmi se umeti islam mori hapat e para drejt orientimit islam.

Mirëpo, jo gjendje nuk zgjati shumë. Përpjekjet e reformimit në vizionin islam iu nënshtruan presioneve dhe hapësira e lirisë relative në aktivitetet pedagogjike me ngjyrë islame u ndal. Shumica e shteteve islame kërkuan ndihmë nga ekspertë të huaj, duke hapur kështu mundësinë për arsim të huaj, qoftë shkollor apo universitar. Institucionet për akreditim ndërkombëtar dhe kriteret e cilësisë, u zhvilluan, gjë e cila e shndërroi fushën e arsimit në treg të hapur, jo

vetëm për teoritë dhe përvojat e huaja, por edhe për referencat e mendimit të mbështetura me presione politike dhe interesa ekonomike.

Për këtë, ne sot kemi nevojë më shumë se çdo herë më parë, për një vullnet të sinqertë, për meditim të pavarur, për interesin e shoqërive dhe gjeneratave tona. E gjithë kjo duke qenë të bindur se mbështetja në referencën tonë islame do të drejton rrugëtimin tonë pedagogjik, pa na privuar nga e drejta për të përfituar nga përvoja dhe eksperiencia pedagogjike në botën e sodit. Marrja e verbër nga konsultimet e huaja rreth zhvillimit të sistemeve pedagogjike, duke miratuar kriteret e tyre, shoqërive tona islame ua ka humbur shanset e kreativitetit në zhvillimin e këtyre sistemeve në atë mënyrë që shërben interesat reale të këtyre shoqërive, duke ruajtur identitetin dhe veçoritë e saj. Në të njëjtën kohë, mund të jenë modele udhërrëfyese për shoqëritë tjera. Me këtë, shoqëritë tona do të rikthejnë dinjitetin e humbur me anë të imitimit dhe tjetërsimit mendor dhe pedagogjik.

Fusha e edukimit dhe arsimit është duke vluar me filozofi dhe teori, të cilat flasin për vetitë e njeriut, që çdo filozofi apo teori dëshiron ta ngrejë atë. Kështu, problemi përfshihet në qartësinë se çka jemi duke dashur për veten tonë në dritën e realitetit, kulturës, shoqërisë dhe përgjegjësisë tonë civilizuese. Ndoshta prioritet i parë që propozojmë të merret në konsideratë është *vetëdija për amanetin* që duhet bartur pedagogët në shoqëritë islame, dhe atë në nivelet e ndryshme arsimore, ngase ata për një kohë të gjatë kishin munguar ose ishin detyruar të mungojnë nga fusha e kreativitetit dhe përpjekjeve. Mungesa e vullnetit politik, pengimi i mundësive nga ana e drejtorive të larta për vizione dhe mendime të pavarura, mungesa e ambientit nxitës për kreativitet në zhvillimin e mendimeve teorike dhe aplikimeve praktike, në kuadër të vizionit islam, si dhe arsyetime tjera, që të gjitha këto, nuk ngrenë përgjegjësinë nga askush.

Në shumë vende në këtë libër, kemi theksuar përgjegjësinë e mendimtarëve të umetit, përballë mendimit pedagogjik dominues sot, si dhe përballë civilizimit njerëzor në përgjithësi. Këtu përsërisim, se mendimi pedagogjik njerëzor ka nevojë për neve, më shumë se sa ne që kemi nevojë për te, dhe atë për dy shkaqe: e para se materia e këtij mendimi, në kontekstin e tij teorik dhe zbatimin e tij praktik është prezente në jetën tonë, dhe e dyta se energjinë ideologjike të fshehur që e posedojmë, nuk është e njohur te të tjerët e as nuk është prezente në praktikat tona. Mësimi nga historia është dëshmitare për ndërveprimin civilizues, ngase orientimi i ndërveprimit rrugëton nga sfera e pasurisë drejt sferës së varfërisë. Kur umeti ynë ishte i pasur në aspektin e mendimit dhe në aspektin civilizues, edhe në raste të dobësisë politike, popujt tjerë qëndronin para tyre në pozicionin e nxënësit.

Amanetin, të cilin prijësit e mendimit pedagogjik islam duhet ta bartin, shfaqet në hulumtimin rreth pozitës së vizionit universal, i cili tematikat dhe elementet e detajuara i vë në kuadër të një kornize universale, i cili do të ndihmon në përcaktimin e ndikimeve reciproke të këtyre elementeve, raportet mes tyre dhe me shumën e përgjithshme. Aktivizimi i këtij vizioni universal është ai që jep mundësinë për hulumtim në tematikat dhe çështjet e detajuara, duke e vënë secilin prej tyre në vendin e duhur, për nga shkalla e rëndësisë, mënyra e bashkëveprimit dhe angazhimi, ngase çështjet dhe tematikat pedagogjike, që të gjitha nuk janë në një shkallë.

Prej çështjeve të mëdha, p.sh. është *natyra e njeriut*, i cili është epiqendër e procesit pedagogjik, dhe atë në dimensionin e tij human, ndërkombëtar dhe vendor, si dhe në dimensionet e tij psikologjike, intelektuale, fizike, shpirtërore, individuale dhe shoqërore. Element tjetër, që elita reformuese pedagogjike duhet ta ketë në konsideratë është edhe vetëdija rreth natyrës së *njohurisë* pedagogjike. Një pjesë e madhe e njohurive është në një nivel të caktuar të zhvillimit. Njohuritë që gjendet në plan-programet mësimore

nuk janë në nivelin e njohurive bashkëkohore, dhe të njëjta përmbajnë gabime dhe iluzione. Për këtë, obligohemi të kemi kritere që janë të përshtatshme për kontrollimin dhe pastrimin e njohurive, si dhe riorientimin e gjërave për qëllimet tona ideologjike, kulturore dhe shoqërore.

Përmbajtjet mësimore përmbajnë tema shkencore të caktuara, të cilat bazohen në referenca filozofike, në mënyrë të shfaqur apo të fshehtë. Për këtë, prijësit e mendimit pedagogjik kanë nevojë për vetëdijesim rreth referencës teorike, mbi të cilën mbështeten plan-programet pedagogjike dhe tematikat e tyre të ndryshme, pastaj përcaktimin e mënyrës së përshtatshme për bashkëveprim me te. Kështu, kur ekziston vetëdija e lartshënuar, nuk do të ketë problem nëse përfitojmë nga disa teori psikologjike apo teori rreth përgatitjes së plan-programeve mësimore. Kështu duhet të jetë gjendja në të gjitha çështjet e edukatës dhe arsimit.

Çështja e *identitetit* në përpjekjet e reformave pedagogjike dhe shoqërore në Botën Islame, ndonjëherë përzihet me një pikëpamje të mbyllur në vete, që kufizon psikën e njeriut musliman, kufizon fuqinë e tij për bashkëveprim në ambientin e botës bashkëkohore, edhe krahas asaj se ambienti është i hapur ndaj diversiteteve dhe llojllojshmërive, gjë që i mundëson njeriut musliman shanse të rëndësishme për kryerjen e obligimeve të tij në shfrytëzimin e këtij ambienti për komunikim dhe njohje, gjë e cila formon një nga intencat e llojllojshmërisë dhe diversitetit. Mjet më i mirë për përputhshmëri mes identitetit dhe përkatësisë nga njëra anë, dhe realizimi i intencës "لِتَعَارَفُوا" "që të njiheni dhe bashkëveproni", në nivel vendor dhe ndërkombëtar nga ana tjetër, është edukimi dhe arsimimi në institucionet dhe nivelet e ndryshme arsimore. Andaj, përgjegjësia e pedagogjisë është përgatitja e njeriut si individ, si anëtar i shoqërisë dhe si lloj njerëzor.

Ndonëse, ky dimension ndërkombëtar në mesazhin islam ka qenë i qartë që nga ditët e para të zbritjes së Kur'anit, si dhe ishte i qartë në praktikat pejgamberike përgjatë periudhës së shpalljes, ky dimension, në disa rrethana, ka

munguar nga praktikimi në shoqërinë islame, për shkak të dominimit të parimit të dallimit mes njerëzve dhe përkujdesit ndaj identitetit të pastër, sidomos në periudhat që dominojnë konfliktet ushtarake. Duke pasur parasysh atë që e përjeton bota jonë bashkëkohore, përfshirë: mjetet e komunikimit dhe lidhjeve, si dhe mbështetjen reciproke mes popujve, mendojmë se obligimi i prijësve pedagogjik është të orientojnë plan-programet dhe praktikat pedagogjike drejt thellimit të vetëdijes ndaj rëndësisë së dimensionit ndërkombëtar të pedagogjisë, përfshirë komunikimin me tjerët i shoqëruar me vetëbesim, përgatitje për të ofruar të tjerëve dhe bashkëveprimi pozitiv me tjerët. E gjithë kjo, duke qenë i bindur se esenca e raportit me të tjerët është paqja dhe bashkëpunimi në këmbimin e interesave dhe dobive, ndërsa lufta, në raportet mes popujve është përjashtim. Në gjendje paqeje dhe këmbim të interesave, shtohen shanset e përshtatshme për t'i mundësuar tjetrit për të kuptuar të mirat që i posedojmë, për të përmirësuar pikëpamjet dhe konceptet e gabuara, të cilat kanë dalë si rezultat i konflikteve dhe luftërave. Kjo është përgjegjësia e muslimanit në këtë jetë. Ndërsa, rezultati i besimit (iman) të besimtarëve dhe mosbesimit (kufr) të jobesimtarëve është çështje çka i takon Allahut, për të cilën do të japin llogari Ditën e Kiametit.

Vizioni islam universal ndaj botës lidhet ngushtë me shkencat pedagogjike. Ai është vizion ndaj njeriut, i cili është objekt i pedagogjisë, përfshirë ekzistencën, jetën dhe rrethin në të cilin jeton. Ky vizion ndërlidhet me parimet e besimit, dispozitat e pjesshme dhe vlerat morale. Ana praktike e shkencave pedagogjike përfaqësohet në rregullimin e jetës dhe sistemin e përgjithshëm të individëve dhe grupimeve në shoqëri. Sistemi i jetës në këtë botë realizon shkaqet e lumturisë në këtë botë dhe ahiret. Për gjithë këtë, nga qëllimet dhe intencat e pedagogjisë sipas pedagogëve islam është interesimi për intencat e sheriatit, të cilat realizohen përmes punës pedagogjike në familje dhe institucionet tjera

edukative, të cilat ndërlidhen drejtpërdrejt me procesin e arsimit dhe edukatës.

Ne mendojmë se -në fund të fundit- qëllimi i shkencave pedagogjike në vizionin islam është zhvillimi i mendimit pedagogjik islam. Kjo nënkupton, kuptimi i shoqërisë islame obligimet të cilat duhet t'ua ofrojë bijve dhe bijave të tij në të gjitha sferat pedagogjike, qofshin sfera që merren me formimin e personalitetit të baraspeshuar islam me identitet të dalluar ose sferat e shkencave dhe njohurive natyrore, shoqërore dhe aplikative. Megjithatë, në formimin e mendimit pedagogjik islam ka një çështje që nuk veçohet vetëm me shkencat dhe njohuritë, por përveç kësaj, veçohet edhe mënyra se si i përfiton muslimani këto njohuri, metodat e përzgjedhjes dhe fushat e shfrytëzimit të tyre në zhvillimin e jetës së tij dhe mbarë shoqërisë. Ajo është edukata e formimit të mendimit, e cila llogaritet sfera më e rëndësishme pedagogjike, të cilën patjetër ta marrin përsipër institucionet pedagogjike në shoqëri. Ajo është zhvillimi i të menduarit, duke hulumtuar rreth të së vërtetës, me metoda dhe forma të përshtatshme që shpijnë drejt saj.

Kujdesi ndaj edukatës së formimit të mendimit në këtë kohë, është e rëndësishme ngase disa grupime bashkëkohore islame kanë ra në devijime ideologjike, ngjashëm me atë që kishin ra më herët disa grupime islame në çështje që ndërlidheshin me kuptimin e teksteve kur'anore, sunetit pejgamberik, kuptimin e disa përvojave historike të shoqërisë islame, përzierjen mes mendimit shkencor dhe miteve, mendimit intencor dhe mendimit të qejfeve dhe tekeve, paaftësia për shfrytëzimin legjitim të ixhtihadit dhe reformave në të kuptuarit islam ndaj realitetit bashkëkohor, ndaj mendimeve dhe ngjarjeve të përhapura brenda shoqërive islame dhe në shoqëritë tjera. Ky çrregullim ka rezultuar dobësi të qartë në praktikat civilizuese dhe në rolin e mendimit islam për pjesëmarrje aktive në të gjitha sferat.

Biseda rreth edukimit të formimit të mendimit nuk nënkupton se nuk ka nevojë për kujdesin ndaj llojeve tjera të edukimit. Gjithashtu nuk nënkupton se ky edukim është i

pavarur dhe i ndarë ndaj llojeve tjera të edukimit. Njeriu është po ai me trupin, mendjen dhe me shpirtin e tij, në raport me Zotin, shoqërinë dhe ambientin e tij. përkujtimi me këtë edukim është mjet për të lehtësuar studimin e tematikës, për të zbuluar rëndësinë e tij dhe për të trajtuar elementet e tij më thellësisht dhe detajisht.

## 2. Pasqyra e realitetit dhe ndryshimi i synuar

Nëse japim një pasqyrë rreth realitetit të mendimit pedagogjik aktual në shoqëritë islame, do të vërejmë se nuk është pasqyrë stabile, por nën ndikimin e rrethanave të ndryshme vendore dhe nga jashtë, rregullisht ndryshon. Ndonëse ky ndryshim që ndodhë brenda kohës, nuk ndryshon shumë veçoritë e përgjithshme të realitetit pedagogjik, por ndryshimi ndodhë në imtësi, detajime dhe në degë. Shkak për këtë ndryshim është ndikimi nga ajo që ndodhë jashtë ose nënshtrimi ndaj personave, në kohë kur gjendja e të menduarit mbetet pa ndonjë ndryshim real. Sa i përket ndryshimit të synuar, ai ka nevojë për mund për ndryshim dhe reformim të një lloji tjetër që ndryshon nga faktorët e lartshënuar. Detyra e mendimit pedagogjik në shoqëritë tona bashkëkohore islame -në realitet dhe me keqardhje- është bekimi i realitetit të këtyre shoqërive, jo ndryshimi i tyre. Ky është problemi kryesor në këtë mendim!

Ndryshimi i synuar nuk është ndryshim i detajuar në pjesët e sistemit pedagogjik, por ndryshim substancial në sistemin pedagogjik, duke përfshirë gjitha elementet dhe përbërësit e tij, ndryshime që i përfaqëson shoqëria me qëllim që reformat pedagogjike të jenë mjet për formimin e një shoqërie të re.

Format dëshpëruese të gjendjes së prapambetur të realitetit pedagogjik, mungesa e madhe e referencës së mendimit pedagogjik islam, identifikimi me kërkesat e globalizmit dhe ndikimi i gjitha këtyre çështjeve në institucionet pedagogjike të jetës bashkëkohore (familja, shkolla, mediat) flasin për sasinë e mundit të nevojitur drejt



reformimit pedagogjik të synuar. Ky reformim është një sistem i kompletuar, i cili bazohet në metodologjinë e kompletuar njohëse si kornizë reference islame e metodologjisë së reformimit pedagogjik dhe rrugë për reformimin e realitetit të shoqërive islame.

Ndryshimi për të cilin jemi duke folur -në të shumtën e rasteve- në mënyrë të shkurtër përfshin dy lloje të përpjekjeve reformuese. E para: kthimi te udhëzimet hyjnore dhe përvoja e trashëgimisë islame. Prej tyre dhe në to ka qenë dallimi, të cilin e kanë realizuar shoqëritë islame në kontributet e mëhershme civilizuese. E dyta: bashkëngjitja shoqërive përparimtare, të cilat kanë realizuar arritje civilizuese bashkëkohore, për të cilat nuk kemi qare pa i realizuar në shoqëritë tona bashkëkohore.

Metodologjinë e përplotësimit njohës e kuptojmë përmes rrugës së hulumtimit ndaj njohjes së synuar për realizimin e reformave. Kjo metodologji mbështetet në katër burime: **Kur'anin** Famëllartë si burim bazë dhe themelues i mendimit islam, **sunetin** peygamberik si burim sqarues i Kur'anit dhe zbatim praktik i dispozitave dhe udhëzimeve të tij në vend dhe kohë, **trashëgiminë islame**, e cila përfshin kontributin e dijetarëve musliman në të kuptuarit e udhëzimeve kur'anore dhe sunetit Peygamberik dhe përvojës njerëzore të shoqërisë islame, dhe në fund **përvojën njerëzore** që e përjeton bota bashkëkohore, ku krahas botës e përjetojmë edhe ne në shoqëritë tona islame. Mendimin tonë nga këto katër burime e përfitojmë përmes dy mjeteve. E para: mendja njerëzore që përdorë të menduarit në katër burimet e lartshënuara. E dyta: grumbullimi i eksperimenteve praktike dhe të ndjeshme të cilat i ka njohur bota bashkëkohore, si dhe inspirimin e sukseseve materiale dhe shpirtërore me qëllim të përfitimit prej tyre.

Është çështje e padiskutueshme se ne nuk mund të rikthejmë një gjendje historike sado që të ishte madhështore. Në këtë botë nuk jetojmë vetëm ne, as nuk mund ta injorojmë natyrën dhe kërkesat e shoqërisë bashkëkohore si dhe dallimin e madh të tij nga natyra e shoqërive në periudha të

ndryshme kohore dhe as imponimet dhe presionet që i zbaton sistemi botëror bashkëkohor. Ibn Ashurit i pëlqen ai që ndjen çrregullime në gjendjen arsimore dhe këshillon për domosdoshmëri të reformave në përputhshmëri me natyrën dhe kërkesat e kohës, ndërsa disa njerëz këtë person e akuzojnë se ka qëllim të keq dhe se metodologjinë që e kanë përdorur të parët tanë është i mjaftueshëm për reformim nga fakti se ajo metodologji “të parët tanë i ka ngritur në nivelet më të larta të suksesit, ku si rezultat i saj kanë dalë dijetarët më të mëdhenj, të cilët janë bërë të njohur në të gjitha vendet. Me anë të këtyre fjalëve, ata dëshirojnë të bindin veten dhe njerëzit mendjelehtë. Që të gjithë janë të pavetëdijshëm rreth ndryshimeve të kohës dhe generatave, ndryshime për të cilat kanë ndryshuar edhe metodat”.<sup>686</sup>

Po, ndërtimi i ardhmërisë duke u nisur nga reformimi i gjendjes aktuale është lëvizje përpara. Një gjë e tillë nuk realizohet përmes lëvizjes drejt të kaluarës dhe kthimit mbropa.

Është më se e vërtetë se ne nuk mund t'i bashkëngjitemi shoqërive të cilat kanë korrur suksese të konsiderueshme nëse ecim pas tyre dhe përcjellim gjurmët e tyre. Dallimi mes neve dhe këtyre shoqërive është i madh, ndërsa ndryshimi që ndodhë në shoqëritë tona është duke ecur shumë ngadalë dhe çalon në çdo hap, në kohë kur ndryshimi që realizohet në shoqëritë e përparuara është shumë i shpejtë. Kështu dallimi mes neve dhe këtyre shoqërive për çdo ditë rritet edhe më shumë. Andaj si mund ne t'u bashkëngjitemi atyre?!

Për këtë, nuk sjell dobi të themi se reformat mund të realizohen përmes “kthimit” në gjendjen që ishim gjatë periudhës së artë të civilizimit islam ose duke ecur pas atyre që kanë qenë para neve. Përpjekjet drejt reformimit janë tonat, në kohën dhe vendin tonë, për të zgjidhur problemet tona, jo problemet e shekullit të katërt apo pestë hixhri, e as problemet e shoqërive tjera që kanë qenë para neve. Megjithatë, është e domosdoshme të thithim përvojën e

<sup>686</sup> Ibn Ashur, *Elejse's-subhu bikaribin? Et-Ta'lim'ul-arabij'ul-islamijj: dirasetun tarigijjetun ve arauun islahijjetun*, vepër e cituar, fq. 104.

trashëgimisë dhe përvojën bashkëkohore, pastaj tejkalimin e gjithë kësaj drejt “kreativitetit” të reformave të reja të veçanta për neve, të cilat krejt në fund do të jenë një përvojë e dalluar që do të realizojë qëllimet tona, dhe do të jetë një përvojë ku shoqëritë tjera do të shohin efikasitetin e saj, gjë që do të tërheq vëmendjen e këtyre shoqërive për të përfituar prej saj.

Reformat pedagogjike janë një projekt i përgjithshëm, për të cilin nuk mjaftojnë vetëm ekspertët pedagogjikë. Çështja është çështje ndryshimi të njerëzve dhe realitetit shoqëror. Psikologët dhe sociologët kanë një rol të madh në këtë sferë. Krejt në fund, çështja është politike, qoftë si vendim politik apo përballim me vendimin politik.

Nuk mund të mohojmë përpjekjet të ndryshme që bëhen ndërkohë në vendet arabe dhe islame me qëllim të reformave pedagogjike. Këto përpjekje, në disa raste mbështeten në referenca ideologjike, ndërsa në të shumtën rasteve vijnë si rezultat i presioneve politike ose ekonomike vendore ose të huaja. Problemi fshihet në atë se mendimi pedagogjik që synohet zhvillimi i tij për të realizuar reforma, shumë pak niset nga pikëpamjet islame që të mund të supozojmë se jemi duke biseduar për mendim pedagogjik islam ose të angazhohemi për reforma pedagogjike me vizion islam ose me referenca dhe sfond islam. Është më se e vërtetë se referenca fetare islame, e cila ekziston sot në plan-programet mësimore shkollore me emrin “edukata islame”, si dhe në programet e fakulteteve të sheriatit, respektivisht islame, nuk kanë fare ndikim në studimin e shkencave tjera, të cilat në të shumtën e rasteve mbështeten në referenca joislame. E gjithë kjo, krahas asaj se mësimi i shkencave fetare në shkolla dhe universitete, është temë e kritikave të shumta, nga qarqe të ndryshme, për qëllime të ndryshme.

Andaj, nuk do të arrihet asnjë reformim real në edukim dhe arsimim që përshtatet me realitetin bashkëkohor në Botën Islame, për derisa Kibla e ndryshimit dhe zhvillimit është Perëndimi, përfshirë filozofitë, teoritë dhe praktikat e tij, si dhe për derisa ndryshimi ndodh nën presionet politike dhe ekonomike.

Mirëpo, si mund të arrihet rifillimi civilizues i muslimanëve pa edukim dhe arsimim? Nëse muslimanët janë në një gjendje të devijuar, atëherë a mund të dilet nga kjo gjendje pa edukim dhe arsimim? Kur'ani Famëlartë përmes katër ajeteve, ku secila prej tyre shton diçka të re, ka sqaruar se si ishte metoda e Muhammedit alejh'is-selam për nxjerrjen e popullit nga devijimi në dituri dhe pastrim.

Populli ishte analfabet me plotë kuptimin e fjalës përfshirë analfabetizmin shkencor dhe civilizues. Për këtë, cilësimi i saj me “devijim të qartë”, ishte i saktë. Allahu thotë:

﴿هُوَ الَّذِي بَعَثَ فِي الْأُمِّيِّينَ رَسُولًا مِّنْهُمْ يَتْلُو عَلَيْهِمْ آيَاتِهِ وَيُزَكِّيهِمْ وَيُعَلِّمُهُمُ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ وَإِن كَانُوا مِن قَبْلُ لَفِي ضَلَالٍ مُّبِينٍ﴾

﴿كَانُوا مِن قَبْلُ لَفِي ضَلَالٍ مُّبِينٍ﴾

“Ai është që arabëve të pashkolluar u dërgoi Pejgamberin nga mesi i tyre që t’ua lexojë ajetet e Tij, t’i pastrojë ata, t’ua mësojë librin dhe sheriatin, edhe pse më parë ata ishin në një humbje të dukshme.” [El-Xhumuah: 2].

I Dërguari, i cili realizonte procesin e reformimit ishte njëri nga bijtë e popullit, e jo nga diku tjetër. Allahu thotë: ﴿رَسُولًا﴾ “u dërgoi Pejgamberin nga mesi i tyre” [El Xhumuah: 2], ﴿رَسُولًا مِّنْكُمْ﴾ “u dërgoi Pejgamberin nga mesi i tyre.” [El-Bekare: 151] ﴿رَسُولًا مِّنْ أَنفُسِهِمْ﴾ “u dërgoi Pejgamberin nga vetë ata.” [Alu Imran: 164].

Ai është i dërguar në “mesin e tyre”, e jo “për ta”, ngase mesazhi i tij është i përgjithshëm dhe jo i veçantë për popullin e tij, siç ishin pejgamberët e mëparshëm. Allahu thotë:

﴿رَبَّنَا وَإِنَّا فِيهِمْ رَسُولًا مِّنْهُمْ﴾ “Zoti ynë, dërغو ndër ta, nga gjiri i tyre të dërguar.” [El-Bekare: 129].

﴿كَمَا أَرْسَلْنَا فِيكُمْ رَسُولًا مِّنْكُمْ﴾ “Ashtu siç dërguam nga gjiri i juaj të dërguar.” [El-Bekare: 151].

﴿إِذْ بَعَثَ فِيهِمْ رَسُولًا مِّنْ أَنفُسِهِمْ﴾ “Kur ndër ta nga mesi i tyre dërgoi të dërguar.” [Alu Imran: 164].

﴿هُوَ الَّذِي بَعَثَ فِي الْأُمِّيِّينَ رَسُولًا مِّنْهُمْ﴾ “Ai është që arabëve të pashkolluar u dërgoi Pejgamberin nga mesi i tyre.” [El-Xhumuah: 2]

Muhammedi është i dërguar nga ana e Allahut si mëshirë për umetin, gjë që nxitë ndjenjën e falënderimit ndaj Allahut. Allahu thotë: ﴿لَقَدْ مَنَّ اللَّهُ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ إِذْ بَعَثَ فِيهِمْ رَسُولًا مِّنْ أَنفُسِهِمْ﴾ “Është e vërtetë se Allahu u dha dhuratë të madhe besimtarëve, kur ndër ta nga mesi i tyre dërgoi të dërguar që atyre t’u lexojë shpalljen e Tij, t’i pastrojë ata, t’ua mësojë Kur’anin dhe sheriatin, edhe pse, më parë ata ishin krejtësisht të humbur.” [Alu Imran: 164].

Metodologjia e reformave ishte metodologji pedagogjike që përfshinte pesë elemente, që asnjërin prej tyre nuk e njihnin. Allahu thotë:

﴿كَمَا أَرْسَلْنَا فِيكُمْ رَسُولًا مِّنكُمْ يَتْلُو عَلَيْكُمْ آيَاتِنَا وَيُزَكِّيكُمْ وَيُعَلِّمُكُمُ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ وَيُعَلِّمُكُم مَّا لَمْ تَكُونُوا تَعْلَمُونَ﴾

“Ashtu siç dërguam nga gjiri i juaj të dërguar t’u lexojë ajetet Tona, t’ju pastrojë, e t’ju mësojë librin dhe traditën, e edhe t’ju mësojë atë që nuk e dinit.” [El-Bekare: 151ç.

﴿يَتْلُو عَلَيْكُمْ آيَاتِنَا﴾ “t’u lexojë ajetet Tona” Do të thotë: ua lexon juve Kur’anin. Në fillim i ka quajtur “ajete” ngase çdo fjale e tij është mrekulli, ndërsa më pas e ka quajtur “libër” ngase është libër legjislativ.

﴿يُزَكِّيكُمْ﴾ “t’ju pastrojë” Tezkije do të thotë pastrim të shpirtit, fjalë e derivuar nga zekat, që nënkupton rritjen. Është kështu ngase në krijimin esencial të shpirtave ka pastrime, të cilat mund të ndoten me papastërti të cilat vijnë nga devijimet. Andaj, pastrimi dhe drejtimi i shpirtave e rritë dhe e shton këtë të mirë që gjendet në te.

﴿وَيُعَلِّمُكُمُ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ﴾ “e t’ju mësojë librin dhe traditën” d.t.th. ua mëson sheriatin, respektivisht legjislacionin. Fjala “libër” këtu nënkupton Kur’anin, nga fakti se është libër legjislacioni. Ua mëson bazat e virtyteve. El-hukmete-urtësia janë mësimet që pengojnë rënien në gabime dhe çrregullime.

﴿وَيُعَلِّمُكُم مَّا لَمْ تَكُونُوا تَعْلَمُونَ﴾ “e edhe t’ju mësojë atë që nuk e dinit”, këtu përfshihet çdo gjë jashtë shariatit-legjislacionit dhe urtësive. Pra, njohuritë e popujve të ndryshëm, politikat e shteteve, çështjet e ahiretit etj. E ka përsëritur fjalën ﴿وَيُعَلِّمُكُم﴾ “t’ju mësojë” edhe pse ka mundur të mos theksohet për të

treguar dallimin dhe të mos kuptohet se ﴿مَّا لَمْ تَكُونُوا تَعْلَمُونَ﴾ “atë që nuk e dinit” është për qëllim libri dhe urtësia.<sup>687</sup>

### 3. Formimi i vetëdijes me realitetin e mendimit pedagogjik bashkëkohor dhe pikënisjet e reformave

#### 3.1. Vetëdija ndaj realitetit pedagogjik, koncepti dhe rëndësia e saj:

Vetëdija dhe kuptimi ndaj realitetit është gjendje që cilëson njeriun se ka njohuri të mjaftueshme rreth realitetit në të cilin jeton. Ai dallon elementet, përbërësit, raportet mes tyre, faktorët ndikues dhe kupton nevojën e këtij realiteti për ndryshim dhe reformim. Ne kemi nevojë për të qenë të vetëdijshëm ndaj realitetit në të gjitha fushat e ndryshme. Ekziston realiteti politik, ekonomik, edukativo-arsimor etj. Pra, vetëdija është cilësim i gjendjes së njeriut që ka vetëdije të plotë ndaj vetes dhe botës që e rrethon atë.

Shprehja el-va'ju në aspektin gjuhësor nënkupton grumbullim, kuptim dhe ruajtje. “El-udhun’ul-va’ijetu” e potencuar në Kur’an nuk është për qëllim veshi i cili dëgjon zërat, por është për qëllim veshi që kupton dhe mendon atë që e dëgjon, dhe më pas reagon dhe përfiton.<sup>688</sup> Veshi i jashtëm grumbullon zërat që vijnë nga jashtë. Më pas i dërgon te qendra e të kuptuarit për të kuptuar atë që dëgjon, ku si rezultat i saj bashkëvepron duke ndikuar dhe duke u ndikuar. Më pas njeriu në kujtimet e tij ruan ngjarjen dhe ndikimin për ta rikujtuar sa herë që tema ndërlihet me të. Muhammedi alejh’is-salam është lutur për të mirë për atë që i dëgjon fjalë e tij, i kupton dhe më pas i kumton.<sup>689</sup>

<sup>687</sup> Ibn Ashur, *Tefsir’ut-tahriri ve’t-tenviri*, vepër e cituar, vëll.2, fq. 48-50.

<sup>688</sup> Allahu thotë: ﴿لِنَجْعَلَنَّ لَكُمْ تَذَكْرًا وَتَعْبًا أُنْزِلْنَا وَإِيَّاهُ﴾ “Për ta bërë atë (ngjarje) përkujtim për ju dhe për ta ruajtur atë veshët që janë përkujtues.” [El-Hakah: 12]

<sup>689</sup> Et Tirmidhi, *El-Xhami’us-Sahih*, vepër e cituar, hadithi nr. 2657, fq. 430.

Teksti i hadithit: Transmeton Abdurrahman ibn Abdullah ibn Mes’udi duke transmetuar nga babai i tij të ketë thënë: kam dëgjuar Muhammedin alejh’is-salam duke thënë: “Allahu e ndriçoftë fytyrën e një personi i cili ka dëgjuar prej neve diçka dhe të njëjtën e ka kumtuar ashtu siç e ka dëgjuar. Mundet që personi të cilit i kumtohet fjala të jetë më i kuptueshëm se vetë dëgjuesi (kumtuesi)”. Sipas një transmetimi tjetër të të njëjtit transmetues: “Allahu e ndriçoftë fytyrën e një njeriu që ka dëgjuar fjalët e mia. I ka kuptuar, i ka mësuar dhe i ka kumtuar. Mundet një person që kupton diçka të bartë te tjetri i cili është më i kuptueshëm se ai...”. Hadithi nr. 2658, fq. 430.

Vetëdija dhe kuptimi ndaj realitetit përfshin këto tre elemente: grumbullimin, kuptimin dhe ruajtjen. Gjithashtu përfshin edhe vetëdijen e raportit të këtyre tre elementeve me tre elemente tjera: realiteti ashtu siç është, nevoja e realitetit për ndryshim dhe gjendjen në të cilën dëshirohet të transferohet realiteti. Vetëdija me këto dy çështje na mundëson të flasim rreth asaj që e quajmë vetëdije metodologjike, në të cilën përfshihet sigurimi i kërkesave për planifikim të ndryshimit të gjendjes aktuale drejt realitetit të synuar dhe përcaktimi i metodologjisë së përshtatshme për këtë çështje. Me këtë lloj të planifikimit shpresojmë të cilësohet përpjekja jonë për reformim pedagogjik me metodologji me qëllime të caktuara, larg reaksioneve dhe presioneve të nevojës urgjente për marrje të vendimit. Kështu fillimi do të jetë pikërisht aty ku duhet të jetë. Kështu, mjetet, metodat dhe të gjitha mundësitë që janë në disponim shfrytëzohen në mënyrën më efikase. Në anën tjetër, angazhimi drejt reformimit është i drejtë, stabil dhe i durueshëm ndaj vështirësive derisa të realizohen qëllimet e synuara.<sup>690</sup>

Është drejtësi të themi se disa forma të kësaj vetëdije gjenden te disa pedagogë në Botën Arabe dhe Islame. Mirëpo, -në shumë raste- është vetëdije e pjesshme rreth një sfare të realitetit, i cili mbështetet në reaksion sipas specializimit shkencor apo praktik që ka ai. Kjo vetëdije përkufizohet vetëm me përshkrimin e dukurisë, vlerësimin e dimensioneve dhe cilësohet si mekanike. Ajo që synohet është arritje përmes vetëdijes metodologjike në vetëdije të përgjithshme që bazohet në vëmendje të thellë, në një vizion universal ndaj botës, përdorë kriterin vlerësues dhe përgjegjësinë morale. Më pas, kjo vetëdije shtrihet për të përfshirë sipërfaqet e ndryshme, për t'u thelluar në nivelet e llojllojshme, derisa vetëdija metodologjike të bëhet "kulturë e gjallë metodologjike" për gjithë të interesuarit rreth reformimit të realitetit të umetit.

<sup>690</sup> Melkavi, *Menhexhijetut tekamulil ma'rifiji: Mukadimatun fil menhexhijetil islamijeti*, vepër e cituar, fq. 113-128.

Me qëllim që vetëdija metodologjike për domosdoshmërinë e reformimit pedagogjik dhe kërkesave të tij të bëhet “kulturë e gjallë metodologjike”, që nuk u intereson vetëm pedagogëve, është patjetër vetëdija rreth natyrës së raportit mes pedagogjisë dhe shoqërisë në atë mënyrë që të jetë element themelor në planet e reformimit pedagogjik dhe shoqëror. Zhvillimi i sistemeve mësimore realizohet përmes teorive të llojllojshme shoqërore, ku përfshihen lëvizjet shoqërore, dallimet shtresore, ndryshimi shoqëror dhe programet zhvillimore. Pastaj duhet kuptuar se rrethanat politike, shoqërore dhe ekonomike ndikojnë fuqishëm në formulimin e qëllimeve, strukturave, plan-programeve dhe praktikave të institucioneve mësimore. Shumë prej studimeve pedagogjike përfshijnë rezultatet mësimore dhe format e lidhshmërisë me faktorët e ndryshëm shoqëror: si gjinia, raca, gjendja sociale, gjendja ekonomike etj.<sup>691</sup>

Për të mos shkuar larg në ëndërrime dhe për të mos imagjinuar formën ideale që është vështirë të realizohet, duhet të themi se edukimi është proces mjaft i komplikuar, i cili përfshin: mësimin, mësimnxënien dhe mësimdhënien. Çështja më e komplikuar në të është se ajo ka nevojë për zhvillim të vazhdueshëm. Nuk ka kufi të caktuar për përmbajtjen mësimore, përvojat e mësimnxënies dhe metodat e mësimdhënies. Edukata nuk është rezultat i asaj që e ofron një institucion shoqëror, por sfera e edukimit përfshin shoqërinë me gjitha institucionet e saj, sidomos familjen, shkollën dhe mjetet informative. Për të pasur sukses në realizimin e një gjendje të shëndoshë pedagogjike, duhet të përfshihen përpjekjet e gjitha këtyre institucioneve. Andaj, nuk pritët të realizohet reformimi pedagogjik i synuar në një shoqëri, nëse e tërë barra e reformimit i lihet vetëm një institucioni. Kështu, shkolla p.sh. bën përpjekje për përmirësim të gjendjes edukative, ndërsa në të njëjtën kohë, atë që e ngritë shkolla, e rrënojnë institucionet tjera.

<sup>691</sup> Emmanuel Jean Francois, "Education and Society", në: *Building Global Education with a Local Perspective*, New York: Palgrave Macmillan, 2015, fq. 1-15.



Reformimi dhe përmirësimi i gjendjes është një proces i përgjithshëm në të cilin përfshihen gjitha elementet, në kohë kur reformimi pedagogjik është një pjesë e këtij procesi, ndonëse është pjesa më e rëndësishme dhe më e ndjeshme.

Ne mendojmë se hulumtimi rreth shkallës së vetëdijes së umetit islam ndaj realitetit të tij shkencor, ideologjik dhe material, si dhe realitetit të botës përreth në këto dhe sfera tjera, është çështje shumë e rëndësishme. Kjo vetëdije, pritet të ndikon në mënyrën se si umeti përpilon sistemet edukative dhe arsimore, zhvillon mendimin e tij pedagogjik, përmes së cilit përgatit gjeneratat për t'ju përballuar problemeve të brendshme dhe rreziqeve të jashtme armiqësore. Me këtë, kuptojmë nivelin e ekuivalencës, përmes së cilit umeti u bënte ballë këtyre problemeve në periudha të ndryshme historike. Hulumtimi rreth shkallës së vetëdijes mund të shpie drejt kuptimit të shkaqeve të joefikasitetit dhe paaftësive të sistemeve arsimore dhe edukative -të cilat kanë dominuar në jetën e umetit gjatë tre shekujve të fundit- në ruajtjen e umetit nga arritja në gjendjen e dobësisë, injorancës dhe copëtimit. Kjo gjendje, nxiti shtetet evropiane të okupojnë shumicën e vendeve islame, t'i copëtojnë ato, të grabitin pasurinë e tyre dhe të imponojnë kulturën, sistemet dhe vlerat perëndimore në mesin e tyre. E gjithë kjo në llogari të kulturës, sistemeve dhe vlerave islame.

### 3.2. Vetëdija rreth domosdoshmërisë së reformimit të realitetit pedagogjik

Vetëdija e plotë ndaj rrethanave të cilat kaplojnë përpjekjet e reformave pedagogjike është kusht i rëndësishëm për planifikimin të këtyre përpjekjeve dhe vlerësimin e niveleve të suksesit të synuar në realizimin e qëllimeve. Sidomos kur dimë se këto rrethana nuk kufizohen në një numër të caktuar të çështjeve pedagogjike apo faktorëve social vendor. Bota bashkëkohore është një botë tejet e komplikuar, ndryshon shpejtë dhe ndikohet nga orientime të ndryshme ideologjike. Shoqëritë e kësaj bote janë të ndërthurura mes vete dhe në mënyrë të vazhdueshme ndikojnë dhe ndikohen mes vete. Edhe pse vërejmë se në këtë botë ka teori dhe sisteme të

ndryshme politike, ekonomike dhe administrative, ekzistojnë përpjekje për të pranuar disa veçori të përgjithshme dhe të përbashkëta të cilat i ngërthejnë orientimet e globalizmit ose i imponojnë fuqitë që udhëheqin këto orientime, me dëshirë apo pa dëshirë. Për këtë, nuk është lehtë të unifikohen veçoritë e shoqërive tona sot me orientimet e e ndryshimit, pa vetëdije të mjaftueshme dhe ndikuese në këto shoqëri. Si rezultat i kësaj, nuk është lehtë të gjykohet mendimi pedagogjik dominues në shoqëritë islame, përmes një shikimi sipërfaqësor dhe të shpejtë.

Megjithatë, mund të bisedojmë rreth prezantimit të kuptimeve të përgjithshme të pedagogjisë në jetën individuale në këto shoqëri. Ekziston një shpirt i fshehur në brendinë e muslimanëve, i cili mund të cilësohet si shpirti qortues. Kjo gjendje e bënë individin të shpresoj që ngjyrosët me edukatën islame, me fjalë dhe vepër. Ekzistojnë kërkesa njerëzore që gjenden në shpirtin urdhërues për të keqe. Kjo gjendje e bënë individin të lirohet nga rregullat edukative islame, duke i përngjasuar gjendjes edukative të jomuslimanëve, gjë e cila duket se është tërheqëse. Nuk duhet injoruar as ekzistimin e shpirtit të qetë, i cili ndjenë kënaqësi në përpjekjet e tij të palodhshme për të zbatuar udhëzimet pedagogjike islame. Ndoshta një studim empirik, do të përcaktonte grupin e madh apo të vogël të këtyre tre llojeve, në çdo shoqëri prej shoqërive islame.

Kjo është rreth domosdoshmërisë së vetëdijes ndaj realitetit të mendimit pedagogjik islam bashkëkohor. Kjo vetëdije doemos kushtëzon një lloj tjetër të vetëdijes, e që është *vetëdija e nevojës* për reformimin e këtij realiteti. Vërejmë se njerëzit gjatë diskutimeve rreth realitetit shoqëror, gjendjes së vështirë ekonomike, rrethanat e punësisë dhe papunësisë, diskutimet politike rreth çështjeve politike vendore, rajonale dhe botërore, kanë mendime të ndryshme. Mirëpo, ata nuk kanë mendime të ndryshme rreth rëndësisë së edukatës, qoftë në mënyrën që ndikon në rezultatin e gjendjes shoqërore apo ndryshimin që mund ta sjell edukata në shoqëri.

Këtu vjen rëndësia e bisedës rreth domosdoshmërisë së reformave në mendimin pedagogjik dhe vetëdija e thellë dhe e shumanshme që doemos duhet ta shoqëron këtë bisedë. Sidomos, nevoja e këtij mendimi për reformim dhe zhvillim të vazhdueshëm, me qëllim që t'i përgjigjet kërkesave të zhvillimit dhe ndryshimit të realitetit të shoqërive islame, si dhe me qëllim që këtij mendimi t'i mundësohet të përfshin tematikat elementare, të cilat formojnë veçoritë e përgjithshme të përfshira në sistemet e përgjithshme pedagogjike, përfshirë bazamentet e tyre si: filozofitë, politikat, teoritë, strategjitë, përfshirjen e detajeve të sistemit pedagogjik, përbërësve, niveleve administrative dhe arsimore. Këtu duhet përfshirë institucionet, qarqet, programet, plan-programet, metodat për mësim dhe vlerësim etj.

Duke u nisur nga metodologjia e kompletuar njohëse, në të cilën mbështetemi gjatë shkrimeve tona, ne -që nga fillimi-jemi të mendimit se mendimi pedagogjik islam bashkëkohor, të cilin e synojmë, duhet patjetër, qëllimet dhe programet e tij t'i bazon në katër burime: Kur'anin Famëlartë, sunetin peygamberik, trashëgiminë islame dhe përvojën bashkëkohore njerëzore. Ky mendim, duke përdorur të kuptuar intencional bashkëkohor, orientohet me ajetet kur'anore dhe sunetin Peygamberik drejt dispozitave dhe udhëzimeve islame në veprimin pedagogjik. Në të njëjtën kohë përfshin edhe trashëgiminë islame dhe përvojën njerëzore bashkëkohore.<sup>692</sup> Qëllimin të cilin e synojmë është i dyfishtë: përforsimi i veçorive ideologjike dhe civilizuese të umetit dhe shoqërive islame, dhe formimi i vetëdijes së përgjegjësive ndaj kontributit pedagogjik, shkencor dhe civilizues në shoqërinë njerëzore bashkëkohore. Për

<sup>692</sup> Lexuesi gjatë leximit të këtij libri dhe librave tjerë të autorit vëren se përcaktimi i burimeve të diturisë dhe njohurisë vjen nga dy burime. Ato janë: 1. shpallja që përfshinë Kur'anin Famëlartë dhe sunetin peygamberik dhe 2. Bota, që përfshinë botën natyrore, shoqërore dhe psikologjike. Në disa raste tjera, potencohen katër burime: Kur'ani Famëlartë, Sunti Peygamberik, trashëgimia islame dhe trashëgimia bashkëkohore njerëzore. Në këtë rast, trashëgimia islame është pjesë e përvojës njerëzore e veçantë për muslimanët, ndërsa trashëgimia njerëzore është përvoja e përgjithshme njerëzore, të cilën si zakonisht e cilësojmë si përvojë perëndimore (evropiane dhe amerikane). Kështu që trashëgimia islame dhe përvoja bashkëkohore perëndimore, që të dyja i takojnë botës shoqërore sipas ndarjes në dy burime.

realizimin e kësaj çështje rreth mendimit, të cilin dëshirojmë ta prodhojmë, kushtëzohet të “ngërthen” të kuptuarit intencial të ajeteve kur’anore dhe sunetit pejgamberik, si dhe të “tejkalon” përvojën historike të trashëgimisë islame dhe përvojës njerëzore bashkëkohore.

### 3.3. Vetëdija ndaj pikënisjeve të reformimit pedagogjik

Në kontekst të hulumtimit ndaj realitetit të mendimit pedagogjik dominues në shoqëritë islame, si dhe në kontekst të ambicieve tona për formimin e mendimit pedagogjik islam, e shohim të përshtatshme të përkujtojmë disa nga pikënisjet, të cilat paqetë të jenë të qarta gjatë trajtimit të realitetit dhe ambicieve.

Pikënisja e *parë* në këtë çështje është se përmirësimi dhe reformimi i gjendjes edukativo-arsimore në shoqëritë tona është pjesë e intencave të përgjithshme reformuese të këtyre shoqërive. Bile është rruga e këtij përmirësimi dhe reformimi. Ne jemi të vetëdijshëm rreth polemikave të vazhdueshme rreth ndikimit të shoqërisë në përcaktimin e pozitës së pedagogjisë në të dhe ndikimit të pedagogjisë në përcaktimin e realitetit shoqëror. Sociologët, politikanët, pedagogët dhe të tjerë prej thirrësve të reformave të përgjithshme pozicionohen në një rën anë të kësaj çështje. Kur disa prej tyre thonë se shoqëria nuk mund të ngrihet pa pedagogji, kjo nënkupton se pedagogjia, për nga rëndësia është para shoqërisë. Ndërsa, kur disa të tjerë thonë se pedagogjia është pasqyra të cilën e reflekton shoqëria dhe përcakton veçoritë e saj, kjo nënkupton se shoqëria, për nga rëndësia është para pedagogjisë. Mirëpo, nuk hasim në mospajtime substanciale rreth ekzistimit të lidhshmërisë së fortë mes shoqërisë dhe pedagogjisë. Që të dy palët në polemikat rreth kësaj çështje kanë të drejtë në mendimet e tyre, dhe se në kontekste të caktuara ndonjëri argument mund të jetë më i fortë se tjetri.

Sistemet e arsimit publik në botën bashkëkohore kanë miratuar disa parime, si: obligueshmëria e arsimit të përgjithshëm, përplotësimi mes plan-programeve të arsimit obligativ në formimin e personalitetit të njeriut të vjeshëm,

fizikisht, shpirtërisht dhe mentalisht, përgatitja e kuadrove të nevojshme praktike për realizimin e zhvillimit dhe përparimit në shoqëri, kontributi në civilizimin njerëzor, si dhe parime tjera, të cilat gjendjen e arsimit publik në shoqëri e vënë në pozicion të shprehë përparimin dhe përmirësimin apo prapambetjen dhe shkatërrimin.

Pikënisja e *dytë* është bindja se e drejtë e gjithë qytetarëve të shoqërive islame është të krenohen me shoqëritë e tyre. Mirëpo, kjo nuk nënkupton të anashkalojmë gjendjen e prapambetjes së shoqërive tona bashkëkohore. Kjo prapambeturi është cilësi e përgjithshme me të cilën cilësohet e tërë shoqëria, përfshirë edhe sektorin edukativo-arsimor. Gjykimi për prapambeturi është gjykim i përgjithshëm, pa marrë parasysh dallimin e kriterit matës në këtë gjykim. Kriteri matës mund të jetë realiteti shoqëror siç është sot në krahasim me atë se a mund të jetë në përputhshmëri me udhëzimet islame. Kriteri matës mund të jetë krahasimi i këtij realiteti me mundësitë në disponim për përmirësim, zhvillim dhe reformim, dhe paaftësia për shfrytëzimin e këtyre mundësive. Kriteri matës mund të jetë krahasimi i realitetit të shoqërisë islame me shoqëritë tjera për nga përparimi civilizues me dy anët e tij, atë shpirtëror dhe material.

Pikënisja e *tretë* se çdo përpjekje për përmirësim, reformim dhe ndryshim në realitetin e shoqërisë duhet të ngritët mbi bazën e të kuptuarit të thellë të këtij realiteti. Këtu duhet përfshirë: problemet dhe shkaqet, nevojat dhe prioritetet dhe ligjet e ndryshimit me orientimet. Pa këtë kuptim të thellë, ndryshimi gjithsesi do të ndodhë, ngase ndryshimi është ligj i vazhdueshëm. Mirëpo, nëse ndryshimi nuk realizohet sipas metodologjisë që shpie drejt zhvillimit dhe përparimit, ai mund të ec në drejtimin që bekon prapambetjen. Ndoshta prej gjërave më të rëndësishme që duhet kuptuar rreth realitetit të cilësdo shoqëri është lidhshmëria e fortë mes gjendjes aktuale të shoqërisë dhe asaj të synuar nga njëra anë dhe përbërësve ideologjik dhe psikologjik, të cilat shprehin personalitetin e shoqërisë dhe veçorive që e dallojnë nga shoqëritë tjera, nga ana tjetër.

Pikënisja e *katërt* është se në kuptimin e realitetit shoqëror, nuk mjafton ekzistimi i disa vërejtjeve dhe dispozitave të përgjithshme përshkruese, por është patjetër të gjenden studime analitike dhe kritike të thella dhe të guximshme për të kuptuar gjendjen e shoqërisë, në të gjitha anët dhe sektorët e saj të ndryshme. Këtu duhet të përfshihet niveli i lirisë, dinjitetit dhe të drejtave të njeriut, natyra e raporteve shoqërore mes individëve dhe grupeve, sistemi i vlerave që gjykon sjelljen e njerëzve së bashku me referencat e këtij sistemi dhe sa shoqëria është e lirë dhe e pavarur në marrjen e vendimeve dhe zgjedhjeve. E gjithë kjo, krahas gjendjes shoqërore sa i përket nivelit të hulumtimit shkencor në fushën e bujqësisë, industrisë, lehtësimet materiale dhe përparimit civilizues. Gjendja shoqërore në të gjitha këto çështje ndikon në gjendjen edukative të personalitetit njerëzor. Çdo reformim pedagogjik i synuar, nuk ka qare të bashkëvepron me gjendjen e shoqërisë aktuale. E gjithë kjo me qëllim që gjendja e saj të kalon në gjendjen e synuar.

Pikënisja e *pestë* është domosdoshmëria e përcaktimit të raporteve mes realitetit të mendimit pedagogjik islam dhe kohës, ose kontekstit kohor në të cilin është zhvilluar ky mendim. Atë që e kanë prodhuar pedagogët musliman në një periudhë kohore që ka kaluar, ajo më tani është trashëgimi pedagogjike islame. Ndërsa, Islami është mesazh dhe fe botërore për gjitha kohët dhe vendet. Parimet islamet në bazat e tij, respektivisht në Kur'an dhe sunetin pejgamberik janë parime bashkëkohore. Këtu përfshihen dispozitat dhe udhëzimet e tyre. Ndërsa, sa i përket trashëgimisë pedagogjike islame, të cilën e kanë ofruar dijetarët islam të umetit, ajo mund të jetë pak ose shumë afër parimeve dhe dispozitave islame. Kur mendimi pedagogjik nuk buron nga parimet dhe dispozitat e islamit, as nuk është i udhëzuar me udhëzimet e këtyre parimeve dhe dispozitave, por buron nga parime tjera që bien ndesh me udhëzimet islame, atëherë ky mendim nuk mund të llogaritet mendim pedagogjik islam.

Pikënisja e *gjashtë* është se mendimi pedagogjik islam të cilin e kemi për qëllim, nuk është "edukata fetare" apo

“edukata islame” si lëndë mësimore, e cila mësohet dhe përfshin disa dimensione shpirtërore, morale dhe etike individuale, ose ofron informacione rreth islamit. As nuk është lënda mësimore që trajton mendimin pedagogjik islam sipas ndonjë dietari islam gjatë historisë, ose dominimin e mendimit në një periudhë kohore gjatë historisë, ose në ndonjë pjesë të caktuar gjeografike, ose të ndonjë medhhebi juridik ose ideologjik..., ngase për gjithë këtë thamë se është trashëgimi pedagogjike islame... Mendimin pedagogjik islam për të cilin jemi duke folur është formim i mendimit i cili riformulon personalitetin individual dhe shoqëror aktual, tash dhe këtu, përfshirë anët psikologjike dhe intelektuale, ku si rezultat i saj do të lind formimi i një shoqërie që do të posedon gjallëri, efikasitet dhe arritje civilizuese të dalluara, tash dhe këtu. Pedagogjia sipas këtij kuptimi nënkupton ndryshimin e shpirtit dhe mendjeve që do të jetë bazament për ndryshim rrënjësor në anët shpirtërore dhe materiale në jetën e individit, shoqërisë dhe umetit.

Pikënisja e shtatë se çdo mendim pedagogjik të cilin e prodhojnë mendimtarët e cilitdo popull, ajo del nga një referencë ideologjike universale, ose vizion universal ndaj botës. Edhe mendimi pedagogjik islam duhet të del nga referenca ideologjike universale, e cila shpreh vizionin islam ndaj botës. Këtu përfshihet perceptimi universal të cilin e pranon shoqëria islame ndaj ekzistimit, jetës dhe njeriut, si dhe bindjet, vlerat dhe sistemet, të cilat bazohen në këto perceptime. Kur shoqëria islame importon mendim pedagogjik nga ndonjë vizion tjetër ndaj botës, atëherë problemi në esencë nuk është në detajimet dhe pjesët e mendimit pedagogjik, por është në pikëpamjet filozofike të cilat dalin nga ajo dhe referenca ideologjike që gjykon ato.

Shpresojmë që vetëdija ndaj gjendjes së realitetit të mendimit pedagogjik bashkëkohor në shoqëritë islame, vetëdija për domosdoshmërinë e reformimit të këtij realiteti dhe vetëdija rreth pikënisjeve të nevojshme për këtë përmirësim dhe reformim, të kontribuon në suksesin e

planifikimit për këtë reformim, si dhe në përpjekjet tona të urta për zbatimin e tij.

#### 4. Qarqet pedagogjike dhe rëndësia e tyre në përpjekjet e reformimit pedagogjik

Qarqet ose agjencitë pedagogjike, janë institucione ose organizata të specializuara, të cilat në mënyrë direkte apo indirekte, të sistemuara apo jo të sistemuara, të programuara apo jo të programuara, ndikojnë tek individit-njeriu. Ato fillojnë me familjen, më pas shkolla me gjitha nivelet e saja: foshnjore, fillore, e mesme dhe universitare. Duhet theksuar se njeriu, në të gjitha rastet dhe gjatë gjithë jetës së tij, jeton në një shoqëri në të cilat gjendet një numër i madh i institucioneve tjera, si: institucionet fetare, shoqërore, sportive, mediatike, rekreative etj. Njeriu, ecurinë e tij edukative, që nga momentet e para të jetës së tij e fillon me njërin apo më shumë prej këtyre institucioneve. Më pas, tërë jetën e tij e vazhdon nën ndikimin e këtyre institucioneve. Mund të ndodhë që gjatë jetës së tij, të kalon nga një mjedis edukativ në mjedis tjetër, si dhe mundet që në të njëjtën kohë të ndikohet nga një numër më të madh të institucioneve.

Literatura pedagogjike, në të shumtën e rasteve merr në konsideratë katër institucione: familja, shkolla, universiteti, mediat dhe rrethi i përgjithshëm social. Në vazhdim -në mënyrë të shkurtër do të flasim për katër institucionet e para. Ndërsa bisedën rreth ndikimit të rrethit të përgjithshëm social do ta lëmë në shkathtësinë dhe përvojën e lexuesit. Mjafton të potencojmë se rrethi i përgjithshëm social përfshin shumë institucione dhe forma të aktiviteteve, ku ndër më të rëndësishmet janë: rrethi i ngushtë i fëmijës (shokët), xhamia, muzeu, sporti, shoqatat, klubi kulturor etj. Ndikimi i këtyre institucioneve ndaj individëve dallon sipas vetë orientimeve dhe interesimeve të individëve dhe natyrës së rrethit familjar. Ndikimi i këtyre institucioneve ndaj individit -pozitivisht apo negativisht- mund të jetë më i madh se ndikimi i institucioneve kryesore si: familja dhe shkolla.



#### 4.1. Rëndësia e familjes në reformimin e arsimit:

Pedagogët dhe psikologët vërtetojnë se formimi psikik dhe emocional i individit formohet në jetën familjare qysh në periudhën fëmijërore. Atë që e sheh dhe e dëgjon fëmija në familje, si dhe mënyra e bashkëveprimit me atë që e shohin dhe e dëgjojnë, e gjithë kjo ka rolin më të rëndësishëm, jo vetëm në të mësuarit e gjuhës dhe përkatësisë, por në të gjitha anët e formimit psikik dhe emocional, përfshirë: vetëbesimin, guximin e marrjes së qëndrimeve, dëshira për bashkëpunim dhe ndihma ndaj të tjerëve etj. Pas kësaj, mësuesit duke u bazuar në këtë mund të vazhdojnë të përforcojnë dhe zhvillojnë këto karakteristika.

Mirëpo, jeta bashkëkohore, për shkaqe të ndryshme, mund të kufizojë ndikimin e edukatës familjare ndaj fëmijëve. Prej këtyre shkaqeve janë edhe dobësimi i edukatës prindërore të baballarët dhe nënat dhe angazhimi i tyre me punë tjera. Kështu, në ambientin e edukimit familjar nuk sigurohen kushtet për formimin e karakteristikave pozitive, shkalla e realizimit të tyre çrregullohet, bile mund të realizohen të kundërtat. Po edhe nëse plotësohen kushtet për edukim të mirë, më pas, ambienti shkollor mund të mos jetë i përshtatshëm për përforcimin e formimit psikik pozitiv, sidomos nëse punës së mësuesve u mungon shpirti i misionit dhe ai nuk posedon në shoqëri autoritetin që ngritë pozitën e tij para vetes dhe nxënësve të tij, si dhe rritë vetëbesimin dhe besimin të nxënësit e tij.

Në realitet, vetëdija e përgjegjësve të fëmijëve rreth edukatës dhe arsimit që e ofrojnë shkollat, si dhe praktikat pedagogjike, komunikimi dhe bashkëveprimi me drejtoritë e shkollave, nuk i liron nga përgjegjësia në planifikim dhe zbatim të shumë prej anëve të reformimit pedagogjik. E gjithë kjo mund të realizohet përmes programeve të caktuara për edukim të fëmijëve në periudha të ndryshme të jetës së tyre.

Edukimi familjar në shoqërinë islame nënkupton që babai dhe nëna të njohin nivelin e edukimit për të cilin ka udhëzuar Kur'ani dhe suneti peygamberik. Kjo njohje më pas duhet të

jetë udhërrëfytes për ta në praktikat e këtij edukimi. Në këtë rast, edukimi do të jetë themel për formimin e mendjes dhe psikës së individit, formimin e personalitetit të tij, ngase individi do të thithë mendimet, ndjenjat dhe pikëpamjet, si dhe ai do të edukohet në një sistem të kompletuar të vlerave të larta njerëzore dhe i nënshtrohet një rrethi të gjerë të raporteve shoqërore. Andaj, familja sipas udhëzimeve kur'anore dhe peygamberike është një depo e vlerave që kontrollojnë pozitën e shtrirë të anëtarëve të familjes, ku krahas djemve, vajzave, nipave e mbesave, përfshihen edhe gjyshi, gjyshja, babai, nëna, vëllai, motra, xhaxhai, daja, halla, tezja. Kështu çështja e të qenit nënë, baba, djalë, axhë, dajë e tjera, që të gjitha janë vlera që kontribuojnë në formimin psikik të fëmijës dhe formimin e raporteve. Çdo anëtar i familjes së zgjeruar ka pozitën që nuk e mbush asnjë anëtar tjetër. Kështu, gjyshi, gjyshja, xhaxhai, halla, daja, tezja kanë vend përplotësues për edukim që përforcon pozitën e babës, nënës vëllait dhe motrës. Detyrat e secilit prej tyre mund të mos jenë të qarta, por janë të fshehta dhe natyrale, të cilat realizohen në mënyrë mekanike. Ato detyra kur realizohen me vetëdije, atëherë ndikimi i tyre pozitiv do të jetë më i madh dhe më me vlerë.

Një meditim rreth ajeteve kur'anore të cilat njoftojnë për raportet e familjes së zgjeruar, qoftë nga gjaku apo martesë<sup>693</sup>, fëmijëve apo nipave dhe mbesave<sup>694</sup>, si dhe çështjet që kanë të bëjnë me lidhjen farefesisore, na bënë të mësojmë se personaliteti i individit-njeriut nuk mund të përplotësohet, përpos nëse ai kryen të gjitha detyrat familjare, detyrat ndaj gjyshit, babait, burrit, vëllait, djalit, nipit, xhaxhait, dajës... Po nëse individit nuk i jepet mundësia të kryejë njërën nga këto detyra, ai do të humb një pjesë të përvojës natyrale që kërkohet për përplotësimin e personalitetit njerëzor. Kjo

<sup>693</sup> Kjo formë e familjes shihet në ajetin kur'anor: ﴿وَهُوَ الَّذِي خَلَقَ مِنَ الْمَاءِ بَشَرًا فَجَعَلَهُ نَسَبًا وَصِهْرًا وَكَانَ رَبُّكَ قَدِيرًا﴾ "Dhe Ai nga uji (fara) krijoi njeriun, dhe e bëri atë të ketë fis dhe të ketë miqësi. Zoti yt ka mundësi të jashtëzakonshme" [El Furkan: 54].

<sup>694</sup> Kjo formë shihet në ajetin kur'anor: ﴿وَاللَّهُ جَعَلَ لَكُمْ مِنْ أَنْفُسِكُمْ أَزْوَاجًا وَجَعَلَ لَكُمْ مِنْ أَزْوَاجِكُمْ بَنِينَ وَحَفَدَةً﴾ "Allahu krijoi për ju bashkëshorte nga vetë lloji juaj, e prej bashkëshorteve tuaja - fëmijë e nipa" [En Nahl: 72].

çështje është e barabartë, si për mashkullin ashtu edhe për femrën.

Raporti mes gjyshërve dhe nipave ishte temë e shumë studimeve, të cilat kanë vërtetuar rëndësinë e këtij raporti për të dyja palët. Shembull për këtë kemi punimin që e ka publikuar Gazeta amerikane Boston Globe të datës 14 dhjetor 2015, punim të cilin e kanë realizuar disa hulumtues nën udhëheqjen e hulumtueses Sara Moorman, profesor inordinar në sociologji në fakultetin e Bostonit. Studimi është publikuar në revistën shkencore Gerontologist dhe temë studimi kishte "Rezultatet pozitive psikike dhe sociologjike të raporteve të ngushta mes gjyshërve dhe nipave". Studimi ka rezultuar se përkujdesi i gjyshërve dhe gjysheve ndaj nipave dhe mbesave zvogëlon problemet psikike dhe të sjelljes të fëmijët, dhe i furnizon me përvoja të pasura që u ndihmojnë për përshtatje dhe ambientim në periudhat e jetës së tyre. Nga ana tjetër, edhe vetë gjyshërit fitojnë shumë nga ky raport, ngase i bënë të ndjehen me vlerë në mesin e familjes, t'i ekspozohen ideve të reja dhe kontribuon në ruajtjen e fuqisë mentale.<sup>695</sup>

Ndryshimet e mëdha në shoqërinë njerëzore moderne, nën ndikimin e globalizmit dhe faktorëve tjerë, pasojat nuk kanë përfshirë vetëm arsimin shkollor dhe atë universitar në shoqëritë islame, por janë zgjeruar saqë kanë përfshirë të gjitha qarqet dhe institucionet pedagogjike. Kështu, për shembull, në sferën familjare, vërejmë se vlerat familjare siç i dëshiron Allahu dhe siç i kanë praktikuar njerëzit gjatë historisë, pothuaj se janë në shkatërrim e sipër në shoqëritë bashkëkohore. Edhe pse disa shoqëri muslimane akoma vazhdojnë të ruajnë disa nga këto vlera, megjithatë, me shpejtësi, janë në zhdukje e sipër. E gjithë kjo vjen si rezultat i shpërbërjes së familjes së zgjeruar, dobësimi i lidhjeve fafëfisnore, tërheqja e prindërve nga përgjegjësia e edukimit

<sup>695</sup> Shih Raportin rreth studimit në:

- Albernaz, Ami. "Study: Close grandparent-grandchild relationships have healthy benefits", Globe Correspondent, Dec. 14, 2015.

Raportin mund ta lexosh në këtë link:

- <http://educatedcompanion.com/study-close-grandparent-grandchild-relationships-have-healthy-benefits-2>

familjar, duke i dërguar në foshnjore, të cilat më shumë kanë karakter komercial se sa edukativ, ose duke sjellë në shtëpi shërbëtore të huaja, të cilat kanë vetëm qëllim material. Realitetit i edukatës familjare kanë marrë kuptimin e të qenit “jetim”, siç e ka kuptuar poeti i madh Ahmed Shevki ku ka thënë:

*Nuk është jetim ai të cilit i kanë vdekur prindërit  
dhe e kanë lënë pas vete të dobët!*

*Jetim është ai që ka nënë, e cila ka hequr dorë prej tij,  
apo ka baba, i zënë me obligime.*

Çështja e edukimit të dobët familjar, nuk përfshin vetëm fëmijët e periudhës së hershme fëmijërore të cilët edukohen në mënyrë jo të vetëdijshme, por kjo dobësi është zgjeruar saqë përfshin edhe periudhat tjera të fëmijërisë. Kështu, familja, përfshirë të gjithë anëtarët e saj, të mëdhenj dhe të vegjël janë të angazhuar me detyrat e tyre, ndërsa detyrën e edukimit ia ka lënë në përgjegjësi shkollës. Anëtarët e familjes merren me përgjegjësitë e punës, raportet shoqërore, angazhimi me informacionet që jepen në mjetet e informimit, rrjetet sociale etj.

Ekzistojnë disa qëllime pedagogjike, të cilat vështirë mund të realizohen jashtë familjes. Sidomos, qëllimet të cilat ndërliken me konceptet themelore të besimit, praktikat morale dhe vetitë e përgjithshme të personalitetit të individit-njeriut. Qëllimet të tilla kanë nevojë për ambient stabil, që lejojnë llojlojshmërinë e bashkëveprimit shoqëror dhe kulturor, edukojnë për bartjen e përgjegjësive dhe performancë cilësore. Megjithatë, familja ka mundësi të përcjell atë që ua ofron shkolla nxënësve, duke u dhënë mbështetjen e duhur, këshillimin, përmirësimin dh trajtimin e sjelljeve jo të përshtatshme të cilat mund t'i përfitojnë fëmijët në shkollë. Kjo nuk e liron shkollën nga përgjegjësia edukative, e cila mund të realizohet përmes formave tjera të bashkëveprimit shoqëror mes nxënësve dhe mësimeve. Jeta shkollore nuk përfshin vetëm marrjen e informacioneve dhe shkathtësive, por zgjerohet për të përfshirë format e ndryshme të bashkëveprimit njerëzor, i cili nuk realizohet në

mënyrë të thatë mekanike, por në mënyrë të gjallë, e mbushur përplot me dashuri dhe mëshirë. Me këtë, mund të kuptojmë rëndësinë e bashkëveprimit dhe komplementimit mes detyrës së familjes dhe detyrës së shkollës.

Edhe kur kujdeset familja për edukimin dhe arsimimin e fëmijëve, përkujdesi më i madh është për rezultatet mësimore, e cila u jep mundësi të konkurrojnë për studime universitare në përgjithësi dhe për garë në specializime të caktuara. Në familje dhe në tërë shoqërinë, pothuaj janë humbur strategjitë pedagogjike për formimin e personalitetit të kompletuar të individit, ose plotësimi i kërkesave të mëvetësimit, përfshirë efikasitetin dhe përvojat shkencore dhe praktike në shoqëri. Dështimi i sistemit pedagogjik në shoqëritë islame nuk përfshin vetëm dobësimin e identitetit fetar dhe kombëtar, si dhe rritjen e dëshirës për migrim në vendet perëndimore, por ky dështim zgjerohet për të përfshirë edhe forma tjera siç janë: varfëria e të diplomuarve për efikasitetin e nevojshëm për plotësimin e kërkesave të zhvillimit, rritja e papunësisë në mesin e të diplomuarve, ku si rezultat i saj vjen importimi i përvojave të larta artistike nga jashtë dhe mbështetja në punëtorët e huaj edhe në profesionet e thjeshta.

Reformimi arsimor -duke filluar nga përpjekjet e familjes- fillon nga përgatitja e mirë e prindërve për të kryer detyrën e tyre madhështore. Formë e kësaj përgatitje është edhe edukata e të qenit prind (peranting), e cila i ndihmon prindërit të përfitojnë njohuri dhe vetëdije të mjaftueshme për bashkëveprim me rrethanat që ndikojnë në edukimin e fëmijëve të tyre, të bartin përgjegjësitë e këtij edukimi, jo për t'i përgatitur ata që të bartin vetëm përgjegjësitë e kësaj jete, por edhe për të shpëtuar nga fundi i keq ata dhe fëmijët e tyre në Botën e Ahiretit. Ky përfundim i pret të gjithë ata të cilët gjatë kryerjes së kësaj përgjegjësie, heqin dorë nga mbështetja në Kur'anin Famëlartë dhe në udhëzimet pejgamberike.<sup>696</sup>

<sup>696</sup> Në këtë rast, përkujtojmë ajetin kur'anor:

Reformimi i shpresuar në arsim, të cilin familja mund ta kryej është reformimi shoqëror gjithëpërfshirës, ku prindërve ua kthen detyrën e tyre edukative, sidomos çka ka të bëjë me detyrat e nënës gjatë periudhës së shtatzënisë, lindjes, gjdhënies dhe viteve të para të jetës së fëmijës. Në këto çështje nuk pritet që dikush përveç nënës do të mund ta kryej këtë detyrë në mënyrë të synuar. Ekzistojnë disa ide reformuese në këtë çështje, ku bënë pajtimin mes kësaj detyre nga njëra anë dhe të drejtën e gruas apo dëshirën e saj për punë nga ana tjetër. Një prej këtyre ideve është që nëna të llogaritet e punësuar me pagë të përshtatshme gjatë tërë periudhës së shtatzënisë, lindjes, gjdhënies dhe të përfshijë periudhën derisa të hyjë edhe fëmija i fundit i saj në shkollë, dhe më pas mundet që nëna të shkojë në punë.

Në lidhje me këtë çështje theksojmë edhe atë se fusha ideologjike dhe kulturore në shumicën e vendeve islame është përplot e mbushur me biseda dhe debate rreth të drejtave të grave për barazi të plotë me burrat. Këto biseda në të shumtën e rasteve realizohen nën moton e demokratizimit, civilizimit dhe liberalizimit, të cilat gjejnë udhëzime, ushtrime dhe financime nga institucione të huaja, gjë e cila në Botën Islame kërkohet kontrollim ndaj motiveve dhe programeve të tyre.

#### 4.2. Rëndësia e arsimit publik në reformimin pedagogjik:

Institucionet mësimore në shoqëritë njerëzore janë shfaqur shumë herët, që kur ka filluar sistemimi dhe specializimi për realizimin e kërkesave të shoqërisë njerëzore. Më pas, ky sistemim është zhvilluar në forma të ndryshme. Ka pasur mësues të profesionit, mësues të fesë, mësues të detyrave shtëpiake, mësues luftarak etj. Po ashtu ka pasur mësues të mektebeve, edukatorë të fëmijëve të mbretërve, princave dhe të pasurve. Sikur që ka pasur raste kur një mësues ka mësuar

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا فُوا أَنْفُسَكُمْ وَأَهْلِيكُمْ نَارًا وَقُودُهَا النَّاسُ وَالْحِجَارَةُ عَلَيْهَا مَلَائِكَةٌ غِلَاطٌ شِدَادٌ لَا يَعْصُونَ اللَّهَ مَا أَمَرَهُمْ  
وَيَفْعَلُونَ مَا يُؤْمَرُونَ﴾

"O ju që besuat, ruajeni veten dhe familjen tuaj prej një zjarri, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët. Atë (zjarrin) e mbikëqyrin engjëjt e rreptë e të ashpër që nuk e kundërshtojnë Allahun për asgjë që Ai i urdhëron dhe punojnë atë që janë të urdhëruar" [Et-Tahrim: 6].

një nxënës një fushë të caktuar, po ashtu ka pasur shkollë, në të cilën janë tubuar disa nxënës për arsim të veçantë apo kulturë të përgjithshme. Në këto shkolla ka pasur disa mësues dhe secili ka kryer një detyrë të caktuar arsimore. Historia njerëzore njihet ekzistimin e shkollave të larta, në të cilat mësohen tema të caktuara dhe në to mësojnë studentë në moshë të përshtatshme për studim.

Shkolla ishte institucioni shoqëror, të cilës shoqëria ia ka besuar sigurimin e ambientit të nevojshëm për përkujdesjen ndaj zhvillimit të kompletuar të bijve dhe bijave të saj, si dhe përgjegjësinë e përcjelljes së kulturës së shoqërisë nga gjenerata e sodit në gjeneratën që vjen pas. Pasi familja përfaqëson një ambient dhe përvojë të caktuar, shkolla përfaqëson ambiente dhe përvoja të ndryshme sipas nxënësve. Andaj, ndjehej nevoja për një normë ndryshe të bashkëveprimit shoqëror mes nxënësve të këtyre ambienteve, si dhe mes nxënësve, mësuesve dhe sistemeve të jetës shkollore. Për këtë, mësimi shkollor, krahas përfitimit të njohurive në përmbajtje të ndryshme mësimore, ngërthen edhe mësimin e të drejtave dhe obligimeve, rregullimin e raporteve me individë dhe grupe, si dhe bashkëveprimin në zbatimin e të drejtave dhe obligimeve.

Kështu është gjendja e shkollave në të gjitha shoqëritë. Ndërsa pikat që dallojnë shoqëritë mes vete fshihen në natyrën e të drejtave dhe obligimeve, elementet e kulturës dhe etika e bashkëveprimit të miratuar në secilën shoqëri. Ne supozojmë se reformat e synuara pedagogjike në vizionin islam, do të kenë në konsideratë realitetin e shoqërisë tonë, natyrën e ambientit familjar me qëllim që shkolla të kryen detyrën e përforcimit të elementeve pozitive të cilat vijnë nga ky ambient, si dhe trajtimin e problemeve të mundshme në te. Trajtimi i problemeve kërkon një nivel të lartë të urtësisë dhe butësisë. Në duhet që udhëzimi pedagogjik islam në shkollë, të sjellë probleme të reja. Komunikimi mes shkollës dhe familjes, nuk është vetëm mjet për bashkëveprim me nxënësin, por mund të jetë edhe mjet për zgjidhjen e problemeve të vet familjes. Andaj, reformat e synuara

pedagogjike islame duhet gjithsesi të cilësohen si të kompletuara në institucionet, ambientet dhe mjetet e saja.

Përgjegjësia arsimore -në të gjitha rastet- do të mbetet përgjegjësi e përbashkët. Shoqëria e përfaqësuar nga institucionet shtetërore bartë përgjegjësinë e planifikimit të përgjithshëm të të gjitha programeve pedagogjike dhe plan-programeve mësimore. Shoqëria vendore në qytete, fshatra dhe mëhalla është përgjegjëse për sigurimin e nevojave që mungojnë në aspektet edukativo-arsimore. Familja përplotësohet me programet edukative dhe arsimore me të gjitha llojet dhe nivelet. Megjithatë, edhe vetë individi nuk lirohet nga përgjegjësia, varësisht nga niveli i zhvillimit dhe shkalla e pjekurisë dhe vetëdijes.

Krahas polemikave që herë pas here ngrihen rreth shkallës së suksesit apo dështimit të sistemeve edukativo-arsimore në udhëheqjen e shoqërive islame drejt qëllimeve të caktuara zhvillimore apo civilizuese, si dhe ndikimit të rritur të disa faktorëve tjerë si politika dhe mjetet informative, edukata dhe arsimi mbeten, nëse jo hyrje kryesore, me siguri hyrje shumë e rëndësishme për ndryshim shoqëror, kulturor dhe civilizues, pa marrë parasysh se ndryshimi është në drejtim negativ apo në drejtim pozitiv.

Shpeshherë dëgjojmë dhe lexojmë se edukata dhe arsimi janë lokomotiva e reformave, zhvillimit dhe ndryshimit në çdo shoqëri. Mirëpo, kemi filluar të kuptojmë se për të qenë edukata dhe arsimi themel për reformim dhe ndryshim në sistemet tjera, vetë sistemi edukativo-arsimor ka nevojë për reformim dhe ndryshim. Me këtë justifikohet thënia se edukata dhe arsimi janë sëmundje dhe ilaç. Supozohet që aspektet e reformimit të cilët duhet të përfshijnë sistemin pedagogjik në shoqëritë tona janë të shumëfishta, ku secili aspekt meriton meditim, analizim dhe hulumtim.

Rëndësia e shkollës në reformim dhe ndryshim pozitiv gjatë bisedimit rreth realitetit aktual të shoqërive islame shfaqet me vizionin reformues islam. Sipas këtij vizioni, këto shoqëri janë të prapambetura, në krahasim me atë që e dëshiron Islami për to, me mundësitë që i posedojnë dhe në



krahasim me shoqëritë tjera. Mirëpo, raporti mes realitetit aktual dhe atij që shpresohet, pa dyshim se ndikohet nga faktorë të shumtë. Disa prej këtyre faktorëve janë të veçantë me aspektet e personalitetit njerëzorë dhe vetive shpirtërore, fizike, intelektuale dhe psikike me të cilat cilësohen individët, në atë mënyrë që përpjekja të jetë drejt një edukimi që cilësohet si i baraspeshuar dhe i përplotësuar në aspektet e personalitetit. Disa faktorë janë të veçantë me temat që përfshihen në procesin edukativo-arsimor si: temat fetare, gjuha, shkencat, matematika, teknika etj. Disa faktorë janë të veçantë për llojllojshmërinë e qëllimeve të procesit pedagogjik, ngase ka arsim të përgjithshëm, arsim profesional dhe lloje tjera për qëllime të caktuara.

Prej faktorëve që duhet të merren në konsideratë gjatë planifikimit të reformave të përgjithshme pedagogjike janë edhe llojllojshmëria e modaliteteve arsimore, të cilat ndikojnë tek individi. Prej këtyre modaliteteve kemi: arsimin formal (arsimi i programuar shkollor), joformal arsimi i programuar jashtëshkollor) dhe informal (arsimi i rastit dhe i paprogramuar).

Shumë prej parimeve dhe praktikave të cilat dominojnë sot në mendimin pedagogjik, llogariten si përvoja të dobishme, të cilat mund të merren si bazë për përshtatshmëri të intencave të synuara reformuese pedagogjike islame. Prej parimeve pedagogjike stabile sot, në pothuaj gjitha vendet e botës, është edhe parimi i obligueshmërisë së arsimit falas. Kjo çështje është e drejtë e çdo individi në shoqëri dhe obligim që shoqëria duhet ta siguron për të gjithë. Parim tjetër është edhe llojllojshmëria arsimore me qëllim të sigurimit të kulturës së përgjithshme dhe njohurive të specializuara, përgatitja profesionale dhe artizanateve të ndryshme, me qëllim të plotësimit të nevojave të shoqërisë në menaxhimin e punëve, zhvillimin e resurseve, realizimin e interesave dhe mundësimin për kontribut efikas në ngritjen e civilizimit. Pjesë e llojllojshmërisë është edhe arsimi i rregullt i cili realizohet në institucionet arsimore në mënyrë të caktuar, dhe arsimi jo i rregullt. Në këtë mënyrë

përplotësohen elementet arsimore dhe merren në konsideratë çështjet nga të cilat do të ndikohet nxënësi gjatë bashkëveprimit me realitetin shoqëror, pa marrë parasysh se rezultatet e saj janë pozitive apo negative. Parim tjetër është edhe shfrytëzimi i mjeteve moderne të komunikimit për pasurimin, lehtësimin dhe ngritjen e cilësisë së praktikave mësimore.

Pjesë e aspekteve të llojllojshmërisë dhe përplotësimit që e kërkon jeta bashkëkohore është edhe përfshirja e gjuhëve tjera jashtë gjuhës zyrtare vendore në plan-programet mësimore, në atë mënyrë që shoqërisë në përgjithësi i mundëson të bashkëveprojë me burimet tjera të të mësuarit dhe kulturimit. E gjithë kjo mundëson rritjen e raporteve dhe bashkëpunimit me shoqëritë tjera, duke marrë prej tyre dhe duke iu ofruar atyre, me kusht që e gjithë kjo të mos jetë në llogari të gjuhës zyrtare vendore. Gjuhës arabe duhet t'i kushtohet një interesim prioritar në shoqëritë islame jashtë Botës Arabe, në atë mënyrë që krahas gjuhës zyrtare vendore, të jetë gjuha e dytë. Gjuhëve të popujve islamë, duhet t'i kushtohet një interesim prioritar në vendet arabe, me qëllim që krahas arabishtes, të jetë gjuha e dytë. Prej këtyre gjuhëve janë: gjuha turke, persiane, urde, malajziane, indoneziane, shqipe etj. Krahas këtyre duhet të mësohen edhe gjuhët e huaja të cilat dominojnë në shumë vende të botës. Natyrisht se me këtë nuk kemi për qëllim që nxënësi t'i mësojë gjitha këto gjuhë, por kemi për qëllim që sistemi arsimor të jep mundësinë që nxënësi, krahas gjuhës së tij zyrtare të mësojë edhe një apo dy gjuhë.

Mendimi pedagogjik ka përjetuar një transformim në epiqendrën e interesimeve: nga mësimdhënia te mësimnxënia, nga mësuesi te nxënësi, nga plan-programet e caktuara në lirinë e zgjedhjes, nga tematikat e ndara në tematikat e lidhura dhe të përplotësuarra, nga menaxhimi qendror në menaxhim vendor, nga administrata mësimore në udhëheqje mësimore etj. Ky transformim -në disa raste- është shoqëruar me disa keqkuptime mes asaj që quhen mendime të vjetra dhe mendime të reja. Sipas neve, e vërteta nuk është

në dallimin mes të vjetrës dhe të rejtës, ngase në këtë transformim nuk ka problem nëse çështja përkufizohet në orientimin e interesimit të nevojshëm drejt aspekteve të rëndësishme, të cilat nuk kanë përjetuar interesimin e merituar. Baraspesha në të gjitha rastet është e kërkuar, e jo kalimi në njërin anë duke hequr dorë nga ana tjetër. Shumë çështje të urta dhe të rëndësishme gjenden në disa elemente të së kaluarës! Sa pak çështje të dobishme ka në disa elemente të së tashmes! Njeriu, në të gjitha rastet, sa shumë ka nevojë për reformim! Sa e sa probleme janë zbuluar në çështjet të cilat i kemi llogaritur si të zakonata dhe nevojën për kuptim të ri, të cilat janë zhvilluar si rezultat i të menduarit apo marrje nga përvojat e të tjerëve.

Marrë parasysh hapësirën e gjerë të fushës së edukatës dhe arsimit dhe sasisë së energjive që kërkojnë reformat pedagogjike në çdo shoqëri, tërheqim vëmendjen që të jemi të urtë dhe të kujdesshëm në angazhimin e normave shoqërore që janë në disponim. E gjithë kjo duke pasur parasysh institucionin arsimor si njësi e reformave pedagogjike. Le ta sqarojmë këtë çështje me një shembull: shkolla është institucion arsimor, në të cilin mund të ketë qindra nxënës dhe dhjetëra mësues, ku që të gjithë janë nën udhëheqjen e drejtorit. Është e sigurt se për secilin nxënës duhet pasur kujdes gjatë procesit mësimor. Nuk është e pranuar të anashkalohet asnjëri prej tyre. Kjo çështje po ashtu vlen edhe për mësuesit. Nuk është e pranuar të ketë në mesin e tyre ndonjë që nuk njeh punën e tij. Çfarë reforma mund të bënë drejtori i shkollës që i mundësojnë atij shndërrimin e shkollës në një model të suksesshëm, që mund të përsëritet në shkollat tjera, me qëllim që të realizohen reformat e përgjithshme pedagogjike në shoqëri?!

Sipas neve, çelësi i gjithë kësaj është zgjedhja adekuate e drejtorit të shkollës. Ai duhet përgatitur që të udhëheq shkollën e tij në rrugëtimin e reformave dhe në këtë shkollë të formojë “kulturën e reformave pedagogjike”, ku gjatë praktikimit të kësaj kulture do të marrin pjesë të gjithë ata që gjenden në shkollë dhe përreth shkollës, përfshirë prindërit

dhe ambientin hapësinor. Shpresohet që përmirësimi i gjendjes së drejtorëve të shkollave të jetë ndihmesë për përmirësimin e gjendjes së mësuesve dhe gjithë atyre që ndërliidhen me shkollën në ndonjë formë.

Vlen të theksohet se në tre dekadat e fundit të shekullit XX dhe më pas, kritikët e drejtuara arsimit shkollor, qoftë në plan-programet mësimore apo ambientin e kulturës islame dominuese, në mënyrë kryesore i janë drejtuar arsimit fetar islam dhe kulturës pedagogjike islame. E gjithë kjo nën pretekstin se kërkojnë rrënjët e prapambetjes në normat e të menduarit, mbyllja, fanatizmi, urrejtja e tjetrit, ekstremizmi etj. Kjo kritikë ka arritur sukses në zvogëlimin e orëve të parapara për lëndën e edukatës islame në shkolla, ndërhyrja në programin mësimor dhe insistimi nga ana e mediave me qëllim për të dhënë përshtypje negative ndaj saj. Ne, për derisa flasim për reformat e mendimit pedagogjik islam e shohim si të domosdoshme nevojën që plan-programet e edukatës islame dhe të gjitha plan-programet tjera mësimore të zhvillohen në mënyrë të vazhdueshme me qëllim që të formohet një sistem i vlerave të do të jetë i fuqishëm që gjeneratave të reja t'ju mundësojë të japin kontribut në ngritjen e civilizimit të synuar. Ndërsa, sulmi me kritikë dhe deformim ndaj plan-programeve të edukatës islame, edhe krahas asaj se është bartësja kryesore e vlerave të këtij umeti, kemi frikë se e gjithë kjo do të shpie në zhveshjen nga identiteti, bekimin e imitimit dhe çaktivizimin e ngritjes së vërtetë.

#### 4.3. Reformat pedagogjike dhe arsimit i lartë

Biseda jonë rreth reformave të mendimit pedagogjik në nivel të arsimit të lartë mbështetet në disa hipoteza. Si hipotezë më e rëndësishme është se reformat e mendimit në realitetin e popullatës islame kanë prioritet në përkujdesje ngase ato janë lokomotiva e reformave në sferat tjera. Është kështu, për arsye se biseda në esencë i drejtohet elitës shkencore, mendore dhe kulturore të administratës dhe profesorëve të universiteteve. Universiteti është institucion

për përgatitjen e udhëheqjes së shkencës, mendimit dhe punës në të gjitha fushat e aktiviteteve në shoqërinë moderne, ngase ai, në veçanti, përmes programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të tretë (magjistraturë dhe doktoraturë) bartë përgjegjësinë e formimit të mendjeve të studentëve, sigurimin e shanseve të nevojshme për të poseduar shkathtësi përparimtare në të menduarit, hulumtuarit dhe zgjidhjen e problemeve në profesione të ndryshme. Shumica e atyre që punojnë në arsim në fazat e mëhershme të arsimit të përgjithshëm, në mësimin e mesëm, fillor dhe në çerdhe, janë të diplomuar në universitet. Shumë prej të rinjve dhe të rejave nuk bëhen baballarë dhe nëna para se të diplomojnë në universitet dhe para se të arrijnë një nivel të pjekurisë psikologjike dhe shoqërore, dhe të vetëdijesohen për kërkesat e edukatës prindërore dhe familjare.

Biseda rreth reformave në arsimin e lartë në Botën Islame është bisedë e shumëdegëzuar. Realiteti i këtij lloj arsimi vuan nga shumë probleme. Disa probleme janë të tilla për të cilat flasin njerëzit e veçantë dhe popullata si p.sh. mungesa e emrave të universiteteve të Botës Islame në listën e rangimit të universiteteve më të mira në botë. Ky rangim realizohet sipas kriterëve të ndryshme të cilat i vënë institucionet për rangimin dhe vlerësimin e universiteteve, qoftë për nga investimi në hulumtime shkencore, ose për qindjen e profesorëve në krahasim me numrin e studentëve, ose numrin e programeve në studimet postdiplomike, ose arritjet shkencore të profesorëve etj. Çështja më e rrezikshme nga gjithë kjo është përmbajtja shkencore dhe mendore e cila u ofrohet studentëve dhe zhvillohet në universitetet e Botës Islame. Kjo përmbajtje në të shumtën e rasteve është e importuar nga Perëndimi, qoftë Evropa apo Amerika, dhe si bashkëveprimi me te – në rastet më të mira- realizohet sipas metodologjisë që zbatohet në vendin nga e cila vjen, qoftë në ligjërim, zhvillim apo prodhim. Këtu mungon analizimi kritik, i cili zbulon pikënisjet filozofike të kësaj përmbajtje, mungon shpirti reformues dhe kreativ dhe motivet e kreativitetit dhe zbulimit. Kështu realizohet tjetërsimi i

profesorit universitar dhe studentit në llogari të shkencave dhe mendimeve sipas formulimit përëndimor, qoftë ky tjetërsim me vetëdije apo pa vetëdije. Me anë të këtij tjetërsimi humbet identiteti, qoftë identiteti kombëtar, fetar apo atdhetar.

Biseda rreth reformave në arsimin universitar është e gjerë dhe përfshin shumë probleme. Këto probleme mund të jenë të veçanta për administratën, organizimin dhe udhëheqjen e universitetit, programet dhe specializimet shkencore dhe profesionale, burimet e financimit, kushtet e pranimit të studentëve, kushtet e diplomimit, metodat, mjetet dhe aktivitetet mësimore, ambienti, programet dhe financimi i hulumtimit shkencor etj. Mirëpo, problemi më i madh, për të cilin propozojmë të shihet në mënyrë të veçantë dhe të kujdesemi vazhdimisht për te, është natyra e krizës përmes së cilës ka kaluar arsimit universitar modern në Botën Islame që nga themelimi në shtetet e këtyre vendeve në periudhën e okupimit. Kjo krizë, në formën e “krizës civilizuese” manifestohet në mungesën e identitetit dhe përkatësisë ndaj këtij umeti. Është kështu për arsye se filozofia e arsimit universitar ka ra në problemin e përkujdesit material në llogari të atij shpirtëror dhe moral, tregut të punës në llogari të prodhimit të dijes dhe njohurisë, zhvillimit ekonomik në llogari të përparimit civilizues, civil në llogari të atij fetar, përvojës së huaj në llogari të përvojës kombëtare etj. Nuk duhet harruar se esenca në të gjitha këto çështje duhet të jetë përplotësimi dhe baraspesha.

Është për keqardhje se hulumtimi rreth çështjeve të arsimit universitar anashkalon përkujdesin ndaj kësaj “krize civilizuese”, ngase dimensionit ekonomik dhe material i menaxhimit, financimit dhe zhvillimit të programeve të arsimit universitar nga njëra anë, dhe tregut të punës nga ana tjetër formojnë aspektet më të rëndësishme të përkujdesit.

Mendojmë se përpjekjet për reformim, doemos duhet të fillojnë duke u koncentruar në çështjet të cilat mund me lehtë të reformohen, dhe janë në kuadër të interesimeve të reformatorit, specializimit dhe përgjegjësisë së tij. pamundësi

e profesorit universitar për të bërë reforma në një sferë të caktuar p.sh., nuk e liron atë nga përgjegjësia e reformave në sferat që mund të bëjnë reforma ose kërkohet prej tij përgjegjësi. Profesori universitar ka një hapësirë të madhe të lirisë së veprimit në sfera të ndryshme. Ai ka mundësi të zgjedhë, të bëjë ixhtihad, të komunikojë me studentët përmes diskutimeve, bashkëveprimeve, udhëzimeve, ndikimeve dhe në fund reformimeve. Kjo është edhe pika më me rëndësi gjatë bisedës sonë momentale ndaj reformimit të arsimit universitar.

Konstrukt i përgjithshëm i përpjekjeve për reforma në arsimin universitar, e që mund t'ju ofrohet dhe drejtohet të të interesuarve për reformimin e këtij lloji arsimi sipas vizionit islam, propozojmë të jetë sipas pikave vijuese:

1. Vetëdija e plotë ndaj sfidave të shumta me të cilat përballet arsimi universitar në Botën Islame. Sfidë më e rëndësishme në mënyrë absolute është imitimi shkencor dhe mendor i përfaqësuar në mbështetjen e importimit të plan-programeve mësimore dhe librave referuese dhe metodologjike nga jashtë. Ne i importojmë këto çështje nga jashtë, duke përfshirë përmbajtjet dhe gjuhën, referencat filozofike dhe vizionin ndaj botës, formulimet teorike dhe zbatimet praktike. Vetëdijesimi ndaj kësaj sfide dhe planifikimi për t'iu përballuar sipas një plani të përshtatshëm dhe kalimtar, është në krye të prioritetëve të reformimit në arsimin universitar.

2. Sido që të jenë detyrat të cilat i kryejnë universitetet sot, është doemos të ketë universitete apo fakultete të specializuara, të cilat marrin përgjegjësinë themelore të arsimit të lartë, e që është prodhimi dhe shpërndarja e njohurisë, dhe përgatitja e hulumtuesve të fuqishëm për prodhim. Sipas vlerësimit tonë, kjo çështje është një ndër metodat për të përballuar sfidën e imitimit të theksuar më lartë.

3. Ekzistojnë raste kur studenti vjen në universitet dhe atij i mungon baza për të kuptuar parimet, dispozitat, mendimin dhe kulturën islame. Arsimi universitar nuk i jep

mundësi për të riformuar këtë të kuptuar përsëri. Në lidhje me këtë çështje, propozimi jonë përfshin dy çështje: e para: inicimi i prezantimit të mendimit islam dhe praktikave islame në jetën universitare në atë mënyrë që studentët ta përjetojnë si realitet. E dyta: ofrimi i programeve të reja në studimet universitare rreth shkencave islame dhe çështjeve të mendimit islam. Në këto programe, koncentrimi do të fokusohet në zbritjen e dispozitave dhe intencave në realitetin bashkëkohor, duke mos u zhytur shumë në historinë e shkencave.

4. Është i domosdoshëm përkujdesi për programet e studimeve të larta në ciklin e dytë dhe të tretë. Këto programe mundësojnë komunikimin mes profesorëve dhe studentëve, përkushtimi gjatë hulumtimit ndaj një çështje të profesionalizuar që jep mundësinë e thellimit në të kuptuarit e saj, prodhimin e njohurive rreth saj dhe zgjidhja e problemeve të lidhura me te. Përzgjedhja e temës së ligjërimit dhe hulumtimit në studimet pasuniversitare për të dialoguar rreth shanseve për reformim, është si rezultat i lirisë që i jepet profesorit universitar për të komunikuar me studentë të një shkalle të përparuar të pjekjes dhe përgatitjes për bashkëveprim. Ky komunikim mund të jetë shumë i frytshëm, marrë parasysh numrin e vogël të studentëve në këto programe, në krahasim me numrin e studentëve në programet e studimeve deridiplomike.

5. Nënshtrimi i praktikave të arsimit universitar ndaj traditave dhe zakoneve, duke munguar zhvillimi dhe kreativiteti, të cilat janë të domosdoshme për reformim pedagogjik dhe ngritje civilizuese. Për këtë, propozojmë organizimin e programeve për trajnim, ngritjen e cilësisë dhe bartjen e përvojave apo këmbimit të tyre. Sidomos për profesorët që ligjërojnë në programet studimore pasuniversitare dhe mentorojnë punimet e magistraturës dhe doktoraturës në këto programe. Sfera e reformimit në studimet pasuniversitare varet nga nevoja për te, përcaktimi i qëllimeve dhe prioriteteve, sigurimin e kërkesave, përpilimin e plan-programeve, mënyrën e përshtatshme për menaxhim



dhe zgjedhjen e studentëve dhe profesorëve. Shumë prej këtyre çështjeve nuk bien në kuadër të përgjegjësisë së drejtpërdrejtë të profesorit universitar. Megjithatë, disa profesor kanë rol të drejtpërdrejtë, për shkak të pozitive të tyre administrative në universitete, qoftë në nivel të kryetarit të degës, dekanit, rektorit, anëtarit të komisioneve që merren me këto çështje, qoftë për konsultim, propozim dhe vërejtje apo për marrjen e vendimeve. Çështje e padiskutueshme është se -në fund të fundit- profesori universitar në studimet pasdiplomike do të jetë para një numri të caktuar të studentëve, të cilët posedojnë pjekuri, përgatitje dhe motive, që llogariten si mundësi e shtrenjtë që profesori të fillon me ta përpjekjet për reformim mendor dhe shkencor, ku do të hapë për vete dhe për ta mundësi të gjera për zhvillim, përparim dhe arritje.

6. Vetëdija për rëndësinë e modelit praktik për reforma edukativo-arsimore ka ekzistuar që herët. Kjo vetëdije ishte në kuadër të propozimit për themelimin e universitetit të kompletuar, me qëllim që të bëhet model për reformat e synuara në sferën e arsimit të lartë. Kjo realizohet duke përfshirë përvojat dhe eksperiencat që i përkasin përplotësimit njohës, ku në programet universitare përmbledh njohuritë që vijnë nga vahji (shpallja), shkencat humane dhe shoqërore, specializimin e kombinuar, specializimin kryesor dhe anësor dhe ambientin universitar motivues për kreativitet, shpikje dhe kontribut në shërbim të shoqërisë. Edhe krahas asaj se disa universitete dhe fakultete janë ngritur në bazë të kësaj vetëdije, duke u bazuar në përvojën tonë në këtë fushë, vlerësojmë se akoma vazhdojmë të kemi nevojë të madhe për zhvillimin e programeve dhe praktikave me qëllim që të bëhen Qendra për ekselencë në nivel të mendimit edukativo-arsimor botëror. Në këtë kontekst, i drejtohem disa organizatave të veçanta, që të kujdesen për këto qendra. Këtu veçojmë Organizatën Islame për Edukim, Shkencë dhe Kulturë (ICESCO), Unionin e Universiteteve të Botës Islame, Lidhjen e Universiteteve Islame etj.

7. Pasurimi i mjedisit universitar me aktivitete të shumta shkencore në formë të tribunave, konferencave dhe seminareve formuese rreth çështjeve të përgjithshme ideologjike. E gjithë kjo me qëllim që të rritet interesimi, formimi i mendimit si rezultat i aktiviteteve dhe zgjerimi gradual i rrethit të interesimeve, derisa të dominon “kultura e reformave pedagogjike”.

Këto propozime janë thirrje publike për gjithë të interesuarit në mënyrë të drejtpërdrejtë në universitetet e Botës Islame, thirrje për gjithë mendimtarët, hulumtuesit dhe bartësit e projekteve reformuese të popullatës islame. Ata, çështjes së reformave në arsimin universitar, duhet t’ia kushtojnë kujdesin e merituar, me qëllim që mos të harxhohen gjitha fuqitë e mundshme në interesime ndaj çështjeve politike dhe ekonomike. Kështu, reformave mendore dhe edukativo-arsimore nuk do t’i kushtohen përpjekjet e nevojshme, edhe krahas asaj se këto reforma janë me ndikim të thellë, afatgjatë dhe sigurimi më i rëndësishëm i ardhmërisë së këtij populli dhe gjeneratave të ardhshme.

#### 4.4. Rëndësia e mjeteve të informimit në reformat pedagogjike

Mjetet e informimit, komunikimit dhe lidhjeve në jetën bashkëkohore janë bërë me ndikim tepër të madh (pozitivisht dhe negativisht) në besimin fetar, edukimin shoqëror, normalizimin kulturor, orientimin psikologjik dhe moral, ndërtimin mendor, përkatësinë politike, orientimin ekonomik, si dhe aspekte tjera të bindjes dhe sjelljes, formimit të pozicioneve, si dhe gjykimit ndaj gjësendeve, ngjarjeve, personave dhe ideve... Nuk duhet harruar se shumë prej asaj që publikohet në mjetet e informimit dhe shpërndahet në mjetet e komunikimit dhe rrjetet sociale, po edhe nëse jepet në formë të lajmit, fjalë në këngë, program rekreativ, program dokumentar, fjalim politik e tjerë, është e mbushur përplot me mendime, orientime dhe vlera. Mesazhi i orientuar mediatik, ka mundësi të ndryshojë gjendjen e përgjithshme shoqërore, të hedhë poshtë një koncept ideologjik dhe politik dhe në vend të saj të sjell një koncept

tjetër, të përgatit njerëzit për të pranuar apo refuzuar planet rreth projekteve zhvillimore, pedagogjike, politike etj.

Për këtë, shohim se gjitha institucionet, organizatat, orientimet politike, ideologjike, arsimore dhe artistike, përdorin mjetet e informimit, komunikimit dhe lidhjeve për qëllimet e tyre të mira dhe të këqija. Kështu, edhe një individ ka mundësi të përdorë disa mjete moderne të komunikimit për të formuar një opinion të përgjithshëm rreth një çështje të veçantë, e cila do të përfundon me vendim politik, administrativ apo ekonomik, në një nivel të madh të përkujdesjes.

Bazuar në atë se mjetet e informimit, komunikimit dhe lidhjes bazohen në nxjerrjen dhe publikimin e informacionit apo çështjes, ato në disa raste përdorin forma tejet ndikuese për të shtrembëruar informacionin apo çështjen, duke pohuar, mohuar apo ndryshuar, me qëllim që të merret vendim administrativ, pedagogjik, ose për të shpikur qëndrim politik, ekonomik, shoqëror ose për të justifikuar betejat dhe fillimin e luftërave.

Në nivel vendor dhe botëror, vërehet se zgjerimi në përdorimin e mjeteve të informimit, komunikimit dhe lidhjeve ishte në llogari të tkurrjes së qartë të pozitës së familjes dhe shkollës. Këto dy institucione ishin institucione tradicionale të cilat kryenin detyrën e edukimit, orientimit, ndryshimit, arsimimit dhe përgatitjen e tyre për përgjegjësitë e jetës. Familja e cila përkujdesej për detyrat themelore edukative, ku fëmijët rriteshin duke bashkëvepruar dhe komunikuar, dhe ku zhvillohej sjellja psikologjike dhe shoqërore, ajo -në të shumtën e rasteve- nuk posedon mundësitë për këtë bashkëveprim. Jo vetëm të vegjlit janë të preokupuar me mjetet e komunikimit dhe ndjekjen e rrjeteve sociale, por edhe vetë të rriturit dhe pleqtë. Mjetet e informimit, përmes së cilave jepen informacionet, nuk janë të kufizuara në një numër të vogël të mjeteve, e as në një kohë të caktuar, por këto mjete janë të shumta dhe japin informacione pandërprerë, gjë e cila ka ndryshuar normat e jetës shoqërore. Ka ndryshuar vlerat, kriteret e sjelljes dhe ka

sjellë një ambient kulturor, shoqëror dhe pedagogjik, ndryshe dhe alternativë nga çdo ambient tjetër.

Mjetet e informimit janë bërë objekt i shumë studimeve dhe hulumtimeve. Kështu p.sh. ka studime të cilat janë përpjekur të mësojnë numrin e orëve që kalojnë fëmijët në përdorimin e mjeteve të informimit, komunikimit dhe lidhjeve, si dhe raporti i gjithë kësaj me arritjet mësimore dhe edukative, si dhe shëndetin fizik, psikik dhe intelektual.

Po ashtu, janë organizuar konferenca të shumta rreth ndikimit negativ dhe ndikimit pozitiv të mjeteve të informimit dhe lidhjeve në punën pedagogjike, sidomos rrjetet e reja sociale, të cilat ia kanë kaluar për nga ndikimi mjeteve të mëhershme. Shumë prej këtyre studimeve, edhe krahas rreziqeve të mëdha që janë futur shoqëritë, pranojnë vështirësinë e pengimit të përdorimit të këtyre mjeteve. Ato mjaftojnë duke drejtuar disa udhëzime të caktuar për të kufizuar këto rreziqe dhe për të orientuar se si të përdoren këto mjete në mënyrë të dobishme.<sup>697</sup>

Duhet theksuar se mjetet komunikimit social bashkëkohor kanë mundësuar së pari, zgjerimin e komunikimit mes nxënësve dhe mësimdhënësve, së dyti mes administratës shkollore dhe prindërve dhe së treti mes vetë nxënësve. Çështjet edukativo-arsimore kanë një hapësirë të madhe në rrethin e këtij komunikimi, përfshirë: burimet e mësimdhënies dhe mësimnxënies, ndjekjen e mësimit të nxënësve dhe zgjidhjen e problemeve. Me përdorimin e këtyre mjeteve, çështja e komunikimit, nuk është më e kufizuar vetëm me orët mësimore në shkollë, e as me takimet e programuara zyrtare.

Janë të shumta ankesat ndaj pasojave negative të rrjeteve sociale bashkëkohore, në aspektin shoqëror, ekonomik, psikologjik dhe pedagogjik. Është biseduar shumë në

<sup>697</sup> Kemi pasur në posedim disa hulumtime, studime dhe konferenca të cilat janë marrë enkas me pasojat psikologjike dhe pedagogjike të mjeteve informative bashkëkohore. Në këtu vetëm informojmë rreth përpjekjeve që janë bërë në këtë drejtim, pa i grumbulluar dhe analizuar të gjitha. Për këtë rekomandojmë, në veçanti rekomandojmë një studim të pavarur për analizim të studimeve dhe hulumtimeve të paraqitura në konferencat shkencore në shtete arabe, përfshirë: qëllimet e studimeve, metodologjinë hulumtuese të përdorur dhe rezultatet më të rëndësishme.

shoqëritë tona rreth vështirësive të kontrollimit të përdorimit dhe bashkëveprimit me to, sikur të ishte caktim që nuk mund të kthehet. Në realitet, këto mjete u takojnë mjeteve teknike, të cilat njeriu i ka zbuluar gjatë tërë historisë. Gjenerata e ardhshme do të shohin edhe gjëra më të çuditshme se sa ato që po i shohim ne. Sipas përvojës njerëzore, mjetet në esencë janë të gjykuara e jo gjykuese dhe se ndikimi i tyre përcaktohet nga qëllimi dhe mënyra e përdorimit të tyre. Ajo që bie në sy se numri më i madh i hulumtimeve dhe studimeve të huaja që kanë përfshirë përdorimin e këtyre mjeteve në arsim kanë përfshirë ndikimet pozitive, siç janë zgjerimi e komunikimit arsimor, lehtësi i arritjes deri te informacioni, rritja e efikasitetit të arsimit dhe shanset e kreativitetit..., në kohë kur numri më i madh i hulumtimeve dhe studimeve në shtet arabe janë koncentruar rreth rreziqeve të përdorimit të këtyre mjeteve në shëndet, arsim dhe formimin familjar.<sup>698</sup>

Shembujt janë të shumtë rreth qëndrimit pozitiv të ndikimit të mjeteve të komunikimit. Prej këtyre është edhe studimi i cili ka përfshirë analizimin e 662 temave të doktoraturës të cilat kanë përfshirë rrejetet sociale. Të dhënat janë marrë nga baza e të dhënave ProQuest's & These database, për temat universitare amerikane<sup>699</sup>, në mesin e të cilave 29 tema të doktoraturës rreth përdorimit të këtyre mjeteve në arsimin e lartë. Është vërtetuar se ndikimet negative të këtij përdorimi kanë qenë vetëm në dy studime, ku si shkak ishin disa detaje teknike gjatë mënyrës së përdorimit.<sup>700</sup>

<sup>698</sup> Ky është një gjykim kalimthi, të cilit i mungon verifikimi, i bazuar në shikim kalimthi të asaj që e gjejmë nga titujt në gjuhën arabe rreth pasojave të mjeteve të informimit që i kemi hasur në internet. Do të ishte e dobishme të realizohet një studim krahasues për të hulumtuar në këtë çështje.

<sup>699</sup> ProQuest's Dissertation & Theses database.

<sup>700</sup> Është publikuar një Raport rreth këtij studimi në Revistën amerikane "Hulumtimi në arsimin e lartë". Hulumtimin mund ta gjeni në bazën "Qendra e informacioneve për burimet pedagogjike" (Eduvational Resources Information Center – ERIC). Ai është në Revistën:

- Piotrowski, Chris. "Emerging Research on Social Media Use in Education: A Study of Dissertations", Research in Higher Education Journal, Volume 27, Jan. 2015.

Raportin mund ta gjeni në bazën e të dhënave:

- <http://files.eric.ed.gov/fulltext/EJ1056186.pdf>.

## Përmbyllje

Rezultatet e çdo reformimi pedagogjik ndërlidhen me natyrën e punës pedagogjike, gjë që ka nevojë për durim dhe përkushtim derisa të dalin rezultatet. Rezultatet mund të mos dalin në formën e synuar, pos pas kalimit të një gjenerate të tërë. Me rëndësi në këtë çështje është marrja me çështjet e reformimit pedagogjik në mënyrë serioze, reformat të realizohen në mënyrë adekuate, sot para ditës së nesërme. Mësuesi i ardhshëm është ai të cilin e përgatisim sot. Shkolla e ardhshme është ajo që e ndërtojmë sot. Udhëheqësit e pritshëm janë ata që ulen në bankat e shkollës sot.

Po, rezultatet e reformave pedagogjike kanë nevojë për një gjeneratë të plotë që të realizohen kërkesat. Bazament i këtyre kërkesave është përgatitja e mësuesve, bartës të mesazhit reformues, të cilët janë të dalluar në cilësi dhe arritje pedagogjike. Me siguri se sistemet administrative, të cilat besojnë në mesazhin e reformimit do ta lehtësojnë shumë detyrën e përgatitjes së këtyre mësuesve dhe do të përdorin resurset e nevojshme për ndërtimin e “kulturës së reformimit pedagogjik”, në të cilin marrin pjesë gjitha shtresat e shoqërisë. Sigurimi i këtyre kërkesave është bërë nevojë e padiskutueshme e planifikimit për zhvillim dhe reformim. Pedagogjia në shoqëri është çështje universale, ku zhvillimi kërkon bashkëveprim me të në cilësinë e një çështje të përgjithshme që ndërlidhet me çështjet tjera kulturore, ekonomike dhe politike.

Sferat e reformimit dhe planet e tyre zhvillimore ngërthejnë arsimin shkollor dhe arsimin universitar si dy çështje që përplotësojnë njëra tjetrën dhe nuk mund të ndahen mes veti. Duhet pasur një bashkëveprim mes gjitha qarqeve kryesore pedagogjike: edukimi familjar, arsimit shkollor, mjetet e informimit, komunikimit dhe lidhjes, si dhe rrethi social. Me rëndësi në të gjitha këto raste është që në programet mësimore, të sigurohen mundësi që nxënësi të përfiton njohuri, shkathësi dhe vlera, të cilat përforcojnë përkatësinë e tij ndaj shoqërisë, mburrjen me identitetin e tij,

veprim për dobinë e shoqërisë, duke mbushur kërkesat dhe duke kontribuar në zhvillimin dhe përparimin e saj.

Në këtë kapitull folëm për konceptin “vetëdija e realitetit pedagogjik” dhe domosdoshmërinë e zhvillimit të tij në Botën Islame. Vërtetojmë edhe një herë këtu se zhvillimi i mendimit pedagogjik sipas vizionit islam ngrihet mbi themelin e vetëdijes në konceptin e “umeti-popullata islame”, unitetin dhe detyrat e tij civilizuese për ndërtimin e modelit islam për përparim njerëzor dhe përgjegjësinë e saj morale për udhëzimin e civilizimit njerëzor me vlerat e të së vërtetës, mirësinë dhe paqen.

Ky zhvillim kërkon rikthimin në shkencat e këtij umeti dhe çështjet që përforcojnë përkatësinë ndaj tij (feja, gjuha dhe historia). Duhet bërë përmirësimin e problemeve nga të cilat vuan të kuptuarit tonë ndaj pozitës së burimeve të njohurisë pedagogjike bashkëkohore. Këtu duhet përfshirë: ajetet kur'anore, sunetin pejgamberik, përvojën e trashëgimisë islame dhe përvojën pedagogjike “perëndimore” bashkëkohore. E gjithë kjo, krahas inspirimit të vlerave që ajetet kur'anore dhe suneti pejgamberik kanë insistuar themelimin e tyre në veprimin pedagogjik, duke i përdorur këto vlera në praktikën pedagogjike dhe duka pasur besim në fuqinë e umetit për tejkalimin e problemeve të realitetit pedagogjik, atëherë kur sigurohet vullneti i prerë dhe drejtimi adekuat. Po ashtu duhet pasur parasysh që intencat pedagogjike të jenë prioritare, e jo mjetet, ngase kështu do të çregullohen çështjet dhe vizioni do të jetë i paqartë.

Nuk ka alternativë tjetër, pos ngritjes në nivel të sfidimit dhe posedimit të vetëbesimit. Kjo nënkupton të kuptojmë burimet tona, thithjen e përvojës njerëzore dhe kuptimin e natyrës së realitetit në të cilin jemi duke jetuar. Bazuar në gjithë këtë, duhet realizuar alternativat e përshtatshme kreative, me qëllim të tejkalimit të pengesave të prapambetjes dhe dobësisë, si dhe kontributit për udhëzimin e civilizimit njerëzor dhe prezencës efikase në realitetin botëror.

Mendimi pedagogjik në botë sot, nga pedagogët muslimanë nuk pret rekomandime që ua ofrojnë të tjerëve. Bota, në rend të parë Perëndimi, i cili sot ka ndikim më të madh në këtë botë, nuk ka nevojë, e as nuk dëshiron “të dëgjojë” propozime dhe rekomandime për trajtimin e problemeve të tij, por është gati “të shoh” një gjendje pedagogjike reale në një shtet islam, i cili në brendinë e tij nuk ka çrregullime, anarki dhe hutim. Vetëm në këtë rast, Perëndimi do të meditojë dhe do të koncentrohet shumë për të kuptuar se në brendinë e tij paska shumë sëmundje që mund të trajtohen sipas modelit të këtij rasti.

Po, nëse pedagogët muslimanë nuk kuptojnë domosdoshmërinë për të kontribuar në reformat pedagogjike në nivel të Botës, atëherë e drejtë e njerëzve në këtë botë është të pyesin për shkaqet e mungesës së këtij kontributi dhe domosdoshmërinë e prezencës së tij. Civilizimi bashkëkohor njerëzor ka shumë pozitive dhe negative, gjë që e vë në një pozicion për nevojë të madhe për prezencën islame ku do të kontribuon për udhëzimin e tij. hapësira e botës sot është e hapur për të gjithë. E mira dhe e keqja në cilindo vend të botës, shumë shpejt përhapet edhe në vendet tjera. Ndoshta çështja e “njohjes së anijes” nuk është e veçantë për një popull të caktuar, ngase e gjithë bota është një anije. Secili popull duhet të kontribuojë me efikasitet që anija të arrijë në tokë e sigurt. Këtu, pikërisht, shihet rëndësia dhe roli i prezencës së “kapitenit pedagogjik musliman” i cili bartë busullën kur’anore, për të marrë drejtimin dhe rrugën e duhur.<sup>701</sup>

<sup>701</sup> Me shprehjen “njohje e anijes” sinjalizojmë në hadithin peygamberik të cilin e transmeton Buhariu në Sahihun e tij nga Numan ibn Beshiri r.a. nga Muhammedi alejh’is-selam se ka thënë: “Shembulli i atij që zbaton ligjet e Allahut dhe atij që nuk zbaton është sikur shembulli i një grupi njerëzish të cilët kanë hipur në anije duke hedhur short mes veti. Disa prej tyre janë vendosur lartë, e disa tjerë poshtë. Ata të cilët ishin poshtë, kur u duhej ujë kalonin pranë atyre që ishin lart. Ata thanë: Sikur të hapnim një vrimë poshtë e mos të dëmtojmë ata që janë lart. Nëse i lënë të veprojnë një gjë të tillë, do të fundosen të gjithë, po nëse i ndalojnë nga ky veprim, do të shpëtojnë të gjithë”. Shih: El-Buhari, *Sahih’ul-Buhari*, vepër e cituar, hadithi nr. 2493, fq. 471.



## Përfundimi

Në këtë libër është theksuar disa herë, se ata të cilët shkruajnë rreth mendimit pedagogjik bashkëkohor islam ndahen në tre grupe.

Grupi i parë: ata të cilët shkruajnë rreth mendimit pedagogjik ashtu siç e shohin në Kur'an dhe sunet.

Grupi i dytë: ata të cilët shkruajnë rreth mendimit pedagogjik sipas kontekstit të tij historik.

Grupi i tretë: ata të cilët shkruajnë në shkrimet bashkëkohore rreth parimeve të njohura pedagogjike, me qëllim që të sqarojnë se janë origjinale në udhëzimet islame dhe se Islami është i pari që i ka zbuluar dhe ka ftuar në to.

Pjesa më e madhe e asaj që gjendet në shkrimet *e grupit të parë* ka të bënë me shfrytëzimin e ajeteve kur'anore dhe sunetit pejgamberik rreth sqarimit të vlerës së diturisë dhe dijetarëve në kotë botë dhe në Ahiret, nxitjen për kërkimin e diturisë dhe mësimin të tjerëve në fushat e farzit ajn dhe farzit kifaje. Mirëpo, në të shumtën e rasteve, në detajime, nuk e përfshin përvojën bashkëkohore pedagogjike, sasinë e presioneve që e ushtron ndaj realitetit jetik, nevojën për praktikimin e metodave të përshtatshme për bashkëveprim me te dhe zhvillimin e programeve dhe metodologjive alternative.

Për *grupin e dytë* kemi thënë se trashëgimia pedagogjike islame ishte mendim që e kishin ofruar dijetarët islamë gjatë kohëve të ndryshme, janë përpjekur për të kuptuar intencat pedagogjike në Islam dhe kanë folur rreth asaj që e kanë parë të arsyeshme për realizimin e këtyre intencave. Në mesin e këtyre dijetarëve, nuk ka pasur asnjë që ka qenë i pagabuar në ixhtihadin e tij dhe padyshim se ata ia kanë qëlluar, por edhe kanë gabuar. Megjithatë, ne nuk kemi të drejtë, këtë trashëgimi, e cila është shkruar në rrethana të caktuara të kohës dhe përvojave, ta gjykojmë me kriteret e kohës sonë dhe përvojat tona bashkëkohore. Detyra jonë sot është të

formojmë mendimin bashkëkohor pedagogjik bashkëkohor, ashtu siç kanë formuar dijetarët e mëhershëm mendimin e tyre për kohën e tyre. Ashtu, siç kanë marrë ata nga burimet që i kishin në disponim, edhe ne jemi të detyruar të marrim nga burimet e njëjta: Kur'ani Famëlartë, suneti pejgamberik, trashëgiminë e kultivuar nga ata që ishin para tyre dhe përvojën bashkëkohore të tyre.

Sa i përket *grupit të tretë*, ata ngrenë lart vlerën e parimeve dominuese në praktikat bashkëkohore pedagogjike. Ata për referencë të këtyre parimeve, argumentojnë me mendime të mendimtarëve dhe filozofëve joislamë dhe me praktika të shoqërive joislame. Më pas, për këto parime, si referencë sjellin ajete nga Kur'ani dhe suneti pejgamberik, dhe në disa raste praktika të cilat i kanë njohur shoqëritë islame gjatë periudhave të ndryshme të zhvillimit të tyre. Këtu kemi një lloj krahasimi apo përafrimi, i cili nuk është më shumë se vazhdim i imitimit dhe tjetërsim i përvojës së huaj.

Në parathënien dhe kapitullin e parë të këtij libri në mënyrë të detajuar kemi folur rreth domosdoshmërisë së dallimit mes mendimit pedagogjik islam në kontekstin e kohës në të cilën jemi duke jetuar dhe trashëgimisë pedagogjike islame, e cila ishte mendim pedagogjik islam për kohën që ishte. Si justifikim për këtë çështje ishte se shumë prej shkrimeve bashkëkohore të cilat bartin titujt, si: Mendimi pedagogjik islam, Pedagogjia islame, Pedagogjia në Islam e tjera, ata në realitet flasin rreth trashëgimisë pedagogjike në kontekstin e saj historik. Mendimtarët muslimanë kanë folur për aspektet të ndritshme në këtë trashëgimi, qoftë edhe për nga krenaria, vërtetimi i identitetit, sqarimi i kontributit të muslimanëve në civilizimin njerëzor gjatë periudhave të kaluara etj. Me siguri se në këtë trashëgimi ka gjëra të dobishme, për të bindur popullatën islame rreth vlerës së trashëgimisë, por kjo nuk do të ndihmojë në përpjekjet tona për ngritjen e civilizimit të synuar, si dhe prezencën në arenën e botës bashkëkohore.

Ajo që ndihmon është formimi i mendimit bashkëkohor, praktikat e së cilës ndërliidhen me realitetin aktual sot, me

qëllim që njerëzit ta shohin të gjallë në programet, institucionet dhe praktikat, njerëzit ta shohin të manifestuar në gjeneratat e të diplomuarve në këtë mendim, i cili cilësohet me pastërti dhe moral, ashtu siç cilësohet me kreativitet dhe zbulim. Përmes këtyre personave. Njerëzit do të kuptojnë vlerën e tij dhe nevojën për të. Ky mendim bashkëkohor pedagogjik islam, nuk është domosdoshmëri vetëm për shoqëritë islame, por është domosdoshmëri njerëzore, përmes së cilit, mendimtarët muslimanë do të kontribuojnë në pasurimin dhe udhëzimin e civilizimit bashkëkohor njerëzor.

Çdo bisedë rreth pedagogjisë apo mendimit pedagogjik është bisedë rreth vetive të gjeneratës së cilës dëshirojmë ta formojmë. Andaj është bisedë rreth një të ardhme më të mirë. Pra, është bisedë rreth ndryshimit të synuar në realitetin e individit, i cili do të përfundojë në realizimin e ndryshimit në realitetin e shoqërisë dhe umetit.

Përpyekjet tona për zhvillimin e shoqërive tona, imponojnë që gjendjes bashkëkohore pedagogjike t'i kushtohet një kujdes i merituar, me qëllim që të dihet se çka duhet bërë pedagogët reformistë për të zhvilluar realitetin pedagogjik në këto shoqëri. Duke marrë parasysh gjendjen e shoqërive bashkëkohore njerëzore, ku janë përfshirë nga globalizmi, si dhe gjendjen e prapambetur të shoqërive islame, ne nuk posedojmë diç tjetër, pos të fillojmë nga gjendja reale që jemi. Përvoja bashkëkohore pedagogjike njerëzore në sferën e edukimit dhe arsimit është pikënisja nga e cila fillojmë përpyekjet tona për formimin e mendimit pedagogjik bashkëkohor islam. Fillojmë duke diagnostifikuar simptomat, duke bërë hulumtim të thellë në shkaqet dhe përpyekjet për ofrimin e zgjidhjeve dhe alternativave. E gjithë kjo duhet të jetë në dritën e vizionit islam, duke u mbështetur në Kur'anin Famëlartë dhe sunetin peygamberik.

Lexuesi ka vërejtur se kemi përsëritur disa herë trashëgiminë pedagogjike islame dhe përvojën bashkëkohore pedagogjike, ngase secila prej tyre është burim i rëndësishëm i mendimit pedagogjik bashkëkohor islam. Mirëpo, asnjërën

prej tyre nuk e llogarisim si referencë për gjykim dhe vlerësim, ngase secila prej tyre ka detyrë ndryshe nga detyra e tjetrës. Trashëgimia pedagogjike është përpjekje dhe ixhtihad i dijetarëve muslimanë në periudha të ndryshme të historisë islame për të zbritur dispozitat dhe udhëzimet në çështjet që e kanë parë të arsyeshme këta dijetarë në kohën dhe rrethanat e tyre. Nuk ka dyshim se kjo përpjekje dhe ixhtihad do të na sjell dobi në përpjekjet tona për kohën dhe rrethanat tona. Sa i përket përvojës bashkëkohore njerëzore, ajo është realitet aktual, ku deshëm apo jo, do të duhet të bashkëveprojmë me të! Përpjekjet për reforma pedagogjike në realitetin aktual nuk mund të fillojnë përpos nga kjo përvojë pedagogjike. Andaj, le të fillojmë nga ajo dhe për te, rreth çështjeve të nevojshme për reformim dhe ndryshim.

Edhe pse përvoja pedagogjike bashkëkohore është përvojë e "globalizuar" që dominon në pjesën dërrmuese të botës dhe është një ngarkesë e rëndë, ku për shkak të marrëveshjeve ndërkombëtare, para saj nënshtrohen popujt, megjithatë, rruga nuk është e mbyllur tërësisht, globalizmi pedagogjik, nuk është caktim (kader) që nuk mund të kthehet, bile mund të jetë shans për të vërtetuar mendimi pedagogjik islam praninë e tij efikase në trajtimin e shumë problemeve rreth asaj që thuhet krizë pedagogjike botërore. Ekziston edhe një çështje tjetër. Ajo është se bashkëveprimi i urtë dhe i vetëdijshëm me këtë përvojë njerëzore do t'na jep mundësinë për të zbuluar disa elemente pozitive, të cilat mund të jenë më të mirat në arritjet tona gjatë përpjekjeve tona bashkëkohore islame. Në fushën e edukatës dhe arsimit, përvoja njerëzore bashkëkohore ka arritur deri te disa parime, të cilat pedagogu bashkëkohor musliman nuk sheh pengesë për miratimin e tyre. Jo se janë përvojë e shteteve të përparuara, e as se janë të imponuara ose të pranuar ndërkombëtarisht dhe nuk ka shans të refuzohen, e as se hulumtimet tona rreth teksteve islame i pranojnë ato dhe ne i kemi zbuluar..., por sepse këto parime vetvetiu janë të sakta.

Prej parimeve të pranuar në përvojën bashkëkohore pedagogjike -p.sh.- është edhe ajo se edukimi dhe arsimimi

është e drejtë e çdo individi në shoqëri. Ai ka për obligim të arsimohet, ngase arsimimi nënkupton jetën dhe vazhdon sa të vazhdojë jeta. Nëse duhet të bëjmë dallimin mes edukatës dhe arsimit, atëherë edukata vjen së bashku me arsimin, por i paraprinë për nga rëndësia. Në procesin mësimor, ekzistojnë dallimet individuale, ku secili ka kapacitetet e tij vetjake. Arsimi ka nevojë për mbështetje, ndërsa nxënësi është epiqendra e procesit mësimor. Qëllimi i arsimit është formimi i personalitetit të ekuilibruar të nxënësit. Njohja psikologjike është bazamenti i punës pedagogjike, si dhe parime tjera.

Duhet potencuar edhe atë se përvoja pedagogjike bashkëkohore posedon disa elemente tjera, të cilat janë më të këqijat që ka mundur të arrijë përvoja e njeriut. Këtu nuk duhet luhatur për t'u liruar prej tyre. Shembuj për këtë çështje kemi si: përqendrimi në përmasat materiale të jetës, anashkalimi i përmasës shpirtërore, admirimin e kombëtarizmit dhe atdhetarizmit si çështje qendrore, anashkalimi i dimensionit human të njeriut, interesimi i madh për shkencat natyrore dhe teknike dhe interesimi i ulët për rëndësinë e shkencave shoqërore dhe humane, nxitja e mësimin të përbashkët mes dy gjinive në të gjitha fazat e arsimit, ulja e nivelit të kriterëve morale, si dhe parime dhe praktika tjera.

Nuk është me rëndësi pranimi i disa parimeve apo refuzimi i tyre në mënyrë selektive dhe të rastit, por me rëndësi është që pranimi apo refuzimi të jetë në kuadër të një vizioni të kompletuar, ku përvojën njerëzore e bënë pjesë të këtij vizioni dhe origjinalen e llogarit si alternativë të asaj që refuzohet, duke sqaruar pikat e dobëta dhe rreziqet. Kështu, do të formohen modele të mendimit pedagogjik islam dhe praktika pedagogjike islame, në të cilat popujt tjerë do të shohin vlerën dhe tërheqjen, që i bënë ata të bashkëveprojnë pozitivisht dhe ndoshta do të marrin prej tyre, nga fakti se janë më të mirat që ka arritur përvoja njerëzore.

Në këtë libër, kemi folur rreth filozofive tradicionale dhe të reja pedagogjike, të cilat i ka njohur historia e mendimit pedagogjik dhe i njeh koha moderne. Theksuam pikëpamjet e

ndryshme që ofrojnë këto filozofi rreth procesit të mësimnxënies dhe mësimdhënies dhe ngjyrimin civilizues të shoqërisë që dëshirojnë. Nëse dëshirojmë të zhvillojmë mendimin tonë ndaj filozofisë pedagogjike islame bashkëkohore, me rëndësi është të nxjerrim këto parime pedagogjike, të cilat i ngërthen kjo filozofi së bashku me praktikat e tyre. Këto parime, nuk janë vetëm përpilime të thjeshta teorike, por janë bazament i praktikës pedagogjike në të gjitha nivelet e punës pedagogjike. Ekzistojnë parime të përgjithshme të cilat merren me edukimin e individit-njeriut, siç janë p.sh.: parimi i të drejtës për arsim, parimi i gjithëpërfshirjes për meshkujt dhe femrat, parimi i mësimin gjatë tërë jetës etj. Ka parime që janë të veçanta për sistemin e përgjithshëm arsimor, i cili cakton moshën e fillimit të mësimin dhe nivelet mësimore. Nevojat e secilës fazë për llojet dhe temat arsimore, mënyrat e menaxhimit dhe financimit etj. ka parime që përcaktojnë pozicionin e qarqeve dhe institucioneve që marrin pjesë në procesin edukativ si: familja, shkolla dhe institucionet tjera shoqërore. Ka parime që përcaktojnë përmbytjet për të cilat ka nevojë individit në formimin e tij si: dimensionin intelektual, fizik, psikologjik, shoqëror e tjera, ose përmbytjet mësimore për nga aspekti natyror, human, shoqëror, fetar e tjera, ose metodat mësimore etj. Ekzistojnë disa mënyra, ku në bazë të disa kriterëve, bëhet hulumtimi dhe klasifikimi i parimeve pedagogjike.

Kjo nënkupton se filozofia pedagogjike dhe parimet e nxjerra nga to janë korniza e përgjithshme e gjithë sistemit pedagogjik, përfshirë formulimin e tij ideologjik dhe zbatimin e tij praktik. Formimi i sistemit të synuar pedagogjik islam në përpjekjet tona reformuese imponon studimin e përvojës njerëzore që është në disponim. Këtu përfshihen referencat e këtyre filozofive dhe parimeve, si dhe degët shkencore të specializuara të cilat i ngërthen në fushën e edukatës dhe arsimit, si p.sh.: metodologjinë, metodat mësimore, dokimologjinë, menaxhimin, financimin etj. Këtu duhet potencuar edhe një herë se mendimi pedagogjik

bashkëkohor islam, të cilin përpiqemi të zhvillojmë, nuk përkufizohet vetëm në përgatitjen e një lënde rreth këtij mendimi ku do të përfshihen: konceptet, burimet, intencat dhe veçoritë, siç kemi bërë në këtë libër, por mendimi pedagogjik islam duhet të manifestohet në të gjitha lëndët dhe tematikat të cilat përfshihen në shkencat pedagogjike dhe psikologjike. Kjo duhet bërë me qëllim që dimensionin islam në te, të mos jetë lëndë e shtuar, krahas lëndëve tjera ose e njëjtë me to, por me qëllim që mendimi pedagogjik islam të jetë shpirt që është prezent në të gjitha lëndët mësimore, shpreh identitetin dhe veçimin nga njëra anë, ndërsa nga ana tjetër shpreh tërheqjen dhe përshtatshmërinë për trajtimin e problemeve të mendimit pedagogjik njerëzor në botën e ditës së sodit.

Reformimi i mendimit islam, të cilin synojmë ta realizojmë në shoqëritë tona islame, në fushën pedagogjike dhe në të gjitha fushat tjera, për pikënisje ka vizionin ndaj botës të cilin e ofron Kur'ani Famëlartë. Nga ky vizion kuptojmë vizionin pedagogjik, të cilin e ka sqaruar në mënyrë të detajuar jeta e Muhammedit alejh'is-salam. Nga ky vizion kanë lindur programe pedagogjike me qëllime, përmbajtje, mjete dhe metoda. Ky vizion përfaqëson një filozofi të re, e cila ripërtërihet sa më shumë të kuptojmë intencat e Kur'anit dhe sunetit peygamberik. Ky vizion, në çdo kohë zbulon diç nga natyra e botës **natyrore**, përfshirë: materien, dukuritë dhe ngjarjet. Sipas këtij vizioni mësojmë rreth botës **shoqërore**, përfshirë: popujt, kulturën, gjuhët, civilizimet dhe raportet e tyre. Sipas tij, njohim botën **psikologjike**, përfshirë: ndjenjat, shpresat, dhembjet, përmallimet dhe synimet. Vizioni ndaj botës dhe pikëpamjet pedagogjike që i ofron, vazhdon të jetë burim për ripërtëritjen e mendimit tonë ndaj universit, në dritën e asaj që arrijnë ta zbulojnë shkencat dhe përvojat njerëzore, të cilat i përfitojmë nga edukata dhe arsimit. Fuqia jonë për bashkëveprim me universin, zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme, në atë mënyrë që realizon civilizimin dhe përparimin njerëzor, si dhe hilafetin (mëkëmbësinë) që Allahu ia dëshiroi njeriut për jetën e tij në këtë botë.

Sferat e përparimit dhe civilizimit njerëzor, sipas vizionit kur'anor ndaj botës, janë shumë të gjëra për të përfshirë përparimin **material** në prodhimin industrial dhe bujqësor, përparimin e sistemeve dhe formimit **shoqëror** në drejtësi, liri, dinjitet, përparimin **psikologjik** si pastrimin shpirtëror dhe ndjenjat etj. Që të gjitha këto, janë qëllime dhe intenca të synuara pedagogjike. Këtu përfshihen edhe **institucionet** edukativo-arsimore me të gjitha nivelet, qarqet, programet, planet dhe metodat mësimore. Institucionet janë ambienti në të cilin realizohet komunikimi dhe zhvillimi i përvojës njerëzore përgjatë gjeneratave. Këto përvoja këmbehen dhe bashkëveprohen mes popujve, dhe atë në sfera të ndryshme të përparimit dhe civilizimit.

Përmes reformave pedagogjike, synojmë të realizojmë një sistem pedagogjik, i cili mundëson ngritjen civilizuese të popullatës islame dhe i jep mundësi për pjesëmarrje aktive në botën bashkëkohore. Në këtë libër, theksuam referencat në të cilat mbështeten sistemet pedagogjike bashkëkohore. Sqaruar se reformat pedagogjike, të cilat i synojmë, për pikënisje kanë referencën islame, e cila popullatës islame ia cakton veçoritë dhe identitetin. E gjithë kjo, me qëllim që të kemi mundësi që procedurat dhe mjetet t'i vëmë në shërbim të përpjekjeve reformiste në dritën e kësaj reference, përfshirë shpirtin dhe vlerat e saj. Atëherë, kur kjo referencë është e pranishme në përpjekjet e reformistëve dhe mbrojtëse e vlerave civilizuese të umetit, nuk ka asnjë pengesë të përfitohet edhe nga mjetet e ngritjes civilizuese, të cilat kanë qenë të dobishme në shoqëritë tjera.

Shpresojmë që lexuesi i këtij libri, të hasë në shembuj rreth metodologjisë përplotësuese njohëse, të cilën kujdesemi ta praktikojmë gjatë shkrimeve tona. Kemi qenë të kujdesshëm ta praktikojmë këtë metodologji gjatë shtatë kapitujve të këtij libri, duke bërë grumbullimin përplotësues mes konceptit, burimeve, intencave, veçorive dhe tematikave të mendimit pedagogjik islam. Kemi qenë të kujdesshëm që elementet e secilit kapitull të shpalosin këtë përplotësim, paraqitja e temave të përfshijë: përshkrimin, komentimin, analizimin



dhe kritikata e nevojshme, si dhe të përfshijë dimensionin kohor, për të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen. Libri është përmbyllur me një kapitull ku është bërë përpjekje për diagnostifikimin e realitetit aktual dhe propozimet për zgjidhjet e synuara.

Krejt në fund, ky libër nuk ka thënë fjalën e prerë rreth asaj që kemi nevojë në zhvillimin e mendimit pedagogjik bashkëkohor islam, por është një përpjekje, ku shpresojmë se ka shtuar diçka të dobishme në shkrimet ekzistuese, duke insistuar për shkrime tjera të detajuara rreth tematikave të shkencave të ndryshme pedagogjike dhe psikologjike, në atë mënyrë që këto tema tematika të ngopen me shpirtin e mendimit pedagogjik islam dhe të kontribuojnë në reformimin e synuar pedagogjik për ngritje të përgjithshme civilizuese islame.

Prej Allahut kërkojmë sukses në punë dhe këmbëngulje në veprime.

Falënderimi i takon vetëm Allahut, Zotit të botëve.

## TREGUESI

**Treguesi emëror**

**Treguesi tematik**

# Burimet dhe literatura

## Në gjuhën arabe:

1. El-Axhurri, Ebu Bekr Muhamed ibn El-Husejn (vd. 360 h./971). Ahlak'ul-Ulemai (Morali i dijetarëve), Riad: Riasetu idarat'il-buhuth'il-ilmijjeti ve'l-iftai ve'd- da'veti ve'l-irshadi, (1398 h./1978).
2. Ibn'ul-Ethir, Ebu's-Seadat Mexhduddin Muhamed ibn Muhamed El-Xhezeri (vd. 606 h./1209). En-Nihajetu fi garib'il-hadithi ve'l-etheri, Demmam-Saudi: Daru ibn Xhezeri, 1421 h.
3. Ahmed, Mehdi Rizkullah & Shedi, Adil ibn Ali. El-Kijem'ul-islamijetu fi siretin nebevijetin (Vlerat islame në jetëshkrimin pejgamberik), Riad: Xhamiat'ul-Melik Saud, bot. 1. 2012.
4. Edib, Semir. Merhalet'ut-ta'lim'il-ali fi misre'l-kadimeti: Dur'ul-hajati (Periudha e arsimit të lartë në Egjiptin e vjetër: Shtëpitë e jetës), Kajro: El-Arabi li'n-neshri ve't-tevzi'i, 1990.
5. El-Urxhuvani, Hamza Ebu Faris. "Mekasid'ush-sheriatu ve ahdafuha ve kefijjetu tef'iliha fi'l-menahixh'id-dirasijeh", Mexhel-letu Usul'id-din, El-Xhamiat'ul-Esmerijet'ul-islamijeh – Libi, nr. 2, 2018.
6. Ismaili, Azad Ali. Ed-Dinu ve's-Sihat'un-Nefsijetu (Feja dhe shëndeti psikik), Herndon: El-Ma'had'ul-alemijju li'l-fikr'il-islamij, 2014.
7. Egros, Robert. Stansijo, Xhorxh. El-Ilmu fi mendhurih'il-xhedidi (Shkenca në pikëpamjen e re), Përkthyes: Kemal Halajli, Kuvajt: El-Mexhli's-ul-vatanijju li'th-thekafeti ve'l-fununi ve'l-adabi. Janar 1978.
8. El-Albani, Muhamed Nasirudin. Sahih'ul-Xhami'is-sagiri ve zijadatuhu (el-Fet'h'ul-Kebiru), Damask: El-Mekteb'ul-islamijju, bot. 3, 1408 h./1988.
9. El-Enbari, Ebu'l-Berekat Kemaluddin ibn Abdurrahman (vd. 577 h./1181). Nez'het'ul-Elbai fi tabakat'il-udebai, Zerka: Mektebet'ul-Menar, 1985.
10. El-Ehvani, Ahmed Fuad. Et-Terbijjetu fi'l-islami (Edukata në Islam), Kajro: Dar'ul-Mearif bi Misre, 1967.
11. El-Ixhi, Ebu'l-Fadli Adududdin Abdurrahman ibn Ahmed ibn Abdulgaffar (v. 756 h./1355). El-Mevakifu fi ilm'il-kelami (Qëndrimet mbi shkencën e apologetikës), Kajro: Mektebet'ul-Mutenebbi (pa vit botimi).
12. Ibn Baxhe, Muhamed ibn Baxhe El-Endelusi (vd. 533 h./1139). Kitab'un-Nefsi (Libri mbi shpirtin), Damask: El-Mexhme'ul-ilmij'ul-arabijju, 1960.
13. Bakir, Taha. Mukaddimetun fi tarah'il-hadaret'il-kadimeti (Hyrje në historinë e civilizimeve të vjetra), Bagdad & Bejrut: Dar'ul-Verrak, 2009.

14. El-Buhari, Ebu Abdullah Muhamed ibn Ismail (vd. 256 h./870). Sa-hih'ul-Buhari, Riad: Bejt'ul-efkar'id-devlijeh, bot. 1, 1998.
15. El-Bikai, Burhanudin Ibrahim ibn Omer ibn Ibrahim Es-Sevbini El-Bikai (vd. 885 h./1480). Nudhum'ud-dureri fi tenasub'il-ajati ve's-suveri, Riad: Dar'ul-kitab'il-islamijj, 1984.
16. Blankenshib, Halid. "El-Islamu ve't-tarih'ul-alemijju: Nahve taksimn xhedidin li'l-usur'il-kadimeti", Mexhel-letu islamijjet'il-ma'rifeti, viti 1, nr. 1, (Muharrem 1416 h./Qershor 1995).
17. Ibn Budhunejne, Omer. "Et-Terbijjet'ul-vixhdanijjetu min mendhurin islamijjin mukarene", (Temë doktrature, Fakulteti i Usuludinit, Univer-siteti e Emirit Abdulkadir për shkencat islame, Kosantina/ Algeri, 2017.
18. Buluz, Muhamed. "Mekasid'ush-sheriatu ve ahdafuha ve kefijjetu te'filiha fi'l-menahixh'id-dirasijjeti", Mexhel-letu Usuliddin, El-Xhamiat'ul-Esmerijjet'ul-islamijjetu – Libi, nr. 2, 2017.
19. El-Bejheki, El-Hafidh Ebu Bekr Ahmed ibn El Husejn ibn Ali (vd. 458 h./1066). El-Xhamiu li shu'b'il-imani (Përmbledhësi i degëve të besimit), Riad: Mektebet'ur-Rushdi, 2003.
20. El-Bejheki, El-Hafidh Ebu Bekr Ahmed ibn El-Husejn ibn Ali (vd. 458 h./1066). Es-Sunen'ul-Kubra, Bejrut: Dar'ul-kutub'il-ilmijeh, (1424 h./2003), hadithi nr. 12847.
21. Et-Turkavi, Kinda Hamid. Et-Terbijjet'ul-iktisadijetu fi'l-islami ve ehemijjetuha li'n-nesh'il-xhedidi (Edukata ekonomike në Islam dhe rëndësia e saj për të rinjtë), (pa vend botimi): Daru ihjai lin-neshr'il-elektroni, 2010.
22. Et-Tirmidhi, Ebu Isa Muhamed ibn Isa ibn Sura (vd. 279 h./892). Xha-mi'ut-Tirmidhi, Riad: Bejt'ul-efkar'id-devlijeh, bot. 1, 1999.
23. Ibn Temim Et-Temimi, Ebu'l-Arab Muhamed ibn Ahmed El-Magribi El-Ifriki (v. 333 h./945). Tabakatu ulemai Ifrikija ve kitabu tabakati ulemai Tunuse, Bejrut: Dar'ul-kitab'il-Lubnani, 1970.
24. Toynbee, Arnold. Muhtesar diraset'it-tarihi, përkthyes: Fuad Muhamed Shibl, Kajro: El-Merkez'ul-Kavm'i-li't-terxhemeti, 2011.
25. Ibn Tejmije, Tekijuddin Ebu'l-Abbas Ahmed ibn Abdulhalim ibn Tejmi-je El-Harrani (vd. 728 h./1328). Tezkijet'un-Nefsi, Riad: Dar'ul-muslim, bot. 1, (1415 h./1994).
26. Ibn Tejmije, Tekijuddin Ebu'l-Abbas Ahmed ibn Abdulhalim ibn Tejmi-je El-Harrani (vd. 728 h./1328). Dekaik'ut-Tefsiri: El-Xhamiu li tefsir'il-Imam Ibn Tejmije, Damask: Muessesetu ulum'il-Kur'ani, bot. 2, 1984.
27. Ibn Tejmije, Tekijuddin Ebu'l-Abbas Ahmed ibn Abdulhalim ibn Tejmi-je El-Harrani (vd. 728 h./1328). Er-Rredu ala'l-mantikijjine (Nasihatu ehl'il-imani fi'r-rredi ala mantik'il-Junan), Bejrut: Muessesetur Rejan, 2005.

28. Ibn Tejmije, Tekijuddin Ebu'l-Abbas Ahmed ibn Abdulhalim ibn Tejmije El-Harrani (vd. 728 h./1328). Mexhmu'ul-Fetava, El-Mensura: Dar'ul-Vefai, bot. 3, 2005.
29. Ibn Tejmije, Tekijudin Ebul Abas Ahmed ibn Abdulhalim ibn Tejmije el Harrani (vd. 728 h./1328). Mexhmu'ul-Fetava, El-Mensura: Dar'ul-Vefai, vëll. 12, (1426 h./ 2005).
30. El-Xhahidh, Ebu Uthman Amr ibn Behr ibn Mahbub (vd. 255 h./869). El-Bejanu ve't-Tebjinu, Bejrut: Dar'ul-Xhili, (pa vit botimi).
31. El-Xhahidh, Ebu Uthman Amr ibn Behr ibn Mehbub (vd. 255 h./869). Resail'ul-Xhahidhi, Bejrut: Dar'ul-Xhili, 1991.
32. El-Xhurxhani, Abdulkadir ibn Abdurrahman (vd. 474 h./1081). De-lail'ul- I'xhazi, Kajro: Mektebet'ul-Hanxhi, (1404 h./1984).
33. El-Xhelad, Maxhid Zeki (përgatiti dhe redaktoi). El-Behth'ul-ilmijju fi't-Terbijjet'ul-Islamijjeti fi'l-Urduni: Dirasetun tahlilijjetun bibliografije (Hulumtimi shkencor rreth edukatës islame në Jordani), Hernden & Aman: El-Ma'had'ul-alemijju li'l-fikr'il-islamijji & Daru Verd li'n-neshri ve't-tevzi'i, 2011.
34. El-Xhelad, Maxhid. Teal-lum'ul-kijemi ve ta'limiha: tesavvurun nadharrijun ve tatbikijun li taraiki fi istratixhijjati tedris'il-kijemi, Aman: Dar'ul-Mesirah, bot. 3, (1430 h./2010).
35. Xhelo, El Husejn Xherno Mahmud. Esalib'ut-Teshviki ve't-Ta'zizi fi'l-Kur'an'il-Kerimi (Metodat e nxitjes në Kur'ani Famëlartë), Bejrut: Mues-seset'ur-Risaleti & Dar'ul-ulum'il-insanijjeti, (1414 h./1994).
36. El-Xheman, Muhamed ibn Abdulaziz. "Er-Rua ve'l-ahlamu fi hedji's-sunetin nebevijeh", (temë e magjistraturës në Degën e Kulturës islame, Fakulteti Pedagogjik, Universiteti El-Melik Saud, Riad, 1430 h.).
37. El-Xhundi, Abdulhalim. El-Kur'anu ve'l-Menhexh'ul-ilmijj'ul-muasiru (Kur'ani dhe metodologjia shkencore bashkëkohore), Kajro: Dar'ul-Mearif, 1984.
38. Ibn Xhinni, Ebu'l-Fet'hi Uthman (vd. 392 h./1002). El-Hasais, Kajro: El-Mektebet'ul-ilmijeh, 1952.
39. Ibn 'ul Xhevzi, Xhemaludin Ebu'l-Ferexh Abdurrahman ibn Ali ibn El-Xhevzi (vd. 597 h./1201). Ahbar'ul-hamka ve'l-mugafeline, Bejrut: El Mektebut tixhariju, (pa vit botimi).
40. Ibn 'ul Xhevzi, Xhemaludin Ebu'l-Ferexh Abdurrahman ibn Ali ibn El-Xhevzi (vd. 597 h./1201). Siretu Omer ibn Abdulaziz El-Halifet'uz-Zahid, Bejrut: Dar'ul-kutub'il-ilmijeh, bot. 1, 1984.
41. Haxhim, Abdurrezak Husejn. "Ususu kijam'il-medreseti fi bilad'ir-Rafidejni: dirasetun tarihijeh", Mexhel-letu El-Kadisijjeti li'l-ulum'il-insanijeh, vëll. 13, nr. 4, 2010.

42. Haxhi Halife, Mustafa ibn Abdullah El-Kustantini Er-Rumi (vd. 1067 h./1657). Keshf'udh-Dhununi an esam'il-kutubi ve'l-fununi, Bejrut: Daru ihja'it-turath'il-arabiji, (1360 h./1941).
43. El-Hazimi, Halid ibn Hamid. Usul'ut-terbijet'il-islamijeh (Bazat e edukimit islam), Riad: Daru alem'il-kutubi, bot. 1, 2000.
44. Ibn Haxhe El-Hamevi, Tekijudin Ebu Bekr ibn Ali ibn Muhamed (vd. 838 h./1435). Themerat'ul-evraki, Bejrut: El-Mektebet'ul-asrijeh, 2005.
45. Ibn Haxher, El-Hafidhu Ebu'l-Fadli Ahmed ibn Ali El-Askalani (vd. 852 h./1448). Fet'h'ul-Bari bi sherhi Sahih'il-imami Ebi Abdil-lah Muhamed ibn Ismail El-Buhari, Riad: El-Muhakkik, 2001.
46. Ibn Haxher, El-Hafidhu Ebu'l-Fadli Ahmed ibn Ali El-Askalani (vd. 852 h./1448). Fet'h'ul-Bari bi sherhi Sahih'il-imami Ebi Abdil-lah Muhamed ibn Ismail El-Buhari, Riad: Daru Tajbete, 2005.
47. Ibn Hazm, Ebu Muhamed Ali ibn Ahmed ibn Seid (vd. 456 h./1064). Resailu ibn Hazm El-Endelusi, Bejrut: El-Muesseset'ul-arabijetu li'd-dirasati ve'n-neshri, bot. 1, 1983.
48. Hasan, Muhamed Halife. Tarih'ud-dijanet'il-jehudijeh (Historia e fesë hebreje), Kajro: Dar'uth-Thekafet'il-Arabijeti, 2002.
49. Hattab, Kemal. "Et-Ta'lim'ul-iktisadijjetu fi sunetin nebevijeh", kumtesë e paraqitur në Konferenca Suneti pejgamberik në studimet bashkëkohore, e organizuar nga Universiteti Jermuk në Jordani: 17-18.4.2007.
50. Hamude, Abdulaziz. El-Meraja El-Muhdibe: mine'l-binjevijjeti ile't-tefkiki, Silsiletu alem'il-ma'rifeti nr. 232, Kuvajt: El-Mexhlis'ul-Vataniju li'th-thekafeti ve'l-fununi ve'l-adabi, Prill 1998.
51. El-Hamevi, Shihabudin Jakut ibn Abdullah El-Hamevi (vd. 626 h./1229). Mu'xhem'ul-udebai: Irshad'ul-eribi ila ma'rifet'il-edibi, Bejrut: Dar'ul-garb'il-islamijji, 1993.
52. Ibn Hambel, Ebu Abdullah Ahmed ibn Muhamed ibn Hambel ibn Hilal ibn Esed Esh-Shejbani (vd. 241 h./855). Musned'ul-imami Ahmed, Bejrut: Muesseset'ur-Risaleh, bot. 1, (1421 h./2001).
53. Ibn Hambel, Ebu Abdullah Ahmed ibn Muhamed ibn Hambel ibn Hilal ibn Esed Esh-Shejbani (vd. 241 h./855). Musned'ul-imami Ahmed, Kajro: Dar'ul-Mearif, 1985.
54. Ibn Hambel, Ebu Abdullah Ahmed ibn Muhamed ibn Hambel ibn Hilal ibn Esed Esh-Shejbani (vd. 241 h./855). Musned'ul-imami Ahmed ibn Hanbel, Riad: Bejt'ul-efkar'id-devlijeh, 1998.
55. Hanefi, Sari. "Eslemetu ve te'sil'ul-ulum'il-ixhtimajjeti", Mexhel-letu El-Mustekbel'ul-arabiju, nr. 451, Shtator 2016.
56. Ebu Hanife, En Nu'man ibn Thabit (vd. 80 h./699). El-Alimu ve'l-mutealimi (Mësuesi dhe nxënësi), Kajro: Mektebet'ul-Hanxhi, 1368 h.

57. Havva, Seid. Terbijjetuna er-ruhijeh (Edukimi ynë shpirtëror), Kajro: Dar'us-Selam, bot. 6, 1999.
58. Ibn Havkal, Ebul Kasim Muhamed ibn Havkal En-Nasibi El-Mevsili (vd. 367 h./978). Kitabu Suret'il-erdi (Libri mbi formën e tokës), Bejrut: Menshurat dari mektebet'il-hajati, 1992.
59. Ebu Hajan El-Endelusi, Muhamed ibn Jusuf ibn Ali El Garnati (vd. 745 h./1344). Tefsir 'ul-Bahr'ul-Muhit, Bejrut: Dar'ul-kutub'il-ilmijeti, bot. 1, (1413 h./1993).
60. El-Halidi, Halid Junus Abdulaziz. El-Jehudu fi'd-devlet'il-arabijet'il-islamijeti fi'l-Endelusi (Hebrenjtë në shtetin arab islam në Andaluzi), Gaza: Mektebetu Dar'il-Erkam, 2011.
61. El-Hudari, Muhamed. Tarih'ut-teshri'il-islami (Historia e sheriatit islam), Damask: Dar'ul-fikri, bot. 8, 1967.
62. Ibn Haldun, Ebu Zejd Abdurrahman ibn Muhamed El-Hadrami (v. 808 h./ 1405). Mukaddimetu Ibn Haldun, Kajro: Nahdatu Misre li't-tibaati ve'n-neshri ve't-tevzi'i, bot. 4, 2004.
63. El-Hattabi, Muhamed El-Arabi. Mevsuat'ut-turath'il-fikr'il-arabijj'il-islamijj (Enciklopedia e Trashëgimisë së mendimit arab islam), Bejrut: Dar'ul-garb'il-islami, 1998.
64. El-Hatib El-Bagdadi, Ebu Bekr Ahmed ibn Ali ibn Thabit (vd. 463 h./1071). Er-Rihletu fi taleb'il-ilm (Udhëtimi në kërkimin e diturisë), Bejrut: Dar'ul-kutub'il-ilmijeh, bot. 1. 1975.
65. El-Hatib, Abdulkерim. Et-Tefsir'ul-kur'aniju li'l-Kur'ani, Kajro: Dar'ul-fikr'il-arabiji, 1970.
66. El-Halef, Avvad & Sead, Kasim Ali. El-Xhamiune bejne'l-ulum'ishsher'ijjeti ve'l-ulum'it-texhribijeh, Dubai: Xhaizetu Dubai ed-devlijjeti li'l-Kur'an'il-Kerim, bot. 1, 2015.
67. Halil, Imaduddin. Med'halun ila islamijet'il-ma'rifeti mea muhattatin mukterehin li islamijeti ilm'it-tarihi, Hernden: El-Ma'had'ul-alemiju li'l-fikr'il-islami, bot. 2, 1991.
68. Ed-Darimi, Ebu Muhamed Abdullah ibn Abdurrahman ibn El-Fadl (vd. 255 h./869). Musned 'ud-Darimi, "Sunen'ud-Darimi", Riad: Dar'ul-Mugni, 1420 h.
69. Ed-Damegani, El-Husejn ibn Muhamed (ka jetuar në gjysmën e dytë të shekullit gjashtë hixhri dhe pjesën e parë të shekullit të shtatë hixhri). Kamus'ul-Kur'an "Islah'ul-vuxhuhi ve'n-Nedhairi fi'l-Kur'an'il-Kerim", Bejrut: Dar'ul-ilm li'l-melajin, bot. 4, 1983.
70. Ed-Dani, Ebu Amr Uthman ibn Seid El-Mukri' (vd. 444 h./1052). Es-Sunen'ul-varidetu fi'l-fiteni ve gavailuha ve's-saatu ve eshratuha, Bejrut: Dar'ul-Asimeti, 1416 h.
71. Ebu Davud, Sulejman ibn El-Esh'ath Es-Sixhistani (vd. 275 h./888). Sunenu Ebi Davud, Riad: Bejt'ul-efkar'id-devlijeh, bot. 1, 1999.

72. Draz, Muhamed Abdullah. Ed-Dinu: buhuthun mumehhedetun li diraseti tarih'il-edjani, Kuvajt: Darul Kalemi, 1970.
73. Draz, Muhamed Abdullah. En-Nebe'ul-adhimu: nadharatun xhedidetun fi'l-Kur'ani Kerim, Kuvajt: Dar'ul-Kalem, bot. 9, 2005.
74. Deravishe, Emin. "In'ikas'ul-ijdoloxhijet'is-suhjunijjeti alan nidham'ita'limij'il-israilijji", Rua terbevijjetun (Revistë e botuar nga Instituti i Abdulmuhsin El-Kattan në Britani), nr. 38-39, dhjetor 2012.
75. Ed Dehlevi, Ahmed ibn Abdurrahim El Faruki el Hindi, i njohur si Shah Velijullah (v. 1176 h./ 1763). El Insafu fi bejani esbabil hilafi, Bejrut: Darun Nefaisi, bot. 2, 1404.
76. Ed-Duri, Abdulaziz & Abbas, Ihsan (redaktorë). Et-Terbijet'ul-arabijet'ul-islamijetu: El-Muessesatu ve'l-mumaresatu (Pedagogjia arabe islame: institucionet dhe praktikat), Aman: El-Mexhme'ul-melekiju li buhuth'il-hadareti islamijeh (Instituti Alu'l-Bejt), 1989-1990.
77. Dekart, Rene. Mekalun ani'l-menhexh, Përkthyes: Mahmud Muhamed El-Hudari, Kajro: El-Muesseset'ul-misrijet'ul-ametu li te'lifi ve'n-neshri & Dar'ul-katib'il-arabijji li't-tibaati ve'n-neshri, bot. 2, 1968.
78. Ed-Dejlemi El-Hemedani, Ebu Shuxha Shejrevejh ibn Shehredar ibn Shehrevejh (vd. 509 h./1115). El-Firdevsu bi me'thur'il-hitabi, Bejrut: Dar'ul-kutub'il-ilmijeh, bot. 1, 1986.
79. Durant, William J., Kisa'tul-Hadareti, Përkthyes: Muhamed Bedran, Tunizi: El-Munadhdhame't'ul-arabijjetu li't-terbijjeti ve'th-thekafeti ve'l-ulumu, 1989.
80. Djuj, Xhon. El-Medresetu ve'l-muxhtemeu (Shkolla dhe shoqëria), Përkthyes: Ahmed Hasan Rrahim, Bejrut: Daru Mektebeti hajati, bot. 2, 1978.
81. Edh-Dhehebi, Shemsudin Muhamed ibn Ahmed ibn Uthman ibn Kajmaz (vd. 748 h./1347). Tarih'ul-islami ve vefejat'ul-meshahiri ve'l-a'lami, Bejrut: Dar'ul-kitab'il-arabijji, bot. 1, 1987.
82. Edh-Dhehebi, Shemsudin Muhamed ibn Ahmed ibn Uthman ibn Kajmaz (vd. 748 h./1347). Sijeru A'lam'in-nubelai, Bejrut: Muesseset'ur-risaleti, bot. 2, 1982.
83. Edh-Dhehebi, Shemsudin Muhamed ibn Ahmed ibn Uthman ibn Kajmaz (vd. 748 h./1347). Mizan'ul-i'tidali fi nakd'ir-rixhali, Bejrut: Dar'ul-ma'rifeti, 1963.
84. Edh-Dhehebi, Muhamed Husejn. Et-Tefsiru ve'l-Mufessirune: hulumtim i detajuar rreth lindjes, zhvillimit dhe shkollave të shkencës së tefsirit, me një prezantim të mufesirëve më të njohur, duke bërë analizë të plotë librave më të rendësishëm të tefsirit që nga koha e Muhamedit alejh'is-selam deri në ditët e sodit, Kajro: Mektebetu Vehbe, 1976.



85. Er-Razi, Fahrud-din Muhamed ibn Dijauddin Omer (vd. 604 h./1208). Tefsir'ul-Fahr 'ur-Razi "Et-Tefsir'ul-Kebiru apo Mefatih'ul-Gajbi", Damask: Dar'ul-Fikr, 1981.
86. Er-Ragib El-Isfahani, Ebu'l-Kasim El-Husejn ibn Muhamed ibn El-Mufeddal (vd. 502 h./1109). Tefsir'ul-un-Nesh'etejni ve tahsil'us-seadetejni, Bejrut: Daru mektebet'il-hajati, 1983.
87. Er-Ragib El-Isfahani, Ebu'l-Kasim El-Husejn ibn Muhamed ibn El-Mufeddal (vd. 502 h./1109). Muhaderat'ul-udebai ve muhaverat'ush-shuarai ve'l-bulegai, Kajro: Metbeat'ul-hilal, 1902.
88. Er-Ragib El-Isfahani, Ebu'l-Kasim El-Husejn ibn Muhamed ibn El-Mufeddal (vd. 502 h./1109). Mufredatu elfadh'il-Kur'ani, Damask: Dar'ul-Kalemi, bot. 4. (1430 h./2009).
89. Er-Ragib El-Isfahani, Ebu'l-Kasim El-Husejn ibn Muhamed ibn El-Mufeddal (vd. 502 h./1109). El-Mufredatu fi garib'il-Kur'ani, Kajro: Mek-tebetu Nezar Mustafa El Baz, (pa vit botimi).
90. Raight, William. Kitabu tarih'il-felsefet'il-hadithe (Historia e filozofisë moderne), Përkthyes: Mahmud Sejid Ahmed, Bejrut: Et-Tenvir li't-tibaati ve'n-neshri ve't-tevzi'i, 2010.
91. Rexheb, Mustafa (redaktor). Delilu Resail'it-terbijet'il-islamijeti fi'l-xhamiat'il-misrijeti min 1990-2011, (Katalogu i disertacioneve të Pedagogjisë Islame në universitetet egiptiane në periudhën 1990-2011), Kajro: El-Hej'et'ul-misrijet'ul-ametu li'l-kitabi, 2016.
92. Rexheb, Mustafa. El-I'xhaz'ut-terbeviju fi's-sunetin nebevijeh (Mrekullia pedagogjike në sunetin pejgamberik), Kefre shejh: Dar'ul-ilmi ve'l-imani, 2008.
93. Rexheb, Mustafa. El-I'xhaz'ut-terbeviju fi'l-Kur'an'il-Kerimi (Mrekullia pedagogjike në Kur'anin Famëlartë), Amman & Irbid: Xhidara li'l-kitab'il-alemij, 2006.
94. Ibn Rushd, Ebul Velid Muhamed ibn Ahmed (vd. 595 h./1199). Telhisu kitab'in-nefsi, Kajro: El-Mexhlis'ul-a'la li'th-thekafeti, 1994.
95. Rida, Muhamed Xhevad. "Et-Tejarat'ul-kubra fi'l-fikr'it-terbevijij'il-arabijj'il-islamijji", kapitulli i katërt nga: El-Fikr'ut-Terbevijij'ul-arabijj'ul-islamijju: el-usulu ve'l-mebadiu, Tunizi: El-Munadhhamet'ul-arabijjetu li't-terbijjeti ve'th-thekafeti ve'l-ulumi, 1987.
96. Rida, Muhamed Reshid. Tefsir'ul-Menar, Kajro: Metbeat'ul-Menar, 1350 h.
97. Rida, Muhamed Reshid. Mexhel-let'ul-Menar, Kajro, gusht 1912.
98. Er-Rejsuni Ahmed. El-Fikr'ul-mekasidi, Kavaid ve fevaid, Ribat: Menshurat xheridet'iz-zemen, 1999.
99. Ez-Zubejdi, Muhamed Murteda El-Husejni (vd. 1205 h./1791). Taxh'ul-arus min xhevahir'il-kamus, Kuvajt: Vezaret'ul-irshadi ve'l-enbai, 1965.

100. Ez-Zemehsheri, Ebu'l-Kasim Xharullah Mahmud ibn Omer (vd. 538 h./1144). Tefsir'ul-Keshshaf, Bejrut: Dar'ul-ma'rifeti, 2009.
101. Ez-Zentani, Abdulhamid Es-Sajd. Usus'ut-terbijjeti'il-islamijjeti fi's-sunetin nebevijjeti (Bazat e edukimit islam në sunetin pejgamberik), Tripoli: Ed-Dar'ul-arabijjetu li'l-kitabi, bot. 2, 1993.
102. Ebu Zehra, Muhamed. Zehret'ut-tefasir, Bejrut: Dar'ul-fikr'il-arabi, bot. 1, 1987.
103. Ez-Zejan, Ramadan Is'hak. "Et-Tibbun nefsiyun fi dav'is-sunet'in-nebevijjeti", (punim magjistrature e papublikuar, Fakulteti Usuludin ve't-terbije, Univerziteti islamik Umm Durman, Sudan, 1990).
104. Ibn Sehnun, Muhamed ibn Abduselam Et-Tenuhi (vd. 256 h./870). Kitabu adab'il-mual-limine, Tunizi: Dar'ul-kutub'ish-sherkijeh, 1972.
105. Sehnun, Ebu Seid Abduselam ibn Seid Et-Tenuhi El-Kajrevani (vd. 240 h./854). El-Mudevvenet'ul-Kubra, Riad: Dar'ul-kutub'il-ilmijeh, bot. 1, 1994.
106. Sulejman, Amir. El-Iraku fi't-tarih'il-kadimi, Mosul: Xhamiat'ul-Musul, 1993.
107. Sem'an, Vehib Ibrahim. Eth-Thekafetu ve't-terbijjetu fi'l-usur'il-kadimeh (Kultura dhe edukata në periudhat e vjetra), Kajro: Dar'ul-Mearif, 1961.
108. Ebu Semhedane, Ahmed Dajfullah Omer. "Melamih'ut-terbijjet'il-xhihadijjeti fi's-sunet'in-nebevijjeti ve tatbikatuhu et-terbevijjeh", (Temë e magistraturës, Dega Usul'ut-terbijjeti, Universiteti Islamik, Gaza, 2010).
109. Es-Susuva, Abdulhamid. Fikh'ul-muvazenati fi'sh-sheriat'il-islamijjeti, Dubai: Dar'ul-Kalemi, bot. 1, 2004.
110. Soser, Ferdinan. Durusun fi'l-elsinijet'il-ameti, Tunizi: Ed-Dar'ul-arabijjetu li'l-kitabi, 1985.
111. Soser, Ferdinan. Ilm'ul-lugat'il-ami, Përkthyes: Juil Jusuf Aziz, Bagdad: Daru Afakin arabijetin, 1985.
112. Sejid, Fet'h'ul-babi Abdulhalim. "El-Gajatu ve'l-ahdaf'ut-terbevijjetu fi'l-Kur'ani ve's-suneti", në: Kumtesat e Konferencës pedagogjike, Redaktor: Fet'hi Hasen Melkavi, vëll. 2, 1991.
113. Ibn Sina, Ebu Ali El-Husejn ibn Abdullah (vd. 427 h./1036). Risaletun fi ma'rifetin nefsin natikatin ve ehvaluha, Nedzur: Britania e Bashkuar: Muessesetu Hindavi, 2017.
114. Es-Sujuti, Xhelaluddin Abdurrahman ibn Kemaluddin (vd. 911 h./1505). El-Itkanu fi ulum'il-Kur'ani, Riad: Vezaret'ush-shu'un'il-islamijeh ve'l-evkafi ve'd-da'veti ve'l-irshadi, 1426 h.
115. Es-Sujuti, Xhelaluddin Abdurrahman ibn Kemaluddin (vd. 911 h./1505). Bug'jet'ul-vuati fi tabakat'il-lugavijjine ve'n-nuhati, Kajro: Metbeatu Isa El-Bab'il-Halebi, bot. 1, 1964.

116. Esh-Shatibi, Ebu Is'hak Ibrahim ibn Musa (vd. 790 h./1388). El-Muvafekatu fi usul'ish-sheriati, Bejrut: Dar'ul-kutub'il-ilmijeti, 2004.
117. Esh-Shafii, Muhamed ibn Idris (vd. 204 h./819). El-Ummu, Kajro: Mektebet'ul-kul-lijjat'il-ez'herijjeti, bot. 1, 1961.
118. Esh-Shafii, Muhamed ibn Idris (vd. 204 h./819). Er-Risaletu, Kajro: Metbeatu Mustafa El-Babi 'l-Halebi, 1938.
119. Ebu Shame, Shihabudin Ebu Muhamed Abdurrahman ibn Ismail (vd. 665 h./1267). El-Baithu ala inkar'il-bidei ve'l-havadithi. Mekë: Mektebetu nahdat'il-haditheti, bot. 2, 1981.
120. Shebar, Seid. "Fi mefhum'il-merxhe'ijjeti ve isti'malat'ul-fikr'il-arabijji ve'l-islamij'il-muasir", Mexheletu Dirasatu mustalahije (el Megtib), nr. (1423 h./ 2002).
121. Ibn Sheref El-Kajrevani, Muhamed ibn Ebi Seid (vd. 360h./ 971). Resailul intikadi fi nekdish shi'ri vesh shuarai, Bejrut: Darul kitabil xhedidi, 1983.
122. Shelebi, Ahmed. Tarih'ut-terbijjet'il-islamijeh (Historia e pedagogjisë islame), Kajro: Dar'ul-Keshafi, 1954.
123. Shemsuddin, Abdulemir. El-Fikr'ut-terbeviju inde ibn 'il-Mukaffe' ve'l-Xhahidh ve Abdulhamid El-Katib, Mevsuat'ut-terbijjeti ve't-ta'lim'il-islamijeh, Bejrut: Esh-Sherikat'ul-alemijjetu li'l-kitabi, 1990.
124. Shemsudin, Abdulemir. El Fikrut terbeviju inde Ibn Sehnun vel Kabisi: dirasetun ve tehliil, Mevsuatut terbijjeti vet ta'limil islamijet, Bejrut: Esh Sherikaetul alemijetu lilkitabi, 1990.
125. Esh-Shihri, Aze ibn Abis. "Mebadi'ut-terbijjet'in-nefsijjeti fi'l-Kur'an'il-Kerimi ve tatbikatuh'a't-terbevijjetu", (temë e doktoraturës në: Usul'ul-islamijjetu li't-terbijjeti, Universiteti Umm'ul-Kura, Mekë, (1436 h./2015).
126. Esh-Shejbani, Omer Muhamed Et-Tumi. Tetavvurun Nadharijati ve'l-efkar'it-terbevijjeti (Zhvillimi i teorive dhe mendimeve pedagogjike), Bejrut: Dar'uth-thekafeti, 1971.
127. Sabir, Muhjedin. El-Fikr'ut-terbevijj'ul-arabijj'ul-islamijju: el-usulu ve'l-mebadiu (Mendimi pedagogjik arab islam: bazat dhe parimet), Tunizi: El-Munadhamet'ul-arabijjetu li't-terbijjeti ve'th-thekafeti ve'l-ulumi, 1987.
128. Salih, Abdulaziz. Et-Terbijjetu ve't-ta'limu fi misre'l-kadimeti, Kajro: Ed-Dar'ul-kavmijjetu li't-tibaati ve'n-neshri, 1966.
129. Salih, Abdulaziz. Tetavvurun Nadharijjet'it-terbevijeh (Zhvillimi i teorisë pedagogjike), Kajro: Darul Mearif, 1964.
130. Es-Samedi, Halid. Idmaxh'ul-kijem'il-islamijeti fi'l-menahixh'id-dirasijeh (Inkorporimi i vlerave islame në planprogramet mësimore), Ribat: ICESCO, 2003.

131. Es-Samedi, Halid. El-Kijem'ut-terbevijetu fi'l-mendhümet'it-terbevij'eti: dirasetun li'l-kijem'il-islamij'eti ve alijati ta'zizih, Ribat: ICESCO, bot. 1, 2008.
132. Et-Taberi, Ebu Xhafer Muhamed ibn Xherir (vd. 310 h./922). Xhami'ul-Bejani fi te'vil'il-Kur'ani, Bejrut: Muesseset'ur-Risaleti, 2000.
133. Et-Taberi, Ebu Xhafer Muhamed ibn Xherir (vd. 310 h./922). Tarih'ulumemi ve'l-muluki, Bejrut: Dar'ul-Fikri, 1979.
134. Tarabishi, Xhorxh. Mu'xhem'ul-felasifeti, Bejrut: Dar'ut-Taliati, 2006.
135. Tales, Muhamed Es'ad. Et-Terbijetu ve't-ta'limu fi'l-islami (Edukata dhe arsimi në islam), Kajro: Muessesetu Hindavi li't-ta'limi ve'th-the kafeti, 2014.
136. Ibn Ashur, Muhamed Et-Tahir. Elejse-s-subhu bi karibin? Et-ta'lim'ul-a'abij'ul-islamijju: dirasetun tarihijetun ve araun islahijetun (Mëngjesi a nuk është afër? Arsimi arab islam: studim historik dhe mendime reformuese), Tunizi & Kajro: Daru Sehnu & Dar'us-Selam, bot. 2, 2007.
137. Ibn Ashur, Muhamed Tahir. Tefsir'ut-tahriri ve't-tenviri, Tunizi: Ed-Dar'ut-tunisijetu li'n-neshri, 1984.
138. El-Ani Nezar. Esh-Shehsijet'ul-insanijetu fi't-turath'il-islamijji (Personaliteti human në trashëgiminë islame) në: Herndon: El Ma'had'il-alemijju li'l-fikr'il-islamijji, bot. 1, 1998.
139. Abas, Ala Sahibu Asker. Nahve ru'jetin felsefijetin terbevijetin li'l-kijem (Drejt një vizioni filozofik pedagogjik të vlerave), Aman: Daru Gajda' li'n-neshri ve't-tevzi'i, 2010.
140. Abas, Fadl Hasan. Kasas'ul-Kur'an'il-Kerimi, Aman: Dar'un-nefaisi li'n-neshri ve't-tevzi'i, bot. 3, 2010.
141. Abdulbaki, Muhamed Fuad. El-Mu'xhem'ul-mufehres li elfadh'il-Kur'an'il-Kerim, Bejrut: Dar'ul-Fikri, 2000.
142. Ibn Abdulberr, Ebu Omer Jusuf ibn Abdullah En-Nemri El-Kurtubi (vd. 463 h./1071). Xhamiu Bejan'il-ilmu ve fadluhu, Demam: Daru ibn El-Xhevzi, (1414 h./1994).
143. El-Abdu El-Xhadir, Fejsal Fehd. Ta'ziz'ul-kijemi fi menahixh'it-ta'lim'il-ami: itarun amun li't-terbijet'il-kijemijeh, Kuvajt: El-Merkez'ul-arabijju li'l-buhuth'it-terbevijjeti li duvel'il-halixhi, 2014.
144. Abdulhalik, Abdulgani. Huxhijet'us-suneti, Herndon: El-Ma'had'ul-alemijju li'l-fikr'il-islamijji & Dar'ul-Vefai, (1407 h./1987).
145. Abdudajim, Abdulkerim. Et-Terbijetu abre't-tarihi mundhu ekdem'il-usuri hatta bidajet'il-karn'il-ishrine (Pedagogjia gjatë historisë, nga kohët më të hershme deri në fillim të shekullit XX), Bejrut: Dar'ul-ilmu li'l-melajin, bot. 1, 1973.
146. Abdudajim, Abdulkerim. Et-Terbijetu abre't-tarihi mine'l-usur'il-kadimeti hatta bidajet'il-karn'il-ishrine (Pedagogjia gjatë historisë, nga

- kohët e vjetra deri në fillim të shekullit XX), Bejrut: Dar'ul-ilmî li'l-melajin, bot. 5, 1984.
147. Ibn Abd Rabo, Shihabudin Ahmed ibn Muhamed El-Endelusi (vd. 328 h./940). El-Akd'ul-Feridu, Bejrut: Dar'ul-kutub'il-ilmijeh, bot. 1, 1404.
148. Ibn Abduselam, Izudin ibn Abdulaziz ibn Ebi'l-Kasim , i njohur si Sulltani i Dijetarëve (v. 660 h./1262). El-Kavaid'ul-Kubra: Kavaid'ul-ahkami fi islah'il-enami, Damask: Dar'ul-Kalemi, 2000.
149. Abdulaziz, Salih. Tetavvurun nadharijet'it-terbevijeti (Zhvillimi i teorisë pedagogjike), Kajro: Dar'ul-Mearif, 1964.
150. Abdulfetah, Muhamed Abdulhalim. El-Ihtirak'ul-jehudijju li'l-fatikan, Kajro: Dar'ul-kutub'il-misrijeh, 2005.
151. Abdulmexhid, Muhamed Behr. El-Jehudu fi'l-Endelusi, Kajro: El-Hej'et'ul-misrijetu li'l-kitabi, 1970.
152. Ibn Asakir, Ebu'l-Kasim Ali ibn 'ul-Husejn ibn Hibetullah (vd. 571 h./1176). Keshf'ul-Mugata fi fadl'il-muvetta', Bejrut & Damask: Dar'ul-fikr'il-muasir & Dar'ul-fikr, 1992.
153. Ashak, Abdulhamid. Dar'ul-atabi kadimun: El-Meshru'ut-terbevij'ul-islamijju ve evaid'ut-texhdidi, Ribat: Er-Rabitat'ul-muhamedijeh, 2015.
154. Atije, Imad Muhamed. Tetavvur'ul-fikr'it-terbevijji abre'l-kuruni (Zhvillimi i mendimit pedagogjik gjatë shekujve), Riad: Dar'ur-Rushdi, 2004.
155. El-Alvani Taha Xhabir. "Mine't-ta'lili ile'l-mekasid'il-ulja'l-hakimeti", Mexhel-letu Islamijet'ul-ma'rifeti, nr. 46-47, (12), vjeshtë-dimër 2006-2007.
156. El-Alvani, Taha Xhabir. El-Hakimijetu ve'l-Hejmenetu: Nahve iadeti binai mefhum'il-ummeti ve'd-devleti ve'd-da'veti, Herndon & Aman: El-Ma'had'ul-alemijju li'l-fikr'il-islamijji & Dar'ul-Fet'hi li'd-dirasati ve'n-neshri, 2016.
157. El-Alvani, Taha Xhabir. Mekasid'ush-sheriatî (Intencat e sheriatit), Bejrut: Dar'ul-Hadi, 2001.
158. Ali, Seid Ismail. "Ishkalijet'ut-tehajjuzi fi't-ta'limi", në: Ishkalijet'ut-tehajjuzi; ru'jetun ma'rifijetun ve da'vetun li'l-ixhtihadi, Herndon & Virxhinia: El-Ma'had'el-alemijju li'l-fikr'il-islami, vëll. 2, bot. 2, 1997.
159. Ali, Seid Ismail. Ittixhahat'ul-fikr'it-terbevij'ul-islami, pjesa e pestë e Enciklopedisë Zhvillimi civilizues i pedagogjisë islame, Kajro: Dar'us-selam, 2010.
160. Ali, Seid Ismail. El-Fikr'ut-terbevij'ul-islamijju ve tehadijjat'ul-mustakbeli (Mendimi pedagogjik islam dhe sfidat e të së ardhmes), Kajro: Dar'us-selam, 2006.
161. Ali, Seid Ismail. Mevsuat'ut-tetavvur'ith-thekafi li't-ta'limi fi Misre, Kajro: Dar'us-selam, 2010.

162. Ali, Seid Ismail. Mevsuat'ut-tetavvur'il-hadari li't-terbijjet'il-islamijeh, Kajro: Dar'us-selam, 2010.
163. Ali, Seid Ismail. Nesh'et'ut-terbijjet'il-islamijeh, Kajro: Dar'us-selam, 2010.
164. Ali, Seid Ismail. Ferexh, Hani Abdusetar. Felsefet'ut-terbijjeti: ru'jetun tahlilijetun ve mendhurun islamijun (Filozofia e pedagogjisë: vizion analitik dhe pikëpamje islame), Herndon & Kajro: El-Ma'had'ul-alemijju li'l-fikr'il-islami & Dar'ul-Fikr, 2009.
165. El Ali, Salih. "Et-Ta'lim'ul-ilzamijju fi'l-Kur'ani ve's-sunneti ve fikh'il-eimmeti", Revista e Universitetit të Damaskut për shkencat ekonomike dhe juridike, vëll. 22, nr. (2), 2006.
166. Aljan, Ahmed Fuad. Turuk'ut-ta'lim'it-terbevijjeti fi's-sunnetin nebevijjeti (Metodat mësimore edukative në sunetin pejgamberik), Riad: Dar'ul-muslimi li'n-neshri ve't-tevzi'i, 2000.
167. El-Aljani, Sead ibn Hashim. "Et-Terbijjet'ul-iktisadijjetu fi'l-Kur'an'il-Kerimi ve tatbikatuha fi'l-usreti ve'l-medreseti", (Temë doktrature, në Fakultetin El-Usul'ul-islamijjetu li't-terbijjeti, Universiteti Umm'ul-Kura, Mekë, (1427 h./2005).
168. El-Omari, Abdullah Muhamed Emin Junus. Er-Rua ve'l-ahlamu fi's-sunnetin nebevijjeti: dirasetu xham'in ve tasnifin ve tahrrixhin, Aman: Universiteti i Jordanisë, 1996.
169. El-Ava, Muhamed Selim. "Es-sunet'ut-teshri'ijetu ve gajr'ut-teshri'ijjeti", Revista El-Muslim'ul-Muasir, Numri preliminar, 1974.
170. Garodi, Rozhe. El-Binjevijjetu: Felsefetu mevt'il-insani, Përkthyes: Xorxh Tarabishi, Bejrut: Dar'ut-taliati, bot. 1, 1979.
171. Ebu Gude, Abdulfetah. Er-Resul'ul-mualimu ve esalibuhu fi't-ta'limi (I Dërguari mësuës dhe metodat e tij në arsim), Alep: Mektebet'ul-metbuat'il-islamijeh, bot. 1, 1992.
172. El-Gazali, Ebu Hamid Muhamed ibn Muhamed (vd. 505 h./1111). Ihjau ulum'id-din, Bejrut: El-Mektebet'ul-asrijeh, bot. 1, 2004.
173. El-Gazali, Ebu Hamid Muhamed ibn Muhamed (vd. 505 h./1111). Ihjau ulum'id-din, Bejrut: Darul Ma'rifeti, (pa vit botimi).
174. El-Gazali, Ebu Hamid Muhamed ibn Muhamed (vd. 505 h./1111). Ihjau ulum'id-din, Bejrut: Daru Ibn Hazm, bot. 1, 2005.
175. El-Gazali, Ebu Hamid Muhamed ibn Muhamed (vd. 505 h./1111). Mearixh'ul-kudsi fi'l-medarixhi ma'rifetin nefsi, Bejrut: Dar'ul-afak'il-xhedideti, bot. 2, 1975.
176. El-Gazali, Ebu Hamid Muhamed ibn Muhamed (vd. 505 h./1111). Minhaxh'ul-muteal-limi, Damask: Dar'ut-Tajbate & Dar'un-Nahdah, bot. 1, 2007.
177. El-Gazali Muhamed. El Mehavir'ul-hamsetu fi'l-Kur'an'il-Kerim, Kajro: Esh-Shuruk, 2005.

178. El Gazi, Ebu'l-Berekati Bedruddin Muhamed ibn Muhamed (vd. 984 h./1576). Ed-Durr'un-Nedidu fi edeb'il-mufidi ve'l-mustefidi, Kajro: Mekteb'et-tev'ijat'il-islamijeh, 2009.
179. El-Faruki, Ismail Raxhi & El-Faruki, Luis Lamija'. Atlas'ul-hadaret'il-islamijeti (Atlasi kulturor i Islamit), përkthyes: Abdulvahid Lu'lue, Riad: Mektebet'ul-abikan, bot. 1, (1419 h./1998).
180. Ferairi, Paolo. Ta'lim'ul-mekhurin, përkthyes: Jusuf Nur Ived, Bejrut: Dar'ul-Kalem, 1980.
181. Ferid, Muhamed Ferid bek El-Muhamed. Tarih'ud-devlet'il-alijet'il-uthmanije (Historia e shtetit osman), Bejrut: Dar'un-Nefaisi, 1981.
182. Fridrih, Johan. Tarih'ul-kitabeti, Përkthyes: Sulejman Ahmed Dahir, Damask: Menshurat'ul-hej'et'il-amet'is-surijjeti li'l-kitabi, bot. 2, 2013.
183. Fehmi, Esmâ Hasan. Mebadi'ut-terbijet'il-islamijeti (Parimet e Pedagogjisë Islame), Kajro: Lexhnet'ut-te'lifi ve't-terxhemeh, 1947.
184. El-Fejruz Abadi, Mexhdudin Ebu Tahir, Muhamed ibn Ja'kub (vd. 817 h./1414). El-Kamus'ul-Muhit, Bejrut: Muesseset'ur-Risaleti, bot. 8, (1426 h./2005).
185. Fisher, Herbart. Usul'ut-Tarih'il-Evrob'il-hadithi: min nahdat'il-evrobijjeti ile-th-thevret'il-ferensjeti (Bazat e historisë moderne evropiane: nga Renesanca evropiane deri te Revolucioni francez), Përkthyes: Zejneb Ismet Rashid & Ahmed Abdurrahim Mustafa, Kajro: Dar'ul-Mearif, bot. 3, 1970.
186. El-Kabisi, Ebu'l-Hasan Ali ibn Halef (vd. 403 h./1013). ErRisalet'ul-mufesaletu li ahval'il-muteal-limine ve ahkam'il-mual-limine ve'l-muteal-limine, Tunizi: Esh-Sheriket'ut-tunisijetu li't-tevzi'i, bot. 1, 1986.
187. Kahaf, Mundhir. En-Nusus'ul-iktisadijjetu mine'l-Kur'ani ve's-sunneti, Xhidë: En-Neshr'ul-ilmiju, Univesiteti El-Melik Abdulaziz, 2009.
188. El-Karadavi, Jusuf. "El-Xhanib'ut-teshri'ijju fi's-sunetin-nebevijjeti", Revista Merkezu buhuth'is-sunnetin-nebevijjeti, nr. 3, (1408 h./1988).
189. El-Karadavi, Jusuf. El-Hasais'ul-ammetu li'l-islami, Bejrut: Muesset'ur-Risaleti, bot. 2, 1983.
190. El-Karadavi, Jusuf. Er-Resul'ul-Mual-limu (I Dërguari mësuës), Kajro: Dar'us-Sahveti, 2001.
191. El-Karadavi, Jusuf. Kejfe neteammelu mea'l-Kur'an'il-Adhim?, Kajro: Dar'ush-Shuruki, 2001.
192. El-Kurtubi, Ebu Abdullah, Muhamed ibn Ahmed ibn Ebu Bekr (vd. 671 h./1273). El-Xhamiu li ahkam'il-Kur'ani, Bejrut: Muesseset'ur-Risaleti, 2006.
193. El-Kazvini, Zekerija ibn Muhamed ibn Mahmud El-Ensari (v. 682 h./1283). Athar'ul-biladi ve ahbar'ul-ibadi, Bejrut: Daru Sadir, (pa vit botimi).

194. Kutub, Sejid. Hasais'ut-tesavvur'il-islami ve mukavvimatuhu, Kajro: Dar'ush-Shuruk, 1988.
195. Kamber, Mahmud. Dirasatun turathijjetun fi't-terbijjet'il-islamijeh (Studime trashëguese në Pedagogjinë Islame), Doha: Dar'uth-thekafeh, tre vëllime, të botuara viteve 1985, 1987 dhe 1992.
196. Ibn Kajjim El-Xhevziye, Ebu Abdullah Muhamed ibn Ebu Bekr ibn Ejub (vd. 751 h./1350). I'lam'ul-muveki'ine an Rab'il-alemine, Demam: Daru ibn'ul-Xhevzi, 1423 h.
197. Ibn Kajjim El-Xhevziye, Ebu Abdullah Muhamed ibn Ebu Bekr ibn Ejub (vd. 751 h./1350). Ed-Dau ve'd-Devau (El-Hevab'ul-Kafi limen se'ele ani'd-deva'ish-shafi), Xhidë: Mexhem'ul-fikh'il-islami, Mek-: Daru Alem'il-fevaidi, 1429 h.
198. Ibn Kajjim El-Xhevziye, Ebu Abdullah Muhamed ibn Ebu Bekr ibn Ejub (vd. 751 h./1350). Kitab'ur-Ruhi, Mekë: Daru Alem'il-fevaidi, 1432 h.
199. Ibn Kajjim El-Xhevziye, Ebu Abdullah Muhamed ibn Ebu Bekr ibn Ejub (vd. 751 h./1350). Zad'ul-Meadî fi hadji hajr'il-ibadi, Kontrollloi: Shuajb El-Arnaut & Abdulkadir El-Arnaut, Bejrut: Muesseset'ur-Risaleti, bot. 1, 2009.
200. Ibn Kajjim El-Xhevziye, Ebu Abdullah Muhamed ibn Ebu Bekr ibn Ejub (vd. 751 h./1350). El-Fevaidu, Mekë: Daru Alem'il-fevaidi, 1429 h.
201. Ibn Kajjim El-Xhevziye, Ebu Abdullah Muhamed ibn Ebu Bekr ibn Ejub (vd. 751 h./1350). Medarixh'us-salikinë bejne menazili ijake na'budu ve ijake nesteinu, Bejrut: Dar'ul-kitab'il-arabi, bot. 7, 2003.
202. Ibn Kajjim El-Xhevziye, Ebu Abdullah Muhamed ibn Ebu Bekr ibn Ejub (vd. 751 h./1350). Miftahu Dar'is-seadeti ve menshuru vilajet'il-ilmi ve'l-iradeti, Riad: Daru Alem'il-fevaidi, 1432.
203. Kenan, Abas Subhi. "Et-Terbijjet'ul-ahlakijetu ve bina'ul-menhexh'it-ta'limijji fi Lubnanë", (Temë e doktoraturës në pedagogji, Universiteti Botëror për shkencë, 2016).
204. Ibn Kethir, Ebu'l-Fida Ismail ibn Omer El-Kureshi Ed-Dimeshki (774 h./1372). El-Bidajetu ve'n-nihajeh, Bejrut: Alem'ul-kutubi, (1424 h./2003).
205. Ibn Kethir, Ebu'l-Fida Ismail ibn Omer El-Kureshi Ed-Dimeshki (774 h./1372). El-Bidajetu ve'n-nihajeh, Bejrut: Mektebet'ul-Mearif, bot. 7, 1988.
206. Ibn Kethir, Ebu'l-Fida Ismail ibn Omer El-Kureshi Ed-Dimeshki (774 h./1372). Tefsir'ul-Kur'an'il-Adhim, Rjad: Daru Tajbete, bot. 2, (1420 h./1999).
207. Kurim, Suad. "Ed-Diraset'ul-mefhumijetu: mukarebetun tesavuriijetun ve menhexhijjetun", Revista Islamijet'ul-ma'rifeti, El-Ma'had'ul-alemijju li'l-fikr'il-islamijji, nr. 60, Pranverë (1431 h./2010).
208. El-Kilani, Maxhid Arsan. Ahdaf'ut-terbijjet'il-islamijeh: Mukarenjetun bejne ahdaf'it-terbijjet'il-islamijjeti ve'l-ahdaf'it-terbevijjet'il-muasire



- (Qëllimet e pedagogjisë islame: krahasim mes qëllimeve të pedagogjisë islame dhe qëllimeve të pedagogjisë bashkëkohore), Medinë: Mektebetu Dar'it-Turathi, bot. 2, (1408 h./1988).
209. El-Kilani, Maxhid Arsan. Tetavvur'un-Nadharijet'it-terbevijet'il-islamijeh (Zhvillimi i teorisë pedagogjike islame), Damask & Bejrut: Dar Ibn Kethir, bot. 2, 1985.
210. El-Kilani, Maxhid Arsan. Felsefet'ut-terbijet'il-islamijeti: dirasetun mukareneton bi'l-felsefat'it-terbevijet'il-muasire (Filozofia e pedagogjisë islame), Aman: Dar'ul-Fet'hi, 2009.
211. Komisioni i lartë për politikat arsimore. Vethikatu sijaset'it-ta'limi fi'l-memleketi, Riad: Ministria e Edukatës dhe Arsimit në Mbretërinë Arabe të Saudisë, 1416 h.
212. Lukas, Kristofer. Hadarat'ur-Rakam'it-Tinijeti, ve sijaset'ut-terbijeti ve't-ta'limi fi'l-Irak'il-kadimi, Seri e Enciklopedisë së vogël (61), Përkthyes: Jusuf Abdulmesih Therve, Bagdad: Ministri e Kulturës dhe Informatikës\* Dar'ul-Xhahidh, 1980.
213. Ibn Maxhe, Ebu Abdullah Muhamed ibn Jezid (v. 273 h./886). Sunenu Ibn Maxhe, Riad: Bejt'ul-efkar'id-devlijjeti, bot. 1, 1999.
214. Ibn Malik, Xhemaluddin ibn Malik Et-Tai (vd. 672 h./1274). Tes'hil'ul-fevaidi ve tekmil'ul-mekasidi, Kajro: Dar'ul-kitab'il-arabijeti, 1967.
215. El-Maverdi, Ebu'l-Hasan Ali ibn Muhamed ibn Habib (vd. 450 h./1058). Nasihat'ul-Muluki, Kuvajt: Mektebet'ul-Felah, bot. 1, 1983.
216. El-Muberid, Ebu'l-Abas Muhamed ibn Jezid (vd. 285 h./898). El-Kamilu fi'l-lugati ve'l-edebi, Riad: Ministria për Çështje Islame, Vakëfit dhe Thirrjes, (1419 h./1998).
217. Këshilli i Lartë për Edukim. El-Mebadi'ul-ametu li's-sijaset'it-terbevijeti ve islah'it-ta'lim'il-esasi, Algjeri, 1998.
218. Mexhme'ul-lugat'il-arabijeh. El-Mu'xhem'ul-Vesitu, Stamboll: Dar'ud-Da'veti, 1989.
219. Mexhme'ul-lugat'il-arabijeh. El-Mu'xhem'ul-Vesitu, Kajro: Mexhem'ul-lugat'il-arabijeti, bot. 2, 1972.
220. Mexhme'ul-lugat'il-arabijeh. El-Mu'xhem'ul-Vesitu, Kajro: Mektebetu Esh-Shuruk'ud-devlijjeti, bot. 4, 2004.
221. El-Muhasibi, Ebu Abdullah El-Harith ibn Esed (vd. 243 h./857). Adab'un-Nufusi, Bejrut: Muesseset'ul-kutub'ith-thekafijeh, bot. 2, 1991.
222. Ibn Muhtar, Ahmed Vifak. Mekasid'ush-sheriatu inde'l-imam'ish-Shafi'i, Kajro: Dar'us-salam, 2014.
223. Mursi, Muhamed Munir. Tarih'ut-terbijeti fi'sh-sherki ve'l-garbi (Historia e pedagogjisë në Lindje dhe Perëndim), Kajro: Alem'ul-kutubi, 1977.
224. Mesad, Nivin Abdulmunim. "Es-Sijaset'ul-harixhjet'ul-emirikijje tixhah'ed-duvel'il-arabijeti ba'de ahdathi 11 Shtator 2001", në: Sina-

- nat'ul-kirahijeti fi'l-alakat'il-arabijet'il-emirikije, Bejrut: Merkez Dirasat'ul-vehdet'il-arabijeti, 2003.
225. Muslim, Ebu'l-Husejn Muslim ibn El-Haxhaxh El-Kushejri (vd. 260 h./874). Sahihu Muslim, Riad: Bejt'ul-efkar'id-devlijjeti, bot. 1, 1998.
226. Ibn Miskevejh, Ebu Ali Ahmed ibn Muhamed (vd. 421 h./1030). Tehdhib'ul-ahlaki, Bejrut: Menshurat'ul-xhemeli, 2011.
227. El-Mesiri, Abdulvehab. "Fi ehemmijet'id-ders'il-ma'rifi", fi: Nahve nidhamin ma'rifijin islamijj, Aman: El-Ma'had'ul-alemijju li'l-fikr'il-islamijji, 2000.
228. El-Mesiri, Abdulvehab. Felsefet'ul-madijete ve tefik'ul-insani (Filozofia e materializmit dhe shpartallimi i njeriut), Damask: Dar'ul-Fikri, 2007.
229. El-Mesiri, Abdulvehab. Fikh'ut-tehajjuzi fi kitabi ishkalijjete tehajuzi, Herndon: El-Ma'had'ul-alemijju li'l-fikr'il-islamijji, 1995.
230. El-Misri, Muhamed Emin. Lemehatun min vesail'it-terbijet'il-islamijjete ve gajatuha, Damask: Dar'ul-Fikr, bot. 4, 1978.
231. Ma'ruf Naxhi. Tarihu ulema'il-Mustensirijeh (Historia e dijetarëve të El-Mustensirije), Bagdad: Metbeat'ul-Ani, bot. 1, 1959.
232. El-Makdisi, Dijaudin Ebu Abdullah Muhamed ibn Abdulvahid (vd. 643 h./1245). Ittiba'us-suneni vexhtinab'ul-bidei, Damask: Daru Ibn Kethir, 1987.
233. El-Mukri Et-Telmesani, Ahmed ibn Muhamed. Nefh'ut-Tajjibi min gusn'il-Endelus'ir-Ratibi, Bjerut: Daru Sadir, 1968.
234. El-Makrizi, Tekijudin Ebu'l-Abas Ahmed ibn Ali ibn Abdulkadir (vd. 845 h./1441). El-Mevaidhu ve'l-i'tibaru bi dhikr'il-hutati ve'l-athari "El-Hutat'ul-Mekrizijetu", Kajro: Mektebet'uth-thekafet'id-dinijjete, bot. 2, 1987.
235. Mekteb'ut-terbijet'il-arabijji liduvel'il-halixhi. Min A'lam'it-terbijet'il-arabijjete'il-islamijjete, Riad: Mekteb'ut-terbijet'il-arabijju liduvel'il-halixhi, 1988-1989.
236. Melkavi, Fet'hi Hasan (Redaktor). Buhuth'ul-mu'temer'it-terbevijji, Aman: El-Ma'had'ul-alemijju li'l-fikr'il-islamijji & Xhem'ijet'ud-dirasati ve'l-buhuth'il-islamijjeh, 1990.
237. Melkavi, Fet'hi Hasan. El-Bina'ul-fikriju: mefhumuhu ve mustevejatu-hu ve haraituhu (Formimi mendor: konceptet dhe nivelet), Aman: El-Ma'had'ul-alemijju li'l-fikr'il-islamijji, bot. 2, 2018.
238. Melkavi, Fet'hi Hasan. El-Bina'ul-fikriju: mefhumuhu ve mustevejatu-hu ve haraituhu (Formimi mendor: konceptet dhe nivelet), Hendon: El-Ma'had'ul-alemijju li'l-fikr'il-islamijji, 2015.
239. Melkavi, Fet'hi Hasan. "Et-Tehajuzi fi'l-fikr'it-terbevijj'il-garbijji" (Njëanshmëria në mendimin pedagogjik perëndimor), Revista Islamijjet'ul-ma'rifete, nr. 37-38, Verë & Vjeshtë 2004.

240. Melkavi, Fet'hi Hasan. Et-Turath'ut-terbevijj'ul-islamiju: halet'ul-bahthi fihi, ve lemehatun min tetavvurihi ve kutufun min nususihi ve medarisi, Herndon: El-Ma'had'ul-alemijju li'l-fikr'il-islamijji, (1439 h./2018).
241. Melkavi, Fet'hi Hasan (Redaktor). Esh-Shejh Muhamed Tahir ibn Ashur ve kadaja'l-islahi ve t-texhdidi fi'l-fikr'il-islamijj'il-muasir: ru'jetun ma'rifijjetun ve menhexhijjetun, Herndon & Virxhinia: El-Ma'had'ul-alemijju li'l-fikr'il-islamijji, 2011.
242. Melkavi, Fet'hi Hasan. "Es-Sirau ala merxheijet'il-kijemi fi'l-alem'il-muasiri", kumtesë e paraqitur në: Konferencën e katërt të Qendrës për Studime të Sheriatit Islam dhe Etikës, Universiteti Hamed ibn Halife, Doha, Katar, 2-3 prill 2016.
243. Melkavi, Fet'hi Hasan. Meshruatun bahthijetun fi't-turath'it-terbevijj'ul-islami (Projekte hulumtuese në trashëgiminë pedagogjike islame), Herndon: El-Ma'had'ul-alemijju li'l-fikr'il-islamijji, 2018.
244. Melkavi, Fet'hi Hasan. Mendhume'tul-kijem'ul-ulja: et-tevhidu ve't-tezkijjetu ve'l-umranu (Sistemi i vlerave të larta: unifikimi, edukimi dhe përparimi), Herndon: El-Ma'had'ul-alemijju li'l-fikr'il-islamijji, bot. 2, 2016.
245. Melkavi, Fet'hi Hasan. Menhexhijet'ut-tekamul'ul-ma'rifi (Metodologjia e përplotësimit njohës), Herndon: El-Ma'had'ul-alemijju li'l-fikr'il-islamijji, bot. 2, 2016.
246. El-Menavi, Muhamed Abdurauf. Fejd'ul-Kadiri sherhul Xhami'is-Sagiri min ehadith'il-beshirin nedhir të Hafidh Xhelaludin Es-Sujuti, Bejrut: Dar'ul-Ma'rifeti, bot. 2, 1972.
247. El-Munadhametu arabijju li't-terbijjeti ve'th-thekafeti ve'l-ulumi (ALESCO). El-Fikr'ut-Terbevijj'ul-arabijj'ul-islamijju: El-Ussulu ve'l-Mebadiu (Mendimi pedagogjik arab islam: Bazat dhe parimet), Tunizi: ALESCO, 1987.
248. Ibn Mendhur, Ebul Fadl Xhemaludin Muhamed ibn Mukrim (vd. 711 h./1311). Lisan'ul-Arabi, Bejrut: Daru Sadir (15 vëllime), vëllimi 8, 2003.
249. Mihdad, Ez-Zubejr. "Es-Sultan Sejidi Muhamed ibn Abdullah El-Alevi Raid islah'it-ta'limi bixhami'il-karavijine", Revista Da'vet'ul-hakki, Ministria e Vakëfit dhe Çështjeve Islame në Marok, nr. 367, maj-qershor 2002.
250. El-Mevdudi, Ebu'l-A'la, Nahnu ve'l-hadaret'ul-garbijjetu, Damask: Dar'ul-Fikri, bot. 1, 1964.
251. Muesseset'ul-fikr'il-arabiji. El-Ibtikaru evi'l-inditharu: El-Bahth'ul-ilmijj'ul-arabijju: vakiuhu ve tehadijatuhu ve afakuhu. Raporti i dhjetë arab për zhvillim kulturor të vitit 2018, Bejrut: Muesseset'ul-fikr'il-arabiji, 2018.
252. Nasir, Muhamed. Fi'l-Fikr'it-terbevijj'ul-arabijj'ul-islamijji, Kuvajt: Ve-kalet'ul-Metbuati, 1977.

253. Ibn Nebi, Malik. Teemulat, Damask: Dar'ul-Fikr, 2002.
254. Ibn Nebi, Malik. Mushkilet'ul-efkari fi'l-alem'il-islamijji, Përkthyes: Besam Berekeh & Ahmed Sha'bo, Bejrut & Damask: Dar'ul-Fikr'il-Muasir & Dar'ul-Fikr, 2002.
255. Nexhati, Muhamed Uthman. El-Hadith'un-Nebevijju ve ilm'un-nefsi (Hadithi pejgamberik dhe psikologjia), Kajro: Dar'ush-Shuruk, bot. 5, 2005.
256. En-Nexhadi, Fadil Abbas Ali. Adab'ul-alimi ve'l-muteal-limi fi't-turath'il-arabij'ul-islami (Rregullat e mësuesit dhe nxënësit në trashëgiminë arabe dhe islame), Damask: Dar'ul-Kalem, 2012.
257. En-Nexhar, Zaglul Ragib. Aja't'ul-kevni fi'l-Kur'an'il-Kerim, Përkthyes: Nadija El Ivedi.
258. En-Nisai, Ebu Abdurrahman Ahmed ibn Shuajb ibn Ali En-Nisai (vd. 303 h./916). Sunen'un-Nisai, Riad: Bejt'ul-efkar'id-devlijjeti, bot. 1, 1999.
259. En-Nuajmi, Abdulkadir Muhamed Ed-Dimeshki. Ed-Darisu fi tarih'il-medarisi, Bejrut: Dar'ul-kutub'il-ilmijeti, bot. 1, 1990.
260. En-Nekib, Abdurrahman (përgatitje dhe redaktur). Delilu mustehlesati resail'il-xhami'ijeti fi't-terbijjet'il-islamijjeti bi'l-xhamiat'il-misrijeti ve's-suudijeti (Katalogu i abstrakteve të temave universitare në Pedagogjinë islame në Universitetet e Egjiptit dhe Saudisë), Herndon: El Ma'hedul alemiju lil fikril islamiji, 1994.
261. Nuruddin, Abdulhalim. Et-Terbijjetu ve't-ta'limu fi Misre'l-kadimeti, Biblioteka digjitale e Aleksandrisë.
262. Nitche, Fridrih. Hakedha tekel-leme Zeradisht, Përkthyes: Filiks Faris, Bejrut: Dar'ul-Kalem, (pa vit botimi).
263. El-Hejthemi, Nurudin ibn Ebu Bekr (vd. 807 h./1405). Mexhme'uz-zevaiddi ve menbe'ul-fevaiddi, Damask: Dar'ul-Me'muni li't-turathi, 1991.
264. El-Vakidi, Ebu Abdullah Muhamed ibn Omer ibn Vakidi (vd. 207 h./822). Kitab'ul-Megazi, Bejrut: Alemu kutubi, (pa vit botimi).
265. Ministria e Edukatës dhe Arsimit e Omanit. Felsefet'ut-ta'limi fi sultanati Oman, Maskut: Mexhli's'ut-ta'limi në Oman, bot. 1, 2017.
266. El-Vekili, Muhamed. Fikh'ul-Evlevijjati: dirasetun fi'd-Davabiti (Fikhu i prioriteteve: studim rreth kriterëve), Herndon: El-Ma'had'ul-alemiju li'l-fikr'il-islamiji, 1997.
267. El-Vensherisi, Ebu'l-Abas Ahmed ibn Jahja (vd. 914 h./1508). El-Mi'jar'ul-mu'rebi ve'l-xhami'ul-mugrebi an fetava ehli Ifrikija ve'l-Endelusi ve'l-Magrib, Ribat: Ministria e Vakufit dhe çështjeve islame në Marok, 1981.
268. El-Jusi, Ebu'l-Mevahibi El-Hasan ibn Mesud (vd. 1105 h./1694). El-Kanunu fi ahkam'il-ilmi ve ahkam'il-alimi ve ahkam'il-mutealimi, Ribat: El Muhakkik, 1998.

269. UNESCO. Iadetut tefkiri fit terbijeti vet ta'limi: nehve salihin mushterekin alemijin, Paris: UNESCO, 2015.
270. UNESCO. Et-Teal-lumu dhake'l-kenz'ul-meknun, Raporti i Komisionit Ndërkombëtarë në UNESCO e angazhuar për arsimin në shekullin XXI "Raporti i Delorit", Paris, UNESCO, 1996.

### Literatura në gjuhë joarabe

1. Aguilar, Elena. *Teacher Collaboration: When Belief Systems Collide*, California: Edutopia (George Lucas Educational Foundation), Pulished March, 22, 2016.
2. Ahmad, Mumtaz. & Nelson, Natthew. *Islamic Education in Bangladesh and Pakistan. Trends in Tertiary Institutions*, Washington: National Bureau of Asian Research 2009.
3. Albernaz, Ami. "Study: Close grandparent-grandchild relationships have healthy benefits", *Globe Correspondent*, Dec. 14, 2015.
4. Altbach, Philip G. & Reisberg, Liz. & Rumbley, Laura E. *Trends in Global Higher Education: Tracking an Academic Revolution*, A Report Prepared for the 2009 World Conference on Higher Education, Paris: UNESCO, 2009.
5. Altbach, Philip G. & Reisberg, Liz. & Rumbley, Laura E. *Trends in Global Higher Education: Tracking an Academic Revolution*, A Report Prepared for the 2009 World Conference on Higher Education, Paris: UNESCO, 2009.
6. Anfara, Vincent. & Mertz, Norma (Eidors). *Theoretical Frameworks in Qualitative Research*, Los Angeles and London: Sage Publication, Inc. 2015.
7. Appleton, lilla Estella. *A Comparative Study of the Play Activities of Adult Savages and Civilized Children; An Investigation of the Scientific Basis of Education*, Victoria, Australia: Leopold Classic Library, 2017.
8. Ashmore, Malcolm. "Farud in Research", *The Sage Encyclopedia Social Science Research Methods*, edited by Michael S. Lewis-Beck and others, London: Sage Publication, 2004.
9. Ashraf, Sayed Ali. "Islamic Education: Recommendations and Implementation of the Five Conferences on Islamic Education".
10. Aubrey, Karl. & Riley, Alison. *Understanding and Using Educational Theories*, London: Sage Publications Ltd, 2nd Edition, 2019.
11. Baron, Jonathan. *Thinking and Deciding*, London & New York: Cambridge University Press, 2007.
12. Bergen, P. & Pandey, S. The Madrassa myth, *New York Times*, 14 June 2005.
13. Bergen, P. & Pandey, S. *The Madrassa Scapegoat*, Washington Quarterly, 29, 2006.

14. Berger, Warren. *A More Beautiful Question: The Power of Inquiry to Spark Breakthrough Ideas*, London: Bloomsbury Publishing, 2016.
15. Berger, Warren. *The Book of Beautiful Questions*, London: Bloomsbury Publishing 2018.
16. Bhargava, Rajeev. *State, religious diversity and the crisis of secularism*, Open Democracy: free thinking for the world, 22 march 2011.
17. Blankinship, Khalid. *Islam and World History: Towards a New Periodization*, The American Journal of Islamic Social Science, Vol. 8, No. 3, 1991. 628
18. Bradford, Lisa. "Fraudulent and Misleading Data by Lisa Bradford" in: *The sage Encyclopedia of Educational Research measurement and Evaluation* Edited by Bruce Frey, Teller Road: SAGE Publications Inc., 2018.
19. Bradley, Cook. & Malkawi, Fathi (Editors). *Classical Foundations of Islamic Educational Thought: A Compendium of Parallel English-Arabic Texts*, Islamic Translation Series, Provo, UT.: Brigham Young University, (February 15, 2011).
20. Buang, Sa'eda & Chew, Phyllis G. (Eds). *Muslim Education in the 21st Century*, Asian Perspectives, New York: Routledge, 2014.
21. Cahen, Didier. "Derrida and the question of education: a new space for philosophy" in Biesta, Gert J.H. & Egea-Kuehne, denise (Editors) *Derrida & Education*, London, UK; Routledge International Studies in the Philosophy of Education, 2001.
22. Cahn, Steven M. *Philosophical Foundations of Education*, New York: Harpercollins College Div, (June 1970).
23. Calhoun, Craig. & Juergensmeyer, Mark. & BanAntwerpan, Jonathan. (Editors). *Rethinking Secularism*, London: Oxford University Press, 1 edition, August 12, 2011.
24. Calogiannakis, Pella. & Papadakis, Nikos. & Ifanti, Amalia (Editors). *Crisis in Education: Socio- Economic, Political and Cultural challenges*, Nicosia, Cyprus: HM Studies. 2015.
25. Caputo, J. D. (Editor) *Deconstructing in a Nutshell. A Conversation with Jacques Derrida*, New York: Fordham University Press, 1997.
26. Click, Thomas. & Livesey, Steven & Wallis, Faith (Eds). *Medieval Science, Technology and Medicine: An Encyclopedia*, New York and London: Routledge, 2005.
27. Coombs, Phillip H. *The World Crisis in Education: The view from the Eighties*, New York and Oxford: Oxford University Press, 1985.
28. Coombs, Phillip H. *The World Educational Crisis: A Analysis System*, New York and Oxford: Oxford University Press, 1968.
29. Costa, Arthur. & Garmston, Robet. *Cognitive Coaching: Developing Self-Directed Leaders and Learners*, 3rd Edition, Maryland: Rowman & Littlefield Publishers 2015.

30. Cox, Harvey. *The Market as God*, Cambridge, MA: Harvard University Press, 2016.
31. Craig, Edward (Editor). *Concise Routledge Encyclopedia of Philosophy*. London and New York: Routledge, 2000.
32. Crilly, Rhys. International Relations in the Age of 'Post-Truth' Politics, *International Affairs*, Volume 94, Issue 2, 1 March 2018.
33. DALIN, PER. Developing the Twenty-First Century School: A Challenge to Reformers in: David, Hopkins (Ed.). *The Practice and Theory of School Improvement. (Handbook of Educational Change)* Dordrecht The Netherlands: Springer Academic Publishers, 2005.
34. Davidson, C.N. & Goldberg, D. T. *The Future of Learning Institutions in the Digital Age*, Cambridge, MA: MIT Press (MacArthur Foundation Report on digital Media and Learning). 2010.
35. Davis, Derek. & Miroschnikova, Elena (Editors). *The Routledge International Handbook of Religious Education*, London: Routledge, 2013.
36. Deardorff, Darla K. & Smith, Lily A. Arasaratnam (Editors). *Intercultural Competence in Higher Education: International Approaches, Assessment and Application, Internationalization in Higher Education Series*, London and New York: Routledge, 1 edition, 2017.
37. Dev, Kapil. "Youth and moral values in a changing society", *International Journal of Advanced Research and Development*, Issue 4; July 2017.
38. Douglas, Susan. *Muslims in our Community and Around the World: A Supplementary Social Studies*. Herndon VA: International Institute of Islamic Thought and Dubuque, Iowa: Kendall/ Hunt Publication Co. 1995.
39. Egea-Kuehne, Denise and Biesta, Get J. J. *Derrida and Education*, Op.Cit.
40. El-Moslimany, Ann. *Teaching Children: A Moral, Spiritual, and Holistic Approach to Educational Development*, Herndon, VA: International Institute of Islamic Thought (January 1, 2018).
41. Enfield, Nick. "We are in a post-turth world with eroding trust and accountability. It can't end well", *The Gurdian*, Thursday 16 Nov. 2017.
42. Engebreston, Kathleen. & De Souza, Marian. & Durka, Gloria. & Gearon, Liam (Editors). *International Handbook of Inter-religious Education*, London & New York: Springer, 2010.
43. Etherington, Matthew. Values Education: Why The Teaching Of Values In Schools Is Necessary, But Not Sufficient, *Journal Of Research On Christian Education*, 2013.
44. Eyler, Joshua. *How Humans Learn: the Science and Stories behind Effective Colledge Teaching*, Teaching and learning in Higher Education, Morgantown, WVA: West Virginia University Press, October 2018.
45. Faure, Edgar. *Learning to be: The world of education today and tomorrow*, Paris: Unesco, (First edition was in 1972), Seventh impression, August 1982.

46. Faure, Edgar. *Learning to be: The world of education today and tomorrow*, Paris: Unesco, (First edition was in 1972), Seventh impression, August 1982.
47. Francois, Emmanuel Jean. "Education and Society", In: *Building Global Education with a Local Perspective*, New York: Palgrave Macmillan 2015.
48. Freire, Paulo. & Shor, Ira. *A Pedagogy for Liberation: Dialogues on Transforming Education*, Bergin & Garvey Pub, Inc. 1987.
49. Gage, N. L. *The Scientific Basis of the Art of Teaching*. New York: Teacher College Press, Columbia University, 1977.
50. Garmston. Robert J. *Astonishing Power of Storytelling: Leading, Teaching and Transforming in a New Way*. Thousand Oaks: Cal. Corwin and London: Sage Company, 2019. 629
51. Goodman, Paul. *Compulsory Miseducation*, Harmandsworth & New York: Penguin Education specials, 1964.
52. Grodeman, Robert. & Thompson, Julie. & Pacheco, Roberto (Editors), *The Oxford Handbook of Interdisciplinarity (Oxford Handbooks)*, London: Oxford University Press, 2 edition, (March 26, 2017).
53. Hargreaves, Andy. & Lieberman, Ann & Fullan, Michael. & Hopkins, David. *Second International Handbook of Educational Change*, (Springer International Handbooks of Education), Dordrecht Heidelberg London New York: Springer Science+Business Media B.V, 2010.
54. Hargreaves, Andy. & Lieberman, Ann. & Fullan, Michael. & Hopkins, David. *International Handbook of Educational Change*, (2 Volumes), London: Kluwer Academic Publishers, Springer, 1998.
55. Hargreaves, Andy. & Lieberman, Ann. & Fullan, Michael. & Hopkins, David. *Second International Handbook of Educational Change* (Springer International Handbooks of Education), Dordrecht Heidelberg London New York: Springer Science+Business Media B.V., 2010.
56. Harland, Tony & Pichering, Neil. *Values in Higher Education Teaching* New York: Routledge, 2011.
57. Hattie, John. "The Burt Controversy: An essay review of Harnshaw's and Joynson's Biographies and Sir Cyril Burt". *Alberta Journal of Educational Research*, 37 (3).
58. Herrick, Jim. *Humanism: An Introduction*. Amherst and New York: Prometheus Books, 2005.
59. Hirsch, Eric Donald. *Why Knowledge Matters: Rescuing our Children from Failed Educational Theories*, Cambridge, Mas: Harvard Education Press, 2016.
60. Hook, Sidney. The Scope of philosophy of education, In: Lucas, Christopher L. (Editor). *What is Philosophy of Education?* New York: Collier Macmillan Ltd, 1969.



61. Illich, Ivan. *Deschooling Society*. London: Penguin Education/ Penguin Books, 1973.
62. Kerr, Clark. The Internationalisation of Learning and the nationalization of the purpose of Higher Education: two 'laws of motion' in conflict, *European Journal of Education*, Vol. 25, No. 1, 1990.
63. Kettell, Steven. Secularism and Religion, Oxford Research Encyclopedias (Politics), Online Publication, Jan 2019.
64. Kim, Hyejin | Mobrand, Erik. Stealth Marketization: How International School Policy is Quietly Challenging Education Systems in Asia, *Globalization, Societies and Education*, Online Journal, Published online, 25 Jan 2019.
65. Kirby, Alan. *Digimodernism: How New Technologies Dismantle the Postmodern and Reconfigure Our Culture*, London & New York: Bloomsbury Academic, 1 edition, 2009.
66. Kreber, Carolin. Different Perspectives on Internationalization in Higher Education, *New Directions for Teaching and Learning*, Volume 2009, Issue 118, Summer 2009.
67. Krishanan, Armin. *What are Academic Discipline? Some Observation on the Disciplinarity vs. Interdisciplinarity debate*, Southampton: University of Southampton, National Center for Research Methods, Working Paper Series no. 03/09, January 2009.
68. Kuhn, Michael (Ed.). *New Society Models for a New Millennium: The Learning Society in Europe and Beyond*, New York: Peter LANG, 2007.
69. Kurtz, Paul. *Humanist Manifesto 2000: a Call for A New Planetary Humanism*, Amherst: NY: Prometheus books, 2000.
70. Kuusisto, Arniika. & Lovat, Terry (Editors). *Contemporary Challenges for Religious and Spiritual Education*, London and New York: Routledge, 2018.
71. Mackson, Alecia. & Mazzei, Lisa. *Thinking with Theory in Qualitative Research: Viewing Data across Multiple Perspectives*, London and New York: Routledge 2011.
72. Malachowski, Alan (Editor). *The Cambridge Companion to Pragmatism*, New York: Cambridge University Press, 2013.
73. McCallum, Dennis. *Comparing Modernist and Postmodern Educational Theory*
74. McGrath, Simon. & Gu Qing. *Routledge Handbook of International Education and Development*, London and New York: Routledge, 1 edition, 2017.
75. McNergney, Robert & Herbert, Joanne. *Foundations of Education: The Challenge of Professional Practice*. Third Edition. Boston: Allyn & Bacon, 2001.

76. McNergney, Robert. & Herbert, Hoanne. *Foundation of Education: the Challenge of Professional Practicem*, Boston: Allyn and Bacon, Third Edition, 2001.
77. Miller, Joyce. Education and Learning: A Buddhist Perspective, *Journal of the National Association of Teachers of Religious Education*, 29: 3, Summer 2007.
78. Monroe, Paul. *A Text-Book in the History of Education*, New York: The Macmillan Company, 1906.
79. Moore, Terence W. *Educational Theory: An Introduction*, Abingdon: Routledge Library Editions/ Education, 2012 Edition (first published 1974).
80. Moosa, Ibrahim. *What is a Madrasa?* The University of North Carolina Press, 2015.
81. Newsome, George. "Some Propositions Concerning the Teaching of Educational Philosophy", in the Proceeding of the Twenty-First Annual Meeting of Philosophy of Education Society, 1965.
82. Noddings, Nel. *Philosophy of Education*, Fourth Edition, New York and London: Routledge, 2016.
83. Oman, Charles. *The Dark Ages (Quintessential Classics)*, Scotts Valley, California: CreateSpace, 2015. 631 66. Kreber, Carolin. Different Perspectives on Internationalization in Higher Education, *New Directions for Teaching and Learning*, Volume 2009, Issue 118, Summer 2009.
84. Parker, Stuart. *Reflective Teaching In The Postmodern World: A Manifesto of Education in Postmodernity*, Buckingham: Open University Press, 1997.
85. Peled, Elad. Isareli Education in: *Comparative educational systems Ignas*, Edward and Corsini, Raymond, (Editors) Chicago Ill.: Reacock Publishers, 1981.
86. Peters, Michael A. The Humanist Bias in Western Philosophy and Education. *Educational Philosophy and Theory*, Vol. 47, Issue. 11, 2015.
87. Peters, Michael A. The Humanist Bias in Western Philosophy and Education, *Educational Philosophy and Theory*, Vol. 47, Iss. 11, 2015.
88. Phillips, Denis Charles & Burbules, Nocholas C. *Postpositivism and Educational Research*, New York and Oxford: Rowman & Littlefield Publ. Inc., 2000.
89. Piotrowski, Chris. "Emerging Research on Social Media Use in Education: A Study of Dissertations", *Research in Higher Education Journal*, Volume 27, Jan. 2015.
90. Qiang, Zha. Internationalization of Higher Education: towards a conceptual framework, *Policy Futures in Education*, Volume 1, Number 2, 2003.
91. Rahman, Fadhlu. *Major Themes of the Qur'an, With a new Forword by Ebrahim Musa*, Chicago: University of Chicago Press, 2009.

92. Ridgway, Jim. Cyril, & Lodovic Burt. *The Routledge Encyclopedia of Educational Thinkers*, Joy A. Palmer Cooper, (Ed.) London and New York: Routledge Taylor & Francis Group. First published 2016.
93. Rima, Samuel D. *Spiritual Capital: Spirituality in Practice in Christian Perspective (Transformation and Innovation)*, New York: Penguin Books, 2016.
94. Robinson, Ken. & Aronica, Lou. *Creative Schools: the Grassroots Revolution that's Transforming Education*, New York: Penguin Books, 2016.
95. Rueff, Walter. *Themes*. In: *A History of the University: volume 1 Universities of the Middle Ages*, Edited by H. De Ridder-Symoens, Cambridge: UK. Cambridge University Press, Paperback Edition, 2003.
96. Salleh, Muhammad Syukri. "Strategizing Islamic Education", *International Journal of Education and Research*, Vol 1, No. 6, June 2013.
97. Schiro, Michael Stephen. *Curriculum Theory: Conflicting Visions and Enduring Concerns*, 2nd Edition, Volume 2, New York: SAGE Publications, Inc; 2<sup>nd</sup> edition (April 24, 2013).
98. Siegel, Harvey (Editor). *The Oxford Handbook of Philosophy of Education*, London: Oxford University Press, 1 edition, 2012.
99. Singh, Divya & Stuckerlberger, Christoph (editors). *Ethics in Higher Education: Values-driven Leaders for the Future*. Geneva, Switzerland: Globethics. 2017.
100. Sire, James W. *The Universe Next Door*, Downers Grove, Illinois: IVP Academic, 5th. Edition, 2009.
101. Skinner, B. F. *Science and Human Behavior*, New York: Pearson Education Inc., First published, 1953, reprint 2000.
102. Smith, Sue Erica. *Buddhist Voices in School, How a Community Created a Buddhist Education Program for State Schools*, Rotterdam: SensePublishers, 2013.
103. Snauwaert, Dale T. The Importance of Philosophy for Education in a Democratic Society, *Journal of Peace Education and Social Justice*, Volume 6 No. 2, 2012.
104. Sring, Joel. *Golbalization of Education: An Introduction*. New York: Routledge, 2015.
105. Srisa-an, Wichit. Global Education for Asia in the Twenty-first Century, *Asia-Pacific Journal of Cooperative Education*, Volume 3, No.1, 2002.
106. Srivastava, Prem Shankar. *Spiritual Education in Tagore Philosophy*, *Scholarly Research Journal for Humanity Science and English Language*, An International Peer reviewed and Referred, VolII, Issue VII, Dec-Jan, 2015.
107. Stark. Rodney. *How the West Won: The Neglected Story of the Triumph of Modernity*. Wilmington, DE: Intercollegiate Studies Institute, 2015.

108. Storch, Tanya. *Buddhist-Based Universities in the United States: Searching for a New Model in Higher Education*, Lanham MD: Lexington Books, 2015.
109. Storer, Morris B. (Editor). *Humanist Ethics*, New York: Prometheus Books (August 1, 1979)
110. Strick, Simon. "Structuralism/Deconstruction" in Antje Dallmann Eva Boesenbery and Martin Klepper (Editors) *Approaches to American Cultural Studies*. London: Routledge □ □□ edition, 2016.
111. Subotnik, Rena & Walberg, Herbert. *The Scientific Basis of Education Productivity*, Research in Educational Productivity, Charlotte, North Carolina: Information Age Publishing, 2006.
112. Taneri, Pervin Oya. & Gao, Jie. & Johnson, Rodger. "Reasons for the Deterioration of Moral Values: Cross-Cultural Comparative Analysis", Boston, USA: *The 2016 WEI International Academic Conference Proceedings*, 2016.
113. *The Chronicle of Higher Education*, Special Report, January 11, 2017.
114. Traxler, John. Modernity, mobility and the digital divides, Paper presented at the 15th International Conference of the Association for Learning Technology at University of Leeds, England, with a theme: Rethinking the digital divide, Leeds, UK, 9-11 September 2008.
115. UNESCO. *World Declaration on Higher Education for the Twenty-First Century: Vision and Action*. Paris: UNESCO, 1998.
116. Usturali, Adil. *A Conceptual Analysis of Secularism and Its Legitimacy in the Constitutional Democratic State*, Policy Brief Series, Fox International Fellowship, 2015. 633 101. Skinner, B. F. *Science and Human Behavior*, New York: Pearson Education Inc., First published, 1953, reprint 2000.
117. Warnk, Holger. "Alternative Education or Teaching Radicalism? New literature on Islamic Education in Southeast Asia", in: *Journal of Current Southeast Asian Affairs*, 28, 4.
118. Winter, Paul. *On the Trial of Jesus*, 2nd Ed. Revised and Edited by T. A. Burkill and Geza Vermes, Berlin and New York: Walter De. Gruyter, 1974.
119. Wit, Hans De. & Caceres-Avila, Jocelyne. & Jones, Elspeth. & Jooste, Nico. (Editors). *The Globalization of Internationalization: Emerging Voices and Perspectives*, Internationalization in Higher Education Series, London and New York: Routledge, 1 edition, 2017.
120. Yussen, Steve. The publication Gap: Western Bias, *Educational Psychology Journal*, College of Education and Human Development (CE-HD VISION 2020 BLOG), Posted Apr 22, 2016.

1. DOI: 10.1080/14767724.2019.1571405.
2. <http://dhchenfoundation.com/initiatives/inspired-research-project-on-spiritual-education-hkier-cuhk>
3. <http://dictionary.cambridge.org/dictionary/english/ghetto>
4. <http://documents.worldbank.org/curated/en/483221468147581570/Making-schools-work-newevidence-on-accountability-reforms>
5. <http://educatedcompanion.com/study-close-grandparent-grandchild-relationships-have-healthybenefits-2>
6. <http://files.eric.ed.gov/fulltext/EJ1056186.pdf>
7. <http://khayma.com/alhkikh/Yhood/08.htm>
8. <http://tiny.cc/osws6y>
9. <http://tiny.cc/tmws6y>
10. <http://www.alecso.org/newsite/2016-02-02-13-47-43/2114-2018-09-07-11-52-52.html>
11. <http://www.biblestudytools.com/dictionary/gentiles/>
12. <http://www.campuscorner.com/religious-affiliations/jewish-colleges.htm>
13. <http://www.moe.gov.jo/ar/node/15782>
14. <http://www.palestinapedia.net/%D8%A7%D9%84%D9%81%D8%A7%D8%AA%D9%8A%D9%83%D8%A7%D9%86+>
15. <http://www.secularhumanism.org/index.php/13>
16. <http://www.tandfonline.com/doi/abs/10.1080/00131857.2014.991497>
17. <https://ar.actualitix.com/country/afg/ar-statistics-education-afghanistan.php>
18. <https://arabic.rt.com/news/629921>
19. <https://cehdvision2020.umn.edu/blog/western-bias-educational-psychology/>, retrieved Sept. 2, 2017–.
20. <https://elaph.com/Web/News/2017/10/1174739.html>
21. [https://en.wikipedia.org/wiki/Catholic\\_university](https://en.wikipedia.org/wiki/Catholic_university)
22. [https://en.wikipedia.org/wiki/List\\_of\\_Roman\\_Catholic\\_seminaries](https://en.wikipedia.org/wiki/List_of_Roman_Catholic_seminaries)
23. <https://foxfellowship.yale.edu/sites/default/files/files/Adil%20Ustrulai%20%20PolicyBrief.pdf>
24. <https://glasgowguardian.co.uk/2016/09/21/western-bias-in-education/>
25. <https://nation.com.pk/08-Feb-2018/literacy-rate-in-pakistan>
26. <https://oxfordre.com/politics/view/10.1093/acrefore/9780190228637.001.0001/acrefore-9780190228637-e-898>.
27. <https://sqi.co/about-3q-institute>
28. <https://theconversation.com/englands-school-system-is-in-crisis-could-labours-national-educationservice-be-the-solution-111555>
29. <https://www.aahlaldeeth.com/vb/showthread.php?t=98045>

30. <https://www.amazon.com/Book-Beautiful-Questions-Powerful-Connect/dp/163286956X>
31. <https://www.amazon.com/Market-as-God-Harvey-Cox/dp/0674659686>
32. [https://www.bibalex.org/archeology/attachments/ArcheologicalCulturalSeason/files/20101219\\_12363866625.pdf](https://www.bibalex.org/archeology/attachments/ArcheologicalCulturalSeason/files/20101219_12363866625.pdf)
33. <https://www.britannica.com/topic/deconstruction>
34. <https://www.britannica.com/topic/Western-philosophy/Modern-philosophy#ref365981>
35. <https://www.chronicle.com/specialreport/The-Post-Truth-Issue/84>
36. <https://www.chronicle.com/specialreport/The-Post-Truth-Issue/84>
37. <https://www.edutopia.org/blog/educational-beliefs-collide-teachers-elena-aguilar>
38. <https://www.goconqr.com/en/blog/the-importance-of-teaching-values-in-education>
39. <https://www.gospelway.com/religiousgroups/humanism.php>
40. <https://www.opendemocracy.net/en/states-religious-diversity-and-crisis-of-secularism-0>
41. <https://www.paldf.net/forum/showthread.php?t=6248>
42. [https://www.researchgate.net/publication/306088626\\_Inclusion\\_in\\_an\\_age\\_of\\_mobility](https://www.researchgate.net/publication/306088626_Inclusion_in_an_age_of_mobility) [accessed Sep 2, 2017].
43. <https://www.secularism.org.uk/what-is-secularism.html>
44. <https://www.svhe.org>
45. <https://www.theguardian.com/education/2019/apr/18/english-schools-will-see-super-sized-classeswarns-teachers-union>
46. <https://www.westeastinstitute.com/wp-content/uploads/2016/09/P.-O.-Taneri-J.-Gao-R.-Johnson.pdf>.
47. <https://www.worldbank.org/en/news/immersive-story/2019/01/22/pass-or-fail-how-can-the-world-do-its-homework>, 635 20. <https://elaph.com/Web/News/2017/10/1174739.html>
48. <https://www.xenos.org/essays/comparing-modernist-and-postmodern-educational-theory>.
49. <https://books.google.jo/books?id=sZw96Leb7wIC&printsec=frontcover&dq=inauthor:%22Tereference+W.+Moore%22&hl=en&sa=X&ved=0ahUKEWjO9sPQ5vHUAhUEthQKHRVUAkcQ6AEIKDAB#v=onepage&q&f=false>
50. <http://www.unesco.org/iau/iau-mission.html>.
51. <http://www.globethics.net>.



Shënimi i katalogut CIP të këtij libri ndodhet në Bibliotekën Kombëtare Universitare  
"Shën Kliment Ohridski", Shkup  
CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

**[www.logos-a.com](http://www.logos-a.com)**

Copyright©Logos-A, 2023



LOGOS·A





MENDIMI ISLAM



LOGOS-A



Shumica e mendimit arsimor mbizotërues dhe praktikave arsimore edukative bashkëkohore në shoqëritë arabe dhe muslimane janë jehonë e pastër e përvojës arsimore që lindi dhe u zhvillua, dhe është ende në zhvillim, larg pranisë së vizionit islam. Kjo kërkon realizimin e këtij vizioni në analizën kritike të këtyre përvojave dhe dallimin e asaj që është e përshtatshme për shoqëritë islame dhe që kontribuon në pasurimin dhe racionalizimin e qytetërimit bashkëkohor.

Ky është realiteti në të cilin ky libër është përpjekur të kontribuojë për të trajtuar, duke adoptuar metodologjinë e integritit kognitiv në ndërtimin e një platforme të mendimit arsimor edukativ bashkëkohor islam, në: konceptet, burimet, karakteristikat, temat, problemet dhe mënyrat e reformimit të tij.

Me këtë libër autori pretendon t'i lidhë fijet e shkëputura gjatë historisë për të ndërtuar një të ardhme solide. Në tërë këtë, autori nuk e mohon pjesën tjetër të botës, përvojat dhe arritjet e tyre, duke i analizuar, vlerësuar dhe përdorur ato që mund të jenë të nevojshme për brezat e rinj muslimanë.

Dr. Fet'hi Hasan Melkavi (1943, Jordani) është një dijetar, pedagog, psikolog, filozof, etik, teolog i rrallë në botën bashkëkohore muslimane dhe në përgjithësi. I kreu të gjitha nivelet e shkollimit zyrtar në vend dhe jashtë. Veprimi në vende të ndryshme duke lënë gjurmë të dukshme në kohën e tij dhe për brezat e ardhshëm. Ai punoi në arsimin publik si mësues, mbikëqyrës arsimor dhe pjesëmarrës në hartimin e kurrikulave dhe hartimin e teksteve shkollore, nga viti 1966-1978. Më pas punoi në arsimin universitar nga viti 1984-1996 dhe si profesor vizitor në më shumë se 20 vende në Azi, Afrikë, Evropë dhe Amerikë. Mori pjesë në më shumë se gjashtëdhjetë konferenca me kumtesa dhe kërkime shkencore në shumë vende. Kohët e fundit punoi si drejtor rajonal për Institutin Ndërkombëtar të Mendimit Islam, kryeredaktor i Gazetës Islamike të Dijes (El-Ma'rifeh) dhe anëtar i Akademisë Jordaniene të Gjuhës Arabe. Jordanez nga lindja, botëror nga dija dhe intelektualiteti. Ai është autor dhe bashkëautor i mbi 40 librave mbi arsimin shkollor dhe universitar me tema shkencore dhe metoda kërkimore, në specialitetin e mësimdhënies së shkencës, metodave të kërkimit shkencor dhe çështjeve të mendimit islam.